LIGJI Nr. 80/2015

"PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

...dhe aktet nënligjore në zbatim të tij

Përmbledhje

- **LIGJ Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".**
- **LIGJ Nr. 93/2019 "Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik "Fulbright".**

2015

1. VKM nr. 989, datë 9.12.2015 "Për organizimin, funksionimin, kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë dhe shpërblimin e anëtarëve të këshillit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor (KALKSH)".

2016

1. VKM nr. 407, datë 01.06.2016 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 20162017".

2. VKM nr. 607, datë 31.08.2016 "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit (AKKSHI).

3. VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", i ndryshuar. (Ndryshuar me VKM nr. 450, datë 22.5.2017; nr. 697, datë 21.11.2018; nr. 39, datë 23.1.2019; nr. 755, datë 30.11.2019)

2017

4. VKM nr. 66, datë 03.02.2017 "Për përcaktimin e kritereve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare".

5. VKM nr.109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë".(Ndryshuar me VKM nr. 562, datë 31.7.2019, VKM nr. 825, datë 24.12.2021)

6. VKM nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit". (Ndryshuar me VKM nr. 698, datë 21.11.2018; nr. 779, datë 26.12.2018; nr. 40, datë 23.1.2019; nr. 251, datë27.3.202)

7. VKM nr. 329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik".

8. VKM nr. 346, datë 19.04.2017 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 20172018”.

9. VKM nr. 370, datë 26.04.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e kolegjit profesional të lartë”.

10. VKM nr. 371, datë 26.04.2017 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”.

11. VKM nr.397, datë 03.05.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).

12. VKM nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”.

13. VKM nr. 424, datë 10.05.2017 “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës së përzgjedhjes e të emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”. (Ndryshuar me VKM nr.488, datë 31.7.2018)

14. VKM nr. 450, datë 22.05.2017 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”.

15. VKM nr. 654, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të qendrës spitalore universitare “Nënë Tereza”.

16. VKM nr. 655, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të spitalit universitar obstetrik gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.

17. VKM nr. 656, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të spitalit universitar obstetrik gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë.

18. VKM nr. 657, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të spitalit universitar të traumës”.

19. VKM nr. 658, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të spitalit universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.

20. VKM nr.710, datë 01.12.2017 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022”.

2018

21. VKM nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë". (Ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr.185, datë 25.03.2021)

22. VKM nr.70, datë 07.02.2018 "Për mbylljen e veprimtarisë së shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë.

23. VKM nr.75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor". (Ndryshuar me VKM nr. 431, datë 22.06.22)

24. VKM nr. 88, datë 14.02.2018 "Për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH)".

25. VKM nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademike "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor". (Ndryshuar me VKM nr. 808, datë 11.12.2019)

26. VKM nr. 165, datë 21.03.2018 "Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë".

27. VKM nr. 216, datë 20.04.2018 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019". (Ndryshuar me VKM nr.387,datë 12.6.2019)

28. VKM nr. 229, datë 26.04.2018 "Për riorganizimin e shkollës së lartë jopublike "Marubi" në akademi të filmit dhe multimedias "Marubi" dhe dhënien e statusit të veçantë këtij institucioni të arsimit të lartë".

29. VKM nr. 288, datë 21.05.2018 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë".
(Ndryshuar me VKM nr.723, datë 6.12.2018;nr. 778, datë 26.12.2018)

30. VKM nr. 327, datë 31.05.2018 "Për një shtesë në vendimin nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike", të ndryshuar".

31. VKM nr. 483, datë 31.07.2018 "Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit të arsimit të lartë jopublik, me statusin e kolegjit profesional të lartë, "Tirana Esthetics & Style School".

32. VKM nr. 488, datë 31.07.2018 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 424, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës së përzgjedhjes e të emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare” .

33. VKM nr. 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”.

34. VKM nr. 560, datë 29.09.2018 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore”. (Ndryshuar me VKM nr. 461, datë 3.7.2019)

35. VKM nr. 562, datë 29.09.2018 “Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë”.

36. VKM nr. 697, datë 21.11.2018, “Për një shtesë në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar”.

37. VKM nr. 698, datë 21.11.2018 “Për një shtesë në vendimin nr. 269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”.

38. VKM nr. 723, datë 6.12.2018, “Për një ndryshim në vendimin nr. 288, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”.

39. VKM nr. 777, datë 26.12.2018, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”. (Ndryshuar me VKM nr. 99, datë 5.2.2020)

40. VKM nr. 778, datë 26.12.2018, “Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 288, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, të ndryshuar”.

41. VKM nr. 779, datë 26.12.2018, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar”.

42. VKM nr. 780, datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”.

43. VKM nr. 781, datë 26.12.2018, “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”.

44. VKM nr. 782, datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”.

45. VKM nr. 783, datë 26.12.2018, “Për vlerësimin e performancës në mësimdhënie të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, edhe nëpërmjet sondazhit kombëtar të studentëve”.

46. VKM nr. 784, datë 26.12.2018, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar.

2019

47. VKM nr. 39, datë 23.1.2019, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar.

48. VKM nr. 40, datë 23.1.2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar.

49. VKM nr. 124, datë 13.3.2019 "Për procedurat e transferimit të fondit grant “Për përmirësimin e kushteve në konviktet e studenteve” të Bashkisë Tiranë".

50. VKM nr. 188, datë 13.3.2019 "Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet eqeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre".

51. VKM nr. 226, datë 17.4.2019 "Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit".

52. VKM nr. 295, datë 10.5.2019 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2019–2020”. (Ndryshuar me VKM nr. 487, datë 10.7.2019; nr. 651, datë 3.10.2019)

53. VKM nr. 372, datë 29.05.2019 “Për financimin e projektit “Rikonstruksioni i godinave të studentëve në qytetet Shkodër, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastër”.

54. VKM nr. 387, datë 12.06.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 216, datë 20.04.2018, të Kshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019”.

55. VKM nr. 461 datë 03.07.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 560, datë 29.09.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore”.

56. VKM nr. 487, datë 10.7.2019, “Për një ndryshim në vendimin nr. 295, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2019–2020”.

57. VKM nr. 562 datë 31.07.2019 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 109, datë 15.02.2017, të Këshillit të Ministrave “ Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”.

58. VKM nr. 651, datë 3.10.2019 “Për disa shtesa në vendimin nr. 295, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklittë parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2019-2020””, të ndryshuar.

59. VKM nr. 755, datë 30.11.2019 “Për një shtesë në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar.

60. VKM nr. 808, datë 11.12.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor””.

61. VKM nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.

2020

62. VKM nr. 908, datë 20.11.2019 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktor për procedurën e partneritetit publik privat, për zhvillimin e projekteve: “Ndërtimi i kampusit të ri të Universitetit të Tiranës”, “Ndërtimi i godinës së Universitetit të Arteve të Tiranës” dhe “Ndërtimi i korpusit të policisë së shtetit”. (FZ nr. 7, datë 28.01.2020)

63. VKM nr. 57, datë 29.1.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë"

64. VKM nr. 99, datë 5.2.2020 ""Për disa ndryshime në vendimin nr. 777, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore"

65. VKM nr. 87, datë 31.1.2020 ""Për ngarkimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të kryejë procedurat e prokurimit, në emër të qendrave të trajtimit të studentëve në qytetet Shkodër, Vlorë dhe Korçë, për kompletimin e ambienteve të brendshme të godinave"

66. VKM nr. 156, datë 19.2.2020 ""Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe organizimin e funksionimin e saj

67. VKM nr. 160, datë 19.2.2020 Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)

68. VKM nr.251, datë 27.3.2020 Për një ndryshim në vendimin nr.269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", të ndryshuar"

69. VKM nr.331, datë 22.4.2020 "Për një shtesë në vendimin nr.649, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara", të ndryshuar

70. VKM nr. 436, datë 3.6.2020 ""Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe nëprogramet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021–2022 e në vijim (Ndryshuar me VKM nr. 46, datë 27.01.2021), (Ndryshuar me VKM nr. 363, dt 26.05.2022).

71. VKM nr. 504, datë 24.6.2020 ""Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë

72. VKM nr. 881, datë 28.10.2020 " Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së sigurisë , si insititucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimin e saj. (Ndryshuar me VKM nr.320, datë 2.6.2021)

73. VKM nr. 1163, datë 24.12.2020 “Për ngritjen e sekretariatit në kuadër të veprimtarisë së mbajtjes së sekretariatit të “Bologna Folloë Up Group” nga Republika e Shqipërisë.

2021

74. VKM nr. 46, datë 27.01.2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 436, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare, për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim””.

75. VKM nr. 145, datë 10.3.2021 "Për dhënien e statusit të veçantë universitetit të arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.

76. VKM nr. 185, datë 25.3.2021 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.

77. VKM nr.320, datë 2.6.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 881, datë 28.10.2020, të këshillit të ministrave, “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimin e saj”.

78. VKM nr. 558, datë 29.9.2021” Për disa shtesa në vendimin nr.160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “ Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (fondi i ekselencës) ”.

79. VKM nr. 661, datë 3.11.2021 “ Për përcaktimin e llojeve të qendrave/institucioneve shëndetësore, publike apo private, si dhe të kritereve që ato duhet të plotësojnë për lidhjen e marrëveshjeve me institucionet e arsimit të lartë, në fushën e shëndetësisë”.

80. VKM nr. 678, datë 10.11.2021 “Për hapjen e institucionit të Arsimit të Lartë, jopublik, Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë.

81. VKM nr. 679, datë 10.11.2021 “Për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, universiteti “ Ëestern Balkans ”.

82. VKM nr. 740, datë 03.12.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Spanjës, për bashkëpunimin e përbashkët në arsimin e lartë”

83. VKM nr.824, datë 24.12.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”. (Fletore Zyrtare nr. 3, datë 10.01.2022) http://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/12/24/824

84. VKM nr.825, datë 24.12.2021 i Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", i ndryshuar""

2022

85. VKM nr. 310, datë 11.5.2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në republikën e shqipërisë"

86. VKM nr. 363, datë 26.5.2022 "Për një shtesë në vendimin nr. 436, datë 3.6.2020, të këshillit të ministrave, "për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021–2022 e në vijim", të ndryshuar.

87. VKM nr. 386, datë 1.6.2022 "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë".

88. VKM nr. 431, datë 22.6.2022 "për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 75, datë 12.2.2018, të këshillit të ministrave, "për miratimin e modelit të financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor".

89. VKM nr. 644, datë 5.10.2022 "Për miratimin e marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e njohjes së ndërsjellë të diplomave dhe gradave shkencore, të lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të autorizuara në ballkanin perëndimor".

90. VKM Nr. 741, datë 23.11.2022 "Për përcaktimin e procedurës dhe të dokumentacionit për krijimin e institucioneve të arsimit të lartë publik të pavarur" (IALPP).

II. UDHËZIME TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

2015

1. Udhëzim nr.27, datë 19.08.2015 "Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit në raundin e parë dhe të dytë të kandidatëve fitues në ciklin e parë të studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015 - 2016".

2. Udhëzim nr.28, datë 19.08.2015 "Për kriteret dhe procedurat e pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi,

në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë.

3. Udhëzim nr.29, datë 21.08.2015 "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe regjistrimit për kandidatët me statusin e të verbrit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe Romët dhe Ballkano-Egjiptianët, në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015 - 2016".

4. Udhëzim nr.30, datë 24.08.2015 "Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 24, datë 31.07.2015 "Për zhvillimin e konkurseve të pranimit dhe tarifën e regjistrimit për konkurrim në disa programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015 - 2016".

5. Udhëzimi nr.32, datë 02.09.2015 "Për procedurën e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë, për shtetasit e huaj që kërkojnë të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2015-2016".

6. Udhëzim nr.39, datë 06.10.2015 "Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 26, datë 18.08.2015 "Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit për kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët Shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015-2016".

7. Udhëzim nr.44, datë 16.10.2015 "Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e specializimeve afatgjata, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2015-2016".

8. Udhëzim nr.46, datë 28.10.2015 "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave" / "Master i Arteve të Bukura" në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015 - 2016".

9. Udhëzim nr.47, datë 02.11.2015 "Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit për kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura" në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015-2016".

10. Udhëzim nr.48, datë 02.11.2015 "Për kriteret dhe procedurat e pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2015-2016".

11. Udhëzim nr.49, datë 02.11.2015 "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe të regjistrimit për kandidatët me statusin e ish - të dënuarit dhe të përndjekurit politik nga sistemi komunist, të verbrit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe

romët dhe ballkano-egjiptianët, për programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura", për vitin akademik 2015 – 2016".

12. Udhëzim nr.50, datë 03.11.2015 "Për zhvillimin e konkursevetë pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrim në disa programe studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave" / "Master i arteve të bukura", në Universitetin e Arteve, Tiranë, në vitin akademik 2015-2016".

13. Udhëzim nr.51, datë 01.12.2015 "Për procedurën e pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë "Master Profesional" "Master i Shkencave"/"Master i Arteve të Bukura", për shtetasit e huaj që kërkojnë të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2015-2016".

14. Udhëzim nr.52, datë 03.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë". (Ndryshuar me udhëzimin nr.11, datë 30.06.216; nr.258, datë 03.08.20016; nr.5, datë16.02.2017; nr.11, datë 10.04.2017; nr.20,datë 22.09.2017)

2016

15. Udhëzim nr.13, datë 22.07.2016 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016 – 2017 dhe viti 2017-2018". (Ndryshuar me udhëzimin nr.15, datë 01.08.2016; nr.22, datë 06.09.2016; nr.24, datë 07.10.2016; nr.17, datë 29.12.2016)

16. Udhëzim nr.15, datë 01.08.2016 " Për disa shtesa në udhëzimin nr. 13, datë 22.07.2016 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, ne institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016 – 2017".

17. Udhëzim nr.17, datë 03.08.2016 "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit". Ndryshuar me udhëzimin nr. 32, datë 29.12.2017; nr. 15, datë 16.4.2018; nr. 5, datë 21.2.2019, nr. 30, datë 30.12.2019

18. Udhëzim nr.18, datë 11.08.2016 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe kandidatëve me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, e jetimit, si dhe romët dhe egjiptianët, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017". (Ndryshuar me udhëzimin nr.2, datë 08/02/2017)

19. Udhëzim nr.22, datë 06/09/2016 "'Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 13, datë 22.7.2016, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016–2017".

20. Udhëzim nr.24, datë 07.10.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 13, datë 22.07.2016 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit te larte, në vitin akademik 2015 -2017", të ndryshuar.

21. Udhëzim nr.24/1 datë 12.10.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne udhëzimin nr. 13, date 22.07.2016 "Për procedurat e aplikimit dhe te regjistrimit ne programet e ciklit te pare te studimeve, ne programet e studimeve me karakter profesional, si dhe ne programet e integruara te studimeve te ciklit te dyte, ne institucionet e arsimit te larte, ne vitin akademik 2016 -2017", te ndryshuar.

22. Udhëzim nr.25, datë 27.10.2016 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 13, datë 22.07.2016 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016-2017".

23. Udhëzim nr.27, datë 29.12.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 13, datë 22.07.2016 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2016 -2017", të ndryshuar.

2017

24. Udhëzim nr.2, datë 08.02.2017 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 18, datë 11.8.2016, "Për procedurat e aplikimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me orgjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe kandidatëve me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe romët dhe egjiptianët në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016–2017".

25. Udhëzim nr.5, datë 16.2.2017, "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 52, datë 3.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar"".

26. Udhëzim nr.8, datë 13.03.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore".

27. Udhëzim nr.11, datë 10.4.2017, "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 52, datë 3.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar".

28. Udhëzim nr.15, datë 19.05.2017 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017 – 2018". (Ndryshuar me udhëzimin nr. 18, datë 16.08.2017, udhëzimin nr.21, datë 02.10.2017, udhëzimin nr.23, datë 16.10.2017)

29. Udhëzim nr.20, datë 22.09.2017 "Për një ndryshim në udhëzimin nr.52 datë 03.12.2015 për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar.

30. Udhëzim nr.21, datë 02.10.2017 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr.15 datë 19.05.2017 për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2017-2018", të ndryshuar.

31. Udhëzim nr.25, datë 10.11.2017 "Për regjistrimin e formave të diploma dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor". (Shfuqizuar)

32. Udhëzim nr.27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë".

33. Udhëzim nr.31, datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë". (Shfuqizuar)

34. Udhëzim nr.32, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016 "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucionet e huaja të autorizuara, jashtë vendit"".

35. Udhëzim nr.33, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr.16, datë 01.08.2016 "Për caktimin e kritereve, masës dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit e administratës shtetërore".

2018

36. Udhëzim nr.1, datë 12.02.2018 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr.25, datë 10.11.2017 "Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor".

37. Udhëzim nr.5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë".(Ndryshuar me udhëzimin nr.24, datë 21.10.2019)

38. Udhëzim nr.6, datë 19.02.2018 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit". (Ndryshuar me udhëzimin nr.15, datë 22.6.2022)

39. Udhëzim nr.7, datë 19.02.2018 "Për miratimin e elementëve dhe formës së kontratës së shërbimit ndërmjet institucionit të arsimit të lartë jopublik dhe studentit".

40. Udhëzim nr.15, datë 16.04.2018 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 17, datë 03.08.2016 "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit", i ndryshuar.

41. Udhëzim nr.18, datë 21.5.2018 "Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2018 -2019" (ndryshuar me udhëzimin nr. 22, datë 20.06.2018, udhëzimin nr. 26, datë 30.07.2018, udhëzimin nr. 31, datë 13.09.2018, udhëzimin nr. 32, datë 05.10.2018, udhëzimin nr. 33, datë 23.10.2018).

42. Udhëzim nr.22, datë 20.06.2018 "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 18, datë 21.5.2018 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2018–2019".

43. Udhëzim nr.26, datë 30.07.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 18, datë 21.05.2018 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018 2019"

44. Udhëzim nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë".(Ndryshuar me udhëzimin nr. 36, datë 23.11.2018,udhëzimin nr.37, datë 04.12.2018)

45. Udhëzim nr. 31, datë 13.09.2018 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 18, datë 21.5.2018 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018–2019", të ndryshuar".

46. Udhëzim nr. 32, datë 5.10.2018 "Për një shtesë në udhëzimin nr. 18, datë 21.5.2018, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2018–2019", të ndryshuar".

47. Udhëzim nr. 33, datë 23.10.2018 "Për një shtesë në udhëzimin nr. 18, datë 21.5.2018, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2018–2019", të ndryshuar".

48. Udhëzim nr. 36, datë 23.11.2018 Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 29, datë 10.9.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë".

49. Udhëzim nr. 37, datë 4.12.2018, "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 29, datë 10.9.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar".

2019

50. Udhëzim nr. 5, datë 21.2.2019, "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016, "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të diplomave,

certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit", i ndryshuar.

51. Udhëzim nr. 10, datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë" .(Ndryshuar me udhëzimin nr. 17, datë 30.7.2019; Udhëzim nr. 19, datë 10.9.2019, Udhëzim nr. 15, datë 26.5.2020, Udhëzim nr. 17, datë 23.6.2020, Udhëzimin nr.11 datë 02.06.2021, Udhëzim nr.16, datë 29.6.2022, Udhëzim nr.23, datë 1.8.2022)

52. Udhëzim nr. 14, datë 27.05.2019, "Përcaktimin e kritereve dhe procedurave për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit".

53. Udhëzim nr. 16, datë 08.07.2019, "Për paisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave".

54. Udhëzim nr. 17, datë 30.07.2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.05.2019, " Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter professional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë".

55. Udhëzim nr. 19, datë 10.9.2019 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar.

56. Udhëzim i përbashkët i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 20, datë 20.9.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor".

57. Udhëzimi ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 24, datë 21.10.2019 "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 5, datë 19.2.2018, "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë".

58. Udhëzim nr. 29, datë 18.12.2019 "Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë".

59. Udhëzim nr. 30, datë 30.12.2019 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016 "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit", i ndryshuar.

2020

60. Udhëzim nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë".(Ndryshuar, me udhëzimin nr. 22, datë 3.9.2020, nr. 23, datë 28.9.2020; nr.27, datë 23.12.2020; nr. 7, datë31.3.2021; nr. 20, datë 30.9.2021, nr.5, datë 8.3.2022)

61. Udhëzim nr. 6, datë 4.3.2020 "Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kritereve dhe procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënien e bursave të parashikuara nga Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë".

62. Udhëzim nr.10, datë 30.3.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor".(Ndryshuar me udhëzimin nr.7, datë 31.03.2021 dhe Udhëzim nr.14, datë 21.06.2022)

63. Udhëzim nr.11, datë 2.4.2020 "Për përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës".

64. Udhëzim nr.15, datë 26.5.2020 Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar.

65. Udhëzim nr. 17, datë 23.6.2020 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar.

66. Udhëzim nr. 22, datë 03.9.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë".

67. Udhëzim nr.23, datë 28.9.2020 "Për një shtesë në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen , riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të ndryshuar.

68. Udhëzim nr. 25, datë 1.12.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar

69. Udhëzim nr. 26, datë 7.12.2020 "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016 "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë , të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera të autorizuara , jashtë vendit", i ndryshuar.

70. Udhëzim nr. 27, datë 23.12.2020 "Për një shtesë në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen , riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të

arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të ndryshuar.

2021

71. Udhëzim nr. 5, datë 03.03.2021 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 10 datë 30.03.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor".

72. Udhëzim nr. 7, datë 31.3.2021 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar.

73. Udhëzim nr.11, datë 2.6.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.10, datë 15.5.2019, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë" të ndryshuar".

74. Udhëzim nr. 20, datë 30.9.2021 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të Arsimit të Lartë ", të ndryshuar.

75. Udhëzim nr. 21, datë 15.10.2021 "Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të Arsimit të Lartë dhe institucione të tjera të autorizuara"(ndryshuar me Udhëzim nr.18, datë 8.7.2022).

2022

76. Udhëzim nr.5, datë 8.3.2022 "Për një shtesë në udhëzimin nr.1, datë 14.1.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të Arsimit të Lartë ", i ndryshuar "".

77. Udhëzim nr. 13, datë 20.6.2022 "Për frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimore në auditor dhe ciklit të studimit" (shfuqizuar nga Udhëzimi nr. 29. datë 7.10.2022).

78. Udhëzim nr. 14, datë 21.6.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 30.3.2020, "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", të ndryshuar"".

79. Udhëzim nr. 15, datë 22.6.2022 “Për një shtesë dhe një ndryshim në udhëzimin nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit””.

80. Udhëzim nr. 16, datë 29.6.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar””.

81. Udhëzim nr. 18, datë 8.7.2022 për disa ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara”.

82. Udhëzim nr.23, datë 1.8.2022 për disa ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.

83. Udhëzim nr. 27, datë 2.8.2022 “Për përcaktimin e rregullave, afateve të aplikimit, shqyrtimit dhe procedurat e masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar ”.

84. Udhëzim nr. 29, datë 7.10.2022 “Për frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimore në auditor, dhe ciklit të studimit”.

85. Udhëzim nr.30 datë 4.11.2022 “Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar”.

86. Udhëzim nr. 31 datë 15.11.2022 “Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

III. RREGULLORE TË MINISTRIT

1. Rregullore nr.2459/1 prot., datë 15.03.2016 “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

IV. URDHRA TË MINISTRIT

1. Urdhër nr.294, datë 17.08.2015, “Për shpërndarjen e kuotave të pranimit në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, për kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015 - 2016”.

2. Urdhër nr.295, datë 18.08.2015 “Për shpërndarjen e kuotave të transferimit të studimeve, si dhe kuotat për programe të dyta studimi, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2015 - 2016”.

3. Urdhër nr. 298, datë 19.08.2015 “Për caktimin e datës së fillimit të vitit akademik 2015 - 2016 në institucionet e arsimit të lartë”.

4. Urdhër nr.417, datë 02.11.2015 i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për shpërndarjen e kuotave të transferimit të studimeve në programet të ciklit të dytë, të studimeve me kohë të plotë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”/”Master i Arteve të Bukura në vitin akademik 2015-2016”;

5. Urdhër i përbashkët i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.54, datë 30.01.2019, “Për miratimin e formatit të publikimit të të dhënave të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare të institucioneve publike të arsimit të lartë”.

6. Urdhër i përbashkët nr. 418, datë 30.7.2019 i Ministrit të Kulturës dhe i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për përcaktimin e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit në fushën e artit dhe kulturës”.

7. Urdhër i përbashkët i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 440, datë 11.9.2019 "Për përcaktimin e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit në fushën e turizmit dhe mjedisit".

8. Urdhër i përbashkët i ministrit të Mbrojtjes dhe i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1242, datë 14.8.2019 "Për miratimin e listës së shërbimeve që do të ofrohen nga strukturat vartëse të Ministrisë së Mbrojtjes, me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit.

9. Urdhër nr.293, datë 29.09.2020 “Për caktimin e datës së fillimit të vitit akademik 2020-2021 në institucionet e arsimit të lartë”.

10. Urdhër nr.219, datë 16.7.2021 “Për mbylljen e degës “Epitech Albania”, si njësi bazë e institucionit të arsimit të lartë të huaj “Ecole Pour L’informatique Et Les Nouvelle Technologies (Epitech)”.

11. Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.275, datë 19.5.2022 “ Për pezullimin e veprimtarisë së Kolegjit Universitar “Pavarsia” Vlorë ”.

LIGJ
Nr. 80/2015

PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Misioni i arsimit të lartë

Arsimi i lartë është e mirë dhe përgjegjësi publike dhe ka për mision:

a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet;

b) të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend;

c) të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës;

ç) të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare;

d) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; dh) të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor;

e) të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë.

Neni 2

Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim:

a) të përcaktojë rolin e shtetit në arsimin e lartë; b) të përcaktojë misionin, objektivat kryesorë të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, rregullat e
krijimit, organizimit, drejtimit, administrimit, financimit dhe mbylljes të institucioneve të arsimit të lartë;

c) të krijojë një sistem të unifikuar të arsimit të lartë, kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë, inovacionit bashkëkohor e konkurrues në hapësirën europiane të arsimit të lartë; ç) të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet europiane;

d) të vendosë arsimin e lartë mbi baza të qëndrueshme financiare, duke krijuar mundësinë për shfrytëzimin e burimeve të ligjshme të financimit;

dh) të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë;

e) të bazojë sistemin e arsimit të lartë mbi parimin e konkurrencës së lirë mes institucioneve të arsimit të lartë, personelit akademik dhe studentëve.

Neni 3

Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë

1. Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Liria akademike garantohet nëpërmjet së drejtës:

a) për të organizuar veprimtaritë e mësim-dhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese;

b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore;

c) për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik.

3. Autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës:

a) për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) për të përfituar fonde nga shteti dhe organizma të tjerë;

c) për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit;

ç) për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj;

d) për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që institucionet zotërojnë ligjërisht, në përputhje me misionin e tyre.

4. Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohet nëpërmjet së drejtës:
a) për t'u vetëqeverisur, për të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të tyre të brendshme, të hartuara në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi;

b) për të caktuar kritere për pranimin e studentëve në programet e studimit, në përputhje me këtë ligj;

c) për të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimore-shkencore, kualifikuese, inovative, si edhe veprimtari të tjera të ligjshme;

ç) për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit.

Neni 4

E drejta për arsimim

1. Të drejtën për të ndjekur arsimin e lartë e kanë të gjithë ata individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm dhe të cilët plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi dhe nga institucionet e arsimit të lartë.

2. Shteti garanton arsimimin edhe për individët që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, por që nuk kanë mundësitë financiare për t'i përballuar ato.

3. Arsimi u garantohet në këto programe studimi edhe individëve, të cilëve u njihet kjo e drejtë me ligje të veçanta.

4. Këshilli i Ministrave nxjerr akte nënligjore për përcaktimin e kategorive të individëve që përfitojnë nga kjo e drejtë, sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 5

Roli i shtetit në arsimin e lartë

1. Shteti ushtron funksione rregullatore dhe krijuese të institucioneve publike të arsimit të lartë, si dhe financon arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

2. Shteti, nëpërmjet organeve dhe strukturave përgjegjëse të tij, ka përgjegjësitë dhe detyrimet si më poshtë:

a) garanton autonominë dhe lirinë akademike të institucioneve të arsimit të lartë;

b) është përgjegjës për përcaktimin dhe monitorimin e standardeve në arsimin e lartë për hapjen dhe akreditimin e institucioneve e të programeve të studimit që ato ofrojnë;

c) vlerëson cilësinë dhe funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë, përmes agjencive të tij, atyre të pavarura ose të huaja, duke bërë publik procesin dhe rezultatet e tij;

ç) vë në dispozicion fonde publike për mbështetjen e programeve të studimit ose fushave të caktuara të kërkimit shkencor, në përputhje me përparësitë e zhvillimit dhe interesave strategjikë të vendit;

d) vë në dispozicion fonde publike për të garantuar aksesin në arsimin e lartë, sipas meritës, pavarësisht nga mundësitë financiare të individëve;

dh) garanton paprekshmërinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe të territorit të tyre. Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset akademike bëhet me kërkesën ose lejen e titullarit të institucionit të arsimit të lartë. Vetëm në rastet e kryerjes së një vepre penale flagrante, në rastet e fatkeqësive natyrore dhe gjendjes së jashtëzakon-shme, organet e rendit publik kanë të drejtë të ndërhyjnë edhe pa lejen e titullarit të institucionit të arsimit të lartë. Cenimi i paprek-shmërisë së institucioneve të arsimit të lartë ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi;

e) garanton laicitetin e institucioneve të arsimit të lartë publik dhe mospërdorimin e simboleve fetare prej tyre. Arsimi i lartë jolaik dhe specifikat e funksionimit të institucioneve të tij rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3.Institucionet e arsimit të lartë ruajnë neutralitet politik.

Neni 6

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akreditimi” është procesi i pavarur për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, i cili përcakton nëse institucioni i arsimit të lartë dhe/ose programet e studimit, që ai ofron, përmbushin standardet e caktuara të cilësisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. “Arsimi i lartë” është arsimimi që ofrohet pas arsimit të mesëm nga institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore.

3. “Bursa” është financimi monetar që jepet për të mbështetur arsimimin e një studenti, mbi bazën e arritjeve akademike të tij ose kritereve të tjera, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4. “Diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë” është diploma e lëshuar veçmas nga dy ose më shumë institucione të arsimit të lartë, me marrëveshje, që dëshmon përfundimin me sukses të një programi të përbashkët studimi.

5. “Diplomë e përbashkët” është diploma e lëshuar bashkërisht me marrëveshje nga së paku dy institucione të arsimit të lartë, që dëshmon përfundimin me sukses të një programi të përbashkët studimi.

6. “Dokumenti i prioriteteve” është dokumenti që përcakton strukturën e shpenzimit të fondit publik për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në përputhje me prioritetet e vendit.

7. “ECTS - EuropianCreditTransferSystem” është përcaktimi i kreditit, sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve të formimit në arsimin e lartë.
8. “Gjurmimi i studentëve” është procesi i ndjekjes së studentit,lidhur me kualifikimet e tij të mëtejshme dhe punësimit, sipas programit të ndjekur.

9. “Institucionet e arsimit të lartë” janë personat juridikë që ofrojnë arsimim të lartë ose kualifikim profesional pas arsimit të mesëm dhe, sipas llojit të institucionit, edhe kërkim shkencor, si pjesë e sistemit të arsimit të lartë, të krijuar, dhe që ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

10. “Karrierë akademike” është veprimtaria mësimore dhe kërkimore-shkencore e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë.

11. “Kërkimi shkencor bazë” është veprimtaria kërkimore-shkencore, që ka për qëllim kryesor zgjerimin, thellimin, rikonceptimin dhe riintegrimin e njohurive shkencore mbi fenomenet e studiuara dhe të kuptuarit teorik të ndërveprimit midis aktorëve të ndryshëm dhe vetë procesit ku ato ndikojnë.

12. “Kërkimi shkencor i zbatuar” është veprimtaria kërkimore-shkencore, që ka për qëllim të gjejë zgjidhje praktike dhe specifike me objektiv krye sor shfrytëzimin e njohurive teorike, me qëllim zbatimin e tyre në praktikë.

13. “Kodi i cilësisë” është përmbledhje e standardeve dhe udhëzimeve për sigurimin e brendshëm e të jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë.

14. “Leja e hapjes” është vendimi i Këshillit të Ministrave për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë, kur ky i fundit përmbush kriteret dhe standardet e përcaktuara në këtë ligj dhe në akte nënligjore, që i njeh një subjekti të drejtën për të themeluar një institucion të arsimit të lartë.

15. “Leja për të filluar veprimtarinë akademike” përmbahet në urdhrin e ministrit përgjegjës për arsimin për fillimin e veprimtarisë së një institucioni të arsimit të lartë.

16. “Mbyllja e veprimtarisë së institucionit” është heqja e së drejtës për të ushtruar veprimtarinë mbi bazën e lejeve të përfituara, në rastet kur IAL-ja nuk përmbush kushtet dhe nuk plotëson kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë.

17. “Në kategorinë “Profesorë” përfshihen titujt akademikë: “Profesor”, “Profesor i asociuar”, “Profesor emeritus”, si dhe titujt “Akademik i asociuar” dhe “Akademik”, të njohura sipas kuadrit ligjor në fuqi.

18. “Plani buxhetor afatmesëm” është parashikimi i specifikuar i aktivitetit financiar të një institucioni të arsimit të lartë, që pritet të kryhet në një periudhë trevjeçare.

19. “Plani buxhetor njëvjeçar” është parashikimi i specifikuar i aktivitetit financiar të një institucioni të arsimit të lartë, që pritet të kryhet në një periudhë njëvjeçare.

20. “Plani strategjik i zhvillimit të institucionit” është dokumenti ku përcaktohen objektivat e

institucionit të arsimit të lartë apo të njësive përbërëse të tij, si dhe mjetet e mënyrat e realizimit të tyre.

21. Pezullimi i veprimtarisë së institucionit" është heqja e së drejtës për të regjistruar studentë për një afat maksimal dyvjeçar, deri në përmbushjen e kushteve të vendosura nga ministria përgjegjëse për arsimin për plotësimin e kritereve për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë.

22. "Programi i studimit" është një tërësi veprimtarish akademike dhe/ose kërkimore shkencore, përfundimi me sukses i të cilave i jep të drejtën studentit të pajiset me një certifikatë, diplomë ose gradë shkencore prej institucionit të arsimit të lartë që e ofron atë, në varësi të llojit të programit të studimit.

23. "Riorganizimi i institucionit të arsimit të lartë" është ndryshimi i strukturës dhe mënyrës së funksionimit të institucionit të arsimit të lartë.

24. "Sigurimi i brendshëm i cilësisë" është procesi i vazhdueshëm i monitorimit, vlerësimit, garantimit, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë në institucionet e arsimit të lartë, që zhvillohet nga vetë institucionet.

25. "Sistemi i studimeve me kohë të plotë" përfshin organizimin e programeve të studimit me ngarkesë akademike normale 60 kredite ECTS në një vit akademik.

26. "Sistemi i studimeve me kohë të zgjatur" përfshin organizimin e programeve të studimit me të njëjtën ngarkesë akademike totale të programeve të studimit me kohë të plotë, por me kohëzgjatje më të madhe e që në asnjë rast nuk mund të kalojë dyfishin e kohëzgjatjes normale.

27. "Tarifa e aplikimit" është vlera monetare që paguan studenti për aplikim në një program studimi.

28. "Tarifa e konkurrimit" është vlera monetare që paguan studenti për të konkurruar pranë institucionit të arsimit të lartë për të fituar në një program studimi, në ato raste kur institucioni parashikon zhvillimin e konkursit.

29. "Tarifa e regjistrimit" është vlera monetare që paguan studenti për t'u regjistruar në një program studimi.

30. "Tarifa e shkollimit" është vlera monetare që paguan studenti për ndjekjen e një programi studimi pranë një institucioni të arsimit të lartë.

31. "Tarifa e studimit" përfshin tarifën e regjistrimit dhe tarifën e shkollimit.

32. "Të mësuarit gjatë gjithë jetës" është ndjekja e veprimtarive dhe/ose programeve mësimore në periudha të ndryshme të jetës, me synim zgjerimin e njohurive për të rritur aftësitë studimore dhe/ose profesionale.

33. "Vlerësimi krahasues" është procesi formal i analizës së rezultateve të arritura prej institucioneve të arsimit të lartë, mbi bazën e të cilit kryhet renditja e tyre.

KREU II

ORGANIZIMI I ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Neni 7

Ministria përgjegjëse për arsimin

1. Ministria përgjegjëse për arsimin është institucioni që realizon programin qeverisës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

2. Ministria përgjegjëse për arsimin ka këto kompetenca:

a) harton politika në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, si dhe miraton planin strategjik në këtë fushë;

b) harton dhe propozon bazën ligjore në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

c) propozon në Këshillin e Ministrave modelin e financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi;

ç) propozon në Këshillin e Minis trave marrjene **vendim**it për hapjen, bashkimin e një institucioni të arsimit të lartë me një institucion tjetër dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë;

d) lejon fillimine veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë;

dh) miraton hapjene programeve të reja të studimit, riorganizimin, pezullimine veprimtarisë akademike dhe mbylljen e tyre;

e) kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

ë) auditon, së paku një herë në tre vjet, përdorimine fondeve publike në institucionet e arsimit të lartë;

f) i propozon Këshillit të Ministrave kufirin maksimal të tarifës së shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë në institucionet publike të arsimit të lartë;

g) administron regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë;

gj) mbështet me infrastrukturën e nevojshme veprimtaritë kërkimore-shkencore vetëm në institucionet publike të arsimit të lartë;

h) mbështet veprimtarinë e inovacionit dhe zhvillimit;

i) përcakton datën zyrtare të fillimit dhe mbarimit të vitit akademik për të gjitha institucionet e arsimit të lartë;

j) verifikon ligjshmërinë e zhvillimit të zgjedhjeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcjell për emërim kandidatin fitues të zgjedhjeve për rektor në universitetet publike te Presidenti i Republikës;

k) vendos kushte për institucionin e arsimit të lartë dhe /ose pezullon veprimtarinë e tij, bazuar në raportet e kontrollit të ligjshmërisë, të akreditimit ose auditimit;

l) i propozon Këshillit të Ministrave mbylljen e veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë, bazuar në raportet e kontrollit të ligjshmërisë, të akreditimit ose auditimit.

Neni 8
Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor

1. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALKSH) është organ këshillimor për politikat e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, pranë ministrit përgjegjës për arsimin.

2. Anëtarët e KALKSH-it janë personalitete të njohura të fushave akademike dhe emërohen nga ministri përgjegjës për arsimin.

3. Organizimi, funksionimi dhe kohëzgjatja e qëndrimit në detyrë dhe shpërblimi i anëtarëve të KALKSH-it përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Qendra e Shërbimeve Arsimore

1. Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) është institucion publik, në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që ka për mision ofrimin e shërbimeve në fushën e arsimit të lartë dhe sigurimin e aksesit publik në të dhënat për arsimin e lartë.

2. QSHA-ja ka për objekt veprimtarie ofrimin e shërbimeve për qytetarët, IAL-të, institucionet e tjera dhe të tretët. Ofrimi i shërbimeve ndaj të

tretëve bëhet nga QSHA-ja pas miratimit nga ministria përgjegjëse për arsimin, kundrejt pagesës së tarifave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. QSHA-ja financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga të ardhurat e veta, si dhe ka të drejtën e administrimit të të ardhurave të krijuara, në masën 90 për qind të vitit buxhetor. Të ardhurat e papërdorura kalojnë në vitin pasardhës buxhetor.

4. Organizimi, funksionimi i QSHA-së dhe procedurat e regjistrimit të studentëve rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

Neni 10

Funksionet e Qendrës së Shërbimeve Arsimore

1. QSHA-ja ka këto funksione:

a) koordinon procesin e aplikimit në institucionet e arsimit të lartë për ndjekjen e studimeve në programet e ciklit të parë, atyre të integruara dhe programet profesionale;

b) krijon dhe administron regjistrin kombëtar të studentëve të të gjitha cikleve dhe një bazë të dhënash për institucionet e arsimit të lartë, lidhur me programet e studimit, diplomat apo certifikatat që ato lëshojnë;

c) pajis çdo student të regjistruar në një institucion të arsimit të lartë me një numër unik matrikullimi, që e shoqëron deri në marrjen e diplomës për programin përkatës të studimit, sipas përcaktimeve të bëra me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin;

ç) organizon dhe administron provimin e shtetit për profesionet e rregulluara, në bashkëpunim me organet kompetente përkatëse;

d) ofron çdo shërbim tjetër të ngarkuar nga ministri përgjegjës për arsimin.

2. Çdo institucion i arsimit të lartë raporton në QSHA për të gjithë aplikantët e regjistruar në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve të larta, si dhe për listën e të diplomuarve, sipas cikleve, brenda afateve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Neni 11

Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë

1. Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) është institucion publik në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që ka për detyrë kryesore shpërndarjen e fondeve publike për:

a) mbështetjen e veprimtarisë së institucioneve publike të arsimit të lartë, ku përfshihet mësimdhënia, kërkimi shkencor dhe pjesëmarrja në çështjet e menaxhimit akademik dhe administrativ;

b) mbështetjen me bursa studimi për studentët e shkëlqyer me notë mesatare maksimale nga sistemi i arsimi t të mesëm të lartë, studentët në programet e studimit në fusha prioritare dhe studentët nga shtresa sociale në nevojë;

c) garantimin e skemës së kredive studentore.

2. AKFAL-i propozon kriteret për shpërndarjen e fondeve publike.

3. Ministria përgjegjëse për arsimin miraton kriteret dhe formulat e shpërndarjes së fondeve publike, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Ministria përgjegjëse për arsimin miraton dhe shpall çdo vit dokumentin e prioriteteve, sipas drejtimeve kryesore.

5. Organizimi dhe funksionimi i AKFAL-it rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

1. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) është institucion publik në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe shkencën, që ka për detyrë kryesore shpërndarjen e fondeve për programet e kërkimit shkencor, mbi bazën e projekteve të paraqitura prej institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve të kërkimit shkencor në fushat e shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane.

2. AKKSHI-ja identifikon fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, si dhe vlerëson në nivel kombëtar programet e projektet në fushat e sipërpërmendura.

3. AKKSHI-ja është përgjegjëse për përhapjen e informacionit dhe koordinimin e proceseve të aplikimit në projekte ndërkombëtare të kërkimit shkencor në arsimin e lartë.

4. AKKSHI-ja organizon çdo katër vjet procesin e vlerësimit të veprimtarisë kërkimoreshkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë, si dhe i rendit ato në bazë të këtij vlerësimi. AKKSHI-ja i komunikon vlerësimin Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë. Metodologjia e procesit të vlerësimit rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. AKKSHI-ja miraton, mbi bazën e konkurrencës së lirë midis aplikantëve, fonde për projektet e studimeve të doktoratës.

6. Agjencia administron edhe fonde të tjera të kërkimit shkencor dhe inovacionit, në kuadrin e programeve kombëtare, ndërkombëtare dhe dypalëshe të kërkimit shkencor, të cilat i shpërndan bazuar në aplikimet e institucioneve.

7. AKKSHI-ja paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe shkencën raportin vjetor të veprimtarisë së saj. Rezultatet e punës së saj vlerësohen nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe shkencën, bazuar edhe në fondet e përftuara në nivel kombëtar nga programet ndërkombëtare të kërkimit shkencor.

8. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i AKKSHI-së, i Bordit të Administrimit, si dhe shpërblimi i anëtarëve të këtij bordi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Baza kombëtare e të dhënave për kërkimin shkencor

1. Baza kombëtare e të dhënave për kërkimin shkencor në sistemin e arsimit të lartë administrohet dhe përditësohet nga AKKSHI-ja dhe përfshin:

a) listën e disertacioneve të doktoratave të mbrojtura dhe abstraktet përkatëse në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht;

b) listën e punimeve të diplomës së ciklit të dytë dhe të tretë, të mbrojtura, dhe abstraktet përkatëse në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht;

c) listën e përditësuar të kontributit shkencor të personelit akademik e kërkimor të institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor dhe të personelit kërkimor të instituteve të tjera të kërkim-zhvillimit.

2. AKKSHI-ja administron dhe bën publike bazën e të dhënave me të gjitha projektet e financuara, në kuadrin e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim-zhvillimit.

Neni 14

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë

1. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) është person juridik publik. Ajo është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL, përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, akreditimit dhe proceseve të tjera, monitoron dhe vlerëson cilësinë e institucionit dhe të programeve të ofruara. ASCAL mbështet

veprimtarinë e saj mbi udhëzuesit e saj, në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, i cili përditësohet me standardet dhe udhëzuesit europianë të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë.

2. ASCAL realizon procesin e vlerësimit për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit që ato ofrojnë, si dhe monitorimin në vijim të cilësisë së tyre.

3. ASCAL bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

4. ASCAL gëzon pavarësi në hartimin dhe miratimin e procedurave të saj, kritereve dhe formateve të vlerësimit, përzgjedhjen e ekspertëve dhe komisioneve të posaçme të vlerësimit, si dhe përmbajtjen dhe rezultatet e raporteve të vlerësimit të cilësisë akademike.

5. ASCAL vepron edhe nëpërmjet komisioneve të zgjedhura dhe të pavarura, sipas fushave kryesore të arsimit të lartë në shkencat natyrore, inxhinierik e dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane. Këto komisione kanë karakter të përkohshëm dhe përbëhen nga ekspertë me kualifikime akademike, me përvojë në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe njohës të proceseve të cilësisë.

6. Emërimi i Drejtorit të ASCAL-it bëhet me urdhër të Kryeministrit, mbështetur në propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin.

7. Në kuadër të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, ASCAL bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me agjenci homologe, pjesë të Rrjetit Europian të Sigurimit të Cilësisë (ENQA) dhe/ose RegjistrinEuropian i Sigurimit të Cilësisë (EQAR).

8. ASCAL publikon raportin vjetor të veprimtarisë së saj dhe raportet përfundimtare të vlerësimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit.

9. ASCAL financohet në mënyrë të balancuar nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e saj. Ajo ka të drejtën e përdorimit të 90 për qind të këtyre të ardhurave. Të ardhurat e papërdorura gjatë një viti financiar kalojnë në vitin pasardhës.

10. Organizimi dhe funksionimi i ASCAL-it rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Bordi i Akreditimit

1. Për procesin e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit, pranë ASCAL-it ngrihet Bordi i Akreditimit, i cili është organ kolegjial vendimmarrës dhe i pavarur në veprimtarinë e tij.

2. Bordi merr vendimin përfundimtar mbi akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve që ato ofrojnë.

3. Bordi miraton, me kërkesë të institucionit të arsimit të lartë, kryerjen e vlerësimit të jashtëm nga një prej agjencive anëtare të ENQA-s.

4. Bordi i Akreditimit përbëhet nga ekspertë të huaj dhe vendas, personalitete në fushën e arsimit të lartë dhe sigurimit të cilësisë.

5. Mandati i anëtarëve të Bordit të Akreditimit është 4 vjet.

6. Emërimi dhe shkarkimi i Kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Akreditimit bëhet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
7. Organizimi dhe funksionimi i Bordit të Akreditimit, si dhe masa e shpërblimit të kryetarit dhe anëtarëve të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16

Konferenca e Rektorëve

1. Konferenca e Rektorëve është organ kolegjial, i pavarur, i përbërë nga titullarët e institucioneve të arsimit të lartë.

2. Konferenca e Rektorëve kryen veprimtari të koordinimit dhe zhvillimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe funksione të tjera të përcaktuara me ligje të veçanta.

3. Konferenca e Rektorëve jep rekomandime lidhur me çështje të arsimit të lartë me interes kombëtar.

4. Konferenca e Rektorëve mban lidhje me shoqata homologe për nxitjen e shkëmbimeve universitare që ndihmojnë përparimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

5. Konferenca e Rektorëve funksionon në bazë të statutit të miratuar prej dy të tretave të anëtarëve të saj.

KREU III

INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Seksioni 1

Organizimi dhe llojet e institucioneve të arsimit të lartë

Neni 17

Organizimi i institucioneve të arsimit të lartë

1. Institucionet e arsimit të lartë janë të organizuara në institucione publike, jopublike dhe publike të pavarura, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Institucionet e arsimit të lartë krijohen, hapen, organizohen, financohen, akreditohen, vlerësohen, pezullohen dhe mbyllen në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Ato ofrojnë programe të licencuara të studimeve, për të cilat lëshojnë diploma pas akreditimit të institucionit dhe programit të studimit.

2. Institucionet publike të arsimit të lartë janë persona juridikë publikë që vetëfinancohen, financohen nga Buxheti i Shtetit ose nga burime të tjera të ligjshme.

3. Institucionet jopublike të arsimit të lartë janë persona juridikë privatë. Veprimtaria që ato zhvillojnë mund të jetë fitimprurëse ose jofitimprurëse.

4. Institucionet publike të pavarura të arsimit të lartë janë persona juridikë publikë që krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas përcak-timeve të këtij ligji.

5. Institucionet e arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi në fusha me veprimtari akademike specifike, lidhur me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, gëzojnë status të veçantë. Ky status i jepet institucionit të arsimit të lartë me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

6. Institucionet ofruese të arsimit të lartë, që gëzojnë status të veçantë, në rastet kur nuk u nënshtrohen rregullimeve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimit përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin,

funksionojnë dhe administrohen sipas parimeve dhe përcaktimeve të këtij ligji për institucionet e arsimit të lartë.

7. Institucionet e arsimit të lartë të llojeve kolegj universitar ose akademi, të cilat për të paktën tri vite akademike nuk kanë më shumë se, respektivisht, gjashtëqind dhe treqind studentë, dhe që përmbushin kushtet e kodit të cilësisë të procesit mësimor, mund të mos plotësojnë kushtet e pikës 4, të nenit 25, në marrëveshje me ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë.

8. Llojet e institucioneve të arsimit të lartë janë: universitetet, kolegjet universitare, akademitë dhe kolegjet profesionale të larta.

Neni 18

Universiteti

1. Universiteti është institucion i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale.

2. Universiteti përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit. Ai ka në përbërje së paku tri fakultete.

3. Universiteti ofron arsimim të lartë, zhvillim të dijeve, të shkencës, të inovacionit dhe të profesioneve.

4. Universiteti zhvillon kërkim shkencor bazë e të zbatuar, veprimtari krijuese, ofron shërbime dhe ushtron veprimtari të tjera, në përputhje me fushat e programeve të studimit, me këtë ligj dhe me statutin e tij, si dhe mbështet aftësimin e personelit akademik në funksion të misionit të tij.

5. Universiteti ofron programe studimi në të gjitha ciklet e studimeve të arsimit të lartë, si edhe programe studimi me karakter profesional.

Neni 19

Akademia

1. Akademia është institucion i arsimit të lartë i profilizuar, që vepron në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale.

2. Akademia përfaqëson një strukturë të përbërë nga të paktënnjë fakultet. Në përputhje me fushën përkatëse të kompetencës, akademia mund të ofrojë programe të studimeve në të gjitha ciklet e studimit, si dhe programe studimi me karakter profesional.

3. Akademia mund të realizojë kërkim shkencor bazë dhe të zbatuar, shërbime, si dhe ushtron veprimtari të tjera, bazuar në këtë ligj dhe në statutin e saj.

Neni 20

Kolegji Universitar

1. Kolegji universitar është institucion i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale.

2. Kolegji universitar përfaqëson një strukturë të përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit. Ai ka në përbërjen e tij së paku dy fakultete.

3. Kolegji ofron arsimim të lartë, zhvillim të dijeve, të shkencës, të inovacionit dhe të profesioneve.

4. Kolegji mund të zhvillojë kërkim shkencor, veprimtari krijuese, ofron shërbime, si dhe ushtron veprimtari të tjera, në përputhje me fushat e programeve të studimit, me këtë ligj e me statutin e tij, si dhe mbështet aftësimin e personelit akademik në funksion të misionit të tij.

5. Kolegji universitar ofron programe studimi në ciklin e parë dhe/ose të dytë të studimeve dhe programe studimi me karakter profesional.

Neni 21 Kolegji profesional i lartë

1. Kolegjiprofesionalilartë është institucion i arsimit të lartë me orientim profesional, që përgatit profesionistë me aftësi praktike.

2. Kolegjiprofesionali lartë përfaqëson një strukturë të përbërë nga së paku dy departamente.

3. Kolegjiprofesionali lartë ofron veprimtari mësimore dhe trajnuese, që zgjasin një ose dy vite akademike me ngarkesë përkatësisht 60 ose 120 kredite ECTS dhe që finalizohen me lëshimin përkatësisht të një certifikate ose diplome profesionale.

4. Kolegji profesional i lartë mund të ngrihet edhe pranë institucioneve të arsimit të lartë, që kanë statusin e universiteteve dhe kolegjeve universitare. Në këto raste ai konsiderohet si njësi kryesore e institucionit. Në të gjitha rastet e tjera kolegji profesional i lartë konsiderohet njësi e veçantë e arsimit të lartë.

5. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tij rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Seksioni 2

Struktura e institucioneve të arsimit të lartë

Neni 22

Njësitë përbërëse të institucioneve të arsimit të lartë

1. Institucionet e arsimit të lartë përbëhen nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë.
2. Njësitë kryesore janë fakultetet, institutet kërkimore-shkencore dhe kolegjet profesionale të larta, në rastet kur ngrihen pranë institucioneve të arsimit të lartë që kanë statusin e universiteteve dhe kolegjeve universitare.

3. Njësitë bazë janë departamentet dhe qendrat kërkimore-shkencore.

Neni 23

Fakulteti

1. Fakulteti është njësi kryesore që bashkë-rendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura. Fakulteti ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme, në përputhje me llojin e institucionit të arsimit të lartë.

2. Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente.

3. Struktura e fakultetit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tij përcaktohen në statutin dhe aktet e tjera të institucionit të arsimit të lartë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

4. Fakulteti miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, bazuar në propozimet e njësive bazë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të akteve nënligj ore.

Neni 24

Instituti kërkimor-shkencor

1. Institucionet e arsimit të lartë mund të krijojnë institute kërkimore-shkencore, si pjesë përbërëse të tyre. Instituti kryen veprimtari kërkimore-shkencore, zhvillimi dhe inovacioni. Ai përbën një njësi kryesore të institucionit dhe mund të mbështesë realizimin e programeve të ciklit të dytë dhe të tretë, kur programet ofrohen nga njësi të tjera kryesore të institucionit.

2. Struktura e institutit kërkimor-shkencor, përbërja, funksionimi, drejtimi i tij përcaktohen në statutin dhe në aktet e tjera të institucionit të arsimit të lartë.

Neni 25

Departamenti

1. Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimoreshkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron.

2. Departamenti mund të krijohet edhe nga fakultete të ndryshme të një IAL-je për organizimin dhe realizimin e programeve të studimit me karakter ndërdisiplinor. Në këto raste, funksionimi dhe varësia e këtij departamenti përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Ky departament nuk merret në konsideratë, për efekt të përmbushjes së standardeve të institucionit.

3. Departamenti nxit, programon, bashkë-rendon, zhvillon, organizon dhe adminis-tron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore, në varësi të llojit të institucionit.

4. Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Departamenti mund të ketë në përbërje dhe personel ndihmës akademik.

5. Departamenti mund të organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor, në përputhje me llojin dhe misionin e institucionit.

6. Në institucionet e arsimit të lartë publik, që kanë struktura shëndetësore universitare, departamentet përbëhen nga shërbimet, të cilat formohen në bazë të specialitetit.

7. Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve të cilësisë.

8. Departamenti propozon kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore. Departamenti përzgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë.

9. Departamenti mund të ofrojë shërbime për të tretë, si dhe të zhvillojë veprimtari të tjera, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të përcaktuara në statutin dhe aktet e tjera të institucionit të arsimit të lartë.

10. Departamenti menaxhon fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera që gjenerohen nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare.

11. Rregulla të tjera për strukturën dhe funksionimin e departamentit përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë.

Neni 26

Qendra kërkimore-shkencore

1. Qendra kërkimore-shkencore e fakultetit oseeinstitutit është njësi bazë që kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi.

2. Qendra mund të mbështetë realizimin e programeve të studimeve “Master i shkencave” dhe “Doktoratë”, të ofruara nga departamentet e fakultetit përkatës ose departamente të fakulteteve të tjera.

3. Struktura e qendrës, përbërja, funksionimi dhe drejtimi i saj përcaktohen në statutin dhe në aktet e tjera të institucionit të arsimit të lartë.

4. Kur qendra nuk përmbush standardet e njësisë bazë, ajo nuk llogaritet për qëllimin e përmbushjes së standardeve institucionale, si njësi bazë e njësisë kryesore.

Neni 27

Qendrat studimore ndërdisiplinore

1. Për interesa të përbashkët studimorë, kërkimorë dhe zhvillimorë, njësitë kryesore përbërëse të një institucioni të arsimit të lartë mund të krijojnë në bashkëpunim qendra studimore ndërdisiplinore.
2. Struktura e qendrës studimore ndërdisi-plinore, përbërja, funksionimi, drejtimi i saj përcaktohen në statutin dhe në aktet e tjera të institucionit të arsimit të lartë.

3. Qendra nuk përfshihet në kriterete përmbushjes së standardeve institucionale.

Neni 28

Strukturat shëndetësore universitare

1. Strukturat shëndetësore universitare janë njësi të sistemit arsimor dhe të sistemit shëndetësor, të cilat realizojnë shërbime terciare, funksione diagnostikuese e trajtuese, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore, si pjesë e institucionit të arsimit të lartë.

2. Strukturat shëndetësore universitare miratohen dhe funksionojnë si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave, pas plotësimit të standardeve specifike dhe në bazë të kritereve të përcaktuara, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin me kërkesë të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Në institucionet e arsimit të lartë publik, që kanë struktura shëndetësore universitare, departa-mentet përbëhen nga shërbimet, të cilat formohen në bazë të specialitetit. Në këto institucione mund të ketë edhe departamente, që nuk kanë në përbërje të tyre shërbime, në varësi të fushave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, që ato përfshijnë.

4. Këshilli i Ministrave përcakton kriteret dhe procedurat për ngritjen dhe organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare, si edhe kriteret specifike shtesë dhe procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e drejtuesve të shërbimit të tyre. Ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë dërgojnë propozimin përkatës në Këshillin e Ministrave pas specifikimeve të bëra nga institucioni i arsimit të lartë.

5. Institucionet e arsimit të lartë në fushën e shëndetësisë mund të lidhin marrëveshje me qendra/institucione shëndetësore, publike apo private. Lloji i këtyre qendrave/institucioneve shëndetësore, publike apo private, si dhe kriteret që ato duhet të plotësojnë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Në rastet e krijimit të një shërbimi të ri ose të IAL-ve të reja, të cilat kanë strukturë shëndetësore universitare, drejtuesi i shërbimit emërohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ministri përgjegjës për arsimin për një mandat me kohëzgjatje deri në 1 vit, kohë brenda së cilës zhvillohen zgjedhjet e drejtuesit të njësisë kryesore ose përzgjidhet drejtuesi i shërbimit.

Neni 29

Degët e institucioneve të arsimit të lartë

Një institucion i arsimit të lartë, vendas apo i huaj, ka të drejtë të hapë degë në Republikën e Shqipërisë për të ofruar programe studimi, në përputhje me kompetencat dhe fushën e veprimtarisë së tij. Në varësi të llojit të institucionit, ai mund të zhvillojë edhe kërkim shkencor, veprimtari trajnuese, shërbime dhe veprimtari të tjera.

1. Dega e institucionit të arsimit të lartë vendas është:
a) një njësi e veçantë në strukturën e institucionit të arsimit të lartë si njësi kryesore ose njësi bazë;

b) pjesë përbërëse e njësive të selisë qendrore të institucionit.

3. Kriteret dhe procedurat për hapjen e degëve të institucioneve të arsimit të lartë, vendase dhe të huaja, të akredituara në vendin e origjinës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Degët e institucioneve të arsimit të lartë dhe programet e studimit, që ofrohen në to, u nënshtrohen kritereve dhe procedurave të vlerësimit dhe akreditimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

KREU IV

HAPJA, RIORGANIZIMI DHE MBYLLJA E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

Neni 30

Hapja, mbyllja, riorganizimi i një institucioni të arsimit të lartë

1. Hapja e një institucioni të arsimit të lartë, mbyllja dhe ndarja ose bashkimi i një institucioni me një institucion tjetër të arsimit të lartë bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin.

2. Për institucionet publike të arsimit të lartë, të cilat janë hapur me propozim të përbashkët të të paktën dy ministrive, riorganizimi dhe mbyllja, si dhe bashkimi me një institucion tjetër të arsimit të lartë bëhet me propozim të po atyre ministrive.

3. Hapja e një institucioni të arsimit të lartë bëhet me plotësimin e standardeve akademike, sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare për përfundimin e studimeve të filluara nga secili student i regjistruar dhe përmbushjen e kritereve të tjera, të përcaktuara në këtë ligj apo akte të tjera nënligjore, të nevojshme për të siguruar cilësinë e programeve të planifikuara të studimeve, si dhe të veprimtarive të tjera të institucionit. Standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Dokumentacioni që duhet të përmbajë projekti i paraqitur nga institucioni për hapjen e tij, si dhe për fillimin e aktivitetit përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

Në rastin e refuzimit të një projekti të paraqitur, ministria përgjegjëse për arsimin informon aplikantin për vendimin dhe për shkaqet e marrjes së tij brenda një afati nëntëdhjetëditor nga data e aplikimit.

4. Për mbylljen, riorganizimin, ndarjen ose bashkimin me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë kërkohet paraprakisht propozimi i Senatit Akademik dhe miratimi i Bordit të Administrimit. Në rastet kur iniciativa për mbylljen e institucionit ndërmerret nga ministri përgjegjës për arsimin, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit shprehin mendimin brenda një muaji.

5. Hapja e njësive kryesore të institucioneve të arsimit të lartë, riorganizimi ose mbyllja e tyre bëhen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, në bazë të propozimit të institucionit të arsimit të lartë, pas miratimit të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit.
6. Hapja, riorganizimi ose mbyllja e njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë bëhen me vendim të Senatit Akademik, në përfundim të vitit akademik, pas miratimit të Bordit të Administrimit. Institucion i i njofton vendimin e tij, brenda një afati tridhjetëditor, ministrisë përgjegjëse për arsimin.

7. Procedurat, që ndiqen për hapjen, mbylljen, riorganizimin dhe fillimin e veprimtarisë së një institucioni të arsimit të lartë, përcaktohen në udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.

Neni 31

Hapja dhe fillimi i veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë

1. Hapja e një institucioni të arsimit të lartë bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, sipas përcaktimeve të nenit 30 të këtij ligji.

2. Leja për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë përmban edhe detyrimin që, në rastin kur ai institucion ndërpret veprimtarinë e tij, të ofrojë mjetet e nevojshme financiare dhe mundësitë për përfundimin e studimeve të filluara, për të gjithë studentët që janë të regjistruar në atë institucion.

3. Institucioni i huaj i arsimit të lartë, i akredituar në një shtet tjetër, në kërkesën për lejen e hapjes është i detyruar të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dokumentin zyrtar që certifikon akreditimin.

4. Pas vendimit të Këshillit të Ministrave për hapjen e institucionit, ky i fundit fillon veprimtarinë e tij vetëm pas nxjerrjes së urdhrit të ministrit përgjegjës për arsimin për fillimin e veprimtarisë.

5. Leja e dhënë për hapjen bëhet e pavlefshme në rastet kur institucioni i arsimit të lartë nuk fillon veprimtarinë e tij brenda njëzet e katër muajve nga marrja e saj.

6. Një institucion i arsimit të lartë përfundon veprimtarinë e tij akademike, të përcaktuar në misionin e tij, vetëm në fund të vitit të akademik.

Neni 32

Raportimi

1. Institucionet e arsimit të lartë paraqesin, për çdo vit akademik, pranë ministrisë përgjegjëse, raportet vjetore për veprimtarinë e kryer, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim, informacion për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që ato ofrojnë, si dhe elemente të tjera të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës.

2. Afatet për raportim përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

Neni 33

Statuti dhe rregullorja e institucioneve të arsimit të lartë

1. Statuti i një institucioni të arsimit të lartë përmban normat bazë, që rregullojnë veprimtarinë e tij.
2. Statuti hartohet dhe ndryshohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe aktet nënligjore në fuqi. Ai miratohet nga Senati Akademik i institucionit të arsimit të lartë dhe Bordi i Administrimit. Statuti i dërgohet ministrit përgjegjës për arsimin, i cili, brenda dy muajve, kryen kontrollin e ligjshmërisë së tij. Kur konstatohen mospërputhje të tij me ligjin, ministri ia kthen statutin për ripunim institucionit të arsimit të lartë. Kur ministri nuk ka vërejtje për ligjshmërinë e statutit ose nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, statuti konsiderohet i miratuar.

Ndryshimet në statut miratohen me të njëjtat procedura.

3. Institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë e tyre përbërëse rregullojnë veprimtarinë e tyre në rregulloret e tyre të brendshme, që hartohen dhe miratohen në përputhje me këtë ligj dhe sipas mënyrës së përcaktuar në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

4. Në statut, në përputhje me këtë ligj dhe me vendimin e hapjes së institucionit të arsimit të lartë, përcaktohen hollësisht: organizimi, strukturat përbërëse të tij, veprimtaritë e autoriteteve dhe organeve drejtuese, zgjedhja apo emërimi i tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe të studentëve, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e institucionit.

Neni 34

Emri dhe stema e institucioneve të arsimit të lartë

1. Institucionet e arsimit të lartë kanë emrin zyrtar dhe stemën, të cilat përcaktohen në vendimin e hapjes së institucionit.

2. Emërtimet e llojit të institucionit të arsimit të lartë “universitet”, “kolegj universitar”, “akademi” dhe “kolegj profesional i lartë” nuk mund të përdoren dhe nuk mund të jenë pjesë e emrit të përveçëm të institucionit të arsimit të lartë.

3. Institucioni i arsimit të lartë i njofton ministrisë ndryshime të emrit ose stemës së institucionit. Ndryshimet e mësipërme miratohen me vendim të Senatit Akademik.

4. Nëse emri dhe stema e institucionit është e njëjtë me atë të një institucioni tjetër apo janë në kundërshtim me rendin e moralin publik apo me dispozitat e këtij ligji, ministri kërkon ndryshimin e tyre. Ministria përgjegjëse për arsimin mban regjistrin përkatës për këtë qëllim.

Neni 35

Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë

1. Hapja e programeve të studimit, mbyllja, si dhe riorganizimi i tyre në masën mbi 20 për qind të përmbajtjes së tyre, të shprehur në kredite, pas një

cikli të plotë studimi, miratohet nga ministri përgjegjës për arsimin, në bazë të kërkesës së institucionit të arsimit të lartë, bazuar në vlerësimin e nevojave për aftësi në tregun e punësdhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Hapja e një programi të ri studimi në një institucion publik të arsimit të lartë bëhet me miratimin paraprak edhe të AKFAL-it, në të gjitha ato raste kur për hapjen e tij kërkohet financim nga Buxheti i Shtetit. Në rastet kur programi hapet pa miratimin e AKFAL-it, institucioni i arsimit të lartë merr përsipër mbulimin e shpenzimeve të programit të studimit në mënyrë të përhershme.

3. Ministri përgjegjës për arsimin refuzon kërkesën në rastet kur institucioni i arsimit të lartë nuk përmbush kushtet për hapjen e programit të studimit, ose nuk provon se është në gjendje të ofrojë garancitë e nevojshme financiare dhe infrastrukturën përkatëse për veprimtarinë e kërkuar.

4. Institucionet e arsimit të lartë, përpara fillimit të vitit akademik, njoftojnë zyrtarisht ministrinë përgjegjëse për arsimin për ndryshimet që u bëhen programeve të studimit, pas lejes së hapjes dhe akreditimit të tyre, shoqëruar me argumentimin përkatës, një vit para datës së fillimit të implementimit të programit të studimit.

5. Institucione të huaja të arsimit të lartë të njërit prej shteteve të Bashkimit Europian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë dhe Australisë mund të ofrojnë programe studimi ose formime profesionale të larta. Këto programe duhet të jenë të akredituara në shtetin e origjinës dhe të ofrohen në institucione shqiptare të akredituara të arsimit të lartë pas miratimit të tyre nga ministri përgjegjës për arsimin. Realizimi i programit kryhet me të njëjtat standarde, modalitete dhe personel akademik siç zhvillohet në vendin e origjinës të institucionit të huaj. Institucioni shqiptar i arsimit të lartë ka përgjegjësi për plotësimin e standardeve dhe realizimin e procesit akademik. Hapja e këtyre programeve i nënshtrohet paraprakisht procesit të vlerësimit dhe njohjes nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit, në përputhje me Kodin e Cilësisë, si dhe detyrimet e tjera ligjore.

6. Ministri përgjegjës për arsimin përcakton me udhëzim kriteret dhe dokumentacionin që duhet të përmbajë kërkesa për hapjen e programeve të reja të studimit, si dhe procedurat që ndiqen për hapjen e tyre.

7. Leja e dhënë për hapjen e programit të ri të studimit bëhet e pavlefshme në rastet kur institucioni i arsimit të lartë nuk e aktivizon programin brenda njëzet e katër muajve nga nxjerrja e urdhrit të hapjes.

8. Bazuar në mosrespektimin e kritereve të ligjshmërisë dhe/ose të akreditimit të një programi studimi, ministri përgjegjës për arsimin urdhëron mbylljen e programit përkatës.

9. Institucioni i arsimit të lartë për programe studimi të akredituara mund të bëjë ndryshime profilizuese deri në masën 20 për qind dhe t'i reflektojë ato në diplomën e lëshuar prej tij. Miratimi i ndryshimeve bëhet nga Senati Akademik dhe për to njoftohet ministria përgjegjëse për arsimin e lartë jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit akademik.

KREU V

ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

Neni 36

Organet dhe autoritetet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë

1. Organi më i lartë drejtues akademikështë Senati Akademik. Organe të tjera akademike janë asambleja e personelit akademik dhe komisionet e përhershme.
2. Autoritetet drejtuese akademike janë rektori, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë.

3. Organi më i lartë drejtues administrativ është Bordi i Administrimit.

4. Autoritetet drejtuese administrative janë: administratori i institucionit dhe administratori i njësisë kryesore. Autoritet administrativ është administratori i njësisë bazë.

5. Organe kolegjiale të tjera janë: rektorati, dekanati, këshilli i etikës.

6. Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të krijojnë në strukturën e tyre autoritete dhe organe të tjera, në përputhje me misionin dhe veprimtaritë e institucionit, sipas përcaktimeve në statutin e tyre.

7. Në institucionet publike të arsimit të lartë anëtarët e Senatit Akademik dhe autoritetet drejtuese akademike zgjidhen, nëpërmjet një procesi të përgjithshëm zgjedhor, i cili zhvillohet çdo katër vjet. Anëtarët e Bordit të Administrimit zgjidhen sipas përcaktimeve të këtij ligji. Autoritetet administrative përzgjidhen në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

8. Në institucionet jopublike të arsimit të lartë anëtarët e Senatit Akademik, autoritetet drejtuese akademike, anëtarët e Bordit të Administrimit dhe autoritetet administrative përzgjidhen/emërohen dhe shkarkohen sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe statutit të institucionit.

Seksioni 1

Organizimi akademik

Neni 37

Senati Akademik

1. Senati është organi kolegjial më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij.

2. Senati kryesohet nga rektori dhe mblidhet periodikisht.

3. Anëtarët e Senat it Akademik të institucioneve të arsimit të lartë zgjidhen nga asambletë e personelit akademik të njësive kryesore, përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar.

4. Anëtarët e senatit në institucionet e arsimit të lartë i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së, në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull dhe, për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë, sipas përcaktimeve të bëra në statutin e institucionit. Në Senatin Akademik përfaqësohen edhe studentët në institucionet publike, në masën dhjetë për qind, ndërsa në institucionet jopublike përfaqësohen në masën e përcaktuar në statutin e institucionit.

5. Numri i anëtarëve, mënyra e funksionimit dhe përfaqësimi i njësive kryesore në senat përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Neni 38

Funksionet e Senatit Akademik

1. Funksionet e Senatit Akademik janë:

a) garanton autonominë e institucionit të arsimit të lartë, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;

b) propozon planin strategjik të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë;

c) miraton statutin e institucionit të arsimit të lartë me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit;

ç) harton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet;

d) miraton rregulloret e institucionit dhe aktet e tjera, sipas përcaktimeve të bëra në statut;

dh) miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet si dhe mbylljen e tyre. Programet e reja të studimit duhet të jenë të mbështetura në projektbuxhetin vjetor të institucionit;

e) propozon mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;

ë) miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të institucionit të arsimit të lartë mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Në këto raste merr vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit;

f) miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore;

g) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati, dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin; gj) zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit;

h) miraton paraprakisht planin buxhetor vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit;

i) krijon Komisionin e Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, për dhënien e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", kur institucioni plotëson kriteret ligjore, si edhe komisionet e tjera të përcaktuara në statutin e institucionit;

j) garantonsigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionin e arsimit të lartë;

k) krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik;

l) organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprim- tarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atë financiare.

2. Kompetenca për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në shkronjat “b”, “ç”, “e”, “ë” dhe “h”, të pikës 1, të këtij neni, në institucionet jopublike të arsimit të lartë, përcaktohen në statutet e tyre.

3. Funksione të tjera të Senatit Akademik përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Neni 39

Rektori

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Në institucionet publike të arsimit të lartë, ai zgjidhet nga anëtarët e asamblevetë personelit akademik të njësive kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e rektorit llogariten në masën dhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidatët për rektor vetëkandidohen.

3. Rektori në institucionet e arsimit të lartë mban titullin “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij. Kriteret specifike përzgjedhëse të kandidatëve konkurrues përcak-tohen në statutin e IAL-së përkatëse.

4. Rektori drejton Senatin Akademik dhe raporton para tij.

5. Rektori nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik në institucionet e arsimit të lartë.

6. Rektori i paraqet senatit planin strategjik të zhvillimit të institucionit.

7. Mandati i rektorit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.

8. Presidenti i R epublikës dekreton rektorët e institucioneve të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

9. Në rastet e krijimit të një universiteti publik, Presidenti i Republikës emëron rektorin e tij për një mandat me kohëzgjatje njëvjeçare, me detyrë organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme të atij institucioni brenda këtij mandati. Në rastin e largimit të rektorit për shkaqe

ligjore ose mospërmbushje të detyrës, ministri përgjegjës për arsimin komandon në detyrë një prej zëvendësrektorëve për një afat deri në gjashtë muaj, me qëllim organizimin e zgjedhjeve në institucion.

10. Në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë, ministri pezullon rektorin dhe i propozon Presidentit të Republikës shkarkimin e tij, i cili shprehet brenda një muaji. Në rast se Presidenti i Republikës nuk shprehet brenda këtij afati, propozimi i ministrit konsiderohet i miratuar në

heshtje. Pas dekretimit të shkarkimit, ministri shpall zgjedhje të parakohshme brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit.

11. Rektori i propozon ministrit përgjegjës për arsimin shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë kryesore të institucionit publik, në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë. Ministri shprehet brenda një muaji. Rektori cakton njërin prej zëvendësve të autoritetit deri në zgjedhjen e autoritetit të ri brenda dy muajve nga data e shkarkimit. Rektori, menjëherë pas shkarkimit, shpall zgjedhje të parakohshme brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit.

12.Funksione të tjera të rektorit përcaktohen në statutin e institucionit.

Neni 40

Rektorati

1. Rektorati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjial që drejtohet nga rektori dhe përbëhet nga:

a) rektori;

b) zëvendësrektori/ët;

c) administratori i institucionit;

ç) drejtuesit e njësive kryesore;

d) autoritete të tjera, të përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

2. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në statutin e tyre numrin e zëvendësrektorëve, të cilët i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Ata janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga rektori, pas miratimit në Senatin Akademik.

3. Rektorati harton planin strategjik të zhvillimit të institucionit, mbështetur në propozimet e njësive bazë dhe kryesore të institucionit, si dhe ato të administratorëve.

4. Funksionet e rektoratit përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Neni 41

Asambleja e personelit akademik

1. Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësive kryesore.
2. Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore në institucionet e arsimit të lartë ka këto funksione:

a) zgjedh rektorin e institucionit në institucionet publike të arsimit të lartë;

b) zgjedh anëtarët e Senatit Akademik në institucionet publike të arsimit të lartë;

c) zgjedh drejtuesin e njësisë kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë;

ç) krijon dhe zgjedh anëtarët e komisioneve të përhershme të njësisë kryesore.

3. Asambleja e personelit akademik mund të ushtrojë edhe kompetenca të tjera, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Neni 42

Drejtuesi i njësisë kryesore

1. Drejtuesi i njësisë kryesore është dekani i fakultetit, drejtori i institutit kërkimor-shkencor, kur instituti plotëson standardet si njësi kryesore, si dhe drejtori i kolegjit profesional të lartë, në rastet kur ky i fundit krijohet pranë institucioneve të arsimit të lartë të llojit universitet ose kolegj universitar.

2. Drejtuesi është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.

3. Në institucionet publike të arsimit të lartë ai zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e drejtuesit llogariten në masën dhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidati për drejtues vetëkandidohet. Ai është personel akademik i kategorisë "Profesor"dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të

institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij. Kriteret specifike përzgjedhëse të kandidatëve konkurrues përcaktohen në statutin e IAL-së përkatëse.

4. Mandati i drejtuesit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.

5. Në ins titucionet publike të arsimit të lartë rektori emëron drejtues të njësisë kryesore kandidatin fitues të zgjedhjeve.

6. Në rastet e krijimit të një njësie të re kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë, ose në rastet e krijimit të një institucioni të ri të arsimit të lartë, drejtuesi i saj emërohet nga rektori për një mandat me kohëzgjatje njëvjeçare, me detyrë organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve të drejtuesit të njësisë kryesore dhe njësive përbërëse, brenda kohëzgjatjes së mandatit.

7. Drejtuesi i njësisë kryesore i përcjell Senatit Akademik propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij.

8. Funksione të tjera të këtij autoriteti drejtues përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucioneve të arsimit të lartë.
9. Drejtuesi i njësisë kryesore i propozon rektorit shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë bazë në institucionet publike të arsimit të lartë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë. Rektori shprehet brenda një muaji. Zëvendësuesi i drejtuesit të njësisë bazë caktohet nga rektori, me propozimin e drejtuesit

të njësisë kryesore. Rektori shpall zgjedhje të parakohshme brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit.

10. Drejtuesi i njësisë kryesore i propozon administratorit të institucionit shkarkimin e administratorit të njësisë kryesore.

Neni 43

Dekanati

1. Dekanati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjial që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:

a) dekani;

b) zëvendësdekanët;

c) administratori i njësisë kryesore;

ç) drejtuesit e njësive bazë;

d) autoritete të tjera të përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

2. Zëvendësdekanët janë anëtarë me kohë të plotë të personelit akademik. Ata emërohen dhe shkarkohen nga dekani, sipas përcaktimeve të bëra në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

3. Dekanati harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore, mbështetur në propozimet e njësive bazë të tij, si dhe ato të administratorit të njësisë kryesore.

4. Dekanati koordinon veprimtarinë e njësive bazë.

5. Funksionet e dekanatit përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë.

Neni 44

Këshilli i etikës i institucionit

1. Këshilli i etikës ngrihet pranë institucioneve të arsimit të lartë. Ai promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale.

2. Rregullat e organizimit dhe funksionimit të këshillit të etikës përcaktohen në statutet e institucioneve të arsimit të lartë, si dhe në rregulloret e tyre të brendshme.

Neni 45

Drejtuesi i njësisë bazë

1. Drejtuesi i njësisë bazë është drejtuesi i departamentit ose i qendrës kërkimore-shkencore. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë. Në institucionet publike të arsimit të lartë ai zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë bazë. Në institucionet jopublike të arsimit të lartë, ai zgjidhet ose emërohet sipas përcaktimeve në statutin e institucionit.

2. Në institucionet publike të arsimit të lartë drejtuesi i njësisë kryesore emëron drejtues të njësisë bazë kandidatin fitues të zgjedhjeve. Në rastet e krijimit të një njësie të re bazë në institucionet publike të arsimit të lartë, ose në rastet e krijimit të një institucioni të ri të arsimit të lartë, drejtuesi i saj emërohet nga dekani për një mandat me kohëzgjatje deri në zhvillimin e zgjedhjeve të drejtuesit të njësisë bazë.

3. Kandidati për drejtues vetëkandidohet dhe është personel akademik i kategorisë "Profesor" ose ka gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore "Doktor". Kritere të tjerapërzgjedhëse të kandidatëve konkurrues përcaktohen në statutin e IAL-së përkatëse.

4. Drejtuesi mund të shërbejë në detyrë për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike. Bën përjashtim rasti kur, si rezultat i zbatimit të dispozitës së këtij paragrafi, nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

5. Drejtuesi i propozon administratorit të institucionit shkarkimin e administratorit të njësisë bazë.

6.Funksionet e drejtuesit të njësisë bazë rregullohen në statutin dhe rregulloret e institu-cionit të arsimit të lartë.

Neni 46

Komisionet e përhershme

1. Komisionet e përhershme janë organe kolegjiale, që kryejnë funksione në fushat e përcaktuara në statut, që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit.

2. Komisionet e përhershme krijohen në nivel institucional dhe në nivel të njësisë kryesore. Ato përbëhen prej jo më pak se pesë anëtarësh.

3. Anëtarët e komisioneve të përhershme të institucionit të arsimit të lartë vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore në institucionet e arsimit të lartë vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

4. Në rastet kur institucioni i arsimit të lartë ofron dhënien e gradës shkencore "Doktor", asambleja e personelit akademik të njësisë kryesorepërzgjedh nga personeli akademik i njësisë kryesore përkatëse anëtarët e komisionit të përhershëm, që monitorojnë procesin për dhënien e gradës shkencore. Ata mbajnë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar". Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

5. Në rastet kur institucioni i arsimit të lartë plotëson kushtet për dhënien e titujve akademikë "Profesor" dhe "Profesor i asociuar", Senati Akademik përzgjedh nga personeli

akademik i njësive kryesore anëtarët e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik. Ata mbajnë titullin "Profesor". Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

6. Në përbërje të komisioneve të përhershme përfaqësohen dhe studentët, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit të arsimit të lartë, me përjashtim të Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" dhe Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik. Numri maksimal i anëtarëve të komisioneve dhe i vetë komisioneve, funksionet dhe organizimi i tyre përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë.

Seksioni 2

Organizimi administrativ

Neni 47

Bordi i Administrimit

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjial administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Neni 48

Përbërja dhe krijimi i Bordit të Administrimit

1. Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë apo propozohen nga njësitë bazë të institucionit të arsimit të lartë apo institucioneve përkatëse. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë

ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Përbërja e Bordit të Administrimit përcak-tohet në varësi të planit buxhetor afatmesëm të institucionit publik të arsimit të lartë, të miratuar nga Bordi i Administrimit.

Nëse institucioni siguron vetë pesëdhjetë për qind ose më shumë të buxhetit afatmesëm, katër prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së dhe tre janë përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Në rastet kur institucioni siguron vetë më pak se pesëdhjetë për qind të buxhetit afatmesëm, tre prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së dhe katër janë përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
Në rastet kur njësia e qeverisjes vendore, në territorin e së cilës zhvillon veprimtarinë institucioni i arsimit të lartë, kontribuon financiarisht, së paku në masën prej dhjetë për qind të buxhetit afatmesëm të IAL-së, atëherë një prej përfaqësuesve, që i takon ministrisë përgjegjëse për arsimin, përcaktohet nga njësia e qeverisjes vendore.

3. Niveli i kontributit financiar të ministrisë, të qeverisjes vendore dhe të vetë institucionit bazohet në planin buxhetor afatmesëm të institucionit, me marrëveshje midis tyre. Ky plan përditësohet çdo vit dhe në fund të vitit të tretë financiar bëhet rivlerësimi i financimit dhe përcaktimi i pjesëmarrjes së kontribuesve në Bordin e Administrimit.

4. Për institucionet e arsimit të lartë, të cilat gëzojnë status të veçantë, njëri prej anëtarëve, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, emërohet nga ministri i linjës.

5. Bordi i Administrimit në institucionet jopublike të arsimit të lartë krijohet dhe funksionon sipas përcaktimeve të bëra në statutet e tyre.

6. Rektori, drejtuesit e njësive kryesore, drejtuesit e njësive bazë dhe administratorët nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Administrimit, por mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e tij.

Neni 49

Funksionet e Bordit të Administrimit në institucionet e arsimit të lartë

1. Bordi i Administrimit ka këto fun ksione kryesore:

a) garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;

b) me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;

c) me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;

ç) me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;

d) vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;

dh) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;

e) jep mendim për projektrregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;

ë) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

f) është përgjegjës për caktimin e kritereve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;

g) emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
gj) miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;

h) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

2. Në institucionet publike të arsimit të lartë vendimet e Bordit të Administrimit, për përcaktimin e bërë në shkronjën "gj", të pikës 1, të këtij neni, merren me jo më pak se tre të pestën e votave të anëtarëve.

3. Kompetencat për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në shkronjat "b", "c", "ç", "d" dhe

"dh", të pikës 1, të këtij neni, në institucionet jopublike të arsimit të lartë, përcaktohen në statutet e tyre.

4. Funksione të tjera të Bordit të Administrimit përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Neni 50

Mbarimi i parakohshëm i mandatit të autoriteteve drejtuese dhe anëtarëve të zgjedhur të organeve drejtuese të institucionit publik të arsimit të lartë

1. Mandati i autoritetit ose i anëtarit të zgjedhur mbaron para kohe në rastet:

a) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

b) kur anëtari i organit ose autoriteti jep dorëheqjen;

c) e pamundësisë për të kryer detyrën;

ç) e shkeljeve të rënda të ligjit;

d) e tjera të parashikuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë; dh) e ndryshimit të raporteve të

përfaqësimit në organin drejtues.

2. Shkarkimi i anëtarëve të Bordit të Administrimit bëhet nga ministri përgjegjës për arsimin, me propozimin e organit që i zgjedh apo emëron.

3. Shkarkimi për secilin autoritet apo anëtar bëhet sipas procedurave të parashikuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

4. Në rast mbarimi të parakohshëm të mandatit të autoriteteve dhe anëtarëve të zgjedhur të organeve, mandati i anëtarit të ri të zgjedhur të organit drejtues është plotësues.

Neni 51

Administratori i institucionit të arsimit të lartë

1. Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
2. Në institucionet publike të arsimit të lartë, ai përzgjidhet me konkurs të hapur, sipas kritereve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Lista e kandidaturave që plotësojnë kriteret miratohet nga

Senati Akademik. Emërimi i administratorit bëhet nga Bordi i Administrimit. Në institucionet jopublike të arsimit të lartë administratori emërohet dhe shkarkohet sipas përcaktimeve në statutin e institucionit.

3. Administratori i institucionit publik të arsimit të lartë shkarkohet nga Bordi i Administrimit me 2/3 e votave të anëtarëve të tij.

4. Administratori duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin "Master i shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune së paku shtatë vjet në këto fusha.

5. Administratori nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.

6. Administratori i raporton për veprimtarinë e tij Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit të arsimit të lartë.

Neni 52

Funksionet e administratorit

1. Administratori kryen këto funksione:

a) harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;

b) propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimin e tyre;

c) ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit të arsimit të lartë në strukturat e varësisë së tij;

ç) zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ;

d) i paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit të arsimit të lartë, në përfundim të vitit akademik;

dh) bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të institucionit të arsimit të lartë për çështje të administrimit të përditshëm;

e) emëron dhe shkarkon administratorët e njësive kryesore dhe njësive bazë pas miratimit të Bordit të Administrimit;

ë) plotëson kërkesat e rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.

2. Funksione të tjera të administratorit përcaktohen në statut dhe në rregulloret e institucionit.

Neni 53
Administratori i njësisë kryesore

1. Administratori i njësisë kryesore është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të saj.

2. Në institucionet publike të arsimit të lartë, ai zgjidhet me konkurs, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Në institucionet jopublike të arsimit të lartë administratori emërohet sipas kritereve të përcaktuara në statutin e institucionit.

3. Administratori i njësisë kryesore duhet të ketë formim universitar, së paku në nivelin "Master i shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune, së paku pesë vjet në këto fusha.

4. Administratori i njësisë kryesore nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.

5. Administratori i njësisë kryesore i raporton për veprimtarinë e tij administratorit të institucionit të arsimit të lartë, si dhe informon drejtuesin e njësisë kryesore, sipas përcaktimeve në aktet e institucionit të arsimit të lartë.

6. Administratori i njësisë kryesore propozon shkarkimin e administratorëve të njësive bazë.

Neni 54

Funksionet e administratorit të njësisë kryesore në institucionet e arsimit të lartë

1. Funksionet e administratorit të njësisë kryesore janë:

a) realizon administrimin e përditshëm financiar të njësisë kryesore;

b) mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë financiare të njësisë kryesore;

c) plotëson kërkesat e drejtuesit të njësisë kryesore, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;

ç) bashkëpunon me autoritetet dhe organet drejtuese të njësisë kryesore për çështjet themelore të administrimit të saj.

2. Funksione të tjera të administratorit përcaktohen në statut dhe në rregulloret e institucionit.

Neni 55

Administratori i njësisë bazë në institucionet e arsimit të lartë

1. Administratori i njësisë bazë është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të saj. Ai ushtron veprimtari mbështetëse në funksion të realizimit të misionit të një ose më shumë njësive bazë. Bordi i Administrimit, me kërkesë të njësisë bazë, propozon përfshirjen ose jo të këtij autoriteti në strukturën e institucionit. Në rastet kur parashikohet ekzistenca e këtij autoriteti, Bordi i Administrimit mund të përcaktojë, në varësi të madhësisë dhe kapacitetit financiar të institucionit, numrin e njësive që mund të administrohen nga një administrator.

2. Në institucionet publike të arsimit të lartë, ai zgjidhet nga administratori i institucionit, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Në institucionet

jopublike të arsimit të lartë administratori emërohet sipas kritereve të përcaktuara në statutin e institucionit.

3.Administratori i njësisë bazë duhet të ketë formim universitar, së paku në nivelin "Master i shkencave", në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune së paku tre vjet në këto fusha.

4. Administratori i njësisë bazë nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.

5.Administratori i njësisë bazë i raporton për veprimtarinë e tij administratorit të njësisë kryesore dhe drejtuesit të njësisë bazë, sipas përcaktimeve në aktet e institucionit të arsimit të lartë.

Neni 56

Funksionet e administratorit të njësisë bazë në institucionet e arsimit të lartë

1. Funksionet e administratorit të njësisë bazë janë:

a) administron fondet e njësisë/njësive bazë;

b) zbaton vendimet e administratorit të njësisë kryesore për mënyrën e ndarjes së të ardhurave të krijuara nga njësia/njësitë bazë;

c) plotëson kërkesat e drejtuesit të njësisë bazë, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.

2. Funksione të tjera të administratorit të njësisë bazë përcaktohen në statut dhe në rregulloret e institucionit të arsimit të lartë.

KREU VI

PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

Neni 57

Personeli i institucioneve të arsimit të lartë

1. Personeli i institucioneve të arsimit të lartë përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmësakademik dhe personeli administrativ.

2. Personeli i institucioneve të arsimit të lartë mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të p jesshme.

3. Të drejtat dhe detyrimet e personelit të institucioneve të arsimit të lartë përcaktohen në statutet dhe aktet e brendshme të tyre, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 58

Statusi i personelit akademik

1. Personeli akademik gëzon status dhe trajtim të veçantë. Statusi dhe trajtimi i veçantë propozohen nga ministri përgjegjës për arsimin, pasi ka marrë mendimin nga KALKSH-i, dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave.

2. Institucionet publike të arsimit të lartë mund të kontribuojnë në trajtimin e veçantë financiar të personelit akademik, krahas përfitimeve nga Buxheti i Shtetit.

3. Aspekte të trajtimit të veçantë, si dhe përfitime të tjera të personelit akademik të institucioneve të arsimit të lartë përcaktohen nga Bordi i Administrimit.

Neni 59

Kategoritë e personelit akademik

1. Personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të institucionit të arsimit të lartë, këshillim për studentët si dhe veprimtari të tjera.

2. Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:

a) profesorë;

b) lektorë;

c) asistent-lektorë.

3. Në kategorinë "Profesorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë "Profesor" ose "Profesor i asociuar". Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.

4. Në kategorinë "Lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore "Doktor", kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade dhe përmbushin kriteret e përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.

5. Në kategorinë "Asistent-lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën "Master i shkencave" dhe të përmbushin kriteret e përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Asistent-lektori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të caktuar.

6. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Në kolegjet profesionale të larta, personeli akademik duhet të ketë fituar së paku diplomën "Master profesional".

7. Raportet ndërmjet veprimtarive të ndryshme për personelin akademik, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përcaktohen nga institucioni i arsimit të lartë.

8. Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik në institucionet publike të arsimit të lartë përcaktohet nga institucioni, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Në institucionet jopublike ngarkesa minimale përcaktohet nga vetë institucioni.

Neni 60

Titujt akademikë

1. Titujt akademikë "Profesor" dhe "Profesor i asociuar" jepen nga institucionet e arsimit të lartë, të llojit "universitet", të cilët:

a) ushtrojnë veprimtari akademike dhe kërkimore-shkencore, në mënyrë të vazhdueshme, për jo më pak se dhjetë vjet;

b) janë institucione të akredituara;

c) kanë të punësuar si personel akademik jo më pak se tetëmbëdhjetë anëtarë të personelit akademik që mbajnë titullin "Profesor", me kohë të plotë, me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar. Në çdo rast, universiteti duhet të ketë të paktën pesë pedagogë me kohë të plotë që mbajnë titullin profesor në çdo fakultet;

ç) ofrojnë studimet e doktoratës apo specializime afatgjata;

d) përmbushin kritere të tjera shtesë, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Lista e institucioneve të arsimit të lartë, që përmbushin kriteret për dhënien e titujve akademikë, publikohet zyrtarisht çdo vit akademik nga ministria përgjegjëse.

3. Standardet shtetërore për fitimin e titujve "Profesor" dhe "Profesor i asociuar" përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë, me veprimtari në fushën e arteve, sporteve, rendit dhe mbrojtjes, mund të japin tituj të tjerë, veç atyre të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, ekuivalent me to, sipas parashikimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

Neni 61

Fitimi i titujve akademikë

1. Për fitimin e titullit "Profesor i asociuar" mund të aplikojë personeli akademik që gëzon gradën shkencore "Doktor", prej së paku pesë vitesh, është personel akademik i kategorisë "Lektor" dhe përmbush standardet shtetërore për fitimin e titullit. Për fitimin e titullit "Profesor" mund të aplikojë personeli akademik që gëzon prej së paku pesë vjetësh titullin "Profesor i asociuar", si dhe përmbush standardet shtetërore për fitimin e t itullit.

2. Personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë, të cilat nuk përmbushin kriteret për dhënien e titujve akademikë, si dhe personat, të cilët nuk janë personel akademik pranë ndonjë institucioni, por përmbushin standardet për fitimin e titujve, paraqesin kërkesën pranë një institucioni, i cili përmbush kriteret për dhënien e titujve.

3. Kandidati për fitimin e titullit “Profesor i asociuar” ose “Profesor” paraqet dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore. Dosja e kandidatit i përcillet senatit akademik, pas paraqitjes dhe vlerësimit në njësinë bazë. Senati i kalon dosjen

Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, i cili merr vendimin përfundimtar pas vendimit të jurisë mbi përmbushjen e standardeve. Titulli regjistrohet në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin. Titulli akademik lëshohet nga institucioni dhe firmoset nga rektori.

4. Në rast vlerësimi negativ të kërkesës për fitimin e titujve akademikë nga Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik,kandidatit i lind e drejta të ripërsërisë kërkesën pas një periudhekohore jo më të shkurtër se dy vjet.

5. Personelit akademik, që mban titullin “Profesor”, pas daljes në pension, në vlerësim të veprimtarisë së spikatur akademike, me propozim të njësisë bazë ku ka zhvilluar karrierën e tij dhe me vendim të Senatit Akademik, i akordohet titulli “Profesor emeritus”.

Neni 62

Personeli akademik i ftuar

1. Njësitë bazë të institucioneve të arsimit të lartë kanë të drejtë të kërkojnë të punësohenme kontratë për periudha të shkurtra kohe studiues, personalitete, artistë vendas ose të huaj.

2. Për përzgjedhjen e personelit akademik të ftuar ndërthuren kualifikimet e tyre me nevojën e njësisë bazë për veprimtari mësimdhënieje ose kërkimore-shkencore.

3. Personeli i ftuar punësohet sipas përcak-timeve në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë.

4. Shpenzimet për personelin akademik të ftuar përballohen nga të ardhurat e institucionit.

Neni 63

Viti akademik sabatik

Personeli akademik i kategorisë “Lektor” dhe “Profesor”, me miratim të njësisë bazë ku zhvillon veprimtarinë akademike, ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institucionit, një herë në shtatë vjet, për periudha kohe deri në një vit, për të punuar për përparimin e tij akademik. Mënyra e rregullimit të marrëdhënieve juridike ndërmjet palëve për këtë periudhë përcaktohet në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Neni 64

Punësimi i personelit akademik

1. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, dhe miratohen nga rektori. Konkursi në institucionet publike të arsimit të lartë drejtohet nga një komision adhoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit adhoc, si edhe të përzgjedhjes së personelit akademik caktohen në statutin e IAL-së.

Në institucionet jopublike kriteret, rregullat dhe procedurat për punësimin e personelit akademik përcaktohen në statutin e institucionit.

2. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në një institucion të arsimit të lartë nuk mund të punësohet si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjetër të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit. Ai mund të angazhohet me kohë të pjesshme vetëm në një institucion tjetër të arsimit të lartë, me miratimin e drejtuesit të njësisë bazë dhe të rektorit, si dhe në marrëveshje mes institucioneve. Pjesëmarrja e personelit akademik në projekte, konsulenca, botime dhe shërbime që realizohen në institucionin e arsimit të lartë, ku ai është i punësuar me kohë të plotë, nuk konsiderohet si dypunësim brenda institucionit.

Neni 65

Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik

1. Personeli akademik, që mban titullin "Profesor", shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur, me kërkesën e tij, largohet nga detyra. Mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

2. Personeli akademik, që mban titullin "Profesor i asociuar", shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç. Mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

3. Personeli akademik i kategorisë "Profesor" mund të shkëputet përkohësisht nga institucioni i arsimit të lartë, për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh, për t'u angazhuar në detyra të rëndësishme shtetërore dhe politike. Për periudhën e shkëputjes mund të zëvendësohet nga personel akademik i p unësuar me kontratë me afat të caktuar. Pas përfundimit të detyrës, me kërkesë të tij, anëtari i personelit akademik rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlershëm.

Neni 66

Personeli ndihmësakademik

1. Personeli ndihmësakademik ndahet në personel ndihmësakademik me karakter mësimor dhe ndihmësakademik me karakter administrativ.

2. Personeli ndihmësakademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Në këtë kategori futen laborantët dhe teknikët, si dhe personel tjetër, sipas përcaktimeve të bëra në aktet e brendshme të institucionit.

3. Personeli ndihmësakademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. Në këtë kategori bëjnë pjesë personeli i përcaktuar në aktet e brendshme të institucionit.

4. Kriteret e punësimit të personelit ndihmës-akademik, me kohë të plotë, propozohen nga njësia së cilës ky personel i shërben, bazuar në nevojat e kësaj të fundit. Konkursi në institucionet e arsimit të lartë drejtohet nga një komisionadhoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë përkatëse.
Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit adhoc, si edhe të përzgjedhjes së personelit ndihmësakademik caktohen në aktet e brendshme të IAL-së.

Neni 67

Personeli administrativ

1. Kategoritë e personelit administrativ dhenivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit të institucionit të arsimit të lartë, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në statutin dhe rregulloret e tyre procedurat e vlerësimit të punës së personelit administrativ, politikat e motivimit, shpërblimit, zhvillimit e trajnimit të tij, si edhe procedurat për masat disiplinore.

3. Punësimi i personelit administrativ në institucionet publike të arsimit të lartë bëhet me konkurs publik. Kriteret e punësimit përcaktohen në statutet dhe rregulloret e brendshme të institucioneve.

Neni 68

Masat disiplinore për personelin akademik

1. Masat disiplinore përcaktohen në përputhje me statutin dhe aktet e tjera të IAL-së.

2. Largimi nga detyra i personelit akademik të IAL-së bëhet nga rektori i institucionit, me propozimin e drejtuesit të njësisë bazë, ku personeli akademik zhvillon veprimtarinë e tij dhe pas miratimit të komisionit adhoc, të ngritur nga Senati Akademik, në rastet e shkeljeve të rënda dhe të përsëritura të ligjit, sipas përcaktimeve në statut dhe në aktet e tjera të IAL-së.

KREU VII

ORGANIZIMI I STUDIMEVE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Neni 69

Format e studimeve dhe pranimi në institucionet e arsimit të lartë

1. Format e studimeve në institucionet e arsimit të lartë janë:

a) studime me kohë të plotë;

b)studime me kohë të zgjatur.

2. Studimet me kohë të zgjatur mund të ofrohen në programet e studimit një deri në dyvjeçare me karakter profesional, programet e ciklit të dytë “Master profesional” dhe programet e ciklit të tretë “Master ekzekutiv”. Programet e studimit, që japin të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë.

3. Pranimet e studentëve në institucionet e arsimit të lartë në të gjitha programet e studimit bëhen me vendim të institucioneve, në përputhje me standardet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore. Këto standarde verifikohen dhe certifikohen nga ministria përgjegjëse për arsimin, përpara deklarimit të kuotave të pranimit nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë.

Neni 70

Ciklet dhe programet e studimeve

1. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS).

2. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite.

3. Programet e studimeve hartohen nga njësitë bazë të institucioneve të arsimit të lartë dhe miratohen në senatet e tyre akademike.

4. Programet e studimeve në institucionet e arsimit të lartë organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë dhe diploma profesionale, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

5. Institucionet e arsimit të lartë shpallin publikisht programet e hapura dhe ato të akredituara të studimeve, para fillimit të aplikimeve për pranimin e studentëve.

Neni 71

Programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë

1. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe studimi në cikle të ndryshme në varësi të llojit të institucionit, si dhe programe me karakter profesio nal të lartë dhe programe të formimit të vazhduar në fushat ku ato plotësojnë kriteret dhe përmbushin standardet shtetërore.

2. Elementet, që duhet të përmbajnë programet e studimit, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në statut dhe rregullore elemente të hollësishme për programet e studimeve që ato ofrojnë.

Neni 72

Programet e studimit me karakter profesional

1. Institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, me 60 ose 120 kredite formimi, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja e tyre normale është një ose dy vite akademike dhe në përfundim lëshohet respektivisht “Certifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer.

2. Kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, që referohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas kritereve të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

Neni 73

Programet e ciklit të parë të studimeve

1. Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 krediteeuropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

2. Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloren e tyre pragun e notës mesatare, që i jep të drejtë studentit të ciklit të parë të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome.

3. Në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma "Bachelor" në fushën e arsimimit të kryer.

Neni 74

Pranimi në ciklin e parë të studimeve

1. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Institucionet e arsimit të lartë mund të vendosin edhe kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat shpallen nga institucioni i arsimit të lartë dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

3. Në fillim të vitit akademik, institucionet e arsimit të lartë dërgojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar.

Neni 75

Programet e ciklit të dytë të studimeve

1. Cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit "Master i shkencave", "Master i arteve" dhe "Master profesional", referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Të gjitha kriteret dhe modalitetet e fitimit të diplomave "Master i arteve" janë të njëjta me ato për fitimin e diplomës "Master i shkencave", me ndryshimin që diploma "Master i arteve" lëshohet nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë formime në fushën e arteve.

3. Programet e studimit "Master i shkencave" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen në:

a) programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike;

b) programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë, që realizohen me 300 dhe 360 kredite dhe me kohëzgjatje normale respektivisht pesë dhe gjashtë vite akademike. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ofrohen në fushat e drejtësisë, mjekësisë, të stomatologjisë, të farmacisë, të veterinarisë e të arkitekturës. Këshilli i Ministrave përcakton fusha të tjera, në të cilat mund të ofrohen programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

4. Programet e studimit "Master i arteve" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, në fushën e arteve. Këto programe realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike.

5. Studimet e ciklit të dytë "Master i shkencave" përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master i shkencave" në fushën e arsimimit të kryer. 6. Programet e studimeve "Master profesional" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen me 60 ose 120 kredite dhe

kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike. Studimet e ciklit të dytë "Master profesional" përmbyllen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master profesional" në fushën e arsimimit të kryer.

Neni 76

Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve

1. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimi t të lartë ku ata aplikojnë.

2. Pranimi në programet e integruara të studimeve është i mundur për kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1, të nenit 74, të këtij ligji.

3. Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve përcaktohen nga njësia bazë ofruese e programit. Bëjnë përjashtim nga ky rregull programet e integruara të studimit. Kriteret bëhen publike nga njësia kryesore dhe QSHA-ja dhe miratohen sipas përcaktimeve në statutin e IAL-së.

4. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.

5. Institucionet e arsimit të lartë mund të njohin kredite të përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional", me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit "Master i shkencave".

6. Në fillim të vitit akademik, institucionet e arsimit të lartë dërgojnë në QSHA listën e studentëve të regjistruar.

Neni 77

Programet e ciklit të tretë të studimeve

1. Cikli i tretë i studimeve përfshin programet e studimeve “Master ekzekutiv”, programet e studimeve specializuese afatgjata, si dhe studimet e
doktoratës, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Programet e studimeve “Master ekzekutiv” ofrojnë arsimim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional. Ato kanë kohëzgjatje normale një ose dy vite akademike dhe organizohen përkatësisht me 60 ose 120 kredite. Ato përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma “Master ekzekutiv” në fushën e arsimimit të kryer.

3. Programet e studimeve specializuese afatgjata janë programe të formimit profesional që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta. Ato zgjasin jo më pak se dy vite akademike dhe organizohen me jo më pak se 120 kredite. Ato përmbyllen me provim formimi ose me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet “Diplomë specializimi” në fushën përkatëse të programit të studimit.

4. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”. Institucionet e arsimit të lartë vendosin kritere për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor.

Neni 78

Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve

1. Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën “Masteri shkencave” ose “Master i arteve”dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë.

2. Kriteret e pranimit në programet e ciklit të tretë përcaktohen nga njësitë bazë, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Këto kritere bëhen publike nga IAL-ja dhe i përcillen QSHA-së, si dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

3. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të tretë është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombë-

tare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

4. Lista e studentëve fitues dërgohet në QSHA, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

5. Lista e të diplomuarve në programet e ciklit të tretë përcillet nga institucioni i arsimit të lartë në ministrinë përgjegjëse për t'u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë.

Neni 79

Studimet e doktoratës

1. Institucionet e arsimit të lartë, që ofrojnëstudime të doktoratës, hartojnë projekte kërkimoreshkencore dhe zhvillimi për këto studime. Ato aplikojnë për financim pranë AKKSHI-t apo institucioneve të tjera financuese.

2. Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.

3. Kur studimet e doktoratës zhvillohen në bashkëpunim midis institucioneve të arsimit të lartë, pjesë të procesit kërkimor, mund të zhvillohen pranë institucioneve bashkëpunuese.

4. Numri i studentëve doktorantë që rcaktohet nga njësia bazë dhe projekti kërkimor i çdo doktoranti përcaktohet në varësi të projekteve kërkimore të kësaj të fundit.

5. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, studenti mund të përfitojë edhe financime nga subjekte të tjera apo të vetëfinancohet.

6. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar" dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë. Ky numër përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik i kategorisë "Profesor" ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar dhe përcaktohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Në rastet kur një pjesë e studimeve të doktoratës kryhet në një institucion të arsimit të lartë të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, SHBA-ve dhe Kanada-së, bashkudhëheqësi në institucionin pritës mund të jetë me gradën shkencore "Doktor".

7. Këshilli i Ministrave miraton kriteret që duhet të përmbushë kandidati për fitimin e gradës shkencore "Doktor", sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe standardet për fitimin e titujve akademikë "Profesor" dhe "Profesor i asociuar".

Neni 80

Programet e përbashkëta të studimit

1. Programet e përbashkëta të studimit realizohen nga një institucion i arsimit të lartë ose njësi kryesore të tij, në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë vendit.

2. Procesi i realizimit të programeve të përbashkëta mund të kryhet në një ose në institucionet pjesëmarrëse, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit.

3. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse.

4. Në kushtet e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore.

5. Hapja e programeve të përbashkëta të studimit bëhet me miratimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Neni 81

Programet e studimeve të formimit të vazhduar

1. Institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë të gjithë jetës. Këto programe shërbejnë për plotësim, thellim e konsolidim të njohurive dhe mund të ofrohen si kurse kualifikimi e rikualifikimi, shkolla verore dhe veprimtari të ngjashme. Programet e studimeve të formimit të vazhduar ndihmojnë individët në rritjen e kualifikimit dhe të aftësive profesionale.

2. Struktura e këtyre programeve, kohëzgjatja dhe kreditet e tyre përcaktohen në mënyrë të pavarur nga secila njësi bazë përgjegjëse, në bashkëpunim me ministritë e linjës, nëse kanë kompetencë, sipas kuadrit ligjor për profesionet e rregulluara, dhe bëhen publike nga njësia kryesore.

3. Në përfundim të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, institucionet e arsimit të lartë lëshojnë certifikatat përkatëse, të cilat regjistrohen në përputhje me këtë ligj.

4. Institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë edhe kurse përgatitore për programet e studimeve që organizojnë.

Neni 82

Programet e studimit në fushën e drejtësisë

1. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë realizohen me 300 kredite, për një kohëzgjatje prej jo më pak se 5 vite akademike.

2. Personat që kanë kryer studimet e integruara në drejtësi, ose në një program të ciklit të dytë të studimeve, të barasvlershëm me to, mund të konkurrojnë për t'u përgatitur si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, avokatë të shtetit, përmbarues privatë ose shtetërorë, si dhe juristë në administratën shtetërore, qendrore dhe vendore, pasi të kenë kryer provimin e shtetit në drejtësi.

3. Provimi i shtetit organizohet nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe Ministria e Drejtësisë, sipas rregullave dhe procedurave, të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 83

Programet e studimit në fushën e mësuesisë

1. Programet e studimit në fushën e mësuesisë për arsim parashkollor dhe arsim fillor,organizohen në dy cikle:

a) program i ciklit të parë, “Bachelor”, që formon mësues të arsimit parashkollor;

b) program i ciklit të dytë “Master profesional”, që formon mësues të arsimit fillor.

2. Programet e studimit për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, me 120 kredite, sipas fushave përkatëse të formimit.
3. Programet e ciklit të dytë të studimit në fushën e mësuesisë duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik.

4. Programet e ciklit të dytë të studimit, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.

Neni 84

Programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë

Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me këtë ligj dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Neni 85

Ndjekja e një programi të dytë studimi në institucionet publike të arsimit të lartë

1. Individët, që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi të të njëjtit cikël. Në këtë rast, kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.

2. Në statutet e institucioneve të arsimit të lartë përcaktohen kriteret që duhet të plotësohen për t'u pranuar në një program të dytë studimi.

Neni 86

Kodifikimi i programeve të studimit

1. Programet e studimit organizohen dhe grupohen në kode që identifikojnë fusha të ngjashme studimi në nivel kombëtar. Kodifikimi i programeve të studimit bëhet nga ministria përgjegjëse për arsimin.

2. Programet e studimit, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.

3. Hapja e një programi të ri studimi shoqërohet me përcaktimin e kodit, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin.

4. Specifikimet dhe përmbajtja për kodifikimin e programeve të studimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 87

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet në institucionet e arsimit të lartë zhvillohen në vite akademike. Data zyrtare e fillimit të vitit akademik shpallet nga ministri përgjegjës për arsimin.

2. Viti akademik organizohet në semestra.
3. Frekuentimi i procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimdhënëse në auditor, dhe ciklit të studimit, është i detyrueshëm në një masë të caktuar, e cila përcaktohet bazuar në Kodin e Cilësisë dhe udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Organizimi i studimeve në institucionet e arsimit të lartë bëhet sipas përcaktimeve të këtij ligji ose të një modeli tjetër, kur ai ofrohet nga një institucion i arsimit të lartë, cili lëshon një diplomë të përbashkët ose të dyfishtë me një institucion të huaj.

Neni 88

Gjuha e studimeve

1. Programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë ofrohen normalisht në gjuhën shqipe. Këto programe mund të ofrohen dhe në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian, të miratuar në aktin përkatës të hapjes së programit të studimit. Përjashtohen nga ky rregull programet e përbashkëta të studimit të ofruara me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe programet e studimit që kanë për objekt mësimin e gjuhëve të huaja.

2. Në rastin e programeve të studimit që ofrohen në gjuhë të huaj, studentët duhet të dëshmojnë njohjen e gjuhës së huaj përkatëse në nivelin e nevojshëm për të kryer studime të larta, të përcaktuar nga institucioni i arsimit të lartë, ofrues i programit të studimit.

Neni 89

Transferimi i studimeve Njohja dhe njësimi i periudhave të studimit

1. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.

2. Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja, njihen dhe njësohen, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.

3. Njohja kryhet nga institucioni i arsimit të lartë, pranë të cilit është paraqitur kërkesa për vazhdimin e studimeve.

4. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik.

5. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë, në përputhje me këtë ligj dhe akte të tjera nënligjore.

6. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, më qëllim vazhdimin e studimeve në institucionin pritës të arsimit të lartë, i takon komisionit përkatës, të ngritur nga njësia bazë e institucionit të arsimit tëlartë.

Neni 90

Kohëzgjatja e studimeve

1. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.

2. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritës. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e saj.

Neni 91

Lëshimi i diplomave, certifik atave dhe suplementi i diplomës

1. Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën ose certifikatën përkatëse. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.

2. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë, si edhe ato "Master ekzekutiv" të ciklit të tretë shoqërohen me suplementin e diplomës.

3. Çdo formë diplome dhe certifikate, përpara se të lëshohet nga institucioni i arsimit të lartë, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit.

4. Institucionet e arsimit të lartë nuk mund të lëshojnë dublikatë diplome, por mund të lëshojnë dokument të barasvlershëm me diplomën në formën e vërtetimit, i cili duhet të përmbajë emrin e institucionit që ka lëshuar diplomën, numrin e diplomës origjinale, datën e lëshimit të saj, ciklin dhe programin e studimit.

5. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në statutin e institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Neni 92

Njohja e diplomave, certifikatave e gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit dhe njohja e titujve të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë

1. Diplomat, certifikatat e gradat e fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, njihen

dhe njësohen përmes lëshimit të dokumentit zyrtar, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes.

2. Një kualifikim apo program studimi i kryer jashtë vendit, për të cilin është lëshuar një certifikatë, diplomë apo gradë nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, që vërteton përfundimin e kualifikimit apo programit të studimit, vlerësohet, njihet dhe njësohet në bazë të Kornizës Europiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe të Kornizës së Kualifikimeve të Republikës së Shqipërisë, sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë.

3. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin zyrtar, në Republikën e Shqipërisë, të certifikatave, diplomave dhe gradave shkencore

është ministria përgjegjëse për arsimin. Ky proces kryhet nga njësia përgjegjëse e njësimit të diplomave.

4. Titujt e lëshuar jashtë vendit nga një institucion i huaj i arsimit të lartë njihen në Republikën e Shqipërisë, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, përmes procedurës zyrtare të njohjes.

5. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare, në Republikën e Shqipërisë, të titujve akademikëtë lëshuar jashtë vendit është ministria përgjegjëse për arsimin.

6. Procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave dhe gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, si dhe njohjen e titujve akademikë të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, duke respektuar marrëveshjet ndërkombë-tare të nënshkruara nga vendi ynë për këtë qëllim. Ministria përgjegjëse për arsimin mund të përcaktojë dhe vlefshmërinë e diplomës së njësuar, sipas fushës së punësimit.

7. Ministria përgjegjëse për arsimin mban bazën e të dhënave kombëtare të diplomave, certifikatave, gradave dhe titujve të njësuar apo tënjohur në Republikën e Shqipërisë.

KREU VIII

KËRKIMI SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Neni 93

Veprimtaria kërkimore-shkencore

1. Institucionet e arsimit të lartë kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore bazë ose të zbatuara, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese, të përcaktuara në statutin e tyre, sipas natyrës dhe objektivave specifikë të institucionit. Ato garantojnë integrimin e veprimtarisë kërkimore në atë të mësimdhënies.

2. Veprimtaria kërkimore-shkencore, që kryhet në institucionet e arsimit të lartë, synon të mbështetë zhvillimin e vendit dhe rritjen e cilësisë së arsimit.

3. Nëpërmjet veprimtarisë kërkimore-shkencore personeli akademik dhe studentët fitojnë aftësi për kërkime të pavarura, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional dhe të karrierës akademike.

4. Veprimtaria kërkimore-shkencore e krijuese rregullohen sipas këtij ligji, akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe statutit të institucioneve të arsimit të lartë.

Neni 94
Struktura e kërkimit shkencor

1. Veprimtaria kërkimore-shkencore zhvillohet, sipas përcaktimeve të këtij ligji, në:

a) institucionet e arsimit të lartë;

b) institutet dhe qendrat ndërinstitucionale të kërkim-zhvillimit;

c) institutet e kërkim-zhvillimit pranë ministrive.

2. Strukturat e sipërpërmendura të kërkimit shkencor zhvillojnë veprimtaritë e tyre në përputhje me misionin dhe fushat e kompetencës dhe u nënshtrohen kritereve të financimit të veprimtarisë së tyre kërkimore-shkencore, sipas këtij ligji dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ato kanë detyrimin të bëjnë publike veprimtarinë e tyre, si edhe rezultatet përkatëse, me përjashtim të rasteve të veçanta, që rregullohen me akte ligjore ose nënligjore.

3. Kërkimi shkencor zhvillohet e organizohet edhe në institucione të tjera, veprimtaria e të cilave rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 95

Kërkimi shkencor në institucionet e arsimit të lartë

1. Veprimtaritë e kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë realizohen mbi bazën e programeve dhe projekteve të miratuara nga organet kompetente në këto institucione, në përputhje me statutin dhe rregulloret e institucionit.

2. Fushat, drejtimet, vëllimi i punës dhe afatet e veprimtarisë kërkimore-shkencore përcaktohen nga vetë institucionet e arsimit të lartë, bazuar në fushat prioritare të zhvillimit kombëtar dhe në programet e ofruara.

3. Veprimtaria kërkimore-shkencore e personelit akademik në IAL vlerësohet sipas përcaktimeve në statut ose akteve të tjera të institucionit.

4. Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të hartojnë programe dhe projekte kërkimore në bashkëpunim me institucione të tjera publike ose private, brenda dhe jashtë vendit.

5. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë, nëpërmjet veprimtarive kërkimore-shkencore, të zhvillimit dhe krijuese, shërbime për të tretë. Të

ardhurat nga këto veprimtari administrohen nga njësia bazë ose ajo kryesore, që realizon veprimtarinë, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 96

Institutet dhe qendrat ndërinstitucionaletë kërkim-zhvillimit

1. Institutet dhe qendrat ndërinstitucionale të kërkim-zhvillimit krijohen nga dy apo më shumë IAL ose nga IAL me institucione kërkimore-shkencore, kulturore dhe ekonomike, publike e private, me marrëveshje midis tyre.
2. Struktura, organizimi, fushat e kërkimit dhe objekti i veprimtarisë së tyre propozohen nga institucionet themeluese dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Funksionimi i tyre përcaktohet në rregulloren e tyre, në përputhje me statutet e institucioneve themeluese.

KREU IX

STUDENTËT DHE TË DHËNAT MBI STUDENTËT

Neni 97

Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit

1. Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në një institucion të arsimit të lartë. Ky status humbet me marrjen e diplomës ose certifikatës përkatëse, si dhe në rastin e çregjistrimit të studentit nga ai institucion.

2. Studenti mund t'i pezullojë studimet dhe t'i rifillojë ato, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë.

3. Studenti nuk mund të regjistrohet, njëkohësisht, në më shumë se një program studimi. Bëjnë përjashtim nga ky nen nxënësit dhe studentët e shkëlqyer.

Neni 98

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

1. Studentët kanë të drejtë:

a) të ndjekin të gjitha veprimtaritë mësimore që zhvillohen në kuadrin e programit të studimit ku ata janë regjistruar;

b) të përdorin infrastrukturën, që institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të procesit mësimor, si dhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen nga ai institucion;

c) të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së institucionit të arsimit të lartë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe statutin e institucionit;

ç) të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në institucionin e arsimit të lartë;

d) të nënshkruajnë kontratë shërbimi, në momentin e regjistrimit në institucionet jopublike të arsimit të lartë. Elementet e kontratës dhe forma e saj përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin;

dh) të sigurohen nga institucioni i arsimit të lartë, në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera, sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin dhe Ministrit të Financave.

2. Studentët kanë për detyrë:

a) të zbatojnë rregullat e përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë;
b) të respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;

c) të paguajnë tarifat e përcaktuara në këtë ligj dhe nga institucionet e arsimit të lartë, si dhe tarifat e shërbimeve që u ofrojnë institucionet e arsimit të lartë;

ç) të respektojnë Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë.

3. Studentit përsëritës i ndërpritet mbështetja nga fondet publike, me përjashtim të rasteve të forca ve madhore.

4. Në statutin e institucionit mund të përcaktohen të drejta dhe detyra të tjera të studentëve.

Neni 99

Këshillat e studentëve

1. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentorë në nivel njësie kryesore, institucioni të arsimit të lartë, si edhe në nivel kombëtar.

2. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve në institucionet e arsimit të lartë, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këto këshilla promovojnë pjesë-marrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqë-simin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë.

3. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo dy vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Në rastet kur një individ i

zgjedhur në këshillat e studentëve përfundon studimet universitare, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit, deri në përfundim të mandatit të nisur.

4. Këshillat e studentëve nuk mund të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë institucioneve përkatëse të arsimit të lartë. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tyre përcaktohen në statutet dhe rregulloret e institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me këtë ligj, mbësh-tetur edhe në propozimet e paraqitura nga studentët.

5. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.

6. Institucionet e arsimit të lartë mbështetin këshillat e studentëve dhe financojnë veprimtari të tyre.

Neni 100

Karta e studentit

1. Studentët e institucioneve publike e private të arsimit të lartë pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik. Me anë të saj studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara.

2. Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit përcakton kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit.

3. Përfitimet e studentëve nga përdorimi i kartës së studentit përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të ministrisë përkatëse që mbulon institucionin e arsimit të lartë ose njësive të qeverisjes vendore që mbulojnë shërbimet e ofruara ndaj studentëve.

4. Kategoritë e shërbimeve që ofrojnë entet shtetërore bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje me organizma që kanë objekt të tyre interesat studentorë e me persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme.

Neni 101

Dokumentacioni i procesit mësimor

1. Çdo institucion i arsimit të lartë detyrohet të mbajë në formë të shkruar:

a) regjistrin themeltar të studentëve;

b) regjistrin e arritjeve akademike;

c) regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.

2. Regjistrat shpërndahen nga ministria përgjegjëse për arsimin kundrejt tarifës përkatëse që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Regjistri themeltar i studentëve është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në një institucion të arsimit të lartë. Çdo student pajiset me një numër unik matrikullimi, që e mban deri në marrjen e diplomës ose certifikatës, i cili pasqyrohet në këtë regjistër. Regjistri themeltar depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit të arsimit të lartë. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.

4. Regjistri i arritjeve akademike është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në institucionin e arsimit të lartë, sipas programeve të studimit. Regjistri i arritjeve akademike depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit të arsimit të lartë. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.

5. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave është dokumenti që vërteton emetimin e tyre prej institucionit të arsimit të lartë. Institucionet e arsimit të lartë dokumentojnë tërheqjen e diplomës dhe suplementit të diplomës prej secilit student që ka përfunduar me sukses

detyrimet akademike dhe ato të tjera institucionale. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit të arsimit të lartë. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.

6. Çdo institucion i arsimit të lartë duhet të plotësojë elementet e regjistrave, të përcaktuara në pik ën 1, të këtij neni, në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Dokumentacioni, pas plotësimit përfundimtar të tij,

depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet në arkivin e institucionit të arsimit të lartë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren e institucionit. Në rastin e mbylljes së veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë, regjistrat e tij, sipas përcaktimeve në pikën 1, të këtij neni, dhe çdo dokument tjetër, depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat.

Neni 102

Baza e të dhënave të studentëve në institucionet e arsimit të lartë

1. Institucionet e arsimit të lartë ruajnë të dhënat personale të studentëve.

2. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga institucionet e arsimit të lartë kryhen, bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU X

SIGURIMI I CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Neni 103

Sigurimi i brendshëm i cilësisë

1. Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

2. Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.

3. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.

4. Njësia e sigurimit të cilësisë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë.

5. Standardet për sigurimin e cilësisë hartohen nga institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me Kodin e Cilësisë.

6. Raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Neni 104

Sigurimi i jashtëm i cilësisë

1. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.

2. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit që ato ofrojnë i nënshtrohen vlerësimit të parë, vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike nga ASCAL.

3. Vlerësimi i parë institucional dhe vlerësimi i programeve kryhen përpara lëshimit të diplomave të para nga një institucion i arsimit të lartë. Vlerësimi institucional i paraprin atij të programeve të studimit.

4. Vlerësimi periodik kryhet për institucionet e arsimit dhe programet e studimit që kanë fituar akreditimin e parë, brenda afatit kohor të vlefshmërisë së tij.

5. Institucionet e arsimit të lartë i nënshtrohen procesit të vlerësimit të mësimdhënies, çdo tre vjet, nga ASCAL dhe monitorohen në mënyrë të vazhdueshme, përmes Sondazhit Kombëtar të Studentëve.

6. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë kryhet në përputhje me Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Ministria përgjegjëse dhe ASCAL mund të bashkëpunojnë me agjenci të huaja të sigurimit të cilësisë, që janë anëtare të rrjetit ENQA.

Neni 105

Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë

1. Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë është dokumenti kryesor për të gjitha proceset dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Ai përcakton standardet shtetërore të cilësisë, të detyrueshme për zbatim prej institucioneve të arsimit të lartë.

2. Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë hartohet nga ASCAL dhe ministria përgjegjëse për arsimin dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 106

Akreditimi

1. Akreditimi institucional është procesi i certifikimit të cilësisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë.

2. Akreditimi i programeve të studimit është procesi i certifikimit të cilësisë së tyre, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.

3. Akreditimi i parë institucional dhe ai i programeve kryhen përpara lëshimit të diplomave të para nga një institucion i arsimit të lartë. Akreditimi institucional i paraprin atij të programeve të studimit.

4. Vlefshmëria e çdo akreditimi institucional dhe e programeve të studimit që lidhen me të nuk mund të zgjasë më shumë se 6 vjet.
5. Vendimi për akreditimin është pozitiv ose negativ. Në rast se institucioni i arsimit të lartë nuk akreditohet institucionalisht apo për program studimi, ai nuk mund të lëshojë diploma për programet përkatëse të studimit që ka ofruar.

6. Standardet, mbi bazën e të cilave është dhënë akreditimi, duhet të përmbushen për të gjithë periudhën kohore të vlefsh mërisë së akreditimit. Në qoftë se ministria përgjegjëse për arsimin konstaton shmangie nga këto standarde, vendos kushte dhe afate kohore për përmbushjen e tyre.

7. Për institucionet e arsimit të lartë, që zhvillojnë programe të përbashkëta studimi me institucione të huaja të arsimit të lartë, si dhe për filialet e institucioneve të huaja të arsimit të lartë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, vlerësimi dhe akreditimi kryhen duke marrë parasysh edhe vlerësimin e akreditimin e tyre në vendin e origjinës.

8. Shpenzimet për vlerësimin e jashtëm të cilësisë dhe akreditimin përballohen nga vetë institucionet e arsimit të lartë, sipas tarifave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU XI

PRONAT DHE FINANCIMI I ARSIMIT TË LARTË

Neni 107

Parime bazë të financimit të institucioneve të arsimit të lartë nga Buxheti i Shtetit Parimet

bazë të financimit të institucioneve të arsimit të lartë nga Buxheti i Shtetit janë:

a) konkurrenca e lirë midis institucioneve që gëzojnë të njëjtin status, sipas përcaktimeve të nenit 17 të këtij ligji;

b) mundësitë e barabarta për institucionet e arsimit të lartë, në varësi të statusit që ato kanë;

c) mbështetja e interesave prioritarë e strategjikë të vendit;

ç) shpërndarja e fondeve, bazuar mbi treguesit e cilësisë së institucioneve për mësimdhënien, kërkimin shkencor, veprimtaritë krijuese dhe inovacionin e zhvillimin.

Neni 108

Autonomia financiare e institucioneve të arsimit të lartë

1. Institucionet e arsimit të lartë funksionojnë sipas parimit të autonomisë financiare.

2. Institucioni i arsimit të lartë harton një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan përditësohet çdo vit.

3. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga institucionet publike të arsimit të lartë përdoren prej tyre dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës.

4. Përdorimi fondeve publike nga Buxheti i Shtetit për institucionet e arsimit të lartë bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar.

Neni 109

Burimet e financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë

1. Institucionet publike të arsimit të lartë financohen nga:

a) Buxheti i Shtetit;

b)pagesat e studentëve për arsimim;

c) të ardhurat për shërbimet e kryera;

ç) të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;

d)donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi; dh)

veprimtari kërkimore-shkencore;

2. Të ardhurat e përfituara nga shërbimet, veprimtaritë kërkimore-shkencore, konsulencat, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik ndahet ndërmjet personelit akademik dhe IAL-së, sipas rregullores së miratuar nga Bordi i Administrimit.

3. Institucionet publike të arsimit të lartë rregullojnë në aktet e tyre të brendshme mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat e përcaktuara në këtë nen, me përjashtim të të ardhurave nga Buxheti i Shtetit.

Neni 110

Shpërndarja e fondeve nga Buxheti i Shtetit

1. Fondet nga Buxheti i Shtetit shpërndahen në formë granti, sipas kategorive të mëposhtme:

a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;

b) granti i mësimdhënies;

c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.

2. Këshilli i Ministrave miraton me vendim modelin e financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

3. Zbatimi i skemës së financimit, sipas këtij ligji, për institucionet publike të arsimit të lartë, kryhet sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

Neni 111

Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë

1. Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë përfshin:

a) fondin për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike;
b) fondin e projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë.

2. Fondi për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike shpërndahet mbi bazën e renditjes së institucioneve publike të arsimit të lartë, të kryer nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor.

3. Fondi i projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë shpërndahet mbi bazën e projekteve që ato paraqesin, sipas kritereve të përcaktuara në strategjitë sektoriale dhe në ligjin vjetor të buxhetit.

4. Ministria përgjegjëse për arsimin miraton me udhëzim prioritetet, termat e shpërndarjes, formën e aplikimit për grantin, si dhe miraton grantin e politikave të zhvillimit të institucioneve publike të arsimit të lartë, mbi bazën e aplikimit apo të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.

Neni 112

Granti i mësimdhënies

1. Granti i mësimdhënies përfshin:

a) fondin për institucionet publike të arsimit të lartë;

b) fondin e mbështetjes studentore.

2. Fondi institucional u shpërndahet institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas një formule që garanton mundësi të bara barta, drejtësi dhe transparencë.

3. Fondi i mbështetjes studentore përfshin tri kategori financimi:

a) bursat e studimit për studentët e shkëlqyer;

b) bursat e studimit për studentët në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar;

c) bursat e studimit për studentët që i përkasin shtresave sociale në nevojë.

4. Bursat e studimit për studentët e shkëlqyer u jepen studentëve me notë mesatare maksimale në hyrje, në rang vendi, pavarësisht programit të studimit dhe institucionit, në të cilin ata kanë zgjedhur të ndjekin studimet. Studenti vazhdon të përfitojë nga ky grant nëse rezultatet e tij, gjatë gjithë viteve të studimit, vazhdojnë të jenë të shkëlqyera.

5. Bursat e studimit për studentët që kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit në institucione publike të arsimit të lartë, që përbëjnë prioritet kombëtar, u shpërndahen studentëve që studiojnë në fushat e përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Bursat e studimit për studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë u shpërndahen studentëve që janë shpallur fitues në institucionet publike të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret për t'u konsideruar si studentë në nevojë, të përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Ky grant shpërndahet nga AKFAL-i.

Neni 113
Granti i punës kërkimore-shkencore

1. Granti i punës kërkimore-shkencore përfshin fondet për kërkimin shkencor.

2. Pjesë e këtij granti janë edhe fondet për studimet e doktoratës, të cilat u jepen institu-cioneve të arsimit të lartë mbi bazën e aplikimit. Nga ky fond përjashtohet financimi i ngarkesës së pedagogëve për udhëheqjen e doktoratës.

3. Ky grant është i hapur për të gjitha institucionet e arsimit të lartë të akredituara që zhvillojnë kërkim shkencor.

4. Shpërndarja e fondeve të kësaj kategorie bëhet nga AKKSHI, mbi bazën e projekteve që institucionet paraqesin, sipas kritereve të përcaktuara në strategjitë sektoriale dhe në ligjin vjetor të buxhetit.

5. Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor përbën kriterin bazë të renditjes së institucioneve të kërkimit shkencor nga AKKSHI dhe përcaktimin e masës së financimit, të përfituar prej AKFAL-it, për IAL-të publike. Institucionet e kërkimit shkencor marrin masa për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, nëpërmjet njësisë përkatëse, përbërja dhe funksionimi i së cilës përcaktohen në statutin ose rregulloren e institucionit përkatës.

Neni 114

Kredia studentore

1. Ministria përgjegjëse për arsimin ndërmjetëson kreditimin e studentëve, me qëllim mbështetjen financiare për përballimin e kostos së studimeve.

2. Kredia studentore është e hapur për aplikim për të gjithë studentët që fitojnë të drejtën për studime në programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë.

3. Skema e kreditimit studentor përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 115

Kreditë për institucionet publike të arsimit të lartë

1. Institucionet publike të arsimit të lartë kanë të drejtën e marrjes së kredive për zhvillimin e tyre institucional dhe infrastrukturor.

2. Kushtet që duhen plotësuar për aplikim për kredi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 116

Kontrolli dhe auditimi

1. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë përbërëse të tyre realizohen nga njësitë e auditimit të brendshëm të institucionit. Krijimi dhe funksionimi i njësive të auditimit të brendshëm bëhen në përputhje me aktet e brendshme të institucionit të arsimit të lartë.
2. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm në institucionet e arsimit të lartë kryhen nga audituesë të brendshëm ose të jashtëm, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave.

Neni 117

Pronat e institucioneve publike të arsimit të lartë

1. Pronat e paluajtshme, në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre institucionet publike të arsimit të lartë, që i shërbejnë institucionit për të garantuar përmbushjen e misionit të tij, kalojnë në administrim të institucioneve, me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit përgjegjës për arsimin.

2. Institucionet kanë detyrimin të ruajnë dhe të mirëmbajnë pronat në administrim dhe nuk mund të ndryshojnë destinacionin e tyre. Institucionet mund të zhvillojnë pronat me miratim paraprak të subjektit që i ka kaluar pronën në administrim.

KREU XII

INSTITUCIONI PUBLIK I PAVARUR I ARSIMIT TË LARTË

Neni 118

Institucionet publike të pavarura të arsimit të lartë

1. Institucionet publike të pavarura të arsimit të lartë (IALPP) janë persona juridikë publikë, që krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me kërkesë të organizatave jofitimprurëse të llojit fondacion, të krijuar për këtë qëllim.

2. IALPP-të kanë personalitet juridik të ndarë nga ai i themeluesit.

3. IAL-të transformohen në IALPP me vendim të Këshillit të Ministrave. Institucionet që kërkojnë të transformohen në IALPP duhet të përmbushin, paraprakisht, kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

4. Bordi i Administrimit të IAL-së është autoriteti që vendos për transformimin e institucionit, pasi të ketë marrë mendimin e Senatit Akademik.

5. IALPP-të nuk kanë qëllim fitimin dhe të ardhurat e përfituara nga veprimtaria dhe pasuritë e tyre përdoren për realizimin e misionit të institucionit.

6. Pavarësisht nga origjina e themelimit, IALPP-të zbatojnë të njëjtat rregulla organizimi si institucionet e tjera të arsimit të lartë. Në të gjitha rastet, kur nuk parashikohet ndryshe në këtë kre, gjejnë zbatim dispozitat për institucionet publike të arsimit të lartë.

7. Në kuptim të këtij ligji, fondacionit i njihet e drejta e themeluesit të IALPP-së.

Neni 119

Kriteret e krijimit të IALPP-së

Mund të aplikojnë për transformim në IALPP institucionet e arsimit të lartë që përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) institucioni ekzistues i arsimit të lartë duhet të jetë i akreditуar institucionalisht dhe të ketë të akredituara programet e studimit që ofron, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji;

b) themeluesi i institucionit ekzistues të arsimit të lartë duhet të ofrojë garancitë e duhura financiare për funksionimin e IALPP-së, për, të paktën, tri vitet e para të veprimtarisë;

c) themeluesi merr përsipër detyrimin t'i kalojë IALPP-së në mënyrë të parevokueshme të drejtën e përdorimit mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme, ku zhvillon veprimtarinë IAL-ja ekzistuese, si edhe pasurive të tjera, të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së IALPPsë. Pasuritë duhet të jenë të lira nga çdo barrë dhe themeluesi nuk duhet të ketë detyrime ndaj personave të tretë;

ç) themeluesi nuk duhet të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) themeluesi nuk duhet të jetë palë e paditur në procese gjyqësore që kanë të bëjnë me çështje thelbësore, të cilat lidhen me veprimtarinë dhe funksionimin e IAL-së ekzistuese;

dh) institucionet e arsimit të lartë, që kërkojnë të transformohen, duhet të kenë krijuar, paraprakisht, strukturat akademike dhe të funksionojnë sipas përcaktimeve të këtij ligji për institucionet publike të arsimit të lartë.

Neni 120

Mënyra e krijimit të IALPP-ve

1. Bordi i Administrimit i IAL-së vendos për transformimin e institucionit të arsimit të lartë me tre të katërtat e votave të anëtarëve të tij. Për këtë kërkohet, paraprakisht, mendimi i Senatit Akademik, i cili jep pëlqimin me shumicën e anëtarëve të tij.

2. Kërkesa për themelimin apo transformimin e IAL-së në IALPP, së bashku me dokumentacionin e kërkuar, i paraqiten Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin.

3. Themeluesi i nënshtrohet një auditimi financiar të pavarur, përpara propozimit në Këshillin e Ministrave, sipas pikës 2, të nenit 116, të këtij ligji.

4. Këshilli i Ministrave miraton krijimin e IALPP-së pas verifikimit të përmbushjes së kritereve të përcaktuara në këtë ligj.

5. Në rastin e krijimit të IALPP-së nga transformimi i IAL-së publike, Këshilli i Ministrave vendos edhe për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pronat e luajtshme dhe të paluajtshme, në favor të fondacionit themelues të IALPP-së.

6. Në rastin e refuzimit të kërkesës, ministria përgjegjëse i paraqet kërkuesit vendimin e arsyetuar, brenda një afati nëntëdhjetëditor nga momenti i paraqitjes së kërkesës. Kërkuesi ka të drejtë të përsëritë kërkesën e tij, pasi të ketë plotësuar kriteret, por jo më parë se një vit nga dita e refuzimit.

7. Këshilli i Ministrave përcakton procedurën, dokumentacionin dhe rregullat e tjera që duhen zbatuar për krijimin e IALPP-së.

Neni 121

Bordi i Administrimit

1. Bordi i Administrimit në IALPP përbëhet nga 11 anëtarë, për një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Themeluesi i institucionit përfaqësohet në këtë organ me 6 anëtarë. Ministria, në cilësinë e institucionit shtetëror rregullator, përfaqësohet në Bordin e Administrimit me 1 anëtar. Senati Akademik përfaqësohet në Bordin e Administrimit me 4 anëtarë, një ndër të cilët është rektori i institucionit, për shkak të funksionit.

3. Përfaqësimi i themeluesit në Bordin e Administrimit mund të ndryshojë, në raport me financimin nga subjekte të tjera juridike, publike apo jopublike. Përfaqësimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe i Senatit Akademik, në cilësinë e përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, nuk mund të ndryshojë.

4. Anëtarët e bordit janë të punësuar me kohë të plotë. Anëtarët e propozuar nga senati akademik, të

cilët ushtrojnë funksione apo veprimtari në institucionin e arsimit të lartë, trajtohen sipas përcaktimeve në statut. Anëtarët e bordit nuk duhet të kenë konflikt interesi, sipas legjislacionit në fuqi dhe përcaktimeve në statutin e institucionit.

Neni 122

Administrimi i fondeve

Fondet e përfituara nga IALPP-ja adminis-trohen në përputhje me rregullat e përcaktuara në aktet e brendshme të institucionit, si dhe kushtet specifike të përcaktuara për fondet e përfituara. Për to nuk zbatohen, në mënyrë të drejtpërdrejtë, rregullat e shpërndarjes së të ardhurave, sipas standard eve të programimit buxhetor dhe të menaxhimit financiar publik, si dhe të prokurimit publik.

Neni 123

Inspektimi i veprimtarisë dhe masat ndaj IALPP-së

Në rast se nga inspektimet dhe/ose mbikëqyrja e ministrisë përgjegjëse për arsimin, konstatohet që IALPP-ja nuk përmbush kriteret ligjore, sipas nenit 119 të këtij ligji, për këtë formë institucioni, ministri përgjegjës për arsimin vendos kushte për vijimin e veprimtarisë nën

mbikëqyrje të ministrisë, ose pezullimin e veprimtarisë deri në plotësimin e kushteve, për një periudhë jo më të gjatë se dy vite akademike ose i propozon Këshillit të Ministrave mbylljen e veprimtarisë së institucionit.

KREU XIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 124

1. Diplomat e programeve të studimit, që kanë zgjatur 3 vite (6 semestra), janë ekuivalente me diplomat "Bachelor".
2. Diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë,që kanë zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat "Master i shkencave".

3. Diplomat për programet e integruara të nivelit të dytë (DIND), të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ekuivalente me diplomën universitare "Master i shkencave". Diplomat e nivelit të dytë (DND), të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ekuivalente me diplomën universitare "Master i shkencave".

4. Diplomat e programeve të studimit, "Master i nivelit të parë" janë ekuivalente me diplomat "Master profesional".

5. Diplomat e fituara në studimet në kuadër të "Shkollës pasuniversitare të studimeve të thelluara" dhe "Master i nivelit të dytë" janë ekuivalente me diplomat "Master ekzekutiv".

6. Diplomat e fituara në kuadër të Shkollës së Magjistraturës janë ekuivalente me diplomat e studimeve të specializimeve afatgjata.

7. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, fillojnë zbatimin e programeve të integruara në vitin akademik 2017-2018.

8. Brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, bëhen ndryshimet në ligjet e fushave 0përkatëse, të përcaktuara në nenin 82 të këtij ligji.

Neni 125

Kodifikimi i programeve të studimit kryhet brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Çdo program, që miratohet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kodifikohet, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore përkatëse. Procedurat për kodifikimin e programeve të reja të studimit, atyre ekzistuese dhe për riorganizimin e tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

Të gjitha programet e miratuara deri në hyrjen në fuqi të Kodit të Programeve të Studimit riorganizohen dhe kodifikohen brenda vitit akademik 2016-2017.

Neni 126

1. Personeli akademik, i punësuar në institucionet e arsimit të lartë, i kategorisë “Docent”, në kuadër të përcaktimeve të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, konsiderohet “Lektor”.

2. Personeli akademik, i punësuar në institucionet e arsimit të lartë, ikategorisë “Lektor”, në kuadër të përcaktimeve të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, konsiderohet “Asistent-lektor”.

3. Personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë riorganizohet sipas kategorive të personelit

akademik, të përcaktuara në këtë ligj, me fillimin e vitit të ri akademik, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Dispozitat e këtij ligji nuk cenojnë kontratat e punës, me kohëzgjatje të pacaktuar, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, midis institucioneve të arsimit të lartë dhe personelit akademik. Personeli akademik, i punësuar në institucionet e arsimit të lartë, si personel me kohë të plotë, brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, duhet të përfundojë studimet e doktoratës. Kur, brenda këtij afati, personeli akademik nuk përfundon studimet e doktoratës, rektori kryen procedurat për zgjidhjen e kontratës së punës.

5. Procedurat e punësimit të personelit akademik të ftuar, atij me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme do të kryhen sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore, pas hyrjes në fuqi të tij.

Neni 127

Kërkesat për hapjen, riorganizimin, mbylljen e një institucioni të arsimit të lartë dhe kërkesat për fillimin e veprimtarisë së një institucioni, të paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të cilat nuk ka pasur vendimmarrje deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, shqyrtohen sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 128

Kërkesat për hapjen dhe mbylljen e programeve të studimit, të ofruara nga një institucion i arsimit të lartë, të paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të cilat nuk ka pasur vendimmarrje deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, shqyrtohen sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 129

1. Institucionet ekzistuese të arsimit të lartë riorganizohen brenda dy viteve të para akademike, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dhe në përputhje m e përcaktimet e këtij ligji për:

a) llojet e institucioneve të arsimit të lartë;

b) emërtimin e tyre, si dhe programet e studimit të ofruara;

c) strukturën e brendshme akademike dhe administrative.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për arsimin për nxjerrjen ose propozimin e akteve nënligjore për riorganizimin e IAL-ve, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 130

1. Institucionet e arsimit të lartë publik mund të transformohen në IALPP, sipas përcaktimeve të këtij ligji, jo më parë se viti akademik 2017-2018.

2. Institucionet e arsimit të lartë jopublik mund të transformohen në IALPP, sipas përcaktimeve të këtij ligji, jo më parë se viti akademik 2018-2019.

Neni 131

1. Zgjedhjet për autoritetet, organet drejtuese akademike, Bordin e Administrimit, administratorin e institucionit të arsimit të lartë, administratorin e njësisë kryesore dhe administratorin e njësisë bazë, në institucionet publike të arsimit të lartë do të zhvillohen në përfundim të mandatit të autoriteteve dhe organeve ekzistuese, të zgjedhur sipas ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. IAL-të jopublike riorganizohen brenda të njëjtit afat.

2. Ministria përgjegjëse për arsimin, para përfundimit të mandatit të autoriteteve dhe organeve ekzistuese në IAL-të publike, miraton rregulloren për zgjedhjet e para, sipas këtij ligji, të autoriteteve dhe organeve drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë publik. Rregullorja përcakton kriteret për hartimin e listave zgjedhore, regjistrimin e kandidatëve, procesin e votimit, kriteret e vlefshmërisë e të numërimit të votave, rregullat për shpalljen e rezultatit dhe të fituesve, procesin dhe afatet e ankimit.

3. Numri i mandateve të fituara si autoritet drejtues akademik i IAL-së, në të njëjtin funksion dhe në të njëjtin institucion, nuk mund të jetë më shumë se dy, të njëpasnjëshme apo të ndara. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, përllogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim.

4. Raportet e përfaqësimit në Bordin e parë të Administrimit do të përcaktohen në raport me nivelin e financimit të institucioneve pjesëmarrëse në të, përgjatë katër viteve të fundit financiare.

5. Institucionet ekzistuese riorganizojnë njësitë e brendshme, në përputhje me këtë ligj, brenda vitit të parë akademik, nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 132

Institucionet e arsimit të lartë hartojnë dhe miratojnë statutet në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe rregulloret e tyre, në përputhje me këtë ligj, brenda vitit të parë akademik nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 133

1. Brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ministria përgjegjëse për arsimin miraton dhe bën publike listën e institucioneve të arsimit të lartë që plotësojnë kriteret për dhënien e titujve akademikë.

2. Deri në dhënien e gradave dhe titujve akademikë, sipas këtij ligji, gradat dhe titujt trajtohen sipas kuadrit ligjor ekzistues në fuqi. Komisioni i vlerësimit të titujve akademikë pushon së ekzistuari 1 vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 134

1. Studentët, të cilët kanë nisur programet e studimit të doktoratës para hyrjes në fuqi të këtij ligj, i përfundojnë ato sipas kritereve dhe modaliteteve të legjislacionit të kohës kur këta studentë janë pranuar.

2. Përcaktimet e këtij ligji mbi kohëzgjatjen e programeve të studimit zbatohen për studentët që nisin studimet pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Neni 135

Pranimi i kandidatëve në institucionet e arsimit të lartë në vitin akademik 2016-2017 e në vijim, në të gjitha programet e studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, kryhet sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 136

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, riorganizohet në ASCAL, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

Neni 137

Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë miratohet brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 138

Procesi i sigurimit të jashtëm të cilësisë, akreditimit institucional dhe programeve të studimit vijon sipas kuadrit ligjor ekzistues, deri në riorganizimin e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë si ASCAL dhe miratimin e Kodit të Cilësisë.

Neni 139

Financimi i institucioneve të arsimit të lartë fillon të aplikohet, sipas këtij ligji, në mënyrë të shkallëzuar, nga viti buxhetor 2016.

Neni 140

Instituti i Shëndetit Publik konsiderohet, në zbatim të këtij ligji, institucion/qendër e kërkimit shkencor, i cili ruan marrëveshjet ekzistuese me IAL-të në fushën mjekësore deri në plotësimin e kushteve të parashikuara në nenin 28, pika 5, të këtij ligji.

Neni 141

Aktet nënligjore

Aktet nënligjore në zbatim të nenit 4, pika 4; nenit 5, pika 1, shkronja “e”;nenit 8, pika 3; nenit 9, pikat 2,4 dhe 6; nenit 10, pika 1, shkronja “c”; nenit 11, pikat 3 dhe 4; nenit 12, pikat 4 dhe 8; nenit 14, pika 10; nenit 15, pika 7; nenit 28, pika 5; nenit 29, pika 3; nenit 30, pikat 3 dhe 7;

nenit 32, pika 2; nenit 35, pika 6; nenit 60, pika 3; nenit 71, pika 2; nenit 75, pika 3,shkronja”b”; nenit 79, pika 7; nenit 82, pika 3; nenit 87, pika 3; nenit 91, pika 5; nenit 92, pika 6; nenit 96, pika 2; nenit 98, pika 1, shkronja”d”; nenit 100, pika 4; nenit 101, pika 2; nenit 105, pika 2; nenit 106, pika 8; nenit 112, pikat 5 dhe 6; nenit 114, pika 3; nenit 115, pika 2; nenit 120, pika 7; nenit 125 dhe nenit 136miratohen brenda 9 muajve nga hyrja më fuqi e këtij ligji.

Neni 142 Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Aktet nënligjore, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien ndesh me të, do të zbatohen derisa nuk janë miratuar aktet e nënligjore të parashikuara në nenin 139 të këtij ligji.

Neni 143
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ilir Meta

Miratuar në datën 22.7.2015

LIGJ

Nr. 93/2019

PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (KËSHILLI I MINISTRAVE) DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR PROGRAMIN E SHKËMBIMIT AKADEMIK "FULBRIGHT"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik "Fulbright", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.12.2019

Shpallur me dekretin nr.11404, datë 30.12.2019, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR PROGRAMIN E SHKËMBIMIT AKADEMIK FULBRIGHT

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfaqësuar nga Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (më poshtë referuar së bashku si "Pjesëmarrësit" dhe në njëjës referuar përkatësisht si "Pjesëmarrësi shqiptar" dhe "Pjesëmarrësi amerikan");

me dëshirën për të zhvilluar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve arsimore, shkencore dhe kërkimore të Republikës së Shqipërisë dhe atyre të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe nxitjen e mirëkuptimit dhe miqësisë së ndërsjellë ndërmjet dy kombeve tona;

kanë arritur në mirëkuptim sa më poshtë:

SEKSIONI 1

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi (referuar më poshtë si "MM") është të forcojë dhe të zhvillojë lidhjet ndërmjet pjesëmarrësve në procesin e zbatimit të Programit të Shkëmbimit Akademik Fulbright (referuar më poshtë si "Programi Fulbright") në arsim, kulturë, shkencë dhe punë kërkimore, bazuar në kushte me përfitim të ndërsjellë.

SEKSIONI 2

Me pjesëmarrjen e tyre në Programin Fulbright, pjesëmarrësit shpresojnë nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore, shkencore dhe kërkimore në të dy vendet dhe inkurajimin e përmirësimit të kualifikimeve të profesionistëve akademikë, studiuesve, pedagogëve dhe studentëve, si dhe nxitjen e projekteve, të përbashkëta kërkimore-shkencore.

SEKSIONI 3

Koordinatori i këtij MM, në emër të pjesëmarrësit amerikan, është Seksioni për Marrëdhëniet me Publikun i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë (më poshtë referuar si "PAS Tirana") dhe, në emër të pjesëmarrësit shqiptar, është Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (më poshtë referuar si "Ministria").

SEKSIONI 4

Gjatë zbatimit të këtij MM, Pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të koordinojë si vijon: menaxhimin e Programit Fulbright në Republikën e Shqipërisë; organizimin e përzgjedhjes fillestare të kandidatëve për Programin Fulbright; zhvillimin e aktiviteteve mësimore dhe shkencore; si dhe analizën e potencialit për shkëmbime akademike shtesë.

A. Pjesëmarrësit kanë për qëllim që përzgjedhja e kandidatëve për Programin Fulbright të jetë e hapur, bazuar në meritë dhe në përputhje me kriteret e vendosura nga Bordi i Bursave të Huaja J. Ëilliam Fulbright të Shteteve të Bashkuara, të cilat gjenden në adresën:

http://fulbright.state.gov/fsb/program-policies. PAS Tirana mund të vendosë kritere më specifike, në përputhje me politikat e programit Fulbright, të cilat njoftohen publikisht në momentin që bëhet thirrja për aplikim.

SEKSIONI 5

A. Çdo vit, pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të propozojë studentë, staf akademik dhe profesionistë nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë për të studiuar në universitetet e SHBA-së dhe të koordinojë pjesëmarrjen e studentëve, stafit akademik dhe profesionistëve të Shteteve të Bashkuara në studim, kërkim ose trajnime akademike në institucionet akademike apo institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë.

B. Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të delegojë një përfaqësues për të marrë pjesë në Komisionin Përzgjedhës të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë për të zgjedhur studentët, stafin akademik dhe profesionistët që aplikojnë për Programin Fulbright.

SEKSIONI 6

Çdo vit, pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të propozojë studentë nga Republika e Shqipërisë për të studiuar në universitetet e Shteteve të Bashkuara për periudha nga 12 (dymbëdhjetë) deri në 24 (njëzet e katër) muaj.

SEKSIONI 7

Çdo vit, pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të propozojë staf akademik dhe profesionistë nga Republika e Shqipërisë për të dhënë leksione dhe/ose për të zhvilluar kërkime-shkencore në universitetet dhe institucionet kërkimore të Shteteve të Bashkuara dhe të koordinojë punën kërkimore dhe/ose leksionet e personelit akademik nga Shtetet e Bashkuara në institucionet arsimore, institutet dhe qendrat ndërinstitucionale të kërkim- zhvillimit të Republikës së Shqipërisë për periudha kohore që variojnë nga 3 (tre) deri në 9 (nëntë) muaj.

SEKSIONI 8

Çdo vit, pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të propozojë staf akademik dhe profesionistë nga Republika e Shqipërisë për të marrë pjesë në programe të zhvillimit profesional dhe programe të shkëmbimit në Shtetet e Bashkuara.

SEKSIONI 9

Pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të koordinojë financimin dhe zbatimin e Programit Fulbright në Republikën e Shqipërisë. Byroja për Çështjet e Arsimit dhe Kulturës e Departamentit Amerikan të Shtetit planifikon të financojë studimet, kostot e jetesës, kostot e udhëtimit dhe sigurimin shëndetësor për studentët, stafin akademik dhe profesionistët amerikanë që marrin pjesë në Programin Fulbright në Republikën e Shqipërisë.

SEKSIONI 10

A. Në bashkërendim me pjesëmarrësin amerikan, pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të ofrojë mbështetjen financiare në shumën prej 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) euro në vit, për të mbështetur kostot e Programit Fulbright Student, me qëllim krijimin e më shumë mundësive për studentët, stafin akademik dhe profesionistët që marrin pjesë në Programin Fulbright.

B. Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim ta fillojë dhënien e këtij kontributi në vjeshtën e vitit 2019 dhe ta vazhdojë deri në vitin akademik 2024—2025. Pjesëmarrësi shqiptar mund të konsiderojë bashkëpunimin e mëtejshëm me pjesëmarrësin amerikan përmes akordimit të burimeve shtesë nga fondi i bursave të ekselencës në Republikën e Shqipërisë për studentët shqiptarë në fushat me interes të veçantë për pjesëmarrësin shqiptar.

SEKSIONI 11

Në zbatimin e këtij MM, pjesëmarrësit planifikojnë të shkëmbejnë informacion rreth institucioneve arsimore, kulturore, shkencore dhe kërkimore në Programin Fulbright për t'u dhënë përparësi nevojave arsimore, kulturore, shkencore dhe kërkimore të këtyre institucioneve.

SEKSIONI 12

Në zbatimin e këtij MM, pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të inkurajojë institucionet qeveritare, arsimore, kulturore, shkencore dhe kërkimore që të mundësojnë kushtet më të favorshme për zbatimin e Programit Fulbright në Republikën e Shqipërisë.

SEKSIONI 13

Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të koordinojë në kohë aprovimin dhe lëshimin e dokumenteve ligjore të nevojshme për studentët, stafin akademik dhe profesionistët amerikanë, për të marrë pjesë në Programin Fulbright në Republikën e Shqipërisë.

SEKSIONI 14

Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të punojë me institucionet e tij arsimore, shkencore dhe kërkimore që pranojnë pjesëmarrës të Programit Fulbright, me synim mundësimin e hapësirave të duhura të punës dhe pajisjeve përkatëse të nevojshme për kërkimet akademike, vendosjen e këshilltarëve sipas nevojave, garantimin

e aksesit në bibliotekat dhe arkivat e institucionit pritës dhe për të lejuar pjesëmarrësit e Programit Fulbright të marrin pjesë në programe, kurse, leksione dhe seminare të përzgjedhura.

SEKSIONI 15

Pjesëmarrësit kanë për qëllim që shkëmbimet akademike që parashikohen në këtë MM, të zbatohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës duke përfshirë dhe ato që lidhen me disponueshmërinë e fondeve.

SEKSIONI 16

Pjesëmarrësit kanë për qëllim të shkëmbejnë informacion rreth zbatimit të këtij MM.

SEKSIONI 17

Për zbatimin e këtij MM, Ministria ka për qëllim të nënshkruajë një Marrëveshje me Institutin e për Edukimin Ndërkombëtar (më poshtë "IIE"), sa u përket modaliteteve dhe procedurave të lëvrimit të fondeve të parashikuara në seksionin 10 të këtij MM. IIE është përgjegjës për administrimin e të gjitha fondeve të Departamentit Amerikan të Shtetit për programin Fulbright në Shqipëri.

SEKSIONI 18

A. Ky MM ka për qëllim të fillojë pas njoftimit të Pjesëmarrësve nga autoritetet kompetente për përfundimin e të gjitha procedurave të nevojshme të brendshme dhe të vijojë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

B. Ky MM mund të modifikohet me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të të dy pjesëmarrësve.

C. Ky MM mund të ndërpritet në çdo kohë nga njëri pjesëmarrës, duke informuar pjesëmarrësin tjetër me shkrim. Pjesëmarrësi, i cili dëshiron të ndërpresë memorandumin, duhet të përpiqet të njoftojë me shkrim pjesëmarrësin tjetër të paktën 12 (dymbëdhjetë) muaj para mbi qëllimin e tij për ndërprerjen.

Nënshkruar në Nju-Jork, këtë ditë 25 të muajit shtator 2019, në dublikatë, në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Pjesëmarrësit kanë për qëllim që teksti në gjuhën angleze të jetë versioni zyrtar i këtij MM.

Për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës Marie Royce, ndihmëssekretare e Shtetit për Çështjet e Arsimit dhe Kulturës

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë Gent Cakaj, ministër i Jashtëm në Detyrë

VENDIME TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 989, datë 9.12.2015

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, KOHËZGJATJEN E QËNDRIMIT NË DETYRË DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR (KALKSH)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALKSH), si organ këshillimor për politikat e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, pranë ministrit përgjegjës për arsimin.

2. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin dhe ka në përbërje 12 anëtarë, të cilët duhet të jenë personalitete të njohura të fushave akademike.

3. Anëtarët e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor emërohen me urdhër nga ministri përgjegjës për arsimin për një periudhë 1-vjeçare, me të drejtë riemërimi pa kufizim dhe shkarkohen prej tij.

4. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, sipas kërkesave apo propozimeve të ministrit përgjegjës për arsimin, shqyrton dhe këshillon ministrin lidhur me:

a) hartimin e strategjive e të programeve kombëtare për arsimin e lartë e kërkimin shkencor, drejtimet e politikave respektive dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore;

b) fushat parësore dhe programet e kërkimit shkencor e të zhvillimit teknologjik;

c) standardet për hapjen, riorganizimin, pezullimin, mbylljen dhe akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë ose programeve të studimeve;

ç) kriteret për dhënien e titujve dhe gradës shkencore;

d) zhvillimin e politikave të veçanta dhe mënyrat e financimit të tyre; dh) statusin dhe trajtimin

e veçantë të personelit akademik;

e) çdo çështje tjetër që kërkohet nga ministri përgjegjës për arsimin.

5. Ministri përgjegjës për arsimin, me qëllim realizimin e misionit të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor me urdhër mund të ngrejë komisione të përhershme apo të përkohshme me anëtarët e këtij këshilli, për studimin e çështjeve e të problematikave të veçanta.
6. Ministri përgjegjës për arsimin, me qëllim realizimin e misionit të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor me urdhër mund të caktojë nëpunës të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në cilësinë e sekretariatit teknik të KALKSH-it.

7. Kryetari i Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor apo në mungesë një anëtar i caktuar prej tij me urdhër thërret mbledhjet dhe i drejton ato, cakton rendin e ditës, drejton diskutimet, bashkërendon punën, si dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara në rregulloren e funksionimit të brendshëm të KALKSH-it.

8. Njoftimi për mbledhjet, rendi i ditës, si dhe çdo ndryshim në datën e kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohen çdo anëtari nga sekretariati i KALKSH-it ose nëpunës të ngarkuar me urdhër të ministrit.

9. Ministri përgjegjës për arsimin miraton me urdhër të tij rregulloren e funksionimit të brendshëm të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor.

10. Anëtarët e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor shpërblehen për pjesëmarrje në mbledhjet e këtij Këshilli, sipas akteve nënligjore në fuqi.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 407, datë 01.06.2016

PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2016-2017

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kanë të drejtën të aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë kandidatët që kanë përfunduar me sukses nivelin e arsimit të mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në këtë vendim.
2. Për të gjithë kandidatët, të cilët kanë përfunduar nivelin e arsimit të mesëm të lartë, nota mesatare për pranim në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017, të jetë 6 (gjashtë). Nota mesatare për pranim në institucionet e arsimit të lartë, përllogaritet si mesatare aritmetike e thjeshtë e treguesve të mëposhtëm:

a) Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë;

b) Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të maturës/Maturës Shtetërore.

3. Kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dy vjeçare me karakter profesional nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në këtë vendim.

4. Institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe njësitë arsimore vendore janë përgjegjëse për përllogaritjen e notës mesatare dhe përcjelljen e të dhënave pranë Agjencisë Kombëtare të Provimeve.

5. Procedurat për njëvlershmërinë e dokumenteve të paraqitura nga shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë përfunduar nivelin e arsimit të mesëm të lartë jashtë vendit dhe përllogaritja e notës mesatare për këta kandidatë të kryhen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit bazuar në përcaktimet e pikës 2, të këtij vendimi, me përjashtim të rasteve kur nuk aplikohen provime mature, maturë shtetërore apo provime lirimi. Në këto raste me vendim të komisionit përkatës përcaktohet mënyra e përllogaritjes së notës mesatare. Komisioni përkatës përcjell të dhënat te njësitë arsimore vendore dhe tek Agjencia Kombëtare e Provimeve.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë, njësitë arsimore vendore, dhe institucionet e arsimit të lartë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 607, datë 31.08.2016

PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT (AKKSHI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të neneve 12 e 13, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) si një institucion publik, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

2. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit është institucion buxhetor, që financohet me fonde të buxhetit të shtetit dhe fonde nga programet dhe projektet e BE-së, të shteteve të veçanta dhe të organizatave partnere, donacione të subjekteve fizike dhe juridike, vendase dhe të huaja, si dhe çdo financim tjetër të ligjshëm.

3. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka për mision të nxisë kërkimin shkencor dhe inovacionin, nëpërmjet mbështetjes, monitorimit e vlerësimit të programeve dhe projekteve në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit (SHTI), si dhe administrimin e përditësimin e bazës kombëtare të të dhënave për kërkimin shkencor dhe inovacionin.

4. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka për detyrë:

a) identifikimin e fushave prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, që miratohen nga ministri i Arsimit dhe Sportit;

b) shpërndarjen e fondeve për programet e kërkimit shkencor, mbi bazën e projekteve të paraqitura prej institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve publike e jopublike, që kanë për objekt të veprimtarisë kërkimin shkencor në fushat e shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane;

c) organizimin, çdo katër vjet, sipas metodologjisë së miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, të procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë, të institucioneve të arsimit të lartë, duke i renditur ato në bazë të këtij vlerësimi;

ç) miratimin, mbi bazën e konkurrencës së lirë ndërmjet aplikantëve, të fondeve për projektet e studimeve të doktoratës;

d) administrimin dhe përditësimin e bazës kombëtare të të dhënave për kërkimin shkencor në sistemin e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të nenit 13, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e

lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe kuadrit ligjor në fuqi për administrimin e bazave elektronike të të dhënave;

dh) administrimin dhe bërjen publike të bazës të të dhënave, me të gjitha projektet e financuara prej saj, në kuadër të programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim-zhvillimit;

e) dhënien e informacioneve, rekomandimeve e sugjerimeve Ministrisë së Arsimit e Sportit dhe institucioneve të tjera, lidhur me aspektet e politikave dhe strategjive sektoriale në fushën e kërkimit shkencor e inovacionit.

5. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, ka përgjegjësi për:

a) shpërndarjen e informacionit dhe koordinimin e proceseve të aplikimit në projekte ndërkombëtare të kërkimit shkencor, për institucionet e arsimit të lartë, qendrat dhe institutet kërkimore-shkencore në vend;

b) koordinimin e Rrjetit të Pikave Kombëtare të Kontaktit të Programit të BE-së për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin;

c) komunikimin e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe renditjen e njësive kryesore e bazë të institucioneve të arsimit të lartë, për Agjencinë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë;

ç) administrimin e fondeve të tjera të kërkimit shkencor dhe inovacionit, në kuadrin e programeve kombëtare, ndërkombëtare të kërkimit shkencor, të cilat i shpërndan bazuar në aplikimet e subjekteve publike e jopublike, që kanë në statusin e veprimtarisë së tyre kërkimin shkencor;

d) paraqitjen, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të raportit vjetor të veprimtarisë së saj, pasi e ka miratuar paraprakisht në bordin e administrimit;

dh) bashkëpunimin me ministritë dhe institucionet e tjera për zbatimin e strategjisë kombëtare sektoriale në fushën e shkencës dhe inovacionit;

e) nxitjen e bashkëpunimit me sektorin e biznesit në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë e inovacionit dhe mbështetjen ndaj iniciativave të tij, në këtë fushë.

6. Për nevoja të realizimit të veprimtarisë së saj, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit shkëmben informacion me:

a) institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

b) institucionet e arsimit të lartë, qendra dhe institucione kërkimore-shkencore në vend;

c) institucione të tjera publike dhe jopublike, që lidhen me fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionin.

7. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit organizohet dhe funksionon nëpërmjet organeve dhe autoriteteve drejtuese të saj, të cilat janë bordi i administrimit dhe drejtori i Përgjithshëm.

8. Bordi i administrimit është organ kolegjial vendimmarrës, që kryesohet nga ministri i Arsimit dhe Sportit dhe ka në përbërje:

a) ministrin e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike;

b) dy përfaqësues të nivelit të lartë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

c) drejtorin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë;

ç) drejtorin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë;

d) përfaqësues nga Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë; dh) përfaqësues nga Konferenca e Rektorëve;

e) përfaqësues nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë.

9. Funksionet e bordit të administrimit janë:
a) Miraton, përpara miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit që do të financohen;

b) Miraton përbërjen e komisioneve të ekspertëve të vlerësimit të programeve dhe projekteve, sipas fushave të shkencës;

c) Miraton aktet e brendshme të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;

ç) Propozon në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit buxhetin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;

d) Miraton financimin e projekteve në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit dhe projektet e studimeve të doktoratës, bazuar në:

i) fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, të miratuara nga Ministria e Arsimit e Sportit; ii) grantin e punës kërkimore-shkencore; iii) vlerësimin e komisioneve të ekspertëve të programeve dhe projekteve.

dh) Miraton rezultatet e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë përpara se këto rezultate dhe renditja përfundimtare t'i komunikohet Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë;

e) Miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit brenda katërmujorit të parë të vitit pasardhës, i cili bëhet publik.

10. Bordi i Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit funksionon sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", dhe rregullores së tij të brendshme, të miratuar nga ministri i Arsimit dhe Sportit.

11. Kryetari dhe anëtarët e bordit të administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, shpërblehen nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

12. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit është titullari i institucionit dhe përfaqëson agjencinë në marrëdhënie me të tretë. Drejtori i Përgjithshëm ka këto kompetenca:

a) Drejton, koordinon dhe monitoron veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit;

b) Paraqet në Bordin e Administrimit, për miratim, aktet e brendshme që lidhen me veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;

c) Nënshkruan kontratat e financimit me aplikantët fitues, në kuadër të thirrjeve të hapura që realizohen nga agjencia;

ç) Bashkëpunon me agjencitë homologe në vende të tjera, nëpërmjet vendosjes së kontakteve, nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit për shkëmbim të eksperiencave dypalëshe;

d) Informon Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe bordin e administrimit për veprimtarinë e agjencisë, sa herë i kërkohet;

dh) Harton dhe paraqet, brenda afatit të parashikuar në bordin e administrimit, raportin vjetor për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit;

e) Siguron pjesëmarrjen e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit në rrjetet ndërkombëtare të institucioneve të financimit të kërkimit shkencor;

ë) Siguron pjesëmarrjen e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit në projekte të ndryshme ndërkombëtare.

13. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit emërohet dhe shkarkohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

14. Struktura dhe organika e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit miratohen me urdhër të Kryeministrit, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

15. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

16. Numri i punonjësve të Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) i kalon AKKSHI-it. Për nëpunësit civilë të AKTI-t zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunë sin civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.

17. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, për çështjet e përmbajtjes dhe të vlerësimit të projekteve, kontrakton ekspertë vendas e të huaj si pjesë e komisioneve të vlerësimit.

18. Programet dhe projektet në administrim të Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) transferohen me të gjitha të drejtat dhe detyrimet pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

19. Të gjitha komisionet e ekspertëve të vlerësimit, të Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, që kanë qenë përzgjedhur për vlerësimin e projekteve kombëtare të kërkimzhvillimit dhe projekteve të bashkëpunimit shkencor dypalësh, qëndrojnë në detyrë deri në përzgjedhjen e ekspertëve të komisioneve të reja të vlerësimit. Raportet e vlerësimit që ata kanë hartuar gjatë kësaj periudhe, për vlerësimin e projekt-propozimeve të ndryshme, të paraqitura pranë Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, mbeten në fuqi dhe shërbejnë si bazë për financimin e projekteve të përzgjedhura nga Agjencia Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

20. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1.7.2016 dhe përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

21. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 903, datë 21.12.2016

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË *(Ndryshuar me VKM nr. 450, datë 22.5.2017; nr. 697, datë 21.11.2018; nr. 39, datë 23.1.2019; nr. 755, datë 30.11.2019)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 112, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, nenit 6, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, nenit 12, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të nenit 32, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Studentët e shkëlqyer, me notë mesatare maksimale nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që ndjekin studimet në një program studimi të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në

institucionet publike të arsimit të lartë, përfitojnë bursë në masën e parashikuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Notë mesatare maksimale do të konsiderohet nota 10 (dhjetë), e përllogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë dhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore. Lista e studentëve të shkëlqyer hartohet nga Agjencia Kombëtare e Provimeve.

2. Për studentët e regjistruar në vitet pas të parit, notë mesatare maksimale do të konsiderohet nota 10 (dhjetë), e përllogaritur si mesatare e notave të të gjitha provimeve/detyrimeve të shlyera dhe të parashikuara për programin përkatës të studimit për vitet pararendëse. Këta studentë duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitet e mëparshme të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit akademik paraardhës.

3. Bursat e studimit për studentët, të cilët kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar në institucionet publike të arsimit të lartë, të shpallura të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave, u shpërndahen studentëve që studiojnë në këto programe dhe institucione, sipas masës së përcaktuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Studentët që frekuentojnë këto programe studimi e përfitojnë bursën vetëm për periudhën që ndjekin studimet në fushat prioritare dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.

4. Studentëve të regjistruar në programet e ciklit të parë të studimeve në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë publik dhe që u përkasin shtresave sociale në nevojë, u akordohen bursa kur ata plotësojnë kriteret për t'u konsideruar si studentë në nevojë. Masa e përfitimit të bursës është e përcaktuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Studentë në nevojë konsiderohen:

5.1 Sipas kriterit ekonomik:

a) Studentët që ndjekin studimet në largësinë mbi 10 (dhjetë) km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike nga njësia e vetëqeverisjes vendore;

b) Secili nga studentët, i cili rezulton bashkëshort me fëmijë, dhe kur familja e tij trajtohet me ndihmë ekonomike nga njësia e vetëqeverisjes vendore;

c) Personat me aftësi të kufizuar, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punës, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.

5.2 Jashtë kriterit ekonomik:

a) Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit;

b) Studentët që kanë humbur përgjegjësinë prindërore, me vendim gjykate të formës së prerë;

c) Studentët që janë identifikuar e trajtuar si viktima të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;

ç) Studentët që rezultojnë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të

Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

5.3 Studentët nuk përfitojnë bursë apo humbasin të drejtën e përfit imit në rast se:

a) janë ndarë nga trungu familjar;

b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

c) vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;

ç) shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese;

d) nuk kanë përfunduar programin e studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij, të përcaktuar në aktin e hapjes së programit përkatës të studimit.

6. Bursat për vitet e tjera, pas vitit të parë të studimeve, rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga institucionet publike të arsimit të lartë, për çdo student që rezulton student në nevojë. Njësia e qeverisjes vendore pajis studentët me dokumentacionin ligjor që vërteton gjendjen për t'u konsideruar student në nevojë.

7. Studentët që ndjekin studimet në IAL publike në vitet e tjera, pas vitit të parë të studimeve, që nuk kanë përfituar bursë në vitin e parë akademik dhe plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën 5, të këtij vendimi, mund të përfitojnë bursë brenda numrit të bursave të planifikuara dhe që administrohen nga institucionet publike të arsimit të lartë.

8. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për studentët administrohen nga institucionet publike të arsimit të lartë. Bursa përllogaritet si shpenzim mesatar ditor për lekë në ditë (lekë/ditë) dhe paguhet çdo muaj, me kalim në numrin e llogarisë bankare të çdo studenti. Drejtuesit e njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë dërgojnë zyrtarisht, çdo muaj, pranë njësisë së financës në institucionin e arsimit të lartë, të dhënat për shlyerjen e detyrimeve për frekuentimin e programit përkatës të studimit, që rrjedhin si pasojë e regjistrimit si student në atë program studimi, për të gjithë studentët që përfitojnë bursë.

9. Ministria e Arsimit dhe Sportit, mbështetur në numrin e studentëve që ndjekin vitin e parë akademik 2016-2017, harton planin e shpërndarjes së bursave, të cilat i përcjell për vlerësim dhe miratim në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këshillat bashkiakë, mbështetur në planin e dërguar nga MAS-i, shqyrtojnë dhe miratojnë kërkesat për bursë.

10. Kopje e vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e bursave përcillet zyrtarisht pranë IAL- ve publike dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nga njësitë e qeverisjes vendore.

11. Fondi përkatës për bursat transferohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në formën e transfertës së pakushtëzuar ose transfertës për individët te çdo IAL publike.

12. Për vitin akademik 2016-2017, Ministria e Arsimit dhe Sportit harton planin e shpërndarjes për 1 800 (një mijë e tetëqind) bursa dhe ndjek procedurat e sipërcituara. Për vitet në vijim, numri dhe plani i shpërndarjes së bursave miratohet me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

13. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave, për studentët e regjistruar në vitin e parë të studimeve për vitin akademik 2016- 2017, është data 31 janar 2017. Për të gjitha kategoritë tjera të studentëve të regjistruar në vitet e tjera, pas vitit të parë të studimeve në IALtë publike, është data 30 dhjetor 2016. Për vitet akademike në vijim, afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për të gjitha kategoritë, për sa më sipër, është jo më vonë se muaji dhjetor i vitit përkatës akademik.

14. Vendimet e institucioneve publike të arsimit të lartë dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore për miratimin e bursave të studentëve bëhen publike nga këto institucione, nëpërmjet publikimit në faqet e tyre ëeb, si dhe në ambientet e institucioneve përkatëse.

15. Efektet financiare për mbulimin e shpenzimeve për bursa për një vit të caktuar akademik përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit, të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për periudhat përkatëse buxhetore.

16. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, institucionet publike të arsimit të lartë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

ANEKSI 1

MASA E BURSËS PËR STUDENTËT NË IAL PUBLIKE

Nr. Kategoritë e bursave Totali mujor i bursës në lekë

1 Universitetet dhe shkollat e tjera të larta

a) Bursa për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentë në nevojë, që ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë 8 900

b) Gjysmë bursa, akordohen për raste të veçanta për kategorinë e studentëve në nevojë, që ndjekin studimet në vitin në ciklin e parë në institucionet e arsimit të lartë publik. 4 450

2 Universiteti i Sporteve

a) Bursa për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentë në nevojë, që ndjekin programe studimi në fushën e edukimit fizik në të cilat parashikohet të kryhen orë praktikash sportive 9 410

b) Gjysmë bursa, akordohen për raste të veçanta për kategorinë e studentëve në nevojë, që ndjekin studimet në vitin në ciklin e parë në institucionet e arsimit të lartë publik . 4 705

VENDIM

Nr. 66, datë 03.02.2017

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË PROCEDURAVE PËR NGRITJEN E ORGANIZIMIN E SHËRBIMEVE DHE STRUKTURAVE SHËNDETËSORE UNIVERSITARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Strukturat shëndetësore universitare realizojnë funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si dhe funksione mësimore e kërkimore, shkencore, për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë.
2. Strukturat shëndetësore universitare plotësojnë kërkesat e legjislacionit për institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë. Strukturat shëndetësore spitalore universitare publike përbëhen nga shërbimet shëndetësore/ mjekësore universitare, të cilat krijohen në bazë specialiteti.

3. Strukturat shëndetësore spitalore universitare janë të përgjithshme ose të profilizuara, në varësi të shërbimeve që ofrojnë.

4. Struktura Shëndetësore Spitalore Universitare e Përgjithshme duhet të ofrojë të paktën këto shërbime shëndetësore universitare:

a) Shërbimin e urgjencës polivalente;

b) Shërbimin e mjekësisë interne, ku përfshihen të gjitha specialitetet e sëmundjeve të brendshme, në varësi të programit akademik që ofron institucioni i arsimit të lartë;

c) Shërbimin e laboratorit mjekësor;

ç) Shërbimin e imazherisë;

d) Shërbimin e kirurgjisë; dh) Shërbimin e pediatrisë;

e) Shërbimin e terapisë intensive.

5. Struktura Shëndetësore Spitalore Universitare e Profilizuar ofron shërbim shëndetësor universitar në një profil të caktuar shërbimi.

6. Pranë strukturave shëndetësore spitalore universitare organizohen dhe funksionojnë edhe njësi mjekësore, të cilat nga natyra e specialitetit mjekësor/klinik që trajtojnë, kanë lidhje funksionale me shërbimet shëndetësore universitare. Këto njësi realizojnë shërbime shëndetësore, funksione diagnostikuese e trajtuese. Njësitë mjekësore duhet të jenë të pajisura me jo më pak se 10 shtretër. Hapja dhe mbyllja e njësive mjekësore publike bëhen me miratimin e ministrit të Shëndetësisë, ndërsa

ato jopublike hapen dhe mbyllen sipas legjislacionit në fuqi për licencimin e institucioneve shëndetësore.

7. Organet drejtuese të Strukturës Shëndetësore Universitare janë:

a) Bordi i Strukturës Shëndetësore Universitare;

b) Drejtoria e Përgjithshme;

c) Komisioni Mjekësor i Strukturës Shëndetësore Universitare.

8. Mënyra e funksionimit të Strukturës Shëndetësore Universitare publike përcaktohet në statutin e saj, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin e sportin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

9. Bordi i Strukturës Shëndetësore Universitare publike përbëhet nga 5 anëtarë, si më poshtë vijon:

a) Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe sportin;
b) Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë;

c) Përfaqësues nga institucioni i arsimit të lartë mjekësor;

ç) Kryetari i Komisionit Mjekësor;

d) Përfaqësues nga institucioni që financon kujdesin shëndetësor.

Kryetar i Bordit është përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

10. Bordi i Strukturës Shëndetësore Universitare publike ka këto funksione kryesore:

a) Miraton projektbuxhetin, strukturën

administrative, strukturën shëndetësore universitare dhe numrin e personelit të shërbimeve shëndetësore universitare;

b) Miraton raportin e veprimtarisë shëndetësore dhe kërkimore shkencore të shërbimeve shëndetësore universitare;

c) Miraton raportin vjetor të veprimtarisë financiare;

ç) Miraton rregulloret e funksionimit të Strukturës Shëndetësore Universitare;

d) Miraton rregullat dhe procedurat e punësimit të Strukturës Shëndetësore Universitare dhe kërkon raport nga drejtori i Përgjithshëm për zbatimin e tyre.

Përgjegjësitë e veçanta të Bordit miratohen në statutin e institucionit shëndetësor.

11. Detyrat dhe kompetencat e drejtorit të Përgjithshëm dhe të Komisionit Mjekësor përcaktohen në statutin e institucionit.

12. Drejtori i Përgjithshëm i Strukturës Shëndetësore Universitare publike emërohet nga ministri i Shëndetësisë sipas legjislacionit në fuqi. Ai administron aktivitetin e përgjithshëm të institucionit sipas shërbimeve shëndetësore /mjekësore/e njësive dhe siguron zbatimin e objektivave të institucionit bazuar në strategjinë e zhvillimit të tij, nëpërmjet strukturave në varësi. Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë të jetë pjesëmarrës në çdo mbledhje të Bordit të institucionit shëndetësor, pa të drejtë vote.

13. Shërbimi shëndetësor spitalor universitar organizohet dhe funksionon në bazë të kritereve të mëposhtme:

a) Të ketë një normativë 70% të shfrytëzimit të shtratit në shërbimin spitalor me shtretër;

b) Të mbulojë minimumi 50% të nevojave për kujdes shëndetësor/mjekësor, bazuar në të dhënat e aktivitetit të institucionit;

c) Të ketë në përbërje të tij jo më pak se dy anëtarë efektivë si personel akademik ku njëri prej tyre me kohë të plotë për secilin shërbim, që duhet të zotërojë gradë shkencore "Doktor" ose titull shkencor.

ç) Të plotësojë standardet e ofrimit të shërbimit spitalor;
d) Të plotësojë standardet e miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe sportin për realizimin e procesit të mësimdhënies në fushën e shëndetësisë.

14. Strukturë Shëndetësore Universitare është edhe Instituti i Shëndetit Publik, i cili ofron shërbim shëndetësor parandalues dhe funksione mësimore e kërkimore shkencore. Organet drejtuese të Institutit të Shëndetit Publik janë sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 10138, datë 11.5.2009, "Për shëndetin publik".

15. Strukturë Shëndetësore Universitare është edhe Klinika Stomatologjike Universitare, e cila ofron shërbime shëndetësore stomatologjike publike për popullatën dhe funksione mësimore e kërkimore shkencore.

16. Strukturë Shëndetësore Universitare është edhe Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, e cila ofron shërbime shëndetësore dhe funksione mësimore e kërkimore shkencore në fushën e mjekësisë transfuzive.

17. Vendimi nr.764, datë 12.11.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve në qendrat spitalore universitare", shfuqizohet.

18. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr.109, datë 15.02.2017

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË E TË BORDIT TË AKREDITIMIT DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR PROCESET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË ". *(Ndryshuar me VKM nr. 562, datë 31.7.2019)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 15 e 106, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Riorganizimin e Agjencisë Publike të Arsimit të Lartë (APAAL) në Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

2. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë është institucion publik qendror, person juridik, me seli në Tiranë, dhe financohet nga buxheti i shtetit e të ardhurat e tjera të ligjshme.
3. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë ushtron veprimtarinë brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.

4. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë gëzon pavarësi në:

a) hartimin dhe miratimin e procedurave të saj, të kritereve e të formateve të vlerësimit;

b) përzgjedhjen e ekspertëve e të komisioneve të posaçme të vlerësimit;

c) përpilimin e përmbajtjes dhe të rezultateve të raporteve të vlerësimit të cilësisë akademike.

5. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë mbështet veprimtarinë e saj mbi udhëzuesit e brendshëm dhe në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, i cili përditësohet me standardet dhe udhëzuesit evropianë të cilësisë në hapësirën evropiane të arsimit të lartë dhe ka për mision:

a) sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë përmes vlerësimit të jashtëm, objektiv dhe të pavarur; b)

ruajtjen e standardeve të cilësisë;

c) promovimin dhe përmirësimin e cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë e të programeve të studimit që ato ofrojnë.

6. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë drejtohet nga drejtori, i cili është titullari i institucionit dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretë. Ai organizon dhe drejton gjithë veprimtarinë e institucionit.

7. Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë emërohet, lirohet/shkarkohet nga detyra me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, me urdhër të Kryeministrit. Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Të zotërojë titull akademik ose gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së.

b) Të ketë 5 (pesë) vjet përvojë pune në drejtim të:

i) njësive kryesore të institucioneve të arsimit të lartë; ii) institucioneve të arsimit të

lartë; iii) strukturave të institucioneve që ushtrojnë veprimtari në fushën e arsimit të

lartë.

8. Struktura dhe organika e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë miratohet me urdhër të Kryeministrit, brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

9. Marrëdhëniet e punës për drejtorin dhe punonjësit e ASCAL-it rregullohen sipas përcaktimeve të Kodit të Punës.

10. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë ka objekt të veprimtarisë:

a) vlerësimin e jashtëm të cilësisë për akreditimin e parë dhe periodik të institucioneve të arsimit të lartë e të programeve të studimit që ato ofrojnë;
b) monitorimin, vlerësimin e cilësisë akademike e të përputhshmërisë me standardet e cilësisë së institucioneve dhe programeve të ofruara prej tyre, përpara vlerësimit për akreditim të parë dhe në vijim;

c) vlerësimin paraprak në kuadër të hapjes dhe/ose riorganizimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit me kërkesë të ministrisë përgjegjëse për arsimin;

ç) vlerësimin paraprak dhe njohjen e programeve të studimit, të ofruara në institucione shqiptare të akredituara të arsimit të lartë nga institucione të huaja të arsimit të lartë të njërit prej shteteve të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë dhe Australisë;

d) vlerësimin periodik, çdo tre vjet, të cilësisë së mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë dhe monitorimin e vazhdueshëm të saj përmes Sondazhit Kombëtar të Studentëve, në përputhje me udhëzuesit e saj;

dh) vlerësimin e sistemeve të brendshme të cilësisë (auditimin) në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me udhëzuesit e saj dhe standardet e udhëzimet për sigurimin e cilësisë në hapësirën evropiane të arsimit të lartë;

e) vlerësimet tematike, analitike dhe krahasuese të institucioneve dhe/ose programeve të studimit, në funksion të politikave për arsimin e lartë, në mënyrë autonome ose me kërkesë të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

11. ASCAL-i ka këto detyra dhe përgjegjësi specifike:

a) Ndihmon për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me Kodin e Cilësisë. Ajo bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë dhe mban marrëdhënie të vazhdueshme me këto njësi.

b) Bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për arsimin për përgatitjen e standardeve shtetërore të cilësisë dhe përditësimin në vijim të tyre si pjesë e Kodit të Cilësisë.

c) Harton udhëzuesit e vlerësimit, kriteret, procedurat, formatet e vlerësimeve dhe akte të tjera për funksionimin e brendshëm të saj.

ç) I propozon ministrit përgjegjës për arsimin ndryshime të bazës ligjore në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

d) Është autoriteti përgjegjës për administrimin dhe shkëmbimin e informacionit që lidhet me rezultatet, cilësinë dhe akreditimin në arsimin e lartë.

dh) Bën publike, përmes faqes zyrtare të saj në internet, raportet përfundimtare të vlerësimit të jashtëm, monitorimit të vazhduar të cilësisë, Sondazhit Kombëtar të Studentëve si dhe aktet e Bordit të Akreditimit. Jep informacion të përditësuar mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë/programeve lidhur me vlerësimin dhe akreditimin si dhe bën të njohur, para fillimit të çdo viti akademik listën e institucioneve të arsimit të lartë e të programeve të studimit të akredituara.

e) Publikon dhe boton materiale e informacione kombëtare e ndërkombëtar, mbi sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.
ë) Administron databazën elektronike në funksion të procesit të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë.

f) Administron kërkesat e institucioneve të arsimit të lartë për vlerësimin e jashtëm nga agjenci, anëtare të Rrjetit Evropian të Sigurimit të Cilësisë (ENQA), të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Akreditimit.

g) Bashkëpunon dhe bashkërendon veprimta-rinë e saj me agjenci homologe, pjesë të (ENQA) dhe/ose Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë (EQAR), nëpërmjet kryerjes së vlerësimeve të përbashkëta dhe/ose të koordinuara, përzgjedhja e të cilave bëhet sipas profilit dhe karakteristikave për çdo vlerësim ku angazhohen.

gj) Ndjek procedurat për anëtarësimin e ASCAL-it me të drejta të plota në Rrjetin Evropian të Sigurimit të Cilësisë (ENQA) dhe/ose Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë (EQAR).

h) Bashkërendon aktivitetin e saj me ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe institucionet e saj të varësisë, në shërbim të politikave që lidhen me cilësinë në arsimin e lartë, për vlerësimin e kërkimit shkencor, financimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe shkëmbimin e të dhënave në fushën e arsimit të lartë.

i) Bashkëpunon dhe bashkërendon me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, duke përfshirë rezultatet e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të AKKSHI-t për proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë.

12. Për procedurën e vlerësimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë vepron, si më poshtë vijon:

a) Ngre komisionet e posaçme të vlerësimit, të përbëra nga ekspertë vendas dhe/ose të huaj, të cilët duhet të kenë:

- gradë shkencore ose titull akademik;

- përvojë pune të dokumentuar të mëparshme në vlerësimin institucional dhe/ose në fushën e programeve të studimit, në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë në Shqipëri dhe/ose jashtë vendit.

Kriteret shtesë për përzgjedhjen e këtyre ekspertëve, në raste specifike e të certifikuara, në varësi të llojit të vlerësimit të jashtëm, programit dhe ciklit të studimit, përcaktohen në rregulloren e brendshme të Bordit të Akreditimit.

b) Ekspertët në përbërje të këtyre komisioneve përzgjidhen sipas rregullores së brendshme të

ASCAL-it nga listat vjetore të miratuara nga Bordi i Akreditimit. Përbërja e komisioneve të posaçme të vlerësimit, numri i ekspertëve për çdo lloj vlerësimi dhe shpërblimi i tyre përcaktohen sipas shtojcës 1 dhe tabelave 1/a e 1/b që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

c) Komisionet e përkohshme për vlerësime tematike, analitike e krahasuese përbëhen nga ekspertë vendas dhe/ose të huaj, me kualifikime akademike, me përvojë në arsimin e lartë e kërkimin shkencor dhe njohës të proceseve të cilësisë, sipas fushave kryesore të arsimit të lartë në shkencat natyrore, inxhinierike e teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale e humane, nga listat e miratuara nga Bordi i Akreditimit.

13. Pranë ASCAL-it ngrihet dhe funksionon Bordi i Akreditimit , si organ kolegjial vendimmarrës dhe i pavarur në veprimtarinë e tij.

14. Bordi i Akreditimit ka në përbërje 11 anëtarë, nga të cilët minimalisht 3 dhe maksimalisht 5 duhet të jenë të huaj. Kryetari dhe anëtarët e këtij bordi duhet të kenë një përvojë të paktën 10-vjeçare në institucione akademike dhe kërkimore, brenda e jashtë vendit, gradë shkencore/titull akademik ose njohje e përvojë të paktën 5-vjeçare në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Kryetari dhe anëtarët e bordit duhet gjithashtu të kenë njohje në nivel të avancuar të gjuhës angleze të shkruar dhe të folur.

15. Emërimi dhe shkarkimi i kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Akreditimit bëhen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin. Mandati i anëtarëve të këtij bordi është 4 vjet.

16. Bordi i Akreditimit mblidhet jo më pak se 6 (gjashtë) herë në vit. Anëtari i këtij bordi që mungon pa arsye në 1/3 e mbledhjeve zëvendësohet.

17. Anëtarët e Bordit të Akreditimit duhet të respektojnë aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë konfliktin e interesit.

18. Mbledhja e Bordit të Akreditimit zhvillohet kur marrin pjesë jo më pak se 8 (tetë) anëtarë të tij. Ajo nuk zhvillohet nëse, së paku, dy ekspertë të huaj nuk janë të pranishëm. Vendimet e bordit merren me shumicë të cilësuar, prej 3/4 të anëtarëve të pranishëm.

19. Bordi i Akreditimit miraton rregulloren e funksionimit të tij të brendshëm.

20. Bordi i Akreditimit mbështetet nga sekretariati teknik, nëpunës të ASCAL-it të caktuar nga drejtori i ASCAL-it.

21. Bordi i Akreditimit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Shqyrton raportet përfundimtare të vlerësimit të jashtëm të cilësisë për akreditim të parë dhe periodik, për akreditimin institucional dhe atë të programeve të studimit dhe merr vendimin përfundimtar për akreditimin e tyre.

b) Në rastet kur vlerësimi i jashtëm kryhet nga agjenci të huaja, me kërkesë të institucioneve të arsimit të lartë, sipas pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr.80/2015, ky bord shqyrton dhe miraton paraprakisht kërkesën e institucionit të arsimit të lartë për kryerjen e vlerësimit përkatës nga agjencia e huaj.

c) Merr vendim përfundimtar, i cili mund të jetë:

- "pozitiv", kur përmbushen standardet dhe kriteret përkatëse institucionale apo të programeve.

Kohëzgjatja dhe afati i vlefshmërisë së akreditimit institucional përcaktohen sipas shkallës së plotësimit të standardeve të cilësisë, ndërsa për programet e studimit edhe në varësi të kohëzgjatjes së tyre. Kohëzgjatja maksimale e vlefshmërisë së akreditimit institucional dhe/ose programeve të studimit nuk mund të jetë më shumë se 6 vite;

- "negativ", kur konstatohet një nivel i ulët i cilësisë dhe mosplotësim i standardeve, si dhe pamundësi e institucionit për t'i përmbushur ato.

ç) Përpara marrjes së vendimit përfundimtar, mbështetur në rezultatet e vlerësimit dhe mundësitë e institucionit, bordi mund të kërkojë plotësime, të vendosë kushte dhe afate për përmbushjen e tyre.

d) Shqyrton raportet e vlerësimit paraprak në kuadër të hapjes dhe/ose riorganizimit të institucioneve të arsimit të lartë e të programeve të studimit dhe i rekomandon ministrit përgjegjës për arsimin hapjen/riorganizimin ose jo të institucioneve të arsimit të lartë e të programeve të studimit.

dh) Shqyrton ankesat për procesin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe shprehet me vendim të arsyetuar lidhur më këto ankesa, duke vendosur pranimin apo mospranimin e saj, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Admini-strative.

e) Lëshon certifikatën zyrtare të akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së vendimit.

ë) Administron, për efekt vendimmarrjeje apo rishikim të vendimmarrjes së mëparshme të akreditimit, rastet kur nga ASCAL-i apo ministria përgjegjëse për arsimin konstatohen shmangie nga standardet prej institucioneve të arsimit të lartë.

f) Në vendimmarrjen për akreditimin e programeve të përbashkëta të studimit, që ofrohen midis institucioneve vendase të arsimit të lartë me institucione të huaja të arsimit të lartë, si dhe për filialet e institucioneve të huaja të arsimit të lartë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, merr parasysh edhe akreditimin e tyre në vendin e origjinës.

g) Për marrjen e vendimeve të tij, bordi ndjek Kodin e Procedurave Administrative. Vendimi i bordit është i formës së prerë, përfundimtar dhe i detyruar për t'u zbatuar. Kundër vendimeve të bordit mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore nga pala që ka interes të ligjshëm, sipas afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për kundërshtimin gjyqësor të akteve administrative.

gj) Kryen vlerësimin paraprak dhe njohjen e programeve të studimit të ofruara në institucione shqiptare të akredituara të arsimit të lartë nga institucione të huaja të arsimit të lartë të njërit

prej shteteve të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë dhe Australisë.

h) Miraton raportin vjetor të veprimtarisë së bordit dhe ASCAL-it, i cili publikohet brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik pasardhës dhe i përcillet menjëherë për dijeni edhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

i) Miraton kriteret specifike të përzgjedhjes së ekspertëve vendas dhe të huaj të vlerësimit.

j) Miraton listën vjetore të ekspertëve vendas dhe të huaj të vlerësimit, që angazhohen në kuadër të komisioneve të posaçme ose të përkohshme sipas fushave akademike, mbështetur në listat e ASCAL-it dhe atyre të ekspertëve të huaj, të vëna në dispozicion nga ENQA/EQAR.

k) Miraton udhëzuesit mbi proceset e sistemit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë, të hartuar dhe të propozuar nga ASCAL-i.

l) Miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të ASCAL-it.

ll) Mbështetur në rezultatet e akreditimit, i kërkon ASCAL-it kryerjen e proceseve të posaçme të monitorimit të cilësisë për institucionet e arsimit të lartë apo programeve të stud imit dhe shqyrton rezultatet e tyre.

m) Miraton metodologjinë dhe instrumentet e Sondazhit Kombëtar të Studentëve për cilësinë e mësimdhënies, të propozuar nga ASCAL.

n) Shqyrton raportet përfundimtare të Sondazhit Kombëtar të Studentëve përpara publikimit të tyre. nj) Miraton modelin dhe formatin e certifikatës së akreditimit që përgatitet nga ASCAL.

22. Financimi i ASCAL-it dhe Bordit të Akreditimit realizohet nga buxheti i shtetit, si dhe të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e saj: si tarifat e vlerësimit, të ardhurat nga trajnimet, të ardhurat nga shërbimet e ofruara, të ardhurat nga programe dhe projekte vendase e të huaja, donacione të subjekteve fizike e juridike, vendase e të huaja, si dhe çdo burim tjetër i ligjshëm.

23. Tarifat për vlerësimin e jashtëm të cilësisë dhe akreditimin, që paguhen nga institucionet e arsimit të lartë, janë sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

24. ASCAL-i ka të drejtën e përdorimit të 90 për qind të të ardhurave nga veprimtaria e saj. Të ardhurat e papërdorura gjatë një viti financiar kalojnë në vitin pasardhës. Të ardhurat shërbejnë për pagesat e konsulentëve e të ekspertëve të jashtëm të angazhuar, pagesat dhe shpenzimet e Bordit të Akreditimit, për investime, pagesa dhe shpenzime operative të ASCAL-it, veprimtaritë jashtë vendit, përfshirë anëtarësimin në rrjetet ndërkombëtare.

25. Skema e përdorimit të të ardhurave miratohet nga Ministria e Financave.

26. Kryetari dhe anëtarët e Bordit të Akreditimit paguhen për çdo pjesëmarrje në mbledhje për jo më shumë se 9 (nëntë) mbledhje për një vit kalendarik.

27. Masa e shpërblimit për çdo mbledhje të jetë, si më poshtë vijon:

a) Anëtarët vendas, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

b) Anëtarët e huaj, në masën 1 200 (një mijë e dyqind) euro;

c) Në rastin kur kryetari është vendas, në masën 30% më shumë se anëtarët vendas. Në rastin kur kryetari është i huaj, në masën 30% më shumë se anëtarët e huaj.

28. Kryetarit dhe anëtarëve të huaj të Bordit të Akreditimit u mbulohen shpenzimet e udhëtimit e të akomodimit në Shqipëri për jo më shumë se tre ditë kalendarike për mbledhje.

29. Kryetarit dhe anëtarëve vendas të Bordit të Akreditimit, me vendbanim jashtë kryeqytetit, u mbulohen shpenzimet e udhëtimit e të akomodimit në Tiranë, për jo më shumë se tre ditë kalendarike për mbledhje. Shpenzimet për veprimtarinë e bordit mbulohen nga të ardhurat e ASCAL-it.

30. ASCAL-i ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare, të cilat miratohen nga titullari i Agjencisë.

31. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: "Republika e Shqipërisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë", në përputhje me vendimin nr.474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj", të ndryshuar.

32. Vula zyrtare e ASCAL-it ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin nr.390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare", të ndryshuar. Vula e ASCAL-it prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

33. Struktura dhe organika e APAAL-it, e miratuar sipas urdhrit nr.171, datë 27.9.2010, të Kryeministrit, mbeten në fuqi deri në miratimin e strukturës dhe organikës së re sipas këtij vendimi.

34. Kryetari dhe anëtarët e Bordit të Akreditimit emërohen me urdhër të Kryeministrit, brenda 1 (një) muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Këshilli i Akreditimit vijon të funksionojë me përbërjen aktuale deri në krijimin e Bordit të Akreditimit.

35. Vendimi nr.424, datë 2.6.2010, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe organizimin e APAAL", i ndryshuar, shfuqizohet.

36. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Shtojca 1.

Pagesat e ekspertëve të huaj dhe vendas që angazhohen në procesin e vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit

1. Ekspertët e huaj, që angazhohen për vlerësimin e jashtëm të institucioneve dhe programeve të studimit në kuadër të akreditimit, paguhen me 500 euro/për ditë, për një numër ditësh që përcaktohen sipas tabelave 1/a. dhe 1/b.

2. Ekspertët vendas, që angazhohen për vlerësimin e jashtëm të institucioneve dhe programeve të studimit në kuadër të akreditimit, paguhen me 25 000 lekë/për ditë, për një numër ditësh që përcaktohen sipas tabelave 1/a dhe 1/b.

3. Ekspertëve të huaj u mbulohen shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit në Shqipëri, por jo më shumë se 5 ditë, ndërsa ekspertëve vendas u mbulohen shpenzimet e udhëtimit e të qëndrimit kur vlerësimi kryhet jashtë vendbanimit të saj/tij, për jo më shumë se 5 ditë.

4. Pagesa e ekspertit për shërbimet e kryera sipas pikës 6, të nenit 104, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin sh kencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", bëhet sipas pikave 1 dhe 2 dhe tabelave 1/a dhe 1/b të kësaj shtojce.

5. Komisionet e përkohshme përbëhen nga tre ekspertë. Pagesa e ekspertit për "... vlerësime analitike e krahasuese, si dhe procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.", të parashikuara në pikën 1, të nenit 104, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", bëhet sipas kategorisë së personelit akademik me titullin "Profesor", në institucionet publike të arsimit të lartë, për jo më shumë se 5 ditë për çdo vlerësim.

6. Eksperti vendas ose i huaj, që angazhohet në kuadër të plotësimit të kushteve apo për vlerësimin paraprak në kuadër të hapjes dhe/ose riorganizimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit, paguhet në masën 25% të tarifës bazë të parashikuar për vlerësimin e jashtëm të IAL-së dhe/ose programit të studimit, sipas tabelave 2/a dhe 2/b.

Tabela 1/a: Pagesa e ekspertëve për vlerësimin institucional

Nr. Programet e studimit Ekspert i huaj Ekspert vendas

Ditë/ekspert Nr. i ekspertëve Ditë/ekspert Nr. i ekspertëve

1 Kolegj profesional 1 deri 3 1 1 deri 3 1

2 Akademi 2 deri 4 1 2 deri 4 1

3 Kolegj universitar 3 deri 5 1 3 deri 5 2

4 Universitet 4 deri 6 2 4 deri 6 1

Tabela 1/b: Pagesat e ekspertëve për vlerësimin e programeve të studimit

Nr. Programet e studimit Ekspert i huaj Ekspert vendas

Ditë/ekspert Nr. i ekspertëve Ditë/ekspert Nr. i ekspertëve

1 2-vjeçar profesional - - 1 deri 2 2

2 Bachelor - - 2 deri 3 2

3 Bachelor 4-vjeçar - - 2 deri 4 2

4 Master profesional 1 vit - - 1 deri 2 2

5 Master Profesional 2 vite - 2 deri 3 2

6 Master i Shkencave 1 deri 2 1 1 deri 2 1

7 Master i Shkencave i Integruar 3 deri 4 1 3 deri 4 1

8 Master ekzekutiv 1 vit 1deri 2 1 1deri 2 1

9 Master ekzekutiv 2 vite 2 deri 3 1 2 deri 3 1

10 SPA 2 vite 1deri 2 1 1deri 2 1

11 SPA 3-4 vite 2 deri 3 1 2 deri 3 1

12 Doktoratë 2 deri 3 2 1 deri 3 0

Shtojca 2. Tarifat për vlerësimin dhe akreditimin në institucionet e arsimit të lartë

1. Tarifat, që paguajnë IAL-të për vlerësimin dhe akreditimin institucional, përllogariten sipas tarifës bazë të përcaktuar për llojin e institucionit mbi të cilën aplikohet rritje në % në varësi numrit të fushave të studimit ku operon IAL-ja, nivelit të studimeve dhe numrit të studentëve që ka në momentin e paraqitjes së kërkesës për vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit. Tarifa bazë dhe përllogaritjet përkatëse paraqiten në tabelën 2/a. Me vendim të Bordit të Akreditimit, mund të përjashtohen nga pagesa e tarifave për vlerësimin dhe akreditimin institucional institucionet e arsimit të lartë që kanë jo më shumë se 30 studentë, në të gjitha ciklet e studimit.

2. Tarifat që paguajnë IAL-të për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit sipas llojit të tyre paraqiten në tabelën 2/b.

3. Tarifa e vlerësimit dhe akreditimit të programit të studimit është për programet pa profile ose me një profil. Për programet e studimit që kanë më shumë se një profil dhe vlerësimi kryhet njëkohësisht, pagesa për vlerësimin e programit shtohet me 10% të vlerës së tarifës bazë, për çdo profil të shtuar. Profilet, të cilat nuk vlerësohen dhe nuk akreditohen bashkë me programin, i nënshtrohen tarifës së plotë të programit në momentin e vlerësimit e të akreditimit të tyre.

4. Tarifat që paguajnë IAL-të, në kuadër të plotësimit të kushteve apo për vlerësimin paraprak në kuadër të hapjes dhe/ose riorganizimit të institucioneve të arsimit të lartë e të programeve të studimit është në masën 30% të tarifës bazë të parashikuar për vlerësimin e jashtëm të IALsë dhe/ose programit të studimit, sipas tabelave 2/a dhe 2/b.

5. Programet e studimit sipas pikës 5, të nenit 35, të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, paguajnë 50% të tarifës së vlerësimit dhe akreditimit të programit të të njëjtit cikël dhe lloj.

6. Për vlerësimin e kërkesës dhe miratimin e agjencisë së huaj të vlerësimit, sipas pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", tarifa është në masën 120 000 lekë.

7. Për shqyrtimin e vlerësimit të jashtëm dhe vendimmarrjen e akreditimit që kryhet sipas pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", tarifa është në masën 180 000 lekë.

8. Tarifa për shqyrtimin e aplikimit për vlerësim në kuadër të akreditimit është në masën 3 000 lekë.

9. Llogaritja e tarifës për çdo vlerësim të kërkuar nga IAL-të bëhet nga ASCAL dhe i njoftohet IAL-së, e cila para fillimit të procesit të vlerësimit e arkëton pranë bankave të nivelit të dytë për llogari të ASCAL-it, në degën e thesarit Tiranë.

10. Tarifat për shërbime të tjera të ofruara nga ASCAL, për individë, ekspertë apo institucione, janë të parashikuara në tabelën 2/c.

11. Të ardhurat, që krijohen nga tarifat e vlerësimit dhe shërbimeve të tjera të ofruara nga ASCAL, përdoren për:

a) pagesat dhe shpenzimet e ekspertëve që angazhohen sipas shtojcës 2;
b) pagesat dhe shpenzimet për Bordin e Akreditimit;

c) mbulimin e shpenzimeve operative për Bordin e Akreditimit;

ç) investime për ASCAL-in dhe BA-në;

d) tarifat vjetore të anëtarësimit të ASCAL-it në rrjetet ndërkombëtare;

dh) pagesat për vlerësimin për anëtarësimin e ASCAL-it në ENQA, EQAR apo rrjete të tjera ndërkombëtare;

e) shpërblime suplementare për punonjësit e ASCAL-it.

Tabela 2/a: Tarifat bazë për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin institucional të IAL-ve

Nr. Lloji i institucionit të arsimit të lartë Tarifa bazë Rritja mbi tarifën bazë

1 Kolegj profesional me 1-2 fusha studimi, deri në 200 studentë 791 500 lekë Tarifa bazë rritet me 10% për çdo fushë të shtuar dhe 5% për çdo 200 studentë mbi atë që parashikon tarifa bazë. (Tarifa bazë + 10% të tarifës bazë për çdo fushë studimi + 5% të tarifës bazë për çdo 200 studentë plus)

2 Akademi për ciklin I dhe II, deri në 300 studentë 910 875 lekë Tarifa bazë rritet me 15% në raste kur ofron programe të studimit të ciklit të tretë dhe 5% për çdo 300 studentë mbi atë që parashikon tarifa bazë.

(Tarifa bazë + 15% të tarifës bazë për ofrimin e ciklit të tretë të studimit + 5% të tarifës bazë për çdo 300 studentë plus)

3 Kolegji universitar me 1-2 fusha studimi, deri në 600 studentë 1 205 250 lekë Tarifa bazë rritet me 10% për çdo fushë të shtuar dhe 5% për çdo 600 studentë mbi atë që parashikon tarifa bazë

(Tarifa bazë +10% të tarifës bazë për çdo fushë studimi + 5% të tarifës bazë për çdo 600 studentë plus)

4 Universitet me 1-2 fusha studimi, deri në 2000 studentë 1 888 625 lekë Tarifa bazë rritet me 10% për çdo fushë të shtuar dhe 5% për çdo 2000 studentë mbi atë që parashikon tarifa bazë (Tarifa bazë + 10% të tarifës bazë për çdo fushë studimi +5% të tarifës bazë për çdo 2000 studentë plus)

Tabela 2/b: Tarifat për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin e programeve të studimit

Nr. Programet e studimit Tarifa

1 2-vjeçar profesional 204 260 lekë

2 Bachelor 265 585 lekë

3 Bachelor 4-vjeçar 326 910 lekë

4 Master Profesional 1 vit 204 260 lekë
5 Master Profesional 2 vite 265 585 lekë

6 Master i Shkencave 428 844 lekë

7 Master i Shkencave i Integruar 706 994 lekë

8 Master ekzekutiv 1 vit 362 844 lekë

9 Master ekzekutiv 2 vite 428 844 lekë

10 SPA 2 vite 428 844 lekë

11 SPA 3-4 vite 567 919 lekë

12 Doktoratë 718 224 lekë

Tabela 2/c: Tarifa për shërbime të tjera

Nr. Përshkrimi Koha e pagesës Lekë

1. Tarifë për vlerësimin e jashtëm të sistemit të brendshëm të cilësisë Tarifa paguhet me depozitimin e aplikimit pranë ASCAL-it. 100 000

2 Tarifë për aktivitete të posaçme me kërkesë të IAL-së në kuadër të procesit të vlerësimit të cilësisë Tarifa paguhet me depozitimin e aplikimit pranë ASCAL-it 20 000

3 Tarifë për vërtetime dhe informacione/për faqe Tarifa paguhet me depozitimin e aplikimit pranë ASCAL-i 200

4 Tarifë për dhënie dokumentacioni që lidhet me vlerësimin dhe akreditimin që nuk përfshihen në ligjin për informimin publik /për faqe Tarifa paguhet me depozitimin e aplikimit pranë ASCAL-it 10

5 Tarifë vjetore për shërbime të kryera nga ASCAL për IAL-të (botime të veçanta, ëorkshop, trajnime, etj.) Çdo fillim viti akademik 50,000

6 Tarifë vjetore për shërbime të kryera nga ASCAL për ekspertët (botime të veçanta, ëorkshop, trajnime etj.) Çdo fillim viti akademik 5,000

VENDIM

Nr. 269, datë 29.03.2017

PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT
(Ndryshuar me VKM nr. 698, datë 21.11.2018; nr. 779, datë 26.12.2018; nr. 40, datë 23.1.2019; nr. 251, datë 27.3.2020)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 dhe 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 dhe 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 dhe 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të neneve 5 dhe 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore""", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentët të cilët janë pranuar në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, në institucionet publike të arsimit të lartë, të kategorive të mëposhtme:

a) Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

b) Studentët, familjet e të cilëve trajtohen /përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, si dhe studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;

c) Studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;

ç) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë;

d) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktima të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktima të trafikut të qenieve njerëzore;

dh) Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe ajo e mbrojtjes;

e) Studentët romë dhe ballkano-egjiptianët, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mirëqenien sociale;

ë) Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;

f) Studentët e shkëlqyer që rezultojnë me notën mesatare vjetore 10 (dhjetë), për studentët e regjistruar në vitet pas të parit, notë mesatare maksimale do të konsiderohet nota 10 (dhjetë), e përllogaritur si mesatare e notave të të gjitha provimeve/detyrimeve të shlyera dhe të parashikuara për programin përkatës të studimit për vitet pararendëse. Këta studentë duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitet e mëparshme të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit akademik paraardhës;

g) Studentët e shkëlqyer, me notë mesatare maksimale nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që ndjekin studimet në një program studimi të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë. Notë mesatare maksimale do të konsiderohet nota 10 (dhjetë) e përllogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë dhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore. Lista e studentëve të shkëlqyer hartohet nga Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe dërgohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit si dhe në institucionet publike të arsimit të lartë.

2. Studentët sipas kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1 të këtij vendimi, përjashtohen nga tarifa vjetore e studimit, pas paraqitjes së dokumentacionit vërtetues për statusin e tyre ligjor, me vendim të Bordit të Administrimit të Institucionit Publik të Arsimit të Lartë.

Bordi i Administrimit të institucionit shqyrton dhe miraton për çdo vit akademik, jo më vonë se muaji dhjetor, listën e studentëve të kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1, të këtij vendimi. Për vitin akademik 2016-2017, ky vendim duhet të realizohet brenda muajit prill 2017. Vendimi i Bordit të Administrimit të Institucionit Publik të Arsimit të Lartë i njoftohet Agjencisë Kombëtare së Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit.

3. Individët që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi të të njëjtit cikël. Në këtë rast, kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.

4. Studentit përsëritës i ndërpritet mbështetja nga fondet publike, me përjashtim të rasteve të forcave madhore.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes si dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 329, datë 12.04.2017

PËR STATUSIN DHE TRAJTIMIN E VEÇANTË TË PERSONELIT AKADEMIK
Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 58, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personeli akademik gëzon status dhe trajtim të veçantë, që konsiston në liritë akademike, të drejtat ekonomiko-financiare, detyrimet e përgjegjësitë si dhe garancitë juridike e civile në zbatim të tyre.

2. Personeli akademik gëzon liri akademike në këto drejtime të veprimtarisë së tij,

në: a) mësimdhënie;

b) punë kërkimore-shkencore;

c) kontribut institucional;

ç) kontribut profesional.

3. Liria akademike ushtrohet në kuadrin e përgjegjshmërisë pedagogjike e shkencore dhe nuk presupozon përjashtimin nga vlerësimi i performancës së personelit akademik.

Personeli akademik nuk mund të penalizohet për shkak të qëndrimeve të tij ndaj politikave të institucionit. Në të gjitha rastet, personeli akademik vepron brenda normave të etikës, në respekt të institucionit dhe kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

4. Personeli akademik e humbet statusin kur përfundon/zgjidhet kontrata.

5. Anëtarët e personelit akademik nuk mund të penalizohen nga institucioni i arsimit të lartë për shkak të rezultateve të vlerësimit të punës së tyre kërkimore-shkencore, të kryera në përputhje me fushën përkatëse dhe misionin e institucionit të arsimit të lartë.

6. Në rast se anëtari i personelit akademik konstaton se i është cenuar liria akademike, dinjiteti profesional apo ka një qëndrim joetik ndaj tij, i drejtohet Këshillit të Etikës të IAL-së, për këtë çështje. Procedura e trajtimit të ankesave kryhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të institucionit të arsimit lartë. Vendimi i Këshillit të Etikës është gjithnjë i ankimueshëm në rrugë gjyqësore.

7. Anëtarët e personelit akademik të kategorive "Profesor" dhe "Lektorë", punësohen në IAL nëpërmjet një kontrate me kohëzgjatje të pacaktuar. Anëtarët e personelit akademik të kategorisë "Asistentë-lektorë", punësohen në IAL nëpërmjet një kontrate me kohëzgjatje të caktuar. Të tria këto kategori mund të punësohen me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme.

8. Personeli akademik nuk mund të largohet apo të zëvendësohet, pa miratimin e tij, gjatë kryerjes së punës kërkimore-shkencore në një projekt të ndjekur prej tij, përveç rasteve të shkeljeve të rënda të vërtetuara, të parashikuara në Kodin e Punës dhe aktet e brendshme të institucionit të arsimit të lartë.

9. Koha normale e punës së personelit akademik nuk mund të jetë më shumë se 1 536 orë në vit. Ngarkesa mësimore e personelit akademik parashikohet në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.
10. Leja vjetore e personelit akademik është jo më pak se 40 ditë pune (56 ditë kalendarike). Në rast se kjo leje nuk konsumohet nga personeli akademik, si pasojë e nevojës së institucionit dhe me propozimin e drejtuesit të njësisë bazë dhe me miratimin e Bordit të Administrimit, jepet shpërblimi përkatës në të holla.

11. Personeli akademik, brenda kohës efektive të punës, mund të kryejë detyra akademike, shkencore ose në mbështetje institucionale ndaj të tretëve, në përputhje me statutin dhe rregulloret e IAL-së.

12. Personeli akademik, për aktivitete që lidhen me drejtimet e punës së tij, sipas pikës 2, të këtij vendimi, ka të drejtën e përfitimit të një leje deri në dy javë, me miratim nga drejtuesi i njësisë kryesore, që informon, në çdo rast, rektorin. Për kohëzgjatje mbi dy javë, leja merret nga rektori. Në të gjitha rastet, kërkesat për leje duhet të jenë të dokumentuara dhe të justifikuara. Personeli akademik raporton përpara departamentit mbi aktivitetin e kryer gjatë lejes.

13. Personeli akademik mund të kryejë detyra të larta në administratën publike, vendase apo të huaj, për jo më shumë se 5 vjet, pa ndërprerje, duke ruajtur statusin e tij. Në funksion të ruajtjes së vendit të punës, sipas profilit akademik, nënshkruhet një marrëveshje e posaçme me rektorin e institucionit. Pas kësaj periudhe, anëtari i personelit akademik, me kërkesën e tij, rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlefshëm.

14. Personelit akademik i lindin edhe këto të drejta të tjera:

a) Të përparojë në karrierën akademike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

b) Të trajnohet, të kualifikohet në institucionet akademike e kërkimore shkencore, brenda dhe jashtë vendit, sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me profilin;

c) Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e IAL-së, duke kryer aktivitete zgjedhore në përputhje me statutin dhe rregulloret e tjera të IAL-së.

15. Personeli akademik ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Të njohë, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

b) Të respektojë kohën në funksion të mësimdhënies dhe të kërkimit shkenco r, sipas orarit te punës dhe ta shfrytëzojë vetëm për kryerjen e detyrave. Koha e punës dhe e mësimdhënies përcaktohet nëpërmjet kontratës së punës;

c) Të rrisë aftësitë profesionale akademike dhe të marrë pjesë në veprimtari formuese për këtë qëllim;

ç) Të mos kërkojë ose pranojë asnjë përfitim pasuror, për kryerjen e detyrave akademike, me përjashtim të pagës dhe privilegjeve të tjera, të përcaktuara me ligj, akte nënligjore dhe aktet e brendshme të IAL-së;

d) Të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet e tij, gjatë kryerjes së detyrës si personel akademik në IAL dhe institucionin kërkimor shkencor;

dh) Të zbatojë etikën institucionale në respektim të imazhit të institucionit të arsimit të lartë dhe figurës profesionale.
e) Të zbatojë kodin e etikës në veshje e sjellje, gjatë kohës së ushtrimit të aktivitetit akademik.

16. Personeli akademik, me kohë të plotë apo të pjesshme, nuk mund të ushtrojë asnjë funksion administrimi në institucionin e arsimit të lartë ku është punësuar, me përjashtim të zgjedhjes anëtar në Bordin e Administrimit.

17. Pagat e personelit akademik të të gjitha kategorive përcaktohen nga Bordi i Administrimit, pasi ka marrë mendimin e Senatit Akademik, por jo më shume se kufijtë maksimalë të pagës për funksion/titull, të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë".

18. Personeli akademik përfiton kompensim e rimbursim financiar, kur punon për aktivitetet e parashikuara në drejtimet e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, në masën dhe sipas procedurave të përcaktuara nga Bordi i Administrimit dhe kuadrit ligjor në fuqi.

19. Personeli akademik mund të kërkojë leje, pa të drejtë page, për arsye shëndetësore apo familjare. Kohëzgjatja maksimale e të gjitha lejeve të papaguara, brenda një viti kalendarik, nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë.

20. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 346, datë 19.04.2017

PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 74, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kanë të drejtën të aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë kandidatët që kanë përfunduar me sukses nivelin e arsimit të mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në këtë vendim.

2. Për të gjithë kandidatët, të cilët kanë përfunduar nivelin e arsimit të mesëm të lartë, nota mesatare minimale për t'u pranuar në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018, të jetë 6 (gjashtë). Nota mesatare për t'u pranuar në institucionet e arsimit të lartë përllogaritet si mesatare aritmetike e thjeshtë e treguesve të mëposhtëm:

a) Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë;

b) Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të maturës/Maturës Shtetërore.

3. Kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në këtë vendim.

4. Institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe njësitë arsimore vendore janë përgjegjëse për përllogaritjen e notës mesatare dhe përcjelljen e të dhënave pranë strukturave të ngarkuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

5. Procedurat për njëvlershmërinë e dokumenteve të paraqitura nga shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë përfunduar nivelin e arsimit të mesëm të lartë jashtë vendit dhe përllogaritja e notës mesatare për këta kandidatë të kryhen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit bazuar në përcaktimet e pikës 2, të këtij vendimi, me përjashtim të rasteve kur nuk aplikohen provime mature, maturë shtetërore apo provime lirimi. Në këto raste, me vendim të komisionit përkatës përcaktohet mënyra e përllogaritjes së notës mesatare. Komisioni përkatës përcjell të dhënat te njësitë arsimore vendore dhe te strukturat e ngarkuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë, njësitë arsimore vendore dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 370, datë 26.04.2017

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOLEGJIT PROFESIONAL TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kolegji profesional i lartë organizohet si institucion i arsimit të lartë ose si njësi kryesore e universiteteve apo kolegjeve universitare dhe përfaqëson një strukturë të përbërë nga, së paku, dy departamente.
2. Kolegji profesional i lartë vepron në fushën e arsimit të orientuar profesional dhe përgatit profesionistë me aftësi praktike.

3. Departamenti i kolegjit është njësi e zhvillimit të mësimdhënies dhe trajnimit, i cili përfshin fusha të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore trajnuese të përafërta. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron.

4. Departamenti i kolegjit nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë të trajnimit.

5. Departamenti i kolegjit ka në përbërje të tij, të paktën, pesë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë si personel mësimdhënës, nga të cilët, të paktën, një me gradë shkencore ose titull akademik. Kolegjet profesionale të larta, departamentet e të cilave kanë programe studimi që zgjasin dy vite akademike, me 120 kredite (ECTS), kanë, të paktën, dy pedagogë me gradë shkencore ose titull akademik për çdo departament. Departamenti mund të ketë në përbërje edhe personel ndihmës mësimdhënës.

6. Kolegji profesional i lartë ofron programe të akredituara që zgjasin një ose dy vite akademike, me 60 ose 120 kredite (ECTS) dhe për të cilat lëshohet certifikatë ose diplomë profesionale.

7. Kolegji profesional i lartë, kur organizohet si institucion i arsimit të lartë, ka organe dhe autoritete drejtuese. Organet drejtuese janë Senati Akademik, Asambleja e Personelit Mësimdhënës dhe Bordi i Administrimit, ndërsa autoritetet drejtuese janë rektori, drejtuesi i departamentit dhe administratori i kolegjit.

8. Kolegji profesional i lartë, kur organizohet si njësi kryesore e universiteteve ose kolegjeve universitare, ka vetëm autoritete drejtuese. Autoritetet drejtuese janë drejtori, drejtuesi i departamentit dhe administratori i kolegjit.

9. Në kolegjet profesionale të larta, publike, organet dhe autoritet drejtuese zgjidhen sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

10. Në kolegjet profesionale të larta, jopublike, organet dhe autoritetet drejtuese përzgjidhen /emërohen dhe shkarkohen sipas përcaktimeve në statutin e institucionit, të miratuar nga ministri përgjegjës për arsimin.

11. Në kolegjet profesionale të larta, Senati Akademik përbëhet nga jo më pak se pesë anëtarë dhe rektori është kryetari i Senatit Akademik.

12. Në kolegjet profesionale të larta, rektori ose drejtori mban titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar".

13. Anëtarët e Senatit Akademik të kolegjit i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull/gradë shkencore dhe për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë, sipas përcaktimeve të bëra në statutin e institucionit.

14. Në kolegjet profesionale të larta, drejtuesi i departamentit i përket kategorisë "Profesor" ose ka gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull/gradë shkencore dhe për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë, sipas përcaktimeve të bëra në statutin e institucionit.

15. Bordi i Administrimit të kolegjit përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Në institucionet publike të arsimit të lartë një nga anëtarët zgjidhet nga Senati Akademik, ndërsa dy anëtarët e tjerë përzgjidhen/emërohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në institucionet jopublike të arsimit të lartë, anëtarët e Bordit të Administrimit zgjidhen sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

16. Administratori i Kolegjit emërohet nga Bordi i Administrimit ose nga administratori i universitetit/kolegjit universitar. Administratori duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin "Master i Shkencave" në fushën e drejtësisë ose të ekonomisë dhe përvojë pune, së paku pesë vjet, në këto fusha.

17. Për veprimtarinë e kolegjeve profesionale të larta dhe të studentëve në këto kolegje respektohen dispozitat e ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

18. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore n Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 371, datë 26.04.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1013, DATË 10.12.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PROVIMEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në titull dhe kudo në përmbajtje të vendimit, emërtimi "Agjencia Kombëtare e Provimeve" zëvendësohet me "Qendra e Shërbimeve Arsimore".

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:
"3. QSHA-ja është institucion i posaçëm për organizimin, monitorimin, mbikëqyrjen e problemeve të reformës arsimore për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve dhe të provimeve. Ajo ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit dhe të organizimit të provimeve të maturës e të shtetit.".

c) Pikat 4, 5, 6 dhe 7 shfuqizohen.

ç) Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. QSHA-ja kryen këto funksione:

a) Zhvillon provimet kombëtare, kryen procesin e vlerësimit të arritjes së nxënësve dhe administron bazën e të dhënave të këtyre rezultateve.

b) Kryen dhe administron vlerësime të jashtme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe/ose me kampionim për arritjet e nxënësve të sistemit arsimor parauniversitar.

c) Ofron kontribut në hartimin e politikave arsimore e të strategjive dhe në zbatimin e tyre.

ç) Përpunon dhe analizon rezultatet e provimeve kombëtare, të vlerësimeve, të provimeve të shtetit, sipas standardeve bashkëkohore, dhe raportet vjetore të cilat i publikon.

d) Organizon dhe administron Provimin e Shtetit, që zhvillohet përmes teknologjisë digjitale, duke bashkëpunuar me autoritetet kompetente përkatëse, sipas ligjit për profesionet e rregulluara. dh) Krijon bazën shtetërore të të dhënave për kandidatët e regjistruar në Provimin e Shtetit.

e) Digjitalizon fondet e pyetjeve të miratuara nga komisionet e Provimit të Shtetit dhe e zhvillon këtë provim, përmes teknologjisë digjitale.

ë) Trajnon periodikisht personelin organizues dhe mbikëqyrës të Provimit të Shtetit dhe të provimeve kombëtare.

f) Publikon on-line programin orientues të këtij provimi dhe fondet e pyetjeve për çdo profesion të rregulluar.

g) Administron bazën e të dhënave për arsimin parauniversitar.

gj) Krijon, arkivon, përditëson dhe administron bazën elektronike të të dhënave për arritjet e nxënësve në provimet kombëtare.

h) Kontribuon në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të cilat janë pjesë e objektit të veprimtarisë së saj.".

d) Pikat 9, 10 dhe 11 shfuqizohen.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 397, datë 03.05.2017

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË (AKFAL)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) të organizohet dhe të funksionojë si person juridik publik, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me seli në Tiranë.

2. AKFAL-i ka për mision shpërndarjen e fondeve publike për mbështetjen e veprimtarisë së institucioneve publike të arsimit të lartë, mbështetjen me bursa studimi për studentët dhe garantimin e skemës së kredive studentore, sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

3. AKFAL-i ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Propozon në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit kriteret dhe formulën për shpërndarjen e fondeve publike, të cilat miratohen nga kjo ministri;

b) Në bazë të kritereve e të formulës së miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, AKFALi:

i) shpërndan fondin për mbështetjen e institucioneve të arsimit të lartë dhe infrastrukturën akademike; ii) shpërndan fondin për projektet konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë; iii) shpërndan fondin e mbështetjes studentore.

c) Garanton skemën e kredive studentore, sipas akteve nënligjore në fuqi;

ç) Miraton paraprakisht hapjen e programeve të reja të studimit në një institucion publik të arsimit të lartë, kur kërkohet që këto programe të financohen nga buxheti i shtetit;

d) Boton raporte periodike për aspekte të funksionimit administrativ dhe financiar të IAL-së, si numri i studentëve, numri i pedagogëve, infrastruktura e kërkimit, numri i studentëve të diplomuar që punësohen, numri i patentave etj.; dh) Paraqet në institucionet e arsimit të lartë "dokumentin e prioriteteve", ku përcaktohet struktura e shpenzimit të fondit publik për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në përputhje me prioritetet e vendit, 6 muaj përpara financimit;

e) Nënshkruan me çdo institucion të arsimit të lartë që financon kontratën e garancisë e të llogaridhënies, e cila përmban kushtet specifike të institucionit, financimin përkatës, edukimin akademik që institucioni do të ofrojë nëpërmjet këtij fondi, strukturat e brendshme financiare të institucionit të arsimit të lartë, skemën e kontrollit të brendshëm financiar dhe mënyrën e kontrollit të jashtëm financiar;

ë) Boton çdo vit udhëzuesin, i cili përmban informacionet e nevojshme që duhet të përfshijnë institucionet e arsimit të lartë në raportin e tyre vjetor financiar;

f) Publikon udhëzime lidhur me mënyrat dhe format e menaxhimit të qëndrueshëm financiar të institucioneve të arsimit të lartë;

g) Kryen për çdo institucion të arsimit të lartë të financuar vlerësimin e riskut dhe qëndrueshmërisë financiare, sipas procedurave të auditimit publik;

gj) Kryen vlerësimin e kushteve që duhet të plotësojnë institucionet e arsimit të lartë për aplikim për kredimarrje;

h) Vlerëson respektimin e kushteve të skemës së kredisë studentore nga institucionet kredidhënëse;

i) Publikon raportin e financimit të institucioneve të arsimit të lartë për çdo vit akademik;

j) Administron të dhënat statistikore për institucionet e arsimit të lartë.

4. AKFAL-i financohet nga buxheti i shtetit dhe nga çdo burim tjetër financiar i ligjshëm.

5. Organet e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) janë Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKFAL-it, të cilët drejtojnë dhe administrojnë agjencinë.

Bordi Drejtues është organi kolegjial vendimmarrës i AKFAL-it, që përbëhet nga:

- Nëpunësi i parë autorizues i Ministrisë Financave;

- Nëpunësi autorizues i ministrisë përgjegjëse për arsimin; - Dy rektorë nga IAL-ja, propozuar nga Konferenca e Rektorëve;

- Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave.

Bordi i Drejtues asistohet nga sekretariati, që përbëhet nga nëpunës të AKFAL-it, të përcaktuar nga drejtori i Përgjithshëm.

6. Funksionet e Bordit Drejtues janë:

a) Propozon kriteret për shpërndarjen e fondeve publike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

b) Propozon "dokumentin e prioriteteve" në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

c) Miraton shpërndarjen e fondit për institucionet, pjesë e grantit të mësimdhënies;

ç) Miraton shpërndarjen e fondit të mbështetjes studentore, pjesë e grantit të mësimdhënies;
d) Miraton format e garantimit të skemës së kredive studentore;

dh) Miraton hapjen e programeve të reja të studimit në institucionet publike të arsimit të lartë, kur kërkohet financim nga buxheti i shtetit;

e) Miraton raportet periodike për aspekte të funksionimit administrativ dhe financiar të IALve;

ë) Miraton udhëzuesin lidhur me informacionet e nevojshme që duhet të përfshijë IAL-ja në raportin e tyre vjetor financiar;

f) Miraton udhëzimet për mënyrat dhe format e menaxhimit të qëndrueshëm financiar të IALve;

g) Miraton vlerësimet e riskut dhe qëndrueshmërisë financiare të IAL-ve;.

gj) Kryen vlerësimin e kushteve që duhet të plotësojnë IAL-të për aplikim për kredimarrje;

h) Vlerëson respektimin e kushteve të skemës së kredisë studentore nga institucionet kredidhënëse;

i) Miraton raportin e financimit të IAL-ve, për çdo vit akademik;

j) Miraton rregulloren e brendshme të Bordit Drejtues të AKFAL-it.

7. Anëtarët e Bordit Drejtues të AKFAL-it shpërblehen në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për mbledhje, për jo më shumë se 12 mbledhje. Drejtori i Përgjithshëm merr pjesë në mbledhjet e Bordit Drejtues pa të drejtë vote.

8. AKFAL-i drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet para ministrit të Arsimit dhe Sportit.

9. Drejtori i Përgjithshëm i AKFAL-it është titullari i institucionit dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretë.

10. Drejtori i Përgjithshëm i AKFAL-it emërohet, lirohet nga detyra, sipas përcaktimeve të legjislacionit të shërbimit civil.

11. Funksionimi i brendshëm i AKFAL-it bëhet sipas rregullores përkatëse të miratuar nga ministri i Arsimit dhe Sportit.

12. Struktura dhe organika e AKFAL-it miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit.

13. AKFAL-i ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare, të cilat miratohen nga ministri i Arsimit dhe Sportit, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të AKFAL-it.

14. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: "Republika e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë", në përputhje me vendimin nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj", të ndryshuar.
15. Vula zyrtare e AKFAL-it ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 11, të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare", të ndryshuar. Vula e AKFAL-it prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

16. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 418, datë 10.05.2017

PËR STANDARDET, KRITERET DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN, NDARJEN, BASHKIMIN OSE MBYLLJEN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË DHE TË DEGËVE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 29, 30 e 31, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjekte juridike, vendase ose të huaja, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, depozitojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit projektin për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë ose degë të një institucioni ekzistues. Afati fundor i depozitimit është data 15 maj, për vitin e dytë pasardhës akademik.

2. Subjekti kërkues për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë duhet të përmbushë standardet e mëposhtme:

a) Standardet e organizimit të IAL-së:

i) Organi më i lartë akademik i IAL-së është Senati Akademik.

ii) Organi më i lartë administrativ i IAL-së është Bordi i Administrimit.

iii) Autoriteti më i lartë akademik i IAL-së është Rektori. Rektori është personel akademik me kohë të plotë. iv) Autoriteti më i lartë administrativ i IAL-së është administratori i saj.

v) Autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore është Dekani. Dekani është personel akademik me kohë të plotë. vi) Autoriteti më i lartë administrativ i njësisë kryesore është administratori i saj.

vii) Autoriteti më i lartë akademik i njësisë bazë është drejtues i saj. Drejtuesi i njësisë bazë është personel akademik me kohë të plotë.

viii) Autoriteti më i lartë administrativ i njësisë bazë është administratori i saj. Ai është personel administrativ me kohë të plotë.

ix) Asambleja e personelit akademik është organi i IAL-së, që zgjedh rektorin, dekanin dhe organet akademike të IAL-së.

x) Një institucion i arsimit të lartë organizohet në njësi përbërëse kryesore dhe bazë, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për arsimin e lartë, duke respektuar llojin e institucionit.

xi) Çdo njësi kryesore duhet të ketë, të paktën, tre njësi bazë, që grupojnë disiplina mësimore të përafërta ose të ndërthurura dhe që përfshijnë fusha kërkimi respektive.

xii) Njësia bazë duhet të ketë në përbërje të tij, të paktën, 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik.

xiii) Një institucion i huaj i arsimit të lartë apo degë e tij, që zotëron një formë akreditimi në një shtet tjetër, mund të ketë organizim tjetër strukturor, në varësi të formës në shtetin e origjinës.

b) Standardet për personelin akademik të IAL-së:

i) Standardi i raportit personel akademik me kohë të plotë/student, sipas fushave kryesore të studimit, është sipas shkronjës "A", të aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

ii) Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi.

c) Standarde dhe normativa për infrastrukturën e IAL-së:

i) Standardet ndërtimore të IAL-ve të jenë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për institucionet arsimore dhe ato të jenë të vendosura larg varrezave apo zonave me ndotje mbi normat e lejuara, sipas standardeve përkatëse. ii) Objektet që do të përdoren për hapjen e institucioneve të arsimit të lartë duhet të përmbajnë, minimalisht, ambientet sipas shkronjës

“B”, të aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, dhe natyrës së programeve të studimit që do të ofrojnë. iii) Objektet që do të ofrohen për institucionet e arsimit të lartë, duhet të plotësojnë normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, të ndara sipas fushave të studimit, sipas shkronjës “C”, të aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

iv) Numri i studentëve, sipas veprimtarive akademike, nuk duhet të jetë më i madh se numri i përcaktuar në shkronjës “D”, të aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
ç) Objektet e arsimit të lartë, me më shumë se 200 studentë (në një godinë), detyrimisht duhet të jenë të pajisur me dalje dhe shkallë emergjence.

d) Të gjitha objektet, që do të shërbejnë si institucione të arsimit të lartë, duhet të kenë të instaluar sistemin e mbrojtjes kundra zjarrit ose të jenë kompletuar (sipas normativave përkatëse) me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundra zjarrit si dhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike.

dh) Institucionet e arsimit të lartë duhet të jenë të pajisura me pikën e ndihmës së shpejtë/mjedisi shëndetësor dhe mjetet e pajisjet e nevojshme për ketë qëllim.

e) Objektet e arsimit të lartë duhet të kenë të garantuar burime alternative për furnizimin me energji elektrike si edhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm.

ë) Mjediset e IAL-ve duhet të jenë të pajisura me sisteme funksionuese ngrohje-ftohjeje.

3. Për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë të respektohet procedura e mëposhtme:

a) Kërkesa dhe dokumentacioni për hapjen e institucionit të arsimit të lartë depozitohen në ministrinë përgjegjëse të arsimit të lartë.

b) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë verifikon plotësimin e standardeve dhe të kritereve për hapjen e IAL-së. Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, për vlerësimin e plotësimit të tyre, cakton ekspertë të jashtëm nga lista e ASCAL-it. Shpenzimet e ekspertit paguhen nga kërkuesi.

c) Eksperti/ASCAL-i, brenda 3 javëve, dorëzon raportin e vlerësimit në MAS. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga eksperti, subjektit i kërkohet plotësimi i tij, brenda tre javëve nga marrja e raportit të vlerësimit. Nëse edhe pas njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet sipas këtij vendimi, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë njofton subjektin/aplikuesin për refuzimin e kërkesës.

ç) Në rastin e refuzimit të një projekti të paraqitur, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë informon aplikantin për vendimin dhe shkaqet e marrjes së tij, brenda një afati 30-ditor nga data e aplikimit.

d) Nëse vlerësimi dhe vendimi përfundimtar është pozitiv, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë i propozon Këshillit të Ministrave hapjen e institucionit të arsimit të lartë.

dh) Pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të

Ministrave për miratimin e hapjes së institucionit të arsimit të lartë, ministria përgjegjëse për arsimin

e lartë nxjerr urdhrin për fillimin e veprimtarisë së institucionit.

e) Kur subjekti juridik kërkon të transferojë aktin e hapjes së IAL-s një subjekti tjetër juridik, ai duhet të marrë paraprakisht miratimin me shkrim nga ministri përgjegjës për arsimin e lartë. Subjekti juridik që ka marr të drejtën, duhet të përmbushë të gjitha kushtet dhe standardet e përcaktuara, të cilat verifikohen në vijimësi nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë.

4. Për riorganizimin e një institucioni të arsimit të lartë të respektohet procedura e mëposhtme:
a) Kërkesa dhe dokumentacioni depozitohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë. Iniciativa për riorganizimin e IAL-së/IAL-ve merret nga IAL-të e interesuara, me vendim të organeve kolegjiale të saj.

b) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, për vlerësimin e dokumentacionit, cakton ekspertë të jashtëm nga lista e ASCAL-it. Shpenzimet e ekspertit paguhen nga kërkuesi.

c) Eksperti/ASCAL-i, brenda 3 javëve, dorëzon raportin e vlerësimit në MAS. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë njofton subjektin për plotësimin e tij, brenda 2 javëve nga marrja e raportit të vlerësimit.

ç) Në rast se tre javë pas njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet, kërkesa refuzohet dhe dosja e aplikimit arkivohet. Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në rastin e vlerësimit negativ, njofton me shkrim institucionin kërkues për vendimin e tij, të argumentuar, dhe praktika arkivohet.

d) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në rast të vlerësimit pozitiv, nxjerr aktin e riorganizimit të institucionit të arsimit të lartë, jo më vonë se 3 muaj pas dorëzimit të dokumentacionit.

5. Për ndarjen ose bashkimin e një institucioni të arsimit të lartë, të respektohet procedura e mëposhtme:

a) Kërkesa dhe dokumentacioni për bashkimin e dy ose më shumë IAL-ve ekzistuese për krijimin e një IAL-je të vetme apo ndarjen e IAL-së në dy ose më shumë IAL, nga një IAL e vetme ekzistuese, merret nga vetë institucioni/ institucionet e interesuara. Procesi i bashkimit ose ndarjes nuk duhet të cenojë standardet e sigurimit të cilësisë.

b) Në rastet e shkrirjes së IAL-ve, përgjegjësitë dhe asetet e IAL-ve të mëparshme i transferohen IAL-së së re, ndërsa, në rastet e përfshirjes së IAL-ve në procesin e bashkimit, ngelet një IAL e vetme, e cila administron përgjegjësitë dhe asetet edhe të IAL-së/IAL-ve të përfshira.

c) IAL-të e përfshira në procesin e bashkimit ose të ndarjes janë përgjegjëse për realizimin e procesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar një vijimësi normale të procesit akademik si dhe mbrojtjen e të drejtave të palëve të përfshira në këtë proces.

ç) Autoritetet drejtuese të IAL-së/IAL-ve pjesëmarrëse në këtë proces janë përgjegjëse për realizimin e tij. Menaxhimi financiar dhe administrativ në procesin e bashkimit ose të ndarjes, gjatë periudhës tranzitore, bëhet në përputhje me statutin e IAL-ve dhe legjislacionin në fuqi.

d) Kërkesa dhe dokumentacioni për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë depozitohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë.

dh) Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë njofton IAL-në/IAL-të për plotësime përkatëse. Nëse brenda tre javëve, nga marrja e njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet sipas këtij vendimi, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë njofton subjektin aplikues për refuzimin e kërkesës.

e) Në rastin e refuzimit të kërkesës së paraqitur, ministria përgjeg jëse për arsimin e lartë informon aplikantin për vendimin dhe për shkaqet e marrjes së tij brenda një afati 90-ditor, nga data e aplikimit. Praktika arkivohet në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë.
ë) Nëse vlerësimi dhe vendimi përfundimtar është pozitiv, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë i propozon Këshillit të Ministrave ndarjen/bashkimin e institucionit/institucioneve të arsimit të lartë.

6. Për mbylljen e institucionit/eve të arsimit të lartë ose të degëve të tyre të respektohet procedura dhe kriteret e mëposhtme:

a) Mbyllja e IAL-së bëhet, në çdo rast, me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës të arsimit të lartë, ndërsa mbyllja e degëve të IAL-ve bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin e lartë. Vendimi

përkatës i Këshillit të Ministrave dhe urdhri përkatës i ministrit përgjegjës për arsimin e lartë përcaktojnë pasojat dhe detyrimet që lindin, përkatësisht, nga mbyllja e IAL-së/ve ose degëve të tyre.

b) Në rastet e mbylljes së IAL-së vullnetarisht, nga vetë institucioni, nevojitet propozimi i senatit akademik dhe miratimi i bordit të administrimit.

c) Në rastet e mbylljes së IAL-së me nismën e ministrit përgjegjës për arsimin e lartë, nevojitet, paraprakisht, mendimi i senatit akademik dhe i bordit të administrimit, të cilët shprehen brenda një muaji, nga data e propozimit të dërguar nga ministri.

ç) Një institucion i arsimit të lartë mbyllet detyrimisht, si pasojë e:

i) shkeljeve të konstatuara nga kontrolli i ligjshmërisë; ii)

shkeljeve të konstatuara nga auditimi i IAL-së; iii) vlerësimit

negativ nga procesit i akreditimit institucional.

d) Ministri përgjegjës për arsimin e lartë, në rast konstatimesh të shkeljeve të ligjshmërisë, mund të vendosë edhe kushte, si masë paraprake, mosplotësimi i të cilave brenda afateve të përcaktuara çon në mbylljen e IAL-së.

dh) Ministri përgjegjës për arsimin e lartë, në rast konstatimesh të shkeljeve të ligjshmërisë, vijimësia e të cilave sjellë dëme të rënda dhe të pariparueshme për interesin publik, vendos për pezullimin e veprimtarisë së IAL-së, si masë e ndërmjetme deri në vendimmarrje përfundimtare. Pezullimi mund të jetë i pjesshëm ose i plotë, me afat deri në dy vjet.

e) Mbyllja e IAL-së bëhet kur IAL-ja nuk përmbush kriteret thelbësore të hapjes, shkel rëndë detyrimet e përcaktuara në të, për përfitime abuzive që rëndojnë mbi interesat ekonomike të studentëve, si dhe kur marrja e të drejtës së ushtrimit të veprimtarisë është realizuar nëpërmjet mashtrimit, falsifikimit të dokumenteve, pasqyrimit të të dhënave të pavërteta dhe çdo shkeljeje

tjetër të procedurës administrative. Konstatimi i mosplotësimit të kritereve apo shkeljes së detyrimeve bëhet si rregull nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë.

7. Për hapjen e degëve të institucioneve të arsimit të lartë të respektohet procedura dhe kriteret e mëposhtme:

a) Institucionet e arsimit të lartë, që kanë seli qendrore dhe kryejnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë, kanë të drejtë, brenda kompetencave dhe fushave të veprimtarive të tyre akademike, të hapin degë të tyre jashtë selisë qendrore, për të ofruar programe të studimeve, kërkim shkencor, veprimtari trajnuese, shërbime dhe veprimtari të tjera.
b) Këtë të drejtë e kanë edhe institucione të arsimit të lartë me seli qendrore jashtë Republikës së Shqipërisë. Këto institucione duhet të jenë të akredituara në vendin e tyre të origjinës. Dega e institucionit të arsimit të lartë, që e ka selinë qendrore jashtë Republikës së Shqipërisë, organizohet dhe administrohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

c) Dega e institucionit të arsimit të lartë, vendas ose e huaj, është:

i) pjesë përbërëse e njësive të selisë qendrore të institucionit; ii) njësi e veçantë në strukturën e

institucionit të arsimit të lartë, si njësi kryesore ose njësi bazë.

ç) Degët e IAL-ve, që kanë seli qendrore dhe kryejnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, duhet të:

i) përmbushin standardet akademike për personelin akademik;

ii) përmbushin standardet infrastrukturore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe përcaktimeve të këtij vendimi; iii)

paraqesin plan-biznesin,

iv) marrin përsipër mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e veprimtarisë së tyre akademike, për një periudhë, të paktën 3-vjeçare.

v) vetëdeklarojnë, në çdo rast, burimin e financimit.

d) Institucionet e arsimit të lartë, që kanë seli qendrore në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj dhe që duan të hapin degë të tyre në Republikën e Shqipërisë, paraqesin pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë dosjen e aplikimit jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti.

dh) Në rastet e hapjes së degës në nivel njësie bazë, në Republikën e Shqipërisë, institucioni i arsimit të lartë duhet të depozitojë në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë dosjen e aplikimit, jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti.

e) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në rast të vlerësimit pozitiv të dosjes, nxjerr aktin e hapjes së degës në nivel njësie kryesore dhe në nivel njësie bazë për institucionet e

arsimit të lartë, me seli qendrore jashtë Republikës së Shqipërisë, jo më vonë se 3 muaj pas dorëzimit të dosjes.

ë) Në rastet e hapjes së degës në nivel njësie bazë, për institucionet e arsimit të lartë brenda Republikës së Shqipërisë, pas vendimit të senatit akademik dhe miratimit të bordit të administrimit, njoftohet ministria përgjegjëse për arsimin e lartë brenda 30 ditëve.

f) Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në rastin e vlerësimit negativ, njofton me shkrim institucionin kërkues dhe praktika arkivohet.

8. Projektet e paraqitura për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin apo mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë ose të degëve të tyre përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, trajtohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në kohën e paraqitjes së projektit.
9. Projekti për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë ose degë të një institucioni ekzistues, përjashtimisht për vitin 2017, mund të paraqiten deri më 30 qershor, për vitin e dytë pasardhës akademik.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

ANEKSI 1

A. Standardi i raportit personel akademik me kohë të plotë / student, sipas fushave kryesore të studimit, është si më poshtë:

Fusha Personeli akademik Studentë

Shkencat natyrore 1 45

Inxhinieri dhe teknologji 1 35

Shkenca mjekësore dhe shëndetit 1 35

Shkenca bujqësore dhe veterinarisë 1 45

Shkenca sociale 1 45

Shkenca humane dhe arte 1 45

B. Ambientet minimale të nevojshme për hapjen e institucioneve të arsimit të lartë, sipas natyrës së programeve të studimit që do të ofrohen, janë si më poshtë:

1. Auditorë mësimi;

2. Ambiente për laboratorë dhe ndjekje praktikash klinike mjekësore;

3. Ambiente për personelin akademik;

4. Ambiente për personelin administrativ;

5. Ambiente për bibliotekën, senatin, salla audiovizive, kompjuterësh etj.;

6. Ambiente teknike (që i shërbejnë funksionit te godinës si kaldaja, motor gjeneratori, depozita uji dhe elektropompa, depo, kabina elektrike, etj.) oborr dhe ambiente të gjelbëruara.

C. Normativa e sipërfaqes së shfrytëzueshme e ndara sipas fushave të studimit, për objektet që do të ofrohen nga institucionet e arsimit të lartë, është si më poshtë:

Fusha Sipërfaqja në m2 për studentë
Shkencat natyrore 2.5 m2

Inxhinieri dhe teknologji 5 m2

Shkenca mjekësore dhe shëndeti 5 m2/

Shkenca bujqësore dhe veterinarisë 2.5 m2

Shkenca sociale 2.5 m2

Shkenca humane dhe arte 2.5 m2

D. Numri i studentëve sipas veprimtarive akademike, nuk duhet të jetë më i madh se:

Fusha e studimit Nr. Studentëve/ Seminar Nr. Studentëve/ Laborator Nr. Studentëve/ Praktika Nr. Studentëve/ leksion

Shkenca Natyrore 35 25 25 6 grupe seminari

Inxhinieri & Teknologji 25 20 20 6 grupe seminari

Shkenca Mjekësore dhe Shëndetit 25 20 20 6 grupe seminari

Shkenca Agrikulturore dhe Veterinarisë 35 25 25 6 grupe seminari

Shkenca Sociale 35 25 25 6 grupe seminari

Humanitete dhe Arte 35 25 25 grupe seminari

VENDIM

Nr. 424, datë 10.05.2017

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES E TË EMËRIMIT TË DREJTUESVE TË SHËRBIMIT NË STRUKTURAT SHËNDETËSORE UNIVERSITARE *(Ndryshuar me VKM nr.488, datë 31.7.2018)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimi në institucionet shëndetësore universitare drejtohet nga drejtuesi i shërbimit, i cili përzgjidhet në bazë konkurrimi.

2. Drejtuesi i shërbimit në momentin e kandidimit duhet të plotësojë kriteret minimale bazë, si më poshtë vijon:

a) Të jetë mjek specialist i diplomuar në fushën e shërbimit për të cilin kandidon;
b) Në rastet kur kandidati ka vetëm shtetësi të huaj, ai duhet të zotërojë certifikatën e mbrojtjes së gjuhës shqipe, me përjashtim të rasteve kur kandidati ka kryer një cikël të plotë studimesh në gjuhën shqipe;

c) Të jetë i regjistruar në urdhrin profesional përkatës;

ç) Të zotërojë titullin "Profesor", "Profesor i Asociuar" ose të ketë Doktoratë/PhD, të mbrojtur në një nga universitetet e BE-së, SHBA-ve, Kanada, Australi apo Japoni. Në rast se asnjë nga pjesëtarët e stafit mjekësor nuk plotëson kriteret e sipërpërmendura, mund të pranohen edhe kandidatë me doktoratë/PhD, të mbrojtur në Shqipëri apo vende të papërmendura më sipër;

d) Të jetë mjek pedagog me kohë të plotë, me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar në IAL-në përkatëse dhe të ketë të njëjtin specialitet në shërbimin shëndetësor universitar, për të cilin kandidon, ose të jetë/të ketë qenë mjek pedagog me kohë të plotë i strukturave universitare homologe të Bashkimit Evropian ose vendeve anëtare të OECD; dh) Të mos ketë qenë asnjëherë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë;

e) Të mos ketë asnjë dënim të dhënë nga Urdhri i Mjekut;

ë) Të ketë përvojë akademike si pedagog me kohë të plotë, jo më të vogël se 5 (pesë) vjet.

Në rastet kur asnjë nga pjesëtarët e stafit mjekësor nuk plotëson kriterin e sipërpërmendur, mund të pranohen edhe kandidatë me përvojë akademike, jo më të shkurtër se 8 (tetë) vjet, si pedagog me kohë të pjesshme. Konsiderohet përvojë akademike aktiviteti didaktik i kryer në institucione publike të arsimit të lartë apo në institucione jopublike të arsimit të lartë, të akredituara dhe në programe studimi të akredituara brenda vendit, në periudhën e përvojës së kryer. I njëjti kriter vlen dhe për institucionet dhe programet e akredituara/e njohura në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose vendet anëtare të OECD;

f) Të ketë përvojë klinike/diagnostike jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në specialitetin përkatës.

3. Procedurat për përzgjedhjen e drejtuesit të shërbimit shëndetësor universitar nisin nga rektorati i IAL-së (UMT), me përfundimin e mandatit të radhës, me kërkesë të strukturës shëndetësore universitare përkatëse.

4. Procesi i përzgjedhjes së kandidaturave bëhet nga një komision i posaçëm, i ngritur me urdhër të përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, i cili ka në përbërje të tij një përfaqësues nga Rektorati, Dekanati i IAL-së, struktura shëndetësore universitare, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Shëndetësisë.

5. Komisioni shpall datat dhe bën publike kriteret e vlerësimit të dosjeve.

6. Komisioni organizon punën nëpërmjet sekretariatit të përbashkët me 5 (pesë) anëtarë, të cilët bëjnë verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar për çdo aplikues dhe përputhshmërinë e kritereve të përcaktuara me këtë vendim.

7. Kandidatët për drejtues të shërbimeve aplikojnë për pozicionin përkatës për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike, duke nisur nga 1 (një) muaj para datës së konkurrimit.
8. Kërkesa shoqërohet me curriculum vitae, vetëdeklarimet bazuar në legjislacionin në fuqi, kopje të noterizuar të dokumentacionit përkatës provues të plotësimit të kritereve dhe të kartës së identitetit, si dhe projektin për zhvillimin e shërbimit. Kërkesa dorëzohet pranë zyrës së burimeve njerëzore të fakultetit, pjesë e të cilit është shërbimi ku do të konkurrojnë, i cili, me përfundimin e afatit për aplikim, ia kalon dokumentacionin sekretariatit të përbashkët.

9. Kandidatët paraqiten ditën e konkurrimit për të kryer intervistën me komisionin, e cila ka për qëllim prezantimin e projektit të kandidatit për zhvillimin dhe drejtimin e shërbimit. Projekti duhet të paraqesë të dhëna dhe produkte konkrete të matshme të cilat do të shërbejnë më pas si bazë për vlerësimin e punës së drejtuesit të ardhshëm të shërbimit që i ka paraqitur ato. Komisioni vlerëson projektin e paraqitur. Angazhimet e paraqitura nga kandidati në projekt bëhen pjesë e kontratës që kandidati lidh nëse ai shpallet fitues me strukturën shëndetësore universitare.

10. Kandidatët konkurrues për një shërbim të caktuar vlerësohen nga komisioni përkatës, sipas përcaktimeve dhe kritereve të parashikuara në aneksin nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.

11. Komisioni pas shqyrtimit bën renditjen e kandidaturave që aplikojnë për postin e drejtuesit të shërbimit shëndetësor universitar.

12. Komisioni duhet të bëjë transparente rezultatet e vlerësimit.

13. Pas miratimit, komisioni ia dërgon rezultatet e vlerësimit ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Shëndetësisë, të cilët bëjnë emërimin me shkresë të përbashkët.

14. Kandidati fitues lidh kontratën me drejtuesin e strukturës shëndetësore universitare, pjesë e të cilës është shërbimi përkatës.

15. Nëse kandidati fitues vjen nga jashtë strukturave të IAL-së, ai fiton automatikisht edhe pozicionin e pedagogut me kohë të plotë, me kontratë me kohë të pacaktuar pranë IAL-së përkatëse.

16. Drejtuesi i shërbimit drejton shërbimin për 4 (katër) vjet, me të drejtë rikandidimi.

17. Vlerësimi i punës së drejtuesit të shërbimit bëhet përmes vlerësimit të treguesve të performancës si dhe në bazë të detyrimeve kontraktore sipas parashikimeve në kontratën përkatëse të lidhur në momentin e marrjes së detyrës. Vlerësimi i punës është vjetor dhe kryhet nga drejtori i strukturës shëndetësore universitare ku shërbimi në fjalë bën pjesë.

18. Drejtuesi i shërbimit shëndetësor universitar mund të pezullohet dhe të shkarkohet nga detyra sipas Kodit të Punës apo për arsye të tjera të parashikuara me ligj. Pezullimi dhe propozimi për shkarkim mund të bëhen nga titullari i strukturës shëndetësore universitare. Shkarkimi bëhet nga ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Arsimit dhe Sportit, me urdhër të përbashkët.

19. Në rast ndërprerjeje të parakohshme të mandatit të drejtuesit të shërbimit shëndetësor universitar, me propozim të drejtorit të institucionit mjekësor dhe rektorit të IAL-së, ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Arsimit dhe Sportit, me shkresë të përbashkët, komandojnë në këtë detyrë një nga pjesëtarët e stafit akademik me kohë të plotë të shërbimit shëndetësor universitar përkatës. Në këtë rast, brenda 6 (gjashtë) muajve, duhet të organizohet procesi i përzgjedhjes së drejtuesit të ri të shërbimit, mandati i të cilit përfundon në të njëjtën kohë me atë të drejtuesve të tjerë të shërbimeve shëndetësore universitare të institucionit mjekësor.

20. Në rastet e IAL-ve jopublike procedurat kryhen nga IAL-ja jopublike dhe struktura shëndetësore universitare jopublike përkatëse, sipas statuteve përkatëse dhe udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

21. Shpenzimet, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga institucioni përkatës i arsimit të lartë dhe struktura shëndetësore universitare.

22. Çdo akt, që vjen në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

23. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë, institucionet përkatëse të arsimit të lartë dhe strukturat shëndetësore universitare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

ANEKSI 1

Nr. KRITERET VLERËSUESE TË TJERA

1 Të zotërojë titullin/gradën në fushën ku aplikon

Profesor

Profesor i Asociuar

PhD të mbrojtur në një nga universitetet e BE-së, SHBA, Kanada, Australi apo Japoni

2 Përvojë drejtuese dhe rezultate pozitive në drejtimin e shërbimeve shëndetësore universitare

3 Aftësi profesionale dhe organizative në QSUT apo struktura të ngjashme shëndetësore universitare

4 Performanca profesionale në fushën ku aplikon

5 Realizimi i procedurave mjekësore të veçanta (nëse aplikohet)

6 Realizimi i operacioneve kirurgjikale të kategorisë së vështirë (nëse aplikohet)

7 Integritet etik dhe moral, si dhe konsiderata që zotëron në komunitet

8 Projekti 4-vjeçar i kandidatit për zhvillimin e shërbimit shëndetësor ku aplikon

9 Specializime jashtë vendit në fushën ku aplikon

Afatshkurtër, ?3 muaj, institucioni
Afatgjatë, >3muaj, institucioni

10 Referime në konferenca shkencore në fushën ku aplikon

10.1 Kategoria 1

Konferenca shkencore të shoqatave ndërkombëtare: evropiane, botërore dhe nacionale në vendet si BE, Norvegji, Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Australi

REFERUES ME GOJE

Autor i parë

Bashkautor

POSTER

Autor i parë

Bashkautor

10.2 Kategoria 2

Konferenca shkencore të shoqatave ndërkombëtare: rajonale dhe ballkanike

REFERUES ME GOJE

Autor i parë

Bashkautor

POSTER

Autor i parë

Bashkautor

10.3 Kategoria 3

Konferenca shkencore të shoqatave kombëtare të vendeve të rajonit që

nuk përfshihen në kategorinë 1

REFERUES ME GOJE

Autor i parë

Bashkautor

POSTER
Autor i parë

Bashkautor

11 Artikuj në revista shkencore në fushën ku aplikon

11.1 Kategoria 1

Artikuj në revista shkencore me faktor impakti

Autor i parë Faktori i impaktit

Bashkautor Faktori i impaktit

11.2 Kategoria 2

Artikuj në revista shkencore pa faktor impakti me bord editorial e ISNN në vendet evropiane, botërore dhe nacionale si BE, Norvegji, Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Australi Autor i parë

Bashkautor

11.3 Kategoria 3

Artikuj në revista shkencore pa faktor impakti me bord editorial e ISNN në Shqipëri dhe vendet e rajonit që nuk janë në të përfshira sipas kategorisë 1.

Autor i parë

Bashkautor

12 Organizator i konferencave apo shkollave, kurseve shkencore edukative në fushën ku aplikon.

12.1 Kategoria 1

Organizator i konferencave të shoqatave ndërkombëtare të organizuara

në Shqipëri

12.2 Kategoria 2

Organizator i konferencave të shoqatave ndërkombëtare të organizuara

jo në Shqipëri

12.3 Kategoria 3

Organizator i konferencave të organizuara në Shqipëri

13 Pjesëmarrës në projekte të fushës ku aplikon
Drejtues

Pjesëmarrës

14 Anëtar i bordeve shkencore ndërkombëtare në fushën ku aplikon

15 Anëtar i shoqatave ndërkombëtare të profesionistëve në fushën ku aplikon

16 Anëtar i shoqatave kombëtare të profesionistëve në fushën ku aplikon

Drejtues

Anëtar

17 Tekst, monografi në fushën ku aplikon

Jashtë vendit

Brenda vendit të aprovuara nga Këshilli Botues i universitetit/fakultetit

18 Çmime dhe tituj shkencore ndërkombëtarë dhe kombëtarë

19 Arritje profesionale në fushën ku aplikon

20 Të tjera

VENDIM

Nr. 450, datë 22.05.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 903, DATË 21.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 112, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, nenit 12, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të nenit 32, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave
VENDOSI:

1. Pika 13, e vendimit nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"13. Afati për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për studentë të regjistruar në IAL-të publike përcaktohet për çdo vit, në urdhrin e ministrit që përcakton edhe planin e shpërndarjes së bursave për vitin akademik.".

2. Përjashtimisht për vitin 2017, afati për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për studentë të regjistruar në IAL-të publike do të jetë data 30 maj 2017.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 654, datë 10.11.2017

PËR MIRATIMIN, SI STRUKTURË SHËNDETËSORE UNIVERSITARE, TË QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", si strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme, e cila realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si pjesë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

2. Mënyra e funksionimit të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e saj, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Departamentet përkatëse të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, që përbëhen nga shërbime në bazë specialiteti, propozojnë fushat e mësimdhënies e të kërkimit shkencor për shërbimet shëndetësore universitare, që ofron Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", të cilat miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.
4. Në vendimin nr. 70, datë 15.2.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për statusin e spitaleve universitare", të ndryshuar, të gjitha dispozitat, që i referohen Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 655, datë 10.11.2017

PËR MIRATIMIN, SI STRUKTURË SHËNDETËSORE UNIVERSITARE, TË SPITALIT UNIVERSITAR OBSTETRIK GJINEKOLOGJIK "MBRETËRESHA GERALDINË", TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin, si strukturë shëndetësore universitare e profilizuar të Spitalit, Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë, i cili realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si pjesë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

2. Mënyra e funksionimit të Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë, si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e tij, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Departamentet përkatëse të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, që përbëhen nga shërbime në bazë specialiteti, propozojnë fushat e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor për shërbimet shëndetësore universitare, që ofron Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë, të cilat miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Në vendimin nr. 70, datë 15.2.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për statusin e spitaleve universitare", të ndryshuar, të gjitha dispozitat që i referohen Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë, shfuqizohen.
5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 656, datë 10.11.2017

PËR MIRATIMIN, SI STRUKTURË SHËNDETËSORE UNIVERSITARE, TË SPITALIT UNIVERSITAR OBSTETRIK GJINEKOLOGJIK "KOÇO GLIOZHENI", TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, si strukturë shëndetësore universitare e profilizuar, e cila realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si pjesë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

2. Mënyra e funksionimit të Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë, si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e tij, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Departamentet përkatëse të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, që përbëhen nga shërbime në bazë specialiteti, propozojnë fushat e mësimdhënies e të kërkimit shkencor për shërbimet shëndetësore universitare, që ofron Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë, të cilat miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Në vendimin nr. 70, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e spitaleve universitare”, të ndryshuar, të gjitha dispozitat që i referohen Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë, shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë, dhe Universiteti i Mjekësisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.
KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 657, datë 10.11.2017

PËR MIRATIMIN, SI STRUKTURË SHËNDETËSORE UNIVERSITARE, TË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Spitalit Universitar të Traumës, si strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme, e cila realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si pjesë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

2. Mënyra e funksionimit të Spitalit Universitar të Traumës, si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohen në statutin e tij, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Departamentet përkatëse të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, që përbëhen nga shërbime në bazë specialiteti, propozojnë fushat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor për shërbimet shëndetësore universitare, që ofron Spitali Universitar i Traumës, të cilat miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, si dhe Spitali Universitar i Traumës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 658, datë 10.11.2017

PËR MIRATIMIN, SI STRUKTURË SHËNDETËSORE UNIVERSITARE, TË SPITALIT UNIVERSITAR "SHEFQET NDROQI", TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin, si strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme, të Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi", Tiranë, i cili realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si pjesë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

2. Mënyra e funksionimit të Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi", Tiranë, si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e tij, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Departamentet përkatëse të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, që përbëhen nga shërbime në bazë specialiteti, propozojnë fushat e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor për shërbimet shëndetësore universitare, që ofron Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", Tiranë, të cilat miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Në vendimin nr. 70, datë 15.2.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për statusin e spitaleve universitare", të ndryshuar, të gjitha dispozitat që i referohen Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi", Tiranë, shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 710, datë 01.12.2017

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR SHKENCËN, TEKNOLOGJINË DHE INOVACIONIN, 2017-2022

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, 2017-2022, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet e arsimit të lartë, institucionet kërkimore-shkencore, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit, të përmendura në tekstin e kësaj strategjie, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Senida Mesi

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR SHKENCËN, TEKNOLOGJIINË DHE INOVACIONIN

2017-2022

Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, 2017-2022, është hartuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me Ministritë e linjës, Institucionet kërkimore, Institucionet e Arsimit të Lartë, si dhe me mbështetjen teknike financiare të programit "PERFORM – Shkenca Sociale Aktive dhe të Përgjegjshme", projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), zbatuar nga HELVETAS Sëiss Intercooperation dhe Universiteti i Friburgut".

Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, 2017-2022, u realizua

nën kujdesin e veçantë të Z. Redi Shtino, Zv.Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Grupi i punës që punoi për strategjinë: Dr. Redi Shtino; MA-Master of Arts Geron Kamberi; Prof.asoc.Dr. Përparim Kabo; Akademik Prof.Dr. Neki Frasheri; Prof.Dr.Ferdinand Bego; Prof.Dr.Genc Sulçebe; Prof.Dr.Sulejman Sulçe; Prof.Dr.Adrian Civici; Prof.Dr.Fatos Ylli; Prof.Dr.Kristaq Jorgo; Prof.Asoc.Dr.Elfrida Shehu; Prof.asoc.Dr.Shpresa Caslli; Z. Robert Dumi; MSc.Adela Kula.

Me mbështetjen e "PERFORM" u kontraktuan për shkrimin e strategjisë ekspertët Dr. Manjola Duli, Prof.Dr.Anila Paparisto dhe Prof.Asoc.Dr.Enri Hide.

PARATHËNIE

Të nderuar lexues dhe studiues të fushave të shkencës teknologjisë dhe inovacionit,

Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2017-2022, përbën një dokument të rëndësishëm programatik të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Hartimi i këtij dokumenti u realizua në kuadër të objektivave të qeverisë shqiptare për nxitjen e mbështetjen e kërkimit shkencor, duke pasur parasysh rolin që ai luan përmes inovacionit dhe risive teknologjike, në dobi të zhvillimit socio-ekonomik.

Në një ekonomi të orientuar gjithnjë e më shumë drejt dijes, planifikimi strategjik në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit merr rendësi parësore në funksion të vizionit global të zhvillimeve aktuale.

Për këto arsye e jo vetëm, përgatitjes së kësaj Strategjie ju përkushtua një vëmendje e veçantë. Strategjia identifikon prioritetet dhe objektivat kryesore lidhur me konsolidimin e mëtejshëm të reformës së arsimit të lartë e kërkimit shkencor, duke e harmonizuar atë me parimet e Zonës Evropianë të Kërkimit Shkencor – ERA.

Në këtë strategji, përveç analizës së situatës aktuale të kuadrit institucional, ligjor e financiar të kërkimit shkencor, ekosistemit të inovacionit dhe zhvillimit teknologjik, janë identifikuar objektiva realistë në funksion të rritjes së cilësisë, vlerësimit të impaktit të investimeve në shkencë dhe nxitjes së bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë sektor.

Nëpërmjet Planit të Veprimit, Strategjia ka përcaktuar aktivitete të rëndësishme që shtrihen përgjatë periudhës 2017-2022, duke synuar që struktura institucionale e kërkimit shkencor përmes universiteteve publike e jopublike, Akademisë së Shkencave, qendrave e institucioneve kërkimore dhe biznesit të ofrojë mundësi për zhvillim të qëndrueshëm e afatgjatë.

Shqipëria po ecën drejt perspektivës së anëtarësimit në BE dhe përafrimi i objektivave kombëtarë të sektorit të kërkimit shkencor, inovacionit e teknologjisë me ato të Zonës Evropianë të Kërkimit dhe Unionit të Inovacionit janë një garanci më shumë, veçanërisht për aspekte të tilla, si cilësia e kërkimit, infrastruktura kërkimore – shkencore, mobiliteti i studiuesve, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi rolin e shkencës në shoqëri.

Energjia, mjedisi, agro-përpunimi, shëndetësia, ICT, teknologjia e materialeve, siguria, ruajtja dhe forcimi i identitetit kombëtar dhe kohezionit social janë fusha të rëndësishme kërkimi për studiuesit shqiptarë rezultatet e të cilave mund e duhet t'i paraprijnë politikëbërjes, duke ofruar rrugëzgjidhje inovative.

Për këto arsye, karakteri ndërsektorial i Strategjisë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë e Inovacionit, 2017-2022, është theksuar në funksion të bashkëpunimit më të fortë dhe të qëndrueshëm ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

Sfida e Shqipërisë drejt përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së kapaciteteve njerëzore e infrastrukturore në fushën e shkencës, zhvillimit të teknologjisë e inovacionit është një proces afatgjatë, ndërkohë që ky dokument strategjik synon hedhjen e atyre hapave të domosdoshëm për të garantuar më tej dhe më të shpejtë zhvillimin ne këta sektor.

Nëpërmjet dialogut dhe bashkëveprimit me komunitetin e kërkimit shkencor dhe duke nxitur monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë e Inovacionit, 2017-2022, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë synon ta shndërrojë atë në platforme të dobishme pune dhe histori suksesi për brezat dhe të ardhmen e vendit.

Një falënderim të veçantë kam për Grupin e Punës, stafin dhe ekspertët që kontribuuan në hartimin e saj, IAL-et, akademikët, ministritë e linjës dhe të gjithë ata që, me komentet dhe sugjerimet e tyre, e pasuruan përmbajtjen e këtij dokumenti programatik.

Në mbyllje, një ftesë ndaj të gjithë subjekteve institucionale dhe jo vetëm, për mbështetje në procesin e zbatimit të kësaj strategjie, për një Shqipëri më të mirë dhe të begatë!

LINDITA NIKOLLA
Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Tiranë, më 10.10.2017

Hyrje 151
Organizimi i dokumentit të strategjisë 152
Pjesa I. KUSHTET AKTUALE 153
I.1 Zhvillimi i kuadrit ligjor dhe institucional (2006-2016) 154
1.1.1 Situata e kuadrit ligjor, institucional dhe financiar në fushën e kërkimit shkencor 154
1.1.2 Situata e kuadrit ligjor, institucional dhe financiar në fushën e inovacionit 166
1.1.3 Situata e kuadrit ligjor, institucional dhe financiar në fushën e zhvillimit të transferimit të teknologjisë 169
II. VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET STRATEGJIKE 174
Vizioni 175
Politikat 175
Qëllimet Strategjike 175
III. OBJEKTIVAT E SHTI-së DHE PRODUKTET MADHORE 176
IV. BURIMET FINANCIARE 188
V. LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE 213

Hyrje

Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin-SHTI, përcakton politikat, vizionin, qëllimet dhe objektivat strategjike të zhvillimit të kërkimit shkencor, teknologjisë e inovacionit përgjatë periudhës 2017-2022.

Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim e Integrim 2015-2020[1], kërkimi shkencor, teknologjia dhe inovacioni konsiderohen prioritete të rëndësishme kombëtare për zhvillimin e ekonomisë konkurruese.

Bazuar në statistikat e viteve të fundit indikatori GERD (që shpreh financimin për kërkimin shkencor përkundrejt GDP), është në një nivel të ulët; krahasuar dhe me vendet e rajonit. Fuqizimi dhe përmirësimi cilësor i sistemit kombëtar të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit rrit mundësitë e zgjidhjeve për zhvillimin social-ekonomik të vendit, si dhe lehtëson trasferimin dhe përmirësimin e teknologjive në shërbim të sipërmarrjes.

Zhvillimi i kërkimit shkencor, teknologjisë e inovacionit konsiderohet politikë horizontale, pasi zbatimi i saj ndikon drejtpërsëdrejti në zhvillimin e sektorëve socialë, ekonomikë dhe kulturorë të vendit.

[1] VKM Nr 348 datë 11.05.2015 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim e Integrim 2015-2020 (Fletore Zyrtare Nr 86, Viti 2016, fq. 4795)

Strategjia Kombëtare SHTI 2017-2022, përputhet me dokumentat strategjikë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për shkencën teknologjinë dhe inovacionin. Ajo bazohet edhe në të dhënat e Censusit kombëtar[2] ne Kërkimin Shkencor, mbi kapacitetet aktuale të kërkimit shkencor në vend, të zhvilluar mbi bazën e vetëdeklarimit. Censusi u programua në kuadrin e reformës dhe strategjisë të Kërkimit Shkencor në Republikën e Shqipërisë dhe u drejtua nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR).

Prioritetet strategjike të përcaktuara në këtë dokument zhvillohen me gjerë, në nivel kombëtar, si pjesë e shtyllës së dytë të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 20152020[3]: "Rritja ekonomike përmes rritjes së konkurrueshmërisë dhe novacionit".

Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë e Inovacionit 2017-2022 mbështetet në:

- Prioritetet e përcaktuara në Axhendën 21-të OKB[4]-së
- Axhendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm[5]
- Strategjinë Europa 2020
- Axhendën Europiane për Unionin e Inovacionit
- Strategjinë e Zhvillimit Rajonal SEE-2020

Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë e Inovacionit 2017-2022 bazohet në parimet e Zonës Evropiane për Kërkimit Shkencor [5]:

- Maksimalizimi i rezultateve të kërkimit shkencor në nivel kombëtar[6]
- Forcimi i lidhjeve ndërkombëtare e rajonale në fushën e kërkimit shkencor[7]
- Hapja e tregut kombëtar për studiuesit e huaj[8]
- Rritja e barazisë gjinore mes kërkuesve shkencore në universitete e qendra kërkimore - Aksesi i hapur në informacionin shkencor [9]

Organizimi i dokumentit të strategjisë

Dokumenti strategjisë është organizuar në pesë pjesë kryesore.

[2] Aneks nr. 4

[3] VKM Nr 348 datë 11.05.2015 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim e Integrim 2015-2020 (Fletore Zyrtare Nr 86, Viti 2016, fq. 4893)

[4] Axhend 21 plan veprimi gjithëpërfshirë për t'u kryer në nivel global, kombetar, dhe lokal nga organizatat e Kombeve te Bashkuara, qeveritë dhe gupet e mëdha në çdo sektor që njeriu ndikon mbi mjedisin [5] Kjo Axhende është një plan i veprimit për njerëzit, planetin dhe prosperitetin.

[5] Ph ec.europa.eu/research/era/pdf/era-communication/era_final_report_2015.pdf (Assessment of Progress in achieving ERA, Annex 7, ERA Intervention Logic MS/AC)

[6] Politikat , objektivat strategjikë e financimi i qëndrueshëm i kërkimit shkencor nga ana e shtetit dhe mekanizmat e vlerësimit të perfomancës së kërkimit shkencor

[7] Pjesëmarrja aktive në programin e BE H2020, përcaktimi i agendës së përbashkët të kërkimit shkencor me atë të BE, marrëveshje dypalëshe në fushën e kërkimit shkencor, shfrytëzimi I infrastrukturave të përbshkëta të kërkimit shkencor , forcimi i lidhjeve me strukturat e BE në kërkim shkencor si JRC (Qendrat e Përbashkëta të Kërkimit Shkencor) dhe EIT (Instituti Europian i Teknologjisë e Inovacionit)

[8] Forcimi i rrjetit Euraxess, miratimi i strategjive të kërkimit e burimeve njerëzore nga ana e universiteteve e respektimi i Kartës dhe Kodit të BE për Kërkuesin shkencor)

[9] Krijimit të bazave të dhënave bibliografike on-line për botimet shkencore që janë realizuar apo realizohen nga studiuesit shqiptarë

Pjesa I. KUSHTET AKTUALE

Në këtë pjesë paraqitet kuadri aktual ligjor, financiar dhe institucional i sektorit të shkences, teknologjisë dhe inovacionit.

Pjesa II. VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET

Në këtë pjesë paraqitet:

- Vizioni, për fuqizimin e sistemit kërkimor dhe inovativ për të përballuar me sukses sfidat e zhvillimit aktual dhe perspektiv të vendit.
- Politikat që do të ndiqen për bashkëpunim me sektorin privat, shoqërinë civile, pushtetin lokal dhe në mënyrë të veçantë me institucionet mësimore akademike e kërkimore, vendas dhe të huaj.
- Qëllimet strategjike të përcaktuara[10],do të realizohen nëpërmjet maksimalizimit të rezultateve të kërkimit shkencor, bazuar në parimin (Triple Helix) bashkëpunimi institucione qeveritare-akademi-biznes-shoqëri civile.

Pjesa III. OBJEKTIVAT E SHTI-SË DHE PRODUKTET MADHORE

Në këtë pjesë trajtohen objektivat, produktet dhe aktivitetet që parashikon Qeveria lidhur me prioritetet për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

Këto prioritete përfshijnë: 1) Përmirësimi i kuadrit ligjor, institucional dhe financiar në shërbim të shkencës, teknologjisë dhe inovacionit (SHTI); 2) Mbështetja e Kërkimit Shkencor për nxitjen e Inovacionit dhe zhvillimin e teknologjisë në bashkëpunim me sektorin e biznesit; 3) Rritja e ndërgjegjësimit të aktorëve të shoqërisë civile, medias dhe publikut për rolin e Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit në zhvillimin e përgjithshëm të shoqerisë; 4)Fuqizimi i bashkëpunimit në nivel rajonal, europian dhe global.

Pjesa IV. BURIMET FINANCIARE

Në këtë pjesë paraqiten, burimet financiare për zbatimin dhe bashkërendimin e strategjisë, planifikimet e parashikuara sipas Programit të Buxhetit Afatmesën 2018-2020, në përputhje me Kuadrin Makroekonomik në vend. Gjithashtu, parashtrohen mekanizmat kryesore financiarë të koordinimit dhe bashkërendimit midis institucioneve, partnerëve, donatorëve ndërkombëtarë që do të mundësojnë zbatimin e kësaj strategjie.

Pjesa V. LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

Kjo pjesë paraqet procedurat që zbatohen për garantimin e llogaridhënies dhe monitorimit në zbatimin e Strategjisë së SHTI-së. Sistemi i vlerësimit realizohet sipas indikatorëve përkatës.

Dokumenti përmban anekset me:

- Indikatorët për matjen e performancës së strategjisë SHTI-së (Aneksi nr. 2)
- Indikatorët e aktiviteteve sipas planit të veprimit (Aneksi nr. 1)

Procesi i zbatimit të strategjisë SHTI-së, vlerësohet në vazhdimësi sipas një kornize monitorimi e cila synon hap pas hapi të integrohet me indikatorët e BE-së. Në këtë mënyrë ofrohet mundësia

[10] Specifikuar ne faqen nr 29 te ketij dokumenti

për vlerësimin strategjik afatgjatë në drejtim te realizimit të politikave, qëllimeve, objektivave, produkteve dhe ndikimit të tyre në shoqëri dhe ekonomi[11].

I. KUSHTET AKTUALE

Të dhënat e paraqitura në këtë pjesë, tregojnë ecurinë në sektorin e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit,si dhe rezultatet e zbatimit te politikave publike gjatë periudhës 2006 – 2016. Në të hidhet dritë mbi zhvillimin e kuadrit ligjor,institucional, financiar, arritjet konkrete dhe mosrealizimet.

I.1 Zhvillimi i kuadrit ligjor dhe institucional (2006-2016)

1.1.1 Situata e kuadrit ligjor, institucional dhe financiar në fushën e kërkimit shkencor

Gjatë periudhës 2006-2016, skema institucionale dhe kuadri ligjor që rregullonin marrëdhëniet mes institucioneve politikëbërëse, atyre që kryenin kërkim shkencor dhe që e financonin atë, ishin rrjedhojë e ndryshimeve themelore që kishin ndodhur në këtë sektor, veçanërisht gjatë reformës së vitit 2006.
Lidhur me **INSTITUCIONET POLITIKËBËRËSE NË FUSHËN E KËRKIMIT SHKENCOR,** Ministria e Arsimit dhe Shkencës –MASH, do të vazhdonte të ishte nga viti 1997-2013, institucioni parësor i cili do kryente hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e arsimit të lartë e të shkencës.

Emërtimi i saj do të ndryshonte pas vitit 2013 në Ministria e Arsimit e Sportit – MAS. Përgjegjësia e saj institucionale në raport me politikat në fushën e shkencës mbeti e pandryshuar sic e parashikonte edhe VKM-ja Nr. 843, date 7.09.2013[12].

Ndërkohë, në Shtator 2017, emërtimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit do të ndryshonte sërish në Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, por fusha e saj e përgjegjësisë në lidhje me politikat në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit mbetet e njëjtë.

Gjatë periudhës 1990-2006 rolin këshillues dhe rekomandues në fushën e kërkimit shkencor e ka kryer: “Këshilli i Politikës Shkencore dhe i Zhvillimit Teknologjik-KPSHZHT”[13]. Kjo strukturë u shfuqizua në vitin 2006 nga ligji “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”,dhe në vend të tij u krijua Këshilli i Arsimit të Lartë e Shkencës-KALSH, i cili i ushtroi funksionet e tij deri në vitin 2015[14][15].

---

[11] Raporti i BE-së për Shqipërinë

[12] VKM Nr 843 datë 27.09.2013 Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (Fletore Zyrtare Nr 161, Viti 2013, Faqe 2312; VKM Nr 328 datë 28.05.2014 Për disa ndryshime e shtesa në VKM Nr 843 datë 27.09.2013 Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (Fletore Zyrtare Nr 85, Viti 2014, Faqe 3500)

[13] Funksionet e detyrat e të cilit ishin përcaktuar nga VKM Nr. 424, datë 06.08.1993 “Për krijimin e Këshillit të Politikës Shkencore e të Zhvillimit Teknologjik-KPSHZHT dhe riorganizimin e Komitetit të Shkencës e të Teknologjisë”.

[14] VKM, Nr. 308, datë 24.05.2006 , nderkohe qe nëpërmjet amendimit që iu bë me datë 03.07.2006, Ligjit Nr.

[15] , datë 25.02.1999 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, u parashikua krijimi i Këshillit të Arsimit të Lartë e Shkencës- KALSH.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit 80/2015 datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë", kjo strukturë u rikonceptua sërish duke u riemërtuar si Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALKSH)[16].
Aktualisht KALKSH është struktura kryesore këshilluese pranë Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë mbi çështjet e kuadrit politik e strategjik të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë.

Përsa i përket **INSTITUCIONEVE QË KRYEJNË KËRKIM SHKENCOR**, aktualisht funksionojnë 38 IAL (Institucione publike (14) dhe jopublike (24) të arsimit të lartë). Gjithashtu, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e kërkimit jashtë IAL-ve për ministritë e linjës e institucione te tjera edhe rreth 20 institute, qendra e shërbime kombëtare, me karakter kërkimor.

Roli i Akademisë së Shkencave, e cila ka qenë institucioni kryesor në fushën e kërkimeve nga viti 1972-2006, ndryshoi që prej reformës së vitit 2006. Ajo nuk ka më aktualisht në vartësi institutet e shkencave natyrore e albanologjike, të cilët kryenin kërkim shkencor në nivel kombëtar[17].

Deri në vitin 2006 struktura e institucioneve kërkimore ishte e ndarë si më poshtë a)

Institucionet kërkimore në vartësi të Akademisë së Shkencave

b) Universitetet Publike

c) Institutet në vartësi të ministrive të linjës

Në vitin 2006 Qeveria Shqiptare ndërmori një nga reformat më tërësore por edhe më të diskutueshme të pas viteve '90 që solli ndryshime në konceptimin dhe funksionimin e sistemit institucional të kërkimit shkencor.

Për realizimin e kësaj reforme:

- Kryeministri emëroi një grup ekspertësh nga komuniteti akademik, të cilët mbi bazën e një vlerësimi të sistemit të kërkimit, hartuan një platformë për reformimin e sistemit të kërkimit shkencor.
- Grupi propozoi që kërkimi shkencor të kalonte nga juridiksioni i institucione të pavarura në institucione kërkimore pranë IAL-ve, si pjesë strukturore e tyre.
- Rekomandimet e grupit të ekspertëve u përpunuan deri në detaje nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës (KALSH). Bazuar në këto rekomandime Qeveria në vitin 2006 mori një sërë vendimesh për riorganizimin e rrjetit të institucioneve të kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë.

Reforma institucionale e ndërmarrë në vitin 2006 përfshiu edhe sistemin e instituteve kërkimore shkencore në vartësinë e ministrive të linjës. Pothuajse 30 institute kërkimore, u shkrinë, u mbyllën, dhe u ristrukturuan përmes bashkimit ose transferimit të vartësisë së tyre institucionale. Këto ndryshime të thella patën ndikim të dukshëm në ecurinë e tyre të mëtejshme.

Kërkimi shkencor deri në vitin 1999 është kryer vetëm në universitetet publike si të vetmet institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

[16] VKM Nr. 989, datë 09.12.2015 "Për organizimin, funksionimin, kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALKSH)
[17] Per me teper rreth zhvillimeve institucionale dhe normative te periudhes ne fjale shih Ankesin nr 3

Me ligjin nr. 8461 datë 25.02.1999 për Arsimin e Lartë në RSH, (neni 3) u lejua hapja e institucioneve jo publike të arsimit të lartë që futi konceptin e arsimit të lartë jo-publik. Ndërkohë deri në 2006 u krijuan vetëm 6 IAL-jo publike.

Pas miratimit të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", numri i IAL–jo publike nga viti 2007 -2013 arriti në mbi 40 [18].
Pavarësisht nga ky ndryshim sasior, për shkak eksperiencës së gjatë, kërkimi shkencor mbeti i përqendruar dhe si prioritet në universitetet publike.

Duhet theksuar se pas vitit 2006 në një pjesë të universiteteve publike si Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik, Universiteti Bujqësor u përfshinë edhe institutet që kishin qënë më parë në vartësi të Akademisë së Shkencave.

Vit pas viti disa prej IAL jo-publike si Universiteti i Neë Yorkut, Universiteti Epoka, Universiteti Evropian i Tiranës, Universiteti Polis, Universiteti Marin Barlet, Albanian University, Zonja e Këshillit të Mirë, ShLP Mesdhetare e Shqipërisë, Kolegji Universitar Luarasi ndërtuan kapacitetet e tyre për kërkimin shkencor dhe u përfshinë në këtë veprimtari.

Në lidhje me promovimin e personelit akademik e kërkimor kuadri ligjor në fuqi mbështetet në VKM-në nr.467, datë 18.07.2007, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik [19]. VKM-ja do të jetë subjekt ndryshimi si rrjedhojë e miratimit të ligjit nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"[20].

Në lidhje me statusin social ekonomik i personelit akademik e kërkimor në institucionet publike përveç miratimit të VKM Nr. 748, datë 11.06.2009 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë ndryshimi ligjor më i rëndësishëm ishte miratimi i Ligj Nr. 10139, datë 15,05.2009 "Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë titujt shkencor".

Përsa i përket **NIVELIT INSTITUCIONAL TË FINANCIMIT TË KËRKIMIT SHKENCOR**

[18] Duhet theksuar se Ligji Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" ka pësuar një sërë amendimesh ligjore të tilla si: 1)Ligj Nr. 9832, datë 12.11.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; 2)Vendim i Gjykates Kushtetuese Nr. 9, datë 19.03.2008 Për ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007 Me objekt: 1. Shfuqizimin e fjalisë së tretë, të pikës 1, të nenit 23 dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 64 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë"; 3)Ligj Nr. 10307, datë 22.07.2010 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" ; 4)Ligj Nr. 10307, datë 22.07.2010 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"; 5)Ligj Nr. 10307, datë 22.07.2010 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; 6) Ligj Nr. 10493, datë 15.12.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; 7)Ligj Nr. 51/2014, datë 15.05.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

[19] VKM Nr 91 datë 10.02.2010 Për disa ndryshime e shtesa në VKM Nr 467 adtë 18.07.2007 Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik ; VKM Nr 438 datë 09.06.2010 Për disa ndryshime e shtesa në VKM Nr 467 adtë 18.07.2007 Për përcaktimin e kritereve **dhe të** procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik; VKM Nr 252 datë 30.04.2014 Për funksionimin, të drejtat dhe detyrat e Komisonit të Vlerësimit të Titujve Akademike

[20] Ligj 80/2015 datë 22.07.2015 Për arsimin e lartë e kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë

aktualisht kuadri ligjor e institucional i'a ka ngarkuar këtë përgjegjësi Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit –AKKSHI (ish-AKTI)[21], në bazë të Ligjit 80-2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë e kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë" specifikuar në Nenin 12, që parashikonte krijimin e një strukturë të tillë në vartësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit-AKKSHI u ngrit mbi punen e kryer nga Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI), e cila që prej krijimit të saj me VKM Nr. 903, datë 26.08.2009 kishte për mision kryesor financimin e kërkimit shkencor përmes_Projekteve Kombëtare të Kërkim – Zhvillimit (PKKZH) dhe Projektet Dypalëshe e Shumëpalëshe të Bashkëpunimit Shkencor[22].

Krijimi i Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) ishte një nga objektivat e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtarë të Shkencës, Teknologjisë e Inovacionit 20092015, çka mundesoi përqëndrimin e finacimit te kërkimit shkencor në nivel kombëtar pranë një agjensie ekzekutive, sipas modelit të vendeve anëtare të BE[23].

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit – AKKSHI, ushtron funksionet bazë të financimit kombëtar të kërkimit shkencor e inovacionit si dhe vlerësimin e performancës së kërkimit shkencor në nivel kombëtar për IAL-të dhe institutet e mirëfillta kërkimore.

Në misionin financues të Kërkimit Shkencor në IAL-të shqiptare, Ligji 80/2015 i njeh të drejtën edhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë – AKFAL. Aktiviteti i AKFAL parashikuar sipas Nenit 11 të këtij ligji ka per objektiv dhënien e Grantit për realizimi e Punës Kërkimore për universitetet publike, me qëllim fuqizimin e instrumentave financiarë publikë në dobi të kërkimit shkencor.

Elementët e mbështetjes të kërkimit shkencor kanë qenë të lidhur me:

- aspektet e financimit të projekteve kombëtare të kërkim - zhvillimit

[21] VKM Nr 607 datë 31.08.2016 Për krijimin, përbërjen,organizimin e funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit- AKKSHI

[22]VKM Nr. 903, datë 26.08.2009 "Për krijimin e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) [23] Në bazë të pikës 4 të VKM Nr. 903, datë 26.08.2009 "Për krijimin e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, (AKTI) e realizonte financimin e kërkimit shkencor përmes buxhetit të shtetit nga "Fondi për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin (FSHTI)", në nënzërat e mëposhtëm:
i) Fondi për programet kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit ii) Fondi për infrastrukturën e kërkimit
iii) Fondi për qendrat e ekselencës në kërkim iv) Fondi për transferimin e teknologjisë dhe inovacionin
v) Fondi për kërkuesit e rinj vi) Fondi për programin Brain Gain Mjete financiare nga:
i) palë të treta, të destinuara për SHTI-në ii) programet dhe projektet e BE-së, të shteteve të veçanta dhe të organizatave partnere iii) donacione të subjekteve fizike dhe juridike, të vendit dhe të huaja iv) sektori privat, vendas dhe i huaj
Ndërkohë gjatë kësaj periudhe mënyra e financimit të kërkimit shkencor në Universitet Publike, Qendrës së Studimeve Albanologjike-QSA dhe institute në vartësi të ministrive të linjës, vazhdonte të realizohej nëpërmjet fondeve buxhetore të institucioneve nga kishin varësinë financiare.

- forcimin e kapaciteteve akademike përmes hapjes së programeve të doktoraturës e Fondit të Ekselencës[21] për shkencëtarët e rinj

[21] Udhëzim i MASH Nr 37 datë 31.12.2012 Për përcaktimin e rregullave në zbatim të kritereve, masës së financimit dhe procedurave që ndiqen për përfitimin e Fondit të Ekselencës nga studentët dhe shkencëtarët e shkëlqyer (

- ndërkombëtarizimin e _shkencës falë pjesëmarrjes në Programet e BE për Kërkim- Shkencor e Inovacionin FP7 e H2020 dhe rritjes së bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtar
- zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe të bashkëpunimit shkencor e programeve të mobilitetit akademik

Gjatë periudhës 2010-2014, janë zhvilluar dhe financuar Programe Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit në 7 fusha si më poshtë: 1) Programi kombëtar "Shkencat Sociale dhe Albanologjike"; 2) Programi kombëtar "Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit"; 3) Programi kombëtar "Bujqësia (veterinaria, zooteknika), Ushqimi dhe Bioteknologjitë"; 4) Programi kombëtar "Uji dhe Energjia"; 5) Programi kombëtar "Biodiversiteti dhe Mjedisi"; 6) Programi kombëtar "Shëndetësia"; 7) Programi kombëtar "Materialet".

Në këtë kuadër, AKTI ka financuar gjatë viteve 2010-2014 një sërë projektesh kërkimore shkencore, në shumë fusha (Figura 1). [22]

Figura 1: Projektet e financuara nga AKTI për periudhën 2010-2014, sipas fushave.

Burimi: AKKSHI 2017

Shpërndarja e fondeve për kërkimin shkencor ka qenë proporcionale me fushat e paraqitura në grafikun e mëposhtëm, ku vëmendje më e madhe i është kushtuar sektorit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Bioteknologjisë (me rreth 31% të fondeve të thithura), e ndjekur nga shkencat sociale dhe albanologjike (me 23%)[23](Figura 2).

Fletore Zyrtare Nr 178, Viti 2012, Faqe 10639) VKM Nr 478 datë 16.07.2014 Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës) (Fletore Zyrtare Nr 117, Viti 2014, Faqe 5180

[22] http://ëëë.akti.gov.al/pkkzh_financime.html (16 mars 2017)

[23] http://ëëë.akti.gov.al/pkkzh_financime.html (16 mars 2017)

Figura 2: Shpërndarja e fondeve të projekteve të financuara nga AKTI për periudhën 2010-2014, sipas fushave.

Burimi: AKKSHI 2017

Gjithashtu, gjatë periudhës 2006-2016 zhvillimi më i rëndësishëm në fushën e kërkimit shkencor ishte hapja e programeve të studimeve të doktoratës fillimisht në një sërë IAL-sh publike e më pas në ato jo-publike apo private[24]. Rëndësia e tyre lidhet me faktin se cikli i tretë i studimeve doktorale përfaqëson një hap të rëndësishëm për rritjen, inkurajimin e nxitjen e shkencëtarëve të rinj në fusha të ndryshme. Por masivizimi i skajshëm i procedurave të pranimit të kandidatëve në ciklin e studimeve të doktoratës e dëmtoi cilësinë e tyre

[24] VKM Nr 864 datë 05.12.2007 Për hapjen e programeve të studimeve të doktoraturës në IAL publike dhe përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë studenti, për marrjen e diplomës për gradën shkencore `DOKTOR`PHD ; Udhëzim Nr 5 datë 22.01.2008 Për përcaktimin e standarteve akademike të nevojshme për hapjen , mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të Doktoratës , si dhe të elementëve bazë sipas të cilave institicionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin rregulloren përkatëse; VKM Nr 877 datë 18.06.2008 Për disa ndryshime në VKM Nr 864 datë 05.12.2007 Për hapjen e programeve të studimeve të doktoraturës në IAL publike dhe përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë student, për marrjen e diplomës për gradën shkencore `DOKTOR`PHD; Udhëzim Nr 20 datë 29.07.2009 Për disa ndryshime në shtojcën 1 të Udhëzim Nr 5 datë 22.01.2008 Për përcaktimin e standarteve akademike të nevojshme për hapjen , mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të Doktoratës , si dhe të elementëve bazë sipas të cilave institicionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin rregulloren përkatëse; Udhëzim MASH nr. 21, datë 30.07.2009 "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të doktoraturës, në institucionet publike të arsimit të lartë; Udhëzim Nr 30 datë 08.12.2009 Për disa ndryshime në Udhëzim MASH nr. 21, datë 30.07.2009 "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të doktoraturës, në institucionet publike të arsimit të lartë ; VKM Nr 450 date 23.06.2011Për disa ndryshime në VKM Nr 864 datë 05.12.2007 Për hapjen e programeve të studimeve të doktoraturës në IAL publike dhe përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë student, për marrjen e diplomës për gradën shkencore `DOKTOR`-PHD ;VKM Nr 24 datë 9.1.2013 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kuotave të pranimit dhe të tarifave të shkollimit në programet e studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2012 - 2013

Në këtë kuadër që prej vitit 2009 u hapën 30 Programe Doktorate në fusha të ndryshme kërkimi në 7 universitete publike [28]. Ndërkohë pas vitit 2011 u hapën Programet e Doktoratës edhe në IAL-te jo-publike[29].

Nga ana tjetër një tregues i zhvillimit e financimit të kërkimit shkencor përgjatë viteve 20062016 ka qenë niveli i pjesëmarrjes dhe shkalla e suksesit e fondeve të përfituara prej IAL-ve, qendrave kërkimore e instituteve shqiptare në Programet Kuadër të BE për Kërkim Shkencor

[28] VKM Nr.686, datë 18.06.2009 "Për hapjen e programeve të studimeve të Doktoraturës, në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës; VKM Nr.1278, datë 23.12.2009 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 686, datë 18.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për hapjen e programeve të studimeve të Doktoraturës, në Fakultetin e Drejtësisë, në Uiversitetin e Tiranës ; VKM Nr.695, datë 18.06.2009 "Për hapjen e programeve të studimit të Doktoraturës, në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, në Universitetin Politeknik të Tiranës; VKM nr 115 qe hap doktoraturat ne UAMD, VKM Nr. 1167, datë 25.11.2009 "Për disa shtesa në vendimin nr. 855, datë 8.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për hapjen e programit të studimeve të doktoraturës, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, të Universitetit Politeknik të Tiranës; VKM Nr.1168, datë 25.11.2009 "Për disa shtesa në vendimin nr. 825, datë 29.7.2009 të Këshillit të Ministrave "Për hapjen e programit të studimeve të doktoraturës në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare të Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe miratimin e kuotave dhe të tarifës për këtë program; VKM Nr.803, datë 22.07.2009 "Për hapjen e programit të studimeve të doktoraturës në matematikë, në Fakultetin e Shkencave Teknike të universitetit "Ismail Qemali", në Vlore; VKM Nr.825, datë 29.07.2009 "Për hapjen e programit të studimeve të doktoraturës në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare të Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe miratimin e kuotave dhe të tarifës për këtë program", të ndryshuar; VKM Nr.854, datë 5.08.2009 "Për hapjen e programeve të studimeve të doktoraturës , në Fakultetin e shkencave sociale dhe në atë të mjeksisë të Universitetit të Tiranës; VKM Nr.855, datë 5.08.2009 "Për hapjen e programeve të studimeve të doktoraturës , në Fakultetin e gjeologjisë dhe minierave, të Universitetit të Tiranës; VKM Nr.1115, datë 13.11.2009 "Për hapjen e programit të studimeve të "Për hapjen e programi studimeve të doktoraturës në "Arkitekturë - Urbanistikë", në Fakultetin e inxhinierisë së Ndërtimit, të Universitetit Politeknik të Tiranës, sidhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, për vitin akademik 2009 -2010, në këtë program studimi";VKM Nr.1116, datë 13.11.2009 "Për hapjen e programi studimeve të doktoraturës në "Arkitekturë - Urbanistikë", në Fakultetin e inxhinierisë së Ndërtimit, të Universitetit Politeknik të Tiranës, sidhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, për vitin akademik 2009 -2010, në këtë program studimi; VKM Nr. 1164, datë 25.11.2009 "Për hapjen programeve të studimeve të doktoraturës, në Qendrën e Studimeve Albanologjike, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, në këto programe studimi"; VKM Nr. 1165, datë 25.11.2009 "Për hapjen e programeve të studimeve të doktoraturës, në "Shkenca Komunikimi", në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, të Universitetit të Tiranëssi dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, në këtë program studimi"; VKM Nr. 1166, datë 25.11.2009 "Për hapjen e programeve të studimit të doktoraturës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Tiranëssi dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, në këto programe studimi; VKM Nr. 1185, datë 03.12.2009 "Për hapjen e programit të studimeve të doktoraturës, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të
Universitetit Politeknik të Tiranës dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit në këtë program; VKM Nr 284 datë 21.04.2010 Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe në atë të inxhinierisë së ndërtimit në Universitetin Politeknik të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe studimi; VKM Nr 285 datë 21.04.2010 Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në histori, në fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit në këtë program studimi; VKM Nr 286 datë 21.04.2010 Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në gjeografi, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit në këtë program studimesh; VKM Nr 678 datë 13.08.2010Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Infermierisë të Universitetit të Tiranës, si dhe për kuotën e pranimit dhe tarifën e shkollimit në këto programe studimi; Urdhër Nr 567 datë 23.11.2011 Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë të doktoratës në "Shkenca politike", në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës; Urdhër Nr 498 datë 07.10.2011 Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, në universitetin "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës; Urdhër Nr 500 datë 07.10.2011 Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, në universitetin "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit; Urdhër Nr 501 datë 07.10.2011 Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, në universitetin "Fan S. Noli" të Korçës; Urdhër Nr 502 datë 07.10.2011Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, në Akademinë e Mbrojtjes "Spiro Moisiu" të Tiranës; Urdhër Nr 605 datë 29.12.2010 Për hapjen e programeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe të Inxhinierisë Fizike, të Universitetit Politeknik të Tiranës; Urdhër Nr 607 datë 29.12.2010Për hapjen e programeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës

[29] Universiteti Europian i Tiranës, Universiteti i Neë Yorkut, Universiteti Epoka, Universiteti Polis dhe Albanian University.

e Inovacion. Këto rezultate kanë sherbyer si tregues të kapaciteteve të brendshme por edhe të shkallës së bashkëveprimit me institucionet homologe të vendeve anëtare të BE në fushën e projekteve kërkimore–shkencore.

Shqipëria për herë të parë mori pjesë në mënyrë institucionale në Programin e Shtatë Kuadër të BE për Kërkimit Shkencor, dhe Inovacionin, (EU Seventh Frameëork Programme -FP72007-2013). Gjatë kësaj periudhe institucionet akademike e kërkimore shqiptare përmes projekteve të paraqitura kanë pasur një shkallë të përgjithshme niveli suksesi prej 14.4%, në krahasim me mesataren e BE-së prej 21.6%[25] me fonde totale të përfituara rreth 2.36 milionë euro.

Të dhënat mbi pjesëmarrjen e Shqipërisë në Programin e Shtatë Kuadër të BE për Kërkimit Shkencor, dhe Inovacionin, (EU Seventh Frameëork Programme -FP7-2007-2013 janë, siç tregohet në Tabelën 1, .Rezultatet janë në nivelin mesatar të rajonit të Ballkanit, me një numër total prej 245 projektesh të fituara për një periudhë 6 vjeçare [31].

Figura 3: Pjesëmarrja e Shqipërisë në Programin Kuadër të BE-së (FP7) (2007-2013)

Për më tepër, 41% e fondeve të përfituara i takojnë sektorit të shëndetësisë, 20% në shkencat sociale, 17% në fusha si ushqimi, agrikultura & bioteknologjia, 12% në mjedis (përfshirë ndryshimet klimatike), 5% në ICT, 4% në sektorin e transportit (përfshirë aeronautikën), ndërsa 1% i takojnë Nano Shkencave.

Në vitin 2014 Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen me Komisionin Europian për të marrë pjesë në Programin Kuadër për Kërkim – Shkencor e Inovacion Horzion 2020 (2014-2020)[26].që pasoi programin pararadhës FP7

[25] Raport-Progresi i BE-së për Shqipërinë (2010-2014), Kapitulli 25 "*Kërkimi dhe Shkenca*". [31] Burimi: AKTI, http://akti.gov.al/dokumenta/statistika_FP7.pdf (16/03/2017)

[26] Ligj nr.132/2014 datë 24.06.2014 Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin kuadër "Horizon 2020 - Programi për kërkim dhe inovacion" Ligj Nr 61-2015 datë 11.06.2015 Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Unionit "Konkurrenca e ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) 2014-2020"

Programi Kuadër i BE për Kërkim – Shkencor e Inovacion Horizon 2020 ka në fokus të veçantë marrëdhëniet e bashkëpunimin mes biznesit e komunitetit kërkimor shkencor. Gjatë 2 viteve të para të zbatimit të tij 2014-2016, IAL-te, institutet e qendrat kërkimore në vend janë përpjekur të marrin pjesë e të përfitojnë nga ky program por të dhënat e deritanishme dëshmojnë se Shqipëria ende ka nivele të ulëta të pjesëmarrjes e përthithjes së fondeve edhe përkundrejt vendeve të tjera të Ballkanit.

Ndonëse përgjatë periudhës 2015-2016, numri i aplikantëve shqiptarë është rritur në 146, nga 66 që ishte në vitin 2014-2015.ende, numri i projekteve të suksesshme nga Shqipëria mbetet i ulët ashtu sikurse pjesëmarrja e sektorit privat(SME) në këtë program.

Të dhënat e Komisionit Europian tregojne se gjatë periudhës 2014-2016 që përkon me 2 vjecarin e parë të Programit Kuadër të BE Horizon 2020 kanë aplikuar gjithsej rreth 50 organizata nga Shqipëria me një numër të përgjithshëm prej 140 projektesh. Shkalla e suksesit ka qenë shumë e vogël (vetëm 4.8% ose 6 projekte të suksesshme nga të gjithë aktorët publikë dhe jo-publikë që aplikuan (3 nga aktorë jo-publik, një prej të cilëve nuk i përket shoqërisë civile)– për një vlerë prej rreth 330.000 euro nga rreth 30.000.000 të kërkuara) (shih Tabelën 2 dhe 3).

Tabela 2: Shkalla e suksesit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Shkurt 2017

	Shqipëria	B/H	Maqedonia	Kosova	Mali I Zi	Serbia	Shuma
Aplikime	**140**	**176**	**286**	**44**	**99**	**1161**	**1906**
Aplikime të vlerësuara	**125**	**152**	**256**	**41**	**88**	**1006**	**1665**
Aplikimet fituese	**6**	**14**	**27**	**6**	**7**	**91**	**150**
% e suksesit (të aplikimeve)	**4.80%**	**9.215**	**10.55%**	**14.63%**	**7.95%**	**9.05%**	**9.35%**

Burimi: AKKSHI Shkurt 2017

Tabela 3: Resurset financiare të siguruara nga fondet Horizont 2020 për vendet e Ballkanit Perëndimor, Shkurt 2017

Burimi: AKKSHI, Shkurt 2017

Figura 4, në vijim, nga 140 aplikime për projektet shkencore Horizon 2020, 31% e tyre (ose 43-44 projekte) janë aplikime nga institucione jofitimprurëse dhe aktorë të tjerë jo-shtetërorë. Kjo tregon potencialin e madh të këtyre aktorëve, interesin e fortë të tyre për t'u bërë pjesë e Hapësirës Evropiane të Kërkimit (ERA) dhe e rrjeteve evropiane të kërkimit shkencor. Nga ana tjetër, kjo tregon rritjen graduale të eksperiencës së këtyre aktorëve në njohjen e Horizon 2020, çka duhet marrë parasysh në kontekstin e strategjisë së kërkimit shkencor, duke e parë këtë si një potencial të madh në vitet e ardhshme për të aksesuar në fonde evropiane të kërkimit shkencor.

Figura 4: Shpërndarja e aplikimeve për projekte Horizon 2020 sipas aktorëve:



Burimi: AKKSHI, Shkurt 2017

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor gjatë viteve 20092016 IAL-te, qendrat e institucionet kërkimore shkencore përfituan nga marrëveshjet e bashkëpunimit shkencor shumëpalësh të nënshkruara nga qeveria shqiptare me UNESCO[33] dhe BE (FP7 , ERASMUS, H2020) si edhe ato dypalëshe.

Sic kemi vërejtur një ndër elementët më të rëndësishëm të këtij bashkëpunimi vazhdon të mbetet vecanërisht pjesëmarrja e studiuesve shqiptarë në Programet Kuadër të BE për Kërkim Shkencor e Inovacion –FP7 2007-2013 dhe H2020 (2014-2020)[34].

Por nga ana tjetër një element prioritar i ndërkombëtarizimit të shkencës shqiptare është nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve dypalëshe të bashkëpunimit shkencor. Shqipëria ka nënshkruar rreth 20 marrëveshje të tilla[35], Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe

[33] Ligj Nr.8157, datë 31.10.1996. Për miratimin e .Memorandumit të bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për arsimin, shkencën dhe kulturën- UNESCO; Ligj Nr.7725, datë 23.06.1993. Për ratifikimin e Konventës së Detit të Zi mbi bashkëpunimin në fushate kulturës, arsimit, shkencës dhe informacionit

[34] Ligj Nr 9866 datë 31.01.2008 Për ratifikimin e "Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për asociimin e Republikës së Shqipërisë në Programin e Shtatë Kuadër të Komunitetit Europian për kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe të veprimtarive të demonstrimit – FP7 (20072013)"

[35] Ligj Nr 9819 datë 25.10.2007 Për ratifikimin "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Argjentinës për bashkëpunimin shkencor dhe teknik"; Ligj Nr 9522 datë 25.04.2006 Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë në fushën e kulturës, të arsimit dhe shkencës VKM Nr 620 datë 12.09.2012 Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik; VKM-në nr. 657 datë 26.09.2012 Për miratimin e Protokollit ndryshues i marrveshjes ndërmjet Keshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e Kulturës, Arsimit dhe Shkencës; VKM Nr.435, datë 26.06.2003 "Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë Hercegovinës për bashkëpunimin në fushat e arsimit e të shkencës; VKM Nr 62 datë 31.01.2013 Për miratimin e programit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë, për bashkëpunimin në fushën e arsimit, shkencës dhe kulturës, për periudhën 2012-2014 VKM Nr 16.04. 2012 Për miratimin e marrëveshje snë fushën e arsimit dhe shkencës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Çeke, nënshkruar 16 prill 2012; VKM Nr 57 datë 11.02.1993 Për miratimin në parim të projektmarrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Arabe të Egjiptit për bashkëpunimin ekonomik, industrial e tekniko shkencor.; VKM Nr 530 datë 27.07.2005 Për miratimin e protokollit të sesionit të 9-të të Komitetit të Përbashkët Ndërqeveritar Shqiptaro-Grek, për bashkëpunimin ekonomik, industrial dhe tekniko-shkencor; VKM Nr 108 datë 02.03.2001 Për miratimin e protokollit të sesionit të parë të komisionit të përbashkët shqiptaroitalian, për bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik.; VKM nr.59, datë 11.02.1993. Për miratimin në parim të .Marrëveshjes për zhvillimin ebashkëpunimit tregtar, ekonomik, industrial, kërkimet teknologjike dhe zhvillimin ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së shtetit të Izraelit; VKM Nr 238 datë 22.09.1995Për miratimin në parim të "Marrëveshjes së bashkëpunimit shkencor e teknologjisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Koresë së Jugut " VKM Nr 265 datë 21.04.2010 Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës; VKM Nr 01.02. 1994 Për miratimin e marrëveshje snë fushën e arsimit dhe shkencës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë VKM Nr 765 datë 28.09.2004 Për miratimin e marrëveshjes për bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës.; VKM Nr 434 datë 30.03. 1994 Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malajzisë mbi bashkëpunimin ekonomik shkencor dhe teknik; VKM Nr 654 datë 13.03.1992 Për miratimin e Marrëveshjes mbi bashkëpunimin kulturor dhe shkencor midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maltës, nënshkruar më 3.2.1992; VKM Nr 553 datë 01.05.2008 Për miratimin e programit kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për bashkëpunimin në fushat e arsimit, shkencës, kulturës, arteve, rinisë e sporteve, medias dhe kontakteve ndërmjet njerëzve; VKM Nr 260 datë 28.04.2005 Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Sllovenisë, për bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik. ;VKM Nr 765 datë 23.05.1995 Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Federatës Ruse për tregti, bashkëpunimin ekonomik dhe tekniko shkencor; VKM Nr.654, datë 23.12.2006 "Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të

Inovacionit- AKKSHI është agjencia që realizon zbatimin e tyre përmes financimit të Projekteve të Bashkëpunimit Shkencor Dypalësh. Projektet e Bashkëpunimit Shkencor Dypalësh bëjnë të mundur shkëmbimin e eksperiencave e krijimin e kontakteve e realizimin e përbashkët të aspekteve të ndryshme kërkimore mes studiuesve shqiptarë dhe atyre të vendeve të tjera.

Në këtë kuadër përgjatë periudhës 2009-2016 AKKSHI (ish-AKTI) ka zbatuar një sërë marrëveshjes të tilla përmes financimit të projekteve dypalëshe të bashkëpunimit shkencor mes studiuesve shqiptarë dhe atyre të vendeve të tjera. Si rezultat i Protokollit Bashkëpunimi me

Sllovenině në vitin 2010 u financuan 10 projekte të përbashkëta shkencore midis kërkuesve të të dy vendeve por për shkak të mungesës së financimit u financua vetëm faza e parë ; ndërkohë që vitin 2014, u realizua Protokollin e Bashkëpunimit me Austrinë ku u financuan nga AKKSHI (ISH-akti) 10 projekte të përbashkëta shkencore midis kërkuesve të të dy vendeve për periudhën 2 vjecare 2015-2016.

Gjithashtu përmes Protokollit të dytë të bashkëpunimit me agjencinë TUBITAK (Turqi), aktualisht
po financohet një projekt i përbashkët kërkimor mes studiuesve nga Shqipëria.)

Duke qenë se bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor është një nga kriteret e integrimit në Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor – ERA, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë vazhdon të rishikojë e të nxisë nënshkrimin e memorandume e marrëveshjeve dypalëshe të mirëkuptimit e bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor e inovacionit me vende e institucione të BE, rajonit e më gjerë .

Një vëmendje e vecantë në këtë drejtim i është kushtuar hartimit e miratimit të Protokolleve e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit në fushën e kërkimir shkencor e inovacionit mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës e Maqedonisë ku komuniteti kërkimor shkencor i atjeshëm përbëhet nga shqiptarë që jetojnë jashtë kufijve administrativë të RSH. Përmes këtyre marrëveshjeve synohet bashkëpunimi në projekte të përbashkëta që u shërbejnë prioriteteve e objektivave në cdo fushë të zhvillimit social-ekonomik. Nga ana tjetër nxitja e procesit për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit shkencor e inovacionit me vende të tilla si Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja përbën një shtysë që fuqizon dimensionin rajonal të bashkëpunimit shkencor të Shqipërisë.

Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Rumanisë, për bashkëpunimin ekonomik, shkencor dhe teknik ; VKM Nr.243, datë 27.05.1993. Për miratimin e marrëveshjes për bashkëpunimin kulturor e shkencor ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Polonisë; VKM Nr 781 datë 22.09.2015Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për bashkëpunim në fushën e arsimit dhe shkencës ;VKM Nr.40, datë 14.01.2009 "Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik

Ndërkohë janë një sërë marrëveshjesh që nxisin mobilitetin akademik mes studentëve e pedagogëve e studiuesve shqiptarë siç është Programi CEEPUS[27] e Programi ERASMUS +[28] në të cilat Shqipëria merr pjesë që prej vitit 1996.

Në këtë drejtim mund të theksojmë se edhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit (ish-AKTI), përveç nxitjes së bashkëpunimit shkencor përmes financimit të kërkimit shkencor, gjatë periudhës 2009-2016 është përfshirë në mënyrë institucionale në një sërë iniciativash dhe projektesh që kanë pasur si synim nxitjen e këtij bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, të tilla si:

- Albanian Euraxess Service Netëork (AL-ES.NET), në kuadër të programit FP7 (20132016);
- European Enterprise Netëork, projekt për ngritjen e rrjetit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri;
- EURAXESS TOP III, projekt në kuadrin e programit Horizon 2020 për testimin dhe pilotimin e shërbimeve të reja në zhvillimin e karrierës dhe përmirësimin e mjedisit për mobilitetin e kërkuesve shkencorë (2015-2018);
- Ëeb-InUnion, projekt për identifikimin dhe eliminimin e pengesave të lëvizjes së kërkuesve shkencorë;
- INCO. Netëork (2011-2013), projekt për mbështetjen e dialogut ndër-rajonal për shkencë dhe teknologji.

1.1.2 Situata e kuadrit ligjor, institucional dhe financiar në fushën e inovacionit

Pas viteve 90' politikat në fushën e zhvillimit të teknologjisë e inovacionit janë relativisht të reja për Shqipërinë. Kjo duke patur parasysh se termi[29], inovacion mori një popullaritet të gjerë veçanërisht pas viteve 90' për të karakterizuar zhvillimet e vrullshme ekonomike të mbështetura tek ekonomia e dijes dhe bashkëpunimi shkencë-biznes.

[27] Ligj Nr 9473 date 09.02.2006 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Austrisë, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Çekisë, Republikës së Hungarisë, Republikës së Polonisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Sllovakisë dhe Republikës së Sllovenisë për mbështetjen e bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë, në kuadër të Programit të Shkëmbimeve të Studimeve Universitare për Europën Qendrore (CEEPUS) II". ; Ligj Nr 25-2016 date 10.03.2016 Për ratifikimin e marrëveshjes në lidhje me Programin e Shkëmbimit të Studimeve Universitare në Evropën Qendrore (CEEPUS III).

[28] Ligj Nr 117/2014 datë 11.09.2014 Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin "Erasmus +", Programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin

[29] Përkufizimi i termit inovacion sipas Manualit të Oslos të OECD-së[38], është i ndarë në katër kategori 1) inovacion i produkteve 2) processeve 3) marketingu dhe 4) organizativ. Lidhja e kërkimit shkencor, veçanërisht ai që realizohet në shkencat e aplikuara si shkencat natyrore e teknike është i lidhur kryesisht me dy kategoritë e para të inovacionit si është inovacioni në produkte e proceseve ndërkohë që shkencat sociale e humane janë më të prirura të ofrojnë zgjidhjet inovative në fushën sociale dhe atë organizative.

Sistemet e inovacionit[30] janë një kuadër i përgjithshëm elementësh institucionalë e ligjorë për të kuptuar kushtet në të cilat zhvillohet inovacioni. Ky argument veçanërisht pas viteve 90 është shndërruar në një term popullor mes politikëbërsve dhe studiuesve.

Në bazë të përcaktimeve të mësipërme, fillimisht institucioni politikëbërës në fushën e teknologjisë e inovacionit ishte Ministria për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e Komunikimit- MITIK, e cila u krijua pas vitit 2009 dhe u përqëndrua kryesisht në nxitjen e sektorit ICT në fushën e shërbimeve publike dhe inovacionit të proceseve të ndryshme. Pas vitit 2013 politikat e teknologjisë e inovacionit u ndanë mes Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike[31] dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes e Turizmit[32] ku një rol të veçantë mori nxitja e inovacionit brenda sektorit të administratës publike dhe SME. Një nga zhvillimet më të rëndësishme institucionale të Shtatorit 2017, ishte riorgarnizimi i ministrive të mësipërme që bashkëndanin fushat e përgjegjësisë për zhvillimin e teknologjisë e inovacionit. Si rrjedhojë Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike u shkri dhe funksionet e fusha e saj e përgjegjësisë iu kaluan Ministrisë së Energjisë e Infrastrukturës, Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë dhe Ministrisë së Financës e Ekonomisë Nga ana tjetër edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Sipërmarrjes e Turizimit u shkri dhe funksionet e fusha e saj e përgjegjësisë kaluan tek Ministria e Financës e Ekonomisë dhe Ministria e Turizmit e Mjedisit

Në bazë të Progres–Raportit të Komisionit Evropian (2011) për kapitullin 25: Shkenca e Kërkimi Shkencor, përcaktohet se "*Shqipëria duhet të bëjë përpjekje institucionale e ligjore për t'u përafruar me objektivat e Unionit të Inovacionit*".

Sipas Komunikatës së BE të 6 Tetorit 2010 Arritja e objektivave të Unionit të Inovacionit realizohet nëpërmjet përmbushje së 30 hapa veprimi që u përkasin këtyre 13 fushave 1) nxitja e ekselencës në zhvillimin e arsimit dhe aftësive 2) Përhapja e Zonës Europiane të Kërkimit Shkencor 3) fokusimi i instrumentave të financimit të BE mbi prioritetet e Unionit të Inovacionit 4) promovimi i Institutit Europian të Teknologjisë e Inovacionit si një model i qeverisjes së inovacionit në Europë 5) forcimi i aksesit në financë për kompanitë inovative 6) krijimi i një tregu të vetëm të inovacionit 7) nxitja e hapjes e kapitalizimit të potencialit krijues të Europës 8) përhapja e përfitimeve nga inovacioni në të gjithë BE 9) rritja e përfitimeve sociale 10) arritja e Partneriteteve të Inovacionit 11) nxitja e politikave te inovacionit te BE jashtë vendit 12)

[30] Koncepti i sistemit të inovacionit u përdor për herë të parë në vitin 1985 nga B.A.Lundëall, por do të ishte Christopher Freeman që pas një studimi të vitit 1988 mbi suksesin e ekonomisë japoneze do të fuste në vitin 1995 termin: sistemi kombëtar i inovacionit. Sipas teorisë së sistemit të inovacionit, zhvillimet e teknologjisë e inovacionit janë rezultat i një sërë marrëdhëmiesh që krijohen mes aktorëve të sektorit të biznesit, universiteteve e institutevve kërkimore në një vend të caktuar. Në këtë kuadër sistemet e inovacionit janë kategorizuar në sisteme inovacioni kombëtare, rajonale, lokale, teknologjike e sektoriale. Përveç termit "sistemi kombëtar të inovacionit" sot përdoret gjerësit edhe termi "ekosistemi i inovacionit "(innovation ecosysteem) për të përcaktuar ndikimin që ka mjedisi i një sërë faktorësh ligjorë, institucionalë, financiarë e fiskalë që bëjnë të mundur zhvillimin nga bizneset, universitetet apo institutetet kërkimore të risive teknologjike që ofrojnë zgjidhje apo produkte të reja.

[31] VKM nr.943 datë 09.10.2013Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike

[32] VKM nr.835 datë 18.09.2013, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes" ;VKM nr.158 datë 25.02.2015, "Për një ndryshim në vendimin nr. 835, datë 18.9.2013, të Këshillit Të ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes", të ndryshuar"; VKM nr.172 datë 03.03.2016, "Për një ndryshim në vendimin nr. 835, datë 18.9.2013, të Këshillit Të ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes", të ndryshuar".

reformimi i sistemeve të kërkimit shkencor e inovacionit 13) Matja e progresit në fushën e inovacionit

Përgjatë periudhës 2009-2016 qeveria shqiptare ndërmori disa hapa institucionalë, ligjorë e financiarë për tu përafruar me Objektivat e Unionit të Inovacionit të BE. Në këtë kuadër përsa i përket fushës 5) forcimi i aksesit në financë për kompanitë inovative gjatë vitit 2011 u ngrit Qendrën e Ndërmjetësimit të Inovacionit – QNIB-BRIC pranë Agjencisë Shqiptare të Investimeve- AIDA , për të promovuar dhe për të forcuar kapacitetin e inovacionit të ndërmarrjeve shqiptare.

QNIB është organi ekzekutiv, dhe në fillimet e veprimtarrisë së saj ndërmori hapa për të përcjellë programet e Strategjisë së Biznesit, Teknologjisë dhe Inovacionit 2011-2016 (BITS) si dhe Planit të Veprimit të Biznesit, Teknologjisë dhe Inovacionit (BITAP) të miratuar nga Qeveria Shqiptare. BRIC ofron informacion për grupet e interesuara që dëshirojnë të dinë për inovacionin e biznesit dhe transferimin e teknologjisë. Ai u angazhua në zbatimin e strategjisë BITS ne:

- Programin e Inovacionit
- Programin e Klasterave
- Programin e Inkubacionit

Rol të rëndësishëm në këtë drejtim luajnë edhe PRO TIK Resource Center[33]dhe Innovation Hub [34] dy struktura që administroheshin nga Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, me synim nxitjen, këshilimin, trajnimin e promovimin e nismave të inovacionit në fushën e ICT tek të rinjtë per krijimin e Start–up të reja dhe gjallërimin e modeleve të reja ekonomike.

Në tetor 2014, PROTIK me mbështetjen e Ministrise së Shtetit për Inovacionin dhe

Adminsitratën Publike filloi programin "Accelerator Star-Up" për t'u ofruar ndihmë biznesve të reja në fushën e Teknologjisë e Informacionit[35]. Projekti parashikonte pjesëmarrjen në këtë program përmes një aplikimi nga individë e biznese që kanë një ide për produkte ose shërbime.

Gjithashtu, një zhvillim i rëndësishëm institucional në dobi të forcimit të ekosistemit të inovacionit ishte krijimi në vitin 2016 i Innovation Hub ,një projekt i Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Adminsitratën Publike në bashkëpunim me Institutin e Universitetit Marin Barleti për Kërkim e Zhvillim, organizatën Partner Albania dhe financuar nga Programi i qeverisë italiane IADSA Italian – Albanian Debt for Development Sëap Program (IADSA). Innovation Hub i bashkëngjitej strukturave e kapaciteteve institucionale që nxisin e lehtësojnë procesin e inovacionit në Shqipërisë përmes bashkëpunimit të sektorit të sipërmarrjes, komunitetit akademik e kërkimor dhe të rinjve apo biznesve të reja që dëshirojnë të zhvillohen në mënyrë inovative.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit dhe Investimeve AIDA dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit AKKSHI si agjenci ekzekutive kanë për detyrë zbatimin e **INSTRUMENTAVE TË FINANCIMIT TË POLITIKAVE TË INOVACIONIT.**

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit dhe Investimeve AIDA, administron një sërë Fondesh Kombëtare të financuar nga fondet publike në dobi të forcimit të kapaciteteve të inovacionit, zhvillimit teknologjik e start up-eve si:

- Fondi i Inovacionit

[33] http://www.protik.org/
[34] http://incubator.al/
[35] http://www.protik.org/success-story/protik-startup-accelerator-program

- Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja "Start-Up
- Fondi i skemës "Voucher[45]

Gjithashtu, Qeveria Shqiptare nëpërmjet miratimit të Dokumentit Strategjik Operacional për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve 2015-2016 përcaktoi për herë të parë fondin "Shqipëria dixhitale" në dobi të mbështetjes së nismave inovative në institucionet publike në nivel qëndror e lokal"[46].

1.1.3 Situata e kuadrit ligjor, institucional dhe financiar në fushën e zhvillimit të transferimit të teknologjisë

Koncepti i transferimit të teknologjisë është ende në fazat fillestare në IAL, institutet apo qendrat kërkimore të Shqipërisë. Një nga treguesit themelorë është vecanërisht niveli i ulët i patentave për shpikje të regjistruar nga shkencëtarët shqiptarë si edhe numri pothuajse inekzistent i kompanive të tipit spin-off apo start up të krijuar prane IAL, instituteve apo qendrat kërkimore në vend. Kjo pasqyrohet në të dhënat e Dokumentit Strategjik për Pronësinë Intelektuale 2016-2020[47].

Nga ana tjetër Shqipëria nuk ka ende një Park Shkencor & Teknologjik sikundër kanë krijuar një pjesë e vendeve të Ballkanit Perëndimor në fusha të veçanta kërkimi pa përmendur vendet

[45]VKM Nr 406 datë 13.05.2015 Për krijimin e Fondit të Inovacionit (Fletore Zyrtare Nr 80, Viti 2015, Faqe 3570) ; VKM Nr 593 , datë 10.09.2014 Për krijimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja "Start-Up" (Fletore Zyrtare Nr 143, Viti 2014, Faqe 6603) , VKM Nr 715 datë 26.08.2015 Për krijimin e skemës "Voucher".(Fletore Nr 154, Viti 2015, Faqe 11135)

[46] Vendim i Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve nr.1, datë 19.01.2015 "Për përcaktimin e drejtimeve prioritare të investimeve dhe miratimin e Dokumentit Strategjik Operacional për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve 2015-2016";
Vendim i Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve Nr 13 datë 25.02.2015 Për shpërndarjen e fondit për programin "Shqipëria dixhitale", thirrja e parë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, Faqe 1619 VKM Nr 226 datë 25.02.2015 Për shpërndarjen e fondit për programin "Shqipëria Dixhitale" (Fletore Zyrtare Nr 41, Viti 2015, Faqe 1837

[47] "....Aplikimet nga Universitetet dhe institucionet kërkimore përbëjnë pak më shumë se 2% të e aplikimeve për patenta në DPPM. Numri i ulët i aplikimeve për patenta nga IAL-te ka mbetur konstant me kalimin e kohës. Universitetet dhe institutet kërkimore të cilat aplikojnë për mbrojtjen e patentave në Shqipëri janë të vendosura kryesisht në vendet e BE dhe SHBA dhe këto aplikime përqendrohen kryesisht në aplikime për patenta farmaceutike dhe kimike. Nuk ka asnjë aplikim për patentë të paraqitur nga universitet apo institute kërkimore shqiptare. Ashtu si IAL-te edhe Institucionet e tjera aktive ne fushen e kerkimit shkencor nuk luajnë asnjë rol në sistemin e patentave shqiptare..." * Strategjia për Pronësinë Intelektuale 2016-2020 (VKM Nr 527 datë 20.07.2016).

tjera[36] që tashmë janë pjesë e Shoqatës Ndërkombëtare e Parqeve Shkencore e Zonave të Inovacionit-(International Association of Science Parks and Areas of Innovation)[49].

Rol të rëndësishëm në këtë proces luan identifikimi dhe mbrojtja e aseteve teknologjike që kanë ardhur si rrjedhojë e kërkimeve shkencore, të cilat përmes Marrëveshjeve të Licensimit përhapen drejt biznesit për t'u shndërruar në produkte apo procese tregu. Në këtë drejtim luan rol parësor kultura e sipërmarrjes dhe lidhja e ngushtë e sektorit të kërkimit shkencor me ekonominë kombëtare e atë ndërkombëtare për të kuptuar nevojat e tregut, kapacitetet kërkimore drejt një specializimi inteligjent në fusha kërkimi ku ka avantazhe konkuruese e për t'i shndërruar ato më pas produkte apo proceseve inovative.

Për këtë arsye, procesi i zhvillimit të teknologjive të reja dhe transferimi i tyre drejt sektorit të biznesit për t'i shndërruar në produkte tregu kërkon struktura e zhvillim të legjislacionit të mbrojtjes së pronësisë intelektuale, përvec kapaciteteve njerëzore e infrastrukturore.

Lidhur me aspeket e mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale, që është element i rëndësishëm në zhvillimin e trasnferimit të teknologjisë drejt biznesit nga IAL-të, institutet apo qendrat kërkimore, ekziston një kuadër ligjor e institucional. Aktualisht në nivel institucional Shqipëria ka Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale si institucion në vartësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, që koordinon, informon e këshillon lidhur me legjislacionin në fushën e pronësisë industriale[37] dhe Drejtorinë e të Drejtës së Autorit në Ministrinë e Kulturës.

Që prej vitit 2001 Shqipëria ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh e konventash ndërkombëtare lidhur me pronësisë industriale e të drejtën e autorit që i bëjnë të mundur komunitetit dhe insitucioneve të kërkimor shkencor dhe biznesit të ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme për të zhvilluar e transferuar teknologji me orientim drejt tregut të tilla si:

Konventa për themelimin e Organizatës Boterore të Pronësisë Intelektuale"(2003); Traktatin e Organizatës Botërore për Pronësinë Intelektuale "Për të Drejtën e Autorit-COPYRIGHT (2001)"; Konventën Universale për të Drejtën e Autorit-COPYRIGHT dhe dy protokollet shtesë (2003); Traktatin e Budapestit për Njohjen Ndërkombëtare të Depozitimit të Mikroorganizmave për qëllime të Procedures se Patentave (2003); Marrëveshjen e Strasburgut për Klasifikimin Ndërkombëtar të Patentave,1979 (2006); Marrëveshja për aderimin e Republikës së Shqiperisë në Konventën Europiane të Patentave (2009); Marrëveshjen për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (ËIPO) për të drejtën e patentave (2009); Marrëveshjen e Londrës për zbatimin e nenit 65 të Konventës për Patentat Evropiane (2013)[38]; Protokolli i Marrevëshjes së Madridit për Regjistrimin Ndërkombëtar të Markave; Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Nicës për Klasifikimin Ndërkombëtar të Mallrave dhe Shërbimeve për Qëllimet e Regjistrimit të Markave; Për aderimin e Republikës

[36] Në shumë vende të zhvilluara dhe vecanërisht në BE, ekipet e Transferimit të Teknologjisë shërbëjnë për të njohur, mbështetur e inkurajuar përhapjen e teknologjive të reja të dala si rrjedhojë e rezultateve të kërkimit shkencor, p.sh. Qendra e Përbashkët e Kërkimeve Shkencore e BE – Joint Research Center JRC's Technology Transfer team luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim (https://ec.europa.eu/jrc/en/research/crosscuttingactivities/intellectual-property/technology-transfer).
Njëkohësisht pranë shumë universiteteve, instituteve apo qendrave kërkimore në Europë e më gjerë funksionojnë Zyrat e Transferimit të Teknologjisë – Technology Transfer Office – TT , të cilat ofrojnë shërbimin e trasnferimit të teknologjisë drejt sektorit të biznesit duke përdor kuadrin ligjor kombëtar e ndërkombëtar të pronësisë intelektuale që lidhet me të drejtat e përdorimit e shitjes së patentave apo shpikejeve të ndryshme nga studiues të ndryshëm, veçanërisht në shkencat e aplikuara. [49] http://ëëë.iasp.ës/

[37] Ligj Nr 9947 datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale" i ndryshuar ; Ligj Nr 35-2016 date 31.03.2016 Për të Drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.

[38] Ligj Nr 8993 datë 30.01.2003 Për Aderimin e Republikës se Shqipërisë në "Konventën për themelimin e Organizatës Boterore të Pronësisë Intelektuale". Ligj Nr 8838 datë 22.11.2001 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e OBPI `Për të Drejtën e Autorit-COPYRIGHT, Ligj Nr 9219 datë 08.09.2003 Për

së Shqipërisë në Aktin e Gjenevës të Marrëveshjes së Hagës për Regjistrimin Ndërkombëtar të Disenjove Industriale dhe rregulloret mbështetur në aktin e Gjenevës, 1999; Për aderimin e Republikës se Shqipërisë në Aktin e Hagës; Për aderimin e Republikës se Shqipërisë në Aktin e Gjenevës të Marrëveshjes së Hagës për Regjistrimin Ndërkombëtar të Disenjove Industriale dhe rregulloret mbështetur në aktin e Gjenevës, 1960[52].

Kuadri aktual ligjor në Shqipëri u mundëson IAL-ve dhe institucioneve kërkimore që të nxisin transferimin e teknologjive drejt biznesit. Që prej vitit 1994 është në fuqi Ligj Nr 7893 datë 22.12.1994 Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik[53]. Ndërkohë përmes miratimit të Urdhri të Ministrit të Arsimit e Sportit, Nr 297 datë 01.06.2016 Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Ligjit të ri për Shkencën e Zhvillimin Teknologjik synohet të përcaktohet një kuadër më i qartë dhe më i plotë ligjor lidhur me nxitj en e bashkëpunimit mes komunitetit akademik e kërkimor e biznesit në dobi të zhvillimit teknologjive të reja.

Nga ana tjetër për ngritjen e zhvillimin e Zonave Ekonomike e Parqeve Industriale, në të cilat mund të ketë një rol të rëndësishëm përfshirja e IAL-ve apo institucioneve kërkimore, që prej vitit 2007 është në fuqi Ligji Nr 9789 datë 19.07.2007 Për krijimin dhe funksionimin e Zonave Ekonomike. Këto Zona Ekonomike parashikoheshin të kishin disa statuse si Statusin e Zonës së Lirë dhe Statusin e Parkut Industrial. Megjithëse që nga viti 2007 janë miratuar disa vendime për dhënie statusi Zonë Ekonomike me status të ndryshëm në Shkodër, Vlorë, Elbasan, Tiranë e Durrës[54], ende nuk ka patur zhvillime të qëndrueshme në këtë drejtim. Në vitin 2015, Qeveria Shqiptare amendoi Ligjin Nr 9789 datë 19.07.2007 Për krijimin dhe funksionimin e Zonave Ekonomike duke parashikuar Statusin e Zonës së Zhvillimit Teknologjik dhe përcaktoi përmes VKM Nr 646 datë 22.07.2015 kriteret për individët apo kompanitë që do të financonin në këtë drejtim[55].

Gjitashtu edhe kuadri ligjor aktual ofron lehtësi për studiuesit e IAL-ve, institucioneve kërkimore shkencore për të regjistruar e mbrojtur të drejtat e tyre të përdorimit për produkte apo risi teknologjike që kanë dalë si rezultat i kërkimeve shkencore. Që prej vitit 2008 është në

aderimin e Republikës së Shiqpërisë në Konventën Universale për të Drejtën e Autorit-COPYRIGHT dhe dy protokollet shtesëLigj Nr 9031 datë 20.03.2003 Pë aderimin e Shqipërisë në Konventën e Patentave Europiane Ligj Nr 10180 datë 29.10.2009 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për të drejtën e patentave të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (ËIPO) Ligj Nr 118-2013 date 23.06.2013 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Londrës për zbatimin e nenit 65 të Konventës Për Patentat Europiane.

[52] Ligj Nr 8992 datë 30.01.2003 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Protokollin e Marrëveshjes së Madridit per Regjistrimin Ndërkombetar të Markave"; Ligj Nr 9033 datë 20.03.2003Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Nicës për Klasifikimin Ndërkombëtar të Mallrave dhe Shërbimeve, për Qëllimet e Regjistrimit te Markave.; Ligj Nr 9647 datë 27.11.2006 Për aderimin e Republikës se Shqipërisë në Aktin e Gjenevës të Marrëveshjes së Hagës për Regjistrimin Ndërkombëtar të Projekteve Industriale dhe rregulloret mbështetur në aktin e Gjenevës,
1999.; Ligj Nr 9647 datë 27.11.2006 Për aderimin e Republikës se Shqipërisë në Aktin e Hagës Për aderimin e Republikës se Shqipërisë në Aktin e Gjenevës të Marrëveshjes së Hagës për Regjistrimin Ndërkombëtar të Projekteve Industriale dhe rregulloret mbështetur në aktin e Gjenevës, 1960.

[53] Ligj Nr 7893 datë 22.12.1994 Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik, Ligj Nr 8401 datë 09.09.1998 Për disa ndryshime në Ligjin Nr 7893 datë 22.12.1994 Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik

[54] VKM Nr 105 datë 09.02.2011 Për shpalljen "Zonë ekonomike me statusin e Parkut Industrial" të një territori në Rrashbull, Durrës; VKM nr.790 datë 22.07.2009 Për shpalljen "Zonë Ekonomike", me statusin "Park industrial" në Laknas, Tiranë ; VKM Nr 262 datë 06.04.2016 Për shpalljen e Zonës së Zhvillimit Teknologjik dhe Ekonomik , Spitallë, Durrës

[55] Ligj Nr 54-2015 datë 28.05.2015 Për disa ndryshime e shtesa në Ligjin nr. 9789 datë 19.07.2007 Për krijimin dhe funksionimin e Zonave Ekonomike ; VKM nr. 646 datë 22.07.2015 Për përcaktimin e procedurave e të kritereve të përzgjedhjes së zhvilluesit në Zonën e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik-ZTZHE

fuqi VKM, Nr 1707 datë 29.12.2008, Për miratimin e rregullores për lëshimin e Patentave për Shpikjet dhe modelet e përdorimit", të ndryshuar[39] e cila ofron lehtësira në procedura, tarifa të ulëta lidhur me patentat për shpikje që dalin nga komuniteti i kërkimit shkencor duke i hapur rrugë më pas transferimit të tyre si teknologji apo produkte të reja drejt sektorit të biznesit[40].

Edhe në fushën e së Drejtës së Autorit apo *COPYRIGHT* pas miratimit të Ligj Nr. 35-2016 date 31.03.2016, Për të Drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to, për kërkuesit shkencorë janë miratur një sërë aktesh nënligjore që lidhen me lehtësimin e mbrojtjes së të drejtës të veprave, ideve e publikimeve të tyre shkencore.[41]

Aktualisht në Shqipëri në nivel institucional të zhvillimit teknologjik funksionojnë 5 Qendra të Tranferimit të Teknologjive Bujqësore – QTTB mbi bazën e shkrirjes së 6 instituteve kërkimore, që funksiononin me pare, në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë e Ushqimit, siç ishin: 1) Instituti i Kërkimeve të Bimëve të Arave, Fushë-Krujë, (IKBA) [42] 2) Instituti i PerimePatateve, Tiranë, (IPP) 3) Institutit të Pemëtarisë, Vlorë, [43](IP);4) Instituti i Kërkimeve Zooteknike, Tiranë, (IKZ); 5) Instituti i Misrit, Shkodër, (IM) [44] 6) Instituti i Studimit të Tokave (IST)[62].

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore – QTTB kanë gati 10 vjet që janë krijuar (2007-2017) por është disi e vështirë të jepen të dhëna të sakta lidhur me zbatimin të konceptit të transferimit të teknologjive bujqësore në sektorin e biznesit bujqësor e agropërpunimit nëpërmjet Marrëveshjeve të Licensimit dhe përdorimi të legjislacionit të pronësisë intelektuale, duke patur parasysh se aktualisht në Shqipëri funksioniojnë afro 400, 000 njësi bujqësore dhe afro 5 000 njësi të sektorit të agropërpunimit

Nga pikëpamja institucionale në IAL-të, qendrat e institucionet kërkimore në Shqipëri aktualisht mungojnë Zyrat e Transferimit të Teknologjive, Pronësisë Intelektuale – ZTTPI të cilat në vende të tjera luajnë një rol të rëndësishëm për këshillimin e ndërgjegjësimin e komuitetit shkencor në lidhje me transferimin ligjor të njohurive e rezultateve të kërkimit shkencor drejt sektorit të biznesit e tregut.

---

[39] VKM Nr 1707 datë 29.12.2008 Për miratimin e rregullores për lëshimin e Patentave për Shpikjet dhe modelet e përdorimit", të ndryshuar

[40] VKM Nr 618 datë 07.00.2011 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1707, datë 29.12.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për lëshimin e Patentave për Shpikjet dhe modelet e përdorimit", të ndryshuar (Fletore Zyrtare Nr 139, Viti 2011, Faqe 6271)

[41] Urdhër Nr 158,datë 21.04.2015 Për licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv për të Drejtat e Autorit-ÀLBAUTOR , VKM Nr 33 datë 18.01.2017 Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit ; VKM Nr 34 datë 18.01.2017 Për procedurat e regjistrimit, të organizimit dhe klasifikimit të veprave të të drejtave të autorit.

[42] Qendra e Transferimit të Teknologjisë –Fushë Krujë u krijua në vitin 2006 nga ristrukturimi i Institutit të Bimëve e Arave (IMO) , Instituti i Kërkimeve Zooteknike (IKZ), Instituti i Studimit të Tokave(IST) përmes VKM Nr 515 datë 19.07.2006 Për ristrukturimin e instituteve kërkimore –shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit

[43] Qendra e Transferimit të Teknologjisë –Vlorë u krijua në vitin 2006 nga ristrukturimi i Institutit të Pemëtarisë(IP) dhe stacionet eksperimentale përkatëse përmes VKM Nr 515 datë 19.07.2006 Për ristrukturimin e instituteve kërkimore –shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit

[44] Qendra e Transferimit të Teknologjisë) u krijua në vitin 2006 nga ristrukturimi i Institutit të Misrit dhe Orizit (IMO) dhe stacionet eksperimentale përkatëse përmes VKM Nr 515 datë 19.07.2006 Për ristrukturimin e instituteve kërkimore –shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit [62] Per me shume shih Aneksin 3.

Ndërkohë ndonëse në bazë të pikës 4 të VKM Nr. 903, datë 26.08.2009 "Për krijimin e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI)" "Fondi për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin (FSHTI)", kishte të parashikuar nën zërin iv) Fondin për transferimin e teknologjisë dhe inovacionin, që nënkuptonte financimin nga Sektori i Teknologjisë e Inovacionit të AKTI-t të Projekteve të Përbashkëta Kërkimore Akadeni-Biznes për transferim teknologjie e produkte innovative, ai nuk u arrit të alokohej përgjatë viteve 20092016.

Aktorët të cilët merrem me inovacion dhe teknologji përfshijnë burimet materiale (fonde, paisje, laboratorë) dhe kapitalet njerëzore (studentët, fakultetet, pedagogët, kërkuesit shkencorë të sektorit të industrisë, etj), strukturat institucionale që marrin pjesë në ekosistemin e inovacionit siç janë IAL-të, bankat, kapitali privat, institutet kërkimore dhe Qendrat e Ekselencës, shoqatata e biznesit, agjencitë financuese dhe politikëbërësit.

Ekosistemi i inovacionit përfshin dy lloje ekonomish të dallueshme e gjerësisht të ndara siç janë ekonomia e dijes që udhëhiqet nga kërkimet e studimet shkencore dhe ekonomia komerciale që udhëhiqet nga tregu**.** Dy mënyrat për të arritur suksesin ekonomik brenda një ekonomie janë rritja e numrit të burimeve në procesin e prodhimit ose mënyra të reja për të marrë më shumë rezultatet me të njëjtat burime. Kjo e fundit është thelbi i inovacionit, i cili karakterizohet nga futja e produkteve të reja apo thellësisht të përmirësuara (mallra ose shërbime), procese, metoda organizative dhe marketing. Në kushtet e ekonomisë së sotme globale inovacioni besohet se është burimi themelor i pasurisë brenda një ekonomie.

Gjatë periudhës 2009-2016 vëmendja kryesore është përqëndruar tek nxitja e iniciativave për ndërgjegjësimin e grupeve të interesit lidhur me konceptin e inovacionit duke u përqëndruar kryesisht në sektorin e ICT, e start-up të reja që e kanë fillesën tek risitë e teknologjive të informacionit. Në kushtet e Shqipërisë përqëndrimi i iniciativave të inovacionit në sektorin e ICT dhe Start Up që lindin prej tyre ka qenë i lidhur me moshën e re të popullsisë shqiptare, shpejtësinë e lehtësinë e transferimit të rezultatit në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar dhe një kërkesë më të pakët për infrastruktura të kushtueshme kërkimi shkencor sesa fushat e tjera për të prodhuar risi teknologjike e produkte inovative. Pjesë e këtyre iniciativave janë fushatat e nismave globale për promovimin e inovacionit e ideve inovative për të transformuar ekonominë[45].

Nxitja koncepteve të inovacionit tek të rinjtë ka qenë një objektiv për të rritur brezin e të rinjve me ide inovative në fusha të ndryshme. Në këtë drejtim mund të përmenden Kampet Rajonale

[45] Element me rëndësi në këtë drejtim ka qenë inkurajimi nga qeveria shqiptare i një sërë nismash e iniciatiavsh për të nxitur kulturën e shpirtin e inovacionit veçanërisht tek të rinjtë në formë sipërmarrjesh të reja Start Up. Në këtë drejtim mund të përmemden Start Up Ëeek End që zhvillohet që prej vitit 2012 si pjesë e një lëvizjes mbarëbotërore ;Start Up-Live Tirana e cila ofron lidhje, burime financiare dhe nxitje për individidët dhe ekipet që shkojnë nga ideja innovative tek biznesi ku idetë e projekteve mbështeten tek teknologjia. Në këto iniciativa një rol të rëndësishëm luajnë IAL-te, ku në kuadër të një projekti Universiteti i Neë Yorkut organizoi për herë të parë në vitin 2015 ADRIATinn Innovation Ëeekends. Aktivitet tjetër promovues që prej vitit 2012 në fushën e inovacionit e ideve të reja innovative është Talent Garden Tirana, që ofron mundësi trajnimi për të gjithë sipërmarrësit e rinj që të aplikojnë në projekte ndërkombëtare që financojnë dhe asistojnë startup-et nga Shqipëria dhe u japing mundësi të bëhen pjesë e tregut ndërkombëtar.,.
Për të nxitur idetë inovative një platformë është Startup Grind Tirana, mundësi e veçantë për të gjithë sipërmarrësit e rinj të cilët mund të takohen dhe njohin profesionistë të fushave të ndryshme, të ndajnë eksperiencat e tyre e shumë të tjera. Komuniteti Startup Grind Tirana përmes takimeve të ndryshme ndan idetë dhe diskutimet e tij me CEO –të e ndryshme si pjesë e . komunitetit global startup-esh mbështetur nga *Google for Enterprenuers* për të edukuar, inspiruar dhe lidhur sipërmarrësit. dhe bashkëpunimin e tyre me botën akademike e kërkimore . Crereative Mornings Tirana, degë lokale e Creative Mornings, krijuar në USA dhe Rrjeti Thing Lab Albania, i menduar si një "laborator i teknologjisë", përbëjnë platforma që synojnë t'u vijnë në ndihmë të rinjve të apasionuar pas teknologjisë dhe studentëve që studiojnë në këtë fushë.`

të Inovacionit[46] të organizuara prej vitit 2013 nga Organizata Junior Achievement Albania. Kampet e inovacionit përbëjnë një qasje të re në edukimin e të rinjve dhe formimin e tyre me mendësitë e inovacionit dhe të sipërmarrëjes. Gjithashtu që prej vitit 2012 organizohet Konkursi Vjetor "Microsoft Imagine Cup Albania" në mbështetje të teknologjisë dhe inovacionit për të shtyrë më tej zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri[47].

Një aktivitet i rëndësishëm në vazhdën e nxitjen së ideve me inovacionit me fokus ICT është Hackathon Albania në vazhdën e e Hackathonëve botërore, një mbledhje e studenteve, profesionistëve, aktivistëve socialë për të shkruar aplikime, dhe botuar analiza duke përdorur të dhënat e hapura.[48] Në këtë kuadër një aktivitet tjetër është Hello Tomorroë Albania[49],një organizatë me qendër në Paris e cila organizon një konkurs dhe konferencë ndërkombëtare për sipërmarrësit e rinj dhe shërben gjithashtu si një "mjet për krijimin e lidhjeve mes shkenctarëve, investitorëve dhe sipërmarrësve" në fushën e teknologjisë.

Nga ana tjetër në kuadër të nxitjes së debatit publik mbi rëndësinë e inovacionit dhe rëndësinë e tij në transformimin e ekonomisë organizohet aktivitete të përvitshme në nivel konferencash e rrjetëzimesh, që prej vitit 2012 zhvillohet në Tiranë ICT Aëards -Albanian Information Technology Aëards Albania[50], i cili është një aktivitet mbarëkombëtar vjetor që ndan çmime për sipërmarrjet e suksesshme, për një periudhë një vjeçare kanë dhënë kontributin e tyre në zhvillimin e inovacionit në Shqipëri, në aspekte të ndryshme.

Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike MIAP, prej vitit 2014[51] organizon Javen e Inovacionit, me qëllim krijimin e një platforme kombëtare diskutimi lidhur me çështjet e zhvillimit të ekosistemit të inovacionit në Shqipëri përmes shkëmbimit të eksperiencave apo modeleve të ndryshme. Gjate kesaj jave zhvillohen aktivitete ku përfshihet komuniteti akademik kërkimor shkencor, ai i biznesit, strukturat publike.

Prej vitit 2009 zhvillohet Infocom Albania[52] një Forum Vjetor që organizohet çdo vit në kryeqytetin shqiptar dhe shërben si një platform për të diskutuar inicitivat më të fundit innovative në Shqipëri. Çdo konferencë është e ndarë në 3 sesione dhe secili sesion i jep mundësi kompanive të telekomunikacionit të flasin rreth inovacionit të tyre, lidhjes dhe produkteve.

Në tërësinë e tyre të gjithë iniciativat e mësipërme qofshin nga institucione publike apo jopublike kanë bërë të mundur nxitjen e iniciativave kombëtare në fushën e zhvillimit të ekosistemit kombëtar të inovacionit, duke krijuar mundësi për start-up e modele të reja biznesi, ne funksion të komunitetit kërkimor i cili përpiqet të marrë rolin e peshën e vet.

II. VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Zbatimi i sukseshëm i Strategjisë së Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit 2017-2022 do të kontribuojë në;

- Standartizimin e sistemit institucional

[46] http://ëëë.junior-albania.org/;http://junior-albania.org/lajmet-e-fundit/kampi-i-1-r%C3%AB-rajonal-iinovacionit-1421/

[47] https://ëëë.facebook.com/Microsoft.Imagine.Cup.Albania?fref=photo

[48] Informacion mbi eventin mund të gjeni duke vizituar Faqen Zyrtare të Institutit Shqiptar të Shkencave http://ais.al dhe rrejte sociale të AIS dhe Open Data Albania. Ky aktivitet zhvillohet nga Instituti Shqiptare i Shkencave AIS në kuadër të Projektit Open Data Albania

[49] http://hello-tomorroë.org/event/hello-tomorroë-challenge-2015-kick-off-event-tirana

[50] http://ictaëards.org/

[51] http://ëëë.akti.gov.al/dokumenta/java_inovacionit.pdf

[52] http://ëëë.infocomalbania.com/

- Orientimin e kërkimit shkencor për të kontribuar në zhvillimin ekonomiko-social.

Strategjia 2017-2022, bazohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në parimet kryesore të zhvillimit të Zonës Europiane të Kërkimit Shkencor.
Strategjia përputhet me Agendën Europiane për Unionin e Inovacionit dhe Strategjinë Rajonale SEE-2020.

Dialogu dinamik ndërmjet strukturave publike dhe jopublike; me Bashkimin Evropian (BE); Agjensitë Ndërkombëtare; vendet e rajonit partnerët, në lidhje me çështjen e kërkimit shkencor, inovacionit dhe teknologjisë; do t'i shërbejë implementimit korrekt të strategjisë 2017-2022.

Vizioni

Gjatë 5 viteve 2017-2022, zhvillimi i Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Republikën e Shqipërisë do të bazohet në:

"Fuqizimi i sistemit kërkimor dhe inovativ për të përballuar me sukses sfidat e zhvillimit aktual dhe prespektiv të vendit si:

rritja e kapaciteteve institucionale dhe ligjore (KSH) për çështjet e sigurisë ushqimore, shëndetit publik, mjedisit, energjisë,shkencat e materialeve, albanalogjisë etj

Politikat

Strategjia e Shkencës Teknologjisë dhe Inovaciont bazohet në katër politika:

A. *Përmirësimi i kuadrit ligjor, institucional dhe financiar në shërbim të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (SHTI)*

B. *Mbështetja e Kërkimit Shkencor për nxitjen e Inovacionit dhe zhvillimin e teknologjisë në bashkëpunim me sektorin e biznesit*

C. *Rritja e ndërgjegjësimit të operatorëve të shoqërisë civile, medias dhe publikut për rolin e Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit në zhvillimin e përgjithshëm të shoqerisë*

D. *Fuqizimi i bashkëpunimit në nivel rajonal, europian dhe global*

Qëllimet Strategjike

1. *Maksimalizimi i rezultateve të kërkimit shkencor,* nëpërmjet përmirësimit të politikave, instrumentave ligjorë, institucionalë dhe financiarë.
2. Forcimi i lidhjeve të bashkëpunimit ndërkufitar e ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor

3. Rritja e investimeve për infrastrukturën e kërkimit shkencor dhe efektivitetit të përdorimit të tyre.
4. Thjeshtëzimi i praktikave që garantojnë treg të hapur për kërkuesit shkencorë vendas dhe të huaj, dhe lehtësim mobiliteti akademik.

5. Promovimi i barazisë gjinore në fushën e SHTI-së

6. Garantimi i aksesit për marrjen e informacionit mbi rezultatet e kërkimit shkencor dhe përdorimi i pakushtëzuar i të dhënave shkencore

7. Rritja e bashkëpunimit mes komunitetit të kërkuesëve shkencorë dhe atij të biznesit

8. Informimi dhe ndërgjegjesimi i publikut dhe institucioneve vendimmarrëse mbi rëndësinë e shkencës, inovacionit dhe teknologjisë

III. OBJEKTIVAT E SHTI-së DHE PRODUKTET MADHORE

Ky kapitull paraqet objektivat kryesore që orientojnë zhvillimin e politikve publike në Republikën e Shqipërisë për SHTI 2017-2022.

A. Përmirësimi i kuadrit ligjor, institucional dhe financiar në shërbim të shkencës, teknologjisë dhe inovacionit (SHTI)

Qëllimi: *Maksimalizimi i rezultateve të kërkimit shkencor, në periudhën 2017 - 2022,* nëpërmjet përmirësimit të politikave, instrumentave ligjorë, institucionalë dhe financiarë, do të realizohet nëpërmjet përmbushjes së objektivave të mëposhtëm:

- **Reformimi i sistemit institucional të kërkimit shkencor**
- **Rritja e investimeve për SHTI bazuar në fondet publike dhe burime të tjera alternative deri në 1% të GDP- 2022**
- **Përfshirja e diasporës shkencore shqiptare në SHTI**
- **Rritja e bashkëpunimit mes komunitetit të kërkimit shkencor dhe biznesit ¯ Monitorimi i cilësisë së kërkimit shkencor**

Objektivi 1: Reformimi i sistemit institucional të kërkimit shkencor

Produkti 1.1- Dokumenti i Politikave të reformimit institucional për Kërkimin Shkencor Aktiviteti 1.1.1 - Përgatitja e draftit të parë nga Grupi i Punës për hartimin e Dokumentit të Politikave Institucionale për Kërkimin Shkencor – Prill 2017
Aktiviteti 1.1.2 - Realizimi i takimeve me grupet e interesit për diskutimin e Dokumentit të Politikave Institucionale për Kërkimin Shkencor – Maj 2017
Aktiviteti 1.1.3 - Miratimi i Dokumentit të Politikave Institucionale për Kërkimin Shkencor – Qershor 2017

Produkti 1.2 Krijimi i Nënkomisionit të përhershëm Parlamentar për Shkencën, Teknologjinë e Inovacionin pranë komisionit të Arsimit
Aktiviteti 1.2.1.- Hartimi i Draft - Propozimit nga MASR drejtuar Konferencës së Kryetarëve, pranë Parlamentit Shqiptar për ngritjen e Nënkomisionit për Shkencën, Teknologjinë e Inovacionin pranë Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit PublikShtator 2017
Aktiviteti 1.2.2- Realizimi i takimeve me grupet parlamentare për ngritjen e Nënkomisionit – Tetor 2017
Aktiviteti 1.2.3 Miratimi nga Konferenca e Kryetarëve e Draft Propozimit të MAS – Nëntor 2017

Produkti 1.3 Krijimi i Këshillit Ndërministror të Politikave të Shkencës, Teknologjisë e Inovacionit
Aktiviteti 1.3.1 - Pjesëmarrja aktive e MASR në takimet e Grupit Ndërministror për zbatimin e Urdhërit të Kryeminsitrit Nr. 10; datë 17.01.2017, për zbatimin e Planit të Veprimit të Qasjes Triple Helix
Aktiviteti 1.3.2 - Zbatimi nga ana e MASR dhe AKKSHI i rekomandimeve të Grupit Ndërministror për zbatimin e Urdhrit të Kryeminsitr Nr. 10, datë 17.01.2017, për zbatimin e Planit të Veprimit të Qasjes Triple Helix

Produkti 1.4 Miratimi i ligjit të ri për Shkencën e Inovacionin
Aktiviteti 1.4.1- Hartimi i draftit të parë nga grupi i punës për hartimin e Projekt-ligjit të ri për Shkencën e Inovacionin Shtator -2017
Aktiviteti 1.4.2 - Realizimi i takimeve me grupet e interesit për diskutimin e Projekt-ligjit të ri për Shkencën e Inovacionin- Nentor- Dhjetor 2017
Aktiviteti 1.4.3 Miratimi në Parlament i ligjit të ri për Shkencën e Inovacionin – Dhjetor 2017

Produkti 1.5 Krijimi i një Strukture Koordinuese Kombëtare për politikat SHTI
Aktiviteti 1.5.1 - Hartimi i studimit të fizibiliteti per ngritjen e Struktures Koordinuese Kombëtare Nëntor- Dhjetor 2017

Aktiviteti 1.5.2- Miratimi me VKM i strukturës, funksioneve dhe buxhetit sipas modelit të përzgjedhur Janar 2018

Produkti 1.6 Hartimi i Studimit të Vizibilitetit për ngritjen e Qendrave të Ekselencës Shkencore / Parkut Shkencor & Teknologjik në fusha prioritare në përputhje me parimin e specializimit inteligjent (smart specialization)
Aktiviteti 1.6.1 Ngritja e grupit të përbashkët të punes me ekspertë nga MAS, AKKSHI, Ministritë e Linjës dhe institucione të tjera që merren me SHTI. Viti 2018
Aktiviteti 1.6.2 Përcaktimi i termave të referencës për asistencë e financim nga donatorë të huaj, lidhur me hartimin e studimit të fizibilitetit viti 2018 Aktiviteti 1.6.3 Hartimi i studimit të fizibilitetit viti 2018
Aktiviteti 1.6.4 Diskutimi me Grupet e Interesit viti 2019
Aktiviteti 1.6.5 Përzgjedhja e modelit
Aktiviteti 1.6.6 Hartimi i Plan-Biznesit dhe financimi i modelit të përzgjedhur viti 2019

Objektivi 2: Rritja e investimeve për SHTI bazuar në fondet publike dhe burime të tjera alternative deri në 1% të GDP- 2022

Produkti 2.1 Financimi i të paktën 60 projekteve kombëtare të kërkimit shkencor në vit nga AKKSHI përmes fondeve kombëtare të Kërkim-Zhvillimit në fushat prioritare të SHTI
Aktiviteti 2.1.1 - Përditësimi dhe miratimi në Bordin e Administrimit të AKKKSHI të rrregulloreve e udhëzimeve për financimin e projekteve prioritare 2017

Aktiviteti 2.1.2 - Hapja e thirrjeve për projektet kombëtare të kërkim –zhvillimit brenda 3 mujorit të parë të çdo vitit Janar-Mars 2018-2022
Aktiviteti 2.1.3 – Përzgjedhja dhe vlerësimi dhe financimi i projekteve kombëtare të kërkimzhvillimit nga AKKSHI Prill- Maj 2018-2022
Aktiviteti 2.1.4 - Hartimi i platformës së aplikimit on-line për projektet kombëtare të kërkimzhvillimit vitit 2019

Produkti 2.2 Përcaktimi i identifikuar me % në buxhetin e IAL nga fondi i përftuar nga AKFAL-i që do të shpenzohen për SHTI
Aktiviteti 2.2.1 Lëvrimi i fondeve për SHTI bazuar në projektet për kërkim shkencor, zhvillim teknologjik dhe inovacion në rang kombetar dhe ndërkombëtar.
Aktivitëti 2.2.2 Hartimi i rregulloreve nga IAL dhe institucioneve te tjera të specializuara të shkencës dhe teknologjisë që përcaktojnë procedurat e aplikimit, afatet dhe mënyrën e lëvrimit të fondeve. Viti 2018
Aktiviteti 2.2.3 IAL-të dhe institucionet e tjera të kërkimit shkencor raportojnë të paktën një herë në vit në lidhje me përdorim e fondeve të lëvruara në SHTI viti 2018-2022

Objektivi 3: Përfshirja e diasporës shkencore shqiptare në SHTI

Produkti 3.1- Krijimi i Bazës Kombëtare të Dhënave AlbScience -Diaspora (ALBSDI)
Aktiviteti 3.1.1 - Ngritja e një Grupi Pune ndërministror në drejtimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për hartimin dhe koordinimin e procesi - Mars 2018
Aktiviteti 3.1.2 - Krijimi i një platforme on-line me vetëdeklarim në bazë të fushave të Manualit të Frascatit ku mund të regjistrohen kërkues dhe studiues nga diaspora Maj 2018
Aktiviteti 3.1.3- Prezantimi i platformës me të dhënat e mbledhura në një konferencë me përfaqësues të disporës Tetor -2018
Aktiviteti 3.1.4 Përfshirja e përfaqësuesëve të diasporës SHTI, në SKK dhe strukturat institucionale kombëtare të kërkimit shkencor viti 2018-2022

Produkti 3.2 - Krijimi i Skemës së Bursës: “Studiuesi Vizitor i Diasporës” - Visiting Diaspora Scholar Felloëship
Aktiviteti 3.2.1 - Ngritja e grupit shumëpalësh të punës për hartimin e modelit të Skemës së Bursës, kritereve, dhe udhëzimit – Janar “Janar 2019
Aktiviteti 3.2.2 - Hapja e thirrjeve të para për aplikim nga studuesit shqiptare të diasporës viti 2019
Aktiviteti 3.2.3 - Përzgjedhja, vlerësimi i aplikimeve për skemës së bursës “Studiuesi Vizitor i Diasporës” - Visiting Diaspora Scholar Felloëship viti 2019

Objektivi 4: Rritja e bashkëpunimit mes komunitetit të kërkimit shkencor dhe biznesit 2017-2022

Produkti 4.1 - Lëvrimi i granteve të përbashkëta komuniteti i kërkusëve shkencor – biznes përmes Fondit të Teknologjisë e Inovacionit të AKKSHI
Aktiviteti 4.1.1 - Përgatitja dhe miratimi në Bordin e Administrimit të AKKSHI të rregulloreve, udhëzimeve si dhe e materialeve teknike për format e aplikimit për grantet, viti 2017-2018
Aktiviteti 4.1.2 - Hapja e thirrjes së parë për aplikimin Grante të Përbashkëta komuniteti i kërkusëve shkencor – biznes përmes Fondit të Teknologjisë e Inovacionit të AKKSHI, viti 2018-2019
Aktiviteti 4.1.3 - Përzgjedhja, vlerësimi dhe financimi i projekteve të para fituese viti 20192020

Produkti 4.2 – Zyrat e projekteve pranë IAL të profilizuara dhe institutet kërkimore shkencore jashtë IAL-ve, në bashkëpunim më DPPI mbulojnë edhe aktivitete mbi transferimin e teknologjisë e inovacionit, informimit të Pronësisë Industriale dhe Intelektuale.

Aktiviteti 4.2.1 Hartimi i marrëveshjeve të përbashkëta bashkëpunimi mes DPPI, IAL dhe instituteve kërkimore jashtë IAL-ve për ngritjen dhe funksionimin e strukturave të informimit pranë tyre
Aktiviteti 4.2.2 Bashkëpunimi dhe përfshirja në projekte të përbashkëta midis DPPI, IAL dhe instituteve kërkimore jashtë IAL-ve për ngritjen strukturave të informimit.
Aktiviteti 4.2.3 Zhvillimi i projekteve të përbashkëta të AKKSHI, DPPI dhe AIDA për ndërgjegjësim dhe asistencë teknike në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, IAL në lidhje me pronësinë industriale, intelektuale

Produkti 4.3 - Udhëzimi për mbledhjen dhe matjen e të dhënave në nivel kombëtar për financimin e SHTI, në përputhje me indikatorët ndërkombëtarë, që përcaktojnë këtë procedurë.
Aktiviteti 4.3.1 Hartimi i Udhëzimi të Përbashkët mes MASR , MFE dhe INSTAT për Mbledhjen dhe matjen e të dhënave për financimin e SHTI në nivel kombëtar në përputhje me indikatorëve ndërkombëtarë viti 2018
Aktiviteti 4.3.2 Publikimi i Udhëzimit të Përbashkët mes MASR , MFE e INSTAT, shqip dhe në gjuhë të huaj viti 2018.
Aktiviteti 4.3.3. Organizimi i trajnimit nga INSTAT me personat në institucionet publike përgjegjës për metodologjine e mbledhjes dhe matjen e treguesve financiarë në lidhje me SHTI (viti 2018)
Aktivitet 4.3.4. Bashkëpunimi me ekspertë të huaj për trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve në rang kombëtar për mbledhjen dhe matjen e të dhënave.
Aktiviteti 4.3.5. Përfshirja në Buletinin Vjetor të Statistikave të INSTAT edhe të dhënave për treguesit financiarë që lidhen me SHTI: (R&D Albania) (të dhënat do të maten çdo dy vjet)

Produkti 4.4 Hartimi dhe zbatimi një projekti pilot Innovation Albania me finacimin e fondeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë
Aktiviteti 4.4.1. Ngritja e grupit të përbashkët pune me ekspertë nga MASR, AKKSHI, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Turizmit dhe Mjedisit, Infrastrukturës dhe Energjisë, ASH, IAL, Institutet kërkimore jashtë IAL-ve, me qëllim përcaktimin e termave të referencës dhe fushave prioritare. Dhjetor 2017
Aktiviteti 4.4.2 Përcaktimi i termave të referencës për asitencë e financim nga donatorë të huaj lidhur me hartimin e projektit në bazë të eksperiencës ndërkombëtare. 2018
Aktiviteti 4.4.3 Organizimi i tryezave me donatorë të huaj për projektin pilot Innovation Albania dhe mundësitë e gjetjes së burimeve financiare viti 2018
Aktiviteti 4.4.4. Ngritja e fondeve dhe financimi i projektit viti 2018

Produkti 4.5 Hartimi i Udhëzimit të përbashkët mes MAS, MF dhe institucioneve homologe për kriteret e bashkëpunimit mes IAL, institucionet kërkimore shkencore jashtë IAL-ve dhe biznesit.
Aktiviteti 4.5.1 Hartimi i draft – Udhëzimit viti 2017
Aktiviteti 4.5.2 Diskutimi i draft udhëzimit me IAL-të, Institutet dhe shoqatat e biznesit viti 2017
Aktiviteti 4.5.3 Miratimi i Udhëzimit viti 2017

Produkti 4.4 Hartimi i studimit në nivel kombëtar ”Innovation Gap Analysi in Albania”-
IGAIA në bazë të indikatorëve ndërkombëtare të inovacionit
Aktiviteti 4.4.1 Ngritja e Grupit të Përbashkët Pune me ekspertë nga MASR, AKKSHI,

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Turizmit dhe Mjedisit, Infrastrukturës dhe Energjisë, ASH, DPPI, IAL, instituteve kërkimore jashtë IAL-ve
Aktiviteti 4.4.2 - Hartimi i termave të referencës për asitencë e financim nga donatorë të huaj lidhur me hartimin e studimit
Aktiviteti 4.4.3 - Diskutimi i rezulateve të studimit me Grupet e Interesit

Objektivi 5. Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor

Produkti 5.1 Miratimi i metodologjisë së vlerësimit të kërkimit shkencor në nivel kombëtar
Aktiviteti 5.1.1. Ngritja e Grupit të Punës për Standartet Akademike e Kërkimit Shkencor nga ana e MASR, viti 2017.
Aktiviteti 5.1.2. Organizimi i aktiviteteve kombëtare mbi prezantimin e modeleve të vlerësimit të kërkimit shkencor të vendeve me eksperienca të përafërta. Viti 2017-2022
Aktiviteti 5.1.3. Përgatitja e draft-metodologjisë së vlerësimit të kërkimit shkencor në nivel kombëtar bazuar në modele ndërkombëtare – 2017.
Aktiviteti 5.1.4. Diskutimi i draft-metodologjisë me IAL dhe institucionet kërkimore shkencore jashtë IAL-ve, 2017.
Aktiviteti 5.1.5. Miratimi nga Këshilli i Ministrave i metodologjisë së vlerësimit të kërkimit shkencor në nivel kombëtar 2017.

Produkti 5.2 Hartimi dhe miratimi i Udhëzimit nga MASR për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Revistave dhe Periodikëve Shkencorë në Republikën e Shqipërisë
Aktiviteti 5.2.1 Hartimi nga MASR dhe AKKSHI i draft-udhëzimit mbi përcaktimin e kritereve që duhet të plotësojnë revistat dhe periodikët shkencorë për t'u regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Republikës së Shqipërisë. Dhjetor 2017.
Aktiviteti 5.2.2 Diskutimi i draft-udhëzimit me grupet e interesit dhe ekspertë të huaj 2018 Aktiviteti 5.2.3. Miratimi i Udhëzimit nga MAS viti 2018.

Produkti 5.3 Krijimi i Platformës (on-line) të të dhënave për kërkimin shkencor në RSH, në lidhje me kapacitetet njerëzore, infrastrukturore, biblioteka & arkiva,(Albanian Research Information System- ARIS)
Aktiviteti 5.3.1. Ngritja e grupit të punës me ekspertë nga MASR, AKKSHI, RASH, INSTAT, IAL dhe institutet kërkimore jashtë IAL-ve 2017
Aktiviteti 5.3.2. Përcaktimi i moduleve dhe përmbajtjes së tyre, 2017
Aktiviteti 5.3.3 Diskutimi me grupet e interesit në lidhje përmbajtjen e platformës dhe aksesimi i saj, 2017
Aktiviteti 5.3.4 Përzgjedhja e personave të kontaktit në çdo IAL dhe institut kërkimor jashtë IAL-ve , përgjegjës për përditësimin e të dhënave individuale dhe institucionale, 2017
Aktiviteti 5.3.5 Vënia e platformës në funksionim 2017
Aktivitet 5.3.6 Vlerësimi një herë në dy vjet i hedhjes së të dhënave 2019/2022

Qellimi: Rritja e investimeve për infrastrukturën e kërkimit shkencor dhe efektivitetit të përdorimit të tyre, do të realizohet nëpërmjet përmbushjes së objektivit:

- **Vlerësimi dhe përmirësimi i infrastrukturës kombëtare të kërkimit shkencor për çështjet e sigurisë ushqimore, shëndetit publik, mjedisit, energjisë, shkencat e materialeve, ICT, albanalogjisë**

Objektivi: Vlerësimi dhe përmirësimi i infrastruktures kombëtare të kërkimit shkencor *për çështjet e sigurisë ushqimore, shëndetit publik, mjedisit, energjisë, shkencat e materialeve, ICT, albanalogjisë*

Produkti 1.1 Krijimi i Hartës Kombëtare të infrastukturës së Kërkimit Shkencor në Shqipëri në përputhje me ESFRI (European Strategic Frameëork of Research Infrastructure)
Aktiviteti 1.1.1 Ngritja e grupit të pune nga MASR për krijimin e hartës të infrastukturës së Kërkimit Shkencor në Shqipëri, 2017
Aktiviteti 1.1.2 Vlerësimi derë më derë `- "door to door" i infrastrukturës së kërkimit shkencor në vend, Janar- Mars 2018
Aktiviteti 1.1.3 Krijimi i hartës kombëtare off-line e on-line të infrastukturës së Kërkimit Shkencor në Shqipëri
Aktiviteti 1.1.4 Publikimi hartës kombëtare off-line e on-line të infrastukturës së Kërkimit Shkencor në Shqipëri

Produkti 1.2 Hartimi i Plani kombëtar të investimeve për infrastrukturë e kërkimit
Aktiviteti 1.2.1 Evidentimi dhe vlerësimi i nevojave të institucioneve kërkimore dhe IAL për infrastruktura të reja të kërkimit shkencor Shtator 2018
Aktiviteti 1.2.2 Miratimi i planit te investimeve me VKM - Mars 2019

Produkti 1.3 Financimi i akreditimit i 10 laboratorëve të kërkimit shkencor në të institute kërkimore e IAL viti 2018-2022

Aktiviteti 1.3.1 Përzgjedhja e 10 laboratorëve të kërkimit shkencor në fushat, *siguria ushqimore, shëndeti publik, mjedisi, energjia, shkencat e materiale, ICT, albanalogjia*

Aktiviteti 1.3.2 Fillimi i procedurave të akreditimit

Aktiviteti 1.3.3 Përfundimi dhe akreditimi i laboratorëve

Produkti 1.4 Përmirësimi i rrjetit të bibliotekave dhe arkivave shkencore në nivel IAL dhe institucionesh kërkimore jashtë IAL –ve 2017-2022
Aktiviteti 1.4.1 Hartimi i metodologjise vlerësuese për gjendjen e bibliotekave dhe arkivave shkencorë në nivel kombëtar në nivel IAL dhe institucionesh kërkimore jashtë IAL-ve.
Aktiviteti 1.4.2 Planifikimi i financimit të përmirësimit të infrastrukturës fizike, koleksionit të librave dhe dokumentave në të paktën 4 bibliotekat dhe arkivat shtetrorë (bujqësi, mjedisit, albanalogji, energji).
Aktiviteti 1.4.3 Hartimi i planit të dixhitalizimit i bibliotekave dhe arkivave shkencore në nivel IAL dhe institucionesh kërkimore
Aktiviteti 1.4.4 Pilotimi dhe përfundimi i dixhitalizimit në të paktën 2 biblioteka dhe 2 arkiva shkencore.

Produkti 1.5 Përfundimi i procedurave për ngritjen dhe funksionimin e Qëndrës së Studimeve Biomarine, Vlorë në bashkëpunim më Bashkimin Europian.
Aktivitetet 1.5.1 Përcaktimi i godinës në qytetin e Vlorës.

Aktiviteti 1.5.2 Përshtatja infrastrukturore për kryerjen e funksionit si Qëndër e Studimeve Biomarine. Aktiviteti 1.5.3 Nënshkrimi i një marrëveshje bashkëpunimi dhe partneriteti me institucionet akademike vendase për funksionimin e Qëndrës së Studimeve Biomarine. Aktiviteti 1.5.4 Vënia në funksionim e Qëndrës së Studimeve Biomarine.

Qëllimi; Thjeshtëzimi i praktikave që garantojnë treg të hapur për kërkuesit shkencorë vendas dhe të huaj, dhe lehtësim mobiliteti akademik, do të realizohet nëpërmjet përmnushjes së objektivave :

- **Përmirësimi i praktikave të rekrutimit të stafeve akademike e kërkimore shkencore**
- **Rishikimi i kuadrit ligjor kombëtar që garanton lëvizjen e kërkuesve të huaj, nëpërmjet botimi të guidës së mobilitetit akademik.**

Objektivi 1. Përmirësimi i praktikave të rekrutimit të stafeve akademike e kërkimore shkencore

Produkti 1.1. Publikimi në portalin Euraxess-Albania i të gjithë vendeve të hapura të punës në institucionet akademike e kërkimore shqiptare 2017-2022
Aktiviteti 1.1.1 Hartimi Udhëzimit të MASR për IAL-të dhe institutet kërkimore jashtë IALve, për detyrimin e publikimit të vendeve të lira të punës për stafet akademike e kërkimore në të gjitha nivelet.
Aktiviteti 1.1.2 Përgatitja e Udhëzimi nga MASR për caktimin e Pikës Kombëtare të Kontaktit të Euraxess në të gjitha IAL–të e institutetet kërkimore jashtë IAL-ve, e bizneset që kanë departamente K & ZH
Aktiviteti 1.1.3 Organizimi i INFO DAY vjetore për Rrjetin Euraxess nga AKKSHI në IAL , institutetet kërkimore jashtë IAL-ve, biznese dhe shoqërinë civile
Aktiviteti 1.1.4 Nënshkrimi i Kartës dhe Kodit të Studiuesit nga të gjithë IAL –të dhe institutet kërkimore jashtë IAL-ve
Aktiviteti 1.1.5 Organizimi i 10 trajnimeve nga AKKSHI për të marrë HR4 Excellecnce **Objektivi 2. Rishikimi i kuadrit ligjor kombëtar që garanton lëvizjen e lirë për qëndrimin e kërkuesve të huaj në institucionet akademike dhe kërkimore shqiptare**

Produkti 2.1 Botimi i guidës së mobilitetit për studiuesit e kërkuesit e huaj 2017-2018 Aktiviteti 2.1.1 Ngritja grupit ndër institucional me përfaqësues nga Ministritë e linjës për rishikimin e legjislacionit vendas mbi mobilitetin akademik të studiuesve të huaj
Aktiviteti 2.1.2 Përgatitja e një pakete ndryshimesh ligjore në përputhje me udhëzimet e direktivat e Komisionit Europian për mobilitetin akademik e studiuesve të vendeve të tjera
Aktiviteti 2.1.3 Botimi i një Guide të Mobilitetit për Studiuesit e Kërkuesit e Huaj në anglisht në version të shtypur e on-line e botimin e saj në faqen Euraxess-Albania

Qëllimi: Promovimi i barazisë gjinore në fushën e SHTI-së, do të realizohet nëpërmjet përmbushjes së objektivave:

- Rritja me 30% deri në vitin 2022 e drejtuesve femra në pozicionet, akademike e kërkimore, të IAL dhe qendrave kërkimore jashte IAL-ve.
- Rritja me 30% deri në vitin 2022 e financimit të projekteve kombëtare të kërkim zhvillimit, qe drejtohen nga kërkuese femra dhe doktoraturave të fushave prioritare të kërkimit.

Objektivi 1. Rritja me 30 % deri në vitin 2022 e drejtuesve femra në pozicionet drejtuese akademike e kërkimore, të IAL -ve dhe qendrave kërkimore jashte IAL-ve.

Produkti 1.1 Botimi i Raportit Vjetor Gender in Science –GIS

Aktiviteti 1.1.1 Hartimi i metodologjisë për mbledhjen e të dhënave, "Gender in Science" në MASR ne bashkëpunim me INSTAT

Aktiviteti 1.1.2 Hartimi i Udhëzimit nga MASR për caktimin e koordinatorit të barazisë gjinore në nivel IAL, institutive kërkimore jashtë IAL-ve.

Aktiviteti 1.1.3 Botimi i raportit vjetor "Gender in Science".

Objektivi 2. Rritja me 30 % e financimit të projekteve kombëtare të kërkim zhvillimit që drejtohen nga kërkuese femra dhe Doktoraturave të fushave prioritare të kërkimit, (deri ne vitin 2022

Produkti 2.1 Financimi i projekteve kombëtare të kërkim-zhvillimit si dhe jo më pak se 5 Doktoratura Kombëtare me aplikante femra.

Aktiviteti 2.1.1 Rishikimi i Udhëzimeve e Rregulloreve të financimit nga AKKSHI për t'i përshtatur me parimin e kuotës gjinore

Aktiviteti 2.1.2 Botimi i Udhëzimeve & Rregulloreve on-line

Aktiviteti 2.1.3 Promovimi i projekteve dhe doktoratureve Best ëomen in Science-BËS

Aktiviteti 2.1.4 Shpallja çdo vit e institucionit kërkimor shkencor e akademik, kampion në mbështetjen e grave në shkencë "Champion Ëomen Promotion in Science".

Aktiviteti 2.1.5 Shpallja e çmimit të Karrierës të Gruas Shkencëtare dhe çmimit të Kërkueseve të Reja.

Qellimi: Garantimi i aksesit për marrjen e informacionit mbi rezultatet e kërkimit shkencor dhe përdorimi i pakushtëzuar i të dhënave shkencore, do të realizohet nëpërmjet përmbushjes së objektivit:

- **Garantimit të aksesit të hapur on-line për të gjitha botimet shkencore të financuara me fonde publike**

Objektivi 1. Garantimi i aksesit të hapur on-line për të gjitha botimet shkencore të financuara me fonde publike 2022

Produkti 1.1 Krijimi i Bazës së të dhënave të Doktoraturave dhe Projekteve Kombëtare të Kërkim – Zhvillimit nga AKKSHI

Aktiviteti 1.1.1 Hartimi i një Udhëzuesi nga AKKSHI, për krijimin e Bazës së të dhënave të Doktoraturave dhe Projekteve Kombëtare të Kërkim-Zhvillimit

Aktiviteti 1.1.2 Realizimi i një Marrëveshje Bashkëpunimi mes Bibliotekës Kombëtare e AKKSHI për transferimin e të dhënave bibliografike për titujt e doktoraturave në BK. Aktiviteti 1.1.3 Krijimi i një platforme on-line për hedhjen e të dhënave dhe përcaktimi i kalendarit dhe kostos të hedhjes së të dhënave.

Aktiviteti 1.1.4 Aksesi i hapur në platformën on-line të Bazës së të dhënave të Doktoraturave dhe Projekteve Kombëtare të Kërkim- Zhvillimit nga AKKSHI.

Produkti 1.2 Dixhitalizimi i koleksioneve të revistave e periodikëve shkencorë në gjuhën shqipe

Aktiviteti 1.2.1 Përcaktimi nga AKKSHI i listës kombëtare të revistave e periodikëve shkencorë në gjuhën shqipe.

Aktiviteti 1.2.2 Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimi mes Bibliotekës Kombëtare dhe AKKSHI-t për dixhitalizimin e revistave.
Aktiviteti 1.2.3. Krijimi i një platforme on-line (depository) për të siguruar akses të hapur në koleksionin e revistave dhe periodikëve shkencorë të dixhitalizuar.

Produkti 1.3 Krijimi i katalogut bibliografik on-line të bazës së të dhënave AlbaDatanet dhe AlbResearchPublications.Net me titujt e të gjithë botimeve shkencore në albanologji e shkencat e tjera
Aktiviteti 1.3.1 Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimi mes Bibliotekës Kombëtare dhe bibliotekave shkencore të IAL, institucionet e kërkimit jashtë IAL-ve e AKKSHI-t për trasferimin e të dhënave bibliografike për titujt botimeve albanologjike brenda e jashtë vendit.
Aktiviteti 1.3.2 Krijimi i një platforme on-line në bashkëpunim me RASH për hedhjen e të dhënave, përcaktimin e kalendarit dhe kostostove të hedhjes së të dhënave.
Aktiviteti 1.3.4 Sigurimi i aksesit të hapur në platformën on-line të bazës së të dhënave AlbaDatanet dhe AlbResearch Publications.Net me titujt e të gjithë botimeve shkencore në albanologji e shkencat e tjera.
Aktiviteti1.3.5 Përzgjedhja nga baza e të dhënave AlbaDatanet dhe AlbResearchPublications. Net me titujt e të gjithë botimeve shkencore në albanologji e shkencat e tjera, titujt që do të dixhitalizohen.

Produkti 1. 4 Krijimi i portalit Alb Info Science-AIS dhe Alb Science Memorial Days-ASMEDA
Aktiviteti 1.4.1 Hartimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimi me Qendrën e Studimeve Enciploedike pranë ASH dhe Drejtorinë e Përgjithshem të Arkivave për mbledhjen e të dhënave
Aktiviteti 1.4.2: Përcatimi i kalendarit vjetor të Alb Science Memorial Days ASMEDA me ngjarjet e datat kryesore që përkujtojnë individë, institucione apo kontribute të rëndësishme të shkencës shqiptare ndër vite
Aktiviteti 1.4.3. Realizimi i aktivitetit kombëtar ”Dita e Shkencës”, me një tematikë të caktuar të përvitshme

B. Mbështetja e Kërkimit Shkencor për nxitjen e Inovacionit dhe zhvillimin e teknologjisë në bashkëpunim me sektorin e biznesit

Qëllimi: Rritja e bashkëpunimit mes komunitetit të kërkuesëve shkencorë dhe atij të biznesit do të realizohet nëpërmjet përmbushjes së objektivave të mëposhtëm:

- **Krijimi i mekanizmave nxitës ligjorë, fiskalë për financimin e kërkimit shkencor nga biznesi**
- **Rritja e pjesëmarrjes së biznesit në inisiativa dhe programe rajonale**
- **Nxitja e biznesit për krijimin e Sipërmarrjeve të Reja (Start-Up) në Inovacion dhe teknologji**
- **Mbështetje për zhvillimin e Inovacionit dhe TIK për bizneset e vogla dhe të mesme, si një formë bashkërendimi edhe me objektivat e “Axhendes Dixhitale të Shqipërisë 2015-2020”**

Objektivi 1: Krijimi i mekanizmave nxitës ligjorë, fiskalë për financimin e kërkimit shkencor nga biznesi.

Produkti 1.1 Rishikimi i Ligjit Nr 7982 date 21.12.1994 “ Për Sponsorizimet”për vendosjen e mekanizmave nxitës fiskalë të biznesit për financimin e kërkimit shkencor

Aktiviteti 1.1.1 Ngritja e grupit të punës për vlerësimin e analizën e ligjit "Për Sponsorizimet"
Aktiviteti 1.1.2 Propozimi i ndryshimeve ligjore lidhur me ligjin "Për Sponsorizimet"
Aktiviteti 1.1.3 Diskutimi me grupet e interesit të propozimeve te ndryshime Aktiviteti
1.1.4 Miratimi në Parlament i ndryshimeve ligjore

Produkti 2. Rishikimi i ligjit Nr. 92/2014 date 24.07.2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" për përjashtime specifike (përjashtime nga taksat dhe TVSH mbi pjesën e investuar në shkencë)
Aktiviteti 1.2.1 Ngritja e grupit të punës për vlerësimin e analizën e kuadrit ligjor "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar"
Aktiviteti 1.2.2 Propozimi i ndryshimeve ligjore lidhur me ligjin "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar"
Aktiviteti 1.2.3. Diskutimi me grupet e interesit
Aktiviteti 1.2.4. Miratimi në Parlament i ndryshimeve ligjore

Objektiv 2. Rritja e pjesëmarrjes së biznesit në inisiativa dhe programe rajonale si: (SEECEL (Qendra e Evropës Juglindore për të Mësuarit e Sipërmarrjes), EIF (Fondi Evropian i Investimeve), COSME (Program i BE-së për Konkurrueshmërinë e Sipërmarrjeve dhe për Sipërmarrjet e Vogla dhe të Mesme), HORIZON 2020 (Programi Kuadër i BE-së për Kërkime dhe Novacione), EDIF (Instrumenti i Zhvillimit të Sipërmarrjes dhe Novacionit, ENIF (Fondi i Novacionit të Sipërmarrjes), ENEF (Fondi i Zgjerimit të Sipërmarrjes), IPA (Instrumenti i Ndihmës përpara Antarësimit) në BE).

Produkti 1. Rritja me 10% në vit e bizneseve, të cilat përfitojnë nga fondet e programeve rajonale
Aktiviteti 1.1.1 Informimi i bizneseve (SME-ve) për programet rajonale nga AIDA
Aktiviteti 1.1.2 Trajnimi i përfaqësuesëve të biznesit në hartimin e projekt propozimeve për programet rajonale.
Aktiviteti 1.1.3 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit IAL, biznes, AKKSHI për projekte të përbashkëta sipas sektorëve prioritar të kërkim-zhvillimit.

Objektivi 3: Nxitja e biznesit për krijimin e Sipërmarrjeve të Reja (Start-Up) në Inovacion dhe teknologji
Produkti 1. Mbështetje financiare dhe këshillim për 20 sipërmarrje të reja (start-up)
Aktiviteti 1.1.1 Mbështetje nga skema e granteve për bizneset– AIDA
Aktiviteti 1.1.2 Organizimi i trajnimeve për zhvillimin e aftësive, shërbimeve të teknologjisë shërbimeve të zgjerimit të prodhimeve- AIDA

C.Rritja e ndërgjegjësimit të operatorëve të shoqërisë civile, medias dhe publikut për rolin e Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit në zhvillimin e përgjithshëm të shoqerisë

Qëllimi: Informimi dhe ndërgjegjesimi i publikut dhe institucioneve vendimmarrëse mbi rëndësinë e shkencës, inovacionit dhe teknologjisë, do të realizohet nëpërmjet përmbushjes së objektivave të mëposhtëm:

- **Përmirësimi i kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse që kryejnë aktivitete kërkimore**
- **Rritja e mbështetjes financiare, institucionale për kërkim zhvillimin në sektorin e shoqërisë civile**

- **Rritja e ndërgjegjësimi në shoqërinë shqiptare për rolin e dobinë e kërkimit shkencor si aktivitet publik**

Objektivi 1: Përmirësimi i kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse që kryejnë aktivitete kërkimore

Produkti 1: Rishikimi i ligjit për organizatat jofitimprurëse
Aktiviteti 1.1.1 Vlerësimi e analiza e kuadrit ligjor për organizatat e shoqërisë civile me status OJF-je që kryejn aktivitete me objekt kërkimin shkencor.
Aktiviteti 1.1. 2 Propozimi i ndryshimeve ligjore lidhur me statusin e këtyre OJF-ve
Aktiviteti 1.1.3 Diskutimi me grupet e interesit të ndryshimeve të propozuara
Aktiviteti 1.1. 4 Miratimi në Parlament i ndryshimit të ligjit për shoqërinë civile

Objektivi 2. Rritja e mbështetjes financiare, institucionale për kërkim zhvillimin në sektorin e shoqërisë civile

Produkti 1: Mbështetje financiar në masën 30% nga fondet publike të dhëna për shoqërinë civile në funksion të kërkim zhvillimit.
Aktiviteti 1.1.1: Përcaktimi i një kuote prej 10% në fondet e PKKZH-së për kërkimin shkencor nga institutet/qendrat kërkimore shkencore me status organizatash joqeveritare.
Aktiviteti 1.1.2 Financim në masën 20% nga fondet totale të Agjensisë së Mbështetjes së Shoqërisë Civile (AMSHC) për aktivitetet e kërkimit shkencor të qendrave kërkimore dhe organizatave të shoqërisë civile.
Produkti 2 . Krijimi i bazës së të dhënave për studimet e kryera nga organizatat e shoqërisë civile kombëtare ndërkombëtare.
Aktivitet 1.2.1 Evidentimi i organizatave të shoqërisë civile kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat kanë kryer studime që pas vitit 1990
Aktiviteti1.2.2 Krijimi i nje sistemi online për arshivimin e studimeve të kryera nga organizatave të shoqërisë civile kombëtare dhe ndërkombëtare

Objektivi 3. Rritja e ndërgjegjësimit në shoqërinë shqiptare për rolin e dobinë e kërkimit shkencor si aktivitet publik

Produkti 1. Realizimi i programeve në Tv për promovimin e shkencës tek moshat e reja
Aktiviteti 1.1.1 Përcaktimi i Termave të Referencës për realizimin e TV
Aktiviteti 1.1.2. Miratimi i Marrëveshje Bashkëpunimi me 3 TV kombëtare për për promovimin e shkencës tek të rinjtë
Aktiviteti 1.1.3. Zhvillimi i emisioneve TV Shoë-Science Factor

Produkti 2. Realizimi i Ciklit Dokumentar (shqip- anglisht) Një histori e shkencës shqiptare
Aktiviteti 1.2.1 Përcaktimi i Termave të Referencës për realizimin e Ciklit Dokumentar (shqipanglisht) "Një histori e shkencës shqiptare"
Aktiviteti 1.2.2 Hartimi i një Marrëveshje Bashkëpunimi me Arkivin Kombëtar të Filmit dhe RTSH Cikli Dokumentar (shqip-anglisht) "Një histori e shkencës shqiptare"
Aktiviteti 1.2.3. Hartimi i një Marrëveshje Bashkëpunimi me 3 TV kombëtare për t'a shfaqur Ciklin e Dokumentarëve "Një histori e shkencës shqiptare"

Produkti 3. Realizimi i trajnimeve për punonjës të administratës publike lidhur me përdorimin e të dhënave shkencore në politikbërje (pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA)

Aktiviteti 1.3.1 Përcaktimi i Termave të Referencës për realizimin e kurrikulës për kërkimin shkencor teknologjinë dhe inovacionin
Aktiviteti 1.3.2 Hartimi i planit të veprimit për përcaktimin e institucioneve dhe afateve kohore për zhvillimin e trajnimit
Aktiviteti 1.3.4 Zhvillimi i trajnimit

D. Fuqizimi i bashkëpunimit në nivel rajonal, europian dhe global

Qëllimi: Forcimi i lidhjeve të bashkëpunimit ndërkufitar e ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor, do të realizohet nëpërmjet përmbushjes së objektivave të mëposhtëm:

- **Rritja e financimit deri në 20% krahësuar me pesë vitet e fundit, në projektet e bashkëpunimit ndërkufitar e ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor**
- **Rritja e pjesëmarrjes dhe projekteve fituese deri në 20%, krahasuar me vitin 2014 Programin Kombëtar të Kërkimit Shkencor e Inovacionit H2020**

- **Pjesëmarrja aktive dhe angazhimi institucional në iniciativat Open Science të Komisionit Europian dhe Grupin e Punës Open Science të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal**

Objektivi 1: **Rritja e financimit deri në 20% krahësuar me pesë vitet e fundit, në projektet e bashkëpunimit ndërkufitar e ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor**

Produkti1.1 Mbështetja nga MASR nëpërmjet AKKSHI jo më pak se gjashtë marrëveshjeve të bashkëpunimit shkencor dypalëshe dhe shumëpalëshe me vendet e rajonit dhe më gjerë.
Aktiviteti 1.1.1 Rivlerësimi i statusit të marrëveshjeve dyplaëshe dhe shumëpalëshe të bashkëpunimit shkencor. viti 2017
Aktiviteti 1.1.2 Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit shkencor dypalësh dhe shumëpalësh 2017-2022

Produkti 1.2 Pjesëmarrje në Qendrën Rajonale të Kërkimit Shkencor e Inovacionit –ËISE (Split Kroaci)
Aktiviteti 1.2.1 Planifikimi nga MASR i detyrimeve financiare vjetore për pjesëmarrje në ËISE. Viti 2017 -2022
Aktiviteti1.2.2 Realizimi i takimeve promovuese të përvitshme mbi funksionimin bashkëpunimin me Qendrën Rajonale të Kërkimit Shkencor e Inovacionit-ËISE

Objektivi 2: Rritja e pjesëmarrjes dhe projekteve fituese deri në 20%, krahasuar me vitin 2014 për Programin Kombëtar të Kërkimit Shkencor e Inovacionit H2020

Produkti 2.1 Dyfishimi i numrit të projekteve të fituara "Programi H2020" nga komuniteti i kërkimit shkencor
Aktiviteti 2.1.1 Fuqizimi i Rrjetit të Pikave Kombëtare të Kontaktit-NCP të H2020 duke i kaluar si strukturë pranë AKKSHI
Aktiviteti 2.1.2 Ngritja e një Komiteti të Përbashkët Koordinues mes Programeve H2020, Erasmus e COSME për ndërgjegjësimin e apliknatëve nga sektori i kërkimit shkencor e SME
Aktiviteti 2.1.3 Hartimi i Udhëzimi të Përbashkët mes MASR dhe MFE për nxitjen e IAL publike e instituteteve kërkimore publike për pjesëmarrje në H2020.

Objektivi 3 Pjesëmarrje aktive dhe angazhimi institucional në iniciativat Open Science të Komisionit Europian dhe Grupin e Punës Open Science të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal

Produkti 3.1 Caktimi i "Open Science Contact Point" në Shqipëri dhe raportimi në Komisionin Europian për Open Science
Aktiviteti 1.3.1 Hartimi i Udhëzimit nga MASR për Open Science Contact Point
Aktivititeti 3.1.2. Realizimi i aktiviteteve promovuese për Open Science në IAL e institucionet kërkimore jashte IAL-ve.
Aktiviteti 3.1.3 Pjesëmarrja në Takimet Vjetore të Open Science

IV. BURIMET FINANCIARE

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e masave të SHTI-së 2017-2022 është rreth 9.1 miliard lekë, fondet jane alokuar nga:

a) Buxheti i shtetit per institucionet publike (Ministritë e Linjës (ML) dhe institutucionet kërkimore jashtë IAL-ve), në shumen prej 3.3 miliard lekë.
b) Buxheti IAL–ve, në shumën rreth 2.2 miliard lekë.
c) Buxheti nga donatorët në shumën rreth 1 miliard lekë.

Buxheti i alokuar për zbatimin e SHTI-së për periudhën 2017-2022, sipas institucioneve të mësipërme, është rreth 6.5 miliard lekë. Paraqitet hendek në financim në masen rreth 2.5 miliardë lekë, fond i cili duhet të planifikohet në Programin e Buxhetit Afatmesëm (PBA) nga institucionet buxhetore për zbatimin e SHTI 2017-2022.
Planifikimi i fondeve ne kete forme synon te arrije objektivin e parashikuar qe shpenzimet per kerkimin shkencore te arrijne në 1% të PBB.

Burimet financiare të përcaktuara nga ML-të dhe institucionet sipas programeve buxhetore për kërkimin shkencor, mbulojnë rreth 51% të kostos së përllogaritur si pjesë e planit të veprimit për SHTI 2017-2022. Nevojat për fonde për periudhën 2019-2020 janë programuar në përputhje me kuotat tavan të projektbuxhetit.
Burimet financiare nga donatorët mbulojnë rreth 15% të kostos së SHTI 2017-2022. Burimet finaciare nga IAL-të mbulojnë rreth 34% të kostos së SHTI 2017-2022.

Kostimi i planit të veprimit për zbatimin e SHTI-së 2017-2022, është realizuar bazuar në metodologjinë dhe praktikën e planifikimit buxhetor, më konkretisht duke konsideruar shpenzimet e projekteve të trupëzuara në produkte dhe ato jashtë projekteve. Një metodologji e tillë është në përputhje me sistemin e planifikimit buxhetor në Republikën e Shqipërisë sikurse parashikohet në ligjin organik të buxhetit.

Buxhetimi i planit të veprimit të SHTI-së është mbështetur në elementët si më poshtë vijon:

- Kostot për zbatimin e SHTI 2017-2022 konsiderohen shpenzimet kapitale dhe korrente
  - Kostot e financuara nga IAL-te dhe donatorët janë konsideruar si shpenzime kapitale.
- Buxheti i SHTI-së është parashikuar brenda rritjes ekonomike të parashikuar sipas kuadrit makro-ekonomik.

Tabela 1 : Buxheti i nevojshëm "Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022"

	Kostimi I aktivitet/ produkte / objektiva ne 000/ leke

	(Buxheti i nevojshem per realizimi e Politikes A: në lekë) 7,874,450	**Politika A :Përmirësimi i kuadrit ligjor, institucional dhe financiar në shërbim të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (SHTI)**				
Qëllimi	**Objektivi**	**Buxheti i nevojshëm (Lekë)**	**Buxheti i shtetit i planifikuar**	**Buxheti I IAL- ve Publike dhe Private, Institucione të tjera kerkimore shkencore.**	**Donatorë (Lekë)**	**Hendeku Finaciar/ objektiva të pambuluara me fonde (Lekë)**
Totali i buxhetit Qëllimit 1		**4,128,450**	**1,538,950**	**1,309,400**	**50,000**	**1,230,100**
Qëllimi 1: Maksimalizimi i rezultateve të kërkimit shkencor, nëpërmjet përmirësimit të politikave, instrumentave ligjorë, institucionalë dhe financiarë	**Objektivi 1: Reformimi i sistemit institucional të kërkimit shkencor**	**17,950**	10,150	3,600		4,200
	Objektivi 2, Rritja e investimeve për SHTI bazuar në fondet publike dhe burime të tjera alternative deri në 1% të GDP	**2,630,000**	1,000,000	880,000	50,000	700,000

	Objektivi 3: Përfshirja e diasporës shkencore shqiptare në SHTI	**520,000**	210,000	110,000	-	200,000
	Objektivi 4: Rritja e bashkëpunimit mes komunitetit të kërkimit shkencor dhe biznesit	**957,500**	318,000	315,000	-	**324,500**
	Objektivi 5. Monitorimi i cilësisë së kërkimit shkencor	**3,000**	800	800		1,400
Qellimi 2: Rritja e investimeve për infrastrukturën e kërkimit shkencor dhe efektivitetit të përdorimit të tyre	**Objektivi: Vlerësimi dhe përmirësimi i infrastruktures kombëtare të kërkimit shkencor *për çështjet e sigurisë ushqimore, shëndetit publik, mjedisit, energjisë, shkencat e materiale***	2,990,000	1,100,000	550,000	700,000	640,000

	ve, IC T, albanalogjisë					
Totali i buxhetit Qëllimit 3		**116,300**	**32,200**	**28,100**		**56,000**
Qëllimi 3: Thjeshtëzimi i praktikave që garantojnë treg të hapur për kërkuesit shkencorë vendas dhe të huaj, dhe lehtësim mobiliteti akademik	**Objektivi 1. Përmirësimi i praktikave të rekrutimit të stafeve akademike e kërkimore shkencore**	**20,300**	8,200	4,100		8,000
	Objektivi 2. Rishikimi i kuadrit ligjor kombëtar që garanton lëvizjen e lirë për qëndrimin e kërkuesve të huaj në institucionet akademike dhe kërkimore shqiptare	**96,000**	24,000	24,000		48,000
Totali i buxhetit Qëlimit 4		**600,300**	120,300	120,000		360,000

	Objektivi 1. Rritja me 30 % deri në vitin 2022 e drejtuesve femra në pozicione drejtuese akademike e kërkimore, të IAL -ve dhe qendrave kërkimore jashte IAL-ve	**300**	300			
Qëllimi 4: Promovimi i barazisë gjinore në fushën e SHTI-së	**Objektivi 2. Rritja me 30 % e financimit të projektve kombëtare të kërkimit zhvillimit që drejtohen nga kërkuese femra dhe Doktoraturave të fushave prioritare të kërkimit,**	**600,000**	120,000	120,000		360,000
Qellimi 5 : Garanti	**Objektivi 1. Garanti**	39,400	9,200	15,000		15,200

	mi i aksesit për marrjen e	**mi i aksesit të hapur on-line për të gjitha**					
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	
	[illegible]	[illegible]					
[illegible]	[illegible]	[illegible]					
	[illegible]	[illegible]					

	Objektivi 3: Nxitja e biznesit për krijimin e Sipërmarrjeve të Reja (Start-Up) në Inovacion dhe teknologji	**19,200**	3,200	16,000	
	(Buxheti i novojshem per realizimin e Politikes C: në lekë)18,000	**Politika C. Rritja e udërgjegjësimit të operatorëve të shoqërisë civile, medias dhe publikut për rolin e Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë**			
Qëllimi 3: Informimi dhe udërgjegjesimi i publikut dhe institucioneve vendim marrëse mbi rëndësinë e shkencës, inovacionit dhe teknologjisë	**Objektivi 1: Përmirësimi i kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse që kryejnë aktivitete kërkimore**	-			
	Objektivi 2. Rritja e mbështetjes financiare, institucionale për kërkim zhvillimin në sektorin e	-	-		
		-	-		

	shoqërisë civile				
	Objektivi 3. Rritja e ndërgjegjësimi në shoqërinë shqiptare për rolin e dobinë e kërkimit shkencor si aktivitet publik	**18,000**	18,000		
	(Buxheti i nevojshëm per realizimi e Politikes D: në lekë) 1,018,400	**Politika D. Fuq izimi i bashkëpunimit në nivel rajonal, europian dhe global**			
Qëllimi: Forcimi i lidhjeve të bashkëpunimit ndërkufitar e ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor	**Objektivi 1: Rritja e financimit deri në 20% krahësuar me pesëvitet e fundit, në projektet e bashkëpunimit ndërkufitar e**	**107,400**	42,000	1,400	36,000

	ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor				
	Objektivi 2: Rritja e pjesëmarrjes dhe projektve e fituese deri në 20%, krahasuar me vitin 2014 për Programin Kombëtar të Kërkimit Shkencore Inovacionit H2020	**905,000**	430,000	45,000	215,000
	Objektivi 3 Pjesëmarrje aktive dhe angazhimi institucional në iniciativat Open Science t				

	ë Komision it Europian dhe Grupin e Punës Open Science të Këshillit të Bashk ëpunimit Rajonal	**6,000**	1,800	1,800	

PLANI I VEPRIMIT 2017 - 2022 **MATRICA E PËRPUTHSHMËRISË SË PRIORITETEVE STRATEGJIKE ME PLANIFIKIMIN BUXHETOR AFATMESËM & DEKLARATA E POLITIKAVE TË PROGRAMEVE**								
Politika	**Qëllimi**	**Objektivi**	**Ministria/ Ministritë**	**Programet buxhetore**	**Deklarata e programeve buxhetore**	**Buxheti i parashikuar në strategji**	**Buxheti i parashikuar në programin buxhetor 20172020**	**Perqindja e buxhetit ndaj totalitet buxhetit të strategjise**

Politika **A. Përmirësimi i kuadrit ligjor, institucional dhe financiar në shërbim të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (SHTI)**	*Maksimalizimi i rezultateve të kërkimit shkencor,* nëpërmjet përmirësimit të politikave, instrumentave ligjorë, institucionalë dhe financiarë	**Objektivi 1: Reformimi i sistemit institucional të kërkimit shkencor**	**MASR/ KM**	**Fonde per shkencen**	**Synimi kryesor politik i programit është që sistemi i kërkimit shkencor t'i përgjigjet me besim të lartë sfidave të së ardhmes si çështjeve të mjedisit, mungesës së burimeve, cështjeve të shëndetit publik, të kohesionit social si dhe drejt zhvillimeve globale dhe integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Programi synon zgjerimin dhe rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor në Shqipëri, për të arritur në raportin 7 kërkues për cdo 1000 të punësuar në vitin 2020. Integrimi i kërkimin shkencor shqiptar në Hapësirën Evropiane të Kërkimit (ERA) numri i aplikimeve nga programet bilaterale dhe Programin Horizon 2020 të rritet me 10% në vit, dhe orientuar kërkimin shkencor kah**	1,600	**1,600**	0.02%

					nevojave të tregut nëpërmjet forcimit të lidhjeve të Programeve Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë me biznesin privat.			
			MASR	**Fonde per shkence n**	**Synimi kryesor politik i programit është që sistemi i kërkimit shkencor t'i përgjigjet me besim të lartë sfidave të së ardhmes si çështjeve të mjedisit, mungesës së burimeve, cështjeve të shëndetit publik, të kohesionit social si dhe drejt zhvillimeve globale dhe integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Programi synon zgjerimin dhe rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor në Shqipëri, për të arritur në raportin 7 kërkues për cdo 1000 të punësuar në vitin 2020. Integrimi i kërkimin shkencor shqiptar në Hapësirën Evropiane të Kërkimit (ERA) numri i aplikimeve nga programet bilaterale dhe Programin Horizon 2020 të rritet me 10% në vit, dhe orientuar kërkimin shkencor kah nevojave të tregut nëpërmjet forcimit të lidhjeve të Programeve Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë me biznesin privat.**	4,500	**300,800**	0.05%
			MASR/Parlamenti	**Fonde per shkence n**		1,200	1,200	0.01%
			MASR	**Fonde per shkence n**		2,250	2,250	0.02%

		MASR/ AKKSHI	**a)Fonde per shkencë n b) Arsimi i Lartë**	**Arsimi i larte:** Sigurimi i cilësisë në AL në nivel institucional e të programeve të studimit sipas kritereve e standardeve ndërkombëtare të HEAL-it në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Rritja e transparencës dhe krijimi i mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënies në kuadrin e luftës ndaj korrupsionit. Ofrimi i kurrikulave universitare konform nevojave të tregut të punës. Krijimi i mekanizmave mbështetës dhe promovues të pjesmarrjes në projekte kërkimore ndërkombëtare përmes promovimit akademik. Rritja e dimensionit social në AL. Sigurimi i kualifikimit të vazhdueshëm profesional bazuar në konceptin e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Internacionalizim i AL dhe ritja e mobilitetit	8,400	7,200	0.09%
	Objektivi 2, Rritja e investimeve për SHTI bazuar në fondet publike dhe burime të tjera alternative deri në 1% të GDP	**AKKSHI**	**Fonde per shkencen**	**Synimi kryesor politik i programit është që sistemi i kërkimit shkencor t'i përgjigjet me besim të lartë sfidave të së ardhmes si çështjeve të mjedisit, mungesës së burimeve, çështjeve të shëndetit publik, të kohesionit social si dhe drejt zhvillimeve globale dhe integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Programi synon zgjerimin dhe rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor në Shqipëri, për të arritur në raportin 7 kërkues për cdo 1000 të punësuar në vitin 2020. Integrimi i kërkimin shkencor shqiptar në Hapësirën Evropiane të Kërkimit (ERA) numri i aplikimeve nga programet bilaterale dhe Programin Horizon 2020 të rritet me**	2,400,000	1,700,000	26.45%

				10% në vit, dhe orientuar kërkimin shkencor kah nevojave të tregut nëpërmjet forcimit të lidhjeve të Programeve Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë me biznesin privat.			
		AKKSHI/ IAL	**a)Fonde per shkence n b) Arsimi i Larte**		230,000	230,000	2.53%
	Objektivi 3: Përfshirja e diasporës shkencore shqiptare në SHTI	**Ministria për Evropën dhe Punët Jashtme /MASR**	**a)Fonde per shkence n b) Arsimi i Larte**	**Arsimi i larte:** Sigurimi i cilësisë në AL në nivel institucional e të programeve të studimit sipas kritereve e standardeve ndërkombëtare të HEAL-it në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Rritja e transparencës dhe krijimi i mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënies në kuadrin e luftës ndaj korrupsionit. Ofrimi i kurrikulave universitare konform nevojave të tregut të punës. Krijimi i mekanizmave mbështetës dhe promovues të pjesmarrjes në projekte kërkimore ndërkombëtare përmes promovimit akademik. Rritja e dimensionit social në AL. Sigurimi i kualifikimit të vazhdueshëm profesional bazuar në konceptin e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Internacionalizim i AL dhe rritja e mobilitetit	20,000	20,000	0.22%
		MASR	**a)Fonde per shkence n b) Arsimi i Larte**		500,000	300,000	5.51%

		AKKSHI			900,000	600,000	9.92%
	Objektivi 4: Ritja e bashkëpunimit mes komunitetit të kërkimi shkencor dhe biznesit	DPPI/ IAL/AKKSHI/AIDA/Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	a)Fonde per shkencë n b) Arsimi i Lartë c)Mbesh tetje për Zhvillim Ekonom ik	Ritja e financimit të SME-ve nëpërmjet fondeve dhe programeve me kontribution e qeverisë dhe donatorëve, krijimi i instrumentave dhe programeve mbështetëse për sektorët prodhues të SME-ve.	60,000	30,000	0.66%
		MASR/ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	a)Fonde per shkence n b) Arsimi i Larte c)Mbesh tetje per Zhvillim Ekonom ik		6,000	2,000	0.07%
		MASR/AKKSHI/ ML	a)Fonde per shkence n b) Arsimi i Larte c)Mbesh tetje per Zhvillim Ekonom ik		1,500	1,500	0.02%
	Objektivi 5. Vlerësimi i cilësisë së kërkimi t	MASR	Fonde per shkence n		3,000	1,600	0.03%

		shkencor						
	Qëllimi 2: Kritja e investimeve për infrastrukturën e kërkimit shkencor dhe efektivitetit të përdorimit të tyre	Objektivi 1, Vlerësimi dhe përmirësimi i infrastruktures kombëtare të kërkimit shkencor *për çështjet e sigurisë ushqimore, shëndetit publik, mjedisit, energjisë, shkencat e materialeve, ICT, albanalogjisë*	MASR	Fonde per shkencen		50,000	10,000	0.55%
			MASR	Fonde per shkencen		1,000,000	600,000	11.02%
			MASR	Fonde per shkencen		600,000	600,000	6.61%
			MASR	Fonde per shkencen		1,340,000	1,140,000	14.77%
	Qëllimi 3: Thjeshtërimi i praktikave që garnetojnë treg të hapur për kërkuesit shkencorë vendas	Objektivi 1, Përmirësimi i praktikave të rekrutimit të stafeve akademike e kërkimore shkencore	MASR	Fonde per shkencen		20,300	12,300	0.22%

	dhe të huaj, dhe lëvizshmërinë akademik	Objektivi 2. Rishikimi i kuadrit ligjor kombëtar që garanton lëvizjen e lirë për qëndrimin e kërkuesve të huaj në institucionet akademike dhe kërkimore shqiptare	AKKSHI	Fonde per shkencen		96,000	48,000	1.06%
	Qëllimi 4: Promovimi i bashkëpunimeve në fushën e SHTI-së	Objektivi 1. Rritja me 30 % deri në vitin 2022 e drejtuesve femra në pozicione drejtuese akademike e kërkimore, të IAL -ve dhe qendrave kërkimore jashtë IAL-ve	AKKSHI	Fonde per shkencen		300	300	0.00%

		Objektivi 2. Rritja me 30 % e financimit të projekteve kombëtare të kërkimzhvillimit që drejtohen nga kërkuesë femra dhe Doktoraturave të fushave prioritare të kërkimit.	AKKSHI	Fonde për shkencën		600,000	240,000	6.61%
	Qëllimi 5: Garantimi i aksesit për marrjen e informacionit mbi rezultatet e kërkimit shkencor dhe përdorimi i pakushtëzuar i të dhënave shkencore	Objektivi 1. Garantimi i aksesit të hapur on-line për të gjitha botimet shkencore të financuara me fonde publike	AKKSHI	Fonde për shkencën		20,000	10,000	0.22%
			AKKSHI	Fonde për shkencën		10,000	4,800	0.11%
			RASH/AKKSHI	Fonde për shkencën		6,000	6,000	0.07%
			MASR	Fonde për shkencën		3,400	3,400	0.04%

Politika B. Mbështetja e Kërkimit Shkencor për nxitjen e Inovacionit dhe zhvillimin e teknologjisë në bashkëpunim me sektorin e biznesit	**Qëllimi 1: Rritja e bashkëpunimit mes komunitetit të kërkuesëve shkencorë dhe atij të biznesit**	**Objektivi 1: Krijimi i mekanizmave nxitës ligjor, fiskalë për financimin e kërkimit shkencor nga biznesi**	**MFE/MASR**			-		0.00%
			MFE/MASR	**Fonde per shkencen**		1,500	1,500	0.02%
		Objektivi 2. Rritja e pjesëmarrjes së biznesit në inisiativa dhe programe rajonale	**AKKSHI/IAL/AIDA**	**a)Fonde për shkencën b) Arsimi i Lartë c)Mbështetje për Zhvillim Ekonomik**		132,000	132,000	1.45%
		Objektivi 3: Nxitja e biznesit për krijimin e Sipërmarrjeve të Reja (Start-Up) në Inovacion dhe teknologji	**AIDA**	**Mbeshtetje për Zhvillim Ekonomik**		19,200	19,200	0.21%

Politika C. Rritja e ndërgjegjësimit të operatorëve të shoqërisë civile, medias dhe publikut për rolin e Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit në zhvillimin e përgjithshëm të shoqerisë	**Qëllimi 1: Informimi dhe ndërgjegjesimi i publikut dhe institucioneve vendim marrëse mbi rëndësinë e shkencës, inovacionit dhe teknologjisë**	**Objektivi 1: Përmirësimi i kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse që kryejnë aktivitete kërkimore**	**AMSHC**	**AMSHC**		-		0.00%
		Objektivi 2. Rritja e ndërgjegjësimi në shoqëri në shqiptare për rolin e dobinë e kërkimit shkencor si aktivitet publik	**MASR**	**Fonde per shkencen**		18,000	18,000	0.20%
Politika D. Fuqizi	**Qëllimi: Forcimi i lidhjeve të**	**Objektivi 1: Rritja e financimit deri**	**MASR**	**Fonde per shkencen**		100,000	72,000	1.10%

mi i bashkëpunimit në nivel rajonal, europian dhe global	**bashkëpunimit ndërkufitar e ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor**	**në 20% krahësuar me pesë vitet e fundit, në projektet e bashkëpunimit ndërkufitar e ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor**		**Fonde per shkencen**		7,400	7,400	0.08%

		Objektivi 2: Rritja e pjesëmarrjes dhe projekteve fituese deri në 20%, krahasuar me vitin 2014 për Programin Kombëtar të Kërkimit Shkencor e Inovacionit H2020	**MASR**	**Fonde per shkencen**		905,000	690,000	9.97%
		Objektivi 3 Pjesëmarrje aktive dhe angazhimi institucional në iniciativ						

		at Open Science të Komisionit Europian dhe Grupin e Punës Open Science të Këshillit të Bash	**MASR**	**Fonde per shkencen**		6,000	3,600	0.07%
		këpunimit Rajonal						

V. LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022, është pjesë integrale e Sistemin e Planfikimit të Integruar (SPI) dhe mekanizmave të Programit të Buxhetit Afatmesëm (PBA). Strategjia SHTI –së 2017-2022, do të vlerësohet mbi bazën e realizimit të qëllimeve, objektivave të saj si dhe zbatimit të planit të veprimit.

Vlerësimi analitik i situatës do të kryhet cdo vit dhe do të ndjekë ecurinë e arritjes së qëllimeve dhe objektivave të strategjisë 2017-2022. Analiza do të nxjerrë në pah realizimin në terma sasiorë të produkteve të parashikuara, si dhe shkaqet kryesore të mosrealizimit të tyre.

Raportimi vjetor. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, do të zbatojë sistemin e monitorimit për strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Monitorimi dhe vlerësimi i indikatorëve të strategjisë do të mbështetet në :

- analizën e indikatorëve të aktiviteteve, pjesë e planit të veprimit, aneksit nr 1,bashkëlidhur
- analizën e indikatorëve të SHTI, pjesë e aneksit nr 2, bashkëlidhur

Në këtë kuadër, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, do të hartojë raportin vjetor të strategjisë 2017-2022, për realizimin e politikave, qëllimeve, objektivave bazuar në hapat si më poshtë vijon:

- Monitorohen indikatorët e përcaktuar në strategji, në bashkëpunim me INSTAT, IAL, ministritë e linjës, Institucionet jashtë IAL-ve.
- Rekomandohen ndryshime duke patur në konsideratë procesin e analizës së riskut për secilin objektiv, aktivitet

- Sigurohen konsultime me IAL-të, institucionet jashtë IAL-ve,grupet e interesit, donatorët etj

V.1 Mënyra e raportimit dhe e konsultimit të raporteve të monitorimit

Njësia përgjegjëse në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila do të hartojë raportet e progresit për ecurinë e strategjisë duhet: (1) të kryejë vlerësimin e progresit në lidhje me zbatimin e strategjisë 2017-2022; (2) të përdorë informacione të tjera statistikore për të analizuar zhvillimet afatgjata dhe ta krahasojnë Shqipërinë me vendet e tjera të rajonit; dhe (3) të evidentojnë problematikat më të rëndësishme në procesin e arritjes së objektivave kombëtare afatgjata për Shkencen, Teknologjinë dhe Inovacionin në vend.

Instrumenti kryesor i monitorimit, Raporti Vjetor i Monitorimit të Strategjisë do të hartohet dhe miratohet brenda muajit Maj të çdo viti duke nisur nga Maj 2018. Dokumenti do të prezantohet në Njësinë e Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik në Departamentin e Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj në Këshillin e Ministrave.

Prezantimi i raporteve vjetore mund të kombinohet me një konferencë vjetore midis Qeverisë dhe partnerëve të zhvillimit apo me një tryezë të rrumbullakët me të njejtët.

Strukturat e vlerësimit dhe monitorimit

Mekanizmi institucional për monitorimin e kësaj strategjie përbëhet nga struktura monitoruese, Grupi Ndërinstitucional i Punës.

Grupi Ndërinstitucional i Punës i ngarkuar për mbikqyrjen dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë 2017-2022, do të ngrihet me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe do të ketë përfaqësues nga MASR, Ministitë e linjës, IAL, Institucione jashtë IAL-ve.

Detyrat dhe procedurat e vlerësimit e raportimit do të përcaktohen nga MASR në bashkëpunim me Njësinë e Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik në Departamentin e Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj në Këshillin e Ministrave.

	MATRICA PËR ÇDO PRIORITET STRATEGJIK & INDIKATORET				
NR	**Indikatori**	**Bazamenti**	**Afati i realizimit**	**Synimi 2017-2022**	**Burimi i verifikimit**
Politika A :Për mirësimi i kuadrit ligjor, institucional dhe financiar në shërbim të (SHTI)					
a.1	**100% e sistemit institucional dhe ligjor i hartuar dhe vene ne zbatim**		**2019**	100%	**Raportet e vlerësimit të qeverisë**

a.2	**Rritja e investimeve për SHTI bazuar në fondet publike dhe burime të tjera alternative deri në 1% të GDP**		**2022**	100%	**Raportet e vlerësimit të qeverisë- Programi i Buxhetit Afatmesem (PBA)**
a.3	**Rritja me 20% e përfshirja e diasporës shkencore shqiptare në SHTI**		**2022**	100%	**Raportet e vlerësimit të qeverisë**
a.4	**Rritja e bashkëpunimit mes komunitetit të kërkimit shkencor dhe biznesit**		**Në vazhdim**	**Trend rritës**	**Raportet e vlerësimit Qeverisë , donatorë ve, biznesit (INSTAT një here në dy vjet)**
a.5	**Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor**		**Në vazhdim**	**Trend rritës**	**Raportet e vlerësimit të qeverisë**
a.6	**Vlerësimi dhe përmirësimi i infrastruktures kombëtare të kërkimit shkencor *për 10 labrator***		**2022**	**Trend rritës**	**Raportet e vlerësimit të qeverisë- Programi i Buxhetit Afatmesem (PBA)**
a.7	**Përmirësimi i praktikave të rekrutimit të stafeve akademike e kërkimore shkencore**		**2019**	**Trend rritës**	**Raportet e vlerësimit të qeverisë**
a.8	**30 % e drejtuesve femra në pozicioneve drejtuese akademike e kërkimore, të IAL -ve dhe qendrave kërkimore jashte IAL-ve**		**2022**	**Trend rritës**	**Raportet e vlerësimit të qeverisë (IAL-te, institucionet jashtë IAL-ve)**

a.9	**30 % e financimit për projekte kombëtare të kërkim zhvillimit që drejtohen nga kërkuese femra dhe Doktoraturave të fushave prioritare të kërkimit**		**2022**	**Trend rritës**	**Raportet e vlerësimit të qeverisë (AKKSHI)**
a.10	**Garantimi i aksesit të hapur online për të gjitha botimet shkencore të financuara me fonde publike**		**2019**	**100%**	**Raportet e vlerësimit të qeverisë**
Politika B. Mbështetja e Kërkimit Shkencor për nxitjen e Inovacionit dhe zhvillimin e teknologjisë në bashkëpunim me sektorin e biznesit					
b.1	**Rritja e pjesëmarrjes së biznesit në inisiativa dhe programe rajonale**		**Në vazhdim**	**Trend rritës**	**Raportet e vlerësimit të qeverisë**
b.2	**Nxitja e biznesit për krijimin e Sipërmarrjeve të Reja (Start-Up) në Inovacion dhe teknologji**		**Në vazhdim**	**Trend rritës**	**Raportet e vlerësimit të qeverisë**
Politika C. Rritja e ndërgjegjësimit të operatorëve të shoqërisë civile, medias dhe publikut për rolin e ShTI ne shoqëri					
c.1	**Rritja e mbështetjes financiare, institucionale për kërkim zhvillimin në sektorin e shoqërisë civile**		**Në vazhdim**	**Trend rritës**	**Raportet e vlerësimit të qeverisë**

Politika D. Politika D. Fuqizimi i bashkëpunimit në nivel					
rajonal, europian dhe global					
d.1	**Rritja e financimit deri në 20% krahësuar me pesë vitet e fundit, në projektet e bashkëpunimit ndërkufitar e ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor**		2022	**Trend rritës**	**Raportet e vlerësimit të qeverisë**
d.2	**Rritja e pjesëmarrjes dhe projekteve fituese deri në 20%, krahësuar me vitin 2014 për Programin Kombëtar të Kërkimit Shkencor e Inovacionit H2020**		2022	**Trend rritës**	**Raportet e vlerësimit të qeverisë**
d.3	**Pjesëmarrje aktive dhe angazhimi institucional në iniciativat Open Science të Komisionit Europian dhe Grupin e Punës Open Science të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal**		**Në vazhdim**	**Trend rritës**	**Raportet e vlerësimit të qeverisë**

Aneksi 1 Kostimi *në 000 lekë*

Qëllimi	Objektivi	Aktiviteti				Afati kohor/ per implementimi ne MASRes	Kosto totale	Fonde nga Buxheti i shtetit	Te ardhurate IAL , Publike dhe Private, Institucione te tjera kerkimore shkencore.	Fonde te Donatorëve	Hendeku Finaciar/ Aktivitete / produkte/ objektiva te pambuluara	Njësitë përgjegjëse per implementimin e mases	Produktet që parashikohen të realizohen në synim të qëllimeve të parashikuara	*Sqarime*
1. Maksimalizimi i rezultateve të kërkimit shkencor, nëpërmjet përmirësimit të politikave, instrumentave ligjorë, institucionalë dhe financiarë	**Objektivi 1: Reformimi i sistemit institucional të kërkimit shkencor**	Aktiviteti 1.1.1 - Përgatitja e draftit të parë nga Grupi i Punës për hartimin e Dokumentit të Politikave Institucionale për Kërkimin Shkencor	Aktiviteti 1.1.2 - Realizimi i takimeve me grupet e interesit për diskutimin e Dokumentit të Politikave Institucionale për Kërkimin Shkencor	Aktiviteti 1.1.3 - Miratimi në KM i Dokumentit të Politikave Institucionale për Kërkimin Shkencor		2017	**1,600**	1,600				MASR/KM	Produkti 1.1- Dokumenti i Politikave të reformimit institucional për Kërkimin Shkencor	*Jane parashikuar dy deri ne tre konferenca per te diskutuar kete strategji me pjesemarjen e 80-100 akademike, pedagoge, shkencetare etj*
		Aktiviteti 1.2.1.- Hartimi i një Draft - Propozimi nga MASR, drejtuar Parlamentit Shqiptar për ngritjen e Nënkomisionit për Shkencën, Teknologjinë e Inovacionin pranë Komisionit Parlamentar për Arsimin	Aktiviteti 1.2.2- Realizimi i takimeve me grupet parlamentare për idenë e ngritjes së Nënkomisioni	Aktiviteti 1.2.3 Miratimi nga Parlamenti i Draft Propozimit të MASR		2017	**-**	-		-	-	MASR/Parlamenti	Produkti 1.2 Krijimi i Nënkomisionit të përhershëm Parlamentar për Shkencën, Teknologjinë e Inovacionin pranë komisionit të Arsimit	*Nuk eshte parashikuar kosto*
		Aktiviteti 1.3.1 - Pjesëmarrja aktive e MAS në takimet e Grupit Ndërministror për zbatimin e Urdhërit të Kryeministrit Nr. 10, datë 17.01.2017, për zbatimin e Planit të Veprimit të Qasjes Triple Helix	Aktiviteti 1.3.2 - Zbatimi nga ana e MAS dhe AKKSHI i rekomandimeve të Grupit Ndërministror për zbatimin e Urdhrit të Kryeministr Nr. 10, datë 17.01.2017, për zbatimin e Planit të Veprimit të Qasjes Triple Helix			2017-2019	**4,500**	1,500		-	3,000	MASR	Produkti 1.3 Krijimi i Këshillit Ndërministror të Politikave të Shkencës, Teknologjisë e Inovacionit	*jane parashikuar pagesa dhe honorare qe mund te paguhen sipas urdherit te Kryeministrit 10 anetare x10 muaj x3 vjet x 15 000 leke =4,500,000 leke*
		Aktiviteti 1.4.1- Hartimi i draftit të parë nga grupi i punës për hartimin e Projekt-ligjit të ri për Shkencën e Inovacionin	Aktiviteti 1.4.2 Realizimi i takimeve me grupet e interesit për diskutimin e Projekt-ligjit të ri për Shkencën e Inovacionin	Aktiviteti 1.4.3 Miratimi në Parlament i ligjit të ri për Shkencën e Inovacionin		2017	**1,200**	1,200				MASR/Parlamenti	Produkti 1.4 Miratimi i ligjit të ri për Shkencën e Inovacionin	

		Aktiviteti 1.5.1 - Hartimi i studimit të fizibilitetit per ngritjen e Struktures Koordinuese Kombëtare SKK	Aktiviteti 1.5.2- Miratimi me VKM i strukturës, funksioneve dhe buxhetit modelit të përzgjedhur			2017-2018	**2,250**	2,250				MASR	Produkti 1.5 Krijimi i një Strukture Koordinuese Kombëtare për politikat SHTI	*jane parashikuar pagesa dhe honorare qe mund te paguhen sipas urdherit te Kryeministrit 5 anetare x10 muaj x 3 vjet x 15 000 leke =2 ,250,000 leke*
		Aktiviteti 1.6.1 Ngritja e grupit të përbashkët të punes me ekspertë nga MASR, AKKSHI, Ministritë e Linjës dhe institucione të tjera që merren me SHTI.	Aktiviteti 1.6.2 Përcaktimi i termave të referencës për asistencë e financim nga donatorë të huaj, lidhur me hartimin e studimit të fizibilitetit	Aktiviteti 1.6.3 Hartimi i studimit të fizibilitetit Aktiviteti 1.6.4 Diskutimi me Grupet e Interesit	Aktiviteti 1.6.5 Përzgjedhja e modelit Aktiviteti 1.6.6 Hartimi i Plan-Biznesit dhe financimi i modelit të përzgjedhur	2018-2019	**8,400**	3,600	3,600		1,200	MASR/AKKSHI	Produkti 1.6 Hartimi i Studimit të Fizibilitetit për ngritjen e Qendrave të Ekselencës Shkencore / Parkut Shkencor & Teknologjik në fusha prioritare në përputhje me parimin e specializimit inteligjent (smart specialization)	
	Objektivi 2, Rritja e investimeve për SHTI baznar në fondet publike dhe burime të tjera alternative deri në 1 % të GDP	Aktiviteti 2.1.1 - Përditësimi dhe miratimi në Bordin e Administrimit të AKKKSHI të rregulloreve e udhëzimeve për financimin e projekteve prioritare	Aktiviteti 2.1.2 - Hapja e thirrjeve për projektet kombëtare të kërkim –zhvillimit brenda **2 mujorit të parë të cdo vitit ushtrimor**	Aktiviteti 2.1.3 – Përzgjedhja dhe vlerësimi dhe financimi i projekteve kombëtare të kërkim-zhvillimit nga AKKSHI ..brenda 3-mujorit të parë të cdo viti ushtrimor	Aktiviteti 2.1.4 - Hartimi i platformës së aplikimit online për projektet kombëtare të kërkimzhvillimit, duhet parë platforma e RASH efare ofon	2017-2022	**2,400,000**	820,000	880,000		700,000	AKKSHI	Produkti 2.1 Financimi i të paktën 60 projekteve kombëtare të kërkimit shkencor në vit nga AKKSHI përmes fondeve kombëtare të Kërkim-Zhvillimit në fushat prioritare të SHTI	*Eshte parashikuar Financimi i të paktën 60 projekteve kombëtare të kërkimit shkencor në vit nga AKKSHI përmes fondeve kombëtare të Kërkim-Zhvillimit në fushat prioritare të SHTI me nje fond mesatar vjetor prej 3-5 milion leke per cdo projekt 60 x 5 vjet =300 projekte/ kontrata x 5-8 milion leke =1.5 2.4miliard leke.*
		Aktiviteti 2.2.1 Lëvrimi i fondeve për SHTI baznar në projektet për kërkim shkencor, zhvillim teknologjik dhe inovacion në rang kombetar dhe ndërkombëtar.	Aktiviteti 2.2.2 Hartimi i rregulloreve nga IAL dhe institucionet e tjera të specializuara të shkencës dhe teknologjisë që përcaktojnë procedurat e aplikimit, afatet dhe mënyrën e lëvrimit të fondeve	Aktiviteti 2.2.3 - IAL-të dhe institucionet e tjera të kërkimit shkencor në lidhje me përdorim e fondeve të lëvruara në SHTI të raportojnë të paktën tre herë në vit pas mbylljes së 4mujorit të parë, të dytë dhe vjetor		2018-2022	**230,000**	180,000		50,000		AKKSHI/IAL	Produkti 2.2 Përcaktimi i identifikuar me % në buxhetin e IAL nga fondi i përftuar nga AKFAL-i që do të shpenzohen për SHTI	*Jane parashikuar fonde per krijimin e kushteve dhe funksionimin e AAKSHI*
	Objektivi 3: Përfshirja e diasporës shkencore shqiptare në SHTI	Aktiviteti 3.1.1 - Ngritja e grupit te punes ndërministror në drejtimin e Ministrisë së Europes e Puneve te Jashtme për hartimin dhe koordinimin e procesi	Aktiviteti 3.1.2 - **Krijimi i një platforme on-line** me vetëdeklarim në bazë të fushave të Manualit të Frascati ku mund të regjistrohen kërkues dhe studiues nga diaspora	Aktiviteti 3.1.3- Prezantimi i platformës me të dhënat e mbledhura në një konferencë me përfaqësues të diasporës	Aktiviteti 3.1.4 Përfshirja e përfaqësuesëve të diasporës SHTI, në SKK dhe strukturat institucionale kombëtare të kërkimit shkencor.	2018-2022	**20,000**	10,000	10,000	-		MEPJ /MASR	Produkti 3.1- Krijimi i Bazës Kombëtare të Dhënave AlbScience - Diaspora (ALBSDI)	*Nese ky produkt apo sherbim nuk ogrohet nga Rrjeti Telematik Akademik, parashikohen rreth 20 milion leke per te ndertuar nje sot te tille mbi beze online.*
		Aktiviteti 3.2.1 - Hartimi i Udhëzimit dhe përcaktimi i kritereve për Skemës së Bursës "Studiuesi Vizitor i Diasporës" - Visiting Diaspora Scholar Felloëship	Aktiviteti 3.2.2 - Hapja e thirrjeve të para për aplikim nga studuesit shqiptare të diasporës	Aktiviteti 3.2.3 - Përzgjedhja, vlerësimi i aplikimeve për skemës së bursës "Studiuesi Vizitor i Diasporës" - Visiting Diaspora Scholar Felloëship.		2019-2022	**500,000**	200,000	100,000	**-**	200,000	MASR	Produkti 3.2 - Krijimi i Skemës së Bursës: "Studiuesi Vizitor i Diasporës" - Visiting Diaspora Scholar Felloëship	*Studentet shqiptare qe mbeshteten me bursa ne 50 universitetet me te mira te botes., per nje periudhe 4-vjecare.*

S

tyre përdorimit të efektivitetit të shkencor dhe ën e kërkimit infrastruktur për investimeve Reitja e Qellimi 2:	***albanologjisë materialeve, ICT, shkencat e mjedisit, energjisë, shëndetit publik, ushqimore, çështjet e sigurisë* shkencor *për* kërkimit kombëtare të infrastruktures përmirësimi i Vlerësimi dhe Objektivi 1,**	*albanologjia. materiale, ICT, energjia, shkencat e shëndetit publik, mjedisi,* fushat, *siguria ushqimore,* kërkimit shkencor në e 10 laboratorëve të Aktiviteti 1.3.1 Përzgjedhja	proceduravë të akreditimit Aktiviteti 1.3.2 Fillimi i	dhe akreditimi i laboratorëve Aktiviteti 1.3.3 Përfundimi		2017-2022	**1,000,000**	600,000		-	400,000	MASR/ML	***kërkimore e IAL shkencor në të institute laboratorëve të kërkimit akreditimit të i të paktën 10 ngritjen/ përmirësim dhe Produkti 1.3 Financimi i***	
		të reja të kërkimit shkencor dhe IAL për infrastruktura institucioneve kërkimore dhe vlerësimi i nevojave të Aktiviteti 1.2.1 Evidentimi	**krijuese" dhe veprimtari ve kërkimore-shkencore granti "granti i punës shpërndahen në formë Buxheti i Shtetit** VKM " **Fondet nga** i planit të investimeve me Aktiviteti 1.2.2 Miratimi			2018-2019	-					MASR	buxhetit dhe te IAL Financimi cdo vit me fondet te infrastrukturë e kërkimit, si dhe kombëtar të investimeve për Produkti 1.2 Hartimi i Plani	
		Shkencor në Shqipëri infrastrukturës së Kërkimit për krijimin e hartës të grupit te pune nga MASR Aktiviteti 1.1.1 Ngritja e	vend Janar- Mars kërkimit shkencor në door" i infrastrukturës sëderit në deri - "door to Aktiviteti 1.1.2 Vlerësimi	Shqipëri Kërkimit Shkencor në line të infrastrukturës së hartë kombëtare off-line e onAktiviteti 1.1.3 Krijimi i	Shqipëri Kërkimit Shkencor në on-line të infrastrukturës së hartë kombëtare off-line e Aktiviteti 1.1.4 Publikimi	2017-2018	**50,000**		10,000		40,000	MASR/ML	of Research Infrastructure) (European Strategic Framedork në përputhje me ESFRI Kërkimit Shkencor në Shqipëri Kombëtare të infrastrukturës së Produkti 1.1 Krijimi i Hartës	
	shkencor kërkimit ellësisë së Vlerësimi i Objektivi 5.	IAL-ve institutet kërkimore jashtë RASH, INSTAT, IAL dhe nga MASR, AKKSHI, grupit të punës me eksperte Aktiviteti 5.3.1. Ngritja e	dhe përmbajtjes së tyre Përcaktimi i moduleve Aktiviteti 5.3.2.	aksesimi i saj përmbajtjen e platformës dhe grupet e interesit në lidhje Aktiviteti 5.3.3 Diskutimi me	në funksionim 5.3.5 Vënia e platformës institucionale Aktiviteti individuale dhe pëditësimin e të dhënave IAL-ve , përgjegjës për institut kërkimor jashtë kontaktit në cdo IAL dhe Përzgjedhja e personave të Aktiviteti 5.3.4	2017-2018	-					MAS/AKKSHI/RASH	Information System- ARIS) arkiva,(Albanian Research infrastrukturoe, biblioteka & kapacitetet njerëzore, në RSH, në lidhje me dhënave për kërkimit shkencor Platformës (on-line) të të Produkti 5.3 Krijimi i	
		Shqipërisë Kombëtar të Republikës së regjistruar në Regjistrin periodikët shkencorë për t'u plotësojnë revistat dhe e kritereve që duhet të udhëzimit mbi përcaktimin MASR dhe AKKSHI i draftAktiviteti 5.2.1 Hartimi nga	ekspert të huaj grupet e interesit dhe i draft-udhëzimit me Aktiviteti 5.2.2 Diskutimi	Udhëzimit nga MASR Aktiviteti 5.2.3. Miratimi i		2017-2018	-					AKKSHI/MASR	Republikën e Shqipërisë Periodikëve Shkencorë në Kombëtar të Revistave dhe për krijimin e Regjistrit miratimi i Udhëzimit nga MAS Produkti 5.2 Hartimi dhe	
		e MAS Kërkimit Shkencor nga ana Standartet Akademike e Grupit të Punës për Aktiviteti 5.1.1. Ngritja e	eksperienca të përafërta shkencor të vendeve me të vlerësimit të kërkimit prezantimin e modeleve kombëtare mbi Organizimi i aktiviteteve Aktiviteti 5.1.2.	ndërkombëtare bazuar në modeleve shkencor në nivel kombëtar vlerësimit të kërkimit draft-metodologjisë së Aktiviteti 5.1.3. Përgatitja e	kombëtar shkencor në nivel vlerësimit të kërkimit metodologjisë së Këshilli i Ministrave i 5.1.5. Miratimi nga jashtë IAL-ve Aktivitetë kërkimore shkencore IAL dhe institucionet i draft-metodologjisë me Aktiviteti 5.1.4. Diskutimi	2017-2018	**3,000**	800	800		1,400	MASR	kombëtar kërkimit shkencor në nivel metodologjisë së vlerësimit të Produkti 5.1 Miratimi i	

		Aktiviteti 1.4.1 Hartimi i dokumentit vlerësues për gjendjen e bibliotekave dhe arkivave shkencorë në nivel kombëtar në nivel IAL dhe institucionesh kërkimore jashtë IAL-ve	Aktiviteti 1.4.2 Planifikimi i financimit të përmirësimit të infrastrukturës fizike, koleksionit të librave dhe dokumentave në të paktën 4 bibliotekat dhe arkivat shtetrorë (bujqësi, mjedisit, albanalogji, energji).	Aktiviteti 1.4.3 Hartimi i planit të dixhitalizimit i bibliotekave dhe arkivave shkencore në nivel IAL dhe institucionesh kërkimore	Aktiviteti 1.4.4 Pilotimi dhe përfundimi i dixhitalizimit në të paktën 2 biblioteka dhe 2 arkiva shkencor	2017-2022	**600,000**	360,000	240,000	-		MASR	Produkti 1.4 Përmirësimi i rrjetit të bibliotekave dhe arkivave shkencore në nivel IAL dhe institucionesh kërkimore jashtë IAL−ve	
		Aktivitetet 1.5.1 Përcaktimi i godinës në qytetin e Vlorës	Aktiviteti 1.5.2 Përshtatja infrastrukturore për kryerjen e funksionit si Qëndër e Studimeve Biomarine	Aktiviteti 1.5.3 Nënshkrimi i një marrëveshje bashkëpunimi dhe partneriteti me institucionet akademike vendase për funksionimin e Qëndrës së Studimeve Biomarine	Aktiviteti 1.5.4 Vënia në funksionim e Qëndrës së Studimeve Biomarine	2017-2022	**1,340,000**	140,000	300,000	700,000	200,000		*Produkti 1.5 Përfundimi i procedurave për ngritjen dhe funksionimin e Qëndrës së Studimeve Biomarine, Vlorë në bashkëpunim më Bashkimin Europiane*	
Qëllimi 3; Thjeshtëzimi i praktikave që garantojnë treg të hapur për kërkuesit shkencorë vendas dhe të huaj, dhe lehtësim mobiliteti akademik	**Objektivi 1. Përmirësimi i praktikave të rekrutimit të stafeve akademike e kërkimore shkencore**	Aktiviteti 1.1.1 Hartimi Udhëzimit të MASR për IAL-të dhe institutet kërkimore jashtë IAL-ve, për detyrimin e publikimit të vendeve të lira të punës për stafet akademike e kërkimore në të gjitha nivelet	Aktiviteti 1.1.2 Përgatitja e Udhëzimi nga MAS për caktimin e Pikës Kombëtare të Kontaktit të Euraxess në të gjitha IAL-të e institutetet kërkimore jashtë IAL-ve, e bizneset që kanë departamente K & ZH	Aktiviteti 1.1.3 Organizimi i 20 INFO DAY vjetore të promovimit për Rrjetin Euraxess nga AKKSHI në IAL , institutetet kërkimore jashtë IAL-ve, biznese dhe shoqërinë civile	Aktivitetil.1.4 Nënshkrim i i Kartës dhe Kodit të Studiuesit nga të gjithë IAL −të dhe institutet kërkimore jashtë IAL-ve Aktiviteti 1.1.5 Organizimi i 10 trajnimeve nga AKKSHI për të marrë HR4 Excellecnce	2017-2022	**20,300**	8,200	4,100		8,000		Produkti 1.1. Publikimi në portalin Euraxess-Albania i të gjithë vendeve të hapura të punës në institucionet akademike e kërkimore shqiptare	
	Objektivi 2. Rishikimi i kuadrit ligjor kombëtar që garanton lëvizjen e lirë për qëndrimin e kërkuesve të huaj në institucionet akademike dhe kërkimore shqiptare	Aktiviteti 2.1.1 Ngritja grupit ndër institucional me përfaqësues nga Ministritë e linjës për rishikimin e legjislacionit vendas mbi mobilitetin akademik të studiuesve të huaj	Aktiviteti 2.1.2 Përgatitja e një pakete ndryshimesh ligjore në përputhje me udhëzimet e direktivat e Komisionit Europian për mobilitetin akademik e studiuesve të vendeve të tjera	Aktiviteti 2.1.3 Botimi i një Guide të Mobilitetit për Studiuesit e Kërkuesit e Huaj në anglisht në version të shtypur e on-line e botimin e saj në faqen Euraxess-Albania		2017-2018	**96,000**	24,000	24,000		48,000		Produkti 2.1 Botimi i guidës së mobilitetit për studiuesit e kërkuesit e huaj	
Qëllimi 4: Promovimi i barazisë gjinore në fushën e SHTIsë	**Objektivi 1. Rritja me 30 % deri në vitin 2022 e drejtuesve femra në pozicionet drejtuese akademike e kërkimore, të IAL -ve dhe qendrave kërkimore jashte IAL-ve**	Aktiviteti 1.1.1 Hartimi i metodologjisë për mbledhjen e të dhënave, "Gender in Science" në MASR ne bashkëpunim me INSTAT	Aktiviteti 1.1.2 Hartimi i Udhëzimit nga MAS për caktimin e koordinatorit të barazisë gjinore në nivel IAL , institutive kërkimore jashte IAL-ve	Aktiviteti 1.1.3 Botimi i raportit vjetor "Gender in Science"		2018	**300**	300					Produkti 1.1 Botimi i Raportit Vjetor Gender in Science –GIS	



	Objektivi 3. Rritja e ndërgjegjësimi në shoqërinë shqiptare për rolin e dobinë e kërkimit shkencor si aktivitet publik	Aktivitëti 1.1.1 Përcaktimi i Termave të Referencës për realizimin e TV	Aktivitëti 1.1.2. Miratimi i Marrëveshje Bashkëpuni mi me 3 TV kombëtare për për promovimin e shkencës tek të rinjtë	Aktivitëti 1.1.3. Zhvillimi i emisioneve TV ShoëScience Factor			-	-					Produkti 1. Realizimi i programeve në Tv për promovimin e shkencës tek moshat e reja	
		Aktivitëti 1.3.1 Përcaktimi i Termave të Referencës për realizimin e kurrikulës për kërkimin shkencor teknologjinë dhe inovacionin	Aktivitëti 1.3.2 Hartimi i planit të veprimit për përcaktimin e institucioneve dhe afateve kohore për zhvillimin e trajnimit	Aktivitëti 1.3.4 Zhvillimi i trajnimit			**18,000**	18,000					Produkti 3. Realizimi i trajnimeve për punonjës të administratës publike lidhur me përdorimin e të dhënave shkencore në politikëbërje (pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA	
Qëllimi: Forcimi i lidhjeve të bashkëpunimit ndërkufitar e ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor	**Objektivi 1: Rritja e financimit deri në 20% krahësuar me pesë vitet e fundit, në projektet e bashkëpunimit ndërkufitar e ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor**	Aktivitëti 1.1.1 Rivlerësimi i statusit të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe të bashkëpunimit shkencor	Aktivitëti 1.1.2 Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit shkencor dypalësh dhe shumëpalësh			2017-2022	**100,000**	36,000		36,000	28,000		Produkti1.1 Mbështetja nga MAS nëpërmjet AKKSHI jo më pak se gjashtë marrëveshjeve të bashkëpunimit shkencor dypalëshe dhe shumëpalëshe me vendet e rajonit dhe më gjerë.	
		Aktivitëti 1.2.1 Planifikimi nga MAS i detyrimeve financiare vjetore për pjesëmarrje në eISE.	Aktivitëti1.2.2 Realizimi i takimeve promovuese të përvitshme mbi funksionimin bashkëpunimin me Qendrën Rajonale të Kërkimit Shkencor e Inovacionit-eISE			2017-2022	**7,400**	6,000	1,400				Produkti 1.2 Pjesëmarrje në Qendrën Rajonale të Kërkimit Shkencor e Inovacionit – eISE (Split Kroaci	

	Objektivi 2: Rritja e pjesëmarrjes dhe projekteve fituese deri në 20%, krahësuar me vitin 2014 për Programin Kombëtar të Kërkimit Shkencor e Inovacionit H2020	Aktiviteti 2.1.1 Fuqizimi i Rrjetit të Pikave Kombëtare të Kontaktit-NCP të H2020 duke i kaluar si strukturë pranë AKKSHI	Aktiviteti 2.1.2 Ngritja e një Komiteti të Përbashkët Koordinues mes Programeve H2020, Erasmus e COSME për ndërgjegjësimin e aplikantëve nga sektori i kërkimit shkencor e SME	Aktiviteti 2.1.3 Hartimi i Udhëzimi të Përbashkët mes MASR dhe MFE për nxitjen e IAL publike e institucioneve kërkimore publike për pjesëmarrje në H2020		2017-2022	**905,000**	430,000	45,000	215,000	215,000		Produkti 2.1 Dyfishimi i numrit të projekteve të fituara "Programi H2020" nga komuniteti i kërkimit shkencor	*Eshte parashikuar fitacimi per te dyfishuar numrin e projekteve të fituara "Programi H2020" nga komuniteti i kërkimit shkencor*
	Objektivi 3 Pjesëmarrje aktive dhe angazhimi institucional në iniciativat Open Science të Komisionit Europian dhe Grupin e Punës Open Science të Këshillit të Bashkëpunim it Rajonal	Aktiviteti 1.3.1 Hartimi i Udhëzimit nga MASR për Open Science Contact Point	Aktivititeti 3.1.2. Realizimi i aktiviteteve promovuese për Open Science në IAL e institucionet kërkimore jashtë IAL-ve	Aktiviteti 3.1.3 Pjesëmarrja në Takimet Vjetore të Open Science		2017-2022	**6,000**	1,800	1,800		2,400		Produkti 3.1 Caktimi i "Open Science Contact Point" në Shqipëri dhe raportimi në Komisionin Europian për Open Science	

Aneksi 2: Lista e indikatoreve

I. Produktiviteti

- GDP- GDP e Shqipërisë (Indikator qe prodhohet ne INSTAT nga Drejtoria e Llogarive Kombëtare, i disponueshëm që prej vitit 1996 e ne vazhdim)
- Produktiviteti i Punës në nivel kombëtar (përqindja e rritjes vjetore) (nuk prodhohet aktualisht, parashikohet të prodhohet në 2019 nga Drejtoria e Llogarive Kombëtare)

II. Investimi për Kërkim Shkencor& Zhvillim

- Volumi i Përgjithshëm i investimit për Kërkim Shkencor & Zhvillim (AIDA)
- Volumi i investimit publik për Kërkim Shkencor & Zhvillim (MFE)
- Volumi i investimit të biznesit për Kërkim Shkencor& Zhvillim (INSTAT)
- Shpenzimet qeveritare në nivel qendror për Kërkim Shkencor& Zhvillim të përllogaritur nga zërat e buxhetit për kërkim e zhvillim që u alokohen institucioneve qendrore (MFE)

III. Sistemi i Cilësisë së Kërkimit Shkencor

- Përqindja e botimeve shkencore në nivel kombëtar që renditen brenda 10 % të botimeve më të cituara në nivel rajonal në raport me totalin e botimeve shkencore që janë botuar në vend përgjatë një viti (AKKSHI)
- Mesatarja e Impakt Faktorit (MIF) të botimeve shkencore në nivel kombëtar (AKKSHI)
- Mesatarja Relative e Citimeve (MCR) të një botimi, në raport me llojin e bashkëpunimit që kanë pasur këto botime (3 kategori :botime me një autor të vetëm; botime me bashkautor brenda vendit; botime me bashkautorë të huaj) (AKKSHI)
- Botimet Shkencore Ndërkombëtare me bashkëautorë nga vende të tjera (AKKSHI)
- Indeksi i bashkëpunimit me studiues nga vende të tjera në nivel kombëtar (AKKSHI)
- Numri i të diplomuarve për studime doktorale për 1 mijë banorë të moshës 25-34 vjeç (MAS)
  - Përqindja e numrit të studentëve nga vende të tjera që ndjekin studimet e doktoraturës në vend në raport me numrin total të studentëve në nivel kombëtar që ndjekin studimet e doktoraturës (MASR)

IV. Bashkëpunimi Publik-Privat

- Shpenzimet publike për kërkim & zhvillim që financohen nga sektori i biznesit dhe shuma si përqindje në raport me GDP kombëtare (AIDA, INSTAT, DDPI)
- Botimet shkencore me bashkëautorë nga sektori publik e privat për 1 milion banorë (INSTAT,DDPI)
- Numri i kërkuesve shkencorë në ndërmarrjet e biznesit për 1 mijë forca pune (INSTAT)
- Aplikimet për patentë në kuadër të Traktatit të Bashkëpunimit për Patentat për 1 miliard $ vlerë të GDP kombëtarë në bazë të Shërbimit të Pagesës për Patentat (DDPI)
- Të ardhurat e përfituara nga licencat dhe patentat e shitura jashtë vendit (DDPI)

V. Struktura e Ekonomisë

- Përqindja e firmave të mëdha në raport me numrin total të sipërmarrjeve ekonomike në vend (INSTAT)
- Përqindja e personave të punësuar nga firmat e mëdha në raport me numrin total të personave të punësuar (INSTAT, AIDA, MFE)
- Përqindja SME-ve në raport me numrin total të sipërmarrjeve ekonomike në vend (AIDA,INSTAT)
- Përqindja e personave të punësuar nga firmat e mëdha në raport me numrin total të personave të punësuar (INSTAT)
- Inovacioni i sipërmarrjeve me rritje të lartë ekonomike (INSTAT)
- Përqindja SME-ve që kanë futur një produkt apo proces inovativ në raport me numrin total të SME-ve (INSTAT)
- Përqindja e SME-ve që kanë bërë inovacione pa ndihmë nga jashtë në raport me numrin total të SME-ve (INSTAT)
- Përqindja që zënë produktet e teknologjisë së lartë e të mesme në raport me totalin e eksporteve të vendit (INSTAT)
- Volumi i shpenzimeve për kërkim shkencor e zhvillim në industrinë prodhuese (INSTAT)

VI. Kushtet kuadër

- Përqindja e popullsisë së moshës 30-34 vjeç që ka përfunduar me sukses studimet universitare (MASR)
- Të diplomuarit për kompjuter për 1 mijë banorë mes popullatës të moshës 25-34 (MASR, INSTAT)
- Të porsadiplomuarit për 1 mijë banorë mes popullatës të moshës 25-34 (MASR, INSTAT)

VI. Kushtet kuadër

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Përqindja e popullisë së moshës 30-34 vjeç që ka përfunduar me sukses studimet universitare (MASR)	11,8	11,4	13,3	14,3	15,7	16,7	22,1

Aneksi 3- ZHVILLIMET INSTITUCIONALE DHE NORMATIVE

Situata aktuale e kuadrit ligjor mbi institucionet që kryejnë kërkime shkencore paraqitet si më poshtë:

Në sistemin **e institucioneve të Akademisë së Shkencave, u miratua** Ligji Nr.9655, datë 11.12.2006 "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë"[53], i cili përmes Nenit 4 përcakton

[53] Ligji Nr.9655, datë 11.12.2006 "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë"

funksionet e saj si institucion shkencor pa administrimin e rreth 14 instituteve kërkimore shkencore që prej vitit 1972.

Në bazë të këtyre ndryshime ligjore aktualisht Akademia e Shkencave ka këto funksione:

a) bashkëpunon me institucione kërkimore dhe mësimore, brenda dhe jashtë vendit, që kanë kapacitetet e nevojshme fizike për kërkim, për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës

b) propozon fusha të reja kërkimore e studimore, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit

c) u ofron institucioneve të larta shtetërore këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme në zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme për zhvillimin e vendit

ç) boton organe periodike dhe vepra të tjera me nivel të lartë shkencor

d) organizon kongrese dhe konferenca shkencore dhe problemore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare dh) organizon konkurse dhe dhënie çmimesh shkencore

Në bazë të Nenit 8 (dispozitat kalimtare të fundit) të Ligjit Nr. 9853, datë 26.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin Nr.9655, datë 11.12.2006 "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë", procesi i riorganizimit të Akademisë së Shkencave-ASH kalojnë një periudhë kalimtare, e cila zgjati deri një vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Gjatë periudhës kalimtare u përgatitën kushtet për zgjedhjen e organeve dhe autoriteteve të reja drejtuese të Akademisë. Ndërkohë që riorganizimi i Akademisë së Shkencave u drejtua nga **Komiteti i Reformimit të Akademisë së Shkencave (KRASH)**, i krijuar me urdhër të Kryeministrit dhe që u drejtua nga Zv. Kryeministri, drejtimi veprimtarisë së **Akademisë gjatë periudhës kalimtare, u krye nga Kryesia e Përkohshme e Akademisë (KPA**).

Sipas përcaktimeve të parashikuara në ligj, Komiteti i Reformimit të Akademisë u kryesua nga Zëvendës Kryeministri dhe kishte në përbërjen e tij si anëtarë a) Ministrin e Arsimit dhe Shkencës; b) dy anëtarë të Asamblesë ekzistuese të Akademisë, të cilët e ruajnë anëtarësinë në akademi edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe kanë stazhin më të gjatë në Akademi; c) një anëtar ekspert i Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.

Ndërsa institutet kërkimore–shkencore në vartësi të Akademisë së Shkencave do të ristrukturoheshin në mënyra të ndryshme, të **5 institutet e shkencave sociale e albanologjike** do të rigrupoheshin në Qendrën e Studimeve Albanologjike-QSA **në bazë të VKM Nr. 559,** datë 22.08.2007[54]. **QSA-**ja

[54] VKM Nr. 559, date 22.08.2007[72] "Për bashkimin e disa instituteve te Akademisë së Shkencave, organizimin e tyre ne Qendrën e Studimeve Albanologjike si dhe funksionimin e kësaj Qendre ne periudhën kalimtare".

kaloi një periudhë kalimtare, nga një deri në dy vjet, gjatë së cilës u organizua në njësi përbërëse, si më poshtë:

a) Instituti i Arkeologjisë

b) Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë

c) Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit (Instituti i Kulturës Popullore dhe Qendra e Studimeve të Artit)

ç) Instituti i Historisë

d) Grupi Kërkimor i Enciklopedisë Shqiptare

Në bazë të përcaktimeve ligjore, QSA- Qendra e Studimeve Albanologjike do të kishte si detyrë kryesore **"***kërkimin shkencor, formimin universitar të thelluar të studentëve dhe shkencëtarëve, si dhe shërbime e transferime të njohurive, në fushat e identitetit, të kulturës, pasurive materiale e shpirtërore e të historisë së botës shqiptare"*.

Ndërkohë funksionet e saj kryesore aktualisht janë si më poshtë:

a) Përpunimi i mendimit shkencor të përparuar, që t'i paraprijë zhvillimeve shoqërore e kulturore, ekonomike e politike etj., si dhe të shërbejë si një mbështetje e fuqishme, për përpunimin e politikave publike në këto fusha

b) Përhapja e dijeve dhe e vlerave në shoqëri, nëpërmjet mediatizimit të tyre, si dhe formave të tjera të transmetimit të informacionit

c) Mbledhja dhe studimi i materialeve burimore, klasifikimi dhe arkivimi i tyre

ç) Zhvillimi i teknikave dhe i metodave, për ruajtjen dhe restaurimin e vlerave

d) Transmetimi i dijeve të fituara nga kërkimi shkencor te studentët dhe shkencëtarët, nëpërmjet formimeve të përparuara

QENDRA E STUDIMEVE ALBANALOGJIKE – 2017

Nr	Emërtimi	Kuadri ligjor
1	**Instituti i Antropologjisë Kulturore e Studimeve të Artit(Instituti i Kulturës Popullore& Qendra e Studimeve të Artit)**	VKM Nr 559 date 22.08.2007 Për bashkimin e disa instituteve te Akademisë së Shkencave ,organizimin e tyre ne Qendrën e Studimeve Albanologjike si dhe funksionimin e kësaj Qendre ne periudhën kalimtare
2	**Instituti i Arkeologjisë**	-ii-
3	**Instituti i Gjuhës e Letërsisë**	-ii-
4	**Instituti i Historisë**	-ii-
5	**Qendra e Botimeve Enciklopedike**	-ii-

Nga ana tjetër, **rrjeti 6 instituteve kërkimore shkencoreqë u përkisnin shkencave natyrore në përbërje të Akademisë së Shkencave** u transferua pranë Universitetit të Tiranës, Universitetit Politeknik dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës përmes një sërë aktesh ligjore që u ndërmorën nga Qeveria, në bazë të cilës ishte **VKM Nr. 178,** datë 04.04.2007[55].

Në këtë mënyrë **Instituti i Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar –INIMA** kaloi pranë Universitetit Politeknik duke krijuar **Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Qendrës së Zhvillimit të Teknologjisë** përmes miratimit të **VKM Nr. 146** datë, 28.03.2007[56] .

Instituti i Hidrometereologjisë–IH dhe Qendra e Studimeve Hidraulike-QSH u shkrinë dhe u transferuan pranë Universitetit Politeknik për të krijuar **Institutin e Energjisë, Ujit e MjedisitIEUM,** përmes VKM Nr. 560, datë 22.8.2007[57]. **Instuti i Sizmiologjisë–IS** i Akademisë së Shkencave, u bashkua me disa nga njësitë kërkimore të **Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, përkatësisht, Drejtorinë e Administrimit të Territorit dhe Pasurive Minerale, Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, Drejtorinë e Gjeofizikës së Aplikuar dhe Topogjeodezisë**, duke krijuar **Institutin e Gjeoshkencave**

[55] **VKM Nr. 178, datë 04.04.2007 Për marrjen e masave për zbatimin e studimit të reformës së kërkimit shkencor, pjesë e rrjetit të institutive të Akademisë së Shkencave"**

[56] VKM Nr. 146 datë, 28.03.2007Për shkrirjen e Institutit të Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar dhe riorganizimin e tij, si pjesë përbërëse e Universitetit Politeknik të Tiranës", dhe "Për një ndryshim në vendimin nr. 440, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Akademisë së Shkencav

[57] VKM Nr. 560, datë 22.8.2007 Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IEUM) pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare.

(IGJEO), si njësi kryesore, pranë Universitetit Politeknik UPT-së përmes VKM Nr. 561, datë 22.08.2007[58].

Të dy këto institute, **Instituti i Energjisë, Ujit e Mjedisit-IEUM** dhe **Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO), u bashkuan sërish në vitin 2011 për të krijuar Institutin e Gjeoshkencës dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM),** përmes miratimit të **VKM Nr. 490**, datë 06.07.2011[59] dhe **Urdhri i Ministrit të Arsimit Nr. 371,** datë 28.07.2011.

Edhe **Instituti i Kërkimeve Biologjike**, pjesë e Akademisë së Shkencave, u transferua pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN) të Universitetit të Tiranës (UT), duke u organizuar

a) **Departamentin e Bioteknologjisë dhe b) Seksionin i Florës, pranë Muzeut të Shkencave të Natyrës** dhe **Fakultetin e Shkencave t**ë Natyrës, pranë Universitetit të Tiranës përmes miratimit të **VKM Nr. 562,** datë 22.08.2007[60].

Qendra e Studimeve Gjeografike u shkri me Departamentin e Gjeografisë pranë Fakultetit të Historisë e Filologjisë së Universitetit të Tiranës përmes **VKM Nr 1066**, datë 16.07.2008[61].

Instituti i Fizikës Bërthamore-IFB u riorganizua si **Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar– QFBZ dhe Autoritetit Atomik Shqiptar**-AASH, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universitetit të Tiranës përmes miratimit të **VKM Nr. 563,** datë 22.08.2007[62].

Aktualisht situata e instituteve kërkimore të shkencave natyre që kanë qenë në vartësi të Akademisë së Shkencave është si më poshtë :

---

[58] VKM Nr. 561, datë 22.8.2007Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Gjeoshkencave (IGJ) pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit për periudhën kalimtare.

[59] VKM Nr.490, datë 6.7.2011Për shfuqizimin e VKM Nr. 560, datë 22.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare" dhe VKM Nr.561, datë 22.8.2007 "Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Gjeoshkencave dhe pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit për periudhën kalimtare dhe **Urdhri i Ministrit të Arsimit Nr. 371, datë 28.07.2011 "Për krijimin e Institutit të Gjeoshkencës dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) pranë Universitetit Politeknik"**

[60] VKM Nr. 562, datë 22.08.2007 Për shkëputjen e Institutit të Kërkimeve Biologjike nga Akademia e Shkencave dhe integrimin e tij në Universitetin e Tiranës**".**

[61] VKM Nr 1066 datë 16.07.2008 Për integrimin e ish-Qendrës së Studimeve Gjeografike të Akademisë së Shkencave në Universitetin e Tiranës

[62] VKM Nr. 563, datë 22.08.2007 Për krijimin e Qendrës së Fizikës Bërthamore të zbatuar dhe Autoritetit Atomik Shqiptar, pranë Universitetit të Tiranës**".**

ISH-INSTITUTET E SHKENCAVE NATYRORE TË ASH – 2017

Universiteti i Politeknik- Instituti Gjeoeshkencës, Energjisë, Mjedisit dhe Ujërave	**IGJEUMI** u krijua në vitin 2011 si bashkim i Institutit të Gjeoshkencave(IGJEO) që ishte krijuar në 2007 nga ristrukturimi **i** Institutit të Sizmologjisë, të Akademisë së Shkencave, me disa nga njësitë kërkimore të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, përkatësisht, Drejtorinë e Administrimit të Territorit dhe Pasurive Minerale, Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, Drejtorinë e Gjeofizikës së Aplikuar dhe Topogjeodezisë, dhe të Institutit të Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (INEUM) që ishte krijuar nga ristrukturimi iish-Institutit të Hidrometeorologjisë dhe ish-Qendrës së Kërkimeve Hidraulike, të Akademisë së Shkencave, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës . Ato u krijuan përmes miratimit të VKM .560 datë 22.8.2007 "Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit(IEUM) pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare; VKM nr.561, datë 22.8.2007 "Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Gjeoshkencave(IGJ) dhe pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit për periudhën kalimtare; Urdhri i Ministrit të Arsimit Nr 371 datë 28.07.2011 Për krijimin e Institutit të Gjeoshkencës dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) pranë Universitetit Politeknik
Universiteti Politeknik/Fakulteti i Teknologjisë e Informacionit- Qendra e Kërkimit & Zhvillimit në Teknologjinë e Informacionit – (QKZHTI	**Qendra e Kërkimit & Zhvillimit në Teknologjinë e Informacionit – (QKZHTI** u krijua përmes VKM Nr 146 datë 28.03.2007 Për shkrirjen e Institutit të Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar (INIMA) dhe riorganizimin e tij, si pjesë përbërëse e Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe për një ndryshim në vendimin nr.440, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Akademisë së Shkencave"
Universiteti i Tiranës./Fakulteti i Shkencave të Natyrës- Qendra e Bioteknologjisë- Departament dhe Seksioni i Florës i Muzeut të Shkencave të Natyrës	Qendra e Kërkimeve Biologjike u krijua përmes VKM Nr 562 datë 22.08.2007 Për shkëputjen e Institutit të Kërkimeve Biologjike(IKB) nga Akademia e Shkencave dhe integrimin e tij në Universitetin e Tiranës

Universiteti i Tiranës/ Fakulteti i Shkencave të Natyrës-4.Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar	Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar(QFBZ) u krijua në vitin 2007 nga ristrukturimi ish- Institutit të Fizikës Bërthamore që ishte nën vartësinë e Akademisë së Shkencave përmes VKM Nr 563 datë 22.08.2007 Për krijimin e Qendrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe Autoritetit Atomik Shqiptar, pranë Universitetit të Tiranës
Universiteti i Tiranës/Fakulteti Histori-Filologji/ Qendra e Studimeve Gjeografike	VKM Nr 1066 datë 16.07.2008 Për integrimin e ish-Qendrës së Studimeve Gjeografike të Akademisë së Shkencave në Universitetin e Tiranës

Nga ana tjetër një element i rëndësishëm i strukturës së kërkimit shkencor janë edhe institutet në vartësi të ministrive të linjës. Aktualisht numri i tyre dhe kuadri ligjor në fuqi që rregullon veprimtarinë e tyre është sërish rezultat i reformës së vitit 2006 për këto institucione.

Duke qenë se **Ministria e Bujqësisë e Ushqimit** kishte rrjetin më të madh të këtyre institucioneve, pas vitit 2006 u miratuan një sërë aktesh nënligjore për ristrukturimin e tyre duke cuar në shkrirjen, bashkimin apo ristrukturimin e shumicës nga këto institute.

Në këtë mënyrë **VKM Nr. 515, datë 19.07.2006 "Për ristrukturimin e instituteve kërkimore – shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit**[63]dhe një sërë amendamentesh, përcaktuan një sërë ndryshimesh thelbësore lidhur me institutet kërkimore që kishin qenë varësi të Ministrisë së Bujqësisë duke bërë shndërrimin e tyre në Qendra të Transferimit të Teknologjisë".

U shkrinë 6 institutet kërkimore që funksiononin deri në atë kohë të tillë si: 1) Instituti i Kërkimeve të Bimëve të Arave, Fushë-Krujë, (IKBA), 2) Instituti i Perime-Patateve, Tiranë, (IPP), 3) Institutit të Pemëtarisë, Vlorë, (IP), 4) Instituti i Kërkimeve Zooteknike, Tiranë, (IKZ), 5) Instituti i Misrit, Shkodër, (IM), 6) Instituti i Studimit të Tokave (IST).

Mbi bazën e shkrirjes së instituteve të përmendura u krijuan **pesë Qendra të Transferimit të Teknologjive Bujqësore–QTTB:** 1) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë, 2) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnjë, 3) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë, 4) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë, 5) Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër.

[63] VKM Nr. 163, datë 21.03.2007 "Për disa shtesa në VKM Nr 515 datë 19.07.2006 "Për ristrukturimin e instituteve kërkimore–shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit", dhe VKM Nr. 382, datë 20.06.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në VKM Nr. 515, datë 19.07.2006 "Për ristrukturimin e institutive kërkimore –shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit

Ndërkohë edhe **dy stacione kërkimore si Stacioni i Pemëtarisë, Tiranë, që ishte pjesë e Institutit të Pemëtarisë,** kaluan në administrim e varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (Universitetit Bujqësor, Tiranë, **ndërsa Stacioni i Duhanit, Cërrik,** që ishte në varësi të Institutit të Kërkimit të Bimëve të Arave, kaloi në administrim e varësi të Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve (AKDC).

Në këtë drejtim një ndryshim i rëndësishëm ishte edhe **shkrirja e Institutit të Kërkimeve Veterinare, Tiranë, (IKV) dhe Institutit të Kërkimeve të Ushqimit, Tiranë, (IKU)** dhe mbi bazën e shkrirjes së instituteve të mësipërme, **u krijua Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Tiranë, (ISUV**), i cili do të mbështeste mbështet teknikisht Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për problemet që lidhen me sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit të kafshëve.[64]

Nga ana tjetër, edhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës që kishte patur në vartësi një sërë institutesh, i'u nënshtrua procesit të ristrukturimit. Nëpërmjet **VKM Nr. 547, datë 09.08.2006 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN)[6566], kjo** strukturë u krijua si rezultat i bashkimit të **Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve, Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Metalurgjisë-ISPM, Institutit të Teknologjisë Nxjerrëse & Përpunuese të Mineraleve-ITNPM dhe Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Mekanikës dhe DruritISPMD**.

Një ndryshim tjetër që ndodhi në nivel të instituteve të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ishte ristrukturimi i **Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Industrisë së Lehtë (ISPIL)** i krijuar me VKM Nr. 348, datë 29.09.1990 dhe përfshirja e tij në Inspektoratin Qendror Teknik (IQT) nëpërmjet miratimit të **VKM Nr. 807, datë 06.12.2006[67]**.

Përmes VKM Nr. 740, datë 01.11.2006 "Për mbylljen e veprimtarisë së Qendrës Kombëtare Shkencore të Hidrokarbureve (QKSHH), Qeveria vendosi të mbyllë QKSHH, **e cila ishte krijuar si rezultat i bashkimit të *Institutit të Naftës dhe Gazit-ING, Fier dhe Qendrës së Përpunimit të Informacionit Gjeofizik-QPIG, Fier* dhe stafi i saj kaloi pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë e Energjitikës.**

Duhet theksuar se në pikën 2,2 të Ligjit Nr 58-2015 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zviceriane për grantin e asistencës financiare për projektin *Ngritja e kapaciteteve për zhvillimet në përmasa të mëdha të infrastrukturës së gazit në Shqipëri, II*", është parashikuar edhe ngritja **e Institutit të Naftës e Gazit-ING.**

Një proces ndryshimi përfshiu edhe institutet në varësi të Ministrisë e Mjedisit. Pas miratimit të **VKM Nr. 579, datë 23. 08. 2006 "Për krijimin e Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve AMP"** u shkri me këtë

[64] VKM Nr 515 datë 19.07.2006 "Për ristrukturimin e instituteve kërkimore–shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatori

[65] VKM Nr. 202, datë 11.04.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në VKM Nr. 547, datë 09.08.2006 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN)"; VKM Nr. 364, datë 13.06.2007 "Për një shtesë në VKM Nr. 547, datë

[66] .08.2006 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore,

[67] VKM Nr. 807, datë 06.12.2006Për ristrukturimin e Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Industrisë së Lehtë(ISPIL)".

agjenci edhe **Instituti i Mjedisit** që ishte krijuar në vitin 2002 **nga ristrukturimi i Institutit të Studimeve dhe i Projektimeve të Teknologjisë Kimike.**

Njëkohësisht edhe **Instituti i Studimeve të Transportit** –**IST,** i krjuar në vitin 1993[68]iu nënshtrua një procesi ristrukturimi përmes miratimit të **VKM Nr. 861, datë 21.11.2007[69] "**dhe kalimin e tij në varësi të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

INSTITUTET KËRKIMORE & SHËRBIMIT NË VARTËSI TË MINISTRIVE TË LINJËS – 2017

Nr	Emri i Institucionit	Kuadri Ligjor
1	**Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)- Minsitria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**	Instituti i Shëndetit Publik u krijua në vitin 2001 nga bashkimi i Institutit të Higjenës "Hulo Hadëri" dhe Qendrës Kombëtare të Edukimit dhe së Promocionit të Shëndetit përmes VKM Nr. 178,datë 30.03.2001, "Për bashkimin e Qendrës Kombëtare të Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit me Institutin e Shëndetit Publik
2	**Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Biomjekësore- Minsitria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**	Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Biomjekësore është vazhdim i Qendrës Kombëtare Biomjekësore
3	**Instituti i Transportit (IT)- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**	Instituti i Transportit u krijua në vitin 2007 nga ristrukturimi i Institutit të Studimeve të Transportit (IST)përmes VKM Nr 861 datë 21.11.2007 Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Institutit të Transportit
4	**Instituti i Ndërtimit (IN)- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**	Instituti i Ndërtimit u krijua në vitin 2004 nga bashkimi e ristrukturimi i Instituti i Studimeve te Teknologjise se Ndertimit (ISTN), Instituti i Studimeve e Projektimeve Hidroteknike (ISPH) dhe aktivitetit te ish Instituti i Studimeve e Projektimeve te Ujesjelles Ndertime (ISPUN) përmes Urdhërit të Ministrit të Punëve Publike e Transportit Nr 225 datë 29.06.2004 Për krijimin e Institutit të Ndërtimit

[68] VKM Nr. 568, datë 06.12.1993 Për krijimin e Institutit të Studimeve të Transportit

[69] Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Institutit të Transportit(IT)

5	**Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**	Shqiptar u krijua në vitin 1998 nga bashkimi i Shoqërisë Anonime "Gjeoalba" (Sh. A. " GJEOALBA") , SH. A. " Hidrogjeologji " dhe SH. A " Gjeologji-Gjeodezi përmes Ligjit 8366 datë 02.06.1998 Për krijimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar
7	**Instituti i Policisë Shkencore (sot Laboratori i Policisë Shkencore) – Ministria e Brendshme**	Instituti i Policisë Shkencore u krijua në vitin 2000 përmes VKM Nr 278 datë 02.06.2000 Për krijimin e Institutit të Policisë Shkencore(IPSH).
8	**Instituti i Mjekësisë Ligjore(IML)- Ministria e Drejtësisë**	Instituti i Mjekësisë Ligjore u krijua në vitin 2003 përmes VKM Nr 120 datë 27.02.2003 Për krijimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore
9	**Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë(ISUV_)- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) u krijua në vitin 2006 nga shkrirja e Institutit të Kërkimeve Veterinare(IKV) dhe Institutit të Kërkimeve të Ushqimit (IKU) përmes VKM Nr 515 datë 19.07.2006 Për ristrukturimin e instituteve kërkimore –shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit
10	**Qendra e Transferimit të Teknologjisë –QTT(Lushnjë) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**	Qendra e Transferimit të Teknologjisë –Lushnjë u krijua në vitin 2006 nga ristrukturimi i Institutit të Bimëve e Arave (IMO) , Instituti i Perimeve e Patatave(IPP) dhe stacionet eksperimentale përkatëse përmes VKM Nr 515 datë 19.07.2006 Për ristrukturimin e instituteve kërkimore –shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit
11	**Qendra e Transferimit të Teknologjisë –QTT(Korcë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**	Qendra e Transferimit të Teknologjisë –Korcë u krijua në vitin 2006 nga ristrukturimi i Institutit të Bimëve e Arave (IMO) , Instituti i Kërkimeve Zooteknike(IKZ) dhe stacionet eksperimentale përkatëse përmes VKM Nr 515 datë 19.07.2006 Për ristrukturimin e instituteve kërkimore –shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit

12	**Qendra e Transferimit të Teknologjisë –QTT(Vlorë) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**	Qendra e Transferimit të Teknologjisë –Vlorë u krijua në vitin 2006 nga ristrukturimi i Institutit të Pemëtarisë(IP) dhe stacionet eksperimentale përkatëse përmes VKM Nr 515 datë 19.07.2006 Për ristrukturimin e instituteve kërkimore –shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit
13	**Qendra e Transferimit të Teknologjisë –QTT(Fushë-Krujë) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**	Qendra e Transferimit të Teknologjisë –Fushë Krujë u krijua në vitin 2006 nga ristrukturimi i Institutit të Bimëve e Arave (IMO) , Instituti i Kërkimeve Zooteknike (IKZ), Instituti i Studimit të Tokave(IST) përmes VKM Nr 515 datë 19.07.2006 Për ristrukturimin e instituteve kërkimore –shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit
14	**Qendra e Transferimit të Teknologjisë –QTT(Shkodër), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**	Qendra e Transferimit të Teknologjisë) u krijua në vitin 2006 nga ristrukturimi i Institutit të Misrit dhe Orizit (IMO) dhe stacionet eksperimentale përkatëse përmes VKM Nr 515 datë 19.07.2006 Për ristrukturimin e instituteve kërkimore –shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit
15	**Qendra e Studimeve Albanologjike- QSA- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**	Qendra e Studimeve Albanologjike (QSA) u krijua nga bashkimi i 4 instituteve në vartësi të Akademisë së Shkencave si Instituti i Historisë, Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë, Instituti i Kulturës Popullore, Instituti i Arkeologjisë përmes miratimit të VKM Nr 559 date 22.08.2007 Për bashkimin e disa instituteve te Akademisë së Shkencave ,organizimin e tyre ne Qendrën e Studimeve Albanologjike si dhe funksionimin e kësaj Qendre ne periudhën kalimtare

16	**Instituti i Zhvillimit të Arsimit (QSA) Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**	Instituti i Zhvillimit të Arsimit (QSA) u krijua nga përmes miratimit të nga ristrukturimi i Institutit të Kurrikulave e Trajnimeve Institutit të Studimeve Pedagogjike (ISP) nëpërmjet VKM Nr 67 datë 10.02.2010 Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit – IZHA
17	**Instituti i Monumenteve te Kultures- IMK- Ministria e Kulturës**	Instituti i Monumenteve te Kultures- IMK " Gani Strazimiri u krijua me VKM Nr 983 datë 11.10.2010 si vazhdim i instituitt ë mëparshëm me të njëjtin emër të krijuar në vitin 1961
	Agjencia e Sherbimit Arkeologjik, Ministria e Kulturës	Agjencia e Sherbimit Arkeologjik, u krijua me VKM Nr.724 date 21.5.2008 "Per organizimin dhe funksionimin e Agjencise se Sherbimit Arkeologjik".
18	**Instituti i Statistikave- Kryeministria**	Ligj Nr 9180 datePer statistikat zyrtare VKM nr. 704, datë 16.11.2005 "Për miratimin e kritereve të përfaqësimit, të përzgjedhjes, emërimit e shkarkimit të anëtarëve dhe rregullat e funksionimit të Këshillit të Statistikave
	Akademia e Shkencave –ASH - Kryeministria	Akademia e Shkencave në formën aktuale me Seksionin e Shkencave Shoqërore e Natyrore u struktuar në bazë të Ligjit . Ajo është vazhdim I Akademisë së Shkencave dhe me vart u krijua në vitin 1972 në përbërje të cilisht ishin 5 institute të albanologjisë e artit dhe 6 institute të shkencave natyrore
19	**Qendra e Studimeve Bankare – Banka e Shqipërisë**	*Ligj* Nr 82609 date 23.12.1997 Për Bankën e Shqipërisë
20	**Instituti i Studimeve të Krimeve e Pasojave të Komunizmit-(ISKPK), Kuvendi i Shqipërisë**	Krimeve e Pasojave të Komunizmit-(ISKPK u krijua përmes Ligj Nr 10242 datë 25.02.2010 Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri

21	**Agjencia Kombëtare e Mjedisit(AKM), Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**	Agjencia Kombëtare e Mjedisit e krijuar në vitin 2014 është vazhdim i Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve e krijuar në vitin 2006 që përfshiu në vetvete Institutin e Mjedisit (IM) të krijuar në vitin 2002 si shndërrim i Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Teknologjisë Kimike(ISPTK) dhe Institutin e Pyjeve e Kullotave (IPK) dhe Institutin e Studimeve të Peshkimit (ISP). Agjencia Kombëtare e Mjedisit u krijua përmes VKM Nr 47 datë 29.01.2014 Për përcaktimin e rregullave për organizimin e funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e agjencive rajonale të mjedisit
22	**Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor ASIG, Kryeministria**	ASIG u krijua në vitin 2012 si ristrukturim i Institutit Gjeografik Ushtarak , i cili qe krijuar me Ligj Nr 8907 datë 06.06.2002 Për funksionimin e Institutit Gjeografik Ushtarak të Shqipërisë. ASIG u krijua me Ligjin Nr 72 2012 datë 28.06,2012 Për organizimin e funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë
23	**Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore(AKBN), Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore(AKBN) u krijua në vitin 2006 nga shkrirja e, Qendrës Kombëtare Shkencore të Hidrokarbureve(QKSH) Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Metalurgjisë(ISPM), Institutit të Teknologjisë Nxjerrëse dhe Përpunuese të Mineraleve(ITNPM) dhe Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Mekanikës dhe Drurit(ISPMD). Vetë Qendra Kombëtare Shkencore të Hidrokarbureve(QKSHH) e cila qe krijuar në 2001 nga shkrirja e Instituti i Naftës dhe Gazit, Fier, dhe Qendra e Përpunimit të Informacionit Gjeofizik, Fier . AKBN u krijua përmes VKM Nr 547 datë 09.08.2006 Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore(AKBN VKM Nr 202 datë 11.04.2007 Për disa shtesa e ndryshime në VKM Nr 547 datë 09.08.2006 Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore(AKBN); VKM Nr 364 datë 13.06.2007 Për një shtesë në VKM Nr 547 datë 09.08.2006 Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore

Realizimi i kërkimit shkencor në IAL ishte kryer në universitetet publike që ishin të vetmet institucione të arsimit të lartë deri në vitin 1999. Si rredhojë e Nenit 3 të Ligjit Nr 8461 datë 25.02.1999 për Arsimin e Lartë në RSH që futi konceptin e arsimit të lartë jo-publik, deri në 2006 u krijuar vetëm 3 IAL-jo publike apo universitete private. Por pas miratimit të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", **numri i IAL –jo publike nga viti 2007 -2013 arriti në 40.**

Pavarsisht numrit të lartë të universiteteve jo-publike që u hapën pas vitit 2001 pjesa e kërkimit shkencor në universitete, veçanërisht gjatë periudhës 2009-2016 që përkon me periudhën e zbatimit të Strategjisë së Kërkimit Shkencor, Teknologjisë e Inovacionit 2009-2015, vazhdoi të ishte e përqëndruar kryesisht tek universitetet publike. Duhet patur parasysh se pas vitit 2006 në një pjesë të universiteteve publike u përfshinë edhe institutet në vartësi të Akademisë së Shkencave siç ishin Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik, Universiteti Bujqësor. Ndërkohë në këtë drejtim filluan të spikasin edhe disa universitete jo-publike si Universiteti i Neë Yorkut, Universiteti Epoka, Universiteti Europian i Tiranës, Universiteti Polis, Universiteti Marin Barlet, Albanian University, Zonja e Këshillit të Mirë.

STRUKTURAT KËRKIMORE NË SISTEMIN E UNIVERSITETEVE -2017

1	**Universiteti Politeknik Qendra e Kërkimit Shkencor –QKSH**	**VKM Nr.824, datë 05.12.2007** "Për krijimin e disa njësive kryesore, fakulteteve të Universitetit Politeknik të Tiranës" - **VKM Nr.345, datë 08.04.2008** ""Për disa ndryshime në vendimin nr. 824, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e disa njësive kryesore, fakulteteve të Universitetit Politeknik të Tiranës"

2	**Universiteti Politeknik- Instituti i Gjeoeshkencës, Energjisë, Mjedisit dhe Ujërave**	**IGJEUMI** u krijua në vitin 2011 si bashkim i Institutit të Gjeoshkencave(IGJEO) që ishte krijuar në 2007 nga ristrukturimi **i** Institutit të Sizmologjisë, të Akademisë së Shkencave, me disa nga njësitë kërkimore të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, përkatësisht, Drejtorinë e Administrimit të Territorit dhe Pasurive Minerale, Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, Drejtorinë e Gjeofizikës së Aplikuar dhe Topogjeodezisë, dhe të Institutit të Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (INEUM) që ishte krijuar nga ristrukturimi i ish-Institutit të Hidrometeorologjisë dhe ish-Qendrës së Kërkimeve Hidraulike, të Akademisë së Shkencave, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës . Ato u krijuan përmes miratimit të VKM .560 datë 22.8.2007 "Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit(IEUM) pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare; VKM nr.561, datë 22.8.2007 "Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Gjeoshkencave(IGJ) dhe pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit për periudhën kalimtare; Urdhri i Ministrit të Arsimit Nr 371 datë 28.07.2011 Për
		krijimin e Institutit të Gjeoshkencës dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) pranë Universitetit Politeknik
3	**Universiteti Politeknik/Fakulteti i Teknologjisë e Informacionit- Qendra e Kërkimit & Zhvillimit në Teknologjinë e Informacionit –(QKZHTI**	Qendra e Kërkimit & Zhvillimit në Teknologjinë e Informacionit –(QKZHTI u krijua përmes VKM Nr 146 datë 28.03.2007 Për shkrirjen e Institutit të Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar(INIMA) dhe riorganizimin e tij, si pjesë përbërëse e Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe për një ndryshim në vendimin nr.440, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Akademisë së Shkencave"

4	**Universiteti i Tiranës./Fakulteti i Shkencave të Natyrës- Qendra e Bioteknologjisë- Departament dhe Seksioni i Florës i Muzeut të Shkencave të Natyrës**	Qendra e Kërkimeve Biologjike u krijua përmes VKM Nr 562 datë 22.08.2007 Për shkëputjen e Institutit të Kërkimeve Biologjike(IKB) nga Akademia e Shkencave dhe integrimin e tij në Universitetin e Tiranës
5	**Universiteti i Tiranës/ Fakulteti i Shkencave të Natyrës-4. Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ)**	Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ) u krijua në vitin 2007 nga ristrukturimi ish-Institutit të Fizikës Bërthamore që ishte nën vartësinë e Akademisë së Shkencave përmes VKM Nr 563 datë 22.08.2007 Për krijimin e Qendrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe Autoritetit Atomik Shqiptar, pranë Universitetit të Tiranës
6	**Universiteti i TiranësëFakulteti Ekonomik** **Qendra Shqiptare për Kërkime Sociale Ekonomike –(QSHKES)**-	
7	**Universiteti i Tiranës- Fakulteti i Shkencave Sociale** **Qendra e Studimeve Gjinore – (QSGJ)**	
8	**Universiteti i Tiranës- Fakulteti i Shkencave Sociale** **Qendra e Ekselencës – (QEFSHS)**	
9	**Universiteti Bujqesor i Tiranes/ Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve – (IRGJB)**	Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve – (IRGJB u krijua përmes VKM Nr 515 datë 19.07.2006 Për ristrukturimin e instituteve kërkimore –shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit

		VKM Nr.400, datë 11.07.2007 "Për ndarjen e Fakultetit të Bujqësisë dhe krijimin e tri fakulteteve, në Universitetin Bujqësor të Tiranës"."
10	**Universiteti i Tiranës/Fakulteti Histori- Filologji/ Instituti i Studimeve Europiane –**	Instituti i Studimeve Europiane u krijua përmes, VKM Nr 1182 datë 03.12.2009
11	**Universiteti i Tiranës/Fakulteti Histori- Filologji/ Qendra e Studimeve Gjeografike**	VKM Nr 1066 datë 16.07.2008 Për integrimin e ish-Qendrës së Studimeve Gjeografike të Akademisë së Shkencave në Universitetin e Tiranës
12	**Universiteti Luigj Gurakuqi – Shkodër - Instituti i Studimeve Ujore të Rajonit të Shkodrës- (ISURSH)-**	**VKM** nr.360, datë 10.08.1992. Për përshpejtimin e proceseve të riorganizimit të shkollave të larta dhe të kërkimeve shkencore.
13	**Universiteti Aleksandër Xhuvani - Elbasan Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike (QSAB) "Aleks Buda**	**VKM** nr.360, datë 10.08.1992. Për përshpejtimin e proceseve të riorganizimit të shkollave të larta dhe të kërkimeve shkencore.
		VKM Nr.821, datë 05.12.2007 "Për krijimin e disa njësive kryesore, fakulteteve tëuniversitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan"
14	**Universiteti Eqerem Cabej- Gjirokastër**	**VKM** nr.360, datë 10.08.1992. Për përshpejtimin e proceseve të riorganizimit të shkollave të larta dhe të kërkimeve shkencore.
		VKM Nr.823, datë 05.12.2007 "Për krijimin e disa njësive kryesore, fakulteteve të universitetit "Eqerem Qabej", Gjirokastër" –
15	**Universiteti Fan Noli-Korce- Qendra e Ekselencës (FSHNH)–**	**VKM** nr.360, datë 10.08.1992. Për përshpejtimin e proceseve të riorganizimit të shkollave të larta dhe të kërkimeve shkencore.

16	**Universiteti Fan Noli-Korcë- Qendra e Ekselencës (FEF)**	
17	**Universiteti Ismail Qemali-Vlorë Qendra Kërkimore Shkencore (QKSH)**	**VKM** nr.360, datë 10.08.1992. Për përshpejtimin e proceseve të riorganizimit të shkollave të larta dhe të kërkimeve shkencore.
18	**Universiteti Ismail Qemali-Vlorë Qendra Long Life Learning- (QLLL)**	**VKM Nr.822, datë 05.12.2007** "Për ndryshimin e emërtimit dhe riorganizimin e njësive kryesore, fakulteteve të Universitetit "Ismail Qemali', Vlorë"."
19	**Akademia e Forcave të Armatosura(ka ne përbërhe Universitetin ushtarak Skëndërbej dhe Akademinë e Mbrojtjes Spiro Moisiu. Në bazë të Dekretit të Presidentit Nr 7458 datë 11.05.2012 Mbi strukturën organizative të FA , emërtohet** **Akademia e Forcave të Armatosura(Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes)** **Qendra e Doktrinës dhe Kërkimit – (QDK)**	**VKM Nr.720, datë 30.10.2003** "Për krijimin e Universitetit Ushtarak "Skëndërbej"" **VKM Nr 180 datë 10.04.2004** Për krijimin e Akademisë së Mbrojtjes `Spiro Moisiu`(vazhdim i VKM Nr 136 datë 10.05.1958 Shkolla e Lartë Ushtarake, VKM Nr 381 datë 28.10.1961, Akademia Ushtarake e RSH, VKM Nr 120, datë 05.01.1963 Akademia Ushtarake, VKM Nr 465 datë 24.12.1992 Akademia e Shtabit të Përgjithshëm
20	**Akademia e Forcave te Armatosura Qendra e Simulimit(QS)**	

21	**Akademia e Sigurisë** **Qëndra Kërkimore Shkencore – (QKSH)**	**VKM Nr 185 datë 25.02.2015** Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë (vazhdin I **VKM Nr 281 datë 02.06.2000** Për organizimin e funksionimin e Akademisë së Policisë -**VKM Nr 299 datë 14.05.2004** Për disa shtesa e ndryshime në VKM Nr 281 datë 02.06.2000 Për organizimin e funksionimin e Akademisë së Policisë **VKM Nr.135, datë 11.02.2009** "Për mbylljen e Akademisë së Policisë "Arben Zylyftari" dhe riorganizimin e arsimit policor si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit"
22	**Universiteti i Sportit - Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit**	**VKM Nr 123 datë 17.02.2010** Për krijimin e Universitetit të Sporteve
	Universiteti Àleksandër MoisiuDurrës	**VKM Nr. 686 (VKM e riorganizimit te UAMD"**Univeristetit i Durrësit""" - **VKM Nr.801, datë 20.12.2005** "Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës"
	--	**VKM Nr.827, datë 11.06.2008** "Për hapjen pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP) dhe për mënyrën e funksionimit të tij në periudhën kalimtare Qendra per Kerkim Zhvillim dhe Ekselence po ashtu dhe Qendra e Fakultetit te Edukimit.
23	**Qendra Spitalore Universitare e Sëmundjes së Mushkërive "Shefqet Ndroqi"**	**VKM nr.823, datë 11.06.2008** "Për kthimin e spitalit universitar të mushkërive "Shefqet Ndroqi" në spital universitar "Shefqet Ndroqi"". -
24	**Universiteti i Mjekësisë**	**VKM Nr 48 datë 23.01.2013** Për krijimin e Universitetit të Mjekësisë
25	**Universiteti i Arteve**	**VKM Nr 234 datë 23.03.2011** Për krijimin e Universitetit të Arteve

26	**Shkolla e Lartë e Kinematografisë `Marubi**	**VKM Nr.652, datë 30.09.2004** "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë jopublike "Marubi" -
27	**Shkolla e Lartë e Magjistraturës**	Ligji Nr.8136, datë 31.07.1996 "Për Shkollën e Magjistraturës të Republikës së Shqipërisë
28	**Universiteti Neë York Tirana-Qendra për Kërkimet Sociale –(QKS)-**	**VKM Nr.397, datë 15.08.2002** "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë Universitare Jopublike "Neë York University-Tirana""
29	**Universiteti Neë York Tirana-Qendra Kërkimore per Studime të Ekonomisë dhe Biznesit-** **(QKSEB)**	
30	**Universiteti Luarasi Njësia e Kërkimit Shkencor –(NJKSH)-**	**VKM Nr.611, datë 11.09.2003** "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Luarasi"" –
31	**Universiteti Ufo -Dental Qendra Kërkimore Shkencore&Zhvillimit(QKSHZH)-**	**VKM Nr.197, datë 10.04.2004** "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike "Ufo Dental" -
32	**Universiteti Zoja e Keshillit te Mire Qendra për Formimin e Deputetëve të Europës Juglindore-(QFDEJL)**	**VKM Nr.567, datë 27.08.2004** "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike "Zoja e Këshillit të Mirë"
33	**Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë Observatori i Sistemeve Shëndetësore të Ballkanit-(OSSHB)**	
34		
35	**Universiteti `Marin Barleti Instituti Shqiptar për Cështje Publike –(ISHCP)-**	

36	**Universiteti `Marin Barleti** **Qendra Jean Monnet**	
37	**Universiteti Europian i Tiranës** **Qendra Kërkimore "Ligji, Norma dhe Tradita"-(QLNT**	**VKM Nr.636, datë 20.09.2006** "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Universiteti Europian i Tiranës
38	**Universiteti Europian i Tiranës Instituti i Studimeve të Sigurisë dhe të Strategjisë-(ISSS**	
39	**Universiteti Europian i Tiranës Instituti i Studimeve Sociale dhe të Politikave- (ISSP)-**	
40	**Universiteti Europian i Tiranës Instituti i Historisë Bashkëkohore (IHB)**	
41	**Universiteti Europian i Tiranës Qendra për Studime Gjinore-(QSGJ)**	
42	**Universiteti Europian i Tiranës Qendra –UET**	
43	**Universiteti Europian i Tiranës Fondacioni për Liri Ekonomike(FLE)-**	
44	**Universiteti Europian i Tiranës Qendra e Zhvillimit dhe Inovacionit, -(QZHI)-**	
45	**Universiteti Europian i Tiranës Qendra Ndër-disiplinore për Kërkim, - (QNK)-**	
46	**Universiteti Europian i Tiranës Qendra e Kërkimit për Sigurinë Njerëzore, -(QKSNJ)-**	
47	**Universiteti Europian i Tiranës Qendra për Hulumtim Traditash-(QHT)**	

48	**Universiteti Europian i Tiranës Qendra Rajonale e Ekspertizës**	
	(RCE)-	
49	**Universiteti Europian i Tiranës Qendra për Studime Strategjike dhe të Sigurisë(QSSS)**	
50	**Universiteti Europian i Tiranës Qendra e Studimeve të Europës Jug-Lindore- (QSEJL)**	
51	**Universiteti Ëisdom**	**VKM Nr.672, datë 27.09.2006** "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike "Ëisdom University""
52	**Universiteti Aldent Qendra e Formimit dhe Shërbimit Klinik(QFSHK)-**	**VKM Nr.673, datë 27.09.2006** "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike "Aldent"" –
53	**Universiteti Aldent Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike-(QKF)-**	
54	**Universiteti Polis Qendra e Kërkimit Shkencor (QKSH)–**	**VKM Nr.698, datë 11.10.2006** "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Universiteti Polis""
55	**Universiteti Polis Qendra e Kërkimit të Aplikuar-(QKA)**	
56	**Universiteti Epoka-**Qendra e Studimeve Evropiane-(QSE) **Universiteti Epoka** Qendra për Arsim të Vazhdueshëm- (QAV)	**VKM Nr.281, datë 12.03.2008** "Për licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë "Shkolla e Lartë "Epoka

57	**Universiteti Epoka** Qendra e Kërkimit dhe Projektimit në Arkitekturë –(QKPA- CoRDA)	
58	**Ùniversiteti Mesdhetar i Tiranës Qendra Mesdheu (QM)**	**VKM Nr.177, datë 19.02.2009** "Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit "Shkolla e lartë private mesdhetare e Shqipërisë) -
59	**Universiteti Logos Qendra e Kërkimit Shkencor (QKSH)–**	**VKM Nr.1055, datë 29.7.2009** "Për licensimin e shkollës së lartë private"Logos
60	**Universiteti Metropol i Tiranës Qendra e Kërkimit Shkencor (QKSH- FI)**	**VKM Nr 357 datë 12.05.2010** Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit **Universiteti Metropol i Tiranës**
61	**Universiteti Metropol i Tiranës Qendra e Kërkimit Shkencor (QKSH- FE)**	
62	**Universiteti Tirana Busines University -TBU Qendra për Kërkime e Studime Juridike- (QKSTJ)**	**VKM Nr 794 datë 06.10.2010** Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit **Universiteti Tirana Busines University -TBU**
63	**Universiteti Tirana Busines University -TBU Qendra për Kërkime e Studime Ekonomike – (QKSTJ)**	
64	**Universiteti Hëna e Plotë - Bedër Qendra Kërkimore Zhvillimore për Shkencat Islame- (QKZHSHI)-**	**VKM Nr 286 datë 06.04.2011** Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit **Universiteti Hëna e Plotë = Bedër**
65	**Universiteti Hëna e Plotë Bedër Qendra e Medias dhe Komunikimit-(QMK)-**	
66	**Universiteti Pavarësia Qëndra e Kërkimeve Humane Rajonale (QKHR)**	

67	**Universiteti Instituti i Studimeve Strategjike - ISSAT Instituti i Studimeve Strategjike dhe Trajnimeve- (ISST)**	
68	**Instituti Kanadez i Teknologjisë-**	**VKM Nr 761 datë 10.11.2011** Për dhënien e
	CIT Qendra për Kërkime Inovative & Zhvillim (QKIZH)	lejes për hapjen e institucionit Instituti Kanadez i Teknologjisë-CIT “) -
69	**Universiteti Akademia Profesionale e Biznesit Qendra Kërkimore Shkencore Juridike-(QKSHJ)-**	“
70	**Akademia Profesionale e Biznesit Qendra Kërkimore Shkencore Ekonomike-(QKSHE)**	
71	**Akademia e Studimeve të Aplikuara- REALD Qendra e Kërkimit Shkencor -(QKSH)**	

Në Shtator 2013, Qeveria e re shqiptare e dalë nga zgjedhjet e 23 Qershorit 2013 ngriti Komisionin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, që hartoi në Korrik 2014 Raportin Përfundimtar për Reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në të cilin parashikonte hartimin e një Ligji të ri për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë[87]. Nga ana tjetër si rezultat i kësaj reforme u mbyllën nga MASR rreth 20 universitete jo-publike që nuk plotësonin kriteret e standartet për të funksionuar si institucione universitare. Në Korrik 2015 u miratua Ligji 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë” që parashikonte në mënyrë të veçantë mënyrën e funksionimit, realizimit e financimit të kërkimit shkencor pranë universiteteve.

Ndërkohë, me **Urdhër të Kryeministrit Nr. 128, datë 25.03**.2014 u ngrit një Grup Pune nën drejtimin e prof. Paskal Milos që hartoi një raport për Reformën Institucionale të Kërkimit Shkencor duke paraqitur disa propozime kryesore për një skemë të re institucionale për organizimin e kërkimit shkencor[88].

[87]Raportin Përfundimtar për Reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Korrik 2014, hartuar nga Komisioni për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, drejtues Dr. Arjan Gjoncaj, Kreu 8 . Kërkimi Shkencor(faqe 50-53) 78 faqe http://ëëë.arsimi.gov.al/dokumenta/Raport_Final_Ministria_Arsimit.pdf

[88]**Propozimi 1.Agjencia- Këshilli-Komiteti Kombëtar i Shkencës (në varësi të Këshillit të Ministrave).** Kjo Agjenci- Këshilli apo Komitet të ketë në varësi 3 struktura kryesore:
a)Akademinë e Shkencave që do të rimarrë në administrim ***Qendrën e Studimeve Albanologjike-QSA***;

b)Qendrën e Shkencave Natyrore e Teknike-QSHNT që do të rimarrë në administrim Institutin e Gjeoshkencave, Mjedisit e Ujit- IGJEUM dhe Institutin e Fizikës Bërthamore që i kanë kaluar në varësi me reformën e 2006 Universitetit Politeknik; Universitetet publike e jopublike e institutet e ministrive veprojnë më vete **c)** ***Agjencinë Kombëtare të Financimit të Kërkimit Shkencor*** **-AKFKSHI.**

Propozimi 2Agjencia-Këshilli-Komiteti Kombëtar i Shkencës (në varësi të Këshillit të Ministrave). Kjo AgjenciKëshilli apo Komitet, të ketë në varësi vetëm Akademinë e Shkencave që do të ketë nën administrim institutet kërkimore shkencore si para vitit 2006:

a)Akademinë e Shkencave përmes

Aneks 4 Censusi kombëtar në kërkimin shkencor

I. VLERËSIMI I INFRASTRUKTURËS SË KËRKIMIT SHKENCOR

2. VLERËSIMI I BIBLIOTEKAVE SHKENCORE

3.VLERËSIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE NË FUSHËN AKADEMIKE E KËRKIMORE – SHKENCORE

4. VLERËSIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE PËR PROFESORËT

5. VLERËSIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE PËR DOCENTËT

6. VLERËSIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE PËR PhD

7. VLERËSIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE PËR PROF.ASS

I. VLERËSIMI I INFRASTRUKTURËS SË KËRKIMIT SHKENCOR

1.1 Numri total i institucioneve që janë përgjigjur për infrastrukturën

Universitetet e institucionet përgjegjëse që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor janë 3.638 institucione. Shpërndarja e tyre sipas llojit të institucionit jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 1: Numri total i institucioneve që janë përgjigjur për infrastrukturën në përqindje

- Seksionit të **Shkencave Shoqërore** do të rimarrë dhe administrojë ***Qendrën e Studimeve Albanologjike-QSA***, aktualisht në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
-Seksionit të **Shkencave Natyrore e Teknike** do të rimarrë dhe administrojë Institutin e Gjeoshkencave, Mjedisit e UjitIGJEUM dhe Institutin e Fizikës Bërthamore, që i kanë kaluar në varësi me reformën e 2006 Universitetit Politeknik.

c) *Agjencinë Kombëtare të Financimit të Kërkimit Shkencor*-AKFKSHI



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor, universitetet publike janë rreth 85,6% e tyre ndërsa universitetet private janë përgjigjur rreth 13,9% dhe agjensitë, ministritë apo institucionet e tjera janë rreth 0,5%.

1.2 Numri total i pedagogëve që përdorin infrastrukturën kërkimore

Pedagogët apo kërkuesit shkencorë që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor janë 3.638. Shpërndarja e tyre sipas kategorive të jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 2: Numri total i pedagogëve/kërkuesve Shkencorë që përdorin infrastrukturën kërkimore në përqindje.



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor, rreth 79,6% e tyre kanë 1-24 pedagog /kërkues shkencor ndërsa 12,5% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

1.3 Numri total i studentëve në 3 nivelet(Bachelor, MA, PHD)

Institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor kanë dhënë informacion edhe për numrin e studentëve në 3 nivelet Bachelor, MA, PHD. Shpërndarja e studenteve tyre sipas kategorive të jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 3: Numri total i studentëve në 3 nivelet (Bachelor, MA PHD) në përqindje



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor, rreth 50,3% e tyre kanë nga 100-499 student në tre nivelet ndërsa 10,5% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

1.4 Akreditimi

Institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor kanë dhënë informacion edhe akreditimin apo pozicionimin (akredituar/në process akreditimi ose I pozicionuar) pranë institucionit ose ministrisë. Shpërndarja e tyre sipas kategorive të jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 4: Numri total i studentëve në 3 nivelet (Bachelor, MA PHD) në përqindje.



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor, rreth 79,3% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje në lidhje me akreditimin ndërsa 6,5% e tyre janë të akredituar.

1.6 Laborator Didaktik/Kërkimor Shkencor

Institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor kanë dhënë informacion edhe për laboratororët didaktik/kërkimor shkencor. Shpërndarja e tyre sipas kategorive të jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 5: Paisjet e infrastrukturës së kërkimit shkencor në përqindje



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor, rreth 1 % e tyre nuk kanë dhënë përgjigje në lidhje me laboratorët ndërsa 99% e tyre kanë të paktën një laborator didaktik/kërkimor Shkencor.

1.6 Paisjet e infrastrukturës së kërkimit shkencor

Institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor kanë dhënë informacion edhe për paisjet e laboratorëve didaktik. Shpërndarja e tyre sipas kategorive të jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 6: Paisjet e infrastrukturës së kërkimit shkencor në përqindje

Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor, rreth 46,4% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje në lidhje me numrin e paisjeve të laboratorëve didaktik ndërsa 52,6% e tyre kanë nga 1-99 copë.

1.7 Universitetet

Universitetet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 7: Universitetet që kanë plotësuar formularin e kërkimit shkencor në përqindje



Nga të gjitha universitetet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor universiteti i Tiranës përbën rreth 34,0% të universiteteve.

2. VLERËSIMI I BIBLIOTEKAVE SHKENCORE

2.1 Numri total i institucioneve që janë përgjigjur për bibliotekat shkencore

Universitetet e institucionet përgjegjëse që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore janë 52 institucione. Shpërndarja e tyre sipas llojit të institucionit jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 8: Numri total i institucioneve që janë përgjigjur për infrastrukturën në përqindje



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore universitetet publike janë rreth 48,1% e tyre ndërsa universitetet private janë përgjigjur rreth 42,3% dhe agjensitë, ministritë apo institucionet e tjera janë rreth 9,6%.

2.2 Institucionet që kanë biblioteka/arkiva sipas fushave të Manualit Frascati

Universitetet e institucionet përgjegjëse që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore janë kategorizuar sipas fushave të Manualit Frascati. Shpërndarja e tyre sipas këtij manuali jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 9: Institucionet që kanë biblioteka/arkiva sipas fushave të Manualit Frascati në përqindje



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore, rreth 53,8% e tyre kanë bëjnë pjesë në shkencat sociale ndërsa 25,0% e tyre bëjnë pjesë tek shkencat natyrore.

2.3 Numri i sallave të leximit/ hapësirave të dedikuara për kërkim shkencor dhe punonjësve

Universitetet e institucionet përgjegjëse që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore kanë dhënë informacion edhe për numrin e sallave të leximit/ hapësirave të dedikuara për kërkim shkencor. Shpërndarja e tyre jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 10: Numri i sallave të leximit/ hapësirave të dedikuara për kërkim shkencor dhe punonjësve të Bibliotekës /Arkivit në përqindje



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore, rreth 44,2% e tyre kanë vetëm një bibliotekë apo arkiv për kërkim shkencor të punonjësve ndërsa 7,7 % e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

2.4 Numri total i pedagogëve të fakultetit/studiuesve të institucionit

Universitetet e institucionet përgjegjëse që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore kanë dhënë informacion edhe për numrin e sallave të leximit/ hapësirave të dedikuara për kërkim shkencor. Shpërndarja e tyre jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 11: Numri total i pedagogëve të fakultetit/studiuesve të institucionit në përqindje



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore, rreth 33,0% e tyre kanë mbi 100 pedagog apo studiues ndërsa 13,5 % e tyre nuk kanë dhënë përgjigje. **2.5 Numri total i studentëve në 3 nivelet(Bachelor, MA, PHD)**

Institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore kanë dhëne informacion edhe për numrin e studentëve në 3 nivelet Bachelor, MA, PHD. Shpërndarja e studenteve tyre sipas kategorive jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 12: Numri total i studentëve në 3 nivelet (Bachelor, MA PHD) në përqindje



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore, rreth 50,0% e tyre kanë mbi 500 student në tre nivelet ndërsa 13,5% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

2.6 Numri total i titujve shkencorë shqip e në gjuhë të huaj

Institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore kanë dhëne informacion edhe për numrin total të titujve shkencorë (libra e monografi shkencore) shqip e në gjuhë të huaj apo dokumenteve apo objekteve arkivorë. Shpërndarja tyre sipas kategorive jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 13: Numri total i titujve shkencorë në përqindje



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore, rreth 40,4% e tyre kanë mbi 5000 tituj shkencorë ndërsa 11,5% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

2.7 Numri total i librave në gjuhën shqipe

Institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore kanë dhëne informacion edhe për numrin total të libra në gjuhën shqipe. Shpërndarja tyre sipas kategorive jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 14: Numri total i librave në gjuhën shqipe në përqindje



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore, rreth 13,5% e tyre kanë mbi 5000 libra në shqip ndërsa 36,5% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

2.8 Numri total i librave në gjuhën e huaj

Institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore kanë dhëne informacion edhe për numrin total të libra në gjuhën e huaj. Shpërndarja tyre sipas kategorive jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 15: Numri total i librave në gjuhën e huaj në përqindje



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore, rreth 23,1% e tyre kanë mbi 5000 libra në gjuhë të huaj ndërsa 36,5% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

2.9 Numri total i titujve të revistave dhe periodikëve shkencorë në shqip e gjuhë të huaj

Institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore kanë dhëne informacion edhe për numrin total të titujve, revistave dhe periodikëve shkencorë në shqip e gjuhë të huaj. Shpërndarja tyre sipas kategorive jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 16: Numri total i revistave dhe periodikëve shkencorë në përqindje



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore, rreth 65,4% e tyre kanë nga 1-999 revista dhe periodik ndërsa 21,2% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

2.10 Numri total i revistave dhe periodikëve shkencorë në gjuhën shqipe

Institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore kanë dhëne informacion edhe për numrin total të revistave dhe periodikëve shkencorë në gjuhën shqipe. Shpërndarja tyre sipas kategorive të jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 17: Numri total i revistave dhe periodikëve shkencorë në gjuhën shqipe në përqindje



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore, rreth 57,7% e tyre kanë nga 1-999 revista dhe periodik në gjuhën shqipe ndërsa 32,7% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

2.11 Numri total i revistave dhe periodikëve shkencorë në gjuhën e huaj

Institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore kanë dhëne informacion edhe për numrin total të revistave dhe periodikëve shkencorë në gjuhën e huaj. Shpërndarja tyre sipas kategorive jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 18: Numri total i revistave dhe periodikëve shkencorë në gjuhën e huaj në përqindje



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore, rreth 51,9% e tyre kanë mbi 1-999 revista dhe periodik në gjuhë të huaj ndërsa 34,6% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

2.12 Niveli i dizhitalizimit

Institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore kanë dhëne informacion edhe për niveli e dixhitalizimit të bibliotekës (katalogu bibliografik on-line) sa % e titujve të librave artikujve dhe periodikëve shkencorë të revistave të bibliotekës aksesohen on-line në përqindje. Shpërndarja tyre sipas kategorive jepet në grafikun e mëposhtëm. Grafiku 19: Niveli i dizhitalizimit në përqindje



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore, rreth 25,0% e tyre kanë mbi 50% nivelin e dixhitalizimit të bibliotekës pra 25% e titujve të librave artikujve dhe periodikëve shkencorë të revistave të bibliotekës aksesohen on-line, ndërsa 36,5% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

2.13 Abonimi në bibliotekat shkencore

Institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore kanë dhëne informacion nëse biblioteka shkencore ka abonim. Shpërndarja tyre sipas kategorive jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 20: Abonimi në bibliotekat shkencore në përqindje



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore, rreth 38,5% e tyre kanë abonim, ndërsa 15,4% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

2.14 Abonimi në bibliotekat shkencore sipas manualit të Fraskatit

Informacioni i marrë për bibliotekat shkencore nëse ato kane abonim është ndare edhe sipas manualit të Fraskatit. Shpërndarja tyre sipas kategorive të jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 21: Abonimi në bibliotekat shkencore sipas manualit të Fraskatit



Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur pyetësorit për vlerësimin e bibliotekave shkencore, që janë shkencat sociale 11 prej tyre kanë dhënë përgjigje se kane abonim dhe po kaq kanë thëne qe nuk kanë abonim në bibliotekat e kërkimit shkencor.

3. VLERËSIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE NË FUSHËN AKADEMIKE E KËRKIMORE –SHKENCORE

3.1 Numri total i institucioneve që janë përgjigjur për kapacitetet njerëzore

Universitetet e institucionet përgjegjëse kanë plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore –shkencore për 3,209 staf akademik. Shpërndarja e tyre sipas llojit të institucionit jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 22: Stafi Akademik në përqindje



Rreth 73,9 % e stafit akademik është pranë universitetet publike ndërsa në universitetet private janë rreth 23,9% e stafit akademik që është përgjigjur si dhe tek agjensitë, ministritë apo institucionet e tjera janë rreth 2,2%.

3.2 Stafi Akademik sipas Universiteteve në përqindje

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore sipas universiteteve jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 23: Stafi Akademik sipas Universiteteve në përqindje



Rreth 13,6 % e stafit akademik është pranë universitetet të Tiranës ndërsa në universitetet privat Epoka janë rreth 1,8% e stafit akademik që është përgjigjur pyetësorit.

3.3 Stafi akademik sipas fushave të Manualit Frascati

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore sipas manualit të Fraskatit jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 24: Kapacitetet Njerëzore të Kërkimit Shkencor sipas manualit Fraskati në përqindje



Rreth 38,4 % e stafit akademik është në shkencat sociale ndërsa në shkencat natyrore janë rreth 18,3 % e stafit akademik që është përgjigjur pyetësorit.

3.4 Stafi akademik sipas nën fushave të Manualit Frascati

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore sipas nën fushave të Manualit Frascati jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 24: Kapacitetet Njerëzore të Kërkimit Shkencor sipas nën fushave të Manualit Frascati në përqindje



Rreth 15,4 % e stafit akademik është nën fushën ekonomik dhe biznes ndërsa në nën fushën Gjuhësi janë rreth 9,3 % e stafit akademik që është përgjigjur pyetësorit.

3.5 Stafi akademik sipas gjinisë

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë sipas gjinisë dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 25: Kapacitetet Njerëzore sipas gjinisë



Rreth 54,5 % e stafit akademik janë femra dhe 45,5% e tyre janë meshkuj.

3.6 Stafi akademik sipas grupmoshës

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë sipas grupmoshës dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 26: Kapacitetet Njerëzore sipas grupmoshës



Rreth 63,7 % e stafit akademik janë mbi 45 vjeç dhe 36,3% e tyre janë nën 45 vjeç.

3.7 Kapacitetet Njerëzore sipas studimeve universitare

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë sipas viteve që kanë kryer studimet universitare dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 27: Kapacitetet Njerëzore sipas studimeve universitare në përqindje



Rreth 65,1 % e stafit akademik kanë kryer studimet universitare pas viteve 1990 , 27,6% e tyre kanë kryer studimet universitare para viteve 1990 dhe 7,3% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

3.8 Kapacitetet Njerëzore sipas studimeve pas universitare

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë sipas viteve që kanë kryer studimet pas universitare dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 28: Kapacitetet Njerëzore sipas studimeve pas universitare në përqindje



Rreth 35,6 % e stafit akademik kanë kryer studimet pas universitare pas viteve 1990 , 4,9% e tyre kanë kryer studimet pas universitare para viteve 1990 dhe 59,6% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

3.9 Kapacitetet Njerëzore sipas MA/ Kandidat i Shkencave

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë nëse ata kanë kryer ose jo MA/ Kandidat i Shkencave (për ata që e kanë marrë para vitit 1990) dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 29: MA/ Kandidat i Shkencave (për ata që e kanë marrë para vitit 1990) në përqindje



Stafi akademik që ka kryer studimet para viteve 1990 është përgjigjur se 40,9 e tyre janë MA/ Kandidat i Shkencave ndërsa 59,1 nuk janë MA/ Kandidat i Shkencave.

3.10 Kapacitetet Njerëzore sipas PHD/Doktor i shkencave

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë nëse ata kanë kryer studimet PHD/Doktor i shkencave dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 30: PHD/Doktor i shkencave në përqindje



Rreth 59,5 % e stafit akademik kanë kryer studimet Phd / Doktor Shkencash , 40,5 % e tyre nuk kanë kryer studime Phd / Doktor Shkencash.

3.11 Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë nëse ata kanë qenë bashkëpunëtor të vjetër shkencor (për studiuesit që kanë punuar par viteve 90) dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 31: Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor në përqindje



Rreth 99,5 % e stafit akademik nuk kanë qenë bashkëpunëtor të vjetër shkencor (për studiuesit që kanë punuar par viteve 90).

3.12 Docent

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë nëse ata janë apo jo docent dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 31: Docentet në përqindje



Rreth 92,5 % e stafit akademik nuk janë docent dhe vetëm 7,5% e tyre janë docenta.

3.13 Ass.Profesor

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë nëse ata janë apo jo Ass.Profesor dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 32: Ass.Profesor në përqindje



Rreth 72,7 % e stafit akademik nuk janë Ass.Profesor dhe 27,3% e tyre janë Ass.Profesor.

3.14 Profesor

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë nëse ata janë apo jo Profesor dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 33: Profesor në përqindje



Rreth 87,9 % e stafit akademik nuk janë Profesor dhe 12,1% e tyre janë Profesor.

3.15 Monografi shkencore (si autor dhe me bashkëautor) brenda dhe jashtë vendit

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas numrit të monografive shkencore (si autor dhe me bashkëautor) brenda dhe jashtë vendit. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 34: Monografi shkencore (si autor dhe me bashkëautor) brenda dhe jashtë vendit në përqindje



Rreth 68,5 % e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me monografitë shkencore (si autor dhe me bashkëautor) brenda dhe jashtë ndërsa 30,6% e tyre kanë marrë pjesë si autor dhe me bashkautor deri në 10 monografi shkencore.

3.16 Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj)

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas artikujve në revistat dhe periodikët shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 35: Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj) në përqindje



Rreth 27,9 % e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me artikujt në revistat dhe periodikët shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj) ndërsa 65,9% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 artikuj.

3.17 Artikuj në revista dhe periodike shkencorë jashtë vendit

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas artikujve në revistat dhe periodikët shkencorë jashtë vendit. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 36: Artikuj në revista dhe periodike shkencorë jashtë vendit në përqindje



Rreth 27,0 % e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me artikujt në revistat dhe periodikët shkencorë jashtë vendit ndërsa 64,9% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 artikuj.

3.18 Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 37: Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) në përqindje



Rreth 36,0 % e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca), ndërsa 55,7% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

3.19 Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 38: Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) në përqindje



Rreth 83,4 % e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca), ndërsa 15,9% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

3.20 Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 39: Pjesëmarrje pjesëmarrjeve si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) në përqindje



Rreth 87,5 % e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca), ndërsa 11,7% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

3.21 Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 40: Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare në përqindje



Rreth 27,6 % e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare, ndërsa 52,6% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

3.22 Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 41: Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare në përqindje



Rreth 83,9 % e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare, ndërsa 15,7% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

3.23 Pjesëmarrje si Drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 42: Pjesëmarrje si drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare në përqindje



Rreth 87,2 % e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare, ndërsa 12,4% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

3.24 Pjesëmarrje në Projekte Kombëtare

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve në projekte kombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 43: Pjesëmarrje në projekte kombëtare në përqindje



Rreth 67,5 % e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve në projekte kombëtare, ndërsa 30,7% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 projekte.

3.25 Pjesëmarrje në Projekte ndërkombëtare

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve në projekte ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 44: Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare në përqindje



Rreth 68% e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve në projekte ndërkombëtare, ndërsa 30,9% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 projekte ndërkombëtare .

3.26 EKSPERIENCA TË MOBILITETIT NDËRKOMBËTAR SI KËRKUES SHKENCOR

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas numrit të eksperiencave të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 45: Eksperienca të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor në përqindje



Rreth 83,1% e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e eksperiencave të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor, ndërsa 16,5% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

3.27 ANËTAR I BORDIT EDITORIAL NË REVISTAVE SHKENCORE (KOMBËTARE & NDËRKOMBËTARE)

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas numrit të eksperiencave si anëtar i bordit editorial në revistave shkencore (kombëtare & ndërkombëtare). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 46: Anëtar i bordit editorial në revistave shkencore (kombëtare & ndërkombëtare) në përqindje



Rreth 84,0% e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin si pjesamarrjeve si anëtar i bordit editorial në revistave shkencore (kombëtare & ndërkombëtare), ndërsa 15,7% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

3.28 Çmime kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkëautor)

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas numrit çmime kombëtare për punën kërkimoreshkencore (autor dhe me bashkëautor). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 47: Numri i çmime kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkëautor) në përqindje



Rreth 95,4 % e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e çmimeve kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor), ndërsa 4,5% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

3.29 Çmime ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkëautor)

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas numrit çmime ndërkombëtare për punën kërkimoreshkencore (autor dhe me bashkëautor). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 47: Numri i çmime ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkëautor) në përqindje



Rreth 95,4 % e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e çmimeve ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor), ndërsa 4,6% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

3.30 Patentat për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit

Stafi Akademik që ka plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas numrit të patentave për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 48: Numri i patentave për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit në përqindje



Rreth 99,3 % e stafit akademik nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e patentave për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit, ndërsa 0.7% e tyre ka deri në 10 patenta.

4. VLERËSIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE PËR PROFESORËT

4.1 Numri total i institucioneve që janë përgjigjur për profesorët

Universitetet e institucionet përgjegjëse kanë plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore-shkencore dhe kanë deklaruar që kanë 388 profesorë në stafin e tyre. Shpërndarja sipas llojit të institucionit jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 49: Profesorët në përqindje



Rreth 83,2 % e profesorëve punojnë pranë universitetet publike ndërsa në universitetet private janë rreth 16,8% e tyre.

4.2 Profesorët sipas fushave të Manualit Frascati

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimoreshkencore sipas manualit të Fraskatit jepet në grafikun e mëposhtëm. Grafiku 50: Profesorët sipas manualit Fraskati në përqindje



Rreth 25,3% e profesorëve janë në shkencat sociale ndërsa në shkencat natyrore janë rreth 25,0 % e profesorëve që i janë përgjigjur pyetësorit.

4.3 Profesorët sipas nën fushave të Manualit Frascati

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin sipas nën fushave të Manualit Frascati jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 51: Profesorët sipas nën fushave të Manualit Frascati në përqindje



Rreth 11,9 % e profesorëve janë në nën fushën ekonomike dhe biznes ndërsa në nën fushën Gjuhësi janë rreth 7,5 % e profesorëve që i janë përgjigjur pyetësorit.

4.4 Profesorët sipas gjinisë

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas gjinisë dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 52: Profesorët sipas gjinisë



Rreth 71,1 % e profesorëve janë meshkuj dhe 28,9% e tyre janë femra.

4.5 Profesorët sipas grupmoshës

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas grupmoshës dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 53: Profesorët sipas grupmoshës



Rreth 89,9% e profesorëve janë mbi 45 vjeç dhe 10,1% e tyre janë nën 45 vjeç.

4.6 Profesorët sipas studimeve universitare

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas viteve që kanë kryer studimet universitare dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 54: Profesorët sipas studimeve universitare në përqindje



Rreth 84,3 % e profesorëve kanë kryer studimet universitare para viteve 1990, 12,9% e tyre kanë kryer studimet universitare pas viteve 1990 dhe 2,8% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

4.7 Profesorët sipas studimeve pas universitare

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas viteve që kanë kryer studimet pas universitare dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 55: Profesorët sipas studimeve pas universitare në përqindje



Rreth 21,4 % e profesorëve kanë kryer studimet pas universitare para viteve 1990 , 20,9% e tyre kanë kryer studimet pas universitare pas viteve 1990 dhe 57,7% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

4.8 Monografi shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë vendit

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të monografive shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë vendit. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 56: Monografi shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë vendit në përqindje



Rreth 59,3 % e profesorëve kanë marrë pjesë si autor dhe me bashkautor deri në 10 monografi shkencore brenda dhe jashtë , ndërsa 36,6% nuk ka dhënë informacion në lidhje me monografitë shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë.

4.9 Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj)

Profesorët që ka plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas artikujve në revistat dhe periodikët shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 57: Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj) në përqindje



Rreth 14,9 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me artikujt në revistat dhe periodikët shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj) ndërsa 63,7% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 artikuj.

4.10 Artikuj në revista dhe periodike shkencorë jashtë vendit

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas artikujve në revistat dhe periodikët shkencorë jashtë vendit. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 58: Artikuj në revista dhe periodike shkencorë jashtë vendit në përqindje



Rreth 13,1 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me artikujt në revistat dhe periodikët shkencorë jashtë vendit ndërsa 63,7% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 artikuj.

4.11 Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 59: Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) në përqindje



Rreth 21,1 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca), ndërsa 53,6% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

4.12 Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 60: Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) në përqindje



Rreth 73,5 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca), ndërsa 24,7% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

4.13 Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 61: Pjesëmarrje pjesëmarrjeve si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) në përqindje



Rreth 72,4 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca), ndërsa 26,3% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

4.14 Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 62: Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare në përqindje



Rreth 15,7 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare, ndërsa 44,3% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

4.15 Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 63: Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare në përqindje



Rreth 68,0 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare, ndërsa 30,7% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

4.16 Pjesëmarrje si Drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 64: Pjesëmarrje si drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare në përqindje



Rreth 72,2 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare, ndërsa 26,0% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

4.17 Pjesëmarrje në Projekte Kombëtare

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve në projekte kombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 65: Pjesëmarrje në projekte kombëtare në përqindje



Rreth 35,1 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve në projekte kombëtare, ndërsa 58,8% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 projekte.

4.18 Pjesëmarrje në Projekte ndërkombëtare

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve në projekte ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 66: Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare në përqindje



Rreth 39,2% e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve në projekte ndërkombëtare, ndërsa 55,9% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 projekte ndërkombëtare .

4.19 Eksperienca të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të eksperiencave të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 67: Eksperienca të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor në përqindje



Rreth 61,9% e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e eksperiencave të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor, ndërsa 36,9% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

4.20 Anëtar i bordit editorial në revista shkencore (kombëtare&ndërkombëtare)

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të eksperiencave si anëtar i bordit editorial në revista shkencore (kombëtare & ndërkombëtare). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 68: Anëtar i bordit editorial në revistave shkencore (kombëtare & ndërkombëtare) në përqindje



Rreth 50,5% e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin si pjesëmarrës si anëtar i bordit editorial në revistave shkencore (kombëtare & ndërkombëtare), ndërsa 47,7% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

4.21 Çmime kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor)

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të çmime kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 69: Numri i çmimeve kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor) në përqindje



Rreth 85,6 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e çmimeve kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor), ndërsa 13,9% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

4.22 Çmime ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor)

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të çmimeve ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 70: Numri i çmimeve ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor) në përqindje



Rreth 88,41 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e çmimeve ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor), ndërsa 11,9% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

4.23 Patentat për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit

Profesorët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të patentave për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 71: Numri i patentave për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit në përqindje



Rreth 98,5 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e patentave për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit, ndërsa 1,5% e tyre ka deri në 10 patenta.

5. VLERËSIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE PËR DOCENTËT

5.1 Numri total i institucioneve që janë përgjigjur për docentët

Universitetet e institucionet përgjegjëse kanë plotësuar pyetësorin dhe kanë deklaruar që kanë në stafin e tyre rreth 241 Docentë. Shpërndarja e tyre sipas llojit të institucionit jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 72: Docentët në përqindje



Rreth 79,7% e profesorëve punojnë pranë universitetet publike ndërsa në universitetet private janë rreth 19,1% e tyre.

5.2 Docentët sipas fushave të Manualit Frascati

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin sipas manualit të Fraskatit jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 73: Docentët sipas manualit Fraskati në përqindje



Rreth 39,8,% e docentëve është në shkencat sociale ndërsa në shkencat natyrore janë rreth 19,5 % e docentëve që i janë përgjigjur pyetësorit.

5.3 Docentët sipas nën fushave të Manualit Frascati

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin sipas nën fushave të Manualit Frascati jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 74: Docentët sipas nën fushave të Manualit Frascati në përqindje



Rreth 19,5 % e docentëve është në nën fushën ekonomike dhe biznes ndërsa në nën fushën Gjuhësi janë rreth 10,3 % e docentëve që i janë përgjigjur pyetësorit.

5.4 Docentët sipas gjinisë

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas gjinisë dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 75: Docentët sipas gjinisë



Rreth 53,9 % e docentëve janë meshkuj dhe 46,1% e tyre janë femra.

5.5 Docentët sipas grupmoshës

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas grupmoshës dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 76: Docentët sipas grupmoshës



Rreth 58,1% e docentëve janë mbi 45 vjeç dhe 41,9,1% e tyre janë nën 45 vjeç.

5.6 Docentët sipas studimeve universitare

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas viteve që kanë kryer studimet universitare dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 77: Docentët sipas studimeve universitare në përqindje



Rreth 49,4 % e stafit akademik kanë kryer studimet universitare para viteve 1990, 46,9% e tyre kanë kryer studimet universitare pas viteve 1990 dhe 3,7% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

5.7 Docentët sipas studimeve pas universitare

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas viteve që kanë kryer studimet pas universitare dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 78: Docentët sipas studimeve pas universitare në përqindje



Rreth10,0 % e docentëve kanë kryer studimet pas universitare para viteve 1990 , 27,8% e tyre kanë kryer studimet pas universitare pas viteve 1990 dhe 62,2% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

5.8 Monografi shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë vendit

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të monografive shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë vendit. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 79: Monografi shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë vendit në përqindje



Rreth 41,1 % e docentëve kanë marrë pjesë si autor dhe me bashkautor deri në 10 monografi shkencore brenda dhe jashtë , ndërsa 58,1% nuk ka dhënë informacion në lidhje me monografitë shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë.

5.9 Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj)

Docentët që ka plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas artikujve në revistat dhe periodikët shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 80: Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj) në përqindje



Rreth 14,9 % e docentëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me artikujt në revistat dhe periodikët shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj) ndërsa 78,0% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 artikuj.

5.10 Artikuj në revista dhe periodike shkencorë jashtë vendit

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas artikujve në revistat dhe periodikët shkencorë jashtë vendit. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 81: Artikuj në revista dhe periodike shkencorë jashtë vendit në përqindje



Rreth 13,7 % e docentëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me artikujt në revistat dhe periodikët shkencorë jashtë vendit ndërsa 69,7% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 artikuj.

5.11 Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 82: Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) në përqindje



Rreth 34,4 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca), ndërsa 56,8% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

5.12 Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 83: Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) në përqindje



Rreth 79,7 % e docentëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca), ndërsa 18,7% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

5.13 Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 84: Pjesëmarrje pjesëmarrjeve si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) në përqindje



Rreth 87,6 % e docentëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca), ndërsa 11,2% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

5.14 Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 85: Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare në përqindje



Rreth 18,7 % e docentëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare, ndërsa 47,7% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

5.15 Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 86: Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare në përqindje



Rreth 80,9 % e docentëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare, ndërsa 18,7% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

5.16 Pjesëmarrje si Drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 87: Pjesëmarrje si drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare në përqindje



Rreth 85,9 % e docentëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare, ndërsa 13,7% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

5.17 Pjesëmarrje në Projekte Kombëtare

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve në projekte kombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 88: Pjesëmarrje në projekte kombëtare në përqindje



Rreth 67,6 % e docentëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve në projekte kombëtare, ndërsa 29,9% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 projekte.

5.18 Pjesëmarrje në Projekte ndërkombëtare

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve në projekte ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 89: Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare në përqindje



Rreth 60,6% e docentëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve në projekte ndërkombëtare, ndërsa 38,2% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 projekte ndërkombëtare .

5.19 Eksperienca të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të eksperiencave të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 90: Eksperienca të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor në përqindje



Rreth 79,7% e docentëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e eksperiencave të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor, ndërsa 19,5% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

5.20 Anëtar i bordit editorial në revista shkencore (kombëtare&ndërkombëtare)

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të eksperiencave si anëtar i bordit editorial në revista shkencore (kombëtare & ndërkombëtare). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 91: Anëtar i bordit editorial në revistave shkencore (kombëtare & ndërkombëtare) në përqindje



Rreth 75,1% e docentëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin si pjesëmarrës si anëtar i bordit editorial në revistave shkencore (kombëtare & ndërkombëtare), ndërsa 24,1% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

5.21 Çmime kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor)

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të çmimeve kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 92: Numri i çmimeve kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor) në përqindje



Rreth 90,9 % e docentëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e çmimeve kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor), ndërsa 8,7% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

5.22 Çmime ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor)

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të çmimeve ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 93: Numri i çmimeve ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor) në përqindje



Rreth 92,5% e docentëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e çmimeve ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor), ndërsa 7,5% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

5.23 Patentat për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit

Docentët që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të patentave për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 94: Numri i patentave për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose

jashtë vendit në përqindje



Rreth 99,6 % e docentëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e patentave për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit, ndërsa 0,4% e tyre ka deri në 10 patenta.

6. VLERËSIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE PËR PhD

6.1 Numri total i institucioneve që janë përgjigjur për PhD

Universitetet e institucionet përgjegjëse kanë plotësuar pyetësorin dhe kanë deklaruar që kanë në stafin e tyre 1909 PhD. Shpërndarja e tyre sipas llojit të institucionit jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 95: PhD në përqindje



Rreth 77,3 % e PhD –ve punojnë pranë universitetet publike ndërsa në universitetet private janë rreth 20,0% e tyre.

6.2 PhD sipas fushave të Manualit Frascati

PhD-të që ka plotësuar pyetësorin sipas manualit të Fraskatit jepet në grafikun e mëposhtëm. Grafiku 96: Profesorët sipas manualit Fraskati në përqindje



Rreth 38,3% e PhD-ve është në shkencat sociale ndërsa në shkencat natyrore janë rreth 19,1 % e PhD-ve që i janë përgjigjur pyetësorit.

6.3 PhD sipas nën fushave të Manualit Frascati

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin sipas nën fushave të Manualit Frascati jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 97: Profesorët sipas nën fushave të Manualit Frascati në përqindje



Rreth 16,8 % e PhD-ve është në nën fushën ekonomike dhe biznes ndërsa në nën fushën Gjuhësi janë rreth 11,1 % e PhD-ve që i janë përgjigjur pyetësorit.

6.4 PhD sipas gjinisë

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas gjinisë dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 98: PhD sipas gjinisë



Rreth 53,9 % e PhD-ve janë meshkuj dhe 46,1% e tyre janë femra.

6.5 PhD sipas grupmoshës

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas grupmoshës dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 99: PhD sipas grupmoshës



Rreth 42,7% e profesorëve janë mbi 45 vjeç dhe 57,3% e tyre janë nën 45 vjeç.

6.6 PhD sipas studimeve universitare

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas viteve që kanë kryer studimet universitare dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 100: PhD sipas studimeve universitare në përqindje



Rreth 33,5 % e PhD-ve kanë kryer studimet universitare para viteve 1990, 63,2% e tyre kanë kryer studimet universitare pas viteve 1990 dhe 3,3% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

6.7 PhD sipas studimeve pas universitare

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas viteve që kanë kryer studimet pas universitare dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 101: PhD sipas studimeve pas universitare në përqindje



Rreth 6,1 % e PhD-ve kanë kryer studimet pas universitare para viteve 1990 , 35,4% e tyre kanë kryer studimet pas universitare pas viteve 1990 dhe 58,6% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

6.8 Monografi shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë vendit

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të monografive shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë vendit. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 102: Monografi shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë vendit në

përqindje



Rreth 36,8% e PhD-ve kanë marrë pjesë si autor dhe me bashkautor deri në 10 monografi shkencore brenda dhe jashtë , ndërsa 62,1% nuk ka dhënë informacion në lidhje me monografitë shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë.

6.9 Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj)

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas artikujve në revistat dhe periodikët shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 103: Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj) në

përqindje



Rreth 16,3 % e PhD-ve nuk ka dhënë informacion në lidhje me artikujt në revistat dhe periodikët shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj) ndërsa 75,7% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 artikuj.

6.10 Artikuj në revista dhe periodike shkencorë jashtë vendit

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas artikujve në revistat dhe periodikët shkencorë jashtë vendit. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 104: Artikuj në revista dhe periodike shkencorë jashtë vendit në përqindje



Rreth 13,7 % e PhD-ve nuk ka dhënë informacion në lidhje me artikujt në revistat dhe periodikët shkencorë jashtë vendit ndërsa 74,6% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 artikuj.

6.11 Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 105: Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) në përqindje



Rreth 29,0 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca), ndërsa 60,3% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

6.12 Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 106: Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) në përqindje



Rreth 80,8 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca), ndërsa 18,4% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

6.13 Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 107: Pjesëmarrje pjesëmarrjeve si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) në përqindje



Rreth 84,9 % e PhD-ve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca), ndërsa 14,3% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

6.14 Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 108: Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare në përqindje



Rreth 19,7 % e PhD-ve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare, ndërsa 52,7% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

6.15 Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 109: Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare në përqindje



Rreth 80,8 % e PhD-ve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare, ndërsa 18,8% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

6.16 Pjesëmarrje si Drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 110: Pjesëmarrje si drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare në përqindje



Rreth 85,0 % e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare, ndërsa 14,5% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

6.17 Pjesëmarrje në Projekte Kombëtare

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve në projekte kombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 111: Pjesëmarrje në projekte kombëtare në përqindje



Rreth 85,0 % e PhD-ve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve në projekte kombëtare, ndërsa 14,5% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 projekte.

6.18 Pjesëmarrje në Projekte ndërkombëtare

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve në projekte ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 112: Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare në përqindje



Rreth 64,1% e PhD-ve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve në projekte ndërkombëtare, ndërsa 34,5% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 projekte ndërkombëtare .

6.19 Eksperienca të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të eksperiencave të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 113: Eksperienca të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor në përqindje



Rreth 80,1% e profesorëve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e eksperiencave të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor, ndërsa 19,5% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

6.20 Anëtar i bordit editorial në revista shkencore (kombëtare&ndërkombëtare)

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të eksperiencave si anëtar i bordit editorial në revista shkencore (kombëtare & ndërkombëtare). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 114: Anëtar i bordit editorial në revistave shkencore (kombëtare & ndërkombëtare) në përqindje



Rreth 80,0% e PhD-ve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin si pjesëmarrës si anëtar i bordit editorial në revistave shkencore (kombëtare & ndërkombëtare), ndërsa 19,5% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

6.21 Çmime kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor)

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të çmime kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 115: Numri i çmimeve kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor) në përqindje



Rreth 95,7 % e PhD-ve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e çmimeve kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor), ndërsa 4,3% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

6.22 Çmime ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor)

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të çmimeve ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 116: Numri i çmimeve ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor) në përqindje



Rreth 95,2 % e PhD-ve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e çmimeve ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor), ndërsa 4,8% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

6.23 Patentat për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit

PhD-të që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të patentave për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 117: Numri i patentave për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit në përqindje



Rreth 99,2 % e PhD-ve nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e patentave për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit, ndërsa 0,8% e tyre ka deri në 10 patenta.

7. VLERËSIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE PËR PROF.ASS

7.1 Numri total i institucioneve që janë përgjigjur për Prof.Ass

Universitetet e institucionet përgjegjëse kanë plotësuar pyetësorin dhe kanë deklaruar që kanë në stafin e tyre rreth 877 Prof.Ass . Shpërndarja e tyre sipas llojit të institucionit jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 118: Prof.Ass në përqindje



Rreth 84,2 % e Prof.Ass punojnë pranë universitetet publike ndërsa në universitetet private janë rreth 14,9% e tyre.

7.2 Prof.Ass sipas fushave të Manualit Frascati

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin sipas manualit të Fraskatit jepet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 119: Prof.Ass sipas manualit Fraskati në përqindje



Rreth 32,6% e Prof.Ass është në shkencat sociale ndërsa në shkencat natyrore janë rreth 19,4 % e Prof.Ass që i janë përgjigjur pyetësorit.

7.3 Prof.Ass sipas nën fushave të Manualit Frascati

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin sipas nën fushave të Manualit Frascati jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 120: Prof.Ass sipas nën fushave të Manualit Frascati në përqindje



Rreth 15,7 % e Prof.Ass janë në nën fushën ekonomike dhe biznes ndërsa në nën fushën Gjuhësi janë rreth 8,6 % e Prof.Ass që i janë përgjigjur pyetësorit.

7.4 Prof.Ass sipas gjinisë

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas gjinisë dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 121: Prof.Ass sipas gjinisë



Rreth 57,2 % e stafit akademik janë meshkuj dhe 42,8% e tyre janë femra.

7.5 Prof.Ass sipas grupmoshës

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas grupmoshës dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 122: Prof.Ass sipas grupmoshës

Rreth 33,2% e profesorëve janë mbi 45 vjeç dhe 66,8% e tyre janë nën 45 vjeç.

7.6 Prof.Ass sipas studimeve universitare

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas viteve që kanë kryer studimet universitare dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 123: Prof.Ass sipas studimeve universitare në përqindje



Rreth 56,3 % e Prof.Ass kanë kryer studimet universitare para viteve 1990, 40,0% e tyre kanë kryer studimet universitare pas viteve 1990 dhe 3,6% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

7.7 Prof.Ass sipas studimeve pas universitare

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë sipas viteve që kanë kryer studimet pas universitare dhe të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 124: Prof.Ass sipas studimeve pas universitare në përqindje



Rreth 58,2 % e Prof.Ass kanë kryer studimet pas universitare para viteve 1990 , 31,2% e tyre kanë kryer studimet pas universitare pas viteve 1990 dhe 10,6% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

7.8 Monografi shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë vendit

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të monografive shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë vendit. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 125: Monografi shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë vendit në përqindje



Rreth 55,1 % e Prof.Ass kanë marrë pjesë si autor dhe me bashkautor deri në 10 monografi shkencore brenda dhe jashtë , ndërsa 42,9% nuk ka dhënë informacion në lidhje me monografitë shkencore (si autor dhe me bashkautor) brenda dhe jashtë.

7.9 Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj)

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas artikujve në revistat dhe periodikët shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 126: Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj) në përqindje



Rreth 12,5 % e Prof.Ass nuk ka dhënë informacion në lidhje me artikujt në revistat dhe periodikët shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj) ndërsa 73,0% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 artikuj.

7.10 Artikuj në revista dhe periodike shkencorë jashtë vendit

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin për kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore–shkencore është ndarë edhe sipas artikujve në revistat dhe periodikët shkencorë jashtë vendit. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 127: Artikuj në revista dhe periodike shkencorë jashtë vendit në përqindje



Rreth 12,8 % e Prof.Ass nuk ka dhënë informacion në lidhje me artikujt në revistat dhe periodikët shkencorë jashtë vendit ndërsa 66,4% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 artikuj.

7.11 Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 128: Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) në përqindje



Rreth 22,8 % e Prof.Ass nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve me referim në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca), ndërsa 58,4% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

7.12 Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 129: Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) në përqindje



Rreth 74,3 % e Prof.Ass nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca), ndërsa 24,2% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

7.13 Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 130: Pjesëmarrje pjesëmarrjeve si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca) në përqindje



Rreth 77,9 % e Prof.Ass nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si Drejtues shkencor ose anëtar i Bordit Drejtues në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca), ndërsa 20,6% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

7.14 Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 131: Pjesëmarrje me referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare në përqindje



Rreth 16,6 % e Prof.Ass nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve referim në aktivitete shkencore ndërkombëtare, ndërsa 41,4% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

7.15 Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 132: Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare në përqindje



Rreth 73,1 % e Prof.Ass nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare, ndërsa 26,1% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

7.16 Pjesëmarrje si Drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve si drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 133: Pjesëmarrje si drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare në përqindje



Rreth 77,4 % e Prof.Ass nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve si drejtues shkencor ose anëtar i bordit drejtues në aktivitete shkencore ndërkombëtare, ndërsa 22,1% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 aktivitete.

7.17 Pjesëmarrje në Projekte Kombëtare

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve në projekte kombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 134: Pjesëmarrje në projekte kombëtare në përqindje



Rreth 47,0 % e Prof.Ass nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve në projekte kombëtare, ndërsa 48,9% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 projekte.

7.18 Pjesëmarrje në Projekte ndërkombëtare

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të pjesëmarrjeve në projekte ndërkombëtare. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 135: Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare në përqindje



Rreth 48,0% e Prof.Ass nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e pjesëmarrjeve në projekte ndërkombëtare, ndërsa 50,1% e tyre kanë marrë pjesë deri në 10 projekte ndërkombëtare .

7.19 Eksperienca të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të eksperiencave të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 136: Eksperienca të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor në përqindje



Rreth 70,7% e Prof.Ass nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e eksperiencave të mobilitetit ndërkombëtar si kërkues shkencor, ndërsa 28,7% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

7.20 Anëtar i bordit editorial në revista shkencore (kombëtare&ndërkombëtare)

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të eksperiencave si anëtar i bordit editorial në revista shkencore (kombëtare & ndërkombëtare). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 137: Anëtar i bordit editorial në revistave shkencore (kombëtare & ndërkombëtare) në përqindje



Rreth 66,8% e Prof.Ass nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin si pjesëmarrës si anëtar i bordit editorial në revistave shkencore (kombëtare & ndërkombëtare), ndërsa 32,4% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

7.21 Çmime kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor)

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të çmime kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 138: Numri i çmimeve kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor) në përqindje



Rreth 92,6 % e Prof.Ass nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e çmimeve kombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor), ndërsa 7,2% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

7.22 Çmime ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor)

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të çmimeve ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor). Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 139: Numri i çmimeve ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor) në përqindje



Rreth 92,6 % e Prof.Ass nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e çmimeve ndërkombëtare për punën kërkimore-shkencore (autor dhe me bashkautor), ndërsa 7,4% e tyre ka deri në 10 eksperienca.

7.23 Patentat për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit

Prof.Ass që kanë plotësuar pyetësorin janë ndarë edhe sipas numrit të patentave për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit. Të dhënat jepen në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 140: Numri i patentave për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit në përqindje



Rreth 98,7 % e Prof.Ass nuk ka dhënë informacion në lidhje me numrin e patentave për shpikje si rezultat i kërkimit shkencor të regjistruara brenda ose jashtë vendit, ndërsa 1,3% e tyre ka deri në 10 patenta.

VENDIM

Nr. 41, datë 24.01.2018

PËR "ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË" *(Ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019, nr.185 datë 25.3.2021))*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 71, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Diplomë", dokumenti zyrtar që i jepet studentit në përfundim të programit të studimit, pasi ka plotësuar të gjitha detyrimet akademike të lidhura me të;

b) "Grup-lëndë", një strukturë akademike dhe administrative organizimi brenda një departamenti, e cila grupon anëtarë të stafit akademik që mbulojnë lëndë të përafërta brenda një fushe të ngjashme studimi;

c) “IAL”, institucion i arsimit të lartë;

ç) “Komponent mësimor”, veprimtari e strukturuar dhe formale mësimore;
d) “Laborator”, veprimtaria formuese akademike, gjatë së cilës studenti përvetëson dhe provon aftësitë e tij për të eksperimentuar, investiguar, observuar dhe provuar teori e metoda të caktuara, të planifikuara brenda një lënde të caktuar, e cila mund të vlerësohet me notë dhe me kredite; dh) “Lëndë”, një degë e një fushe shkencore, e organizuar si një disiplinë mësimore e veçantë, që mësohet në mënyrë sistematike gjatë një kohe të caktuar;

e) “Lëndë individuale artistike”, një degë në fushën e arteve, e organizuar si një disiplinë mësimore e veçantë, që mësohet në mënyrë individuale;

ë) “Modul”, një pjesë e programit të lëndës, i cili përmbledh në mënyrë të logjikshme, të vazhduar, të rregullt dhe të organizuar tematika të ngjashme, që ndërtohet mbi një numër të kufizuar objektivash mësimorë – akademikë që pritet të realizohen nga studenti;

f) “Praktikë”, një veprimtari formuese akademike, që vlerësohet me vlerësim pozitiv ose edhe me notë kaluese e me kredite, gjatë së cilës studentit i kërkohet të zgjerojë dhe të aplikojë njohuritë e marra në auditor, për të fituar aftësi shtesë brenda një mjedisi praktik profesional ose artistik, në kuadër të një programi të caktuar studimi, duke plotësuar kërkesa dhe standarde të njohura etike, profesionale e ligjore;

g) “Profil i programit të studimit”, një tërësi veprimtarish akademike dhe/ose kërkimore-shkencore brenda një programi studimi, përfundimi me sukses i të cilave e pajis studentin me emërtimin e profilit përkatës brenda diplomës që ofron institucioni i arsimit të lartë; gj) “Provim i përgjithshëm përfundimtar”, një detyrim akademik, përmbledhës i një cikli studimi “Bachelor” ose “Master profesional”, pas kalimit me sukses të të cilit studenti pajiset me diplomën përkatëse;

h) “Objektiva formues dhe kompetenca profesionale”, bashkësia e dijeve, aftësive e kompetencave specifike të fushës, që studentët duhet të fitojnë në përfundim të programit të studimit.

2. Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në:
a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);

b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;

c) objektivat formues dhe kompetencat profesionale;

ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;

d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi; dh) planin mësimor;

e) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;

ë) programin lëndor (Syllabus-et);

f) profilin e programit;

g) diplomën dhe suplementin. 2.1 Kreditet sipas ECTS-së

a) Krediti i formimit të arsimit të lartë i referohet ECTS-së dhe shpreh volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore.

b) Një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit.

c) Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh në arsimin e lartë, nga një student me kohë të plotë, është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1 500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij.

ç) Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1 500 (një mijë e pesëqind) orëve mësimore vjetore.

d) Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe.

dh) Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv, në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm).

e) Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në një program tjetër studimi në të njëjtin IAL, si dhe në të njëjtin apo një tjetër program studimi në një IAL tjetër, bëhet nga njësia bazë që pret studentin, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në rregulloren mësimore të institucionit.

ë) IAL-të mund të njohin si kredite të formimeve universitare në një program të caktuar studimi, sipas kritereve të përcaktuara, njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese të nivelit pas shkollës së mesme, që janë në përputhje me objektivat specifikë të programit përkatës të studimit. Në këtë rast, numri maksimal i krediteve të njohura nuk i kalon 60 (gjashtëdhjetë) kredite për programet e studimit të ciklit të parë dhe 40 (dyzet) kredite për programet e studimit të ciklit të dytë. 2.2 Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit.

a) Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim e me gojë, eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, performancave artistike, praktikave dhe tezave të diplomave.

b) Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit nga studenti.

c) Kriteri i vlerësimit përshkruan atë çfarë pritet të bëhet nga studenti dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të objektivave formues dhe të kompetencave profesionale.

ç) Metodat e vlerësimit janë strategjitë, teknikat, mjetet dhe instrumentet për grumbullimin e informacionit për të përcaktuar masën, në të cilën studenti demonstron përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit.

2.3 Objektivat formues dhe kompetencat profesionale.
a) Objektivat formues dhe kompetencat profesionale në një program studimi përcaktojnë formimin, njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që përfiton studenti deri në përfundim të programit të studimit. b) Objektivat formues dhe kompetencat profesionale:

i) i atribuohen komponentëve të veçantë mësimorë, si dhe programit të studimit në tërësi; ii) përcaktohen në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve gjatë përshkrimit të kualifikimeve individuale, për sa u përket njohurive, aftësive dhe kompetencave të fituara me përfundimin e studimeve. iii) vlerësohen nëpërmjet procedurave të bazuara në kritere të qarta e transparente. c) Objektivat formues dhe kompetencat profesionale ndahen në:

i) përcaktues/e, të cilët/të cilat janë të njëjtë/a për programet e studimit me të njëjtin emërtim, të ofruar nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë.

ii) specifikë/e, të cilët/ të cilat diferencojnë programet e studimit me të njëjtin emërtim, të ofruara nga IAL të ndryshme. Këta/o objektiva e kompetenca përcaktohen veçmas nga secili institucion ofrues i programit të studimi.

2.4 Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit.

a) Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në:

i) mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; ii) studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh; iii) përgatitje për provime; iv) përgatitje e tezës së diplomës;

v) veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private.

b) Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë.

c) Studentëve, në përfundim të programit të studimit, u përllogaritet nota mesatare e ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

2.5 Kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi.

a) Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS.

b) Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:

i) Lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;
ii) Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;

iii) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje; iv) Lëndë plotësuese, të fokusuara në përftimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe

në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim;

v) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar. Pesha që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit, sipas llojit të programit, përcaktohet në shtojcën nr. 1, tabela 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. c) Veprimtaritë formuese mund të jenë:

i) të detyrueshme;

ii) të zgjedhura nga vetë studentët, ndërmjet atyre të ofruara nga institucioni, dhe koherente me programin e studimit, të realizuara këto gjatë viteve akademike të programit të studimit.

2.6 Plani mësimor Në planin mësimor të çdo programi studimi përcaktohen:

i) lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra;

ii) kreditet përkatëse. 2.7 Kuotat e pranimit dhe grupet mësimore

a) IAL-të përcaktojnë kuotat e lira për regjistrimet e reja të studentëve për çdo program studimi në përputhje me standardet e përcaktuara për raportin personel akademik me kohë të plotë për studentë dhe normativën e përcaktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme për student, sipas përcaktimeve në vendimin nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre". Kuotat e pranimit llogariten mbi bazën e studentëve aktivë, që ndjekin programet e studimit. Ato bëhen publike nga IAL-të dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

b) Në varësi të ecurisë së regjistrimeve, kapaciteti i kuotave të programeve mund të përshtatet nga IAL-të në përputhje me interesin e studentëve, për programet e të njëjtit cikël studimi, që ofrohen nga njësitë bazë të së njëjtës njësi kryesore, duke mos tejkaluar, në asnjë rast, totalin e kapacitetit të deklaruar të kuotave, të përcaktuar në nivel njësie kryesore.

c) Kuotat në dispozicion për transferimin e studentëve nga IAL të tjera ose brenda së njëjtës IAL përbëhen nga kuotat e paplotësuara nga regjistrimet e vitit të mëparshëm dhe kapacitetet që mund të krijohen, si rezultat i çregjistrimit të studentëve gjatë vitit akademik. Transferimet pranohen në fillim të çdo viti akademik, jo më vonë se fundi i javës së pestë të semestrit të parë.

ç) Kuotat në dispozicion të transferimeve mund të shfrytëzohen edhe nga studentë, të cilët ndërpresin studimet në një program për t'u regjistruar në një program të të njëjtit cikël studimi, që i përket një fushe të ndryshme studimesh nga ajo e mëparshmja, nëse numri i krediteve, që njihen nga IAL-ja pritëse, është i mjaftueshëm për t'u regjistruar në vitin e dytë të studimeve.

d) Numri i studentëve, që përmban grupi mësimor sipas fushës së programit të studimit, përcaktohet në shtojcën nr. 1, tabela nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.8 Programi lëndor (syllabus-et). Modeli i programit të lëndës, që do të përdoret për hartimin e syllabus-eve, duhet të përmbajë elementet sipas përcaktimeve në shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.9 Profili i programit

a) Programi i studimit mund të organizohet në profile, të cilat ofrojnë specializime në drejtime të ngushta të fushës së programit të studimit, në fusha integruese ose ndërdisiplinore të përafërta.

b) Emërtimi i profilit të programit të studimit shënohet në diplomën, që lëshohet në përfundim të tij.
c) Me vendim të Senatit Akademik, institucioni i arsimit të lartë ka të drejtë të bëjë ndryshime të profileve (të hapë, të mbyllë ose të riorganizojë) brenda programit të studimit. IAL-ja njofton ministrinë përgjegjëse për arsimin, jo më vonë se gjashtë muaj përpara fillimit të vitit akademik, për ndryshimet deri në masën 20 për qind të përmbajtjes së programit, të shprehur në kredite ECTS.

2.10 Diploma dhe suplementi

a) Diplomat, që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të dytë, si dhe ato të ciklit të tretë "Master ekzekutiv", shoqërohen me suplementin e diplomës.

b) Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe përshkruan natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, si dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Senida Mesi

SHTOJCA NR. 1 Tabela nr. 1

Veprimtaritë formuese përcaktohen në tabelën e mëposhtme: Kategoria Tipi i komponentit mësimor Cikli i parë Cikli i dytë Bachelor Master profesional Master i shkencave/ master i arteve Master i shkencave (i integruar) A LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 15% - 20% (kredite) 5%-10% (kredite) 5%-10% (kredite) 15% - 20% (kredite) B LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore 50% - 55% (kredite) 30% - 40% (kredite) 50% - 60% (kredite) 45% - 55% (kredite) C LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTE GRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje 12% -15% (kredite) 20%-30% (kredite) 12% -20% (kredite) 12% -15% (kredite) D LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale 10-15% (kredite) 10% (kredite) 10% (kredite) 6 – 8 % (kredite) E DETYRIME PËRMBYLLËSE 3%-5% (kredite) 10%- 20% (kredite) 10-15% (kredite) 3%-5% (kredite) Shënim. Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70% në rastin e programeve "Bachelor" e "Master i shkencave i integruar", dhe jo më pak se 60% në rastin e programeve "Master i shkencave". Në rastin e "Master i arteve" ky raport vendoset sipas specifikave të vetë programit të studimit.

TABELA NR. 2

GRUPIMET MËSIMORE Grupet mësimore në programet e studimit të ciklit të parë, ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë të organizohen me numër studentësh, si më poshtë: Fusha e studimit Nr. i studentëve/ seminar Nr. i studentëve/ laborator Nr. i studentëve/ praktika Nr. i studentëve/ leksion Shkenca natyrore 35 25 25 6 grupe seminari Inxhinieri dhe teknologji 25 20 20 6 grupe seminari Shkenca mjekësore dhe shëndetit 25 20 20 6 grupe seminari Shkenca agrikulturore dhe veterinarisë 35 25 25 6 grupe seminari Shkenca sociale 35 25 25 6 grupe seminari Humanitete dhe arte 35 25 25 6 grupe seminari

PËR

UNIVERSITETIN E ARTEVE (BAZUAR NË SPECIFIKAT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE MËNYRËS SË MËSIMDHËNIES)

Fusha e studimit Lëndë individuale artistike/ nr. i studentëve Mësim artistik në grup/ nr. i studentëve Nr. i studentëve/ seminar Nr. i studentëve/ praktika/ shoqërim në piano Nr. i studentëve/ leksion Studentëve/ laborator ARTET 1 1–15 1–15 1–15 1–6 grupe seminari 1-–15

SHTOJCA NR. 2

PROGRAMI I LËNDËS (Emri i lëndës) Shënim. Të gjitha shënimet brenda kllapave, me të pjerrëta, duhet të fshihen, përfshirë këtë shënim) Titullari /pedagogu i lëndës: (emri, titulli akademik, grada shkencore dhe nënshkrimi) Ngarkesa: (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminar, praktika etj.) Tipologjia e lëndës: Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Lloji i lëndës: (e detyrueshme ose me zgjedhje) Programi i studimit: (programi për të cilin ofrohet kjo lëndë) Kodi i lëndës: Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT: (Përmbledhja është një abstrakt që jep idenë e përgjithshme të kursit. Objektivat e lëndës janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundimi të saj, të cilat ndahen në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studenti pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës) KONCEPTET THEMELORE: (janë koncepte e terma bazë mbi të cilat ndërtohet lënda) 1. 2. 3. ... TEMAT E LËNDËS shpjegimi (rreth një paragrafi) i çdo teme të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe) Tema I – Tema II – Tema III – ..... FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE FREKUENTIMI: KONTROLLI I VAZHDUESHËM: (renditen format e vlerësimit të studentëve të shprehura si përqindje e notës përfundimtare: niveli i diskutimit në seminare, kolokiumi, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit dhe provimi përfundimtar etj.) LITERATURA (literatura paraqet listën e botimeve që studenti duhet të lexojë gjatë lëndës, e ndarë në) a) Literatura bazë e detyrueshme: b) Literatura e rekomanduar: VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS (hapësira ku pedagogu parashtron mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik, nëse ka).

VENDIM

Nr. 70, datë 07.02.2018

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "JUSTICIA", TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë së shkollës së lartë universitare jopublike "Justicia", Tiranë, për të gjitha programet e studimit të ofruara.

2. Shkolla e lartë universitare jopublike "Justicia", Tiranë, të përgatitë dosjen për çdo student, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit të lartë për vazhdimin e studimeve dhe t'ia vërë atë në dispozicion vetë studentit apo përfaqësuesit ligjor, pa asnjë detyrim financiar shtesë nga ana e tij, brenda datës 16 shkurt 2018.

3. Shkolla e lartë universitare jopublike "Justicia", Tiranë, të vërë në dispozicion të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë çdo informacion të kërkuar dhe të vazhdojë të mbajë kontakte me të deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë vendim.

4. Të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për mbylljen e këtij institucioni jopublik të arsimit të lartë, në zbatim të këtij vendimi, të përballohen nga ana e institucionit jopublik të arsimit të lartë/personit juridik privat që i përfaqëson. Shkolla e lartë universitare jopublike "Justicia", Tiranë, duhet të kthejë pagesat e kryera nga studentët për pjesën e papërfunduar të programeve përkatëse të studimit, për rastet kur pagesat janë kryer për cikël studimi, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbushur që mund të kenë ndaj studentit.

5. Shkolla e lartë universitare jopublike "Justicia", Tiranë, të arkivojë të gjithë dokumentacionin mësimor, administrativ dhe financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, në përputhje me kuadrin ligjor mbi arkivat brenda datës 28 shkurt 2018.

6. Shkolla e lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë, nuk duhet të kryejë asnjë lloj veprimi financiar apo lëvizje në llogaritë bankare të institucionit, përveç atyre që kanë lidhje me sa parashikohet në pikën 4, të këtij vendimi. Personi juridik privat, që përfaqëson institucionin privat të arsimit të lartë, të cilit i hiqet licenca, nuk mund të kryejë asnjë lloj ndryshimi të aksioneve apo të kuotave të shoqërisë, aseteve të luajtshme e të paluajtshme të saj, para shlyerjes së detyrimeve të parashikuara në këtë vendim.

7. Vula e shkollës së lartë universitare jopublike "Justicia", Tiranë, të asgjësohet sipas procedurave të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si dhe shkolla e lartë universitare jopublike "Justicia", Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 75, datë 12.02.2018

PËR MIRATIMIN E MODELIT TË FINANCIMIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 110, pika 2, 111, 112 e 113, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Financimi nga buxheti i shtetit i institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor shpërndahet në formë granti, i përbërë nga:

a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, i cili të jetë deri në 10% të totalit të grantit vjetor;

b) granti i mësimdhënies, i cili të jetë jo më pak se 85% të totalit të grantit vjetor;

c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese, i cili të jetë 5% deri në 10% të totalit të grantit vjetor.

2. Përdorimi i fondeve publike nga buxheti i shtetit për institucionet e arsimit të lartë bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të miratuar.

3. Fondet e përfituara në formë granti nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe të papërdorura në fund të vitit financiar, në përputhje me rregullat dhe standardet e menaxhimit financiar publik, trashëgohen në vitin pasardhës.

4. Institucionet publike të arsimit të lartë, të cilat planifikojnë fonde për punën kërkimore-shkencore dhe veprimtaritë krijuese nga të ardhurat e tyre, në raport me parashikimin e bashkëfinancimit, kanë prioritet në përfitimin e fondeve grant nga buxheti i shtetit.

II. GRANTI I POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT PËR INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

1. Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë përfshin, si më poshtë:

a) Fondin për mbështetjen e institucionit dhe të infrastrukturës akademike;

b) Fondin e projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve publike të arsimit të lartë.

2. Fondi për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike shpërndahet mbi bazën e renditjes së institucioneve publike të arsimit të lartë, të kryer nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

3. Fondi i projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve publike të arsimit të lartë shpërndahet mbi bazën e projekteve që paraqesin këto institucione, sipas kritereve të përcaktuara në strategjitë sektoriale dhe në ligjin vjetor të buxhetit.

4. Ministria përgjegjëse për arsimin miraton me udhëzim prioritetet, termat e shpërndarjes dhe formën e aplikimit për grantin.

5. Ministria përgjegjëse për arsimin miraton grantin e politikave të zhvillimit të institucioneve publike të arsimit të lartë, mbi bazën e aplikimit apo të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.

III. GRANTI I MËSIMDHËNIES

1. Granti i mësimdhënies përfshin:

a) fondin për institucionet publike të arsimit të lartë, në masën jo më pak se 90%;

b) fondin e mbështetjes studentore, në masën deri në 10% në vit.

2. Fondi institucional u shpërndahet institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas një formule, në bazë të elementeve të mëposhtme:

a) Numrit të studentëve që ndjekin ciklin e parë të studimeve, një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, në një vit akademik, të cilët konvertohen në njësi financimi.
Financimi i IAL-ve do të kryhet me bazë studentin;

b) Koeficientëve të financimit, sipas programit të studimit të ndjekur, bazuar në koston mesatare për
student, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) Koeficientit të prioriteteve ose financimit shtesë, në masën 5% për studentët që ndjekin programe prioritare, të përcaktuara në dokumentin e prioriteteve që ministri përgjegjës për arsimin miraton dhe shpall çdo vit sipas drejtimeve kryesore dhe në masën 10% për studentët që ndjekin programe studimi me karakter profesional;

ç) Shumës të të ardhurave nga tarifat e studimit të përllogaritura për çdo IAL, bazuar në numrin e studentëve të regjistruar dhe nivelin e tarifës tavan të shkollimit, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave për çdo program studimi për studentët që ndjekin ciklin e parë të studimeve, programet e integruara të studimeve, si dhe një program të studimeve profesionale;

d) Për një periudhë kalimtare dy deri tre vjet, në përllogaritjen e formulës/masës së financimit për institucionet publike të arsimit të lartë do të konsiderohet rivlerësimi/ekualizimi, bazuar në nevojat specifike të tyre.

3. Fondin e mbështetjes studentore deri në 10% të fondit vjetor të marrë në formë granti. Përdorimi i këtij fondi përfshin tri kategori financimi:

a) Bursat e studimit për studentët e shkëlqyer;

b) Bursat e studimit për studentët në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar;

c) Bursat e studimit për studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë.

4. Bursat e studimit për studentët e shkëlqyer u jepen studentëve me notë mesatare maksimale në hyrje, në rang vendi, pavarësisht nga programi i studimit dhe institucioni në të cilin ata kanë zgjedhur të ndjekin studimet. Studenti vazhdon të përfitojë nga ky grant nëse rezultatet e tij, gjatë të gjitha viteve të studimit, vazhdojnë të jenë të shkëlqyera.

5. Bursat e studimit për studentët që kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit në institucione publike të arsimit të lartë, që përbëjnë prioritet kombëtar, iu shpërndahen studentëve që studiojnë në fushat e përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Bursat e studimit për studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë iu shpërndahen studentëve që janë shpallur fitues në institucionet publike të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret për t'u konsideruar si studentë në nevojë, të përcaktuar si të tillë me vendim të Këshillit të Ministrave.

IV. GRANTI I PUNËS KËRKIMORE-SHKENCORE DHE VEPRIMTARIVE KRIJUESE

1. Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese përfshin fondet për kërkimin shkencor. Ky grant është i hapur për konkurrimin/ aplikimin për të gjitha institucionet e arsimit të lartë të akredituara që zhvillojnë kërkim shkencor.

2. Institucionet e arsimit të lartë të llojit universitet dhe akademi aplikojnë për të përfituar nga ky grant dhe për financimin e studimeve të doktoratës.

3. Nga ky fond përjashtohet financimi i ngarkesës së pedagogëve për udhëheqjen e doktoratës.

4. Shpërndarja e fondeve të kësaj kategorie, të miratuara në formën e një granti të punës kërkimoreshkencore, realizohet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), mbi bazën e projekteve që institucionet paraqesin dhe duke mbajtur në konsideratë treguesit kryesorë për projektet kërkimore-shkencore dhe veprimtarinë krijuese të IAL-ve, të renditur, si më poshtë vijon:

a) Numrin e fakulteteve dhe departamenteve të IAL-ve;

b) Numrin e stafit akademik me titujt "Profesor", "Profesor i asociuar", me gradën shkencore
"Doktor" dhe "Master";

c) Numrin e programeve të studimit në ciklin e parë dhe numrin e programeve të studimit të akredituara në ciklin e dytë;

ç) Numrin total të studentëve në ciklin e parë "Bachelor", ciklin e dytë "Master shkencor", "Master profesional", programet e interguara të studimit dhe ato të ciklit të tretë;

d) Numrin total të laboratorëve didaktikë të IAL-ve, të laboratorëve kërkimorë-shkencorë ekzistues të
IAL-ve dhe numrin e laboratorëve kërkimorë-shkencorë ekzistues të akredituar të IAL-ve; dh) Numrin

e stafit ndihmës akademik që punon në laboratorët kërkimorë-shkencorë të IAL-ve dhe

atyre që përdorin laboratorët kërkimorë-shkencorë;

e) Numrin total të studentëve të tri cikleve të studimit që përdorin laboratorët kërkimorë-shkencorë;

ë) Numrin e artikujve shkencorë të botuar në vitin akademik jashtë vendit nga stafi akademik i IAL-ve në
revista me *Impact Factor* , të listës *Tomson Reuters*;

f) Numrin e artikujve shkencorë të botuar në vitin akademik brenda vendit në revista shkencore nga stafi
akademik i IAL-ve, si autor/bashkautor;

g) Numrin e monografive shkencore të botuara në vit brenda vendit nga stafi akademik i IAL-ve, autor/bashkautor;gj) Numrin e monografive shkencore të botuara në vit jashtë vendit nga stafi akademik i
IAL-ve, autor/bashkautor;

h) Numrin e konferencave dhe aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL-të në vitin akademik;

i) Numrin e stafit akademik të IAL-ve që ka marrë pjesë me referim e kumtesa shkencore në
konferenca/seminare/kongrese shkencore, brenda dhe jashtë vendit, autor/bashkautor;

j) Numrin e patentave të regjistruara nga stafi akademik i IAL-ve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave
e Markave, në Shqipëri e jashtë, autor/bashkautor;

k) Numrin e projekteve/kontratave kombëtare kërkimore-shkencore, të fituara e të zbatuara nga stafi
akademik i IAL-ve;

l) Numrin e projekteve/kontratave ndërkombëtare kërkimore-shkencore të programeve të BE-së për kërkimin shkencor e inovacionin, ku stafi akademik i IAL-ve ka qenë pjesëmarrës, në rolin e drejtuesit të projektit dhe/ose të partnerit; ll) Numrin e projekteve/kontratave ndërkombë-tare kërkimore-shkencore në vit akademik, të karakterit të bashkëpunimit dypalësh IAL + universitet homolog jashtë vendit, ku stafi akademik i IAL-ve ka marrë pjesë;

m) Numrin e projekteve/kontratave ndërkombëtare kërkimore-shkencore IPA,

ERASMUS në vit akademik, ku stafi akademik i IAL-ve ka qenë pjesëmarrës, në rolin e drejtuesit të projektit dhe/ose partnerit;

n) Numrin e projekteve/kontratave ndërkombëtare *ERASMUS*, IPA, si dhe projekteve të tjera ndërkombëtare, ku stafi akademik i IAL-ve ka qenë pjesëmarrës, në rolin e partnerit apo të drejtuesit të projektit; nj) Numrin e çmimeve ndërkombëtare dhe kombëtare për veprimtari kërkimore-shkencore të marra nga

stafi akademik i IAL-ve;

o) Numrin e bursave individuale që ka përfituar në vit akademik stafi akademik i IAL-ve për specializime afatgjata e afatshkurtra jashtë vendit;

p) Numrin e individëve, studentë e pedagogë të huaj, që kanë kryer mobilitet akademik në vitin akademik pranë IAL-ve dhe numrin e stafit akademik të IAL-ve që ka kryer mobilitet akademik në vitin akademik në universitete jashtë vendit;

q) Numrin e projekteve/kontratave të përbashkëta kërkimore me sektorin e biznesit nga stafi akademik i IAL-ve.

5. Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor përbën kriterin bazë të renditjes së institucioneve të kërkimit shkencor nga AKKSHI-ja dhe të përcaktimit të masës së financimit të përfituar nga Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, për IAL-të publike. Institucionet e kërkimit shkencor marrin masa për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, nëpërmjet njësisë përkatëse, përbërja dhe funksionimi i së cilës përcaktohen në statutin ose rregulloren e institucionit përkatës.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Zbatimi i skemës së financimit, sipas këtij vendimi, për institucionet publike të arsimit të lartë kryhet sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

2. Fondet e buxhetit të shtetit, të miratuara në formë transferte për "Shoqëritë e trajtimit të studentëve", sh.a., në Tiranë dhe në rrethe, paguhen në llogarinë bankare të përfituesit nga struktura përgjegjëse për thesarin, me urdhër të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhënëse dhe me paraqitjen nga kjo e fundit të dokumenteve justifikuese të shpenzimit (situacion, fatura, listëpagesa etj.).

3. Kompetencat dhe funksionet e AKFAL-it do të ushtrohen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, deri në momentin e ushtrimit të plotë të funksioneve dhe të kompetencave nga AKFAL-i.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTR
I **Edi**
Rama
SHTOJC
A 1

Tabela 1. Koeficientët e financimit bazuar në kosto mesatare për student sipas programeve të studimit.

Programet e studimeve	**Koeficienti i financimit bazuar në kosto**

Shkenca mjekësore	**mesatare**3.6
Infermieri	2.5
Shkenca të inxhinierisë	2.2
Shkenca natyrore	2.2
Shkenca kompjuterike	1.9
Agrikulturë dhe shkencë toke	2.2
Shkenca sociale (drejtësi, sociologji, politikë etj.)	1.0
Ekonomi dhe biznes	1.0
Filozofi (gjuhë, histori, gjeografi, letërsi, filozofi)	1.1
Edukim mësuesi	1.3
Arte figurative	5.0
Sporte	3.9

Formula e financimit llogarit shumën totale të grantit qeveritar të mësimdhënies dhe të të ardhurave të përllogaritura nga tarifat tavan të studentëve nga të gjitha universitetet në sistem, duke marrë parasysh diferencën në nivelin e tarifave të cilat do të paguhen nga studentët që ndjekin degë, nivele dhe vendndodhje të ndryshme.

Formula llogarit numrin e njësive të financimit për çdo universitet, bazuar në numrin e koeficientëve të studentëve, sipas degës së studimit dhe në bazë të faktorëve të tjerë të përshkruar më sipër, sipas formulës:

- *∑ totale e njësive të financimit = {Numri i studentëve që ndjekin ciklin e parë të studimeve X Koeficientet e financimit bazuar në kosto mesatare për student sipas programeve të studimit} + Numrin e studentëve në programet prioritare të konvertuar në njësi financimi.*

Pjesëtimi i vlerës totale të fondit që është në dispozicion (grant plus tarifa) me shumën e të gjitha njësive të financimit për të gjitha universitetet përllogarit nivelin e financimit për njësi financimi, sipas formulës:

- *∑ e financimit për njësi financimi = ë∑ e grantit vjetor +∑ e të ardhurave)]/ ∑ totale e njësive të financimit;*

Shuma e financimit bazë (grant plus të ardhurat nga tarifat e shkollimit) që çdo institucion do të marrë, do të jetë prodhimi i njësive totale të financimit shumëzuar me financimin për njësi financimi, sipas formulës:

- *∑* ***e financimit për IAL-në*** *= ∑ e financimit për një njësi financimi x Numrin e njësive të financimit*
- *∑* ***e gratit nga fondet e buxhetit që i takon IAL-s ë = Totalin e financimit*** *për IAL zbritur të ardhurat nga tarifat.*

Shembull: Për detajimin e fondeve pjesë e grantit për mësimdhënien "fondin për institucionet publike të arsimit të lartë", për dy universitete të cilat ofrojnë dy programe studimi në "shkenca natyrore" dhe "shkenca sociale".

- *Në programin e studimit "shkenca natyrore" koeficienti është 2.2, ndërsa programi i studimit "shkenca sociale" koeficienti është 1.0.*

- *Koeficienti i financimit shtesë, për degët prioritare është 5 për qind.*
- *Tarifat për "shkenca natyrore" jepen 1 000 lekë në vit për student, tarifat për "shkenca sociale" janë 500 lekë në vit për student.*
- *Granti total* ***"fondi për institucionet publike të arsimit të lartë"*** *për të gjithë sistemin është 200 000 lekë.*

- *Universiteti A ka 150 studentë, prej të cilëve 100 studiojnë në programin e studimit "shkenca natyrore" dhe 50 studentë në "shkenca sociale" dhe nga 150 studentë, 50 studentë ndjekin programet prioritare.*
- *Universiteti B, gjithashtu, ka 150 studentë, prej të cilëve 50 studiojnë në programin e studimit "shkenca natyrore" dhe 100 studentë në "shkenca sociale" dhe nga 150 studentë, 10 studentë ndjekin programet prioritare.*

Formula e financimit për institucionet publike të arsimit të lartë, ilustrim i shpërndarjes së grantit prej 200 000 lekësh)

	NR. I STUDENTËVE QË STUDIOJNË NË PROGRAMIN	**NR. I STUDENTËVE QË STUDIOJNË NË PROGRAMIN E**	**NR. I STUDENTËVE NË NJËSI FINANCIMI**	**NR. I STUDENTËVE QË NDJEKIN PROGRAME PRIORITARE**	**NJËSI FINANCIMI SHTESË PËR STUDENTË NË PROGRAME**	**TOTALI I NJËSI FINANCIMI SIPAS IAL-VE**
a	**E STUDIMIT**b	**STUDIMIT**C	d	e	**PRIORITARE** f	G=d+f
Univer A	100	50	270	50	5	**275**
Univer B	50	100	210	10	1	**211**
			484		**12**	**496**
	Nr. studentësh N	**Nr. studentësh Soc**	**Të ardhurat nga tarifa vjetore në lekë**	**Financimi total për çdo IAL (grant + të**	**Të ardhurat nga tarifat vjetore**	**Masa e financimit nga granti vjetor**
1	2	3	4	5	6	7
Univer A	100	50	125 000	240 483.54	125 000	115 483.5
Univer B	50	100	100 000	184 516.46	100 000	84 516.5
		Totali	**225 000**	**425 000.00**	225 000	200 000.0

A-GRANTI TOTAL VJETOR "*FONDIN PËR INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË" NË LEKË*	200 000.0
b - Të ardhurat vjetore nga tarifat e shkollimit, *në lekë*	225 000.0
TOTALI A +B në lekë	425 000.0
Numri total i njësive të financimit g=d+f	486.0
Fondi për njësi financimi në lekë (425,000 / 496 njësi = 874.5 lekë njësi)	874.5
Fondi për universitetin A është (275 njësi x 874.5 njësi = 240 483.5 lekë total, minus 125 000 lekë shumën e të ardhurave = 115 483.5 fond nga granti i mësimdhënies vjetore	115 483.5 lekë

Në këtë version të thjesht mund të verifikohet se: Universiteti "A" përfiton 275 njësi financimi dhe merr një fond total prej 240 483.5 lekësh; Universiteti "B" përfiton 211 njësi financimi dhe merr një fond në total prej 184 516.46 lekësh.

VENDIM

Nr. 88, datë 14.02.2018

PËR "KRIJIMIN E QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE TË RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR (RASH)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 9704, datë 2.4.2007, "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të një rrjeti telematik për universitetet", dhe të neneve 96 e 129, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Riorganizimin e Qendrës Ndëruniversitare të Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik (QNSHRRT) në Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), sipas marrëveshjes së krijimit ndërmjet universiteteve dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. 2. Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar ka statusin e personit juridik publik dhe gëzon autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit. Fushat e kërkimit dhe objekti i veprimtarisë së Qendrës Ndërinstitu-cionale të Rrjetit Akademik Shqiptar të jenë për institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor. 3. Qëllimi i Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar është: a) zhvillimi dhe promovimi i projekteve të kërkim-zhvillimit dhe inovacionit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) për arsimin dhe shkencën; b) krijimi i infrastrukturës për ngritjen e një qendre të përbashkët ndërdisiplinore kërkim-zhvillimi (TIK) nga IAL-të pjesëmarrëse apo palë të treta; c) koordinimi i pjesëmarrjes së kërkuesve vendës në projektin evropian të kërkimit GÉANT dhe projekte të tjera në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), pjesë përbërëse e programit kuadër evropian të kërkim-zhvillimit dhe inovacionit; ç) zhvillimi i programeve softëare dhe ofrimi i shërbimeve përkatëse për ministrinë përgjegjëse për arsimin, agjencitë e varësisë për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, institucionet e arsimit të lartë, të kërkimit shkencor dhe inovacionit e për të gjithë anëtarësinë e RASH-it, si dhe për palë të treta. 4. Për realizimin e qëllimit të saj, Qendra

Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar kryen veprimtaritë e mëposhtme: a) Zhvillimin dhe ofrimin e sistemeve më të përparuara softëare për administrimin e procesit të aplikimit universitar, menaxhimin e proceseve akademiko-shkencore dhe administrative-univer-sitare dhe platformave për formimin dhe testimit on-line për arsimin e lartë, në kuadër të rritjes së cilësisë në arsim dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e kërkimit dhe të zhvillimit, të drejtuara nga komuniteti shkencor dhe arsimor ndërkombëtar; b) Marrjen e masave të nevojshme të sigurisë dhe të ruajtjes së informacionit (back up) për bazat e të dhënave që krijon ose administron për llogari të IAL-ve pjesëmarrëse, ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe agjencive të varësisë për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor apo palëve të treta dhe ndërveprimi i këtyre bazave të të dhënave për të gjithë anëtarësinë e RASHit; c) Mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave për arsimin dhe kërkimin shkencor, për llogari të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si një burim i të dhënave, i statistikave dhe i analizave; ç) Zhvillimin dhe zgjerimin e rrjetit telematik kombëtar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, duke i garantuar komunitetit arsimor, akademik dhe kërkimor shqiptar lidhjen ndërqytetëse, ndërkufitare, lidhjen me rrjetin evropian të arsimit dhe kërkimit GÉANT e ofrimin e shërbimeve të këtij rrjeti në Shqipëri, si dhe lidhjen me rrjetet botërore të arsimit dhe kërkimit; d) Zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës Cloud computing dhe Supercomputing nëpërmjet Qendrës së të Dhënave për Arsimin dhe Shkencën (Datacenter) dhe çdo infrastrukture tjetër TIK të nevojshme për IAL-të dhe institucionet pjesëmarrëse; dh) Promovimin e mobilitetit të maturantëve dhe studentëve përmes shkëmbimit të të dhënave të tyre elektronike, pjesë e rrjetit ndërkombëtar të

"Deklaratës së Gronigenit"; e) Pjesëmarrjen në rrjetin evropian të sistemeve informatike universitare EUNIS, në shërbim të zgjerimit të spektrit të shërbimeve TIK për anëtarësinë; ë) Organizimin e veprimtarive mësimore dhe trajnuese që finalizohen me lëshimin e certifikatës përkatëse. 5. Burimet e financimit të Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar janë: a) fondet, sipas marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të rrjetit telematik për universitetet, të ratifikuar me ligjin nr. 9704, datë 2.4.2007; b) fondet nga buxheti i shtetit; c) kontributi vjetor i anëtarësisë nga IAL-të dhe institucionet e tjera; ç) kontributi vjetor i ministrisë përgjegjëse për arsimin, i agjencive dhe IAL-ve, sipas shërbimeve përkatëse të ofruara; d) të ardhurat që krijohen nga shitja e shërbimeve të qendrës për institucione e ente publike, si dhe shërbime të tjera për të tretë; dh) donacionet, subvencionet dhe kontribute të tjera; e) të ardhura të tjera të ligjshme. 6. Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar do të vijojë të përdorë të gjitha asetet e luajtshme dhe të paluajtshme që disponon, si kontribut në natyrë i bashkëkrijuesit, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. 7. Qendra

Ndëruniversitare e Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik (QNSHRRT) përfundon veprimtarinë e saj me zgjedhjen e organeve të reja drejtuese të Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar. Zbatimi i marrëveshjes së ratifikuar me ligjin nr. 9704, datë 2.4.2007, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të një rrjeti telematik për universitetet", deri në përfundimin e afatit të saj, i kalon Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar. 8. Vendimi nr. 236, datë 6.3.2009, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Qendra Ndëruniversitare të Shërbimeve dhe

Rrjetit Telematik", i ndryshuar, shfuqizohet. 9. Në listën 2, që i bashkëlidhet vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së

Informacionit", emërtimi "Qendra Ndëruniversitare e Shërbimeve dhe e Rrjetit Telematik" hiqet. 10. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe universitetet krijuese të Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 112, datë 23.02.2018

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR" DHE TË STANDARDEVE SHTETËRORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË "PROFESOR I ASOCIUAR" DHE "PROFESOR" *(Ndryshuar me VKM nr. 808, datë 11.12.2019)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 60 dhe të pikës 7, të nenit 79, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

KREU I

KRITERET PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"

1. Studimet për gradën shkencore "Doktor", zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, pranë institucioneve të arsimit të lartë të llojit "Universitet" ose "Akademi", të cilët plotësojë kriteret ligjore dhe ato të përcaktuara në këtë vendim.

2. Grada shkencore "Doktor" fitohet, pas mbrojtjes me sukses të tezës së disertacionit, në përfundim të studimeve të doktoratës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, sipas kritereve dhe brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

3. Studimet e doktoratës zhvillohen në formën e grupeve kërkimore, të cilat drejtohen nga personeli akademik që kanë titullin akademik "Profesor i Asociuar" ose "Profesor". Numri i doktorantëve në përbërje të secilit grup kërkimor, i cili përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, ku ai është i angazhuar, është:
   a) jo më shumë se 7 (shtatë), në rastin e personelit akademik që mban titullin "Profesor";
   b) jo më shumë se 5 (pesë), në rastin e personelit akademik që mban titullin "Profesor i Asociuar";
   c) jo më shumë se 3 (tre), në rastin kur personeli akademik që ka titullin akademik "Profesor i Asociuar" ose "Profesor" është i angazhuar me kohë të pjesshme.

4. Kandidati aplikon individualisht në programin e studimit të miratuar në fushat e kërkimit shkencor të ofruara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Njësia bazë miraton programet individuale të kërkimit të kandidatëve, vetëm për ato fusha që i përkasin programeve të miratuara të doktoratës që ajo ofron. Kur fushat e kërkimit janë të ndërthurura ndërmjet dy ose më shumë njësive bazë, njëra prej njësive bazë caktohet përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në dakordësi ndërmjet tyre.

5. Njësia kryesore përcakton në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve kriteret specifike:
   a) që kandidati duhet të plotësojë për t'u pranuar apo për të transferuar studimet në programin e studimit, sipas fushës së kërkimit;
   b) për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor gjatë periudhës së studimeve të doktoratës;
   c) që kandidati duhet të plotësojë përpara mbrojtjes përfundimtare të tezës së disertacionit;
   d) kur studimet e doktoratës ndërpriten, shtyhen ose pezullohen;
   e) për afatet e pagesës për të gjithë ciklin e programit.

6. Kriteret bazë që duhet të plotësojë kandidati përpara mbrojtjes së disertacionit janë:
   a) Të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, së paku 3 (tre) referime, 2 (dy) nga të cilat, janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet e anëtarë të Bashkimit Evropian, OECDsë, ose G20, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe i botuar në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;

b) të ketë botuar së paku 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 2 (dy) të jenë botuar ose pranuar për botim në revista të indeksuara të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20, me bord editorial, ku së paku në njërin prej tyre të jetë autor i parë dhe në tjetrin, autor i dytë.

7. Kandidati harton disertacionin sipas formatit të miratuar në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve. Disertacioni duhet të sjellë risi teorike dhe/ose empirike në fushën përkatëse të kërkimit, si edhe të jetë një kontribut në avancimin e njohurive shkencore. Disertacioni hartohet në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje e tij (2000 - 4000 fjalë), në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, në format të shtypur dhe elektronik. Disertacioni miratohet nga udhëheqësi shkencor, përpara dorëzimit.

8. Kandidati, dorëzon disertacionin, siç përcaktohet në pikën 7 të këtij Kreu, së bashku me dosjen, pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit. Pas vlerësimit nga njësia bazë, disertacioni dhe dosja e kandidatit i përcillet Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit. Juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj. Disertacioni prezantohet para jurisë, e cila e vlerëson atë. Juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", i cili brenda 10 ditëve merr vendim për dhënien e gradës shkencore "Doktor" dhe ia përcjell për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësisë kryesore.

9. Nëse njësia bazë jep vlerësim negativ për disertacionin dhe/ose dosjen, kandidati ka të drejtë të riparaqesë disertacionin dhe/ose dosjen të plotësuar, pas një periudhe jo më të shkurtër se 3 (tre) muaj.

10. Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", i cili monitoron procesin për dhënien e gradës shkencore "Doktor", përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë të zgjedhur të njësisë kryesore ku ofrohet programi i Doktoratës, që kanë titullin akademik "Profesor i Asociuar" ose "Profesor".

11. Juria për mbrojtjen e gradës shkencore "Doktor" ngrihet nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" dhe ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët të paktën 2 (dy) anëtarë i përkasin njësive bazë nga institucione homologe, vendase ose të huaja. Dy anëtarë të jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e disertacionit, njëri prej të cilëve i përket njësive bazë nga institucione homologe, vendase ose të huaja. Anëtarët e jurisë propozohen nga njësia bazë me miratimin e drejtuesit të njësisë kryesore. Numri i anëtarëve të propozuar është jo më pak se 8 (tetë).

12. Lista e të diplomuarve në programet e ciklit të tretë përcillet nga institucioni i arsimit të lartë në ministrinë përgjegjëse për arsimin për t'u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë dhe në regjistrat përkatës të IAL-së. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë për dhënien e gradës shkencore "Doktor" të nënshkruar nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe rektori.

13. Procedura më të detajuara për fitimin e gradës shkencore "Doktor", përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë (IAL) dhe rregulloren e ciklit të tretë të studimeve, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.

KREU II

STANDARDET PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK "PROFESOR I ASOCIUAR"

1. Titulli akademik "Profesor i asociuar" jepet nga institucionet e arsimit të lartë, të llojit "Universitet", të cilët plotësojnë kriteret ligjore dhe ato të përcaktuara në këtë vendim.

2. Aplikimet për fitimin e titullit akademik "Profesor i Asociuar" kryhen nga anëtarët e personelit akademik të kategorisë "Lektor".

3. Personeli akademik i kategorisë "Lektor", aplikon për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar", të paktën 5 (pesë) vjet nga data që ka mbrojtur gradën shkencore "Doktor".

4. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin "Profesor i asociuar", duhet:
   a) të ketë zhvilluar një cikël të plotë leksionesh për së paku një lëndë, për 3 (tre) vite akademike;
   b) të ketë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë së paku 5 (pesë) vjeçare, me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme si lektor për një periudhë 8 (tetë) vjeçare akademike, me apo pa ndërprerje, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor";
   c) të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle ose të mbrojë veprimtarinë kërkimore botuese përpara Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në një nga gjuhët e mësipërme, në përputhje me statutin dhe rregulloren e IAL-së.

5. Personeli akademik që aplikon për titullin "Profesor i asociuar", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:

   a) ka botuar së paku 5 (pesë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku 2 (dy) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga Thomson Reuters dhe/ose Scopus. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autori i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në të paktën dy artikuj shkencorë të paraqitura për fitimin e titullit.
   b) ka realizuar si autor i parë, së paku 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet e anëtarë të Bashkimit Evropian, OECD-së, ose G20, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe i botuar në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

6. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 4 të këtij Kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:

   a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore "Doktor," brenda vendit ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga të paktën 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore dhe te jetë pranuar nga njësia bazë që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga *SENSE Ranking of Academic Publishers,* në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre, kur ndryshojnë në përmbajtje me të paktën 70%. Monografia e botuar brenda vendit të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga të paktën 2 (dy) "Profesorë" të fushës kërkimore-shkencore nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet e anëtare të BE, OECD ose G20.

   b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:
   i. 2 (dy) artikuj shkencorë të botuar në revistë shkencore brenda vendit, ose ii. 1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

   c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:
   i. 4 (katër) artikuj shkencorë të botuar në revistë shkencore brenda vendit, ose ii. 2 (dy) artikuj shkencorë të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

7. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", në: a) komitete shkencore apo redaktuese;
   b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencore;
   c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;
   d) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
   e) projekte te financuara nga programe me donatorë te huaj, te cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
   f) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
   g) drejtues në komitetet organizues të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
   h) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

8. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 7 të këtij kreu, mund të ekuivalentohet me:
   a) 1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti ose
   b) 1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore brenda vendit dhe 2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet e anëtarë të Bashkimit Evropian, OECD-së, ose G20, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe i botuar në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

9. Niveli sasior i treguesve të përcaktuar në pikat 7 të këtij Kreu, si dhe vlera përkatëse e tyre, parashikohen në rregulloren përkatëse të IAL-ve dhe vendosen në funksion të prioriteteve akademike dhe strategjike të tyre. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në pikën 7 të këtij kreu, hartohet nga njësia bazë dhe njësia kryesore dhe miratohet nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik.

10. Në rastet kur kandidati ka realizuar studim post-doktoratë në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD ose G20, me një kohëzgjatje të paktën 6 (gjashtë) muaj, shoqëruar me raport të detajuar për aktivitetin kërkimor – shkencor të zhvilluar gjatë kësaj periudhe, ai ekuivalentohet me 1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti dhe 1 (një) referim mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet e anëtarë të Bashkimit Evropian, OECD-së, ose G20, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe i botuar në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

11. Për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar", botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së gradës shkencore "Doktor" deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik "Profesor i asociuar".

12. IAL-të përcaktojnë në rregulloret e tyre përkatëse kriteret për vlerësimin akademiko-didaktik të kandidatëve për fitimin e titujve akademikë.

KREU III

STANDARDET PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK "PROFESOR"

1. Titulli akademik "Profesor", jepet nga institucionet e arsimit të lartë, të llojit "Universitet", të cilët plotësojnë kriteret ligjore dhe ato të përcaktuara në këtë vendim.

2. Personeli akademik, i cili ka titullin akademik "Profesor i Asociuar", aplikon për fitimin e titullit akademik "Profesor", të paktën 5 (pesë) vite pas fitimit të titullit akademik "Profesor i Asociuar".

3. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik "Profesor", duhet:
   a) të ketë qenë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore për një periudhë jo më të shkurtër se 5 (pesë) vite akademike;
   b) të jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë si lektor për një periudhë 8 (tetë) vjeçare akademike pas fitimit të gradës shkencore "Doktor" ose me kohë të pjesshme si lektor për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) vjeçare akademike pas fitimit te gradës shkencore "Doktor";
   c) të ketë udhëhequr, të paktën 2 (dy) doktorata, të përfunduara. Në rast se, kandidati ka ushtruar veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzetë) personel akademik me kohë të plotë, në momentin e aplikimit të ketë udhëhequr të paktën 1 (një) doktoratë të përfunduar;
   d) të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle ose të mbrojë veprimtarinë kërkimore shkencore përpara

Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në një nga këto gjuhë, në përputhje me statutin dhe rregulloren e IAL-së.

4. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin "Profesor", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve të mëposhtme:
   a) ka botuar së paku 7 (shtatë) artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku 3 (tre) prej artikujve, të jenë botuar në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga Thomson Reuters dhe/ose Scopus. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autori i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i parë në të paktën 4 (katër) artikuj shkencorë të paraqitura për fitimin e titullit.
   b) ka realizuar si autor i parë, së paku 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku 2 (dy), janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet e anëtarë të Bashkimit Evropian, OECD-së, ose G20, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe i botuar në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

5. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjën "a" të pikës 4 të këtij Kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:

   a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore e botuar pas fitimit të gradës shkencore "Profesor i Asociuar" brenda vendit ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga të paktën dy vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore dhe të jetë pranuar nga njësia bazë që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga *SENSE Ranking of Academic Publishers,* në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre, kur ndryshojnë në përmbajtje me të paktën 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga të paktën 2 (dy) "Profesorë" të fushës kërkimoreshkencore nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet e BE, OECD ose G20.

   b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:
      i. 2 (dy) artikuj shkencorë të botuar në revistë shkencore brenda vendit, ose ii. 1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

   c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:
      i. 4 (katër) artikuj shkencorë të botuar në revistë shkencore brenda vendit, ose ii. 2 (dy) artikuj shkencorë të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

6. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik "Profesor i Associuar", në:
   a) komitete shkencore apo redaktuese;
   b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencore;
   c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;

d) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
e) projekte te financuara nga programe me donatorë te huaj, te cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
f) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
g) drejtues në komitetet organizues të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
h) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

7. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 5 të këtij kreu, mund të ekuivalentohet me:

   a) 1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti ose
   b) 1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore brenda vendit dhe 2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet e anëtarë të Bashkimit Evropian, OECD-së, ose G20, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe i botuar në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

8. Niveli sasior i treguesve të përcaktuar në pikat 6 të këtij Kreu, si dhe vlera përkatëse e tyre, parashikohen në rregulloren përkatëse të IAL-ve dhe vendosen në funksion të prioriteteve akademike dhe strategjike të tyre. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në pikën 6 të këtij kreu, hartohet nga njësia bazë dhe njësia kryesore dhe miratohet nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik.

9. Për fitimin e titullit akademik "Profesor", botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së titullit akademik "Profesor i Asociuar" deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik "Profesor".

10. IAL-të përcaktojnë në rregulloret e tyre përkatëse kriteret për vlerësimin akademiko-didaktik të kandidatëve për fitimin e titujve akademikë.

KREU IV

PROCEDURAT PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

1. Kandidati paraqet kërkesën dhe dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë, brenda 20 (njëzetë) ditëve. Pas vlerësimit nga njësia bazë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, dosja e kandidatit i përcillet Senatit Akademik, i cili, brenda 20 (njëzetë) ditëve nga marrja e dosjes, ia përcjell Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.

2. Nëse njësia bazë jep vlerësim negativ, dosja i kthehet drejtuesit të njësisë kryesore me argumentet dhe sugjerimet përkatëse. Kandidati ka të drejtë të aplikojë sërish brenda një afati kohor prej 6 (gjashtë) muajsh. Vendimi i njësisë bazë merret nga shumica e anëtarëve të saj.

3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përcjelljes së dosjes nga Senati, Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik, vlerëson nëse dosja e dorëzuar nga kandidati është e plotë apo jo. Në rast

se dosja konsiderohet e plotë, Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik vijon menjëherë me ngritjen e jurisë për vlerësimin e dosjes. Në rast të evidentimit të mangësive në dosjen e kandidatit, atij i jepen 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë, për të bërë plotësimet e nevojshme. Në rast se ato nuk plotësohen dosja i kthehet kandidatit.

4. Data e nisjes së procedurës së vlerësimit të kandidatit konsiderohet data e ngritjes së jurisë.

5. Juria përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë me titullin akademik "Profesor", të së njëjtës fushë ose fushave të ngjashme me atë të kandidatit, prej të cilëve, të paktën 2 (dy) duhet të jenë të ftuar nga IAL të tjera, vendase ose të huaja. Anëtarët e jurisë propozohen nga drejtuesi i njësisë kryesore me miratimin e rektorit. Numri i anëtarëve të propozuar është jo më pak se 8 (tetë).

6. Brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga data e nisjes së procedurës së vlerësimit, juria përgatit raportin e vlerësimit të kapaciteteve akademiko – didaktike dhe shkencore të kandidatit, në përfundim të të cilit, jepet edhe rekomandimi për dhënien ose jo të titullit akademik. Raporti i vlerësimit, i përcillet Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.

7. Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik merr vendim përfundimtar për miratimin ose refuzimin e kërkesës së kandidatit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas marrjes së raportit të vlerësimit nga juria.

8. Në rast refuzimi të kërkesës për fitimin e titujve akademikë nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik, kandidatit i lind e drejta të ripërsërisë kërkesën, pas një periudhe kohore, jo më të shkurtër se 2 (dy) vite, nga data e paraqitjes së kërkesës së mëparshme pranë drejtuesit të njësisë kryesore.

9. Titulli akademik regjistrohet në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe në regjistrat përkatës të IAL-së. Titulli akademik lëshohet nga institucioni dhe nënshkruhet nga rektori.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

1. Institucioni i arsimit të lartë mund të akordojë titullin "Doctor Honoris Causa" për figura të shquara të shkencës dhe shoqërisë, brenda e jashtë vendit, për kontribut të veçantë në zhvillimin e arsimit dhe të shkencës, si dhe në zhvillimin e vendit tonë në tërësi. Ky titull jepet me vendim të Senatit Akademik të institucionit pasi merret pëlqimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin.

   Numri i titujve "Doctor Honoris Causa" që një IAL mund të akordojë, si rregull, nuk mund të jetë më shumë se 2 (dy) në vit.

2. Institucioni i arsimit të lartë përcakton në rregulloren e brendshme, procedurën dhe kriteret për fitimin e titullit "Profesor Emeritus" nga anëtarët e personelit akademik që mbajnë titullin

"Profesor", pas daljes së tyre në pension, pasi merret pëlqimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin.

3. Lista e plotë e revistave shkencore, të botuara brenda vendit, botohet në muajin shkurt të çdo viti, nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

4. Kandidatët e regjistruar në programet e studimit të ciklit të tretë, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, përmbushin kriteret e përcaktuara nga legjislacionin në fuqi në momentin e regjistrimit në programin e studimit të ciklit të tretë.

5. Kandidatët, të cilët kanë filluar procedurën për marrjen e gradës shkencore "Doktor", e përfundojnë atë, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në momentin e fillimit të procedurës.

6. Kandidatët, të cilët nuk kanë filluar procedurën e marrjes së gradës shkencore "Doktor", do të ndjekin procedurën e përcaktuar në këtë vendim.

7. Kandidatët, të cilët kanë filluar procedurën për marrjen e titujve akademikë dhe kanë kaluar fazën e miratimit nga Këshilli i Profesorëve, e mbyllin procedurën për marrjen e titullit akademik, sipas kritereve të legjislacionit në fuqi në momentin e dorëzimit të dosjes në Këshillin e Profesorëve. Këta kandidatë, ndjekin procedurat e përcaktuara në këtë vendim, për fazën përfundimtare në Komisionin për Promovimin e Personelit Akademik.

8. Kriteret dhe procedurat për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor" për fushat akademike ushtarake, të policisë, të arteve dhe të sportit, rregullohen me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave.

9. Përjashtimisht, për vitin 2018, afati i përcaktuar në pikën 3 të këtij Kreu, është muaji qershor 2018.

10. Vendimi nr. 467, datë 18.07.2007 i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për kualifikimin, shkencor e pedagogjik, të personelit akademik", i ndryshuar dhe Vendimi nr. 864, datë 5.12.2007 i Këshillit të Ministrave, "Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë studenti, për marrjen e diplomës për gradën shkencore "Doktor" , i ndryshuar, shfuqizohen.

11. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

EDI RAMA

K R Y E M I N I S T Ë R

VENDIM

Nr. 165, datë 21.03.2018

PËR METODOLOGJINË E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË VEPRIMTARISË KËRKIMORE-SHKENCORE TË NJËSIVE BAZË TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozim të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Miratimin e metodologjisë së procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë, mbështetur në kriteret e vlerësimit, të përcaktuara në këtë vendim.

2. Kriteret vlerësimit të njësive bazë përfshijnë një listë treguesish që përllogariten sipas kontributit katërvjeçar të njësisë bazë në fushën e kërkimit shkencor, vlerësim i cili realizohet sipas një sistemi pikëzimi, të miratuar me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Njësitë bazë të institucioneve të arsimit të lartë, për efekt të procesit të vlerësimit, grupohen sipas fushave e nënfushave kryesore natyrore, inxhinierike e teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale e humane, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, llojeve të IAL-ve, formës së organizimit, publike apo jopublike, si dhe sipas veprimtarisë kryesore të departamenteve, qendrave kërkimoreshkencore apo qendrave studimore ndërdisiplinore.

4. Procesi i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë realizohet çdo katër vjet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

a) Kriteri bibliometrik:

i) Lista e artikujve të botuar në revista ndërkombëtare shkencore me faktor impakti, si dhe në revista akademike ndërkombëtare të indeksuara dhe të recensionuara;

ii) Lista e artikujve të botuar brenda vendit në revista shkencore dhe buletine shkencore të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

iii) Lista e monografive shkencore të botuara në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës, të vlerësuara si punime shkencore nga njësia bazë;

iv) Lista e monografive shkencore të botuara brenda vendit, të vlerësuara si punime shkencore nga njësia bazë;

v) Lista e kapitujve të librave akademikë, të redaktuar, të recensionuar dhe të botuar në vendet e BEsë, OECD-së dhe G-20-ës dhe të vlerësuar si punime shkencore nga njësia bazë;

vi) Lista e kapitujve të librave akademikë, të redaktuar, të recensionuar dhe të botuar brenda vendit, si dhe të vlerësuar si punime shkencore nga njësia bazë.

b) Kriteri i impaktit të veprimtarisë kërkimore-shkencore:
i) Lista e patentave apo e shpikjeve të regjistruara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale apo autoriteteve të huaja;

ii) Lista e projekteve kërkimore-shkencore të fituara nga programet kuadër të BE-së për kërkim shkencor, si koordinator projekti ose si partner në projekt;

iii) Lista e sipërmarrjeve të reja, të krijuara si rezultat i punës kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucioneve të arsimit të lartë; iv) Lista e kontratave të shërbimit me objekt studimor.

c) Kriteri infrastrukturor:

i) Lista e laboratorëve shkencorë të akredituar ose jo;

ii) Lista e bibliotekave të profilizuara dhe kapaciteti fizik i tyre, i shprehur në vende/poste punekërkimi; iii) Lista e arkivave dhe e koleksioneve shkencore; iv) Lista e abonimeve në revista apo e botimeve shkencore periodike, përshirë dhe ato elektronike. ç) Kriteri i kapaciteteve njerëzore:

i) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, me tituj akademikë: “profesor”, “profesor i asociuar”, “lektor” dhe “asistent lektor” , me kohë të plotë, në momentin e deklarimit;

ii) Lista e konferencave shkencore ndërkombëtare, të organizuara nga njësia bazë në bashkëpunim me homologët e saj, në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës; iii) Lista e konferencave shkencore kombëtare të organizuara nga njësia bazë;

iv) Lista e pjesëmarrjes së personelit akademik të njësisë bazë, me referime shkencore, në konferenca shkencore ndërkombëtare në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;

v) Lista e pjesëmarrjes me referime shkencore të personelit akademik të njësisë bazë në konferenca shkencore kombëtare;

vi) Lista e çmimeve ndërkombëtare shkencore të fituara nga personeli akademik i njësisë bazë në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës; vii) Lista e çmimeve kombëtare shkencore të fituara nga personeli akademik i njësisë bazë; viii) Lista e programeve të "master ekzekutiv", "specializime afatgjata në mjekësi" dhe "doktoratë";

ix) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore të revistave shkencore periodike në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;
x) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore për botime shkencore joperiodike në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;

xi) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore të revistave shkencore vendëse, të n johura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

xii) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore për botime shkencore joperiodike vendëse;

xiii) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë të komiteteve shkencore të konferencave shkencore ndërkombëtare, të organizuara në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;

xiv) Lista e recensuesve nga personeli akademik i njësisë bazë për artikuj shkencorë të botuar në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës.

d) Kriteri i ndërkombëtarizimit:

i) Lista e studimeve dhe e kërkimeve lëndore ose ndërdisiplinore të aplikuara me partner të vendeve të OECD-së dhe BE-së/të tjerë;

ii) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, të angazhuar në institucionet e arsimit të lartë të vendeve të OECD-së dhe BE-së, e matur person/në javë;

iii) Lista e personelit të huaj akademik të njësisë bazë nga vendet e OECD-së dhe BE-së, të ftuar pranë njësisë bazë, e matur person/në javë; iv) Lista e programeve të studimit për "master i shkencave" dhe të ciklit të tretë, të përbashkëta me IAL-të e huaja nga vendet e OECD-së dhe të BE-së, që përfundojnë me lëshimin e një diplome të përbashkët ose të dyfishtë.

5. Vlerësimi për çdo tregues që përbën kriteret e vlerësimit, në nivel njësie bazë, realizohet nëpërmjet një sistemi pikëzimi algoritmik, në mënyrë automatike nga platforma elektronike, Sistemi i Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor - ACRIS.

6. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit organizon, administron, monitoron dhe publikon rezultatet e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë.

7. Institucioni i arsimit të lartë, pas marrjes së njoftimit nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, njofton dhe vendos afate për personelin akademik të njësive bazë, që të realizojnë procesin përkatës të plotësimit të të dhënave të kërkuara, në portalin "Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore", në platformën ACRIS.

8. Drejtuesi i njësisë bazë udhëzon, monitoron dhe ndjek të gjitha vetëdeklarimet e të dhënave të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucionit të arsimit të lartë, duke kërkuar nga të gjithë anëtarët e njësisë përgjegjshmëri në plotësimin e informacionit, sipas kritereve të përcaktuara, në portalin "Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore".

II. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE GJATË PROCESIT TË VLERËSIMIT

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit janë si më poshtë:

a) Të organizojë dhe të administrojë procesin e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucionit të arsimit të lartë, nëpërmjet portalit "Vlerësimi i veprimtarisë kërkimoreshkencore në Shqipëri";

b) Të njoftojë institucionet e arsimit të lartë, nëpërmjet manualeve elektronike dhe të shkruara, për mënyrën e regjistrimit të të dhënave nga njësitë bazë në sistem, për afatet e plotësimit të formularëve të vlerësimit online e të tjera;

c) Të publikojë raportin përfundimtar të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë dhe renditjen e tyre, në formë elektronike dhe të printuar.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë bazë dhe të drejtuesve të njësive kryesore në institucionet e arsimit të lartë gjatë procesit të vlerësimit janë si më poshtë:

a) Të caktojë një person kontakti brenda njësisë bazë që ndjek procesin e realizimit në afat të vlerësimit;

b) Të koordinojë, të monitorojë dhe të ndjekë procesin e hedhjes së të dhënave nga personeli akademik i njësive bazë të IAL-ve, brenda afatit të përcaktuar.

III. ORGANIZIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT

1. Anëtarët e personelit akademik të njësisë bazë do të kenë akses individual të përdoruesit të kodifikuar dhe të mbrojtur, për vetëdeklarimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të drejtimeve kryesore të fushave të kërkimit dhe të disiplinave specifike.

2. Drejtuesi i njësisë bazë ka akses individual të përdoruesit të kodifikuar dhe të mbrojtur që shërben për ndjekjen dhe monitorimin e të dhënave të deklaruara nga anëtarët e personelit akademik të njësisë bazë.

3. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit është përgjegjëse në bashkëpunim me Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar për administrimin e portalit "Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore", sigurimin dhe ruajtjen e të dhënave të publikuara, zbatimin standardeve të përgjithshme të vlerësimit dhe certifikimin e rezultateve të vlerësimit.

IV. PLAFTFORMA ON-LINE ACRIS - ALBANIA CURRENT RESEARCH INFOR-MATION SISTEM-PLATFORMA ON-LINE E SISTEMIT SHQIPTAR TË INFORMACIONIT TË KËRKIMIT SHKENCOR

1. Për vlerësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë krijohet platforma e Sistemit Shqiptar të Informacionit të Kërkimit Shkencor-ACRIS, e cila shërben si bazë kombëtare të dhënash për kërkimin shkencor, sipa s përcaktimeve të nenit 13, të ligjit nr. 87/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të realizuara mbi bazën e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë.

2. Në bazë të të dhënave të hedhura në sistemin ACRIS nga njësitë bazë të institucioneve të arsimit të lartë, vlerësimi gjenerohet me pikë, automatikisht nëpërmjet algoritmit kompjuterik të sistemit të pikëzimit, për çdo kriter e indikator të përcaktuar në këtë vendim.

3. Në bazë të këtij sistemi vlerësimi, njësitë bazë të institucioneve të arsimit të lartë renditen brenda së njëjtës fushë kërkimi dhe në bazë të IAL-ve, si dhe hartohet raporti përfundimtar që i përcillet Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Njësitë bazë të institucioneve të arsimit të lartë, që i nënshtrohen procesit të vlerësimit, brenda dhjetorit 2019, plotësojnë dhe vetëdeklarojnë në platformën ACRIS veprimtarinë e tyre kërkimoreshkencore, sipas treguesve të kritereve të përcaktuara në këtë vendim.

2. Procesi i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë fillon jo më vonë se muaji tetor 2019.

3. Urdhri i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për sistemin e pikëzimit të treguesve, që përbëjnë kriteret e metodologjisë së vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë miratohet brenda muajit maj 2018.

4. Kriteret dhe procedurat për vlerësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë për institucionet e arsimit të lartë me drejtim ushtarak, policor, artistik dhe sportiv, përcaktohen me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet e arsimit të lartë, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe Rrjeti Akademik Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

SHTOJCA 1

KLASIFIKIMI I FUSHAVE DHE I NËNFUSHAVE TË KËRKIMIT SHKENCOR

Nr. Fushat kryesore Nënfusha

1 Shkenca të natyrës Matematikë dhe Informatikë
Fizikë

Kimi

Shkenca të tokës

Biologji

2 Shkenca inxhinierike dhe teknologjike Inxhinieria mekanike, elektrike ekonomike, materiale, fizike, navale, tekstil

Inxhinieri e teknologjisë së informacionit, Inxhinieri matematike

Inxhinieri e ndërtimit, mjedisit, Arkitektura

Inxhinieri e gjeologjisë, minierave

3 Mjekësia Mjekësi, Farmaci, Stomatologji, Shkenca teknike mjekësore

4 Shkenca sociale dhe humanitare Shkenca politike dhe sociale

Histori, Filozofi, Pedagogji, Psikologji

Shkenca juridike

Shkenca të antikitetit, filologjisë, letërsisë

Ekonomi dhe Statistikë

5 Shkenca bujqësore Bujqësi

Veterinari

VENDIM

Nr. 216, datë 20.04.2018,

PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019 *(Ndryshuar me VKM nr.387,datë 12.6.2019)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose për të transferuar studimet në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në këtë vendim.

2. Për të gjithë kandidatët, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, nota mesatare për pranimin në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose për të transferuar studimet në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019, të jetë nota 6 (gjashtë). Nota mesatare për pranimin në institucionet e arsimit të lartë përllogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve, si më poshtë vijon:

a) Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë.

b) Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.

3. Për kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimit të fushës së mësuesisë, për vitin akademik 2018-2019, nota mesatare e përllogaritur, sipas këtij vendimi, të jetë nota 7 (shtatë). Programet e studimit të fushës së mësuesisë përcaktohen në shtojcën 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi. Nota mesatare për pranimin në programet e mësuesisë përllogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve të përcaktuar në shkronjat "a" e "b", të pikës 2, të këtij vendimi.

4. Kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare, me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi.

5. Institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe njësitë arsimore vendore janë përgjegjëse për përllogaritjen e notës mesatare dhe dërgimin e këtyre të dhënave në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.

6. Procedurat për njëvlershmërinë e dokumenteve të paraqitura nga shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, dhe përllogaritja e notës mesatare për këta kandidatë kryhen në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij vendimi. Në rastet kur nuk aplikohen provimet e Maturës Shtetërore, komisioni përkatës përcakton mënyrën e përllogaritjes së notës mesatare. Komisioni përkatës dërgon të dhënat te njësia arsimore përkatëse.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, njësitë arsimore vendore dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

SHTOJCA 1

Nr. INSTITUCIONI I ARSIMIT TE LARTË PROGRAMI I STUDIMIT NOTA MESATARE

1 Universiteti i Tiranës Biologji 7

2

Filozofi 7

3

Fizikë 7

4

Gjeografi 7

5

Gjuhë angleze 7

6

Gjuhë angleze (Sarandë) 7

7

Gjuhë frënge 7

8

Gjuhë gjermane 7

9

Gjuhë greke 7

10

Gjuhë italiane 7
11

Gjuhë - letërsi 7

12

Gjuhë ruse 7

13

Gjuhë spanjolle me profil gjuhë - letërsi dhe qytetërim hispanik 7

14

Gjuhë turke 7

15

Histori 7

16

Informatikë 7

17

Kimi 7

18

Matematikë 7

19

Psikologji 7

20

Sociologji 7

Nr. Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” PROGRAMI I STUDIMIT NOTA MESATARE

1

Biologji - kimi 7

2
Edukim qytetar 7

3

Filozofi - sociologji 7

4

Gjeografi dhe gjuhë italiane 7

5

Gjuhë - letërsi 7 6

Gjuhë angleze 7

7

Gjuhë frënge 7

8

Gjuhë gjermane 7

9

Gjuhë italiane 7

10

Histori - gjeografi 7

11

Histori dhe gjuhë gjermane 7

12

Matematikë informatike 7

13

Matematikë - fizikë 7

14
Mësuesi për arsimin parashkollor 7

15

Mësuesi për arsimin fillor 7

16

Psikologji 7

Nr. Universiteti “Aleksandër

Moisiu”,

Durrës PROGRAMI I STUDIMIT NOTA MESATARE

1

Gjermanisht-anglisht 7

2

Gjuhë angleze 7

3

Gjuhë - letërsi - anglisht 7

4

Histori 7

5

Informatikë - anglisht 7

6

Matematikë - informatikë 7

7

Mësuesi për arsim fillor 7

8

Mësuesi për arsim parashkollor 7
9 Psikologji sociologji 7

Nr. Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjiro kastër PROGRAMI I STUDIMIT NOTA MESATARE

1

Biologji - kimi 7

2

Gjuhë - letërsi shqipe 7

3

Gjuhë - letërsi angleze 7

4

Gjuhë - letërsi dhe qytetërim grek 7

5

Gjuhë - letërsi italiane 7

6

Histori - gjeografi 7

7

Matematikë - informatikë 7

8

Mësuesi për arsimin fillor 7

9

Mësuesi për arsimin parashkollor 7

10

Fizikë dhe teknologji informacioni 7

Nr. Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë PROGRAMI I STUDIMIT NOTA MESATARE

1
Biologji - kimi 7

2

Filozofi - sociologji 7

3

Gjuhë angleze 7

4

Gjuhë dhe kulturë frënge 7

5

Gjuhë - letërsi 7

6

Histori - gjeografi 7

7

Matematikë - fizikë 7

8

Matematikë - informatikë 7

9

Mësuesi për arsimin fillor 7

10

Mësuesi për arsimin parashkollor 7

Nr. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë PROGRAMI I STUDIMIT NOTA MESATARE

1

Biologji 7

2

Fizikë 7
3

Gjuhë angleze 7

4

Gjuhë italiane 7

5

Gjuhë shqipe dhe letërsi 7

6

Histori - gjeografi 7

7

Informatikë 7

8

Kimi 7

9

Matematikë 7

10

Mësuesi për arsimin fillor 7

11

Mësuesi për arsimin parashkollor 7

12

Pedagogji e specializuar 7

Nr. Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër PROGRAMI I STUDIMIT NOTA MESATARE

1

Biologji - kimi 7

2
Fizikë 7

3

Gjeografi 7

4

Gjuhë - letërsi 7 5

Gjuhë angleze 7

6

Gjuhë frënge 7

7

Gjuhë gjermane 7

8

Gjuhë italiane 7

9

Histori 7

10

Informatikë 7 11

Matematikë 7

12

Mësuesi arsimi fillor 7

13

Mësuesi arsimi parashkollor 7

14
Pedagogji muzikore 7

15 Pikturë e grafikë 7

16

Psikologji 7

Nr Kolegji Universitar “Bedër” PROGRAMI I STUDIMIT NOTA MESATARE

1

Arsimi parashkollor dhe fillor 7

2

Gjuhë dhe letërsi angleze 7

3

Psikologji këshillimi dhe pedagogji 7

Nr. Kolegji Universitar “ËISDOM” PROGRAMI I STUDIMIT NOTA MESATARE

1

Psikologji 7

Nr. Shkolla e lartë universitare, jopublike,

universiteti “Marin

Barleti” PROGRAMI I STUDIMIT NOTA MESATARE

1

Psikologji 7

Nr. Universiteti Europian i Tiranës PROGRAMI I STUDIMIT NOTA MESATARE

1

Psikologji 7

2

Sociologji - antropologji sociale 7
Nr. Universiteti i Neë York-ut në Tiranë PROGRAMI I STUDIMIT NOTA MESATARE

1

Psikologji 7

Nr. Universiteti Privat “Albanian University” PROGRAMI I STUDIMIT NOTA MESATARE

1

Anglisht 7

2

Mësuesi për arsimin fillor 7

3

Mësuesi për arsimin parashkollor 7

4

Psikologji e përgjithshme 7

VENDIM

Nr. 229, datë 26.04.2018

PËR RIORGANIZIMIN E SHKOLLËS SË LARTË JOPUBLIKE "MARUBI" NË AKADEMI TË FILMIT DHE MULTIMEDIAS "MARUBI" DHE DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË KËTIJ INSTITUCIONI TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Riorganizimin e shkollës së lartë jopublike "Marubi" në Akademi të Filmit dhe Multimedias "Marubi" dhe dhënien e statusit të veçantë këtij institucioni të arsimit të lartë.

2. Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi" është institucion jopublik i arsimit të lartë, i profilizuar, me veprimtari akademike specifike, që lidhet ngushtë me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, krijues e artistik e që shoqërohet me produktin artistik në fushën e kinematografisë dhe multimedias.
3. Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi" ushtron aktivitetin në adresën: rruga "Aleksandër Moisiu", nr. 78, Kinostudio, Tiranë.

4. Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi", si institucion i arsimit të lartë, që zhvillon veprimtari akademike, krijuese dhe profesionale në fushën e filmit dhe të multimedias, gëzon status të veçantë, duke mos iu nënshtruar kritereve të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", lidhur me:

a) strukturën institucionale të Akademisë së Filmit dhe Multimedias "Marubi", e cila organizohet në Fakultetin e Filmit dhe Medias, të përbërë, si më poshtë:

i. Departamenti i Regjisë dhe Skenarit; ii.

Departamenti i Kameras dhe Montazhit;

iii. Njësia e produksioneve.

Hapja e departamenteve të tjera specifike dhe

periodike kryhet në bazë të nevojave të kësaj akademie, me miratim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

b) organizimin akademik dhe administrativ të institucionit të arsimit të lartë. Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi" administrohet nga shtëpia kinematografike "Orafilm". Organet dhe autoritetet drejtuese akademike dhe administrative të Akademisë janë:

i. Këshilli akademik; ii.

Drejtori i AFMM-së; iii.

Drejtori i produksioneve; iv.

Drejtori administrativ;

v. Këshilli studentor.

c) kategoritë dhe titujt akademikë të personelit akademik. Personeli akademik i Akademisë së Filmit dhe Multimedias "Marubi" përbëhet nga specialistë të fushës audiovizuale, si më poshtë vijon:

i. Specialistë në fushën e kinematografisë dhe medias së shkruar dhe televizive;

ii. Specialistë të arteve figurative; iii. Specialistë dhe historianë të artit dhe

kulturës;

iv. Specialistë të huaj të shkollave homologe ose individë të huaj të fushës së artit dhe kinematografisë.
ç) diplomat dhe emërtimin e tyre. Diplomat që lëshon Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi" nënshkruhen nga drejtori i AFMM-së dhe përgjegjësi i departamentit. Në përfundim të studimeve, sipas fushës së arsimimit të kryer, lëshohen diplomat e mëposhtme:

i. "Bachelor" në film dhe media, profili "Regjisurë";

ii. "Bachelor" në film dhe media, profili "Kamera";

iii. "Bachelor" në film dhe media, profili "Skenar";

iv. "Bachelor" në film dhe media, profili "Montazh".

5. Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi" ofron programe studimi të ciklit të parë, të cilat synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike, sipas drejtimeve: regji, montazh, skenar e kamera. Programet e studimeve realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike. Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi" u ofron studentëve mundësinë e studimeve kualifikuese "master" në institucione homologe me të cilat Akademia ka lidhur marrëveshje.

6. Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi" duhet t'i nënshtrohet procesit të vlerësimit dhe akreditimit institucional të programeve të studimit, si dhe të zbatimit të ligjshmërisë, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Akademia e Filmit dhe Multimedias “Marubi”, për realizimin e veprimtarisë së saj, bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, organizmat ndërkombëtarë dhe institucionet homologe të huaja, si dhe organizatat e tjera në fushën e filmit dhe multimedias.

8. Statuti i Akademisë së Filmit dhe Multimedias “Marubi” miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin mbi bazën e statusit të veçantë të dhënë me këtë vendim dhe sipas marrëveshjes së lidhur me ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe Akademinë e Filmit dhe Multimedias “Marubi”, për personelin akademik me kohë të plotë, në njësitë bazë.

9. Akademia e Filmit dhe Multimedias “Marubi” arkivon pasurinë e krijuar si produkt artistik pranë Arkivit Shtetëror të Filmit, ndërsa dokumentacionin ligjor, në Arkivin e Shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për kinematografinë dhe arkivat.

10. Vendimi nr. 652, datë 30.9.2004, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë jopublike “Marubi”“, shfuqizohet.

11. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Akademia e Filmit dhe Multimedias “Marubi” për ndjekjen, realizimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM

Nr. 288, datë 21.05.2018

PËR MIRATIMIN E KUFIRIT MAKSIMAL TË TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE ME KOHË TË PLOTË
(Ndryshuar me VKM nr.723, datë 6.12.2018;nr. 778, datë 26.12.2018)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kufiri maksimal i tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të

studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë, pasqyrohet në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Institucionet publike të arsimit të lartë, brenda muajit prill, por, në çdo rast, jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë para fillimit të vitit akademik, me vendim të organeve kolegjiale, miratojnë tarifën vjetore të shkollimit për çdo program studimi brenda kufirit maksimal të përcaktuar në këtë vendim. Tarifat vjetore të shkollimit, të miratuara me vendim të bordit të administrimit, bëhen publike në faqen zyrtare të institucioneve publike të arsimit të lartë.

3. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti, i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.

4. Studenti, i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik si përsëritës në një lëndë apo në shumë lëndë dhe vijon studimet në vitin pasardhës, i nënshtrohet tarifës së shkollimit për kredit për detyrimet apo lëndët përsëritëse, si dhe tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.

5. Studentët, që transferojnë studimet nga një program studimi të ciklit të parë në një program tjetër studimi të ciklit të parë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin transferohen dhe ndjekin studimet.

6. Kandidatët/aplikantët, që kanë përfunduar me sukses një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi, sipas kritereve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë për pranimet në një program të dytë studimi dhe, në këtë rast, aplikantët fitues përballojnë koston e plotë të studimeve, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. Kufiri maksimal i tarifës vjetore të shkollimit për studentët që vijojnë një program të dytë studimi pasqyrohet në tabelën nr. 1 të këtij vendimi.

7. Shtetasit e huaj, që vazhdojnë studimet në një program të parë apo në një program të dytë studimi të ciklit të parë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë vjetore të shkollimit, si shtetasit shqiptarë që vazhdojnë studimet në këto programe studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare shtetërore, janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave vjetore të shkollimit. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dërgon për çdo vit në institucionet publike të arsimit të lartë listën e studentëve të huaj që përfitojnë nga marrëveshjet zyrtare shtetërore.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Tabela nr. 1

Kufiri maksimal i tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në një program të studimeve të ciklit të parë, me kohë të plotë, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, si dhe në një program të dytë studimi

EMËRTIMI I UNIVERSITETIT ID_ PROGRAMI EMËRTIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT Kufiri maksimal I tarifës vjetore të shkollimit në një program të ciklit të parë

(në lekë) Kufiri maksimal i tarifës vjetore të shkollimit në një program të dytë studimi të ciklit të parë (në lekë)

Universiteti i Tiranës 001 Histori 30,000 111,778

Universiteti i Tiranës 002 Gjeografi 30,000 111,778

Universiteti i Tiranës 003 Gjuhë dhe letërsi 30,000 111,778

Universiteti i Tiranës 004 Gazetari 30,000 111,778

Universiteti i Tiranës 005 Arkeologji 30,000 111,778

Universiteti i Tiranës 006 Biologji 25,000 203,690

Universiteti i Tiranës 007 Bioteknologji 25,000 203,690
Universiteti i Tiranës 008 Matematikë 25,000 203,690

Universiteti i Tiranës 009 Fizikë 25,000 203,690

Universiteti i Tiranës 010 Informatikë 25,000 203,690

Universiteti i Tiranës 011 Kimi 25,000 203,690

Universiteti i Tiranës 0 12 Kimi dhe teknologji ushqimore 25,000 203,690

Universiteti i Tiranës 013 Kimi industriale dhe mjedisore 25,000 203,690

Universiteti i Tiranës 014 Inxhinieri matematike dhe informatike 25,000 203,690

Universiteti i Tiranës 015 Teknologji informacioni dhe komunikimi 25,000 203,690

Universiteti i Tiranës 016 Gjuhë angleze 25,000 135,730

Universiteti i Tiranës 017 Gjuhë frënge 25,000 135,730

Universiteti i Tiranës 018 Gjuhë gjermane 25,000 135,730

Universiteti i Tiranës 019 Gjuhë italiane 25,000 135,730

Universiteti i Tiranës 020 Gjuhë greke 25,000 135,730

Universiteti i Tiranës 021 Gjuhë turke 25,000 135,730

Universiteti i Tiranës 022 Gjuhë ruse 25,000 135,730

Universiteti i Tiranës 023 Gjuhë spanjolle me profil gjuhë, letërsi dhe qytetërim hispanik 25,000 135,730

Universiteti i Tiranës 024 Gjuhë angleze (Sarandë) 25,000 135,730

Universiteti i Tiranës 025 Psikologji 40,000 111,778

Universiteti i Tiranës 026 Punë sociale 40,000 111,778

Universiteti i Tiranës 027 Filozofi 40,000 111,778

Universiteti i Tiranës 028 Sociologji 40,000 111,778

Universiteti i Tiranës 029 Shkenca politike 40,000 111,778

Universiteti i Tiranës 030 Administrim dhe politika sociale 40,000 111,778
Universiteti i Tiranës 031 Administrim-biznes 35,000 86,374

Universiteti i Tiranës 032 Ekonomiks 35,000 86,374

Universiteti i Tiranës 033 Financë 35,000 86,374

Universiteti i Tiranës 034 Informatikë ekonomike 35,000 86,374

Universiteti i Tiranës 035 Administrim-biznes (Sarandë) 35,000 86,374

Universiteti i Tiranës 036 Drejtësi 40,000 63,341

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë 037 Mjekësi e përgjithshme 45,000 233,916

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë 038 Farmaci 45,000 233,916

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë 039 Stomatologji 45,000 233,916

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë 040 Infermieri e përgjithshme 40,000 233,916

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë 041 Mami 35,000 233,916

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë 042 Teknikë e lartë laboratorike 35,000 233,916

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë 043 Fizioterapi 35,000 233,916

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë 044 Logopedi 35,000 233,916

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë 045 Imazheri 35,000 233,916

Universiteti Bujqësor i Tiranës 046 Menaxhim agrobiznesi 35,000 86,374

Universiteti Bujqësor i Tiranës 047 Ekonomi dhe politikë agrare 30,000 144,906

Universiteti Bujqësor i Tiranës 048 Financë-kontabilitet 30,000 144,906

Universiteti Bujqësor i Tiranës 049 Menaxhim i turizmit rural 25,000 144,906

Universiteti Bujqësor i Tiranës 050 Informatikë biznesi 25,000 144,906

Universiteti Bujqësor i Tiranës 051 Ekonomiks i aplikuar 25,000 144,906

Universiteti Bujqësor i Tiranës 052 Mbrojtje bimësh 25,000 144,906

Universiteti Bujqësor i Tiranës 053 Hortikulturë 25,000 144,906

Universiteti Bujqësor i Tiranës 054 Prodhim bimor 25,000 144,906
Universiteti Bujqësor i Tiranës 055 Zootekni dhe biznes blegtoral 25,000 144,906

Universiteti Bujqësor i Tiranës 056 Akuakulturë dhe menaxhim peshkimi 25,000 144,906

Universiteti Bujqësor i Tiranës 057 Agromjedis dhe ekologji 25,000 144,906

Universiteti Bujqësor i Tiranës 058 Inxhinieri agrare - agromekanizim 25,000 144,906

Universiteti Bujqësor i Tiranës 059 Teknologji agroushqimore 25,000 144,906

Universiteti Bujqësor i Tiranës 060 Vreshtari-enologji 25,000 144,906

Universiteti Bujqësor i Tiranës 061 Mbarështim pyjesh 30,000 144,906

Universiteti Bujqësor i Tiranës 062 Përpunim druri 30,000 144,906

Universiteti Bujqësor i Tiranës 063 Mjekësi veterinare 40,000 233,916

Universiteti Bujqësor i Tiranës 064 Menaxhim veterinar (2-vjeçar) 25,000 50,000

Universiteti Politeknik i Tiranës 065 Inxhinieri ndërtimi 35,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 066 Inxhinieri hidroteknike 25,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 067 Inxhinieri mjedisi 25,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 068 Arkitekturë (arkitekt) 40,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 069 Arkitekturë (urbanist) 40,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 070 Inxhinieri gjeodezi 25,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 071 Inxhinieri elektrike (automatizim i industrisë) 25,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 072 Inxhinieri elektrike (energjetikë) 25,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 073 Inxhinieri mekatronike 25,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 074 Inxhinieri fizike 25,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 075 Inxhinieri matematike 25,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 076 Inxhinieri mekanike 25,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 077 Inxhinieri tekstile dhe modë 25,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 078 Inxhinieri materiale 25,000 203,690
Universiteti Politeknik i Tiranës 079 Inxhinieri ekonomike 25,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 080 Inxhinieri gjeologjike 25,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 081 Inxhinieri gjeoburimesh 25,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 082 Inxhinieri gjeoinformatikë 25,000 203,690

Univer siteti Politeknik i Tiranës 083 Inxhinieri gjeomjedis 25,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 084 Inxhinieri elektronike 30,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 085 Inxhinieri informatike 30,000 203,690

Universiteti Politeknik i Tiranës 086 Inxhinieri telekomunikacioni 30,000 203,690

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 087 Gjuhë dhe letërsi 20,000 111,812

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 088 Gjuhë dhe kulturë frënge 20,000 135,730

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 089 Gjuhë angleze 20,000 111,812

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 090 Mësuesi për arsimin fillor 20,000 111,812

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 091 Mësuesi për arsimin parashkollor 20,000 111,812

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 092 Histori-gjeografi 20,000 111,812

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 093 Filozofi-sociologji 20,000 111,812

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 094 Matematikë-fizikë 20,000 111,812

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 095 Matematikë-informatikë 20,000 111,812 Universiteti

“Fan S. Noli” Korçë 096 Biologji-kimi 20,000 111,812

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 097 Teknologji informacioni 20,000 111,812

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 098 Infermieri e përgjithshme 20,000 233,916

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 099 Mami (infermier) 20,000 233,916

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 100 Administrim dhe politika sociale 20,000 233,916

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 101 Financë-kontabilitet 20,000 86,374

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 102 Menaxhim 20,000 86,374
Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 103 Administrim biznesi në marketing 20,000 86,374

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 104 Administrim biznesi në turizëm 20,000 86,374

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 105 Agroushqim 20,000 86,374

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 106 Agrobiznes 20,000 86,374

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 107 Inxhinieri agronomike 20,000 86,374

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë 108 Mjekësi e bimëve dhe hortikulturë 20,000 86,374

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 109 Gjuhë dhe letërsi 25,000 126,800

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 110 Gjuhë dhe letërsi shqipe dhe frënge 25,000 153,900

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 111 Histori-gjeografi 25,000 126,800

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 112 Histori dhe gjuhë gjermane 25,000 153,900

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 113 Gjeografi dhe gjuhë italiane 25,000 153,900

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 114 Gjuhë angleze 25,000 153,900

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 115 Gjuhë gjermane 25,000 153,900

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 116 Gjuhë frënge 25,000 153,900 Universiteti

“Aleksandër Xhuvani” Elbasan 117 Gjuhë italiane 25,000 153,900 Universiteti

“Aleksandër Xhuvani” Elbasan 118 Gazetari 25,000 126,800

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 119 Gazetari-anglisht 25,000 153,900

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 120 Gjuhë shqipe dhe rome 25,000 153,900

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 121 Biologji-kimi 25,000 243,800

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 122 Matematikë-fizikë 25,000 243,800

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 123 Teknologjitë e informacionit 25,000 243,800

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 124 Teknologji laboratori (2-vjeçar) 25,000 243,800

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 125 Fizikë kompjuterike 25,000 243,800

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 126 Matematikë informatike 25,000 243,800 Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 127 Infermieri e përgjithshme 25,000 243,800

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 128 Infermieri - mami 25,000 243,800

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 129 Fizioterapi 25,000 243,800

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 130 Logopedi 25,000 243,800

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 131 Imazheri 25,000 243,800

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 132 Teknologji laboratori 25,000 243,800

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 133 Mësuesi për arsimin fillor 25,000 138,700

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 134 Mësuesi për arsimin parashkollor 25,000 138,700

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 135 Edukim qytetar 25,000 138,700 Universiteti

“Aleksandër Xhuvani” Elbasan 136 Punonjës social 25,000 138,700

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 137 Filozofi-sociologji 25,000 138,700

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 138 Psikologji 25,000 138,700

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 139 Edukim fizik dhe sporte 25,000 233,916

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 140 Administrim-biznes 25,000 92,200

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 141 Financë-kontabilitet 25,000 92,200

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 142 Ekonomia dhe e drejta 25,000 92,200

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 143 Informatikë ekonomike 25,000 92,200

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 144 Ekonomi turizmi 25,000 92,200

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 145 Administrim biznesi dhe inxhinieri 25,000 92,200

Universiteti “ Aleksandër Xhuvani” Elbasan 146 Shkenca juridike në biznes 25,000 92,200

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 147 Shkenca juridike në sektorin publik 25,000 92,200

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 148 Biologji-kimi 20,000 203,690

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 149 Fizikë dhe teknologji informacioni 20,000 203,690

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 150 Matematikë-fizikë 20,000 203,690
Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 151 Matematikë-informatikë 20,000 203,690

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 152 Teknologji informacioni 20,000 203,690

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 153 Infermieri e përgjithshme 20,000 233,916

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 154 Infermieri - mami 20,000 233,916

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 155 Histori-gjeografi 20,000 111,778

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 156 Gjuhë dhe letërsi shqipe 20,000 111,778

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 157 Gjuhë dhe letërsi angleze 20,000 135,730

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 158 Gjuhë dhe letërsi italiane 20,000 135,730

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 159 Gjuhë dhe letërsi dhe qytetërim grek 20,000 135,730

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 160 Histori dhe gjuhë italiane 20,000 135,730

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 161 Mësuesi për arsimin fillor 20,000 111,778

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 162 Mësuesi për arsimin parashkollor 20,000 111,778

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 163 Kontabilitet-financë 20,000 111,778

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 164 Administrim-publik 20,000 111,778

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër 165 Ekonomi turizmi 20,000 111,778

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 166 Gjuhë dhe letërsi 25,000 111,778

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 167 Gazetari dhe komunikim 20,000 111,778

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 168 Histori 20,000 111,778

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 169 Gjeografi 20,000 111,778

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 170 Matematikë 20,000 203,690

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 171 Fizikë 20,000 203,690

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 172 Informatikë 20,000 203,690

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 173 Biologji-kimi 20,000 203,690

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 174 Infermieri e përgjithshme 20,000 233,916 Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 175 Infermieri (mami) 20,000 233,916

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 176 Infermieri (fizioterapi) 20,000 233,916

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 177 Mësuesi për arsimin fillor 20,000 111,778

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 178 Mësuesi për arsimin parashkollor 20,000 111,778

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 179 Psikologji 25,000 111,778

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 180 Punë sociale 25,000 111,778

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 181 Edukim fizik dhe sporte 20,000 111,778

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 182 Financë-kontabilitet 20,000 86,374

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 183 Administrim-biznes 20,000 86,374

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 184 Turizëm 20,000 86,374

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 185 Gjuhë angleze 20,000 135,730

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 186 Gjuhë italiane 20,000 135,730

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 187 Gjuhë gjermane 20,000 135,730

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 188 Gjuhë frënge 20,000 135,730

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 189 Drejtësi 25,000 66,452

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 190 Pikturë e grafikë 27,000 140,000

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 191 Pedagogji muzikore 27,000 140,000

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 192 Matematikë 20,000 135,730

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 193 Fizikë 20,000 135,730

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 194 Shkenca kompjuterike 20,000 203,690

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 195 Teknologji informacioni 20,000 203,690

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 196 Informatikë 20,000 203,690

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 197 Inxhinieri navale 20,000 203,690

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 198 Inxhinieri mekanike 20,000 203,690
Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 199 Navigacion 20,000 203,690

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 200 Kimi 20,000 203,690

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 201 Biologji 20,000 135,730

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 202 Inxhinieri elektrike 20,000 203,690 Universiteti

“Ismail Qemali” Vlorë 203 Administrim biznesi 20,000 86,374

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 204 Menaxhim turizmi 20,000 86,374

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 205 Ekonomiks 20,000 86,374

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 206 Financë 20,000 86,374

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 207 Kontabilitet 20,000 86,374

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 208 Marketing 20,000 86,374

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 209 Mësuesi për arsimin fillor 20,000 135,730

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 210 Mësuesi për arsimin parashkollor 20,000 135,730

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 211 Pedagogji e speciali zuar 20,000 135,730

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 212 Gjuhë shqipe dhe letërsi 20,000 135,730

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 213 Gjuhë angleze 20,000 135,730

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 214 Gjuhë italiane 20,000 135,730

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 215 Histori-gjeografi 20,000 135,730

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 216 Drejtësi 20,000 100,446

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 217 Infermieri e përgjithshme 20,000 233,916

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 218 Infermier mami 20,000 233,916

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 219 Administrim biznesi 25,000 86,374

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 220 Menaxhim-marketing 25,000 86,374

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 221 Shkenca ekonomike 25,000 86,374

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 222 Financë-kontabilitet 25,000 86,374 Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 223 Bankë financë 25,000 86,374

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 224 Menaxhim hotel restorant 25,000 86,374

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 225 Menaxhim turizëm kulturor 25,000 86,374

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 226 Menaxhim turizëm arkeologjik 25,000 86,374

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 227 Drejtësi 25,000 146,232

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 228 Shkenca politike 25,000 146,232

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 229 Administrim publik 25,000 146,232

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 230 Politikë ekonomike 25,000 146,232

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 231 Marrëdhënie me publikun 25,000 146,232

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 232 Histori 25,000 146,232

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 233 Infermieri e përgjithshme 25,000 247,950

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 234 Mami 25,000 247,950

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 235 Fizioterapi 25,000 247,950

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 236 Navigacion dhe peshkim detar 25,000 247,950

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 237 Teknikë elektrike (2-vjeçar) 25,000 93,285

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 238 Hidroteknikë Ujësjellës-Kanalizime (2-jeçar) 25,000 93,285

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 239 Asistencë stomatologji (2-vjeçar) 25,000 93,285

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 240 Menaxhim ndërtimi (2-vjeçar) 25,000 93,285

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 241 Menaxhim transporti (2-vjeçar) 25,000 93,285

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 242 Asistencë ligjore (2-vjeçar) 25,000 93,285

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 243 Asistencë administrative (2-vjeçar) 25,000 93,285

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 244 Teknologji automobilash (2-vjeçar) 25,000 93,285

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 245 Teknikë e rrjeteve kompjuterike (2-vjeçar) 25,000 93,285
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 246 Informatikë praktike (2-vjeçar) 25,000 93,285

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 247 Gjuhë angleze 25,000 135,730

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 248 Mësuesi për arsimin fillor 25,000 111,778

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 249 Mësuesi për arsimin parashkollor 25,000 111,778

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 250 Gjuhë dhe letërsi - anglisht 25,000 111,778

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 251 Gjermanisht - anglisht 25,000 111,778 Universiteti

“Aleksandër Moisiu” Durrës 252 Shkenca kompjuterike 25,000 204,000

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 253 Sistemet e informacionit 25,000 204,000

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 254 Teknologji informacioni 25,000 204,000

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 255 Matematikë - informatikë 25,000 204,000

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 256 Informatikë - anglisht 25,000 204,000

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 257 Multimedia dhe televizioni digjital 25,000 204,000

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 258 Menaxhim i Bankave (program në gjuhë angleze) 25,000 171,000

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 259 Menaxhim hoteleri turizëm (program në gjuhë angleze) 25,000 171,000

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 260 Menaxhim i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (program në gjuhë angleze) 25,000 171,000

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 261 Ekspert në proceset e formimit 25,000 111,778

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 262 Psikologji sociologji 25,000 111,778

Universiteti i Arteve, Tiranë 263 Regji filmi dhe televizioni 40,000 220,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 264 Aktrim 40,000 220,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 265 Regji 40,000 220,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 266 Skenografi-kostumografi 40,000 220,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 267 Koreografi 40,000 220,000
Universiteti i Arteve, Tiranë 268 Pikturë 40,000 280,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 269 Skulpturë 40,000 280,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 270 Muzikologji 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 271 Kompozim 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 272 Dirizhim 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 273 P iano 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 274 Violinë 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 275 Violonçel 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 276 Violë 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 277 Kitarë 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 278 Kontrabas 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 279 Flaut 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 280 Oboe 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 281 Klarinetë 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 282 Fagot 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 283 Korno 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 284 Trombë 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 285 Trombonë 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 286 Bastub 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 287 Kanto 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 288 Pedagogji muzikore 40,000 320,000

Universiteti i Arteve, Tiranë 289 Fizarmonikë klasike 40,000 320,000

Universiteti i Sporteve të Tiranës 290 Shkencat e lëvizjes 35,000 233,916 Universiteti i Sporteve të Tiranës 291 Fushat e veprimtarisë fizike, të shëndetit dhe të rekreacionit 35,000 233,916

Akademia e Sigurisë 292 Siguria dhe hetimi 35,000 250,000

Akademia e Sigurisë (Kolegji Profesional i Lartë) 293 Patrullë e përgjithshme 30,000 0

VENDIM

Nr. 327, datë 31.05.2018

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 395, DATË 29.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
"PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE DHE INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 12 shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

"12/1. Për mbështetjen e procesit të integrimit evropian, institucionet sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, angazhojnë numrin e përcaktuar të praktikantëve që do të punojnë në funksion të procesit të integrimit evropian, nën koordinimin dhe mbikëqyrjen e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për përgatitjen e *database*-ve me të dhënat e çdo institucioni.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Lidhja 1

Institucioni	Propozimi për numër kontratash internship të studentëve për punë
Kryeministria	3
Ministria e Brendshme (MB)	3
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)	4
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ)	2
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)	4
Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)	5
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)	3
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)	5
Ministria e Kulturës (MK)	2
Ministria e Mbrojtjes (MM)	2
Ministria e Drejtësisë (MD)	3
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)	2

VENDIM

Nr. 483, datë 31.07.2018

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

JOPUBLIK, ME STATUSIN E KOLEGJIT PROFESIONAL TË LARTË, "TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, 30 e 31, pika 1, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes për hapjen e institucionit të arsimit të lartë jopublik, me statusin e kolegjit profesional të lartë, "Tirana Esthetics & Style School" (në vijim, kolegji profesional i lartë "TESS"), i cili ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës, shoqërisë "NLT" sh.p.k.

2. Kolegji profesional i lartë "TESS" të organizohet në dy departamente:

a) Departamenti i Estetikë-Nutricionit;

b) Departamenti i Kozmetologjisë.

3. Kolegji profesional i lartë "TESS" të ofrojë programe të studimeve jouniversitare profesionale, 1 ose 2 vite akademike, pas arsimit të mesëm.

4. Kolegji profesional i lartë "TESS" të fillojë veprimtarinë e tij, vetëm pas nxjerrjes së urdhrit të ministrit përgjegjës për arsimin për fillimin e veprimtarisë.

5. Kolegji profesional i lartë "TESS" t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6. Statuti i kolegjit profesional të lartë "TESS" miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

7. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të ushtrojë kontroll periodik të ligjshmërisë në institucion, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe kolegji profesional i lartë "TESS" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 488, datë 31.07.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 424, DATË 10.5.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES E TË EMËRIMIT TË DREJTUESVE TË SHËRBIMIT NË STRUKTURAT SHËNDETËSORE UNIVERSITARE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 424, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në vendim, emërtesat "Ministria e Shëndetësisë" dhe "Ministria e Arsimit dhe Sportit" zëvendësohen me "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale" dhe "Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë".

2. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja "ç" ndryshohet si më poshtë vijon: "ç. Të zotërojë titullin "Profesor", "Profesor i asociuar" ose të ketë Doktoratë/PhD të mbrojtur në një nga universitetet e Shqipërisë, të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Turqisë, Australisë ose Japonisë.".

b) Në fjalinë e parë të paragrafit të fundit, fjalët "… jo më të shkurtër se 8 (tetë) vjet si pedagog me kohë të pjesshme …" zëvendësohen me "… jo më të shkurtër se 8 (tetë) vjet pa ndërprerje si pedagog me kohë të pjesshme në fushën ku ai konkurron…".

3. Pika 10 ndryshohet si më poshtë vijon:

"10. Kandidatët konkurrues për një shërbim të caktuar vlerësohen nga komisioni përkatës, sipas përcaktimeve dhe kritereve të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Aneksi 1 bashkëlidhur vendimit shfuqizohet.".

4. Pika 14 ndryshohet si më poshtë vijon:

"14. Kandidati fitues lidh kontratë punësimi trepalëshe me drejtuesin e strukturës shëndetësore universitare, pjesë e së cilës është shërbimi përkatës, dhe me drejtuesin e IAL-së përkatëse. Mospërmbushja e detyrimeve kontraktore që lidhen me funksionimin e strukturës shëndetësore universitare përbën shkak për prishjen e kontratës trepalëshe.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 531, datë 11.09.2018

PËR MIRATIMIN E KODIT TË CILËSISË SË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 105, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë, si përmbledhje e standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë, për programet e studimit me karakter profesional, programet e ciklit të parë të studimeve Bachelor, programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional", "Master i shkencave" dhe "Master i arteve", si dhe për programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, sipas shtojcave nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4 e nr. 5, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Senida Mesi

SHTOJCA NR. 1

STANDARDET PËR SIGURIMIN E CILËSISË PËR PROGRAMET E STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL
STANDARDET DHE KRITERET

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës

Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.

Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.

Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.

Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.

Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.

Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.

Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit

Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.

Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.

Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton
raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.

Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.

Standardi I.3 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi

Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përftimin e njohurive gjithëpërfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionesh e spec ialitetesh.

Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.

Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.

Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.

Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formues të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit

Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.
Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.

Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.

Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.

Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.

Kriteri 6. Mësimit praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.

Standardi II.2 Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formues, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe

Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.

Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.

Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion.

Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.

Standardi II.3 Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formues, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe

Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.
Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehitë e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.

Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.

Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në konteks te konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.

Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës

Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.

Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.

Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.

Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.

Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.

Standardi III.2 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.

Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.

Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.

Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.

Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.

Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.

Standardi III.3 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre

Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.

Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.

Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit e tyre.

Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.
Standardi III.4 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vl erësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student

Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.

Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.

Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës /modulit.

Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimatin, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.

Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.

Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.

Standardi III.5 Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme

Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përftimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional.

Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.

Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.

Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.

Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.

Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe

përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standard IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e perso nelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive nga ana e tyre

Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.

Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet part nere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.

Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.

Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.

Standard IV.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e

procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional

Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.

Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhëniesmësimnxënies.

Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e

kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.

Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.

Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.

Standardi IV.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.

Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.

Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.

Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.

Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.

Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep informacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vl erësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.

Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.

Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.

Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.

Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.

Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.
Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional

Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.

Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.

Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.

Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.

Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit

Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kritere të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.

Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.

Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.

Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.

Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.

Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formues, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.

Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizmit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.

Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.

Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.

Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IALve.

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.

Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.

Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.

Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.

Standardi V.5 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.

Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.

Kriteri 3. Përmes zyrës/njësisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.

SHTOJCA NR. 2

STANDARDET PËR SIGURIMIN E CILËSISË PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

STANDARDET DHE KRITERET

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare

Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.

Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.

Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.

Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.

Standardi I.2 Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij

Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.

Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.

Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.

Standardi I.3 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij

Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.

Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.

Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion

Kriteri 1. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.

Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit

Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet

ndarjes së detyrave mes njës ive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.

Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.

Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi II.1 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi

Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.

Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.

Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.

Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.

Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.
Standardi II.3 Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formues të programeve të ciklit të parë

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.

Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.

Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.

Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.

Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.

Standardi II.4 Struktura, organizimi dh e përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formues, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesave të tregut të punës

Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.

Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.

Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar

në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.

Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.

Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.

Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.

Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmësakademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies

Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.

Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor- shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.

Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.

Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.

Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira

Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, laboratorët, detyra kursit/esetë, praktikat profesionale e klin ike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.

Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.

Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave

didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.

Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.

Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.

Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.

Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.
Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.

Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.

Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.

Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.

Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.

Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.

Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.

Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.

Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.

Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.

Standard III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.

Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.

Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.

Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshm ëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.

Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre

Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.

Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe

transparent, bazuar në meritën e çdo studenti

Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.

Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.

Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.

Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.

Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.

Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.

Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.

Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore

Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.

Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).

Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.

Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.

Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.

Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.

Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.

Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.

Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.

Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm

Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.

Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.

Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.

Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.

Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.

Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.

Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.

Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit

Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.

Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.

Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.

Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.

Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.

Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.

Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.

Standardi IV.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.

Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhëniesmësimnxënies.

Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.

Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me

institucione d he subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.

Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të

mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.

Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.

Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.

Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e ve atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.

Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.

Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.

Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.

Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve

Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.

Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.

Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.

Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.

Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e t ë ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.

Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.

Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.

Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.

Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.

Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.

Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.

Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formues, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.

Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.

Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.

Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.

Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.

Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.

Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.

Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.

Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë

Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.

Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.

Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.

Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formues dhe rezultateve të synuara të të nxënit

Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.

Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.

Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.

Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.

Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.

Standardi VI.3 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.

Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.

Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.

Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të

studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.

Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e mara në vijim të tyre

Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.

Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.

Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.

Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.

Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.

Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.

Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjeg jësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.

SHTOJCA NR. 3

STANDARDET PËR SIGURIMIN E CILËSISË PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL”

STANDARDET DHE KRITERET

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë "Master profesional" në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare

Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.

Kriteri 2. Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.

Kriteri 3. Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.

Kriteri 4. Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.

Standardi I.2 Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij

Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.

Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.

Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.

Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.

Standardi I.3 Programet e studimit "Master profesional" synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij

Kriteri 1. Programet e studimit "Master profesional" kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.

Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.

Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.

Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.

Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në

legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.

Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë "Master profesional" përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.

Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.

Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.

Standardi I.4 Programet e ciklit të dytë "Master profesional" janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion
Kriteri 1. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.

Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë "Master profesional" në një drejtim

specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me

institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit

Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.

Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.

Kriteri 3. Për realizmin e programeve të ciklit të dytë "Master profesional", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.

Kriteri 4. Institucioni i arsimi të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.

Kriteri 5. Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.

Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT
Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi

Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.

Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.

Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.

Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kreditë.

Kriteri 7. Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.

Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të

studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.

Kriteri 7. Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.

Standardi II.3 Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formues të programeve të ciklit të dytë

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.

Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.

Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.

Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.

Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.

Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formues, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe

Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës

Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.

Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.

Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.

Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.

Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.

Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.

Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmësakademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteri 1 . Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin

e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e d iplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës-mësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.

Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre

Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.

Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.

Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e

diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.

Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.

III MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit

Kriteri 1 . Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.

Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.

Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.

Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.

Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.

Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe

përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.

Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.

Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.

Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.

Kriteri 2. Ambientet e dedikuara pë r procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.

Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.

Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.

Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.

Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.

Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.

Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.

Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit

Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.

Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.

Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.

Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.

Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit profesionistë të fushës, jashtë strukturës akademike, të cilët propozojnë dhe japin ide për forma të ndryshme të mësimdhënies.

Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteri 1 . Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.

Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent bazuar në meritën e çdo studenti

Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.

Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.

Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohe t në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.

Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.

Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.

Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.

Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.

Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).

Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.

Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.

Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.

Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.

Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.

Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.

Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.

Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.

Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve

Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.

Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.

Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.

Standardi III.9 Institucioni ndjek një

procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm

Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.

Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.

Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.

Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.

Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisi onit.

Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.

Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.

Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit

Kriteri 1 . Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimorshkencor dhe administrativ.

Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.

Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.

Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.

Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.

Kriteri 4. Institucioni i arsimi të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.

Standardi IV.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.

Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhëniesmësimnxënies.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.

Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.

Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.

Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.

Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.

Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.

Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.

Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin
dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.

Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.

Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.

Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.

Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.

Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve

Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.

Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.

Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të

hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.

Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.

Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.

Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.

Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.

Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.

Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.

Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formues, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.

Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi

zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.

Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.

Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose

përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi proce sin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.

Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.

Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.

Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.

Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.

Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse.

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi VI.1Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.

Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.

Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formues dhe rezultateve të synuara të të nxënit

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.

Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.

Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.

Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.

Standardi VI.3 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.

Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.

Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës-akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.

Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.

Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.

Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.

Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.

Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.

Kriteri 2. Institucioni i arsimi të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.

Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.

SHTOJCA NR. 4

STANDARDET PËR SIGURIMIN E CILËSISË PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE” DHE “MASTER I ARTEVE”

STANDARDET DHE KRITERET

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave” /”Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare

Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/”Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.

Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/”Master i arteve” synon ruajt jen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.

Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.

Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/”Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.

Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/”Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor.

Standardi I.2 Programi i studimit MSH/ MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij

Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.

Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.

Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/”Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.

Standardi I.3 Programi i studimit “Master i shkencave”/”Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij

Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/”Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.

Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.

Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.

Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.

Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.

Kriteri 6. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.

Kriteri 7. Në programin e studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.

Kriteri 8. Për programin studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze.

Standardi I.4 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion
Kriteri 1. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.

Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit Kriteri 1. Institucioni për hartimin,

mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.

Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.

Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.

Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.

Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.

Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.

Standardi I.6 Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike

Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.

Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.

Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.

Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.

Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor.

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi II.1 Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi

Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Kriteri 2. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.

Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/”Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.

Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/”Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/”Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.

Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/”Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj.

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.

Kriteri 4. Njësia kryesore/baz ë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.

Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.

Kriteri 7. Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.

Standardi II.3 Programi i studimit MSH/ MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formues të programit të ciklit të dytë

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.

Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.

Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.

Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.

Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i

programit të studimit është në përputhje me objektivat formues, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesave të tregut të punës

Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/”Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.

Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.

Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.

Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.

Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.

Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.

Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.

Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë

njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve.

Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve"

Kriteri 1 . Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.

Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.

Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre

Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së

programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.

Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.

Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.

Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi.

Standardi II.7 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor

Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.

Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.

Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.

Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.

Standardi II.8 Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit

Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.

Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.

Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimi të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit

Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.

Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.
Kriteri 4. Strukturat përgjeg jëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira

Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësim-nxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.

Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.

Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.

Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.

Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.

Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.

Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.

Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësim-nxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.

Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.

Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.

Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.

Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.

Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.

Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.

Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.

Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit

Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.

Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovati ve të mësimdhënies.

Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.

Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.

Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre

Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.

Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent bazuar në meritën e çdo studenti

Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.

Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.

Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.

Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.

Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.

Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.

Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.

Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore

Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.

Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).

Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.

Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.

Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.

Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.

Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në i nterpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.

Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.

Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.

Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.
Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm

Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.

Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.

Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.

Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.

Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.

Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.

Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.

Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.

IV.BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit

Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit

akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimorshkencor dhe administrativ.

Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.

Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.

Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.

Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.

Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.

Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë.

Standardi IV.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit

Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teori ke, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.

Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhëniesmësimnxënies.

Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.

Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.

Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.

Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.

Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.

Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.

Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit

Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.

Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.

Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.

Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.

Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve

Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.

Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin n ë bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.

Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.

Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.

Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

V.STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.

Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.

Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.

Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.

Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.

Kriteri 5.Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formues, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.

Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.

Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.

Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve.

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e

studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.

Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.

Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IALve.

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.

Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në

programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.

Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.

Standardi V.6 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte

Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.

Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.

Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.

Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.

Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.

Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës.

Standardi V.7 Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor

Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë,

kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.

Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.

Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.

Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetitin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.

Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore.

Standardi V.8 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e anki mimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.

Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.

Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.

Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.

VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë

Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.

Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.

Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.

Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formues dhe rezultateve të synuara të të nxënit

Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.

Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.

Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.

Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.

Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.

Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.

Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.

Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.

Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.
Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.

Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.

Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.

Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.

Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.

Standardi VI. 5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.

Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke

respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.

Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.

Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.

SHTOJCA NR. 5
STANDARDET PËR SIGURIMIN E CILËSISË PËR PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE”

STANDARDET DHE KRITERET

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi “Master i shkencave” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare

Kriteri 1. Institucioni i arsimi të lartë ofron program të integruar studimi “Master i shkencave” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.

Kriteri 2. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.

Kriteri 3. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.

Kriteri 4. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.

Kriteri 5. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor.

Standardi I.2 Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij

Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.

Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i integruar i studimit “Master i shken cave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.

Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.

Kriteri 4. Programi i integruar i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.

Standardi I.3 Programi i integruar i studimit synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij

Kriteri 1. Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.

Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.

Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të integruar të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.

Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare, me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.

Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.

Kriteri 6. Programi i integruar përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.

Kriteri 7. Në programin e integruar duhet të përfshihen elementë të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.

Kriteri 8. Për programin e integruar, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze.

Standardi I.4 Programi i integruar është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion

Kriteri 1. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.

Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit

Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.

Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.

Kriteri 3. Për realizmin e programit të integruar të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.

Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon m e punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.

Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimoreshkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.

Kriteri 6. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.

Standardi I.6 Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike

Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe studentëve.

Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.

Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.

Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.

Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor.

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi II.1 Programi i integruar i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi

Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Kriteri 2. Programi i integruar i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.

Kriteri 3. Programi i integruar i studimit jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.

Kriteri 4. Programi i integruar i studimit zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.

Kriteri 6. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

Kriteri 7. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuara kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj.

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.

Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.

Kriteri 7. Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.

Standardi II.3 Programi i integruar i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar

në përputhje me parashikimet dhe objektivat formues të programit të integruar të ciklit të dytë Kriteri

1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse

për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.

Kriteri 2. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

Kriteri 3. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës dhe, të ndara në vite e semestra.

Kriteri 4. Programi i integruar i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.

Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Kriteri 6. Programi i integruar i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.

Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.

Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formues, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesave të tregut të punës

Kriteri 1. Ngarkesa e programit të integruar të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.

Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të integruar “Master i shkencave” dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.

Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.

Kriteri 7. Përmbajtja e programit të integruar të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë.

Kriteri 8. Përmbajtja e programit të integruar të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.

Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të integruar të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.

Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor mundëson njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve.

Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmësakademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit

Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi.

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të integruar të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.

Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjete ve dhe organizmave të tjera në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre

Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.

Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.

Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.

Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi.

Kriteri 5. Në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private, institucioni përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme.

Standardi II.7 Programi i integruar i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor

Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.

Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.

Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.

Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.
Standardi II.8 Institucioni i arsimit të lartë, nëpërmjet programit të studimit, garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit

Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.

Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.

Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit

Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.

Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.

Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

Standardi III.2 Institucioni i arsimit të lartë garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira

Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.

Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën
e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e akti viteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.

Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.

Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.

Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.

Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.

Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.

Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësim-nxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.

Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.

Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.

Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.

Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.

Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.

Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.

Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët, shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.

Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit

Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.

Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.

Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.

Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.

Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.

Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe meto dave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.

Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent bazuar në meritën e çdo studenti.

Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.

Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.

Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.

Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.

Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente /feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.

Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.

Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.

Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.

Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.

Standardi III.7 Programi i integruar i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore te studentët Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.

Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).

Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.

Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, stafi akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.

Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.

Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.

Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.

Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.

Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.

Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.

Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm

Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së d iplomës.

Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.

Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.

Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.

Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.

Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.

Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit

Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.

Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.

Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.

Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.

Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.

Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të integruar të studimeve.

Standardi IV.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit

Kriteri 1 . Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.

Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë

së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.

Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.

Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me i nstitucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteri 1 . Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.

Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.

Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të

bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.

Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.

Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.

Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.

Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.

Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.

Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.

Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.

Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.

Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.

Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit t ë programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.

Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.

Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e integruar të studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.

Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.

Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë.

Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve, deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.

Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formues, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.

Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.

Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.

Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.

Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve.
Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e inte gruar të studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.

Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IALve.

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.

Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.

Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.

Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.
Standardi V.6 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte

Kriteri 1 . Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.

Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje

partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.

Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe të publikojnë studime e punime shkencore.

Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore-shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.

Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.

Kriteri 6. Personeli akademik mbështet studentët në kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës.

Standardi V.7 Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor

Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë kombëtarë me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit

Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.

Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj vendës dhe të huaj në projekte kërkimore.

Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.

Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetitin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.

Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore.

Standardi V.8 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.

Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për infor mimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.

Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e

cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.

Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.

Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.

Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formues dhe rezultateve të synuara të të nxënit

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.

Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.

Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.

Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit

dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.

Standardi VI.3 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.

Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.

Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.

Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.

Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.

Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.

Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.

Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.

Standardi VI. 5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.

Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.

Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.

Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.

VENDIM

Nr. 560, datë 29.09.2018

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE *(Ndryshuar me VKM nr. 461, datë 3.7.2019)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pikat 2 e 3, 10 dhe 101, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 9, pika 7, 10 e 13, shkronja "c", të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore për qytetarët, institucionet e arsimit të lartë, institucionet e tjera dhe palët e treta, sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Tarifat e përcaktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi, arkëtohen, parapaguhen para ofrimit të shërbimit përkatës, pranë bankave të nivelit të dytë ose zyrave të Postës Shqiptare, në adresë të Degës së Thesarit Tiranë, me përfitues Qendrën e Shërbimeve Arsimore, Tiranë.

3. Të ardhurat e arkëtuara nga tarifat e parapaguara për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore janë të pakthyeshme.

4. Pjesa prej 90% e të ardhurave, që i takon Qendrës së Shërbimeve Arsimore, autorizohet dhe përdoret me strukturë të veçantë buxhetore në programin buxhetor 09450, kapitulli 06, "Të ardhurat e veta jashtë limitit".

5. Të ardhurat që sigurohen nga këto tarifa menaxhohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe përdoren për:

a) Mbulimin e shpenzimeve të personelit të Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Në shpenzime personeli përfshihen pagat e punonjësve, si dhe kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore;

b) Mbulimin e shpenzimeve të veprimtarisë së Qendrës së Shërbimeve Arsimore, ku përfshihen dhe mbulimi i shpenzimeve të hartimit, vlerësimit e korrigjimit të testeve të provimeve, si dhe pagesa e kuotave/tarifave në rrjetet ndërkombëtare;

c) Mbulimin e shpenzimeve për investime në përmirësimin dhe rritjen e kapaciteteve infrastrukturore të QSHA-së.

6. Çdo shërbim tjetër i ofruar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi apo i ngarkuar nga ministri përgjegjës për arsimin, për të cilin nuk aplikohet tarifë shërbimi sipas këtij vendimi, financohet nga fondet e buxhetit të shtetit, të miratuara për ministrinë përgjegjëse për arsimin.

7. Të ardhurat e papërdorura gjatë një viti financiar kalojnë në vitin pasardhës.

8. Vendimi nr. 812, datë 10.11.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tarifave për provimin e shtetit", shfuqizohet.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

ANEKSI 1

LISTA E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Lloji i shërbimit	Tarifa (lekë)
1. Provimi i shtetit për profesionet e rregulluara:	
a) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati për herë të parë:	10 000 lekë;
b) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati për herë të dytë:	12 500 lekë;
c) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati për herë të tretë:	15 000 lekë;
ç) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati për herë të katërt:	17 500 lekë;
d) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati për herë të pestë:	20 000 lekë;
e) Për provimin e shtetit dhënë nga kandidati më shumë se pesë herë:	25 000 lekë.

2. Njohja e diplomave, certifikatave e titujve dhe gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit të lëshuara nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, 2 000 lekë për çdo aplikant.

3. Provimi i specializimit në mjekësi, si dhe profesione të tjera të rregulluara, 5 000 lekë për çdo aplikant.

4. Provime të tjera të digjitalizuara, të kërkuara nga institucionet publike dhe private, 5 000 lekë çdo aplikant.

5. Aplikim për ndjekjen e studimeve në institucionet e arsimit të lartë në sistemin që administrohet nga QSHA-ja, 2 000 lekë për çdo aplikant.

6. Regjistrimi i formës së diplomave dhe certifikatave, 3 000 lekë për diplomë/certifikatë të regjistruar.

7. Tarifa për pajisjen me numrin unik të matrikullimit (për student) 100 lekë;

8. Pajisja e IAL-së me: 2 000 lekë;

a) Regjistrin themeltar të studentëve (për regjistër);

b) Regjistrin e arritjeve akademike;

c) Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.

VENDIM

Nr. 562, datë 29.09.2018

PËR MASAT E PËRSHTATSHME PËR NXITJEN E NJOHJES SË KULTURËS, HISTORISË, GJUHËS DHE BESIMIT FETAR TË PAKICAVE KOMBËTARE NË VEPRIMTARINË MËSIMORE DHE SHKENCORE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 13, të ligjit nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet publike të arsimit të lartë, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mësimore e shkencore shkencat shoqërore, sociale dhe ato të edukimit, të përfshijnë në veprimtarinë e tyre mësimore njohjen, hulumtimin dhe promovimin e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare.

2. Institucionet publike të arsimit të lartë, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mësimore e shkencore shkencat shoqërore, sociale dhe ato të edukimit të përfshijnë, të mbështesin dhe të inkurajojnë realizimin e veprimtarive kërkimore-shkencore lidhur me njohjen, hulumtimin dhe promovimin e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare.

3. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nëpërmjet aktiviteteve, fushatave sensibilizuese dhe koordinimit me institucionet e arsimit të lartë, promovon njohjen e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare.

4. Efektet financiare të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve, fushatave sensibilizuese që do të ndërmerren me nismën e ministrisë përgjegjëse për arsimin, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Efektet financiare të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore e shkencore, të realizuara nga institucionet e arsimit të lartë, do të përballohen nga të ardhurat e vetë institucioneve të arsimit të lartë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 697, datë 21.11.2018

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 903, DATË 21.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 112, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit të punës", të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të nenit 12, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të nenit 32, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 3, të vendimit nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

" 3.1. Përjashtimisht për vitin akademik 20182019, përfitojnë bursa financiare sipas aneksit 1, të këtij vendimi, studentët e regjistruar në vitin e parë dhe në vitet pas të parit, në ciklin e parë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën 1, të vendimit nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 20182019".

Studentët e regjistruar në vitin e parë, sipas përcaktimeve të kësaj pike, duhet të përmbushin kriterin e notës mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), e përllogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore.

Studentët e regjistruar në vitet pas të parit, sipas përcaktimeve të kësaj pike, duhet të përmbushin kriterin e notës mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), e përllogaritur si mesatare e notave të të gjitha detyrimeve të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe të shlyera për vitet pararendëse.

Studentët, sipas përcaktimeve të kësaj pike, përfitojnë bursën vetëm për periudhën që ndjekin studimet në këto programe studimi dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 698, datë 21.11.2018

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 269, DATË 29.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 e 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 e 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit të punës", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë
17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës, "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore""", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, pas shkronjës "g" shtohet shkronja "gj", me këtë përmbajtje:

"gj) Përjashtimisht për vitin akademik 2018- 2019, studentët e regjistruar në vitin e parë dhe në vitet pas të parit, në ciklin e parë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimit në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën nr. 1, të vendimit nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019".

Studentët e regjistruar në vitin e parë, sipas përcaktimeve të kësaj shkronje, duhet të përmbushin kriterin e notës mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), e përllogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore.

Studentët e regjistruar në vitet pas të parit, sipas përcaktimeve të kësaj shkronje, duhet të përmbushin kriterin e notës mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), e përllogaritur si mesatare e notave të të gjitha detyrimeve të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe të shlyera për vitet pararendëse.

Studentët përfitojnë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit vetëm për periudhën që ndjekin studimet në këto programe studimi dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 723, datë 06.12.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.288, DATË 21.5.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,"PËR MIRATIMIN E KUFIRIT MAKSIMAL TË TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE ME KOHË TË PLOTË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 4 e vendimit nr.288, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 777, datë 26.12.2018

PËR KONTROLLIN ANTIPLAGJIATURË TË DISERTACIONEVE PËR FITIMIN E GRADAVE SHKENCORE *(Ndryshuar me VKM nr. 99, datë 5.2.2020)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "e", të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e arkivit digjital të disertacioneve të përdorura për fitimin e gradave shkencore në institucionet e arsimit të lartë publik dhe jopublik, në Republikën e Shqipërisë, pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin apo institucioneve të ngarkuara prej saj.

2. Arkivi digjital të jetë pjesë e regjistrit të gradave shkencore, në kuptim të ligjit për arsimin e lartë.

3. Institucionet e arsimit të lartë si dhe çdo institucion tjetër shtetëror që disponon kopje origjinale të disertacioneve kanë detyrimin që, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të depozitojnë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin kopje të njësuar me origjinalin të disertacionit, si dhe materialin në formë elektronike.

4. Ministria përgjegjëse për arsimin kryen kontrollin digjital antiplagjiaturë të disertacioneve të përdorura për marrjen e gradës shkencore, në institucionet e arsimit të lartë, publik dhe jopublik.
5. Për kryerjen e kontrollit digjital antiplagjiaturë, ministria siguron softëare për kontroll automatik si dhe programe apo pajisje të tjera që i shërbejnë kontrollit për plagjiaturë të disertacioneve të paraqitura për fitimin e gradës shkencore.

6. Ministria përgjegjëse për arsimin i përcjell institucioneve të arsimit të lartë rezultatet e gjetjeve nga kontrolli antiplagjiaturë, mbi bazën e të cilave do të bëhet rivlerësimi përfundimtar mbi gradën shkencore të dyshuar si plagjiaturë.

7. Institucioni i arsimit të lartë, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga vënia në dispozicion e gjetjeve të kontrollit antiplagjiaturë, i njofton ministrisë përgjegjëse për arsimin vendimin e rivlerësimit përfundimtar për çdo gradë shkencore të shqyrtuar.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet e arsimit të lartë, publik dhe jopublik, dhe institucionet e tjera shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 778, datë 26.12.2018

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË VENDIMIN NR. 288, DATË 21.5.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KUFIRIT MAKSIMAL TË TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE ME KOHË TË PLOTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 288, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Pika 1 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

"1. Kufiri maksimal i tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë, për vitin akademik 20182019 dhe në vijim, paguhet nga studentët në masën 50% të vlerave të pasqyruara në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Institucionet publike të arsimit të lartë rimbursohen me fonde grant nga buxheti i shtetit për vlerën e tarifës vjetore të reduktuar, sa më sipër.".

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Studentët, të cilët rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) në përfundim të vitit të parë akademik, nga viti akademik 2019-2020 e në vijim paguajnë tarifën e plotë të studimit, të pasqyruar në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 779, datë 26.12.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 269, DATË 29.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 e 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 e 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore"", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:
1. Shkronjat "f" dhe "g", të pikës 1, të vendimit nr. 269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"f) Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë). Këta studentë duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitet e mëparshme të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit akademik paraardhës;

g) Studentët e pranuar në vitin e parë akademik në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, të përllogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore. Lista e studentëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare hartohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe dërgohet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 780, datë 26.12.2018

PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR ULJE TË TARIFËS VJETORE TË STUDIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 e 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 e 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës, "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore""", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave
VENDOSI:

1. Studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të dytë të studimeve, sipas kategorive të mëposhtme, paguajnë 50% të tarifës vjetore të studimeve të miratuar nga institucionet publike të arsimit të lartë:

a) Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

b) Studentët, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, si dhe studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;

c) Studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;

ç) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë;

d) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktima të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktima të trafikut të qenieve njerëzore;

dh) Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria/institucioni përgjegjës;

e) Studentët romë dhe ballkano-egjiptianë, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale;

ë) Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;

f) Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë);

g) Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të regjistruar në vitin e parë pas të parit dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin akademik paraardhës.

2. Studentët sipas kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1, të këtij vendimi, paguajnë tarifën vjetore të studimeve në masën 50%, pas paraqitjes së dokumentacionit vërtetues për statusin e tyre ligjor, me vendim të Bordit të Administrimit të institucionit publik të arsimit të lartë.

3. Bordi i Administrimit të institucionit shqyrton dhe miraton për çdo vit akademik, jo më vonë se muaji dhjetor, listën e studentëve të kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1, të këtij vendimi.

4. Vendimi i Bordit të Administrimit të institucionit publik të arsimit të lartë i njoftohet Agjencisë Kombëtare së Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit.

5. Institucionet publike të arsimit të lartë rimbursohen me fonde grant nga buxheti i shtetit për vlerën e tarifës vjetore të reduktuar sa më sipër.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 781, datë 26.12.2018

PËR GARANTIMIN E TRANSPARENCËS NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", dhe të neneve 7, shkronjat "b" e "e", dhe 116, pika 2, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Me qëllim garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë bën publike të dhëna/informacione në kuadër të programit të transparencës dhe të trajtimit të ankesave ndaj institucioneve të arsimit të lartë, përmbajtja e të cilave do të publikohet nga Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar në portalin e transparencës dhe të trajtimit të ankesave.

2. Portali të jetë i aksesueshëm nga të gjithë dhe në të të publikohen on-line:

a) të dhëna të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare të çdo institucioni të arsimit të lartë, sipas formatit të miratuar me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për financat.
Duke filluar nga viti buxhetor 2019, bordi i administrimit të institucionit të arsimit të lartë, nëpërmjet administratorit, të përcjellë çdo tre muaj, për publikim, pranë Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, të dhënat e detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare, sipas përcaktimit të kësaj shkronje;

b) të dhëna për buxhetin afatmesëm (PBA), buxhetin vjetor, grantin nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e tjera, të gjitha shpenzimet operative, shpenzimet për kërkim shkencor dhe shpenzimet kapitale të çdo institucioni publik të arsimit të lartë;

c) informacion për procedurat e prokurimit publik (parashikim/realizim) apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat;

ç) vendimet e bordit, të senatit dhe organeve të tjera drejtuese/ vendimmarrëse;

d) kuotat e parashikuara për çdo vit akademik; dh) instrumentet dhe programet e shkëmbimit

studentor dhe procedurat përkatëse;

e) instrumentet e financimit të studimeve dhe procedurat përkatëse (bursat publike dhe ato specifike për çdo IAL);

ë) marrëveshjet dy-apo shumëpalëshe në nivel IAL-je apo institucione të tjera;

f) të dhënat për bursat dhe stimujt financiarë të ofruar nga shteti për studentët; g) CV-të e pedagogëve; gj) rezultatet e kontrollit dhe të verifikimit të titujve shkencorë;

h) mekanizmat dhe procedurat për bërjen e kërkesave dhe paraqitjen e ankesave në lidhje me veprimet ose mosveprimet e drejtuesve/ organeve drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, procedurën, nëpërmjet së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të institucionit të arsimit të lartë.

3. Për trajtimin e ankesave në platformën e transparencës on-line, kontrollin e transparencës dhe pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë krijohet struktura përgjegjëse për kontrollin e transparencës së arsimit të lartë.

4. Misioni i kësaj strukture është të kryejë verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë, të ankimeve dhe/ose kallëzimeve për veprimtari abuzive, korruptive apo arbitrare, të identifikojë punonjësit e IAL-ve, të cilët, me veprime apo mosveprime pretendohet se kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, rritjen e eficiencës e të përgjegjësisë në zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore.

5. Rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e strukturës përgjegjëse për kontrollin e transparencës në arsimin e lartë miratohen me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM
Nr. 782, datë 26.12.2018

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, pika 1, shkronja "b", 47 dhe 48, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kritereve e të procedurave transparente të përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë, me qëllim garantimin e profesionalizmit, të pavarësisë dhe të integritetit etik të anëtarit të bordit.
2. Bordi i Administrimit, si organi më i lartë kolegjial administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij, përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme.
3. Anëtarët, përfaqësues të institucionit publik të arsimit të lartë, përzgjidhen nga senati akademik i institucionit përkatës.
4. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin do të jenë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike dhe emërohen nga ministri përgjegjës për arsimin.
5. Përbërja e Bordit të Administrimit përcaktohet në varësi të planit buxhetor afatmesëm të institucionit publik të arsimit të lartë, të miratuar nga Bordi i Administrimit.
6. Një nga anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin përzgjidhet nga studentët e IAL-së përkatëse, të cilët i paraqesin ministrit tri kandidatura. Ministri përgjegjës për arsimin emëron një prej kandidaturave të paraqitura nga studentët. Kandidaturat e paraqitura nga studentët duhet të plotësojnë të njëjtat kritere si dhe anëtarët e tjerë të bordit përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
7. Njoftimi për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të bordit, mënyra e vlerësimit të kandidatëve bazuar në kriteret e parashikuara në këtë vendim dhe afati i dorëzimit të dokumentacionit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.
8. Njoftimi i konkurrimit për anëtar të bordit përmban këto të dhëna:
a) Një përshkrim të shkurtër të kompetencave e të funksionit që do të mbulojë anëtari;
b) Kërkesat për pranimin e kandidatëve;
c) Listën e dokumenteve që duhet të paraqiten, vendin dhe afatin deri kur do të paraqiten dokumentet;
ç) Mënyrën dhe kohën kur do të shpallet lista e kandidatëve që do të kualifikohen.
9. Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.
10. Çdo kandidat për anëtar të bordit duhet të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit, në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike.
11. Kriteret për t'u emëruar anëtar i bordit janë, si më poshtë vijon:
a) Të ketë integritet etik dhe profesional;

b) Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;

c) Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

ç) Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesave.

12. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të bordit kryhet nga një komision ad-hoc i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore.

13. Komisioni ad-hoc, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e mbylljes së afatit të dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton dokumentacionin dhe harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim, të shoqëruar me një relacion përmbledhës, i cili i paraqitet për miratim ministrit përgjegjës për arsimin.

14. Ministri përgjegjës për arsimin emëron anëtarët e bordit për secilin institucion të arsimit të lartë.

15. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 783, datë 26.12.2018

PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS NË MËSIMDHËNIE TË PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, EDHE NËPËRMJET SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 104, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë vlerëson procesin dhe performancën në mësimdhënie të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, me qëllim sigurimin, promovimin dhe përmirësimin e cilësisë së procesit të mësimdhënies në këto institucione.

2. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të ndjekë të gjithë procedurën e njoftimit të IAL-ve, ngritjes së grupeve të punës që do të realizojnë procesin e vlerësimit të performancës në mësimdhënie të personelit akademik, deri në hartimin e raporteve përfundimtare.

3. Procesi i vlerësimit të mësimdhënies monitorohet në mënyrë të vazhdueshme edhe përmes sondazhit kombëtar të studentëve, në të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë harton metodologjinë dhe instrumentet e sondazhit kombëtar të studentëve për cilësinë e mësimdhënies.

4. Në procesin dhe grupet e vlerësimit, të ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, marrin pjesë dhe përfaqësuesit e studentëve të propozuar nga institucionet e arsimit të lartë.

5. Raporti përfundimtar, i përgatitur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë, i paraqitet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionit të arsimit të lartë që i është nënshtruar procesit të vlerësimit të performancës në mësimdhënie.

6. Strukturat përgjegjëse në institucionet e arsimit të lartë shqyrtojnë dhe marrin në konsideratë rezultatet e raportit për vlerësimin e punës mësimdhënëse të çdo anëtari të personelit akademik.

7. Vlerësimi përfundimtar, për çdo anëtar të personelit akademik, bëhet pjesë e dosjes së tij personale, së bashku me vlerësimet e tjera gjithëvjetore.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe institucionet të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 784, datë 26.12.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 903, DATË 21.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 112, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë
31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të nenit 12, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të nenit 32, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Përfitojnë bursë, në masën e përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, studentët e pranuar në vitin e parë akademik, për çdo program studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore mbi 9 (nëntë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, të përllogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore. Lista e studentëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare hartohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe dërgohet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Gjithashtu, përfitojnë bursë në masën e përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, studentët e regjistruar në çdo program studimi, në vitet pas të parit, me kriterin e notës mesatare mbi 9 (nëntë), të përllogaritur nga institucionet e arsimit të lartë, vetëm për periudhën që ndjekin studimet në këto programe studimi dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.”.

b) Aneksi 1, që i bashkëlidhur vendimit në fuqi, zëvendësohet me aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

ANKESI 1

MASA E BURSËS PËR STUDENTËT NË IAL PUBLIKE

Nr.	**Kategoritë e bursave**	**Totali mujor i bursës në lekë**
1.	Universitetet dhe shkollat e tjera të larta	
	a) Bursa për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentë në nevojë, që ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë	10 000
	b) Gjysmëbursa akordohen për raste të veçanta për kategorinë e studentëve në nevojë, që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë	5 000
2.	Universiteti i Sporteve	
	a) Bursa për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentë në nevojë, që ndjekin programe studimi në fushën e edukimit fizik, në të cilat parashikohet të kryhen orë praktikash sportive	10 000
	b) Gjysmëbursa akordohen për raste të veçanta për kategorinë e studentëve në nevojë, që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë	5 000

2019

VENDIM

Nr. 39, datë 23.01.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 903, DATË 21.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 4 e 112, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidëve të punës", të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të nenit 12, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar dhe të nenit 32, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Përfitojnë bursë nga fondi i mbështetjes studentore, në masën e përcaktuar në këtë vendim, studentët e pranuar në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve, programet e integruara të studimeve, si dhe studentët e shtresave sociale në nevojë, që plotësojnë kriteret, si më poshtë:

a) studentët e pranuar në vitin e parë akademik, në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve dhe programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që përllogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve, si më poshtë:

i) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë; ii) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave

të provimeve të Maturës Shtetërore.

Lista e studentëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare hartohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe dërgohet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

b) Studentët e regjistruar në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve, programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitet pas të parit, me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të vitit paraardhës

akademik të përllogaritur me kreditet dhe notat e atij viti akademik nga institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare vjetore e ponderuar.".

2. Pika 2 shfuqizohet.

3. Në pikën 3, fjalët "... sipas masës së përcaktuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi ..." hiqen.

4. Pika 3.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3.1 Përjashtimisht, për vitin akademik 20182019, të gjithë studentët e regjistruar në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve, që plotësojnë kriteret e këtij vendimi dhe nuk kanë përfituar bursë të plotë sipas këtij vendimi, me vendim të njësive të vetëqeverisjes vendore apo me vendim të bordit të administrimit të IAL-ve publike, plotësojnë formularin e kërkesës dhe dokumentacionin provues të plotësimit të kritereve përkatëse për të përfituar nga e drejta për bursë financiare sipas këtij vendimi, brenda 20 (njëzet) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e kërkesës, IAL-të publike kryejnë verifikimet e nevojshme dhe i dërgojnë për shqyrtim dhe miratim në bordin e administrimit. Bordi i administrimit miraton bursat për studentët që përmbushin kriteret sipas këtij vendimi, brenda 5 (pesë) ditëve. Këto bursa miratohen dhe jepen nga muaji janar 2019 dhe në vijim.".

5. Në pikën 4 hiqet fjalia e fundit.

6. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Studentë në nevojë konsiderohen:

a) studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike;

b) bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili bursë financiare;

c) studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të
Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;

ç) studentët që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;

d) studentët që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk
jeton; dh) studentët, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë;

e) studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;

ë) studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç;

f) studentët që janë identifikuar si viktima të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar
statusin ligjor për trajtim si viktima të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç;

g) studentët që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.".

7. Pikat 6 dhe 7 shfuqizohen.

8. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. Studentët aplikojnë për bursë, sipas kritereve të përcaktuara në këtë vendim, me dokumentacionin provues të plotësimit të kritereve, në momentin e regjistrimit, pranë institucioneve publike të arsimit të lartë ose në momentin që plotësojnë kriteret sipas këtij vendimi.".

9. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës dhe e dokumentacionit, kryejnë verifikimet e nevojshme për plotësimin e tij në bashkëpunim me institucionet të cilat kanë detyrimin ligjor për të konfirmuar dokumentacionin dhe i dërgojnë për shqyrtim dhe miratim në bordin e administrimit të institucionit publik të arsimit të lartë.

Bordi i administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë shqyrton dhe merr vendim për bursat financiare për studentët që përmbushin kriteret sipas këtij vendimi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga studenti. Bursa financiare paguhet nga data e regjistrimit në rastet e aplikimit në fillim të vitit akademik ose nga muaji pasardhës kur studenti ka paraqitur kërkesën në rast plotësimi të kritereve të përcaktuara në këtë vendim gjatë vitit akademik. Vendimet e Bordit të administrimit për miratimin e bursave financiare bëhen publike dhe ankimohen, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.".

10. Pika 10 shfuqizohet.

11. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"11. Bursa financiare u jepet studentëve përfitues çdo muaj, në llogarinë bankare të deklaruar nga studentët, në bankat e nivelit të dytë, pas konfirmimit të frekuentimit të programit përkatës të studimit nga përgjegjësi i njësisë bazë. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me IAL-të publike, sipas kritereve të parashikuara në këtë vendim, parashikon numrin e pritshëm të studentëve që përfitojnë bursë në periudhën afatmesme dhe efektet financiare, si pjesë e programit buxhetor afatmesëm.".

12. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"12. Studentët që vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi nuk trajtohen me bursë financiare.".

13. Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"13. Bursa financiare është në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.".

14. Pika 14 shfuqizohet.

15. Pika 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"16. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 40, datë 23.01.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 269, DATË 29.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 e 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 e 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit të punës", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës, "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave
VENDOSI:

Në vendimin nr. 269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, Pikat 2 ndryshohet, Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5, Pas pikës 4 shtohet pikat 4.1, Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentët, të cilët janë pranuar në programe të studimeve profesionale, programe të ciklit të parë të studimeve ose programe të integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, të kategorive, si më poshtë vijon:

a) Studentët e pranuar në vitin e parë akademik, në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që përllogaritet si mesatare e thjeshtë e këtyre treguesve:

i) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë; ii) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave

të provimeve të Maturës Shtetërore.

Lista e studentëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare hartohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe dërgohet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

b) Studentët e regjistruar në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve, programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitet pas të parit, me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) të vitit paraardhës akademik, të përllogaritur me kreditet dhe notat e atij vitit akademik, nga institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare vjetore e ponderuar.

c) Studentët, të cilët u përkasin shtresave sociale në nevojë, si më poshtë vijon:

i) studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike; ii)

bashkëshortët, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy studentë;

iii) studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar; iv) studentët, të cilët i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;

v) studentët, të cilët i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton; vi) studentët, të cilët janë të tretët e lart në radhën e fëmijëve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë; vii)

studentët, të cilët kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;

viii) studentët, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç; ix) studentët, të cilët janë identifikuar si viktima të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktima të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç;

x) studentët, të cilët janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës; xi) studentët romë dhe egjiptianë, të cilët do të identifikohen nëpërmjet vetëdeklarimit; xii) studentët, fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.”.

2. Pikat 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Studentët aplikojnë për përjashtim nga tarifat, sipas kritereve të përcaktuara në këtë vendim, me dokumentacionin provues të plotësimit të kritereve në momentin e regjistrimit pranë institucioneve publike të arsimit të lartë ose në momentin që plotësojnë kriteret, sipas këtij vendimi.”.

3. Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5, me këtë përmbajtje:

“2.1. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës, kryejnë verifikimet e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit, në bashkëpunim me institucionet që kanë detyrimin ligjor për të konfirmuar dokumentacionin dhe i dërgojnë për shqyrtim e miratim në bordin e administrimit të institucionit publik të arsimit të lartë.

2.2. Bordi i administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë shqyrton dhe merr vendim për përjashtim nga tarifat për studentët, të cilët përmbushin kriteret sipas këtij vendimi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga studenti. Përjashtimi nga tarifat bëhet nga data e regjistrimit, në rastet e aplikimit në fillim të vitit akademik, ose nga muaji pasardhës, kur studenti ka paraqitur kërkesën gjatë vitit akademik, në rast plotësimi të kritereve të përcaktuara në këtë vendim.

2.3. Vendimet e bordit të administrimit për miratimin e përjashtimit nga tarifat bëhen publike dhe ankimohen sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

2.4. Vendimi i bordit të administrimit të institucionit publik të arsimit të lartë i njoftohet Agjencisë Kombëtare së Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga data e marrjes së vendimit.

2.5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me IAL-të publike, sipas kritereve të parashikuara në këtë vendim, parashikon numrin e pritshëm të studentëve, të cilët përfitojnë përjashtim nga tarifat në periudhën afatmesme dhe efektet financiare, si pjesë e programit buxhetor afatmesëm.".

4. Pas pikës 4 shtohet pikat 4.1, me këtë përmbajtje:

"4.1 Përjashtimisht, për vitin akademik 20182019, të gjithë studentët e regjistruar në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve, të cilët plotësojnë kriteret e këtij vendimi dhe nuk kanë përfituar përjashtim nga tarifat sipas këtij vendimi, me vendim të njësive të vetëqeverisjes vendore apo me vendim të bordit të administrimit të IAL-së publik, plotësojnë formularin e kërkesës dhe dokumentacionin provues të plotësimit të kritereve përkatëse për të përfituar përjashtim nga tarifat sipas këtij vendimi, brenda 20 (njëzet) ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e kërkesës, IALtë publike kryejnë verifikimet e nevojshme dhe i dërgojnë për shqyrtim e miratim në bordin e administrimit. Bordi i administrimit miraton përjashtimin nga tarifat për studentët, të cilët përmbushin kriteret sipas këtij vendimi, brenda 5 (pesë) ditëve. Përjashtimi nga tarifat miratohet nga muaji janar 2019 dhe në vijim.".

5. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM
Nr. 124, datë 13.3.2019

PËR PROCEDURAT E TRANSFERIMIT TË FONDIT GRANT "PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE NË KONVIKTET E STUDENTEVE" TË BASHKISË TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi në dispozicion të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në masën 300 000 000 (treqind milionë) lekë, në llogarinë ekonomike 604, të programit buxhetor 09450, "Arsimi i Lartë", i trashëguar për vitin 2019, të përdoret me destinacion përmirësimin e kushteve në konviktet e studentëve të Bashkisë Tiranë.
2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, pas miratimit nga Komiteti i Ndihmës Shtetërore, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të transferohet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë te përfituesi, ndërmarrja/et e trajtimit të studentëve, me pronar Bashkinë Tiranë, si transfertë në llogarinë e përfituesit në bankën e nivelit të dytë.

3. Transferimi i fondeve të realizohet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pas konfirmimit nga Bashkia Tiranë të ndërmarrjes/eve të trajtimit të studentëve, Tiranë, (përfituesi), dhe numrit të llogarisë bankare të tij/tyre në bankën e nivelit të dytë përkatëse.
4. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Bashkia Tiranë të monitorojnë mbarëvajtjen e punimeve për realizimin e projektit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, nëpërmjet një grupi ekspertësh me përfaqësues nga të dyja institucionet.
5. Përbërja dhe detyrat e grupit të ekspertëve përcaktohen me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Tiranë dhe ndërmarrja/et e trajtimit të studentëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM
Nr. 188, datë 13.3.2019

PËR OFRIMIN NGA INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË TË SHËRBIMEVE, NË PËRPUTHJE ME VEPRIMTARINË E TYRE, PËR INSTITUCIONET E QEVERISJES QENDRORE DHE INSTITUCIONET NË VARËSI TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të neneve 18, 19 e 95, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore apo institucionet në varësinë e tyre të kërkojnë fillimisht, sipas nevojave, shërbime me fonde buxhetore, si konsulenca, studime apo ekspertiza nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas fushave të veprimit.
2. Për shërbimet e ofruara sipas këtij vendimi, institucionet publike të arsimit të lartë zbatojnë tarifat e miratuara sipas legjislacionit në fuqi dhe, në mungesë të tyre, miratojnë tarifa me akte të brendshme. Tarifat e miratuara me akte të brendshme duhet t'u referohen kontratave për punë të ngjashme dhe, në mungesë të tyre, t'i referohen mesatares së vlerave të tregut për shërbimin përkatës të kërkuar.
3. Bordet e administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë miratojnë tarifat për shërbimet e ofruara për institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, si dhe për të tretët.
4. Institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, nënshkruajnë kontratë shërbimi me titullarin për çështjet financiare dhe administrative të institucionit publik të arsimit të lartë.
5. Grupi i punës, mënyra e administrimit të të ardhurave dhe masa e shpërblimit të personelit akademik dhe/ose studentëve të angazhuar në ofrimin e shërbimit rregullohen me procedura të brendshme të institucionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Përparësi në rastet e ofrimit të shërbimeve kanë ato IAL, të cilat kanë marrëveshje partneriteti me ministritë e linjës. Në rastet kur një shërbim ose kategori shërbimesh ofrohet nga më shumë se një IAL publik dhe nuk ka marrëveshje partneriteti, përzgjedhja nga ana e institucioneve publike duhet të kryhet bazuar mbi ofertën më të mirë.

7. Institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, vijojnë me procedurat e prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi, në rastet kur:

a) cilësia e shërbimeve të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë nuk është sipas marrëveshjes së nënshkruar;

b) shërbimet e kërkuara nuk mund të realizohen nga institucionet publike të arsimit të lartë;

c) tarifat e ofruara nga këto institucione nuk janë sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

8. Të gjitha institucionet e pavarura kanë të drejtë që, sipas nevojave të tyre, të kërkojnë shërbimet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas fushave të veprimit.

9. Ngarkohen Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore, institucionet në varësinë e tyre dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 226, datë 17.4.2019

PËR KATEGORITË E SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA ENTET SHTETËRORE DHE SUBJEKTE TË TJERA, TË CILAT PËRFITOHEN ME ÇMIME TË REDUKTUARA PËRMES PËRDORIMIT TË KARTËS SË STUDENTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 100, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimet që ofrohen nga entet shtetërore në fushën e artit dhe të kulturës, të shëndetësisë dhe të mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe rinisë, transportit, turizmit dhe mjedisit, ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit dhe ato të mbrojtjes përfitohen nga studentët me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit, si një dokument unik i çdo studenti.

2. Ministrat, sipas fushës së përgjegjësisë përkatëse, miratojnë, me urdhër të përbashkët me ministrinë përgjegjëse për arsimin, listën e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara për studentët. Në urdhrin e përbashkët përcaktohen çmimet e reduktuara për shërbimet që do të ofrohen. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxheti i secilës ministri, ofruese e shërbimit për studentët, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore.

3. Përfituesit e kartës së studentit përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara edhe nga subjekte të tjera publike apo private, që kanë objekt të fushës së veprimtarisë së tyre shërbime për studentët, në bazë të marrëveshjeve përkatëse, pa efekte financiare për buxhetin e shtetit, të nënshkruara me ministrinë përgjegjëse për arsimin.

4. Në nivel vendor, marrëveshjet për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit nënshkruhen ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore nënshkruajnë marrëveshje me subjekte të tjera publike dhe private për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit.

6. Çdo institucion i arsimit të lartë mund të nënshkruajë marrëveshje, pa efekte financiare, me subjekte publike apo private, për ofrimin e shërbimeve të ndryshme, në nivel qendror apo vendor, me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit.

7. Marrëveshjet e lidhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e arsimit të lartë marrin miratimin paraprak në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Ministria përgjegjëse për arsimin konfirmon miratimin brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga njoftimi i marrëveshjes. Në rast se konfirmimi nuk paraqitet brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, miratimi konsiderohet i dhënë.

8. Përfituesit e kartës së studentit përfitojnë të gjitha shërbimet e ofruara sipas përcaktimeve të këtij vendimi nëpërmjet paraqitjes së kartës së studentit si dokument unik. Shërbimet e ofruara, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, bëhen publike nga të gjitha institucionet qendrore e vendore, si dhe nga subjektet publike e private në faqet e tyre zyrtare, ndërsa ministria përgjegjëse për arsimin publikon të gjitha shërbimet e siguruara me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit.

9. Karta e studentit mund të bëhet pjesë e projekteve ndërkombëtare përmes marrëveshjeve që lidhen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kjo pjesëmarrje mundëson që shërbimet e ofruara nga këto projekte të përfitohen nga të gjithë përfituesit e kartës së studentit në shtetet anëtare të projektit apo të marrëveshjeve ndërkombëtare. Efektet financiare të pjesëmarrjes në projektet ndërkombëtare përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin.

10. Shpenzimet për prodhimin dhe administrimin e kartës së studentit do të përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxheti i ministrive sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore.

11. Në rast se njësitë e vetëqeverisjes vendore paraqesin kërkesë për prodhimin dhe administrimin e kartës së studentit, ministria përgjegjëse për arsimin nënshkruan një marrëveshje dypalëshe me këto njësi për delegimin e këtyre përgjegjësive e kompetencave. Në këtë rast, shpenzimet do të përballohen nga buxheti i këtyre njësive.

12. Qendra e Shërbimeve Arsimore konfirmon, për çdo vit akademik, studentët e regjistruar në vitin përkatës akademik, për çdo institucion të arsimit të lartë, pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, në rastin e delegimit të prodhimit dhe të administrimit të kartës së studentit.

13. Ngarkohen ministritë sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, entet shtetërore, si dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM
Nr. 295, datë 10.5.2019

PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020 *(Ndryshuar me VKM nr. 487, datë 10.7.2019; nr. 651, datë 3.10.2019)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 74, dhe të pikës 2, të nenit 76, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në këtë vendim.
2. Për të gjithë kandidatët, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, nota mesatare për pranimin në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2019-2020, të jetë nota 6.5 (gjashtë pikë pesë).
3. Në rastet e transferimit të studimeve nga brenda apo jashtë vendit, në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit, brenda të njëjtit cikël, studentët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave të vitit akademik që studenti është pranuar në institucionin e arsimit të lartë, duke filluar nga viti akademik 2016-2017 dhe në vijim.
4. Nota mesatare për pranimin në institucionet e arsimit të lartë përllogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve, si më poshtë vijon:

a) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë;
b) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.

5. Për kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimit të fushës së mësuesisë, për vitin akademik 2019-2020, nota mesatare e përllogaritur sipas këtij vendimi të jetë nota 7.5 (shtatë pikë pesë). Nota mesatare e kandidatëve që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimit të fushës së mësuesisë përllogaritet sipas përcaktimeve të pikës 4, të këtij vendimi.
6. Programet e studimit të fushës së mësuesisë përcaktohen në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
7. Kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare, me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi.
8. Institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, janë përgjegjëse për përllogaritjen e notës mesatare dhe dërgimin e këtyre të dhënave në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.
9. Procedurat për njëvlershmërinë e dokumenteve të paraqitura nga shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, si dhe përllogaritja e notës mesatare për këta kandidatë të kryhen në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, sipas përcaktimeve të pikës 4, të

këtij vendimi. Në rastet kur nuk aplikohen provimet e Maturës Shtetërore, komisioni përkatës përcakton mënyrën e përllogaritjes së notës mesatare. Komisioni përkatës dërgon të dhënat tek institucioni arsimor vendor përkatës, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 372, datë 29.5.2019

PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I GODINAVE TË STUDENTËVE NË QYTETET SHKODËR, ELBASAN, VLORË, KORÇË DHE GJIROKASTËR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 50 e 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin, në vlerën 320 000 000 (treqind e njëzet milionë) lekë, të projektit "Rikonstruksioni i godinave të konvikteve të studentëve në qytetet Shkodër, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastër", në përputhje me projektet e Institutit të Ndërtimit.

2. Autoriteti kontraktues dhe zbatues i projektit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, do të jetë Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe përfituesit do të jenë ndërmarrjet e trajtimit të studentëve. Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të nënshkruajë marrëveshjen e investimit me ndërmarrjet e trajtimit të studentëve, të cilat janë të detyruara të marrin masa për lirimin e godinave të studentëve si dhe pajisjen me lejet e nevojshme, në përputhje me legjislacionin për planifikimin e territorit.

3. Në buxhetin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, miratuar për vitin 2019, në zërin "Shpenzime kapitale të brendshme", në programin "Programe Zhvillimi", shtohet fondi prej 64 (gjashtëdhjetë e katër) milionë lekësh.

4. Në buxhetin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, miratuar për vitin 2019, në zërin "Shpenzime kapitale të brendshme", në programin "Arsimi i Lartë", pakësohet fondi prej 64 (gjashtëdhjetë e katër) milionë lekësh.

5. Diferenca e fondit të nevojshëm për zbatimin e plotë të projektit si dhe vlera e kostos operacionale të FSHZH-së do të lëvrohet nëpërmjet buxhetit të shtetit, në përputhje me ecurinë e zbatimit të punimeve, deri në vlerën e plotë, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Instituti i Ndërtimit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM
Nr. 387, datë 12.6.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 216, DATË 20.4.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2018–2019"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numrat rendorë 14 dhe 15, të tabelës në shtojcën 1, të vendimit nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, për programet e studimit të ciklit të parë "Pedagogji Muzikore" dhe "Pikturë Grafike", në universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër, për vitin akademik 2018 – 2019, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM
Nr. 461, datë 3.7.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 560, DATË 29.9.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR CAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pikat 2 e 3, 10 dhe 101, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën

e Shqipërisë", dhe të neneve 9, 10, pika 7, dhe 13, shkronja "c", të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5, e aneksit 1, bashkëlidhur vendimit nr. 560, datë 29.9.2018, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 487, datë 10.7.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 295, DATË 10.5.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2019–2020"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 74, pika 1, e 76, pika 2, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shtojca 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 295, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1

Nr.	INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE

1	**Universiteti i Tiranës**	Biologji	7.5
2		Filozofi	7.5
3		Fizikë	7.5
4		Gjeografi	7.5
5		Gjuhë angleze	7.5
6		Gjuhë angleze (Sarandë)	7.5
7		Gjuhë frënge	7.5
8		Gjuhë gjermane	7.5
9		Gjuhë greke	7.5
10		Gjuhë italiane	7.5
11		Gjuhë - Letërsi	7.5
12		Gjuhë ruse	7.5
13		Gjuhë spanjolle me profil gjuhë - letërsi dhe qytetërim hispanik	7.5
14		Gjuhë turke	7.5
15		Histori	7.5
16		Informatikë	7.5
17		Kimi	7.5
18		Matematikë	7.5
19		Psikologji	7.5
20		Sociologji	7.5
Nr.	**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”**	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Biologji - Kimi	7.5
2		Edukim qytetar	7.5
3		Filozofi - Sociologji	7.5
4		Gjeografi dhe gjuhë italiane	7.5
5		Gjuhë shqipe dhe letërsi	7.5
6		Gjuhë angleze	7.5
7		Gjuhë frënge	7.5
8		Gjuhë gjermane	7.5
9		Gjuhë italiane	7.5
10		Histori - Gjeografi	7.5
11		Histori dhe gjuhë gjermane	7.5
12		Matematikë informatike	7.5
13		Matematikë - Fizikë	7.5
14		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
15		Mësuesi për arsim fillor	7.5
16		Psikologji	7.5
Nr.	**Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës**	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Gjuhë gjermane dhe angleze	7.5
2		Gjuhë Angleze	7.5
3		Gjuhë - Letërsi - Anglisht	7.5
4		Histori	7.5
5		Informatikë - Anglisht	7.5

6		Matematikë - Informatikë	7.5
7		Mësuesi për arsim fillor	7.5
8		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
9		Psikologji	7.5
10		Filozofi - Sociologji	7.5
Nr.	**Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër**	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Biologji - Kimi	7.5
2		Gjuhë - Letërsi shqipe	7.5
3		Gjuhë - Letërsi angleze	7.5
4		Gjuhë - Letërsi dhe Qytetërim grek	7.5
5		Gjuhë - Letërsi italiane	7.5
6		Histori - Gjeografi	7.5
7		Matematikë - Informatikë	7.5
8		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
9		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
10		Fizikë dhe teknologji informacioni	7.5
11		Matematikë-Fizikë	7.5
Nr.	**Universiteti "Fan S. Noli", Korçë**	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Biologji - Kimi	7.5
2		Filozofi - Sociologji	7.5
3		Gjuhë angleze	7.5
4		Gjuhë dhe kulturë frënge	7.5
5		Gjuhë - Letërsi	7.5
6		Histori - Gjeografi	7.5
7		Matematikë - Fizikë	7.5
8		Matematikë - Informatikë	7.5
9		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
10		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
Nr.	**Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë**	**PROGRAMI I STUDIMIT**	
1		Biologji	7.5
2		Fizikë	7.5
3		Gjuhë angleze	7.5
4		Gjuhë italiane	7.5
5		Gjuhë shqipe dhe Letërsi	7.5
6		Histori - Gjeografi	7.5
7		Informatikë	7.5
8		Kimi	7.5
9		Matematikë	7.5
10		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
11		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
12		Pedagogji e specializuar	7.5
Nr.	**Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër**	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Biologji - Kimi	7.5

2		Fizikë	7.5
3		Gjeografi	7.5
4		Gjuhë - Letërsi	7.5
5		Gjuhë angleze	7.5
6		Gjuhë frënge	7.5
7		Gjuhë gjermane	7.5
8		Gjuhë italiane	7.5
9		Histori	7.5
10		Informatikë	7.5
11		Matematikë	7.5
12		Mësuesi për Arsim Fillor	7.5
13		Mësuesi për Arsim parashkollor	7.5
14		Psikologji	7.5
Nr.	**Kolegji universitar "*Bedër*"**	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Arsimi parashkollor dhe fillor	7.5
2		Gjuhë dhe letërsi angleze	7.5
3		Psikologji këshillimi dhe Pedagogji	7.5
Nr.	**Kolegji universitar "*Ëisdom*"**	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Psikologji	7.5
Nr.	**SHLUJ, Universiteti "Marin Barleti"**	**PROGRAMI I STUDIMIT**	
1		Psikologji	7.5
Nr.	**Universiteti Europian i Tiranës**	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Psikologji	7.5
2		Sociologji	7.5
3		Filozofi	7.5
4		Histori	7.5
5		Letërsi	7.5
6		Linguistikë	7.5
7		Arsim parashkollor	7.5
Nr.	**Universiteti i *Neë York*-ut në Tiranë**	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Psikologji	7.5
Nr.	**Universiteti privat "*Albanian University*"**	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Anglisht	7.5
2		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
3		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
4		Psikologji e përgjithshme	7.5
Nr.	**Kolegji universitar "*Logos*"**	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
2		Gjuhë dhe Civilizim grek	7.5

VENDIM

Nr. 562, datë 31.7.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 109, DATË 15.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË E TË BORDIT TË AKREDITIMIT DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR PROCESET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 15 e 106, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Shkronja "b", e pikës 27, ndryshohet si më poshtë vijon:

"b") Anëtarët e huaj, në masën 600 (gjashtëqind) euro;".

b) Pika 28 ndryshohet si më poshtë vijon:

"28. Kryetarit dhe anëtarëve, të huaj e shqiptarë, të Bordit të Akreditimit, me rezidencë të përhershme jashtë Shqipërisë, iu mbulohen shpenzimet e udhëtimit e të akomodimit në Shqipëri, për jo më shumë se tri ditë kalendarike për mbledhje.".

c) Pika 6, e shtojcës 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

"6. Eksperti vendas ose i huaj, që angazhohet në kuadër të plotësimit të kushteve apo për vlerësimin paraprak në kuadër të hapjes dhe/ose riorganizimit të IAL-ve, dhe të programeve të studimit, përzgjidhet nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e miratuar nga ASCAL-i. Numri i ekspertëve duhet të jetë jo më pak se dy dhe masa e pagesës për të gjithë ekspertët të jetë jo më shumë se 25% e tarifës bazë të parashikuar për vlerësimin e jashtëm të IAL-së dhe/ose programit të studimit, sipas tabelave 2/a dhe 2/b.".

ç) Në fund të pikës 2, të shtojcës 2, shtohen fjalitë, si më poshtë vijon:

"Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të parë të programeve profesionale të studimit, si dhe të programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë në IAL-të publike bëhet i grupuar, aty ku është e mundur dhe për jo më shumë se tri programe, sipas ciklit dhe fushës së studimit në nivel njësie bazë. Tarifat për vlerësimin në kuadër të akreditimit të parë të këtyre programeve të jenë sa 65% e tarifës së secilit program që do të vlerësohet i grupuar, sipas tabelës 2/b.

Në rastet kur njësia bazë ofron një program studimi profesional apo nga një program studimi për ciklin e parë dhe/ose të dytë, tarifat për vlerësimin në kuadër të akreditimit të parë të këtyre programeve të jenë sa 65% e tarifës së programit përkatës, sipas tabelës 2/b.

Ekspertët për vlerësimin e jashtëm, në kuadër të akreditimit të parë të programeve të studimit profesional, si dhe të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimit në IAL-të publike, paguhen 70% të vlerës së secilit program studimi që vlerësohet i grupuar sipas tabelës 1/b.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 651, datë 3.10.2019

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 295, DATË 10.5.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 74, pika 1, e 76, pika 2, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 7, të vendimit nr. 295, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen pikat 7/1 dhe 7/2, me këtë përmbajtje:

"7/1. Kandidatët, që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve në fushën e artit dhe të sportit, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare, të parashikuar në pikat 2 e 5, të këtij vendimi.

7/2. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, që aplikojnë për t'u pranuar në programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare, të parashikuar në pikat 2 e 5, të këtij vendimi.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 755, datë 30.11.2019

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 903, DATË 21.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 112, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të

Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidëve të punës", të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të nenit 12, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 14, të vendimit nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 14.1, me këtë përmbajtje:

"14.1 Vetëm për vitin akademik 2019—2020 përfitojnë bursë në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, studentët të cilët ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe janë anëtarë të familjeve që kanë humbur persona ose që janë shpallur të zhdukur në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, për shkak të tërmetit të datës 26.11.2019. Institucionet publike të arsimit të lartë identifikojnë studentët dhe dërgojnë listat e studentëve të identifikuar për miratim në ministrinë përgjegjëse për arsimin.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 808, datë 11.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 112, DATË 23.2.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE 'DOKTOR' DHE TË STANDARDEVE SHTETËRORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË 'PROFESOR I ASOCIUAR' DHE 'PROFESOR'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 60, pika 3, e 79, pika 7, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) kudo në tekstin e vendimit, emërtimi "Thomson Reuters", zëvendësohet me emërtimin "Journal Citation Reports";

b) në pikën 3, të kreut I, bëhen këto ndryshime:

i) shkronjat "a" dhe "b", ndryshohen, si më poshtë vijon:

"a) jo më shumë se 3 (tre), në rastin e personelit akademik që mban titullin "profesor";

b) jo më shumë se 2 (dy), në rastin e personelit akademik që mban titullin "profesor i asociuar";";

ii) shkronja "c" shfuqizohet.

c) shkronja "b", e pikës 6, të kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 1 (një) të jetë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të rankuara në Journal Citation Reports ose Scopus, ku është, së paku, autor i dytë.".

ç) pika 8, e kreut V, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 879, datë 18.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 71, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) kudo në tekstin e vendimit, emërtimi "objektiva formues" zëvendësohet me "rezultatet e të nxënit";

b) shkronjat "e" dhe "h", të pikës 1, ndryshohen si më poshtë vijon:

"e) "lëndë individuale artistike/sportive", një tërësi komponentësh mësimorë, e organizuar si një disiplinë mësimore e veçantë, që mësohet në mënyrë individuale;

h) "rezultate të të nxënit", bashkësi e dijeve, aftësive dhe kompetencave specifike të fushës, që studenti duhet të fitojë në përfundim të programit të studimit.";

c) pas shkronjës "h", të pikës 1, shtohen shkronjat "i" dhe "j", me këtë përmbajtje:

"i) "tema/disertacioni", një punim origjinal akademik/kërkimor, nën drejtimin e personelit akademik, që mbrohet përpara një komisioni si detyrimi final për fitimin e diplomës apo gradës shkencore përkatëse, i cili i nënshtrohet kontrollit të plagjiaturës dhe vlerësohet me notë dhe kredite;

j) "master ekzekutiv", program i ciklit të tretë të studimeve, që ofrohet për profesionistë, sipas kritereve të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë.";

ç) pas shkronjës "g", të pikës 2, shtohet shkronja "gj", me këtë përmbajtje:

"gj) kodin e etikës;";

d) paragrafi i fundit i shkronjës "b", të pikës 2.5, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Pesha që zë secila lëndë dhe veprimtari formuese brenda programit të studimit:

i. për programet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë përcaktohen në shtojcën nr. 1, tabela 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. për programet me karakter profesional përcaktohen në shtojcën nr. 1, tabela 1.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.".

dh) Pika 2.8 ndryshohet si më poshtë vijon:

"2.8 Modeli i programit të lëndës, që do të përdoret për hartimin e *syllabus-eve,* duhet të përmbajë elementet sipas përcaktimeve në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.".

e) Titulli dhe shkronjat "a" e "b", të pikës 2.10 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"2.10 Diploma/certifikata dhe suplementi i saj

Diplomat/certifikatat, që lëshohen në përfundim të programeve të studimit me karakter profesional të ciklit të parë e të dytë si dhe ato të ciklit të tretë "master ekzekutiv", shoqërohen me suplementin e diplomës.";

ë) pas pikës 2.10 shtohen pikat 2.11, 2.12 dhe 2.13, me këtë përmbajtje:

"2.11 Kodi i Etikës

a) Tërësia e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse, të cilat kodifikohen në nivel IAL-je ndaj studentëve, personelit akademik dhe atij ndihmësakademik, për t'u sjellë me integritet akademik, mbështetur në ndershmërinë;

b) Elementet e Kodit të Etikës, që prekin aktivitetin studentor, listohen në *syllabus-e,* sidomos për sa i përket detyrimit të studentëve për të mos kopjuar në provime, në punën e dikujt tjetër, për të mos fabrikuar të dhëna dhe respektuar dinjitetin e integritetin njerëzor e profesional të studentëve të tjerë dhe personelit akademik e atij mbështetës;

c) Studimet e doktoratës kanë një kod etike të dedikuar, që specifikon standardet etike të kërkimit, të cilat duhen respektuar, dhe rastet e procedurat kur, si pasojë e thyerjes së Kodit të Etikës, doktoranti mund të përjashtohet nga studimet e doktoratës ose mund t'i revokohet grada shkencore.".

2.12 Studimet e doktoratës

a) Studimet e doktoratës zhvillohen pranë njësisë bazë, si pjesë e projektit kërkimor-shkencor të aprovuar dhe me financim të siguruar nga IAL- ja. Pas licencimit të programit të studimeve të doktoratës dhe certifikimit të kuotave, studentët e pranuar mund të përfitojnë nga financimi i siguruar nga IAL-ja, financim nga subjekte të tjera apo të vetëfinancohen. Njësia bazë mund të ofrojë më shumë se një projekt kërkimor për fushën e kërkimit që mbulon;

b) Studimet e doktoratës organizohen në fusha kërkimi. Ato përmbajnë veprimtari kërkimore-shkencore dhe veprimtari akademike, sipas përcaktimeve të tabelës 1, të shtojcës 1, të këtij vendimi, me qëllim garantimin e formimit akademik shkencor në fushën përkatëse të studimit;

c) Personeli akademik, i angazhuar në studimet e doktoratës, është i kategorisë "profesor". Njësia përgjegjëse e programit të studimeve të doktoratës duhet të garantojë standardet akademike dhe të ofrojë infrastrukturën e domosdoshme për realizimin e projektit kërkimor-shkencor;

ç) Numri i studentëve doktorantë përcaktohet nga njësia bazë përgjegjëse për studimet e doktoratës, pas verifikimit dhe certifikimit të kapaciteteve nga ministria përgjegjëse për arsimin;

d) Në rregulloren e programit të studimit të doktoratës njësia bazë:

1. përcakton kriteret e pranimit të studentëve sipas parimit të thellimit të studimit në fushë të njëjtë apo të përafërt me studimet e ciklit paraardhës;

ii. bashkërendon, në funksion të realizimit të projektit kërkimor-shkencor, veprimtarinë akademike të studentëve;

iii. parashikon në mënyrë të detajuar rregullat e organizimit e të funksionimit të programit të doktoratës;

dh) Njësia bazë, përgjegjëse për programin e doktoratës, administron të dhënat e çdo doktoranti, në lidhje me veprimtarinë akademike dhe kërkimore-shkencore të tij, si dhe raportet e vlerësimit të progresit.

2.13. Specializimet afatgjata

Programet e studimeve specializuese afatgjata janë programe të formimit profesional, që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta. Elementet e këtyre programeve, sipas fushave, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.”.

2. Shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, të vendimit nr. 41, datë 23.1.2018, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me shtojcat nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Elementet e programeve të studimit të formimit të vazhduar përcaktohen në mënyrë të pavarur nga secila njësi bazë përgjegjëse, në bashkëpunim me ministritë e linjës, sipas elementeve orientuese të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjëse për arsimin.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

SHTOJCË NR. 1

Elementet e programeve të studimit përcaktohen në tabelat 1 dhe 1.1, si vijon:

Tabela 1

Kategoria	Komponenti mësimor	Cikli i parë (niveli 6 i	Cikli i dytë (niveli 7 i KSHK-së)			Cikli i tretë (niveli 8 i KSHK-së)	
		Bachelor	Master profesional	Master i shkencave / master i	Master i shkencave (i	Master ekzekutiv	Studimet e doktoratës
A	LËNDË BAZË — përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	15-20% (kredite)	5-10% (kredite)	5-10% (kredite)	15-20% (kredite)	5-10% (kredite	Detyrime akademike gjatë vitit të parë të
B	LËNDË KARAKTERIZUESE - përgatitje për disiplinën shkencore	50-55% (kredite)	30-40% (kredite)	50-60% (kredite)	45-55% (kredite)	50-60% (kredite)	Detyrime akademike gjatë vitit të parë të
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGR	12-15% (kredite)	20-30% (kredite)	12-20% (kredite)	12-15% (kredite)	12-15% (kredite)	
D	LËNDË PLOTËSUESE — gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika	10-15% (kredite)	10% (kredite)	10% (kredite)	6-8% (kredite)		
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3-5% (kredite)	10-20% (kredite)	10-15% (kredite)	3-5% (kredite)	18-20% (kredite)	Detyrime akademike gjatë gjithë

Shënim. Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70%, në rastin e programeve të ciklit të parë *Bachelor* dhe programeve të integruara të studimit të ciklit të dytë "master i shkencave", dhe jo më pak se 60% në rastin e programeve të ciklit të dytë "master i shkencave". në rastin e programeve të ciklit të dytë "master i arteve" ky raport vendoset sipas specifikave të vetë programit të studimit.

Për programet e studimit të ciklit të tretë "master ekzekutiv" lëndët e kategorisë B duhet të kenë një karakter dhe orientim të theksuar praktik, me qëllim avancimin e mëtejshëm profesional të studentëve. Për të përmbushur këtë objektiv, lëndët mund të ofrohen në bashkëpunim me industrinë dhe botën profesionale dhe, për çdo rast, ato duhet të jenë, të paktën, 50% praktikë në terren.

Për programet e doktoratës në kategorinë A përfshihen lëndë të strukturimit të kërkimit shkencor të thelluar, metodave cilësore dhe sasiore të përpunimit të të dhënave, etikës së

kërkimit shkencor dhe shkrimit të punimeve shkencore e të disertacionit doktoral. Në kategorinë B përfshihen lëndë të avancuara të debateve teorike, përqasjeve kërkimore, bashkëpunimeve ndërdisiplinore dhe zhvillimeve të fundit të disiplinës shkencore të doktorantit.

Detyrimet akademike gjatë vitit të parë të studimeve të doktoratës nuk duhet të jenë më pak se 30 ECTS.

Tabela 1.1

Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Programe me karakter profesional (niveli 5 i KSHK-së) 60-120 kredite
A	LËNDË BAZË- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	10-15% (kredite)
B	LËNDË KARAKTERIZUESE - përgatitje për disiplinën që karakterizon programin, lëndët praktike	45-55% (kredite)
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE — nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	5-15% (kredite)
D	LËNDË PLOTËSUESE — gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	10-15% (kredite)
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3-5% (kredite)

Shënim. Duhet të ruhet një raport i balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50/50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion.

SHTOJCË NR. 2

Grupet mësimore në programet e studimit me karakter profesional, të ciklit të parë dhe ciklit të dytë (përfshirë dhe programet e integruara) të studimit, të organizohen me numër maksimal studentësh, si më poshtë:

Tabela 2

Fusha e studimit	Nr. i studentëve/ seminar	Nr. i studentëve/ laborator	Nr. i studentëve/ praktika	Nr. i studentëve/ leksion
Shkenca natyrore	25	20	20	6 grupe seminari
Inxhinieri dhe teknologji	25	20	20	6 grupe seminari
Shkenca mjekësore dhe të shëndetit	25	20	20	6 grupe seminari
Shkenca agrikulturore dhe të veterinarisë	25	20	20	6 grupe seminari
Shkenca sociale	35	25	25	6 grupe seminari
Humanitete dhe arte	35	25	25	6 grupe seminari

Grupet mësimore në programet e studimit të ciklit të tretë të studimit të organizohen me numër maksimal studentësh, si më poshtë:

Tabela 2.1

Fusha e studimit	Nr. i studentëve/ seminar	Nr. i studentëve/ laborator	Nr. i studentëve/ leksion
Shkenca natyrore	20	15	3 grupe seminari
Inxhinieri dhe teknologji	20	15	3 grupe seminari
Shkenca mjekësore dhe të shëndetit	20	15	3 grupe seminari
Shkenca agrikulturore dhe të veterinarisë	20	15	3 grupe seminari
Shkenca sociale	25	20	3 grupe seminari
Humanitete dhe arte	25	20	3 grupe seminari

PËR UNIVERSITETIN E ARTEVE (BAZUAR NË SPECIFIKAT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE TË MËNYRËS SË MËSIMDHËNIES)

Tabela 2.2

Fusha e studimit	Nr. i studentëve/ Lëndë individuale artistike	Nr. i studentëve/ Mësim artistik në g[r]up	Nr. i studentëve / seminar	Nr. i studentëve/ praktika/shoqërim në piano	Nr. i studentëve / leksion	Nr. i studentëve / laborator
Arte	1	1-15	1-15	1-15	1-6 grupe seminari	1-15

PËR UNIVERSITETIN E SPORTEVE (BAZUAR NË SPECIFIKAT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE MËNYRËS SË MËSIMDHËNIES)

Tabela 2.3

Fusha e studimit	Nr. i studentëve/ Lëndë individuale në sporte	Nr. i studentëve / seminar teorik	Nr. i studentëve/ leksion	Nr. i studentëve/ laborator	Nr. i studentëve/ laborator (në palestër
Sporte	Jo më shumë se 18	20 - 30	2-6 grupe	20 - 30	jo më shumë se

SHTOJCA NR. 3

PROGRAMI I LËNDËS

Emërtimi i lëndës

(Shënim. Të gjitha shënimet brenda kllapave, me të pjerrëta, duhet të fshihen, përfshirë këtë shënim)

Titullari / /pedagogu i lëndës (për programet profesionale): *(emri, titulli akademik, grada shkencore dhe nënshkrimi)*

Ngarkesa: *(numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminar,praktika etj.)*

Viti akademik/semestri kur zhvillohet:

Lloji i lëndës: *(e detyrueshme ose me zgjedhje)*

Programi i studimit: *(programi për të cilin ofrohet kjo lëndë)*

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:

Kodi i Etikës:

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT: *(Përmbledhja është një abstrakt që jep idenë e përgjithshme të kursit. Objektivat e lëndës janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundimi të saj, të cilat ndahen në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studenti pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës.)*

KONCEPTET THEMELORE: *(Janë koncepte e terma baze mbi të cilat ndërtohet lënda.)*

1.

2.

3.

TEMAT E LËNDËS *(shpjegimi (rreth një paragrafi) i çdo temë të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe)*

Tema I —

Tema II —

Tema III —

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI:

KONTROLLI I VAZHDUESHËM: *(renditen format e vlerësimit të studentëve të shprehura si përqindje e notës përfundimtare: niveli i diskutimit në seminare, kolokiumi, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit dhe provimi përfundimtar etj.)*

LITERATURA *(literatura paraqet listën e botimeve që studenti duhet të lexofe gjatë lëndës, e ndarë në)*

a) literatura bazë e detyrueshme:

b) literatura e rekomanduar:

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS *(hapësira ku pedagogu parashtron mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik, nëse ka, si edhe elementet e Kodit të Etikës sipas pikës 2.10 të këtij vendimi)*

VENDIM

Nr. 57, datë 29.1.2020

PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS SI INSTITUCIONI I VETËM PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË NË FUSHËN E SPORTIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Universiteti i Sporteve të Tiranës (në vijim "UST") është institucion publik i arsimit të lartë, me karakter akademik, shkencor e sportiv, i krijuar me vendimin nr. 123, datë 17.2.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", të cilit i jepet status i veçantë.

2. Statusi i veçantë i dhënë për UST-në konsiston në trajtimin e veçantë të personelit akademik e administrativ, si dhe të programeve të studimit sipas legjislacionit në fuqi.

3. UST-ja është përgjegjëse për ofrimin e të gjitha programeve të studimit me kohë të plotë, programe studimi me karakter profesional, programe studimi në të tria ciklet e studimit, në fushën e edukimit fizik e sporteve, aktivitetit fizik për shëndet, rekreacionit e rehabilitimit, miratuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4. UST-ja ka për mision:

a) formimin universitar të studentëve e të specialistëve në të tria ciklet e studimeve;

b) kualifikimin e punonjësve akademikë e shkencorë në fushën e edukimit fizik, shëndetësor dhe të sporteve, të veprimtarisë fizike, shëndetit, rekreacionit, turizmit sportiv e rehabilitimit;

c) nxitjen e kërkimeve e të studimeve në fushën e edukimit fizik, shëndetësor dhe sporteve, veprimtarisë fizike, shëndetit, rekreacionit, turizmit sportiv e rehabilitimit;

ç) thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistëve të lartë në fushën e veprimtarisë fizike, rekreacionit dhe turizmit, rehabilitimit, si dhe të mësuesisë në profilet e edukimit fizik dhe edukimit shëndetësor;

d) ofrimin e shërbimeve për të tretët dhe konsulenca në fushat e edukimit fizik, të atij shëndetësor dhe të sporteve, veprimtarisë fizike, rekreacionit, turizmit sportiv e rehabilitimit.

5. UST-ja përfaqëson një strukturë të integruar dhe përbëhet nga njësi kryesore dhe institute kërkimore-shkencore.

6. UST-ja, si institucion i arsimit të lartë, që zhvillon veprimtari akademike në fushën e mësimdhënies e të kërkimit shkencor në fushën e edukimit fizik e shëndetësor, të sporteve, rekreacionit, turizmit sportiv e rehabilitimit, gëzon status të veçantë lidhur me:

a) organizimin e programeve të studimeve në cikle studimi që përfundojnë me marrjen e diplomave ose të certifikatave sipas rastit. Programet e studimeve në UST hartohen nga njësitë bazë dhe paraqiten për miratim në Senatin Akademik. Senati shpall publikisht programet e akredituara të studimeve që ofrojnë njësitë e universitetit para fillimit të aplikimeve për pranime në universitet. Studimet universitare organizohen, si më poshtë vijon:

i. studime të ciklit të parë "Bachelor";

ii. studime të ciklit të dytë "Master i shkencave" ose "Master profesional";

iii. studime të ciklit të tretë për gradën shkencore "Doktor";

iv. studime specializuese afatgjata;

v. studime të ciklit të tretë "Master ekzekutiv";

vi. programe të formimit të vazhduar/afatshkurtër për fushat e edukimit fizik e shëndetësor, të sporteve, rekreacionit, turizmit sportiv e rehabilitimit;

vii. programe studimi me karakter profesional;

b) ofrimin e procesit promovues, vlerësimin konkurrues dhe përfundimin me sukses të programit përkatës të formimit/trajnimit;

c) veprimtarinë profesionale dhe sportive të realizuar nga personeli akademik i saj, konvertuar në veprimtari shkencore, që shërbejnë për të vlerësuar performancën akademike vjetore sipas përcaktimeve në statutin e UST-së, konvertime, të cilat nuk janë të vlefshme për fitimin e gradave shkencore apo titujve akademikë;

ç) punësimin e personelit akademik me kohë të plotë, sipas kritereve të përcaktuara nga njësia bazë e të miratuara nga rektori, veç arritjeve akademike e shkencore të kandidatit, si dhe vlerësimin e karrierës profesionale sportive sipas përcaktimeve në statutin e UST-së;

d) mbështetjen, promovimin dhe pranimin për studime të sportistëve me statusin e nivelit të lartë sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi;

dh) të drejtën për të realizuar marrëveshje bashkëpunimi me universitete, akademi, kolegje të larta, institucione shkencore, agjenci dhe shoqata brenda e jashtë vendit, për shkëmbim përvoje dhe bashkëpunim në procesin mësimor-shkencor për ngritjen e komisioneve të përhershme për promovimin e personelit akademik, si dhe për kualifikimin e personelit

akademik/administrativ e të studentëve, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Niveli i bashkëpunimit përcaktohet në marrëveshjet përkatëse të lidhura ndërmjet institucioneve;

e) të drejtën e hartimit e zhvillimin e programeve të studimeve dhe të projekteve të kërkimit shkencor në fushën e edukimit fizik, atij shëndetësor dhe sporteve, të veprimtarisë fizike, rekreacionit, turizmit sportiv e rehabilitimit;

ë) hartimin e kritereve dhe testeve fizike të pranimit me konkurrim të kandidatëve për studentë në UST.

7. Vetëm për efekt të mësimdhënies si veprimtari akademike në UST, pa gëzuar të drejta të tjera, figurat e shquara dhe me një veprimtari të spikatur sportive brenda dhe jashtë vendit ftohen të japin kontributin e tyre në mësimdhënie për lëndët speciale, si personel akademik, në rast se plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të kenë kryer studimet në arsimin e lartë në profilin përkatës për të cilin kërkojnë të punësohen e të zotërojnë diplomën "Master i shkencave". Në rastet kur studimet në fushën e sporteve në profilin përkatës, për të cilin kërkojnë të punësohen, janë kryer në një IAL jashtë vendit, duhet të kenë të njohur e të njësuar diplomën përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi;

b) të kenë një veprimtari sportive të spikatur, veprimtari me interes kombëtar, e cila të jetë e dokumentuar me botime në katalogët/agjendat përkatëse.

8. Vlerësimi i kërkesave për njësimin e gradave shkencore dhe titujve akademikë, vetëm për efekt të mësimdhënies së personelit akademik që do të ftohet të japë kontributin e tij në mësimdhënie, bëhet nga komisioni "ad-hoc", i ngritur me vendim të Senatit Akademik të UST-së. Rektori i UST-së, në bazë të pozicioneve të lira të miratuara nga Senati Akademik dhe të listës së kandidatëve të përzgjedhur nga komisioni "ad-hoc", lidh kontratat njëvjeçare të punës.

9. Statuti i UST-së miratohet me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, bazuar edhe në statusin e veçantë të dhënë me këtë vendim.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Universiteti i Sporteve të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 908, datë 20.11.2019

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTOR PËR PROCEDURËN E PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT, PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE: "NDËRTIMI I KAMPUSIT TË RI TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS", "NDËRTIMI I GODINËS SË UNIVERSITETIT TË ARTEVE TË TIRANËS" DHE "NDËRTIMI I KORPUSIT TË POLICISË SË SHTETIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13, pika 3, 16 e 18, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, me propozimin të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të ministrit të Kulturës, të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e Bashkisë Tiranë si autoritet kontraktor për të ndërmarrë e për të zhvilluar procedurat për dhënie me koncesion/partneritet publik privat të projekteve: "Ndërtimi i kampusit të ri të Universitetit të Tiranës", "Ndërtimi i godinës së Universitetit të Arteve të Tiranës" dhe "Ndërtimi i korpusit të Policisë së Shtetit".
2. Komisioni, i cili do ngrihet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, për ndjekjen e procedurave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përbëhet prej 9 (nëntë) anëtarësh, nga të cilët 5 (pesë) anëtarë nga Bashkia Tiranë, 2 (dy) anëtarë nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), 1 (një) anëtar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe 1 (një) anëtar nga Ministria e Brendshme.
3. Komisioni i ngritur, sipas pikës 2 të këtij vendimi, për marrjen e opinioneve dhe të ekspertizave të nevojshme, asistohet nga përfaqësues të Universitetit të Tiranës, të Universitetit të Arteve të Tiranës dhe të Ministrisë së Brendshme. Komisioni mund të angazhojë këshilltarë të jashtëm për të siguruar mbështetjen e ekspertëve në përgatitjen e procedurave të koncesionit/partneritetit publik/privat.
4. Ngarkohet Bashkia Tiranë të administrojë procedurat për dhënien me koncesion/PPP, në përputhje me ligjin nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, të projekteve, me objekt: "Ndërtimi i kampusit të ri të Universitetit të Tiranës", "Ndërtimi i godinës së Universitetit të Arteve të Tiranës" dhe "Ndërtimi i korpusit të Policisë së Shtetit".
5. Ministria e Financave dhe Ekonomisë vlerëson e miraton paraprakisht projektet sipas këtij vendimi, si dhe çdo ndryshim apo transferim të tyre nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.
6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Brendshme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 99, datë 5.2.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 777, DATË 26.12.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KONTROLLIN ANTIPLAGJIATURË TË DISERTACIONEVE PËR FITIMIN E GRADAVE SHKENCORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "e", të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 777, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Institucionet e arsimit të lartë kryejnë kontrollin digjital antiplagjiaturë të disertacioneve të përdorura për marrjen e gradës shkencore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.";

b) pika 6 shfuqizohet;

c) pika 7 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

"7. Institucionet e arsimit të lartë njoftojnë ministrinë përgjegjëse për arsimin, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e vendimit përfundimtar, për rezultatet e gjetjeve nga kontrolli antiplagjiaturë dhe masat e marra pas rivlerësimit përfundimtar për gradën shkencore të dyshuar si plagjiaturë.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 87, datë 31.1.2020

PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË TË KRYEJË PROCEDURAT E PROKURIMIT, NË EMËR TË QENDRAVE TË TRAJTIMIT TË STUDENTËVE NË QYTETET SHKODËR, VLORË DHE KORÇË, PËR KOMPLETIMIN E AMBIENTEVE TË BRENDSHME TË GODINAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të kryejë procedurat e prokurimit, në emër të qendrave të trajtimit të studentëve në qytetet Shkodër, Vlorë dhe Korçë, për kompletimin e ambienteve të brendshme të godinave me mobilje dhe pajisje të tjera akomoduese e ndihmëse, me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2020.

2. Procedurat ligjore dhe fondet përkatëse për realizimin e kontratës publike të furnizimit për kompletimin e ambienteve të brendshme të godinave të qendrave të trajtimit të studentëve në qytetet sipas pikës 1, të këtij vendimi, do të kryhen dhe do të sigurohen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin "Shpenzime kapitale të brendshme", programi buxhetor 09450, "Arsimi i lartë", në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

3. Përfituesit do të jenë qendrat e trajtimit të studentëve në qytetet Shkodër, Vlorë dhe Korçë, të cilat do të kryejnë procedurat për marrjen në dorëzim dhe inventarizimin e pajisjeve të furnizuara e të vendosura apo të instaluara, në përputhje me sasitë dhe çmimet e përcaktuara në kontratën publike të furnizimit.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe qendrat e trajtimit të studentëve në qytetet Shkodër, Vlorë dhe Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRËR

Edi Rama

VENDIM
Nr. 156, datë 19.2.2020

PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA, SI INSTITUCIONI I VETËM PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË, NË FUSHËN E MBROJTJES DHE TË SIGURISË KOMBËTARE, SI DHE ORGANIZIMIN E FUNKSIONIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 5 e 6, të nenit 17, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozim të ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Akademia e Forcave të Armatosura (në vijim "AFA") është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, së cilës i jepet status i veçantë dhe ka varësi nga ministri përgjegjës për mbrojtjen dhe ministri përgjegjës për arsimin.

2. Statusi i veçantë i dhënë për AFA-në konsiston në organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, trajtimin specifik të organizimit akademik dhe administrativ, të personelit akademik, të personelit ndihmësakademik, trajnues dhe administrativ, të programeve të studimit, të kualifikimit, të trajnimit dhe të stërvitjes, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi.

3. AFA-ja zhvillon veprimtari mësimore e shkencore në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare. Ajo ka si mision arsimimin, kualifikimin dhe kërkimin shkencor në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare të personelit ushtarak e civil, për të gjitha nivelet e drejtimit të Forcave të Armatosura, si dhe të institucioneve të tjera të sigurisë kombëtare.

4. AFA-ja përbëhet nga njësitë kryesore, respektivisht:

a) Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë;

b) Instituti Kërkimor-Shkencor Ushtarak.

5. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të organeve kolegjiale, drejtuesit e njësive kryesore dhe të njësive bazë mësimore e kërkimore të AFA-së, përbërja e bordit të administrimit, si dhe kompetencat e administratorit të AFA-së parashikohen në statutin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.

6. Rektori i AFA-së dekretohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen dhe të ministrit përgjegjës për arsimin.

7. AFA-ja, si institucion i arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, përgjigjet për përgatitjen, arsimimin e kualifikimin e specialistëve të lartë të personelit ushtarak e civil, për të gjitha nivelet e drejtimit të Forcave të Armatosura, për fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, lidhur me:

a) arsimimin, kualifikimin dhe stërvitjen e kandidatëve për oficerë të rinj në ciklin e parë të studimeve;

b) hartimin e realizimin e programeve të studimit dhe të kualifikimit në të gjitha ciklet e studimit në arsimin e lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare;

c) arsimimin e kualifikimin, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare;

ç) formimin, kualifikimin dhe specializimin e nënoficerëve dhe ushtarëve profesionistë;

d) ofrimin e kualifikimit të vazhduar për personelin akademik në fushat që mbulon.

8. AFA-ja, si institucion i arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, përgatit dhe jep ekspertizë lidhur me fushat, si më poshtë vijojnë:

a) kryerjen e studimeve të karakterit teoriko-shkencor në fushat e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, që t'i paraprijë zhvillimeve në mjedisin strategjik të mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare;

b) dhënien e ekspertizës lidershipit civil dhe ushtarak të Republikës së Shqipërisë, për hartimin e politikës së mbrojtjes dhe formulimin e dokumenteve kryesore strategjike, si: Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake, rishikimi strategjik i mbrojtjes, doktrinat e përdorimit të forcave etj.

c) mbështetjen e Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të institucioneve të mbrojtjes e të sigurisë kombëtare, të vendit dhe atyre partnere, nëpërmjet përdorimit të programeve simulative, kryerjen e testimeve, eksperimenteve dhe kërkimit shkencor;

ç) menaxhimin e procesit akademik në interes të përmirësimit të koncepteve dhe bazës doktrinare ushtarake;

d) monitorimin dhe vlerësimin e standardeve të NATO-s, mbi bazën e të cilave siguron bazat teorike dhe aplikative të arkitekturës së sistemit doktrinar të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, si: doktrina, direktiva, manuale teknike dhe taktike, në përdorim të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

e) në përmbushje të misionit dhe detyrave të saj, në aspektin doktrinar dhe të stërvitjes, AFA-ja luan edhe rolin e Komandës së Doktrinave dhe Stërvitjes.

9. AFA-ja, për përmbushjen e përgjegjësive të saj, bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, me akademitë homologe rajonale, të NATO-s dhe atyre të vendeve partnere në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare.

10. AFA-ja, si institucion i arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, ka në përbërje personel akademik, personel ndihmësakademik, personel trajnues dhe personel administrativ.

11. Personeli akademik, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në profesorë, lektorë, asistent-lektorë. Për personelin akademik ushtarak të AFA-së, vetëm për efekt të veprimtarisë akademike, bëhet ekuivalentimi i gradave ushtarake me gradat shkencore dhe titujt akademikë të personelit akademik.

12. Ekuivalentimi me gradat shkencore dhe me titujt akademikë, vetëm për efekt të veprimtarisë akademike në AFA, pa gëzuar të drejta të tjera, për personelin aktiv dhe rezervë, janë, si më poshtë vijon:

a) për personelin akademik të kategorisë "Profesor", gradat ushtarake "gjenerallejtënant, gjeneralmajor", "admiral"/"gjeneral brigade, kundëradmiral" janë ekuivalente me titujt akademikë "profesor"/"profesor i asociuar";

b) për personelin akademik të kategorisë "Lektor", gradat ushtarake "kolonel" dhe "kapiten i rangut I"/nënkolonel" dhe "kapiten i rangut II", janë ekuivalente me gradën shkencore "doktor";

c) për personelin akademik të kategorisë "Asistent–lektor", gradat ushtarake "major" dhe "kapiten i rangut III"/"kapiten" dhe "lejtnant" janë ekuivalente me "master i shkencave";

ç) për personelin ndihmësakademik, gradat ushtarake "kryekapterr", "kapterr" dhe "rreshter" janë ekuivalente me "master profesional".

13. Pranimi i studentëve në AFA kryhet sipas procedurës, standardeve dhe kritereve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe sipas nevojave të Ministrisë së Mbrojtjes, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe institucioneve të tjera të mbrojtjes e të sigurisë kombëtare.

14. Kuotat e pranimit të studentëve për çdo program studimi dhe trajnimi përcaktohen nga senati akademik, sipas rekomandimeve të bëra nga bordi i administrimit, në përputhje me nevojat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe institucionet e tjera të mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, sipas standardeve shtetërore të kapaciteteve akademike e infrastrukturore, të cilat certifikohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.

15. Ministri përgjegjës për mbrojtjen përcakton politikat e arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, në përputhje me nevojat AFA-së, si dhe garanton që veprimtaria e funksionimi i AFA-së të zhvillohen në përputhje me standardet e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë.

16. Akreditimi institucional i AFA-së dhe i programeve të studimit që ai ofron bëhet nga strukturat përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi, duke respektuar statusin e veçantë të AFA-së dhe standardet respektive të NATO-s.

17. Ekuivalentimi/njëvlershmëria e programeve të studimit dhe të kualifikimeve të kryera në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, rregullohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për mbrojtjen dhe të ministrit përgjegjës për arsimin.

18. AFA-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme. Programi buxhetor i AFA-së është zë më vetë në programin buxhetor të Ministrisë së Mbrojtjes.

19. Statuti i AFA-së miratohet nga ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për mbrojtjen, bazuar edhe në statusin e veçantë të dhënë me këtë vendim.

20. Struktura dhe organika e AFA-së përfshihen në strukturën e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes dhe nuk mund të ndryshohen pa përfunduar viti akademik.

21. AFA-ja ka simbolet e veta identifikuese, sipas lidhjes që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

22. Vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 445, datë 14.8.1995, "Për arsimimin e oficerëve pranë Akademisë Ushtarake"; nr. 180, datë 10.4.2004, "Për dhënien e emrit 'Spiro Moisiu' Akademisë së Mbrojtjes"; nr. 720, datë 30.10.2003, "Për krijimin e Universitetit Ushtarak 'Skënderbej'"; nr. 832, datë 29.7.2009, "Për mbylljen e disa programeve të studimit të Universitetit Ushtarak 'Skënderbej', Tiranë, dhe transferimin e studentëve të këtij universiteti, në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin Politeknik të Tiranës", si dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore, që bien ndesh me këtë vendim, shfuqizohen.

23. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Akademia e Forcave të Armatosura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja 1

Simbolet identifikuese të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA)

Flamuri Dekorativ i AFA-së

Flamuri kombëtar me shqiponjën me dy koka. Në qendër të flamurit është një shqyt me ngjyrë ulliri, në të cilin është vendosur simboli i AFA-së.

Përmasat e flamurit janë 107x150 cm dhe rrethohet me një kordon dekorativ të artë.

Emblema e AFA-së

Në një shqyt me sfond të zi dhe i kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt i vogël me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë.

Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt i vogël me ngjyrë ulliri (ushtarake) me simbolin e AFA-së, i cili përmban:

- Rrethi: element i orientimit gjeografik;
- Penda: element i të shkruarit dhe i të mësuarit;
- Kartat e mbledhura: element i hartave dhe i librave;
- Shpata: element i përgatitjes fizike dhe ushtarake;
- Kurora e dafinës simbolizon fitimtarin.

Shenja krahëse e AFA-së

Një drejtkëndësh me ngjyrë ulliri në qendrën e të cilit ndodhet simboli AFA-së, ku janë kombinuar këto elemente: rrethi, penda, kartat e mbledhura, shpata dhe kurora e dafinës.



Në këndet e poshtme të drejtkëndëshit janë vendosur dy degë ulliri të arta. Drejtkëndëshi është i rrethuar me bordurë të artë.

Përmasat e krahëses janë 6x4 cm

VENDIM
Nr. 160, datë 19.2.2020

PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË STUDENTËVE TË SHKËLQYER DHE TË NËPUNËSVE CIVILË (FONDI I EKSELENCËS)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 4, dhe 112, pika 4, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin nga buxheti i shtetit, brenda fondeve buxhetore të miratuara për vitin përkatës për Fondin e Ekselencës, dhe nga donacione ose të ardhura të tjera, nga burime të ligjshme, për mbështetjen financiare të studentëve shqiptarë të shkëlqyer, i cili përdoret nga ministria përgjegjëse për arsimin për bursa, për:

a) studentët, të cilët ndjekin studimet e ciklit të dytë apo të tretë jashtë vendit, në universitetet më të mira të botës;

b) nëpunësit civilë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Nga fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfitojnë mbështetje financiare kandidatët që plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:

a) studentët, që ndjekin jashtë vendit programe studimi të ciklit të dytë, kur:

i. janë shtetas shqiptarë;

ii. kanë përfunduar studimet e ciklit të parë me notë mesatare mbi 9, për shkencat natyrore dhe teknike, dhe mbi 9.5 për shkencat ekonomike e shoqërore;

iii. janë pranuar në njërin nga 15 universitetet më të mira të botës, sipas renditjes së përgjithshme për vitin përkatës të aplikimit dhe/ose asaj specifike, sipas fushave, nga "Times Higher Education" – renditja botërore e universiteteve, për të ndjekur një program studimi të ciklit të dytë;

iv. pranojnë të punojnë në institucionet e administratës buxhetore shtetërore dhe institucionet e pavarura publike në Shqipëri, për së paku 2 (dy) vjet, pas përfundimit të studimeve dhe diplomimit në ciklin përkatës të studimeve, për të cilin përfitojnë bursën;

v. nuk janë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar;

b) studentët, të cilët ndjekin studimet e plota të doktoratës, pasi kanë përfunduar ciklin e parë e të dytë të studimeve universitare, kur:

i. janë shtetas shqiptarë;

ii. janë pranuar në njërin nga 15 universitetet më të mira të botës në shkencat shoqërore dhe ekonomike ose në njërin nga 50 universitetet më të mira të botës në shkenca natyrore e teknike, sipas renditjes së fundit të përgjithshme dhe/ose asaj specifike, sipas fushave, të "Times Higher Education" – renditja botërore e universiteteve, ose janë pranuar në njërin prej universiteteve të mirënjohura ndërkombëtare për studime në albanologji;

iii. nuk përfitojnë financim apo shpërblim të plotë ose bursë të plotë për punën kërkimore apo mësimore që bëjnë gjatë këtyre studimeve në universitetin pritës, në vlerë më të madhe se ajo e parashikuar për financim nga Fondi i Ekselencës;

iv. pranojnë të kthehen dhe të punojnë në institucionet e administratës buxhetore shtetërore dhe institucionet e pavarura publike në Shqipëri, për së paku 2 (dy) vjet, pas përfundimit të studimeve të doktoratës në fushën e studimeve të kryera;

v. nuk janë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar;

c) nëpunësit civilë, të cilët ndjekin jashtë vendit një program 1-vjeçar, "Master" të ciklit të dytë apo të tretë, kur:

i. janë shtetas shqiptarë;

ii. janë pranuar në njërin nga 300 universitetet më të mira të botës, sipas renditjes së fundit të përgjithshme ose në njërin nga 100 universitetet më të mira të botës, sipas fushave, nga "Times Higher Education" – renditja botërore e universiteteve, në vitin më të fundit, për të ndjekur në ciklin e dytë apo të tretë të studimit një program "Master" me kohëzgjatje 1-vjeçare në fushat: politika publike, administrim publik, politika ekonomike, politika arsimore, politika shëndetësore, urbanistikë dhe zhvillim urban, menaxhim i financave publike, e drejtë administrative/publike dhe studime evropiane;

iii. pranojnë që pas përfundimit të studimeve të kthehen dhe të punojnë për së paku 2 (dy) vjet, pas përfundimit të studimeve, në institucionin e mëparshëm;

iv. kanë marrë aprovimin e titullarit të institucionit ku punojnë për kryerjen e studimeve jashtë vendit dhe aplikimin për përfitimin financiar nga Fondi i Ekselencës;

v. nuk janë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar.

3. Për kandidatin që plotëson kriteret e njërës prej kategorive të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, në rastet kur përfiton një financim të pjesshëm nga universiteti pritës apo nga donatorë të tjerë, financimi nga Fondi i Ekselencës do të bëhet për diferencën e vlerës, deri në vlerën maksimale të parashikuar nga universiteti pritës, për vitin akademik, për shpenzime si tarifa e regjistrimit dhe/ose shpenzime të tjera të jetesës e udhëtimit, në varësi të masës së fondit në dispozicion.

4. Përfituesi ka detyrimin për të kthyer masën e bursës së përfituar në rastet, kur:

a) përjashtohet nga universiteti pritës;

b) ndërpret studimet, për të cilat është mbështetur financiarisht;

c) pas përfundimit të studimeve nuk është punësuar, sipas kushteve të parashikuara në këtë vendim;

ç) nuk ka përmbyllur apo përfunduar studimet në ciklin përkatës brenda 1 viti, pas përfundimit të afatit zyrtar të studimeve, me përjashtim të rasteve të sëmundjeve, të vërtetuara, të rasteve të fatkeqësive familjare apo kur parashikohet nga universiteti pritës.

5. Rregullat e hollësishme për afatet e aplikimit, të zbatimit të kritereve e procedurave, për përcaktimin e masës dhe të mënyrës së financimit si dhe për numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni, për secilën nga bursat e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili miratohet brenda 30 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6. Përzgjedhja e kandidateve kryhet para fillimit të vitit akademik, nga komisione përzgjedhëse të ngritura me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin. Komisioni përzgjedhës kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin ose nga personi i deleguar prej tij, në nivel zëvendësministri ose nëpunësi civil i nivelit të lartë drejtues. Kur Fondi i Ekselencës plotësohet edhe nga donacione, në komision ka të drejtë të marrë pjesë edhe një përfaqësues i donatorëve.

7. Studentët e ciklit të dytë, të cilët nuk i japin të gjitha provimet apo e përfundojnë vitin me notë mesatare më të ulët se nota 8 (vlerësimi ndërkombëtar, sistemi anglosakson B), nuk përfitojnë bursë për vitin e dytë.

8. Studentët e ciklit të tretë "Doktoratë", të cilët nuk i shlyejnë të gjitha detyrimet akademike të vitit përkatës, për të cilin përfitojnë bursë, nuk mbështeten nga Fondi i Ekselencës për vitet në vijim.

9. Studentët e përcaktuar në pikat 7 e 8, të këtij vendimi, depozitojnë në ministrinë përgjegjëse për arsimin certifikatën/listën e notave dhe detyrimet e shlyera për vitin e parë të studimeve si dhe dokumentacionin justifikues financiar të shpenzimeve që mbulojnë vlerën e

bursës së akorduar. Afatet për dorëzimin dhe shqyrtimin e aplikimeve për këta përfitues përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

10. Përfituesi dërgon në ministrinë përgjegjëse për arsimin diplomën e studimeve, të financuara nga programi i Fondit të Ekselencës, dhe jetëshkrimin e tij, brenda 30 ditëve, nga marrja e diplomës nga universiteti përkatës.

11. Brenda 30 ditëve, pas diplomimit, deri në përmbushjen e detyrimit për punësim, përfituesit duhet të aplikojnë për çdo pozicion të lirë pune në institucionet e administratës buxhetore shtetërore dhe institucionet e pavarura publike. Në institucionet, në të cilat marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, rekrutimi në pozicionet përkatëse i përfituesve të Fondit të Ekselencës kryhet me prioritet. Përfituesit e Fondit të Ekselencës punësohen nga Departamenti i Administratës Publike, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për punësimin e përkohshëm të studenteve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, për gjithë kohëzgjatjen e detyrimit për punësim.

12. Studentët, të cilët kanë përfituar bursë dhe nuk kanë realizuar detyrimet e programit përkatës dhe/ose i ndërpresin ato, sipas kushteve të përcaktuara në këtë vendim dhe në aktmarrëveshjen e lidhur ndërmjet përfituesit dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin, duhet t'i kthejnë ministrisë përgjegjëse për arsimin shumën e përfituar në formë burse nga Fondi i Ekselencës brenda 6 (gjashtë) muajve, nga dita e njoftimit. Në rast të moskthimit të shumës apo refuzimit nga ana e përfituesit brenda këtij afati, do të ndiqen procedurat ligjore për zgjidhjen e çështjes, sipas legjislacionit në fuqi.

13. Kandidatët e përcaktuar në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të këtij vendimi, financohen për tarifën e studimit dhe shpenzimet e akomodimit e të ushqimit për kohëzgjatjen e vitit akademik.

14. Studentët doktorantë mbështeten financiarisht nga ky fond për shpenzimet e jetesës dhe sigurimet shëndetësore, në masë jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë në muaj. Këta studentë nuk mbështeten për tarifën e studimit. Në rastet kur studenti përfiton një financim tjetër nga universiteti pritës ose nga donatorë të tjerë, financimi nga Fondi i Ekselencës do të bëhet për diferencën e vlerës, deri në vlerën maksimale të parashikuar nga ky fond.

15. Me përjashtim të kategorisë "nëpunës civil", për përfituesit e kategorive të tjera, të përcaktuara në këtë vendim, që angazhohen në projekte kërkimore në fushën përkatëse të diplomimit jashtë Republikës së Shqipërisë, shlyerja e detyrimit të punësimit në Shqipëri pezullohet për kohëzgjatjen e një projekti kërkimor, pasi të kenë marrë, më parë, miratimin nga ministria përgjegjëse për arsimin. Pas përfundimit të projektit kërkimor, përfituesi duhet të kthehet për t'u punësuar në Republikën e Shqipërisë, sipas afateve dhe përcaktimeve të pikës 11, të këtij vendimi.

16. Për studentët e shpallur fitues të Fondit të Ekselencës përpara datës 31.12.2019, zbatohen dispozitat e vendimit nr. 483, datë 16.7.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës)", dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, deri në përfundim të studimeve përkatëse.

17. Vendimi nr. 483, datë 16.7.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës)", shfuqizohet.

18. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr.251, datë 27.3.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.269, DATË 29.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 e 5, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 e 8, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 e 15, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit të punës", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr.10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës, "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore"", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nënndarja "iv", e shkronjës "c", të pikës 1, të vendimit nr.269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"iv) studentët, të cilët kanë, të paktën, njërin prind person me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr.331, datë 22.4.2020

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.649, DATË 14.9.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË SPECIALITETEVE, NËNSPECIALITETEVE APO SPECIALITETEVE PLOTËSUESE PËR PROFESIONET E RREGULLUARA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13, të ligjit nr.10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.40/2016, "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.649, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në shtojcën 1 "Lista e specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara", pas ndarjes XI shtohet ndarja XII, me këtë përmbajtje:

"XII. Profesioni i psikologut (Diplomë e ciklit të dytë ose ekuivalente me të).".

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM
Nr. 436, datë 3.6.2020

PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË

PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITET AKADEMIKE 2020–2021 DHE 2021-2022 E NË VIJIM *(Ndryshuar me VKM nr 46, datë 27.1.2021)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pranuar në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020–2021, përkatësisht, si më poshtë:
a) Në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, kandidatët, që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë, minimalisht me notë mesatare 6.5 (gjashtë pikë pesë);
b) Në programet e studimit të gjuhëve të huaja, të përcaktuara në shtojcën nr. 1 të këtij vendimi, minimalisht me notë mesatare 7 (shtatë);
c) Në programet e studimit të ciklit të parë *Bachelor*, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën nr. 2, të këtij vendimi, minimalisht me notë mesatare 7.5 (shtatë pikë pesë).
2. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pranuar në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2021–2022 dhe në vijim, përkatësisht, si më poshtë:
a) Në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë, minimalisht me notë mesatare 7 (shtatë);
b) Në programet e studimit të ciklit të parë *Bachelor*, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë master, në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën nr. 2 të këtij vendimi, minimalisht me notë mesatare 8 (tetë).
3. Përjashtohen nga detyrimi i plotësimit të kriterit të notës mesatare kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare, me karakter profesional, kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve në fushën e artit dhe të sportit, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Republika e Kosovës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci.
4. Në rastet e transferimit të studimeve nga brenda apo jashtë vendit, në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit, brenda të njëjtit cikël, studentët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave të vitit akademik, që studenti është pranuar në institucionin e arsimit të lartë, duke filluar nga viti akademik 2016–2017 dhe në vijim.
5. Nota mesatare për pranimin në institucionet e arsimit të lartë përllogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve, si më poshtë vijon:
a) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë;
b) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.
6. Institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, janë përgjegjëse për përllogaritjen e notës mesatare dhe dërgimin e këtyre të dhënave në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.
7. Procedurat për njëvlershmërinë e dokumenteve të paraqitura nga shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, si dhe përllogaritja e notës

mesatare për këta kandidatë të kryhen në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, sipas përcaktimeve të pikës 5 të këtij vendimi. Në rastet kur nuk aplikohen provimet e Maturës Shtetërore, komisioni përkatës përcakton mënyrën e përllogaritjes së notës mesatare. Komisioni përkatës dërgon të dhënat tek institucioni arsimor vendor përkatës, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1
(PROGRAMET E STUDIMIT TË GJUHËVE TË HUAJA,
PËR VITIN AKADEMIK 2020–2021)

Nr.	**INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË**	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1	Universiteti i Tiranës	Gjuhë angleze	7
2		Gjuhë angleze (Sarandë)	7
3		Gjuhë frënge	7
4		Gjuhë gjermane	7
5		Gjuhë greke	7
6		Gjuhë italiane	7
7		Gjuhë ruse	7
8		Gjuhë turke	7
9		Gjuhë spanjolle me profil gjuhë - letërsi dhe qytetërim hispanik	7
Nr.	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Gjuhë angleze	7
2		Gjuhë frënge	7
3		Gjuhë gjermane	7
4		Gjuhë italiane	7
Nr.	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Gjuhë gjermane dhe angleze	7
2		Gjuhë angleze	7
Nr.	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Gjuhë angleze	7
		Gjuhë dhe kulturë frënge	7
Nr.	Universiteti “Ismail	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Gjuhë angleze	7

2	Qemali", Vlorë	Gjuhë italiane	7
Nr.	Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Gjuhë angleze	7
2		Gjuhë frënge	7
3		Gjuhë gjermane	7
4		Gjuhë italiane	7
Nr.	Kolegji universitar "Logos"	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Gjuhë dhe civilizim grek	7
Nr.	Kolegji universitar "Bedër"	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Gjuhë dhe letërsi angleze	7
Nr.	Universiteti privat "Albanian University"	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Anglisht	7
Nr.	Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
1		Histori dhe gjuhë italiane	7

SHTOJCA NR. 2
(PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË *BACHELOR*, TË CILAT JAPIN AKSES NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË MASTER, NË FUSHËN E MËSUESISË, PËR VITIN AKADEMIK 2020–2021 DHE 2021–2022 E NË VIJIM)

Nr.	**INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË**	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE, VITI AKADEMIK 2020–2021**	**NOTA MESATARE, VITI AKADEMIK 2021–2022 DHE NË VIJIM**
1	Universiteti i Tiranës	Biologji	7.5	8
2		Filozofi	7.5	8
3		Fizikë	7.5	8
4		Gjeografi	7.5	8
5		Gjuhë-letërsi	7.5	8
6		Histori	7.5	8
7		Informatikë	7.5	8
8		Kimi	7.5	8
9		Matematikë	7.5	8
10		Psikologji	7.5	8
11		Sociologji	7.5	8

Nr.		PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE	NOTA MESATARE
1	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”	Biologji-kimi	7.5	8
2		Edukim qytetar	7.5	8
3		Filozofi-sociologji	7.5	8
4		Gjeografi dhe gjuhë italiane	7.5	8
5		Gjuhë shqipe dhe letërsi	7.5	8
6		Histori-gjeografi	7.5	8
7		Histori dhe gjuhë gjermane	7.5	8
8		Matematikë informatike	7.5	8
9		Matematikë-fizikë	7.5	8
10		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5	8
11		Mësuesi për arsim fillor	7.5	8
12		Psikologji	7.5	8
13		Gjuhë shqipe dhe frënge	7.5	8
14		Gjuhë shqipe dhe rome	7.5	8
Nr.		**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**	**NOTA MESATARE**
1	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	Gjuhë-letërsi-anglisht	7.5	8
2		Histori	7.5	8
3		Informatikë-anglisht	7.5	8
4		Matematikë-informatikë	7.5	8
5		Mësuesi për arsim fillor	7.5	8
6		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5	8
7		Psikologji	7.5	8
8		Filozofi-sociologji	7.5	8
Nr.		**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**	**NOTA MESATARE**
1	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër	Biologji - kimi	7.5	8
2		Gjuhë-letërsi shqipe	7.5	8
3		Gjuhë-letërsi angleze	7.5	8
4		Gjuhë-letërsi dhe qytetërim grek	7.5	8
5		Gjuhë-letërsi italiane	7.5	8
6		Histori-gjeografi	7.5	8

7		Matematikë-informatikë	7.5	8
8		Mësuesi për arsimin fillor	7.5	8
9		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5	8
10		Fizikë dhe teknologji informacioni	7.5	8
11		Matematikë-fizikë	7.5	8
Nr.		**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**	**NOTA MESATARE**
1	Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	Biologji-kimi	7.5	8
2		Filozofi-sociologji	7.5	8
3		Gjuhë-letërsi	7.5	8
4		Histori-gjeografi	7.5	8
5		Matematikë - fizikë	7.5	8
6		Matematikë - informatikë	7.5	8
7		Mësuesi për arsimin fillor	7.5	8
8		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5	8
Nr.		**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**	**NOTA MESATARE**
1	Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	Biologji	7.5	8
2		Fizikë	7.5	8
3		Gjuhë shqipe dhe letërsi	7.5	8
4		Histori-gjeografi	7.5	8
5		Informatikë	7.5	8
6		Kimi	7.5	8
7		Matematikë	7.5	8
8		Mësuesi për arsimin fillor	7.5	8
9		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5	8
10		Pedagogji e specializuar	7.5	8
Nr.		**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**	**NOTA MESATARE**
1	Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	Biologji - kimi	7.5	8
2		Fizikë	7.5	8
3		Gjeografi	7.5	8
4		Gjuhë-letërsi	7.5	8
5		Histori	7.5	8

6		Informatikë	7.5	8
7		Matematikë	7.5	8
8		Mësuesi për arsim fillor	7.5	8
9		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5	8
10		Psikologji	7.5	8
Nr.	Kolegji universitar "Bedër"	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**	**NOTA MESATARE**
1		Arsimi parashkollor dhe fillor	7.5	8
2		Psikologji këshillimi dhe Pedagogji	7.5	8
Nr.	Kolegji universitar "Ëisdom"	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**	**NOTA MESATARE**
1		Psikologji	7.5	8
Nr.	SHLUJ, Universiteti "Marin Barleti"	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**	**NOTA MESATARE**
1		Psikologji	7.5	8
Nr.	Universiteti Europian i Tiranës	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**	**NOTA MESATARE**
1		Psikologji	7.5	8
2		Sociologji	7.5	8
3		Filozofi	7.5	8
4		Histori	7.5	8
5		Letërsi	7.5	8
6		Linguistikë	7.5	8
7		Arsim parashkollor	7.5	8
Nr.	Universiteti i *Neë York*-ut në Tiranë	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**	**NOTA MESATARE**
1		Psikologji	7.5	8
Nr.	Universiteti privat "Albanian University"	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**	**NOTA MESATARE**
1		Mësuesi për arsimin fillor	7.5	8
2		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5	8
3		Psikologji e përgjithshme	7.5	8
Nr.	Kolegji universitar "Logos"	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**	**NOTA MESATARE**
1		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5	8

VENDIM

Nr. 504, datë 24.6.2020

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË STUDENTËVE, TË CILËT STUDIOJNË JASHTË VENDIT, DHE SHTETASVE TË HUAJ ME ORIGJINË SHQIPTARE, TË CILËT PËRFITOJNË BURSA NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore"; të shkronjës "a", të nenit 5, të ligjit nr. 16/2018, "Për diasporën"; të pikës 1, të nenit 6, të ligjit nr. 115/2017, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë.

2. Baza e të dhënave shtetërore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përmban të dhëna personale, për:

a) shtetasit shqiptarë, të cilët kryejnë studimet e arsimit të lartë jashtë vendit;

b) shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë;

c) shtetasit shqiptarë, të cilët kanë përfituar bursat e studimit, të cilat u ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera, ku Republika e Shqipërisë është palë.

3. Të dhënat që përmban baza e të dhënave shtetërore e studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijojnë:

a) Të dhëna parësore konsiderohen ato të dhëna, të cilat grumbullohen nga ky regjistër dhe përfshijnë:

i. periudhën e studimeve;

ii. shtetin pritës;

iii. institucionin e arsimit të lartë pranë të cilit studion;

iv. fushën e studimeve;

v. burimin e financimit të bursës;

vi. adresën e postës elektronike *(email)*;

vii. të dhënat e shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, sipas shkronjës "b", të pikës 2, të këtij vendimi:

- emri;

- mbiemri;

- atësia;

- adresa;

- gjinia;

- vendlindja;

- datëlindja.

b) Të dhënat dytësore, që shkëmbehen me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (DPGJC), janë si më poshtë vijojnë:

i. NID-i i shtetasit;

ii. emri;

iii. mbiemri;

iv. atësia;

v. adresa;

vi. gjinia;

vii. vendlindja;

viii. datëlindja.

4. Baza e të dhënave shtetërore e studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, ka si institucion administrues Agjencinë Kombëtare të Diasporës.

5. Baza e të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, ndërvepron me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (DPGjC) dhe *database*-t e tjera shtetërore, të cilat, në aktin e krijimit të tyre, parashikojnë ndërveprimin me bazën e të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë.

6. Dhënës të informacionit për bazën e të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, janë ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punët e jashtme.

7. Vlerësimi i rezultateve të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, realizohet nga një komision i veçantë me 9 (nëntë) anëtarë, nga institucionet përgjegjëse, i cili ngrihet me urdhër të Kryeministrit. Ai drejtohet nga ministri përgjegjës për diasporën. Komisioni realizon një raport vjetor për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë. Dhënia e bursave shtetasve të huaj me origjinë shqiptare bëhet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe rregullohet me akte të tjera.

8. Baza e të dhënave shtetërore aksesohet nga të gjitha institucionet e interesuara nëpërmjet kërkesës drejtuar Agjencisë Kombëtare të Diasporës, në përputhje me rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore të përcaktuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM
Nr. 881, datë 28.10.2020

PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË AKADEMISË SË SIGURISË, SI INSTITUCIONI I VETËM PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË NË FUSHËN E RENDIT E TË SIGURISË PUBLIKE, SI DHE ORGANIZIMIN E FUNKSIONIMIN E SAJ

(Ndryshuar me VKM nr.320, datë 2.6.2021)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe të pikës 5, të nenit 37, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Akademia e Sigurisë, në vijim "AS", është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, së cilës i jepet status i veçantë dhe ka varësi nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministri përgjegjës për arsimin.
2. Statusi i veçantë i AS-së konsiston në organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, trajtimin specifik të organizimit akademik dhe administrativ, të personelit akademik, të personelit ndihmësakademik, trajnues dhe administrativ, të programeve të studimit, të kualifikimit, të trajnimit e të stërvitjes, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi.
3. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike përcakton politikat e arsimimit e të kualifikimit në fushën e rendit e të sigurisë publike, në përputhje me nevojat e Policisë së Shtetit dhe të institucioneve të tjera të sigurisë në vend.
4. AS-ja ofron programe për formimin, specializimin, kualifikimin dhe trajnimin, në të gjitha nivelet, të punonjësve në uniformë e civilë të institucioneve, si:
a) Policia e Shtetit;
b) Garda e Republikës;
c) Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve;
ç) Shërbimi i Provës;
d) Shërbimi i çështjeve të brendshme në Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë;
dh) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
e) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
ë) Policia Bashkiake;
f) Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin;
g) Persona fizikë e juridikë, që ofrojnë shërbimin e sigurisë fizike, subjekt të së drejtës private apo publike;
gj) Institucione të tjera, pavarësisht emërtimit, të krijuara me akte të tjera që operojnë në fushën e rendit dhe të sigurisë publike.
5. Organizimi i AS-së është, si më poshtë vijon:
a) Senati Akademik;
b) Rektori;
c) Rektorati;
ç) Dekani;
d) Dekanati;
dh) Asambleja e personelit akademik;
e) Drejtuesit e njësive bazë;

ë) Komisionet e përhershme;

f) Bordi këshillues;

g) Bordi i administrimit;

gj) Administratori i institucionit.

6. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të organeve kolegjiale dhe e autoriteteve drejtuese, përbërja e bordit të administrimit, si dhe kompetencat e administratorit të AS-së parashikohen në statutin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.

7. Rektori i AS-së dekretohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e rendit e të sigurisë publike dhe të ministrit përgjegjës për arsimin.

8. Pranë AS-së krijohet Bordi Këshillues, si organ kolegjial këshillimor për çështjet e zhvillimit institucional të Akademisë, për planifikimin/koordinimin e kuotave dhe kapaciteteve, profilet akademike dhe çështje të tjera të veprimtarisë së Akademisë me institucionet përfituese. Mënyra e organizimit dhe e përzgjedhjes së anëtarëve dhe funksionet e tjera të Bordit Këshillues të AS-së përcaktohen në statut, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi dhe të kuadrit ligjor në fuqi.

9. Akademia e Sigurisë organizon programe studimi të arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike në të gjitha ciklet, kurse profesionale të formimit bazë dhe të kualifikimit të vazhduar për çdo gradë, kurse specializimi për çdo shërbim e profil dhe trajnim praktik për punonjësit e strukturave, të përmendura në pikën 4, të këtij vendimi.

10. Njësitë kryesore përbërëse të Akademisë së Sigurisë janë:

a) Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit;

b) Kolegji Profesional i Formimit Policor.

11. Personeli, i cili rekrutohet në institucionet e përcaktuara në pikën 4, dhe personeli që konkurron për gradën pasardhëse dhe funksione më të larta në këto institucione u nënshtrohen programeve të formimit/kualifikimit përkatës në AS, sipas përcaktimeve në strategjinë e formimit në fushën e rendit e të sigurisë publike për këto institucione.

12. AS-ja ofron, gjithashtu:

a) zhvillimin e kërkimeve dhe të studimeve shkencore në fushën e policimit dhe të sigurisë;

b) dhënien e ekspertizës për lidershipin e lartë civil e atë profesional në hartimin dhe formulimin e dokumenteve kryesore strategjike në fushën e rendit e të sigurisë publike, zhvillimin dhe përdorimin e kapaciteteve në këtë fushë;

c) realizimin e shërbimeve mbështetëse për nevojat e trajnimit dhe të formimit: si trajtimin me ushqim, akomodim etj. të studentëve dhe të kursantëve përfitues;

ç) administrimin e të dhënave për të gjitha programet dhe trajnimet që zhvillohen në Akademi;

d) koordinimin periodik me institucionet e sigurisë mbi nevojat e planifikimit të trajnimeve/shkollimeve dhe kuotave për formimin dhe trajnimin e punonjësve të këtyre institucioneve.

13. AS-ja, për përmbushjen e përgjegjësive të saj, bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, organizmat ndërkombëtarë, institucionet homologe të huaja, si dhe organizatat joqeveritare me rol të rëndësishëm në fushën e rendit e të sigurisë publike.

14. Personeli i Akademisë së Sigurisë përbëhet nga: personel akademik, personel ndihmësakademik, personel trajnues dhe personel administrativ.

15. Personeli akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë dhe personeli akademik me kohë të pjesshme në cilësinë e ekspertëve të fushave përkatëse. Punësimi i personelit bëhet në përputhje me dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi, rregullat e përcaktuara në statutin e Akademisë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit midis titullarit të Akademisë së Sigurisë dhe titullarit të institucionit përfitues.

16. Personeli akademik, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në: profesorë, lektorë, asistent-lektorë.

17. Në mungesë të personelit akademik dhe vetëm pasi nga ana e AS-së janë bërë 2 shpallje publike të njëpasnjëshme për plotësimin e vendeve vakante në pozicionet akademike me anë të konkurrimit dhe kanë rezultuar të pasuksesshme për përzgjedhjen e personelit akademik, plotësimi i këtyre vendeve bëhet me personel nga Policia e Shtetit dhe institucionet përfituese. Për këtë kategori të personelit, për kohën që janë pjesë e strukturave mësimdhënëse në Akademinë e Sigurisë dhe vetëm për efekt të veprimtarisë akademike, bëhet njësimi i gradave policore apo edhe i gradave të institucioneve të tjera me titujt dhe gradat e personelit/funksionit akademik.

18. Njësimi me titujt akademikë dhe gradat shkencore, vetëm për efekt të veprimtarisë akademike në Akademi, pa gëzuar të drejta të tjera, është si më poshtë vijon:

a) Për personelin akademik të kategorisë "Profesor", grada policore "Drejtues i lartë"/"Drejtues i parë" është ekuivalente me titujt akademikë "Profesor" ose "Profesor i asociuar";

b) Për personelin akademik të kategorisë "Lektor", grada policore "Drejtues"/"Kryekomisar" është ekuivalente me gradën shkencore "Doktor";

c) Për personelin akademik të kategorisë "Asistent–Lektor", grada policore "Komisar"/"Nënkomisar" është ekuivalente me "Master i shkencave".

19. Punësimi i personelit të Akademisë, sipas kategorive përkatëse, bëhet në përputhje me dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi, rregullat e përcaktuara në statutin e Akademisë, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit midis titullarit të AS-së dhe titullarit të institucionit përfitues. Personeli i punësuar sipas kësaj pike, për periudhën që punon në Akademi, ruan statusin në institucionet respektive.

20. Në strukturat dhe njësitë përbërëse të Akademisë së Sigurisë, funksionet organike cilësohen në bazë të specialitetit dhe të institucionit përfitues, të përmendura në pikën 4, të këtij vendimi. Institucionet përfituese janë përgjegjëse për plotësimin me personel të këtyre funksioneve.

21. Pranimi i kandidatëve për kursantë në Akademi kryhet sipas kritereve të përcaktuara në legjislacionin sektorial të institucioneve përfituese.

22. Kuotat e pranimit të kandidatëve për studentë, për çdo program studimi, shqyrtohen në bazë të nevojës së institucioneve të interesuara dhe kapaciteteve të Akademisë nga Bordi Këshillues i Akademisë së Sigurisë, miratohen nga Senati Akademik i Akademisë dhe paraqiten për certifikim në ministrinë përgjegjëse për arsimin, sipas legjislacionit në fuqi.

23. Kuotat e pranimit të kursantëve për programet e trajnimit dhe specializimeve shqyrtohen mbi bazën e nevojës së institucioneve të interesuara dhe kapaciteteve të Akademisë nga Bordi Këshillues i AS-së dhe miratohen me vendim të Senatit të Akademik.

24. Akademia përgatit planin periodik për studime, specializime, kualifikime dhe trajnime në bashkëpunim me institucionet e interesuara. Procedurat e planifikimit për studime, specializime, kualifikime dhe trajnime miratohen nga Senati Akademik, me propozim të Bordit Këshillues të Akademisë së Sigurisë.

25. Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e programeve të studimit miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar statusin e veçantë të Akademisë së Sigurisë.

26. Akreditimi institucional i Akademisë së Sigurisë dhe i programeve të studimit bëhet nga struktura përgjegjëse, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar statusin e veçantë të Akademisë së Sigurisë.

27. Ekuivalentimi/njëvlershmëria e programeve të studimit dhe e kualifikimeve të kryera në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit, në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, rregullohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe të ministrit përgjegjës për arsimin.

28. Statuti i Akademisë miratohet nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministri përgjegjës për arsimin.

29. Akademia financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme. Programi buxhetor i Akademisë është pjesë e programit buxhetor të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

30. Struktura dhe organika e Akademisë së Sigurisë miratohen para fillimit të vitit akademik, me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përcaktimet në statut dhe nuk mund të ndryshohet pa përfunduar viti akademik.

31. Me miratimin e strukturës së re organike, në zbatim të këtij vendimi, Akademia e Sigurisë bën shpalljen publike për plotësimin e pozicioneve akademike me konkurs, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, sipas legjislacionit në fuqi.

32. Vendimi nr. 185, datë 25.2.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë", shfuqizohet.

33. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 1163, datë 24.12.2020

PËR NGRITJEN E SEKRETARIATIT NË KUADËR TË VEPRIMTARISË SË MBAJTJES SË SEKRETARIATIT TË "BOLOGNA FOLLOË UP GROUP" NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e sekretariatit në kuadër të veprimtarisë së mbajtjes së sekretariatit të "Bologna Folloë Up Group" nga Republika e Shqipërisë (në vijim, Sekretariati), në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin.

2. Sekretariati do të funksionojë për periudhën kohore nga data 1.1.2021 deri më 31.12.2024.

3. Ministria përgjegjëse për arsimin siguron mjediset dhe pajisjet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë për funksionimin e Sekretariatit.

4. Qëllimi parësor i veprimtarisë së Sekretariatit është të sigurojë mbështetjen asnjanëse për konsolidimin e mëtejshëm të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (në vijim, ZEAL) nën autoritetin e "Bologna Folloë Up Group" (në vijim, BFUG) e të koordinojë veprimet që ndërmerren në rang ndërkombëtar me planin e punës së BFUG-së dhe veprimtarinë e grupit të punës mbështetës të Sekretariatit të BFUG-së gjatë periudhës së mbajtjes së Sekretariatit nga Republika e Shqipërisë.

5. Sekretariati ka për objekt veprimtarie:

a) ofrimin e mbështetjes administrative dhe operative për BFUG-në e bordin e saj, përfshirë planifikimin e takimeve dhe mbajtjen e procesverbaleve përkatëse;

b) ofrimin e ndihmës për BFUG-në dhe bordin e saj në punën pasuese për periudhën 1.1.2021 deri më 31.12.2024, përfshirë planifikimin e aktiviteteve dhe përcjelljen/ndjekjen e vendimeve të BFUG-së;

c) ofrimin e mbështetjes ndaj të gjitha grupeve të punës, grupeve këshilluese e strukturave të tjera dhe, sipas kërkesës, përgatitjen e projektraporteve;

ç) kryerjen edhe të detyrave të veçanta lidhur me zbatimin e programit të punës së ZEAL-së;

d) rishikimin e përditësimin e faqes në internet të ZEAL-së ëëë.ehea.info dhe arkivat e saj;

dh) funksionimin si një pikë e jashtme dhe e brendshme e kontaktit për ZEAL-në;

e) shpërndarjen e njoftimeve të rëndësishme me anëtarë të BFUG-së dhe palët e interesit;

ë) sigurimin e përfaqësimit në takimet e jashtme me kërkesë të organizatorëve;

f) mbështetjen e bordit të BFUG-së për të vendosur bashkëveprim me Zonën Evropiane të Kërkimit (në vijim, ZEK);

g) përgatitjen e Konferencës Ministrore në Shqipëri 2024 dhe Forumin e Politikave të Bolonjës nën mbikëqyrjen e BFUG-së;

gj) kryerjen e çdo veprimtarie tjetër të nevojshme, të caktuar nga BFUG-ja.

6. Sekretariati drejtohet nga kryetari (chair), i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e Sekretariatit. Kryetari asistohet në punën e tij nga një asistent.

7. Sekretariati do të përbëhet nga personel i punësuar me kohë të plotë, ekspertë, dhe personel i punësuar me kohë të pjesshme, ekspertë, që janë njohës shumë të mirë në fushën e arsimit të lartë, si më poshtë vijon:

a) 1 (një) ekspert me kohë të plotë dhe 3 (tre) ekspertë të jashtëm me kohë të pjesshme, në fushën e menaxhimit dhe të implementimit të projekteve, të cilët angazhohen në zhvillimin e aktiviteteve dhe takimeve të ndryshme të BFUG-së, bordit të BFUG-së, grupeve të punës dhe grupeve këshilluese të BFUG-së, si edhe në organizimin e Konferencës Ministrore të ZEAL-së, në vitin 2024;

b) 1 (një) ekspert me kohë të plotë në fushën e medias dhe komunikacionit, i cili do të ndihmojë në zbatimin e strategjisë dhe instrumenteve të mediave sociale, dhe 1 (një) ekspert i jashtëm me kohë të pjesshme në fushën e mirëmbajtjes së faqes ekzistuese të internetit ëëë.ehea.info dhe përditësimit të saj nga grupi i punës mbështetës i Sekretariatit të BFUG-së;

c) 2 (dy) ekspertë teknikë të nivelit të lartë me kohë të plotë dhe 3 (tre) ekspertë të jashtëm me kohë të pjesshme për marrjen e vendimeve strategjike e udhëzimeve për të zbatuar të gjitha aktivitetet e Sekretariatit;

ç) 2 (dy) ekspertë me kohë të plotë dhe 3 (tre) ekspertë të jashtëm me kohë të pjesshme, të cilët do të ndihmojnë në hartimin e përgatitjen e dokumenteve mbështetëse për BFUG-në, menaxhimin e proceseve teknike dhe institucionale, analizimin e të dhënave e dhënien e rekomandimeve dhe të asistencës në takimet e grupeve të punës.

8. Ekspertët e jashtëm, vendas ose të huaj, do të kontraktohen sipas fushës përkatëse, për të dhënë kontributin e tyre, sa herë të konsiderohet e nevojshme, me qëllim bashkërendimin e punës.

9. Sekretariati, në bashkëpunim me bashkëkryetarin dhe nënkryetarin e BFUG-së, kryen këto detyra:

a) harton agjendat e takimeve të BFUG-së;

b) harton përmbajtjen e dokumenteve për diskutim;

c) harton dokumentet përkatëse për BFUG-në dhe bordin e tij, grupet e punës dhe takimet e komisionit të bordit;

ç) harton procesverbalet e mbledhjeve të BFUG-së dhe bordit, për të qartësuar fjalën e kryetarëve;

d) dërgon për komente dhe miratim procesverbalet në takimin pasues të BFUG-së dhe bordit;

dh) ndihmon grupet e punës dhe grupet këshilluese për përmbushjen e detyrave të tyre;

e) mbështet zbatimin e programit të punës të miratuar nga BFUG-ja;

ë) merr pjesë në seminare që zhvillohen në kuadër të procesit të Bolonjës dhe takime të tjera, kur është e nevojshme;

f) rishikon e përditëson faqen e internetit të ZEAL-së, duke siguruar që informacioni të vihet në dispozicion në çdo kohë për BFUG-në dhe publikun;

g) garanton një sistem komunikimi ad hoc, duke përdorur mjete të përditësuara teknologjike dhe propozon një faqe të re ëebsite, në mënyrë që të ofrojë një shërbim më efikas;

gj) kryen detyra të tjera specifike, siç është rënë dakord nga nënstrukturat e përmendura në BFUG.

10. Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Sekretariatit miratohet nga ministri përgjegjës për arsimin, me propozimin e kryetarit të Sekretariatit.

11. Kryetari dhe personeli i Sekretariatit emërohen e lirohen nga detyra nga ministri përgjegjës për arsimin, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës, nëpërmjet thirrjeve për shprehje interesi.

12. Niveli i pagës së kryetarit dhe personelit të Sekretariatit t'u referohet pagave të personelit në institucionet publike të arsimit të lartë, të përcaktuara me vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, si më poshtë vijon:

a) Kryetari i Sekretariatit, sa paga e personelit akademik "Rektor";

b) Ekspertët e nivelit të lartë dhe/ose të huaj, të punësuar me kohë të plotë dhe ose të pjesshme, sa paga e personelit akademik të kategorisë "Profesor";

c) Ekspertët e punësuar me kohë të plotë, sa paga e personelit akademik që zotëron gradën shkencore "Doktor";

ç) Ekspertët e punësuar me kohë të pjesshme, sa paga e personelit akademik "Lektor/kërkues".

Niveli i pagës së asistentit të kryetarit të Sekretariatit është sa paga e sekretarit të rektorit, të përcaktuar në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore", të ndryshuar.

13. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, mbulohen nga granti i Komisionit Evropian, buxheti i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ardhura të tjera nga financime të ngjashme.

14. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIME 2021

VENDIM
Nr. 46, datë 27.1.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 436, DATË 3.6.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE, PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITET AKADEMIKE 2020–2021 DHE 2021–2022 E NË VIJIM"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 436, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
a) në pikën 1, pas fjalëve "për vitin akademik 2020–2021" shtohen fjalët "dhe në vijim";
b) pika 2 shfuqizohet;
c) në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur vendimit, titulli riformulohet, si më poshtë vijon:
"(Programet e studimit të gjuhëve të huaja, për vitin akademik 2020–2021 dhe në vijim)";
ç) shtojca nr. 2, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 2

(PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR", TË CILAT JAPIN AKSES NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË "MASTER", NË FUSHËN E MËSUESISË, PËR VITIN AKADEMIK 2020–2021 DHE NË VIJIM)

	INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE, VITI AKADEMIK 2020–2021 DHE NË VIJIM**
	Universiteti i Tiranës	Biologji	7.5
		Filozofi	7.5
		Fizikë	7.5
		Gjeografi	7.5

		Gjuhë-letërsi	7.5
		Histori	7.5
		Informatikë	7.5
		Kimi	7.5
		Matematikë	7.5
		Psikologji	7.5
		Sociologji	7.5
	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
		Biologji-kimi	7.5
		Edukim qytetar	7.5
		Filozofi-sociologji	7.5
		Gjeografi dhe gjuhë italiane	7.5
		Gjuhë shqipe dhe letërsi	7.5
		Histori-gjeografi	7.5
		Histori dhe gjuhë gjermane	7.5
		Matematikë informatike	7.5
		Matematikë-fizikë	7.5
		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
		Mësuesi për arsim fillor	7.5
		Psikologji	7.5
		Gjuhë shqipe dhe frënge	7.5
		Gjuhë shqipe dhe rome	7.5
	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
		Gjuhë-letërsi-anglisht	7.5
		Histori	7.5
		Informatikë-anglisht	7.5
		Matematikë-informatikë	7.5
		Mësuesi për arsim fillor	7.5
		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
		Psikologji	7.5
		Filozofi-sociologji	7.5
	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
		Biologji-kimi	7.5
		Gjuhë-letërsi shqipe	7.5
		Gjuhë-letërsi angleze	7.5

		Gjuhë-letërsi dhe qytetërim grek	7.5
		Gjuhë-letërsi italiane	7.5
		Histori-gjeografi	7.5
		Matematikë-informatikë	7.5
		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
		Fizikë dhe teknologji informacioni	7.5
		Matematikë-fizikë	7.5
	Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
		Biologji-kimi	7.5
		Filozofi-sociologji	7.5
		Gjuhë-letërsi	7.5
		Histori-gjeografi	7.5
		Matematikë-fizikë	7.5
		Matematikë-informatikë	7.5
		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
	Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
		Biologji	7.5
		Fizikë	7.5
		Gjuhë shqipe dhe letërsi	7.5
		Histori-gjeografi	7.5
		Informatikë	7.5
		Kimi	7.5
		Matematikë	7.5
		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
		Pedagogji e specializuar	7.5
	Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
		Biologji-kimi	7.5
		Fizikë	7.5
		Gjeografi	7.5
		Gjuhë-letërsi	7.5
		Histori	7.5
		Informatikë	7.5

		Matematikë	7.5
		Mësuesi për arsim fillor	7.5
		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
		Psikologji	7.5
	Kolegji Universitar "Bedër"	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
		Arsimi parashkollor dhe fillor	7.5
		Psikologji këshillimi dhe pedagogji	7.5
	Kolegji Universitar "Ëisdom"	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
		Psikologji	7.5
	Universiteti "Barleti"	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
		Psikologji	7.5
	Universiteti Europian i Tiranës	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
		Psikologji	7.5
		Sociologji	7.5
		Filozofi	7.5
		Histori	7.5
		Letërsi	7.5
		Linguistikë	7.5
		Arsim parashkollor	7.5
	Universiteti i *Neë York*-ut në Tiranë	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
		Psikologji	7.5
	Universiteti "*Albanian University*"	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
		Psikologji e përgjithshme	7.5
	Kolegji Universitar "*Logos*"	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**NOTA MESATARE**
		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5

VENDIM

Nr. 145, datë 10.3.2021

PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË UNIVERSITETIT TË ARTEVE SI INSTITUCIONI I VETËM PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË NË FUSHËN E ARTEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve (në vijim, UART), si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter akademik, artistik dhe shkencor, me veprimtari në fushën e arteve, krijuar me vendimin nr.234, datë 23.3.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Universitetit të Arteve".

2. Statusi i veçantë i jepet UART-it për trajtimin e veçantë për efekt mësimdhënieje, veprimtarie akademike, të organizimit akademik dhe administrativ, të organizimit të programeve të studimit, të organizimit të aktivitetit kërkimor artistik-shkencor, të njohjes së aktivitetit artistik si pjesë e aktivitetit shkencor, që shërben për të vlerësuar performancën akademike vjetore, sipas përcaktimeve në statutin e UART-it e të legjislacionit në fuqi.

3. UART-i organizohet dhe funksionon si një institucion i arsimit të lartë që ofron programe studimi në fusha me veprimtari akademike-artistike.

4. Për efekt të mësimdhënies në funksion të procesit akademik, për ekuivalentimin e kualifikimit për personelin akademik krijues dhe interpretues, grada shkencore nuk përbën detyrim. Personelit akademik krijues dhe interpretues, me arritje të shquara artistike, i bëhet ekuivalentimi i aktivitetit artistik e krijues me punën kërkimore-shkencore vetëm për efekt të mësimdhënies, në shërbim të vlerësimit të performancës akademike vjetore. Ekuivalentimi bëhet me vendim të Senatit Akademik, sipas përcaktimeve në statutin e UART-it, miratuar nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

5. Figurat e shquara me një veprimtari të spikatur artistike, brenda dhe jashtë vendit, vetëm për efekt mësimdhënieje, pa gëzuar të drejta të tjera, thirren në UART të japin kontributin e tyre, sipas përcaktimeve në statutin e UART-it.

6. Procedura për ekuivalentimin e gradës shkencore vetëm për efekt të mësimdhënies të personelit akademik që thirren në UART bëhet, si më poshtë vijon:

a) pozicionet e lira të punës, për të cilat do të ftohen personel me arritje në veprimtaritë krijuese dhe interpretuese, miratohen me vendim të Senatit Akademik;

b) kërkesat për ekuivalentim vlerësohen nga një komision ad-hoc, i ngritur me vendim të Senatit Akademik të UART-it;

c) pas ekuivalentimit, komisioni ad-hoc paraqet listën e kandidatëve që u janë ekuivalentuar arritjet, duke i renditur sipas përcaktimeve në statutin e UART-it;

ç) rektori i UART-it, në bazë të pozicioneve të lira të miratuara nga Senati Akademik dhe të listës së kandidatëve të renditur nga komisioni ad-hoc, lidh kontratat njëvjeçare të punës.

7. UART-i përfaqëson një strukturë të integruar, e cila përbëhet nga njësi kryesore dhe njësi bazë, me veprimtari kërkimore artistike-shkencore.

8. UART-i gëzon status të veçantë lidhur me:

a) organizimin e programeve të studimeve në tri cikle të njëpasnjëshme që përfundojnë me marrjen e diplomave ose të certifikatave përkatëse. Programet e studimeve në UART hartohen nga njësitë bazë dhe paraqiten për miratim në Senatin Akademik. UART-i ofron edhe studime specializuese afatgjata, programe të formimit të vazhduar për fushat e edukimit artistik, si dhe programe studimi me karakter profesional në fushën e arteve;

b) punësimin e personelit akademik me kohë të plotë, sipas kritereve të përcaktuara nga njësia bazë përkatëse e të miratuara nga rektori, që mbajnë parasysh vlerësimin e karrierës profesionale dhe artistike, sipas përcaktimeve në statutin e UART-it;

c) të drejtën për të realizuar marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbim përvoje dhe mobiliteti në procesin mësimor-artistik dhe shkencor me institucione të arsimit të lartë, institucione të kërkimit shkencor, persona juridikë publikë ose privatë, vendas apo të huaj. Niveli i bashkëpunimit përcaktohet në marrëveshjet përkatëse të lidhura ndërmjet institucioneve;

ç) hartimin e kritereve dhe të testeve artistike të pranimit me konkurrim të kandidatëve për studentë në UART.

9. Statuti i UART-it miratohet me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, bazuar edhe në statusin e veçantë të dhënë me këtë vendim.

10. Ngarkohen Universiteti i Arteve dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM
Nr. 185, datë 25.3.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, "PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 71, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 2, fjalët "Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL, konsistojnë në: …" zëvendësohen me "Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, me përjashtim të studimeve të doktoratës, konsistojnë në: … ".

b) Shkronja "ç", e pikës 2.7, shfuqizohet.

c) Shkronja "c", e pikës 2.9, ndryshohet si më poshtë vijon:

"c) Me vendim të Senatit Akademik, institucioni i arsimit të lartë ka të drejtë të bëjë ndryshime profilizuese brenda programit të studimit të akredituar pa ndryshuar emërtimin e programit të studimit. IAL-ja njofton ministrinë përgjegjëse për arsimin jo më vonë se gjashtë muaj përpara fillimit të vitit akademik për ndryshimet profilizuese deri në masën 20 për qind të përmbajtjes së programit, të shprehur në kredite ECTS.".

ç) Pika 2.10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2.10 Diploma/certifikata dhe suplementi i saj

Diplomat/certifikatat, që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të dytë, si dhe ato të ciklit të tretë "Master ekzekutiv", shoqërohen me suplementin e diplomës.".

d) Pika 2.12 e vendimit shfuqizohet.

dh) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të doktoratës konsistojnë:

a) Për studimet e doktoratës hartohen projekte kërkimore-shkencore dhe zhvillimi të aprovuara dhe me financim të siguruar nga IAL-ja. Pas aktit të hapjes/riorganizimit të programit të studimeve të doktoratës e certifikimit të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore, studentët e pranuar mund të përfitojnë financim sipas ligjit. Njësia bazë mund të ofrojë më shumë se një projekt kërkimor për fushën e kërkimit që mbulon;

b) Studimet e doktoratës organizohen në fusha/nënfusha kërkimi. Ato përmbajnë veprimtari kërkimore-shkencore, me qëllim garantimin e formimit në fushën/nënfushën përkatëse të studimit;

c) Në bazë të projekteve kërkimore-shkencore, njësia bazë përgjegjëse për studimet e doktoratës përcakton numrin e studentëve doktorantë dhe IAL-ja, me vendim të Senatit Akademik, deklaron numrin e doktorantëve, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë

dhe certifikimin e kapaciteteve akademike e infrastukturore nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Njësia përgjegjëse e programit të studimeve të doktoratës duhet të garantojë standardet akademike dhe të ofrojë infrastrukturën e domosdoshme për realizimin e projektit kërkimor-shkencor.

ç) Në rregulloren e programit të studimit të doktoratës, njësia bazë:

i. përcakton kriteret e pranimit të studentëve, sipas parimit të thellimit të studimit në fushë të njëjtë apo të përafërt me studimet e ciklit të parë dhe të dytë;

ii. bashkërendon, në funksion të realizimit të projektit kërkimor-shkencor, veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe krijuese të studentëve;

iii. parashikon në mënyrë të detajuar rregullat e organizimit e të funksionimit të programit të doktoratës;

iv. parashikon në mënyrë të detajuar administrimin e të dhënave të çdo doktoranti lidhur me veprimtarinë kërkimore-shkencore e krijuese të tij dhe detyrimin për raportimin e vlerësimit të progresit të doktorantit.”.

2. Shtojca nr. 1, e vendimit nr. 41, datë 23.1.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, si dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCË NR. 1

Elementet e programeve të studimit përcaktohen në tabelat 1 dhe 1.1, si më poshtë vijon:

Tabela 1

Kategoria	**Komponenti mësimor**	**Cikli i parë (niveli 6 i KSHK-së)**	**Cikli i dytë (niveli 7 i KSHK-së)**			**Cikli i tretë (niveli 8 i KSHK-së)**
		Bachelor	**Master profesional**	**Master i shkenc**	**Master i shkencav**	**Master ekzekutiv**

				ave/ master i arte ve	e (i integ ruar)	
	LËNDË BAZË – Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	15–20% (kredite)	5–10% (kredite)	5–10% (kredite)	15–20% (kredite)	5–10% (kredite
	LËNDË KARAKTERIZUESE – Përgatitje për disiplinën shkencore	50–55% (kredite)	30–40% (kredite)	50–60% (kredite)	45–55% (kredite)	50–60% (kredite)
	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – Nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	12–15% (kredite)	20–30% (kredite)	12–20% (kredite)	12–15% (kredite)	12–15% (kredite)
	LËNDË PLOTËSUESE – Gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	10–15% (kredite)	10% (kredite)	10% (kredite)	6–8% (kredite)	
	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3–5% (kredite)	10–20% (kredite)	10–15% (kredite)	3–5% (kredite)	18–20% (kredite)

Shënim. Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70%, në rastin e programeve të ciklit të parë *"Bachelor"* dhe të programeve të integruara të studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave", dhe jo më pak se 60% në rastin e programeve të ciklit të dytë "Master i shkencave". Në rastin e programeve të ciklit të dytë "Master i arteve" ky raport vendoset sipas specifikave të vetë programit të studimit. Për programet e studimit të ciklit të tretë "Master ekzekutiv" lëndët e kategorisë B duhet të kenë një karakter dhe orientim të theksuar praktik, me qëllim avancimin e mëtejshëm profesional të studentëve. Për të përmbushur këtë objektiv, lëndët mund të ofrohen në bashkëpunim me industrinë dhe botën profesionale dhe, për çdo rast, ato duhet të jenë, të paktën, 50% praktikë në terren.

Tabela 1.1

Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Programe me karakter profesional (niveli 5 i KSHK-së) 60–120 kredite
A	LËNDË BAZË – Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	10–15% (kredite)
B	LËNDË KARAKTERIZUESE – Përgatitje për disiplinën që karakterizon programin, lëndët praktike	45–55% (kredite)
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE – Nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	5–15% (kredite)
D	LËNDË PLOTËSUESE – Gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	10–15% (kredite)
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3–5% (kredite)

Shënim. Duhet të ruhet një raport i balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50/50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion.

VENDIM

Nr. 320, datë 2.6.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 881, DATË 28.10.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË AKADEMISË SË SIGURISË, SI INSTITUCION I VETËM PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË NË FUSHËN E RENDIT E TË SIGURISË PUBLIKE, SI DHE ORGANIZIMIN E FUNKSIONIMIN E SAJ"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutë; të nenit 37, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar; të neneve 17, pika 5, dhe 30, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 881, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Akademia e Sigurisë është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike, së cilës i jepet status i veçantë.".

2. Shkronja "f", e pikës 5, shfuqizohet.

3. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjial administrativ i Akademisë së Sigurisë, i cili garanton përmbushjen e misionit të këtij institucioni dhe mbarëvajtjen financiare e administrative të tij. Ky bord përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Tre anëtarë, përzgjidhen nga Senati Akademik i Akademisë së Sigurisë, tre anëtarë nga ministri përgjegjës për arsimin, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili propozon kandidatët për anëtarë të bordit pasi ka marrë dakordësinë paraprake të ministrit përgjegjës për arsimin, si dhe të një anëtari nga ministri përgjegjës për rendin e sigurinë publike, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.".

4. Pika 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"15. Personeli akademik, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, karakterizohet në profesorë, lektorë, asistent-lektorë. Për personelin akademik me gradë policore ose gradë sipas statutit të strukturave përfituese, vetëm për efekt të veprimtarisë akademike, bëhet ekuivalentimi i këtyre gradave me gradat shkencore dhe titujt akademikë të personelit akademik.

Personeli akademik me gradë policore përzgjidhet nga radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit, sipas kritereve të përcaktuara në statutin e Akademisë së Sigurisë dhe emërohet nga Rektori, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Personeli akademik me gradë sipas statutit të strukturave përfituese përzgjidhet nga radhët e punonjësve të këtyre strukturave, sipas kritereve të përcaktuara në statutin e Akademisë së Sigurisë dhe emërohet nga Rektori me propozim të titullarëve të strukturave përfituese, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit midis titullarit të Akademisë së Sigurisë dhe titullarit të strukturave përfituese.".

5. Në pikën 20, pas fjalëve "… funksionet organike …" shtohen "… me kohë të pjesshme ...".

6. Në pikën 22, emërtimi "Bordi Këshillues i Akademisë së Sigurisë" zëvendësohet me "Bordi i Administrimit të Akademisë së Sigurisë".

7. Në pikën 23, fjalët "… nga Bordi Këshillues i AS-së dhe miratohen me vendim të Senatit Akademik ..." zëvendësohen me "… miratohen nga Bordi i Administrimit të Akademisë së Sigurisë …".

8. Në pikën 24 hiqen fjalët "… me propozim të Bordit Këshillues të Akademisë së Sigurisë …".

9. Pika 29 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“29. Akademia e Sigurisë financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme. Akademia e Sigurisë është njësi shpenzuese më vete brenda programit buxhetor të Policisë së Shtetit.”.

10. Pika 30 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“30. Struktura dhe organika e Akademisë së Sigurisë miratohen para fillimit të vitit akademik nga ministri i Brendshëm, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në dakordësi me strukturat përfituese. Kjo strukturë organike nuk mund të ndryshohet pa përfunduar viti akademik.”.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM
Nr. 558, datë 29.9.2021

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 160, DATË 19.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË STUDENTËVE TË SHKËLQYER DHE TË NËPUNËSVE CIVILË (FONDI I EKSELENCËS)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 4, e 112, pika 4, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Pas nënndarjes “v”, të shkronjës “a”, të pikës 2, shtohet nënndarja “vi”, me këtë përmbajtje:

“vi. nuk kanë përfituar më parë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, brenda fondeve buxhetore të miratuara për Fondin e Ekselencës, për një program tjetër studimi të ciklit të dytë.”.

b) Pas nënndarjes “v”, të shkronjës “b”, të pikës 2, shtohet nënndarja “vi”, me këtë

përmbajtje:

"vi. nuk kanë përfituar më parë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, brenda fondeve buxhetore të miratuara për Fondin e Ekselencës, për një program tjetër studimi të ciklit të tretë (doktoratë).".

c) Pas pikës 16 shtohet pika 16/1, me këtë përmbajtje:

"16/1. Studentët, që ndjekin studimet në vitet e ndërmjetme dhe kanë përfituar bursë nga Fondi i Ekselencës, vijojnë me përfitimin e bursës edhe në rastet kur institucioni i arsimit të lartë nuk i ka vlerësuar me nota për shkak të pandemisë së shkaktuar nga infeksioni i COVID-19, me kusht që nota mesatare e ponderuar në përfundim të studimeve të jetë jo më pak se nota 8.".

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 661, datë 3.11.2021

PËR PËRCAKTIMIN E LLOJEVE TË QENDRAVE/INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE, PUBLIKE APO PRIVATE, SI DHE TË KRITEREVE QË ATO DUHET TË PLOTËSOJNË PËR LIDHJEN E MARRËVESHJEVE ME INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, NË FUSHËN E SHËNDETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet e arsimit të lartë (IAL) në fushën e shëndetësisë lidhin marrëveshje, për të gjitha ciklet e studimit, me qendrat/institucionet e kujdesit shëndetësor, publike apo private, të licencuara dhe të akredituara, sipas llojit e që plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë vendim.

2. Qendrat/institucionet e kujdesit shëndetësor, me të cilat lidhen marrëveshje, janë të llojeve të mëposhtme:

a) spitale rajonale dhe terciare;

b) struktura spitalore që ofrojnë shërbime shëndetësore, sipas përcaktimeve të bëra nga ministri përgjegjës për shëndetësinë;

c) struktura ambulatore të specializuara.

3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë përcakton kapacitetet pritëse të qendrave/institucioneve të kujdesit shëndetësor, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, përpara se ata të lidhin marrëveshje me IAL-et, sipas standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë.

4. Qendrat/institucionet e kujdesit shëndetësor, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, me përjashtim të qendrave spitalore universitare, mund të lidhin marrëveshje me institucionet e arsimit të lartë në fushën e shëndetësisë, për qëllime mësimore dhe kërkimore-shkencore. Për ndjekjen e praktikave mësimore dhe kërkimore-shkencore pranë qendrave/institucioneve të kujdesit shëndetësor, me përjashtim të qendrave spitalore universitare, IAL-i i paguan qendrës/institucionit të kujdesit shëndetësor tarifën përkatëse, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, të ministrit përgjegjës për arsimin dhe të ministrit përgjegjës të financave. Të ardhurat e përfituara nga këto tarifa konsiderohen të ardhura dytësore për qendrat/institucionet e kujdesit shëndetësor.

5. Mënyra e ndjekjes së praktikave mësimore dhe kërkimore-shkencore, sipas cikleve të studimit, përcaktohet në marrëveshjen që do të lidhin qendra/institucioni i kujdesit shëndetësor dhe institucioni i arsimit të lartë në fushën e shëndetësisë.

6. Qendra/institucioni i kujdesit shëndetësor, i përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

a) objekti, për të cilin është ngritur e funksionon, përfshin edhe objektin e marrëveshjes së propozuar për nënshkrim;

b) të jetë licencuar dhe akreditуar sipas legjislacionit në fuqi për akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor;

c) të ketë normativë të shfrytëzimit të kapacitetit të qendrës/institucionit të kujdesit shëndetësor mbi 60 (gjashtëdhjetë) %;

ç) të ketë personel mjekësor, me kualifikimet e nevojshme akademike e profesionale, sipas kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi;

d) të ketë kapacitetet profesional në funksion të plotësimit të kërkesave për një mësim, sipas standardit të përcaktuar. Procedurat praktike të jenë sipas standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë;

dh) të plotësojë kushtet infrastrukturore, teknologjike dhe fizike, sipas natyrës së institucionit e të shërbimeve që ofron;

e) të ketë strukturë organizative me kapacitetet e nevojshme profesionale, si dhe kapacitetet organizative, për të pritur numrin e praktikantëve, bazuar në marrëveshjet e lidhura ndërmjet IAL-eve dhe qendrave/institucioneve të kujdesit shëndetësor të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi;

ë) të respektojë kapacitetin pritës të institucionit dhe të qendrës shëndetësore, duke mos cenuar veprimtarinë normale të qendrës/institucionit të kujdesit shëndetësor dhe plotësimin e nevojave të institucionit të arsimit të lartë për qëllime mësimore cilësore, brenda kohës së punës, përcaktuar në Kodin e Punës.

7. Stafi akademik që drejton studentët nuk ofron kujdes shëndetësor në këto struktura shëndetësore, përveç rasteve kur është pjesë e stafit të institucionit.

8. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë publikon listën e qendrave/institucioneve të kujdesit shëndetësor, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, që mund të lidhin marrëveshje me institucionet e arsimit të lartë në fushën e shëndetësisë, sipas natyrës së shërbimeve shëndetësore që ofrojnë qendrat/institucionet e kujdesit shëndetësor.

9. Qendrat/institucionet e kujdesit shëndetësor, për çdo marrëveshje të lidhur, njoftojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, ndërsa institucionet e arsimit të lartë njoftojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve ministrinë përgjegjëse për arsimin.

10. Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe të kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve, sipas marrëveshjes së nënshkruar. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve zgjidhet nga gjykata kompetente.

11. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, qendrat/institucionet e kujdesit shëndetësor, si dhe institucionet përkatëse të arsimit të lartë në fushën e shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 678, datë 10.11.2021

PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, JOPUBLIK, KOLEGJI PROFESIONAL I LARTË GJERMAN I TEKNOLOGJISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, 30 e 31, pika 1, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë, në emër të shoqërisë "Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë" sh.p.k., i cili e ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë organizohet në 3 (tre) departamente, si më poshtë vijon:

a) Departamenti i Mekanikës;

b) Departamenti Elektrik dhe i Teknologjisë së Informacionit;

c) Departamenti i Ndërtimit dhe Infrastrukturës.

3. Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë ofron programe të studimit sipas kuadrit ligjor në fuqi.

4. Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë e fillon veprimtarinë e tij vetëm pas nxjerrjes së urdhrit të ministrit përgjegjës për arsimin për fillimin e veprimtarisë.

5. Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional e të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6. Statuti i institucionit të arsimit të lartë, jopublik, Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë, miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

7. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontroll periodik të ligjshmërisë në institucion, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe shoqëria "Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë" sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 679, datë 10.11.2021

PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, JOPUBLIK, UNIVERSITETI "*ËESTERN BALKANS*"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, 30 e 31, pika 1, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, universiteti "*Ëestern Balkans*" (në vijim, universiteti "*Ëestern Balkans*"), në emër të shoqërisë "*Ëestern Balkans University*" sh.p.k., i cili ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Universiteti "*Ëestern Balkans*" organizohet në 3 (tri) fakultete:

a) Fakulteti i Mjekësisë Dentare;

b) Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;

c) Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit.

3. Universiteti "*Ëestern Balkans*" mund të ofrojë programe studimi në të gjitha ciklet e studimeve të arsimit të lartë, si edhe programe studimi me karakter profesional, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

4. Universiteti "*Ëestern Balkans*" e fillon veprimtarinë e tij vetëm pas nxjerrjes së urdhrit të ministrit përgjegjës për arsimin për fillimin e veprimtarisë akademike.

5. Universiteti "*Ëestern Balkans*" duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional e të programeve të studimit brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6. Statuti i universitetit "*Ëestern Balkans*" miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

7. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontroll periodik të ligjshmërisë në institucion, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

8. Çdo ndryshim i njësive kryesore të universitetit "*Ëestern Balkans*" miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe shoqëria "*Ëestern Balkans University*" sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM
Nr. 740, datë 3.12.2021

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË SPANJËS, PËR BASHKËPUNIMIN E PËRBASHKËT NË ARSIMIN E LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Spanjës, për bashkëpunimin e përbashkët në arsimin e lartë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Memorandum Mirëkuptimi

mbi Bashkëpunimin e Përbashkët në Arsimin e Lartë

ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe

Qeverisë së Mbretërisë së Spanjës

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Spanjës, në vijim referuar si nënshkruesit,

Bazuar në Marrëveshjen për bashkëpunim kulturor dhe arsimor midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, nënshkruar në Madrid më 25 nëntor 1999,

Duke dëshiruar të intensifikojnë marrëdhëniet dypalëshe, bazuar në vlerësimin e tyre për rëndësinë e arsimit si një faktor kyç për zhvillimin dhe besimin e tyre, se në veçanti nga bashkëpunimi në fushën e arsimit të lartë do të përfitojnë të dy nënshkruesit,

Të dy nënshkruesit propozojnë si më poshtë:

SEKSIONI 1

Nënshkruesit do të shkëmbejnë informacion mbi sistemet e tyre arsimore, si bazë për të përforcuar marrëdhëniet e tyre. Kjo përfshijnë organizimin e vizitave dhe shkëmbimin e informacionit mbi arsimin e lartë, duke përfshirë kërkimin e tij shkencor, sistemet e tyre përkatëse të kualifikimit, konferencat arsimore, forumet dhe diskutimet në panele të mbajtura në të dy vendet.

SEKSIONI 2

Të dy nënshkruesit po punojnë në forcimin e bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë, duke përfshirë kërkimin shkencor, si dhe për të inkurajuar institucionet e tyre që të zhvillojnë sisteme e arsimit të lartë në mënyrë reciproke.

SEKSIONI 3

Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë e Republikës së Shqipërisë përmes Zyrës Kombëtare Erasmus + do të punojë së bashku me Ministrinë e Universiteteve të Mbretërisë së Spanjës përmes Agjencisë Spanjolle të Shërbimit për Ndërkombëtarizimin e Arsimit (SEPIE), për të lehtësuar zhvillimin e programeve

të mobilitetit dhe shkëmbimin akademik midis institucioneve të arsimit të lartë të të dy vendeve.

SEKSIONI 4

Nënshkruesit kupcjnë se aktivitetet e informacionit dhe bashkëpunimit midis institucioneve të arsimit të lartë përfshijnë studentët, mësuesit, studiuesit dhe personelin jo-akademik të të dy vendeve.

SEKSIONI 5

Për të arritur qëllimet e këtij memorandumi, nënshkruesit do të veprojnë si më poshtë:

A. Shkëmbejnë përvoja në fushën e arsimit të lartë.

B. Sigurojnë më shumë vërtetësi për njerëzit e caktuar.

C. Inkurajojnë partneritete dhe asortëveshje midis universiteteve nga të dy vendet.

D. Ofrojnë burse sipas mundësive që disponojnë të dy vendet.

E. Shkëmbejnë informacion dhe publikime në fushën e arsimit të lartë, si dhe publikime në lidhje me sistemin e arsimit të lartë të secilit vend.

F. Organizojnë konferenca, takime, seminare dhe kuvende shkencore të përbashkëta, me kusht që ato të jenë të koordinuara me Palën tjetër, dhe që kjo e fundit të informohet paraprakisht në një periudhë të arsyeshme kohore.

G. Bashkëpunojnë në fusha të tjera të propozuara dhe miratuara nga të dy nënshkruesit.

SEKSIONI 6

Nënshkruesit do të punojnë për:

A. Mbikëqyrjen e shkëmbimit të studentëve të arsimit të lartë në programe bachelor, master dhe doktoraturë.

B. Shkëmbimin e profesorëve dhe studiuesve vizitorë për të trajtuar disa pjesë shkencore, të kërkuesve të institucioneve të arsimit të lartë, ekzaminuesve dhe rezidentëve për projekte kërkimore dhe shkencore.

C. Shkëmbimin e personelit jo-mësimdhënës që dëshiron të realizojë në institucionet e arsimit të lartë në të dy vendet.

SEKSIONI 7

Aktivitetet që lindin nga ky Memorandum nuk do të sjellin nevojë kosto të veçantë financiare.

Aty ku është e zbatueshme, kostot financiare që lindin si rezultat i këtyre aktiviteteve do të përfshihen në buxhetet vjetore të dy Ministrive, në përputhje me legjislacionin e të dy vendeve.

SEKSIONI 8

Nënshkruesit do të përcaktojnë detajet, organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi, me krijimin e një komiteti pasues që do të takohet më baza të rregullta, duke caktuar me shkrim vendin dhe datën e takimeve të tij. Ky komitet do të përgatisë programet e bashkëpunimit me të cilët do të përcaktojë dhe identifikojë kushtet e bashkëpunimit në përputhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi, duke kryer kontrollin e zbatimit të tij, vlerësimin dhe dhënien e udhëzimeve të nevojshme që synojnë zbatimin e tij efikas.

SEKSIONI 9

Të drejtat e pronësisë intelektuale

A. Nënshkruesit do të marrin përsipër të respektojnë të drejtat dhe të sigurojnë zbatimin e plotë të të drejtave të pronësisë intelektuale, në përputhje me ligjet kombëtare të secilit vend, para fillimit të çdo aktiviteti të përbashkët.

B. Rezultatet e bulumtimeve dhe patentave të shpikjes që rezultojnë nga një bashkëpunim i tillë, do të jenë të drejtat e nënshkruesve dhe rezultatet mund të botohen në revista shkencore vendase dhe ndërkombëtare, me pëqimin e nënshkruesve.

C. Të gjitha korrespondencat dhe komunikimet në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi do të bëhen me shkrim midis dy vendeve.

SEKSIONI 10

Dispozitat përfundimtare

Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk është ligjërisht i detyrueshëm dhe as nuk prodhon detyrime sipas së Drejtës Ndërkombëtare.

Çdo ndryshim, objekt miratimi paraprak midis nënshkruesve, duhet t'i bashkëngjitet si një Shtojcë, e cila do të ishte pjesë e qenësishme e këtij Memorandumi, doke treguar datën nga e cila ndryshimi për të cilin është vënë dakord, duhet të jetë i zbatueshëm.

SEKSIONI 11

Çdo mosmarrëveshje midis nënshkruesve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të agjidhet në mënyrë miqësore, përmes këshillimit dhe negociatave midis të dy nënshkruesve dhe pa u apeluar tek palët e treta ose arbitraziti ndërkombëtar.

SEKSIONI 12

Ky Memorandum do të filloje zbatimin e tij që nga data e nënshkrimit, për një periudhë pesëvjeçare, dhe rinovohet në mënyrë të heshtur për periudha të njëpasnjëshme prej pesë vjetësh, përveç rastit kur njëra Palë njofton Palën tjetër me shkrim përmes kanaleve diplomatike paraprakisht gjashtë muaj përpara, me synimin për të përfunduar këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Në fusë të zbatimit të këtij Memorandumi, çdo program në vazhdim do të vijojë, përveç në rastet e forcave madhore.

Nënshkruar në Madrid më 4 tetor 2021 në dy kopje në gjuhët shqipe, spanjolle dhe anglezo, të dyja janë njësoj të vlefshme. *Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në interpretim, tekstë në gjuhën anglezo do të katë përparësi.*

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë	Për Qeverisë e Mbretërisë së Spanjës
Edi Rama	Pedro Sánchez Pérez-Castejón
KRYESONJËTËR	PRESIDENTI I QEVERISË

VENDIM
Nr. 825, datë 24.12.2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 109, DATË 15.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË E TË BORDIT TË AKREDITIMIT DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR PROCESET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË", TË NDRYSHUAR[70]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 15 e 106, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të shkronjës "c", të pikës 4, shtohen fjalët "..., në funksion të rritjes së cilësisë dhe formatimit, sipas modeleve të aprovuara të tyre.".

b) Pas shkronjës "c", të pikës 4, të shtohen shkronjat "ç" dhe "d", me këtë përmbajtje:

"ç) ndjekjen e proceseve të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit periodik e të monitorimit të vazhduar të cilësisë të institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të tyre të studimit;

d) organizimin dhe nxjerrjen e rezultateve përfundimtare në kuadër të Sondazhit Kombëtar të Studentëve.".

c) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë emërohet, lirohet/shkarkohet nga detyra me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, me urdhër të Kryeministrit. Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të zotërojë të paktën gradën shkencore "Doktor";

b) të ketë eksperiencë pune mbi 5 (pesë) vjet në institucione që ushtrojnë veprimtari në fushën e arsimit të lartë, duke përfshirë edhe eksperiencë në nivele të larta drejtuese.".

ç) Në fund të shkronjës "a", të pikës 12, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Bëhen pjesë e komisioneve të vlerësimit të jashtëm partnerë nga tregu i punës dhe studentë (anëtar i organeve kolegjiale të IAL-ve), pa të drejtë vote, dhe kanë vetëm rol monitorues.".

d) Në fund të shkronjës "b", të pikës 12, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Përjashtim bëjnë rastet kur në një fushë mungojnë ekspertët dhe duhen angazhuar ekspertë të rinj, që shtojnë listën, por gjithmonë sipas kritereve dhe në bashkëpunim me Bordin e Akreditimit.".

dh) Tabela 2/b, e shtojcës 2, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me tabelën me të njëjtën numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

[70] Ky vendim është përafruar pjesërisht me Rekomandimin e Këshillit të Evropës (2017/C 189/03), datë 22 maj 2017, "Mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe shfuqizimin e rekomandimit të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 prillit 2008, për themelimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela 2/b
Tarifat për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin e programeve të studimit

Nr.	Programet e studimit	Tarifa
1	2-vjeçar profesional	173 621
2	Bachelor	225 747
3	Bachelor 4-vjeçar	277 874
4	Master profesional 1 vit	173 621
5	Master profesional 2 vjet	225 747
6	Master i shkencave	364 517
7	Master i shkencave i integruar	600 945
8	Master ekzekutiv 1 vit	308 417
9	Master ekzekutiv 2 vjet	364 517
10	SPA 2 vjet	364 517
11	SPA 3–4 vjet	482 731
12	Doktoratë	610 490

VENDIM
Nr. 310, datë 11.5.2022

PËR SPECIFIKIMET DHE PËRMBAJTJEN E KODIFIKIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 86, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Grupimin e programeve të studimit, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, sipas elementeve të mëposhtme:

a) Identifikimi i llojit të programit të studimit. Ky element përmban 4 (katër) karaktere, ku përcaktohet niveli i tij referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, kohëzgjatja e programit të studimit dhe lloji i programit;

b) Fusha e detajuar, në të cilën bën pjesë programi i studimit. Ky element përbëhet nga 4 (katër) shifra, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, referuar Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit 2011 (KSNA 2011), Fushat e Arsimit dhe Trajnimit 2013 (KSNA-F 2013);

c) Një shkronjë, e cila identifikon gjuhën në të cilën zhvillohet programi i studimit, sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Identifikimi i llojit të programit të studimit përcaktohet, si më poshtë vijon:

a) Programe studimi me karakter profesional me 60 ECTS (51PP);

b) Programe studimi me karakter profesional me 120 ECTS (52PP);

c) *Bachelor,* jo më pak se 180 ECTS (63BA);

ç) Master profesional me 60 ECTS (71MP);

d) Master profesional me 120 ECTS (72MP);

dh) Master i shkencave, jo më pak se 120 ECTS (72MS);

e) Master i arteve, jo më pak se 120 ECTS (72MA);

ë) Program i integruar i studimeve të ciklit të dytë me 300 ECTS (75MI);

f) Program i integruar i studimeve të ciklit të dytë me 360 ECTS (76MI);

g) Master ekzekutiv me 60 ECTS (81ME);

gj) Master ekzekutiv me 120 ECTS (82ME);

h) Specializim afatgjatë, me kohëzgjatje 2 vite akademike, me 120 ETCS, (82SA);

i) Specializim afatgjatë, me kohëzgjatje 3 vite akademike, me 180 ECTS, (83SA);

j) Specializim afatgjatë, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me 240 ECTS, (84SA);

k) Specializim afatgjatë, me kohëzgjatje 5 vite akademike, me 300 ECTS, (85SA);

l) Doktoratë (83DO).

3. Për programet e studimit, të cilat ofrohen me kohë të zgjatur, përveç elementeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, në fillim të kodit shënohet shkronja "Z".

4. Për programet e përbashkëta të studimit, përveç elementeve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, në fillim të kodit shtohet shkronja "P".

5. Për programet e studimit të formimit të vazhduar, elementet e kodit, që përcaktojnë identifikimin e llojit të programit të studimit, përbëhen nga lloji i programit të studimit "SFV" (studim i formimit të vazhduar). Elementet e tjera të kodifikimit për këto programe studimi janë sipas përcaktimeve të shkronjave "b" dhe "c", të pikës 1, të këtij vendimi.

6. Vlerësimi i fushave të programeve të studimit ndërdisiplinor dhe rasteve të veçanta kryhet në përputhje me rregullat e përcaktimet e referuara në Fushat e Arsimit dhe Trajnimit 2013 (KSNA-F 2013).

7. Për programet ekzistuese të studimit, institucionet e arsimit të lartë dërgojnë zyrtarisht në ministrinë përgjegjëse për arsimin, propozimin/et e tyre të argumentuar/a lidhur me kodet, që duhet të përmbajnë të gjitha programet e studimit që ato ofrojnë, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.

8. Për programet e reja të studimit, kodi i programit të studimit përfshihet në aplikimin e institucionit të arsimit të lartë për hapjen e programit të studimit dhe vlerësohet nga ministria përgjegjëse për arsimin në funksion të procedurave për hapjen e programit të studimit.

9. Kodifikimi i programeve të studimit kryhet nga ministria përgjegjëse për arsimin, në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë, të cilat ofrojnë programet që do të kodifikohen, bazuar në procedurat e miratuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

10. Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë (INSTAT) raporton statistikat e arsimit të lartë, sipas këtij vendimi.

11. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë, si dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
FUSHAT E DETAJUARA TË ARSIMIT DHE TRAJNIMIT TË ISCED-F 2013

Fushë e gjerë	**Fushë e ngushtë**	**Fushë e detajuar**
00 Programe dhe kualifikime të përgjithshme	000 Programe dhe kualifikime të përgjithshme të papërcaktuara më tej	0000 Programe dhe kualifikime të përgjithshme të papërcaktuara më tej
	001 Programe dhe kualifikime bazë	0011 Programe dhe kualifikime bazë
	002 Shkrim-këndim dhe numërim	0021 Shkrim-këndim dhe numërim
	003 Aftësi dhe zhvillim individual	0031 Aftësi dhe zhvillim individual
	009 Programe dhe kualifikime të përgjithshme të paklasifikuara diku tjetër	0099 Programe dhe kualifikime të përgjithshme të paklasifikuara diku tjetër
01 Arsim	011 Arsim	0110 Arsim i papërcaktuar më tej 0111 Shkenca arsimi 0112 Trajnim për mësuesit e ciklit parashkollor 0113 Trajnim për mësuesit pa specializim lënde 0114 Trajnim për mësuesit me specializim lënde 0119 Arsim i paklasifikuar diku tjetër
	018 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë arsimin	0188 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë arsimin
02 Arte dhe shkenca humane	020 Arte dhe shkenca humane të paspecifikuara më tej	0200 Arte dhe shkenca humane të paspecifikuara më tej
	021 Arte	0210 Arte të paklasifikuara diku tjetër 0211 Teknika audio-vizuale dhe produksion mediatik

		0212 Modë, dizajn interior dhe industrial 0213 Arte të bukura 0214 Zejtari 0215 Arte muzikore dhe performimi 0219 Arte të paklasifikuara diku tjetër
	022 Shkenca humane (përveç gjuhëve)	0220 Shkenca humane (përveç gjuhëve) të paspecifikuara më tej 0221 Fe dhe teologji 0222 Histori dhe arkeologji 0223 Filozofi dhe etikë 0229 Shkenca humane (përveç gjuhëve) të paklasifikuara diku tjetër
	023 Gjuhë të huaja	0230 Gjuhë të huaja të paspecifikuara më tej 0231 Mësimi i gjuhës 0232 Literaturë dhe linguistikë 0239 Gjuhë të huaja të paklasifikuara diku tjetër
	028 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë arte dhe shkenca humane	0288 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë arte dhe shkenca humane
	029 Arte dhe shkenca humane të paklasifikuara diku tjetër	0299 Arte dhe shkenca humane të paklasifikuara diku tjetër
03 Shkenca sociale, gazetari dhe informim	030 Shkenca sociale, gazetari dhe informim të papërcaktuara më tej	0300 Shkenca sociale, gazetari dhe informim të papërcaktuara më tej
	031 Shkenca sociale dhe të sjelljes	0310 Shkenca sociale dhe të sjelljes të papërcaktuara më tej 0311 Ekonomi 0312 Shkenca politike dhe civile 0313 Psikologji

		0314 Sociologji dhe shkenca kulturore 0319 Shkenca sociale dhe të sjelljes të paklasifikuara diku tjetër
	032 Gazetari dhe informim	0320 Gazetari dhe informim të papërcaktuara më tej 0321 Gazetari dhe raportim 0322 Bibliotekë, informim dhe studime të arkivit 0329 Gazetari dhe informim të paklasifikuara diku tjetër
	038 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë shkenca sociale, gazetari dhe informim	0388 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë shkenca sociale, gazetari dhe informim
	039 Shkenca sociale, gazetari dhe informim të paklasifikuara diku tjetër	0399 Shkenca sociale, gazetari dhe informim të paklasifikuara diku tjetër
04 Biznes, administrim dhe juridik	040 Biznes, administrim dhe jurisprudencë të papërcaktuara më tej	0400 Biznes, administrim dhe juridik të papërcaktuara më tej
	041 Biznes dhe administrim	0410 Biznes dhe administrim të papërcaktuara më tej 0411 Kontabilitet dhe tatime 0412 Financë, bankë dhe sigurime 0413 Menaxhim dhe administrim 0414 Marketing dhe reklamim 0415 Sekretari dhe punë zyre 0416 Shitjet me shumicë dhe pakicë 0417 Aftësi pune 0419 Biznes dhe administrim të paklasifikuara diku tjetër
	042 Juridik	0421 Juridik

	048 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë biznes, administrim dhe juridik	0488 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë biznes, administrim dhe juridik
	049 Biznes, administrim dhe juridik të paklasifikuara diku tjetër	0499 Biznes, administrim dhe juridik të paklasifikuara diku tjetër
05 Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	050 Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë të papërcaktuara më tej	0500 Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë të papërcaktuara më tej
	051 Shkenca biologjike dhe të lidhura me të	0510 Shkenca biologjike dhe të lidhura me të, të papërcaktuara më tej 0511 Biologji 0512 Biokimi 0519 Shkenca biologjike dhe të lidhura me të, të paklasifikuara diku tjetër
	052 Mjedis	0520 Mjedis i papërcaktuar më tej 0521 Shkenca mjedisore 0522 Mjedise natyrore dhe faunë e egër 0529 Mjedis i paklasifikuar diku tjetër
	053 Shkenca fizike	0530 Shkenca fizike të papërcaktuara më tej 0531 Kimi 0532 Shkenca të tokës 0533 Fizikë 0539 Shkenca fizike të paklasifikuara diku tjetër
	054 Matematikë dhe statistikë	0540 Matematikë dhe statistikë të papërcaktuar më tej 0541 Matematikë 0542 Statistikë
	058 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë	0588 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë

	shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë
	059 Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë të paklasifikuara diku tjetër	0599 Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë të paklasifikuara diku tjetër
06 Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)	061 Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)	0610 Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK) të paklasifikuara diku tjetër 0611 Përdorim kompjuteri 0612 Projektim dhe administrim bazë të dhënash dhe rrjeti 0613 Zhvillim dhe analizë *softëare* dhe aplikacionesh 0619 Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK) të paklasifikuara diku tjetër
	068 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK)	0688 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK)
07 Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	070 Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim të papërcaktuara më tej	0700 Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim të papërcaktuara më tej
	071 Inxhinieri dhe profesione inxhinierie	0710 Inxhinieri dhe profesione inxhinierie të papërcaktuara më tej 0711 Inxhinieri kimike dhe proceset 0712 Teknologji e mbrojtjes mjedisore 0713 Elektricitet dhe energji 0714 Elektronikë dhe automatizëm 0715 Mekanikë dhe profesione punim metali 0716 Mjete motorike, anije dhe avionë 0719 Inxhinieri dhe profesione inxhinierike të paklasifikuara diku tjetër

	072 Prodhim dhe përpunim	0720 Prodhim dhe përpunim të papërcaktuar më tej 0721 Teknologji ushqimore 0722 Materiale (qelq, letër, plastikë dhe dru) 0723 Tekstile (veshje, këpucë dhe lëkurë) 0724 Minierë dhe industri nxjerrëse 0729 Prodhim dhe përpunim të paklasifikuar diku tjetër
	073 Arkitekturë dhe ndërtim	0730 Arkitekturë dhe ndërtim të papërcaktuar diku tjetër 0731 Arkitekturë dhe planifikim qyteti 0732 Ndërtimi dhe inxhinieria e ndërtimit
	078 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	0788 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë inxhinieri, prodhim dhe ndërtim
	079 Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim të paklasifikuar diku tjetër.	0799 Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim të paklasifikuar diku tjetër
08 Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari	080 Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari të papërcaktuar më tej	0800 Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari të papërcaktuar më tej
	081 Bujqësi	0810 Bujqësi e papërcaktuar më tej 0811 Prodhim bimor dhe shtazor 0812 Hortikulturë 0819 Bujqësi e paklasifikuar diku tjetër
	082 Pyje	0821 Pyje
	083 Peshkim	0831 Peshkim
	084 Veterinari	0841 Veterinari

	088 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari	0888 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari
	089 Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari të paklasifikuar diku tjetër	0899 Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari të paklasifikuar diku tjetër
09 Shëndet dhe mirëqenie	090 Shëndet dhe mirëqenie të papërcaktuara më tej	0900 Shëndet dhe mirëqenie të papërcaktuara më tej
	091 Shëndet	0910 Shëndet i papërcaktuar më tej 0911 Studime dentare 0912 Mjekësi 0913 Infermieri dhe mami 0914 Teknologji diagnostikimi dhe trajtimi mjekësor 0915 Terapi dhe rehabilitim 0916 Farmaci 0917 Mjekësi dhe terapi tradicionale dhe plotësuese 0919 Shëndetësi e paklasifikuar diku tjetër
	092 Mirëqenie	0920 Mirëqenie e papërcaktuar më tej 0921 Kujdestari për të moshuar dhe të rritur me aftësi të kufizuara 0922 Kujdes për fëmijë dhe shërbime për të rinjtë 0923 Punë sociale dhe këshillim 0929 Mirëqenie e paklasifikuar diku tjetër
	098 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë shëndetin dhe mirëqenien	0988 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë shëndetin dhe mirëqenien

	099 Shëndet dhe mirëqenie të paklasifikuar diku tjetër	0999 Shëndet dhe mirëqenie të paklasifikuar diku tjetër
10 Shërbime	100 Shërbime të papërcaktuar më tej	1000 Shërbime të papërcaktuar më tej
	101 Shërbime personale	1010 Shërbime personale të papërcaktuar më tej 1011 Shërbime shtëpiake 1012 Shërbime bukurie dhe floku 1013 Hotele, restorante dhe katering 1014 Sporte 1015 Udhëtim, turizëm dhe kohë e lirë 1019 Shërbime personale të paklasifikuara diku tjetër
	102 Shërbime higjiene dhe shëndeti në punë	1020 Shërbime higjiene dhe shëndeti në punë të papërcaktuara më tej 1021 Higjienë komuniteti 1022 Shëndet dhe siguri në punë 1029 Shërbime higjiene dhe shëndeti në punë të paklasifikuar diku tjetër
	103 Shërbime sigurie	1030 Shërbime sigurie të papërcaktuara më tej 1031 Forca të armatosura dhe mbrojtje 1032 Mbrojtje e individëve dhe e pronës 1039 Shërbime sigurie të paklasifikuara diku tjetër
	104 Shërbime transporti	1041 Shërbime transporti
	108 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë shërbime	1088 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë shërbime

	109 Shërbime të paklasifikuara diku tjetër	1099 Shërbime të paklasifikuara diku tjetër
99 Fushë e panjohur	999 Fushë e panjohur	9999 Fushë e panjohur

SHTOJCA NR. 2
GJUHA NË TË CILËN ZHVILLOHET PROGRAMI I STUDIMIT

GJUHA E HUAJ	KODI
Shqip	S
Anglisht	A
Italisht	I
Frëngjisht	F
Gjermanisht	G
Spanjisht	E
Gjuhë tjetër	X

VENDIM
Nr. 363, datë 26.5.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 436, DATË 3.6.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITET AKADEMIKE 2020–2021 DHE 2021–2022 E NË VIJIM", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3, të vendimit nr. 436, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1 Kandidatët, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, minimalisht me notë mesatare 6.5 (gjashtë pikë pesë), mund të aplikojnë edhe në programet e studimit të gjuhëve të huaja dhe në programet

e studimit të ciklit të parë "Bachelor", të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë "Master" në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 1, të vendimit, por këta kandidatë pajisen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore me numër të veçantë matrikullimi, i cili nuk i lejon të ndjekin më pas programet e ciklit të dytë "Master" në fushën e mësuesisë.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 386, datë 1.6.2022

PËR MIRATIMIN E FUSHAVE DHE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT, QË PËRBËJNË PRIORITET KOMBËTAR DHE MBËSHTETJEN FINANCIARE TË STUDENTËVE TË SHKËLQYER E TË STUDENTËVE, QË NDJEKIN KËTO PROGRAME NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 112, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar në institucionet publike të arsimit të lartë, përkatësisht, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit ose të ardhura të tjera të ligjshme, për vitin akademik 2022–2023, e në vijim, të studentëve shtetas shqiptarë, të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë, që nuk janë njëkohësisht përfitues të ndonjë financimi tjetër nga shteti shqiptar dhe që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) Studenti me notë mesatare në pranim, që:

i. ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00;

ii. në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5 deri në 10.00.

b) Studenti fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare të arsimit parauniversitar, me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, pavarësisht notës mesatare, kur pranohet në programe studimi, që lidhen me lëndën/t/disiplinën ku ka fituar çmimin;

c) Studenti, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar dhe që ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare, jo më pak se 8.5, përfshirë notën e përshkallëzuar të provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore.

3. Mbështetjen financiare, vetëm për njërën nga kategoritë e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, e përfiton studenti për program të parë studimi dhe që pranon:

a) të nënshkruajë marrëveshje, ndërmjet përfituesit të financimit apo përfaqësuesit ligjor të tij, institucionit të arsimit të lartë, ku pranohen për të kryer studimet, dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin, për përfitimin e financimit në Republikën e Shqipërisë;

b) të punojë në profesionin për studimet e të cilit përfiton financim nga momenti që i lind e drejta për të punuar, bazuar në legjislacionin në fuqi, në sektorin shtetëror, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, për jo më pak se 3 (tre) vjet, përfshirë edhe rastin kur i ndërpritet financimi, për shkak të mospërmbushjes së kriterit të notës mesatare gjatë studimeve;

c) të kalojë zyrtarisht diplomën/at origjinale përkatëse të arsimit të lartë, për të cilin përfiton financim, nga institucioni publik i arsimit të lartë ku ka përfunduar studimet tek institucioni apo subjekti juridik ku punësohet, deri në shlyerjen e detyrimeve, sipas marrëveshjes së parashikuar në këtë vendim.

4. Studenti përfitues, me qëllim vijimin e financimit, duhet të ruajë notë mesatare, jo më pak se 9.5 gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve të ciklit të parë dhe të dytë ose gjatë ndjekjes së studimeve të integruara të ciklit të dytë në institucionin publik të arsimit të lartë dhe notë mesatare, jo më pak se 8.5 në programin e studimit, që përbën prioritet kombëtar në institucionin publik të arsimit të lartë.

5. Studenti përfitues ka detyrimin për të kthyer masën e financimit të përfituar, në rast se:

a) përjashtohet nga institucioni publik i arsimit të lartë;

b) ndërpret studimet, për të cilat është mbështetur financiarisht, pa miratimin e institucionit publik të arsimit të lartë dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin;

c) nuk ka përfunduar studimet në ciklin përkatës brenda 1 (një) viti, pas përfundimit të kohëzgjatjes normale të studimeve, me përjashtim të rasteve të sëmundjeve, të rasteve të fatkeqësive familjare apo kur parashikohet nga institucioni i arsimit të lartë, sipas përcaktimeve në marrëveshjen përkatëse të financimit.

6. Përzgjedhja e kandidatëve kryhet para fillimit të vitit akademik, mbi bazën e renditjes, sipas notës mesatare dhe fondit në dispozicion për vitin përkatës financiar. Në rast të dhënies së donacioneve për këtë financim, në procedurën përzgjedhëse ka të drejtë të marrë pjesë edhe një përfaqësues i donatorit. Rregullat e hollësishme për afatet e aplikimit, shqyrtimit dhe procedurat për përcaktimin e masës dhe të mënyrës së financimit, për secilën nga kategoritë e parashikuara në këtë vendim, përcaktohen nga ministri përgjegjës për arsimin, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

7. Studentët përfitues, sipas këtij vendimi, depozitojnë në ministrinë përgjegjëse për arsimin listën e notave dhe vërtetimin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve për vitin e parë dhe vijues të studimeve.

8. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas diplomimit deri në përmbushjen e detyrimit për punësim, përfituesit duhet të aplikojnë për çdo pozicion të lirë pune në institucionet e administratës buxhetore shtetërore dhe institucionet e pavarura publike. Në institucionet, në të cilat marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, rekrutimi në pozicionet përkatëse i përfituesve kryhet me prioritet. Përfituesit, sipas këtij vendimi, punësohen nga Departamenti i Administratës Publike, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, për gjithë kohëzgjatjen e detyrimit për punësim. Në rast mospunësimi deri në 6 (gjashtë) vite kalendarike nga dita e lindjes të së drejtës për punësim, studenti konsiderohet se i ka përmbushur detyrimet sipas këtij vendimi dhe ka të drejtën e tërheqjes së diplomës origjinale nga institucioni publik i arsimit të lartë ku ka përfunduar studimet e financuara, sipas këtij vendimi.

9. Studentët, të cilët kanë përfituar financim dhe nuk kanë realizuar detyrimet e programit përkatës dhe/ose i ndërpresin ato, sipas kushteve të përcaktuara në këtë vendim dhe në aktmarrëveshjen e lidhur ndërmjet përfituesit dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin, duhet t'i kthejnë ministrisë përgjegjëse për arsimin shumën e përfituar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga dita e njoftimit nga ministria. Në rast të moskthimit të shumës apo refuzimit nga ana e përfituesit brenda këtij afati, ndiqen procedurat ligjore për zgjidhjen e çështjes, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Studentët përfitues, të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, përjashtohen nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit dhe financohen në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi, për çdo muaj, përgjatë kohëzgjatjes së vitit akademik, pas konfirmimit të frekuentimit të programit përkatës të studimit nga institucioni publik i arsimit të lartë.

11. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

SHTOJCA NR. 1

Fushat e gjera të studimit	**Fushat e detajuara të studimit**	**Programi i studimit**
Arte dhe humanitaret	Gjuhë dhe letërsi	Gjuhë shqipe dhe letërsi
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	Biologji	Biologji
		Biologji-kimi
	Shkencat e mjedisit	Studime mjedisore
		Shkenca mjedisore
	Kimi	Kimi
	Fizikë	Fizikë
	Matematikë	Matematikë
		Matematikë-fizikë
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	Teknologjia e mbrojtjes së mjedisit	Inxhinieri mjedisi
	Mjete motorike, anije dhe avionë	Inxhinieri navale
		Navigacion dhe menaxhim detar
	Miniera dhe industri nxjerrëse	Inxhinieri e burimeve minerare
		Inxhinieri e naftës dhe e gazit
		Inxhinieri gjeoinformatike
		Inxhinieri gjeologjike
		Inxhinieri gjeomjedis
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari	Kultivim dhe prodhim	Inxhinieri agrare profil mbrojtje bimësh
		Inxhinieri agrare profil hortikulture
		Inxhinieri agrare profil agronomi
		Inxhinieri agrare profil agromekanizëm
		Zootekni dhe siguria e produkteve blegtorale
		Biologji marine dhe akuakulturë
		Bioteknologji zooveterinare
		Agrobiologji
		Agrobiznes
		Agroushqim
		Vreshtari enologji
		Inxhinieri agronomike
	Pyje	Inxhinieri pyjore
		Inxhinieri përpunim druri

	Veterinari	Mjekësi veterinare
		Menaxhim turizmi (rural, arkeologjik, kulturor, hoteleri-restorant, mikpritje)
		Ekonomi-turizëm
Shërbime	Turizëm	Turizëm

VENDIM
Nr. 431, datë 22.6.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 75, DATË 12.2.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E MODELIT TË FINANCIMIT TË BUXHETIT PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 110, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 75, datë 12.2.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja "c", e pikës 2, të kreut III, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"c) Koeficienti i prioriteteve ose financimi shtesë, në masën 50% për studentët që ndjekin studimet në programe prioritare, në masën 30% për studentët që ndjekin programe studimi të përbashkëta, sipas marrëveshjeve të nënshkruara me IAL-të e shteteve të tjera, në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit të studimeve, dhe në masën 10% për studentët që ndjekin programe studimi me karakter profesional;".

b) Pas pikës 2, të kreut V, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

"2.1 Fondet e miratuara për financimin e programeve të përbashkëta të studimit në institucionet publike të arsimit të lartë, sipas marrëveshjeve të nënshkruara, në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit me institucionet e arsimit të lartë të shteteve të tjera, do të shpërndahen në bazë të kërkesave specifike që do të paraqesin IAL-të publike.

Institucionet publike të arsimit të lartë kërkojnë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin për përfitimin e financimit nga fondet grant për ndërkombëtarizimin, sipas thirrjes së shpallur nga ministria përgjegjëse për arsimin.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIMI
Nr. 644, datë 5.10.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E NJOHJES SË NDËRSJELLË TË DIPLOMAVE DHE GRADAVE SHKENCORE, TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONET E TJERA TË AUTORIZUARA NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e njohjes së ndërsjellë të diplomave dhe gradave shkencore, të lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të autorizuara në Ballkanin Perëndimor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE
PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E NJOHJES SË NDËRSJELLË TË DIPLOMAVE DHE GRADAVE SHKENCORE, TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONET E TJERA TË AUTORIZUARA NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Ne, pjesëmarrësit e Ballkanit Perëndimor, të referuar bashkërisht si "Palët Kontraktuese" dhe individualisht si "Pala Kontraktuese",

Të nxitur nga dëshira dhe nevoja për të promovuar bashkëpunimin produktiv në fushën e përbashkët të njohjes së ndërsjellë të diplomave dhe të gradave shkencore të lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të autorizuara;

Duke respektuar legjislacionin e brendshëm në fuqi ndërmjet Palëve Kontraktuese, si dhe parimet dhe standardet ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve të përcaktuara në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare;

Duke marrë parasysh vlerat dhe interesat e ngjashëm, si dhe nevojën për bashkëpunim në fushën e njohjes së ndërsjellë të diplomave, bazuar në barazinë dhe përfitimin e ndërsjellë;

Duke ftuar pjesëmarrësit e tjerë të Ballkanit Perëndimor që t'i bashkohen kësaj marrëveshjeje në frymën e gjithëpërfshirjes dhe të bashkëpunimit rajonal, me synimin për të nxitur bashkëpunimin produktiv në fushën e njohjes së ndërsjellë të diplomave dhe certifikatave brenda rajonit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi dhe përkufizimet

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të lehtësojë bashkëpunimin institucional në fushën e njohjes së diplomave dhe gradave shkencore të arsimit të lartë, të fituara në Palët Kontraktuese, ndërmjet zyrave ENIC/NARIC, me qëllim lehtësimin e procedurave të njohjes.

Termi "diplomë" nënkupton dokumentin përfundimtar të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, sipas legjislacionit në fuqi të çdo Pale Kontraktuese, i cili vërteton përfundimin me sukses të një programi studimi ose arritjen e një kualifikimi që i përket nivelit 5, kur është i zbatueshëm në një prej Palëve Kontraktuese dhe nivelet 6 deri në 8 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, pavarësisht nga emri i dokumentit.

Termi "diplomë shkencore" nënkupton kualifikimin "Doktor", i cili vërteton përfundimin me sukses të një programi studimi ose arritjen e një kualifikimi, që i përket nivelit 8, sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.

Neni 2
Institucionet përgjegjëse

Institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë për njohjen e diplomave të fituara jashtë vendit (përveç gradës shkencore "Doktor") është Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë. Institucioni përgjegjës për njohjen në Republikën e Shqipërisë të gradës shkencore "Doktor", të fituar jashtë vendit, është Ministria e Arsimit dhe Sportit. Sekretaria Teknike për këtë shërbim ndodhet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Institucioni përgjegjës për njohjen në Republikën e Serbisë është Agjencia e Kualifikimeve (Qendra ENIC/NARIC) për njohje profesionale (me qëllim punësimin) dhe institucionet e arsimit të lartë të akredituara në Republikën e Serbisë për njohjen akademike (me qëllim vazhdimin e studimeve).

Institucioni përgjegjës për njohjen në Republikën e Maqedonisë së Veriut është Ministria e Arsimit dhe Shkencës-Njësia për Njohjen e Kualifikimit të Diplomës së Huaj.

Neni 3
Metodat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi institucional, në fushën e njohjes së ndërsjellë të diplomave dhe të gradave shkencore të lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë, do të realizohet nëpërmjet:

a) Bashkëpunimit për lehtësimin e njohjes së diplomave dhe gradave shkencore të arsimit të lartë, të fituara në Palët Kontraktuese;

b) Shkurtimit të afateve të ndërsjella për procedurat e njohjes së diplomave dhe të gradave shkencore të arsimit të lartë, të fituara në Palët Kontraktuese.

Neni 4
Lehtësimi i procedurave dhe i afateve

a) Për diplomat e lëshuara nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë, të pajisura me vulë Apostile, institucionet përgjegjëse të procedojnë drejtpërdrejt me njohjen, pa pasur nevojë për verifikimin me *e-mail* të autenticitetit së diplomës. Përjashtimisht, në rastet kur ka dyshime të arsyeshme për autenticitetin e dokumentacionit, secila Palë Kontraktuese rezervon të drejtën të kërkojë konfirmim në rrugë elektronike nga Pala tjetër Kontraktuese.

b) Afati për konfirmimin e autenticitetit të diplomës është deri në 14 ditë pune pas paraqitjes së kërkesës nga Pala tjetër.

c) Afati i përfundimit të procesit të njohjes së diplomës është deri në 20 ditë pune, pas konfirmimit të autenticitetit të diplomës ose paraqitjes së saj me vulën Apostile.

Neni 5
Zbatimi i Marrëveshjes

Bashkëpunimi i parashikuar në këtë Marrëveshje do të zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi te Palët Kontraktuese, si dhe në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare për njohjen e kualifikimeve të përcaktuara në instrumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, pjesë e të cilave janë Palët Kontraktuese.

Neni 6
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet negociatave.

Neni 7
Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare

Republika e Maqedonisë së Veriut do të veprojë si Depozitar i kësaj Marrëveshjeje.

Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e njoftimit të fundit me të cilin Palët Kontraktuese informojnë Depozitarin, se procedurat e tyre të brendshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes janë përmbushur.

Marrëveshja mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të të gjitha Palëve Kontraktuese.

Marrëveshja do të mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar.

Çdo Palë Kontraktuese mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje, duke e njoftuar Depozitarin, me shkrim, për qëllimin e saj për t'u tërhequr. Në këtë rast, Marrëveshja do të pushojë së qeni në fuqi për atë Palë Kontraktuese në ditën e 30 (të tridhjetë) pas datës së marrjes së njoftimit nga Depozitari.

Origjinali i kësaj Marrëveshjeje në një kopje të vetme në gjuhën angleze dhe do të depozitohet te Depozitari, i cili do t'i transmetojë një kopje të vërtetuar secilës Palë Kontraktuese.

Nënshkruar në Ohër, më 8 qershor 2022.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë
Për Qeverinë e Republikës së Serbisë
Për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut

VENDIM
Nr. 741, datë 23.11.2022

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE TË DOKUMENTACIONIT PËR KRIJIMIN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PUBLIK TË PAVARUR (IALPP)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 120, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet e arsimit të lartë (në vijim "IAL"), të cilat plotësojnë kriteret ligjore për t'u transformuar në institucione publike të pavarura të arsimit të lartë (në vijim "IALPP"), paraqesin kërkesën për

transformim, ndërsa institucionet publike dhe subjektet e së drejtës private, në cilësinë e themeluesve, paraqesin kërkesën për krijimin e IALPP-së, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Themeluesi/t paraprakisht, për secilën kategori të IAL-ve, fillojnë procedurat e transformimit në IALPP, si më poshtë vijon:

a) vlerëson me ekspertë të licencuar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, ku do të zhvillojë veprimtarinë IALPP-ja dhe i kontabilizon me vlerën e tregut;

b) themelon fondacionin, sipas kuadrit ligjor në fuqi për organizatat jofitimprurëse, Kodit Civil dhe ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";

c) përgatit dokumentacionin e nevojshëm të fondacionit të themeluar, sipas përcaktimeve të këtij vendimi për krijimin apo transformimin e IAL-së në IALPP dhe e paraqet në ministrinë përgjegjëse për arsimin, e cila pas vlerësimit teknik dhe ligjor të kërkesës, propozon në Këshillin e Ministrave krijimin e IALPP-së së propozuar;

ç) ndjek nëpërmjet portalit "*e-Albania*" procedurat e nevojshme dhe paraqet dokumentacionin, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

3. Institucionet publike dhe subjektet e së drejtës private, në cilësinë e themeluesve, paraqesin për krijimin e IALPP-së dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) kërkesën për themelimin e IALPP-së, e cila duhet të përmbajë emrin dhe objektivat afatgjatë të veprimtarisë arsimore, kërkimore dhe zhvilluese të institucionit;

b) aktin e krijimit dhe statutin e fondacionit, shoqëruar me vendimin e gjykatës kompetente;

c) vendimin e Bordit të Fondacionit për themelimin e IALPP-së;

ç) të dhënat për burimet financiare dhe gjendjen financiare, e cila duhet të garantojë zhvillimin e veprimtarisë së IAL-së, për të paktën 3 (tre) vjet akademikë;

d) planin e zhvillimit të IAL-së për 5 (pesë) vjetët e ardhshëm;

dh) raportin e auditimit financiar nga auditues të jashtëm, referuar nenit 116, të ligjit nr. 80/2015;

e) raportin e vlerësimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme në administrim, pronësi apo posedim;

ë) organizimin akademik dhe administrativ të IALPP-së, si dhe dokumentacionin ligjor për personelin akademik dhe administrativ, sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi;

f) organizimin e programeve të studimit, planeve mësimore, programeve të lëndëve/ moduleve të nënshkruara nga titullari i lëndës, jetëshkrimit të titullarit të lëndës, niveleve dhe emërtimeve të diplomave;

g) strukturën e IAL-së (organigrama);

gj) projektstatutin e IALPP-së;

h) kontratat e punës për personelin akademik të punësuar dhe kriteret e punësimit për çdo vend pune në IAL;

i) deklaratën për plotësimin e standardeve akademike;

j) relacionin për infrastrukturën nga inxhinier i licencuar dhe relacionin për laboratorët e bibliotekat, bazuar në standardet shtetërore;

k) numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS) për regjistrimin si person juridik, me aktivitet në fushën e arsimit.

4. IAL-të, që kërkojnë të transformohen në IALPP, kryejnë procedurat paraprake, si më poshtë vijon:

a) administratori i IAL-së, së bashku me auditues të jashtëm, referuar nenit 116, të ligjit nr. 80/2015, bëjnë paraprakisht vlerësimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, duke i kontabilizuar me vlerën e tregut. Shpenzimet për audituesin përballohen nga vetë IAL-ja;

b) administratori i IAL-së, bazuar në pasqyrat financiare të 3 (tri) viteve të fundit, harton raportin e ecurisë financiare të institucionit, ku identifikon masën e financimit nga të ardhurat e IAL-së, e cila duhet të garantojë zhvillimin e veprimtarisë së IAL-së për të paktën 3 (tri) vite akademike;

c) administratori harton planin e zhvillimit të IAL-së për 5 (pesë) vitet e ardhshme;

ç) administratori i IAL-së paraqet për mendim në senatin akademik dokumentacionin për plotësimin e kritereve të mësipërme dhe gjendjes financiare, si dhe propozimin për transformim të IAL-së në IALPP;

d) në rast se mendimi i Senatit Akademik është pozitiv, atëherë Senati Akademik ia paraqet për vendimmarrje Bordit të Administrimit;

dh) Bordi i Administrimit shprehet brenda 1 (një) muaji për propozimin e administratorit. Vendimi i Bordit të Administrimit për transformim duhet të merret me tre të katërtat e votave të anëtarëve të tij;

e) në rast të një vendimi pozitiv për transformim nga Bordi i Administrimit, dokumentacioni dhe vendimi i paraqitet ministrit përgjegjës për arsimin;

ë) fondacioni i themeluar, sipas kuadrit ligjor në fuqi për organizatat jofitimprurëse, Kodit Civil dhe ligjit nr. 80/2015, përgatit dokumentacionin e nevojshëm për ngritjen e IALPP-së dhe e paraqet në ministrinë përgjegjëse për arsimin, e cila pas vlerësimit të dokumentacionit, sipas këtij vendimi dhe kritereve ligjore të përcaktuara në nenin 119, të ligjit nr. 80/2015, propozon në Këshillin e Ministrave krijimin e IALPP-së.

5. IAL-të, që kërkojnë të transformohen në IALPP, paraqesin dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) kërkesën për transformimin e IALPP-së, e cila duhet të përmbajë emrin dhe objektivat afatgjatë të veprimtarisë arsimore, kërkimore dhe zhvilluese të institucionit;

b) aktin e krijimit dhe statutin e fondacionit, shoqëruar me vendimin e gjykatës kompetente;

c) aktin e hapjes së IAL-së, aktin e akreditimit institucional dhe të të gjitha programeve të studimit;

ç) vendimin e Bordit të Fondacionit për themelimin e IALPP-së;

d) të dhënat për burimet financiare dhe gjendjen financiare, e cila duhet të garantojë zhvillimin e veprimtarisë së IAL-së, për të paktën 3 (tre) vjet akademikë;

dh) planin e zhvillimit të IAL-së për 5 (pesë) vjetët e ardhshëm;

e) raportin e auditimit financiar nga audituesë të jashtëm, referuar nenit 116, të ligjit nr. 80/2015;

ë) raportin e vlerësimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme në administrim, pronësi apo posedim;

f) organizimin akademik dhe administrativ të IALPP-së, si dhe dokumentacionin ligjor për personelin akademik dhe administrativ, sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi;

g) organizimin e programeve të studimit, planeve mësimore, programeve të lëndëve/ moduleve të nënshkruara nga titullari i lëndës, jetëshkrimit të titullarit të lëndës, niveleve dhe emërtimeve të diplomave;

gj) strukturën e IAL-së (organigrama);

h) projektstatutin e IALPP-së;

i) kontratat e punës për personelin akademik të punësuar, të paktën për 1 (një) vit akademik dhe kriteret e punësimit për çdo vend pune në IAL;

j) deklaratën për plotësimin e standardeve akademike;

k) relacionin për infrastrukturën nga inxhinier i licencuar dhe relacionin për laboratorët e bibliotekat, bazuar në standardet shtetërore;

l) numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS) për regjistrimin si person juridik, me aktivitet në fushën e arsimit;

ll) pasqyrat financiare për 3 (tre) vjetët e fundit;

m) deklaratën analitike për tatimin mbi të ardhurat dhe deklaratat e tatimit mbi të ardhurat nga burime të tjera, për 3 (tre) vjetët e fundit, sipas kuadrit ligjor përkatës në fuqi;

n) vërtetimet që themeluesit nuk janë palë të paditura në procese gjyqësore, që kanë të bëjnë me çështje thelbësore, të cilat lidhen me veprimtarinë e IALPP-së.

6. IAL-të jopublike, që kërkojnë të transformohen në IALPP, së bashku me dokumentet e përcaktuara në pikën 5, paraqesin edhe dokumentet, si më poshtë vijon:

a) dokumentin zyrtar të akreditimit për institucionet private, që zotërojnë një formë akreditimi në një shtet tjetër;

b) dokumentin zyrtar të bashkëpunimit, si dhe dokumentin zyrtar të akreditimit të institucionit bashkëpunues, nëse ka, në rast se institucioni parashikon të ofrojë programe studimi të përbashkëta me IAL-të e tjera, vendase apo të huaja;

c) kontratën tip që studenti lidh me IALPP-në, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;

ç) vërtetimet që themeluesit nuk janë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) vërtetimin nga gjykata që IAL-ja ekzistuese nuk është në procedura falimentimi;

dh) vërtetimin nga prokuroria që personi juridik dhe (ose) përfaqësuesi i tij nuk janë në ndjekje penale.

7. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për krijimin e IALPP-së apo transformimin e IAL-së në IALPP është, si më poshtë vijon:

a) dokumentacioni shqyrtohet, sipas rregullave të brendshme të ministrisë përgjegjëse për arsimin brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e depozitimit të tij në portalin "*e-Albania*". Në rast se konstatohen mangësi në dokumentacion, ministria përgjegjëse për arsimin i kërkon subjektit plotësimin e tyre, brenda afatit kohor prej 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit. Në rast se dokumentacioni nuk plotësohet brenda këtij afati, konsiderohet që subjekti ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

b) kur dokumentacioni është i plotë, sipas kërkesave të këtij vendimi, vijon procedura me vlerësimin e plotësimit të standardeve nga ekspertë të jashtëm, nga lista e miratuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, të cilët caktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin. Numri i ekspertëve për vlerësimin paraprak institucional, tarifat që paguhen nga IAL-të, si dhe masa e pagesës së ekspertëve përcaktohen në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar;

c) ekspertët brenda 21 (njëzet e një) ditëve dorëzojnë raportin e vlerësimit në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga ekspertët, ministria përgjegjëse për arsimin njofton subjektin, i cili bën plotësimet e nevojshme brenda 21 (njëzet e një) ditëve nga marrja e njoftimit;

ç) nëse pas njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet nga subjekti brenda këtij afati, prezumohet që subjekti ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

d) dokumentacioni me plotësime i depozituar nga subjekti i përcillet ekspertëve, të cilët brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve dorëzojnë raportin e rivlerësuar. Nëse vlerësimi dhe vendimi përfundimtar është pozitiv, ministri i propozon Këshillit të Ministrave hapjen e institucionit të arsimit të lartë.

8. IAL-të publike, të cilat transformohen në IALPP, sipas përcaktimeve në këtë vendim, kthejnë në buxhetin e shtetit të gjitha fondet buxhetore të përfituara dhe të pashpenzuara deri në atë moment.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËZIME TË MINISTRIT PËRGJEGJËS PËR ARSIMIN

2015

UDHËZIM

Nr. 27, datë 19.08.2015

"PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË RAUNDIN E PARË DHE TË DYTË TË KANDIDATËVE FITUES NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE JOUNIVERSITARE PROFESIONALE, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015 – 2016"

Në mbështetje, të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26, 33, 35, 36 dhe 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 - 2016", vendimit nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", të ndryshuar, vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)", të vendimit nr. 241, datë 31.3.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për kryerjen, nga "Posta Shqiptare" sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike",

UDHËZOJ:

I. Raundi i parë (aplikimi me formularin A2)

1. Pranimi i kandidatëve në ciklin e parë të studimeve në programet e studimeve jouniversitare, profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë (IAL), në vitin akademik 2015-2016, të bëhet sipas listave emërore të renditura nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP).

2. Kandidatët fitues përcaktohen nga AKP në bazë të dy parimeve:

a) "Parimi i Meritës" përcaktohet sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të Maturës Shtetërore (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore), dhe, për disa programe studimi, edhe të rezultateve të konkursit të zhvilluar në bazë të udhëzimit nr. 24, datë 31.7.2015, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për zhvillimin e konkurseve të pranimit dhe tarifën e regjistrimit për konkurrim, në disa programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015- 2016".

“Parimi i Preferencës” përcaktohet nga vullneti i kandidatëve, i shprehur përmes preferencës më të lartë të grupit të preferencave fituese, ndër jo më shumë se 10 preferencave të përzgjedhura nga ata vetë në formularin A2.

3. Pas përfundimit të konkurseve në të gjitha IAL-të që ofrojnë programe studimi për të cilat është parashikuar të zhvillohet konkurs për pranimin e kandidatëve, rezultatet e tyre në formë shkresore dhe elektronike të dorëzohen, nga këto të fundit, në AKP brenda orës 14.00 të datës 31 gusht 2015. Deri më datë 29 gusht 2015 personat përgjegjës të ngarkuar nga dekanët e fakulteteve që kanë programe studimi me konkurs, hedhin në sistemin informatik rezultatet e konkurseve duke përdorur për logimin në sistem kredencialet (username dhe passëord) të dërguara më parë nga AKP.

4. AKP brenda orës 11.00 të datës 3 shtator 2015 të dërgojë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) listat paraprake të kandidatëve fitues, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe të preferencës më të lartë fituese të kërkuar prej tyre në formularin A2, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara me vendimin nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 - 2016”.

5. Listat paraprake të kandidatëve fitues shpallen në faqen zyrtare elektronike të MAS dhe AKP. AKP-ja ia dërgon listat në format elektronik me postë elektronike njësive arsimore vendore (drejtorive arsimore rajonale/zyrave arsimore (DAR/ZA), brenda datës 3 shtator 2015. DAR/ZA-të printojnë dhe afishojnë listat në vende të dukshme në mjediset e shkollave të mesme që kanë në varësi brenda datës 4 shtator 2015.

6. IAL-të publike tërheqin listat, në formë të shkruar dhe elektronike, në AKP nga ora 11.00 deri në orën 13.00 të datës 4 shtator 2015. Rektoratet dhe dekanatet, brenda datës 4 shtator 2015, të shpallin në mënyrë të qartë dhe në vende të dukshme, në mjediset e fakulteteve përkatëse listat paraprake të fituesve, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit on-line nga sekretaritë mësimore, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve plotësues si dhe njoftime t ë tjera të nevojshme. Këto njoftime të publikohen edhe në median e shkruar dhe elektronike nga IAL-të publike.

7. Për organizimin dhe realizimin e procesit të pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë ngarkohen AKP dhe sekretaritë mësimore të IAL-ve publike. Ky proces do të jetë nën monitorimin e AKP-së dhe të MAS.

8. Kandidatët fitues në listat paraprake, kanë të drejtë të bëjnë dy zgjedhje në momentin e regjistrimit on-line:

a) të konfirmojnë dhe kryejnë regjistrimin përfundimtar në preferencën e fituar në listat paraprake të shpallura, duke ndërprerë konkurrimin;

b) të vazhdojnë konkurrimin për të fituar një preferencë më të lartë duke bërë zgjedhjen përkatëse gjatë procedurave të regjistrimit on-line. Këta kandidatë, së bashku me kandidatët që nuk janë shpallur fitues në listat paraprake, konkurrojnë për vendet e mbetura bosh të kandidatëve fitues të cilët nuk kanë kryer regjistrimin on-line.

9. Kandidati fitues në listat paraprake, për t'u regjistruar dhe ndjekur më pas studimet në programin përkatës të studimit në IAL, ndjek procedurat e parashikuara në dy etapat e mëposhtme:

- Procedurat e regjistrimit on-line (vetëm për fituesit në listat paraprake);

- Procedurat e regjistrimit me dokumentacion pranë sekretarive të IAL-ve publike ku janë shpallur fitues me listën përfundimtare (për të gjithë kandidatët e shpallur fitues në listën përfundimtare). Vetëm pas përfundimit të kësaj procedure brenda afateve të parashikuara në këtë udhëzim, kandidati do të rezultojë i regjistruar në programin e studimit ku ishte shpallur fitues në listat paraprake.

10. Procedurat e regjistrimit on-line

10.1 Kandidati i shpallur fitues ndjek procedurën e regjistrimit on-line në programin e studimit që ka fituar, në portalin e Maturës Shtetërore, sipas procedurës së mëposhtme:

Regjistrimi on-line kryhet në cilindo kompjuter që ka akses interneti (sipas procedurave të përshkruara në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi), nga data 4 shtator 2015 deri në orën 24:00 të datës 9 shtator 2015, për të bërë zgjedhjen sipas germës "a" dhe "b" të pikës 8 të këtij udhëzimi.

10.2 Kur kandidati nuk arrin të realizojë procedurën e regjistrimit on-line sipas pikës 10.1 të këtij udhëzimi, ai duhet të paraqitet pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është shpallur fitues, e cila do të kryejë procedurën e regjistrimit on-line të kandidatit.

a) Regjistrimi on-line pranë sekretarive mësimore bëhet sipas procedurave të përshkruara në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, nga data 4 shtator 2015 deri më datë 9 shtator 2015, nga ora 08:00, deri në orën 18:00.

b) Kandidati që paraqitet për të kryer regjistrimin on-line pranë sekretarisë mësimore, duhet të paraqesë vetëm një dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosjen e sekretarisë mësimore mbahet fotokopja e dokumentit të identifikimit.

c) Gjatë kryerjes së procedurës së regjistrimit on-line, sekretaritë mësimore të fakulteteve duhet të mbajnë detyrimisht një regjistër të veçantë, në të cilin kandidati fitues dhe sekretarja nënshkruajnë në momentin e regjistrimit duke shënuar datën dhe orën e regjistrimit.

d) Studentët, të cilët procedojnë sipas germës "a" të pikës 8 të këtij udhëzimi, nënshkruajnë një deklaratë në sekretarinë mësimore, sipas modelit në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Sekretaria mësimore pajis menjëherë kandidatët me fletëregjistrimin në preferencën e përzgjedhur, ku shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si edhe data dhe ora e regjistrimit. Fleta e regjistrimit e vulosur duhet të jetë e nënshkruar nga dekani dhe kryesekretarja mësimore e fakultetit.

e) Kandidati fitues firmos së bashku me sekretaren në listën e konfirmimit të regjistrimeve të kandidatëve fitues të listës paraprake. Në përfundim, çdo fletë firmoset dhe vuloset nga dekani. Në fletët e regjistrimit dhe në regjistrat e konfirmimit duhet të paraqiten data dhe ora e regjistrimit.

f) Kopje të deklaratave të kandidatëve fitues, si dhe lista origjinale e fituesve të regjistruar pranë sekretarive mësimore, të parashikuara përkatësisht në germat "d" dhe "e" të pikës 10.2 të këtij

udhëzimi, dërgohen nga IAL-të në AKP, brenda orës 14:00, të datës 10 shtator 2015, në formë shkresore dhe elektronike, sipas formatit të përgatitur nga AKP.

10.3 Kandidatët, të cilët nuk kryejnë regjistrimin paraprak (on-line, ose në sekretaritë mësimore) brenda datave të përcaktuara në këtë udhëzim, për çfarëdolloj arsyeje, humbasin të drejtën e regjistrimit dhe të vazhdimit të procesit. Këta kandidatë nuk do të përfshihen në listën përfundimtare të fituesve.

11. AKP shpall, brenda datës 14 shtator 2015, listën përfundimtare të kandidatëve fitues. Lista shpallet edhe në faqen zyrtare elektronike të MAS dhe AKP. IAL-të publike tërheqin listat, në formë të shkruar dhe elektronike, në AKP nga ora 12.00 deri në orën 14.00 të datës 14 shtator 2015. IAL-të dhe DAR/ZA-të shpallin në vende të dukshme listat përfundimtare brenda datës 14 shtator 2015.

12. Procedurat e regjistrimit me dokumen-tacion pranë sekretarive të IAL-ve publike ku janë shpallur fitues të jenë si më poshtë:

12.1 Sekretaritë mësimore të fakulteteve nga data 15 shtator 2015 deri më 19 shtator 2015, të pranojnë dokumentacionin plotësues për të gjithë kandidatet fitues. Kandidatët dorëzojnë personalisht dokumentacionin plotësues të mëposhtëm:

a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e një prej dokumenteve të identifikimit, (e panoterizuar);

b) 2 fotografi personale;

c) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1.600 lekë, paguar pranë zyrave të Postës Shqiptare apo bankave të nivelit të dytë, për llogari të IAL-së përkatëse;

d) Deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 4, e cila plotësohet dhe firmoset nga kandidati në prani të punonjëses së sekretarisë mësimore dhe kundërfirmoset nga kjo e fundit.

12.2 Gjatë kryerjes së procedurës së dorëzimit të dokumentacionit plotësues, sekretaritë mësimore të fakulteteve mbajnë regjistër të veçantë me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve fitues dhe të sekretarisë mësimore. Sekretaritë mësimore kryejnë regjistrimin on-line të kandidatëve që kanë dorëzuar dokumentacionin plotësues, brenda orës 19.00 të datës 19.9.2015.

13. Institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në AKP në formë shkresore dhe elektronike brenda orës 10.00 të datës 21 shtator 2015 listat përfundimtare të studentëve të regjistruar, për çdo program studimi, të ciklit të parë me kohë të plotë, sipas udhëzimit nr. 45, datë 19. 12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit" të ndryshuar, në formë shkresore dhe elektronike, si dhe deklaratën sipas germës "d" të pikës 12.1 të këtij udhëzimi.

II. Raundi i dytë (aplikimi me formularin A3)

14. Regjistrimin në institucionet publike të arsimit të lartë (IPAL), në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jouniversitare, profesionale dhe në programet e integruara

të studimeve të ciklit të dytë për vitin akademik 2015-2016, sipas programeve përkatëse të studimit, maturantët/ kandidatët që shpallen fitues nga rishpërndarja e kuotave të parealizuara, pas përfundimit të raundit të parë.

15. Maturantët/kandidatët do të aplikojnë on-line vetëm për programet e studimit dhe kuotat e shpallura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në formularin A3 prej datës 24.9.2015, ora 09:00 deri 28.9.2015 ora 24:00. Maturantët/kandidatët që nuk kanë plotësuar formularin A2, përpara se të bëjnë përzgjedhjen e preferencave me anën e formularit A3, duhet të bëjnë pagesën prej 1.600 lekësh në një nga zyrat e Postës Shqiptare apo bankave të nivelit të dytë (formulari për arkëtim gjendet në faqen zyrtare të AKP) dhe me mandat pagesën e kryer duhet të paraqiten në shkollën ku kanë kryer aplikimin me formularin A1Z për të hedhur në sistemin informatik (portalin e Maturës Shtetërore) notën mesatare. Në rast të moskryerjes së procedurës së sipërcituar, për hedhjen e notës mesatare, sistemi informatik i Maturës Shtetërore nuk lejon aplikimin e kandidatëve me formularin A3.

Aplikimi on-line kryhet sipas procedurave të parashikuara në përcaktimet teknike të AKP-së që do të publikohen në faqet elektronike zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS): ëëë.arsimi.gov.al dhe Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP-së): ëëë.akp.gov.al .

16. Klasifikimi i kandidatëve fitues në programe të ndryshme studimi, të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë në raundin e dytë (formulari A3), bëhet në mënyrë të informatizuar, duke u mbështetur në pikët e grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të Maturës Shtetërore, ndërsa për programet e veçanta të studimit të parashikuara me konkurs edhe të rezultateve të konkursit të zhvilluar (për programe të caktuara studimi) (merita), si dhe të përzgjedhjes së programeve të studimit (preferenca), të bërë nga vetë kandidati/ja.

17. Kanë të drejtë të konkurrojnë në raundin e dytë të pranimeve:

17.1. Maturantët/kandidatë që nuk kanë konkurruar më parë me formularin A2, por që në këtë raund do të konkurrojnë për herë të parë me formularin A3. Në këtë grup përfshihen kandidatët që:

a) kanë rezultuar kalues në provimet e Maturës Shtetërore, sesioni i parë, por nuk kanë plotësuar formularin A2;

b) kanë rezultuar kalues në provimet e Maturës Shtetërore, në sesionin e vjeshtës 2015;

c) kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit dhe, mbi bazën e ekuivalentimit të rezultateve të shkollës së mesme, kanë fituar të drejtën të aplikojnë për vazhdimin e studimeve universitare të ciklit të parë në IAL-të publike në Republikën e Shqipërisë. Nga kandidatët e kategorive të sipërcituara, mund të aplikojnë në këtë raund, vetëm kandidatët që kanë plotësuar formularin A1Z në sesionin e dytë të Maturës Shtetërore 2015.

17.2 Maturantët /kandidatët që kanë konkurruar në raundin e parë me formularin A2 (fitues ose jo dhe të regjistruar ose jo) dhe dëshirojnë të vazhdojnë garën për të qenë fitues ose për të kaluar në një preferencë më të lartë, duke ruajtur renditjen e preferencave të formularit A2 të plotësuar në raundin e parë, nuk plotësojnë formular të ri, por vetëm shprehin vullnetin të vazhdojnë konkurrimin on-line. Nëse në përfundim, maturanti/kandidati që është shpallur fitues në raundin e parë, nuk arrin të

klasifikohet në një preferencë më të lartë, mbetet fitues në programin ku është regjistruar dhe vijon studimet e ciklit të parë.
Përjashtohen nga konkurrimi në raundin e dytë, maturantët /kandidatët:

a) fitues në preferencën e parë të shprehur në formularin A2 dhe që janë regjistruar në atë program studimi në raundin e parë të pranimeve me dokumentacion;

b) fitues që kanë konfirmuar regjistrimin përfundimtar në preferencën e shpallur në fazën e parë të A2, nëpërmjet regjistrimit on-line, dhe që janë të regjistruar me dokumentacion në atë program studimi në raundin e parë të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jouniversitare, profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

18. AKP të shpallë listën e fituesve të raundit të dytë, më datën 5.10.2015, të ndarë sipas programeve përkatëse të studimit, në përputhje me kuotat e rishpërndara nga MAS.

Lista e kandidatëve fitues (raundi i dytë) publikohet në faqet elektronike zyrtare të MAS dhe AKP më datë 5.10.2015.

19.AKP i dërgon IAL-ve publike, listat e kandidatëve fitues në formë shkresore, brenda datës 05.10.2015. Këto institucione, duke filluar nga kjo datë, t'i publikojnë listat në vende të dukshme në mjediset e fakulteteve përkatëse.

20. Sekretaritë mësimore të fakulteteve në datat 5.10.2015 deri 9.10.2015, të pranojnë dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e një prej dokumenteve;

b) 2 fotografi;

c) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1.600 lekë, paguar pranë zyrave të Postës Shqiptare ose bankave të nivelit të dytë për llogari të IALP-ve përkatëse, nga të gjithë kandidatët e shpallur fitues në këtë raund.

d) Deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 4, e cila plotësohet dhe firmoset nga kandidati në prani të punonjëses së sekretarisë mësimore dhe kundërfirmoset nga kjo e fundit.

Sekretaritë mësimore të fakulteteve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve fitues (në formatin e dërguar nga AKP) dhe konfirmojnë në portalin matura.akp.gov.al dorëzimin e dokumentacionit. Regjistri i veçantë, i firmosur dhe vulosur nga titullari i IAL-së publike/i fakultetit që kryen regjistrimin dhe nga kryesekretari mësimor, dërgohet në AKP brenda datës 14 tetor 2015, për raundin e dytë.

21. Sekretaria mësimore pajis kandidatin me fletë - regjistrimi ku shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si edhe data dhe ora e regjistrimit. Fletë-regjistrimi i vulosur duhet të jetë i nënshkruar nga dekani dhe kryesekretarja mësimore e fakultetit.

22. IAL-të publike të dorëzojnë në AKP në formë shkresore dhe elektronike brenda datës 21 tetor 2015 listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në raundin e parë dhe të dytë, për çdo program studimi, të ciklit të parë me kohë të plotë, sipas udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", të ndryshuar, në formë shkresore dhe elektronike, si dhe deklaratën sipas germës "d" të pikës 19 të këtij udhëzimi. AKP dërgon IALP-ve brenda datës 23.11.2015, numrat individualë të regjistrimit (matrikullimit) të studentëve të regjistruar.

III. Zbatimi dhe hyrja në fuqi

23. Kandidatët e shpallur fitues në programet e studimit me kohë të plotë nuk mund të regjistrohen për të ndjekur njëkohësisht studimet në dy programe studimi në IAL publike dhe/ose private.

24. IAL-të të përpilojnë një raport të hollësishëm në lidhje me regjistrimet e studentëve në afatet dhe formatet e kërkuara sipas udhëzimit nr. 9, datë 25.2.2010 "Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore". Ky raport dërgohet në MAS brenda datës 14 nëntor 2015.

25. Pranimi i kandidatëve për një program të dytë studimi dhe transferimet e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, të kryhen sipas kritereve të përcaktuara me akt të veçantë.

26. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, DAR/ZA-të, si dhe IAL-të publike, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 28, datë 19.08.2015

"PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR TRANSFERIM TË STUDIMEVE DHE PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE JOUNIVERSITARE PROFESIONALE DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, NË VITIN AKADEMIK 2015-2016"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 33, 35 dhe 36 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e

integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 - 2016”,

UDHËZOJ:

1. Kandidatët e interesuar aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi nga data 31 gusht 2015 deri në datën 11shtator 2015.

Kandidatët që konkurrojnë në programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimi, aplikojnë pranë IAL-ve respektive, deri në datën 21 gusht 2015, sipas procedurave të udhëzimit nr. 24, datë 31.7.2015.

2. Studenti që aplikon për transferim studimesh, paraqet dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve:

a) Kërkesa drejtuar IAL-së publike për programin e studimit, në të cilin do të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit);

b) Dokumenti origjinal i çregjistrimit, nga IAL nga ku transferohet (paraqitet në momentin e regjistrimit përfundimtar pas shpalljes fitues), i cili përmban:

i) Emrin, atësinë, mbiemrin;

ii) Datëlindjen: iii)

Vendlindjen; iv) Shtetësinë:

v) Numrin e matrikullimit që ka pasur në IAL - në përcjellëse; vi) Emrin e shkollës së

mesme/IAL-së së kryer përpara ndjekjes së këtij programi studimi; vii) ID e Maturës

Shtetërore/nr.Regj. të veçantë1; viii) Numrin personal të identitetit; ix) Datën e regjistrimit

në programin e studimit të ofruar nga IAL - ja;

x) Emërtimin e programit të studimit dhe fakulteti përkatës;

xi) Ciklin dhe formën e studimit; xii) Datën e ndërprerjes së

studimeve.

c) Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse;

d) Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;

e) Kopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore, së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri dhe të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore të lëshuar

1 Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme para vitit 2006

nga AKP, ose dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës se mesme dhe të vërtetuar në drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës se mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

f) Fotokopjen e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

g) Pagesën e tarifës së regjistrimit prej 3,000 lekë;

h) Dy fotografi personale.

3. Transferimi i studimeve mund të bëhet nga një program studimi i njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtit cikël edhe lloj, të ndjekur nga kandidati në IAL-të publike, ose në IAL të tjera private apo të huaja, të akredituara për programin përkatës të studimit. IAL-ja mund të përcaktojë kritere të tjera shtesë të cilat përcaktohen në statut, në rregulloret përkatëse, ose me vendim të senatit akademik.

4. IAL-të nuk mund të pranojnë aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Transferimi i studimeve do të kryhet në zbatim të procedurave dhe afateve të parashikuara në këtë udhëzim.

5. Studenti që aplikon për program të dytë studimi nuk duhet të jetë duke ndjekur një tjetër program studimi. Për të aplikuar, studenti duhet të ketë përfunduar një program studimi të të njëjtit cikël dhe lloj dhe të disponojë diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë. Studenti paraqet dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve:

a) Kërkesa drejtuar IAL-së publike për programin e studimit, në të cilin aplikon për program të dytë studimi (ose formulari i aplikimit);

b) Kopje e noterizuar e diplomës së studimeve universitare të kryera më parë, për të njëjtin nivel dhe lloj programi studimi, të shoqëruar me suplementin e diplomës;

c) Vërtetim të listës së notave dhe kr editeve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse);

d) Kopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore, së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri dhe të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Kandidati që ka përfunduar

shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore të lëshuar nga AKP, ose dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës se mesme dhe të vërtetuar në drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës se mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

e) Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

f) Pagesën e tarifës së regjistrimit prej 3,000 lekë;

g) Pagesën e tarifës për konkurrim prej 5,000 lekë për pranimin ne konkurs (vetëm për kandidatët që aplikojnë për program studimi që parashikon kryerjen e konkursit për pranim); h) Dy fotografi personale.

6. Të gjitha tarifat e regjistrimit për konkurrim në programet e ndryshme të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë të arkëtohen nëpërmjet sistemit bankar ose zyrave të postës shqiptare, për llogari të IAL-së publike përkatëse.

7. Konkurset e pranimit, për programet që i parashikojnë ato, zhvillohen konform udhëzimit përkatës. Vlerësimi i studentëve bëhet mbi bazën e rezultateve të Maturës Shtetërore (kur kjo nuk disponohet nga të gjithë kandidatët, për vlerësim përdoret mesatarja e notave të të gjitha viteve të shkollës së mesme) dhe të rezultateve të fituara nga konkursi i pranimit i organizuar nga këto institucione publike të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të parashikuara në udhëzimin nr. 24, datë 31.7.2015, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

8. Institucioni i arsimit të lartë shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës 11 shtator 2015 dhe ia përcjell ato Ministrisë së Arsimit dhe Sporti brenda kësaj date.

9. Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda orës 11.00 të datës 18 shtator 2015. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kritereve të tjera shtesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të IAL-së dhe të programit të studimit, të cilat duhet të shpallen në vende të dukshme brenda datës 31 gusht 2015 dhe t'u bëhen me dije të gjithë kandidatëve që aplikojnë në momentin e aplikimit, së bashku me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

10. Komisioni kryen renditjen e kandidatëve bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e fakultetit të IAL-së, si dhe faqet ëeb përkatëse, e plotësuar sipas tabelave nr. 1a dhe 1b të parashikuara në shtojcën nr. 1 të këtij udhëzimi, respektivisht, për kandidatët që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe për kandidatët që kanë aplikuar për program të dytë studimi, brenda datës 22 shtator 2015, si dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit e plotësuar sipas këtyre formateve, në formë shkresore dhe elektronike në format excel.

11. MAS shqyrton materialet e paraqitura dhe brenda datës 29 shtator 2015, miraton dhe shpall në faqen e saj ëeb të dhënat për kandidatët fitues si dhe renditjen e të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar.

Këto të dhëna i përcillen institucioneve të arsimit të lartë për regjistrim përfundimtar të kandidatëve brenda të së njëjtës datë.

12. Kandidatët fitues kryejnë regjistrimin e tyre përfundimtar në IAL nga data 29 shtator 2015 deri në datën 5 tetor 2015. Me datë 6 tetor 2015 IAL-ja shpall në vende të dukshme, publikon në faqen e saj ueb, si dhe ia përcjell MAS elektronikisht në adresën: linda.pustina@arsimi.gov.al dhe dhimiter.bako@arsimi.gov.al, listën emërore të kandidatëve të regjistruar. Në rast se brenda këtyre afateve nuk janë paraqitur për regjistrim kandidatët të cilët rezultojnë fitues sipas renditjes së shpallur, IAL-ja mund të pranojë për regjistrim kandidatët vijues, në listën e renditur të shpallur, si dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 3 dhe pikën 4 të urdhrit nr. 295, datë 18.8.2015 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, deri në plotësimin e kuotave përkatëse të studimit të parashikuara për atë program studimi duke njoftuar kandidatët që janë të vendosur më poshtë në listë. Nëse një nga kandidatët vijues heq dorë me shkrim nga r egjistrimi në programin përkatës, IAL-ja depoziton dokumentin dhe vijon me regjistrimin e kandidatit vijues në listë. Afati i fundit për regjistrimin e kandidatëve është data 12 tetor 2015.

13. Institucionet e arsimit të lartë i dërgojnë MAS-it dhe AKP-së brenda datës 16 tetor 2015, në rrugë postare, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguara pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit.

14. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës nr. 2 të këtij udhëzimi.

15. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

SHTOJCA NR. 1

Tabela 1a. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

nr. Emër Atësi Mbiemër Datëlindje Emërtimi IAL-ja nga Viti i Kreditet Emërtimi i Viti i Kreditet

Pikët e akorduara Statusi i 1 2 3 .... programit të studimit nga transferohet

dhe lloji

(bachelor,

PICD) transferohet studimit i ndjekur në vitin akademik 2014-2015 (ECTS) të grumbulluara nga kandidati programit të studimit nga transferohet dhe lloji

(Bachelor,

PICD) studimit ku transferohet e njohura Kriteri 1 Kriteri 2 etj Pikët totale kandidatit

fitues/jo fitues

Tabela 1b. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

nr. Emër Atësi Mbiemër Datëlindje Emërtimi i IAL-ja ku Data e Emërtimi i Viti i Kreditet Pikët e akorduara Statusi i programit të studimit të kryer më parë dhe lloji

(Bachelor, PICD) ka përfunduar programin e parë të studimit

diplomimit në programin e parë të studimit programit të studimit

ku aplikon për program të dytë dhe lloji

(Bachelor, PICD) studimit ku mund të regjistrohet kandidati e njohura Kriteri 1 Kriteri 2 .... Pikët totale kandidatit Fitues/Jo fitues 1

2

3

....

SHTOJCA NR. 2

Deklaratë

Unë i nënshkruari , lindur më

Emri, atësia, mbiemri me kartë

identiteti/pasaportë nr.

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe

regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre.

Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik në të cilin po aplikoj.

3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

4. Deklaroj se jam njohur me udhëzimin "Për kriteret dhe procedurat e pranimit dhe regjistrimit së kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në vitin akademik 2015-2016" dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit për transferim/program të dytë studimi, si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në urdhrin "Për shpërndarjen e kuotave të transferimit të studimeve, si dhe kuotat për programe të dyta studimi, në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në vitin akademik 2015-2016", për të aplikuar për transferim studimesh/program të dytë studimi.

5. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shtesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të IAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumentave të fallsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente. Emër, atësi, mbiemër Emër, mbiemër i kandidatit i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma Firma

Vendi: Data: ____ . ____.

UDHËZIM

Nr. 29, datë 21.08.2015

"PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT ME STATUSIN E TË VERBRIT, TË INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, TË JETIMIT, SI DHE ROMËT DHE BALLKANO-EGJIPTIANËT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, NË PROGRAMET E STUDIMEVE JOUNIVERSITARE PROFESIONALE, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015-2016"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 33 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 638, datë 22.7.2015 të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 - 2016", vendimit nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", të ndryshuar, vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)", si dhe vendimit nr. 241, datë 31.3.2011 të Këshillit të Ministrave "Për kryerjen nga "Posta Shqiptare" sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike",

UDHËZOJ:

1. Kandidatët me statusin e të verbrit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe romët dhe ballkano-egjiptianët, të aplikojnë drejtpërdrejt në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), nga data 24 gusht deri më 7 shtator 2015.
Për programet e studimit që parashikojnë konkurs, përveç aplikimit në MAS, kandidatët kryejnë regjistrimin për pranimin e tyre në konkurs pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL) përkatës sipas përcaktimeve në udhëzimin përkatës.

2. Aplikimi bëhet duke dorëzuar në MAS, personalisht, dokumentacionin e mëposhtëm në dy kopje: A. Për të gjithë kandidatët:

a) Formulari i aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në formular duhen radhitur pesë programe studimi ku kandidati kërkon të aplikojë, si dhe institucioni i arsimit të lartë (IAL) përkatës, në renditje prioritare, pra i pari renditet programi më i preferuar dhe i fundit ai më pak i preferuar nga të pesta programet. Për emërtimin dhe ID e programit përkatës i duhet referuar tabelës nr. 1 të vendimit nr. 638, datë 22.7.2015 të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e

studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 - 2016".

b) Letër motivimi, ku të shpjegojë arsyet e aplikimit, si dhe të zgjedhjes së programeve të studimit të përcaktuara në formular prej tij.

c) Kopje e njësuar me origjinalin e diplomës së Maturës Shtetërore, së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri dhe të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë kopje të njësuar me origjinalin e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), ose dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në njësinë arsimore vendore (drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore) përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit.

d) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë). e) Dy

fotografi personale.

B) Kandidatët me statusin e të verbrit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën A duhet të dorëzojnë dhe dokumentet e mëposhtme:

a) Kopje e njësuar me origjinalin e librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje e njësuar me origjinalin e vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

C) Kandidatët me statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën A duhet të dorëzojnë dhe dokumentet e mëposhtme:

a) Kopje e njësuar me origjinalin e librezës së invalidit paraplegjik e tetraplegjik të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje e njësuar me origjinalin e vendimit të KMCAP-së.
D) Kandidatët me statusin e jetimit, përveç dokumentacionit të parashikua r në pikën A duhet të dorëzojnë dhe dokumentet e mëposhtme:

a) Kopje e njësuar me origjinalin e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

E) Kandidatët romë dhe ballkano-egjiptianë, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën A duhet të dorëzojnë dhe dokumentet e mëposhtme:

a) Vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian.

3. IAL-të, në të cilat janë paraqitur për konkurrim kandidatë që u përkasin kategorive të sipërcituara, dërgojnë në MAS vlerësimin e kandidatëve brenda datës 29 gusht 2015.

4. Komisioni i posaçëm, i përbërë nga kryetari, përfaqësues i MAS-it dhe 4 anëtarë, nga të cilët dy përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe dy përfaqësues nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shqyrton dhe vlerëson aplikimet e kandidatëve me statusin përkatës brenda datës 15Shtator 2015. Aplikimet me dokumentacion të paplotë nuk merren në konsideratë. Vlerësimi të bëhet mbi kriterin e meritës, pikëve të Maturës Shtetërore ose notës mesatare të të gjitha viteve të shkollës së mesme, duke vlerësuar dhe programet që gjykohet të jenë prioritare dhe nevojat për secilën kategori të veçantë, si dhe duke marrë parasysh kapacitetet pritëse të çdo IAL-je për programin përkatës të studimit. Për kandidatët që aplikojnë për programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimi, në vlerësimin final të kandidatit komisioni vlerëson dhe rezultatet e fituara nga konkursi i pranimit i organizuar nga IAL-të përkatëse, sipas përcaktimeve të parashikuara në udhëzimin nr. 24, datë 31.7.2015, "Për zhvillimin e konkurseve të pranimit dhe tarifën e regjistrimit për konkurrim në disa programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015 -2016". Pjesë e vlerësimit do të jetë dhe intervista me secilin kandidat, që do të zhvillohet nga komisioni brenda datës 15 shtator 2015. Nuk mund të shpallen fitues kandidatë të cilët kanë grumbulluar një total pikësh në përfundim të Maturës Shtetërore më të ulët se 70% e pikëve të grumbulluara nga fituesi i fundit për programin e studimit përkatës, në vitin akademik 2014-2015. Në mungesë të Maturës Shtetërore, si referencë përdoret nota mesatare e të gjitha viteve të shkollës së mesme. Për kandidatët, shtetas shqiptarë, që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit merren për bazë pikët e përcaktuara në dokumentin e lëshuar sipas përcaktimeve të kryera nga komisioni i posaçëm për procedurat e njëvlefshmërisë së dëftesave/diplomave të shkollave të mesme të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë shtetit, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ose nota mesatare krahasuar me atë të fituesit të fundit për programin përkatës të studimit.

5. Komisioni kryen renditjen e kandidatëve sipas secilës kategori të veçantë, duke specifikuar kandidatët fitues. Lista emërore e kandidatëve të çdo kategorie shpallet në faqen ëeb të MAS dhe i përcillet IAL-ve brenda orës 16.00 të datës 18 shtator 2015, së bashku me një nga kopjet e dokumentacionit të depozituar në MAS nga secili kandidat. Në protokollin e MAS ruhet kopja tjetër e dokumentacionit.

6. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës 25 shtator 2015, duke paraqitur mandatin e pagesës së tarifës së regjistrimit prej 100 lekë.

7. IAL-ja shpall në vende të dukshme, publikon në faqen e saj ëeb, si dhe ia përcjell MAS-it elektronikisht në adresën: linda.pustina@arsimi.gov.al dhe dhimiter.bako@arsimi.gov.al, listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 28 shtator 2015. Në rast se brenda këtyre afateve nuk janë paraqitur për regjistrim kandidatët të cilët rezultojnë fitues sipas renditjes së shpallur, IALja mund të pranojë për regjistrim kandidatët vijues, në listën e renditur të shpallur, si dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 4 të këtij udhëzimi, deri në plotësimin e kuotave përkatëse të studimit të parashikuara për atë program studimi, duke njoftuar kandidatët që janë të vendosur më poshtë në listë. Nëse një nga kandidatët vijues heq dorë me shkrim nga regjistrimi në programin përkatës, IALja depoziton dokumentin dhe vijon me regjistrimin e kandidatit vijues në listë. Afati i fundit për regjistrimin e kandidatëve është data 2 tetor 2015.

8. IAL-të publike i dërgojnë MAS-it dhe AKP-së brenda datës 7 tetor 2015, në rrugë postare, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel, me qëllim

pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe do të kërkohet nga AKP çregjistrimi i tyre.

9. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Komisioni i Posaçëm, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publik e të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

SHTOJCA nr. 1 Tiranë, më ____/____/2015

Formular aplikimi

Unë i nënshkruari , lindur më

Emri, atësia, mbiemri me kartë

identiteti/pasaportë nr.

1. Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit:

a) , ID , në IAL , ose

b) , ID , në IAL , ose

c) , ID , në IAL , ose

d) , ID , në IAL , ose
e) , ID , në IAL .

2. Deklaroj se jam (të shënohet me “x” kategoria e veçantë të cilës i përket kandidati):

? i/e verbër;

? invalid paraplegjik /tetraplegjik;

? jetim;

? rom;

? ballkano-egjiptian.

3. Autorizoj institucionet e arsimit të lartë të sipërcituara, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, aplikimin, si dhe të dhënat e deklaruara në këtë formular.

4. Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik në të cilin po aplikoj.

5. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

6. Deklaroj se jam njohur me Udhëzimin "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe regjistrimit për kandidatët me statusin e të verbrit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe romët dhe ballkano-egjiptianët, në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015 -2016" dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.

7. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente. Emër, atësi, mbiemër Emër, mbiemër i kandidatit i punonjësit që pranoi aplikimin

Firma Firma

UDHËZIM

Nr. 30, datë 24.08.2015

"PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 31.7.2015 "PËR ZHVILLIMIN E KONKURSEVE TË PRANIMIT DHE TARIFËN E REGJISTRIMIT PËR KONKURRIM NË DISA PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË PARË ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015-2016"

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 33 dhe 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimin nr. 638, datë 22.8.2015 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016", si edhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.
78, datë 8.2.2006 "Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 24, datë 31.7.2015, në fund të pikës 7, shtohet fjalia si më poshtë:

"Për universitetin e Arteve të Tiranës periudha e regjistrimit të jetë deri në orën 12.00 të datës 25 gusht 2015.".

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) dhe Universiteti i Arteve të Tiranës.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 32, datë 02.09.2015
"PËR PROCEDURËN E PRANIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, PËR SHTETASIT E HUAJ QË KËRKOJNË TË STUDIOJNË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2015-2016"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 33, pika 4 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shkronjës "ç" të pikës 1 dhe pikës 6 të vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve, programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 - 2016",

UDHËZOJ:

1. Shtetasit e huaj që aplikojnë individualisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit apo në kuadër të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe ose shumëpalëshe, për ndjekjen e studimeve në ciklin e parë të studimeve, për vitin akademik 2015-2016, të përzgjidhen për programin e studimit të kërkuar, në bazë të dosjeve të aplikantëve të përcjella individualisht nga vetë të interesuarit ose të ardhura nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, nga Ministritë e Arsimit të vendeve përkatëse ose nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë.

2. Studentët e huaj duhet të paraqesin në Drejtorinë e Integrimit Evropian dhe Projekteve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në periudhën 2 - 25 shtator 2015 dokumentet e mëposhtme:

a) Formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 1 të këtij udhëzimi;

b) Vërtetim, që nuk ka qenë i ndjekur penalisht dhe që nuk është në ndjekje penale, nga vendi i origjinës, i lëshuar 6 muajt e fundit;

c) Kopjen e njësuar me origjinalin të dokumentit personal të identitetit;

d) Kopjen e njësuar të origjinalit të legalizuar të diplomës së shkollës së mesme e shoqëruar me një dokument të lëshuar nga autoritetet arsimore kompetente, që dëshmon se mbajtësi i diplomës ka të drejtë të ndjekë studimet në institucione të arsimit të lartë në vendin e tij/saj; aplikantët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit duhet të dorëzojnë dhe dokumentin e njësimit të diplomës nga MAS; shtetasit e huaj, që kanë përfunduar arsimin e mesëm në Republikën e Shqipërisë, të paraqesin kopje të njësuar me origjinalin e diplomës dhe certifikatës së Maturës Shtetërore ose dokument ekuivalent me të; nxënësit që do të vijojnë studimet në Shqipëri mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare nuk do të kryejnë procedurën e njësimit të diplomës së arsimit të mesëm;

e) Certifikatën e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë së Universitetit të Tiranës. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument që provon njohjen e gjuhës shqipe në nivelin e kërkuar

(për shembull, diplomë e kryerjes së një cikli studimi në gjuhën shqipe, etj);

f) Kopjen e njësuar të origjinalit të lejeqëndrimit për shtetasit e huaj, lëshuar nga Ministria e Brendshme, nëse disponohet nga aplikuesi;

g) Curriculum Vitae;
h) Deklaratë sipas shtojcës nr. 2 të këtij udhëzimi.

3. Kur dokumentacioni paraqet mangësi, Drejtoria e Integrimit Europian dhe Projekteve i kërkon kandidatit plotësimin e tij brenda datës 25 shtator 2015. Drejtoria e Integrimit Europian dhe Projekteve dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, shqyrtojnë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi dhe, në rastet kur numri i kërkesave është më i lartë se ai i kuotave të miratuara për shtetasit e huaj për ciklin përkatës të studimit, bëjnë renditjen e kandidatëve sipas kriterit të meritës dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues në programet e studimit përkatës, bazuar dhe në kapacitetet pritëse të institucioneve publike të arsimit te lartë (IAL-ve). Kërkesat e kandidatëve që nuk kanë dorëzuar dokumentacion të plotë, sipas specifikimeve në këtë udhëzim brenda afateve të parashikuara, nuk do të merren në shqyrtim.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit i dërgon institucioneve publike të arsimit të lartë, brenda datës 2 tetor 2015, dokumentacionin përkatës të aplikantëve të përzgjedhur sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, për të kryer procedurat e mëtejshme të regjistrimit në programet e studimit përkatës.

5. Shtetasit e huaj brenda datës 12 tetor 2015 të paraqiten pranë sekretarive mësimore të fakulteteve përkatëse për të kryer procedurat e regjistrimit në programin përkatës të studimit dhe të kryejnë pagesën e tarifës së regjistrimit dhe shkollimit, në përputhje me kërkesat ligjore. Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

6. Brenda datës 19 tetor 2015 institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Agjencinë Kombëtare të Provimeve (AKP) listat përfundimtare në dy kopje, në formë të shkruar dhe elektronike, me regjistrimet e kryera për shtetasit e huaj, për çdo program studimi, të plotësuara, sipas shtojcës nr. 3 të udhëzimit nr. 45 datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", i ndryshuar. AKP përgatit dhe i përcjell IAL-ve përkatëse numrat e matrikullimit të shtetasve të huaj brenda datës 19 nëntor 2015. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe do të kërkohet nga AKP çregjistrimi i tyre.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Drejtoria e Integrimit Europian dhe Projekteve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

SHTOJCA NR. 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FORMULARI I APLIKIMIT

2015 - 2016
Për studime universitare (Për t'u plotësuar në shqip në tri kopje)

1. IDENTITETI

MBIEMRI

EMRI

VENDLINDJA

DATËLINDJA

SHTETËSIA

GJINIA

PROFESIONI OSE STUDIMET AKTUALE

ADRESA AKTUALE

2. ARSIMI

EMRI I SHKOLLËS SË MESME DHE DIPLOMA E MARRË

Emri i shkollës Lloji i shkollës (e përgjithshme ose profesionale) Rezultate

1.

2.

3.

3. NJOHURI GJUHËSORE

GJUHA AMTARE ...

Gjuhë të huaja Leximi Të folurit Shkrimi

Shqip

Anglisht

Frëngjisht

Të tjera

1.
2.

3.

^^^ MIRË ^^ MESATAR ^ DOBËT

4. PROGRAMI I STUDIMIT

KENI APLIKUAR OSE FITUAR BURSA TË TJERA STUDIMI NË SHQIPËRI?

SHËNONI PROGRAMIN E STUDIMIT DHE UNIVERSITETIN KU DO TË DONI TË STUDIONI NË SHQIPËRI (TRE MUNDËSI TË RENDITURA NË RADHË PREFERENCIALE):

1

2

3

Vendi dhe data Emër, mbiemër, firmë

BASHKË ME FORMULARIN PLOTËSONI DOKUMENTET E POSHTËSHËNUARA:

a) Formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 1 të këtij udhëzimi;

b) Vërtetim, që nuk ka qenë i ndjekur penalisht dhe që nuk është në ndjekje penale, nga vendi i origjinës, i lëshuar 6 muajt e fundit;

c) Kopjen e njësuar me origjinalin të dokumentit personal të identitetit;

d) Kopjen e njësuar të origjinalit, të legalizuar, të diplomës së shkollës së mesme e shoqëruar me një dokument të lëshuar nga autoritetet arsimore kompetente, që dëshmon se mbajtësi i diplomës ka të drejtë të ndjekë studimet në institucione të arsimit të lartë në vendin e tij/saj; aplikantët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit duhet të dorëzojnë dhe dokumentin e njësimit të diplomës nga MAS; shtetasit e huaj, që kanë përfunduar arsimin e mesëm në Republikën e Shqipërisë, të paraqesin kopje të njësuar me origjinalin e diplomës dhe certifikatës së Maturës Shtetërore ose dokument ekuivalent me të; nxënësit që do të vijojnë studimet në Shqipëri mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare nuk do të kryejnë procedurën e njësimit të diplomës së arsimit të mesëm;

e) Certifikatën e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë së Universitetit të Tiranës. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument që provon njohjen e gjuhës shqipe në nivelin e kërkuar
(për shembull, diplomë e kryerjes së një cikli studimi në gjuhën shqipe, etj);

f) Kopjen e njësuar të origjinalit të lejeqëndrimit për shtetasit e huaj, lëshuar nga Ministria e Brendshme, nëse disponohet nga aplikuesi;

g) Curriculum Vitae;
h) Deklaratë sipas shtojcës nr. 2 të këtij udhëzimi.

Dokumentacioni i mësipërm mund të paraqitet në gjuhën shqipe ose gjuhën angleze. Për dokumentet të cilat disponohen në gjuhë të tjera, është i nevojshëm përkthimi i noterizuar në një nga gjuhët e sipërpërmendura.

SHTOJCA NR. 2

Deklaratë

Unë i nënshkruari , lindur më

emri atësia mbiemri me kartë

identiteti/pasaportë nr.

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë Ministrinë e Arsimit dhe

Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre.

Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015-2016.

3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimit të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e

nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit Emër, mbiemër i punonjësit të sekretarisë

Nënshkrimi mësimore

Nënshkrimi

Vendi: Data: ____ . ____.

UDHËZIM

Nr. 39, datë 06.10.2015

"PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 18.8.2015, "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, SI DHE KANDIDATËT SHQIPTARË NGA MAQEDONIA, MALI I ZI, PRESHEVA, BUJANOVCI DHE MEDVEGJA, NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015-2016"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 33, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016", si dhe në zbatim të vendimit nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", të ndryshuar, vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)", si dhe vendimit nr. 241, datë 31.3.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për kryerjen nga Posta Shqiptare, sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 26, datë 18.8.2015, "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit për kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015-2016", të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 6, datë "22 shtator 2015" zëvendësohet me datën "7 tetor 2015";

b) Në pikën 7, periudha “23 shtator deri 1 tetor 2015” zëvendësohet me periudhën “deri më 15 tetor 2015”, dhe data “2 tetor 2015” zëvendësohet me datën “16 tetor 2015”;

c) Në pikën 9, data “6 tetor 2015” zëvendësohet me datën “22 tetor 2015”;

d) Në pikën 10, periudha “7 tetor 2015 deri më 12 tetor 2015” zëvendësohet me periudhën “23 tetor 2015 deri më 27 tetor 2015” dhe data “16 tetor 2015” zëvendësohet me datën “30 tetor 2015”.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.
MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 44, datë 16.10.2015

“PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E SPECIALIZIMEVE AFATGJATA, NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2015- 2016”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 18, 70, 71, 77 dhe 89 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, të vendimit nr. 808, datë 3.10.2015, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit, në programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2015-2016”, dhe të vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”,

UDHËZOJ:

1. Kandidatët, shtetas shqiptarë, brenda vendit dhe kandidatët me kombësi shqiptare nga trojet shqiptare jashtë kufijve të vendit, aplikojnë për një program specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë (UMT), në vitin akademik 2015-2016, respektivisht, në zbatim të germës “a” dhe “b”, të pikës 1, të vendimin nr. 808, datë 3.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit, në programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2015-2016”, nga data 19 tetor 2015 deri në datën 26 tetor 2015. Procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe konkurrimit bëhen konform rregullores së specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, të miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet e shëndetësisë dhe ministri përgjegjës për çështjet e arsimit, respektivisht me nr. 6636/1 prot., datë 4.12.2014 dhe nr. 9095/1 prot., datë 4.12.2014.

2. Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, të organizojë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë. Procesi monitorohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Shëndetësisë.

3. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e specializimeve afatgjata, në fushën e mjekësisë, kandidatët që:

a) kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse, në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave", si dhe kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë;

b) janë diplomuar jashtë vendit në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave" dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it, si dhe kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë.

4. Për të aplikuar në programet e specializimit afatgjatë për të cilat janë parashikuar kuota sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur vendimit nr. 808, datë 3.10.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit, në programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2015-2016", kandidatët duhet të kenë përfunduar një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave" në "Mjekësi të përgjithshme".

Të gjithë kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e parashikuara në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.

5. Kandidati paraqitet personalisht për të bërë aplikimin dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Formular aplikimi, sipas modelit të parashikuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi (kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh plotësojnë formularin sipas modelit të parashikuar në shtojcën nr. 1/a);

b) Një letërmotivimi e aplikantit;

c) Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, kartë identiteti ose pasaportë;

d) Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e diplomës universitare, të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor", si dhe të ciklit të dytë "Master i shkencave" ose të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe listës/listave të notave. Për rastet e diplomave të huaja paraqitet kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë, e shoqëruar me diplomën/diplomat dhe listën/listat përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në universitet në vendin ku janë kryer studimet, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë përkatës. Në rast se njohja e diplomës nuk ka përfunduar ende, kandidati paraqet vërtetim që ka dorëzuar dokumentacionin për njohje në MAS dhe duhet të dorëzojë dokumentin e njohjes jo më vonë se data e parashikuar për testimin e informatizuar, si dhe përpara shpalljes së rezultatit përfundimtar nga Komisioni i Vlerësimit.

e) Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e dokumentit që vërteton njohjen e gjuhës së huaj, sipas parashikimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë;

f) Fotokopje e noterizuar në Republikën e Shqipërisë, e lice ncës për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë dhe e dëshmisë së regjistrimit në urdhrin profesional përkatës; g) Dëshmi penaliteti e vlefshme;

h) Mandatpagesa për tarifën e konkurrimit prej 5,000 lekësh;

i) Kandidatët që aplikojnë për kuotat e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, dorëzojnë një letërmbështetëse të ministrisë përkatëse sipas formatit të parashikuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

j) Dy foto personale.

6. Dekanati, brenda datës 27 tetor 2015, shpall në faqen zyrtare ëeb të fakultetit dhe/ose UMT-së listën emërore të kandidatëve të regjistruar për konkurrim, të cilët plotësojnë kriteret për të marrë pjesë ë procesin e konkurrimit. Kandidatët, brenda 2 ditëve nga shpallja, verifikojnë listën emërore dhe, në rast pasaktësish, bëjnë kërkesë për saktësim pranë dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë brenda datës 29 tetor 2015. Dekanati pas kryerjes së verifikimeve shpall brenda datës 2 nëntor 2015 listën përfundimtare të kandidatëve, si dhe kalendarin e zhvillimit të intervistave me gojë dhe testimit të informatizuar. Datat e zhvillimit të testimit të informatizuar konsultohen me AKP-në, lidhur me disponibilitetin për zhvillimin e testimit të informatizuar. Listat e studentëve të ndara sipas datave përkatëse të zhvillimit të intervistës me gojë dhe në vijim të testimit të informatizuar përcaktohen me short. Listat përfundimtare dhe kalendari i zhvillimit të testimit të informatizuar i dërgohen AKP-së dhe MAS-së brenda kësaj date sipas formatit të përcaktuar paraprakisht nga AKP-ja. Kandidatët duhet të kryejnë intervistën me gojë dhe më pas testimin e informatizuar.

7. Dekanati ngre brenda datës 6 nëntor 2015 komisionin e vlerësimit. Komisionet e intervistës krijohen në bazë shorti ditën e parashikuar për zhvillimin e intervistës, para zhvillimit të saj. Kombinimi i listës së studentëve që do të intervistohen në një datë të caktuar me një nga komisionet e intervistës të ngritura, përcaktohet me short, një orë përpara zhvillimit të intervistës, në prani të kryetarëve të komisioneve përkatëse. Për hedhjen e shortit dekani ngre një komision të posaçëm.

8. Konkurrimi fillon në datën 6 nëntor 2015, me intervistimet me gojë. Rezultatet e intervistimit me gojë shpallen nga komisioni pas aprovimit nga Ddekani. Dekanati shpall rezultatet përfundimtare të intervistës me gojë në faqen e ëeb të fakultetit përkatës dhe UMT-së, si dhe në ambientet e fakultetit dhe rektoratit brenda 2 ditëve pune nga përfundimi i intervistës me gojë.

9. Testimi i informatizuar fillon në datën 9 nëntor 2015 për kandidatët që kanë kryer intervistën me gojë dhe zhvillohet në Agjencinë Kombëtare të Provimeve (AKP) sipas kalendarit të përcaktuar nga dekanati, bazuar në disponibilitetin e ambienteve të testimit të përcaktuara nga AKP-ja.

10. Ditën e zhvillimit të provimit, kandidatët duhet të kenë parasysh rregullat e mëposhtme:

a) të jenë të pajisur me dokument identiteti (kartë identiteti ose pasaportë), si dhe me një fotokopje të saj;

b) të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të provimit/testimit;

c) ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve dhe mjeteve të tjetra të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter skualifikimi;

d) ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit;

e) ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të provimit.

Sallat e provimit mbikëqyren nga një ose më shumë administratorë, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit/testimit sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve dhe këtij udhëzimi.

11. Agjencia Kombëtare e Provimeve, si autoritet në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, është përgjegjëse për zhvillimin e provimeve të specializimit në mjekësi.
AKP-ja zbaton procedurat për zhvillimin e provimeve të specializimit, përmes teknologjisë dixhitale.

AKP-ja, lidhur me zhvillimin e provimeve të specializimit, kryen detyrat e mëposhtme:

a) Dixhitalizon fondin e pyetjeve për çdo specialitet të miratuar nga Komisioni i Vlerësimit;

b) Harton në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, grafikun e datave të provimeve;

c) Publikon listat e kandidatëve sipas datës dhe orarit të caktuar për zhvillimin e provimit.

d) Verifikon identitetin dhe dokumentet përkatëse të kandidatëve pjesëmarrës në provimet e specializimit;

e) Siguron kushte të përshtatshme në sallat e provimit për zhvillimin e provimit të specializimit përmes teknologjisë dixhitale;

f) Siguron kushte të përshtatshme për kandidatët me aftësi të kufizuara fizike;

g) Merr masa për hartimin e formatit të testit sipas përcaktimit të bërë nga Komisioni i Vlerësimit;

h) Mban procesverbale për çdo vendimmarrje gjatë procedurave të zhvillimit të provimeve të specializimit, deri në shpalljen e rezultateve;

i) Dërgon rezultatet e provimit të specializimit pranë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

12. Në përfundim të testimit të të gjithë kandidatëve, komisioni i vlerësimit përgatit listën përmbledhëse të meritës me rezultatet kumulative të intervistës, testimit të informatizuar dhe notës mesatare, duke renditur kandidatët sipas pikëve në rend zbritës, sipas tipologjisë së kuotave të

miratuara, sipas tabelës së paraqitur në shtojcën 3 bashkëlidhur. Tabela më sipër miratohet nga dekani dhe shpallet dhe afishohet në vende të dukshme, brenda 2 ditëve nga përfundimi i testimit të informatizuar, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet ëeb të Fakultetit të Mjekësisë dhe UMT-së, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët. Vlerësimi me pikë i kandidatëve bëhet konform rregullores përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë. Kandidatët mund ta ankimojnë rezultatin brenda 2 ditëve nga shpallja e listës paraprake. Komisioni i vlerësimit merr në shqyrtim ankimimet dhe prononcohet brenda 3 ditëve me vendimin përkatës, i cili i përcillet dekanit. Ky i fundit shprehet brenda 2 ditësh me vendim të formës së prerë.

13. Zgjedhja e programit të specializimit afatgjatë bëhet brenda dy ditëve nga shpallja e rezultateve përfundimtare, përfshirë dhe procedurat e ankimimit, sipas afateve të përcaktuara në rregulloren e specializimeve. Të drejtën e regjistrimit si fitues e kanë aq persona sa janë edhe kuotat e caktuara në programin e specializimit përkatës, sipas rendit zbritës të pikëve totale.

14. Zgjedhja e specializimit bëhet në mënyrë transparente, nga vetë kandidatët fitues, sipas rendit zbritës të pikëve në listën përfundimtare të ndërtuar në bazë të pikëve të fituara nga çdo kandidat, si dhe në përputhje me kuotat e VKM-së përkatëse, në prani të Komisionit të Vlerësimit, të drejtuar nga dekani ose përfaqësuesi i tij, me praninë e të interesuarve (në grupe me nga 5 konkurrues).
15. Regjistrimi i kandidatëve në programet e specializimit afatgjatë, ku janë shpallur fitues, bëhet brenda 7 ditëve nga data e përzgjedhjes së specializimit.

16. Transferimit e studimeve do të kryhen në zbatim të germës "c", të pikës 1, të vendimit nr. 808, datë 3.10.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit, në programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2015-2016".

Kandidati, në momentin e aplikimit, veç ca është parashikuar në pikën 5 të këtij udhëzimi, dorëzon

dhe kopje të noterizuar të dokumenta-cionit si më poshtë:

a) Planin e plotë të programit të studimit specializues të ndjekur;

b) Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, si dhe syllabuset përkatëse për lëndët e shlyera, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;

c) Vërtetim për periudhat e praktikave dhe frekuentimin e aktiviteteve të parashikuara në programin specializues të ndjekur.

Në momentin e regjistrimit përfundimtar, nëse kandidati është shpallur fitues, dorëzon vërtetimin e çregjistrimit nga programi i mëparshëm specializues, pa të cilin nuk mund të kryhet regjistrimi i studentit.

17. Kandidati transferohet në vit të parë ose të dytë, por jo më lart se viti i dytë i studimeve. Kandidatët që plotësojnë kriteret për t'u transferuar, vlerësohen për periudhën e specializimit të kryer dhe ekuivalentimin e saj, si dhe të krediteve të përfituara gjatë studimeve të mëparshme, duke i përcaktuar vitin se ku mund të transferohet eventualisht kandidati.

Në vijim, nëse numri i kandidatëve që kanë aplikuar dhe që plotësojnë kriteret është më i madh se numri i kuotave të përcaktuara në programin specializues, për të cilin parashikohet kuotë transferimi, kandidatët u nënshtrohen procedurave të konkurrimit si të gjithë kandidatët e tjerë duke konkurruar brenda numrit të kuotave të përcaktuara për transferimet dhe shpërndarjes së tyre.

Për kandidatët që kërkojnë të transferohen nga programe specializimi për të cilat kanë përfituat kuotë të mbuluar nga Ministria e Shëndetësisë apo ministritë e tjera, duhet të merret miratimi paraprak për transferimin nga ministria me të cilën është lidhur kontrata e mëparshme.

Ministria e Shëndetësisë shprehet, gjithashtu, për rastet kur kandidatët kërkojnë të transferohen nga një program specializimi për të cilin nuk kanë lidhur kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë në një program specializimi që parashikon kuotë të mbuluar nga Ministria e Shëndetësisë.

Në përfundim të konkurrimit, komisioni i vlerësimit përllogarit pikët totale të kandidatit duke marrë në konsideratë intervistën me gojë, testimin e informatizuar dhe notën mesatare të ponderuar të studimeve universitare të mëparshme në mjekësi. Komisioni përgatit një listë me kandidatët e renditur sipas pikëzimit sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi, dhe shpall kandidatët fitues për çdo program specializues.

18. Regjistrimi i kandidatëve që transferohen në programet e specializimit afatgjatë, ku janë shpallur fitues, bëhet brenda 7 ditëve nga data e shpalljes. Në mungesë të regjistrimit të kandidatëve për transferimet e studimeve, e drejta e regjistrimit i lind kandidatit të renditur më poshtë në listën e meritës së kandidatëve. Regjistrimi mbyllet në çdo rast brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

Kandidatët që do të regjistrohen në kuadër të kuotave të transferimit duhet të dorëzojnë dhe dokumentin e çregjistrimit nga programi i specializimit nga ku transferohen. Në rastet e transferimit nga programe specializuese jashtë vendit, në pamundësi të depozitimit të vërtetimit të çregjistrimit brenda afateve të parashikuara për regjistrim, kandidati regjistrohet me rezervë deri në depozitimin e vërtetimit përkatës. Nëse kandidati nuk e depoziton dokumentin e çregjistrimit brenda një muaji nga data e shpalljes së fituesve, fakulteti çregjistron kandidatin dhe mund të vijojë me regjistrimin eventual të kandidatit vijues në listën përkatëse.

19. Brenda 5 ditëve pune nga regjistrimi i kandidatëve fitues, UMT-ja i dërgon AKP-së, në rrugë postare, listën e studentëve specializantë të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi në zbatim të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", i ndryshuar. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe do të kërkohet nga AKP-ja çregjistrimi i tyre.

20. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose private. AKP-ja pas verifikimit i kërkon IAL-së ta çregjistrojë atë.

21. Për specializantët që kanë përfituar nga kuotat e mbuluara nga Ministria e Shëndetësisë apo nga Ministri të tjera, marrëdhëniet kontraktuale financiare lidhen mes specializantit dhe ministrisë përkatëse sipas parashikimeve në rregulloren përkatëse.

22. Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen në këtë udhëzim merret për referencë rregullorja e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë e miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet e arsimit dhe ministri përgjegjës për çështjet e shëndetësisë.

23. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe Universiteti i Mjekësisë Tiranë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

Nr.

Emër Atësi Mbiemër Datëlindje Emërtim i programit të studimit specializues nga transferohet IAL-ja nga transferohet Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik të mëparshëm Kreditet (ECTS) të grumbulluara nga kandidati Emërtim i programit të studimit specializues ku transferohet Vitet e studimit ku transferohet Kreditet e njohura Pikët e akorduara

Intervista Testimi i informatizimit Nota mesatare Pikët totale

UDHËZIM

Nr. 46, datë 28.10.2015

"PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I SHKENCAVE"/"MASTER I ARTEVE TË BUKURA" NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015-2016"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, neneve 34, 36 dhe 75, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 135, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; vendimin nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015-2016", i ndryshuar, vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të

Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, dhe vendimin nr. 103, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)", UDHËZOJ:

1. Pranimin e kandidatëve, shtetas shqiptarë, brenda vendit, në zbatim të shtojcës 1/1 të vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016", të ndryshuar, në programet e ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë publik (IAL), në vitin akademik 2015-2016, realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga IAL-të, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si edhe sipas kritereve shtesë të përcaktuara në statutet dhe rregulloret e tyre dhe të bëra publike paraprakisht.
2. Njësitë kryesore të IAL-ve publike, organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura". Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.

3. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Mater i arteve të bukura" të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, nga data 29.10.2015 deri në datën 5.11.2015.

4. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë kandidatët që:

a) Kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse, në një program të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, i cili rezulton i akreditуar në momentin e diplomimit të studentit;

b) Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.

5. Kandidati paraqitet personalisht dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Diplomë ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Për diplomat e fituara jashtë vendit, vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MAS-i të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.

b) Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar", paraqesin dëftesën e pjekurisë (origjinal, ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).

Në rast se kandidatët kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 3.11.2010, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike, të ndryshuar" dhe kanë dhënë me sukses (me rezultate kaluese) provimet me zgjedhje të Maturës Shtetërore, paraqesin edhe dokumentin përkatës të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve.

Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublika të të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA) ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit, së bashku me listën e notave.

Kandidatët që kanë kryer shkollën e mesme jashtë vendit duhet të dorëzojnë dokumentin e njohjes të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të shoqëruar me fotokopje të njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë, të përkthyer në gjuhën shqipe, nëse është lëshuar në gjuhë të huaj, të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose diplomës/dëftesës së shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet, të njohura në Republikën e Shqipërisë ose të një dokumenti të lëshuar nga autoritetet arsimore kompetente mbi bazën e të cilit është kryer njohja nga MAS-i.

c) Formulari i aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

d) Mandatpagesa e tarifës së aplikimit prej 2.500 lekë, paguar në Postën Shqiptare (për të gjithë kandidatët);

e) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); f) Dy fotografi personale.

6. Pranë njësive kryesore përgjegjëse të IAL-ve të ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe kriteret shtesë të përcaktuara në statutet dhe rregulloret e tyre dhe të bëra publike paraprakisht.

7. Brenda orës 16:00, të datës 9.11.2015, IAL-të publike të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet ëeb të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuar.

8. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues, të zhvillohet nga data 10.11.2015 deri në datën 16.11.2015 pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të IAL-së.

9. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat 10-12 nëntor 2015, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim. MAS-i monitoron konkurset e pranimit dhe procedurat e ndjekura për vlerësimin e studentëve. IAL-të dërgojnë në MAS vlerësimin e

kandidatit brenda datës 12 nëntor 2015 në formë shkresore dhe elektronike në adresën linda.pustina@arsimi.gov.al dhe dhimiter.bako@arsimi.gov.al. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit, ku janë shpallur fitues nga data 13.11.2015 deri në datën 16.11.2015, duke paraqitur dhe mandatpagesën e tarifës së konkurrimit prej 3,000 lekë, paguar Postës Shqiptare.

10. IAL-ja shpall në vende të dukshme, publikon në faqen e saj ëeb, si dhe ia përcjell MAS-së elektronikisht në adresën: linda.pustina@arsimi.gov.al dhe dhimiter.bako@arsimi.gov.al, listën emërore të kandidatëve të regjistruar, brenda datës 17.11.2015.

11. IAL-të publike i dërgojnë AKP-së, brenda datës 19.12.2015, në rrugë postare, listën e studentëve të regjistruar për çdo program studimi të ciklit të dytë "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura", në formë shkresore dhe elektronike në format Excel, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, në zbatim të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011, i ndryshuar.
12. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose private. AKP-ja pas verifikimit i kërkon IAL-ve ta çregjistrojë atë.

13. IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

14. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

SHTOJCA NR. 1

Tiranë, më 2015

FORMULAR APLIKIMI

Unë i/e nënshkruari/a , lindur më,

emër, atësi, mbiemër me kartë

identiteti/pasaportë nr.

1. Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të dytë:

? Mater profesional

? Master i shkencave/Master i arteve të bukura

Në , ID , në IA L

2. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t?u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdolloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.

3. Deklaroj se nuk kam aplikuar për t?u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015-2016.

4. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

5. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtar e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit Emër, mbiemër i punonjësit që pranoi aplikimin Firmë

Firmë

UDHËZIM

Nr. 47, datë 02.11.2015

"PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, SI DHE KANDIDATËT SHQIPTARË NGA MAQEDONIA, MALI I ZI, PRESHEVA, BUJANOVCI DHE MEDVEGJA, NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I SHKENCAVE"/"MASTER I ARTEVE TË BUKURA", NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015-2016"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 34 dhe 75, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimit e lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 135, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015 - 2016", të ndryshuar, dhe vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)",

UDHËZOJ:

1. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, aplikojnë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), nga data 2 deri në 9 nëntor 2015, në zbatim të vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015-2016", të ndryshuar. Kandidatët shprehin 5 referenca të ndryshme, lidhur me aplikimin në programet e preferuara të studimit sipas formularit në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Kandidatët nga Republika e Kosovës., si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, në momentin e aplikimit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm në dy kopje të njësuara me origjinalin.

a) Formulari i aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në formular duhen radhitur pesë programe studimi ku kandidati kërkon të aplikojë, si dhe institucioni i arsimit të lartë (IAL) përkatës, në renditje prioritare, pra i pari renditet programi më i preferuar dhe i fundit ai më pak i preferuar nga të pesta programet. Për emërtimin dhe ID-në e programit përkatës u duhet referuar tabelave nr. 1/1 dhe 2/2, të vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015-2016", i ndryshuar.

Diploma universitare e ciklit të parë të studimeve të përfunduar brenda Republikës së Shqipërisë, së bashku me suplementin e diplomës ose listën e notave. Në mungesë të diplomës, IAL-të publike pajisin kandidatin me një vërtetim që provon mbarimin e studimeve konform ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe lejon regjistrimin në ciklin e dytë të studimeve. Kandidati paraqet vërtetim në IAL-në ku kërkon të regjistrohet sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim, dhe brenda 6 muajve dorëzon fotokopjen e njësuar me origjinalin të kartonit të diplomës të lëshuar nga IAL-ja përkatëse. Për diplomën universitare të ciklit të parë të fituar jashtë vendit, të depozitohet dhe vërtetimi i njohjes dhe njësimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Për kandidatët të cilët nuk kanë njohur dhe njësuar diplomat e tyre të fituara jashtë vendit, depozitojnë dokumentacionin për njohje diplome në të njëjtën ditë me aplikimin.

b) Diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, me certifikatën e notave, të njohura nga komisioni i posaçëm për njohjen e diplomave të shkollës së mesme në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Për kandidatët të cilët nuk kanë njohur dhe njësuar diplomat e tyre të fituara jashtë vendit, depozitojnë dokumentacionin për njohje diplome të shkollës së mesme së bashku me aplikimin.

c) Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit.

d) Dy fotografi personale.
e) Mandatarkëtimi i tarifës së aplikimit prej 2,000 lekësh paguar pranë zyrave të Postës Shqiptare, për llogari të IAL-së përfituese.

Një kopje e dokumentacionit të depozituar ruhet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Aplikimet me dokumentacion të paplotë nuk merren në konsideratë.

3. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision i posaçëm, i ngritur me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit. Vlerësimi të bëhet mbi kriterin e meritës, bazuar në notën mesatare të të gjitha viteve të studimeve universitare të ciklit të parë dhe në notën mesatare të të gjitha viteve të shkollës së mesme, duke vlerësuar dhe programet që gjykohet të jenë prioritare sipas propozimeve të autoriteteve të vendeve përkatëse, si dhe duke marrë parasysh kapacitete pritëse të çdo IAL-je për programin përkatës të studimit. Nëse do të rezultojnë kandidatë me pikë të barabarta do t'i nënshtrohen testimit që do të kryhet nga MAS-i.

4. Brenda datës 16 nëntor 2015, MAS-i përcjell në IAL-të respektive listën e renditur të kandidatëve të përzgjedhur sipas procedurës së mësipërme dhe një kopje të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati, për të vijuar me regjistrimin e kandidatëve në programet përkatëse të studimit. MAS-i publikon në faqen ëeb listën e kandidatëve dhe afatet e regjistrimit të tyre në IAL-të përkatës.

5. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, të cilët rezultojnë fitues, regjistrohen pranë sekretarive mësimore të fakulteteve nga data 16 deri në datën 20 nëntor 2015.

6. Me mbylljen e regjistrimit përfundimtar, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në AKP, brenda datës 25 nëntor 2015, listat përfundimtare të përgatitura sipas formatit të dërguar nga AKP-ja, me regjistrimet e kryera për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për dhënien e numrave të matrikullimit, në formë të shkruar dhe elektronike.
7. AKP-ja, brenda datës 28 dhjetor 2015, i dërgon IAL-ve publike në rrugë postare, listën me numrat e matrikullimit të studentëve. IAL-të publike çregjistrojnë studentët e papajisur me numër matrikullimi dhe ia komunikojnë çregjistrimin AKP-së brenda 10 ditëve nga marrja e komunikimit zyrtar nga AKP-ja me listat me numrat e matrikullimit.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Komisioni i Posaçëm, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 48, datë 02.11.2015

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR TRANSFERIM TË STUDIMEVE DHE PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI, NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2015-2016

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, neneve 34, 35 dhe 36, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 135, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit nr. 6381, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015-2016", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Kandidatet aplikojnë pranë institucioneve publike të arsimit të lartë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, nga data 2 deri në datën 9 nëntor 2015.

2. Studenti që aplikon për transferim studimesh, paraqet dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve:

a) Kërkesën drejtuar institucionit publik të arsimit të lartë (IAL) për programin e studimit, në të cilin kërkon të transmetojë studimet (ose formulari i aplikimit);

b) Plani i plotë i programit të studimit nga ku transferohet;

c) Vërtetim të listës së notave, krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer në ciklin e dytë të studimeve, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin eventual të lëndëve të programit të studimit të ndjekur, si dhe programeve/syllabuseve përkatëse të lëndëve të shlyera;

d) Fotokopje të diplomës së Maturës Shtetërore dhe të certifikatës së notave, të noterizuar, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA) ose dublikatën e tyre. Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar", paraqesin dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).

Në rast se kandidatët kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 876, datë 3.11.2010, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", të ndryshuar", dhe kanë dhënë me sukses (me rezultate kaluese) provimet me zgjedhje të Maturës Shtetërore, paraqesin edhe dokumentin përkatës të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve.

Kandidatët që kanë kryer shkollën e mesme jashtë vendit duhet të dorëzojnë dokumentin e njohjes të lëshuar nga MAS-i, të shoqëruar me fotokopje të njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë;

e) Fotokopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë të diplomës universitare të ciklit të parë të studimeve, së bashku me suplementin e diplomës ose listën e notave. Në mungesë të diplomës, IAL-të publike pajisin kandidatin me një vërtetim që provon mbarimin e studimeve konform ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe lejon regjistrimin në ciklin e dytë të studimeve. Kandidati paraqet vërtetimin në IAL-në ku kërkon të aplikojë sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim, dhe brenda 6 muajve, nëse është regjistruar pranë kësaj IAL-je, dorëzon fotokopjen e njësuar me origjinalin të diplomës së lëshuar nga IAL-ja përkatëse. Për diplomën universitare të ciklit të parë të fituar jashtë vendit, të depozitohet dhe vërtetimi i njësimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, ose në mungesë të tij, një dokument tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës. Në rast se nuk janë përfunduar procedurat e njësimit, kandidati dorëzon një vërtetim që konfirmon dorëzimin në MAS të dokumentacionit të parashikuar për njësimin e diplomës së ciklit të parë, dhe brenda 45 ditëve dorëzon vërtetimin përkatës të njësimit;

f) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë);
g) Pagesën e tarifës së regjistrimit prej 3,000 lekësh, për llogari të IAL-së përfituese; h) Dy fotografi personale.

Dokumentacioni që disponohet në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer dhe i noterizuar në Republikën e Shqipërisë.

3. Kanë të drejtë të aplikojnë për transferim studimesh të gjithë kandidatët që:

a) Kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë me sukses studimet dhe janë paji sur me diplomën përkatëse ose me vërtetimin përkatës, sipas përcaktimeve në germën "f", të pikës 2, të këtij udhëzimi, në një program të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, i cili rezulton i akreditуar në momentin e diplomimit të studentit, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë brenda ose jashtë vendit të akreditуar në momentin e transferimit;

b) Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it ose janë në proces njësimi, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë të akreditуar në momentin e transferimit brenda ose jashtë vendit.

4. Transferimi i studimeve mund të bëhet në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtit cikël dhe tipologji. IAL-ja mund të përcaktojë kritere të tjera shtesë për përzgjedhjen e studentëve që aplikojnë për transferim apo për program të dytë studimi.

5. IAL-të nuk mund të pranojnë aplikime për transferime gjatë vitit akademik.

Transferimi i studimeve do të kryhet në zbatim të procedurave dhe afateve të parashikuara në këtë udhëzim.

6. Transferimet nga IAL-të private bëhet vetëm nga programe të akredituara. IAL-ja mund të përcaktojë kritere të tjera shtesë, të cilat përcaktohen në statut, në rregulloret përkatëse.

7. Studenti që aplikon për transferim studimesh apo për program të dytë studimi nuk duhet të jetë duke ndjekur njëkohësisht një program tjetër studimi të çfarëdolloj cikli, në IAL-të publike e private.

8. Për të aplikuar për program të dytë studimi, studenti paraqet dokumentacionin e parashikuar në germat "e", "f", "g", "h", "i", të pikës 2, të këtij udhëzimi, si dhe dokumentacionin e mëposhtëm, pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve:

a) Kërkesë drejtuar IAL-së publike, në të cilin aplikon për program të dytë studimi (ose formulari i aplikimit);

b) Fotokopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë të diplomës universitare të ciklit të dytë të studimeve, së bashku me suplementin e diplomës ose listën e notave. Në mungesë të diplomës, IAL-të publike pajisin kandidatin me një vërtetim që provon mbarimin e studimeve konform ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe lejon regjistrimin në ciklin e dytë të studimeve. Kandidati paraqet vërtetimin në IAL-në ku kërkon të aplikojë, sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim, dhe brenda 6 muajve, nëse është regjistruar pranë kësaj IAL-je, dorëzon fotokopjen e njësuar me origjinalin të diplomës së lëshuar nga IAL-ja përkatëse. Për diplomën universitare të ciklit të dytë të fituar jashtë vendit, të depozitohet dhe vërtetimi i njësimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Në mungesë të tij, një dokument tjetër zyrtar, mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës. Kandidatët, të cilët nuk kanë njësuar diplomën universitare të fituar jashtë vendit, aplikojnë për njohje diplome. Kandidati dorëzon në dosje një vërtetim mbi aplikimin e tij për njësim diplome në MAS.

c) Plani i plotë i programit të studimit, përfshirë dhe syllabuset përkatëse, vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për njohjen e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse, nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse.

9. Kanë të drejtë të aplikojnë për program të dytë studimi të gjithë kandidatët, që:

a) Kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse ose me vërtetimin përkatës, sipas përcaktimeve në germën "f", të pikës 2, të këtij udhëzimi, në një program të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, si dhe në një program studimi të ciklit të dytë, sipas përcaktimeve në germën "b", të pikës 9, të këtij udhëzimi, të cilët rezultojnë të akredituar në momentin e diplomimit të studentit;

b) Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, si dhe në një program studimi të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it ose janë në proces njësimi.

10. IAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi, në vende të dukshme brenda datës 10 nëntor 2015.

11. Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja nga data 11 nëntor 2015 deri në datën 13 nëntor 2015. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënli gjor në fuqi, si dhe të kritereve të tjera shtesë, të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të IAL-së dhe të programit të studimit, të cilat duhet të shpallen në vende të dukshme brenda datës 13 nëntor 2015. Kriteret e vlerësimit t?u bëhen me dije në momentin e aplikimit të gjithë kandidatëve, së bashku me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

12. Komisioni kryen renditjen e kandidatëve, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi dhe vlerëson kandidatët me statusin fitues/jofitues. Këto të dhëna shpallen nga dekanati përkatës në ambientet e fakultetit dhe IAL-së, si dhe faqet ëeb përkatëse, të plotësuara sipas tabelave nr. 1/a dhe 1/b, të parashikuara në shtojcën nr. 1 të këtij udhëzimi, respektivisht, për kandidatët që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe për kandidatët që kanë aplikuar për program të dytë studimi, brenda datës 16 nëntor 2015. IAL-të dërgojnë tabelat në MAS, në formë shkresore dhe elektronike, në format Excel.

13. Kandidatët fitues kryejnë regjistrimin e tyre përfundimtar në IAL nga data 16 deri në datën 20 nëntor 2015, duke paraqitur dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:
i) emri, atësia, mbiemri;

ii) datëlindja; iii)

vendlindja; iv) shtetësia;

v) numri i matrikullimit që ka pasur në programin e studimit të ciklit të parë; vi) emërtimi

i IAL-së dhe i programit të studimit të ciklit të parë, si dhe forma e studimit;

vii) numri i matrikullimit, si dhe emërtimi i programit të studimit të ciklit të dytë dhe të fakultetit përkatës në IAL-në nga ku transferohet; viii) cikli dhe forma e studimit; ix) data e regjistrimit ne programin e studimit të ofruar nga IAL-ja nga ku transferohet; x) data e ndërprerjes së studimeve.

14. Në datën 23 nëntor 2015, IAL-ja shpall në vende të dukshme, publikon në faqen e saj ëeb, si dhe ia përcjell MAS-it elektronikisht, listën emërore të kandidatëve të regjistruar.

15. IAL-të publike i dërgojnë MAS-it dhe AKP-së, brenda datës 24 nëntor 2015, me shkresë zyrtare përmes postës, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike, në format Excel, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi.

16. AKP-ja, brenda datës 21 dhjetor 2015 i dërgon IAL-ve publike në rrugë postare, listën me numrat e matrikullimit të studentëve. IAL-të publike çregjistrojnë studentët e papajisur me numër matrikullimi, si dhe ia komunikojnë çregjistrimin AKP-së brenda 10 ditëve nga marrja e komunikimit zyrtar nga AKP-ja me listat me numrat e matrikullimit.

17. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës nr. 2 të këtij udhëzimi.

18. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

SHTOJCA NR. 2

DEKLARATË
Unë i nënshkruari , lindur më

emër, atësi, mbiemër me kartë

identiteti/pasaportë nr. :

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë , Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre.

Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me studimet universitare ku kam aplikuar për t?u regjistruar/periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdolloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk kam aplikuar për t?u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015-2016.

3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

4. Deklaroj se jam njohur me udhëzimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për kriteret dhe procedurat e pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për

program të dytë studimi, në programet e ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë, institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2015-2016" dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit për transferim/program të dytë studimi, si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për shpërndarjen e kuotave të transferimit të studimeve, si dhe kuotat për programe të dyta studimi, në programet e ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë, "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura", në vitin akademik 2015-2016", për të aplikuar për transferim studimesh/program të dytë studimi.

5. Deklaroj se jam njo hur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shtesë, të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të IAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe të dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes se dokumenteve të falsifikuara, apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja, nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ua përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër Emër, mbiemër i kandidatit i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firmë Firmë
Vendi: Data:

UDHËZIM

Nr. 49, datë 02.11.2015

"PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE TË REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT ME STATUSIN E ISH-TË DËNUARIT DHE TË PËRNDJEKURIT POLITIK NGA SISTEMI KOMUNIST, TË VERBRIT, TË INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, TË JETIMIT, SI DHE ROMËT DHE BALLKANO-EGJIPTIANËT, PËR PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË ME KOHË TË PLOTË, "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTERI SHKENCAVE"/"MASTER I ARTEVE TË BUKURA", PËR VITIN AKADEMIK 2015-2016"

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 34, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 135, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", i ndryshuar të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit, të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, ""Për statusin e jetimit", të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe

të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015-2016", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Kandidatët me statusin e ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politik, të verbrit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe romët dhe ballkano-egjiptianët, aplikojnë direkt në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), nga data 2 deri më 9 nëntor 2015.

Kandidatët shprehin 5 preferenca të ndryshme lidhur me aplikimin në programet e preferuara të studimit sipas formularit në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

II. Aplikimi bëhet duke dorëzuar në MAS, personalisht, dokumentacionin e mëposhtëm në dy kopje:

1. Për të gjithë kandidatët:

a) Letërmotivimi ku të shpjegojë arsyet e aplikimit, si dhe të zgjedhjes së programeve të studimit të përcaktuara në formular prej tij;

b) Formulari i aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në formular duhen radhitur pesë programe studimi ku kandidati kërkon të aplikojë, si dhe institucioni i arsimit të lartë (IAL) përkatës, në renditje prioritare, pra i pari renditet programi më i preferuar dhe i fundit ai me pak i preferuar nga të pesta programet. Për emërtimin dhe ID-në e programit përkatës u duhet referuar Tabelave nr. 1/1 dhe 2/2, të vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015-2016", i ndryshuar.

c) Diplomë universitare e ciklit të parë të studimeve të përfunduar brenda Republikës së Shqipërisë, së bashku me suplementin e diplomës ose listën e notave. Në mungesë të diplomës, IAL-të publike pajisin kandidatin me një vërtetim që provon mbarimin e studimeve, si dhe lejon regjistrimin në ciklin e dytë të studimeve. Kandidati paraqet vërtetimin në IAL-në ku kërkon të regjistrohet sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim, dhe brenda 6 muajve dorëzon fotokopjen e njësuar me origjinalin të kartonit të diplomës të lëshuar nga IAL-ja përkatëse. Për diplomën universitare të ciklit të parë të fituar jashtë vendit, të depozitohet dhe vërtetimi i njohjes dhe i njësimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Për kandidatët të cilët nuk kanë njësuar diplomat e tyre të fituara jashtë vendit, depozitojnë dokumentacionin për njësim diplome në të njëjtën ditë me aplikimin.

d) Fotokopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri dhe të njohur nga MAS-i. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme, së bashku me vërtetimin nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) për shlyerjen e provimeve me zgjedhje, nëse kanë dhënë provime të tilla. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore dhe provimesh me zgjedhje (nëse kanë dhënë provime të tilla) të lëshuar nga AKP-ja ose dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të

vërtetuar në njësinë arsimore vendore ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

e) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); f) Dy fotografi personale.

2. Kandidati me statusin e ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politik, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1 duhet të dorëzojë:

a) për ish-të dënuarit, fotokopjen e njësuar në Republikën e Shqipërisë të dokumentit që vërteton statusin e ish-të dënuarit, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;

b) për ish-të përndjekurit politikë, fotokopjen e njësuar në Republikën e Shqipërisë të dokumentit që vërteton statusin e ish-të përndjekurit, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme;

3. Kandidati me statusin e të verbrit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1 duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës së të verbrit, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

4. Kandidati me statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1) duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e librezës së invalidit paraplegjik e tetraplegjik të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje e noterizuar e vendimit të KMCAPja.

5. Kandidati me statusin e jetimit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1 duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të dokumentit që certifikon statusin e jetimit, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

6. Kandidati rom dhe ballkano-egjiptian, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1 duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano^egjiptian.

III. Komisioni i posaçëm, i përbërë nga Sekretari i Përgjithshëm i Arsimit dhe Sportit, në cilësinë e kryetarit dhe 4 anëtarë, nga të cilët dy përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe dy përfaqësues nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shqyrton dhe vlerëson aplikimet e kandidatëve me statusin përkatës brenda datës 16 nëntor 2015. Pjesë e vlerësimit të jetë dhe intervista me secilin kandidat, që zhvillohet nga Komisioni i Posaçëm. Aplikimet me dokumentacion të paplotë nuk merren në konsideratë. Vlerësimi të bëhet mbi kriterin e meritës, bazuar në notën mesatare të të gjitha viteve të studimeve universitare të ciklit të parë, si dhe eventualisht në notën mesatare të të gjitha viteve të shkollës së mesme, duke vlerësuar dhe programet që gjykohet të jenë prioritare sipas propozimeve të autoriteteve të vendeve përkatëse, si dhe duke marrë parasysh kapacitetet pritëse të çdo IAL-je për programin përkatës të studimit. Nëse do të rezultojnë kandidatë me pikë të barabarta, do t'i nënshtrohen testimit që do të kryhet nga MAS-i.

IV. Brenda datës 20 nëntor 2015, MAS-i përcjell në IAL-të respektive listën e renditur të kandidatëve të përzgjedhur sipas procedurës së mësipërme dhe një kopje të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati, për të vijuar me regjistrimin e kandidatëve në programet përkatëse të studimit. MAS-i publikon në faqen ëeb listën kandidatëve dhe afatet e regjistrimit të tyre në IAL-të përkatëse.

V. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës 27 nëntor 2015.

VI. Me mbylljen e regjistrimit përfundimtar, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në AKP, brenda datës 30 nëntor 2015, listat përfundimtare të përgatitura sipas formatit të dërguar nga AKP-ja, me regjistrimet e kryera për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për dhënien e numrave të matrikullimit, në formë të shkruar dhe elektronike.

VII. AKP-ja, brenda datës 29 dhjetor 2015, u dërgon IAL-ve publike në rrugë postare, listën me numrat e matrikullimit të studentëve. IAL-të publike çregjistrojnë studentët e papajisur me numër matrikullimi, dhe ia komunikojnë çregjistrimin AKP-së brenda 10 ditëve nga marrja e komunikimit zyrtar nga AKP-ja me listat me numrat e matrikullimit.

VIII. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Komisioni i Posaçëm, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

SHTOJCA NR. 1

Tiranë, më ___.___.2015

FORMULAR APLIKIMI

Unë i nënshkruari , lindur më ,

emër, atësi, mbiemër me kartë

identiteti/pasaportë nr. , e-mail: ,

tel: :

1. Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit:

a) , ID , në IAL ; ose

b) , ID , në IAL ; ose

c) , ID , në IAL ; ose

d) , ID , në IAL ; ose

e) , ID , në IAL .

2. Deklaroj se jam (të shënohet me "x" kategoria e veçantë së cilës i përket kandidati): a) i/e verbër;

   b) invalid paraplegjik/tetraplegjik;
   c) jetim;
   d) rom;
   e) ballkano-egjiptian.

3. Autorizoj institucionet e arsimit të lartë të sipërcituara, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të m ia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdolloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, aplikimin, si dhe të dhënat e deklaruara në këtë formular.

4. Deklaroj se nuk kam aplikuar për t?u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015-2016.

5. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj. Deklaroj se jam njohur me udhëzimin "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe regjistrimit për kandidatët me statusin e të verbrit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe romët dhe ballkano-egjiptianët, për programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura", për vitin akademik 2015-2016" dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe të dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara, apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e

nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ua përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit Emër, mbiemër i kandidatiti punonjësit që pranoi aplikimin Firmë

Firmë

UDHËZIM

Nr. 50, datë 03.11.2015

"PËR ZHVILLIMIN E KONKURSEVE TË PRANIMIT, TARIFËN E REGJISTRIMIT PËR KONKURRIM NË DISA PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË DYTË MË KOHË TË PLOTË "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I SHKENCAVE"/"MASTER I ARTEVE TË BUKURA", NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, TIRANË, NË VITIN AKADEMIK 2015-2016"

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 26, 34 dhe 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 135 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, vendimin nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015-2016", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pranimet në programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vitin akademik 20152016, në Universitetin e Arteve, Tiranë, bëhen mbi bazën e rezultateve të ciklit të parë dhe të rezultateve të fituara nga konkursi i pranimit, i organizuar nga ky institucion publik i arsimit të lartë.

2. Rezultatet e ciklit të parë (nota mesatare e viteve të shkollimit), të llogariten në masën 30% dhe rezultatet e konkursit të pranimit në masën 70%, sipas tabelës nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

3. Për të gjitha programet e studimit, sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, pikët minimale dhe maksimale të konkurseve përcaktohen në tabelën nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

4. Rregulloret dhe programet e konkurseve, të miratuara nga Universiteti i Arteve, Tiranë, të bëhen publike, duke filluar nga data 3 nëntor 2015.

5. Rektorati dhe dekanatet e Universitetit të Arteve, Tiranë, të shpallin në mjediset e tyre, si dhe në faqet ëeb përkatëse deri në datën 3 nëntor 2015, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për të siguruar një ecuri normale të procesit të regjistrimit në konkursin e pranimit në ciklin e dytë me kohë të plotë.

6. Kandidatët brenda vendit, si edhe kandidatët shqiptarë, që do të marrin pjesë në konkurset e pranimit për këto programe studimi, nga Republika e Kosovës, nga Republika e Maqedonisë, nga Republika e Malit të Zi dhe nga Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, të regjistrohen për zhvillimin e konkursit pranë sekretarive mësimore të fakultetit përkatës, nga data 3 nëntor 2015 deri në orën 12:00 të datës 6 nëntor 2015.

7. Sekretaritë mësimore të fakulteteve për-katëse, pas verifikimit të listave të të regjistruarve, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, i përcjellin dekanatit listat e aplikantëve për shpallje dhe afishim në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 16:00, të datës 6.11.2015.

8. Konkurset e pranimit të zhvillohen në datat 10-12 nëntor 2015.

9. Tarifa e regjistrimit të kandidatëve pjesë-marrës në konkurset e pranimit është 3,000 lekë.

10. Konkurset e pranimit monitorohen nga përfaqësues të MAS-it.

11. Rezultatet e konkurseve të pranimit të dërgohen në MAS e në AKP, në formë shkresore dhe elektronike në CD, brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre.

12. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe Universiteti i Arteve, Tiranë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 51, datë 01.12.2015

PËR PROCEDURËN E PRANIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË ME KOHË TË PLOTË, "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I SHKENCAVE"/"MASTER I ARTEVE TË BUKURA", PËR SHTETASIT E HUAJ QË KËRKOJNË TË STUDIOJNË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2015–2016

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", pikës 1/"ç", të pikës 6 dhe pikës 16, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 638, datë 22.7.2015, të

Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015–2016", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Studentët e huaj që aplikojnë individualisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit apo në kuadër të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe ose shumëpalëshe, për ndjekjen e studimeve në ciklin e dytë të studimeve "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura", për vitin akademik 2015–2016, të përzgjidhen për programin e studimit të kërkuar, në bazë të dosjeve të aplikantëve të përcjella individualisht nga vetë të interesuarit ose të ardhura nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, nga ministritë e arsimit të vendeve përkatëse ose nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë.

2. Studentët e huaj, duhet të paraqesin në Drejtorinë e Integrimit dhe Projekteve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, deri në datën 4 dhjetor 2015 dokumentet e mëposhtme:

a) Formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) Vërtetim që nuk ka qenë i ndjekur penalisht dhe që nuk është në ndjekje penale, në vendin e origjinës, i lëshuar 3 muajt e fundit;

c) Fotokopjen e dokumentit personal të identitetit;

d) Fotokopjen të njësuar me origjinalin të vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë të diplomës së ciklit të parë të studimeve të shoqëruar me kopje të njësuar me origjinalin të diplomës ose të listës së notave;

e) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri;

f) Kopjen e njësuar të origjinalit të lejeqëndrimit për shtetasit e huaj, lëshuar nga Ministria e Brendshme, nëse disponohet nga aplikuesi; g) *Curriculum Vitae*;

h) Deklaratën sipas shtojcës nr. 2 të këtij udhëzimi.

3. Kur dokumentacioni paraqet mangësi, Drejtoria e Integrimit dhe Projekteve i kërkon aplikantit plotësimin e tij brenda datës 9 dhjetor 2015. Drejtoria e Integrimit dhe Projekteve dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, shqyrtojnë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi dhe, në rastet kur numri i kërkesave është më i lartë se ai i kuotave të miratuara për shtetasit e huaj për ciklin përkatës të studimit, bëjnë renditjen e kandidatëve sipas kriterit të meritës dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues në programet e studimit përkatës, bazuar dhe në kapacitetet pritëse të IAL-ve. Kërkesat e aplikantëve që nuk kanë dorëzuar dokumentacion të plotë, sipas specifikimeve në këtë udhëzim brenda afateve të parashikuara, nuk do të merren në shqyrtim.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit u dërgon institucioneve publike të arsimit të lartë, brenda datës 15 dhjetor 2015, dokumentacionin përkatës të aplikantëve të përzgjedhur sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, për të kryer procedurat e mëtejshme të regjistrimit në programet e studimit përkatës.

5. Shtetasit e huaj, brenda datës 23 dhjetor 2015, paraqiten pranë sekretarive mësimore të fakulteteve përkatëse për të përfunduar procedurat e regjistrimit në programin përkatës të studimit.

6. Brenda datës 28 dhjetor 2015, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Agjencinë Kombëtare të Provimeve (AKP) listat përfundimtare në dy kopje, në formë të shkruar dhe elektronike, me regjistrimet e kryera për shtetasit e huaj, për çdo program studimi, të plotësuara, sipas shtojcës nr. 3 të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", i ndryshuar. AKP-i përgatit dhe u përcjell IAL-ve përkatëse numrat e matrikullimit të shtetasve të huaj brenda datës 15 janar 2016.

7. Ngarkohen, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Drejtoria e Integrimit dhe Projekteve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet publike të arsimit të lartë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

UDHËZIM

NR. 52, DATË 03.12.2015

"PËR PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË"
(Ndryshuar me udhëzimin nr.11, datë 30.06.216; nr.258, datë 03.08.20016; nr.5, datë16.02.2017; nr.11, datë 10.04.2017; nr.20,datë 22.09.2017)

Në mbështetje pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4, të nenit 76 dhe pikës 3, të nenit 78, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e niveleve dhe testeve ndërkombëtare të 5 (pesë) gjuhëve të huaja, përkatësisht: gjuhës angleze, gjuhës frënge, gjuhës gjermane, gjuhës italiane dhe gjuhës spanjolle. Kandidatët, të cilët aplikojnë për t'u pranuar në programe studimi të ciklit të dytë apo të tretë në institucionet e arsimit të lartë, duhet të kenë nivel të njohjes së njërës prej gjuhëve të huaja, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.

2. Klasifikimi i aftësive gjuhësore dhe niveleve të njohjes së gjuhëve, bëhet sipas tabelës bashkëlidhur këtij udhëzimi në referencë të pikëve të testimeve të ndryshme ndërkombëtare dhe shërben si standard për njohjen e gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare përkatëse në Shqipëri.

3. Për pranimin në programet e studimit të ciklit të dytë kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, ndërmjet nivelit B1 dhe nivelit C1. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloret e tyre nivelin e gjuhës, që do të jetë kriter hyrës në programet e studimit të ofruara prej tyre në ciklin e dytë, brenda niveleve të sipërcituara në këtë pikë të udhëzimit. Për pranimin në programin e studimeve të ciklit të tretë, kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, të nivelit C1.

4. Kandidati që aplikon për t'u pranuar në programe studimi të ciklit të dytë apo të tretë në institucionin e arsimit të lartë, duhet të ketë certifikime dhe rezultate të testimeve ndërkombëtare për nivelet e njohjes së gjuhëve, të cilat i përkasin një periudhe jo më vonë se 2 (dy) vjet nga momenti i lëshimit të tyre.

5. Dokumenti i njohjes së gjuhëve, mund të jetë një certifikatë, diplomë apo dëshmi, e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare.

6. Institucionet e arsimit të lartë duhet të shpallin në faqen zyrtare dhe ambientet e tyre:
a) Listën e niveleve të njohjes së gjuhëve të huaja dhe testimeve ndërkombëtare në referencë të përcaktimeve të tabelës 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi, të përcaktuar si kriter pranimi në programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë në atë institucion;

b) Listën e subjekteve të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testimet ndërkombëtare.

7. Institucionet e arsimit të lartë duhet të garantojnë akses dhe mundësi të barabarta për të gjitha subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testimet ndërkombëtare dhe certifikimin të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

8. Institucionet e arsimit të lartë, përcaktojnë në rregulloret e tyre, modalitetet e dorëzimit dhe verifikimit të certifikimit të nivelit të njohjes së gjuhës së huaj, në përputhje me procedurat e tjera të pranimit të kandidatit në programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë.

9. Subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale për ofrimin e testeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, certifikimet e të cilëve do të shërbejnë në përmbushjen e detyrimit ligjor, duhet të:

a) Paraqesin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, dokumentacionin ligjor për të drejtën e pronësisë intelektuale dhe ofrimin e testeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas procedurave dhe afateve kohore të publikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

b) Nënshkruajnë marrëveshjen me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me qëllim njohjen e të drejtës së subjektit për ofrimin e testeve, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, shkëmbimin e informacionit në lidhje me testimet ndërkombëtare, si dhe ofrimin e të dhënave për të gjithë kandidatët që aplikojnë në institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë.

10. Subjektet që ofrojnë kurse përgatitore, për prodhimin ose/dhe shpërndarjen e teksteve didaktike të gjuhëve të huaja, nuk mund të jenë ofruese të shërbimit të testimeve dhe certifikimeve ndërkombëtare.

11. Studentët e regjistruar në ciklin e dytë apo të tretë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë, të cilët nuk i janë nënshtruar testimit të gjuhës angleze, si dhe nuk kanë paraqitur dokumentacion pranë institucioneve të arsimit të lartë, sipas udhëzimit nr. 14, datë 28.3.2011, "Për njohjen e testimeve dhe certifikimeve për gjuhën angleze për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë", kryejnë testimin sipas këtij udhëzimi.

12. Udhëzimi i ministrit të MASH-it nr. 14, datë 28.3.2011, "Për njohjen e testimeve dhe certifikimeve për gjuhën angleze për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në i nstitucionet e arsimit të lartë", shfuqizohet.

13. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

2016

UDHËZIM

Nr. 13, datë 22.07.2016

PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2016–2017 *(Ndryshuar me udhëzimin nr.15, datë 01.08.2016; nr.22, datë 06.09.2016; nr.24, datë 07.10.2016; nr.17, datë 29.12.2016)*

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 1.6.2016, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017",

UDHËZOJ:

I. Hedhja e të dhënave në portalin e maturantit dhe përzgjedhja e programeve të studimit në portalin e Maturës Shtetërore *on-line*

1. Portali i maturantit është një sistem elektronik baze të dhënash, i cili administron të dhënat e rezultateve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë.

2. Përzgjedhja e programeve të studimit dhe regjistrimi i fituesve të shpallur nga IAL-të, sipas kritereve të përcaktuara me vendim senati prej tyre, i maturantëve/kandidatëve në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë (IAL), në vitin akademik 2016–2017, do të bëhet nëpërmjet "Portali i Maturës Shtetërore *on-line*". Ky portal është sistem elektronik baze të dhënash, i cili administron:

a) procedurat e aplikimit nga maturantët/ kandidatët me formularët A1 dhe A1Z;

b) rezultatet e Maturës Shtetërore;

c) procesin e përzgjedhjes së preferencave në programet e studimit të IAL-ve (publike dhe jopublike);

d) regjistrimin e studentëve të shpallur fitues nga IAL-të.

3. Përzgjedhja e programeve të studimit nga maturantët/kandidatët për programet e ciklit të parë të studimeve, për programet e studimeve me karakter profesional dhe për programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë (IAL), në vitin akademik 2016–2017, fillon pas përfundimit të procesit të hedhjes nga drejtoritë e shkollave në portalin *on–line* të maturantit, të të dhënave lidhur me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë.

4. Për të gjithë maturantët e vitit shkollor 2015–2016, të cilët kanë aplikuar me formularin A1, nga drejtoritë e shkollave hidhen në portalin *on-line* të maturantit të gjitha të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

5. Për kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë përpara vitit shkollor 2015–2016 dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e shkollave, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen në portalin *on-line* të maturantit të gjitha të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

6. Për të gjithë kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e shkollave, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen në portalin *on-line* të maturantit të gjitha të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm. II. Raundi i parë i aplikimeve

1. Të gjithë kandidatët, për ndjekjen e studimeve në institucionet e arsimit të lartë, publike dhe jopublike, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të dytë, me kohë të plotë, duhet të kryejnë procesin e aplikimit *on-line* në portalin e Maturës Shtetërore.

2. Aplikimi të kryhet nga kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, janë pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor, nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, në IAL-të publikdhe/ose jopublike, plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit për të cilat aplikojnë.

3. Kandidatët, përpara aplikimit në portalin e Maturës Shtetërore, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës së publikuar në faqen zyrtare elektronike të AKP-së.

4. Mandati i pagesës dorëzohet në shkollën përkatëse, ku kandidatët kanë kryer plotësimin e formularit A1/A1Z. Pas dorëzimit të mandatit të pagesës, sekretaritë e shkollave hedhin në sistem notën mesatare të llogaritur sipas VKM-së nr. 407, datë 1.6.2016, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017", deri më 10 gusht 2016. 5. Kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM-në nr. 407, datë 1.6.2016.

6. Të gjithë kandidatët që duan të ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit, pas pagesës së tarifës së aplikimit dhe hedhjes në sistem të notës mesatare, do të aplikojnë në portalin e Maturës Shtetërore, nëpërmjet formularit të aplikimit, për çdo DAR/ZA sipas kalendarit bashkëlidhur këtij udhëzimi, në datat 1–11 gusht 2016.

7. Aplikimi nëpërmjet formularit të aplikimit në portalin e Maturës Shtetërore në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017, kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti (sipas procedurave të përshkruara në udhëzuesin teknik të publikuar në faqen zyrtare të AKP-së). Kandidatët aksesohen në portal me kredencialet e tyre: ID-në e kandidatit; emri, atësia, mbiemri; karta e identitetit; *e-mail*-i i kandidatit etj., duke zgjedhur deri në 10 (dhjetë) programe studimi nga lista e programeve të studimit që ofrohen nga IALtë publike dhe/ose jopublike, për vitin akademik 2016–2017.

8. Portali i Maturës Shtetërore nuk do të pranojë aplikime nga kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, si dhe kriteret specifike të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

9. AKP-ja u përcjell IAL-ve që parashikojnë konkurse pranimi, në format elektronik dhe zyrtarisht, brenda datës 16 gusht 2016, listën e aplikantëve që konkurrojnë në programet përkatëse të studimit.

10. AKP-ja u përcjell IAL-ve, në format elektronik dhe zyrtarisht, brenda datës 30 gusht 2016, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre, listën e kandidatëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi, së bashku me notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme, rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore, si dhe tregues vlerësimi të tjerë të nevojshëm për renditjen dhe shpalljen e fituesve nga ana e IAL-ve.

11. Të gjitha IAL-të publike dhe jopublike që në kriteret e tyre kanë përcaktuar konkurs/testime etj., do t'i afishojnë listat e pjesëmarrësve në konkurset e pranimit, në datën 16 gusht 2016, në mjediset e tyre dhe në faqet zyrtare elektronike përkatëse, si dhe do të realizojnë këto konkurse, në periudhën 20 deri 30 gusht 2016.

12. Brenda datës 4 shtator 2016, IAL-të, e pikës 11 të këtij kreu, hedhin në sistemin informatik pikët e secilit kandidat në konkurrim.

13. Çdo IAL që zhvillon konkurse për pranimin në programet përkatëse të studimit që ofron, pas kryerjes së përllogaritjeve të pikëve për çdo konkurrent, sipas kritereve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja, si dhe pas renditjes së studentëve në varësi të pikëve të grumbulluara, afishon në mjedise publike si dhe në faqen e saj zyrtare listat e renditjes së aplikuesve, ku fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit me konkurs. Afishimi dhe publikimi duhet bërë brenda datës 5.9.2016. Një kopje elektronike e këtyre listave i përcillet AKP-së brenda datës 6.9.2016.

14. IAL-të të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kritereve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. Në listën e publikuar, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

15. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

16. IAL-të shpallin listat jopërfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 5.9.2016, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Një kopje elektronike e këtyre listave i përcillet AKP-së brenda datës 6.9.2016.

17. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 11.9.2016, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Një kopje elektronike e këtyre listave i përcillet AKP-së brenda datës 12.9.2016.

18. Të gjithë kandidatët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e parë dhe janë shpallur fitues nga IAL-të, duhet të kryejnë procesin e regjistrimit *on-line* dhe me dokumentacion në sekretaritë mësimore të IAL-ve në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet, në datat 13–20 shtator 2016. Kandidati që është shpallur fitues në më shumë se një program studimi, lejohet të regjistrohet vetëm në njërin nga programet e studimit ku është fitues.

19. Sekretaritë mësimore të IAL-ve do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues. Kandidatët dorëzojnë personalisht, ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e një prej dokumenteve të identifikimit;

b) Fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar në MAS;

c) Deklaratën e paraqitur në shtojcën bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga kandidati në

prani të punonjëses së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe nënshkruhet nga kandidati dhe nga kjo e fundit; d) Dy fotografi personale.

20. Sekretaritë mësimore të fakulteteve të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.

III. Raundi i dytë i aplikimeve

1. Për të gjithë maturantët që kanë rezultuar kalues në provimet e sesionit të dytë (sesioni i vjeshtës), nga drejtoritë e shkollave hidhen në portalin *on-line* të maturantit, të gjitha të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm menjëherë pas publikimit të rezultateve të provimeve të këtij sesioni.

2. Të gjitha IAL-të, brenda datës 22 shtator 2016, i dërgojnë AKP-së numrin e kuotave të paplotësuara për çdo program studimi, në rrugë elektronike dhe zyrtare.

3. Të gjithë kandidatët, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe rezultojnë kalues në provimet e Maturës Shtetërore, por nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë për arsye të ndryshme dhe kandidatët që kanë kryer procesin e aplikimit *on-line* në raundin e parë dhe nuk janë shpallur fitues apo nuk kanë arritur të regjistrohen, të kryejnë procesin e aplikimit *on-line* në raundin e dytë me formularin e aplikimit në portalin e Maturës Shtetërore duke bërë 10 (dhjetë) përzgjedhje preferencash, për çdo DAR/ZA sipas kalendarit bashkëlidhur këtij udhëzimi në datat 23 shtator – 1 tetor 2016.

4. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti (sipas procedurave të përshkruara në udhëzuesin teknik të publikuar në faqen zyrtare të AKP-së).

5. Kandidatët që nuk kanë aplikuar në raundin e parë, përpara aplikimit në portalin e Maturës Shtetërore, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 lekë dhe e paraqesin në sekretarinë e shkollës, ku kandidatët kanë kryer plotësimin e formularit A1/A1Z.

6. Pas dorëzimit të mandatit të pagesës, sekretaritë e shkollave hedhin në sistem notën mesatare të llogaritur sipas VKM-së nr. 407, datë 1.6.2016, në datat 22–29 shtator 2016.

7. AKP-ja u përcjell IAL-ve, në format elektronik dhe zyrtarisht, brenda datës 4 tetor 2016, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre, listën e kandidatëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi, së bashku me notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme, rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore, si dhe tregues vlerësimi të tjerë të nevojshëm për renditjen dhe shpalljen e fituesve nga ana e IAL-ve.

8. IAL-të të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kritereve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes.

9. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

10. IAL-të shpallin listat jopërfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 6 tetor 2016, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Një kopje elektronike e këtyre listave i përcillet AKP-së brenda datës 7 tetor 2016.

11. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 12 tetor 2016, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Një kopje elektronike e këtyre listave i përcillet AKP-së brenda datës 13 tetor 2016.

12. Të gjithë kandidatët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e dytë dhe janë shpallur fitues nga IAL-të, duhet të kryejnë procesin e regjistrimit *on-line* dhe me dokumentacion në sekretaritë mësimore të IAL-ve, në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet, deri në datën 16 tetor 2016. Kandidati që është shpallur fitues në më shumë se një program studimi, lejohet të regjistrohet me dokumentacion vetëm në njërin nga programet e studimit ku është fitues.

13. Pas datës 16 tetor 2016, deri në datën 20 tetor 2016, sekretaritë mësimore të IAL-ve do të regjistrojnë *on-line* dhe me dokumentacion, deri në plotësimin e numrit të kuotave për programin e studimit përkatës, të gjithë kandidatët e tjerë që kërkojnë të regjistrohen, duke respektuar renditjen në lista. Kandidati nuk mund të regjistrohet në më shumë se një program studimi.

14. Sekretaritë mësimore të IAL-ve do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë kandidatët që do të regjistrohen. Kandidatët dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e një prej dokumenteve të identifikimit.

b) Fotokopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar në MAS.

c) Deklaratën e paraqitur në shtojcën bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga kandidati në prani të punonjëses së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe nënshkruhet nga kandidati dhe nga kjo e fundit. d) Dy fotografi personale.

15. Sekretaritë mësimore të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.

IV. Aplikimi nga kandidatë shtetas të huaj

1. Të gjithë kandidatët shtetas të huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimittë lartë në Republikën e Shqipërisë, paraqesin vetë apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, kopje të dokumenteve me të dhënat e

rezultateve të të gjitha viteve shkollore të arsimit të mesëm dhe mandatin e arkëtimit të tarifës së aplikimit në shkollat apo institucionet arsimore të autorizuara nga MAS-i.

2. Aplikimi me formularin A1Z kryhet në shkollat apo institucionet arsimore të autorizuara nga MAS për hedhjen në portalin e Maturës Shtetërore të rezultateve të provimeve të MSH-së dhe notës mesatare, të njësuara në MAS, nën mbikëqyrjen e specialistëve të DAR/ZA-ve dhe MAS-it, në datat 31 gusht 2016–4 shtator 2016.

3. Kandidatët shtetas të huaj duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe të jenë të pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor, nuk duhet të rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi në IAL-të publike dhe/ose jopublike, të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.

4. Kandidatët shtetas të huaj, përpara aplikimit në portalin e Maturës Shtetërore, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës së publikuar në faqen zyrtare elektronike të AKP-së.

5. Kandidatët shtetas të huaj që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM-në nr. 407, datë 1.6.2016.

6. Kandidatët shtetas të huaj, për ndjekjen e studimeve në institucionet e arsimit të lartë, në programet e ciklit të parë, atyre të integruara dhe programet me karakter profesional, duhet të kryejnë procesin e aplikimit *on-line*, për kuotat për shtetasit e huaj, në portalin e Maturës Shtetërore, sipas procedurave të përshkruara në udhëzuesin teknik të publikuar në faqen zyrtare të AKP-së, në datat 5–10 shtator 2016.

7. Kandidatët shtetas të huaj aplikojnë me formularin e aplikimit, duke zgjedhur deri në 10 (dhjetë) programe studimi nga lista e programeve të studimit që ofrohen nga IAL-të, për vitin akademik 2016–2017.

8. Pasi ka përfunduar procesi i aplikimit në portalin e Maturës Shtetërore, AKP-ja u përcjell IAL-ve, në format elektronik dhe zyrtarisht, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre, listën e kandidatëve shtetas të huaj që kanë përzgjedhur ato programe studimi, së bashku me notën mesatare të viteve të shkollës së mesme.

9. IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues, në bazë të kuotave dhe kritereve të përcaktuara nga ana e tyre, në datat 11–14 shtator 2016.

10. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve sipas të dhënave të përcjella nga AKP-ja dhe mënyrën /formulën e përzgjedhjes së kandidatëve. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

11. Të gjithë kandidatët shtetas të huaj, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit *on-line* dhe janë shpallur fitues, duhet të paraqiten në sekretaritë mësimore të IAL-ve dhe të regjistrohen me dokumentacion në programin e studimit përkatës. Regjistrimi nga sekretaritë do të kryhet brenda datave 15–20 shtator 2016.

12. Kandidati shtetas i huaj që është shpallur fitues në më shumë se një program studimi, lejohet të regjistrohet me dokumentacion vetëm në njërin nga programet e studimit ku është fitues.

13. Sekretaritë mësimore të IAL-ve do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues. Shtetasit e huaj dorëzojnë personalisht, ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vërtetimin që nuk ka qenë i ndjekur penalisht dhe që nuk është në ndjekje penale, në vendin e origjinës,
i lëshuar tre muajt e fundit;

b) Fotokopjen e dokumentit personal të identitetit;

c) Fotokopjen e njësuar me origjinalin të vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë nga komisioni i posaçëm për njohjen e diplomave të arsimit të mesëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

d) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe;

e) Autorizimin për trajtimin e të dhënave personale sipas shtojcës bashkëlidhur këtij udhëzimi.

14. Sekretaritë mësimore të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.

V. Dispozita kalimtare dhe hyrja në fuqi

1. Aplikimi për kuotat e veçanta, për kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe kandidatët me status të verbri, invalidi paraplegjik dhe tetraplegjik, jetim, rom dhe egjiptian do të bëhet në institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MAS-it.

2. Aplikimi për program të dytë studimi dhe për transferimin e studimeve do të bëhet në institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MAS-it.

3. IAL-të të dorëzojnë në AKP, në formë zyrtare dhe elektronike, brenda datës 30 nëntor

2016, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar për pajisjen e studentëve me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", të ndryshuar, si dhe deklaratën sipas shtojcës bashkëlidhur këtij udhëzimi. AKP-ja u dërgon IAL-ve, brenda datës 31.12.2016, numrat individualë të regjistrimit (matrikullimit) të studentëve të regjistruar.

4. Kandidatët e shpallur fitues në programet e studimit me kohë të plotë nuk mund të regjistrohen për të ndjekur njëkohësisht studimet në dy programe studimi në IAL-të publike dhe/ose jopublike, në të njëjtin vit akademik.

5. IAL-të të përpilojnë një raport të hollësishëm në lidhje me regjistrimet e studentëve në afatet dhe formatet e kërkuara sipas udhëzimit nr. 9, datë 25.2.2010, "Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore". Ky raport të dërgohet në MAS, brenda datës 15 dhjetor 2016.

6. Ngarkohen, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, DAR/ZA-të dhe IAL-të, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

SHTOJCA 1

DEKLARATË

Unë i nënshkruari , lindur më , me

kartë identiteti, pasaportë nr. .

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë ,

Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve, për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve, për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve, që lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017.

3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit Emër, atësi, mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma: Firma:

Vendi: Data: ____ . ____.

SHTOJCA 2

KALENDARI I APLIKIMEVE PËR RAUNDIN E PARË

Planit kalendar i aplikimit *on-line* me formularin e aplikimit në IAL

DAR/ZA							
Tirana qytet	Tirana qark						
Tirana qytet	Tirana qark						

Tirana qytet	Tirana qark	Kamëz	Kavajë	Durrës	Krujë		
Elbasan	Peqin	Gramsh	Librazhd	Korçë	Pograde	Kolonjë	Devoll
Fier	Mallakastër	Lushnjë	Berat	Kuçovë	Skrapar		
Shkodër	M. e Madhe	Pukë	Lezhë	Kurbin	Mirditë		
Vlorë	Sarandë	Delvinë	Gjirokastë	Tepelenë	Përmet		
Kukës	Has	Tropojë	Dibër	Mat	Bulqizë		

SHTOJCA 3

KALENDARI I APLIKIMEVE PËR RAUNDIN E DYTË

Planit kalendar i aplikimit *on-line* me formularin e aplikimit për kuotat e paplotësuara

Datë	**DAR/ZA**							
23.9.16	Tirana qytet	Tirana qark						
24.9.16	Tirana qytet	Tirana qark						
25.9.16	Tirana qytet	Tirana qark	Kamëz	Kavajë	Durrës	Krujë		
26.9.16	Elbasan	Peqin	Gramsh	Librazhd	Korçë	Pogradec	Kolonjë	Devoll
27.9.16	Fier	Mallakastër	Lushnjë	Berat	Kuçovë	Skrapar		
28.9.16	Shkodër	M. e Madhe	Pukë	Lezhë	Kurbin	Mirditë		
29.9.16	Vlorë	Sarandë	Delvinë	Gjirokastë	Tepelenë	Përmet		
30.9.16	Kukës	Has	Tropojë	Dibër	Mat	Bulqizë		

SHTOJCA 4

KALENDARI I APLIKIMEVE PËR STUDENTËT E HUAJ

Planit kalendar i aplikimit *on-line* me formularin e aplikimit për shtetas të huaj

1. Nga datat 31 gusht 2016 deri në datën 4 shtator 2016, aplikime me formularin A1Z dhe pasqyrimin e notës mesatare.
2. Nga datat 5 deri në datën 10 shtator 2016 aplikimi në IAL.

UDHËZIM

Nr. 15, datë 01.08.2016

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 22.7.2016, "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2016–2017

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 1.6.2016, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017",

UDHËZOJ:

Pas kreut IV, të udhëzimit nr. 13, datë 22.7.2016, shtohet kreu IV/1, si më poshtë:

1. Zhvillimi i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimit objekt të këtij udhëzimi, në IAL-të që i zhvillojnë këto programe, si programe të përbashkëta studimi, që përfundojnë me një diplomë të përbashkët, të dyfishtë ose të shumëfishtë, në bashkëpunim me IAL të vendeve të BE-së, kryhet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara nga vetë IAL-të.

2. Njohja e dokumentacionit të kandidatëve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.

3. Kandidatët që aplikojnë në programet e përbashkëta të studimit e paraqesin aplikimin e tyre pranë IAL-së përkatëse. Të dhënat e tyre i dërgohen AKP-së nga IAL-ja në përfundim të procesit të regjistrimit të aplikimeve. Pas zhvillimit të konkurseve/testimeve të pranimit, IAL-ja i dërgon AKP-së listat e fituesve dhe të dhënat e tyre, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të nevojshëm për zhvillimin e procedurave të njohjes së diplomës.

4. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues nga AKP-ja, kryhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor. Pas përfundimit të njohjes, AKP-ja kryen regjistrimin e tyre përfundimtar me statusin e studentit dhe brenda datës 20 janar 2017 ia komunikon IAL-së.

5. Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm në institucione arsimore në të njëjtën gjuhë të huaj që zhvillohet edhe programi i përbashkët i integruar i studimit i ciklit të dytë i IAL-së ku aplikon, përjashtohen nga detyrimi i mbrojtjes së kësaj gjuhe sipas përcaktimeve të nenit 76, pika 4, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 17, datë 03.08.2016

PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË, TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË VENDIT

Ndryshuar me udhëzimin nr. 32, datë 29.12.2017; nr. 15, datë 16.4.2018; nr. 5, datë 21.2.2019, nr. 30, datë 30.12.2019

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 92, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Të drejtën për njohjen dhe njësimin e certifikatave, diplomave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të fituara jashtë vendit, e ka Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS).

Njohja dhe njësimi ka për qëllim njohjen e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Republikën e Shqipërisë.

Veprimtaria e njohjes dhe njësimit të diplomave dhe certifikatave, nënkupton administrimin dhe kryerjen e procedurave për të gjitha aplikimet për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që u përkasin niveleve nga 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe të titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë apo nga institucione të tjera të autorizuara nga kuadri ligjor i vendit përkatës për lëshimin e tyre.

1. Termat e mëposhtëm, të përdorur në këtë udhëzim, kanë kuptimin:

a) "Kualifikim" është një program studimi në përfundim të të cilit është lëshuar një certifikatë apo
diplomë e vlefshme zyrtarisht në vendin e origjinës që vërteton përfundimin e tij;

b) "Korniza Shqiptare e Kualifikimeve", në vijim (KSHK), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve" është një sistem kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve, sipas një tërësie kriteresh, për nivele specifike të të nxënit të përftuar, që ka për qëllim integrimin dhe koordinimin e nënsistemeve kombëtare të kualifikimeve dhe përmirësimin e transparencës, aksesit, përparimit dhe cilësisë së kualifikimeve që lidhen me tregun e punës dhe shoqërinë civile.

c) "Korniza Evropiane e Kualifikimeve", në vijim (KEK), sipas ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010, është një kornizë, që përmban 8 nivele, të miratuara nga Parlamenti Evropian, për të ndihmuar vendet dhe sektorët të krahasojnë kualifikimet, të përmirësojnë njohjen e ndërsjellë dhe të nxisin lëvizjen gjeografike, si dhe të nxënit gjatë të gjithë jetës.

d) "Institucione të autorizuara" janë institucione kompetente, të cilat nuk janë institucione të arsimit të lartë, por lëshojnë diploma dhe certifikata të arsimit të lartë të vlefshme në vendin e origjinës, që vërtetojnë përfundimin e studimeve, konform kuadrit ligjor në fuqi të vendit përkatës.

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk shqyrton aplikimet për rastet si më poshtë:

i) certifikata, diploma universitare dhe grada shkencore për programe studimi të ndjekura në Republikën e Shqipërisë; ii) certifikata, diploma universitare dhe grada shkencore të fituara nga

ndjekja e programeve të

studimit *online* apo në distancë; iii) dokumente për programe studimi të papërfunduara. Këto dokumente shqyrtohen nga institucioni i arsimit të lartë pranë të cilit aplikohet për transferim studimesh; iv) certifikata/dëshmi për kurse kualifikimi ose plotësuese, si gjuhë e huaj, kompjuter etj.;

v) diploma ose certifikata të fituara në institucione ushtarake të arsimit të lartë, përjashtuar diplomat për drejtime civile të studimeve; vi) certifikata, diploma universitare dhe grada

shkencore të fituara në institucione fetare të arsimit

të lartë, përjashtuar diplomat me drejtim civil studimi.

3. Kriteret që duhet të përmbushë certifikata dhe/ose diploma për t'u njohur dhe njësuar, janë:

1) Të jetë lëshuar nga institucione të licencuara, të njohura/akredituara të arsimit të lartë apo institucione të autorizuara në vendin e origjinës;

2) Programi i studimit në përfundim të të cilit lëshohet certifikata apo diploma të jetë i njohur/ akredituar në kohën e ndjekjes së studimeve dhe momentin e lëshimit të dokumentit në fjalë; 3) Certifikata apo diploma të jetë e vlefshme në vendin e origjinës; 4) Certifikata apo diploma të jetë autentike.

KREU II

MËNYRA E APLIKIMIT

1. Mënyrat e aplikimit për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që i përkasin nivelit nga 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare apo Evropiane të Kualifikimeve, janë: a) Aplikim shkresor (*hard-copy*), në rrugë postare;

b) Aplikim *online*, në faqen zyrtare të MAS-it, në rubrikën e rezervuar të njësimit të diplomave të
huaja sipas manualit të përdoruesit, publikuar në faqen zyrtare të MAS-it.

Në rastet e aplikimit *online*, ai duhet të shoqërohet me dërgimin në rrugë postare të dokumentacionit përkatës (*hard-copy*) në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Aplikimi për njohjen e titujve akademikë mund të bëhet vetëm përmes aplikimit shkresor (*hardcopy*).

Aplikimi shkresor dërgohet nga aplikanti në rrugë postare në MAS dhe më pas depozitohet në Sektorin e Protokollit në MAS, ku merr dhe numrin e regjistrit përkatës.

Në rastet kur aplikimi kryhet vetëm *hard-copy*, sektori i protokollit regjistron dhe hedh të dhënat në sistemin *online*. Në përfundim të procedurës, sektori i protokollit i dërgon me *email* aplikantit *username* dhe *passëord*-in e tij, të krijuar gjatë procesit të hedhjes së të dhënave. Aplikanti bën ndryshimin e *passëord*-it *online*.

Në rastin e aplikimit *online* dokumentacioni përcillet dhe në format *hard-copy* në rrugë postare në MAS dhe i përcillet më pas sektorit të njohjes së diplomave.

KREU III

DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PËRMBAJË APLIKIMI

1. Dokumentacioni i dërguar në rrugë postare në MAS për të dyja format e aplikimit të parashikuara në pikën 1 të kreut II të këtij udhëzimi, për njësimin e certifikatave dhe diplomave universitare të nivelit 5 deri në nivelin 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK) (me përjashtim të diplomave të doktoratës), duhet të përmbajë:

a) formularin e aplikimit të plotësuar individualisht, i cili shkarkohet nga faqja zyrtare e MAS-it (në rast se aplikohet vetëm në formë shkresore) ose atë të printuar pas aplikimit *online* (në rast se aplikohet *online*);

b) diplomën[71] ose certifikatën që vërteton përfundimin e studimeve (në rastet kur ky përbën
dokumentin zyrtar përkatës në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën);

c) listën e notave dhe/ose suplementin e diplomës;

d) fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës;

e) mandat pagesën *hard-copy* (në rastet kur aplikimi kryhet vetëm në rrugë shkresore).

1.2 Dokumentet e përcaktuara në këtë pikë të udhëzimit duhet të jenë dokumente origjinale (me përjashtim të diplomës) ose fotokopje të njësuara me origjinalin. Dokumenti i shkronjës "b" dhe/ose "c", duhet të jetë i pajisur me vulën apostille/ legalizimin[2]. Në rastet kur kjo

[71] Diplomat e lëshuara në Republikën e Kosovës duhet të pajisen me vulën përkatëse nga MASHTi dhe Agjencia e Akreditimit e Kosovës.

vulë/vërtetim, për sa më sipër, mungon, ndiqet procedura e përcaktuar në pikën 2.1 të kreut IV të këtij udhëzimi.

Dokumentet e dorëzuara për njohje nuk i kthehen më aplikantit.

Dokumentet e përcaktuara në germat "b" dhe "c" duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të dokumentacionit në gjuhën angleze, italiane dhe frënge për të cilat nuk është i domosdoshëm përkthimi në gjuhën shqipe. [2] Të gjitha dokumentet shkollore, që lëshohen nga institucionet arsimore të shteteve që janë palë e Konventës së Hagës, duhet të pajisen me vulën apostile. Bëjnë përjashtim dokumentet arsimore të lëshuara nga shtetet: Greqi, Gjermani, Spanjë, të cilat duhen të legalizohen nga përfaqësitë diplomatike shqiptare në këto shtete. E njëjta procedurë legalizimi vlen edhe për ato shtete të cilat nuk janë pjesë (palë) e Konventës së Hagës.

Në rastet e pamundësisë së kryerjes së procedurave të përkthimit në gjuhën shqipe, aplikanti mund të përkthejë dokumentin në vendin e origjinës në gjuhën angleze nga një përkthyes i autorizuar /licencuar për këtë qëllim, në vendin përkatës. Në këto raste dokumenti duhet të mbajë domosdoshmërish vulën apostile/legalizimin lidhur me përkthimin.

2. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore "doktor", duhet të përmbajë dokumentacionin si më poshtë:

a) formularin e aplikimit të plotësuar indivi-dualisht, i cili shkarkohet nga faqja zyrtare e MAS-it (në rast se aplikohet vetëm në formë shkresore) ose i printuar pas aplikimit *online* (në rast se aplikohet *online*);

b) kopje të diplomës dhe suplementit të saj (nëse ka të tillë) të lëshuar nga institucioni përkatës i arsimit të lartë, që dëshmon fitimin e gradës shkencore "doktor", si dhe kopje të noterizuara të studimeve pararendëse universitare;

c) disertacionin e doktoratës, në format *hard-copy* (*të lidhur dhe firmosur nga aplikanti dhe udhëheqësi shkencor. Në mungesë të firmosjes nga udhëheqësi, të siglohet nga sekretaria mësimore e institucionit të arsimit të lartë dhe të vuloset*) dhe elektronik (në CD në format Ëord);

d) përmbledhje në gjuhën shqipe të disertacionit në format *hard-copy* (të firmosur nga aplikanti) dhe
elektronik (në CD në format Ëord), 5–10 faqe;

e) vërtetimin e lëshuar nga Biblioteka Kombë-tare në Tiranë, të depozitimit të kopjes së
disertacionit;

f) *Curriculum Vitae* të firmosur nga aplikanti;

g) fotokopje të kartës së identitetit ose të pasaportës;

h) mandat pagesën *hard-copy* (në rastet kur aplikimi kryhet vetëm në rrugë shkresore).

2.1 Dokumentet e përcaktuara në pikën 2 të këtij kreu të udhëzimit duhet të plotësojnë kërkesat e parashikuara në pikën 1.2 të këtij kreu.

3. Aplikimi për njohjen e titujve akademikë “profesor” dhe “profesor i asociuar”, duhet të përmbajë dokumentacionin si më poshtë:

a) kërkesë me shkrim për njohjen e titullit akademik;

b) dokumenti i fitimit të titullit akademik, fotokopje e njësuar me origjinalin;

c) diplomën e fitimit të gradës shkencore “doktor”, fotokopje e njësuar me origjinalin;

d) dokumente që certifikojnë fitimin e titujve të tjerë akademikë;

e) vërtetimin e regjistrimit të titullit akademik në *database*-n në zbatim të kuadrit ligjor të vendit përkatës;

f) *Curriculum Vitae*;

g) fotokopje e kartës së identitetit apo pasa-portës;

h) aplikimi të shoqërohet me një skedë që duhet të plotësohet prej kërkuesit në të cilin të jepet
informacion, për:

i)eksperiencën akademike mësimdhënie;

ii) aktivitetin shkencor – pjesëmarrje në simpoziume, konferenca, kongrese shkencore, të shoqëruara me titujt e materialeve të paraqitura; iii) botime të punimeve

shkencore në organe shkencore ndërkombëtare.

Informacioni i parashikuar në këtë skedë duhet të shoqërohet me dokumentacion provues përkatës;

i) informacion mbi bazën ligjore për përfitimin dhe mbajtjen e titullit në vendin e origjinës.

Dokumentet e përcaktuara në germat “b”, “c”, “d” dhe “e” duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe nga një përkthyes i licencuar në Republikën e Shqipërisë, përveç dokumenteve në gjuhën angleze, frënge dhe italiane;

KREU IV

PROCEDURAT E NJOHJES

1. Procedura e njohjes dhe e njësimit, pas aplikimit *online* ose pas hedhjes së të dhënave, vijon me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit nga ana e Sektorit të Njohjes së Diplomave (SENJOD). Aplikimi nuk quhet i plotë, nëse mungon një nga dokumentet e cituara në këtë udhëzim. Informimi për plotësim dokumentacioni bëhet me *email* ose postë të zakonshme. Procedura e njohjes dhe njësimit vijon vetëm në rastet kur dokumentacioni i përcaktuar si i detyrueshëm në formularin e aplikimit është i plotë. Aplikimi nuk konsiderohet i plotë nëse formulari i aplikimit nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara me detyrim aty. Në këto raste dosja arkivohet dhe aplikanti njoftohet me *email*.

2. Afatet e përcaktuara në këtë udhëzim për njësimin e kualifikimeve, gradave apo titujve i referohen datës së plotësimit të praktikës me të gjithë dokumentacionin e plotë.

3. Në rastet e aplikimit *online,* kandidati njoftohet automatikisht me *email* për plotësimin e aplikimit, si dhe për komunikimet me institucionet e huaja lidhur me praktiken e depozituar.

4. Verifikimi i dokumenteve:

4.1 SENJOD-i, në cilësinë e sekretariatit teknik, kryen verifikimin e autenticitetit të diplomës apo certifikatës, në rastet kur këto dokumente nuk janë të pajisur me vulë apostille/legalizim apo nuk janë të legalizuara në vendin e origjinës sipas përcaktimeve në këtë udhëzim, si dhe në rastet e dokumentacionit të lëshuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë rast, SENJOD-i kontakton me *email* ose në rrugë postare me institucionin që ka lëshuar diplomën apo certifikatën përkatëse. SENJOD-i mund të kërkojë dhe informacion të mëtejshëm që e konsideron të nevojshëm për vlerësimin objektiv për njohjen dhe njësimin e diplomës apo certifikatës.

4.2 SENJOD-i kërkon informacion pranë qendrave të rrjetit evropian të informimit dhe njohjes së diplomave (ENIC–NARIC), mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë, vlefshmërinë e diplomave apo certifikatave, nivelin e tyre sipas kornizës kombëtare apo evropiane të kualifikimeve, si dhe informacion tjetër shtesë në funksion të njësimit të diplomës. SENJOD-i shërben dhe si qendra kombëtare e rrjetit ENIC/NARIC për informimin dhe njohjen e diplomave për Shqipërinë.

4.3 Materialet shkresore ose të printuara për të gjitha verifikimet e kryera, depozitohen në dosjen e aplikantit. Për verifikimet e kryera *online* ose me *pin code* të aplikantit, dokumentacioni i printuar firmoset nga nëpunësi që kryen verifikimet dhe depozitohet në dosjen e aplikantit.

5. Procedurat për marrjen e vendimit të njohjes dhe të njësimit:

5.1 Për njohjen dhe njësimin e certifikatave dhe diplomave të lëshuara në përfundim të programeve të studimit, që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, përveç gradave shkencore "doktor", ngrihet Komisioni i Njohjes së Diplomave, në përbërje të të cilit janë nëpunës të Drejtorisë së Arsimit të Lartë dhe Shkencës në MAS dhe drejtohet nga drejtori i kësaj drejtorie.

5.2 Komisioni i Njohjes së Diplomave vlerëson, njeh dhe njëson, në bazë të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë duke respektuar dhe parashikimet e kuadrit ligjor shqiptar në fuqi.

5.3 Komisioni i Njohjes së Diplomave merr vendimin për njohje dhe njësim ose mund të vendosë t'ia kthejë dosjen SENJOD-it, për plotësime të nevojshme në dokumentacion, sipas këtij udhëzimi. SENJOD-i, në bazë të vendimit të Komisionit, përgatit vërtetimin e njohjes dhe njësimit, për çdo aplikant. Në rastet e mosnjohjes së diplomës apo certifikatës, SENJOD-i përgatit përgjigjen përkatëse për aplikantin.

5.4 Për njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë ngrihen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsim, komisione *ad hoc* sipas fushave përkatëse me pedagogë ekspertë të fushës të kategorisë "profesor", i cili mblidhet në varësi të numrit të aplikimeve dhe shqyrton dosjet përkatëse. Kryetar i komisionit është ministri i Arsimit dhe Sportit. Komisioni përkatës nuk mund të mblidhet më vonë se 15 ditë kalendarike pas njoftimit për shqyrtimin e një aplikimi. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit komisioni firmos procesverbalin dhe ministri i Arsimit dhe Sportit lëshon vërtetimin për njohjen e gradës shkencore apo titullit akademik.

6. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit (me përjashtim të gradave shkencore dhe titujve akademikë) lëshohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në përfundim të procedurës së njohjes, pas depozitimit të aplikimit në formë shkresore, jo më vonë se një javë nga përfundimi i procedurës së njohjes. Vërtetimi nënshkruhet nga kryetari i Komisionit dhe kundërfirmoset nga Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (ose një person i autorizuar prej tij). Formati i vërtetimit të njohjes dhe njësimit, bashkëlidhur shtojca 1, përmban këto elemente:

a) emrin dhe mbiemrin e kandidatit;

b) institucionin e arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën/certifikatën;

c) shtetin përkatës;

d) kohëzgjatjen zyrtare të programit të studimit;

e) numrin e krediteve të përfituara sipas sistemit ECTS (*European Credit Transfer System* – Sistemi Evropian i Transferimit të Krediteve), në ato raste kur është e mundur të përcaktohet në bazë të të dhënave të suplementit të diplomës ose listës së notave, si numër total kreditesh të përfituara; f) emërtimin e programit të studimit;

g) njësimin e certifikatës/diplomës në Republikën e Shqipërisë.

Vërtetimi i njohjes dhe njësimit është i aksesueshëm *online* në çdo kohë nga aplikanti, kundrejt *username*-it dhe *passëord*-it të tij për aplikantët që kanë ndjekur procedurën e aplikimit *online*.

KREU V

AFATET

Procedurat për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave dhe gradave shkencore të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, si dhe njohjen e titujve akademikë të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë udhëzim, përfundojnë brenda 45 ditëve në rastet e aplikimit *online*, dhe brenda 3 muajve në rastet e aplikimit në formë shkresore.

Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk mban përgjegjësi për vonesa që vijnë për shkak të mungesës së përgjigjes, ose të përgjigjes së vonuar nga ana e aplikantit për dorëzimin e dokumenteve plotësuese apo për mungesën e përgjigjes /përgjigjes së vonuar të institucionit të arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën, apo qendrës kombëtare përkatëse të rrjetit ENIC-NARIC.

KREU VI

TARIFAT

Tarifa për njohjen dhe njësimin e certifikatave dhe diplomave që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të kornizës shqiptare të kualifikimeve dhe kornizës evropiane të kualifikimeve (me përjashtim të njësimit të gradave shkencore), për çdo diplomë që kërkohet të njësohet, është 2,000 (dy mijë) lekë për aplikimet e kryera *online* dhe 4,000 (katër mijë) lekë për aplikimet e kryera vetëm

në formë shkresore. Për gradat shkencore tarifa për çdo diplomë që kërkohet të njësohet, është 3,500 (tre mijë e pesëqind) lekë për aplikimet e kryera *online* dhe 5,000 (pesë mijë) lekë për aplikimet e kryera vetëm në formë shkresore.

Tarifa për njohjen e titujve akademikë është 5,000 (pesë mijë) lekë.

Pagesa kryhet në llogarinë bankare të MAS të përcaktuar në faqen *ëeb* të MAS-it në seksionin përkatës të njohjes së diplomave. Mandatpagesa dorëzohet me dosjen e aplikimit për aplikimin shkresor. Për aplikimin *online* ndiqen procedurat e parashikuara në manualin përkatës të publikuar në faqen zyrtare të MAS-it.

KREU VII
ANKIMIMI

Aplikanti ka të drejtë të bëjë ankimim me shkrim drejtuar Komisionit të Njohjes së Diplomave, brenda 30 ditëve nga tërheqja e vërtetimit të njohjes dhe njësimit, për njohjen e diplomave të niveleve 5 deri 8 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, me përjashtim të njohjes së gradës shkencore "doktor" dhe titujve akademikë për të cilin i drejtohet Komisionit *ad hoc* përkatës. Ankesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin mbi të cilët mbështeten pretendimet e ankuesit. Afati i ankimimit dhe kthimit të përgjigjes për ankesën i referohet përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 41, datë 8.12.2009, "Për procedurat e njohjes zyrtare dhe njësimit të diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë", i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës dhe komisionet përkatëse.

Ky udhëzim hyn fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Komisioni i Njohjes së Diplomave

Nr. Regjistrit _____ Tiranë, më _____

VËRTETIM NIOHJEJE DHE NIËSIMI

Vërtetohet njohja e diplomës/certifikatës së Z/Tri, _____(Emër Mbiemër), lëshuar nga _____(institucioni që ka lëshuar diplomën/certifikatën), _____(shtetë), me program ____vjeçar (kohëgjatja e programit), ____ECTS (numri i krediteve te fituara në rast kur kino disponohen), në _____(emërtimi i programit të studiuri).

Kjo diplomë/certifikatë njëvlerë të _____ në Republikën e Shqipërisë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

(Emër Mbiemër)
(Nënshkrimi)

KRYETAR I KOMISIONIT

(Emër Mbiemër)
(Nënshkrimi)

(Tuda e institucionit)

Shtesë: Ky vërtetim njohjeje nuk i njohjes kur shqiptohet me diplomën/certifikatën e lënë dhe lëshuar nëpër të Republikën e Shqipërisë.

UDHËZIM

Nr. 18, datë 11.08.2016

PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, KANDIDATËVE ME ORIGJINË SHQIPTARE NGA MAQEDONIA, MALI I ZI, PRESHEVA, MEDVEGJA DHE BUJANOVCI, SI DHE KANDIDATËVE ME STATUSIN E TË VERBRIT, INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, E JETIMIT, SI DHE ROMËT DHE EGJIPTIANËT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2016-2017" *(Ndryshuar me udhëzimin nr.2, datë 08/02/2017)*

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 93/2014, datë 24.7.2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 1.6.2016, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017",

UDHËZOJ:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, si dhe kandidatët me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, e jetimit, romët dhe egjiptianët, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL), nga data 12-19 gusht 2016 në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL-ja. Kuotat e parashikuara për kandidatët me statusin e të verbrit, invalidit tetraplegjik dhe paraplegjik, të paplotësuara janë të hapura për aplikimin për të gjithë kategorinë e kandidatëve, persona me aftësi të kufizuara.

2. Kandidatët që aplikojnë në programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimi, aplikojnë pranë IAL-ve respektive, deri në datën 24 gusht 2016. Në të njëjtën datë, IAL-të shpallin listën e kandidatëve që do të marrin pjesë në konkurs, e cila bëhet publike në mjediset e IAL-ve dhe faqet elektronike zyrtare. Konkurset e pranimit zhvillohen nga data 25-30 gusht 2016.

3. Aplikimi të kryhet vetëm nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotësojnë kriterin e mesatares të përcaktuar në vendimin nr. 407, datë 1.6.2016, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017", si dhe plotësojnë kriteret e pranimit të vendosura nga vetë IAL-të për programet e studimit për të cilat aplikojnë. Përjashtohen nga kriteri i notës mesatare kandidatët që aplikojnë për ndjekjen e programeve të studimit me karakter profesional.

4. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 programe studimi në një ose disa IAL.

KREU II

DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT

1. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, si dhe kandidatët me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, e jetimit, romët dhe egjiptianët, në momentin e aplikimit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

1.1 Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja:

a) Formulari i aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 1.

b) Kopje të dokumentit të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, që vërteton se diploma e arsimit të mesëm është në proces njohjeje, të shoqëruar me fotokopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave.

Në momentin e regjistrimit, kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-ve, deklaratën bashkëlidhur këtij udhëzimi (shtojca 3), si dhe kopje të noterizuar në Republikën e Shqipërisë (dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nëse është lëshuar në gjuhë të huaj), të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet, si dhe dokumentin e njohjes në Republikën e Shqipërisë nga komisioni i posaçëm për njohjen e diplomave të arsimit të mesëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Në rast se kandidati/ja ka përfunduar shkollën e mesme në Shqipëri , dorëzon kopje të noterizuar të Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave;

c) Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

d) Dy fotografi personale;

e) Kopje të mandatpagesës;

1.2 Kandidatët me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, e jetimit, romët dhe egjiptianët:

a) Formulari i aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
b) Kopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave.

Në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-ve, deklaratën bashkëlidhur këtij udhëzimi (shtojca 3), si dhe kopje të njësuar me origjinalin të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri dhe të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë kopje të njësuar me origjinalin të dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) ose dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në njësinë arsimore vendore (drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore) përkatëse ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

c) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); d) Dy fotografi personale;

e) Kopje të mandatpagesës.

1.2.1 Kandidatët me statusin e të verbrit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1.2 duhet të dorëzojnë dhe kopje të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

1.2.2 Kandidatët me statusin invalidit paraplegjik e tetraplegjik, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1.2 duhet të dorëzojnë kopje të librezës të invalidit paraplegjik e tetraplegjik të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

1.2.3 Kandidatët me statusin e jetimit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1.2 duhet të dorëzojnë dhe kopje të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

1.2.4 Kandidatët romë dhe egjiptianë, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1.2 duhet të dorëzojnë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo egjiptian.

Për përzgjedhjen e kandidatëve romë dhe egjiptianë, IAL-të marrin dhe ekspertizën e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

1.2.5 Në rastet e aplikimeve nga kandidatët nga kategori të tjera të personave me aftësi të kufizuara, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1.2, duhet të dorëzojnë dhe kopje të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

Në momentin e regjistrimit si kandidat fitues vendimi i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë depozitohet si kopje e njësuar me origjinalin.

KREU III
PROCEDURA E APLIKIMIT, PËRZGJEDHJES DHE REGJISTRIMIT

1. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, si dhe kandidatët me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, e jetimit, romët dhe egjiptianët përpara aplikimit, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 200 lekë për program studimi, në zyrat e Postës Shqiptare në llogari të çdo IAL-je pranë të cilit aplikon.

2. Aplikimi për programet e studimit në IAL dërgohet me postë pranë sekretarive mësimore ose depozitohet në zyrën e protokollit të njësive kryesore të IAL-ve.

3. Sekretaritë mësimore mbajnë regjistër për aplikimet e depozituara. Me depozitimin e aplikimit, njësitë kryesore përllogaritin mesatare për çdo kandidat në përputhje me vendimin nr. 407, datë 1.6.2016, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucione të arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017". Për kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare njoftohen nga sekretaritë mësimore për ndërprerjen e aplikimit.

4. IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kritereve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të, në datën 5 shtator 2016, publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre zyrtare të internetit listën jopërfundimtare të fituesve të identifikuar me IDnë e kandidatit, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të d hënave personale.

5. Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit brenda tri ditëve kalendarike nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

6. IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën 12 shtator 2016, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës 19 shtator 2016. Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të heqë dorë për t'u regjistruar në një program tjetër studimi.

8. Pas datës 19 shtator 2016, sekretaritë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve, për kuotat e paplotësuara, njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.

9. IAL-të, brenda datës 6 tetor 2016 përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues.

10. IAL-të, brenda datës 7 tetor 2016, dërgojnë pranë Agjencisë Kombëtare të Provimeve dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe do të kërkohet nga AKP-ja çregjistrimi i tyre.

11. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

Shtojca nr. 1

Tiranë, më ____.____.2016

Formular aplikimi

1. Unë i nënshkruari , l indur më

emër, atësi, mbiemër me kartë

identiteti/pasaportë nr.

E-mail: , tel:

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit në IAL .

1. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët me kombësi shqiptare nga trojet (të shënohet me "x" vendi nga vjen kandidati):

Republika e Kosovës;

Mali i zi;

Maqedonia;

Presheva;

Bujanovci;

Medvegja;

2. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.
3. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në një nga programet e studimit në të cilin do të shpallem fitues për vitin akademik 2016-2017.

4. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

5. Deklaroj se jam njohur me udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe të dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre, duke ua përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Firma

Shtojca nr. 2

Tiranë, më ____.____.2016

Formular aplikimi

Unë i nënshkruari , lindur më

emër, atësi, mbiemër me kartë

identiteti/pasaportë nr.

7. Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit në IAL .

8. Deklaroj se jam (të shënohet me “x” kategoria):

i/e verbër; jetim; invalid

paraplegjik/tetraplegjik; rom; të tjerë

(PAK); egjiptian.

9. Autorizoj institucionet e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.
10. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në një nga programet e studimit në të cilin do të shpallem fitues për vitin akademik 2016-2017.

11. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

12. Deklaroj se jam njohur me udhëzimin "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe kandidatëve me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, jetimit, romët dhe ballkano-egjiptianët, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017" dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.

13. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ua përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Firma

Shtojca nr. 3

DEKLARATË

Unë i nënshkruari , lindur më , me

kartë identiteti, pasaportë nr. .

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë , Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve, për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve, për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve, lidhur me studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdolloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në një nga programet e studimit në të cilin do të shpallem fitues për vitin akademik 2016-2017.
3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve, dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre, duke ua përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit Emër, atësi, mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma: Firma:

Vendi: Data: ____ . ____. ___

UDHËZIM

Nr. 22, datë 06.09.2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 22.7.2016, "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2016–2017

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 1.6.2016, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017":

UDHËZOJ:

I. Pas kreut IV/I të udhëzimit nr. 13, datë 22.7.2016, shtohet kreu IV/II, si më poshtë:

"Kreu IV/II

1. Kandidatët që kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi apo transferojnë studimet, kanë të drejtë të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, nga data 7 shtator 2016 deri në datën 19 shtator 2016.

2. Kandidatët që aplikojnë në institucionet e arsimit të lartë, për program të dytë studimi apo transferim studimesh, kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 programe studimi, përpara fillimit të vitit akademik dhe sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin nr. 407, datë 1.6.2016 të Këshillit të Ministrave, si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.

4. Kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh apo për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional, si program i dytë studimi nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të miratuar.

5. Nuk mund të pranohen aplikime për transferime të studimeve gjatë vitit akademik. Kandidatët që aplikojnë për transferim të studimeve apo program të dytë studimi duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë, për programet e studimit për të cilët aplikojnë. Kandidati nuk duhet të jetë duke ndjekur një tjetër program studimi.

6. Aplikimi për transferim studimesh mund të bëhet nga një program studimi i njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtit cikël edhe lloj, të ndjekur nga kandidati në IAL-të publike ose në IAL private, vendase apo të huaja, të akredituara për programin përkatës të studimit.

7. Të gjithë kandidatët për program të dytë studimi, që kanë mbaruar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, duhet të kenë të njohur diplomën/certifikatën e arsimit të mesëm të lartë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

8. Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë për transferim të studimeve, paraqesin, pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve, dokumentet si më poshtë:

a) Kërkesa drejtuar IAL-së për programin e studimit, në të cilin do të transferojë studimet (ose formulari
i aplikimit);

b) Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse;

c) Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të
shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;

d) Kopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore se bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri dhe të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme, të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

e) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); f) Dy fotografi personale.

9. Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në IAL-ja (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet dhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban: i) emri, atësia, mbiemri; ii) datëlindja: iii) vendlindja; iv) shtetësia;

v) numri i matrikullimit që ka pasur në IAL-në përcjellëse;
vi) emri i shkollës së mesme / IAL-së së kryer përpara ndjekjes së këtij programi studimi; vii) ID e Maturës Shtetërore / nr. regj. të veçantë[1]; viii) numri personal i identitetit; ix) data e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja; x) emërtimi i programit të studimit dhe fakulteti përkatës; xi) cikli dhe forma e studimit; xii) data e ndërprerjes së studimeve.

10. Kandidati që aplikon për program të dytë studimi paraqet dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve:

a) Kërkesa drejtuar IAL-së publike për programin e studimit, në të cilin aplikon për program të dytë
studimi (ose formulari i aplikimit);

b) Kopje e noterizuar e diplomës së studimeve universitare të kryera më parë, të shoqëruar me suplementin e diplomës;

c) Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse);

d) Kopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose të një
dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme
me të në [1] Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme para vitit 2006.

Shqipëri dhe të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

e) Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); f) Dy fotografi personale.

11. IAL-të i përcjellin AKP-së, brenda datës 20 shtator 2016, listën e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh apo program të dytë studimi, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare.

12. IAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës 21 shtator 2016.

13. Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës 30 shtator 2016. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve, si dhe të kritereve të tjera të shpallura prej tyre, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e fakultetit të IAL-së, si dhe faqet *ëeb* përkatëse, e plotësuar sipas tabelave nr. 1/a dhe 1/b të parashikuara në shtojcën nr. 5 të këtij udhëzimi.

IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës 3 tetor 2016. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

14. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

15. IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 10 tetor 2016.

16. Regjistrimi i kandidatëve kryhet pranë sekretarive mësimore nga data 10 tetor 2016 deri më datë 14 tetor 2016. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës 18 tetor 2016.

17. IAL-të nisin në AKP për t'u pajisur me numër matrikullimi, emrat e studentëve të regjistruar sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit brenda datës 21 tetor 2016.

18. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës nr. 6 të këtij udhëzimi.

19. Pas shtojcës 4, të udhëzimit nr. 13, datë 22.7.2016, i ndryshuar, shtohen shtojcat 5 dhe 6 bashkëlidhur këtij udhëzimi.".

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 24, datë 07.10.2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 22.7.2016, "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË

CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2016– 2017", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

I.Titulli i udhëzimit nr. 13, datë 22.7.2016, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016–2017", të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:
"Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2016–2017".

II. Pika 13 e kreut II të udhëzimit, ndryshon si më poshtë:

"13. Kandidatët të cilët nuk janë regjistruar brenda datës 16 tetor 2016 konform përcaktimeve të këtij udhëzimi, humbin të drejtën për t'u regjistruar në fazat e mëtejshme të parashikuara më poshtë në programet e studimit ku ata rezultonin fitues gjatë raundit të dytë.

Pas mbylljes së regjistrimeve të raundit të dytë, në datat 17–18 tetor 2016, sekretaritë mësimore të IAL-ve do të regjistrojnë *on-line* dhe me dokumentacion kadidatët. Regjistrimi do të bëhet duke respektuar renditjen në listat e fituesve të raundit të dytë, pas zbritjes së vijës së fituesit të fundit konform numrit të kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit. Kandidatët që rezultojnë fitues në këtë fazë dhe nuk regjistrohen me dokumentacion dhe *on-line* pranë sekretarisë mësimore përkatëse brenda afateve të sipërcituara humbin të drejtën e regjistrimit në fazat e mëpasme të konkurrimit për programet e studimit ku ata rezultonin fitues në këtë fazë.

Në datat 19–20 tetor 2016, sekretaritë mësimore të IAL-ve do të regjistrojnë *on-line* dhe me dokumentacion, konform numrit të kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit, kandidatët që rezultojnë fitues pas zbritjes së vijës së fituesit të fundit të fazës pararendëse për shkak të mosregjistrimit gjatë asaj faze, brenda datës 18 tetor 2016, të kandidatëve të tjerë pararendës fitues, duke respektuar renditjen në listat e fituesve të raundit të dytë.

Në kuotat e disponueshme për zbritjen e vizës për regjistrimet në një program të caktuar studimi, nga data 17 tetor 2016 deri më 20 tetor 2016, do të bëjnë pjesë të gjitha kuotat e mbetura të paplotësuara, duke përfshirë kuotat e paplotësuara për kandidatët shqiptarë brenda vendit, shtetasit e huaj, kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit, kandidatë të kategorive të veçanta, transferime dhe programe të dyta studimi, si dhe duke respektuar numrin total të kuotave nga IAL-ja për atë program studimi.

Kandidati nuk mund të regjistrohet në më shumë se një program studimi." III.

Në fund të pikës 15 të kreut II të udhëzimit shtohet fjalia si më poshtë:

"Pas nënshkrimit në regjistër kryhet menjëherë regjistrimi i kandidatit *on-line* nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të tij, dhe në fund të procedurës përkatëse firmoset formulari i printuar nga sistemi nga aplikanti dhe sekretarja, në dy kopje, një prej të cilave i jepet aplikantit. Në përfundim të procesit

ditor të regjistrimeve, çdo IAL dërgon të skanuar fletët e regjistrave të veçantë ku janë shënuar regjistrimet për atë ditë, të mbajtur sipas përcaktimeve të kësaj pike, në adresën elektronike rezana.vrapi@akp.gov.al, jo më vonë se ora 19:00 e çdo dite në të cilën janë kryer regjistrime." IV. Pas kreut IV/II të udhëzimit, shtohet kreu IV/III, si më poshtë:

"Kreu IV/III

Pranimet në ciklin e dytë të studimeve "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve".

1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IAL-të publike nga data 7 tetor 2016 deri në datën 12 tetor 2016 dhe në IAL-të jopublike nga data 11 tetor 2016 deri në datën 17 tetor 2016.

2. Brenda datës 14 tetor 2016, IAL-të publike dhe brenda datës 18 tetor 2016. IAL-të private të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet ëeb të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.

3. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga data 14 tetor 2016 deri në datën 19 tetor 2016, pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së publike dhe nga data 18 tetor 2016 deri në datën 20.11.2016, pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së jopublike.

4. IAL-ja shpall në vende të dukshme, publikon në faqen e saj ëeb, listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 20 tetor 2016 për IAL-të publike dhe 21 tetor 2016 për IAL-të private.

5. Njësitë kryesore të IAL-ve organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë. Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.

6. Pranimi, në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura", në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016–2017, sipas kuotave respektive të deklaruara nga IAL-të, realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga IAL-të, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kritereve të përcaktuara paraprakisht dhe të bëra publike paraprakisht.

7. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë, kandidatët që:

a) kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën
e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë "Bachelor";

b) janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të
integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.

8. Kanë të drejtë të aplikojnë për transferim studimesh të gjithë kandidatët që:

a) Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në germën "a", të pikës 7, të këtij kreu, në një program

të ciklit të parë "Bachelor", si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë brenda ose jashtë vendit të njohur/të akreditуar në momentin e transferimit;

b) Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor", kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë të njohur/të akreditуar në momentin e transferimit brenda ose jashtë vendit.

9. Transferimi i studimeve mund të bëhet në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtit cikël dhe lloj sipas kritereve të vendosura dhe të shpallura publikisht paraprakisht nga IAL-ja.

10. IAL-të nuk mund të pranojnë aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Transferimi i studimeve do të kryhet në zbatim të procedurave dhe afateve të parashikuara në këtë udhëzim.

11. Kanë të drejtë të aplikojnë për program të dytë studimi të gjithë kandidatët që:

a) Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në
Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë "Bachelor", sipas përcaktimeve në germën "a", të pikës 7, të këtij kreu, si dhe në një program studimi të ciklit të dytë;

b) Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, si dhe në një program studimi të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomave respektive pranë MAS-it.

12. Kandidati paraqitet personalisht dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Diplomë ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet e ciklit të parë dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara për ciklin përkatës të studimit konform kuadrit ligjor në fuqi, por që nuk disponojnë ende kartonin e diplomës në momentin e aplikimit, pajisen me dokument nga IALja ku kanë përfunduar studimet konform përcaktimeve të pikës 4, të nenit 91, të ligjit nr. 80/2015, datë
22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Për diplomat e fituara jashtë vendit, vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MAS-i, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.

b) Diplomën e maturës shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me
origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA).

Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, paraqesin dëftesën e pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).

Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA) ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave.

Kandidatët që kanë kryer shkollën e mesme jashtë vendit duhet të dorëzojnë dokumentin e njohjes të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

c) formulari i aplikimit (sipas formatit të shtojcës nr. 7, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

d) fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); e) dy fotografi personale.

13. Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:

a) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe). Shtetasit e huaj, që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.

b) Curriculum Vitae;

c) Deklaratën sipas shtojcës nr. 7 të këtij udhëzimi.

14. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh:

a) Kërkesën drejtuar institucionit të arsimit të lartë (IAL) për programin e studimit, në të cilin kërkon të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit);

b) Plani i plotë i programit të studimit nga ku transferohet;

c) Vërtetim të listës së notave, krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer në ciklin e dytë të studimeve, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin eventual të lëndëve të programit të studimit të ndjekur, si dhe programeve/syllabuseve përkatëse të lëndëve të shlyera.

15. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi:

a) Fotokopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë të diplomës universitare të ciklit të dytë të studimeve, së bashku me suplementin e diplomës ose listën e notave. Kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet e ciklit të parë dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara për ciklin përkatës të studimit konform kuadrit ligjor në fuqi, por që nuk disponojnë ende kartonin e diplomës në momentin e aplikimit, pajisen me dokument nga IAL-ja ku kanë përfunduar studimet konform përcaktimeve të pikës 4, të nenit 91, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Për diplomat e fituara jashtë vendit, duhet të dorëzojë dhe vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MAS-i.

b) Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse, vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për njohjen e

provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse, nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse.

16. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:

a) Kandidati me statusin e të verbrit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit
Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP);

b) Kandidati me statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës së invalidit paraplegjik e tetraplegjik të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje e noterizuar e vendimit të KMCAP-it;

c) Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të dokumentit që
certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;

d) Kandidati rom dhe ballkano-egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që
vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian.

17. Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione *ad hoc* sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.

18. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

19. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose private. AKP-ja, pas verifikimit, e pajis me numër matrikullimi vetëm për programin e studimit ku është regjistruar më parë në kohë dhe i kërkon IAL-së tjetër ta çregjistrojë atë nga programi tjetër i studimit.

20. IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

21. Komisionet respektive kryejnë renditjen e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh apo program të dytë studimi bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi dhe vlerëson kandidatët me statusin fitues/jo fitues. Këto të dhëna shpallen nga dekanati përkatës në ambientet e fakultetit dhe IAL-së, si dhe faqet ëeb përkatëse, të plotësuara sipas tabelave nr. 1a dhe 1b të parashikuara në shtojcën nr. 8 të këtij udhëzimi, respektivisht, për kandidatët që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe për kandidatët që kanë aplikuar për program të dytë studimi.

22. Kandidatët fitues kryejnë regjistrimin e tyre përfundimtar në IAL.

23. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që transferojnë studimet:

Kandidati duhet të paraqesë në momentin e regjistrimit dhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IALja nga ku transferohet, i cili përmban:

i) emri, atësia,

mbiemri; ii)

datëlindja; iii)

vendlindja; iv)

shtetësia;

v) numri i matrikullimit që ka pasur në programin e studimit të ciklit të parë; vi)

emërtimi i IAL-së dhe i programit të studimit të ciklit të parë, si dhe forma e

studimit;

vii) numri i matrikullimit, si dhe emërtimi i programit të studimit të ciklit të dytë dhe fakultetit përkatës në IAL-në nga ku transferohet; viii) cikli dhe forma e studimit; ix) data e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja nga ku transferohet; x) data e ndërprerjes së studimeve;

24. IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj ëeb listën emërore të kandidatëve të regjistruar sipas programit të studimit dhe kategorive respektive."

V. Pas shtojcës 6, të udhëzimit nr. 13, datë 22.7.2016, të ndryshuar, shtohen shtojcat nr. 7 dhe 8 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

VI. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

SHTOJCA nr. 7 Tiranë, më ____/____/2016

FORMULAR APLIKIMI

Unë i/e nënshkruari/a , lindur më

emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. e-mail: ,

Tel:

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të dytë:

□ Master profesional
□ Master i shkencave/Master i arteve të bukura në

, në IAL

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (vendosni një rreth mbi kategorinë përkatëse): A. Shtetas shqiptarë, brenda vendit për program të parë studimi B. Shtetas shqiptarë, brenda vendit për program të dytë studimi C. Shtetas shqiptarë, brenda vendit për transferim studimesh

D. Kandidatë shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit (të shënohet me "x" vendi nga vjen kandidati):

□ Republika e Kosovës;
□ Mal i Zi;
□ Maqedoni;
□ Preshevë;
□ Bujanovc;
□ Medvegjë;

E. Nga kategoritë e veçanta (të shënohet kategoria e veçantë së cilës i përket kandidati):

.

F. Shtetas i huaj

Gjuha amtare . Shtetësia

Emri i universitetit

1. Deklaroj se jam njohur me parashikimet e udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Sportit për pranimet në vitin akademik 2016–2017 në ciklin përkatës të studimit.

2. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shtesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të IAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.

3. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, institucionin e arsimit të lartë dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.

4. Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017.

5. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

emër atësi mbiemër emër mbiemër i kandidatit i punonjësit që pranoi aplikimin

Firma Firma

SHTOJCË NR. 8 Tabela 1a. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga transferohet	IAL-ja nga transferohet	Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik 2015-2016	Kreditet (ECTS) të e grumbulluara nga kandidati	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga transferohet	Viti i studimit ku transferohet	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit Fitues/Jo fitues
												Kriteri 1	Kriteri 2	....	Pikët totale	
1					dhe lloji				dhe lloji							
2																
3																
....																

Tabela 1b. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

											Pikët e akorduara	

615

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) të	IAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të studimit	Data e diplomimit në programin e parë të studimit	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) ku	Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati	Kreditet e njohura	Kriteri 1	Kriteri 2	....	Pikët totale	Statusi i kandidatit Fitues/Jo fitues
1					kryer më parë			aplikon për							
2															
3															
....															

732

SHTOJCA NR.5

Tabela 1 a. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindja	Emërtimi i programit të studimit nga transferohet dhe	IAL-ja nga transferohet	Viti i studimit i ndjekur në vitin akademiik 2015–2016	Kreditet (ECTS) të grumbulluara nga kandidati	Emërtimi i programit të studimit nga transferohet dhe lloji (Bachelor, PICD)	Viti i studimit ku transferohet	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit fitues/jofitues
												Kriteri 1	Kriteri 2	Etj.	Pikët totale	
1																
2																
3																
....																

Tabela 1 b. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindja	Emërtimi i programit të studimit të kryer	IAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të	Data e diplomimit në programin e parë të studimit	Emërtimi i programit studimit ku aplikontë për program të dytë	Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit fitues/jofitues
											Kriteri 1	Kriteri 2	.....	Pikët totale	
1					më parë dhe lloji			dhe lloji (Bachelor,							
2															
3															

....

SHTOJCA NR. 6

DEKLARATË

Unë i nënshkruari _____ , lindur më _____ emri

atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____ Ministrinë e Arsimit dhe

Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre.

Autorizoj, gjithashtu institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik në të cilin po aplikoj.

3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

4. Deklaroj se jam njohur me udhëzimin nr. 13, datë 22.7.2016 "Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016–2017", i ndryshuar, dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit për transferim/program të dytë studimi, si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në të për të aplikuar për transferim studimesh/program të dytë studimi.

5. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast

dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

_____ _____

Emër, atësi, mbiemër Emër, mbiemër

i kandidatit i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma Firma

Vendi: _____ Data: ____ . ____. _____

UDHËZIM

Nr.24/1, datë 12.10.2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 22.07.2016 "PER PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARE STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2016-2017", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, dhe pikës 4 të nenit 9 të ligjit nr. 80/ 2015, datë 22.07.2015 "Per arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë":

UDHËZOJ:

I. Titulli i Udhëzimit nr. 13, datë 22.07.2016 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit te parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016 -2017", të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

"Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2016-2017".

Il. Pika 13 e Kreut II të Udhëzimit ndryshon si më poshtë:

"13. Kandidatët të cilët nuk janë regjistruar brenda datës 16 tetor 2016 konform përcaktimeve të këtij udhëzimi, humbin të drejtën për t'u regjistruar në fazat e mëtejshme të parashikuara më poshtë në programet e studimit ku ata rezultonin fitues gjatë raundit të dytë.

Pas mbylljes së regjistrimeve të raundit të dytë, në datat 17-18 tetor 2016, sekretaritë mësimore të IAL-ve do të regjistrojnë, online dhe me dokumentacion kadidatët. Regjistrimi do të bëhet duke respektuar renditjen në listat e fituesve të raundit të dytë, pas zbritjes së vijës së fituesit të fundit konform numrit të kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit. Kandidatët që rezultojnë fitues në këtë fazë dhe nuk regjistrohen me dokumentacion dhe online pranë sekretarisë mësimore përkatëse brenda afateve të sipërcituara humbin të drejtën e regjistrimit në fazat e mëpasme të konkurrimit për programet e studimit ku ata rezultonin fitues në këtë fazë.

Në datat 19-20 tetor 2016 sekretaritë mësimore të IAL-ve do të regjistrojnë, online dhe me dokumentacion, konform numrit të kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit, kandidatët që rezultojnë fitues pas zbritjes së vijës së fituesit të fundit të fazës pararendëse për shkak të mosregjistrimit gjatë asaj faze, brenda datës 18 tetor 2016, të kandidatëve të tjerë pararendës fitues, duke respektuar renditjen në listat e fituesve të raundit të dytë.

Në rast se konstatohen kuota të paplotësuara edhe mbas datës 20 tetor 2016, procesi i regjistrimeve online dhe me dokumentacion, vijon mefaza 48-orëshe, konform numrit të kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e fituesve të raundit të dytë. Këtofaza vijojnë deri në plotësimin e kuotave të parashikuara, deri në datën 27 Tetor 2016. Në cdo fazë regjistrohen kandidatët që rezultojnë fitues pas zbritjes së vijës së fituesit të fundit të fazës pararendëse për shkak të mosregjistrimit gjatë kësaj tëfundit.

Kandidati nuk mund të regjistrohet në më shumë se një program studimi. " Ill.

Në fund të pikës 15 të Kreut Il të Udhëzimit shtohet fjalia si më poshtë:

"Pas nënshkrimit në regjistër kryhet menjëherë regjistrimi i kandidatit online nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të tij, dhe në fund të procedurës përkatëse firmoset formulari i printuar nga sistemi nga aplikanti dhe sekretarja, në dy kopje, një prej të cilave i jepet aplikantit. Në përfundim të procesit ditor të regjistrimeve, cdo IAL dërgon të skanuarfletët e regjistrave të vecantë ku janë shënuar regjistrimet për atë ditë, të mbajtur sipas përcaktimeve të kësaj pike, në adresën elektronike rezana.vrapi@akp.gov.al, jo më vonë se ora 19.00 e Gdo dite në të cilën janë kryer regjistrime.

IV. Pas Kreut IV/ Il të Udhëzimit, shtohet Kreu IV/ Ill, si më poshtë:

"Kreu IV/III

Pranimet në ciklin e dytä të studimeve "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve". 1 Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IAL-të publike deri në datën 20 Tetor 2016 dhe në IAL-të jopublike deri në datën 27 Tetor 2016.

2 Brenda datës 24 Tetor 2016 IAL-të publike dhe brenda datës 31 Tetor 2016 IAL-të private, të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet ëeb të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.

3 Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet, pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së publike deri në datën 28 Tetor 2016, dhe deri në datën 04 Nëntor 2016, pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së jopublike.

4 IAL-ja shpall në vende të dukshme, publikon në faqen e saj ëeb, listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 31 Tetor 2016 për IAL-të publike dhe 07 Nëntor 2016 për IAL-të private.

5 Njësitë kryesore të IAL-ve, organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë. Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.

6. Pranimi, në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve", në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016 - 2017, sipas kuotave respektive të deklaruara nga IAL-të, realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga IAL-të, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kritereve të përcaktuara paraprakisht dhe të bëra publike paraprakisht.

7. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë, kandidatët që:
   a. kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë "Bacllelor",
   b. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS.

8. Kanë të drejtë të aplikojnë për transferim studimesh të gjithë kandidatët që:
   a. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në germën "a" të pikës 7 të këtij kreu, në një program të ciklit të parë "Bachelor", si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë brenda ose jashtë vendit të njohur/të akreditуar në momentin e transferimit;
   b. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor", kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë të njohur/të akreditуar në momentin e transferimit brenda ose jashtë vendit.

9. Transferimi i studimeve mund të bëhet në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtit cikël dhe Iloj sipas kritereve të vendosura dhe shpallura publikisht paraprakisht nga [AL.

10. IAL-të nuk mund të pranojnë aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Transferimi i studimeve do të kryhet në zbatim të procedurave dhe afateve të parashikuara në këtë udhëzim.

11. Kanë të drejtë të aplikojnë për program të dytë studimi të gjithë kandidatët që:
   a. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë "Bachelor", sipas përcaktimeve në germën "a" të pikës 7 të këtij Kreu, si dhe në një program studimi të ciklit të dytë;
   b. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, si dhe në një program studimi të ciklit të dytë, dhe kanë kryer njësimin e diplomave respektive pranë MAS.
12. Kandidati paraqitet personalisht dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:
   a. Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet

e ciklit të parë dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara për ciklin përkatës të studimit konform kuadrit ligjor nëfuqi, por që nuk disponojnë ende kartonin e diplomës në momentin e aplikimit, pajisen me dokument nga IAL-ja ku kanë përfunduar studimet konform përcaktimeve të pikës 4 të nenit 91 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Për diplomat e fituara jashtë vendit, vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MAS, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.

b. Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës

   Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rastfotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).

   Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave. Kandidatët që kanë kryer shkollën e mesme jashtë vendit duhet të dorëzojnë dokumentin e njohjes të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

c. Formulari i aplikimit (sipas formatit të Shtojcës nr. 7, bashkëlidhur këtij Udhëzimi);

d. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); e. Dyfotografi personale.

13. Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:

a. Dëshminë e njohjes së gjuhës Shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit te Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe). Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës Shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës Shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën Shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri. b. Curriculum Vitae;

c. Deklaratën sipas Shtojcês nr. 7 tê këtij udhêzimi.

14. Dokumentacion shtesê vetêm pêr kandidatêt që aplikojnê pêr transferim studimesh:

a. Kêrkesên drejtuar institucionit tê arsimit tê lartê (IAL) pêr programin e studimit, nê tê cilin kêrkon tê transferojê studimet (ose formulari i aplikimit);

b. Plani i plotê i programit tê studimit nga ku transferohet;

c. Vërtetim të listês sê notave, krediteve têfituara pêr çdo lêndê dhe detyrim të shlyer nê ciklin e dytê të studimeve, i cili do të shêrbejê pêr ekuivalentimin eventual të lêndêve të programit të studimit të ndjekur, si dhe programeve/syllabuseve pêrkatêse të lêndêve të shlyera;

15. Dokumentacion shtesê vetêm pêr kandidatêt qê aplikojnê pêr program të dytê studimi:
    a. Fotokopje e njêsuar me origjinalin nê Republikên e Shqipêrisê të diplomês universitare të ciklit të dytê të studimeve, sê bashku me suplementin e diplomês ose listên e notave. Kandidatêt qê kanê pêrfunduar me sukses studimet e ciklit të parê dhe kanê shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara pêr ciklin pêrkatês të studimit konform kuadrit ligjor nêfuqi, por qê nuk disponojnê ende kartonin e diplomês nê momentin e aplikimit, pajisen me dokument nga IAL-ja ku kanê pêrfunduar studimet konform pêrcaktimeve të pikês 4 të nenit 91 të ligjit nr. 80/2015, datê 22.07.2015 "Pêr arsimin e lartê dhe kêrkimin shkencor nê institucionet e arsimit të lartê nê Republikên e Shqipêrisê". Pêr diplomat e fituara jashtê vendit, duhet të dorêzojê dhe vërtetimin e njohjes nê Republikên e Shqipêrisê, të lêshuar nga MAS.
    b. Plani i plotê i programit të studimit pêrfshirê dhe syllabuset pêrkatêse, vërtetim i listês sê notave dhe krediteve të fituara pêr çdo lêndê dhe detyrim të shlyer, i cili do te shêrbejê pêr njohjen e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve pêrkatêse, nêse kêrkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve pêrkatêse.

16. Dokumentacion shtesê vetêm pêr kandidatêt e kategorive të vecanta:
    a. Kandidati me statusin e të verbrit, duhet të dorêzojê dhe fotokopjen e noterizuar e librezês sê të verbrit të lêshuar nga Shêrbimi Social Shtetêror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekêsor të Caktimit të Aftêsisê pêr Punê (KMCAP).
    b. Kandidati me statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik, duhet të dorêzojê dhefotokopjen e noterizuar të librezês sê invalidit paraplegjik e tetraplegjik të lêshuar nga Shêrbimi Social Shtetêror ose kopje e noterizuar e vendimit të KMCAP.
    c. Kandidati me statusin ejetimit, duhet të dorêzojê dhefotokopjen e noterizuar e dokumentit qê çertifikon statusin e jetimit të lêshuar nga Shêrbimi Social Shtetêror.
    d. Kandidati Rom dhe Ballkano-Egjiptian, duhet të dorêzojê dhe vetêdeklarim ose njê dokument qê vêrteton qê êshtê Rom apo Ballkano-Egjiptian.

17. Pranê departamenteve të njêsive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave pêrkatêse, pêr çdo program studimi të ciklit të dytê me kohê të plotê, pêr vlerêsimin e dosjeve të kandidatêve sipas kategorive dhe pêrzgjedhjen nê bazê të meritês të atyre kandidatêve qê plotêsojnê kriteret e parashikuara nê aktet ligjore e nênligjore (Statut dhe rregullore) nê fuqi, si dhe kriteret për cdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.
18. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë Udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

19. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose private. AKP pas verifikimit e pajis me numër matrikullimi vetëm për programin e studimit ku është regjistruar më parë në kohë dhe i kërkon IAL-së tjetër t'a cregjistrojë atë nga programi tjetër i studimit.

20. IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshëm për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranëfakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

21. Komisionet respektive kryejnë renditjen e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh apo program të dytë studimi bazuar në pikëzimin për cdo kriter vlerësimi, dhe vlerëson kandidatët me statusin fitues/jo fitues. Këto të dhëna shpallen nga dekanati përkatës në ambientet e fakultetit dhe IAL-së, si dhe faqet ëeb përkatëse, të plotësuara sipas Tabelave nr. la dhe lb të parashikuara në Shtojcën nr. 8 të këtij udhëzimi, respektivisht, për kandidatët që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe për kandidatët që kanë aplikuar për program të dytë studimi.

22. Kandidatëtfitues kryejnë regjistrimin e tyre përfundimtar në IAL.

23. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që transferojnë studimet:
    Kandidati duhet të paraqesë në momentin e regjistrimit dhe dokumentin origjinal të cregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

i. Emri, Atësia,
Mbiemri; ii. Datëlindja; iii.
Vendlindja; IV.
Shtetësia;
v. Numri i matrikullimit që ka pasur në programin e studimit të ciklit të parë; vi.
Emërtimi i IAL-së dhe i programit të studimit të ciklit të parë, si dhe forma e studimit; vii. Numri i matrikullimit, si dhe emërtimi i programit të studimit të ciklit të dytë dhe fakultetit përkatës në IAL-në nga ku transferohet; viii. Cikli dhe forma e studimit; ix. Data e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja nga ku transferohet;

x. Data e ndërprerjes së studimeve;

24. IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj tveb listën emërore të kandidatëve të regjistruar sipas programit të studimit dhe kategorive respektive.

V. Pas Shtojcës 6 të udhëzimit nr. 13, datë 22.07.2016, të ndryshuar, shtohen shtojcat nr. 7 dhe 8 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

VI. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

SHTOJCA nr. 7 Tiranë, më____/____/2016

Formular aplikimi

Unë i/ e nënshkruari/ a , lindur më_____

_____

emri atësia mbiemri me kartë identiteti/ pasaportë nr. _____ e-mail: Tel:

_____ _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të dytë: n Master profesional n Master i shkencave/Master i arteve të bukura nënë IAL

UDHËZIM

Nr.25, datë 27.10.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 22.07.2016 "PËR PROCEDURAT E APLKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2016 -2017

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 4 të nenit 9 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 01.06.2016 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidateve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017" UDHËZOJ:

1. Në pikën 13 të Kreut II të Udhëzimit nr. 13, datë 22.07.2016, data "27 Tetor 2016" të ndryshojë në "01 Nëntor 2016." .
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Pergjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare" .

MINISTËR

LINDITA NIKOLLA

UDHËZIM

Nr. 27, datë 29.12.2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 22.7.2016, "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË VITIN AKADEMIK 2016–2017", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 9 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

I. Pas kreut IV/III të udhëzimit, shtohet kreu IV/IV, si më poshtë:

"Kreu IV/IV

Pranimet dhe transferimet në një program specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë në vitin akademik 2016– 2017.

1. Pranimet në një program specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë në vitin akademik 2016–2017, bëhen në përputhje me kuotat e deklaruara nga institucionet arsimit të lartë (IAL) dhe të verifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), lidhur me kapacitetet pritëse përkatëse, për secilin program studimi specializues afatgjatë. Procedurat e aplikimit, konkurrimit dhe përzgjedhjes bëhen në përputhje me rregulloren së specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë të miratuar nga IAL-ja.

2. Kanë të drejtë të konkurrojnë për programet e specializimeve afatgjata, në fushën e mjekësisë, kandidatët që kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse ose janë diplomuar jashtë vendit, në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Mjekësi të përgjithshme", si dhe kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë. Për diplomat e përfituara jashtë vendit kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.

3. Kandidati paraqitet personalisht për të bërë aplikimin pranë sekretarisë përkatëse dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) formular aplikimi, sipas modelit të parashikuar në shtojcën nr. 9, bashkëlidhur këtij udhëzimi (kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh plotësojnë formularin sipas modelit të parashikuar në shtojcën nr. 10);

b) një letër motivimi e aplikantit;

c) fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, kartë identiteti ose pasaportë;

d) kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e diplomës universitare, të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë, dhe listës të notave. Për rastet e diplomave të huaja paraqitet kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë, e shoqëruar me diplomën dhe listën përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë përkatës. Në rast se njohja e diplomës nuk ka përfunduar ende, kandidati paraqet vërtetim që ka dorëzuar dokumentacionin për njohje në MAS, dhe duhet të dorëzojë dokumentin e njohjes jo më vonë se data e parashikuar për testimin e informatizuar, si dhe përpara shpalljes së rezultatit përfundimtar nga
Komisioni i Vlerësimit;

e) kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e dokumentit që vërteton njohjen e gjuhës së huaj.

f) kopje e noterizuar në Republikën e Shqipërisë, e licencës për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë dhe e dëshmisë së regjistrimit në urdhrin profesional përkatës për kandidatët shtetas shqiptar. Në rast se kandidati ka plotësuar kriteret për marrjen e licencës dhe është në proces të marrjes së saj duhet të dorëzojë licencën jo më vonë se data e parashikuar për intervistën me gojë". Për shtetasit me kombësi shqiptare apo shtetas të huaj paraqesin dokument të barasvlershëm të strukturave përkatëse të vendit.

g) dy foto personale.

4. IAL-ja sipas rregullores së specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, shpall në faqen zyrtare ëeb të fakultetit listën emërore të kandidatëve të regjistruar për konkurrim, të cilët plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit. Kandidatët brenda afateve të përcaktuara në

rregullore, verifikojnë listën emërore dhe, në rast pasaktësish, bëjnë kërkesë për saktësim pranë IAL-së. IAL-ja pas kryerjes së verifikimeve shpall listën përfundimtare të kandidatëve. Në UMT shpallet dhe kalendari i zhvillimit të intervistave me gojë dhe testimit të informatizuar. Në UMT datat e zhvillimit të testimit të informatizuar konsultohen me AKP lidhur me disponibilitetin për zhvillimin e testimit të informatizuar. Listat e studentëve të ndara sipas datave përkatëse të zhvillimit të intervistës me gojë dhe në vijim të testimit të informatizuar përcaktohen me short. Listat përfundimtare dhe kalendari i zhvillimit të testimit të informatizuar i dërgohen AKP-së dhe MAS-it brenda kësaj date sipas formatit të përcaktuar paraprakisht nga AKP-ja. Kandidatët duhet të kryejnë intervistën me gojë dhe më pas testimin e informatizuar.

5. Agjencia Kombëtare e Provimeve, si autoritet në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, është përgjegjëse për zhvillimin e provimeve të specializimit në mjekësi, për UMT-në. AKP-ja zbaton procedurat për zhvillimin e provimeve të specializimit, përmes teknologjisë digjitale.

6. AKP-ja, lidhur me zhvillimin e provimeve të specializimit, kryen detyrat e mëposhtme:

a) Digjitalizon fondin e pyetjeve për çdo specialitet të miratuar nga Komisioni i Vlerësimit;

b) Harton në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, grafikun
e datave të provimeve;

c) Publikon listat e kandidatëve sipas datës dhe orarit të caktuar për zhvillimin e provimit;

d) Verifikon identitetin dhe dokumentet përkatëse të kandidatëve pjesëmarrës në provimet e specializimit;

e) Siguron kushte të përshtatshme në sallat e provimit për zhvillimin e provimit të specializimit përmes
teknologjisë digjitale;

f) Siguron kushte të përshtatshme për kandidatët me aftësi të kufizuara fizike;

g) Merr masa për hartimin e formatit të testit sipas përcaktimit të bërë nga Komisioni i Vlerësimit;

h) Mban procesverbale për çdo vendimmarrje gjatë procedurave të zhvillimit të provimeve të specializimit,
deri në shpalljen e rezultateve;

i) Dërgon rezultatet e provimit të specializimit pranë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

7. Zgjedhja e programit të specializimit afatgjatë bëhet brenda dy ditëve nga shpallja e rezultateve përfundimtare, përfshirë dhe procedurat e ankimimit sipas afateve të përcaktuara në rregulloren e specializimeve. Të drejtën e regjistrimit si fitues e kanë aq persona sa janë edhe kuotat e caktuara në programin e Specializimit përkatës, sipas rendit zbritës të pikëve totale.

8. Regjistrimi i kandidatëve në programet e specializimit afatgjatë ku janë shpallur fitues bëhet brenda 7 ditëve nga data e përzgjedhjes së specializimit.

9. Transferimet e studimeve do të kryhen në zbatim të përcaktimeve të rregullores përkatëse të specializimeve të sipërcituar dhe kuotave të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja për transferime në programet përkatëse specializuese afatgjata në mjekësi.

10.Kandidati, në momentin e aplikimit, veç sa është parashikuar në pikën 3 të këtij kreu, dorëzon dhe kopje e njësuar me origjinalin e dokumentacionit si më poshtë:

a) Planin e plotë të programit të studimit specializues të ndjekur;

b) Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, si dhe syllabuset përkatëse për lëndët e shlyera, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;

c) Vërtetim për periudhat e praktikave dhe frekuentimin e aktiviteteve të parashikuara në programin specializues të ndjekur.

d) Në momentin e regjistrimit përfundimtar, nëse kandidati është shpallur fitues, dorëzon vërtetimin e çregjistrimit nga programi i mëparshëm specializues, pa të cilin nuk mund të kryhet regjistrimi i studentit.

11.Kandidati transferohet, në të njëjtin program specializues afatgjatë, në vit të parë ose të dytë, por jo më lart se viti i dytë i studimeve. Kandidatët që plotësojnë kriteret për t'u transferuar, vlerësohen për periudhën e specializimit të kryer dhe ekuivalentimin e saj, si dhe të krediteve të përfituara gjatë studimeve të mëparshme duke i përcaktuar vitin se ku mund të transferohet eventualisht kandidati. Në vijim, nëse numri i kandidatëve që kanë aplikuar dhe që plotësojnë kriteret është më i madh se numri i kuotave të përcaktuara në programin specializues, për të cilin parashikohet kuotë transferimi, kandidatët i nënshtrohen procedurave të konkurrimit si të gjithë kandidatët e tjerë, duke konkurruar brenda numrit të kuotave të përcaktuara për transferimet dhe shpërndarjes së tyre.

Për kandidatët në UMT që kërkojnë të transferohen nga programe specializimi për të cilat kanë përfituar kuotë të mbuluar nga Ministria e Shëndetësisë, duhet të merret miratimi paraprak për transferimin nga Ministria me të cilën është lidhur kontrata e mëparshme.

Ministria e Shëndetësisë shprehet, gjithashtu, për rastet kur kandidatët kërkojnë të transferohen nga një program specializimi për të cilin nuk kanë lidhur kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë në një program specializimi që parashikon kuotë të mbuluar nga Ministria e Shëndetësisë.

Në përfundim të konkurrimit, komisioni i vlerësimit përllogarit pikët totale të kandidatit duke marrë në konsideratë intervistën me gojë, testimin e informatizuar dhe notën mesatare të ponderuar të studimeve universitare të mëparshme në Mjekësi. Komisioni përgatit një listë me kandidatët e renditur sipas pikëzimit sipas shtojcës 12, bashkëlidhur këtij udhëzimi, dhe shpall kandidatët fitues për çdo program specializues.

12.Regjistrimi i kandidatëve që transferohen në programet e specializimit afatgjatë ku janë shpallur fitues bëhet brenda 7 ditëve nga data e shpalljes. Në mungesë të regjistrimit të kandidatëve për transferimet e studimeve, e drejta e regjistrimit i lind kandidatit të renditur më poshtë në listën e meritës së kandidatëve. Regjistrimi mbyllet në çdo rast brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

Kandidatët që do të regjistrohen në kuadër të kuotave të transferimit duhet të dorëzojnë dhe dokumentin e çregjistrimit nga programi i specializimit nga ku transferohen. Në rastet e transferimit nga programe specializuese jashtë vendit, në pamundësi të depozitimit të vërtetimit të çregjistrimit brenda afateve të parashikuara për regjistrim, kandidati regjistrohet me rezervë deri në depozitimin e vërtetimit përkatës. Nëse kandidati nuk e depoziton dokumentin e çregjistrimit brenda një muaji nga

data e shpalljes së fituesve, Fakulteti çregjistron kandidatin dhe mund të vijojë me regjistrimin eventual të kandidatit vijues në listën përkatëse.

13.Brenda 5 ditëve pune nga regjistrimi i kandidatëve fitues, IAL-të i dërgojnë AKP-së, në rrugë postare, listën e studentëve specializant të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi në zbatim të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", i ndryshuar. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit nga AKP-ja dhe IAL-ja i çregjistron ata.

14.Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose private. AKP pas verifikimit nuk do të procedojë me dhënien e numrave të matrikullimit në programin ku është regjistruar më pas dhe UMT-ja i çregjistron ata.

15.Për specializantët që përfitojnë nga kuotat e mbuluara të Ministrive, marrëdhëniet kontraktuale financiare, lidhen mes specializantit dhe Ministrisë përkatëse.

II. Pas shtojcës 6 të udhëzimit nr. 13, datë 22.7.2016, të ndryshuar, shtohen shtojcat nr. 9, 10, 11, 12, 13 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

III. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

SHTOJCA NR. 9

FORMULAR APLIKIMI

Unë i/e nënshkruari/a _____ , lindur më _____

emri atësia mbiemri

në _____ ,Vendbanimi _____ me

kartë identiteti/pasaportë nr. _____

Adresa _____ ,

Tel _____ , Cel _____ , E-mail _____ ,

KËRKOJ:

Të aplikoj për të vazhduar specializimin afatgjatë pranë Fakultetit të _____

duke përfituar nga (të shënohet me "x" vetëm një nga alternativat e mëposhtme):

□ Kuotat e mbuluara nga Ministria e Shëndetësisë
□ Kuotat e lira të pambuluara nga Ministria e Shëndetësisë
□ Kuotat e Ministrive të tjera dhe specifikisht të Ministrisë së _____
□ Kuotat e trojeve, specifikisht të _____ Në momentin e paraqitjes së kësaj kërkese, nën përgjegjësinë time ligjore,

DEKLAROJ se:

- Zotëroj:

□ Diplomë të Integruar të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në _____ , lëshuar nga IAL _____ , Shteti _____

□ të njohur në RSH (për diplomat e huaja)
□ Diplomë të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në _____ , lëshuar nga IAL _____ , Shteti _____

□ të njohur në RSH (për diplomat e huaja)

- Kam notë mesatare të ponderuar të gjithë viteve të studimeve universitare (cikli i parë + cikli i dytë ose diplomë e integruar e ciklit të dytë) _____ (me dy shifra të rrumbullakosura pas presjes dhjetore).
- Nuk jam duke kryer dhe nuk kam kryer më parë një program specializimi afatgjatë në fushën e mjekësisë.

- Zotëroj gjuhën/t e huaj/a më poshtë:

□ Angleze,niveli _____
□ Italiane,niveli _____
□ Frënge,niveli _____
□ Gjermane,niveli _____
□ Spanjolle, niveli _____
^ Bashkëlidhur këtij formulari kam dorëzuar:

- □ Letër motivimi.
- □ Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, kartë identiteti ose pasaportë.
- □ Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e diplomës universitare, të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor", si dhe të ciklit të dytë "Master i Shkencave", ose të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë, dhe listës/listave të notave. Për rastet e diplomave të huaja paraqitet kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë, e shoqëruar me diplomën/diplomat dhe listën/listat përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë përkatës.
- □ Për rastet e diplomave të huaja kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë e shoqëruar me diplomën dhe listën përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet të lëshuar nga Institucioni i arsimit të lartë përkatës.
- □ Vërtetim që ka dorëzuar dokumentacionin për njohje në MAS (nëse procesi i njohjes nuk ka përfunduar ende). Dokumenti i njohjes duhet të dorëzohet jo më vonë se data e parashikuar për testimin e informatizuar, si dhe përpara shpalljes së rezultatit përfundimtar nga Komisioni i Vlerësimit.
- □ Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e dokumentit/eve që vërteton/jnë njohjen e gjuhës së huaj/gjuhëve të huaja.
- □ Fotokopje e noterizuar e licencës për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë.
- □ Fotokopje e noterizuar e dëshmisë së regjistrimit në Urdhrin Profesional përkatës në Republikën e Shqipërisë.
- □ Dëshmi penaliteti e vlefshme.
- □ Letër mbështetëse nga Ministria përkatëse.
- □ Mandat pagesën për konkurrimin (e cila është e pakthyeshme).
- □ Dy foto personale.

^ Deklaroj se jam në dijeni të faktit se në përfundim të procesit të konkurrimit dhe përpara regjistrimit përfundimtar në specializimin afatgjatë nënshkruhet kontrata përkatëse, në rastet kur përfitohet një kuotë specializimi e mbuluar nga Ministria e Shëndetësisë apo Ministritë e tjera, e cila ka detyrime për angazhimin pas përfundimit të specializimit për një kohëzgjatje në përputhje me kontratën. Mosrespektimi i kësaj kontrate ka penalitetet përkatëse për specializantin, të parashikuara në kontratën e lidhur mes palëve.

^ Deklaroj se jam në dijeni se përcaktimi i vendit të punës, në rast përfitimi të një kuote të mbuluar nga Ministria e Shëndetësisë, do të bëhet nga kjo Ministri pas përfundimit të specializimit përkatës

sipas kritereve dhe procedurave të parashikuara në rregulloren përkatëse të specializimeve për të cilën kam marrë dijeni.

^ Autorizoj UMT, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve specializuese, si dhe publikimin eventual të tyre.

^ Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

^ Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik në të cilin po aplikoj.

^ Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

^ Deklaroj se jam njohur me rregulloren e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, si dhe udhëzimin përkatës të Ministrit përgjegjës për arsimin, dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit dhe konkurrimit, si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në rregulloren e sipërcituar, udhëzimin përkatës, si dhe vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

^ Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose UMT nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

^ _____ _____

Emër Atësi Mbiemër i Kandidatit Emër Mbiemër i punonjësit të ngarkuar për pranimin e aplikimit

Firma

Firma

Vendi: _____ Data: ____ . ____. _____ , ora _____

Shtojca nr. 10

FORMULAR APLIKIMI (Për transferimet)

Unë i/e nënshkruari/a _____ , lindur më _____

emri atësia mbiemri

në _____ ,Vendbanimi _____ me

kartë identiteti/pasaportë nr. _____

Adresa _____

,

Tel _____ , Cel _____ , E-mail _____ ,

KËRKOJ:

Të transferohem për të vazhduar Specializimin Afatgjatë në programin e studimit:

_____ , ID ____ Në

momentin e paraqitjes së kësaj kërkese, nën përgjegjësinë time ligjore,

DEKLAROJ se:

• Zotëroj:

□ Diplomë të Integruar të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në _____ ,

lëshuar nga IAL _____ , Shteti _____

□ të njohur në RSH (për diplomat e huaja)

□ Diplomë të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në _____ , lëshuar nga IAL _____ , Shteti _____

□ të njohur në RSH (për diplomat e huaja)

• Kam notë mesatare të ponderuar të të gjithë viteve të studimeve universitare (cikli i parë+cikli i dytë ose diplomë e integruar e ciklit të dytë) _____ (me dy shifra të rrumbullakosura pas presjes dhjetore).

• Po ndjek programin specializues afatgjatë në _____

Pranë IAL-së _____ , shteti _____

• Zotëroj gjuhën/t e huaj/a më poshtë:

□ Angleze, niveli _____

□ Italiane, niveli _____

□ Frënge, niveli _____

□ Gjermane, niveli _____

□ Spanjolle, niveli _____

^ Bashkëlidhur këtij formulari kam dorëzuar:

□ Letër motivimi.

□ Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, kartë identiteti ose pasaportë.

- □ Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e diplomës universitare, të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" si dhe të ciklit të dytë "Master i Shkencave", ose të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë, dhe listës/listave të notave. Për rastet e diplomave të huaja paraqitet kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën e Shqipërisë, e shoqëruar me diplomën/diplomat dhe listën/listat përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë përkatës.
- □ Për rastet e diplomave të huaja kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes në Republikën

  e Shqipërisë e shoqëruar me diplomën dhe listën përkatëse të notave ose të një dokumenti tjetër të vlefshëm për regjistrimin në Universitet në vendin ku janë kryer studimet të lëshuar nga Institucioni i arsimit të lartë përkatës.
- □ Vërtetim që ka dorëzuar dokumentacionin për njohje në MAS (nëse procesi i njohjes nuk ka përfunduar ende). Dokumenti i njohjes duhet të dorëzohet jo më vonë se data e parashikuar për testimin e informatizuar, si dhe përpara shpalljes së rezultatit përfundimtar nga Komisioni i Vlerësimit.
- □ Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e dokumentit/eve që vërteton/jnë njohjen e gjuhës së huaj/gjuhëve të huaja.
- □ Fotokopje e noterizuar e licencës për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë.
- □ Fotokopje e noterizuar e dëshmisë së regjistrimit në Urdhrin Profesional përkatës në Republikën e Shqipërisë.
- □ Dëshmi penaliteti e vlefshme.
- □ Letër mbështetëse nga Ministria përkatëse (sipas formatit të parashikuar në udhëzim).
- □ Mandat pagesën për konkurrimin (e cila është e pakthyeshme).
- □ Dy foto personale.
- □ Planin e plotë të programit të studimit specializuas të ndjekur.
- □ Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, si dhe syllabuset përkatëse për lëndët e shlyera i cili do te shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur.
- □ Vërtetim për periudhat e praktikave dhe frekuentimin e aktiviteteve të parashikuara në programin

  specializues të ndjekur.

^ Deklaroj se jam në dijeni të faktit se në përfundim të procesit të konkurrimit dhe përpara regjistrimit përfundimtar në specializimin afatgjatë nënshkruhet kontrata përkatëse, në rastet kur përfitohet një kuotë specializimi e mbuluar nga Ministria e Shëndetësisë apo Ministritë e tjera, e cila ka detyrime për angazhimin pas përfundimit të specializimit për një kohëzgjatje në përputhje me kontratën. Mosrespektimi i kësaj kontrate ka penalitetet përkatëse për specializantin, të parashikuara në kontratën e lidhur mes palëve.

^ Deklaroj se jam në dijeni se përcaktimi i vendit të punës, në rast përfitimi të një kuote të mbuluar nga Ministria e Shëndetësisë, do të bëhet nga kjo Ministri pas përfundimit të specializimit përkatës sipas kritereve dhe procedurave të parashikuara në rregulloren përkatëse të specializimeve për të cilën kam marrë dijeni.

^ Autorizoj UMT, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve specializuese, si dhe publikimin eventual të tyre.

^ Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

^ Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik në të cilin po aplikoj.

^ Deklaroj se jam në dijeni se para regjistrimit përfundimtar duhet të paraqes dokumentin e çregjistrimit nga programi specializues afatgjatë që jam duke ndjekur, dhe se mosparaqitja e dokumentit të çregjistrimit nuk lejon regjistrimin përfundimtar në programin specializues ku kam aplikuar. Deklaroj se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

^ Deklaroj se jam njohur me rregulloren e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, si dhe udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit dhe konkurrimit, si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në rregulloren e sipërcituar, udhëzimin përkatës, si dhe vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

^ Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose UMT nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

_____ _____

Emër Atësi Mbiemër i kandidatit Emër Mbiemër i punonjësit të ngarkuar për pranimin e aplikimit

Firma Firma

Vendi: _____ Data: ____ . ____. _____ , ora _____

Shtojca nr. 11

Stema dhe emërtimi i Ministrisë mbështetëse

Ministri

Nr. _____ Prot. Datë ___.___. _____

LETËR MBËSHTETËSE

Në zbatim të vendimit nr. 808, datë 3.10.2015, të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit, në programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2015–2016", si edhe të propozimit të

_____

(Emërtimi i institucioni ku kandidati është i punësuar aktualisht)

mbështesim kërkesën e kandidatit _____

(Emër Atësi Mbiemër i kandidatit/e kandidates)

për të aplikuar me kuotat e Ministrisë _____

(Emërtimi i Ministrisë që lëshon letrën mbështetëse)

në programin specializues afatgjatë në _____ .

(Emërtimi i programit specializues)

_____

(Emër Mbiemër i Ministrit)

MINISTËR

Firma, Vula

Shtojca nr. 12

Tabela 3. Lista e të gjithë kandidatëve e renditur sipas pikëzimit në përfundim të shqyrtimit të komisionit të vlerësimit.

Nr.	**Emër**	**Atësi**	**Mbiemër**	**Datëlindje**	**Pikët e akorduara**			
					Intervista	**Testimi i informatizuar**	**Nota mesatare**	**Pikët totale**
1								
2								

3 ....

Shtojca nr. 13

Tabela 4. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të vlerësimit.

[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
1											
2											
3											
[illegible]											

UDHËZIM

Nr. 2, datë 08.02.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 11.8.2016, "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT TË KANDIDATËVE NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, KANDIDATËVE ME ORGJINË SHQIPTARE NGA MAQEDONIA, MALI I ZI, PRESHEVA, MEDVEGJA DHE BUJANOVCI, SI DHE KANDIDATËVE ME STATUSIN E TË VERBRIT, INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, TË JETIMIT, SI DHE ROMËT DHE EGJIPTIANËT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2016-2017"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 1.6.2016 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 18, datë 11.8.2016, togfjalëshi "me statusin e të verbrit, invalidit parapelgjik dhe tetraplegjik ", të ndryshojë në "me statusin e personit me aftësi të kufizuar".

2. Pika 1.2.1 e kreut II, të ndryshojë në: "1.2.2 Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1.2 duhet të dorëzojnë kopje të vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).".

3. Pika 1.2.2 e kreut II, shfuqizohet.

4. Ngarkohet, për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 5, datë 16.02.2017
PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 52, DATË 3.12.2015 "PËR PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4 të nenit 76 dhe pikës 3 të nenit 78 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Pika 4 e udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, ndryshohet si më poshtë:

"4. Kandidati që aplikon për t'u pranuar në programe studimit të ciklit të dytë apo të tretë në institucionin e arsimit të lartë, duhet të ketë certifikime dhe rezultate të testimeve ndërkombëtare për nivelet e njohjes së gjuhëve, brenda afateve të vlefshmërisë së certifikimeve të lëshuara".

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 8, datë 13.03.2017

"PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 9, pika 4 dhe nenit 10, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 8, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 9 dhe 10, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar",

UDHËZOJ:

1. Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), është institucion publik i krijuar me ligj, në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin, që ka për mision ofrimin e shërbimeve dhe sigurimin e aksesit publik në fushën e arsimit të lartë dhe arsimit parauniversitar.
2. QSHA-ja ka për objekt veprimtarie ofrimin e shërbimeve për nxënësit, studentët, kandidatët për të marrë titullin e një profesioni të rregulluar, shkollat, IAL-të, urdhrat profesionalë, institucionet dhe të tretët.
3. Shërbimet ndaj të tretëve ofrohen nga QSHA-ja pas miratimit nga ministria përgjegjëse për arsimin. QSHA-ja i ofron këto shërbime kundrejt tarifave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. QSHA-ja ka këto funksione:

a) Koordinon procesin e aplikimit në institucionet e arsimit të lartë, për ndjekjen e studimeve në programet e ciklit të parë, atyre të integruara dhe programet profesionale;
b) Pranon aplikimet, koordinon procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga Komisioni i Posaçëm i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe nëpërmjet nëpunësve të caktuar shërben si Sekretariat Teknik i Komisionit për procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të ardhur nga jashtë vendit. QSHA-ja administron dokumentacionin e këtij procesi sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.
c) Pranon aplikimet, koordinon procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga Komisioni i Posaçëm i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe nëpërmjet nëpunësve të caktuar shërben si Sekretariat Teknik i Komisionit për njohjen e diplomave, certifikatave e gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit dhe njohja e titujve të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë. QSHA-ja administron dokumentacionin e këtij procesi sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.
d) Përcjell rezultatet e provimit të shtetit në ministritë e linjës, urdhrat profesionalë dhe njësitë arsimore vendore.
e) Krijon dhe administron regjistrin kombëtar të studentëve të të gjitha cikleve dhe një bazë të dhënash për institucionet e arsimit të lartë, lidhur me programet e studimit, diplomat apo certifikatat që ato lëshojnë.
f) Pajis çdo student, në regjistrimin fillestar në një institucion të arsimit të lartë me një numër unik matrikullimi, për çdo cikël studimi. Ky numër e shoqëron studentin deri në marrjen e diplomës ose certifikatës për ciklin përkatës të studimit, sipas përcaktimeve të bëra me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.
g) Realizon studime që lidhen me provimet kombëtare dhe provimet e shtetit.
h) Merr masa për sigurinë e bazave të të dhënave që administron.
i) Ofron çdo shërbim tjetër, të lidhur me objektin e veprimtarisë së saj, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe shërbime të tjera të miratuara nga Ministri përgjegjës për arsimin.

5. Çdo institucion i arsimit të lartë raporton në QSHA, programet e studimit që ofrojnë dhe diplomat apo certifikatat që ata lëshojnë, sipas procedurës të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.
6. Çdo institucion i arsimit të lartë raporton në QSHA, të gjithë aplikantët e regjistruar në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve të larta, si dhe listën e të diplomuarve sipas cikleve, brenda afateve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
7. Çdo urdhër profesional dhe njësi arsimore vendore raporton në QSHA, listat e kandidatëve që do t'i nënshtrohen provimit të shtetit, për çdo profesion të rregulluar sipas afateve të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.
8. QSHA-ja bën publike kuotat dhe kriteret e pranimit të përcjella nga IAL-të, për të gjitha ciklet e studimit.

9. QSHA-ja lëshon diplomën e maturës shtetërore, që është dokumenti i përfundimit të arsimit të mesëm të lartë është, dhe jepet pasi nxënësi është kalues në provimet kombëtare, të detyruara dhe me zgjedhje, të maturës shtetërore.
10. Struktura dhe organika e QSHA-së përcaktohen me urdhër nga ministri përgjegjës për arsimin në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.
11. QSHA-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm.
12. Drejtori i përgjithshëm emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me vendimin nr.173, datë 7.3.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit".
13. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të QSHA-së rregullohen në bazë të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.
14. QSHA-ja është institucion që financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e veta, si dhe ka të drejtën e administrimit të të ardhurave të krijuara, në masën 90 për qind të vitit buxhetor.

Të ardhurat e papërdorura kalojnë në vitin pasardhës buxhetor.

15. Ministri përgjegjës për arsimin miraton rregulloren e funksionimit të QSHA-së.
16. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij udhëzimi, për vitin 2017, do të përballohen nga buxheti i këtij viti, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
17. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, njësitë arsimore vendore, urdhrat profesionalë dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 11, datë 10.04.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 52, DATË 3.12.2015 "PËR PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4 të nenit 76 dhe të pikës 3 të nenit 78 të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Tabela nr. 1, bashkëlidhur udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, 2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, zëvendësohet me tabelën nr.1/1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 15, datë 19.05.2017

"PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2017 – 2018" *(Ndryshuar me udhëzimin nr. 18, datë 16.08.2017, udhëzimin nr.21, datë 02.10.2017, udhëzimin nr.23, datë 16.10.2017)*

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 346, datë 19.4.2017, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018",

UDHËZOJ:

KREU I
PORTALET E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT

1. Aplikimi i maturantëve/kandidatëve me formularët A1 dhe A1Z dhe përzgjedhja e programeve të ciklit të parë të studimeve, të programeve të studimeve me karakter profesional, si dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, të ofruara nga IAL-të për vitin akademik 2017-2018, bëhet në Portalin e Maturës Shtetërore online: ëëë.matura.qsha.gov.al.
2. Hedhja e rezultateve lëndore të të gjitha viteve të arsimit të mesëm, për maturantët/kandidatët që kanë plotësuar online formularin A1 ose A1Z, bëhet nga drejtoritë e institucioneve arsimore në portalin "Maturanti": ëëë.rezultateam.al.
3. Regjistrimi i fituesve të shpallur nga IAL-të bëhet nga sekretaritë mësimore dhe pasqyrohet në portalin U-Albania: ëëë.ulbania.arsimi.gov.al.
4. Për të gjithë maturantët e vitit shkollor 2016-2017, të cilët kanë aplikuar me formularin A1, nga drejtoritë e institucioneve arsimore hidhen në Portalin Online të Maturantit të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

Deri më 31 maj 2017 hidhen rezultatet e arsimit të mesëm, me përjashtim të atyre të vitit të fundit. Rezultatet e vitit të fundit hidhen gjatë muajit qershor, pas përfundimit të vitit shkollor.

5. Për kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm përpara vitit shkollor 2016-2017 dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen deri më 30 qershor 2017 në Portalin Online të Maturantit të gjitha të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

6. Për të gjithë kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen deri më 30 qershor 2017 në Portalin Online të Maturantit të gjitha të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

KREU II

RAUNDI I PARË

A. Procedurat e aplikimit

1. Të gjithë maturantët/kandidatët, për ndjekjen e studimeve në IAL-të, publike dhe jopublike, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, duhet të kryejnë procesin e aplikimit online në Portalin Matura Shtetërore Online.

2. Aplikimi kryhet nga maturantët/kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) janë pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të arsimit të mesëm;
b) plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave;
c) plotësojnë kriteret shtesë të përcaktuara nga IAL-të, për programet e studimit për të cilat aplikojnë;
d) nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.

3. Maturantët/kandidatët, përpara aplikimit në Portalin e Maturës Shtetërore, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dy mijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare elektronike të QSHA-së: ëëë.qsha.gov.al.

4. Deri më 18 korrik 2017, QSHA-ja do t'iu përcjellë shkollave të mesme përllogaritjen e notës mesatare sipas VKM-së.

5. Maturantët/kandidatët dorëzojnë në shkollën ku kanë kryer plotësimin e formularit A1/A1Z mandatin e pagesës së kryer. Pas dorëzimit të mandatit të pagesës, sekretaritë e shkollave hedhin në portalin e Maturës Shtetërore Online notën mesatare të llogaritur nga QSHA-ja, në zbatim të VKM-së nr. 346, datë 19.4.2017.

6. Maturantët/kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM-në nr. 346, datë 19.4.2017.

7. Në periudhën 20 - 29 korrik 2017, të gjithë maturantët/kandidatët që duan të ndjekin studimet në IAL, përfshirë edhe kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit, pas pagesës së tarifës së aplikimit dhe hedhjes në sistem të notës mesatare, do të aplikojnë në Portalin e Maturës Shtetërore Online, nëpërmjet formularit të aplikimit. Aplikimi kryhet për çdo DAR/ZA, sipas kalendarit të publikuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

8. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti (sipas procedurave të përshkruara në udhëzuesin teknik, të publikuar në faqen zyrtare të QSHA-së).

9. Maturantët/kandidatët aksesohen në portal me kredencialet e tyre: ID e kandidatit; emri, atësia, mbiemri; karta e identitetit; email-i i kandidatit etj. Kandidatët zgjedhin deri në 10 (dhjetë) programe studimi nga lista e programeve të studimit, që ofrohen nga IAL-të publike/ jopublike, për vitin akademik 2017-2018.
10. DAR/ZA-të duhet të marrin masa për krijimin e kushteve (mjedise, asistencë teknike, këshilluese etj.) për t'iu ofruar maturantëve/ kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar, lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.
11. Portali i Maturës Shtetërore Online nuk dotë pranojë aplikime nga maturantët/kandidatët, të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me VKM për programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë.

B. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përllogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/ kandidatëve të renditur

1. Brenda datës 8 gusht 2017, QSHA-ja iu përcjell IAL-ve që zhvillojnë konkurse/testime pranimi, në formë elektronike dhe zyrtarisht, listën e aplikantëve që konkurrojnë në programet përkatëse të studimit.
2. Më datë 9 gusht 2017, të gjitha IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi, afishojnë në mjediset e tyre dhe në faqet zyrtare elektronike përkatëse listat e aplikantëve. Në periudhën 11 deri 22 gusht 2017 do të zhvillohen konkurset/testimet.
3. Brenda datës 23 gusht 2017, QSHA-ja iu përcjell të gjitha IAL-ve, në formë elektronike dhe zyrtarisht, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:
a) listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;
b) notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme;
c) rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;
d) mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme;
e) mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;
f) mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas VKM-së nr. 346, datë 19.4.2017;
g) indekset e profileve të shkollave të mesme.
4. Të gjitha IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, pas kryerjes së përllogaritjes së pikëve për çdo konkurrent, sipas kritereve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja me vendim senati, si dhe renditjes së tyre në varësi të pikëve të grumbulluara, afishon në mjediset publike, si dhe në faqen e saj zyrtare listat e renditjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.
5. Brenda datës 28 gusht 2017, të gjitha IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-në e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës 28 gusht 2017, IAL-të i përcjellin zyrtarisht një kopje elektronike të këtyre listave QSHA-së. Gjithashtu, brenda datës 28 gusht 2017, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

C. Procesi i regjistrimit

1. Në datat 29 gusht deri 11 shtator 2017, të gjithë aplikantët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e parë dhe janë shpallur fitues, mund të kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretaritë mësimore të IAL-ve në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.
2. Periudha 29 gusht deri 11 shtator është e ndarë në 7 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në njërin apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.
3. Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë.

Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 7 fazave 48-orëshe, MAS dhe QSHA do të publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare: ëëë.arsimi.gov.al dhe ëëë.qsha.gov.al.

4. Procesi i regjistrimeve nga sekretaritë mësimore, me dokumentacion dhe online, vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e fituesve të raundit të parë.

5. Në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj mund të regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Këto faza vijojnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën 11 shtator 2017.

6. Aplikantët fitues duhet të regjistrohen vetëm në një program studimi, me përjashtim të nxënë sve dhe studentëve të shkëlqyer. Pas marrjes së dokumentacionit nga aplikanti dhe regjistrimit të tij, sekretaria pasqyron regjistrimin e tij edhe online në Portalin U-Albania. Aplikantët dorëzojnë, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja;
b) fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehsuar në MAS;
c) deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjëses së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë.

7. Sekretaritë mësimore mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të aplikantit pasqyrohet regjistrimi i tij edhe online në portalin U-Albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretarja firmoset në dy kopje formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit.

8. Brenda datës 13 shtator 2017, IAL-të përcjellin në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të parë bashkë me kuotat e paplotësuara në format elektronik dhe në hard copy.

9. Aplikantët fitues në një program studimi, të cilët nuk janë regjistruar sipas afateve të raundit të parë, humbasin të drejtën për t'u regjistruar. Ata kanë të drejtën që të plotësojnë formularin e aplikimit të raundit e dytë. Ç. Procesi i çregjistrimit

1. Aplikanti, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, ka të drejtë të çregjistrohet vetëm më datë 12 shtator 2017. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda kësaj date, ai nuk ka të drejtë ta ndryshojë programin e studimit për atë vit akademik.

2. Sekretaritë mësimore, pas çregjistrimit të aplikantëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, i dërgojnë QSHA-së, brenda datës 13 shtator, listën e aplikantëve të çregjistruar, si dhe pasqyrojnë brenda po kësaj date në portalin U-Albania këto lista në format elektronik.

D. Procesi i ankimimit

1. Aplikantët kanë të drejtën e ankimimit në IAL në datat 29-30 gusht 2017. Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesave, IAL-të duhet të shprehen me vendim lidhur me ankimimet. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

2. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, përcjellin zyrtarisht në QSHA, brenda datës 1 shtator 2017, vendimet lidhur me ankimimet e aplikantëve, si dhe pasqyrojnë brenda po kësaj date në portalin U-Albania këto vendime në format elektronik.

3. Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, mund të vijojnë procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa e tyre është

pranuar, ata mund të çregjistrohen nga programi i studimit (nëse janë regjistruar) dhe të regjistrohen sipas dëshirës në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, vetëm më datë 12 shtator 2017.

KREU III

RAUNDI I DYTË

A. Procedurat e aplikimit

1. Në periudhën 15 shtator - 22 shtator 2017 do të kryhet procesi i aplikimit online për raundin e dytë në Portalin e Maturës Shtetërore Online. Kanë të drejtë të aplikojnë, duke përzgjedhur deri në 10 (dhjetë) preferenca, të gjithë maturantët/kandidatët, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe rezultojnë kalues në provimet e Maturës Shtetërore, por që: a) nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë;

b) kanë kryer procesin e aplikimit online në raundin e parë dhe nuk janë shpallur fitues;

c) kanë kryer procesin e aplikimit online në raundin e parë dhe nuk kanë arritur të regjistrohen;

d) janë çregjistruar pas përfundimit të raundit të parë.

2. Aplikimet për çdo DAR/ZA do të kryhen sipas kalendarit të publikuar në shtojcën nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Deri më datë 10 shtator 2017, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, për të gjithë maturantët/kandidatët që kanë rezultuar kalues në provimet e sesionit të dytë (sesioni i vjeshtës), menjëherë pas publikimit të rezultateve të provimeve të këtij sesioni, hidhen në Portalin Online të Maturantit të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

4. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti (sipas procedurave të përshkruara në udhëzuesin teknik të publikuar në faqen zyrtare të QSHA-së).

5. DAR/ZA-të të marrin masa për krijimin e kushteve (mjedise, asistencë teknike, këshilluese etj.) për t'i ofruar maturantëve/kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.

6. Maturantët/kandi datët që nuk kanë aplikuar në raundin e parë, përpara aplikimit në Portalin e Maturës Shtetërore, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 lekë. Mandati i pagesës së kryer dorëzohet në shkollën përkatëse, ku maturantët/kandidatët kanë kryer plotësimin e formularit A1/A1Z. Maturantët/kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë dhe do të riaplikojnë në raundin e dytë nuk duhet të kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit prej 2000 lekësh. 7. Deri më datë 14 shtator 2017, QSHA-ja do t'iu përcjellë shkollave të mesme përllogaritjen e notës mesatare sipas VKM-së.

8. Maturantët/kandidatët dorëzojnë në shkollën ku kanë kryer plotësimin e formularit A1/A1Z mandatin e pagesës së kryer. Pas dorëzimit të mandatit të pagesës, sekretaritë e shkollave hedhin në portalin e Maturës Shtetërore Online notën mesatare të llogaritur nga QSHA-ja, në zbatim të VKM-së nr. 346, datë 19.4.2017.

B. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përllogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/ kandidatëve të renditur

1. Brenda datës 27 shtator 2017, QSHA-ja iu përcjell IAL-ve, në formë elektronike dhe zyrtarisht, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:

a) listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;

b) notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

c) rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;

d) mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

e) mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;

f) mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas VKM-së nr. 346, datë 19.4.2017;

g) indekset e profileve të shkollave të mesme.

2. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë kryejnë procesin e përllogaritjeve të pikëve për çdo aplikant, sipas kritereve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja me vendim senati. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e aplikantëve të renditur dhe formulën/mënyrën e përllogaritjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

3. Brenda datës 30 shtator 2017, IAL-të afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-në e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës 30 shtator 2017, IAL-të i përcjellin zyrtarisht një kopje elektronike të këtyre listave QSHA-së. Gjithashtu, brenda datës 30 shtator 2017, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin UAlbania.

C. Procesi i regjistrimit

1. Në datat 1 tetor deri 14 tetor 2017, të gjithë aplikantët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e dytë dhe janë shpallur fitues, mund të kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretaritë mësimore në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.

2. Periudha 1 tetor deri 14 tetor është e ndarë në 7 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në njërin apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë.

Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 7 fazave 48-orëshe, MAS dhe QSHA do të publikojnë një Udhëzues Teknik në faqet përkatëse zyrtare: ëëë.arsimi.gov.al dhe ëëë.qsha.gov.al.

3. Procesi i regjistrimeve nga sekretaritë mësimore, me dokumentacion dhe online, vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e rankuara të raundit të dytë.

4. Në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj mund të regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Këto faza vijojnë deri në plotësimin e kuotave.

5. Sekretaritë mësimore do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë aplikantët fitues që dëshirojnë të regjistrohen vetëm në një program studimi. Pas marrjes së dokumentacionit nga aplikanti dhe regjistrimit të tij, sekretaria bën regjistrimin online në Portalin U-Albania. Aplikantët dorëzojnë, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja;
b) fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehsuar në MAS;
c) deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij Udhëzimi, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjëses së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë.

6. Sekretarit ë mësimore të fakulteteve të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të aplikantit pasqyrohet regjistrimi i tij edhe online në portalin U-Albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretarja firmoset në dy kopje formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit.

7. Brenda datës 20 tetor 2017, IAL-të përcjellin në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të dytë në format elektronik dhe hard copy.
8. Aplikantët, të cilët kanë bërë regjistrimin me dokumentacion dhe kanë nënshkruar në regjistër, nuk kanë të drejtë të ndryshojnë programin e studimit për atë vit akademik.
Ç. Procesi i ankimimit
1. Aplikantët kanë të drejtën e ankimimit në IAL në datat 1 - 2 tetor 2017. Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesave, IAL-të duhet të shprehen me vendim lidhur me ankimimet. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.
2. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, përcjellin zyrtarisht në QSHA, brenda datës 4 tetor 2017, vendimet lidhur me ankimimet e aplikantëve, si dhe pasqyrojnë brenda po kësaj date në portalin U-Albania këto vendime në format elektronik.
3. Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, mund të vijojnë procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa e tyre është pranuar, ata mund të çregjistrohen nga programi i studimit (nëse janë regjistruar) dhe të regjistrohen sipas dëshirës në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, vetëm më datë 16 tetor 2017.

KREU IV

DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMIMI

1. Portali Matura Shtetërore Online është sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të administrojë:
a) procedurat e aplikimit me formularët A1 dhe A1Z të maturantëve/kandidatëve të Maturës Shtetërore 2017, që synojnë të bëhen pjesë e garës për t'u shpallur fitues dhe regjistruar në njërin prej programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të për vitin akademik 2017-2018; b) digjitalizimin e rezultateve të këtyre provimeve;
c) procesin e përzgjedhjes nga maturantët/ kandidatët të preferencave në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve dhe/ose programeve të studimeve me karakter profesional dhe/ose programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, të shpallura nga IAL-të (publike dhe jopublike) për vitin akademik 2017-2018.
2. Portali Maturanti është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të kryejë proceset e mëposhtme:
a) regjistrimin dhe administrimin e rezultateve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të maturantëve/kandidatëve, që kanë plotësuar formularin e aplikimit A1 ose A1Z në Portalin Matura Shtetërore Online;
b) përcjelljen IAL-ve të bazës së plotë të të dhënave të maturantëve/kandidatëve, që kanë përzgjedhur programet e studimit që këto IAL ofrojnë.
3. Portali U-Albania është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të mundësojë me transparencë të plotë:
a) informimin e maturantëve/kandidatëve për programet e studimit që ofrojnë IAL-të publike dhe jopublike për vitin akademik 2017-2018 dhe për çdo program, në mënyrë të detajuar: i) kriteret e pranimit; ii) kuotat e pranimit; iii) programet mësimore, kurrikulat etj.
b) dhënien online të informacioneve të nevojshme për maturantët/kandidatët për ndjekjen në mënyrë dinamike, përgjatë raundit të parë dhe raundit të dytë, të procesit të shpalljes së fituesve.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE

1. Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian do të bëhet sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MAS.
2. Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve shtetas të huaj në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018 do të bëhet sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MAS.
3. Aplikimi për program të dytë studimi dhe për transferimin e studimeve do të bëhet në institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MAS.
4. Aplikimi për programe të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë, si dhe programet specializuese afatgjata do të bëhen në institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të udhëzimeve të posaçme të MAS.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI

1. IAL-të të dorëzojnë në QSHA, në formë zyrtare dhe elektronike, brenda datës 15 nëntor 2017, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar për pajisjen e studentëve me numër matrikullimi, sip as udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", të ndryshuar, si dhe deklaratën sipas shtojcës nr. 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi.
QSHA-ja u dërgon IAL-ve, brenda datës 31.12.2017, numrat individualë të regjistrimit (matrikullimit) të studentëve të regjistruar.
2. Kandidatët e shpallur fitues në programet e të gjitha cikleve të studimit nuk mund të regjistrohen për të ndjekur njëkohësisht dy programe studimi në IAL-të publike dhe/ose jopublike, në të njëjtin vit akademik, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.
3. IAL-të të përpilojnë një raport të hollësishëm në lidhje me regjistrimet e studentëve në afatet dhe formatet e kërkuara sipas udhëzimit nr. 9, datë 25.2.2010 "Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore". Ky raport të dërgohet në MAS brenda datës 15 dhjetor 2017.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Drejtoria e Arsimit Paraauniversitar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, DAR/ZA-të dhe IAL-të publike dhe jopublike. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

Shtojca nr. 1

KALENDARI I APLIKIMEVE PËR RAUNDIN E PARË PLANI KALENDAR I APLIKIMIT ONLINE ME FORMULARIN E APLIKIMIT NË IAL
Datë DAR/ZA

20.7.17 Tirana qytet Tirana qark
21.7.17 Tirana qytet Tirana qark
22.7.17 Tirana qytet Tirana qark Kamzë Kavajë Durrës Krujë
23.4.17 Kukës Has Tropojë Dibër Mat Bulqizë
24.7.17 Elbasan Peqin Gramsh Librazhd Korçë Pogradec Kolonjë Devoll
25.7.17 Fier Mallakastër Lushnjë Berat Kuçovë Skrapar
26.7.17 Shkodër M. Madhe Pukë Lezhë Kurbin Mirditë
27.7.17 Vlorë Sarandë Delvinë Gjirokastër Tepelenë Përmet
28.7.17 Rezervë Rezervë Rezervë Rezervë Rezervë Rezervë Rezervë Rezervë
29.7.17 Rezervë Rezervë Rezervë Rezervë Rezervë Rezervë Rezervë Rezervë

Shtojca nr. 2

KALENDARI I APLIKIMEVE PËR RAUNDIN E DYTË
Datë DAR/ZA
15.9.17 Tirana qytet Tirana qark
16.9.17 Tirana qytet Tirana qark Kamzë Kavajë Durrës Krujë
17.9.17 Kukës Has Tropojë Dibër Mat Bulqizë
18.9.17 Fier Mallakastër Lushnjë Berat Kuçovë Skrapar
19.9.17 Shkodër M. Madhe Pukë Lezhë Kurbin Mirditë
20.9.17 Vlorë Sarandë Delvinë Gjirokastër Tepelenë Përmet
21.9.17 Elbasan Peqin Gramsh Librazhd Korçë Pogradec Kolonjë Devoll
22.9.17 Rezervë Rezervë Rezervë Rezervë Rezervë Rezervë Rezervë Rezervë

Shtojca nr. 3

DEKLARATË
Unë i nënshkruari , lindur më me kartë identiteti/pasaportë nr.
emri atësia mbiemri
1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu, institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.
2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.
3. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.
4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër,atësi,mbiemërikandidatit Emër, atësi, mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore Firma:
Firma:
Vendi: Data: ____.____.____

UDHËZIM

Nr. 20, datë 22.09.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 52, DATË 3.12.2015, "PËR PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4, të nenit 76 dhe pikës 3, të nenit 78, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Tabela nr. 1/1 e udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, zëvendësohet me tabelën nr. 1/2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Lindita Nikolla

Tabela 1/2

Në mbështetje të kuadrit të referencave për gjuhët, të krijuar nga Këshilli i Europës (2001), Kuadrit të Përbashkët Europian të Referencave për Gjuhët, si dhe në bashkëpunim me ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Spanjës të akredituara në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit njeh testet e gjuhëve të huaja dhe nivelet si më poshtë:

Niveli B1 B2 C1

Gjuha angleze

Cambridge PET FCE CAE

IELTS 4.0 / 5.0 5.5 / 6.0 6.5 / 7.0

TOEFL Internet-based Test (iBT) 57/86 87/109 110/120

TOEFL Paper-based Test (ITP) 460 543 627

TOEIC 381 / 649 650/ 785 786 / 935

GESE - 7, 8, 9 10, 11

APTIS Aptis B1 Aptis B2 Aptis C

Gjuha gjermane

Goethe-Institut, Goethe Zentrum Goethe-Zertifikat B1 Goethe-Zertifikat B2 Goethe-Zertifikat C1

TestDaF - TDN 3 - TDN4 TDN 5
OSD OSD-Zertifikat B1 OSD-Zertifikat B2 OSD-Zertifikat C1

Gjuha franceze

TFI 345/604 605/824 825

DELF DELFB1 DELFB2 DALFC1

TCF TCF 300 - 399 TCF 400 - 499 TCF 500 - 599

TEF TEF 361-540 TEF 541-698 TEF 699-833

Gjuha italiane

Peruggia CELI2 livello2 CELI3 livello3 CELI4 livello4

Sienna CILS uno B1 CILS 2 CILS 3

PLIDA PLIDA certification B1 PLIDA certification B2 PLIDA certification C1

Gjuha spanjolle

DELE DELE inicial DELE intermedio DELE superior

UDHËZIM

Nr. 21, datë 02.10.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 15, DATË 19.5.2017, "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË VITIN AKADEMIK 2017-2018", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Pika 2 e germës "C", e kreut III të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

"2. Periudha 1 tetor deri 14 tetor është e ndarë në 7 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në njërin apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë. Për programet e studimit të ofruara nga universitetet private, të cilat nuk parashikojnë kritere shtesë, nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe.

Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 7 fazave 48-orëshe, MASR-ja dhe QSHA-ja do të publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare: ëëë.arsimi.gov.al dhe ëëë.qsha.gov.al".

2. Pika 4 e germës "C", e kreut III të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

"4. Në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj mund të regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Këto faza vijojnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën 14 tetor 2017. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara të cilat nuk ka aplikantë në pritje, do të rikthehen në garë aplikantët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi në garë kryhet sipas listës së renditjes të aplikantëve për raundin e dytë.".

3. Pika 14 e kreut VI/1 të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

"14. Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore nga data 10 tetor 2017 deri në datën 14 tetor 2017, sipas dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës 24 tetor 2017.".

4. Pika 15 e kreut VI/1, të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“15. IAL-të, brenda datës 27 tetor, 2017 dërgojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format *Excel*, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin e tyre.”.

5. Pika 1 e kreut VI/3, të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“1. Të gjithë kandidatët shtetas të huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 20172018, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL), nga data 16-19 gusht 2017, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL.”.

6. Germa “b” e pikës 14, e kreut VI/3, të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“b) Njohja e dokumentacionit të kandidatëve fitues, të pajisur me diploma të huaja, në programet e përbashkëta të studimit, kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen regjistrimin e tyre përfundimtar me statusin e studentit dhe brenda datës 26 janar 2018 ia komunikon IAL-së.”. 7. Germa “f” e pikës 14, e kreut VI/3, të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“f) IAL-të, brenda datës 27 tetor, 2017 dërgojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format *Excel*, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin e tyre.”.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, DAR/ZA-të, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 25, datë 10.11.2017

“PËR REGJISTRIMIN E FORMAVE TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE NË REGJISTRIN SHTETËROR TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR” *(Shfuqizuar)*

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 10, dhe pikës 3, të nenit 91 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

Neni 1
Përcaktimi i regjistrit
1. Regjistri shtetëror i diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor (në vijim Regjistri shtetëror) është një bazë unike të dhënash e të gjitha formave të diplomave dhe certifikatave të lëshuara në përputhje me legjislacionin në fuqi nga institucionet e arsimit të lartë.
2. Regjistri shtetëror mbahet në formë të shkruar dhe elektronike.
3. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja elektronike e të dhënave të depozituara në regjistër kryhet nëpërmjet një sistemi të informatizuar.
4. Regjistrat e shkruar trajtohen sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat". Qendra e Shërbimeve Arsimore (në vijim QSHA) merr dhe arkivon dokumentet shoqëruese të paraqitura nga IAL.

Neni 2
Detyrimi për regjistrim
Institucionet e Arsimit të Lartë (në vijim IAL) kanë detyrimin ligjor të regjistrojnë të gjitha format e diplomave dhe certifikatave në Regjistrin shtetëror përpara datës së lëshimit të tyre, në të kundërt ato nuk marrin vlerë ligjore.

Neni 3
Ligjshmëria e formave të diplomave
Çdo formë diplome apo certifikate që lëshohet nga IAL-të, duhet të jetë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe aktin nënligjor përkatës për përmbajtjen dhe formën e diplomës, të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Neni 4
Procedura e aplikimit për regjistrim
1. Regjistrimi fillestar i formave të diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga IAL-të, si dhe çdo regjistrim tjetër i mëvonshëm, që ndryshon formën apo përmbajtjen e tyre, bëhet në bazë të aplikimit drejtuar QSHA-së.
2. Aplikimi kryhet në QSHA me dosje, në përbërje të së cilës duhet të jenë:
a) Kërkesa për regjistrim.
b) Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e formës së diplomës, për çdo cikël dhe lloj programi studimi.
c) Akti i hapjes së IAL-së.
d) Akti i akreditimit të IAL-së.
e) Akti i hapjes së programit të studimit për të cilin lëshohet diploma.
f) Akti i akreditimit të programit të studimit për të cilin lëshohet diploma.
g) Forma e diplomës apo certifikatës që do të regjistrohet.
h) Dokumenti i pagesës së tarifës për regjistrim, në regjistrin shtetëror, për llogari të QSHA-së.
3. Dokumentet e cituara në pikat "b" dhe "h" duhet të jenë në origjinal ose kopje autentike me origjinalin. Dokumentet duhet të jenë të sakta dhe të plota. Ato nuk duhet të përmbajnë korrigjime apo fshirje.

4. Dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyera dhe të vërtetuara në gjuhën shqipe dhe të legalizuara sipas legjislacionit në fuqi.
5. Qendra e Shërbimeve Arsimore kryen shqyrtimin dhe verifikimin e dokumenteve të paraqitura në dosjen e aplikimit, brenda një afati 30-ditor nga data e depozitimit të aplikimit.

Neni 5
Miratimi i regjistrimit
1. QSHA-ja, pasi kryen shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit në dosjen e aplikimit dhe vëren se IAL dhe programi i studimit përmbushin kriteret për lëshimin e diplomave/certifikatave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe dokumentacioni i depozituar është i plotë sipas kërkesave të këtij udhëzimi, miraton formën e diplomës/certifikatës.
2. Pas miratimit kryhet regjistrimi i formës së diplomës apo certifikatës në regjistrin shtetëror dhe, nga QSHA, lëshohet vërtetimi përkatës për IAL-në e interesuar.
3. Vërtetimi i regjistrimit lëshohet brenda 2 muajsh nga data e paraqitjes së aplikimit.

Neni 6
Pezullimi i aplikimit
Në rast se pas verifikimeve të parashikuara në nenin 5 të këtij udhëzimi rezulton se nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat për regjistrim, të parashikuara në këtë udhëzim, QSHA-ja pezullon aplikimin deri në plotësimin ose ndreqjen e elementeve që pengojnë regjistrimin e formës së diplomës apo certifikatës. Në këtë rast, QSHA-ja njofton me shkrim IAL-në. Procedura rifillon menjëherë pas përmbushjes së kritereve të parashikuara dhe konsiderohet si riaplikim. Afati i shqyrtimit të aplikimit fillon të llogaritet nga dita e depozitimit të plotësimeve/saktësimeve.

Neni 7
Refuzimi i regjistrimit
1. QSHA-ja refuzon regjistrimin në rastet kur:
a) Aplikimi nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kriteret e vendosura në këtë udhëzim.
b) Të dhënat që kërkohen të regjistrohen janë të ndryshme nga dokumentet e paraqitura.
2. Refuzimi i njoftohet IAL-së me shkrim, ku sqarohet edhe shkaku i refuzimit.
3. IAL-ja ruan të drejtën e një aplikimi të ri për regjistrimin e formës së diplomës apo certifikatës, nëse ai është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 8
Të dhënat e regjistrimit
1. Të dhënat që do të mbahen në regjistrin shtetëror për çdo diplomë apo certifikatë do të jenë:
a) Emërtimi i IAL-së në përputhje me aktin e hapjes (apo të riorganizimit institucional).
b) Lloji i IAL-së, e cila lëshon diplomën/certifikatën: Universitet, Kolegj Universitar, Akademi dhe Kolegj Profesional i Lartë.
c) Numri dhe data e aktit të hapjes dhe të akreditimit të IAL-së, e cila lëshon diplomën/ certifikatën.
d) Numri dhe data e aktit të hapjes dhe të akreditimit të programit të studimit për të cilin lëshohet diploma/certifikata.
e) Adresa e vendndodhjes së IAL-së.
f) Numri unik i identifikimit të diplomës/certifikatës.
g) Numri dhe data e aktit të miratimit të formës konkrete të diplomës.

Neni 9
Numri unik i identifikimit
1. Çdo formë diplome apo certifikate, e regjistruar në regjistrin shtetëror, pajiset me një numër unik identifikimi.
2. Numri unik i identifikimit është sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
3. IAL-të janë të detyruara që të shënojnë numrin unik të identifikimit në diplomat dhe certifikatat që ato lëshojnë.

Neni 10
Efektet e regjistrimit dhe publikimit
1. Diplomat dhe certifikatat e regjistruara në regjistrin shtetëror vlerësohen të njohura dhe përbëjnë akte zyrtare për të gjitha autoritetet që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi.
2. QSHA-ja publikon listën me format e diplomave dhe certifikatave të regjistruara në faqen e saj zyrtare të internetit.

Neni 11
Tarifa e regjistrimit
1. Regjistrimi fillestar, si dhe regjistrimi i mëvonshëm i çdo forme diplome apo certifikate i nënshtrohet tarifës së regjistrimit.
2. Tarifa e regjistrimit do të jetë 3 000 (tre mijë) lekë për çdo formë diplome dhe certifikate të regjistruar, për llogari të QSHA-së.

Neni 12
Ankimi administrativ
1. Çdo IAL e interesuar, së cilës i është refuzuar regjistrimi i formës së diplomës/certifikatës, ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e ankimit administrativ brenda 30 ditësh në MASR.
2. MASR, pasi shqyrton ankimin, merr vendim dhe ia njofton IAL-së së interesuar brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.
3. IAL-ja e interesuar ka të drejtë të ankimojë aktin e MASR-së në rrugë gjyqësore, sipas Kodit të Procedurës Civile.

Neni 13
Aksesi publik dhe ekstraktet
Çdo person i interesuar ka të drejtë të kërkojë lëshimin e ekstrakteve për formën e diplomave /certifikatave të regjistruara në regjistrin shtetëror.

Neni 14
Dispozita tranzitore
1. QSHA-ja të fillojë regjistrimet e formave të diplomave dhe certifikatave në një regjistër të ri, në të cilin të jenë parashikuar të gjitha elementet e përcaktuara në këtë udhëzim.
2. Regjistri shtetëror, i krijuar me udhëzimin nr. 12, datë 18.3.2009, "Për krijimin e regjistrit shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin
Shtojca nr. 1
Formimi i numrit unik të identifikimit
e lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar, i mbajtur në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të transferohet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.

Neni 15 Zbatimi

1. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.
2. Udhëzimi nr. 12, datë 18.3.2009, "Për krijimin e regjistrit shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 27, datë 29.12.2017

PËR STRUKTURAT E BRENDSHME AKADEMIKE DHE ADMINISTRATIVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 129, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Struktura e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë të organizohet e ndarë për nga varësia hierarkike dhe institucionale.

2. Struktura akademike në nivel institucioni të konsiderohen:

a) Senati akademik;

b) Rektorati;

c) Rektori;

d) Zëvendësrektori/ët.

3. Struktura ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel institucioni të konsiderohen: a) Strukturat e kurrikulave;

b) Strukturat e kërkimit shkencor;

c) Strukturat e projekteve;

d) Strukturat e promovimit akademik dhe botimeve;
e) Strukturat e marrëdhënieve me publikun;

f) Strukturat e marrëdhënieve me jashtë:

g) Strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë;

h) Strukturat e karrierës;

i) Strukturat e bibliotekave;

j) Strukturat juridike;

k) Strukturat e teknologjisë së informacionit;

l) Strukturat e burimeve njerëzore;

m) Strukturat e arkiv-protokollit;

n) Asistent i rektorit.

4. Struktura administrative në nivel institucioni të konsiderohen:

a) Bordi i administrimit;

b) Administratori i institucionit;

c) Strukturat e auditimit të brendshëm;

d) Strukturat ekonomike;

e) Strukturat e investimeve;

f) Strukturat e prokurimeve;

g) Strukturat e shërbimeve;

5. Struktura akademike në nivel njësie kryesore të konsiderohen:

a) Asambleja e personelit akademik;

b) Dekanati;

c) Dekani;

d) Zëvendësdekani/ët.

6. Struktura ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore të konsiderohen:

a) Strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë;

b) Strukturat e karrierës;

c) Strukturat e bibliotekave;

d) Strukturat e burimeve njerëzore;

e) Strukturat e arkiv-protokollit.

f) Strukturat e teknologjisë së informacionit;

g) Sekretaritë mësimore të njësive kryesore;

h) Asistent i dekanit.

7. Struktura administrative në nivel njësie kryesore të konsiderohen:

a) Administratori i njësisë kryesore;

b) Strukturat ekonomike;

c) Strukturat e shërbimeve;

8. Struktura akademike në nivel njësie bazë të konsiderohen:

a) Drejtuesi i departamentit;

b) Grupet mësimore/kërkimore shkencore që përbëhen nga jo më pak se 5, personel akademik, me kohë të plotë.

9. Struktura ndihmësakademike me karakter akademik në nivel njësie bazë të konsiderohen:

a) Laborantët;

b) Teknikët.

10. Struktura ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie bazë të konsiderohen:

a) Sekretaritë në departamente (në rastet me mbi 21, personel akademik, në nivel njësie bazë me kohë të plotë).

11. Struktura administrative në nivel njësie bazë të konsiderohen:

a) Administratori i njësisë bazë (në rastet me mbi 21, personel akademik, në nivel njësie bazë me
kohë të plotë).

12. Me përjashtim të strukturave akademike dhe administrative të përcaktuara në ligjin 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", organizimi i strukturave të tjera, bëhet në varësi të numrit të përgjithshëm të personelit akademik dhe atij administrativ, numrit të studentëve dhe buxhetit të institucionit publik të arsimit të lartë.

13. Në nivel institucional, strukturat e mësipërme me personel ndihmësakademik me karakter administrativ dhe personel administrativ organizohen ne drejtori, sektorë dhe zyra, ku secila drejtori nuk mund të ketë me pak se dy sektorë apo zyra, secili sektor apo zyrë nuk mund të ketë më pak se tre specialistë.

14. Në nivel njësie kryesore, strukturat organizohen në degë dhe secila degë nuk mund të ketë më pak se dy punonjës.

15. Struktura akademike, ndihmësakademike, me karakter akademik dhe ndihmësakademike, me karakter administrativ, janë në varësi të rektorit të institucionin publik të arsimit të lartë. Strukturat akademike, ndihmësakademike, me karakter akademik dhe ndihmësakademike, me karakter administrativ, në nivel njësie kryesore, kanë varësi funksionale nga dekani i njësisë kryesore përkatëse.

16. Struktura administrative është në varësi të administratorit të institucionin publik të arsimit të lartë. Struktura administrative në nivel njësie kryesore, ka varësi funksionale nga administratori i njësisë kryesore përkatëse.

17. Strukturat e auditimit të brendshëm janë në varësi të bordit të administrimit të institucionin publik të arsimit të lartë.

18. Strukturat juridike, burimeve njerëzore, arkiv-protokollit dhe teknologjisë së informacionit në nivel institucioni apo njësie kryesore, ushtojnë veprimtarinë e tyre në funksion të të gjitha strukturave në institucion.

19. Struktura organizative dhe organigrama e institucionit publik të arsimit të lartë, të jenë pjesë e statutit të institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas kërkesave të nenit 33, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".

20. Ngarkohen institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 31, datë 29.12.2017

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, DOKUMENTACIONIT DHE PROCEDURAVE PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË (Shfuqizuar)

Në mbështetje, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 35 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) depoziton në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR) dokumentacionin dhe formularin sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, për hapjen dhe/ose riorganizimin e një ose disa programeve studimi. Afati i fundit i depozitimit është data 30 nëntor, për vitin akademik pasardhës.

2. Hapja dhe/ose riorganizimi i një ose disa programeve studimi bëhet duke u mbështetur në vlerësimin e nevojave për njohuri, aftësi dhe kompetenca në tregun e punës, si edhe duke u provuar nga ana e subjektit se është në gjendje të ofrojë garancitë e nevojshme akademike e infrastrukturore dhe mbështetjen e nevojshme financiare për veprimtarinë e kërkuar.

3. Miratimi i hapjes së programeve të studimit bëhet kur plotësohen kriteret infrastrukturore, organizative dhe ato të lidhura me personelin akademik që do të përfshihet në realizimin e disiplinave apo veprimtarive të tjera formuese. Hapja e programeve të studimit bëhet me urdhër të ministrit të MASR-së, pas plotësimit te kritereve dhe kërkesave ligjore në fuqi.

KREU II

DOKUMENTACIONI PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT PËR TË GJITHA CIKLET

1. Dokumentacioni që IAL depoziton për hapjen e programeve të reja të studimit për të gjitha ciklet përbëhet nga:

a) Kërkesa e hapjes së programit/eve të reja të studimeve, në të cilën specifikohen njësia bazë që do ta ofrojë atë, emërtimi, cikli, lloji dhe kodi i programit të studimit, kreditet që fitohen, kohëzgjatja normale, forma dhe gjuha e studimit, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

b) Të dhënat për aktin e hapjes dhe të lejes për fillimin e veprimtarisë akademike të institucionit dhe aktin e hapjes/riorganizimit të njësisë kryesore që e ofron, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

c) Propozimi i njësisë bazë, shoqëruar me argumentet përkatëse që mbështesin nevojën për hapjen e programit/programeve të ri/reja.

d) Vendimi i Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton hapjen e programit/eve të studimit. Në rast se propozimi vjen nga një institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkon financim nga buxheti i shtetit depozitohet miratimi paraprak i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).

e) Mandatpagesën për vlerësimin nga eksperti të programit sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 10.5.2017, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 15.2.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", të Këshillit të Ministrave.

f) Lista e plotë emërore e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, për të gjitha programet e studimit, së bashku me ngarkesat dhe formën e punësimit, si dhe titullin dhe gradën përkatëse. Dosja e personelit përmban:

i) jetëshkrimin;

ii) kontratën e punës për personelin efektiv ose një aktmarrëveshje dypalëshe për personelin e planifikuar për t'u angazhuar me kohë të plotë në rast të hapjes së programit; iii) dokumente që vërtetojnë shkollimin e kualifikimet, titujt dhe gradat (fotokopje);

iv) letrën e angazhimit të çdo anëtari të personelit akademik të planifikuar për t'u angazhuar me kohë të pjesshme dhe lejen e punëdhënësit kryesor (sipas nenit 64, pika 2 e ligjit nr. 80/2015).

v) Në rastin e hapjes së një programi studimi në gjuhë të huaj, personeli akademik i rekrutuar duhet të plotësojë së paku një nga kriteret e mëposhtme:

- Të ketë fituar së paku një diplomë të një programi studimi në një nga ciklet e studimeve universitare të kryer në gjuhën në të cilën do të zhvillohet programi i studimit.

- Të zotërojë nivelin C1 të njohjes së gjuhës respektive, në të cilën do të ofrohet programi, e vërtetuar përmes testeve ndërkombëtare, të cilat ndodhen në listën e miratuar nga MASR-ja për pranimet në ciklin e dytë dhe të tretë.

vi) Deklaratë mbi numrin e përgjithshëm të studentëve ekzistues dhe të kuotave të studentëve të parashikuara për programin/et të reja që kërkohen të hapen. Kjo deklaratë të shoqërohet me deklaratën nga subjekti (të nënshkruar nga titullari dhe me vulën e institucionit) mbi përmbushjen e standardeve akademike dhe të infrastrukturës dhe mbi sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare për përfundimin e studim eve nga secili student i regjistruar, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

g) Modeli i kontratës së shërbimit (regjistrimit) që studenti lidh me IAL-në, si dhe tarifa e shkollimit për studentët, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

h) Në rast se IAL-ja parashikon zgjerim të infrastrukturës ekzistuese në dispozicion të programeve, të depozitohet:

i) relacioni i verifikimit të godinës së re, i përpiluar nga një person juridik apo fizik i licencuar nga organi kompetent shtetëror, sipas kuadrit ligjor në fuqi (shoqëruar me kopjen e njësuar me origjinalin të licencës së këtij të fundit).
ii) Planimetria dhe planvendosja e godinës/pjesës së re të institucionit, leja e shfrytëzimit të godinës, së bashku me bazën

materiale dhe didaktike. Aktin e posedimit të godinës apo kontratën e qirasë me afat së paku 3-vjeçar, të shoqëruar me vërtetimin e pronësisë të qiradhënësit.

i) Dokumentacion mbi programet e studimit, të plotësuar në të gjitha elementet e tij, në zbatim të VKM-së për elementet e programeve të studimit:

i) Rregullorja e IAL-së; ii) Rregullore mësimore

e programit të studimit; iii) Plani mësimor për

çdo program studimi;

iv) Programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkruara nga hartuesit/titullarët e tyre. Në rastin kur IALja aplikon për hapjen e më shumë se një programi studimi në të njëjtën kohë, syllabuset e lëndëve që mund të shfaqen në më shumë se një program studimi depozitohen në një kopje të vetme.

j) Gjithë dokumentacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu duhet të depozitohet edhe i skanuar në format elektronik (PDF) në një CD/flash drive, të cilat paraqiten së bashku me dokumentacionin për aplikim.

k) Në rast bashkëpunimi me një institucion tjetër vendës ose të huaj të arsimit të lartë për hapjen e programeve të përbashkëta të studimit, së bashku me dokumentacionin e mësipërm, kërkohet depozitimi edhe i:

i) Aktit të themelimit/licencimit të institucionit në vendin e origjinës.

ii) Aktit të akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit.

iii) Dokumentit zyrtar bashkëpunimi (marrëveshje kuadër), ku parashikohet ofrimi i programeve të përbashkëta të studimit.

iv) Marrëveshjes specifike për programin konkret të studimit, ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij, si autorësia dhe pronësia e syllabuseve të depozituara, gjuha dhe metoda e mësimit dhe provimeve, shkëmbimi i stafit pedagogjik etj. Kjo marrëveshje mund të jetë dhe në formën e rregullores së përbashkët mësimore.

v) Llojit të diplomës (e dyfishtë, e shumëfishtë, e përbashkët) dhe modelin e diplomës të miratuar nga të dyja palët.

vi) Deklaratë për plotësimin e standardeve akademike edhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi (deklarata e nënshkruar nga titullari dhe me vulë të institucionit), sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

l) Në rast deklarimi të rremë, subjekti juridik i nënshtrohet përgjegjësisë penale të parashikuar në Kodin Penal. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, MASR-ja nis procedurën e kontrollit dhe më pas, në rast të vërtetimit të dyshimeve, ia përcjell të dhënat organit kompetent.

2. Procedura për shqyrtimin e aplikimeve për hapjen e programeve të reja të studimit të të gjitha cikleve.

a) Kërkesa dhe dokumentacioni, i përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, depozitohen në MASR. Struktura e ngarkuar së bashku me strukturat juridike, brenda tri javëve, bën shqyrtimin paraprak të dokumentacionit. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR-ja i kërkon IAL-së që të bëjë plotësimin /saktësimin e dokumentacionit, brenda katër javëve nga data e kthimit për plotësim /saktësim. Në mungesë të plotësimit/saktësimit të dokumentacionit të kërkuar, praktika përkatëse refuzohet dhe arkivohet, duke konsideruar që subjekti ka hequr dorë në heshtje nga kërkesa e bërë.

b) Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu i kalon për vlerësim ekspertit, të caktuar nga MASR-ja, i zgjedhur nga lista e ekspertëve të miratuar.

Eksperti brenda tre javësh dorëzon raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga eksperti, subjektit i kërkohet plotësimi i tij, brenda tri javësh nga marrja e njoftimit nëpërmjet ministrisë.

c) Dokumentacioni i plotësuar i kalon për rivlerësim ekspertit, i cili, brenda tri javësh, dorëzon raportin e rivlerësimit në MASR. Praktika nuk mund të shqyrtohet më shumë se dy herë. Në rastet kur dokumentacioni është përsëri i paplotë, praktika përkatëse refuzohet dhe arkivohet.

d) Në rast kur vlerësimi përfundimtar i MASR-së është pozitiv, ministri miraton hapjen e programit të ri të studimit.

e) Në rast ankese nga ana e subjektit, ministri i MASR-së i kërkon mendim të argumentuar me shkrim Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator. Në përfundim është ministri i MASR, që vendos mbi refuzimin apo vijimësinë e praktikës së de pozituar. Në rast refuzimi, praktika arkivohet në MASR.

KREU III

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURAT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË TË GJITHA CIKLEVE

1. Dokumentacioni që IAL-ja depoziton për riorganizim të programeve të studimit përbëhet nga:

a) Kërkesa e institucionit për riorganizim programesh studimi, lloji, forma dhe gjuha e studimit, shoqëruar me të dhënat për aktin e hapjes/riorganizimit të programeve të studimit ekzistuese që kërkohen të riorganizohen. Në kërkesë argumentohen arsyet që mbështesin kërkesën për riorganizimin e programit.

b) Vendimi i Senatit dhe i Bordit të Administrimit të IAL-së.

c) Planet mësimore të programeve të propozuara.

d) Rregulloren e ciklit të studimeve të programeve që riorganizohen.

e) Programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkruara nga titullari i lëndës.

f) Lista e stafit akademik në funksion të programeve të studimit dhe forma e angazhimit (me kohë të plotë, me kohë të pjesshme).

2. Procedura e shqyrtimit të riorganizimit të programeve të studimit.
a) Kërkesa dhe dokumentacioni depozitohen në MASR. Shqyrtimi mbi plotësimin dhe rregullsinë e praktikës së depozituar me dokumentet e kërkuara sipas këtij udhëzimi bëhet nga njësia përgjegjëse dhe struktura juridike në MASR, brenda tri javëve nga depozitimi i kërkesës. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR-ja i kërkon IAL-së të bëjë plotësimin/saktësimin e dokumentacionit brenda katër javëve nga data e kthimit për plotësim/saktësim. Në mungesë të plotësimit/saktësimit të dokumentacionit të kërkuar, praktika përkatëse refuzohet dhe arkivohet.

b) Dokumentacioni i kalon për vlerësim ekspertit. Eksperti brenda tri javësh dorëzon raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen
mangësi/pasaktësi nga eksperti, subjektit i kërkohet plotësimi i

tij, brenda tri javësh nga marrja e njoftimit.

c) Dokumentacioni i plotësuar nga subjekti i kalon për rivlerësim ekspertit. Eksperti brenda tri javësh dorëzon raportin e rivlerësimit në MASR. Praktika nuk mund të shqyrtohet më shumë se dy herë. Në rastet kur dokumentacioni është përsëri i paplotë, praktika përkatëse refuzohet dhe arkivohet.

d) Në rast kur vlerësimi përfundimtar i MASR-së është pozitiv, ministri miraton programin e riorganizuar të studimit.

e) Në rast ankese nga ana e subjektit, ministri i kërkon mendim të argumentuar me shkrim Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator. Në përfundim është ministri i MASR-së, që vendos mbi refuzimin apo vijimësinë e praktikës së depozituar. Në rast refuzimi, praktika arkivohet në MASR.

f) Në rastin kur riorganizimi i programit bëhet për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për arsimin e lartë, përshtatja e programeve të studimit me ndryshimet ligjore bëhet me vendim të Senatit Akademik të institucionit. MASR-ja, pasi njoftohet me shkrim nga institucioni i arsimit të lartë për ndryshimet e bëra në programet e studimit, në përputhje me kërkesat e reja të legjislacionit, merr masat për riregjistrimin e formave të reja të diplomave (nëse është e nevojshme).

KREU IV

PROCEDURAT PËR MBYLLJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË TË GJITHA CIKLEVE

1. Akti për hapjen e një programi studimi anulohet në rastet si më poshtë:

a) Institucioni i arsimit të lartë për arsye të ndryshme i drejtohet ministrit të MASR-së me kërkesën për mbylljen e një ose disa programeve të studimit të ofruar nga ky institucion. Kërkesa duhet të shoqërohet me vendimet përkatëse të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit. Institucioni është përgjegjës për pasojat juridike të ardhura nga mbyllja e programit për studentët që kanë përfunduar programin apo janë në proces ndjekje të programit.

b) Në rast se institucioni i arsimit të lartë nuk e aktivizon programin brenda dy viteve

akademike të njëpasnjëshme nga dalja e urdhrit të hapjes, leja e dhënë për hapjen e këtij programi studimi bëhet e pavlefshme.

c) Në rastin kur programi i aktivizuar i studimit bëhet joaktiv për dy vite akademike të njëpasnjëshme, leja e dhënë për hapjen e këtij programi studimi bëhet e pavlefshme.
d) Programi i studimit i bërë i pavlefshëm, mund të rihapet pasi IAL-ja depoziton në MASR projektin për rihapjen e tij, si kërkesë për program të ri.

e) Bazuar në konstatime të vërtetuara mbi mosrespektimin, nga ana e një institucioni të arsimit të lartë, të kritereve të ligjshmërisë dhe/ose të akreditimit të një programi studimi.

2. Bazuar në rastet e përcaktuara në germën "a" të pikës 3 të këtij kreu, ministri i MASR-së urdhëron mbylljen e programit përkatës, në fund të vitit akademik.

3. Studentët që nuk kanë përfunduar ende studimet në programin që mbyllet, kanë të drejtë të transferojnë studimet brenda të njëjtit institucion ose në një institucion tjetër të arsimit të lartë.

KREU V

KRITERET E POSAÇME PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT, "SPECIALIZIME AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË"

1. Kritere të përgjithshme p ër hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit, "Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë"

a) Këto programe organizohen dhe realizohen nga IAL-të të cilat janë të integruara me strukturat shëndetësore universitare ose nga IAL-të që kanë marrëveshje bashkëpunimi me strukturat shëndetësore universitare.

b) Strukturat shëndetësore universitare dhe të rrjetit formues duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për strukturat shëndetësore, si dhe standardet specifike të programeve të studimit, në të dyja rastet e përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike.

c) IAL-të, publike dhe jopublike, vendëse ose të huaja, që paraqesin kërkesën për hapjen e programeve të studimit pranë ministrisë, duhet të kenë zhvilluar dhe akredituar /riakredituar programe të studimit të

integruara të ciklit të dytë në fushën e mjekësisë, të paktën me kohëzgjatje 5-vjeçare (300 ECTS) në programet Stomatologji dhe Farmaci, dhe të paktën 6-vjeçare (360 ECTS), në programin Mjekësi e Përgjithshme.

d) Hapja e programeve të studimit bëhet kur plotësohen kriteret infrastrukturore, organizative, si dhe kriteret e lidhura me personelin akademik e ndihmës që do të përfshihen në realizimin e disiplinave apo veprimtarive të tjera formuese, duke marrë në konsideratë dhe objektivat e nevojat për zgjerimin e sistemit të arsimit të lartë.

e) IAL-të që paraqesin dokumentacionin sipas kreut II të këtij udhëzimi dhe kritereve të posaçme të këtij kreu, për hapjen e programeve të studimit. Strukturat shëndetësore universitare që janë pjesë integrale e tyre duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për strukturat shëndetësore universitare, si dhe standardet specifike të programeve të studimit. Të njëjtat kritere dhe standarde specifike duhet të plotësojnë edhe strukturat shëndetësore universitare me të cilat IAL-ja që

paraqet kërkesën për hapjen e programeve të studimit, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e programit të studimit.

f) IAL-të që paraqesin kërkesën për hapjen e programeve të studimit, duhet të dokumentojnë/verifikojnë paraprakisht që struktura spitalore dhe rrjeti formues që do të angazhohet në secilin program studimi, plotëson kriteret dhe standardet specifike të programeve të studimit.
g) Programet e studimit mund të organizohen dhe zhvillohen bashkërisht nga IAL-të të cilat kanë domosdoshmërisht njësi baze dhe njësi kryesore në fushën e mjekësisë, mbi bazën e marrëveshjeve ndërinstitucionale përkatëse, si dhe marrëveshjeve specifike për organizimin e këtyre programeve. Në këtë rast, institucioni përgjegjës për realizimin dhe mbarëvajtjen e tyre është IAL-ja pranë të cilit zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë dhe mbahet dokumentacioni i procesit mësimor. IAL-ja përgjegjëse për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit duhet të disponojë burimet financiare, infrastrukturën dhe personelin akademik të nevojshëm për realizimin e programit të studimit.

h) Për realizimin e programeve të studimit, IAL-të mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me struktura shëndetësore universitare të huaja, të licencuara për zhvillimin e aktivitetit shëndetësor në vendin e origjinës. Në këtë rast, kërkesa e IAL-së për hapjen e programeve të studimit shoqërohet edhe me statusin ligjor dhe dokumentacionin ligjor të strukturës shëndetësore universitare të huaj për zhvillimin e aktivitetit shëndetësor në vendin e origjinës, si dhe konfirmimin e këtij statusi nga ministri i MASR-së dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë në Republikën e Shqipërisë.

i) Për realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me IAL të huaja zbatohen standardet shtetërore të cilësisë të vendit, ku zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë mësimore të programit.

j) Nevoja për formim të specializuar në kuadër të programit të studimit dhe madhësia e rrjetit formues përcaktohet mbi bazën e kapacitetit formues të strukturës shëndetësore, edhe në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.

k) Rrjeti formues është përcaktuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në bazë të marrëveshjeve dhe protokolleve të nxitura nga IAL-të interesuara.

2. Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë "Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë"

a) Personeli akademik i programit të studimit përbëhet nga pedagogë të angazhuar me punë klinike/diagnostike dhe me tituj akademikë, si: profesor, profesor i asociuar ose gradë shkencore doktor/PhD.

b) Personeli akademik i programit të studimit përbëhet nga:

i) Personel akademik me kohë të plotë me tituj akademikë dhe grada shkencore, jo më pak se 50% të pedagogëve që mbulojnë programin e studimit. Të paktën 1 (një) pedagog me kohë të plotë, me titullin akademik "Profesor", duhet t'i përkasë fushës së programit të studimit.

ii) Personeli akademik me kohë të integruar, në masën jo më shumë se 50% e pedagogëve

që mbulojnë programin e studimit, të cilët ushtrojnë profesionin në strukturat shëndetësore universitare të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Ky personel akademik të ketë eksperiencë didaktike-formuese dhe eksperiencë profesionale-klinike. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës nga personeli i strukturave shëndetësore të rrjetit formues kërkon miratimin paraprak të drejtuesit të strukturës shëndetësore.

iii) Personel akademik me kohë të pjesshme, për disiplina të veçanta, jo më shumë se 10% e pedagogëve që mbulojnë programin e studimit, me të cilët lidhet një kontratë sipas nevojave të strukturës së programit të studimit.

c) IAL-të dhe strukturat shëndetësore të rrjetit formues të tyre, sipas kompetencave respektive, përcaktojnë mënyrën e përfshirjes së personelit të strukturave shëndetësore universitare, në zbatimin e programit të studimit.

d) Përgjegjësi/Drejtuesi i programit të specializimit duhet të jetë personel akademik me kohë të plotë. Përgjegjësi/Drejtuesi i programit të specializimit është njëkohësisht edhe kryetari i Këshillit Drejtues të programeve të studimeve specializuese afatgjata, zgjidhet nga anëtarët e këtij këshilli me shumicë të thjeshtë votash (50% + 1). Përgjegjësi i një programi studimi në një IAL nuk mund të ngarkohet me përgjegjësinë e drejtimit të një tjetër programi studimi që realizohet nga IAL-të.

e) Këshilli drejtues i programit të studimit të specializimeve afatgjata punon për përgatitjen, organizimin dhe kontrollin e programit të specializimit përkatës. Këshilli Drejtues i programit përkatës të studimeve specializuese afatgjata ngrihet në nivel njësie kryesore dhe përbëhet nga të paktën 5 (pesë) pedagogë me kohë të plotë të IAL-së, jo më pak se 2 (dy) pedagogë për çdo program studimi që ofron njësia kryesore, të cilët duhet të jenë figura të spikatura në fushën e specialitetit përkatës, me përvojë klinike dhe akademike të paktën 10-vjeçare.

f) Drejtimi i specializantit i ngarkohet, në cilësinë e udhëheqësit, një pedagogu (udhëheqës akademik) dhe/ose një anëtari të personelit të strukturës shëndetësore të rrjetit formues (udhëheqës klinik/tutori) të

programit të studimit i cili/të cilët udhëheqin specializantin gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe janë përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit, si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e punës së studentit.

g) Fusha e specializimit të udhëheqësit përputhet me atë të programit specializues që ndjek specializanti. Udhëheqësi klinik/tutori ka një eksperiencë profesionale të paktën 10-vjeçare (dhjetëvjeçare) me përvojë klinike në fushën klinike përkatëse dhe ka të paktën gradën shkencore "Doktor". Numri maksimal i studentëve specializantë që mund të ndiqet nga udhëheqësi akademik /klinik është 3 (tre).

h) Udhëheqësi klinik/tutori është personel i punësuar me kohë të plotë pranë njërës nga strukturat e rrjetit formues dhe ka kontratë bashkëpunimi me IAL-në që ofron programin specializues. Kur tutori nuk është pjesë e personelit me kohë të plotë të strukturës që ofron programin e specializimit, specializantit i caktohet edhe një udhëheqës akademik, anëtar i personelit akademik me kohë të plotë të institucionit. Për caktimin e udhëheqësit klinik merret mendimi i drejtuesit të strukturës shëndetësore dhe udhëheqja e tij klinike konsiderohet si pjesë e orarit të punës.

i) Aktiviteti i mësimdhënies kryhet njëkohësisht me aktivitetin asistencial/profesional, në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës në selinë ku realizohet programi i studimit nga personeli i strukturave shëndetësore universitare kërkon miratimin paraprak të drejtuesit të këtij shërbimi.

j) Specializanti i përfshirë në rrjetin formues merr gradualisht përgjegjësi klinike gjatë specializimit.

k) Kriteret, kuotat, tarifat dhe modalitetet e pranimit në programet e studimit propozohen nga njësia/njësitë bazë propozuese të programit të studimit, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Ato bëhen publike pas miratimit nga organet drejtuese të IAL-së dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MASR-së.

l) IAL-të duhet të përcaktojnë modalitetet e koordinimit dhe gjenerimit të kuotave për specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, me kërkesat të sistemit shëndetësor kombëtar
nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë.

m) Gjatë periudhës së studimeve në një program studimi, studenti nuk mund të ndjekë njëkohësisht programe të tjera studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

3. Organizimi i programit të studimit të ciklit të tretë "Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë".

a) Programet e studimit të ciklit të tretë, "Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë", përfshijnë të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese dhe 20% të ECTS-ve totale për studime të organizuara teorike, të shpërndara në vite, sipas një plani të studimit.

b) Raporti i lëndëve të përcaktuara në programin e studimit përbëhet nga:

i) 60% lëndë specifike; ii) 30% lëndë karakterizuese të fushës; ii) 5% lëndë të formimit

bazë, ndërdisiplinore ose integruese dhe për aktivitete të tjera; iii) 5% provimi

përfundimtar etj.

15% e totalit të lëndëve specifike dhe 15% e totalit të lëndëve karakterizuese duhet të jenë lëndë me zgjedhje.

c) Njësia bazë propozuese harton Rregulloren e programeve të studimeve specializuese afatgjata, me anekset specifike për çdo program, në të cilën parashikohen të gjitha proceset dhe elementet përbërëse të nevojshme për realizimin e programit, dhe ia paraqet Senatit Akademik të IAL-së për miratim. Në rregullore duhet të përcaktohet edhe:

i) vlerësimi i njohurive teorike dhe praktike të specializantit, në fund të çdo viti akademik;

ii) modalitetet e vlerësimit përfundimtar të specializantit, i cili i nënshtrohet provimit përfundimtar përkatësisht për njohuritë teorike, praktike ose paraqitjes së temës eksperimentale-studimore të diplomës.

d) Nevoja për formim të specializuar në kuadër të programit të studimit dhe madhësia e rrjetit formues përcaktohet mbi bazën e kapacitetit formues të strukturës shëndetësore universitare edhe në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.

e) Për realizimin e programit të studimit, IAL-të garantojnë personelin akademik të nevojshëm me

tituj dhe grada shkencore.

f) Në kuadër të programit të studimit, specializantët caktohen pranë njësive /shërbimeve/reparteve të strukturave shëndetësore universitare, pjesë e rrjetit formues, në përputhje me planin e studimit të miratuar dhe për kohën e nevojshme për të fituar aftësitë profesionale.

KREU VI

KRITERET E POSAÇME PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT "DOKTORATË"

1. Kritere të përgjithshme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit "Doktoratë"

a) Programet e studimit "Doktoratë" mund të hapen dhe të ofrohen nga IAL-të publike dhe jopublike që kanë statusin Universitet ose Akademi, vendëse ose të huaja, të cilat kanë programe studimi të licencuara dhe akredituara/riakredituara të ciklit të parë dhe të dytë në të njëjtën fushë ose fushë të përafërt me atë të programit "Doktoratë".

b) IAL-të që paraqesin dokumentacionin sipas kreut II të këtij udhëzimi dhe kritereve të posaçme të këtij kreu, për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit "Doktoratë".

c) Programet e studimit të doktoratës realizojnë formimin bazuar mbi hartimin e projekteve individuale për aftësimin e pavarur të kërkimit shkencor, duke u dhënë doktorantëve një kulturë ndërdisiplinare në kuadër të një projekti shkencor inovativ, që ka për qëllim përgatitjen e tyre shkencore dhe profesionale. IAL-ja depoziton së bashku me dokumentacionin për hapjen e programeve të studimit edhe projektet kërkimore-shkencore të hartuara për programin e studimit.

d) IAL-të nxisin nivelin e zhvillimit të kërkimit shkencor dhe ndihmojnë në aftësimin e studentit për të përfunduar me sukses programin e studimit.

e) IAL-të, në kuadër të programit të studimit organizojnë aktivitete me impakt në formimin e përgjithshëm, si dhe këshillojnë studentët të marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore, seminare dhe debate ndërdisiplinore, të lidhura ngushtë me fushën

specifike në të cilën ndjekin studimet dhe që i ndihmojnë në punën e tyre kërkimore, sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme të IAL-ve.

f) IAL-të ndihmojnë në aftësimin e studentit për përvetësimin e metodologjive të kërkimit për veprimtari krijuese të pavarura, si: artikuj shkencorë, prezantime, qasje standarde për referenca, bibliografi, indekse dhe të shkruarit e përmbajtjes, si bazë për përpunimin e tezës së doktoratës, punën e pavarur, përdorimin e burime të informacionit, administrimin dhe përpunimin e informacionit, përdorimin e teknologjive bashkëkohore për studime e komunikime, përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave, njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën kërkimore të doktorantit, si edhe përvetësimin e aftësive komunikuese me nivel shkencor.

g) Për realizimin e projektit kërkimor, IAL-të garantojnë personelin e tyre akademik të nevojshëm me tituj dhe grada shkencore.

h) IAL-ja ofruese e programit të studimit duhet të ketë struktura administrative dhe kërkimore të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara për kryerjen e kërkimeve dhe mund të bashkëpunojë me një apo më shumë IAL, vendëse apo të huaja, në bazë të marrëveshjeve të lidhura midis tyre, në mbështetje të procesit dhe përmirësimit të standardeve.

i) Programet e studimit kanë një kohëzgjatje jo më pak se 3 vite akademike dhe jo më shumë së 5 vite akademike dhe zhvillohen me kohë të plotë. Shtyrja e kohëzgjatjes bëhet sipas procedurave te përcaktuara ne statutet e institucionit. Në rastet kur doktoranti është i punësuar si personel akademik, kërkimor, shkencor në një institucion tjetër të arsimit të lartë, të kërkimit bazë ose të zbatuar, programi

i studimit mund të zhvillohet me kohë të zgjatur. Në këtë rast, IAL-të përcaktojnë vetë tarifën shtesë të studimit.

2. Personeli akademik i programi t të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë"
a) Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit përbëhet nga pedagogë me tituj akademikë të kategorisë "Profesor".

b) Në rastet kur programet e studimit do të kryhen bashkërisht me një IAL të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, udhëheqësi i IAL-së së huaj mund të jetë edhe me gradën shkencore "Doktor"/PhD.

c) Drejtuesi shkencor i studentit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e ecurisë të studentit, si dhe përparimin e punës kërkimore të zhvilluar.

d) Njësia bazë ngarkon një prej anëtarëve të personelit akademik të programit të studimit që mban të paktën titullin akademik të kategorisë "Profesor", në cilësinë e përgjegjësit te programit të studimit.

3. Organizimi i programit të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë"

a) Përgjegjësi i programit të studimit ndjek të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe zbatimin e programit të kërkimeve, duke siguruar praninë dhe angazhimin e personelit akademik të kualifikuar në fushën shkencore të këtij programi.

b) Njësia bazë propozuese harton rregulloren e programit të studimit në të cilën parashikohen të gjitha proceset dhe elementët përbërës të nevojshëm për realizimin e këtij programi. Rregullorja miratohet nga Senati Akademik.

c) Në përfundim të çdo viti akademik, drejtuesi shkencor miraton raportin e aktiviteteve të kryera nga doktorantët në përputhje me rregulloren e ciklit të programit të studimit.

d) Programet e studimit mund të hapen dhe zhvillohen bashkërisht midis IAL-ve mbi bazën e marrëveshjeve ndërinstitucionale përkatëse. Në këtë rast, selia administrative dhe institucioni përgjegjës për realizimin dhe mbarëvajtjen e tyre është IAL-ja pranë të cilit zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë dhe mbahet dokumentacioni i procesit mësimor.

e) IAL-ja përgjegjëse për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit duhet të disponojë burimet financiare, infrastrukturën dhe personelin akademik të nevojshëm për realizimin e programit të studimit.

f) Për realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

g) Kriteret, kuotat, tarifat dhe modalitetet e pranimit në programet e studimit propozohen nga njësia/njësitë bazë propozuese e/të programit të studimit, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe miratohen nga organet drejtuese të IAL-së. Ato bëhen publike nga IAL-të dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MASR-së.

h) Gjatë periudhës së studimeve në një program studimi, studenti nuk mund të ndjekë njëkohësisht programe të tjera studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

KREU V

KRITERET E POSAÇME PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT, "MASTER EKZEKUTIV"

1. Kritere të përgjithshme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit, "master ekzekutiv".

a) IAL-të që paraqesin dokumentacionin sipas kreut II të këtij udhëzimi dhe kritereve të posaçme të këtij kreu, për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit, "master ekzekutiv".

b) Programet e studimit "master ekzekutiv" mund të hapen dhe të ofrohen nga IAL-të publike dhe jopublike që kanë statusin Universitet ose Akademi, vendëse ose të huaja, të cilat kanë programe studimi të licencuara dhe akredituara/riakredituara të ciklit të parë dhe të dytë në të njëjtën fushë ose fushë të përafërt me atë të programit "master ekzekutiv". Gjithashtu, kërkesa mund të paraqitet edhe nga IAL-të të cilat nuk kanë programe studimi të licencuara dhe akredituara/riakredituara të ciklit të parë dhe të dytë në të njëjtën fushë ose fushë të përafërt me atë të programit "master ekzekutiv", por që plotësojnë njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

- kanë akreditim institucional;

- kanë përvojë në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të tretë;

- dëshmojnë se kanë personelin akademik për të plotësuar, menjëherë pas licencimit të programit, strukturën e departamentit që ofron programin e studimit.

c) Programet e studimit mund të hapen dhe zhvillohen bashkërisht midis IAL-ve mbi bazën e marrëveshjeve ndërinstitucionale përkatëse. Në këtë rast, institucion përgjegjës për realizimin dhe mbarëvajtjen e tyre është IAL-ja pranë të cilit zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë dhe mbahet dokumentacioni i procesit mësimor.

d) IAL-ja përgjegjëse për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit duhet të disponojë burimet financiare, infrastrukturën dhe personelin akademik të nevojshëm për realizimin e programit të studimit.

e) Për realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë, mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore.

2. Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë, "master ekzekutiv"

a) Personeli akademik i programit të studimit përbëhet nga personeli aka demik i kategorisë "Profesor" i punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme në IAL. Në personelin akademik të programit të studimit mund të përfshihet edhe personeli akademik i IAL-ve partnere në hapjen e programeve të studimit mbi bazën e marrëveshjeve ndërinstitucionale.

b) Në varësi të shkallës së specializimit të programit të studimit, mund të jenë pjesë e personelit të programit edhe specialistë të fushës me përvojë profesionale në fushën e programit, numri i të cilëve nuk mund të jetë më i lartë se 30% e personelit akademik.

3. Organizimi i programit të studimit të ciklit të tretë, "master ekzekutiv"

a) Programet e studimit hapen në përputhje me Standardet Shtetërore të Cilësisë për programet e studimit të ciklit të tretë, me kohëzgjatje 1 ose 2 vite akademike (respektivisht me 60 ose 120 kredite ECTS).

b) Struktura e programit të studimit pasqyrohet e plotë në planin mësimor ndërsa modalitetet e realizimit të programit të studimit dhe të veprimtarive të tij pasqyrohen në rregulloren e programit të studimit.

c) Veprimtaritë mësimore mund të zhvillohen në formën e leksioneve, seminareve, laboratorëve, praktikave mësimore, vizitave mësimore, konferencave, mësimit ndëraktiv, stazheve.

d) Praktikat mësimore dhe stazhet mund të zhvillohen pranë institucionit të arsimit të lartë ose pranë institucioneve të tjera bashkëpunuese, në varësi të objektivave formuese dhe të strukturave që disponon vetë IAL-ja.

e) Veprimtaritë mësimore, për programet e studimit me kohëzgjatje 1 vit akademik, nuk duhet të përmbajnë më pak se 360 orë në auditor.

f) Veprimtaritë mësimore, për programet e studimit me kohëzgjatje 2 vite akademike, nuk duhet të përmbajnë më pak se 720 orë në auditor.

g) Programet e studimit përmbyllen me tezë diplome.

h) Njërit prej anëtarëve të personelit akademik të programit të studimit që mban të paktën titullin "profesor i asociuar" i ngarkohet, në cilësinë e përgjegjësit, drejtimi i programit të studimit.

Përgjegjësi i një programi studimi në një IAL nuk mund të ngarkohet me përgjegjësinë e drejtimit të një programi tjetër studimi që realizohet nga IAL-ja. Për planifikimin dhe zbatimin e planit të studimit, përgjegjësi i programit të studimit bashkëpunon me personelin akademik të këtij programi.

i) Kriteret, kuotat, tarifat dhe modalitetet e pranimit dhe transferimit në programet e studimit përcaktohen nga njësia/të bazë propozuese të programit të studimit, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe miratohen nga organet drejtuese të IAL-së. Ato bëhen publike nga IAL-të dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MASR-së.

j) Gjatë periudhës së studimeve në një program studimi, studenti nuk mund të ndjekë njëkohësisht programe të tjera studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

KREU VIII KONTROLLET DHE MASAT

1. Programet e studimit të ofruar nga IAL-të i nënshtrohen kontrolleve të zbatimit të ligjshmërisë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të paktën një herë në 3 vjet. Nëse gjatë kontrolleve evidentohen shkelje të dispozitave të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në

Republikën e Shqipërisë" apo të akteve nënligjore, grupi i kontrollit i ngritur me urdhër të ministrit të MASR-së përgatit një raport për ministrin mbi shkeljet e evidentuara. Raporti i grupit të kontrollit i dërgohet edhe IAL-së përkatëse.

2. Pas njoftimit mbi shkeljet dhe detyrimet mbi zbatimin e normave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, institucioni dërgon komentet dhe sqarimet e tij (nëse ka) në lidhje me raportin e hartuar nga grupi i kontrollit. Grupi i kontrollit pasqyron në raportin përfundimtar saktësimet që i gjykon të arsyeshme dhe jep qëndrimin përkatës për pjesën e refuzuar të vërejtjeve të institucionit të arsimit të lartë.

3. Pas marrjes së raportit përfundimtar, institucioni dërgon një deklaratë të firmosur (deklaratë angazhimi), në të cilën angazhohet se do të plotësojë brenda afatit të përcaktuar nga MASR-ja kriteret e paplotësuara sipas kërkesave të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në fuqi.

4. Në rast se institucioni nuk arrin të zbatojë angazhimet brenda afatit të përcaktuar, ministri i MASRsë pezullon programin përkatës të studimit deri në përmbushje të detyrimeve ose mbyllje të programit të studimit.

5. Mbyllja e programeve të studimit bëhet me urdhër të ministrit të MASR-së, në fund të vitit akademik. Studentët që nuk kanë përfunduar ende studimet në programin që mbyllet, kanë të drejtë të transferojnë studimet brenda të njëjtit institucion ose në një institucion tjetër të arsimit të lartë.

KREU IX

DISPOZITA TRANZITORE TË FUNDIT

1. Në zbatim të nenit 129, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", përjashtimisht aplikimet për hapje /riorganizim të programeve të reja/ekzistuese të st udimit do të pranohen gjatë vitit akademik 20172018 për vitin 2018-2019 dhe në vijim deri në muajin korrik të vitit 2018.

2. Aplikimet në vitet në vijim për hapje/riorganizim të programeve të reja /ekzistuese të studimit bëhen brenda datës 30 nëntor të vitit korrent për vitin e ardhshëm akademik.

3. Udhëzimi nr. 11, datë 28.2.2011, "Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, programeve të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimeve jouniversitare, të natyrës profesionale, si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës", shfuqizohet në pjesët që rregullon programet e studimit.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Lindita Nikolla

Shtojca 1

KËRKESË PËR HAPJEN DHE/OSE ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Institucioni i arsimit të lartë:

Viti akademik:

Data e kërkesës: ____.____.

I. INFORMACION MBI INSTITUCIONIN

Të dhënat për aktet themelore Lloji i aktit (VKM/urdhër) Nr. Datë

Licencimi i institucionit

Leja për fillimin e veprimtarisë

Akreditimi i institucionit

Hapja/riorganizimi i njësisë kryesore ku ofrohet programi

Në rastin e aplikimeve për hapjen e programeve të ciklit të tretë

Hapja e programeve të ciklit të parë në të njëjtën fushë/fushë të përafërt

Akreditimi i programeve të ciklit të parë në të njëjtën fushë/fushë të përafërt

Hapja e programeve të ciklit të dytë në të njëjtën fushë/fushë të përafërt

Akreditimi i programeve të ciklit të dytë në të njëjtën fushë/fushë të përafërt

II. INFORMACION MBI PROGRAMIN E STUDIMIT

1. Të dhëna të përgjithshme:

Emërtimi i programit të studimit:

Cikli i studimeve:

Lloji i programit:

Kodi i programit:

Totali i krediteve (ECTS): Kohëzgjatja

normale në vite

Forma e studimit:

Gjuha e studimit:

Vendimi i njësisë bazë dhe kryesore për hapjen e programit të studimit

(Numri i vendimit dhe data)

Vendimi i Senatit Akademik për hapjen e programit të studimit

(Numri i vendimit dhe data)

Shënim. Në rastin kur programi i studimit është i përbashkët, të përfshihen të gjitha vendimet e marra, sipas modelit më sipër.

2. Objektivat formues dhe karakteristikat e programit të studimit
a) Profili kulturor dhe profesional i studentit në përfundim të programit mësimor.

b) Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor

c) Mundësitë për punësim

3. Struktura akademike përgjegjëse dhe strukturat e tjera bashkëpunuese

Fakulteti apo një strukturë tjetër mësimore e kërkimore

Struktura të tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë

Institucione të huaja të arsimit të lartë

Subjekte të tjera publike apo private

Shënim. Në rastin e bashkëpunimit me një apo disa struktura të tjera, të bashkëlidhen marrëveshjet përkatëse.

4. Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit

Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit hartohet bazuar në standardet shtetërore dhe kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi.

5. Personeli akademik për realizimin e programit

Personeli akademik Titulli/grada Institucioni (emri, mbiemri) shkencore Njësia kryesore Njësia bazë Lloji i angazhimit (me

kohë të plotë/të

pjesshme)

6.Plani mësimor me përbërësit specifikë sipas kuadrit ligjor në fuqi.

7. Infrastruktura në dispozicion të programit (Informacion lidhur me: auditorët, laboratorët e duhur, bibliotekën, mjetet kompjuterike sistemet IT etj.

8. Kriteret e pranimit të studentëve në program.

Numri i propozuar i studentëve që do të pranohen në program

Numri minimal i studentëve për hapjen e programit

9. Tarifa e shkollimit Tarifa e Kostoja e shkollimit shkollimit

10. Financimi i programit

Burimi i financimit të programit. Financime të tjera që mund të mbulojnë pjesërisht apo plotësisht koston e shkollimit, nëse ka të tilla.

III. DEKLARATA PËR PLOTËSIMIN E STANDARDEVE AKADEMIKE DHE STANDARDEVE SHTETËRORE SIPAS AKTEVE LIGJORE E NËNLIGJORE NË FUQI

IV. AUTODEKLARIM

Ne/Unë i/e nënshkruari/a

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

1. Të gjithë të dhënat janë të vërteta dhe jam i vetëdijshëm për përgjegjësinë penale në rast dhënie informacioni të pavërtetë, si dhe pranoj t'i nënshtrohem verifikimit nga organet përkatëse për të gjithë informacionin e paraqitur si më sipër.

2. IAL-ja është e regjistruar në QKB si person juridik, me të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në fushën përkatëse të arsimit, si më poshtë:

Subjekti juridik përgjegjës për IAL-në :

NUIS: :

3. Subjekti juridik disponon vërtetim pronësie nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nr.____, datë / ku do të zhvillohet veprimtaria, apo kontratë qiraje me kohëzgjatje jo më pak se tri vite akademike nga momenti i paraqit jes së kësaj kërkese.

4. Deklaroj se subjekti juridik disponon mjedis të përshtatshëm për realizimin e procesit mësimor, bazën materiale të nevojshme sipas standardeve shtetërore në fuqi.

5. Deklaroj se subjekti juridik ka krijuar kushteve për studentët me aftësi të kufizuara në mjediset ku ushtrohet veprimtaria e mësimdhënies. 6. Subjekti juridik dhe personat përgjegjës për administrimin e tij nuk janë në proces gjykimi, hetimi, si dhe nuk rezultojnë të dënuar në fushën që kërkohet të ushtrohet aktiviteti.

7. Deklaroj se subjekti juridik plotëson të gjitha standardet akademike dhe shtetërore sipas kuadrit ligjor në fuqi.

8. Deklaroj se subjekti juridik plotëson të gjitha standardet infrastrukturore shtetërore sipas kuadrit ligjor në fuqi.

9. Deklaroj se subjekti juridik nuk rezulton debitor ndaj organeve tatimore në nivel qendror dhe vendor për të gjitha llojet e detyrimeve, përfshirë energjinë elektrike dhe furnizimin me ujë.

10.Deklaroj se subjekti juridik disponon lejen higjieno-sanitare për çdo mjedis ku do të zhvillohet veprimtaria dhe aktin për mbrojtjen kundër zjarrit, brenda afateve të vlefshmërisë.

11.Deklaroj se subjekti juridik disponon vlerat monetare për financimin e programit përkatës të studimit dhe është përgjegjës ndaj studentëve për mos respektimin e kontratave të lidhura.

REKTORI
Data Firma, vula

ADMINISTRATORI I PERSONIT JURIDIK PËRGJEGJËS PËR IAL-NË JOPUBLIKE

Data Firma, vula

UDHËZIM

Nr. 32, datë 29.12.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 3.8.2016, "PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË VENDIT"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 92, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

"Në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të autorizuara jashtë vendit"", bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1, të kreut III, germa "d" ndryshon si më poshtë vijon:

"d) Fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj).".

2. Në pikën 2, të kreut III, germat "c", "d", "e" dhe "f" shfuqizohen.

3. Në pikën 2, të kreut III, germa "g" ndryshon si më poshtë:

"g) Fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj).".

4. Në pikën 3, të kreut III, germat "d", "f" dhe "i" shfuqizohen.

5. Në pikën 3, të kreut III, germa "g" ndryshon si më poshtë:

"g) Fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj).".

6. Në pikën 3, të kreut III, pika "iii", germa "h" ndryshon si më poshtë:

"iii) Botime të punimeve shkencore në organe shkencore ndërkombëtare.".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 33, datë 29.12.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 16, DATË 1.8.2014, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, MASËS DHE PROCEDURAVE PËR PËRFITUESIT NGA FONDI I EKSELENCËS PËR STUDENTËT E SHKËLQYER DHE NËPUNËSIT E ADMINISTRATËS SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimit nr. 483, datë 16.7.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të administratës shtetërore (fondi i ekselencës)",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 16, datë 1.8.2014, të ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e kritereve, masës dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit e administratës shtetërore", bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pas pikës 6, të kreut I, të shtohet pika 6.1 si më poshtë:

"6.1 Aplikimi fillestar duhet të përmbajë dokumentet e parashikuara në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.".

2. Pika 9.2, e kreut I, ndryshon si më poshtë vijon:

"9.2 Faza e përzgjedhjes përfundimtare:

a) KP-ja kryen intervistën me të gjithë kandidatët e vlerësuar pozitivisht nga përzgjedhja paraprake. Intervista kryhet në prezencë të kandidatit ose në rrugë telematike kur ai ndodhet jashtë vendit.

b) Kandidati, 3 ditë pas intervistës me KP-në, plotëson aplikimin me dokumentacionin e kërkuar në
shtojcën 4 të këtij udhëzimi.

c) KP-ja, mbi bazën e rezultateve të përzgjedhjes së parë të intervistës, si dhe të dokumentacionit të
aplikimit me dokumentacionin e kërkuar në pikën "b", bën vlerësimin përfundimtar të kandidatëve.

d) Vendimet (procesverbalet e mbledhjes) e KP-së i bashkëlidhen urdhrit të ministres për shpalljen e
kandidatëve fitues, ku është parashikuar edhe masa e bursës së akorduar secilit prej tyre.".

3. Shtojca nr. 1 dhe shtojca nr. 2 zëvendësohen me shtojcat nr. 1/1 dhe nr. 2/2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

4. Pas shtojcës nr. 3 shtohet shtojca nr. 4 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Lindita Nikolla

SHTOJCA NR. 1/1

1. DOKUMENTET PËR BURSA TË POSAÇME PËR STUDENTËT QË NDJEKIN JASHTË SHTETIT CIKLIN E PARË DHE TË DYTË

Dokumente që duhet të paraqesin kandidatët:

1. Formular aplikimi (formati shkarkohet nga *ëebsite*-i i MASR-së: ëëë.arsimi.gov.al);

2. Diplomat universitare të ciklit të parë dhe/ose të dytë të studimeve universitare, së bashku me aneksin e notave;

3. Letër pranimi nga institucioni pritës i arsimit të lartë.

2. BURSA TË POSAÇME PËR STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET E DOKTORATËS JASHTË VENDIT.

Dokumente që duhet të paraqesin kandidatët janë:

1. Formular aplikimi (formati shkarkohet nga *ëebsite*-i i MASR-së: ëëë.arsimi.gov.al);

2. Diplomat e studimeve universitare të ciklit të parë dhe të dytë, së bashku me aneksin e notave;

3. Letër pranimi nga institucioni pritës i arsimit të lartë ku të përcaktohet programi i doktoratës ku kandidati është pranuar, kohëzgjatja zyrtare e studimeve të doktoratës dhe udhëheqësi shkencor;

4. Projektideja e temës së doktoratës, në të cilën të paraqitet qartësisht: objekti kryesor i studimit, metodologjia (në varësi të llojit të disiplinës), literatura kryesore që është përdorur apo që do të përdoret potencialisht.

3. BURSA TË POSAÇME PËR NËPUNËSIT E ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Dokumente që duhet të paraqesin kandidatët janë:

1. Formular aplikimi (formati shkarkohet nga *ëebsite*-i i MASR-së: ëëë.arsimi.gov.al);

2. Letër pranimi nga institucioni pritës i arsimit të lartë;

3. Miratimin e titullarit të institucionit të administratës shtetërore ku punon nëpunësi, sipas formatit të parashikuar në shtojcën 3 të këtij udhëzimi.

SHTOJCA NR. 2/2

DOKUMENTET QË DUHET TË DORËZOJNË APLIKANTËT QË DO TË NDJEKIN STUDIMET E VITIT TË DYTË E MË TEJ

1. BURSA E POSAÇME PËR STUDENTËT QË NDJEKIN JASHTË SHTETIT CIKLIN E PARË DHE TË DYTË

1. Formular aplikimi (formati shkarkohet nga *ëebsite*-i i MASR-së: ëëë.arsimi.gov.al);
2. Certifikatë e notave dhe detyrimeve të shlyera nga kandidati për vitin akademik të mëparshëm dhe planin e studimit për programin që ndjek kandidati në universitetin pritës;
3. Vërtetim nga universiteti pritës mbi mbështetjen financiare nga ana e tij për kandidatin, si dhe masën e financimit (origjinale ose fotokopje e noterizuar);
4. Dokumentacionin justifikues financiar të shpenzimeve që mbulojnë vlerën e bursës së akorduar.

2. BURSA E POSAÇME PËR STUDENTËT E NDËRMJETËM QË NDJEKIN JASHTË STUDIMET E DOKTORATËS

1. Formular aplikimi (formati shkarkohet nga *ëebsite*-i i MASR-së: ëëë.arsimi.gov.al.);
2. Deklaratë nga institucioni i arsimit të lartë për periudhën e qëndrimit dhe frekuentimit të institucionit ku kryhet doktorata nga ana e kandidatit (origjinale);
3. Vërtetim i institucionit pritës mbi ciklet e leksioneve të ndjekura dhe rezultatet e arritura (nëse ka)
(origjinale);
4. Artikuj të botuar (nëse ka) (origjinale);
5. Raporti i ndërmjetëm i nënshkruar nga udhëheqësi shkencor, në të cilin të përmblidhet gjithë veprimtaria shkencore e kryer gjatë vitit akademik të mbështetur me bursë dhe parashikimi për vitin pasardhës akademik (origjinale);
6. Vërtetim nga universiteti pritës mbi mbështetjen ose jo financiare nga ana e tij për kandidatin, si dhe masën e financimit (origjinale ose fotokopje e noterizuar);
7. Dokumentacion justifikues financiar të shpenzimeve që mbulojnë vlerën e bursës së akorduar. SHTOJCA NR. 3

EMBLEMA E INSTITUCIONIT

Nr. _____ prot. Tiranë, më __.__.__

AUTORIZIM

Autorizoj z/znj. _____ , të aplikojë në Programin e Fondit të Ekselencës, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për mbështetje financiare për kryerjen e studimeve master, në fushën e _ , në universitetin _____ .

Titullari i institucionit

Firma

Vula

SHTOJCA NR. 4

1. DOKUMENTET QË DUHET TË PARAQESË KANDIDATI PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË:

2. Formular aplikimi (formati shkarkohet nga *ëebsite* -i i MASR-së: ëëë.arsimi.gov.al);

3. Kopje të pasaportës/kartës së identitetit;

4. Vërtetim të qendrës së banimit;

5. CV e hollësishme e shoqëruar me dokumen-tacionin që vërteton të dhënat në CV;

6. Dokument që vërteton përfundimin me sukses të studimeve të shkollës së mesme (dëftesë pjekurie, certifikatë e maturës shtetërore etj.) dhe/ose e diplomës së përfundimit të ciklit të parë të studimeve universitare. Këto dokumente duhet të dorëzohen si fotokopje të noterizuara;

7. Letër pranimi nga institucioni pritës i arsimit të lartë (origjinale ose fotokopje e noterizuar);

8. Planin e studimit për programin që do të ndjekë kandidati në universitetin pritës;

9. Një parashikim të detajuar të kostos së studimeve të lëshuar nga universiteti pritës, si dhe një vërtetim nga universiteti pritës mbi mbështetjen ose jo financiare nga ana e tij për kandidatin, si dhe masën e financimit (origjinale ose fotokopje e noterizuar);

10. Në rast bashkëfinancimi ndërmjet MASR-së dhe organizatave, fondacioneve dhe institucioneve vendëse ose të huaja të paraqitet kopje e noterizuar e dokumentacionit që vërteton marrjen nga kandidati të bursës nga organizatat, fondacionet dhe institucionet vendëse ose të huaja (përjashtuar ato shtetërore);

11. Tri rekomandime origjinale për cilësitë e kandidatit.

2. DOKUMENTET QË DUHET TË PARAQESË KANDIDATI PËR STUDIMET E DOKTORATËS:

1. Formular aplikimi (formati shkarkohet nga *ëebsite* -i i MASR-së: ëëë.arsimi.gov.al);

2. Kopje të pasaportës/kartës së identitetit;

3. Vërtetim të qendrës së banimit;

4. CV e hollësishme e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton të dhënat në CV;

5. Diplomat e noterizuara të studimeve universitare të ciklit të parë dhe të dytë, së bashku me aneksin e notave (fotokopje e noterizuar);

6. Letër pranimi nga institucioni pritës i arsimit të lartë ku të përcaktohet programi i doktoratës ku kandidati është pranuar, kohëzgjatja zyrtare e studimeve të doktoratës dhe udhëheqësi shkencor (origjinale ose kopje e noterizuar);

7. Vërtetim nga institucioni pritës mbi financimin eventual të plotë ose të pjesshëm të studimeve të doktoratës së kandidatit (origjinale ose fotokopje e noterizuar);

8. Në rast bashkëfinancimi ndërmjet MASR-së dhe organizatave, fondacioneve dhe institucioneve vendëse ose te huaja të paraqitet kopje e noterizuar e dokumentacionit që vërteton marrjen nga kandidati të bursës nga organizatat, fondacionet dhe institucionet vendëse ose të huaja (përjashtuar ato shtetërore);

9. Projektideja e temës së doktoratës, në të cilën të paraqitet qartësisht: objekti kryesor i studimit, metodologjia (në varësi të llojit të disiplinës), literatura kryesore që është përdorur apo që do të përdoret potencialisht;

10. Tri rekomandime për cilësitë dhe nivelin e kandidatit (referentët duhet të jenë persona që e njohin mirë kandidatin dhe kanë së paku gradën "doktor" ose janë figura të njohura në fushat e shkencës, kulturës, ekonomisë, politikës etj.).

3. DOKUMENTET QË DUHET TË PARAQESË KANDIDATI NËPUNËS I ADMINISTRATËS SHTETËRORE PËR STUDIMET MASTER:

1. Formular aplikimi (formati shkarkohet nga *ëebsite* -i i MASR-së: ëëë.arsimi.gov.al);
2. Kopje të pasaportës/kartës së identitetit;
3. Vërtetim të qendrës së banimit;
4. CV e hollësishme e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton të dhënat në CV;
5. Diplomat universitare te ciklit të parë dhe/ose të dytë të studimeve universitare. Këto dokumente duhet të dorëzohen si fotokopje të noterizuara.
6. Letër pranimi nga institucioni pritës i arsimit të lartë (origjinale ose fotokopje e noterizuar);
7. Një parashikim të detajuar të kostos së studimeve të lëshuar nga universiteti pritës, si dhe një vërtetim nga universiteti pritës mbi mbështetjen ose jo financiare nga ana e tij për kandidatin, si dhe masën e financimit (origjinale ose fotokopje e noterizuar).
8. Në rast bashkëfinancimi ndërmjet MASR-së dhe organizatave, fondacioneve dhe institucioneve vendëse ose të huaja të paraqitet kopje e noterizuar e dokumentacionit që vërteton marrjen nga kandidati të bursës nga organizatat, fondacionet dhe institucionet vendëse ose të huaja (përjashtuar ato shtetërore).
9. Tri rekomandime origjinale për cilësitë e kandidatit.
10. Miratimin e titullarit të institucionit të administratës shtetërore ku punon nëpunësi, sipas formatit të parashikuar në udhëzim.

UDHËZIM

Nr. 1, datë 12.02.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 25, DATË 10.11.2017, "PËR REGJISTRIMIN E FORMAVE TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE NË REGJISTRIN SHTETËROR TË DIPLOMAVE DHE TË CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 10, dhe pikës 3, të nenit 91, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 25, datë 10.11.2017, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja "a", e pikës 2, e nenit 4, ndryshon si më poshtë:

"a) Kërkesa për regjistrim (me vulën e IAL-së dhe firmosur nga rektori), në të cilën deklarohet numri dhe data e:

i) Vendimit të Senatit Akademik për miratimin e formës së diplomës, për çdo cikël dhe lloj programi

studimi; ii) Aktit të hapjes së IAL-së; iii) Aktit të akreditimit të IAL-së;

iv) Aktit të hapjes së programit të studimit për të cilin regjistrohet

diploma;

v) Aktit të akreditimit të programit të studimit për të cilin regjistrohet diploma.”.

2. Shkronjat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f” të pikës 2, të nenit 4, shfuqizohen.

3. Shkronja “h”, e pikës 2, e nenit 4, ndryshon si më poshtë:

“h. Dokumenti i pagesës së tarifës për regjistrim, në regjistrin shtetëror, për llogari të QSHA-së (dokumenti të jetë origjinal ose kopje e noterizuar)”.

4. Pika 3, e nenit 4, shfuqizohet.

5. Pika 2, e nenit 14, shfuqizohet.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 5, datë 19.02.2018

PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE PËRBËRËS TË RAPORTIMIT VJETOR DHE AFATIT PËR RAPORTIM TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË *(Ndryshuar me udhëzimin nr.24,datë 21.10.2019)*

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 32 të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

UDHËZON:

1. Për çdo vit akademik institucionet e arsimit të lartë (IAL) paraqesin pranë Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, raportet vjetore për veprimtarinë e kryer.

2. Raportimi synon:
   a) të paraqesë informacione të qarta dhe transparente të veprimtarisë së IAL-së në zbatim të misionit të tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
   b) të ofrojë informacion për ministrinë mbi gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim, për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që ato ofrojnë, si dhe elemente të tjera që lidhen me shërbimet që IAL-ja ofron;
   c) të nxitë dhe të rritë përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe sigurinë e cilësisë së shërbimeve që ofron IAL;
   d) të paraqesë problemet e konstatuara nga IAL me qëllim zgjidhjen e tyre, në bashkëpunim me strukturat shtetërore në fushën e arsimit.

3. Raporti vjetor hartohet nga IAL në 1 (një) kopje origjinale në formë të shkruar dhe/ose elektronike dhe i dërgohet zyrtarisht Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, brenda muajit shtator të çdo viti. Raporti vjetor mund të dorëzohet edhe në formë elektronike, sipas rastit, i skanuar në formatin PDF.

4. Raporti vjetor përgatitet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit i institucionit të arsimit të lartë, i strukturuar sipas fushës së tyre të kompetencës ku trajtohen çështjet si më poshtë:

A. Senati Akademik:

a) Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së.

b) Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.

c) Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:

i. politikat e kërkimit shkencor;
ii. të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien;
iii. produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësia bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar, apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit;
iv. të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor.

d) Të dhëna mbi programet e studimit.

i. IAL informon mbi të gjitha programet e studimit që ofron, përfshirë ato ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, nëse ka. Në raport paraqiten programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, për të cilën/cilat është marrë leje për hapjen e tij/tyre, por nuk është aktivizuar.
ii. IAL informon mbi marrjen e lejes për hapjen e programit të studimit që është në proces vlerësimi, si dhe për programe që ofrojnë formim të vazhdueshëm për të tretë apo për zhvillimin profesional të personelit të tyre. Këto të dhëna shoqërohen me numrin dhe datën e aktit për hapjen, pezullimin ose mbylljen e programit të studimit.

iii. IAL-ja pasqyron në raportin vjetor përshtatshmërinë e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimin e synimeve të programit të studimit nga ana e përmbajtje dhe lidhjen e rëndësinë e programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës.

e) Ndryshimet në Statutin apo Rregulloret e IAL-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

f) Parashikimin për angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe/ose modulin/et që do të zhvillojë secili prej tyre për secilin semestër të vitit akademik.

g) Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që IAL-të ofrojnë, të shoqëruar me burimin e informacionin dhe adresën ku konfirmohet informacioni, duke specifikuar:

i. përqindjen e punësimit të të diplomuarve, nëse institucioni deklaron se programet e ofruara përgatisin për një karrierë apo profesion të caktuar;
ii. përqindjen e të diplomuarve që kalojnë provimin e shtetit dhe licencohen, kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar.

h) Të dhëna për Këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

i) Vlerësime të IAL-së dhe rekomandime të mundshme për Ministrinë si dhe një përshkrim të ndërveprimit të IAL-së me strukturat e varësisë të Ministrisë duke përfshirë edhe :
i. një vlerësim të përgjithshëm të komunikimit me Ministrinë dhe institucionet në varësi të saj duke theksuar mbi përmirësimet e mundshme në këtë komunikim;
ii. vlerësime dhe rekomandime për ndryshime të sistemit apo akteve ligjore e nënligjore në fuqi që ndikojnë në veprimtarinë e IAL-së, të shoqëruar me arsyetime të hollësishme.

j) Të dhëna mbi studentët si:

i. numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit;
ii. numrin e studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar, të përcaktuar në dokumentin e prioriteteve të miratuar dhe publikuar çdo vit nga Ministria sipas drejtimeve kryesore.
iii. numrin e studentëve të shkëlqyer;
iv. numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen;
v. numrin e studentëve që kanë përfituar bursa dhe numrin e atyre që kanë përfituar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit;
vi. pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre;
vii. përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen e atyre që diplomohen;
viii. një vlerësim të përgjithshëm mbi cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi;

B. Bordi i Administrimit:

a) Të dhëna të përgjithshme mbi IAL-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit të arsimit të lartë, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse, etj.
b) Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit.
c) Realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim.
d) Dokumentacionin e shlyerjes së detyrimeve tatimore si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore;
e) Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare.

f) Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen ndryshime në mjediset didaktike, kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimit, në bashkëpunim me Senatin Akademik të institucionit të arsimit të lartë.

Të dhënat e mësipërme miratohen në mbledhje të përbashkët të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit të institucionit të arsimit të lartë dhe i dërgohen Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me një raport të përbashkët.

5. Në rastet kur IAL nuk e dorëzon raportin vjetor, brenda afatit kohor të caktuar në këtë udhëzim, pa arsye të përligjura, Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, kërkon marrjen e masave administrative nga organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Në rastet kur Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë konstaton pavërtetësi në të dhënat e paraqitura të raportit vjetor nga IAL-të, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, vendos kushte ndaj IAL-së dhe/ose pezullon veprimtarinë e IAL-së, në rast se veprimi apo mosveprimi nuk përbën vepër penale.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në MASR dhe Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

M I N I S T Ë R

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 6, Datë 19.02.2018

PËR GJENERIMIN DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 10, pika 1, germa "c", të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Studenti në momentin e regjistrimit me dokumentacion në institucionin e arsimit të lartë (IAL), regjistrohet edhe në regjistrin themeltar të studentëve dhe pajiset me një numër matrikullimi (NIM) që e shoqëron atë deri në marrjen e diplomës për programin përkatës të studimit. Ky numër matrikullimi pasqyrohet në regjistrin themeltar të studentëve.

2. NIM përbëhet nga tre germa dhe nëntë shifra. Ciklet e studimit përcaktohen sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Formimi i numrit të matrikullimit është sipas shtojcës nr.2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Në rastin kur studenti çregjistrohet nga një program studimi, NIM-i i tij mbyllet dhe nuk përdoret për një student tjetër.

4. Në rastin kur studenti, transferohet në një program studimi në një IAL tjetër, NIM-i i tij mbyllet dhe nuk përdoret për një student tjetër. Studenti pajiset me NIM tjetër në IAL-në ku transferohet.

5. Në rastin kur studenti pezullon studimin, NIM-i i tij nuk mbyllet dhe mbetet i njëjtë kur studenti e rifillon atë.

6. Në rastin kur studenti i shkëlqyer regjistrohet me dokumentacion në më shumë se një program studimi, në të njëjtën IAL apo në IAL të ndryshme, ai pajiset me NIM të veçantë për secilin program studimi.

7. Në fillim të çdo viti akademik, IAL-të dërgojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA) listën e studentëve të regjistruar, për çdo cikël studimi, në përputhje me afatet e përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, sipas shtojcës nr.3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

8. Në fund të çdo viti akademik, IAL-të dërgojnë në QSHA listën e studentëve të diplomuar, për çdo cikël studimi, sipas afateve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

9. IAL-të mbajnë në formë të shkruar dhe elektronike regjistrin themeltar të studentëve, sipas rubrikave të përcaktuara në shtojcën nr.4, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

10. Udhëzimi nr. 45, datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", i ndryshuar, shfuqizohet.

11. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore si dhe Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

M I N I S T Ë R

LINDITA NIKOLLA

Shtojca nr.1: Për përcaktimin e kodit të ciklit të studimit

Cikli i studimit	Shënime	Forma e studimit		Kodi i ciklit
DP/CP	Programe studimi me karakter profesional (1 ose 2 vjet)	KP	KZ	Q
Bachelor	Cikli i parë i studimeve, me kohë të plotë	KP		A

Master i Shkencave	Cikli i dyte i studimeve, Master i shkencave/Master i arteve të bukura	KP		B
Master Profesional	Cikli i dytë i studimeve, Master Profesional me kohë të plotë dhe me kohë të zgjatur	KP	KZ	G
PISCD	Programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë 5 ose 6 vjeçar, me kohë të plotë	KP		E
Master Ekzekutiv	Master Ekzekutiv cikli i tretë	KP	KZ	K
Specializim Afatgjatë	Studime specializuese afatgjata, cikli i tretë			M
Doktoratë	Doktoratë, cikli i tretë			N

Shtojca nr.2: Formimi i numrit të matrikullimit



Universiteti Programi i studimit Cikli Viti Regj. Numri rendor

1. Kodi i IAL përbëhet nga dy germa të cilat vendosen në mënyrë unike.
2. Programi i studimit përbëhet nga tre shifra.
3. Cikli do të varet nga cikli dhe forma e studimit. Ai do të jetë i njehsuar për të gjitha IAL-të: një cikël studimi + një formë studimi do të përdorë të njëjtën germë.
4. Viti i regjistrimit, përbëhet nga dy shifra të cilat tregojnë vitin e regjistrimit, ku 00 tregon vitin 2011. Ky numër shtohet me 1, për çdo vit.
5. Numri rendor përcaktohet nga sistemi në rend rritës

Shtojca nr. 3: PASQYRA E STUDENTËVE TË REGJISTRUAR NË VITIN AKADEMIK

Emërtimi sipas ciklit dhe formës së studimit (sipas shtojcës nr. 2)

IAL	Fakulteti	Cikli i studimit	Programi i studimit (1)	Data e regjistrimit (2)	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja (3)	Gjinia	Vendlindja	Numri personal i identitetit (4)	Lloji i dokumentit të identitetit	Emri i shkollës së mesme/ IAL nga vjen. (5)	ID e maturës (6)/numër matrikullimi (7)	Shënime (8)

1) Të shënohet emërtimi zyrtar i miratuar për programin e studimit.
2) Të shënohet në formatin dd.mm.yyyy
3) Të shënohet në formatin dd.mm.yyyy
4) Numri personal i identitetit në letërnjoftim ID ose në pasaportën biometrike (ose dokument të barasvlershëm me të për studentët e huaj).
5) Të shënohet emri i shkollës së mesme ose universitetit me ciklin përkatës që studenti ka përfunduar dhe përdoret për tu regjistruar.

6) ID e maturës nëse ka përfunduar shkollën e mesme pas vitit 2006 ose numri i amzës të dëftesës së shkollës së mesme përpara vitit 2006.
Te IAL të shënohet emërtimi i plotë zyrtar i institucionit.
Te Fakulteti të shënohet emërtimi i plotë zyrtar i fakultetit që ndjek studenti.
Te cikli i studimit të shënohet emërtimi i plotë zyrtar.
7) Për studentët e ciklit të parë ose të dytë që janë pajisur me numër matrikullimi dhe janë diplomuar të shënohet numri i matrikullimit
i ciklit paraardhës

8) Për studentët e ciklit të parë ose të dytë që janë pajisur me numër matrikullimi dhe janë diplomuar të shënohet data e diplomim Gjithashtu në këtë kolonë
të shënohet nëse është transferim/program i dytë/pezullim/student i shkëlqyer

Shtojca nr. 4

1. Numri rendor i rekordit të plotësuar;
2. Emërtimi i IAL-së;
3. Emërtimi i Fakultetit;
4. Emërtimi i programit të studimit;
5. Lloji i programit të studimit;
6. Forma e studimit;
7. Numri i regjistrit;
8. Numri i matrikullimit;
9. Emri;
10. Atesia;
11. Mbiemri;
12. Datëlindja;
13. Gjinia;
14. Gjendja civile;
15. Vendlindja: Qyteti/ Fshati, Bashkia/ Komuna, Rrethi;
16. Shtetësia (për të huajt të shënohet dhe referencat e lejes së qëndrimit);
17. Data dhe numri i certifikatës së mbrojtjes së gjuhës shqipe (për studentet e huaj);
18. Adresa e Vendbanimit në Republikën e Shqipërisë;
19. Telefon; 20. E-mail;
21. Gjuha e huaj e mbrojtur (gjuha e huaj dhe testimi, niveli i gjuhës së huaj të mbrojtur për studentët që ndjekin studime në një program studimi të miratuar në gjuhë të huaj);
22. Emri i shkollës së mesme ku ka kryer studimet parauniversitare (për të gjithë studentët); 23. Emri i IAL-se ku ka kryer studimet e ciklit të parë (për studentet që ndjekin ciklin e dytë ose të tretë të studimeve);
24. Emri i IAL-se ku ka kryer studimet e ciklit të dytë (për studentet që ndjekin ciklin e tretë të studimeve);
25. ID e Maturës Shtetërore / Nr. Regj. i veçantë"[72];
26. Lloji i dokumentit të identifikimit;
27. Numri personal i identitetit/numri i dokumentit të identifikimit;
28. Data e regjistrimit;
29. Lloji i regjistrimit;
30. Numri i matrikullimit të mëparshëm (për studentet e transferuar);
31. IAL-ja nga është transferuar (për studentet e transferuar);
32. Data e regjistrimit në programin e studimit në IAL-në nga është transferuar;
33. Emër, Mbiemër, Firmë e personit te autorizuar që hodhi të dhënat e paraqitura ne pikat 1-32;
34. Emër, Mbiemër, Firmë e kryesekretares pas plotësimit të kolonës 33;
35. Data e diplomimit;
36. Numri i diplomës;
37. Tërheqja e diplomës (data dhe të dhënat e personit që e tërhoqi);
38. Ndërprerë studimet/Çregjistruar;
39. Të dhëna për çregjistrimin (data dhe referencat e aktit që ka përcaktuar çregjistrimin);
40. Emër, Mbiemër, Firma e personit të autorizuar që hodhi të dhënat e kolonave 35-39;
41. Emër, Mbiemër, Firma e kryesekretares pas plotësimit të kolonës 40;
42. Statusi i studenti

43. Shënime

[72] Për të diplomuarit para vitit 2006

UDHËZIM

Nr. 7, datë 19.02.2018

PËR MIRATIMIN E ELEMENTEVE DHE FORMËS SË KONTRATËS SË SHËRBIMIT NDËRMJET INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË JOPUBLIK DHE STUDENTIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të shkronjës "d", të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Kontrata e shërbimit që lidhet ndërmjet IAL-së jopublike dhe studentit duhet të përmbajë elementet si më poshtë:

a) Të dhënat e plota për IAL-në jopublike dhe emrin e administratorit të saj në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të IAL-së;

b) Të dhënat e plota për identitetin e studentit;

c) Objektin e kontratës;

d) Bazën ligjore;

e) Afatin e kontratës;

f) Emërtimin e programit të studimit;

g) Vitet akademike, kreditet dhe planin mësimor;

h) Tarifën e studimit dhe mënyrën e pagesës së tarifës së studimit, duke përfshirë një grafik të të gjitha
pagesave, të rimbursueshme dhe të parimbursueshme;

i) Afatet e pagesës së tarifës së studimit;

j) Rastet e pjesëmarrjeve në sesionet e provimeve shtesë dhe tarifat për këto pjesëmarrje;

k) Përgjegjësinë për vonesën apo mospagesën e tarifës së studimit;

l) Të drejtën e studentit për të hequr dorë nga kontrata në fillim të vitit të parë akademik;

m) Të drejtat e palëve në kontratë, për prishje të njëanshme të kontratës pas fillimit të vitit të parë
akademik;

n) Rastet e pamundësisë për të përfituar nga programi i studimit, nga studenti;

o) Sigurimin e studentit në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të
studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera;

p) Të drejtat dhe detyrimet e palëve në kontratë;

q) Të drejtat dhe detyrimet lidhur me publikimin e imazheve të studentëve;

r) Detyrimin e IAL-së për mbrojtjen e të dhënave personale;

s) Deklarimin nga ana e studentit përpara nënshkrimit të kontratës, se ajo është lexuar, kuptuar dhe rënë dakord, lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve në kontratë, si dhe me rregullat e ndërprerjes së kontratës dhe të rimbursimit;

t) Deklarimin nga ana e studentit për marrjen përsipër të ruajtjes së konfidencialitetit të kontratës.

u) Deklarimin nga ana e studentit se nuk është regjistruar dhe nuk është duke ndjekur asnjë program tjetër studimi në institucion tjetër të arsimit të lartë, njëkohësisht.

2. Kontrata e shërbimit që lidhet ndërmjet IAL-së jopublike dhe studentit, hartohet dhe nënshkruhet në formën e kërkuar nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

3. Në përmbajtje të kontratës së shërbimit duhet të paraqiten qartë:

a) E drejta e studentit për të hequr dorë nga kontrata dhe t'i rimbursohen plotësisht pagesat e bëra për ndjekjen e orës së parë të mësimit ose 7 ditë pas nënshkrimit të kontratës së regjistrimit, cilado qoftë më e vonshme prej këtyre datave;

b) Ndarjen e pagesës së tarifës së studimit në këste, në mënyrë të tillë që studenti të paguajë paraprakisht deri në 50% të pagesës për semestër;

c) Përcaktimin e të gjitha tarifave në mënyrë të qartë në kontratë që në momentin e regjistrimit, përfshirë pjesëmarrjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme në sezonet e provimeve, ceremonitë dhe kostot e diplomimit etj.;

d) Detyrimin kontraktor të IAL-së, për të mos shtuar tarifa të tjera, përveç atyre të parashikuara në
kontratën e shërbimit deri në pajisjen me diplomë të studentit;

e) Të drejtën e studentit për t'u siguruar nga institucioni i arsimit të lartë jo publik, në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera;

f) Të drejtat e rimbursimit të studentit në rastet e transferimit apo ndërprerjes së studimeve, duke
përcaktuar qartazi në kontratë se tarifa e studimit që do të paguhet nga studenti do të jetë vetëm për semestrin e fundit që ka ndjekur ose është duke ndjekur studenti;

g) Rregullat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe gjykatën kompetente për rastet e mosmarrëveshjeve të pazgjidhura ndërmjet palëve.

4. Kontrata e shërbimit të shoqërohet me dokumentin e performancës së institucionit të arsimit të lartë, e cila ndër të tjera duhet të përmbajë dhe:

a) të dhëna mbi politikat dhe performancën e institucionit;

b) përqindjen kaluese për programin e studimit që do të ndjekë studenti;

c) përqindjen e kaluesve në provimin e shtetit në rast se aplikohet ky provim;

d) përqindjen e punësimit të studentëve në programin përkatës të studimit për tri vitet e fundit.

5. Kontrata të firmoset dhe t'i vendoset data e nënshkrimit nga vetë studenti ose personi i autorizuar prej tij me prokurë të posaçme.

6. Studenti apo çdo person publik ka të drejtë të marrë informacion dhe/ose të paraqesë ankim për të kontaktuar strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në numrin e telefonit të publikuar në faqen elektronike zyrtare ose duke plotësuar letrën e ankesës që mund të shkarkohet nga kjo faqe, për rastet e mosrespektimit të këtij udhëzimi.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në MASR, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Agjencia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Institucionet e Arsimit të Lartë dhe studentët.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr.15, datë 16.04.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 03.08.2016 "PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË VENDIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 91 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 17, datë 03.08.2016 "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit", i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën "b", të pikës 1, të Kreut III pjesa "Diplomën[1]" të bëhet *"Diplomën"*;

2. Në Kreun II dhe në pikën 1 të Kreut III, shprehjet "Ministria e Arsimit dhe Sportit" dhe "MAS" të zëvendësohen me "Qendra e Shërbimeve Arsimore" dhe "QSHA";

3. Në pikën 1 të kreut IV, fjalia e fundit "*Aplikimi nuk konsiderohet i plotë nëse formulari i aplikimit nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara me detyrim aty. Në këto raste dosja arkivohet dhe aplikanti njoftohet me e-mail"* të ndryshohet si më poshtë:

   "Në rast të mangësive në dokumentacion, aplikantit i kërkohet fillimisht plotësim dokumentacioni me anë të postës elektronike, brenda 15 ditëve nga momenti i depozitimit të aplikimit në QSHA. Në rast të mos depozitimit të plotësimeve brenda katër javëve, aplikantit i kërkohen plotësime për herë të dytë me shkresë zyrtare, të cilat duhet të depozitohen brenda katër javëve në QSHA,, në të kundërt praktika depozitohet në arkivën e QSHA-së dhe aplikanti duhet të bëjë aplikim nga fillimi.".

4. Në pikën 4.1 të kreut IV, të shtohen fjalitë si më poshtë:

"Konfirmimi i autenticitetit kërkohet me e-mail tek IAL-ja përkatëse të paktën dy herë dhe në rast mospërgjigje, konfirmimi kërkohet me shkresë zyrtare. Në rast se pas gjashtë muajve nga momenti i kërkesës së konfirmimit me shkresë zyrtare, ende nuk ka një përgjigje nga IAL-ja, praktika përkatëse depozitohet në arkivën e QSHA-së.".

5. Pika 5.1 e kreut IV, të riformulohet si më poshtë:

"*Për njohjen dhe njësimin e certifikatave dhe diplomave të lëshuara në përfundim të programeve të studimit që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, përveç gradës shkencore "Doktor", ngrihet Komisioni i Njohjes se Diplomave*.".

6. Në pikën 5.2 të kreut IV, të shtohet:

"Në zbatim të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në përcaktimet e shkronjës "b" të nenit 75 dhe pikës 2 të nenit 124 të ligjit nr. 80/2015:
i. Diplomat e fituara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë, përpara aplikimit të sistemit të Bolonjës në Shqipëri, të lëshuara deri në vitin 2010, me kohëzgjatje normale minimale 4 vjet (8 semestra), me kohë të plotë, të njësohen si ekuivalentët e tyre që ofroheshin në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë në të njëjtën periudhë kohore. ii. Diplomat e lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë, për programet e studimit të cilët përmbajnë të paktën 300 ECTS, me kohëzgjatje normale minimale 5 vite akademike, të njësohen si ekuivalentët e tyre që ofrohen në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.".

7. Pika 6 e kreut IV, ndryshohet si më poshtë:
"Vërtetimi i njohjes dhe njësimit (me përjashtim të gradave shkencore dhe titujve akademikë):

   a) *Lëshohet nga QSHA (nënshkruhet nga titullari i QSHA dhe Kryetari i Komisionit të Njohjes) në dy kopje origjinale(njëra kopje i bashkëngjitet procesverbalit përkatës dhe ruhet në dosjen e aplikimit përkatëse).*
   b) *Përmban minimalisht elementët e mëposhtëm:*
      i. *Emrin dhe mbiemrin e kandidatit;*
      ii. *Institucionin e huaj të arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën;*
      iii. *Shtetin përkatës;*
      iv. *Numrin e krediteve ECTS (nëse mund të përcaktohet);*
      v. *Emërtimin e plotë të programit të studimit;*
      vi. *Kohëzgjatja e programit të studimit;*
      vii. *Data e përfundimit të studimeve;*
      viii. *Njësimin e diplomës/certifikatës në Republikën e Shqipërisë.*
   c) *Formulimi grafik i vërtetimit të njohjes dhe njësimit përcaktohet nga struktura përkatëse në QSHA.".*

8. Kreu VII, të ndryshohet si më poshtë:

"Aplikanti ka të drejtë të bëjë ankimim me shkrim drejtuar Komisionit të Njohjes së Diplomave brenda 30 ditëve nga data e lëshimit (publikimit) të vërtetimit të njohjes dhe njësimit, për njohjen e diplomave të niveleve 5 deri 8 të kornizës kombëtare të kualifikimeve, me përjashtim të njohjes së gradës shkencore "Doktor" dhe titujve akademikë për të cilin i drejtohet Komisionit ad hoc përkatës. Ankesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin mbi të cilët mbështeten pretendimet e ankuesit. Afati i ankimimit dhe kthimit të përgjigjes për ankesën i referohet përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.".

9. Ngarkohet për zbatimin e këtij Udhëzimi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

UDHËZIM

Nr. 18, datë 21.05.2018

PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË VITIN AKADEMIK 2018 -2019". Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.4.2018, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019",

UDHËZOJ:

KREU I

PORTALET E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT

1. Aplikimi i maturantëve/i kandidatëve me formularët A1 dhe A1Z bëhet në portalin e Maturës Shtetërore online: ëëë.matura.qsha.gov.al

2. Hedhja e rezultateve lëndore të të gjitha viteve të arsimit të mesëm, për maturantët/kandidatët që kanë plotësuar online formularin A1 ose A1Z, bëhet nga drejtoritë e institucioneve arsimore në portalin maturanti: ëëë.rezultateam.al

3. Për maturantët e vitit shkollor 2017-2018, të cilët kanë aplikuar me formularin A1, nga drejtoritë e institucioneve arsimore hidhen në portalin online të maturantit, të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm. Deri më 31 maj 2018, hidhen rezultatet e të gjitha viteve të arsimit të mesëm, me përjashtim të rezultateve të vitit të fundit. Rezultatet e vitit të fundit hidhen gjatë muajit qershor, pas përfundimit të vitit shkollor.

4. Për kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm, përpara vitit shkollor 2017-2018 dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen deri më 30 qershor 2018, në portalin online të maturantit të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

5. Për kandidatët, që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen deri

më 30 qershor 2018, në portalin online të maturantit të dhënat e lidhura me rezultatet e njësuara të shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.
6. Përzgjedhja e programeve të ciklit të parë të studimeve, të programeve të studimeve me karakter profesional, si dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë të ofruara nga IAL-të për vitin akademik 2018-2019, të bëhet në portalin e aplikimit universitar U-Albania: http://ualbania.arsimi.gov.al

7. Regjistrimi i studentëve fitues, të shpallur nga IAL-të të kryhet nga sekretaritë mësimore dhe të pasqyrohen në portalin e aplikimit universitar U-Albania: http://ualbania.arsimi.gov.al

KREU II

RAUNDI I PARË

A. Procedurat e aplikimit

1. Maturantët/kandidatët, për ndjekjen e studimeve në IAL-të, publike dhe jopublike, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, duhet të kryejnë procesin e aplikimit online në portalin e aplikimit universitar U-Albania.

2. Aplikimi kryhet nga maturantët/kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Janë pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të arsimit të mesëm;

b) Plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin përkatës akademik;

c) Plotësojnë kriteret shtesë të përcaktuara nga IAL-të për programet e studimit për të cilat aplikojnë;

d) Nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.

3. Maturantët/kandidatët, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dy mijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim të cilën e shkarkojnë në portalin U-Albania. Pagesa kryhet në periudhën 5 qershor deri 15 korrik. Pas dorëzimit të mandatit të pagesës, sekretaritë e shkollave konfirmojnë pagesën e kryer në portalin U-Albania brenda datës 20 korrik 2018.

4. Në periudhën 30 korrik-4 gusht 2018, maturantët/kandidatët që duan të ndjekin studimet në IAL, përfshirë edhe kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit, pas pagesës së tarifës së aplikimit do të aplikojnë në portalin U-Albania, nëpërmjet formularit online të aplikimit, mbi bazën e notës mesatare sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.4.2018 dhe kritereve të tjera të përcaktuara nga IAL-të.

5. Maturantët/kandidatët, që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.4.2018.

6. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti, sipas procedurave të përshkruara në udhëzuesin teknik, të publikuar në faqen zyrtare të portalit U-Albania.
7. Kandidatët zgjedhin deri në 10 (dhjetë) programe studimi nga lista e programeve të studimit, që ofrohen nga IAL-të publike/ jopublike, për vitin akademik 2018-2019.

8. DAR/ZA-të duhet të marrin masa për krijimin e kushteve (mjedise, asistencë teknike, këshilluese etj.) për t'iu ofruar maturantëve/ kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar, lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.

9. Portali U-Albania nuk do të pranojë aplikime nga maturantët/kandidatët, të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me vendimin e Këshillit të Ministrave për programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë.

B. Përcjellja e të dhënave dhe e rezultateve, procesi i përllogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/të kandidatëve të renditur

1. Në datën 31 maj 2018, QSHA-ja i përcjell RASH-së, në formë elektronike dhe zyrtarisht, listën e maturantëve/kandidatëve që kanë aplikuar me formularët A1/A1Z.

2. Brenda datës 28 korrik 2018, QSHA-ja i përcjell RASH-it, në formë elektronike dhe zyrtarisht, për çdo maturant/kandidat:

a) ID e maturës;

b) Numrin personal të maturantit/kandidatit;

c) Notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

d) Rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;

e) Mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

f) Mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;

g) Mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.4.2018;

h) Indekset e profileve të shkollave të mesme.

3. Brenda datës 10 gusht 2018, IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi shkarkojnë nga portali U-Albania listën e aplikantëve që konkurrojnë në programet përkatëse të studimit.

4. Në datën 10 gusht 2018, IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi, afishojnë në mjediset e tyre dhe në faqet zyrtare elektronike përkatëse listat e aplikantëve. Në periudhën 11-27 gusht 2018 do të zhvillohen konkurset e pranimit".

5. Deri në datën 13 gusht 2018 RASH-ja i përcjell QSHA-së listën e aplikantëve për çdo program studimi.

6. Pas datës 23 gusht 2018, IAL-të mund të shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:

a) Listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;
b) Notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

c) Rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;

d) Mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

e) Mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;

f) Mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.4.2018;

g) Indekset e profileve të shkollave të mesme.

7. Të gjitha IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, pas kryerjes së përllogaritjes së pikëve për çdo konkurrent, sipas kritereve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja me vendim senati, si dhe renditjes së tyre në varësi të pikëve të grumbulluara, afishon në mjediset publike, si dhe në faqen e saj zyrtare listat e renditjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

8. Brenda datës 28 gusht 2018, të gjitha IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-në e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës 28 gusht 2018, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania. Gjithashtu, brenda datës 28 gusht 2018, IALtë i përcjellin zyrtarisht një kopje elektronike të këtyre listave QSHA-së.

C. Procesi i regjistrimit

1. Në datat 30 gusht deri 12 shtator 2018, të gjithë aplikantët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e parë dhe janë shpallur fitues, mund të kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretaritë mësimore të IAL-ve në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet nga ora 08:00 deri në orën 16:30.

2. Periudha 30 gusht deri 12 shtator është e ndarë në 7 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në njërin apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

3. Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë. Për programet e studimit të ofruara nga IAL-të, për të cilat:

a) Nuk përcaktohen kritere shtesë nga IAL-ja përkatëse, me përjashtim të notës mesatare;

b) Numri i kandidatëve është i njëjtë apo më i ulët se numri i kuotave të miratuara;

Nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe dhe kandidatët kanë të drejtën e regjistrimit gjatë gjithë periudhës së regjistrimeve të raundit të parë.

4. Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 7 fazave 48-orëshe, MASR-ja dhe RASH-ja do të publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare: ëëë.arsimi.gov.al dhe http://ualbania.arsimi.gov.al
5. Procesi i regjistrimeve nga sekretaritë mësimore, me dokumentacion dhe online vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e fituesve të raundit të parë.

6. Në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj mund të regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Këto faza vijojnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën 12 shtator 2018. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara të cilat nuk kanë aplikantë në pritje, do të rikthehen në garë aplikantët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi në garë kryhet sipas listës së renditjes së aplikantëve për raundin e parë.

7. Aplikantët fitues duhet të regjistrohen vetëm në një program studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Pas marrjes së dokumentacionit nga aplikanti dhe regjistrimit të tij, sekretaria mësimore e fakultetit bën regjistrimin online në portalin U-Albania. Aplikantët dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja;

b) Fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar në MASR;

c) deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjëses së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë.

8. Sekretaritë mësimore mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani

të aplikantit kryhet regjistrimi online në portalin U-Albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretarja firmoset në dy kopje formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit.

9. Brenda datës 14 shtator 2018, IAL-të përcjellin në QSHA dhe RASH regjistrimet përfundimtare të raundit të parë bashkë me kuotat e paplotësuara në format elektronik dhe në hardcopy.

10. Aplikantët fitues në një program studimi, të cilët nuk janë regjistruar sipas afateve të raundit të parë, humbasin të drejtën për t'u regjistruar. Ata kanë të drejtën që të plotësojnë formularin e aplikimit të raundit e dytë.

Ç. Procesi i çregjistrimit

1. Aplikanti, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, ka të drejtë të çregjistrohet vetëm në datën 13 shtator 2018. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda kësaj date, ai nuk ka të drejtë ta ndryshojë programin e studimit

për këtë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania nga sekretaria mësimore e fakultetit.
2. Sekretaritë mësimore, pas çregjistrimit të aplikantëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, i dërgojnë QSHA-së dhe RASH-së, brenda datës 14 shtator 2018, listën e aplikantëve të çregjistruar.

D. Procesi i ankimimit

1. Aplikantët kanë të drejtën e ankimimit në IAL në datën 29 gusht 2018. Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesave, IAL-të duhet të shprehen me vendim lidhur me ankimimet. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

2. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, pasqyrojnë në format elektronik në portalin U-Albania, brenda datës 31 gusht 2018, vendimet lidhur me ankimimet e aplikantëve.

3. Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, mund të vijojnë procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa e tyre është pranuar, ata duhet të çregjistrohen nga programi i studimit (nëse janë regjistruar) dhe të regjistrohen në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, vetëm në datën 13 shtator 2018.

KREU III

RAUNDI I DYTË

A. Procedurat e aplikimit

1. Në periudhën 15-20 shtator 2018 do të kryhet procesi i aplikimit online për raundin e dytë në portalin U-Albania. Kanë të drejtë të aplikojnë, duke përzgjedhur deri në 10 (dhjetë) preferenca, të gjithë maturantët/kandidatët, të cilët kan ë plotësuar formularin A1/A1Z dhe rezultojnë kalues në provimet e Maturës Shtetërore, por që:

a) Nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë;

b) Kanë kryer procesin e aplikimit online në raundin e parë dhe nuk janë shpallur fitues;

c) Kanë kryer procesin e aplikimit online në raundin e parë dhe nuk kanë arritur të regjistrohen;

d) Janë çregjistruar pas përfundimit të raundit të parë.

2. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti (sipas procedurave të përshkruara në udhëzuesin teknik të publikuar në portalin e aplikimit universitar U-Albania).

3. Deri në datën 10 shtator 2018, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, për të gjithë maturantët/kandidatët që kanë rezultuar kalues në provimet e sesionit të dytë (sesioni i vjeshtës), menjëherë pas publikimit të rezultateve të provimeve të këtij sesioni, hidhen në portalin online të maturantit, të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

4. DAR/ZA-të marrin masa për krijimin e kushteve (mjedise, asistencë teknike, këshilluese etj.) për t'u ofruar maturantëve/kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.

5. Maturantët/kandidatët që nuk kanë aplikuar në raundin e parë, përpara aplikimit në portalin UAlbania, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2 000 (dy mijë) lekë në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim të cilën e shkarkojnë në portalin U-Albania. Maturantët/kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë dhe do të riaplikojnë në raundin e dytë nuk duhet të kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit.

B. Përcjellja e të dhënave dhe e rezultateve, procesi i përllogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/kandidatëve të renditur

1. Brenda datës 14 shtator 2018, QSHA-ja i përcjell RASH-it, në formë elektronike dhe zyrtarisht, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:

a) ID e maturës;

b) Numrin personal të maturantit/kandidatit;

c) Notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

d) Rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;

e) Mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

f) Mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;

g) Mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.4.2018;

h) Indekset e profileve të shkollave të mesme.

2. Pas datës 21 shtator 2018, IAL-të mund të shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:

a) Listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;

b) Notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

c) Rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;

d) Mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

e) Mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;

f) Mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.4.2018;

g) Indekset e profileve të shkollave të mesme.

3. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë kryejnë procesin e përllogaritjeve të pikëve për çdo aplikant, sipas kritereve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja me vendim senati. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e aplikantëve të renditur dhe formulën/mënyrën e përllogaritjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

4. Brenda datës 25 shtator 2018, IAL-të afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës 25 shtator 2018, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania. Gjithashtu, brenda datës 25 shtator 2018, IAL-të i përcjellin një kopje elektronike të këtyre listave QSHA-së.

C. Procesi i regjistrimit

1. Në datat 27 shtator deri 6 tetor 2018, të gjithë aplikantët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e dytë dhe janë shpallur fitues, mund të kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretaritë mësimore në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet nga ora 8:00 deri në orën 16:30.

2. Periudha 27 shtator deri 6 tetor 2018 është e ndarë në 5 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në njërin apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

3. Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48 orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë. Për programet e studimit të ofruara nga IAL-të, për të cilat:

a) Nuk përcaktohen kritere shtesë nga IAL-ja përkatëse, me përjashtim të notës mesatare;

b) Numri i kandidatëve është i njëjtë apo më i ulët se numri i kuotave të miratuara;

Nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe dhe kandidatët kanë të drejtën e regjistrimit gjatë gjithë periudhës së regjistrimeve të raundit të parë.

4. Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 5 fazave 48-orëshe, MASR-ja dhe QSHA-ja do të publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare: ëëë.arsimi.gov.al dhe http://ualbania.arsimi.gov.al

5. Procesi i regjistrimeve nga sekretaritë mësimore, me dokumentacion dhe online vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e renditura të raundit të dytë. Në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj mund të regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara të cilat nuk kanë aplikantë në pritje, do të rikthehen në garë aplikantët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi në garë kryhet sipas listës së renditjes së aplikantëve për raundin e dytë.

6. Sekretaritë mësimore do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë aplikantët fitues që dëshirojnë të regjistrohen vetëm në një program studimi. Pas marrjes së dokumentacionit nga aplikanti dhe regjistrimit të tij, sekretaria bën regjistrimin online në portalin U-Albania. Aplikantët dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja;

b) Fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar në MASR;
c) Deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjëses së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë.

7. Sekretaritë mësimore të fakulteteve të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të aplikantit kryhet regjistrimi online në portalin U-Albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretarja firmoset në dy kopje formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit.

8. Brenda datës 22 tetor 2018, RASH-ja dhe IAL-të përcjellin në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të dytë në format elektronik dhe hardcopy.

9. Aplikantët, të cilët kanë bërë regjistrimin me dokumentacion dhe kanë nënshkruar në regjistër, nuk kanë të drejtë të ndryshojnë programin e studimit, për atë vit akademik.

Ç. Procesi i ankimimit

1. Aplikantët kanë të drejtën e ankimimit në IAL në datën 26 shtator 2018. Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesave, IAL-të duhet të shprehen me vendim lidhur me ankimimet. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

2. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, përcjellin zyrtarisht në QSHA brenda datës 28 shtator 2018, vendimet lidhur me ankimimet e aplikantëve, si dhe pasqyrojnë brenda po kësaj date në portalin U-Albania këto vendime në format elektronik.

3. Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, mund të vijojnë procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa e tyre është pranuar, ata duhet të çregjistrohen nga programi i studimit (nëse janë regjistruar) dhe të regjistrohen në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, vetëm në datën 7 tetor 2018.

D. Procesi i çregjistrimit

1. Aplikanti, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, ka të drejtë të çregjistrohet vetëm në datën 7 tetor 2018. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda kësaj date, ai nuk ka të drejtë ta ndryshojë programin e studimit për këtë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania nga sekretaria mësimore e fakultetit.

2. Sekretaritë mësimore, pas çregjistrimit të aplikantëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, i dërgojnë QSHA-së dhe RASH-së, brenda datës 9 tetor 2018, listën e aplikantëve të çregjistruar.

KREU IV

RAUNDI I TRETË

1. Gjatë periudhës 9 deri më 13 tetor 2018, IAL-të vijojnë me procedurat e regjistrimit të kandidatëve nëpërmjet portalit U-Albania, në programet e studimit në të cilat kanë aplikuar në raundin e dytë. Të drejtën e regjistrimit e kanë kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi. IAL-të gjatë regjistrimeve respektojnë renditjen e kandidatëve deri në plotësimin e kuotave. Procedurat për regjistrimin e kandidatëve përcaktohen nga njësitë kryesore të IAL-ve.

1.1. Për maturantët që nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë dhe raundin e dytë, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe respektojnë kriterin e notës mesatare sipas Vendimit nr. 216, datë 20.04.2018 të Këshillit të Ministrave, mund të bëhen pjesë e raundit të tretë, pasi të kenë aplikuar në portalin U-Albania, duke ndjekur procedurën e parashikuar në pikën 5, germa A, Kreu III të këtij udhëzimi. Kjo procedurë të kryhet, brenda datës 18 tetor 2018, pasi të jetë kryer më parë konfirmimi në portalin U-Albania nga institucionet e arsimit të lartë, ku këta maturantë janë të interesuar të studiojnë.".

2. Në rast se përfundon e gjithë lista e kandidatëve që kanë aplikuar në raundin e dytë dhe mbeten kuota të paplotësuara në programet përkatëse të studimit, njësitë bazë në institucionet e arsimit të lartë, përzgjedhin kandidatët fitues sipas kërkesave të depozituara nga kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, pavarësisht përzgjedhjeve në raundin e parë apo të dytë, në datat 15-18 tetor 2018. Kandidatët përzgjidhen dhe rankohen nga njësitë

bazë dhe miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, duke ngarkuar një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania. Sekretaritë mësimore regjistrojnë kandidatët e miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore sipas renditjes deri në plotësimin e kuotave për programet përkatëse të studimit.

3. Regjistrimi i kandidatit sipas pikës 2, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarisë mësimore në datat 19-20 tetor 2018, nëpërmjet dokumentacionit të përcaktuar në këtë udhëzim.

4. Sekretaritë mësimore do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë aplikantët fitues që dëshirojnë të regjistrohen vetëm në një program studimi. Pas marrjes së dokumentacionit nga aplikanti dhe regjistrimit të tij, sekretaria bën regjistrimin online në portalin U-Albania. Aplikantët dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja;

b) Fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar në MASR;

c) Deklaratën e paraqitur në shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjëses së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë.

5. Sekretaritë mësimore të fakulteteve të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të aplikantit kryhet regjistrimi

online në portalin U-Albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretarja firmoset në dy kopje formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit.

6. Brenda datës 29 tetor 2018, RASH-ja dhe IAL-të përcjellin në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të tretë në format elektronik dhe hardcopy.

7. Aplikantët, të cilët kanë bërë regjistrimin me dokumentacion dhe kanë nënshkruar në regjistër, nuk kanë të drejtë të ndryshojnë programin e studimit, për këtë vit akademik.
8. Kandidatët që nuk kanë arritur të aplikojnë në tre raundet (përfshirë këtu edhe ata që nuk kanë plotësuar formularin A1/A1Z), si dhe respektojnë kriterin e notës mesatare sipas vendimit nr. 216, datë 20.04.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019", vijojnë me procedurat e regjistrimit pranë IAL-ve, jashtë portalit U-Albania.

9. Kandidatët aplikojnë pranë IAL-ve, në periudhën 29 tetor deri më 02 nëntor 2018.

10. IAL-të vijojnë me regjistrimin e kandidatëve deri në plotësimin e kuotave për programin përkatës të studimit.
11. Regjistrimi i kandidatëve (që paraqiten personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij) kryhet pranë sekretarive mësimore në datat 05 nëntor deri më 07 nëntor 2018, sipas dokumentacionit të përcaktuar në këtë udhëzim.

12. Aplikantët dorëzojnë (personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre), dokumentacionin e mëposhtëm:
    a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja.

    b) Fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar.

    c) Deklaratën e paraqitur në shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjëses së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë.

13. Sekretaritë mësimore të fakulteteve të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretarja firmoset në dy kopje formulari i regjistrimit, një prej të cilave i jepet aplikantit.

14. Institucionet e Arsimit të Lartë për arsye të numrit të ulët të studentëve të regjistruar në programe studimi të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, për vitin akademik 2018-2019, me vendim të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit ndërpresin regjistrimin e mëtejshëm të studentëve në këto programe studimi. Studentët që janë regjistruar në ciklin e parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, për vitin akademik 2018-2019, në programet e studimit që është ndërprerë regjistrimi me vendim të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit, kanë të drejtë të transferojnë studimet brenda të njëjtit institucion të arsimit të lartë, në programe studimi të ngjashme.

15. Brenda datës 16 nëntor 2018, IAL-të përcjellin në QSHA regjistrimet përfundimtare në format elektronik dhe *hardcopy*.".

KREU IV/1

Procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018 – 2019.

1. Kandidatët që kërkojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019, kanë të drejtë të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, nga data 3 shtator 2018 deri në datën 14 shtator 2018.

2. Kandidatët që aplikojnë në IAL, për program të dytë studimi apo transferim studimesh kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 programe studimi përpara fillimit të vitit akademik dhe sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi apo për transferim studimesh të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin nr. 216, datë 20.04.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019", si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.

4. Kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar si program i dytë apo për transferim studimesh në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM-në e sipërcituar.

5. Nuk mund të pranohen aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Kandidatët që aplikojnë për transferim të studimeve apo për program të dytë studimi duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit për të cilët aplikojnë.

6. Aplikimi për transferim studimesh, mund të bëhet nga një program studimi i njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtit cikël edhe lloj, të ndjekur nga kandidati në IAL-të publike ose në IAL-të jopublike të licencuara dhe të akredituara për programin përkatës të studimit, vendase apo të huaja.

7. Nuk kanë të drejtë të aplikojnë për transferim studimesh ish studentët e institucioneve të arsimit të lartë të mbyllura me Vendimin nr. 539, datë 06.08.2014 të Këshillit të Ministrave "Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë" dhe të institucioneve të arsimit të lartë që nuk u hoq masa e pezullimit e dhënë nga Vendimi nr. 540, datë 06.08.2014, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e veprimtarisë së disa institucioneve private të arsimit të lartë".

Kanë të drejtë të aplikojnë për transferim studimesh, vetëm për vitin akademik 2018 – 2019, ish studentët e shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë, të mbyllur me Vendimin nr. 70, datë 7.2.2018 të Këshillit të Ministrave "Për mbylljen e veprimtarisë së shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë.

8. Nuk mund të kryhen transferime studimesh nga një nivel cikli studimesh apo të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve në një tjetër. Në këtë kuadër nuk mund të kryhen transferime studimesh nga programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional në programe të ciklit të parë "Bachelor" dhe programet të integruara të studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave".

9. Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë për transferim të studimeve, paraqesin, pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve, dokumentet si më poshtë:
   a. Kërkesa drejtuar IAL–së për programin e studimit, në të cilin do të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit sipas shtojcës nr.7);
   b. Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse;
   c. Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do te shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur. Studentët që transferojnë studimet e tyre nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse dhe listën e notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, duhet t'i dorëzojnë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin;
   d. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës se mesme dhe të vërtetuar në Drejtorinë Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës se mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;
   e. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); f. Dy fotografi personale.
   g. Kopje e mandatë-pagesës.

10. Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në IAL (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet dhe dokumentin origjinal të çregjistrimit për qëllim transferimi, nga IAL nga ku transferohet, i cili përmban:
    i. Emri, Atësia, Mbiemri;
    ii. Datëlindja: iii. Vendlindja;
    iv. Shtetësia:
    v. Numri i matrikullimit që ka pasur në IAL – në përcjellëse;
    vi. Emri i shkollës së mesme / IAL-së së kryer përpara ndjekjes së këtij programi studimi;
    vii. ID e Maturës Shtetërore / nr. Regj. të veçantë[73];
    viii. Numri personal i identitetit;
    ix. Data e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL - ja;
    x. Emërtimi i programit të studimit dhe Fakulteti përkatës;
    xi. Cikli dhe forma e studimit;
    xii. Data e ndërprerjes së studimeve.

[73] *Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme para vitit 2006*

11. Kandidati që aplikon për program të dytë studimi paraqet dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve:
    a. Kërkesa drejtuar IAL–së për programin e studimit, në të cilin aplikon për program të dytë studimi (formulari i aplikimit sipas shtojcës 7);
    b. Kopje e noterizuar e diplomës së studimeve universitare të kryera më parë, të shoqëruar me suplementin e diplomës;

    c. Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse);
    d. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës se mesme dhe të vërtetuar në Drejtorinë Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës se mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;
    e. Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); f. Dy fotografi personale.

Njohja e dokumentacionit të kandidatëve shtetas të huaj fitues, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.

12. IAL shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës 17 shtator 2018.

13. Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës 24 shtator 2018. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kritereve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e Fakultetit të IAL-së, si dhe faqet ëeb përkatëse, e plotësuar sipas Tabelave nr. 1a dhe 1b të parashikuara në Shtojcën nr. 8 të këtij udhëzimi.

    IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës 25 shtator 2018. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

14. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

15. IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet ëeb zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 03 tetor 2018.

    Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore nga data 06 tetor 2018 deri më datë 12 tetor 2018 sipas dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës 18 tetor 2018.

16. IAL-të brenda datës 12 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format EXCEL me qëllim

pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL - ja çregjistrimin tyre.

17. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas Shtojcës nr.2 të këtij Udhëzimi."

Kreu IV/2

Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018 – 2019.

1. Kandidatët nga republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL), nga data 10 - 24 Gusht 2018, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL.

2. Kandidatët që aplikojnë në programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimi, aplikojnë pranë IAL-ve respektive, deri më datë 24 Gusht 2018. Në të njëjtën datë, IAL-të shpallin listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në konkurs, e cila bëhet publike në mjediset e IAL-ve dhe faqet elektronike zyrtare. Konkurset e pranimit zhvillohen në datën 27 gusht 2018.

3. Aplikimi të kryhet vetëm nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotësojnë kriterin e mesatares të përcaktuar në Vendimin nr. 216, datë 20.04.2018, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019", si dhe plotësojnë kriteret shtesë të pranimit të vendosura nga vetë IAL-të për programet e studimit për të cilët aplikojnë. Përjashtohen nga kriteri i notës mesatare kandidatët që aplikojnë për ndjekjen e programeve të studimit me karakter profesional.

4. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.

5. Kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, përpara aplikimit, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilit aplikon.

6. Aplikimi për programet e studimit në IAL dërgohet me postë pranë sekretarive mësimore ose depozitohet në zyrën e protokollit të njësive kryesore të IAL-ve.

7. Sekretaritë mësimore mbajnë regjistër për aplikimet e depozituara. Me depozitimin e aplikimit, njësitë kryesore përllogaritin mesataren për çdo kandidat në përputhje me vendimin nr. 216, datë 20.04.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019". Për kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare njoftohen zyrtarisht nga sekretaritë mësimore për ndërprerjen e aplikimit.

8. Kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, në momentin e aplikimit duhet te dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

   a) Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja:
      i. Formulari i aplikimit sipas formatit të Shtojcës nr. 3.
      ii. Kopje të dokumentit të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që vërteton se diploma e arsimit të mesëm është njohur, të shoqëruar me fotokopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave.
      iii. Në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-së, deklaratën bashkëlidhur këtij udhëzimi (Shtojca nr. 5) si dhe kopje të noterizuar në Republikën e Shqipërisë (dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nëse është lëshuar në gjuhë të huaj), të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet. Përllogaritja e notave do të kryhet sipas Udhëzimit nr. 44, datë 21.08.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit", i ndryshuar. Në rast se kandidati/ja ka përfunduar shkollën e mesme në Shqipëri, dorëzon kopje të noterizuar të Maturës Shtetërore; iv. Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;
      v. Dy fotografi;
      vi. Kopje e mandat – pagesës.

   b) Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian:
      i. Formulari i aplikimit sipas formatit të Shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij Udhëzimi.
      ii. Kopje të diplomës/Dëftesës dhe listës së notave. iii. Në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-së, deklaratën bashkëlidhur këtij udhëzimi (Shtojca nr. 5) si dhe kopje të njësuar me origjinalin të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë kopje të njësuar me origjinalin e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)dhe dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në njësinë arsimore vendore (Drejtorinë Arsimore Rajonale /Zyra Arsimore) përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit.

iv. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).
v. Dy fotografi personale. vi. Kopje e mandat-pagesës.

c) Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8 të këtij Kreu duhet të dorëzojnë edhe kopje të librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje e njësuar me origjinalin e vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

d) Kandidatët me statusin e jetimit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8 të këtij Kreu duhet të dorëzojnë edhe kopje të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

e) Kandidatët nga komuniteti Romë dhe Egjiptian, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8 të këtij Kreu duhet të dorëzojnë edhe Vetë deklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano – egjiptian. Për përzgjedhjen e kandidatëve romë dhe egjiptianë, IAL-të marrin edhe ekspertizën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

f) Në rastet e aplikimeve nga kandidatët nga kategori të tjera të personave me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8.b duhet të dorëzojnë dhe kopje të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

Njohja e dokumentacionit të kandidateve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.

9. IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kritereve të përcaktuara nga ana e tyre. IAl-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të në datë 5 Shtator 2018 publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre zyrtare të internetit listën jo përfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

10. Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit brenda tre ditëve kalendarike nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim te argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

11. IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën 12 Shtator 2018, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

12. Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës 19 shtator 2018.

13. Pas datës 19 shtator 2018, sekretaritë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë zyrtarisht kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.

14. IAL-të brenda datës 06 tetor 2018 përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit.

15. IAL-të brenda datës 12 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre."

Kreu IV/3

Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve shtetas të huaj, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018 – 2019

1. Të gjithë kandidatët shtetas të huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL), nga data 20 - 30 Gusht 2018, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL.

2. Kandidatët shtetas të huaj duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe të jenë të pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor, nuk duhet të rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi në IAL-te publike dhe/ose jopublike, të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të larte, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.

3. Kandidatët shtetas të huaj, përpara aplikimit kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilit aplikon. Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

4. Kandidatët shtetas të huaj që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në Vendimin Nr. 216, datë 20.04.2018 të Këshillit të Ministrave.

5. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.

6. Studentët e huaj duhet të paraqesin pranë IAL-ve dokumentet e mëposhtme:
    a. Formuarin e aplikimit sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
    b. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).
    c. Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhen shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe.
    d. Dy fotografi personale.
    e. Kopje e mandat-pagesës.
    f. Autorizimin për trajtimin e të dhënave personale sipas shtojcës nr.5 bashkëlidhur këtij Udhëzimi.

7. IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kritereve të përcaktuara nga ana e tyre. IAl-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të në datë 4 Shtator 2018 publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre zyrtare të internetit listën jo përfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

8. Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit brenda tre ditëve kalendarike nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim te argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

9. IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën 12 Shtator 2018, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.
10. Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës 19 shtator 2018. Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të heqë dorë për tu regjistruar në një program tjetër studimi.

11. Pas datës 19 shtator 2018, sekretaritë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.

12. IAL-të brenda datës 06 tetor 2018 përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues.

13. Sekretaritë mësimore të IAL-ve do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit.

14. Procedurat e regjistrimit për programet e përbashkëta të ciklit të parë dhe të dytë të integruar:

a. Zhvillimi i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, të kandidatëve me diploma të huaja të shkollës së mesme, në programet e studimit objekt të këtij udhëzimi, në IAL-të që i zhvillojnë këto programe, si programe të përbashkëta studimi, që përfundojnë me një diplome të përbashkët, të dyfishte ose të shumëfishtë, në bashkëpunim me IAL te vendeve të BE-se, kryhet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuar nga vetë IAL-të.

b. Njohja e dokumentacionit të kandidatëve të pajisur me diploma të huaja të shkollës së mesme, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen pajisjen e tyre me NIM dhe brenda muajit janar 2019 ia komunikon zyrtarisht IAL-së”.”

c. Kandidatët që aplikojnë në programet e përbashkëta të studimit e paraqesin aplikimin e tyre pranë IAL-se përkatëse. Të dhënat e tyre i dërgohen QSHA-së nga IAL-ja në përfundim të procesit të regjistrimit të aplikimeve. Pas zhvillimit te konkurseve/testimeve të pranimit, IAL-ja i dërgon QSHA-së listat e fituesve dhe të dhënat e tyre, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të nevojshëm për zhvillimin e procedurave te njohjes së diplomës.

d. Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm në institucione arsimore në të njëjtën gjuhë të huaj që zhvillohet edhe programi i përbashkët i integruar i studimit i ciklit të dyte i IALsë ku aplikon, përjashtohen nga detyrimi i mbrojtjes së kësaj gjuhe sipas përcaktimeve të nenit 76, pika 4 te ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

e. Sekretaritë mësimore të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër; nuk ka të drejte të ndryshoje programin e studimit, për atë vit akademik.

f. IAL-të brenda datës 12 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre."

"KREU IV/4

PRANIMET NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I SHKENCAVE"/"MASTER I ARTEVE"

1 Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IAL-të publike deri në datën 12 Tetor 2018 dhe në IAL-të jopublike deri në datën 19 Tetor 2018.

2 Brenda datës 22 Tetor 2018, IAL-të publike dhe brenda datës 29 Tetor 2018 IAL-të jopublike të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet ëeb të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.

3 Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

4 Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së publike deri në datën 30 Tetor 2018, dhe deri në datën 06.11.2018, pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së jopublike.

5 IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj ëeb, listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 1 Nëntor 2018 për IAL-të publike dhe 08 Nëntor 2018 për IAL-të jopublike.

6 Njësitë kryesore të IAL–ve, organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë dhe verifikimin e dokumentacionit të pranimit sipas kuadrit ligjor në fuqi. Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.

7 Pranimi, në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/”Master i arteve të bukura”, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018 – 2019, sipas kuotave respektive të deklaruara nga IAL-të, realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga IAL-të, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kritereve të përcaktuara paraprakisht dhe të bëra publike paraprakisht.

8 Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë, kandidatët që:
   a. kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose
   b. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njësimin e diplomës pranë MASR/QSHA brenda muajit dhjetor 2018.

9 Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:
   a. Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.
   b. Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).
      Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave;
   c. Formulari i aplikimit (sipas formatit të Shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij Udhëzimi);
   d. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); e. Dy fotografi personale.

10 Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:
   a. Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit te Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.
      Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.
   b. Curriculum Vitae;
   c. Deklaratën sipas Shtojcës nr. 5 të këtij udhëzimi.

11 Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:
   a. Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).
   b. Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.
   c. Kandidati nga komuniteti Rom dhe Ballkano-Egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është Rom apo Ballkano-Egjiptian.

12 Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (Statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.

13 Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë Udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

14 Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA pas verifikimit i kërkon IALve ta çregjistrojë atë.

15 IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshëm për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

16 IAL-të brenda datës 19 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

17 Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas Shtojcës nr.5 të këtij Udhëzimi."

"KREU IV/5

PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR TRANSFERIM TË STUDIMEVE DHE PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI, NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2018 – 2019

1. Kandidatët që kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve kanë të drejtë të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, nga data 7 shtator 2018 deri në datën 19 shtator 2018.

2. Kandidatët që aplikojnë në IAL, për program të dytë studimi apo transferim studimesh kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 programe studimi përpara fillimit të vitit akademik dhe sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë për program të dytë studimi, kandidatët që:
   a. kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë "Bachelor", apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, i cili rezulton i akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose,
   b. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor", ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MASR/QSHA.

4. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë për transferim studimesh të gjithë kandidatët që:
   a. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në
   Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në germën "a" të pikës 3 të këtij kreu, në një program të ciklit të parë "Bachelor", apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë brenda ose jashtë vendit të akredituar në momentin e transferimit;
   b. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor", apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, kanë kryer njësimin e diplomës pranë MASR/QSHA, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë të akredituar në momentin e transferimit brenda ose jashtë vendit.

5. Transferimi i studimeve në ciklin e dytë mund të bëhet në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtit cikël dhe lloj sipas kritereve të vendosura dhe shpallura publikisht paraprakisht nga IAL.

6. IAL-të nuk mund të pranojnë aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Transferimi i studimeve do të kryhet në zbatim të procedurave dhe afateve të parashikuara në këtë udhëzim.

7. Kandidati që aplikon për program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:
   a. Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.
   b. Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr.

876, datë 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).

Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave.

c. Formulari i aplikimit (sipas formatit të Shtojcës nr. 9, bashkëlidhur këtij Udhëzimi);
d. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); e. Dy fotografi personale.

8. Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:
   a. Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit te Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.
   b. Curriculum Vitae;
   c. Deklaratën sipas Shtojcës nr.5 të këtij udhëzimi.

9. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh:
   a. Kërkesën drejtuar institucionit të arsimit të lartë (IAL) për programin e studimit, në të cilin kërkon të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit);
   b. Plani i plotë i programit të studimit nga ku transferohet;
   c. Vërtetim të listës së notave, krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer në ciklin e dytë të studimeve, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin eventual të lëndëve të programit të studimit të ndjekur, si dhe programeve/syllabuseve përkatëse të lëndëve të shlyera;

   Kandidati duhet të paraqesë në momentin e regjistrimit dhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:
   i. Emri, Atësia, Mbiemri;
   ii. Datëlindja;
   iii. Vendlindja;
   iv. Shtetësia;
   v. Numri i matrikullimit që ka pasur në programin e studimit të ciklit të parë;
   vi. Emërtimi i IAL-së dhe i programit të studimit të ciklit të parë, si dhe forma e studimit;
   vii. Numri i matrikullimit, si dhe emërtimi i programit të studimit të ciklit të dytë dhe fakultetit përkatës në IAL-në nga ku transferohet;
   viii. Cikli dhe forma e studimit;
   ix. Data e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja nga ku transferohet;
   x. Data e ndërprerjes së studimeve;

10. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi:
    a. Fotokopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë të diplomës universitare të ciklit të dytë të studimeve, së bashku me suplementin e diplomës ose listën e notave. Për diplomat e fituara jashtë vendit, duhet të dorëzojë dhe vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MASR/QSHA.

b. Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse, vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do te shërbejë për njohjen e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse, nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse.

11. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:
    a. Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).
    b. Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.
    c. Kandidati nga komuniteti Rom dhe Ballkano-Egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është Rom apo Ballkano-Egjiptian.

12. Studentët e pa diplomuar të ish shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia", e mbyllur me Vendimin nr. 70, datë 7.2.2018 të Këshillit të Ministrave "Për mbylljen e veprimtarisë së shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë", kanë të drejtë, vetëm në vitin akademik 2018 – 2019, të aplikojnë për transferim të studimeve të ndërprera në programe studimi të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtit cikël dhe lloj. Nuk mund të transferojnë studimet ata individë që kanë filluar studimet (regjistruar) përpara licencimit të programit respektiv të studimit ose nuk janë pajisur me numër matrikullimi nga Qendra Shërbimeve Arsimore (ish Agjencia Kombëtare e Provimeve), sipas kërkesës së SHLUJ "Justicia". IAL-të pritëse komunikojnë me shkrim me QSHA-në për çdo sqarim lidhur me këtë çështje.
    Dokumentacioni që do të dorëzojë është i parashikuar si për studentët e tjerë që aplikojnë për transferim studimesh.
    Pranimet do të kryhen brenda numrit të kuotave të përgjithshme të deklaruara për programin e studimeve në IAL-në ku aplikohet.

13. Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (Statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.

14. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë Udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

15. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA pas verifikimit i kërkon IAL-ve ta çregjistrojë atë.

16. IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshëm për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

17. Komisionet respektive kryejnë renditjen e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh apo program të dytë studimi bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, dhe

vlerëson kandidatët me statusin fitues/jo fitues. Këto të dhëna shpallen nga dekanati përkatës në ambientet e fakultetit dhe IAL-së, si dhe faqet ëeb përkatëse, të plotësuara sipas Tabelave nr. 1a dhe 1b të parashikuara në Shtojcën nr. 11 të këtij udhëzimi, respektivisht, për kandidatët që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe për kandidatët që kanë aplikuar për program të dytë studimi.

18. IAL shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës 21 shtator 2018.

19. Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës 01 tetor 2018. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kritereve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e Fakultetit të IAL-së, si dhe faqet ëeb përkatëse, e plotësuar sipas Tabelave nr. 1a dhe 1b të parashikuara në Shtojcën nr. 9 të këtij udhëzimi.
    IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës 3 tetor 2018. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

20. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

21. IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 10 tetor 2018.

22. Regjistrimi i kandidatit, i cili mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij, kryhet pranë sekretarive mësimore nga data 10 tetor 2018 deri më datë 13 tetor 2018. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës 18 tetor 2018.

23. IAL-të brenda datës 19 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

24. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas Shtojcës nr.5 të këtij Udhëzimi.”

KREU IV/6
PRANIMET NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE “MASTER EKZEKUTIV”

1 Aplikimet në programet e studimit të ciklit të tretë “Master ekzekutiv” me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IAL-të publike deri në datën 12 Tetor 2018 dhe në IAL-të jopublike deri në datën 19 Tetor 2018.

2 Brenda datës 22 Tetor 2018, IAL-të publike dhe brenda datës 29 Tetor 2018 IAL-të jopublike të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet ëeb të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.

3 Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

9 Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së publike deri në datën 30 Tetor 2018, dhe deri në datën 06.11.2018, pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së jopublike.

4 IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj ëeb, listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 06 Nëntor 2018 për IAL-të publike dhe 08 Nëntor 2018 për IAL-të private.

5 Njësitë kryesore të IAL–ve, organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë dhe verifikimin e dokumentacionit të pranimit sipas kuadrit ligjor në fuqi. Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.

6 Pranimi, në programet e studimit të ciklit të tretë, me kohë të plotë, "Master ekzekutiv", në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018 – 2019, sipas kuotave respektive të deklaruara nga IAL-të, realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga IAL-të, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kritereve të përcaktuara nga njësitë bazë, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë, të përcjella më parë QSHA-së e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe të bëra paraprakisht publike.

7 Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të tretë "Master ekzekutiv", kandidatët që:
   a. kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të dytë "Master i shkencave"/"Master i arteve", i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose
   b. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave"/"Master i arteve", i licencuar dhe akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njësimin e diplomës pranë MASR/QSHA brenda muajit dhjetor 2018.

9. Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:
   a. Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave"/"Master i arteve" të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave"/"Master i arteve" të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare të ciklit të tretë në vendin përkatës.
   b. Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve "Bachelor" të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të parë të studimeve "Bachelor" të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës

të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë.

c. Vërtetimin për njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Nëse aplikanti ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
d. Formulari i aplikimit (sipas formatit të Shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij Udhëzimi);
e. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); f. Dy fotografi personale.

10. Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:

a. Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit te Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.

   Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.
b. Curriculum Vitae;
c. Deklaratën sipas Shtojcës nr.5 të këtij udhëzimi.

11. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:

a. Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).
b. Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.
c. Kandidati nga komuniteti Rom / Ballkano-Egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është Rom apo Ballkano-Egjiptian.

12. Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi "Master ekzekutiv" me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (Statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.

13. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë Udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

14. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA pas verifikimit i kërkon IAL-ve ta çregjistrojë atë.

15. IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshëm për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për

sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

16. IAL-të brenda datës 19 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

17. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas Shtojcës nr.5 të këtij Udhëzimi."

KREU V

DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMIMI

1. Portali Matura Shtetërore online është sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të administrojë:

a) Procedurat e aplikimit me formularët A1 dhe A1Z të maturantëve/kandidatëve të Maturës Shtetërore 2018;

b) Digjitalizimin e rezultateve të këtyre provimeve;

c) Prodhimin e diplomës së maturës shtetërore.

2. Portali Maturanti është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të kryejë:

a) Procesin e regjistrimit dhe të administrimit të rezultateve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të maturantëve/kandidatëve, që kanë plotësuar formularin e aplikimit A1 ose A1Z në portalin Matura Shtetërore online;

b) Ndërveprimin me portalin U-Albania nëpërmjet përcjelljes në RASH të bazës së plotë të të dhënave të maturantëve/kandidatëve aplikues me formularët A1/A1Z;

c) Prodhimin e certifikatës së maturës shtetërore.

3. Portali U-Albania është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të kryejë procedurat e mëposhtme:

a) Informimin e maturantëve/kandidatëve për programet e studimit që ofrojnë IAL-të publike dhe jopublike për vitin akademik 2018-2019 dhe për çdo program, në mënyrë të detajuar: i) kriteret e pranimit; ii) kuotat e pranimit; iii) programet mësimore, kurrikulat etj.

b) Procesin e përzgjedhjes nga maturantët/ kandidatët të preferencave në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve dhe/ose programeve të studimeve me karakter profesional dhe/ose programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, të shpallura nga IAL-të (publike dhe jopublike) për vitin akademik 2018- 2019.

c) Përcjelljen IAL-ve të bazës së plotë të të dhënave të maturantëve/kandidatëve, që kanë përzgjedhur programet e studimit që këto IAL ofrojnë.

d) Procesin e shpalljes së listave renditëse të kandidateve në rang kombëtar sipas renditjes dhe përllogaritjes së pikëve nga IAL-të.

e) Procesin e regjistrimit dhe të çregjistrimit të studentëve në IAL-të publike dhe jopublike për ciklin e parë të studimeve dhe/ose programeve të studimeve me karakter profesional dhe/ose programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, të shpallura nga IAL-të (publike dhe jopublike) për vitin akademik 2018- 2019.

f) Sinkronizimin e regjistrimeve sipas çdo IAL-je në rang kombëtar dhe lëvizjen e vijës se kuqe.

g) Dhënien online të informacioneve të nevojshme për maturantët/kandidatët për ndjekjen në mënyrë dinamike, përgjatë raundit të parë dhe raundit të dytë, të procesit të shpalljes së fituesve.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE

1. Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian do të bëhet sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MASRsë.

2. Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve shtetas të huaj në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 20172018 do të bëhet sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MASR-së.

3. Aplikimi për program të dytë studimi dhe për transferimin e studimeve do të bëhet në institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MASR-së.

4. Aplikimi për programe të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë, si dhe programet specializues afatgjatë do të bëhen në institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të udhëzimeve të posaçme të MASR-së.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI

1. IAL-të të dorëzojnë në QSHA, në formë zyrtare dhe elektronike, brenda datës 30 nëntor 2018, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar për pajisjen e studentëve me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", si dhe deklaratën sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. QSHA-ja u dërgon IAL-ve, brenda datës 31.12.2018, numrat individualë të regjistrimit (matrikullimit) të studentëve të regjistruar.
2. Kandidatët e shpallur fitues në programet e të gjitha cikleve të studimit nuk mund të regjistrohen për të ndjekur njëkohësisht dy programe studimi në IAL-të publike dhe/ose jopublike, në të njëjtin vit akademik, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.

3. IAL-të të përpilojnë një raport të hollësishëm në lidhje me regjistrimet e studentëve në afatet dhe formatet e kërkuara sipas udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 5, datë 19.2.2018, "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë". Ky raport të dërgohet në MASR brenda datës 31 dhjetor 2018.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, DAR/ZA-të dhe IAL-të publike dhe jopublike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Lindita Nikolla

SHTOJCA NR. 1

DEKLARATË

Unë i nënshkruari , lindur më

emri, atësia, mbiemri me kartë

identiteti/pasaportë nr.

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendrën e Shërbimeve Arsimore dhe Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar për trajtimin e të dhënave të mia personale, në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu, institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

3. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.

4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm, se në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e

kontrollit të tyre, duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente. Emër, atësi, mbiemër i kandidatit Emër, atësi, mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma : Firma:

Vendi: Data: ____ . ____.

UDHËZIM

Nr.22, datë 20.06.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 21.5.2018 "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2018–2019"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.04.2018 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019",

UDHËZOJ:

1. Pika 4 e germës "B" e kreut II të Udhëzimit të MASR nr. 18, datë 21.5.2018, ndryshon si vijon:

   "4. Në datën 10 gusht 2018, IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi, afishojnë në mjediset e tyre dhe në faqet zyrtare elektronike përkatëse listat e aplikantëve. Në periudhën 11-27 gusht 2018 do të zhvillohen konkurset e pranimit."

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

UDHËZIM

Nr.26, datë 30.07.2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 21.05.2018 "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2018 -2019"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, dhe pikës 4 të nenit 9 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"

UDHËZOJ:

I. Titulli i Udhëzimit nr. 18, datë 21.05.2018 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018 -2019", ndryshon si më poshtë: *"Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2018 -2019".*

II. Pas Kreut IV të Udhëzimit, shtohet Kreu IV/1, si më poshtë:

"Kreu IV/1

Procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018 – 2019.

18. Kandidatët që kërkojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019, kanë të drejtë të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, nga data 3 shtator 2018 deri në datën 14 shtator 2018.

19. Kandidatët që aplikojnë në IAL, për program të dytë studimi apo transferim studimesh kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 programe studimi përpara fillimit të vitit akademik dhe sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

20. Kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi apo për transferim studimesh të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin nr. 216, datë 20.04.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019", si dhe të

plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.

21. *Kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar si program i dytë apo për transferim studimesh në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM-në e sipërcituar.*

22. *Nuk mund të pranohen aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Kandidatët që aplikojnë për transferim të studimeve apo për program të dytë studimi duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit për të cilët aplikojnë.*

23. *Aplikimi për transferim studimesh, mund të bëhet nga një program studimi i njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtit cikël edhe lloj, të ndjekur nga kandidati në IAL-të publike ose në IAL-të jopublike të licencuara dhe të akredituara për programin përkatës të studimit, vendase apo të huaja.*

24. *Nuk kanë të drejtë të aplikojnë për transferim studimesh ish studentët e institucioneve të arsimit të lartë të mbyllura me Vendimin nr. 539, datë 06.08.2014 të Këshillit të Ministrave "Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë" dhe të institucioneve të arsimit të lartë që nuk u hoq masa e pezullimit e dhënë nga Vendimi nr. 540, datë 06.08.2014, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e veprimtarisë së disa institucioneve private të arsimit të lartë".*
    Kanë të drejtë të aplikojnë për transferim studimesh, vetëm për vitin akademik 2018 – 2019, ish studentët e shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë, të mbyllur me Vendimin nr. 70, datë 7.2.2018 të Këshillit të Ministrave "Për mbylljen e veprimtarisë së shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë.

25. *Nuk mund të kryhen transferime studimesh nga një nivel cikli studimesh apo të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve në një tjetër. Në këtë kuadër nuk mund të kryhen transferime studimesh nga programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional në programe të ciklit të parë "Bachelor" dhe programet të integruara të studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave".*

26. *Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë për transferim të studimeve, paraqesin, pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve, dokumentet si më poshtë:*
    h. *Kërkesa drejtuar IAL–së për programin e studimit, në të cilin do të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit sipas shtojcës nr.7);*
    i. *Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse;*
    j. *Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do te shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur. Studentët që transferojnë studimet e tyre nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse dhe listën e notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, duhet t'i dorëzojnë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin;*
    k. *Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës se mesme dhe të vërtetuar në Drejtorinë Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës se mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;*
    l. *Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); m. Dy fotografi personale.*
    n. *Kopje e mandatë-pagesës.*

27. *Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në IAL (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet dhe dokumentin origjinal të çregjistrimit për qëllim transferimi, nga IAL nga ku transferohet, i cili përmban:*
    - *xiii. Emri, Atësia, Mbiemri;*
    - *xiv. Datëlindja:*
    - *xv. Vendlindja;*
    - *xvi. Shtetësia:*
    - *xvii. Numri i matrikullimit që ka pasur në IAL – në përcjellëse;*
    - *xviii. Emri i shkollës së mesme / IAL-së së kryer përpara ndjekjes së këtij programi studimi;*
    - *xix. ID e Maturës Shtetërore / nr. Regj. të veçantë[74];*
    - *xx. Numri personal i identitetit;*
    - *xxi. Data e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL - ja;*
    - *xxii. Emërtimi i programit të studimit dhe Fakulteti përkatës;*
    - *xxiii. Cikli dhe forma e studimit;*
    - *xxiv. Data e ndërprerjes së studimeve.*

28. *Kandidati që aplikon për program të dytë studimi paraqet dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve:*
    - g. *Kërkesa drejtuar IAL–së për programin e studimit, në të cilin aplikon për program të dytë studimi (formulari i aplikimit sipas shtojcës 7);*
    - h. *Kopje e noterizuar e diplomës së studimeve universitare të kryera më parë, të shoqëruar me suplementin e diplomës;*
    - i. *Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse);*
    - j. *Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës se mesme dhe të vërtetuar në Drejtorinë Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës se mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;*
    - k. *Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); l. Dy fotografi personale.*

Njohja e dokumentacionit të kandidatëve shtetas të huaj fitues, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.

29. *IAL shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës 17 shtator 2018.*

30. *Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës 24 shtator 2018. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe*

[74] *Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme para vitit 2006*

të kritereve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e Fakultetit të IAL-së, si dhe faqet ëeb përkatëse, e plotësuar sipas Tabelave nr. 1a dhe 1b të parashikuara në Shtojcën nr. 8 të këtij udhëzimi.

IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës 25 shtator 2018. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

31. *Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.*

32. *IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet ëeb zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 03 tetor 2018.*

Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore nga data 06 tetor 2018 deri më datë 12 tetor 2018 sipas dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës 18 tetor 2018.

33. *IAL-të brenda datës 12 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format EXCEL me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL - ja çregjistrimin tyre.*

34. *Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas Shtojcës nr.2 të këtij Udhëzimi."*

III. Pas Kreut IV/1 të Udhëzimit, shtohet Kreu IV/2, si më poshtë:

"Kreu IV/2

Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018 – 2019.

16. *Kandidatët nga republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL), nga data 10 - 24 Gusht 2018, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL.*

17. *Kandidatët që aplikojnë në programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimi, aplikojnë pranë IAL-ve respektive, deri më datë 24 Gusht 2018. Në të njëjtën datë, IAL-të shpallin listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në konkurs, e cila bëhet publike në mjediset e IAL-ve dhe faqet elektronike zyrtare. Konkurset e pranimit zhvillohen në datën 27 gusht 2018.*

18. *Aplikimi të kryhet vetëm nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotësojnë kriterin e mesatares të përcaktuar në Vendimin nr. 216, datë 20.04.2018, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019", si dhe plotësojnë kriteret shtesë të pranimit të vendosura nga vetë IAL-të për programet e studimit për të cilët aplikojnë. Përjashtohen nga kriteri i notës mesatare kandidatët që aplikojnë për ndjekjen e programeve të studimit me karakter profesional.*

19. *Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.*

20. *Kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, përpara aplikimit, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilit aplikon.*

21. *Aplikimi për programet e studimit në IAL dërgohet me postë pranë sekretarive mësimore ose depozitohet në zyrën e protokollit të njësive kryesore të IAL-ve.*

22. *Sekretaritë mësimore mbajnë regjistër për aplikimet e depozituara. Me depozitimin e aplikimit, njësitë kryesore përllogaritin mesataren për çdo kandidat në përputhje me vendimin nr. 216, datë 20.04.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019". Për kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare njoftohen zyrtarisht nga sekretaritë mësimore për ndërprerjen e aplikimit.*

23. *Kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, në momentin e aplikimit duhet te dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:*

g) Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja: vii. Formulari i aplikimit sipas formatit të Shtojcës nr. 3.

viii. Kopje të dokumentit të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që vërteton se diploma e arsimit të mesëm është njohur, të shoqëruar me fotokopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave.

ix. Në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-së, deklaratën bashkëlidhur këtij udhëzimi (Shtojca nr. 5) si dhe kopje të noterizuar në Republikën e Shqipërisë (dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nëse është lëshuar në gjuhë të huaj), të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet. Përllogaritja e notave do të kryhet sipas Udhëzimit nr. 44, datë 21.08.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit", i ndryshuar. Në rast se kandidati/ja ka përfunduar shkollën e mesme në Shqipëri, dorëzon kopje të noterizuar të Maturës Shtetërore;

x. *Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;*
xi. *Dy fotografi;*
xii. *Kopje e mandat – pagesës.*

i) *Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian:*

vii. Formulari i aplikimit sipas formatit të Shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij Udhëzimi. viii. Kopje të diplomës/Dëftesës dhe listës së notave. ix. Në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-së, deklaratën bashkëlidhur këtij udhëzimi (Shtojca nr. 5) si dhe kopje të njësuar me origjinalin të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë kopje të njësuar me origjinalin e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)dhe dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në njësinë arsimore vendore (Drejtorinë Arsimore Rajonale /Zyra Arsimore) përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit.

x. *Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).*
xi. *Dy fotografi personale.*
xii. *Kopje e mandat-pagesës.*

j) *Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8 të këtij Kreu duhet të dorëzojnë edhe kopje të librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje e njësuar me origjinalin e vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).*

k) *Kandidatët me statusin e jetimit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8 të këtij Kreu duhet të dorëzojnë edhe kopje të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.*

l) *Kandidatët nga komuniteti Romë dhe Egjiptian, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8 të këtij Kreu duhet të dorëzojnë edhe Vetë deklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano – egjiptian. Për përzgjedhjen e kandidatëve romë dhe egjiptianë, IAL-të marrin edhe ekspertizën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*

m) *Në rastet e aplikimeve nga kandidatët nga kategori të tjera të personave me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8.b duhet të dorëzojnë dhe kopje të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).*

Njohja e dokumentacionit të kandidateve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.

24. *IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kritereve të përcaktuara nga ana e tyre. IAl-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të në datë 5 Shtator 2018 publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre zyrtare të internetit listën jo përfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.*

25. *Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit brenda tre ditëve kalendarike nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim te argumentuar lidhur me ankimimin*

brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

26. *IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën 12 Shtator 2018, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.*

27. *Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës 19 shtator 2018.*

28. *Pas datës 19 shtator 2018, sekretaritë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë zyrtarisht kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.*

29. *IAL-të brenda datës 06 tetor 2018 përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit.*

30. *IAL-të brenda datës 12 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre."*

IV. Pas Kreut IV/2 të Udhëzimit, shtohet Kreu IV/3, si më poshtë:

"Kreu IV/3

Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve shtetas të huaj, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018 – 2019

15. *Të gjithë kandidatët shtetas të huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL), nga data 20 - 30 Gusht 2018, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL.*

16. *Kandidatët shtetas të huaj duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe të jenë të pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor, nuk duhet të rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi në IAL-te publike dhe/ose jopublike, të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të larte, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.*

17. *Kandidatët shtetas të huaj, përpara aplikimit kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilit aplikon. Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.*

18. *Kandidatët shtetas të huaj që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në Vendimin Nr. 216, datë 20.04.2018 të Këshillit të Ministrave.*

19. *Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.*

20. *Studentët e huaj duhet të paraqesin pranë IAL-ve dokumentet e mëposhtme:*
    g. *Formuarin e aplikimit sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.*
    h. *Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).*
    i. *Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhen shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe.*
    j. *Dy fotografi personale.*
    k. *Kopje e mandat-pagesës.*
    l. *Autorizimin për trajtimin e të dhënave personale sipas shtojcës nr.5 bashkëlidhur këtij Udhëzimi.*

21. *IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kritereve të përcaktuara nga ana e tyre. IAl-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të në datë 4 Shtator 2018 publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre zyrtare të internetit listën jo përfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.*

22. *Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit brenda tre ditëve kalendarike nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim te argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.*

23. *IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën 12 Shtator 2018, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.*
24. *Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës 19 shtator 2018. Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të heqë dorë për tu regjistruar në një program tjetër studimi.*

25. *Pas datës 19 shtator 2018, sekretaritë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.*

26. *IAL-të brenda datës 06 tetor 2018 përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues.*

27. *Sekretaritë mësimore të IAL-ve do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit.*

28. *Procedurat e regjistrimit për programet e përbashkëta të ciklit të parë dhe të dytë të integruar:*
    a. *Zhvillimi i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimit objekt të këtij udhëzimi, në IAL-të që i zhvillojnë këto programe, si programe të përbashkëta studimi, që përfundojnë me një diplome të përbashkët, të dyfishte ose të shumëfishtë, në*

bashkëpunim me IAL te vendeve të BE-se, kryhet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuar nga vetë IAL-të.

b. *Njohja e dokumentacionit të kandidateve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA kryen pajisjen e tyre me NiM dhe brenda datës 26 janar 2018 ja komunikon zyrtarisht IAL-së".*

c. *Kandidatët që aplikojnë në programet e përbashkëta të studimit e paraqesin aplikimin e tyre pranë IAL-se përkatëse. Të dhënat e tyre i dërgohen QSHA-së nga IAL-ja në përfundim të procesit të regjistrimit të aplikimeve. Pas zhvillimit te konkurseve/testimeve të pranimit, IAL-ja i dërgon QSHA-së listat e fituesve dhe të dhënat e tyre, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të nevojshëm për zhvillimin e procedurave te njohjes së diplomës.*

d. *Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm në institucione arsimore në të njëjtën gjuhë të huaj që zhvillohet edhe programi i përbashkët i integruar i studimit i ciklit të dyte i IAL-së ku aplikon, përjashtohen nga detyrimi i mbrojtjes së kësaj gjuhe sipas përcaktimeve të nenit 76, pika 4 te ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".*

e. *Sekretaritë mësimore të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër; nuk ka të drejte të ndryshoje programin e studimit, për atë vit akademik.*

f. *IAL-të brenda datës 12 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre."*

V. Pas Kreut IV/3 të Udhëzimit, shtohet Kreu IV/4, si më poshtë:

"Kreu IV/4

Pranimet në ciklin e dytë të studimeve "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve"

10 *Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IALtë publike deri në datën 12 Tetor 2018 dhe në IAL-të jopublike deri në datën 19 Tetor 2018.*

11 *Brenda datës 22 Tetor 2018, IAL-të publike dhe brenda datës 29 Tetor 2018 IAL-të jopublike të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet ëeb të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.*

12 *Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.*

13 *Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së publike deri në datën 30 Tetor 2018, dhe deri në datën 06.11.2018, pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së jopublike.*

14 *IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj ëeb, listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 1 Nëntor 2018 për IAL-të publike dhe 08 Nëntor 2018 për IAL-të jopublike.*

15 *Njësitë kryesore të IAL–ve, organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë dhe verifikimin e dokumentacionit të pranimit sipas kuadrit ligjor në fuqi. Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.*

16 *Pranimi, në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura", në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018 – 2019, sipas kuotave respektive të deklaruara nga IAL-të, realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga IAL-të, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kritereve të përcaktuara paraprakisht dhe të bëra publike paraprakisht.*

17 *Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë, kandidatët që:*
   c. *kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose*
   d. *janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njësimin e diplomës pranë MASR/QSHA brenda muajit dhjetor 2018.*

18 *Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:*
   f. *Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.*
   g. *Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).*
   Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave;

h. Formulari i aplikimit (sipas formatit të Shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij Udhëzimi);
i. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); j. Dy fotografi personale.

19 Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:
d. Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit te Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.
Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.
e. Curriculum Vitae;
f. Deklaratën sipas Shtojcës nr. 5 të këtij udhëzimi.

20 Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:
d. Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).
e. Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.
f. Kandidati nga komuniteti Rom dhe Ballkano-Egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është Rom apo Ballkano-Egjiptian.

21. Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (Statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.

22. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë Udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

23. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA pas verifikimit i kërkon IAL-ve ta çregjistrojë atë.

24. IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshëm për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

25. IAL-të brenda datës 19 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date

nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

26. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas Shtojcës nr.5 të këtij Udhëzimi."

VI. Pas Kreut IV/4 të Udhëzimit, shtohet Kreu IV/5, si më poshtë:

"Kreu IV/5

Procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018 – 2019

5. Kandidatët që kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve kanë të drejtë të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, nga data 7 shtator 2018 deri në datën 19 shtator 2018.

6. Kandidatët që aplikojnë në IAL, për program të dytë studimi apo transferim studimesh kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 programe studimi përpara fillimit të vitit akademik dhe sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

7. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë për program të dytë studimi, kandidatët që:

c. kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë "Bachelor", apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, i cili rezulton i akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose,

d. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor", ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë

MASR/QSHA.

8. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë për transferim studimesh të gjithë kandidatët që:

c. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në germën "a" të pikës 3 të këtij kreu, në një program të ciklit të parë "Bachelor", apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë brenda ose jashtë vendit të akreditуar në momentin e transferimit;

d. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor", apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, kanë kryer njësimin e diplomës pranë MASR/QSHA, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë të akreditуar në momentin e transferimit brenda ose jashtë vendit.

25. Transferimi i studimeve në ciklin e dytë mund të bëhet në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtit cikël dhe lloj sipas kritereve të vendosura dhe shpallura publikisht paraprakisht nga IAL.

26. IAL-të nuk mund të pranojnë aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Transferimi i studimeve do të kryhet në zbatim të procedurave dhe afateve të parashikuara në këtë udhëzim.

27. *Kandidati që aplikon për program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:*
    f. Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.
    g. Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).
    Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave.
    h. Formulari i aplikimit (sipas formatit të Shtojcës nr. 9, bashkëlidhur këtij Udhëzimi);
    i. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); j. Dy fotografi personale.

28. *Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:*
    d. Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit te Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.
    e. Curriculum Vitae;
    f. Deklaratën sipas Shtojcës nr.5 të këtij udhëzimi.

29. *Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh:*
    d. Kërkesën drejtuar institucionit të arsimit të lartë (IAL) për programin e studimit, në të cilin kërkon të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit);
    e. Plani i plotë i programit të studimit nga ku transferohet;
    f. Vërtetim të listës së notave, krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer në ciklin e dytë të studimeve, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin eventual të lëndëve të programit të studimit të ndjekur, si dhe programeve/syllabuseve përkatëse të lëndëve të shlyera;

    Kandidati duhet të paraqesë në momentin e regjistrimit dhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban: xi. Emri, Atësia, Mbiemri;
    xii. Datëlindja;
    xiii. Vendlindja;
    xiv. Shtetësia;
    xv. Numri i matrikullimit që ka pasur në programin e studimit të ciklit të parë;

xvi. *Emërtimi i IAL-së dhe i programit të studimit të ciklit të parë, si dhe forma e studimit;*
xvii. *Numri i matrikullimit, si dhe emërtimi i programit të studimit të ciklit të dytë dhe fakultetit përkatës në IAL-në nga ku transferohet;*
xviii. *Cikli dhe forma e studimit;*
xix. *Data e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja nga ku transferohet;*
xx. *Data e ndërprerjes së studimeve;*

30. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi:

c. *Fotokopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë të diplomës universitare të ciklit të dytë të studimeve, së bashku me suplementin e diplomës ose listën e notave. Për diplomat e fituara jashtë vendit, duhet të dorëzojë dhe vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MASR/QSHA.*
d. *Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse, vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do te shërbejë për njohjen e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse, nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse.*

31. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:

d. *Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).*
e. *Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.*
f. *Kandidati nga komuniteti Rom dhe Ballkano-Egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është Rom apo Ballkano-Egjiptian.*

32. Studentët e pa diplomuar të ish shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia", e mbyllur me Vendimin nr. 70, datë 7.2.2018 të Këshillit të Ministrave "Për mbylljen e veprimtarisë së shkollës së lartë universitare, jopublike "Justicia", Tiranë", kanë të drejtë, vetëm në vitin akademik 2018 – 2019, të aplikojnë për transferim të studimeve të ndërprera në programe studimi të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtit cikël dhe lloj. Nuk mund të transferojnë studimet ata individë që kanë filluar studimet (regjistruar) përpara licencimit të programit respektiv të studimit ose nuk janë pajisur me numër matrikullimi nga Qendra Shërbimeve Arsimore (ish Agjencia Kombëtare e Provimeve), sipas kërkesës së SHLUJ "Justicia". IAL-të pritëse komunikojnë me shkrim me QSHA-në për çdo sqarim lidhur me këtë çështje.
Dokumentacioni që do të dorëzojë është i parashikuar si për studentët e tjerë që aplikojnë për transferim studimesh.
Pranimet do të kryhen brenda numrit të kuotave të përgjithshme të deklaruara për programin e studimeve në IAL-në ku aplikohet.

33. Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (Statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.

34. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë Udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

35. *Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA pas verifikimit i kërkon IAL-ve ta çregjistrojë atë.*

36. *IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshëm për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.*

37. *Komisionet respektive kryejnë renditjen e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh apo program të dytë studimi bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, dhe vlerëson kandidatët me statusin fitues/jo fitues. Këto të dhëna shpallen nga dekanati përkatës në ambientet e fakultetit dhe IAL-së, si dhe faqet ëeb përkatëse, të plotësuara sipas Tabelave nr. 1a dhe 1b të parashikuara në Shtojcën nr. 11 të këtij udhëzimi, respektivisht, për kandidatët që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe për kandidatët që kanë aplikuar për program të dytë studimi.*

38. *IAL shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës 21 shtator 2018.*

39. *Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës 01 tetor 2018. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kritereve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e Fakultetit të IAL-së, si dhe faqet ëeb përkatëse, e plotësuar sipas Tabelave nr. 1a dhe 1b të parashikuara në Shtojcën nr. 9 të këtij udhëzimi.*
    IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës 3 tetor 2018. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

40. *Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.*

41. *IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 10 tetor 2018.*

42. *Regjistrimi i kandidatit, i cili mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij, kryhet pranë sekretarive mësimore nga data 10 tetor 2018 deri më datë 13 tetor 2018. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës 18 tetor 2018.*

43. *IAL-të brenda datës 19 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.*

44. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas Shtojcës nr.5 të këtij Udhëzimi."

VII. Pas Kreut IV/5 të Udhëzimit, shtohet Kreu IV/6, si më poshtë:

"Kreu IV/6
Pranimet në ciklin e tretë të studimeve "Master ekzekutiv"

8 Aplikimet në programet e studimit të ciklit të tretë "Master ekzekutiv" me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IAL-të publike deri në datën 12 Tetor 2018 dhe në IAL-të jopublike deri në datën 19 Tetor 2018.

9 Brenda datës 22 Tetor 2018, IAL-të publike dhe brenda datës 29 Tetor 2018 IAL-të jopublike të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet ëeb të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.

10 Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

18 Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së publike deri në datën 30 Tetor 2018, dhe deri në datën 06.11.2018, pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-së jopublike.

11 IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj ëeb, listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datës 06 Nëntor 2018 për IAL-të publike dhe 08 Nëntor 2018 për IAL-të private.

12 Njësitë kryesore të IAL–ve, organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë dhe verifikimin e dokumentacionit të pranimit sipas kuadrit ligjor në fuqi. Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.

13 Pranimi, në programet e studimit të ciklit të tretë, me kohë të plotë, "Master ekzekutiv", në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018 – 2019, sipas kuotave respektive të deklaruara nga IAL-të, realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga IAL-të, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kritereve të përcaktuara nga njësitë bazë, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë, të përcjella më parë QSHA-së e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe të bëra paraprakisht publike.

14 Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të tretë "Master ekzekutiv", kandidatët që:

c. kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të dytë "Master i shkencave"/"Master i arteve", i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose

d. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave"/"Master i arteve", i licencuar dhe akredituar. Në rast pranimi kandidati

është i detyruar të kryejë njësimin e diplomës pranë MASR/QSHA brenda muajit dhjetor 2018.

9. Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

g. Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave"/"Master i arteve" të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave"/"Master i arteve" të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare të ciklit të tretë në vendin përkatës.

h. Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve "Bachelor" të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të parë të studimeve "Bachelor" të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë.

i. Vërtetimin për njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Nëse aplikanti ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

j. Formulari i aplikimit (sipas formatit të Shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij Udhëzimi);

k. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë); l. Dy fotografi personale.

10. Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:

d. Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit te Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.

Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

e. Curriculum Vitae;

f. Deklaratën sipas Shtojcës nr.5 të këtij udhëzimi.

11. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:

d. Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

e. Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

f. Kandidati nga komuniteti Rom / Ballkano-Egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është Rom apo Ballkano-Egjiptian.

12. Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi "Master ekzekutiv" me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (Statut dhe

rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.

13. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë Udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

14. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA pas verifikimit i kërkon IAL-ve ta çregjistrojë atë.

15. IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshëm për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

16. IAL-të brenda datës 19 nëntor 2018 dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

17. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas Shtojcës nr.5 të këtij Udhëzimi."

VIII. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, DAR/ZA-të, si dhe IAL-të, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

Shtojca nr. 2

Deklaratë

Unë i nënshkruari _____ , lindur më _____
emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

1. ***Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____ Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre.***
Autorizoj, gjithashtu institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e

Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. ***Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.***
3. ***Deklaroj se jam njohur me këtë udhëzim si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në të për të aplikuar për transferim studimesh/program të dytë studimi.***
4. ***Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.***
5. ***Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.***

_____	_____
Emër Atësi Mbiemër	***Emër Mbiemër***
i kandidatit	***i punonjësit të sekretarisë mësimore***
Firma	***Firma***

Vendi: _____ Data: ____ . ____. _____

Shtojca Nr. 3 *Tiranë, më ____/____/2018*

<u>Formular aplikimi</u>

Unë i nënshkruari _____ , lindur më _____
emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

e-mail: _____, Tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të parë / profesional / integruar i ciklit të dytë _____ në IAL _____.

1. *Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët*

a)me kombësi shqiptare nga trojet (të shënohet me "x" vendi nga vjen kandidati):

□ *Republika e Kosovës;*
□ *Mal i zi;*
□ *Maqedoni;*
□ *Preshevë;*
□ *Bujanovci;*
□ *Medvegja;*

b) e huaj

Me shtetësi _____
Gjuhë amtare_____
Me arsim të mesëm _____
Adresë aktuale _____

2. *Autorizoj institucionin e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.*
3. *Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në njërin nga programet e studimit në të cilin do të shpallem fitues për vitin akademik 2018-2019.*
4. *Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.*
5. *Deklaroj se jam njohur me Udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.*
6. *Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.*

Emër Atësi Mbiemër kandidatit

Firma

SHTOJCA nr. 4 *Tiranë, më ____/____/2018*

<u>Formular aplikimi</u>

Unë i nënshkruari _____ , lindur më _____
emri atësia mbiemri
me kartë identiteti/pasaportë nr. _____, e-mail_____ celular_____.

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit _____ në IAL _____.

1. *Deklaroj se jam (të shënohet me "x" kategoria):*
   □ PAK;
   □ jetim;
   □ Rom;
   □ Egjiptian.
2. *Autorizoj institucionet e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.*
3. *Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në njërin nga programet e studimit në të cilin do të shpallem fitues për vitin akademik 2018-2019.*
4. *Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.*
5. *Deklaroj se jam njohur me Udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.*
6. *Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të*

deklaruar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër kandidatit

Firma

SHTOJCA nr. 5

DEKLARATË

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____,
me kartë identiteti, pasaportë nr. _____,

1. Autorizoj Institucionin e Arsimit të Lartë _____, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu Institucionin e Arsimit të Lartë ku ka kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.
2. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në një nga programet e studimit në të cilin do të shpallem fitues, për vitin akademik 2018-2019.
3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.
4. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.
5. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

_____ _____
Emër, Atësi, Mbiemër i kandidatit *Emër, Atësi, Mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore*

Firma: *Firma:*

Vendi: _____ *Data: ____ . ____. _____*

SHTOJCA nr. 6

Tiranë, më ____/____/2018

Formular aplikimi

Unë i/e nënshkruari/a _____ , lindur më _____
emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____ e-mail: _____,
Tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të dytë / tretë:

□ ***Master profesional***
□ ***Master i shkencave/Master i arteve të bukura***
□ ***Master Ekzekutiv***

në _____, në IAL _____

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (vendosni një rreth mbi kategorinë përkatëse):

A. *Shtetas shqiptarë, brenda vendit*

B. *Kandidatë shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit (**të shënohet me "x" vendi nga vjen kandidati**):*

□ ***Republika e Kosovës;***
□ ***Mal i zi;***
□ ***Maqedoni;***
□ ***Preshevë;***
□ ***Bujanovci;***
□ ***Medvegja;***

C. *Nga kategoritë e veçanta **(PAK, të shënohet kategoria e veçantë të cilës i përket kandidati):***
_____.

D. *Shtetas i huaj*

Gjuha amtare_____. Shtetësia_____ Emri i universitetit _____

6. ***Deklaroj se jam njohur me parashikimet e Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për pranimet në vitin akademik 2018-2019 në ciklin përkatës të studimit.***
7. ***Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shtesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të IAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.***
8. ***Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.***
   Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Institucionin e Arsimit të lartë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.
9. ***Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.***

10. ***Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.***

_____	_____
Emër Atësi Mbiemër	***Emër Mbiemër***
i kandidatit	***i punonjësit që pranoi aplikimin***
Firma	***Firma***

SHTOJCA nr. *7* *Tiranë, më ____/____/2018*

Formular aplikimi

Unë i/e nënshkruari/a _____ , lindur më _____
emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____ e-mail: _____,
Tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit (vendosni një rreth):

□ ***me karakter profesional 2 – vjeçar***
□ ***ciklit të parë "Bachelor"***
□ ***integruar të ciklit të dytë "Master i shkencave"***
□ ***ciklit të dytë "Master profesional"***
□ ***ciklit të dytë "Master i shkencave" / "Master i arteve"***
□ ***ciklit të tretë "Master ekzekutiv"***

në _____, në IAL _____

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (vendosni një rreth mbi kategorinë përkatëse):

A. *Për program të dytë studimi*
B. *Për transferim studimesh*

1. ***Deklaroj se jam njohur me parashikimet e Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për pranimet në vitin akademik 2018-2019 në ciklin përkatës të studimit.***
2. ***Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shtesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të IAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.***
3. ***Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.***
4. ***Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Institucionin e Arsimit të lartë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.***
5. ***Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.***
6. ***Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.***

Emër Atësi Mbiemër	***Emër Mbiemër***
i kandidatit	***i punonjësit që pranoi aplikimin***
Firma	***Firma***

Shtojca nr. 8

Tabela 1a.Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

	Emër	*Atësi*	*Mbiemër*	*Datëlindje*	*Emërtimi i programit të studimit të kryer më parë dhe lloji (Bachelor, PICD)*	*IAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të studimit*	*Data e diplomimit në programin e parë të studimit*	*Emërtimi i programit të studimit ku aplikon për program të dytë dhe lloji Bachelor, PICD*	*Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati*	*Kreditet e njohura*	*Pikët e a* *Kriteri 1*
1											
2											
3											
....											

Tabela 1b.Të dhënat e të gjithë aplikantëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

nr.	*Emër*	*Atësi*	*Mbiemër*	*Datëlindje*	*Emërtimi programit të studimit nga transferohet dhe lloji*	*IAL ja nga transferohet*	*Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik 2015 2016*	*Kreditet ECTS) të grumbulluara*	*nga kandidati Emërtimi i programit të studimit nga*	*Viti i studimit ku* *transferohet*
1										
2										
3										
....										

SHTOJCA nr. 9

Tabela 1a. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

nr.	*Emër*	*Atësi*	*Mbiemër*	*Datëlindje*	*Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga*	*IAL ja nga transferohet*	*Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik 2015*	*Kreditet (ECTS) të e grumbulluara nga kandidati*	*Emërtimi i programit të studimit (Cikli*	*II) nga Viti i studimit ku transferohet*	*Kreditet e niohura*

Tabela 1b. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

nr.	*Emër*	*Atësi*	*Mbiemër*	*Datëlindje*	*Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) të kryer më parë dhe lloji*	*IAL ja ku ka përfunduar programin e*	*parë të studimit Data e diplomimit në programin e*	*parë të studimit Emërtimi t programit të studimit (Cikli II) ku aplikon për program të dytë dhe lloji*	*Viti i studimit ku mund të regjistrohet*	*kandidati Kreditet e niohura*
1										
2										
.....										

UDHËZIM

Nr. 29, datë 10.09.2018

PËR VEPRIMTARINË DHE NGARKESËN MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË *(Ndryshuar me udhëzimin nr. 36, datë 23.11.2018,udhëzimin nr.37, datë 04.12.2018)*

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 59, pika 8, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

UDHËZON:

I. VEPRIMTARIA QË KRYEN PERSO-NELI AKADEMIK NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i veprimtarisë dhe i ngarkesës së plotë mësimore vjetore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë (IAL).

2. Personeli akademik në IAL, ushtron veprimtarinë e tij sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, si dhe statutit dhe rregulloreve të IAL-së.

3. Veprimtaritë që kryen personeli akademik në IAL, janë:

a) Mësimdhënie;

b) Kërkimi shkencor ose artistik;

c) Kontribut institucional;

d) Kontribut profesional. 4. Mësimdhënia përfshin:

a) Veprimtarinë në auditor si vijon:

i. Leksione. ii.

Seminare.

iii. Lëndë speciale. iv.

Ushtrime.

v. Laboratorë. vi.

Projekte kursi. vii.

Detyrë kursi.

viii. Atelier. ix.

Praktika klinike.

x. Praktika profesionale artistike.

b) Veprimtari jashtë auditorit, në mbështetje të procesit mësimor si vijon:

i. Ndjekje dhe/ose drejtim i praktikës mësimore ose profesionale.

ii. Konsultime/këshillim studentësh. iii. Udhëheqje diplome të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë.

iv. Kontroll i dijeve (provime, kolokuiume). v. Përgatitje individuale.

vi. Ekspozitë, garë dhe shfaqje. vii. Recensë punimi diplome cikli i tretë i studimeve.

c) Kontributi në kërkimin shkencor dhe krijimtarinë artistike, përfshin:

i. Kërkim dhe/ose veprimtari krijuese.

ii. Pjesëmarrje në programe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, konferenca, seminare, kongrese, ëorkshop-e, krijimtari artistike në salla të indeksuara etj.

iii. Publikim monografish, artikujsh apo punimesh shkencore të natyrave të ndryshme në periodikë apo serial botimesh shkencore (joperiodike) me komitet shkencor vlerësues dhe drejtues.

d) Pjesëmarrje në borde revistash shkencore apo serial botimesh shkencore (joperiodike) apo veprimtari të tjera formuese të ciklit të tretë të studimit;

i. Udhëheqje në programe doktorale apo veprimtari të tjera formuese të ciklit të tretë të studimit etj.

ii. Përgatitja e projekteve dhe ndjekja e procesit të aplikimit në kuadër të thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

e) Kontributi institucional, përfshin veprimtaritë akademike dhe administrative në mbështetje të njësive bazë, njësive kryesore, institucionit dhe administratës publike, si vijon:

i. Hartimi programeve të studimit.

ii. Hartim i rregulloreve apo dokumenta-cioneve.

iii. Përgatitje botimesh universitare. iv. Pjesëmarrje në komisionet ad hoc.

v. Pjesëmarrje në veprimtarinë e organeve të njësisë bazë, njësisë kryesore dhe IAL-së.

f) Pjesëmarrje në grupe pune të ngritura nga institucione të administratës publike.

g) Kontributi profesional, përfshin:

i. Veprimtari për zhvillim dhe transferim teknologjie dhe/ose shërbime të tjera të lidhura me të;

ii. Ekspertizë; iii. Përhapje të njohurive shkencore e teknologjike në mbështetje të mësimdhënies;

iv. Angazhim si krijues artistik në lidhje me përfshirjen e studentëve.

h) Trajnim për transferime të teknologjisë, të shkencës dhe inovacionit në mësimdhënie;

j) Hartim projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare.

k) Angazhim si ekspert në grupe pune të ngritura me urdhër ministri apo Kryeministri, si dhe në nivel rajonal, bashkitë dhe qarqet administrative.

II. NGARKESA MËSIMORE VJETORE PËR PERSONELIN AKADEMIK NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

1. Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor brenda IAL është:

a) Kategoria profesor 140 orë në auditor;

b) Kategoria lektor 165 orë në auditor;

c) Asistent-lektor 195 orë në auditor.

Çdo orë e realizuar në auditor mbi këtë përcaktim është orë suplementare e cila përllogaritet sipas koeficientëve dhe paguhet e plotë nga IAL-të. Orët suplementare në auditor nuk mund të jenë më shumë se 200 orë. Në raste specifike me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe miratim të drejtuesit të njësisë kryesore, personeli akademik me kohë të plotë mund të mbulojë edhe 100 orë në auditor mbi limitin 200 orë.

Personeli akademik me kohë të plotë nëse kategorizohet me orientim kërkimor sipas procedurave të parashikuara nga IAL të cilat evidentojnë out-putin kërkimor të personelit akademik mund të ketë ulje të detyrimit të ngarkesës mësimore në auditor deri në 35% sipas përcaktimeve në aktet e brendshme të IAL-së. Orët suplementare në auditor për personelin akademik me orientim kërkimor nuk mund të jenë më shumë se 100 orë.

2. Personeli akademik me kohë të pjesshme mund të mbulojë ngarkesën vjetore në auditor:

a) Kategoria profesor 120 orë në auditor.

b) Kategoria lektor 120 orë në auditor.

c) Asistent-lektor 120 orë në auditor.

Personeli akademik me kohë të pjesshme nuk mund të ketë orë suplementare. Ky personel paguhet deri në ngarkesën maksimale të përcaktuar në auditor. Personeli akademik mund të përfshihet në veprimtari të tjera të cilat sipas përcaktimeve kanë kompensim financiar dhe nuk llogariten në limitet e orëve në auditore.

3. IAL-të mund të angazhojnë dhe personel akademik me kohë të pjesshme të dedikuar në veprimtari të kërkimit shkencor i cili nuk ka detyrim mësimdhënien, por që kontribuon në kërkimin shkencor sipas përcaktimeve në pikën 5 të këtij udhëzimi.

4. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, mund të përfshihet në grupet e punës për hartimin dhe aplikimin e projekteve të financuara nga programet e Bashkimit Evropian. Ngarkesa e paguar për përfshirjen në këto grupe pune është deri në 200 orë/projekte në vit (kjo ngarkesë nuk përfshihet në llogaritjet e orëve maksimale të pikës 8 të këtij udhëzimi). Për shkrimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian, grupit të punës i njihen deri në 350 orë, të cilat ndahen ndërmjet anëtarëve të grupit të punës, i cili është angazhuar për përgatitjen e projektit. Projekti përcakton si institucion menaxhues të tij, IAL-në për të cilën grupi i punës po angazhohet. Grupi i punës miratohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe kryesore. Orët certifikohen vetëm pasi projekti ka certifikim formal të dorëzimit dhe merren komentet për sa i përket cilësisë së projektit, në rast se ai nuk rezulton fitues ose kur projekti rezulton fitues.

5. Për autoritetet drejtuese të IAL-ve publike, mësimdhënia vjetore në auditor është:

a) Rektor 50 orë mësimor.
b) Zëvendësrektor 60 orë mësimore.
c) Dekan 70 orë mësimore.
d) Zëvendësdekan 90 orë mësimore.
e) Përgjegjës departamenti 90 orë mësimore.

6. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbajë në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë, të shpërndarë në dy semestra, ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrale, ose 3 lëndë vjetore.

7. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e një anëtari të personelit akademik me orientim kërkimorshkencor nuk mund të përmbajë në një vit akademik më shumë se 2 lëndë semestrale në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë, sipas përcaktimit të programeve të lëndës ose 2 lëndë vjetore.

8. Doktorantët me kohë të plotë dhe që frekuentojnë vitin e dytë ose të tretë të studimeve të doktoratës mund të angazhohen në aktivitete mësimdhënëse mbështetëse jashtë auditorit sipas përcaktimeve të pikave "i" dhe "ii", të pikës 4, germa "b", si dhe në aktivitetet kërkimore sipas përcaktimeve të pikës 5, me përjashtim të pikës 5, germa "d". Angazhimi i doktorantëve në aktivitetet mësimdhënëse të sipërcituara kryhet në kuadër të parashikimeve të programit përkatës të doktoratës nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të doktoratës dhe sipas nevojave të njësisë bazë dhe asaj kryesore.

9. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e një anëtari të personelit akademik mund të reduktohet me propozim të njësisë bazë, aprovim nga njësia kryesore dhe me miratim nga bordi administrimit në rastin e përfitimit të një burse studimi jo më pak se 1-mujore, si dhe në raste të veçanta të angazhimeve në kuadër të kontributit institucional.

10. Një orë mësimdhënie në auditor zgjat 50 minuta.

11. IAL-ja përcakton në rregulloret e brendshme politikat e shpërblimit sipas funksioneve që kryhen nga personeli akademik, personeli ndihmësakademik dhe ai administrativ. Këto politika miratohen nga bordi administrimit.

12. Elementet e veprimtarive jashtë auditorit në ndihmë të procesit mësimor në IAL-të publike, njehsohen në orë si vijon:

a) Provime/mbrojtje teze diplome: 0.4/0.5 orë/student.

b) Kontrolle të pjesshme të programuara të dijeve: 0.25 orë/student.

c) Udhëheqje teze diplome cikli I/II/III: 10/20/30 orë diplomë.

ç) Udhëheqje teze doktorate: 80 orë/vit.

d) Mbikëqyrje e projekteve të kursit 1 orë/ projekt. dh) Mbikëqyrje e detyrave të kursit 0.3 orë/ detyrë.

e) Ndjekje dhe/ose drejtim i praktikave mësimore ngarkesa e përllogaritur si më poshtë:

1 ditë pune në praktikë është 5-orëshe; praktika në terren dhe praktika mësimore profesionale, grupi mësimor duhet të jetë jo më i madh se 20 studentë;

1 orë ushtrime (mësime praktike) të moduleve/lëndëve sportive është 0.8 orë.

Për orët e ushtrimeve (mësime praktike) të moduleve/lëndëve në arte, grupi mësimor duhet të jetë jo më i madh se 15 studentë.

Për orët e ushtrimeve (mësime praktike) të moduleve/lëndëve sportive, që zhvillohen në terren sportiv, palestër grupi mësimor duhet të jetë jo më i madh se 18 studentë.

ë) Përgatitje shfaqjeje, ekspozitë, koncerte, garë: 10–30 orë/shfaqje.

f) Recensë teze diplome cikli I/II/III: 5/10/15 orë/recensë.

g) Oponencë teze doktorate: 25 orë/ oponencë.

gj) Pjesëmarrje në juri doktorate:

i. Kryetar 15 orë; ii.

Anëtar 10 orë.

h) Konsultime të programuara deri në 30 orë në vit.

i) Kolokuiume - 1 në semestër 0.15 orë/ student.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Çdo anëtar i personelit akademik i punësuar me kohë të plotë në IAL duhet të përmbushë detyrimet për kohën vjetore të punës prej 1536 orë.

2. Personeli akademik, i cili angazhohet në veprimtaritë e parashikuara në pikën 12, germat “c”, “ç”, “e”, “g” dhe “gj”, paguhet për ngarkesën e parashikuar si orë suplementare.

3. Çdo angazhim i personelit akademik në IAL, në veprimtari të pagueshme dhe që nuk është parashikuar dhe miratuar në buxhetin vjetor të IAL-së, duhet të marrë përpara ushtrimit të veprimtarisë miratimin e bordit të administrimit të IAL-së.

4. Personeli akademik angazhohet në veprimtari mësimdhënëse, kërkimore-shkencore, artistike krijuese apo veprimtari të tjera, sipas profilit të kualifikimit të tij akademik dhe kontratës së punës të lidhur me IAL-në.

5. Në institucionet jopublike të arsimit të lartë ngarkesa minimale përcaktohet nga vetë institucioni, ndërsa ngarkesa maksimale nuk mund të tejkalojë kohën e punës së përcaktuar në Kodin e Punës.

6. Udhëzimi nr. 20, datë 9.5.2008, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar, shfuqizohet.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, Agjencia Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 31, datë 13.09.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 21.5.2018 "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2018–2019", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, dhe pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"

UDHËZOJ:

1. Germat "a" dhe "b", të pikës 14, të kreut "Kreu IV/3", të udhëzimit nr. 18, datë 30.7.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ndryshojnë si më poshtë:

"a) Zhvillimi i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, të kandidatëve me diploma të huaja të shkollës së mesme, në programet e studimit objekt të këtij udhëzimi, në IAL-të që i zhvillojnë këto programe, si programe të përbashkëta studimi, që përfundojnë me një diplomë të përbashkët, të dyfishtë ose të shumëfishtë, në bashkëpunim me IAL-të e vendeve të BE-së, kryhet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuar nga vetë IAL-të.

"b) Njohja e dokumentacionit të kandidatëve të pajisur me diploma të huaja të shkollës së mesme, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen pajisjen e tyre me NIM dhe brenda muajit janar 2019 ia komunikon zyrtarisht IAL-së"."

2. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, DAR/ZA-të, si dhe IAL-të, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 32, datë 05.10.2018

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 21.5.2018, "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË VITIN AKADEMIK 2018–2019", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 18, datë 21.5.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të ndryshuar, pas pikës 1, të kreut IV, "Raundi i tretë", të shtohet pika 1/1, me përmbajtjen si më poshtë:

"1.1 Për maturantët që nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë dhe në raundin e dytë, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe respektojnë kriterin e notës mesatare, sipas vendimit nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, mund të bëhen pjesë e raundit të tretë, pasi të kenë aplikuar në portalin *U-Albania*, duke ndjekur procedurën e parashikuar në pikën 5, germa A, kreu III, të këtij udhëzimi. Kjo procedurë të kryhet brenda datës 18 tetor 2018, pasi të jetë kryer më parë konfirmimi në portalin *U-Albania* nga institucionet e arsimit të lartë, ku këta maturantë janë të interesuar të studiojnë.".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, njësitë arsimore vendore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Lindita Nikolla

UDHËZIM
Nr. 33, datë 23.10.2018

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 21.5.2018, "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË VITIN AKADEMIK 2018-2019", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr. 18, datë 21.5.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të ndryshuar, pas pikës 7, të kreut IV, "Raundi i tretë", shtohen pikat si më poshtë:

"8. Kandidatët që nuk kanë arritur të aplikojnë në tri raundet (përfshirë këtu edhe ata që nuk kanë plotësuar formularin A1/A1Z), si dhe të respektojnë kriterin e notës mesatare, sipas vendimit nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018—2019", vijojnë me procedurat e regjistrimit pranë IAL-ve, jashtë portalit *U-Albania*.

9. Kandidatët aplikojnë pranë IAL-ve, në periudhën 29 tetor deri më 2 nëntor 2018.
10. IAL-të të vijojnë me regjistrimin e kandidatëve deri në plotësimin e kuotave për programin përkatës të studimit.

II. Regjistrimi i kandidatëve (që paraqiten personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij) kryhet pranë sekretarive mësimore në datat 5 nëntor deri më 7 nëntor 2018, sipas dokumentacionit të përcaktuar në këtë udhëzim.

12. Aplikantët dorëzojnë (personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre), dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja.

b) Fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar.

c) Deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjëses së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë.

13. Sekretaritë mësimore të fakulteteve të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretarja firmoset në dy kopje formulari i regjistrimit, një prej të cilave i jepet aplikantit.
14. Institucionet e arsimit të lartë, për arsye të numrit të ulët të studentëve të regjistruar në programe studimi të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, për vitin akademik 2018—2019, me vendim të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit, ndërpresin regjistrimin e mëtejshëm të studentëve në këto programe studimi. Studentët që janë regjistruar në ciklin e parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, për vitin akademik 2018—2019, në programet e studimit që është ndërprerë regjistrimi me vendim të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit, kanë të drejtë të transferojnë studimet brenda të njëjtit institucion të arsimit të lartë, në programe studimi të ngjashme.
15. Brenda datës 16 nëntor 2018, IAL-të përcjellin në QSHA regjistrimet përfundimtare në format elektronik dhe *hardcopy*.".
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, njësitë arsimore vendore dhe institucionet e arsimit të lartë. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 36, datë 23.11.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 29, DATË 10.9.2018, "PËR VEPRIMTARINË DHE NGARKESËN MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 8 të nenit 59, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

UDHËZON:

1. Në kreun I të udhëzimit nr. 29, datë 10.9.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" , bëhet shtesa e mëposhtme:
a) pas nënpikës "vii", të shkronjës "b", të pikës 4, shtohet nënpika "viii", si vijon:
"viii. Ndjekja dhe/ose drejtimi i praktikës mësimore/profesionale mjekësore për të gjitha ciklet e studimeve, për kategorinë personel akademik me kohë të plotë".
2. Në kreun II bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, togfjalëshi “sipas koeficientëve”, hiqet.

b) Pika 3 ndryshon si vijon:

“3. IAL-të mund të angazhojnë dhe personel akademik me kohë të pjesshme të dedikuar në veprimtari të kërkimit shkencor, i cili nuk ka detyrim mësimdhënien, por që kontribuon në kërkimin shkencor, sipas përcaktimeve në shkronjën “c”, të pikës 4, të kreut I, të këtij udhëzimi.”.

c) Në pikën 4, hiqet fjalia “Kjo ngarkesë nuk përfshihet në llogaritjet e orëve maksimale të pikës 8 të këtij udhëzimi”.

d) Pika 6 të riformulohet si vijon:

“6. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë përmban 3 lëndë semestrale, në një vit akademik, në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë.”. e) Pas pikës 7, të shtohet pika “7.1” me këtë përmbajtje:

“7.1 Për personelin akademik me kohë të plotë në institut dhe qendër të kërkimit e zhvillimit, mësimdhënia vjetore do të jetë 20— 30% e orëve mësimore, përkatësisht, sipas përcaktimeve të pikës 1 të kreut II, të këtij udhëzimi. Ky personel aktivizohet si rregull në fusha që përputhen me misionin e tyre. Për nevoja të veçanta të kërkimit, për këtë personel akademik mund të planifikohet mësimdhënie vjetore më e pakët”. f) Pika 8 ndryshon si vijon:

“8. Doktorantët me kohë të plotë dhe që frekuentojnë vitin e dytë ose të tretë të studimeve të doktoratës mund të angazhohen në aktivitete mësimdhënëse mbështetëse jashtë auditorit sipas përcaktimeve të nënpikave “i” dhe “ii”, të shkronjës “b”, të pikës 4, të kreut I, si dhe në aktivitetet kërkimore sipas përcaktimeve të shkronjës “c”, të pikës 4, të kreut I. Angazhimi i doktorantëve në aktivitetet mësimdhënëse të sipërcituara kryhet në kuadër të parashikimeve të programit përkatës të doktoratës nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të doktoratës dhe sipas nevojave të njësisë bazë dhe asaj kryesore.”

g) Në pikën 12, në fund të shkronjës “e”, të shtohet:

“Ndjekja e 1 orë praktike klinike në mjekësi është 0.5 orë mësimore.

Praktikat mësimore/profesionale mjekësore për të gjitha ciklet e studimeve, të cilat drejtohen nga mbikëqyrës klinikë do të njësohen 12 orë me 1 orë mësimore.”. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË **Lindita Nikolla**

UDHËZIM

Nr. 37, datë 04.12.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 29, DATË 10.9.2018, "PËR VEPRIMTARINË DHE NGARKESËN MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 8 të nenit 59 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

UDHËZON:

Në kreun II, të udhëzimit nr. 29, datë 10.9.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime: a) Pika 6 riformulohet si vijon:
"6. Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë përmban deri në 3 (tri) lëndë në semestër, në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë.". b) Në pikën 12, në fund të shkronjës "e", të shtohet:

"Ndjekja e 1 orë praktike spitalore në shkenca mjekësore teknike është 0.5 orë mësimore.". Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Lindita Nikolla

2019

UDHËZIM

Nr. 5, datë 21.02.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 03.08.2016 "PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË VENDIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 91 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 17, datë 03.08.2016 "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit", i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Kudo në përmbajtje të këtij udhëzimi togfjalëshi "*Ministria e Arsimit dhe Sportit*", të zëvendësohet me "*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*", me përjashtim të rasteve të parashikuar në Kreun II dhe në pikën 1 të Kreut III të tij.

b) Pika 5.4, e kreut IV të udhëzimit riformulohet në këtë mënyrë:

"*Për njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë ngrihen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, komisione "ad hoc" sipas fushave përkatëse me pedagogë ekspertë të fushës të kategorisë "profesor", i cili mblidhet në varësi të numrit të aplikimeve dhe shqyrton dosjet përkatëse. Kryetar i komisionit është zëvendësministri që mbulon çështjet e arsimit të lartë, në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Komisioni përkatës nuk mund të mblidhet më vonë se 15 ditë kalendarike pas njoftimit për shqyrtimin e një aplikimi. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit komisioni firmos procesverbalin dhe ministri përgjegjës për arsimin lëshon vërtetimin për njohjen e gradës shkencore apo titullit akademik*.".

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij Udhëzimi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe komisionet "ad hoc".

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

BESA SHAHINI

UDHËZIM

Nr. 10, datë 15.05.2019

PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË *(Ndryshuar me udhëzimin nr. 17, datë 30.7.2019; nr. 19, datë 10.9.2019, nr. 15, datë 26.5.2020, nr. 17, datë23.6.2020, nr.11, datë 2.6.2021)*

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

KREU I

PORTALET E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT

1. Portali Matura Shtetërore Online është sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të administrojë:

a. procedurat e aplikimit me formularët A1 dhe A1Z të maturantëve/kandidatëve të Maturës Shtetërore;
b. digjitalizimin e rezultateve të këtyre provimeve;
c. prodhimin e diplomës së maturës shtetërore.

2. Portali Maturanti është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të kryejë:

a. procesin e regjistrimit dhe administrimit të rezultateve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë të maturantëve/kandidatëve, që kanë plotësuar formularin e aplikimit A1 ose A1Z në Portalin Matura Shtetërore Online;
b. ndërveprimin me portalin U-Albania nëpërmjet përcjelljes në RASH të bazës së plotë të të dhënave të maturantëve/kandidatëve aplikues me formularët A1/A1Z;
c. prodhimin e certifikatës së maturës shtetërore.

3. Portali U-Albania është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të kryejë procedurat e mëposhtme:

a. informimin e maturantëve/kandidatëve për programet e studimit që ofrojnë IAL-të publike dhe jopublike për çdo vit akademik dhe për çdo program, në mënyrë të detajuar:
    - kriteret e pranimit;
    - kuotat e pranimit;
    - programet mësimore, kurrikulat etj.
b. procesin e përzgjedhjes nga maturantët/kandidatët të preferencave në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve dhe/ose programeve të studimeve me karakter profesional dhe/ose programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, të shpallura nga IAL-të (publike dhe jopublike).
c. përcjelljen IAL-ve të bazës së plotë të të dhënave të maturantëve/kandidatëve, që kanë përzgjedhur programet e studimit që këto IAL ofrojnë.
d. procesin e shpalljes së listave renditëse të kandidateve në rang kombëtar sipas renditjes dhe përllogaritjes së pikëve nga IAL-të.
e. procesin e regjistrimit dhe të çregjistrimit të studentëve nga IAL publike dhe jopublike për ciklin e parë të studimeve dhe/ose programeve të studimeve me karakter profesional dhe/ose programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, të shpallura nga IAL-të (publike dhe jopublike).
f. sinkronizimin e regjistrimeve sipas çdo IAL-je në rang kombëtar dhe lëvizjen e vijës së kuqe.
g. dhënien online të informacioneve të nevojshme për maturantët/kandidatët për ndjekjen në mënyrë dinamike, përgjatë raundit të parë dhe raundit të dytë, të procesit të shpalljes së fituesve.

4. Aplikimi i maturantëve/kandidatëve me formularët A1 dhe A1Z bëhet në Portalin e Maturës Shtetërore Online **ëëë.matura.qsha.gov.al**.

5. Hedhja e rezultateve lëndore të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, për maturantët/kandidatët që kanë plotësuar online formularin A1 ose A1Z, bëhet nga drejtoritë e institucioneve arsimore në Portalin Maturanti **ëëë.rezultateam.al**

6. Për maturantët, të cilët kanë aplikuar me formularin A1, nga drejtoritë e institucioneve arsimore hidhen në Portalin Online të Maturantit, të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë.
   Rezultatet e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, me përjashtim të rezultateve të vitit të fundit, hidhen sipas afatit të përcaktuar me Rregulloren e Maturës Shtetërore. Rezultatet e vitit të fundit hidhen pas përfundimit të vitit shkollor, sipas afatit të përcaktuar me Rregulloren e Maturës Shtetërore.

7. Për kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në vitet e mëparshme dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen në Portalin Online të Maturantit, të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, sipas afatit të përcaktuar me Rregulloren e Maturës Shtetërore.

8. Për kandidatët, që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen në Portalin Online të Maturantit, të dhënat e lidhura me rezultatet e njehsuara të shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, sipas afatit të përcaktuar me Rregulloren e Maturës Shtetërore.

9. Përzgjedhja e programeve të ciklit të parë të studimeve, të programeve të studimeve me karakter profesional, si dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, të ofruara nga IAL-të për vitin akademik përkatës, të bëhet në portalin e aplikimit universitar U-Albania https://ualbania.al/

10. Regjistrimi i studentëve fitues, të shpallur nga IAL-të të kryhet nga sekretaritë mësimore dhe të pasqyrohet në portalin e aplikimit universitar U-Albania https://ualbania.al/

KREU II

PROCEDURAT E APLIKIMIT

A. Procedurat e aplikimit, Raundi i Parë

1. Maturantët/kandidatët, për ndjekjen e studimeve në IAL-të publike dhe jopublike, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, duhet të kryejnë procesin e aplikimit online në portalin e aplikimit universitar U-Albania.

2. Aplikimi kryhet nga maturantët/kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:
    a. janë pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të arsimit të mesëm të lartë;
    b. plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave;
    c. plotësojnë kriteret shtesë të përcaktuara nga IAL-të për programet e studimit për të cilat aplikojnë;
    d. nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.

3. Maturantët/kandidatët, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dymijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim të cilën e shkarkojnë në portalin U-ALBANIA. Periudha e kryerjes se pagesës dhe afati i dorëzimit të mandatit të pagesës si dhe konfirmimi në portalin U-ALBANIA nga sekretaritë e shkollave, përcaktohen në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik.

4. Sipas kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, maturantët/kandidatët që duan të ndjekin studimet në IAL, përfshirë edhe kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, pas pagesës së tarifës së aplikimit, do të aplikojnë në portalin U-Albania nëpërmjet formularit online të aplikimit, mbi bazën e notës mesatare sipas VKM përkatëse mbi kriterin e notës mesatare dhe kritereve të tjera të përcaktuara nga IAL-të.

5. Maturantët/kandidatët, që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM përkatëse mbi kriterin e notës mesatare.

6. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti (sipas procedurave të përshkruara në udhëzuesin teknik, të publikuar në faqen zyrtare të portalit U-Albania).

7. Kandidatët zgjedhin **deri në 10 (dhjetë) programe studimi** nga lista e programeve të studimit, që ofrohen nga IAL-të publike/jopublike, për vitin akademik përkatës.

8. Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (këtu e në vijim DRAP/ZVAP) duhet të marrin masa për krijimin e kushteve (mjedise, asistencë teknike, këshilluese etj.) për t'iu ofruar maturantëve/kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar, lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.

9. Portali U-Albania nuk do të pranojë aplikime nga maturantët/kandidatët, të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me VKM përkatëse, për programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë.

B. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përllogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/kandidatëve të renditur, Raundi i Parë

1. Sipas kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, QSHA-ja i përcjell RASH, në formë elektronike dhe zyrtarisht, listën e maturantëve/kandidatëve që kanë aplikuar me formularët A1/A1Z, të dhënat sa më poshtë:
   a. ID e maturës;
   b. Të dhënat personale dhe të dhëna shkollore (shkolla, DRAP/ZVAP), llojin e formularit);
   c. Indekset e profileve të shkollave të mesme të larta.

2. Sipas kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, QSHA-ja i përcjell RASH, në formë elektronike dhe zyrtarisht, për çdo maturant/kandidat të dhënat sa më poshtë:
   a. ID e Maturës.
   b. Të dhënat personale dhe të dhënat shkollore (shkolla, DRAP/ZVAP/llojin e formularit)
   c. Notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme.
   d. Rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore.
   e. Mestaren e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë.
   f. Mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore.
   g. Mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas VKM për kriterin e notës mesatare;
   h. Indekset e profileve të shkollave të mesme të larta.

3. IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi shkarkojnë nga Portali U-Albania listën e aplikantëve që konkurrojnë në programet përkatëse të studimit, sipas kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik.

4. Në datën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi, afishojnë në mjediset e tyre dhe në faqet zyrtare elektronike përkatëse, listat e aplikantëve. Në periudhën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, do të zhvillohen konkurset e pranimit.

5. Sipas afatit të përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, RASH i përcjell, në formë elektronike dhe zyrtarisht, QSHA-së listën e aplikantëve të raundit të parë për çdo program studimi, për fushat e mëposhtme: a. IAL;
   b. Njësia kryesore e IAL-së;
   c. Cikli i studimit;
   d. Programi i Studimit;
   e. ID e Maturës;
   f. Të dhënat personale të aplikantit.

6. Në datën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, IAL-të mund të shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:

a. Listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;
b. Notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë;
c. Rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;
d. Mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë;
e. Mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;
f. Mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas VKM për kriterin e notës mesatare;
g. Indekset e profileve të shkollave të mesme të lartë.

7. Të gjitha IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, pas kryerjes së përllogaritjes së pikëve për çdo konkurrent, sipas kritereve të pranimit të përcaktuara nga IALja me vendim senati, si dhe renditjes së tyre në varësi të pikëve të grumbulluara, afishojnë në mjediset publike, si dhe në faqen e saj zyrtare listat e renditjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

8. Brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, të gjitha IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID e tyre të maturës, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

C. Procedurat e aplikimit, Raundi i Dytë

1. Në periudhën e caktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, do të kryhet procesi i aplikimit online për raundin e dytë në Portalin UAlbania. Kanë të drejtë të aplikojnë, duke përzgjedhur **deri në 10 (dhjetë) programe studimi**, të gjithë maturantët/kandidatët, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe rezultojnë kalues në provimet e Maturës Shtetërore, por që:
    a. nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë;
    b. kanë kryer procesin e aplikimit online në raundin e parë dhe nuk janë shpallur fitues;
    c. kanë kryer procesin e aplikimit online në raundin e parë dhe nuk kanë arritur të regjistrohen;
    d. janë çregjistruar pas përfundimit të raundit të parë.

2. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti (sipas procedurave të përshkruara në Udhëzuesin teknik të publikuar në faqen zyrtare të RASH-it).

3. Nga drejtoritë e institucioneve arsimore, për të gjithë maturantët/kandidatët që kanë aplikuar me formularin A1 dhe A1Z, hidhen në Portalin Online të Maturantit të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, deri në datën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik.

4. DRAP/ZVAP-të të marrin masa për krijimin e kushteve (mjedise, asistencë teknike, këshilluese, etj.) për t'i ofruar maturantëve/kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.

5. Maturantët/kandidatët, që nuk kanë aplikuar në raundin e parë, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dymijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim, të cilën e shkarkojnë në portalin U-ALBANIA. Maturantët/kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë dhe do të riaplikojnë në raundin e dytë, nuk duhet të kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për këtë raund. Periudha e kryerjes se pagesës, afati i dorëzimit të mandatit të pagesës, si dhe konfirmimi në portalin U-ALBANIA nga sekretaritë e shkollave, përcaktohen në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik.

6. Sipas afatit të përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, RASH i përcjell, në formë elektronike dhe zyrtarisht, QSHA-së listën e aplikantëve të raundit të dytë për çdo program studimi, sipas fushave të mëposhtme: a. IAL.
   b. Njësia kryesore e IAL-së.
   c. Cikli i studimit.
   d. Programi i Studimit.
   e. ID e Maturës.
   f. Të dhënat personale të aplikantit.

D. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përllogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/kandidatëve të renditur, Raundi i Dytë

1. Sipas afatit të përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, QSHA i përcjell RASH-it, në formë elektronike dhe zyrtarisht, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:
   a. ID e maturës;
   b. Të dhënat personale dhe të dhënat shkollore (shkolla, DRAP/ZVAP, lloji i formularit);
   c. Notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme;
   d. Rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;
   e. Mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë;
   f. Mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;
   g. Mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas VKM për kriterin e notës mesatare;
   h. Indekset e profileve të shkollave të mesme të larta.

2. Në datën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, IAL-të mund të shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:
   a. listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;
   b. Numrin personal të maturantit/kandidatit;
   c. notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë;
   d. rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;
   e. mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë;

f. mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;
g. mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas VKM për kriterin e notës mesatare;
h. indekset e profileve të shkollave të mesme të lartë.

3. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë, kryejnë procesin e përllogaritjeve të pikëve për çdo aplikant, sipas kritereve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja me vendim senati. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e aplikantëve të renditur dhe formulën/mënyrën e përllogaritjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

4. Brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, IAL-të afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

E. Procedurat e aplikimit, Raundi i Tretë

1. Në periudhën e caktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, do të kryhet procesi i aplikimit online për raundin e tretë në Portalin UAlbania. Kanë të drejtë të aplikojnë, duke përzgjedhur **deri në 10 (dhjetë) programe studimi**, të gjithë maturantët/kandidatët, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe rezultojnë kalues në provimet e Maturës Shtetërore, por që:
    a. nuk kanë arritur të regjistrohen në raundin e parë ose të dytë;
    b. kanë kryer procesin e aplikimit online në raundin e parë ose të dytë dhe nuk janë shpallur fitues;
    c. kanë kryer procesin e aplikimit online në raundin e parë ose të dytë dhe nuk kanë arritur të regjistrohen;
    d. janë çregjistruar pas përfundimit të raundit të parë ose të dytë.

2. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti (sipas procedurave të përshkruara në Udhëzuesin teknik të publikuar në faqen zyrtare të RASH-it).

3. DRAP/ZVAP-të të marrin masa për krijimin e kushteve (mjedise, asistencë teknike, këshilluese, etj.) për t'i ofruar maturantëve/kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.

4. Maturantët/kandidatët, që nuk kanë aplikuar në raundin e parë ose të dytë, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dymijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim, të cilën e shkarkojnë në portalin U-ALBANIA. Maturantë/kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë ose të dytë dhe do të riaplikojnë në raundin e tretë, nuk duhet të kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për këtë raund. Periudha e

kryerjes se pagesës, afati i dorëzimit të mandatit të pagesës, si dhe konfirmimi në portalin UALBANIA nga sekretaritë e shkollave, përcaktohen në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik.

5. Sipas afatit të përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, RASH i përcjell, në formë elektronike dhe zyrtarisht, QSHA-së listën e aplikantëve të raundit të dytë për çdo program studimi, sipas fushave të mëposhtme: a. IAL;
   b. Njësia kryesore e IAL-së;
   c. Cikli i studimit;
   d. Programi i Studimit;
   e. ID e Maturës;
   f. Të dhënat personale të aplikantit.

F. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përllogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/kandidatëve të renditur, Raundi i Tretë

1. Në datën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, IAL-të shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:
   a. listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;
   b. numrin personal të maturantit/kandidatit;
   c. notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë;
   d. rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;
   e. mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë;
   f. mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;
   g. mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas VKM për kriterin e notës mesatare;
   h. indekset e profileve të shkollave të mesme të lartë.

2. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë kryejnë procesin e përllogaritjeve të pikëve për çdo aplikant, sipas kritereve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja me vendim senati. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e aplikantëve të renditur dhe formulën/mënyrën e përllogaritjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

3. Brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, IAL-të afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

KREU III

PROCEDURAT E REGJISTRIMIT, ÇREGJISTRIMIT DHE ANKIMIMIT

A. Procesi i regjistrimit, Raundi i Parë

1. Në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, të gjithë aplikantët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e parë dhe janë shpallur fitues, kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretaritë mësimore të IAL-ve në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.

2. Periudha e parashikuar në kreun III, A/1 është e ndarë në 7 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në njërin apo disa programe studimi, nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

3. Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë.

4. Për programet e studimit të ofruara nga IAL-të, për të cilat:
   a) Nuk përcaktohen kritere shtesë nga IAL-ja përkatëse, me përjashtim të notës mesatare;
   b) Numri i kandidatëve është i njëjtë apo më i ulët se numri i kuotave të miratuara;
   nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe dhe kandidatët kanë të drejtën e regjistrimit, gjatë gjithë periudhës së regjistrimeve të raundit të parë.

5. Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 7 fazave 48-orëshe MASR dhe RASH do të publikojnë një Udhëzues Teknik në faqet përkatëse zyrtare: **ëëë.arsimi.gov.al** dhe https://ualbania.al/

6. Procesi i regjistrimeve nga sekretaritë mësimore, me dokumentacion dhe online, vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e fituesve të raundit të parë.

7. Në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Këto faza vijojnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara, të cilat nuk kanë aplikantë në pritje, do të rikthehen në garë aplikantët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi në garë kryhet sipas listës së renditjes së aplikantëve për raundin e parë.

8. Brenda datës të përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, RASH përcjell në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të parë bashkë me kuotat e paplotësuara në format elektronik dhe në hardcopy: a) IAL;
   b) Njësia kryesore e IAL-së;
   c) Cikli i studimit;

d) Programi i Studimit;
e) Data e regjistrimit;
f) ID e Maturës;
g) Të dhënat personale të kandidatit të regjistruar.

9. Aplikantët fitues në një program studimi, të cilët nuk janë regjistruar sipas afateve të raundit të parë, humbasin të drejtën për t'u regjistruar. Ata kanë të drejtën që të plotësojnë formularin e aplikimit të raundit e dytë.

B. Procesi i çregjistrimit, Raundi i Parë

1. Aplikanti, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, ka të drejtë të çregjistrohet në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda këtij afati, ai nuk ka të drejtë ta ndryshojë programin e studimit për këtë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania nga sekretaria mësimore e fakultetit.

2. Sekretaritë mësimore, në përfundim të procesit të çregjistrimit të aplikantëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, përcjellin në portalin U-Albania listën e aplikantëve të çregjistruar në format elektronik, brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik.

C. Procesi i ankimimit, Raundi i Parë

1. Aplikantët kanë të drejtën e ankimimit në IAL-të përkatëse në datën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik. Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesave, IAL-të duhet të shprehen me vendim lidhur me ankimimet. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

2. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, pasqyrojnë në format elektronik në portalin U-Albania, brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, vendimet lidhur me ankimimet e aplikantëve.

3. Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, vijojnë procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa e tyre është pranuar, ata duhet të çregjistrohen nga programi i studimit (nëse janë regjistruar) dhe të regjistrohen në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik. Nëse nuk ka çregjistrime, (nuk ka kuota të lira) dhe ankimimi/et pranohen, atëherë IAL dërgon në MASR kërkesën për rialokim kuotash.

D. Procesi i regjistrimit, Raundi i Dytë

1. Në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, të gjithë aplikantët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e dytë dhe janë shpallur fitues, kryejnë procesin e regjistrimit pranë IAL-ve, me dokumentacion në sekretaritë mësimore në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.

2. Periudha e parashikuar në kreun III, D/1 është e ndarë në 5 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në njërin apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

3. Kur aplikanti është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48 orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë.

4. Për programet e studimit të ofruara nga IAL-të, për të cilat:
   a) Nuk përcaktohen kritere shtesë nga IAL-ja përkatëse, me përjashtim të notës mesatare;
   b) Numri i kandidatëve është i njëjtë apo më i ulët se numri i kuotave të miratuara;
   nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe dhe kandidatët kanë të drejtën e regjistrimit, gjatë gjithë periudhës së regjistrimeve të raundit të dytë.

5. Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 5 fazave 48-orëshe MASR dhe RASH do të publikojnë një Udhëzues Teknik në faqet përkatëse zyrtare **ëëë.arsimi.gov.al** dhe në portalin U-Albania https://ualbania.al/

6. Procesi i regjistrimeve nga sekretaritë mësimore, me dokumentacion dhe online vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e renditura të raundit të dytë. Në rast se, pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara të cilat nuk kanë aplikantë në pritje, do të rikthehen në garë aplikantët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi në garë kryhet sipas listës së renditjes së aplikantëve për raundin e dytë.

7. Sipas afatit të përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, RASH përcjell në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të dytë në format elektronik dhe hardcopy:
   a) IAL;
   b) Njësia kryesore e IAL-së;
   c) Cikli i studimit;
   d) Programi i Studimit;
   e) Data e regjistrimit;
   f) ID e Maturës;
   g) Të dhënat personale të kandidatit të regjistruar.

8. Aplikantët, të cilët kanë bërë regjistrimin me dokumentacion dhe kanë nënshkruar në regjistër, nuk kanë të drejtë të ndryshojnë programin e studimit, për atë vit akademik.

E. Procesi i çregjistrimit, Raundi i Dytë

1. Aplikanti, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, ka të drejtë të çregjistrohet vetëm në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda kësaj date, ai nuk ka të drejtë ta ndryshojë programin e studimit për këtë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-ALBANIA nga sekretaria mësimore e fakultetit.
2. Sekretaritë mësimore, në përfundim të procesit të çregjistrimit të aplikantëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, dërgojnë në RASH listën e aplikantëve të çregjistruar, sipas afatit të përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik.

F. Procesi i ankimimit, Raundi i Dytë

1. Aplikantët kanë të drejtën e ankimimit në IAL në datën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik. Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesave, IAL-të duhet të shprehen me vendim lidhur me ankimimet. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

2. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, përcjellin zyrtarisht në RASH, brenda datës së përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, vendimet lidhur me ankimimet e aplikantëve si dhe pasqyrojnë brenda po kësaj date në portalin U-Albania këto vendime në format elektronik.

3. Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, vijojnë procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa e tyre është pranuar, ata duhet të çregjistrohen nga programi i studimit (nëse janë regjistruar) dhe të regjistrohen në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik. Nëse nuk ka çregjistrime, (nuk ka kuota të lira) dhe ankimimi/et pranohen, atëherë IAL dërgon në MASR kërkesën për rialokim kuotash.

G. Procesi i regjistrimit, Raundi i Tretë

1. Në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, të gjithë aplikantët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e tretë dhe janë shpallur fitues, kryejnë procesin e regjistrimit pranë IAL-ve, me dokumentacion në sekretaritë mësimore në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.

2. Periudha e parashikuar në kreun III, G/1 është e ndarë në 3 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në një apo disa programe studimi, nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

3. Kur aplikanti është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48 orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë.

4. Për programet e studimit të ofruara nga IAL-të, për të cilat:
   a) Nuk përcaktohen kritere shtesë nga IAL-ja përkatëse, me përjashtim të notës mesatare;
   b) Numri i kandidatëve është i njëjtë apo më i ulët se numri i kuotave të miratuara;

   nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe dhe kandidatët kanë të drejtën e regjistrimit, gjatë gjithë periudhës së regjistrimeve të raundit të tretë.

5. Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 3 fazave 48-orëshe MASR dhe RASH do të publikojnë një Udhëzues Teknik në faqet përkatëse zyrtare **ëëë.arsimi.gov.al** dhe në portalin U-Albania https://ualbania.al/

6. Procesi i regjistrimeve nga sekretaritë mësimore, me dokumentacion dhe online vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e renditura të raundit të tretë. Në rast se, pas çdo faze 48-orëshe, konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara të cilat nuk kanë aplikantë në pritje, do të rikthehen në garë aplikantët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi në garë kryhet sipas listës së renditjes së aplikantëve për raundin e tretë.

7. Gjatë periudhës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, pas përfundimit të 3 (tri) fazave 48-orëshe të regjistrimit, IALtë vijojnë me procedurat e regjistrimit të kandidatëve nëpërmjet portalit U-Albania në programet e studimit në të cilat kanë aplikuar në raundin e tretë. Të drejtën e regjistrimit e kanë kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi. IAL-të gjatë regjistrimeve respektojnë renditjen e kandidatëve deri në plotësimin e kuotave.

8. Sipas afatit të përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik, RASH përcjell në QSHA regjistrimet përfundimtare të të tri raundeve në format elektronik dhe hardcopy:
   a) IAL;
   b) Njësia kryesore e IAL-së;
   c) Cikli i studimit;
   d) Programi i Studimit;
   e) Data e regjistrimit;
   f) ID e Maturës;
   g) Të dhënat personale të kandidatit të regjistruar.

9. Aplikantët, të cilët kanë bërë regjistrimin me dokumentacion dhe kanë nënshkruar në regjistër, nuk kanë të drejtë të ndryshojnë programin e studimit, për atë vit akademik.

KREU IV

DOKUMENTACIONI PËR REGJISTRIM

1. Aplikantët fitues duhet të regjistrohen vetëm në një program studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Pas marrjes së dokumentacionit nga aplikanti dhe regjistrimit të tij, sekretaria bën regjistrimin online në Portalin U-Albania. Aplikantët dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:
    a. dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja;
    b. fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehsuar në QSHA;
    c. deklaratën e paraqitur në shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjëses së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë.

2. Sekretaritë mësimore mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të aplikantit kryhet regjistrimi online në Portalin U-Albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretarja firmoset në dy kopje formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI

1. IAL-të dorëzojnë në QSHA, në formë zyrtare dhe elektronike, brenda datës 30 nëntor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar për pajisjen e studentëve me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".

2. Kandidatët e shpallur fitues në programet e të gjitha cikleve të studimit nuk mund të regjistrohen për të ndjekur njëkohësisht dy programe studimi në IAL-të publike dhe/ose jopublike, në të njëjtin vit akademik, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.

3. IAL-të të përpilojnë një raport të hollësishëm në lidhje me regjistrimet e studentëve në afatet dhe formatet e kërkuara sipas udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 5, datë

19.2.2018, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”. Ky raport të dërgohet në MASR brenda datës 31 dhjetor të çdo viti akademik.

4. Ngarkohen Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar për miratimin e kalendarit, për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit, për çdo vit akademik, si dhe publikimit të tij brenda muajit janar të çdo viti kalendarik.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe IAL-të publike dhe jopublike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

Besa SHAHINI

Shtojca nr.1

DEKLARATË

Unë i nënshkruari _____ , lindur më _____ emri
atësia mbiemri
me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____ Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu Institucionin e Arsimit të Lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

3. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.

4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

_____	_____ Emër,
Atësi, Mbiemër i kandidatit	Emër, Atësi, Mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore
Firma:	Firma:
Vendi: _____	Data: ____ . ____. _____

UDHËZIM
Nr. 14, datë 27.05.2019

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRGATITJEN DHE LËSHIMIN E KARTËS SË STUDENTIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2 të nenit 100 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe të vendimit nr.226, datë 17.04.2019 të Këshillit të Ministrave "Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara

nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen më çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit",

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e kritereve dhe procedurave për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit, në vijim karta, e cila përbën një dokument unik identifikues që i shërben studentit për të përfituar shërbime, me çmime të reduktuara, nga entet shtetërore në fushën e artit dhe kulturës, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe rinisë, transportit, turizmit dhe mjedisit, ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit dhe ato të mbrojtjes.

2. Të drejtën e pajisjes me kartë e ka çdo individ që gëzon statusin e studentit. Karta humbet vlefshmërinë dhe duhet të dorëzohet menjëherë me marrjen e diplomës të programit përkatës të studimit apo në rastet kur individi humbet statusin e studentit.

3. Studenti mund të përfitojë kartën në momentin e pajisjes me Numër Identifikues Matrikullimi (NIM) nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.

4. Studenti e përdor kartën deri në momentin që do të pajiset me diplomë të ciklit përkatës të studimit.

5. Aplikimi për kartë bëhet nga vetë studenti në IAL-në përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

6. Karta përmban elementë të dukshëm dhe të padukshëm sipas përcaktimeve të shtojcës 1 pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

7. Karta lëshohet për të gjithë kohëzgjatjen normale të studimeve. Në rast dëmtimi apo kur studenti e humbet atë, studenti ka të drejtë të riaplikojë për një kartë të re, e cila lëshohet me të njëjtin afat vlefshmërie sa karta e parë.
8. Studenti që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes normale të programit përkatës të studimit, ka të drejtë të riaplikojë për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së kartës, pas miratimit të zgjatjes së afatit nga IAL-ja përkatëse.

9. Me pezullimin apo largimin e studentit nga IAL-ja, sekretaria e IAL-së përkatëse duhet t'i tërheqë kartën e studentit, të kryejë brenda ditës procedurat e çregjistrimit, me qëllim asgjësimin e saj.

10. Procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës ndiqen nga Ministria përgjegjëse për arsimin. Në rastet kur prodhimi dhe administrimi i kartës së studentit i delegohet njësisë së vetëqeverisjes vendore, procedura përkatëse për përgatitjen dhe lëshimin e saj, përcaktohen në marrëveshjen dypalëshe të nënshkruar për këtë qëllim.

11. Baza e të dhënave që krijohet gjatë procesit të pajisjes me kartën e studentit administrohet nga ministria përgjegjëse për arsimin përmes Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Në rastet kur prodhimi dhe administrimi i kartës së studentit i delegohet njësisë së vetëqeverisjes vendore, baza e të dhënave i vihet në dispozicion ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore nëpërmjet krijimit të aksesit të përhershëm ashtu dhe transferimit të të dhënave në mënyrë të vazhdueshme.

12. Për pajisjen me kartë, studenti duhet të paraqitet personalisht pranë sporteleve të hapura për këtë qëllim dhe duhet të jetë i pajisur me kartën e identitetit.

13. Studenti duhet të plotësojë një formular vetëdeklarimi, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

14. Karta printohet pasi bëhet verifikimi në sistem i të dhënave të studentit. Tërheqja e kartës bëhet pranë IAL-ve nga vetë studenti.

15. Institucionet apo subjektet e kontraktuara prej tyre, për realizimin, përgatitjen dhe lëshimit të Kartës, duhet të pajisin të gjithë IAL-të me bazën materiale të nevojshme (shtojca 1), sipas ngarkesës së studentëve dhe të trajnojë personelin që do punojnë për kryerjen e këtij procesi. Institucionet apo subjektet e kontraktuara prej tyre, mund të kontraktojnë studentë të IAL-së përkatëse, të punësuar me kohë të pjesshme, për realizimin e përgatitjes dhe lëshimit të kartës.

16. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

Besa SHAHINI

SHTOJCA NR.1

UDHËZUESI TEKNIK

Ngritja e një sistemi për regjistrimin e studentëve që do të pajisen me kartë sipas të dhënave të përcaktuara si më poshtë:

a. Elementë të dukshëm të kartës:

1. Logo e MASR, logo e IAL-së,
2. Logo e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas marrëveshjeve, dhe sipas rastit;
3. Emërtimi i institucionit të arsimit të lartë (IAL);
4. Fotografia e studentit;
5. Emri;
6. Mbiemri;
7. Numri i matrikullimit;
8. Kodi QR i identifikimit;
9. Afati i vlefshmërisë së Kartës;
10. Numri i kartës.

b. Elementët e padukshëm të kartës janë:

1. Emërtimi i njësisë kryesore;
2. Emërtimi i programit të studimit;
3. Cikli i studimit;
4. Data e regjistrimit në programin përkatës të studimit;
5. Datëlindja e studentit;
6. Numri i kontaktit;
7. Adresa e email-it.

c. Struktura fizike e kartës së studentit:

Karta duhet të jetë plastike, material PVC me përmasa 85 mm x 55mm dhe trashësi 0.8 mm.

Karta duhet të jetë e pajisur me elementët e nevojshëm në mënyrë që të njihet nga qendrat POS, gjithashtu dhe kod QR që të jetë e identifikueshme elektronikisht.

Ngritja e sporteleve bëhet pranë çdo njësie kryesore me qëllim pajisjen e studentëve me kartë. Sistemi do të jetë i aksesueshëm në të gjitha këto sportele.

Në momentin e paraqitjes së studentit do të plotësohet skeda e shoqëruar me të dhënat e përcaktuara dhe në këtë moment do të kryhet dhe fotografimi direkt i studentit.

Pjesë e softit që do të ndërtohet është kompozimi automatik i kartës dhe printimi i saj në moment, sipas të dhënave të plotësuara.

Baza materiale:

Pikat e shpërndarjes së kartës pranë Fakulteteve dhe Universiteteve do të kenë:
-Soft i personalizuar

-Kompjuter

-Printer i posaçëm për printimin e kartave

-Kamera fotografike e lidhur me kompjuterin

-Lexues dhe aktivizues i kartës

SHTOJCA NR. 2 FORMULARI MBI KUSHTET E PRIVATËSISË PËR PAJISJEN ME KARTËN E STUDENTIT

* EMRI * MBIEMRI

□□□□□□□□□□□□□□□ □□□□□□□□□□□□□□□

Me këtë anëtarësim pranoj që të dhënat e mia personale të përdoren për t'u informuar për mundësitë dhe avantazhet që lidhen me përdorimin e kartës.

Pranoj □ Nuk pranoj □

Pranoj të marr **Kartën e Studentit** Data (dd/mm/vvvv) ☐☐ ☐☐ ☐☐☐☐ Firma

- Të dhënat e treguara nga zotëruesit e kartës së Studentit, do të përfshihen në arkivin elektronik të institucioneve të arsimit të lartë dhe të njësisë së vetëqeverisjes vendore në rastin kur këto të fundit kanë marrëveshje me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për realizimin dhe shpërndarjen e kartës.

- Këto të dhëna klasifikohen si të dhëna personale, referuar ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", dhe do të mblidhen me qëllimin për të realizuar iniciativa publicitare, të posaçme për mbajtësit e Kartës se Studentit , si dhe për t'i informuar në çdo kohë, me anë të mjeteve të ndryshme të komunikimit, për mundësitë dhe avantazhet që lidhen me përdorimin e kartës.

- Këto të dhëna do të përpunohen nga punonjësit dhe bashkëpunëtorët e institucioneve të arsimit të lartë dhe të njësisë së vetëqeverisjes vendore në rastin kur këto të fundit kanë marrëveshje me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për realizimin dhe shpërndarjen e kartës.

- Të anëtarësuarit duhet të vihen në dijeni se të dhënat e tyre përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", dhe se ata kanë të drejtë të njihen me të dhënat e tyre personale, të kërkojnë korrigjim ose fshirje, si dhe të kundërshtojnë përdorimin e tyre, duke kontaktuar me përgjegjësit e përpunimit dhe duke i bërë të ditur mënyrën e kontaktimit me këto përgjegjës.

- Të gjitha këto të drejta do t'i bëhen të ditura përdoruesve të kartës, në momentin e nënshkrimit të kartës së Studentit, ku do të jenë të pasqyruara sa më sipër dhe me anë të të cilit do të kërkohet autorizim për mbajtjen dhe përpunimin e këtyre të dhënave

UDHËZIM
NR. 16 DATË 08.07.2019

PAJISJEN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË ME REGJISTRIN THEMELTAR TË STUDENTËVE, REGJISTRIN E ARRITJEVE AKADEMIKE DHE REGJISTRIN E LËSHIMIT TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe nenit 101, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

U DH Ë Z O J:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë (në vijim IAL) me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike, si dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, sipas formatit dhe përcaktimeve në këtë udhëzim.

2. IAL-të regjistrojnë studentët në regjistrin themeltar, në formë të shkruar (me dorë), si dhe në format elektronik, sipas formatit të përcaktuar në këtë udhëzim.

3. IAL-të regjistrojnë rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar, sipas programeve të studimit, në regjistrin e arritjeve akademike, në formë të shkruar (me dorë), si dhe në format elektronik, sipas formatit të përcaktuar në këtë udhëzim.

4. IAL-të regjistrojnë diplomat dhe certifikatat në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, në formë të shkruar (me dorë), si dhe në format elektronik, sipas formatit të përcaktuar në këtë udhëzim.

5. Aplikimi për pajisjen me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave kryhet nga IAL-ja në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (në vijim QSHA) dhe dosja duhet të përmbajë:

    a) kërkesën për pajisjen me regjistrin përkatës, me të dhënat e mëposhtme:
        i. emërtimi i njësisë kryesore;
        ii. emërtimi i programit të studimit;
        iii. lloji i programit të studimit;
        iv. forma e studimit (studime me kohë të plotë dhe me kohë të zgjatur);

b) aktin e hapjes së IAL-së;
c) aktin e akreditimit të parë dhe periodik të IAL-së;
d) aktin e hapjes së programit të studimit;
e) aktin e akreditimit të parë dhe periodik të programit të studimit (kur është kryer nga Bordi i Akreditimit përpara lëshimit të diplomave);
f) dokumentin e pagesës së tarifës për regjistrin përkatës;
g) autorizimin e titullarit për punonjësin e IAL-së për tërheqjen e tyre.

6. Ministria përgjegjëse për arsimin kryen procedurat e prokurimit. Operatori ekonomik fitues nënshkruan kontratën me QSHA-në e cila kryen dhe pagesat e faturave tatimore për prodhimin e regjistrave sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi. Operatori ekonomik fitues me proces-verbal dorëzimi, dërgon në QSHA, brenda muajit prill të çdo viti, regjistrat. Në rast se regjistrat kanë defekte, brenda 30 ditëve nga momenti i konstatimit të defekteve, QSHA-ja i kthen regjistrat pranë operatorit ekonomik fitues për riprodhim. Në rast se defektet e regjistrave, konstatohen nga IAL-të, ato brenda 10 ditëve i kthejnë në QSHA.

7. QSHA-ja, pas marrjes në dorëzim të regjistrave, plotëson kopertinën me elementët përkatës, i vulos në çdo faqe dhe ia dorëzon personit të autorizuar nga IAL-ja, i cili paraqitet për tërheqjen e tyre. QSHA-ja plotëson në regjistrin e saj me shkrim dore numrin e regjistrit të QSHA-së, duke nisur nga numri rendor 1 dhe vijues, për çdo vit kalendarik. Për çdo regjistër të ri që fillon të plotësohet, pasi ai i mëparshëm nuk ka më rekorde të lira në fund të tij, në rekordin e parë të regjistrit të ri, shënohet numri rendor pasues i rekordit të fundit të regjistrit që mbyllet. Çdo regjistër ka një numër rendor unik, i cili, së bashku me të dhënat e tjera të regjistrit përkatës mbahen në QSHA në një regjistër të veçantë, të shkruar (me dorë) dhe elektronik, sipas shtojcës nr.1 të këtij udhëzimi. Numri i regjistrit përcaktohet në momentin e tërheqjes së regjistrit, bazuar në numrin e regjistrimit të tij në regjistrin e QSHA-së.

8. IAL-të depozitojnë kërkesën për pajisje me regjistrat, sipas nevojave të tyre. Pajisja e IAL-ve me regjistrat bëhet përpara fillimit të vitit akademik, por jo më vonë se data 30 tetor të çdo viti akademik.

9. Regjistrat tërhiqen në QSHA nga personi i autorizuar nga titullari i IAL-së.

10. Në rast ndryshimi/riorganizimi të IAL-së, njësisë kryesore apo të programit të studimit, IAL-të dërgojnë zyrtarisht në QSHA kërkesën për regjistër të ri themeltar, regjistër të ri të arritjeve akademike dhe regjistër të ri të lëshimit të diplomave dhe certifikatave.

KREU II

REGJISTRI THEMELTAR I STUDENTËVE

1. QSHA-ja pajis me regjistër themeltar të studentëve IAL-të, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

2. Regjistri themeltar i studentëve përmban informacionet e parashikuara në shtojcën nr.3 të këtij udhëzimi dhe përbëhet nga 29 fletë.

3. Regjistri themeltar i studentëve depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së IAL-së.

4. Në kopertinën e regjistrave themeltarë të studentëve, punonjësi i QSHA-së plotëson (me dorë) të dhënat lidhur me:

    a) emërtimin e IAL-së;
    b) emërtimin e njësisë kryesore;
    c) emërtimin e programit të studimit;
    d) ciklin e studimit;
    e) llojin e programit të studimit;
    f) formën e studimit;
    g) numrin e regjistrit.

5. Regjistri themeltar i studentëve plotësohet me shkrim dore nga punonjësi i autorizuar i sekretarisë mësimore pranë njësisë kryesore. Për çdo faqe të re të regjistrit që fillon të plotësohet, personi i autorizuar për hedhjen e të dhënave plotëson të dhënat e parashikuara në shtojcën nr.2 të këtij udhëzimi. Për çdo rekord të hedhur punonjësi i autorizuar dhe kryesekretari nënshkruan në hapësirën përkatëse. Plotësimi i regjistrit me të dhënat e studentëve bëhet në momentin e regjistrimit të studentit. Rekordet e plotësuara duhet të pasqyrohen sipas datës së regjistrimit të studentit. Në momentin e regjistrimit të të dhënave të studentit, numri i matrikullimit nuk plotësohet. Numri i matrikullimit plotësohet jo më vonë se 10 ditë nga dërgimi në formë zyrtare nga QSHA-ja, nga personi i autorizuar që ka plotësuar rekordin përkatës. Në mungesë të personit të autorizuar, numri i matrikullimit plotësohet në regjistrin themeltar të studentëve nga kryesekretari i IAL-së, i cili nënshkruan plotësimin e kryer.
   Për studentët e huaj që nuk disponojnë lejen e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë në momentin e regjistrimit, të dhënat përkatëse hidhen nga personi që ka plotësuar rekordin përkatës, jo më vonë se afatet e parashikuara ligjore për qëndrimin e shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë.

6. Në regjistër nuk mund të bëhen korrigjime, fshirje, shtesa apo zëvendësime të dhënash. Çdo ndryshim, duhet të bëhet sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, të jetë i arsyetuar dhe të mbahet proces-verbal. Proces-verbali nënshkruhet nga punonjësi i autorizuar, kryesekretari dhe dekani, përmban datën, arsyen dhe shoqërohet me një fotokopje të fletës përkatëse të regjistrit para kryerjes së ndryshimit, me vulën e njësisë kryesore, si dhe fotokopjen e fletës së regjistrit pas ndryshimit të kryer, të vulosur me vulën e njësisë kryesore dhe ruhet në sekretarinë mësimore të IAL-së.

7. Me përfundimin e hedhjes së të dhënave të regjistrimit, në fund të afatit ligjor për vitin akademik përkatës, të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, regjistri mbyllet me vijë ndarëse të qartë, poshtë së cilës shënohet numri i rekordit të fundit të plotësuar para vijës ndarëse, data dhe nënshkrimi i personit të autorizuar.

8. Hapja e regjistrimeve në vitin pasardhës në të njëjtin program studimi fillon me numrin rendor vijues numerik pas atij të mëparshëm, të saktësuar, në mbylljen e regjistrit me vijën ndarëse, sipas përcaktimeve në pikën 7, të këtij kreu.

9. IAL-të marrin masa për përgatitjen dhe miratimin e rregulloreve të sekretarive mësimore për regjistrimin e studentëve, plotësimin dhe ruajtjen e regjistrit themeltar të studentëve, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

10. Regjistri themeltar i studentëve që arkivohet, mbyllet me vijë ndarëse të qartë, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat dhe ruhet në vend të sigurt, duke u shoqëruar me një dokument të nënshkruar nga kryesekretari, dekani dhe rektori mbi mbylljen e tij, ku shënohen të dhënat për numrin e faqes së fundit dhe rekordit të fundit të plotësuar të regjistrit. Hedhja e të dhënave shoqërohet me nënshkrimin e personave përgjegjës.

11. IAL-ja, përveçse në format të shkruar (me dorë), duhet të mbajë dhe regjistër themeltar të studentëve në formë elektronike, sipas formatit të parashikuar në shtojcën nr. 3 të këtij udhëzimi. Në rast mospërputhjeje të dhënash, merren për bazë të dhënat e regjistrave në formë të shkruar. Regjistri elektronik duhet të përmbajë të paktën të dhënat e parashikuara në shtojcën nr.2 të këtij udhëzimi. Shpjegimet për plotësimin e regjistrit të plotësuar në formë të shkruar (me dorë), ndodhen në faqen e fundit të tij. Shpjegimet për plotësimet e regjistrit në format elektronik ndodhen në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

12. IAL-ja merr të gjitha masat për ruajtjen e përhershme të të dhënave të regjistrit elektronik themeltar të studentëve, duke siguruar *back-up* të tyre pas çdo hedhje të dhënash.

KREU III

REGJISTRI I ARRITJEVE AKADEMIKE

1. QSHA-ja pajis me regjistrin e arritjeve akademike IAL-të, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

2. Regjistri i arritjeve akademike përmban informacionet e parashikuara në shtojcën nr.4 të këtij udhëzimi dhe përbëhet nga 29 fletë.

3. Regjistri i arritjeve akademike depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së IAL-së.

4. Në kopertinën e regjistrave të arritjeve akademike, punonjësi i QSHA-së plotëson të dhënat lidhur me:

    a) emërtimin e IAL-së;
    b) emërtimin e njësisë kryesore;
    c) emërtimin e programit të studimit;
    d) ciklin e studimit;
    e) llojin e programit të studimit;
    f) formën e studimit;
    g) numrin e regjistrit.

5. Regjistri i arritjeve akademike plotësohet me shkrim dore nga punonjësi i autorizuar i sekretarisë mësimore pranë njësisë kryesore. Për çdo faqe të re të regjistrit që fillon të plotësohet, personi i autorizuar për hedhjen e të dhënave plotëson të dhënat e parashikuara në shtojcën nr.5 të këtij udhëzimi. Për çdo rekord të hedhur punonjësi i autorizuar dhe kryesekretari nënshkruan në hapësirën përkatëse. Plotësimi i regjistrit me të dhënat e arritjeve akademike të studentëve bëhet në momentin e përcjelljes së të dhënave të arritjeve akademike. Rekordet e plotësuara duhet të pasqyrohen sipas datës së ardhjes së të dhënave të arritjeve akademike.

6. Në regjistër nuk mund të bëhen korrigjime, fshirje, shtesa apo zëvendësime të dhënash. Çdo ndryshim, duhet të bëhet sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, të jetë i arsyetuar dhe të mbahet proces-verbal. Proces-verbali nënshkruhet nga punonjësi i autorizuar, kryesekretari dhe dekani, që përmban datën, arsyen dhe shoqërohet me një fotokopje të fletës përkatëse të regjistrit para kryerjes së ndryshimit, me vulën e njësisë kryesore, si dhe fotokopjen e fletës së regjistrit pas ndryshimit të kryer, të vulosur me vulën e njësisë kryesore dhe ruhet në sekretarinë mësimore të IAL-së.

7. Në rastin e transferimit të studimeve, në regjistër pasqyrohen arritjet akademike të studentëve, që u janë njohur nga IAL-ja pranuese.

8. Me përfundimin e hedhjes së të dhënave të arritjeve akademike në fund të afatit ligjor për vitin akademik përkatës, të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, regjistri mbyllet me vijë ndarëse të qartë, poshtë së cilës shënohet numri i rekordit të fundit të plotësuar para vijës ndarëse, data dhe nënshkrimi i personit të autorizuar.

9. Hapja e regjistrit të arritjeve akademike në vitin pasardhës për të njëjtin program studimi fillon me numrin rendor vijues numerik pas atij të mëparshëm, të saktësuar, në mbylljen e regjistrit me vijën ndarëse, sipas përcaktimeve në pikën 8 të këtij kreu.

10. IAL-të marrin masa për përgatitjen dhe miratimin e rregulloreve të sekretarive mësimore për regjistrimin e arritjeve akademike, plotësimin dhe ruajtjen e regjistrit të arritjeve akademike, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

11. Regjistri i arritjeve akademike që arkivohet, mbyllet me vijë ndarëse të qartë, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat dhe ruhet në vend të sigurt, duke u shoqëruar me një dokument të nënshkruar nga kryesekretari, dekani dhe rektori mbi mbylljen e tij, ku shënohen të dhënat për numrin e faqes së fundit dhe rekordit të fundit të plotësuar të regjistrit. Hedhja e të dhënave shoqërohet me nënshkrimin e personave përgjegjës.

12. IAL-ja, përveçse në formë të shkruar (me dorë), duhet të mbajë dhe regjistër të arritjeve akademike në formë elektronike, sipas formatit të parashikuar në shtojcën nr.4 të këtij udhëzimi. Në rast mospërputhjeje të dhënash, merren për bazë të dhënat e regjistrave në formë të shkruar. Regjistri elektronik duhet të përmbajë të paktën të dhënat e parashikuara në shtojcën nr.5 të këtij udhëzimi. Shpjegimet për plotësimin e regjistrit të plotësuar në formë të shkruar (me dorë), ndodhen në faqen e fundit të tij. Shpjegimet për plotësimet e regjistrit në format elektronik ndodhen në shtojcën nr.4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

13. IAL-ja merr të gjitha masat për ruajtjen e përhershme të të dhënave të regjistrit elektronik të arritjeve akademike, duke siguruar *back-up* të tyre pas çdo hedhje të dhënash.

KREU IV

REGJISTRI I LËSHIMIT TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE

1. QSHA-ja pajis me regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave IAL-të, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

2. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave përmban informacionet e parashikuara në shtojcën nr.6 të këtij udhëzimi dhe përbëhet nga 29 fletë.

3. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së IAL-së.

4. Në kopertinën e regjistrit të lëshimit të diplomave dhe certifikatave, punonjësi i QSHA-së plotëson të dhënat lidhur me:

    a) emërtimin e IAL-së;
    b) emërtimin e njësisë kryesore;
    c) emërtimin e programit të studimit;
    d) ciklin e studimit;
    e) llojin e programit të studimit;
    f) formën e studimit;
    g) numrin e regjistrit.
    h) aktin e akreditimit të parë dhe periodik të IAL-së;
    i) aktin e akreditimit të parë dhe periodik të programit të studimit.

5. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave plotësohet me shkrim dore nga punonjësi i autorizuar të sekretarisë mësimore pranë njësisë kryesore. Për çdo faqe të re të regjistrit që fillon të plotësohet, personi i autorizuar për hedhjen e të dhënave plotëson të dhënat e parashikuara në shtojcën nr.7 të këtij udhëzimi. Për çdo rekord të hedhur punonjësi i autorizuar dhe kryesekretari nënshkruan në hapësirën përkatëse. Plotësimi i regjistrit me të dhënat e lëshimit të diplomave dhe certifikatave bëhet në momentin e diplomimit të studentit. Rekordet e plotësuara duhet të pasqyrohen sipas datës së lëshimit të diplomave/certifikatave.

6. Në regjistër nuk mund të bëhen korrigjime, fshirje, shtesa apo zëvendësime të dhënash. Çdo ndryshim, duhet të bëhet sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, të jetë i arsyetuar dhe të mbahet proces-verbal. . Proces-verbali nënshkruhet nga punonjësi i autorizuar, kryesekretari dhe dekani, që përmban datën, arsyen dhe shoqërohet me një fotokopje të fletës përkatëse të regjistrit para kryerjes së ndryshimit, me vulën e njësisë kryesore, si dhe fotokopjen e fletës së regjistrit pas ndryshimit të kryer, të vulosur me vulën e njësisë kryesore dhe ruhet në sekretarinë mësimore të IAL-së.

7. Me përfundimin e hedhjes së të dhënave të lëshimit të diplomave dhe certifikatave në fund të afatit ligjor për vitin akademik përkatës, të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore

në fuqi, regjistri mbyllet me vijë ndarëse të qartë, poshtë së cilës shënohet numri i rekordit të fundit të plotësuar para vijës ndarëse, data dhe nënshkrimi i personit të autorizuar.

8. Hapja e regjistrit të lëshimit të diplomave dhe certifikatave në vitin pasardhës për të njëjtin program studimi fillon me numrin rendor vijues numerik pas atij të mëparshëm, të saktësuar, në mbylljen e regjistrit me vijën ndarëse, sipas përcaktimeve në pikën 7 të këtij kreu.

9. IAL-të marrin masa për përgatitjen dhe miratimin e rregulloreve të sekretarive mësimore për regjistrimin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, plotësimin dhe ruajtjen e regjistrit të lëshimit të diplomave dhe certifikatave, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

10. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave që arkivohet, mbyllet me vijë ndarëse të qartë, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat dhe ruhet në vend të sigurt, duke u shoqëruar me një dokument të nënshkruar nga kryesekretari, dekani dhe rektori mbi mbylljen e tij, ku shënohen të dhënat për numrin e faqes së fundit dhe rekordit të fundit të plotësuar të regjistrit. Hedhja e të dhënave shoqërohet me nënshkrimin e personave përgjegjës.

11. IAL-ja, përveçse në formë të shkruar (me dorë), duhet të mbajë dhe regjistër të lëshimit të diplomave dhe certifikatave në formë elektronike, sipas formatit të parashikuar në shtojcën nr.6 të këtij udhëzimi. Në rast mospërputhjeje të dhënash, merren për bazë të dhënat e regjistrave në formë të shkruar. Regjistri elektronik duhet të përmbajë të paktën të dhënat e parashikuara në shtojcën nr.7 të këtij udhëzimi. Shpjegimet për plotësimin e regjistrit të plotësuar në formë të shkruar (me dorë) ndodhen në faqen e fundit të tij. Shpjegimet për plotësimet e regjistrit në format elektronik ndodhen në shtojcën nr.5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

12. IAL-ja merr të gjitha masat për ruajtjen e përhershme të të dhënave të regjistrit elektronik të lëshimit të diplomave dhe certifikatave, duke siguruar *back-up* të tyre pas çdo hedhje të dhënash.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI

1. IAL-të paguajnë tarifën përkatëse të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për llogari të QSHA-së, për çdo regjistër. Kopja e mandatit të pagesës i bashkëlidhet kërkesës

që dorëzohet në QSHA. Tarifa dhe llogaria bankare ku ajo depozitohet i komunikohen IAL-ve nga QSHA-ja dhe bëhen publike në faqen *ëeb* të saj.

2. IAL-ja merr masa për ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave personale në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. IAL-të të marrin masat e nevojshme për sigurimin e informacionit, për plotësimin e regjistrave, në formë elektronike dhe të shkruar (me dorë) me ngjyrë blu, për çdo student, sipas të gjitha rubrikave të përcaktuara në shtojcat e këtij udhëzimi.

4. Udhëzimi nr.31, datë 16.09.2014, "Për pajisjen e institucioneve të arsimit lartë publik dhe privat me regjistra bazë të studentëve", shfuqizohet.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

M I N I S T Ë R

BESA SHAHINI

SHTOJCA NR.1

REGJISTRI I QSHA-SË PËR DORËZIMIN E REGJISTRAVE TË IAL-VE

Nr. _____

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
Lloji i regjistrit	Nr. Rendor	Nr. i regjistrit	Emërtimi i IAL	Emërtimi i Njësisë Kryesore	Emërtimi i Programit të Studimit	Emërtimi i ciklit të studimit	Lloji i Programit të Studimit	Forma e studimit	Data e Dorëzimit të Regjistrit	Personi i Autorizuar për Tërheqjen	Nr. Personal i Personit të Autorizuar për Tërheqjen	Akti i hapjes së Programit të Studimit	Akti i akreditimit te pare dhe periodik te Programit të Studimit	Punonjësi i Autorizuar për Dorëzimin	Nr. Personal i Punonjësit të Autorizuar për Dorëzimin

Udhëzime për plotësimin e regjistrit të QSHA-së

1) Lloji i regjistrit	Regjistri themeltar i studentëve/Regjistri i arritjeve akademike/Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave
2) Nr. rendor	I plotësuar automatikisht.
3) Numër i regjistrit	Numri i regjistrit themeltar i cili jepet nga personi i autorizuar për dorëzimin, në mënyrë rritëse, për çdo regjistër që shtohet.
4) Emërtimi i IAL	Emërtimi i institucionit të arsimit të lartë sipas aktit të hapjes.
5) Emërtimi i Njësisë Kryesore	Emërtimi i Njësisë Kryesore sipas aktit të hapjes / riorganizimit (VKM, urdhër i Ministrit).
6) Emërtimi i Programit të Studimit	Emërtimi i programit të studimit sipas aktit të hapjes / riorganizimit.
7) Emërtimi i Ciklit të Studimit	Cikli i pare I studimeve, cikli i dytë i studimeve, cikli i tretë i studimeve
8) Lloji i Programit të Studimit	Bachelor, Master Profesional, Master i Shkencave etj.
9) Forma e Studimit	Me kohë të plotë, me kohë të zgjatur.
10) Data e Dorëzimit të Regjistrit	Data e dorëzimit të regjistrit.
11) Personi i Autorizuar për Tërheqjen	Emër, mbiemër dhe firmë e personit të autorizuar për të tërhequr regjistrin.
12) Nr. Personal i Personit të Autorizuar	Numri personal i kartës së identitetit të personit të autorizuar për të tërhequr regjistrin.
13) Akti i hapjes së Programit të Studimit	Për IAL publike shënohet: numri dhe data e VKM së hapjes ose urdhrit të Ministrit (hapje / riorganizim programi studimi). Në rast se programi nuk është hapur me një nga këto akte të shënohet VKM me të cilën janë akorduar kuota për vitin akademik në vijim. Për IAL private shënohet: numri dhe data e VKM së hapjes, urdhër i Ministrit (hapje / riorganizim programi studimi).
14) Akti i akreditimit të parë dhe periodik të Programit të Studimit	Për IAL kërkohet Akti i akreditimit të parë dhe periodik të Programit të Studimit
15) Punonjësi i Autorizuar për Dorëzimin	Emër dhe mbiemër i punonjësit të autorizuar për dorëzimin e regjistrit.
16) Nr. Personal i Punonjësit të Autorizuar	Numri personal i kartës së identitetit të personit të autorizuar për të dorëzuar regjistrin.

SHTOJCA NR. 2

TË DHËNAT E REGJISTRIT THEMELTAR TË STUDENTËVE

1. Numri rendor i rekordit të plotësuar:
2. Emërtimi i IAL-së:
3. Emërtimi i Njësisë Kryesore:
4. Emërtimi i programit të studimit:
5. Cikli i studimeve: Cikli i parë i studimeve, cikli i dytë i studimeve, Cikli i tretë i studimeve;
6. Lloji i programit të studimit: Bachelor, Master Profesional, Master i Shkencave etj.;
7. Forma e studimit: Me kohë të plotë, me kohë të zgjatur;
8. Numri i regjistrit: Numri i regjistrit që përcaktohet në momentin e tërheqjes së regjistrit, bazuar në numrin e regjistrimit të tij në regjistrin e QSHA;
9. Numri i Matrikullimit: Numri i Matrikullimit dhënë nga QSHA;
10. Emri;
11. Atësia;
12. Mbiemri;
13. Datëlindja;
14. Gjinia:
15. Gjendja civile:
16. Vendlindja
17. Shtetësia:
18. Data dhe Nr. i Certifikatës së mbrojtjes së Gjuhës Shqipe: Për shtetasit e huaj.
19. Adresa e vendbanimit në Republikën e Shqipërisë:
20. Telefon;
21. E-mail;
22. Gjuha e huaj e mbrojtur:
23. Emri i shkollës së mesme ku ka kryer studimet parauniversitare:

24. Emri i IAL-së ku ka kryer studimet e ciklit të parë:

25. Emri IAL-së ku ka kryer studimet e ciklit të dytë:
26. ID e Maturës Shtetërore / Nr. Regjistri i veçantë: Numri i Regjistrit të veçantë është për të diplomuarit para vitit 2010;
27. Lloji i dokumentit të identifikimit:
28. Numri personal i identitetit / Nr. i dokumentit të identifikimit;

29. Data e regjistrimit: Data e regjistrimit të studentit në programin përkatës të studimit pranë kësaj IAL-je.
30. Lloji i regjistrimit: 1- Regjistruar si program i parë studimi; 2- Regjistruar si program i dytë studimi i të njëjtit lloj dhe cikël; 3- Regjistruar si transferim;
31. Numri i matrikullimit të mëparshëm: Për studentët e transferuar.
32. IAL-ja nga është transferuar: Të plotësohet vetëm për studentët e transferuar;
33. Data e regjistrimit në programin e studimit në IAL-në nga është transferuar: Data e regjistrimit të studentit në programin përkatës të studimit në IAL-në nga ku është transferuar;
34. Numri dhe data e vendimit të Komisionit të Njohjes së sasisë së krediteve ECTS dhe viteve akademike.
35. Emër Mbiemër Firmë e Personit të Autorizuar që hodhi të dhënat në kolonat 1-34;
36. Emër Mbiemër Firmë e Kryesekretarit pas plotësimit të kolonës 34;
37. Data e ndërprerjes së studimeve/Data e rifillimit të studimeve/Data e çregjistrimit;
38. Të dhënat për çregjistrimin: Data dhe referencat e aktit që ka përcaktuar çregjistrimin.
39. Emër, Mbiemër, Firmë e personit te autorizuar që hodhi të dhënat e kolonave 37-38;
40. Emër, Mbiemër, Firmë e kryesekretarit pas plotësimit të kolonës 38;
41. Statusi i studentit;
42. Shënime.

SHTOJCA NR. 3
REGJISTRI THEMELTAR I STUDENTËVE

---

2. **Emërtimi i IAL: _____**

3. **Emërtimi i Njësisë Kryesore: _____**

4. **Emërtimi i Programit të Studimit: _____**

5. **Cikli i studimeve: _____**

6. **Lloji i Programit të Studimit: _____**

7. **Forma e Studimit: _____**

8. **Nr. i regjistrit themeltar: _____**

2. Emërtimi i IAL-së: _____; 3. Emërtimi i Njësisë Kryesore: _____; 4. Emërtimi i Programit të Studimit: _____;

5. Cikli i studimeve: _____6. Lloji i Programit të Studimit: _____; 7. Forma e studimit: _____; 8. Nr. i regjistrit themeltar: _____;

1	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27
Nr. Rendor	Nr. i Matrikullimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Gjendja Civile	Vendlindja Qytet/Fshat, Bashkia/Komuna, Rrethi	Shtetësia	Data dhe Nr. i certifikatës së mbrojtjes së Gjuhës Shqipe	Adresa e Vendbanimit në RSH	Telefon	Email	Gjuha e huaj e Mbrojtur	Emri i shkollës së Mesme ku ka kryer studimet parauniversitare	Emri i IAL-së ku ka kryer studimet e Ciklit të Parë	Emri i IAL-së ku ka kryer studimet e Ciklit të Dytë	ID e Maturës Shtetërore/ Nr. i Regjistrit të Veçantë	Lloji i Dokumentit të Identifikimit

28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42
Numri Personal i Identitetit/ Numri i Dokumentit të Identifikimit	Data e Regjistrimit	Lloji i Regjistrimit	Numri i Matrikullimit të mëparshëm	IAL-ja nga është transferuar	Data e regjistrimit në programin e studimit në IAL-në nga është transferuar	Numri dhe data e vendimit të Komisionit të Njohjes së sasisë së krediteve ECTS dhe viteve akademike.	Emër Mbiemër Firmë e Personit të Autorizuar që hodhi të dhënat në kolonat 1-34	Emër Mbiemër Firmë e Kryesekretarit pas plotësimit të kolonës 34	Data e ndërprerjes së studimeve/Data e rifillimit të studimeve/Data e çregjistrimit;	Të dhëna për çregjistrimin	Emër Mbiemër Firmë e Personit të Autorizuar që hodhi të dhënat në kolonat 37-38	Emër Mbiemër Firmë e Kryesekretarit pas plotësimit të kolonës 38	Statusi i studentit	Shënime

UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E REGJISTRIT THEMELTAR

1. Numri rendor i rekordit të plotësuar: Duhet të plotësohet me shkrim dore për çdo rekord dhe të jetë në rend rritës sipas kohës së paraqitjes së studentit për regjistrim;
2. Emërtimi i IAL-së: Emërtimi i IAL sipas aktit të hapjes / licencimit;
3. Emërtimi i Njësisë Kryesore: Emërtimi i fakultetit sipas aktit të hapjes / licencimit / riorganizimit;
4. Emërtimi i programit të studimit: Emërtimi i programit të studimit sipas aktit të hapjes / riorganizimit;
5. Cikli i studimeve: Cikli i parë i studimeve, cikli i dytë i studimeve, Cikli i tretë i studimeve;
6. Lloji i programit të studimit: Bachelor, Master Profesional, Master i Shkencave etj.;
7. Forma e studimit: Me kohë të plotë, me kohë të zgjatur;
8. Numri i regjistrit: Numri i regjistrit që përcaktohet në momentin e tërheqjes së regjistrit, bazuar në numrin e regjistrimit të tij në regjistrin e QSHA;
9. Numri i Matrikullimit: Numri i Matrikullimit dhënë nga QSHA;
10. Emri;
11. Atësia;
12. Mbiemri;
13. Datëlindja;
14. Gjinia: Të plotësohet M për meshkujt dhe F për femrat;
15. Gjendja civile: Beqar, i/e martuar, i/e divorcuar, i/e ve etj.;
16. Vendlindja Qytet/Fshat, Bashkia/Komuna, Rrethi;
17. Shtetësia: Për të huajt të shënohet dhe referencat e lejes së qëndrimit.
18. Data dhe Nr. i Certifikatës së mbrojtjes së Gjuhës Shqipe: Për shtetasit e huaj.
19. Adresa e vendbanimit në Republikën e Shqipërisë: Të plotësohet për të gjithë studentët.
20. Telefon;
21. E-mail;
22. Gjuha e huaj e mbrojtur: Gjuha e huaj dhe testimi, niveli i gjuhës së huaj të mbrojtur. Është e detyrueshme të plotësohet për studentët që ndjekin studime në një program studimi të miratuar në gjuhë të huaj dhe studentët që kanë detyrim dhënien e gjuhës së huaj për përfundimin e studimeve;
23. Emri i shkollës së mesme ku ka kryer studimet parauniversitare: Të shënohet për të gjithë studentët.

24. Emri i IAL-së ku ka kryer studimet e ciklit të parë: Të plotësohet për studentët që ndjekin ciklin e dytë ose të tretë të studimeve;
25. Emri IAL-së ku ka kryer studimet e ciklit të dytë: Të plotësohet për studentët që ndjekin ciklin e tretë të studimeve;
26. ID e Maturës Shtetërore / Nr. Regjistri i veçantë: Numri i Regjistrit të veçantë është për të diplomuarit para vitit 2010;
27. Lloji i dokumentit të identifikimit: Pasaportë / kartë identiteti;
28. Numri personal i identitetit / Nr. i dokumentit të identifikimit; Për shtetasit shqiptarë shënohet numri personal i kartës së identitetit të personit, për shtetasit e huaj numri i dokumentit të identitetit që njihet në Republikën e Shqipërisë dhe është përdorur për të hyrë në RSH;
29. Data e regjistrimit: Data e regjistrimit të studentit në programin përkatës të studimit pranë kësaj IAL-je.
30. Lloji i regjistrimit: 1- Regjistruar si program i parë studimi; 2- Regjistruar si program i dytë studimi i të njëjtit lloj dhe cikël; 3- Regjistruar si transferim;
31. Numri i matrikullimit të mëparshëm: Për studentët e transferuar.
32. IAL-ja nga është transferuar: Të plotësohet vetëm për studentët e transferuar;
33. Data e regjistrimit në programin e studimit në IAL-në nga është transferuar: Data e regjistrimit të studentit në programin përkatës të studimit në IAL-në nga ku është transferuar;
34. Numri dhe data e vendimit të Komisionit të Njohjes së sasisë së krediteve ECTS dhe viteve akademike.
35. Emër Mbiemër Firmë e Personit të Autorizuar që hodhi të dhënat në kolonat 1-34;
36. Emër Mbiemër Firmë e Kryesekretarit pas plotësimit të kolonës 34;
37. Data e ndërprerjes së studimeve/Data e rifillimit të studimeve/Data e çregjistrimit;
38. Të dhënat për çregjistrimin: Data dhe referencat e aktit që ka përcaktuar çregjistrimin.
39. Emër, Mbiemër, Firmë e personit te autorizuar që hodhi të dhënat e kolonave 37-38;
40. Emër, Mbiemër, Firmë e kryesekretarit pas plotësimit të kolonës 38;
41. Statusi i studentit;
42. Shënime.

SHTOJCA NR. 4
REGJISTRI I ARRITJEVE AKADEMIKE

---

2. **Emërtimi i IAL: _____**

3. **Emërtimi i Njësisë Kryesore: _____**

4. **Emërtimi i Programit të Studimit: _____**

5. **Cikli i studimeve: _____**

6. **Lloji i Programit të Studimit: _____**

7. **Forma e Studimit: _____**

8. **Nr. i regjistrit themeltar: _____**

2. Emërtimi i IAL-së: _____; 3. Emërtimi i Njësisë Kryesore: _____; 4. Emërtimi i Programit të Studimit: _____;

5. Cikli i studimeve: _____6. Lloji i Programit të Studimit: _____; 7. Forma e studimit: _____; 8. Nr. i regjistrit themeltar: _____;

1	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39
Nr. Rendor	Nr. i Matrikullimit	Emri Atesia Mbiemri	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda	Lënda

73		Shënime
72		Emër Mbiemër Firmë e Kryesekretares pas plotësimit të kolonës 72
71		Emër Mbiemër Firmë e Personit të Autorizuar që hodhi të dhënat në kolonat 1-71
70		Lënda që përmirësohet vlerësimi
69		Lënda që përmirësohet vlerësimi
68		Lënda që përmirësohet vlerësimi
67		Lënda që përmirësohet vlerësimi
66		Lënda që përmirësohet vlerësimi
65		Lënda që përmirësohet vlerësimi
64		Lënda
63		Lënda
62		Lënda
61		Lënda
60		Lënda
59		Lënda
58		Lënda
57		Lënda
56		Lënda
55		Lënda
54		Lënda
53		Lënda
52		Lënda
51		Lënda
50		Lënda
49		Lënda
48		Lënda
47		Lënda
46		Lënda
45		Lënda
44		Lënda
43		Lënda
42		Lënda
41		Lënda
40		Lënda

UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E REGJISTRIT TË ARRITJEVE AKADEMIKE

1. Numri rendor i rekordit të plotësuar: Duhet të plotësohet me shkrim dore për çdo rekord dhe të jetë në rend rritës sipas kohës së paraqitjes së studentit për regjistrim;

2. Emërtimi i IAL-së: Emërtimi i IAL sipas aktit të hapjes / licencimit;

3. Emërtimi i Njësisë Kryesore: Emërtimi i fakultetit sipas aktit të hapjes / licencimit / riorganizimit;

4. Emërtimi i programit të studimit: Emërtimi i programit të studimit sipas aktit të hapjes / riorganizimit;

5. Cikli i studimeve, cikli i parë, cikli i dytë, cikli i tretë

6. Lloji i programit të studimit: Bachelor, Master Profesional, Master i Shkencave etj.;

7. Forma e studimit: Me kohë të plotë, me kohë të zgjatur;

8. Numri i regjistrit: Numri i regjistrit që përcaktohet në momentin e tërheqjes së regjistrit, bazuar në numrin e regjistrimit të tij në regjistrin e QSHA;

9. Numri i Matrikullimit: Numri i Matrikullimit dhënë nga QSHA;
10. Emri Atësia Mbiemri

11. Lënda 1 : shkruhet vlerësimi (me notë dhe fjalë) që ka marrë studenti

11 - 64: Lënda 2 -64: shkruhet vlerësimi (me notë dhe fjalë) që ka marrë studenti

65 - 70: Lënda / lëndët që përmirëson studenti shkruhet vlerësimi (me notë dhe fjalë) që ka marrë studenti

72. Emër, Mbiemër, Firmë e personit te autorizuar që hodhi të dhënat e kolonave 1-70;

73. Emër Mbiemër Firmë e Kryesekretares pas plotësimit të kolonës 70
74. Shënime

SHTOJCA NR. 5
TË DHËNAT PËR PLOTËSIMIN E REGJISTRIT TË ARRITJEVE AKADEMIKE

1. Numri rendor i rekordit të plotësuar:

2. Emërtimi i IAL-së:

3. Emërtimi i Njësisë Kryesore:

4. Emërtimi i programit të studimit:

5. Cikli i studimeve,

6. Lloji i programit të studimit:

7. Forma e studimit:

8. Numri i regjistrit:

9. Numri i Matrikullimit:
10. Emri Atësia Mbiemri

11. Lënda 1 : shkruhet vlerësimi (me notë dhe fjalë) që ka marrë studenti

11 - 64: Lënda 2 -64: shkruhet vlerësimi (me notë dhe fjalë) që ka marrë studenti

65 - 70: Lënda / lëndët që përmirëson studenti shkruhet vlerësimi (me notë dhe fjalë) që ka marrë studenti

72. Emër, Mbiemër, Firmë e personit te autorizuar që hodhi të dhënat e kolonave 1-70;

73. Emër Mbiemër Firmë e Kryesekretares pas plotësimit të kolonës 70

74. Shënime

SHTOJCA NR. 6
REGJISTRI I LËSHIMIT TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE

---

2. **Emërtimi i IAL: _____**

3. **Emërtimi i Njësisë Kryesore:**

   _____

4. **Emërtimi i Programit të Studimit: _____**

5. **Cikli i studimeve: _____**

6. **Lloji i Programit të Studimit: _____**

7. **Forma e Studimit: _____**

8. **Nr. i regjistrit themeltar:**

   _____

2. Emërtimi i IAL-së: _____; 3. Emërtimi i Njësisë Kryesore: _____; 4. Emërtimi i Programit të Studimit: _____;

5. Cikli i studimeve: _____6. Lloji i Programit të Studimit: _____; 6. Forma e studimit: _____; 7. Nr. i regjistrit themeltar: _____;

SHTOJCA NR. 7
TË DHËNAT E REGJISTRIT TË LËSHIMIT TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE

1. Numri rendor i rekordit të plotësuar: Duhet të plotësohet me shkrim dore për çdo rekord dhe të jetë në rend rritës sipas kohës së paraqitjes së studentit për regjistrim;
2. Emërtimi i IAL-së: Emërtimi i IAL sipas aktit të hapjes / licencimit;
3. Emërtimi i Njësisë Kryesore: Emërtimi i fakultetit sipas aktit të hapjes / licencimit / riorganizimit;
4. Emërtimi i programit të studimit: Emërtimi i programit të studimit sipas aktit të hapjes / riorganizimit;
5. Cikli i studimeve: Cikli i parë i studimeve, cikli i dytë i studimeve, Cikli i tretë i studimeve;
6. Lloji i programit të studimit: Bachelor, Master Profesional, Master i Shkencave etj.;
7. Forma e studimit: Me kohë të plotë, me kohë të zgjatur;
8. Numri i regjistrit: Numri i regjistrit që përcaktohet në momentin e tërheqjes së regjistrit, bazuar në numrin e regjistrimit të tij në regjistrin e QSHA;
9. Akti i akreditimit të parë dhe periodik të IAL-së;
10. Akti i akreditimit të parë dhe periodik të programit të studimit;
11. Emri;
10. Atësia;
11. Mbiemri;
12. Numri personal i identitetit / Nr. i dokumentit të identifikimit;
13. Emër Mbiemër Firmë e Personit të Autorizuar që hodhi të dhënat në kolonat 1-12;
14. Emër Mbiemër Firmë e Kryesekretarit pas plotësimit të kolonës 12;
15. Data e diplomimit: Korrespondon me datën e mbrojtjes së temës së diplomës, apo mbylljes përfundimtare të programit të studimit në rastet kur nuk parashikohet mbrojtje e temës së diplomës.
16. Numri i diplomës: Është numri i shënuar në diplomën që do i jepet studentit në përfundim të studimeve.
17. Tërheqja e diplomës: Data dhe të dhënat e personit që e tërhoqi diplomën (Emër, mbiemër, Nr. dokumenti identifikimi).
18. Emër, Mbiemër, Firmë e personit te autorizuar që hodhi të dhënat e kolonave 14-17;
19. Emër, Mbiemër, Firmë e kryesekretarit pas plotësimit të kolonës 17;
20. Statusi i studentit, i diplomuar;
21. Shënime.

U DH Ë Z I M
NR. 17, datë 30.7.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.10, DATË 15.05.2019, "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTE TË STUDIMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"

U DH Ë Z O J:

I. Titulli i Udhëzimit nr.10, datë 15.05.2019, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë", ndryshon si më poshtë:
"Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë".

II. Pas Kreut IV, shtohen Krerët IV/1, IV/2, IV/3, IV/4, IV/5 dhe IV/6, si më poshtë:

"Kreu IV/1
Procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë.

1. *Kandidatët që kërkojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve*

   me karakter profesional si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, kanë të drejtë të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, në datat e përcaktuara në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi.

2. *Kandidatët që aplikojnë në IAL, për program të dytë studimi apo transferim studimesh kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 programe studimi përpara fillimit të vitit akademik dhe sipas afateve të përcaktuara në shtojcën nr.10 të këtij udhëzimi.*

3. *Kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin përkatës akademik.*

4. *Në rastet e transferimit të studimeve nga brenda ose jashtë vendit, në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit, brenda të njëjtit cikël, studentët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave të vitit akademik që studenti është pranuar në institucionin e arsimit të lartë, duke filluar nga viti akademik 2016-2017 dhe në vijim.*

5. *Nuk mund të pranohen aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Kandidatët që aplikojnë për transferim të studimeve apo për program të dytë studimi duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit për të cilët aplikojnë. Kandidati nuk duhet të jetë duke ndjekur një tjetër program studimi.*

6. *Aplikimi për transferim studimesh, mund të bëhet nga një program studimi i njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtit cikël edhe lloj, të ndjekur nga kandidati në IAL-të publike ose në IAL-të jopublike të licencuara dhe të akredituara për programin përkatës të studimit, vendase apo të huaja.*

7. *Nuk mund të kryhen transferime studimesh nga një nivel cikli studimesh apo të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve në një tjetër. Në këtë kuadër nuk mund të kryhen transferime studimesh nga programet e studimeve dy-vjeçare me karakter profesional në programe të ciklit të parë "Bachelor" dhe në programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave".*

8. *Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë për transferim të studimeve, paraqesin, pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve, dokumentet si më poshtë:*

   a) *Kërkesën drejtuar IAL–së për programin e studimit, në të cilin do të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit sipas shtojcës nr.6).*
   b) *Planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse.*
   c) *Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur.*

      Studentët që transferojnë studimet e tyre nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse dhe listën e notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, duhet t'i dorëzojnë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin.

d) Fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme (Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011). Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës se mesme dhe të vërtetuar në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar/ Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar (DRAP/ZVAP) përkatëse, ose listën e notave të shkollës se mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit.

e) Fotokopje të dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë.

f) Dy fotografi personale.

g) Kopje të mandat-pagesës.

9. Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në IAL (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet edhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

i. Emrin, Atësinë, Mbiemrin;
ii. Datëlindjen:
iii. Vendlindjen;
iv. Shtetësinë:
v. Numrin e matrikullimit që ka pasur në IAL-në përcjellëse;
vi. Emrin e shkollës së mesme/IAL-së ku ka kryer shkollën//studimet përpara ndjekjes së këtij programi studimi;
vii. ID-në e Maturës Shtetërore / nr. Regj. të veçantë[75];
viii. Numrin personal të identitetit;
ix. Datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja;
x. Emërtimin e programit të studimit dhe fakultetit përkatës;
xi. Ciklin dhe formën e studimit;
xii. Datën e ndërprerjes së studimeve.

10. Kandidati që aplikon për program të dytë studimi paraqet dokumentacionin e mëposhtëm

pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve:

a) Kërkesa drejtuar IAL–së për programin e studimit, në të cilin aplikon për program të dytë studimi (ose formulari i aplikimit sipas shtojcës 6).

b) Kopje e noterizuar e diplomës së studimeve universitare të kryera më parë, të shoqëruar me suplementin e diplomës.

c) Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse).

[75] *Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme para vitit 2006*

d) Fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme (kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011). Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës se mesme dhe të vërtetuar në DRAP/ZVAP përkatëse, ose listën e notave të shkollës se mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit.

e) Fotokopje të dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

f) Dy fotografi personale.

Njohja e dokumentacionit të kandidateve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.

11. *IAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi.*

12. *Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kritereve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e fakultetit të IAL-së, si dhe në faqet ëeb përkatëse, e plotësuar sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr.8, të këtij udhëzimi.*

    IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

13. *Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.*

14. *IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi.*

15. *Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore në datat e përcaktuara në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi, sipas dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi.*

16. *IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (në vijim QSHA) listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format EXCEL me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.*

17. *Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës nr.1, të këtij udhëzimi.*

Kreu IV/2

Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë.

1. *Kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian, aplikojnë pranë IAL-ve, në datat e përcaktuara në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL-të.*

2. *Kandidatët që aplikojnë në programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimi, aplikojnë pranë IAL-ve respektive, deri më datën e përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi. Në të njëjtën datë, IAL-të shpallin listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në konkurs, të cilat bëhet publike në mjediset e IAL-ve dhe faqet elektronike zyrtare. Konkurset e pranimit zhvillohen në datat e përcaktuara në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi.*

3. *Aplikimi të kryhet vetëm nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në vendimin e Këshillit të*

Ministrave për vitin e ri akademik, si dhe plotësojnë kriteret shtesë të pranimit të vendosura nga vetë IAL-të për programet e studimit për të cilët aplikojnë.

4. *Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.*

5. *Kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian, përpara aplikimit, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilit aplikon.*

6. *Aplikimi për programet e studimit në IAL dërgohet me postë pranë sekretarive mësimore ose depozitohet në zyrën e protokollit të njësive kryesore të IAL-ve.*

7. *Sekretaritë mësimore mbajnë regjistër për aplikimet e depozituara. Me depozitimin e aplikimit, njësitë kryesore përllogarisin mesataren për çdo kandidat në përputhje me përcaktimet në vendimin e Këshillit të Ministrave për vitin e ri akademik. Kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare njoftohen nga sekretaritë mësimore për ndërprerjen e aplikimit.*

8. *Kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian, në momentin e aplikimit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:*

   a) *Kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, dorëzojnë:*
      i. *Formularin e aplikimit sipas formatit të shtojcës nr.2, të këtij udhëzimi.*
      ii. *Kopje të dokumentit të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që vërteton se diploma e arsimit të mesëm është njohur, të shoqëruar me fotokopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave.*
      iii. *Në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-së, deklaratën sipas shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi, si dhe kopje të noterizuar në Republikën e Shqipërisë (dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nëse është lëshuar në gjuhë të huaj), të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet. Përllogaritja e notave do të kryhet sipas udhëzimit nr.44, datë 21.08.2013, "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit", i ndryshuar. Në rast se kandidati/ja ka përfunduar shkollën e mesme në Shqipëri, dorëzon kopje të noterizuar të Maturës Shtetërore;*
      iv. *Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit.*

v. *Dy fotografi.*
vi. *Kopje të mandat-pagesës.*

b) *Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian, dorëzojnë:*
   i. *Formularin e aplikimit sipas formatit të shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi.*
   ii. *Kopje të diplomës/dëftesës, të shoqëruar me listën e notave.*
   iii. *Në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-së, deklaratën sipas shtojcës nr.5, të këtij udhëzimi si dhe kopje të njësuar me origjinalin, të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë kopje të njësuar me origjinalin e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore të lëshuar nga QSHA-ja dhe dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në DRAP/ZVAP-në përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit.*
   iv. *Fotokopje të dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).*
   v. *Dy fotografi personale.*
   vi. *Kopje të mandat-pagesës.*

c) *Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8, të këtij kreu duhet të dorëzojnë edhe kopje të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të njësuar me origjinalin të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (në vijim KMCAP).*

d) *Kandidatët me statusin e jetimit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8, të këtij kreu duhet të dorëzojnë edhe kopje të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.*

e) *Kandidatët romë dhe egjiptianë, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8, të këtij kreu duhet të dorëzojnë edhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian. Për përzgjedhjen e kandidatëve romë dhe egjiptianë, IAL-të marrin edhe ekspertizën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.*

f) *Në rastet e aplikimeve nga kandidatët nga kategori të tjera të personave me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8, të këtij kreu duhet të dorëzojnë dhe kopje të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).*

Njohja e dokumentacionit të kandidateve fitues, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.

9. *IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kritereve të përcaktuara nga ana e tyre, si dhe për çdo program studimi që ofrojnë, ato publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. Gjithashtu IAL-të në datën e përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre elektronike zyrtare listën jo përfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.*

10. *Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit brenda tre ditëve kalendarike nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.*

11. *IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën e përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.*

12. *Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi.*

13. *Pas datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi, sekretaritë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve, për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.*

14. *IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit.*

15. *IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi dërgojnë pranë QSHA-së listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format EXCEL me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj*

date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

Kreu IV/3

Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve shtetas të huaj, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë.

1. *Të gjithë kandidatët shtetas të huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në IAL, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, në datat e përcaktuara në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL-ja.*

2. *Kandidatët shtetas të huaj duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe të jenë të pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor, nuk duhet të rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi në IAL-të publike dhe/ose jopublike, të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga IAL-të, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.*

3. *Kandidatët shtetas të huaj, përpara aplikimit kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilit aplikon. Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.*

4. *Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.*

5. *Studentët e huaj duhet të paraqesin pranë IAL-ve dokumentacionin e mëposhtëm:*
   a) *Formuarin e aplikimit sipas shtojcës nr.2, të këtij udhëzimi.*
   b) *Kopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave, të njehsuar nga QSHA-ja.*
   c) *Fotokopjen e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).*
   d) *Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet*

   në gjuhen shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe.

e) Dy fotografi personale.
f) Kopjen e mandat-pagesës.
g) Autorizimin për trajtimin e të dhënave personale sipas shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi.

6. *IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kritereve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të në datën e përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre elektronike zyrtare listën jo përfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.*

7. *Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit brenda tre ditëve kalendarike nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.*

8. *IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën e përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.*

9. *Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi. Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të heqë dorë për tu regjistruar në një program tjetër studimi.*

10. *Pas datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi, sekretaritë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.*

11. *IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues.*

12. *Sekretaritë mësimore të IAL-ve do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit.*

13. *Procedurat e regjistrimit për programet e përbashkëta të ciklit të parë dhe të dytë të integruar:*
    a) Zhvillimi i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimit objekt të këtij udhëzimi, në IAL-të që i zhvillojnë këto programe, si programe të përbashkëta studimi, që përfundojnë me një diplome të përbashkët, të dyfishte ose të shumëfishtë, në

bashkëpunim me IAL-të e vendeve të BE-së, kryhet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuar nga vetë IAL-të.

b) *Njohja e dokumentacionit të kandidateve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen regjistrimin e tyre përfundimtar me statusin e studentit dhe brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi ia komunikon IAL-së.*

c) *Kandidatët që aplikojnë në programet e përbashkëta të studimit e paraqesin aplikimin e tyre pranë IAL-se përkatëse. Të dhënat e tyre i dërgohen QSHA-së nga IAL-ja në përfundim të procesit të regjistrimit të aplikimeve. Pas zhvillimit te konkurseve/testimeve të pranimit, IAL-ja i dërgon QSHA-së listat e fituesve dhe të dhënat e tyre, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të nevojshëm për zhvillimin e procedurave te njohjes së diplomës.*

d) *Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm në institucione arsimore në të njëjtën gjuhë të huaj që zhvillohet edhe programi i përbashkët i integruar i studimit i ciklit të dytë i IAL-së ku aplikon, përjashtohen nga detyrimi i mbrojtjes së kësaj gjuhe sipas përcaktimeve në pikën 4, të nenit 76, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".*

e) *Sekretaritë mësimore të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.*

f) *IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi dërgojnë pranë QSHA-së listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format EXCEL me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.*

Kreu IV/4
Pranimet në ciklin e dytë të studimeve "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/ "Master i arteve"

1. *Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IAL-të publike dhe jopublike, përkatësisht deri në datat e përcaktuara në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi.*

2. *Brenda datave përkatëse të përcaktuara në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi, IAL-të publike dhe jopublike, të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet elektronike zyrtare (ëeb) të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.*

3. *Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.*

4. *Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve publike dhe jopublike, përkatësisht deri në datat e përcaktuara në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi.*

5. *IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj elektronike zyrtare (*ëeb*), listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datave përkatëse të përcaktuara në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi për IAL-të publike dhe jopublike.*

6. *Njësitë kryesore të IAL-ve, organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë dhe verifikimin e dokumentacionit të pranimit sipas kuadrit ligjor në fuqi. Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.*

7. *Pranimi, në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve", sipas kuotave respektive të deklaruara nga IAL-të, realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga ato, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kritereve të përcaktuara paraprakisht dhe të bëra publike paraprakisht.*

8. *Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë, kandidatët që:*
   a) *kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit, dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose;*
   b) *janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njësimin e diplomës pranë QSHA-së brenda muajit të përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi.*

9. *Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:*

a) *Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.*
b) *Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr.876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar", paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose fotokopje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave.*
c) *Formularin e aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr.5, të këtij udhëzimi.*
d) *Fotokopjen e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).*
e) *Dy fotografi personale.*

10. Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:

a) *Dëshmi e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit te Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.*
   Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.
b) *Curriculum Vitae;*
c) *Deklaratën sipas shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi.*

11. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:

a) *Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të KMCAP-së.*

b) Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

c) Kandidati rom dhe ballkano-egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian.

12. Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (Statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.

13. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

14. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA-ja pas verifikimit i bën me dije IAL-ve mbi mospajisjen me numër matrikullimi.

15. IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si dhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

16. IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi dërgojnë pranë QSHA-së listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format EXCEL me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

17. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi.

Kreu IV/5

Procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë

1. *Kandidatët që kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve kanë të drejtë të aplikojnë pranë IAL-ve, në datat e përcaktuara në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi.*

2. *Kandidatët që aplikojnë në IAL, për program të dytë studimi apo transferim studimesh kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 programe studimi përpara fillimit të vitit akademik dhe sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.*

3. *Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë për program të dytë studimi, kandidatët që:*
   a) *kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë "Bachelor" apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit dhe i akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose,*
   b) *janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor", ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë QSHA-së.*

4. *Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë për transferim studimesh të gjithë kandidatët që:*
   a) *kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në germën "a", të pikës 3, të këtij kreu, në një program të ciklit të parë "Bachelor", apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë brenda ose jashtë vendit të akredituar në momentin e transferimit;*
   b) *janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor", apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, kanë kryer njësimin e diplomës pranë QSHA-së, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë të akredituar në momentin e transferimit brenda ose jashtë vendit.*

5. *Transferimi i studimeve në ciklin e dytë mund të bëhet në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtit cikël dhe lloj sipas kritereve të vendosura dhe shpallura publikisht paraprakisht nga IAL-ja.*

6. *IAL-të nuk mund të pranojnë aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Transferimi i studimeve do të kryhet në zbatim të procedurave dhe afateve të parashikuara në këtë udhëzim.*

7. *Kandidati që aplikon për program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e*

mëposhtëm:

a) *Diplomën, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.*
b) *Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr.876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr.78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar", paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP).*

   Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave.
c) *Formularin i aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr.8, të këtij udhëzimi.*
d) *Fotokopjen e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);*
e) *Dy fotografi personale.*

8. *Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:*
   a) *Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit te Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.*
   b) *Curriculum Vitae;*
   c) *Deklaratën sipas shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi.*

9. *Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh:*
   a) *Kërkesën drejtuar IAL-së për programin e studimit, në të cilin kërkon të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit).*
   b) *Planin e plotë të programit të studimit nga ku transferohet.*

c) Vërtetim të listës së notave, krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer në ciklin e dytë të studimeve, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin eventual të lëndëve të programit të studimit të ndjekur, si dhe programeve/syllabuseve përkatëse të lëndëve të shlyera.

10. Kandidati duhet të paraqesë në momentin e regjistrimit edhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

i. Emrin, Atësinë, Mbiemrin;
ii. Datëlindjen;
iii. Vendlindjen;
iv. Shtetësinë;
v. Numrin e matrikullimit që ka pasur në programin e studimit të ciklit të parë;
vi. Emërtimin e IAL-së dhe i programit të studimit të ciklit të parë, si dhe forma e studimit;
vii. Numrin i matrikullimit, si dhe emërtimi i programit të studimit të ciklit të dytë dhe fakultetit përkatës në IAL-në nga ku transferohet;
viii. Ciklin dhe forma e studimit;
ix. Datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja nga ku transferohet;
x. Datën e ndërprerjes së studimeve;

11. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi:

a) Fotokopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë të diplomës universitare të ciklit të dytë të studimeve, së bashku me suplementin e diplomës ose listën e notave. Për diplomat e fituara jashtë vendit, duhet të dorëzojë dhe vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë.
b) Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse, vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për njohjen e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse, nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse.

12. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:

a) Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar, duhet të dorëzojë edhe fotokopjen e noterizuar të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të KMCAP-së.
b) Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.
c) Kandidati rom dhe ballkano-egjiptian, duhet të dorëzojë edhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian.

13. Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që

plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (Statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.

14. *Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.*

15. *Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL-të publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA-ja pas verifikimit i bën me dije IAL-të, mbi mospajisjen me mumër matrikullimi.*

16. *IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.*

17. *Komisionet respektive kryejnë renditjen e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh apo program të dytë studimi bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, dhe vlerëson kandidatët me statusin fitues/jo fitues. Këto të dhëna shpallen nga dekanati përkatës në ambientet e fakultetit dhe IAL-së, si dhe faqet elektronike zyrtare përkatëse (ëeb), të plotësuara sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr.9, të këtij udhëzimi, respektivisht, për kandidatët që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe për kandidatët që kanë aplikuar për program të dytë studimi.*

18. *IAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi.*

19. *Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kritereve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e fakultetit të IAL-së, si dhe faqet elektronike zyrtare përkatëse(ëeb), e plotësuar sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr. 8, të këtij udhëzimi.*
    IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për

programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

20. *Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.*

21. *IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi.*

22. *Regjistrimi i kandidatit, i cili mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij, kryhet pranë sekretarive mësimore në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi.*

23. *IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi dërgojnë pranë QSHA-së listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format EXCEL me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.*

24. *Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi.*

Kreu IV/6
Pranimet në ciklin e tretë të studimeve "Master ekzekutiv"

1. *Aplikimet në programet e studimit të ciklit të tretë "Master ekzekutiv" me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IAL-të publike dhe jopublike, përkatësisht deri në datat e përcaktuara në shtojcën nr.10 të këtij udhëzimi.*

2. *Brenda datave përkatëse të përcaktuara në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi, IAL-të publike dhe jopublike, të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet elektronike zyrtare (ëeb) të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.*

3. *Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin*

brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

4. *Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve publike dhe jopublike, përkatësisht deri në datat e përcaktuara në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi.*

5. *IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj elektronike zyrtare (ëeb), listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datave përkatëse të përcaktuara në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi për IAL-të publike dhe jopublike.*

6. *Njësitë kryesore të IAL-ve, organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë dhe verifikimin e dokumentacionit të pranimit sipas kuadrit ligjor në fuqi. Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.*

7. *Pranimi, në programet e studimit të ciklit të tretë, me kohë të plotë, "Master ekzekutiv", sipas kuotave respektive të deklaruara nga IAL-të, realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga ato, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kritereve të përcaktuara nga njësitë bazë, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe të bëra publike paraprakisht.*

8. *Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të tretë "Master ekzekutiv", kandidatët që:*
   a) *kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të dytë "Master i shkencave"/"Master i arteve", i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose*
   b) *janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave"/"Master i arteve", i licencuar dhe akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njësimin e diplomës pranë QSHA-së brenda muajit të përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi.*

9. *Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:*
   a) *Diplomën, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave"/"Master i arteve" të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave"/"Master i arteve" të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare të ciklit të tretë në vendin përkatës.*
   b) *Diplomën, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve "Bachelor" të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të parë të studimeve "Bachelor" të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës*

të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare të ciklit të tretë në vendin përkatës.

c) Vërtetimin për njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Nëse aplikanti ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

d) Formularin e aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr.5, të këtij udhëzimi.

e) Fotokopjen e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

f) Dy fotografi personale.

10. Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:

a) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit te Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.

Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

b) Curriculum Vitae;

c) Deklaratën sipas, shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi.

11. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:

a) Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar duhet të dorëzojë edhe fotokopjen e noterizuar të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të KMCAP-së.

b) Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

c) Kandidati rom dhe ballkano-egjiptian, duhet të dorëzojë edhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian.

12. Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (Statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.

13. *Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.*

14. *Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA-ja pas verifikimit i bën me dije IAL-të mbi mospajisjen me numër matrikullimi.*

15. *IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshëm për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.*

16. *IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi dërgojnë pranë QSHA-së listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format EXCEL me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.*

17. *Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi".*"

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

MINISTËR

BESA SHAHIN

Shtojca nr. 2

<u>Deklaratë</u>

Unë i nënshkruari _____ , lindur më _____
emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

1. *Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____ Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre.*

Autorizoj, gjithashtu institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. *Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.*
3. *Deklaroj se jam njohur me këtë udhëzim si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në të për të aplikuar për transferim studimesh/program të dytë studimi.*
4. *Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.*
5. *Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.*

_____	_____
Emër Atësi Mbiemër i kandidatit	*Emër Mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore*
Firma	*Firma*

Vendi: _____ *Data:* ____ . ____. _____

Shtojca nr. 3 *Data: ____/____/____*

<u>Formular aplikimi</u>

Unë i nënshkruari _____ , lindur më _____
emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

e-mail: _____, Tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të parë / profesional / integruar i ciklit të dytë _____ në IAL _____.

1. *Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët*
   a)me kombësi shqiptare nga trojet (të shënohet me "x" vendi nga vjen kandidati):
   - □ *Republika e Kosovës;*
   - □ *Mal i Zi;*
   - □ *Maqedonia e Veriut;*
   - □ *Preshevë;*
   - □ *Bujanovci;*
   - □ *Medvegja;*

   b) e huaj

   Me shtetësi _____

   Gjuhë amtare_____

   Me arsim të mesëm _____

   Adresë aktuale _____
2. *Autorizoj institucionin e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.*
3. *Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në njërin nga programet e studimit në të cilin do të shpallem fitues për vitin akademik në vijim.*
4. *Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.*
5. *Deklaroj se jam njohur me Udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.*
6. *Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.*

Emër Atësi Mbiemër kandidatit

Firma

Shtojca nr. 4 *Data: ____/____/____*

<u>Formular aplikimi</u>

Unë i nënshkruari _____ , lindur më _____
emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____, e-mail_____ celular_____.

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit _____ në IAL _____.

1. *Deklaroj se jam (të shënohet me "x" kategoria):*
   □ të tjerë (PAK)
   □ jetim;
   □ Rom;
   □ Egjiptian.
2. *Autorizoj institucionet e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.*
3. *Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në njërin nga programet e studimit në të cilin do të shpallem fitues për vitin akademik në vijim.*
4. *Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.*
5. *Deklaroj se jam njohur me Udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.*
6. *Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.*

Emër Atësi Mbiemër kandidatit

Firma

Shtojca nr. 5

Deklaratë

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____,
me kartë identiteti, pasaportë nr. _____,

1. Autorizoj Institucionin e Arsimit të Lartë _____, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu Institucionin e Arsimit të Lartë ku ka kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.
2. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në një nga programet e studimit në të cilin do të shpallem fitues, për vitin akademik në vijim.
3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.
4. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.
5. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

_____
_____

Emër, Atësi, Mbiemër i kandidatit *Emër, Atësi, Mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore*

Firma: *Firma:*

Vendi: _____ *Data: ____ . ____. _____*

Shtojca nr. 6 *Data: ____/____/____*

<u>Formular aplikimi</u>

Unë i/e nënshkruari/a _____ , lindur më _____
emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____ e-mail: _____, Tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të dytë / tretë:

□ *"Master profesional"*
□ *"Master i shkencave"/ "Master i arteve"*
□ *"Master Ekzekutiv"*

në _____, në IAL _____

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (vendosni një rreth mbi kategorinë përkatëse):

A. Shtetas shqiptarë, brenda vendit

B. Kandidatë shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit (*të shënohet me "x" vendi nga vjen kandidati****):***

□ *Republika e Kosovës;*
□ *Mal i Zi;*
□ *Maqedonia e Veriut;*
□ *Preshevë;*
□ *Bujanovci;*
□ *Medvegja;*

C. Nga kategoritë e veçanta *(PAK, të shënohet kategoria e veçantë të cilës i përket kandidati):*
_____.

D. Shtetas i huaj
Gjuha amtare_____. Shtetësia_____
Emri i universitetit _____

6. *Deklaroj se jam njohur me parashikimet e Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për pranimet në ciklin përkatës të studimit.*
7. *Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shtesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të IAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.*
8. *Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.*
   Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Institucionin e Arsimit të lartë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.

9. *Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.*
10. *Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.*

_____	_____
Emër Atësi Mbiemër i kandidatit	*Emër Mbiemër i punonjësit që pranoi aplikimin*
Firma	*Firma*

Shtojca nr. 7 *Data*
____/____/____

Formular aplikimi

Unë i/e nënshkruari/a _____ , lindur më _____
emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____ e-mail: _____, Tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit (vendosni një rreth):

□ *me karakter profesional 2 – vjeçar*
□ *ciklit të parë "Bachelor"*
□ *integruar të ciklit të dytë*
□ *ciklit të dytë "Master profesional"*
□ *ciklit të dytë "Master i shkencave" / "Master i arteve"*
□ *ciklit të tretë "Master ekzekutiv"*

në _____, në IAL _____

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (vendosni një rreth mbi kategorinë përkatëse):

A. Për program të dytë studimi
B. Për transferim studimesh

1. *Deklaroj se jam njohur me parashikimet e Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për pranimet në ciklin përkatës të studimit.*
2. *Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shtesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të IAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.*
3. *Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.*
4. *Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Institucionin e Arsimit të lartë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.*
5. *Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.*
6. *Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.*

_____	_____
Emër Atësi Mbiemër *i kandidatit*	*Emër Mbiemër* *i punonjësit që pranoi aplikimin*
Firma	*Firma*

Shtojca nr. 8

Tabela 1a.Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

	Emër	*Atësi*	*Mbiemër*	*Datëlindje*	*Emërtimi i programit të studimit të kryer më parë dhe llloji (“Bachelor”, PICD)*	*IAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të studimit*	*Data e diplomimit në programin e parë të studimit*	*Emërtimi i programit të studimit ku aplikon për program të dytë dhe llloji (“Bachelor”, PICD)*	*Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati*	*Kreditet e njohura*	
											Kriteri 1

Tabela 1b.Të dhënat e të gjithë aplikantëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

nr.	*Emër*	*Atësi*	*Mbiemër*	*Datëlindje*	*Emërtimi programit të studimit nga transferohet dhe llloji (Bachelor, PICD)*	*IAL-ja nga transferohet*	*Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik paraardhës*	*Kreditet (ECTS) të grumbulluara nga kandidati*	*Emërtimi i programit të studimit nga transferohet dhe llloji (Bachelor, PICD)*	*Viti i studimit ku transferohet*

Shtojca nr. 9

Tabela 1a. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

nr.	*Emër*	*Atësi*	*Mbiemër*	*Datëlindje*	*Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga transferohet dhe lloji*	*IAL-ja nga transferohet*	*Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik paraardhës*	*Kreditet (ECTS) të grumbulluara nga kandidati*	*Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga transferohet dhe lloji*	*Viti i studimit ku transferohet*	*Kreditet e njohura*

Tabela 1b. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

	Emër	*Atësi*	*Mbiemër*	*Datëlindje*	*Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) të kryer më parë dhe lloji*	*IAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të studimit*	*Data e diplomimit në programin e parë të studimit*	*Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) ku aplikon për program të dytë dhe lloji*	*Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati*	*Kreditet e njohura*
1										
2										
.....										

Shtojca nr. 10
Tabela 1: Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit sipas referencave në udhëzim

Nr.	**Referenca në udhëzim**	**Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit**
1.	Kreu IV/1, pika 1	02.09.2019 - 13.09.2019
2.	Kreu IV/1, pika 11	17.09.2019
3.	Kreu IV/1, pika 12, paragrafi 1	23.09.2019

4.	Kreu IV/1, pika 12, paragrafi 2	24.09.2019
5.	Kreu IV/1, pika 14	27.09.2019
6.	Kreu IV/1, pika 15, fjalia 1	07.10.2019 - 11.10.2019
7.	Kreu IV/1, pika 15, fjalia 2	18.10.2019
8.	Kreu IV/1, pika 16	15.11.2019
9.	Kreu IV/2, pika 1	20.08.2019 - 30.08.2019
10.	Kreu IV/2, pika 2, fjalia 1	30.08.2019
11.	Kreu IV/2, pika 2, fjalia 3	02.09.2019
12.	Kreu IV/2, pika 9	03.09.2019
13.	Kreu IV/2, pika 11	12.09.2019
14.	Kreu IV/2, pika 12	12.09.2019
15.	Kreu IV/2, pika 13	19.09.2019
16.	Kreu IV/2, pika 14	07.10.2019
17.	Kreu IV/2, pika 15	15.11.2019
18.	Kreu IV/3, pika 1	20.08.2019 - 30.08.2019
19.	Kreu IV/3, pika 6	03.09.2019
20.	Kreu IV/3, pika 8	12.09.2019
21.	Kreu IV/3, pika 9	19.09.2019
22.	Kreu IV/3, pika 10	19.09.2019
23.	Kreu IV/3, pika 11	07.10.2019
24.	Kreu IV/3, pika 13, shkronja “b”	24.01.2020
25.	Kreu IV/3, pika 13, shkronja “f”	15.11.2019
26.	Kreu IV/4, pika 1	11.10.2019 (E vlefshme për IAL-të publike) 18.10.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
27.	Kreu IV/4, pika 2	22.10.2019 (E vlefshme për IAL-të publike)

		29.10.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
28.	Kreu IV/4, pika 4	30.10.2019 (E vlefshme për IAL-të publike) 15.11.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
29.	Kreu IV/4, pika 5	01.11.2019 (E vlefshme për IAL-të publike) 08.11.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
30.	Kreu IV/4, pika 8, shkronja “b”	Dhjetor 2019
31.	Kreu IV/4, pika 16	16.12.2019
32.	Kreu IV/5, pika 1	06.09.2019 - 19.09.2019
33.	Kreu IV/5, pika 18	20.09.2019
34.	Kreu IV/5, pika 19, Paragrafi 1	30.09.2019
35.	Kreu IV/5, pika 19, Paragrafi 2	01.10.2019
36.	Kreu IV/5, pika 21	10.10.2019
37.	Kreu IV/5, pika 22, fjalia 1	10.10.2019 - 14.10.2019
38.	Kreu IV/5, pika 22, fjalia 2	18.10.2019
39.	Kreu IV/5, pika 23	16.12.2019
40.	Kreu IV/6, pika 1	11.10.2019 (E vlefshme për IAL-të publike) 18.10.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
41.	Kreu IV/6, pika 2	22.10.2019 (E vlefshme për IAL-të publike) 29.10.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
42.	Kreu IV/6, pika 4	30.10.2019 (E vlefshme për IAL-të publike) 06.11.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
43.	Kreu IV/6, pika 5	01.11.2019 (E vlefshme për IAL-të publike) 08.11.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
44.	Kreu IV/6, pika 8, shkronja “b”	Dhjetor 2019
45.	Kreu IV/6, pika 16	16.12.2019

U DH Ë Z I M

Nr. 19, datë 10.9.2019

PËR
DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.10, DATË 15.5.2019, "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

U DH Ë Z O J:

1. Titulli i kreut IV/3, të udhëzimit nr.10, datë 15.5.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

   "*Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve me diploma të huaja të shkollës së mesme, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë.*".

2. Shkronjat "a" dhe "b", të pikës 13, të kreut IV/3, ndryshojnë si më poshtë:

   "*a) Zhvillimi i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, të kandidatëve me diploma të huaja të shkollës së mesme, në programet e studimit objekt të këtij udhëzimi, në IAL-të që i zhvillojnë këto programe, si programe të përbashkëta studimi, që përfundojnë me një diplomë të përbashkët, të dyfishtë ose të shumëfishtë, në bashkëpunim me IAL-të e vendeve të BE-së, kryhet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuar nga vetë IAL-të.*
   b) Njohja e dokumentacionit të kandidatëve të pajisur me diploma të huaja të shkollës së mesme, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen regjistrimin e tyre përfundimtar dhe pajis me numër matrikullimi studentin, si dhe brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr.10, të këtij udhëzimi, ia komunikon IAL-së.".

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

MINISTËR

BESA SHAHINI

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 20, datë 20.09.2019

PËR

SKEMËN DHE ZBATIMIN E MODELIT TË FINANCIMIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 3 të nenit 110, të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimit nr. 75, datë 12.02.2018 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZOJNË:

KREU I

Dispozita të përgjithshme

1. Financimet në formë granti për institucionet publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, miratohen nga ministria përgjegjëse për arsimin, sipas kuotave dhe kritereve të përcaktuar me vendimin nr. 75, datë 12.02.2018 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor" në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të miratuar, sipas skemës sa vijon;
   a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, në programin 09450, kapitull 01 artikulli 230-231;
   b) granti i mësimdhënies, në programin 09450, kapitull 01, artikulli 604;
   c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese, në programin 09770, kapitulli 01, artikulli 604-230-231.
2. Detajimi i fondeve, sipas strukturës buxhetore për të gjitha njësitë shpenzuese përfituese të fondeve grant, dërgohet nga nëpunësi autorizues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, pranë nëpunësit të parë autorizues për miratim, zyrtarisht dhe në formë elektronike. Pas miratimit, struktura përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për arsimin, regjistron këtë detajim në sistemin financiar (SIMF).

KREU II

Skema e miratimit dhe zbatimit të fondeve, granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë

1. **Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë,** përfshin:
   a) fondin për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike;
   b) fondin e projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë.

2. Fondi për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike shpërndahet mbi bazën e renditjes së institucioneve publike të arsimit të lartë, të kryer nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).
3. Fondi i projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve publike të arsimit të lartë shpërndahet mbi bazën e projekteve që ato paraqesin, sipas kritereve të përcaktuara në strategjitë sektoriale dhe në ligjin vjetor të buxhetit.
4. Ministri përgjegjës për arsimin, miraton prioritetet, termat e shpërndarjes, formën e aplikimit për grantin, si dhe miraton grantin e politikave të zhvillimit të institucioneve publike të arsimit të lartë, mbi bazën e aplikimit apo të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.
5. Fondet e miratuara "grant i politikave të zhvillimit të institucioneve publike të arsimit të lartë", përparësi në financim do të kenë:
   a) projektet në vazhdim nga viti paraardhës ose më parë;
   b) projektet e propozuara/ miratuara për financim gjatë vitit ushtrimor, mbi bazën e aplikimit apo të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit;
   c) detyrimet për TVSH ose bashkëfinancimet nga fonde grant për projektet me financim të huaj, do të financohen në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet financiare të projekteve dhe në përputhje me vlerën e financimit të huaj të planifikuar për vitin ushtrimor;
   d) financimi i projekteve të reja të propozuara për financim, të shqyrtuara nga Këshilli i Ministrave dhe të paraqitura në Kuvend, për vitin ushtrimor.
6. Fondet e miratuara në formë granti i politikave të zhvillimit, në programin buxhetor 09450, kapitullin 01, artikulli 230-231, rishpërndahen sipas projekteve me përfitues institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin vjetor të buxhetit dhe/ose ligjit të arsimit të lartë, në programin buxhetor 09450, kapitullin 01, artikulli 230-231.
7. Institucionet publike të arsimit të lartë, financojnë ose bashkëfinacojnë, nga të ardhurat e tyre, projekte për rritjen dhe/ose përmirësimin e kapaciteteve të infrastrukturës akademike, si dhe projekte për zhvillimin e institucioneve.

KREU III

Skema e miratimit dhe zbatimit të fondeve, granti i mësimdhënies për institucionet publike të arsimit të lartë

1. Granti i mësimdhënies përfshin:
   a) fondin për institucionet publike të arsimit të lartë, në masën jo më pak se 90%;
   b) fondin e mbështetjes studentore, në masën deri në 10% në vit.

2. Fondi institucional u shpërndahet institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas një formule të miratuar me vendimin nr. 75, datë 12.2.2018 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor".

3. Fondi i mbështetjes studentore miratuar në formë granti, përfshin tri kategori financimi:
   a) bursat e studimit për studentët e shkëlqyer;
   b) bursat e studimit për studentët në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar;
   c) bursat e studimit për studentët që i përkasin shtresave sociale në nevojë.

4. Institucionet publike të arsimit të lartë, për një periudhë kalimtare dy deri në tre vjet, në përllogaritjen e formulës për masën e financimit, bazuar në nevojat/kërkesat e tyre specifike do të rivlerësohen, ekualizohen dhe financohen me një fond shtesë.
5. Fondet e miratuara në formë "granti për mësimdhënie për institucionet publike të arsimit të lartë", në programin buxhetor 09450, kapitullin 01, artikulln 604, miratohen dhe rishpërndahen nga ministria përgjegjëse për arsimin për përfitues institucionet publike të arsimit të lartë.
6. Fondet e miratuara në formë "granti për mësimdhënie për institucionet publike e arsimit të lartë", shpërndahen me Vendim të Bordit të Administrimit, në programin buxhetor 09450, kapitulli 08, artikulli 600 - 606, mbështetur në objektivat institucionale të IAL publike si dhe në propozimin e Senatit Akademik, sipas tabelave model nr. 1 dhe nr. 2, të cilat dërgohen zyrtarisht dhe në formë elektronike në ministrinë përgjegjëse për financat për t'u rregjistruar në sistemin informatik financiar (SIFQ) dhe për dijeni në ministrinë përgjegjëse për arsimin.
7. Institucionet publike të arsimit të lartë, financojnë apo bashkëfinacojnë nga të ardhurat e tyre, fonde për mësimdhënie, për blerje materiale dhe shërbime, si dhe mbështetje financiare për studentë.
8. Përdorimi i fondeve publike nga Buxheti i Shtetit për institucionet publike të arsimit të lartë, bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të miratuar.

KREU IV
Skema e miratimit dhe zbatimit të fondeve, granti i punës kërkimore - shkencore dhe veprimtarive krijuese

1. Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese, përfshin fondet për kërkimin shkencor, i miratuar me ligjin vjetor të buxhetit në programin 09770, kapitulli 01, artikulli 604, dhe artikulli 230-231.
2. Ky grant është i hapur, për konkurrim/aplikim për të gjitha institucionet e arsimit të lartë të akredituara që zhvillojnë kërkim shkencor.
3. Institucionet e arsimit të lartë të llojit universitet dhe akademi, aplikojnë për të përfituar nga ky grant dhe për financimin e studimeve të doktoratës.
4. Nga ky fond përjashtohet financimi i ngarkesës së pedagogëve për udhëheqjen e doktoratës.
5. Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor përbën kriterin bazë të renditjes së institucioneve të kërkimit shkencor nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe përcaktimin e masës së financimit, të përfituar nga Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, për IAL-të publike.
6. Institucionet e kërkimit shkencor, marrin masa për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, nëpërmjet njësisë përkatëse, përbërja dhe funksionimi i së cilës përcaktohen në statutin dhe rregulloren e institucionit përkatës.
7. Skema për miratimin dhe shpërndarja e fondeve të kësaj kategorie të miratuara në formën "Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese", realizohet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), mbi bazën e projekteve që institucionet paraqesin dhe duke mbajtur në konsideratë treguesit kryesore për projektet kërkimore-shkencore dhe veprimtarinë krijuese të IAL-ve të miratuar me vendimin nr. 75, datë 12.02.2018 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor".
8. Fondet e miratuara me ligjin vjetor të buxhetit "Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese", në programin buxhetor 09770, kapitullin 01, artikulli 604, rishpërndahet me vendim të Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI),

me përfitues institucionet e arsimit të lartë, të akredituara, që zhvillojnë kërkim shkencor, në programin buxhetor 09770, kapitullin 08, artikulli 602-606. Vendimi i bordit, së bashku me tabelat shoqëruese të detajimit të buxhetit, dërgohen zyrtarisht si edhe në formë elektronike në ministrinë përgjegjëse për financat për t'u rregjistruar në sistemin informatik financiar (SIFQ) dhe për dijeni në ministrinë përgjegjëse për arsimin.

KREU V
Dispozita të Fundit

1. Fondet e buxhetit të shtetit të miratuara në formë granti apo në formë "transfertë e pakushtëzuar" për "Shoqëritë e Trajtimit të Studentëve" sh.a, në Tiranë dhe në rrethe, paguhen në llogarinë bankare të përfituesit nga struktura përgjegjëse për thesarin me urdhër të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhënëse, dhe me paraqitjen nga kjo e fundit të dokumenteve justifikuese të shpenzimit (situacion, fatura, listëpagesa).
2. Kompetencat dhe funksionet e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, do të ushtrohen nga ministria përgjegjëse për arsimin, deri në momentin e ushtrimit të plotë të funksioneve dhe komepetencave nga Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë.
3. Fondet e përfituara në formë granti nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe të papërdorura në fund të vitit financiar në përputhje me rregullat dhe standardet e menaxhimit financiar publik, trashëgohen në vitin pasardhës.
4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTRI **MINISTRI**

Besa SHAHINI **Anila DENAJ**

Tabela nr. 1 fondet e miratuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin, për vitin financiar.

Kodi i Qeverisjes	Ministria e Linjës	Institucioni	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i Qarkut	Kodi i produktit	Emërtimi i Produktit	Fondet e detajuara për vitin ushtrimor, në lekë	Aktivitete të përfshira për t këtë produkt
001	11	1011136	**01**	09450	6040000	3737	91105AA	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve	X1	Fonde grant për mësimdhëni publike, shpenzime të perso korrente. Fondet Detajohen me Vend Administrimit
001	11	1011136	**01**	09450	6040000	3737	91105AA	Studentë që përfitojnë bursa financiare si dhe mbështetje financiare te studentëve	X2	Fonde grant për mësimdhëni publike, shpenzime për burs për studentët. Fondet Grant detajohen me Bordit të Administrimit
001	11	1011136	01	09450	2310000	3737	M112692	Projekte për zhvillimin institucional	X3	Fonde Grant për Projekte pë institucional
001	11	1011136	01	09770	2310000	3737	M112700	Fonde Granti për projekte të punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.	X4	Fonde Granti i punës kërkim shkencore dhe veprimtarive
								Totali	**Tot=x1+x2+x3+x4**	

Tabela nr. 1/8 fondet e shpërndara me vendim të Bordit të Administrimit për vitin ushtrimor, me burim financimi FONDET GRANT, nga B Shtetit për IAL publike, të cilat miratohen, sipas strukturës sa vijon:

Kodi i Qeverisjes	Ministria e Linjës	Institucioni	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i Qarkut	Kodi i produktit	Emërtimi i Produktit
001	11	1011136	**08**	09450	**6000000**	3737	91105AA	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve
001	11	1011136	**08**	09450	**6010000**	3737	91105AA	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve
001	11	1011136	**08**	09450	**6020000**	3737	91105AA	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve
001	11	1011136	**08**	09450	**6050000**	3737	91105AA	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve
001	11	1011136	**08**	09450	**6060000**	3737	91105AA	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve , që përfitojnë bursa financiare si dhe mbështetje financiare.
001	11	1011136	**08**	09450	2310000	3737	M112692	Projekte për zhvillimin institucional
001	11	1011136	**08**	09770	2310000	3737	M112700	Fonde Granti për projekte të punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.
								Totali

U DH Ë Z I M

Nr. 24, DATË 21.10.2019

PËR

NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 19.02.2018 "PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE PËRBËRËS TË RAPORTIMIT VJETOR DHE AFATIT PËR RAPORTIM TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 32, të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

U DH Ë Z O J:

1. Në udhëzimin nr. 5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", fjalia e parë e pikës 3 ndryshon si më poshtë:
   "Raporti vjetor dërgohet nga IAL zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në 1 (një) kopje origjinale në formë të shkruar dhe/ose elektronike, brenda muajit dhjetor të çdo viti".
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTËR

BESA SHAHINI

UDHËZIM

Nr. 29, datë 18.12.2019

PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E REGJISTRAVE SHTETËRORË TË GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës "g", të pikës 2, të nenit 7, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore 'doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë 'profesor i asociuar' dhe 'profesor'", vendimit nr. 777, datë

26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”,

UDHËZOJ:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Regjistrat shtetërorë për regjistrimin e gradës shkencore “doktor” dhe titujve akademikë “profesor i asociuar” dhe “profesor” janë një bazë unike të dhënash e të gjitha gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi.

2. Regjistrat shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë janë:

a) Regjistri shtetëror për gradën shkencore “doktor”.

b) Regjistri shtetëror për titullin akademik “profesor i asociuar”.

c) Regjistri shtetëror për titullin akademik “profesor”.

3. Regjistrat shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) në Republikën e Shqipërisë, krijohen dhe administrohen në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

4. AKKSHI-ja harton një rregullore të veçantë mbi administrimin e regjistrave.

5. Regjistrat shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë mbahen në formë të shkruar (me dorë) dhe format elektronik, sipas formatit të përcaktuar në këtë udhëzim. Regjistrat në formë të shkruar (me dorë) plotësohen nga punonjësi i autorizuar i AKKSHI-së. Në rast mospërputhje të dhënash, merren për bazë të dhënat e regjistrave në formë të shkruar (me dorë). Regjistrat e mbajtur në formë të shkruar (me dorë), depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat.

6. Përdorimi dhe përpunimi i të gjithë informacionit dhe të dhënave të gjeneruara si rezultat i procedurave të regjistrimit, kryhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

7. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja elektronike e të dhënave realizohet nëpërmjet një sistemi të informatizuar që administrohet me rregullore të veçantë.

KREU II

TË DHËNAT E REGJISTRAVE

1. Të dhënat që plotësohen në regjistrin shtetëror të gradës shkencore “doktor”:

a) Numri rendor.

b) Emër, atësi dhe mbiemër të personit të cilit i jepet grada shkencore “doktor”.

c) Gjinia.

d) Datëlindja.

e) Shtetësia.

f) Emërtimi i institucionit/ve të arsimit të lartë ku personi ka kryer studimet e doktoratës.

g) Emërtimi i institucionit të arsimit të lartë, i njësisë kryesore dhe/ose njësisë bazë që jep gradën shkencore "doktor".

h) Forma e studimit.

i) Numri i matrikullimit.

j) Data e regjistrimit në programin e studimit të doktoratës.

k) Numri dhe data e Vendimit të jurisë për dhënien e gradës shkencore "doktor".

l) Data e regjistrimit në regjistër të gradës shkencore.

m) Tema e disertacionit.

n) Fusha e studimit dhe vlerësimi.

2. Të dhënat që plotësohen në regjistrin shtetëror të titullit akademik "profesor i asociuar":

a) Numri rendor.

b) Emër, atësi dhe mbiemër të personit të cilit i jepet titulli akademik.

c) Gjinia.

d) Datëlindja.

e) Shtetësia.

f) Emërtimi i institucionit të arsimit të lartë që lëshon titullin akademik.

g) Numri dhe data e vendimit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.

h) Data e regjistrimit në regjistër e titullit akademik.

i) Fusha e studimit.

j) Data e fitimit të gradës shkencore "doktor".

3. Të dhënat që plotësohen në regjistrin shtetëror të titullit akademik "profesor":

a) Numri rendor.

b) Emër, atësi dhe mbiemër të personit të cilit i jepet titulli akademik.

c) Gjinia.

d) Datëlindja.

e) Shtetësia.

f) Emërtimi i institucionit të arsimit të lartë që lëshon titullin akademik.

g) Numri dhe data e vendimit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.

h) Data e regjistrimit në regjistër e titullit akademik.

i) Fusha e studimit.

j) Datën e fitimit të titullit "profesor i asociuar".

KREU III

KRITERET PËR REGJISTRIM

1. Institucionet e arsimit të lartë përcjellin pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin kërkesën dhe informacion mbi çdo gradë shkencore apo titull akademik të lëshuar prej tyre. Shkresa/kërkesa zyrtare përmban:

a) Për regjistrimin e gradës shkencore "doktor":

i) Emër, atësi, mbiemër, shtetësia, datëlindja dhe gjinia e personit të cilit i jepet grada shkencore.

ii) Forma e studimit.

iii) Numrin e matrikullimit.

iv) Temën e disertacionit.

v) Datën e regjistrimit në studimet e Doktoratës.

vi) Kopje elektronike (CD) të disertacionit në formatin *ëord* dhe *pdf.*

vii) *Linkun/*adresën e faqes *ëeb* në të cilin është publikuar disertacioni përkatës.

Viii) Numrin dhe datën e vendimit të jurisë. Të bashkëlidhet kopje origjinale e vendimit përkatës, si dhe procesverbali (nëse është mbajtur një i tillë).

ix) Fushën e studimit.

x) Konfirmimi që është kryer kontrolli antiplagjiaturë i disertacionit të mbrojtur për fitimin e gradës shkencore "doktor" dhe njoftimi i programit/*soft-it* përkatës të përdorur.

b) Për regjistrimin e titullit akademik "profesor i asociuar":

i) Emër, atësi dhe mbiemër, shtetësia, datëlindja dhe gjinia e personit të cilit i jepet titulli akademik "profesor i asociuar".

ii) Numrin dhe datën e vendimit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik. Të bashkëlidhet kopje origjinale e vendimit përkatës, si dhe procesverbali (nëse është mbajtur një i tillë).

iii) Numrin dhe datën e vendimit të fitimit të gradës shkencore "doktor".

c) Për regjistrimin e titullit akademik "profesor":

i) Emër, atësi dhe mbiemër, shtetësia, datëlindja dhe gjinia e personit të cilit i jepet titulli akademik "profesor".

ii) Numrin dhe datën e vendimit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik. Të bashkëlidhet kopje origjinale e vendimit përkatës, si dhe procesverbali (nëse është mbajtur një i tillë).

iii) Numrin dhe datën e vendimit të fitimit të titullit akademik "profesor i asociuar".

KREU IV

REGJISTRIMI

1. Regjistrat shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë plotësohen sipas formatit të shtojcave përkatëse bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, si dhe fillojnë me numrat rendorë:

a) A01 - Regjistri shtetëror i gradës shkencore "doktor" (shtojca nr. 1).

b) B01 - Regjistri shtetëror i titullit akademik "profesor i asociuar" (shtojca nr. 2).

c) C01 - Regjistri shtetëror i titullit akademik "profesor" (shtojca nr. 3).

2. Specialisti/struktura përgjegjëse për plotësimin e regjistrit shtetëror përkatës, në rastetkur kërkesa e IAL-së nuk është hartuar sipas kërkesave të përcaktuara në kreun III, të këtij udhëzimi, i kërkon IAL-së plotësimet e nevojshme.

3. Kur kërkesa e IAL-së për regjistrimin e gradës shkencore dhe/ose titullit akademik, është hartuar sipas kërkesave të përcaktuara në kreun III të këtij udhëzimi, brenda 15 ditëve nga marrja në dorëzim e kërkesës, kryhet regjistrimi në regjistrin përkatës shtetëror dhe njoftohet zyrtarisht IAL-ja për numrin e regjistrit.

KREU V

PROCEDURA E REGJISTRIMIT

1. Kërkesa zyrtare për regjistrimin e gradave shkencore apo titujve akademikë në regjistrin shtetëror përkatës përcillet pranë AKKSHI-së, pas plotësimit nga IAL-ja të kritereve dhe ndjekjes së procedurave të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.

2. Regjistrimi i gradave shkencore apo titujve akademikë në regjistrin shtetëror përkatës nuk certifikon përmbushjen e kritereve, procedurave dhe modaliteteve për fitimin e tyre, të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.

3. Në rast se në vijim të kontrollit nga ministria përgjegjëse për arsimin konstatohen parregullsi në dhënien e gradave shkencore apo titujve akademikë, AKKSHI-ja rezervon të drejtën për të çregjistruar gradën shkencore/titullin akademik nga regjistri shtetëror përkatës.

4. Dokumentet shoqëruese të kërkesës së IAL- së duhet të jenë në origjinale ose kopje të njehsuara me origjinalin. Dokumentet duhet të jenë të saktë dhe të plotë.

5. Dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe, ose të përkthyera dhe të vërtetuara në gjuhën shqipe dhe të legalizuara sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI

DISPOZITAT E FUNDIT

1. Regjistri shtetëror i gradave shkencore “doktor”, i krijuar dhe plotësuar përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, mbyllet dhe arkivohet sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

2. AKKSHI-ja përcjell informacion në MASR lidhur me regjistrimet e kryera, çdo gjashtë muaj.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Besa Shahini

Nr.	A01	A02	A03	A04	A05	A06	A07	A08	A09	A10	A11	A12	A13	
Emri														
Atësia														
Mbiemri														
Shtetësia														
Gjinia														
Datëlindja														
Institucioni/et e arsimit të lartë														
Njësia kryesore														
Forma e studimit														
Numri i matrikullimit														
Data e regjistrimit														
Numri i vendimit														
Data e vendimit														
Tema														
Fusha														
Vlerësimi														

B01	Nr.
B02	Emri
B03	Atësia
B04	Mbiemri
B05	Shtetësia
B06	Gjinia
B07	Datëlindja
B08	Institution! i arsimit të lartë
B09	Numri i vendimit të KPPA-së
BIO	Data e vendimit
BIl	Data e regjistrimit në regjistër
B12	Fusha
B13	Data e fitimit të gradës shkencore “doktor”

	C13	C12	C11	C10	C09	C08	C07	C06	C05	C04	C03	C02	C01	Nr.
														Emri
														Atësia
														Mbiemri
														Shtetësia
														Gjinia
														Datëlindja
														Institution! i arsimit të lartë
														Numri i vendimit të KPPA-së
														Data e vendimit
														Data e regjistrimit në regjistër
														Fusha
														Data e fitimit të titullit akademik “profesor i asociuar”

UDHËZIM

Nr. 30, datë 30.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 3.8.2016 "PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË VENDIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 6, të nenit 92, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1, e kreut II, ndryshon si më poshtë:

"1. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare apo Evropiane të Kualifikimeve, si dhe të titujve akademikë kryhet vetëm *on-line* nëpërmjet portalit *e-albania.* Dokumentacioni shoqërues i kërkuar duhet të depozitohet detyrimisht i skanuar gjatë aplikimit *on- line".*

b) Pika 1, e kreut III, ndryshon si më poshtë:

"1. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e certifikatave dhe diplomave universitare të nivelit 5 deri në nivelin 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK), kryhet *on-line* sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet *on-line* në portalin *e-albania.* Këtij formulari i ngarkohet në format elektronik (PDF), dokumentacioni i parashikuar në germat "b", "c", "d" dhe "e" të kësaj pike.

b) diploma/certifikata, ose dokumenti zyrtar përkatës në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, kopje e njësuar me origjinalin, si dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës;

c) lista e notave dhe/ose suplementi i diplomës (nëse ka), të njësuar me origjinalin, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës;

d) kopje e kartës së identitetit ose e pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);

e) mandatpagesa ose konfirmimi i pagesës *on- line*.".

c) Pas pikës 1, të kreut III, shtohet pika 1/1, si më poshtë:

"1/1. Në rrugë postare (format *hard-copy)* pas kryerjes së aplikimit *on-line*, paraqitet një kopje e diplomës/certifikatës bashkë me listën e notave ose suplementin e diplomës (nëse ka), të njësuara me origjinalin, si dhe të përkthyera në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës.".

d) Pika 2, e kreut III, ndryshon si më poshtë:

"2. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore "Doktor", kryhet *on-line* sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet *on-line* në portalin *e-albania.* Këtij formulari i ngarkohet në format elektronik (PDF), dokumentacioni i parashikuar në germat "b", "c", "d", "e" dhe "f", të kësaj pike.

b) diploma dhe suplementi i saj (nëse ka të tillë), lëshuar nga institucioni përkatës i arsimit të lartë, që dëshmon fitimin e gradës shkencore "Doktor", kopje e njësuar me origjinalin, si dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës;

c) diploma e studimeve pararendëse universitare dhe/ose vërtetimi i njësimit të diplomës i lëshuar nga institucioni përgjegjës;

d) disertacioni i doktoratës;

e) fotokopja e kartës së identitetit ose e pasaportës (për shtetasit e huaj);

f) mandatpagesa ose konfirmimi i pagesës *on- line,*

g) aplikanti duhet të depozitojë një kopje të disertacionit në Bibliotekën Kombëtare. Vërtetimi i depozitimit të këtij dokumenti do të sigurohet drejtpërdrejt nëpërmjet sistemit nga institucioni përkatës i njohjes së diplomave.".

e) Pas pikës 2, të kreut III, shtohet pika 2/2, si më poshtë:

"2/2 Në rrugë postare (format *hard-copy)* pas kryerjes së aplikimit *on-line*, paraqitet një kopje e diplomës/certifikatës dhe suplementit (nëse ka të tillë), të njësuara me origjinalin, si dhe të përkthyera në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës.".

f) Pika 3, e kreut III, ndryshon si më poshtë:

"3. Aplikimi për njohjen e titujve akademikë "Profesor" dhe "Profesor i asociuar", kryhet *on-line* sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet *on-line* në portalin *e-albania*. Këtij formulari i ngarkohet në format elektronik (PDF), dokumentacioni i parashikuar në germat "b", "c", "d", "e", "f", "g", "h" dhe "i", të kësaj pike;

b) dokumenti i fitimit të titullit akademik, kopje e njësuar me origjinalin si dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës.

c) diploma e studimeve pararendëse universitare dhe/ose vërtetimi i njësimit të diplomës i lëshuar nga institucioni përgjegjës,

d) vërtetimin e regjistrimit të titullit akademik në databazë në zbatim të kuadrit ligjor të vendit përkatës,

e) *Curriculum Vitae;*

f) fotokopja e kartës së identitetit apo pasaportës (për shtetasit e huaj),

g) deklarata/skeda e nënshkruar në të cilin të jepet informacion, për:

1. eksperiencën akademike në mësimdhënie,

ii. aktivitetin shkencor - lista e artikujve/botimeve shkencore, pjesëmarrje në simpoziume, konferenca, kongrese shkencore të shoqëruar me titujt e materialeve të paraqitura,

iii. botime të punimeve shkencore në organe shkencore ndërkombëtare.

ii. informacioni i parashikuar në këtë skedë duhet të shoqërohet me dokumentacion provues përkatës,

h) mandatpagesa ose konfirmimi i pagesës *on- line*.",

g) Pas pikës 3, të kreut III, shtohet pika 3/1, si më poshtë:

"3/1. Në rrugë postare (format *hard-ccpj)* pas kryerjes së aplikimit *on-line* paraqitet një kopje e dokumentit të fitimit të titullit akademik, e njësuar me origjinalin dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës dhe vula.".

2. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe komisionet përkatëse.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTER I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Besa Shahini

UDHËZIM

Nr. 1, datë 14.1.2020

PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË (Ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 31.3.2021)

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; të neneve 30 dhe 35, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; të vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre",

UDHËZOJ:

KREU I

HAPJA, RIORGANIZIMI DHE MBYLLJA E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

A. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR HAPJEN E NJË INSTITUCIONI TË ARSIMIT TË LARTË

1. Subjekti juridik vendës ose i huaj aplikon në sistemin elektronik përkatës pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në vijim "MASR", duke ngarkuar aplikimin për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, sipas shtojcës nr. 1 pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, brenda datës 15 maj për vitin akademik pasardhës.

2. MASR-ja brenda një afati 30-ditor nga data e aplikimit, njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.

3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR-ja, subjekti ngarkon elektronikisht dhe depoziton në mënyrë shkresore pranë MASR-së, brenda 15 ditëve, dokumentacionin e mëposhtëm:

3.1 Dokumentacioni ligjor:

a) ekstrakti i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit ose vendim regjistrimi nga gjykata kompetente për subjektin juridik, ku të jetë përfshirë arsimi i lartë në objektin e veprimtarisë së tij;

b) jetëshkrimet e administratorit dhe ortakut/ëve të shoqërisë;

c) deklarata që subjekti, administratori dhe ortaku/ët nuk janë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

3.2 Dokumentacioni për plotësimin e standardeve akademike dhe të organizimit të IAL-së:

a) projektstatuti i institucionit të arsimit të lartë (në vijim IAL), ku përcaktohen detyrimisht strukturat dhe kërkesat e tjera të parashikuara në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";

b) lista e stafit akademik dhe ndihmësakademik, sipas njësive kryesore/njësive bazë ku do të atashohen. Njësia bazë duhet të plotësojë kushtin që të ketë në përbërje të paktën 7 (shtatë) anëtarë si personel akademik me kohë të plotë, ndër të cilët, të paktën tre me gradë shkencore ose titull akademik. Njësia bazë për Kolegjin Profesional të Lartë duhet të ketë në përbërje të paktën 5 (pesë) anëtarë të punësuar me kohë të plotë si personel mësimdhënës nga të cilët, të paktën 1 (një) me gradë shkencore ose titull akademik;

c) kopje të dëshmive të titujve akademikë dhe gradave shkencore, për kategoritë "Profesor" dhe "Lektor", kopje të diplomës "master i shkencave" për kategorinë "asistent lektor";

d) Aktmarrëveshjet/kontratat për angazhimin me kohë të plotë nënshkruar nga autoritetet drejtuese të institucionit të arsimit të lartë.

3.3 Dokumentacioni për programet mësimore:

a) rregullorja e programit të studimit;

b) plani mësimor për çdo program studimi të propozuar, ku përcaktohen fusha përkatëse e arsimit, lëndët e ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese me kreditet përkatëse, në vite e semestra dhe ngarkesa mësimore e personelit akademik të angazhuar;

c) planet lëndore (*syllabus*-et) përkatëse me firmën e titullarit të lëndës/pedagogut të lëndës (për programet profesionale). Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi;

d) kopje të marrëveshjes kuadër dhe dokumentit të akreditimit të institucionit bashkëpunues, në rastin e ofrimit të një programi të përbashkët studimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, vendës ose të huaj;

e) numri i studentëve që parashikohet të regjistrohen në programet e studimit në rast hapjeje të IAL-së, i nevojshëm për vlerësimin e standardit mbi raportin personel akademik me kohë të plotë/student, sipas fushave kryesore të studimit, parashikuar në VKM-në nr. 418/2017, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre";

f) listën e titullarëve të lëndëve.

3.4 Dokumentacioni financiar:

a) plani financiar i të ardhurave dhe i shpenzimeve të parashikuara mbi veprimtarinë që do të kryejë;

b) deklaratë mbi burimet e financimit.

c) Vërtetim bankar me anë të të cilit subjekti garanton sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare në masën e përllogaritur për studentë të deklaruar për pranim, sipas programit të studimit që do të ofrohet, si garanci e nevojshme për të siguruar cilësinë e programeve të planifikuara të studimeve, si dhe të veprimtarive të tjera të institucionit;

d) mandatpagesë prej 30% të shumës së tarifës bazë për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin institucional të llojit të IAL-së, parashikuar në tabelën 2/a, të vendimit nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", të ndryshuar.

3.5 Dokumentacioni për normativat dhe infrastrukturën:

a) kopje të noterizuar të certifikatës së pronësisë së godinës ose kontrata e qirasë/huapërdorjes me afat jo më pak se 3 vjet, shoqëruar me kopje të njësuar të certifikatës së pronësisë së qiradhënësit;

b) relacion mbi infrastrukturën e godinës nga eksperti i licencuar, ku detajohen ambientet minimale të nevojshme për hapjen e IAL-ve, sipas natyrës së programeve të studimit që do të ofrohen, që janë si më poshtë:

i. auditorë mësimi;

ii. laboratorë për programin studimit dhe ndjekje praktikash;

iii. ambiente për personelin akademik;

iv. ambiente për personelin administrativ;

v. bibliotekë dhe ambiente për senatin, salla audiovizive, kompjuterësh etj.;

vi. ambiente teknike (që i shërbejnë funksionit të godinës, si: kaldaja, motor gjeneratori, depozita uji dhe elektropompa, depo, kabina elektrike etj.), oborr dhe ambiente të gjelbëruara;

c) leja higjieno-sanitare dhe akti për mbrojtjen nga zjarri, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.

4. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për hapjen e IAL-së:

a) dokumentacioni shqyrtohet brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të tij në MASR. Në rast se konstatohen mangësi në dokumentacion, MASR-ja i kërkon subjektit plotësimin e tyre, brenda afatit kohor prej 15 ditëve nga data e njoftimit. Në rast se dokumentacioni nuk plotësohet brenda këtij afati, konsiderohet që subjekti ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

b) kur dokumentacioni është sipas kërkesave të këtij udhëzimi, vijon procedura me vlerësimin e plotësimit të standardeve nga ekspertë të jashtëm nga lista e miratuar nga ASCAL-ja, të cilët caktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, në vijim ministri. Numri i ekspertëve për vlerësimin paraprak institucional, tarifat që paguhen nga IAL-të, si dhe masa e pagesës së ekspertëve, përcaktohen në VKM-në nr. 109/2017, të ndryshuar;

c) ekspertët, brenda 21 ditëve dorëzojnë raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga ekspertët, MASR-ja njofton subjektin i cili bën plotësimet e nevojshme brenda 21 ditëve nga marrja e njoftimit;

d) nëse pas njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet nga subjektit brenda këtij afati, prezumohet që subjekti ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

e) dokumentacioni me plotësime i depozituar nga subjekti i përcillet ekspertëve, të cilët, brenda 15 ditëve dorëzojnë raportin e rivlerësuar. Nëse vlerësimi dhe vendimi përfundimtar është pozitiv, ministri i propozon Këshillit të Ministrave hapjen e institucionit të arsimit të lartë.

A.1 LEJA E FILLIMIT TË VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

1. Pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e hapjes së institucionit të arsimit të lartë, MASR-ja vijon me procedurën e hapjes së programeve të studimit. Pas hapjes së programeve të studimit, MASR-ja kryen verifikimet në terren për përmbushjen e standardeve dhe të kritereve sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Pas verifikimeve, hartohet raporti dhe i dërgohet ministrit përgjegjës për arsimin dhe në rast miratimi nga ministri, nxirret urdhri për fillimin e veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë.

B. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR RIORGANIZIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

1. Institucioni i arsimit të lartë ngarkon aplikimin në sistemin elektronik përkatës, për riorganizimin e IAL-së, sipas shtojcës nr. 1, brenda datës 15 tetor për vitin akademik pasardhës, i cili shqyrtohet në MASR.

2. MASR-ja, brenda një afati 15-ditor nga data e aplikimit, njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.

3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR-ja, subjekti brenda 15 ditëve ngarkon elektronikisht dhe depoziton në mënyrë shkresore pranë MASR-së, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimet e Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit për miratimin e riorganizimit të IAL-së;

b) projektstatutin për llojin e IAL-së së riorganizuar;

c) organigramën ekzistuese dhe atë të propozuar për riorganizimin e IAL-së;

d) aktet e hapjes dhe akreditimit të IAL-së;

e) planbiznesin për riorganizimin e llojit të IAL-së;

f) deklaratën mbi burimin e financimit ku të argumentohet mbulimi i shpenzimeve për zhvillimin e veprimtarisë akademike;

g) listën e programeve të studimit që do të ofrohen në njësitë kryesore dhe njësitë bazë;

h) listën e personelit akademik me kohë të plotë, sipas njësive kryesore dhe dokumentacioni që vërteton shkollimin dhe kualifikimet;

i) deklaratën nga titullari i institucionit për plotësimin e standardeve infrastrukturore të IAL-së, sipas kërkesave të përcaktuara në VKM-në nr. 418, datë 10.5.2017. Kjo deklaratë shoqërohet me dokumente që vërtetojnë pronësinë ose të drejtën e përdorimit të mjediseve dhe plotësimin e kritereve infrastrukturore, për një periudhë jo më pak se 3 vjet;

j) mandatpagesën prej 30% të shumës së parashikuar për vlerësimin e jashtëm të llojit të IAL-së, sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 109/2017, të ndryshuar.

4. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për riorganizimin e IAL-së:

a) dokumentacioni shqyrtohet brenda 30 ditëve nga data e depozitimit në MASR. Në rast se konstatohen mangësi, MASR-ja i kërkon subjektit plotësimin e tyre, brenda një afati 15-ditor. Në rast se dokumentacioni nuk plotësohet brenda këtij afati, konsiderohet që subjekti ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

b) në rast të vlerësimit pozitiv, dokumentacioni i kalon për shqyrtim ekspertëve të jashtëm të fushës për vlerësimin institucional, përzgjedhur nga lista e ASCAL-së, caktuar me urdhër të ministrit;

c) ekspertët, brenda 21 ditëve, dorëzojnë raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur ekspertët vlerësojnë se dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen

mangësi/pasaktësi, MASR-ja njofton subjektin për plotësimin e dokumentacionit, brenda 15 ditëve nga marrja e raportit të vlerësimit;

d) në rast se dokumentacioni nuk plotësohet brenda këtij afati, prezumohet që subjekti ka hequr dorë nga kërkesa dhe praktika arkivohet;

e) në rast të vlerësimit pozitiv të aplikimit nga ekspertët e jashtëm për vlerësimin institucional, ministri miraton me urdhër riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë.

C. PEZULLIMI I VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

1. Ministria përgjegjëse për arsimin mund të vendosë pezullimin e veprimtarisë së IAL-së bazuar në raportet e kontrollit të ligjshmërisë, të akreditimit ose auditimit.

2. Pezullimi i veprimtarisë së IAL-së, mund të jetë pezullim i gjithë veprimtarisë, si dhe pezullim i veprimtarisë së degëve apo i njësive kryesore përkatëse, për një afat jo më të gjatë se dy vjet, duke i hequr të drejtën për të regjistruar studentë, deri në momentin e heqjes së pezullimit.

3. Pezullimi i veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

D. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

I. Mbyllja me kërkesë të IAL-së

1. Mbyllja e institucionit të arsimit të lartë bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave mbi bazë të propozimit të ministrit përgjegjës për arsimin, mbështetur në kërkesën e institucionit të arsimit të lartë. Institucioni i arsimit të lartë ngarkon elektronikisht në sistemin elektronik dhe në mënyrë shkresore dokumentacionin për mbylljen e IAL-së.

2. Afati i fundit i depozitimit të dokumentacionit nga IAL-ja, është 6 muaj para përfundimit të vitit akademik. Dokumentacioni duhet të përmbajë:

a) kërkesën e argumentuar;

b) propozimin e Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit për mbylljen e IAL-së;

c) deklaratën për shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore dhe taksave vendore, shoqëruar me vërtetimin përkatës nga institucionet përgjegjëse;

d) deklaratën mbi masat e marra për përfundimin e rregullt të studimeve nga ana e studentëve të IAL-së;

e) deklaratën mbi pajisjen me dokumentacionin për transferim studimesh të studentëve të IAL-së që nuk kanë përfunduar studimet;

f) deklaratën për përmbushjen e të gjitha detyrimeve financiare kontraktore ndaj studentëve të IAL-së.

3. Dokumentacioni i depozituar shqyrtohet në MASR, e cila brenda 30 ditëve njofton IAL-në për plotësim apo saktësim të dokumentacionit.

4. Nëse dokumentacioni vlerësohet i plotë, MASR-ja i propozon Këshillit të Ministrave mbylljen e IAL-së.

II. Mbyllja e IAL-ve me nismën e MASR-së

1. Mbyllja e IAL-së bëhet me nismën e ministrit përgjegjës për arsimin në rastin e shkeljeve ligjore të konstatuara nga raportet e kontrollit të ligjshmërisë, të akreditimit ose auditimit.

2. MASR-ja njofton paraprakisht Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit, të cilët brenda 30 ditëve nga data e njoftimit shprehin mendimin e tyre.

3. Bazuar në raportet për kontrollin e ligjshmërisë, auditimit apo akreditimit, shoqëruar me provat që faktojnë shkeljet e konstatuara, ministri merr vendim nëse për IAL-në do të propozojë mbylljen pranë Këshillit të Ministrave apo do të vendosë masën e ndërmjetme të pezullimit të veprimtarisë së IAL-së, deri në një vendimmarrje përfundimtare.

E. BASHKIMI OSE NDARJA E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

1. Institucioni/et për arsimin e lartë ngarkojnë në sistemin elektronik përkatës pranë MASR-së aplikimin për bashkimin ose ndarjen e IAL-ve, sipas shtojcës nr. 1 të këtij udhëzimi.

2. Afati i fundit i depozitimit për aplikimit nga IAL-të është data 15 tetor për vitin akademik pasardhës.

3. MASR-ja brenda një afati 15-ditor nga data e aplikimit njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.

4. Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR-ja, subjekti ngarkon elektronikisht dhe depoziton në mënyrë shkresore pranë MASR-së, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të IAL-ve përkatëse për ndarjen ose bashkimin e tyre;

b) emërtimin e IAL-së/ve të krijuara;

c) dokumentacionin mbi veprimet e kryera në ortakërinë e re të krijuar në rastin e bashkimit të IAL-ve jo publike;

d) vendimet e organeve dhe autoriteteve drejtuese të IAL-së/ve të përfshirë;

e) planin paraprak të miratuar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit në rastin e ndarjes ose marrëveshjen paraprake të miratuar nga Senatet Akademike dhe Bordet e Administrimit në rastin e bashkimit;

f) organigramat, statutet, rregulloret ekzistuese dhe ato të propozuara, si rrjedhojë e ndarjes/bashkimit të IAL-së/ve;

g) lista e programeve të studimit që do të ofrohen nga IAL-të, të ndarë sipas njësive kryesore dhe bazë, pas përfundimit të procedurës së ndarjes apo bashkimit;

h) personelin akademik, me kohë të plotë, në funksion të programeve të studimit dhe aktmarrëveshjet/kontratat me ta;

i) relacionin nga një ekspert i licencuar, lidhur me ndryshimet infrastrukturore në godinë dhe në mjedise të reja mësimore që nevojiten pas ndarjes/bashkimit;

j) relacionin mbi efektet financiare që do të lindin pas ndarjes/bashkimit.

5. Pas shqyrtimit të plotësimit të standardeve dhe kritereve për bashkimin apo ndarjen e IAL-së, në rast se konstatohen mangësi, brenda 21 ditëve duhet të hartohet raporti i verifikimit me vërejtjet përkatëse dhe njoftohet IAL-ja për plotësim/saktësim dokumentacioni. Nëse edhe pas njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet, brenda një afati 15-ditor, konsiderohet që subjekti ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet.

6. Nëse vlerësimi dhe vendimi përfundimtar është pozitiv, MASR-ja i propozon Këshillit të Ministrave bashkimin/ndarjen e IAL-së/ve.

7. Pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e bashkimit/ndarjes së institucionit të arsimit të lartë, ministria përgjegjëse për arsimin e lartë kryen verifikimet në terren për përmbushjen e standardeve dhe të kritereve, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ministri miraton me urdhër fillimin e veprimtarisë së IAL-së/ve.

KREU II

HAPJA DHE MBYLLJA E DEGËVE TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

A. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR HAPJEN E DEGËVE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

1. Dega e institucionit të arsimit të lartë, vendëse ose e huaj, është:

a) pjesë përbërëse e njësive të selisë qendrore të institucionit;

b) njësi e veçantë në strukturën e institucionit të arsimit të lartë, si njësi kryesore ose njësi bazë.

2. Afati i aplikimit nga IAL-të është deri më datë 15 tetor për vitin akademik pasardhës.

3. Institucionet e arsimit të lartë, që kanë seli qendrore në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj dhe që duan të hapin degë të tyre në Republikën e Shqipërisë duhet të ngarkojnë elektronikisht aplikimin sipas shtojcës nr. 1 të këtij udhëzimi.

4. Në rast të miratimit të aplikimit, IAL-të ngarkojnë elektronikisht dhe depozitojnë në formë shkresore, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentacionin për përmbushjen e standardeve akademike, normativave dhe infrastrukturës, siç parashikohet në këtë udhëzim;

b) vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Për IAL-të e huaja vendimet e organeve përkatëse të saj duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe noterizuara;

c) planbiznesin për mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e veprimtarisë së tyre akademike;

d) vetëdeklarimin për burimin e financimit dhe vërtetim bankar;

e) aktin e hapjes/të riorganizimit dhe aktin e akreditimit të IAL-së dhe të programeve ekzistuese të studimit, të vendit të origjinës;

f) dokumentacionin përkatës për hapjen e programeve të reja të studimit, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.

5. Dokumentacioni i përcaktuar më sipër shqyrtohet nga MASR-ja dhe në rast të vlerësimit pozitiv, nxirret akti i hapjes së degës në nivel njësie kryesore dhe/ose në nivel njësie bazë për institucionet e arsimit të lartë me seli qendrore jashtë Republikës së Shqipërisë, jo më vonë se 3 muaj pas aplikimit të fazës së parë.

6. Hapja e degës së IAL-së, si në nivel njësie kryesore si në nivel njësie bazë, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

B. PROCEDURA PËR MBYLLJEN E DEGËVE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

I. Mbyllja e degës me kërkesë të IAL-së

1. Mbyllja e degëve të IAL-së bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, bazuar në kërkesën e institucionit të arsimit të lartë. IAL-ja ngarkon në sistemin elektronik përkatës kërkesën dhe dokumentacionin për mbylljen e degës.

2. Afati i fundit i depozitimit të dokumentacionit nga IAL-ja, është 6 muaj para përfundimit të vitit akademik. Dokumentacioni duhet të përmbajë:

a) kërkesën e argumentuar;

b) propozimin e Senatit Akademik dhe i Bordit të Administrimit për mbylljen e degës;

c) deklaratën për shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore dhe vendore, e shoqëruar me vërtetimin përkatës nga institucioni përgjegjës;

d) deklaratën mbi masat e marra për mbarimin e rregullt të studimeve nga ana e studentëve;

e) deklaratën mbi pajisjen me dokumentacionin për transferim studimesh të studentëve që nuk i kanë përfunduar studimet;

f) deklaratën për përmbushjen e të gjitha detyrimeve financiare kontraktore ndaj studentëve.

3. Pas shqyrtimit të plotësimit të kritereve për mbylljen e degës së IAL-së, në rast se konstatohen mangësi, brenda 21 ditëve duhet të hartohet raporti i verifikimit me vërejtjet përkatëse dhe njoftohet IAL-ja për plotësim/saktësim dokumentacioni. Nëse edhe pas njoftimit, dokumentacioni nuk plotësohet, subjekti konsiderohet që ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet.

4. Nëse vlerësimi dhe vendimi përfundimtar është pozitiv, mbyllja e degës/ëve të IAL-së, miratohet me urdhër të ministrit.

II. Mbyllja e degës së IAL-së me nismën e MASR-së

1. Mbyllja e IAL-së bëhet me nismën e ministrit përgjegjës për arsimin në rastin e shkeljeve ligjore të konstatuara nga raportet e kontrollit të ligjshmërisë, të akreditimit ose auditimit.

2. MASR-ja njofton paraprakisht Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit, të cilët brenda 30 ditëve nga data e njoftimit shprehin mendimin e tyre.

3. Bazuar në raportet për kontrollin e ligjshmërisë, auditimit apo akreditimit, shoqëruar me provat që faktojnë shkeljet e konstatuara, bëhet mbyllja e degës së IAL-së me urdhër të ministrit.

KREU III

HAPJA, RIORGANIZIMI DHE MBYLLJA E NJËSIVE KRYESORE TË IAL-së

A. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR HAPJEN DHE RIORGANIZIMIN E NJËSISË KRYESORE TË IAL-së

1. Hapja/riorganizimi i njësive kryesore të institucioneve të arsimit të lartë bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, në bazë të propozimit të IAL-së, pas miratimit të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit.

2. Afati i fundit i aplikimit në fazën e parë është data 15 tetor për vitin akademik pasardhës.

3. Institucioni për arsimin e lartë ngarkon në sistemin elektronik përkatës aplikimin për hapjen/riorganizimin e njësive kryesore, sipas shtojcës nr. 1 të këtij udhëzimi.

4. MASR-ja, brenda një afati 30-ditor nga data e aplikimit njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.

5. Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR-ja, subjekti brenda 15 ditëve ngarkon elektronikisht dhe depoziton në mënyrë shkresore pranë MASR, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për hapjen/riorganizimin e njësisë kryesore;

b) dokumentacionin mbi sipërfaqet e shfrytëzueshme të IAL-së të ndara sipas fushave të studimit që parashikohen në dispozicion të njësisë kryesore që do të hapet, për zhvillimin e veprimtarisë së saj, si dhe çdo dokument që provon përmbushjen e standardeve akademike dhe infrastrukturore për njësinë kryesore që hapet/riorganizohet dhe për njësitë bazë të saj;

c) propozimin për ndryshimet e statutit të miratuar, ku të përcaktohen hapja/riorganizimi i njësisë kryesore, strukturat përbërëse të saj, veprimtaritë e autoriteteve dhe organeve drejtuese të saj, zgjedhja apo emërimi i tyre, si dhe çdo ndryshim tjetër i nevojshëm;

d) listën e stafit akademik dhe ndihmësakademik me kohë të plotë ekzistues dhe listën e stafit akademik dhe ndihmësakademik me kohë të plotë të njësisë kryesore të re/riorganizuar, shoqëruar me:

i. jetëshkrimet, diplomat, titujt dhe gradat shkencore;

ii. kontratat e punës apo aktmarrëveshjet e nënshkruara nga palët;

e) listën e programeve të studimeve ekzistuese të listuara që do të mbulohen/mbështeten nga njësia kryesore.

6. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për hapjen/riorganizimin e njësisë kryesore të IAL-së:

a) pas shqyrtimit të dokumentacionit në MASR, në rast se konstatohen mangësi, MASR-ja i kërkon subjektit plotësimin e tyre, brenda afatit kohor prej 15 ditëve. Në rast se dokumentacioni nuk plotësohet brenda këtij afati, konsiderohet që subjekti ka hequr dorë nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

b) në rast të vlerësimit pozitiv të aplikimit dhe dokumentacionit, ministri miraton me urdhër hapjen/riorganizimin e njësisë kryesore.

B. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR MBYLLJEN E NJËSIVE KRYESORE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

1. Kërkesa dhe dokumentacioni për mbylljen e një njësie kryesore ngarkohet në sistemin elektronik përkatës, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të vitit akademik.

2. Dokumentacioni duhet të përmbajë:

a) vendimet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për mbylljen e njësisë kryesore;

b) deklaratën për masat e marra mbi përfundimin e studimeve nga ana e studentëve të njësisë kryesore përkatëse;

c) deklaratën mbi pajisjen me dokumentacionin përkatës për transferim studimesh të studentëve të njësisë kryesore përkatëse që nuk kanë përfunduar studimet, shoqëruar me dokumentacionin përkatës;

d) deklaratën mbi përmbushjen e të gjitha detyrimeve financiare kontraktore ndaj studentëve të njësisë kryesore përkatëse, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

3. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në MASR, në rast se konstatohen mangësi ose në rast pretendimesh nga studentët, brenda 21 ditëve, MASR-ja kërkon pranë subjektit, plotësim apo saktësim dokumentacioni ose dhënie informacioni për plotësimin e pretendimeve. Në rast të mungesës së pretendimeve apo kur dokumentacioni është i plotë, përgatitet raporti për ministrin, i cili miraton me urdhër mbylljen e njësisë kryesore. Organet drejtuese dhe akademike të IAL-së, kanë përgjegjësinë për rregullimin e pasojave që burojnë nga mbyllja e njësive kryesore, mbi procesin e mësimdhënies dhe sistemimin e studentëve.

KREU IV

HAPJA, RIORGANIZIMI DHE MBYLLJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

A. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

1. IAL-ja ngarkon në sistemin elektronik përkatës aplikimin, sipas shtojcës nr. 2, për hapjen e programeve të studimit, brenda datës 30 shtator për vitin akademik pasardhës.

2. MASR-ja, brenda një afati 60-ditor nga data e aplikimit njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.

3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR, IAL-ja, brenda 15 ditëve, ngarkon elektronikisht dhe depoziton në mënyrë shkresore pranë MASR-së, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) propozimin e njësisë bazë ku do të ofrohet programi i studimit;

b) vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton hapjen e programit/eve të studimit. Në rast se propozimi vjen nga një institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkon financim nga buxheti i shtetit depozitohet miratimi paraprak i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL);

c) mandatpagesën për tarifën që paguhet për vlerësimin nga ekspertët e programit të studimit, sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 109/2017, të ndryshuar;

d) listën e plotë emërore të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme për programin e studimit, ngarkesën mësimore dhe formën e punësimit, si dhe titullin akademik dhe gradën shkencore përkatëse;

e) dosja e personelit përmban:

i. kontratat e punës me personelin e planifikuar për t'u angazhuar me kohë të plotë, në rast të hapjes së programit ose vërtetim nga rektori mbi kategorinë e personelit akademik dhe kohëzgjatjen e kontratës me ose pa afat të caktuar;

ii. dëshmitë që vërtetojnë shkollimin e kualifikimet, titujt dhe gradat (fotokopje);

iii. letrën e angazhimit të çdo anëtari të personelit akademik të planifikuar për t'u angazhuar me kohë të pjesshme;

iv. lejen e punëdhënësit kryesor për anëtarët e personelit akademik me kohë të pjesshme;

v. me përjashtim të personelit akademik nga një IAL e huaj, në rastin e hapjes së një programi studimi në gjuhë të huaj, personeli akademik duhet të ketë fituar së paku një diplomë të një programi studimi në një nga ciklet e studimeve universitare të kryer në gjuhën në të cilën do të zhvillohet programi i studimit ose të zotërojë dëshmi për nivelin C1 të njohjes së gjuhës respektive në të cilën do të ofrohet programi, vërtetuar përmes testeve ndërkombëtare, të cilat ndodhen në listën e miratuar nga MASR-ja për pranimet në ciklin e dytë dhe të tretë.

4. Në rast se IAL-ja parashikon zgjerim të infrastrukturës ekzistuese në dispozicion të programeve, të depozitohet:

a) relacioni i verifikimit të godinës së re, i përpiluar nga një person juridik apo fizik i licencuar nga organi kompetent shtetëror, sipas kuadrit ligjor në fuqi (shoqëruar me kopjen e njësuar me origjinalin të licencës së këtij të fundit);

b) planimetria dhe planvendosja e godinës/pjesës së re të institucionit, leja e shfrytëzimit të godinës, së bashku me bazën materiale dhe didaktike;

c) akti i posedimit të godinës apo kontrata e qirasë me afat së paku 3-vjeçar, e shoqëruar me vërtetimin e pronësisë së qiradhënësit.

5. Dokumentacioni mbi programet e studimit, të plotësuar në të gjitha elementet e tij, në zbatim të vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, është si më poshtë:

a) rregullore e programit të studimit;

b) plani mësimor për çdo program studimi;

c) programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkruara nga titullarët/pedagogët e tyre (për programet profesionale).

6. Në rast bashkëpunimi me një institucion tjetër vendës ose të huaj të arsimit të lartë për hapjen e programeve të përbashkëta të studimit, së bashku me dokumentacionin e mësipërm, kërkohet depozitimi në gjuhë shqipe, i përkthyer dhe noterizuar edhe i dokumenteve si më poshtë:

a) akti i akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit;

b) dokumenti zyrtar i bashkëpunimit (marrëveshje kuadër), ku parashikohet ofrimi i programeve të përbashkëta të studimit;

c) marrëveshja specifike për programin konkret të studimit, ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij, si: autorësia dhe pronësia e syllabuseve të depozituara, gjuha dhe metoda e mësimit dhe provimeve, shkëmbimi i stafit pedagogjik etj. Kjo marrëveshje mund të jetë edhe në formën e rregullores së përbashkët mësimore;

d) lloji dhe modeli i diplomës (e dyfishtë, e shumëfishtë, e përbashkët), i miratuar nga IAL-të.

7. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për hapjen e programeve të studimit:

a) shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të mësipërm realizohet në MASR, brenda 21 ditëve nga depozitimi. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR-ja i kërkon IAL-së që të bëjë plotësimin/saktësimin e dokumentacionit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Në mungesë të plotësimit të dokumentacionit brenda këtij afati, konsiderohet se subjekti ka hequr dorë në heshtje nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

b) në rast se dokumentacioni konsiderohet i plotë, dokumentacioni i kalon për vlerësim ekspertëve të caktuar nga MASR-ja, sipas fushave të ekspertizës dhe të zgjedhur nga lista vjetore e ekspertëve të miratuar nga ASCAL-ja, të caktuar me urdhër të ministrit. Ekspertët, brenda 21 ditëve, dorëzojnë raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni vlerësohet nga ekspertët se është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, institucionit i kërkohet plotësimi i tij brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit. Në mungesë të plotësimit të dokumentacionit, brenda këtij afati, konsiderohet se subjekti ka hequr dorë në heshtje nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

c) dokumentacioni i plotësuar i kalon për rivlerësim ekspertëve, të cilët, brenda 15 ditëve, dorëzojnë raportin e rivlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është përsëri i paplotë, praktika arkivohet;

d) pas vlerësimit përfundimtar pozitiv nga ekspertët, ministri miraton me urdhër hapjen e programit të studimit.

B. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT MBI MASËN 20% TË SHPREHUR NË KREDITE

1. IAL-ja ngarkon aplikimin në sistemin elektronik përkatës, sipas shtojcës nr. 2, për riorganizimin e programeve të studimit, brenda datës 30 shtator për vitin pasardhës, i cili shqyrtohet nga MASR.

2. MASR-ja, brenda një afati 15-ditor nga data e aplikimit njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.

3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR-ja, subjekti ngarkon elektronikisht dhe depoziton në mënyrë shkresore pranë MASR-së, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e Senatit Akademik dhe i Bordit të Administrimit të IAL-së;

b) planin mësimor ekzistues dhe planin mësimor të riorganizuar;

c) rregulloren e programit të studimit që riorganizohet;

d) programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkruara nga titullari/pedagogu i lëndës (për programet profesionale);

e) listën e stafit akademik në funksion të programit të studimit dhe formën e angazhimit (me kohë të plotë, me kohë të pjesshme) shoqëruar me kontratat e punësimit ose vërtetim të rektorit mbi formën e punësimit të tyre dhe kohëzgjatjen me ose pa afat të caktuar, sipas kategorisë së personelit.

4. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për riorganizimin e programeve të studimit mbi masën 20% të shprehur në kredite:

a) shqyrtimi i dokumentacionit bëhet në MASR, brenda 21 ditëve nga data e depozitimit. Në rastet kur konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR i kërkon IAL-së të bëjë plotësimin/saktësimin e dokumentacionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Në

mungesë të plotësimit të dokumentacionit, brenda këtij afati, konsiderohet se subjekti ka hequr dorë në heshtje nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

b) dokumentacioni i plotësuar i kalon për vlerësim ekspertëve. Ekspertët, brenda 21 ditëve, dorëzojnë raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni vlerësohet se është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga ekspertët, IAL-së i kërkohet plotësimi i tij, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit. Në mungesë të plotësimit të dokumentacionit, brenda këtij afati, konsiderohet se subjekti ka hequr dorë në heshtje nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

c) në rast plotësimi nga IAL, dokumentacioni i kalon për rivlerësim ekspertëve, të cilët brenda 15 ditëve dorëzojnë raportin e rivlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është përsëri i paplotë, praktika përkatëse arkivohet;

d) pas vlerësimit pozitiv përfundimtar të ekspertëve, ministri miraton me urdhër riorganizimin e programit të studimit;

e) në rastin kur riorganizimi i programit bëhet nën 20% të përmbajtjes së shprehur në kredite, për programe të akredituara, IAL-ja depoziton pranë MASR-së, vendimin e Senatit Akademik. MASR-ja njoftohet me shkrim nga institucioni i arsimit të lartë për ndryshimet e bëra në programet e studimit jo më vonë se 6 muaj para fillimit të vitit akademik. Ndryshimet nën 20% të shprehura në kredite të përmbajtjes së programit të studimit nuk duhet të ndryshojnë emërtesën e programit të studimit, por vetëm ndryshimet profilizuese. IAL-ja, nëse është e nevojshme, reflekton ndryshimet në diplomën e lëshuar.

C. PROCEDURAT PËR MBYLLJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

1. Akti për hapjen e një programi studimi shfuqizohet në rastet si më poshtë:

a) IAL-ja i drejtohet ministrit përgjegjës për arsimin me kërkesën për mbylljen e një ose disa programeve të studimit të ofruar nga ky institucion jo më vonë se 6 muaj para fillimit të vitit të ri akademik. Kërkesa duhet të shoqërohet me vendimet përkatëse të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit. IAL-ja është përgjegjëse për pasojat juridike të ardhura nga mbyllja e programit për studentët që kanë përfunduar programin apo janë në proces ndjekjeje të programit;

b) kur IAL-ja nuk e aktivizon programin brenda dy viteve akademike të njëpasnjëshme nga dalja e urdhrit të hapjes, leja e dhënë për hapjen e këtij programi studimi bëhet e pavlefshme;

c) kur konstatohet mosrespektimi, nga ana e një IAL-je, i kritereve të ligjshmërisë dhe/ose të akreditimit të një programi studimi;

d) kur IAL-ja nuk ka regjistruar studentë të rinj në programin përkatës të studimit për 2 vjet të njëpasnjëshëm akademike.

2. Ministri, me urdhër, shfuqizon aktin e hapjes së programit ose mbyll programin përkatës të studimit. IAL-ja duhet të garantojë përfundimin e studimeve për studentët e regjistruar në programin që kërkohet të mbyllet.

3. Studentët që nuk kanë përfunduar ende studimet në programin që mbyllet, kanë të drejtë të transferojnë studimet brenda të njëjtit institucion ose në një institucion tjetër të arsimit të lartë.

D. KRITERET E POSAÇME PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT, "SPECIALIZIME AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË"

1. Përveç kritereve të përgjithshme të këtij udhëzimi, për hapjen e programeve të ciklit të tretë të studimit "Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë", duhet të plotësohen edhe kriteret e posaçme, si më poshtë:

a) të organizohen dhe realizohen nga IAL-të, të cilat janë të integruara me strukturat shëndetësore universitare ose nga IAL-të, që kanë marrëveshje bashkëpunimi me strukturat shëndetësore universitare;

b) strukturat shëndetësore universitare dhe të rrjetit formues duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për strukturat shëndetësore, si dhe standardet specifike të programeve të studimit, në të dyja rastet e përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike;

c) IAL-të, publike dhe jopublike, vendëse ose të huaja, që paraqesin kërkesën për hapjen e programeve të studimit pranë ministrisë, duhet të kenë zhvilluar dhe akredituar/riakredituar programe të studimit të integruara të ciklit të dytë në fushën e mjekësisë, të paktën me kohëzgjatje 5-vjeçare (300 ECTS) në programet Stomatologji dhe Farmaci dhe, të paktën 6-vjeçare (360 ECTS), në programin Mjekësi e Përgjithshme;

d) strukturat shëndetësore universitare që janë pjesë integrale e tyre duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për strukturat shëndetësore universitare, si dhe standardet specifike të programeve të studimit. Të njëjtat kritere dhe standarde specifike duhet të plotësojnë edhe strukturat shëndetësore universitare me të cilat IAL-ja që paraqet kërkesën për hapjen e programeve të studimit, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e programit të studimit;

e) IAL-të që paraqesin kërkesën për hapjen e programeve të studimit, duhet të dokumentojnë/të verifikojnë paraprakisht që struktura spitalore dhe rrjeti formues që do të angazhohet në secilin program studimi, plotëson kriteret dhe standardet specifike të programeve të studimit;

f) programet e studimit mund të organizohen dhe të zhvillohen në bashkëpunim/bashkërisht nga IAL-të, të cilat kanë domosdoshmërisht njësi bazë dhe njësi kryesore në fushën e mjekësisë, mbi bazën e marrëveshjeve ndërinstitucionale përkatëse, si dhe marrëveshjeve specifike për organizimin e këtyre programeve. Në këtë rast, institucioni përgjegjës për realizimin dhe mbarëvajtjen e tyre është IAL-ja, pranë të cilës zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë dhe mbahet dokumentacioni i procesit mësimor. IAL-ja përgjegjëse për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit duhet të disponojë burimet financiare, infrastrukturën dhe personelin akademik të nevojshëm për realizimin e programit të studimit;

g) për realizimin e programeve të studimit, IAL-të mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me struktura shëndetësore universitare të huaja, të licencuara për zhvillimin e aktivitetit shëndetësor në vendin e origjinës. Në këtë rast, kërkesa e IAL-së për hapjen e programeve të studimit shoqërohet edhe me statusin ligjor dhe dokumentacionin ligjor të strukturës shëndetësore universitare të huaj për zhvillimin e aktivitetit shëndetësor në vendin e origjinës, si dhe konfirmimin e këtij statusi nga ministri i MASR-së dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë në Republikën e Shqipërisë;

h) për realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me IAL-të të huaja zbatohen standardet shtetërore të cilësisë të vendit, ku zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë mësimore të programit;

i) nevoja për formim të specializuar, në kuadër të programit të studimit dhe madhësia e rrjetit formues përcaktohet mbi bazën e kapacitetit formues të strukturës shëndetësore, edhe në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë;

j) rrjeti formues është përcaktuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në bazë të marrëveshjeve dhe protokolleve të nxitura nga IAL-të e interesuara.

2. Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë, "Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë":

a) personeli akademik i programit të studimit përbëhet nga pedagogë të angazhuar me punë klinike/diagnostike dhe me tituj akademikë, si: profesor, profesor i asociuar ose gradë shkencore doktor/PhD;

b) personeli akademik i programit të studimit përbëhet nga:

i. personel akademik me kohë të plotë me tituj akademikë dhe grada shkencore, jo më pak se 50% të pedagogëve që mbulojnë programin e studimit. Të paktën 1 (një) pedagog me kohë të plotë, me titullin akademik profesor, duhet t'i përkasë fushës së programit të studimit;

ii. personel akademik, i cili ushtron profesionin në strukturat shëndetësore universitare të përcaktuara, sipas legjislacionit në fuqi në masën jo më shumë se 50% e pedagogëve që mbulojnë programin e studimit. Ky personel akademik të ketë eksperiencë didaktike-formuese dhe eksperiencë profesionale-klinike. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës nga personeli i strukturave shëndetësore të rrjetit formues kërkon miratimin paraprak të drejtuesit të strukturës shëndetësore;

iii. personel akademik me kohë të pjesshme, për disiplina të veçanta, jo më shumë se 10% e pedagogëve që mbulojnë programin e studimit, me të cilët lidhet një kontratë, sipas nevojave të strukturës së programit të studimit;

c) IAL-të dhe strukturat shëndetësore të rrjetit formues të tyre, sipas kompetencave respektive, përcaktojnë mënyrën e përfshirjes së personelit të strukturave shëndetësore universitare, në zbatimin e programit të studimit;

d) përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit duhet të jetë personel akademik me kohë të plotë. Përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit është njëkohësisht edhe kryetari i Këshillit Drejtues të programeve të studimeve specializuese afatgjata, i cili zgjidhet nga anëtarët e këtij këshilli me shumicë të thjeshtë votash (50% + 1). Përgjegjësi i një programi studimi në një IAL nuk mund të ngarkohet me përgjegjësinë e drejtimit të një tjetër programi studimi që realizohet nga IAL-të e tjera;

e) këshilli drejtues i programit të studimit të specializimeve afatgjata punon për përgatitjen, organizimin dhe kontrollin e programit të specializimit përkatës. Këshilli Drejtues i programit përkatës të studimeve specializuese afatgjata ngrihet në nivel njësie kryesore dhe përbëhet nga të paktën 5 (pesë) pedagogë me kohë të plotë të IAL-së, jo më pak se 2 (dy) pedagogë për çdo program studimi që ofron njësia kryesore, të cilët duhet të jenë figura të spikatura në fushën e specialitetit përkatës, me përvojë klinike dhe akademike të paktën 10-vjeçare;

f) drejtimi i specializantit i ngarkohet, në cilësinë e udhëheqësit, një pedagogu (udhëheqës akademik) dhe/ose një anëtari të personelit të strukturës shëndetësore të rrjetit formues (udhëheqës klinik/tutori) të programit të studimit, i cili/të cilët udhëheqin specializantin gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe janë përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit, si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e punës së studentit;

g) fusha e specializimit të udhëheqësit duhet të përputhet me atë të programit specializues që ndjek specializanti. Udhëheqësi klinik/tutori ka një eksperiencë profesionale të paktën 10-vjeçare (dhjetëvjeçare) me përvojë klinike në fushën klinike përkatëse dhe ka të paktën gradën shkencore doktor. Numri maksimal i studentëve specializantë që mund të ndiqet nga udhëheqësi akademik/klinik është 3 (tre);

h) udhëheqësi klinik/tutori është personel i punësuar me kohë të plotë pranë njërës nga strukturat e rrjetit formues dhe ka kontratë bashkëpunimi me IAL-në që ofron programin specializues. Kur tutori nuk është pjesë e personelit me kohë të plotë të strukturës që ofron programin e specializimit, specializantit i caktohet edhe një udhëheqës akademik, anëtar i personelit akademik me kohë të plotë të institucionit. Për caktimin e udhëheqësit klinik merret mendimi i drejtuesit të strukturës shëndetësore dhe udhëheqja e tij klinike konsiderohet si pjesë e orarit të punës;

i) aktiviteti i mësimdhënies kryhet njëkohësisht me aktivitetin asistencial/profesional, në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës në selinë ku realizohet programi i studimit nga personeli i strukturave shëndetësore universitare kërkon miratimin paraprak të drejtuesit të këtij shërbimi;

j) specializanti i përfshirë në rrjetin formues merr gradualisht përgjegjësi klinike gjatë specializimit;

k) kriteret, kuotat, tarifat dhe modalitetet e pranimit në programet e studimit propozohen nga njësia/njësitë bazë propozuese të programit të studimit, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Ato bëhen publike pas miratimit nga organet drejtuese të IAL-së dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MASR-së;

l) IAL-të duhet të përcaktojnë modalitetet e koordinimit dhe gjenerimit të kuotave për specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, me kërkesat të sistemit shëndetësor kombëtar nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;

m) gjatë periudhës së studimeve në një program studimi, studenti nuk mund të ndjekë njëkohësisht programe të tjera studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

3. Organizimi i programit të studimit të ciklit të tretë, "Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë":

a) programet e studimit të ciklit të tretë, "Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë", përfshijnë të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese dhe 20% të ECTS-ve totale për studime të organizuara teorike, të shpërndara në vite, sipas një plani të studimit;

b) raporti i lëndëve të përcaktuara në programin e studimit përbëhet, nga:

i. 60% lëndë specifike;

ii. 30% lëndë karakterizuese të fushës;

iii. 5% lëndë të formimit bazë, ndërdisiplinore ose integruese dhe për aktivitete të tjera;

iv. 5% provimi përfundimtar etj.;

v. 15% e totalit të lëndëve specifike dhe 15% e totalit të lëndëve karakterizuese duhet të jenë lëndë me zgjedhje;

c) njësia bazë propozuese harton rregulloren e programeve të studimeve specializuese afatgjata, me anekset specifike për çdo program, në të cilën parashikohen të gjitha proceset dhe elementet përbërëse të nevojshme për realizimin e programit dhe ia paraqet Senatit Akademik të IAL-së për miratim. Në rregullore duhet të përcaktohet edhe:

i. vlerësimi i njohurive teorike dhe praktike të specializantit, në fund të çdo viti akademik;

ii. modalitetet e vlerësimit përfundimtar të specializantit, i cili i nënshtrohet provimit përfundimtar përkatësisht për njohuritë teorike, praktike ose paraqitjes së temës eksperimentale-studimore të diplomës;

d) nevoja për formim të specializuar në kuadër të programit të studimit dhe madhësia e rrjetit formues përcaktohet mbi bazën e kapacitetit formues të strukturës shëndetësore universitare edhe në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë;

e) për realizimin e programit të studimit, IAL-të garantojnë personelin akademik të nevojshëm me tituj dhe grada shkencore;

f) në kuadër të programit të studimit, specializantët caktohen pranë njësive/shërbimeve/reparteve të strukturave shëndetësore universitare, pjesë e rrjetit

formues, në përputhje me planin e studimit të miratuar dhe për kohën e nevojshme për të fituar aftësitë profesionale.

E. KRITERET E POSAÇME PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT "DOKTORATË"

1. Përveç kritereve të parashikuara në VKM-në nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementët e programit të studimit ofruar nga institucioneve të arsimit të lartë", të ndryshuar, duhet të plotësohen edhe kriteret e posaçme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit "Doktoratë", si më poshtë:

a) programet e studimit "Doktoratë" mund të hapen dhe të ofrohen nga IAL-të publike dhe jopublike që kanë statusin Universitet ose Akademi, vendëse ose të huaja, të cilat kanë programe studimi të licencuara dhe akredituara/riakredituara të ciklit të parë dhe të dytë në të njëjtën fushë ose fushë të përafërt me atë të programit "Doktoratë";

b) IAL-të që paraqesin dokumentacionin sipas kritereve të përgjithshme të këtij udhëzimi dhe kritereve të posaçme të këtij kreu, për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit "Doktoratë";

c) IAL-ja depoziton së bashku me dokumentacionin për hapjen e programeve të studimit edhe projektet kërkimore-shkencore të financuara, mbi të cilat zhvillohen programet e studimit;

d) IAL-ja ofruese e programit të studimit duhet të ketë struktura administrative dhe kërkimore të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara për kryerjen e kërkimeve dhe mund të bashkëpunojë me një apo më shumë IAL, vendëse apo të huaja, në bazë të marrëveshjeve të lidhura midis tyre, në mbështetje të procesit dhe përmirësimit të standardeve.

2. Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë".

a) personeli akademik i angazhuar në programin e studimit përbëhet nga pedagogë me titull akademikë të kategorisë "Profesor";

b) në rastet kur programet e studimit do të kryhen në bashkëpunim/bashkërisht me një IAL-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, udhëheqësi i IAL-së së huaj mund të jetë edhe me gradën shkencore "doktor"/PhD.

KREU V

KONTROLLET, MASAT DHE ANKIMI

1. Institucionet e arsimit të lartë, si dhe programet e studimit të ofruara prej tyre u nënshtrohen, si rregull, kontrolleve të zbatimit të ligjshmërisë nga MASR-ja, të paktën një herë në 3 vjet. Nëse gjatë kontrolleve evidentohen shkelje të dispozitave të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" apo të akteve nënligjore, ministrit dhe IAL-së i dërgohet raporti mbi shkeljet e evidentuara.

2. Pas njoftimit mbi shkeljet dhe detyrimet mbi zbatimin e normave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, IAL-ja dërgon komentet dhe sqarimet e tij në lidhje me raportin.

3. MASR-ja, në raportin përfundimtar pasqyron saktësimet që gjykohen të arsyeshme, si dhe qëndrimin përkatës për pjesën e refuzuar të vërejtjeve të institucionit të arsimit të lartë.

4. Pas marrjes së raportit përfundimtar, IAL-ja dërgon një deklaratë të firmosur (deklaratë angazhimi), në të cilën angazhohet se do të plotësojë, brenda afatit të përcaktuar nga MASR-ja, kriteret e paplotësuara, sipas kërkesave të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në fuqi.

5. Në rast se IAL-ja nuk arrin të zbatojë angazhimet brenda afatit të përcaktuar, ministri pezullon programin përkatës të studimit deri në përmbushjen e detyrimeve ose nxjerr aktin për mbylljen e programit të studimit.

6. Mbyllja e programeve të studimit bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin. Kur programi mbyllet me kërkesë të institucionit të arsimit të lartë, paraprakisht duhet të garantojë përfundimin e studimeve për studentët në proces.

7. Në të gjitha rastet e refuzimit nga ana e MASR-së, të parashikuara në këtë udhëzim, institucioni i arsimit të lartë ka të drejtë ankimimi.

8. Ankimi duhet të paraqitet në MASR jo më vonë se 10 ditë pune nga data e përfundimit të afatit të caktuar ose të shtyrë, për përfundimin e procedurës.

9. Në rast ankimi nga IAL-ja, ministri i kërkon mendim të argumentuar me shkrim strukturave përgjegjëse në MASR. Në përfundim është ministri i MASR-së, që vendos pranimin apo refuzimin e aplikimit/kërkesës së depozituar. Në rast refuzimi, praktika arkivohet në MASR.

KREU VI

DISPOZITAT TRANZITORE DHE TË FUNDIT

1. Shpenzimet e ekspertëve paguhen nga kërkuesi. Numri i ekspertëve, tarifat që paguhen nga IAL-të dhe masa e pagesës së tyre përcaktohen sipas VKM-së nr. 109/2017,

“Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, të ndryshuar.

2. Kur subjekti juridik kërkon të transferojë aktin e hapjes të IAL-së një subjekti tjetër juridik, ai duhet të marrë paraprakisht miratimin me shkrim nga ministri përgjegjës për arsimin. Subjekti juridik që ka marrë të drejtën, duhet të përmbushë të gjitha kushtet dhe standardet e përcaktuara në VKM-në nr. 418/2017, të cilat verifikohen në vijimësi nga MASR-ja.

3. Udhëzimi nr. 11, datë 28.2.2011, “Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, programeve të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimeve jouniversitare, të natyrës profesionale, si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës”, të ndryshuar dhe udhëzimi nr. 31, datë 29.12.2017, “Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë”, shfuqizohen.

4. Deri në përgatitjen dhe funksionimin e plotë të sistemit elektronik, shkëmbimi i dokumentacionit do të bëhet në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës elektronike zyrtare: aplikime.ial@arsimi.gov.al.

5. Përjashtimisht, aplikimet për programet e studimit për vitin akademik 2020–2021, do të pranohen deri më 15 shkurt të vitit 2020 dhe shqyrtohen brenda 30 ditëve nga data e aplikimit nga MASR-ja. Subjektet aplikuese të paraqesin dokumentacionin brenda 15 ditëve nga data e vlerësimit pozitiv të aplikimit.

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Besa Shahini

SHTOJCA NR. 1

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

PROJEKT PROPOZIM PËR HAPJE/RIORGANIZIM TË NJË INSTITUCIONI TË ARSIMIT TË LARTË, HAPJE, MBYLLJE E DEGËVE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, HAPJE/RIORGANIZIM I NJËSIVE KRYESORE TË IAL-SË, BASHKIM OSE NDARJE E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË.

1. Institucioni IAL Shkruani emrin e plotë të institucionit	2. Aplikimi (zgjidh një): - Hapje IAL ☐ - Riorganizim IAL ☐ - Hapje e degëve të IAL-së ☐ - Hapje njësie kryesore të IAL-së ☐ - Riorganizim i njësisë kryesore të IAL-së ☐ - Bashkim i IAL-ve ☐ - Ndarje e IAL-ve - Mbyllje ☐

3. Të dhëna mbi personin e kontaktit:

Emër, mbiemër:
Pozicioni në IAL:
Tel:
E-mail:

4. Deklaratë e administratorit të shoqërisë/titullarit të IAL-së për plotësimin e standardeve akademike dhe infrastrukturore, të paradukuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

5. Të dhëna mbi aktin e regjistrimit në QKB, si dhe pershkrim i objektit të veprimtarisë.

6. Firma (emër / mbiemër) e titullarit të institucionit dhe vula e institucionit.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT PËR HAPJE/RIORGANIZIM TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, HAPJE, MBYLLJE E DEGËVE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, HAPJE/RIORGANIZIM I NJËSIVE KRYESORE TË IAL-SË, BASHKIM OSE NDARJE E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

Kjo shtojcë paraqet një udhëzues/strukturë propozimi i cili duhet ndjekur për të propozuar hapje/riorganizim institucioni të arsimit të lartë (IAL), hapje/mbyllje të degëve të IAL-së, hapje/riorganizim të njësive kryesore të IAL-së, ose bashkim/ndarje të IAL-së për miratim në MASR.

Disa rregulla të përgjithshme:

- Propozimet dorëzohen elektronikisht dhe shkruhen në *Times New Roman* ose *Arial* (12 point font).
- Referimi e shtojcave (nëse ka) në fund të propozimit duhet të ndjekë rendin e referimit të tyre në tekst.
- Dokumentacioni dhe të dhënat që përmenden duhet cituar në mënyrë të plotë. Nëse përfshihet një URL (adresë interneti) sigurohuni që të jetë funksionale dhe lidhet me dokumentin e cituar.
- Propozimi duhet të jetë sa më specifik dhe të dhënat që paraqiten në të duhet të lidhen qartazi me propozimin për shqyrtim nga MASR.
- Elementët përbërës të propozimit, për lehtësi, janë përfshirë si një listë për t'u plotësuar. Gjithsesi, propozimi duhet të jetë i strukturuar si një i tërë dhe të përbëjë një narrativë kohezive dhe të rrjedhshme.
- Projekt propozimi nuk duhet të kenë gabime ortografike dhe/shkrimore e duhet të formatohet sipas udhëzimeve të kësaj shtojce.

Ky udhëzues/strukturë propozimi shërben për grupin e punës që do të shkruajë propozimin për shqyrtim nga MASR. Edhe pse ky dokument përmban një sërë elementesh që duhet të jenë në propozim, ai nuk është shterues. Në çdo kohë MASR mund të kërkojë dokumentacion shtesë dhe sqarime të miratojnë të propozimit në kuadër të vendimmarrjes.

a) Të dhëna mbi institucionin/degën/njësinë kryesore/institucionet (që do të bashkohen ose ndahen):

Ky seksion paraqet një përmbledhje *analize* të propozimit duke përfshirur se si përputhet me strategjinë dhe nevojën e IAL-së si dhe me strategjitë e arsimit, shkencës dhe punësimit në vend.

Seksioni duhet të artikulojë, në mënyrë të shtjelluar, justifikimin për nismën e propozuar dhe si kjo nismë adreson nevojat lokale, rajonale, kombëtare dhe/ose ndërkombëtare. Ky seksion duhet përfshirë në mënyrë të sigurtë me një aplikim për grant kërkimor. Lexuesi i tretë/vlerësuesi duhet të bindet që programi i propozuar adreson problemet reale ciklorane për zhvillimin rajonal.

Duhet të sqarojnë dhe të bazohen evidenca dhënë paraqitur për të treguar që nismë i shtrihet nevojave reale të rajonit/vendit. Vetëm burimet dhëna që mbështesin direkt nevojën e nismës të propozuar duhet përfshirë. Seksioni duhet të sqarojë se çfarë burimesh të veçanta ka institucioni që do të kenë efekt në suksesin e aplikimit (p.sh. aparatë studimore, ekspertizë kërkimore, etj.).

Ky seksion duhet të jetë organizuhet i gjatë që të demonstrojë kërkesën dhe nevojën për nismën e propozuar. Sigurohuni që elementët e mëposhtëm të përfshihen: (1) citime të plota për burimet e përdorura; (2) citime në tekst për burimet e përdorura; (3) adresat e burimeve online.

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- Përshkrimi i përgjithshëm i nismës, qëllimit dhe objektivave të rëndësishëm që propozohet të hapet/reorganizohet, bashkëthur/ose ndahet.
- Analiza e *dotajave* dhe e burimeve mbi të dhëna empirike dhe të verifikueshme e situatës prej të cilës burimi nevoja për nismën që mbështet do të ndërmerrë (hapja/reorganizimi të IAL-së / hapja e degëve të IAL-së / hapja/reorganizimi të njësisë kryesore të IAL-së / bashkimi ndarja të IAL-së).
- Risia që sjell kjo nismë, problematikat që ajo adreson për vetë IAL-në dhe territorin që përmbush në sistemin e arsimit të lartë në vend.
- Analiza SWOT e aplikimit për hapje reorganizim të IAL-së / hapje e degëve të IAL-së / hapja/reorganizim të njësisë kryesore të IAL-së / bashkim ndarje të IAL-së.

b) Personeli akademik dhe ndihmës akademik në fushën të strukturës së propozuar (IAL/degë/njësi kryesore)

Në këtë seksion objektivat të dhëna mbi personelin akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar/që do të angazhohet në strukturën e re, duke përfshirë informacionin mbi:

- Numrin e personelit akademik ekzistues njësisë bazë (personel me kohë të plotë/pjesëmarrës)
- Numrin e personelit akademik të përfshirë në fushën karakteristikave (personel me kohë të plotë/pjesëmarrës).
- CV e shkurtuar (e personelit akademik nga IAL-që do të angazhohet në strukturën e re (titulli grada, fusha e ekspertizës kërkimore) angazhimin në programe të personalizuara të aplikantit të fushës së studimit, etj.

- Numrin e personelit akademik me karakter mbështetës në funksion të strukturës së propozuar.

c) Infrastruktura akademike në funksion të IAL-së dega/njësisë kryesore.

Në këtë seksion shtjellohet informacioni mbi infrastrukturën akademike në shërbim të strukturës së propozuar, duke u fokusuar në:

- Numrin dhe sipërfaqet e auditoreve.
- Laboratorët dhe mjediset në dispozicion për realizimin e praktikës profesionale.
- Bibliotekën, numrin i titujve, numrit i postave të leximit, e-librarit, etj.
- Zyrat për stafin akademik dhe ndërtesën akademike.

d) Analizë e tregut të punës.

Ky seksion artikulon mënyrën se si ofrimi i propozuar i përgjigjet nevojave të tregut të punës, duke përfshirë kërkesën aktuale dhe të parashikuar të tregut të punës për të diplomuarit e programit.

Analiza e tregut të punës duhet të përmbushë me objektivat e mëposhtëm:

- Të identifikojë se si ofrimi i propozuar mbi aftësitë/njohuritë/potencialin e studentëve për të përfituar aftësi që përputhen me kërkesat e tregut të punës me qëllim punësimin etabël me të ardhura sa më të larta.
- Të identifikojë se si ofrimi i propozuar përmbush kërkesat e punëdhënësve për forcën e punës në një periudhë afat-mesme.
- Të identifikojë se si ofrimi i propozuar përshtatet me, ose përmbush, politikat kombëtare të punësimit dhe zhvillimit.

Sigurohuni që në analizë të përfshihen elementët e mëposhtëm: (1) citime të plota për burimet e përdorura; (2) citimi në tekst për burimet e përdorura; (3) adresat e burimeve online.

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- Programet e studimit që do të ofrohen nga struktura e propozuar dhe periodicitetin i tyre në lidhje me programet e studimit të ofruar nga IAL-të tjera.
- Trendi vendas dhe rajonal i punësimit në sektorët ku bëjnë pjesë programet e studimit që do të ofrohen nga IAL-ja dega/njësia kryesore, referuar burimeve zyrtare si INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, organizmat ndërkombëtarë, etj.
- Nevoja e papërmbushur e tregut të punës që plotësohet IAL/dega/njësia kryesore e propozuar.
- Strukturat në dispozicion të studentëve për të bërë ndërlidhjen me tregun e punës, si dhe burimet financiare në dispozicion të këtyre strukturave.
- Punësimi potencial i studentëve.
- Marrëveshjet/kërkesa paraprake nga operatorë privatë institucionë publikë për punësimin eventual të studentëve pas diplomimit.

SHTOJCA NR. 2

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

PROJEKT PROPOZIME PËR HAPJE/RIORGANIZIM PROGRAMI STUDIMI

1. Institucioni IAL Shkruani emrin e plotë të institucionit.	2. Aplikimi (cgjidh një): Program i ri _____ Riorganizim programi _____
3. Emërtimi i programit të propozuar për hapje/riorganizim. Shkruani emërtimin e plotë të programit.	
4. Semestri dhe viti akademik i hapjes.	
5. Të dhënat për aktin e hapjes/akreditimit të IAL dhe/ose njësisë kryesore që ofron programin e studimit.	6. Vendimi i miratimit nga Senati Akademik. Vendimi i miratimit nga Bordi Administrimit.
7. Nëse është një program i përbashkët studimi identifiko IAL-të bashkëpunuese dhe ato aktin e bashkëpunimit mes IAL-ve dhe marrëvesjen specifike për realizimin e programit të studimit.	
8. Programi ofrohet nga/në: Departamenti i _____ Fakulteti i _____ Kompozi godina _____	
9. Të dhëna mbi personat e kontaktit përgjegjës për programin e studimit: Emër, mbiemër: Pozicioni në IAL: Tel: E-mail:	
10. Deklarate e titularit të IAL për plotësimin e standardeve akademike dhe infrastrukturore, të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
11. Firma (emër : mbiemër) e titularit të institucionit dhe vula e institucionit.	

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PROPOZUAR PËR HAPJE/RIORGANIZIM

Kjo shtojcë paraqet një udhëzues/strukturë propozimi i cili duhet ndjekur për të propozuar hapje/riorganizim programesh studimi për miratim në MASR.

Rregulla të përgjithshme:

- Propozimet dorëzohen elektronikisht dhe shkruhen në *Times New Roman* ose *Arial* (12 point font).
- Renditja e shtojcave në fund të propozimit duhet të ndjekë rendin e referimit të tyre në tekst.
- Dokumentacioni dhe të dhënat që përmenden ëshen cituar në mënyrë të plotë. Nëse përfshihet një URL (adresë internetë) sigurohuni që të jetë funksionale dhe lidhet me dokumentin e cituar.
- Elementët përbërës të propozimit, për lehtësi, janë përfshirë si një listë për t'u plotësuar. Gjithsesi, propozimi duhet të jetë i strukturuar si një i tërë dhe të përbëjë një narrativë kohezive dhe të rrjedhshme.
- Të dhënat e paraqitura në projekt-propozim, me përjashtim të rasteve kur kërkohet ndryshe, duhet të jenë qartësisht të lidhura me hapjen/riorganizimin e programit specifik për të cilin aplikohet.
- Projekt propozimi nuk duhet të ketë gabime ortografike/drejtshkrimore dhe duhet të formatohet sipas udhëzimeve të kësaj shtojca.

Ky udhëzues/strukturë propozimi shërben për grupin e punës që do të shkruajë propozimin për shqyrtim nga MASR. Edhe pse ky dokument përmban një sërë elementesh që duhet të jenë në propozim, ai nuk është shterues. Në çdo kohë MASR mund të kërkojë dokumentacion shtesë dhe sqarime të mëtejshme të propozimit në kuadër të vendimmarrjes.

a) Të dhëna mbi programin e studimit:

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- Përshkrimi i përgjithshëm i programit, misioni, qëllimet dhe objektivave.
- Llogi i programit, koordinatorja, numri i kredive etj.
- Njësia bazë / njësia kryesore vëmendja e programit të studimit.
- Justifikimi i burimit në të dhëna empirike dhe të verifikueshme për nevojën e hapjes/riorganizimit të programit.
- Analiza SWOT e aplikimit për hapje/riorganizim programi.

b) Të dhëna mbi kriteret e pranimit në këtë program studimi, tarifa dhe mundësitë financiare për studentët

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- Kriteret e pranimit në programin e studimit.
- Fusha e studimeve paraardhëse (në rastet e programeve të cikleve të dytë).
- Numri maksimal i studentëve që do të pranohen.
- Tarifa e studimit.
- Politika e mbështetjes financiare për studentët (llojet e burimeve nëse ka).
- Kuota të dedikuara për studentë të kategorive të veçanta.

c) Plani mësimor/Kurrikula e programit të studimit

Ky seksion përmban/paraqet një analizë të detajuar, të burimit në evidencë, të kurrikulës së programit duke garantuar/argumentuar mënyrën se si lidhjenë ligjore dhe Standardet Shtetërore të Cikleve janë reflektuar në program.

Gjithashtu, ky seksion duhet të tregojë, burimin në evidencë, se si kurrikula e programit të propozuar mbështetet nga programet e fjalës të rejardhme, ndërmon bashkëjetë potencialin në ofertën akademike për studentët, dhe ndërmon gjetjet/përfundimet e analizës së tregut të punës.

Ky seksion duhet të artikulojë, në mënyrë të detajuar, justifikimin për programin e propozuar dhe se si ky program adreson nevojat lokale, rajonale, kombëtare dhe/ose ndërkombëtare. Ky seksion duhet përveçse në mënyrë të rejardhme me një aplikim për grant kërkimor. Lexuesi/vlerësuesi duhet të bindet që programi i propozuar adreson probleme reale shkencore për zhvillimin rajonal.

Duhenë të mbyllemi dhe të bazohemi evidencat dokumentuese për të treguar që programi i shërbenë nevojave reale të rajonit/vendit. Vetëm burimi dhe të dhëna që mbështetën direkt nevojën e programit duhenë përfshirë. Gjithashtu, ky seksion duhet të sqarojë se çfarë burimesh të veçanta ka institucioni që do të kenë efekt në suksesin e programit (p.sh. specifike studimore, ekspertizë kërkimore, etj.).

Në fund, ky seksion duhet të jetë mjaftueshëm i gjatë që të demonstrojë/provojë kërkesën dhe nevojën për programin. Sigurohuni që të përfshihen elementët e mëposhtëm: (1) afatin të gjatë për burimet e përdorura, (2) afatin në rastet për burimet e përdorura, (3) adresat e burimeve online.

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna rrbi elementët e mëposhtëm:

- Numri total i kredituve.
- Pasqyrë analitike (për lëndë e module) e kurrikulës dhe kredituve si më poshtë:
  - Lëndë të përgjithëshme.
  - Lëndë karakterizuese.
  - Lëndë ndërdisiplinore/karakterizuese.
  - Lëndë plotësuese.
- Praktika profesionale.
- Detyrime përmbyllëse.
- Tema e diplomës/prované i përgjithshëm përfundimtar.

c) Personeli akademik dhe ndihmës akademik

Në këtë seksion shtjellohet një përmbledhje mbi personelin akademik dhe ndihmës akademik të përfshirë me programin e studimit, duke përfshirë informacion rrbi:

- Numrin e personelit akademik në njësinë bazë.
- Numrin e personelit akademik që i dedikohet programit të studimit (personel me kohë të plotë/pjesolane).
- Numrin e personelit akademik të përfshirë në lëndët karakterizuese (personel me kohë të plotë/pjesolane).
- CV-të e shkurtuara të personelit akademik që do të angazhohet në program (titulli/grada, fusha e ekspertizës kërkimore), angazhimin në program të personaliteteve të spikatura të fushës së studimit, etj.
- Numrin e personelit ndihmës akademik me karakter mësimor në funksion të programit të studimit.
- Nëse programi i propozuar është inter-disiplinor, identifikoni personelin akademik që vjen nga departamente apo fakultete të tjera.

d) Infrastruktura akademike në funksion të programit

Ky seksion përmbus informacion të përmbledhur rrbi infrastrukturën akademike në shërbim të programit të studimit, duke u fokuruar në:

- Numrin dhe sipërfaqet e auditorëve.
- Laboratorët dhe mjediset për realizimin e praktikës profesionale.
- Bibliotekë, numrin e titujve, numrin e posteve të leximit, e-library (nëse ka), etj.
- Zyrën për stafin akademik dhe ndihmës akademik.

e) Programet e Përbashkët:

Ky seksion plotësohet **vetëm nëse** programi i propozuar ofrohet në bashkëpunim me një institucion tjetër duke përfshirë edhe një përshkrim të nivelit të bashkëpunimit, duke iu përgjigjur elementëve të mposhtëm:

- Burimet financiare.
- Kontributi i partnerëve.
- Vënia në dispozicion e burimeve nga partnerët.
- Administrimi i programit.

- Lëshimi i diplomës dhe listës (*diplomë e përbashkët e dyfishtë e shumëfishtë*).
- Të dhëna mbi akte të fkuara/lëshuara të institucionit partner në vendin e origjinës.
- Të dhëna mbi akte akreditimi të institucionit partner ose të programit të studimit.
- Dokument zyrtar bashkëpunimi mes palëve, marrëveshja kuadër.
- Marrëveshja specifike për programin konkret të studimit.

f) Analizë e hegjit të punës:

Ky seksion artikulon mënyrën se si programi i propozuar i përgjigjet nevojave të tregut të punës duke përfshirë kërkesën aktuale dhe të parashikuar të tregut të punës për të diplomuarit e programit.

Analiza e tregut të punës duhet të përmbushë tre objektivat e mëposhtëm:

- Të identifikojë se si programi i propozuar rrit aftësitë (*kandidon potencialin e studentëve për të gërthuar aftësi njohuri që përputhen me kërkesat e tregut të punës ose qëllëra punësimi stabil*) me të ardhura sa më të larta.
- Të identifikojë se si programi i propozuar *përmbush* kërkesat e punëdhënësve për forcën e punës në një periudhë afatmesme.
- Të identifikojë se si programi i propozuar përmbush me, ose përmbush, politikat kombëtare të punësimit dhe zhvillimit.

Sigurohuni që të analizë elementët e mëposhtëm të përfshihen: (1) citime të plota për burimet e përdorura; (2) citime në tekst për burimet e përdorura; (3) adresat e burimeve online.

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- Ndryshimi dhe evolucioni potencial të programit të propozuar për hapje/reorganizim në lidhje me programet e ngjashme të studimit të ofruar nga IAL të tjera.
- Trendi vendor dhe rajonal i punësimit në sektorin ku bën pjesë programi i studimit, referuar burimeve zyrtare si INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, organizmat ndërkombëtare, etj.
- Nevoja e papërmbushur e tregut të punës që plotëson programi i ri/reorganizuar i propozuar nga IAL-ja.
- Strukturat në dispozicion të studentëve për të bërë ndërlidhjen mes tregut të punës si dhe burimet financiare në dispozicion të këtyre strukturave.
- Potencial i studentëve.
- Marrëveshje/kërkesa paraprake nga operatorë privatë/institucione publike për punësimin eventual të studentëve pas diplomimit.

UDHËZIM

Nr. 6, datë 4.3.2020

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR AFATET E APLIKIMIT, TË ZBATIMIT TË KRITEREVE DHE PROCEDURAVE, PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DHE MËNYRËS SË FINANCIMIT, SI DHE NUMRIN E ANËTARËVE DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE PËR ANËTARË KOMISIONI PËR DHËNIEN E BURSAVE TË PARASHIKUARA NGA FONDI I EKSELENCËS PËR STUDENTËT E SHKËLQYER DHE NËPUNËSIT CIVILË

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe të pikave 5 dhe 9, të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë" (Fondi i Ekselencës),

UDHËZOJ:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Studentët shqiptarë të shkëlqyer dhe nëpunësit civilë (në vijim "kandidatët") mund të përfitojnë mbështetje financiare nga Fondi i Ekselencës, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe financimin nga donacione ose të ardhura të tjera nga burime të ligjshme, për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë apo të ciklit të tretë, jashtë vendit, në universitetet më të mira të botës, në përputhje me vendimin me nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)".

2. Për përzgjedhjen e të gjithë kandidatëve përpara fillimit të vitit akademik dhe ndjekjen e ecurisë së tyre gjatë studimeve, ngrihet komisioni përzgjedhës nga ana e ministrit përgjegjës për arsimin, sipas përbërjes dhe kritereve përzgjedhëse të parashikuara në këtë udhëzim.

3. Komisioni përzgjedhës i kandidatëve kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin ose nga personi i deleguar prej tij në nivel zëvendësministri ose nëpunësi civil të nivelit të lartë drejtues dhe ka në përbërje të tij 7 anëtarë si më poshtë:

a) kryetari (ministri ose personi i deleguar prej tij);

b) katër anëtarë, të cilët janë pjesë e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe kanë titull akademik ose gradë shkencore "Doktor";

c) një anëtar, ish-përfitues i Fondit të Ekselencës, i cili ka përfunduar minimalisht studimet e ciklit të dytë;

ç) një përfaqësues nga Departamenti i Administratës Publike, në rastet e shqyrtimit të aplikimeve për kategorinë "Nëpunës civil".

3.1 Në rastet kur Fondi i Ekselencës plotësohet edhe nga donacione, në komision ka të drejtë të marrë pjesë edhe një përfaqësues i donatorëve.

4. Për administrimin e dokumentacionit të aplikimeve në programin e Fondit të Ekselencës dhe për ndjekjen dhe gjurmimin e ish-përfituesve të Fondit të Ekselencës, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore/nënligjore dhe atyre të parashikuara në aktmarrëveshje, ministri përgjegjës për arsimin formon një Sekretariat Teknik të Programit (STP), të përbërë nga personel administrativ i ministrisë përgjegjëse për arsimin. Përbërja dhe detyrat e STP përcaktohen me urdhër ministri, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.

KREU II

PROCEDURAT E APLIKIMIT

1. Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare nga Fondi i Ekselencës kryhet vetëm në formën elektronike në portalin e-albania ose në sistemin *online* përkatës të shërbimeve.

2. Periudha gjatë së cilës kryhen aplikimet për secilin vit, për të gjitha kategoritë e përfituesve të përcaktuara në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të sipërcituar, shpallet nga ministria përgjegjëse për arsimin.

3. Aplikimet e dërguara jashtë afateve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose vetëm në formë shkresore nuk do të shqyrtohen.

4. Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare për ndjekjen e programit të ciklit të dytë (viti i parë), kryhet elektronikisht sipas procedurës së mëposhtme:

a) plotësohet formulari i aplikimit, që përmban të dhënat sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, në shërbimin e Fondit të Ekselencës në portalin e-albania ose në sistemin *online* përkatës të shërbimeve;

b) përpos dokumentacionit që ngarkohet elektronikisht, brenda 15 ditëve nga kryerja e aplikimit *online*, dërgohet me postë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dokumentacioni si vijon:

i. kopje e formularit të aplikimit;

ii. letra e pakushtëzuar e pranimit nga universiteti që plotëson kriterin e renditjes sipas "Times Higher Education" – renditja botërore e universiteteve (origjinale ose kopje e njehsuar me origjinalin);

iii. diploma dhe lista përfundimtare e notave të studimeve të ciklit të parë "Bachelor" (kopje e njehsuar me origjinalin);

iv. deklaratë noteriale që të gjitha të dhënat e plotësuara në formularin e aplikimit janë të plota dhe të sakta sipas formatit të parashikuar në shtojcën 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare për ndjekjen e programit të ciklit të tretë "Doktoratë" (viti i parë) kryhet elektronikisht sipas procedurës së mëposhtme:

a) plotësohet formulari i aplikimit, që përmban të dhënat sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, në shërbimin e Fondit të Ekselencës në portalin e-albania ose në sistemin *online* përkatës të shërbimeve;

b) përpos dokumentacionit që ngarkohet elektronikisht, brenda 15 ditëve nga kryerja e aplikimit online, dërgohet me postë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dokumentacioni si vijon:

i. kopje e formularit të aplikimit;

ii. letra e pakushtëzuar e pranimit nga universiteti që plotëson kriterin e renditjes sipas "Times Higher Education" – renditja botërore e universiteteve (origjinale ose kopje e njehsuar me origjinalin).

iii. diploma dhe lista përfundimtare e notave të studimeve të ciklit të parë "Bachelor" dhe të ciklit të dytë "Master" (kopje të njehsuara me origjinalin);

iv. deklaratë noteriale që të gjitha të dhënat e plotësuara në formularin e aplikimit janë të plota dhe të sakta sipas formatit të parashikuar në shtojcën 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare nga nëpunësit civilë të cilët janë pranuar në një program "Master" të ciklit të dytë apo të tretë me kohëzgjatje 1-vjeçare (njëvjeçare), kryhet elektronikisht sipas procedurës së mëposhtme:

a) plotësohet formulari i aplikimit, që përmban të dhënat sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, në shërbimin e Fondit të Ekselencës në portalin e-albania ose në sistemin *online* përkatës të shërbimeve;

b) përpos dokumentacionit që ngarkohet elektronikisht, brenda 15 ditëve nga kryerja e aplikimit online, dërgohet me postë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dokumentacioni si vijon:

i. kopja e formularit të aplikimit;

ii. letra e pakushtëzuar e pranimit nga universiteti që plotëson kriterin e renditjes sipas "Times Higher Education" – renditja botërore e universiteteve (origjinale ose kopje e njehsuar);

iii. diploma dhe lista përfundimtare e notave të studimeve të ciklit të parë "Bachelor" dhe/ose të ciklit të dytë "Master" (kopje të njehsuara me origjinalin);

iv. deklaratë noteriale që të gjitha të dhënat e plotësuara në formularin e aplikimit janë të plota dhe të sakta sipas formatit të parashikuar në shtojcën 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7. Dokumentet e paraqitura në ministrinë përgjegjëse për arsimin, duhet të jenë në gjuhë shqipe ose në gjuhë angleze, origjinale ose të njehsuara me origjinalin. Dokumentacioni në gjuhë të ndryshme nga ajo shqipe dhe angleze duhet të paraqitet i përkthyer dhe i njehsuar me origjinalin nga përkthyes të licencuar.

8. Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare për studentët të cilët janë mbështetur nga Fondi i Ekselencës për vitin e mëparshëm dhe aplikojnë për përfitimin e mbështetjes për vitin e dytë e në vijim të studimeve vetëm në ciklin që nuk e kanë përfunduar ende, kryhet elektronikisht sipas procedurës së mëposhtme:

a) plotësohet formulari i aplikimit, që përmban të dhënat sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, në shërbimin e Fondit të Ekselencës në portalin e-albania ose në sistemin *online* përkatës të shërbimeve;

b) përpos dokumentacionit që ngarkohet elektronikisht, dërgohet me postë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dokumentacioni si vijon:

i. lista zyrtare e notave për vitin pararendës të studimeve, të financuar nga Fondi i Ekselencës (origjinale ose kopje e njehsuar);

ii. dokumentacioni justifikues financiar të shpenzimeve që mbulojnë vlerën e bursës së akorduar për vitin e mëparshëm.

KREU III

PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES

1. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga Ministria përgjegjëse për arsimin sipas procedurës si më poshtë:

a) shpall hapjen e programit të fondit të ekselencës dhe afatet e aplikimit;

b) STP-ja njofton kandidatët me e-mail, për mbërritjen e aplikimit dhe për dokumentet shtesë që mund të duhen;

c) STP-ja pasi bën verifikimin e dokumentacionit, informon ministrin/komisionin përzgjedhës për numrin e aplikantëve dhe fushat ku ata kanë aplikuar;

ç) STP-ja vendos në dispozicion të komisionit përzgjedhës gjithë dokumentacionin e depozituar dhe e asiston teknikisht atë gjatë procesit të përzgjedhjes;

d) aplikimet e depozituara në secilin prej muajve të periudhës së aplikimeve të shpallur nga ministria përgjegjëse për arsimin, shqyrtohen nga komisioni përzgjedhës gjatë muajit vijues.

1.1 Fazat e përzgjedhjes:

a) STP-ja bën një vlerësim paraprak për plotësimin e kritereve të parashikuar në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të sipërcituar dhe në këtë udhëzim, nga të gjithë kandidatët, duke përfshirë kandidatët që kanë përfituar mbështetje nga Fondi i Ekselencës për vitin e mëparshëm dhe aplikojnë për vitin e dytë e në vijim të studimeve;

b) vlerësimi paraprak së bashku me dosjet e kandidatëve i kalon për shqyrtim komisionit i cili bën vlerësimin për çdo aplikant;

c) pas këtij vlerësimi, Komisioni merr vendimin për kandidatët që përfitojnë mbështetje nga Fondi i Ekselencës. Ky vendim zbardhet në procesverbalin përkatës në të cilin përcaktohet lista e kandidatëve fitues, si dhe shumat e financimit për secilin prej tyre të cilat janë përllogaritur paraprakisht nga STP-ja pasi është marrë informacioni nga drejtoria përgjegjëse për buxhetin dhe menaxhimin financiar në ministrinë përgjegjëse për arsimin mbi masën e fondit në dispozicion;

ç) në rast se pas vlerësimit të dokumentacionit të përcjellë nga STP-ja, Komisioni nuk arrin të krijojë bindje për një ose më shumë prej kandidatëve, ai mund të kërkojë kryerjen e verifikimeve dhe kërkimin e informacioneve shtesë nga STP-ja ose mund të kërkojë intervistimin e kandidatit/kandidatëve përkatës (vetëm për kandidatët e rinj që aplikojnë për mbështetjen e vitit të parë dhe nuk janë mbështetur më parë nga Fondi i Ekselencës);

d) në rast se Komisioni ka vendosur intervistimin e një ose më shumë kandidatëve, STP-ja njofton përmes e-mail-it kandidatët që janë përzgjedhur për t'u intervistuar për datat dhe vendin e zhvillimit të intervistave. Komisioni kryen intervistën me kandidatët përkatës dhe në përfundim të saj merr vendimin përfundimtar për këta kandidatë.

Intervista kryhet në prezencë të kandidatit ose në rrugë telematike kur ai ndodhet jashtë vendit;

e) vendimet (procesverbalet e mbledhjes) e Komisionit i bashkëlidhen urdhrit të ministrit për shpalljen e kandidatëve fitues ku është parashikuar dhe masa e bursës së akorduar secilit prej tyre.

1.2 Shpallja e kandidatëve fitues:

a) lista e emrave me kandidatët fitues duke përfshirë të dhënat mbi programin e studimit, institutucionin e arsimit të lartë, renditjen sipas "Times Higher Education" – renditja botërore e universiteteve, si dhe masën e financimit, bëhet publike në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin;

b) kandidatët njoftohen, përmes e-mail-it, për klasifikimin e tyre si fitues ose jofitues.

1.3 Lidhja e marrëveshjes:

a) ministria përgjegjëse për arsimin njofton kandidatët fitues për afatin për lidhjen e aktmarrëveshjes;

b) kandidatët fitues nënshkruajnë aktmarrëveshjen me ministrinë përgjegjëse për arsimin. Në emër të ministrisë përgjegjëse për arsimin nënshkruan Sekretari i Përgjithshëm i saj.

Nëse kandidati nuk mund të paraqitet personalisht, për nënshkrimin e aktmarrëveshjes autorizon me prokurë të posaçme një person tjetër që nënshkruan aktmarrëveshjen në emër të kandidatit;

c) për zbatimin e aktmarrëveshjes ngarkohet drejtoria përgjegjëse për buxhetin dhe menaxhimin financiar në ministrinë përgjegjëse për arsimin, si përgjegjëse për veprimet financiare që bëhen me përfituesit e bursës.

1.4 Likuidimi i pagesës:

Kur kandidati shpallet fitues, shuma e miratuar me urdhër ministri paguhet në llogarinë e përfituesit pranë një banke të nivelit të dytë në valutën e kërkuar.

2. Përfundimi i studimeve

a) me përfundimin e kohëzgjatjes zyrtare të studimeve, përfundon edhe mbështetja financiare në kuadër të këtij programi;

b) kandidatët mund të vazhdojnë studimet pa u financuar nga Fondi i Ekselencës deri në 1 (një) vit pas përfundimit të kohëzgjatjes zyrtare të studimeve, pas së cilës nuk do të konsiderohen më pjesë e këtij programi;

c) përfituesit e mbështetjes nga Fondi i Ekselencës dorëzojnë në STP një kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës master dhe listës së notave (dhe temës së diplomës

nëse ka pasur të tillë), ose të diplomës së doktoratës dhe të disertacionit, dokumentacionin justifikues të shpenzimeve financiare, si dhe një Jetëshkrim të hollësishëm, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i studimeve.

3. Programi "Alumni – Ekselencat"

Të gjithë përfituesit nga Fondi i Ekselencës, pas përfundimit të studimeve "master", do të bëhen anëtarë të Programit "Alumni – Ekselencat", i cili synon të ruajë dhe të zhvillojë më tej kontaktet ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe përfituesve nga Fondi i Ekselencës.

KREU IV

KRITERET PËR PËRFITIMIN E FINANCIMIT

I. Bursa të posaçme, për studentë që kryejnë studimet e ciklit të dytë jashtë vendit

1. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që ndjekin jashtë vendit programe studimi të ciklit të dytë, për përfitimin e mbështetjes financiare, janë përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 2, të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)".

2. Studentët që aplikojnë për t'u mbështetur financiarisht, me bursë nga Fondi i Ekselencës, për vitin e dytë apo në vijim të studimeve, duhet të kenë arritur mesataren e notave mbi 8, për vitin pararendës të studimeve dhe të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike. Për studentët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë "Bachelor" jashtë vendit, konvertimi i mesatares në sistemin shqiptar të vlerësimit, kryhet nga Komisioni Përzgjedhës, bazuar në precedentët e viteve të mëparshëm dhe në informacionin mbi sistemin përkatës të vlerësimit të vendit ku janë kryer studimet e ciklit të parë "Bachelor".

3. Mbështetja financiare përfshin mbulimin e:

a) tarifës së studimit;

b) shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit për kohëzgjatjen e vitit akademik;

c) shpenzimeve të një udhëtimi në vit vajtje-ardhje, në masën deri në 40,000 (dyzet mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve evropiane dhe në masën deri në 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve të tjera.

II. Bursa të posaçme, për studentë që kryejnë studimet e ciklit të tretë "Doktoratë jashtë vendit"

1. Kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët që ndjekin jashtë vendit studimet e plota të doktoratës, pasi kanë përfunduar ciklin e parë e të dytë të studimeve universitare,

për përfitimin e mbështetjes financiare, janë përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 2, të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)".

2. Studentët që aplikojnë për t'u mbështetur financiarisht, me bursë nga Fondi i Ekselencës, për vitin e dytë apo në vijim të studimeve, duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të vitit pararendës.

3. Mbështetja financiare përfshin mbulimin e:

a) shpenzimeve të jetesës në masën jo më shumë se 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë/muaj për kohëzgjatjen e vitit akademik;

b) shpenzimet e një udhëtimi në vit vajtje-ardhje, në masën deri në 40,000 (dyzet mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve Evropiane dhe në masën deri në 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve të tjera.

III. Bursa të posaçme, për nëpunësit civilë që kryejnë studimet "Master" të ciklit të dytë apo të tretë me kohëzgjatje 1-vjeçare jashtë vendit

1. Kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët që i përkasin kategorisë nëpunës civilë që ndjekin jashtë vendit një program 1 (një) – vjeçar "Master" të ciklit të dytë apo të tretë janë përcaktuar në shkronjën "c", të pikës 2, të vendimit nr. 160, datë 19.02.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)".

2. Mbështetja financiare përfshin mbulimin e:

a) tarifës së studimeve;

b) shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit për kohëzgjatjen e vitit akademik;

c) shpenzimeve të një udhëtimi në vit vajtje-ardhje, në masën deri në 40,000 (dyzet mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve Evropiane dhe në masën deri në 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë për udhëtimet drejt vendeve të tjera.

KREU V

NDËRPRERJA E FINANCIMIT/KTHIMI I MASËS SË BURSËS SË AKORDUAR

1. Ndërprerja e financimit për bursat e parashikuara më sipër, bëhet në rastet e mëposhtme:

a) kur studenti i ciklit të dytë ndërpret studimet për më shumë se 3 (tre) muaj, gjatë vitit akademik përkatës, përjashtuar rastet e sëmundjeve, të vërtetuara nga autoritetet mjekësore apo në raste fatkeqësish familjare dhe forcës madhore;

b) kur studenti nuk jep të gjitha provimet apo e përfundon vitin akademik me notën mesatare më të ulët se nota 8 (vlerësimi ndërkombëtar, sistemi anglosakson B);

c) kur studenti nuk plotëson gjithë detyrimet akademike të parashikuara nga institucioni i arsimit të lartë për vitin përkatës, duke konsideruar kohëzgjatjen normale minimale të programit përkatës;

ç) kur studenti nuk aplikon në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Detyrimi për të kthyer masën e bursës së përfituar:

a) përjashtohet nga universiteti pritës;

b) ndërpret studimet për të cilat është mbështetur financarisht;

c) kur pas përfundimit të studimeve nuk ka shlyer detyrimin e punësimit në Shqipëri, sipas kushteve të parashikuara në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të sipërcituar;

ç) nuk kanë përmbyllur apo përfunduar studimet në ciklin përkatës brenda 1 (një) viti akademik pas përfundimit të afatit zyrtar të studimeve, me përjashtim të rasteve të sëmundjeve, të vërtetuara, të rasteve të fatkeqësive familjare, forcës madhore apo kur parashikohet nga universiteti pritës.

3. Detyrimi dhe modaliteti i punësimit në Republikën e Shqipërisë pas përfundimit të studimeve të financuara nga Fondi i Ekselencës, përcaktohet në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)".

4. Studentët, që kanë përfituar bursë dhe nuk kanë realizuar detyrimet e programit përkatës dhe/ose i ndërpresin ato, sipas kushteve të përcaktuara në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, në këtë udhëzim dhe në aktmarrëveshjen e lidhur midis përfituesit dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin, t'i kthejnë ministrisë përgjegjëse për arsimin shumën e përfituar në formë burse nga Fondi i Ekselencës, brenda 6 (gjashtë) muajve nga dita e njoftimit. Në rast të moskthimit të shumës apo refuzimit nga ana e përfituesit brenda këtij afati, do të ndiqen procedurat ligjore për zgjidhjen e çështjes, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 16, datë 1.8.2014, “Për përcaktimin e kritereve, masës së financimit dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit e administratës shtetërore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Komisioni Përzgjedhës, Sekretariati Teknik i Programit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT,

SPORTIT DHE RINISË

Besa Shahini

SHTOJCË 1

PËRMBAJTJA E FORMULARIT TË APLIKIMIT PËR TË GJITHA KATEGORITË

1. Të dhëna që plotësohen në formular:

a) të dhëna të aplikantit (emri, atësia, mbiemri, numri ID, gjinia, datë e lindjes, vendlindja, shteti, qyteti, adresa e banimit, adresa elektronike, numri i tel etj.).

b) informacioni akademik (universiteti i studimeve pararendëse, kohëzgjatja e studimeve pararendëse, universiteti ku është pranuar, emërtimi i plotë programit të studimit, kohëzgjatja zyrtare, tarifa e studimit dhe shpenzimet e jetesës për vitin I të studimeve, renditja e universitetit sipas Times Higher Education, masa totale e financimit të kërkuar);

c) deklarata që nuk përfiton apo nuk ka përfituar në të kaluarën ndonjë bursë apo financim tjetër nga shteti shqiptar;

d) deklarata që autorizon ministrinë përgjegjëse për arsimin, për trajtimin dhe përpunimin e të dhënave personale të aplikantit, si dhe publikimin eventual të të gjitha të dhënave që kanë lidhje me studimet e financuara nga Fondi i Ekselencës.

2. Dokumentacion që bashkëlidhet elektronikisht gjatë plotësimit të formularit:

a) letra e pakushtëzuar e pranimit nga universiteti që plotëson kriterin e renditjes sipas Times Higher Education (kopje e noterizuar dërgohet edhe me postë);

b) diploma dhe lista përfundimtare e notave të studimeve të ciklit të parë “Bachelor” (për të gjitha kategoritë) dhe e ciklit të dytë për kandidatët që do të ndjekin studimet e doktoratës (kopje e noterizuar dërgohet edhe me postë);

c) vërtetim nga universiteti pritës mbi mbështetjen ose jo financiare nga ana e tij për kandidatin, si dhe masën e financimit;

d) CV-ja e kandidatit;

e) deklaratën për autorizimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin, në marrjen e informacionit zyrtar nga Universiteti në të cilin kandidati është pranuar, sipas shtojcës 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi;

f) deklaratën noteriale që të gjitha të dhënat e plotësuara në formularin e aplikimit janë të plota dhe të sakta sipas formatit të parashikuar në shtojcën 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi. (dërgohet edhe me postë);

g) në rast bashkëfinancimi ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe organizatave, fondacioneve dhe institucioneve vendase ose te huaja të paraqitet dokumentacioni që vërteton marrjen nga kandidati të bursës nga organizatat, fondacionet dhe institucionet vendase ose të huaja (përjashtuar ato shtetërore);

h) projektidea e temës së doktoratës, në të cilën të paraqitet qartësisht objekti kryesor i studimit dhe metodologjia (vetëm për studentët e Doktoratës);

i) miratimin e titullarit të institucionit të administratës shtetërore ku punon nëpunësi, sipas formatit të parashikuar në shtojcën 5 të këtij udhëzimi (vetëm për nëpunësit civilë).

SHTOJCË 2

PËRMBAJTJA E FORMULARIT TË APLIKIMIT PËR STUDENTËT E NDËRMJETËM

1. Të dhëna që plotësohen në formular:

a) të dhëna të aplikantit (emri, atësia, mbiemri, numri ID, gjinia, datë e lindjes, vendlindja, shteti, qyteti, adresa e banimit, adresa elektronike, numri i tel etj.);

b) informacioni akademik (universiteti ku është financuar nga Fondi i Ekselencës vitin e mëparshëm, emërtimi i plotë programit të studimit, viti i studimit të përfunduar, tarifa e studimit dhe shpenzimet e jetesës për vitin e ardhshëm të studimeve).

2. Dokumentacion që bashkëlidhet elektronikisht gjatë plotësimit të formularit:

a) lista zyrtare e notave për vitin pararendës të studimeve të financuar nga Fondi i Ekselencës (kopje e noterizuar dërgohet edhe me postë);

b) vërtetimin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve akademike për vitin pararendës;

c) vërtetim nga institucioni i arsimit të lartë për periudhën e qëndrimit dhe frekuentimit të institucionit ku ndiqen studimet (vetëm për studentët e Doktoratës);

d) deklaratën për autorizimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin në marrjen e informacionit zyrtar nga universiteti në të cilin kandidati është pranuar, sipas shtojcës 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi;

e) një parashikim të detajuar të kostos së studimeve të lëshuar nga universiteti pritës, si dhe një vërtetim nga universiteti pritës mbi mbështetjen ose jofinanciare nga ana e tij për kandidatin, si dhe masën e financimit;

f) dokumentacion justifikues financiar të shpenzimeve që mbulojnë vlerën e bursës së akorduar për vitin e mëparshëm (kopje e noterizuar dërgohet edhe me postë).

SHTOJCË 3

AUTHORISATION LETTER

I, _____ hereby authorise the Ministry of Education, Sports and Youth of Albania to enquire/ retrieve any information regarding my studies at _____

I also authorise the release of any information to the above Institution for verification purposes.

Full name: _____ University: _____

Signature: _____ Date: _____

SHTOJCË 4

DEKLARATË

Unë i/e nënshkruar _____ i/e datëlindjes _____,

(emër atësi mbiemër) (datë/muaj/vit)

aplikant/kërkues i mbështetjes financiare nga programi i Fondit të Ekselencës në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) për kryerjen e studimeve jashtë vendit,

Deklaroj me vullnet të lirë e të plotë se të gjitha të dhënat që kam plotësuar në formularin e aplikimit në programin e Fondit të Ekselencës me nr. reference: _____ janë të sakta dhe të vërteta.

Deklaruesi

_____

(emër atësi mbiemër nënshkrimi) Datë ____ / ___/_____

SHTOJCË 5

EMBLEMA E INSTITUCIONIT

Nr. _____ prot. Tiranë, më ___.___._____

AUTORIZIM

Autorizoj Z/znj. _____, të aplikojë në programin e Fondit të Ekselencës, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për mbështetje financiare për kryerjen e studimeve master, në fushën e _____ në universitetin _____.

Titullari i institucionit

Firma

Vula

UDHËZIM

Nr.10, datë 30.3.2020

PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE PËRBËRËS, FORMËN E DIPLOMËS OSE CERTIFIKATËS TË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE PROCEDURËS SË REGJISTRIMIT TË TYRE NË REGJISTRIN SHTETËROR TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR (Ndryshuar me udhëzimin nr.5, datë 3.3.2021)

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 10 dhe 91, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ :

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Përcaktimin e elementëve përbërës, formës së diplomës ose certifikatës së lëshuar nga ana e institucioneve të arsimit të lartë (IAL) dhe procedurës së regjistrimit të formës së diplomës dhe certifikatës në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe të Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor (në vijim Regjistri shtetëror).

2. Forma e secilës diplomë ose certifikatë përpara se të lëshohet nga institucioni i arsimit të lartë përkatës, duhet të regjistrohet në Regjistrin shtetëror në Qendrën e

Shërbimeve Arsimore (QShA). Ky regjistrim vërtetohet nga dokumenti përkatës i lëshuar nga QShA-ja, i cili përmban bashkëlidhur edhe kopjen e dokumentit të regjistruar. Forma e diplomës ose certifikatës përcaktohen sipas përmbajtjes së shtojcës nr. 1, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

3. Institucionet e Arsimit të Lartë pajisin me dokumentin zyrtar përkatës, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, studentin i cili ka përfunduar detyrimet akademike dhe detyrime të tjera institucionale për programin përkatës të studimit.

4. Diploma ose certifikata lëshohet si rregull në gjuhën shqipe. Përjashtimisht, në rastin e diplomave të përbashkëta, të dyfishta ose të shumëfishta me një ose më shumë institucione të huaja të arsimit të lartë si dhe në rastin programeve të hapura në gjuhë të huaj ose të diplomave ose certifikatave të IAL-ve të huaja, që lëshohen në përfundim të programeve të studimit që ato zhvillojnë në Republikën e Shqipërisë, diploma ose certifikata lëshohet në njërën nga 5 (pesë) gjuhët e Bashkimit Evropian, konkretisht në anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht, në përputhje me marrëveshjen përkatëse të bashkëpunimit/aktin e miratimit të hapjes së programit.

5. Regjistri Shtetëror është një bazë unike të dhënash e të gjitha formave të diplomave dhe certifikatave të lëshuara në përputhje me legjislacionin në fuqi nga institucionet e arsimit të lartë.

6. Regjistri shtetëror mbahet dhe ruhet në formë të shkruar dhe elektronike.

7. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja elektronike e të dhënave të depozituara në regjistër kryhet nëpërmjet një sistemi të informatizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Regjistrat e shkruar trajtohen sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat". QShA administron dhe ruan dokumentet shoqëruese të paraqitura nga IAL-të.

9. IAL-të kanë detyrimin ligjor të regjistrojnë të gjitha format e diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror përpara datës së lëshimit të tyre, në të kundërt konsiderohen të pavlefshme.

10. Çdo diplomë ose certifikatë që lëshohet nga IAL-të, duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.

KREU II

ELEMENTËT PËRBËRËS TË FORMËS SË DIPLOMËS OSE CERTIFIKATËS

1. Elementët e detyrueshëm, që duhet të përmbajë çdo diplomë ose certifikatë, janë si më poshtë:

a) Stema dhe emërtimi “REPUBLIKA E SHQIPËRISË” me germa të mëdha;

b) Stema e institucionit përkatës të arsimit të lartë;

c) Lloji dhe emri i IAL-së, me germa të mëdha në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi dhe dokumentit të hapjes/riorganizimit të tij;

ç) Emri i njësisë kryesore që ofron programin e studimit, me germa të mëdha dhe stemën përkatëse (nëse ka). Në rastin e një Kolegji Profesional të Lartë ose kur organizohet si njësi kryesore pranë një IAL-je vendoset emri i njësisë bazë qe ofron programin e studimit, me gema të mëdha dhe stemën përkatëse nëse ka;

d) Emërtimi i diplomës ose certifikatës, sipas përcaktimit në aktin e hapjes/riorganizimit të programit të studimit, i shkruar me germa të mëdha;

i. "Diplomë Profesionale" në "fusha e arsimimit të kryer";

ii. "Certifikatë Profesionale" në "fusha e arsimimit të kryer";

iii. Diplomë "Bachelor" në "fusha e arsimimit të kryer";

iv. Diplomë "Master profesional" në "fusha e arsimimit të kryer";

v. Diplomë "Master i shkencave" në "fusha e arsimimit të kryer";

vi. Diplomë "Master i arteve" në "fusha e arsimimit të kryer";

vii. "Master i shkencave" në "fusha e arsimimit të kryer" për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë;

viii. "Master ekzekutiv" në "fusha e arsimimit të kryer";

ix. Diploma e Gradës Shkencore "Doktor" në "fusha e arsimimit të kryer";

x. "Diplomë specializimi" në "fusha e arsimimit të kryer";

xi. "Certifikatë" në "fusha e arsimimit të kryer".

dh) Numri i krediteve (ECTS), në përputhje me përcaktimet në aktin e hapjes/riorganizimit.

Për certifikatat e lëshuara në përfundim të programit të studimit të formimit të vazhduar/ kualifikimit të ofruara nga IAL-të për të nxënit gjatë gjithë jetës, ECTS shënohen vetëm në rastet kur në dokumentin e hapjes dhe akreditimit janë përcaktuar ECTS-të dhe kur këto kualifikime janë përfshirë në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Për programet e studimit të formimit të vazhduar mund të shënohet dhe numri i krediteve të formimit në vazhdim sipas aprovimit përkatës nga institucioni i arsimit të lartë;

e) Niveli përkatës në KSHK, i shprehur me shifra arabe dhe siglën KSHK-së. Për certifikatat e lëshuara në përfundim të programit të studimit të formimit të

vazhduar/kualifikimit, të ofruara nga IAL-të për të nxënit gjatë gjithë jetës, niveli shënohet vetëm kur këto kualifikime janë përfshirë në KSHK;

ë) Emri, atësia (në rastet kur nuk ka atësi në certifikatën e lindjes, ajo lihet bosh) dhe mbiemrin e studentit para martesës si dhe në kllapa mbiemri që mban në momentin e diplomimit (nëse është i ndryshëm);

f) Vendi dhe data e lindjes;

g) Data e lëshimit të diplomës ose certifikatës;

gj) Emri, mbiemri dhe firma e rektorit dhe të drejtuesit të njësisë kryesore që plotësohen me shkrim dore. Në rastin e një Kolegji Profesional të Lartë ose kur organizohet si njësi kryesore pranë një IAL-je vendoset emri, mbiemri dhe firma e rektorit dhe e drejtuesit të njësisë bazë që plotësohen me shkrim dore.

h) Numri i matrikullimit të studentit. Kjo pikë nuk aplikohet për programet e studimit të formimit të vazhduar/ kualifikimit, për të nxënit gjatë gjithë jetës, të ofruara nga IAL-të;

i) Data e regjistrimit të studentit në institucionin që lëshon diplomën për programin përkatës të studimit;

j) Data e përfundimit të studimeve (të shlyerjes së detyrimeve akademike, mbrojtje diplome/provim përfundimtar);

k) Tema e tezës së diplomës (vetëm në rastet e studimeve të doktoratës);

l) Forma e studimeve;

ll) Numri unik i identifikimit të diplomës i lëshuar nga QShA/MASR në momentin e regjistrimit të formës së diplomës;

m) Numri i matrikullimit të ciklit paraardhës të studimeve në diplomat e ciklit të dytë dhe të tretë si dhe ID e Maturës Shtetërore (numri i regjistrit veçantë për studentët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë para vitit 2006) në diplomat “Bachelor”, diplomat ose certifikatat profesionale dhe diplomat “Master i shkencave” të programeve të integruara të studimeve;

n) Numri i diplomës së studimeve universitare të përfunduara më parë për diplomat e ciklit të dytë dhe të tretë;

nj) Numri dhe data e Vendimit të Komisionit për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”;

o) Numri në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë për diplomën përkatëse të Gradës Shkencore “Doktor”.

2. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Senatet akademike miratojnë formulimin grafik dhe përmbajtjen e diplomave, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi, përfshirë elementët e sigurisë.

3. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë, si edhe ato "Master Ekzekutiv" të ciklit të tretë, shoqërohen me suplementin e diplomës që është pjesë e pandarë e diplomës dhe lëshohet së bashku me të konform përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi. Në pjesën e poshtme të diplomës vihet shënimi "Kjo diplomë shoqërohet nga suplementi i saj".

4. Në rastin e diplomave ose certifikatave të përbashkëta, të dyfishta ose të shumëfishta me një ose më shumë institucione të huaja të arsimit të lartë, ato përmbajnë jo të gjitha elementët e parashikuar në pikat 1, 2, dhe 3 të këtij kreu. Në këto raste, elementët në germat a), b), c), d), dh), e), ë) f), g), j) të pikës 1, të këtij kreu, duhet të jenë pjesë e këtyre diplomave ose certifikatave, forma dhe përmbajtja e të cilave përcaktohet me marrëveshje mes IAL-ve, për programin përkatës të studimit.

5. Për programet e studimit të ofruara nga IAL-të e huaja, në përputhje me përcaktimet e pikës 5, të nenit 35, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", diploma dhe suplementi përkatës lëshohet nga IAL-ja e huaj, e cila në suplement specifikon vendin e ofrimit të studimeve dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore të parashikuara në kuadrin ligjor shqiptar për këtë program studimi.

6. Diplomat lëshohen nga IAL-të përkatëse, brenda afatit 3 - mujor, por në çdo rast, jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit të detyrimeve akademike e institucionale dhe plotësimit të kërkesave ligjore nga ana e studentit, për programin përkatës të studimit.

7. IAL-të nuk mund të lëshojnë dublikatë diplome, por mund të lëshojnë dokument të barasvlershëm me diplomën në formën e vërtetimit (vërtetim diplome) i cili duhet të përmbajë emrin e institucionit që ka lëshuar diplomën, numrin e diplomës origjinale, datën e lëshimit të saj, ciklin dhe programin e studimit.

8. IAL-ja ruan në arkivën e tij fotokopje të diplomës origjinale dhe kopje të digjitalizuar të diplomës që i lëshohet studentit.

KREU III

PROCEDURA PËR REGJISTRIMIN E FORMËS SË DIPLOMËS OSE CERTIFIKATËS NË REGJISTRIN SHTETËROR

1. Regjistrimi fillestar i formave të diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga IAL-të, si dhe çdo regjistrim tjetër i mëvonshëm, që ndryshon formën apo përmbajtjen e tyre, bëhet në bazë të aplikimit drejtuar QShA-së.

2. Aplikimi për regjistrimin e formës së diplomës ose certifikatës kryhet në QShA i cili përmban kërkesën për regjistrim të rektorit të IAL-së dhe dokumentacion shoqërues bashkëlidhur saj, si më poshtë:

a) Kopje të statutit të miratuar në fuqi të IAL-së, dhe aktit të miratimit, të cilit i bashkëngjitet edhe forma e miratuar nga Senati Akademik e diplomës ose certifikatës dhe përmbajtja dhe forma e suplementit të saj për çdo cikël dhe lloj programi studimi,

b) Kopjen e aktit të hapjes /riorganizmit (nëse ka) dhe kopjen e aktit të akreditimit të IAL-së.

c) Kopjen e aktit të hapjes/riorganizmit (nëse ka) së programit të studimit për të cilin lëshohet diploma, që regjistrohet.

ç) Kopjen e aktit të akreditimit të programit të studimit për të cilin lëshohet diploma,

që regjistrohet (për certifikatat që lëshohen në përfundim të programeve të formimit të vazhduar kjo pikë aplikohet vetëm në rastet kur është kryer akreditimi i programit përkatës të studimit).

d) Forma e diplomës apo certifikatës që do të regjistrohet, si dhe suplementin e diplomës (kur parashikohet);

dh) Dokumenti i pagesës së tarifës për regjistrim, në regjistrin shtetëror, për llogari të QShA-së.

Dokumentet e parashikuara në germën "a dhe "d" të kësaj pike, nënshkruhen dhe vulosen në çdo faqe nga rektori i IAL-së.

3. Dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyera dhe të vërtetuara në gjuhën shqipe dhe të legalizuara sipas legjislacionit në fuqi.

4. QShA-ja kryen shqyrtimin dhe verifikimin e dokumenteve të paraqitura në dosjen e aplikimit, brenda një afati 45-ditor nga data e depozitimit të aplikimit.

5. QShA-ja pasi kryen shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit në dosjen e aplikimit dhe kur konstaton se IAL-ja dhe programi i studimit përmbushin kriteret për lëshimin e diplomës ose certifikatës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, regjistron formën e diplomës ose certifikatës.

6. QShA-ja kryen regjistrimin e formës së diplomës ose certifikatës në Regjistrin shtetëror dhe lëshon vërtetimin përkatës për IAL-në.

7. Vërtetimi i regjistrimit lëshohet brenda 2 (dy) muajve nga data e paraqitjes së aplikimit.

8. Në rast se pas verifikimeve, rezulton se nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat për regjistrim, të parashikuara në këtë udhëzim, QShA-ja pezullon aplikimin dhe njofton IAL-në me shkrim, për plotësimin ose ndreqjen e elementeve që pengojnë regjistrimin e

formës së diplomës ose certifikatës. Afati i procedurës së regjistrimit rifillon ditën pasardhëse të plotësimit ose ndreqjes së këtyre elementëve.

9. QShA-ja refuzon regjistrimin në rastet kur:

a) Aplikimi nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kriteret e vendosura në këtë udhëzim;

b) Të dhënat që kërkohen të regjistrohen janë të ndryshme nga dokumentet e paraqitura.

10. Refuzimi i kërkesës i njoftohet IAL-së me shkrim, me shkakun e refuzimit.

11. IAL-ja ruan të drejtën e një aplikimi të ri për regjistrimin e formës së diplomës ose certifikatës, nëse ai është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

12. Të dhënat që do të mbahen në Regjistrin shtetëror për çdo diplomë ose certifikatë do të jenë:

a) Emërtimi i IAL-së në përputhje me aktin e hapjes (apo të riorganizimit institucional);

b) Lloji i IAL-së, e cila lëshon diplomën/certifikatën: Universitet, Kolegj Universitar, Akademi dhe Kolegj Profesional i Lartë;

c) Numri dhe data e aktit të hapjes dhe të akreditimit të IAL-së, e cila lëshon diplomën ose certifikatën;

ç) Numri dhe data e aktit të hapjes dhe të akreditimit të programit të studimit për të cilin lëshohet diploma ose certifikata;

d) Adresa e vendndodhjes së IAL-së;

dh) Numri unik i identifikimit të diplomës ose certifikatës;

e) Numri dhe data e aktit të miratimit të formës konkrete të diplomës.

13. Çdo formë diplome ose certifikate, e regjistruar në Regjistrin shtetëror, pajiset me një numër unik identifikimi.

14. Numri unik i identifikimit është sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

15. IAL-të janë të detyruara që të shënojnë numrin unik të identifikimit në diplomat ose certifikatat që ato lëshojnë.

16. Diplomat ose certifikatat e regjistruara në Regjistrin shtetëror vlerësohen të njohura dhe përbëjnë akte zyrtare për të gjitha autoritetet që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi.

17. QShA-ja publikon listën me format e diplomave dhe certifikatave të regjistruara në faqen e saj zyrtare të internetit.

18. Regjistrimi fillestar dhe regjistrimi i mëvonshëm i çdo forme diplome ose certifikate i nënshtrohet tarifës së regjistrimit.

19. Tarifa e regjistrimit do të jetë 3 000 (tre mijë) lekë për çdo formë diplome dhe certifikate të regjistruar, për llogari të QSHA-së, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

20. Çdo IAL e interesuar, të cilës i është refuzuar regjistrimi i formës së diplomës ose certifikatës, ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e ankimit administrativ brenda 30 ditësh në ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë.

21. Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë pasi shqyrton ankimin e depozituar, merr vendim dhe ia njofton IAL-në e interesuar brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

22. IAL-ja e interesuar ka të drejtë të ankimojë vendimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë -së në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

23. Çdo person i interesuar ka të drejtë të kërkojë lëshimin e ekstrakteve për formën e diplomës ose certifikatës së regjistruar në Regjistrin shtetëror.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 5, datë 18.2.2009, “Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar” dhe udhëzimi nr. 25, datë 10.11.2017 “Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar, shfuqizohen.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT

DHE RINISË

Besa Shahini

Shtojca nr.1

Formimi i numrit unik të identifikimit



IAL Programi i studimit Cikli Viti Regj. Numri rendor

1. Kodi i IAL-së përbëhet nga dy shkronja, të cilat vendosen në mënyrë unike.

2. Programi i studimit përbëhet nga tri shifra.

3. Cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

4. Viti i regjistrimit përbëhet nga dy shifra, të cilat tregojnë vitin e regjistrimit, ku 17 tregon vitin 2017.

5. Ky numër shtohet me 1, për çdo vit.

6. Numri rendor përcaktohet nga sistemi në rend rritës.

UDHËZIM

Nr. 11, datë 2.4.2020

PËR PËRCAKTIMIN E PËRMBAJTJES DHE TË FORMËS SË SUPLEMENTIT TË DIPLOMËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 91, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës, si dokument shoqërues, i pandarë dhe që lëshohet së bashku me diplomën nga ana e institucionit të arsimit të lartë, në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë, si edhe ato "Master ekzekutiv" të ciklit të tretë.

2. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit.

3. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës të çdo institucioni të arsimit të lartë, përcaktohen në statutin e tyre dhe miratohen nga Senati Akademik përkatës, hartuar sipas Modelit Kombëtar të Suplementit të Diplomës, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi si aneksi 1.

4. Suplementi i diplomës duhet të përmbajë 8 (tetë) seksione si më poshtë:

a) "1. Të dhëna identifikuese për mbajtësin e diplomës";

b) "2. Informacion identifikues mbi kualifikimin";

c) "3. Informacion mbi nivelin dhe kohëzgjatjen e kualifikimit";

ç. "4. Informacion mbi programin e studimit të përfunduar dhe rezultatet e arritura";

d) "5. Informacion mbi përdorimin e kualifikimit të fituar";

dh) "6. 'Informacion shtesë' ku përfshihet edhe 'Numri rendor i studentit në regjistrin bazë/ themeltar'; 'Numri rendor i regjistrimit të diplomës në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave të IAL-së përkatëse';

e) "7. Certifikimi i suplementit";

ë) "8. Informacion për sistemin kombëtar të arsimit të lartë".

5. Informacioni për sistemin kombëtar të arsimit të lartë, duhet të pasqyrojë organizimin dhe funksionimin e tij në momentin që lëshohet suplementi i diplomës. Ai duhet të jetë i njëjtë për të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë të vendit.

6. Institucionet jopublike të arsimit të lartë që i organizojnë studimet jo sipas modelit shqiptar, duhet të përshijnë në suplementin e diplomës edhe informacionin mbi ekuivalentimin e rezultateve të arritura në programin përkatës të studimit me sistemin kombëtar të vlerësimit.

7. Informacioni në suplementin e diplomës është unik për çdo Institucion të Arsimit të Lartë për sa i përket formës dhe përmbajtjes.

8. Të dhënat personale në suplementin e diplomës janë konfidenciale.

9. Përmbajtja e suplementit të diplomës duhet të jetë në 2 (dy) gjuhë: shqip dhe anglisht. Në rastet kur programi i studimit zhvillohet në Republikën e Shqipërisë nga një institucion i huaj i arsimit të lartë ose në rastin e diplomave të përbashkëta (të dyfishta ose të shumëfishta) ndërmjet një institucioni shqiptar të arsimit të lartë dhe një ose disa institucioneve të huaja të arsimit të lartë, përmbajtja e tij lëshohet në gjuhën angleze dhe në gjuhën e lëshimit të diplomës së përbashkët (ndër 4 gjuhët e tjera kryesore të Bashkimit Evropian: frëngjisht, gjermanisht, spanjisht dhe italisht). Në çdo rast, përmbajtja e suplementit të diplomës, në të gjitha gjuhët, duhet të jetë e njëjtë. Për institucionet e huaja të arsimit të lartë që operojnë në Republikën e Shqipërisë në përmbajtjen e suplementit të diplomës përfshihet edhe informacioni për vendin e ofrimit të studimeve, përkatësisht në germën "dh", të pikës 4, të këtij udhëzimi.

10. Suplementi i diplomës, i lëshuar njëkohësisht së bashku me diplomën, është pa pagesë për të gjithë të diplomuarit. Në rast se mbajtësi i tij e humbet suplementin e diplomës, ai mund të kërkojë rilëshimin e suplementit të diplomës, përkundrejt një tarife të miratuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë përkatës.

11. Suplementi i diplomës nuk e zëvendëson diplomën që jepet në përfundim të programit të studimit.

12. Institucioni i Arsimit të Lartë duhet të përcaktojë në aktet e brendshme të ushtrimit të veprimtarisë së saj, procedurat për përgatitjen, certifikimin, administrimin dhe lëshimin e suplementit të diplomës, në zbatim të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.

13. Udhëzimi nr. 7, datë 18.2.2009, "Për suplementin e diplomës", shfuqizohet.

14. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT,

SPORTIT DHE RINISË

Besa Shahini

ANEKS 1

Suplementi i Diplomës/Diploma Supplement

1. Të dhëna identifikuese për mbajtësin e kualifikimit / Information identifying the holder of the qualification

Mbiemri/at / Last name(s)	Emri/at / First name(s)
Datëlindja (dd.mm.vvvv) / Date of birth (dd/mm/yyyy)	Numri i Matrikullimit / Student identification number or code

2. Informacion identifikues mbi kualifikimin / Information identifying the qualification

Emërtimi i kualifikimit të dhënë (në gjuhën origjinale) / Name of qualification	Fusha/t kryesore e studimit e kualifikimit / Main field(s) of study for the qualification
Emri dhe statusi i institucionit që lëshon diplomën (në gjuhën origjinale) / Name and status of aëarding institution	
Emri dhe statusi i institucionit (nëse është i ndryshëm nga pika 2.3), që ofron studimet (në gjuhën origjinale) / Name and status of institution (if different from 2.3) administering studies	Gjuha/ët e përdorur/a në mësimdhënie/provime / Language(s) of instruction/examination

3. Informacion mbi nivelin dhe kohëzgjatjen e kualifikimit / Information on the level and duration of the qualification

Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit në kredite ECTS dhe vite akademike/ Official duration of programme in ECTS credits and years

Niveli i kualifikimit / Level of the qualification

Kushti/et e hyrjes në programin e studimit / Access requirements(s)

4. Informacion mbi programin e studimit të përfunduar dhe rezultatet e arritura / Information on the programme completed and the results obtained

Rezultatet e të nxënit të parashikuara për programin e studimit / Programme learning outcomes

Forma e studimit / Mode of study

Elementet e programit, kreditet ECTS të fituara dhe notat e marra / Programme details, individual credits gained and grades/marks obtained

Sistemi i notave dhe, nëse disponohet, tabela shpërndarëse e tyre / Grading system and, if available, grade distribution table

Klasifikimi i përgjithshëm i kualifikimit (në gjuhën origjinale) / Overall classification of the qualification

5. Informacion mbi përdorimin e kualifikimit të fituar / Information on the function of the qualification

Mundësia për studime të mëtejshme / Access to further study

Mundësia për të ushtruar një profesion të rregulluar (nëse aplikohet për kualifikimin përkatës) / Access to a regulated profession (if applicable)

6. Informacion shtesë / Additional information

Informacion shtesë / Additional information

Burime të tjera informacioni / Further information sources

7. Certifikimi i suplementit / Certification of the supplement

Data (dd.mm.vvvv) / Date (dd/mm/yyyy)

Firma / Signature

Në cilësinë e / Capacity

Vula zyrtare / Official stamp or seal

8. Informacion për sistemin kombëtar të arsimit të lartë / Information on the national higher education system

Sistemi shqiptar i arsimit të lartë	**Albanian Higher Education system**

Sistemi i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, rregullohet me ligjin nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet përkatëse nënligjore për zbatimin e tij.	The Higher Education System in the Republic of Albania is regulated by Laë no. 80/2015 dated 22.07.2015 "On Higher Education and Scientific Research in the Institutions of Higher Education of the Republic of Albania" and respective bylaës for its implementation.
8.1 Organizimi dhe llojet e Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL)	8.1 The organization and types of of Higher Education Institutions (HEIs)
Llojet e IAL-ve janë: 1. Universitet; 2. Kolegj universitar; 3. Akademi; dhe 4. Kolegj profesional i lartë.	The types of institutions of higher education are: (1) University, (2) University College, (3) Academy and (4) Higher Professional College.
IAL-të janë të organizuara në institucione publike, jopublike dhe publike të pavarura, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Ato ofrojnë programe të licencuara të studimeve të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ECTS), për të cilat lëshojnë diploma pas akreditimit të institucionit dhe programit të studimit. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite ECTS.	HEIs are organized as public, non-public and independent public institutions, as by provisions of the aforementioned laë. They offer licensed study programs, organized in modules and graded in credits ECTS (European Credit Transfer and Accumulation System), for ëhich degrees are issued after the accreditation of the institution and of the study program. The normal quantity of credits accumulated by a student during an academic year is 60 credits ECTS.
8.2 Llojet e programeve të studimit dhe të diplomave	8.2 Types of study programs and degrees aëarded
Programet e studimeve në IAL organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar niveleve 6–8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë dhe programe me karakter profesional, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në fushat ku ato plotësojnë kriteret dhe përmbushin standardet shtetërore.	The study programs offered by the HEIs are organized in three consecutive cycles: the first cycle, the second cycle and the third cycle, ëith reference to levels 6-8 of the Albanian Qualifications Frameëork (AQF). The higher education institutions offer also study programs ëith a professional character, ëith reference to 5th level of the Albanian Qualifications

IAL-të ofrojnë programe studimi në cikle të ndryshme në varësi të llojit të institucionit, si dhe programe të formimit të vazhduar, në fushat ku ato plotësojnë kriteret dhe përmbushin standardet shtetërore. Universiteti ofron programe studimi të niveleve 5–8 të KSHK. Kolegji Universitar ofron programe studimi të niveleve 5–7 të KSHK-së. Akademia ofron programe studimi të niveleve 5–8 të KSHK-së. Kolegji Profesional i Lartë ofron programe studimi të nivelit 5 të KSHK-së. 8.3 Licencimi dhe akreditimi 8.3.1 Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i IAL-ve Hapja e një IAL-je, mbyllja dhe ndarja/bashkimi i një institucioni me një institucion tjetër të arsimit të lartë bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave (VKM), me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, sipas standardeve përkatëse të miratuara me VKM. IAL fillon veprimtarinë e tij vetëm pas nxjerrjes së urdhrit të ministrit përgjegjës për arsimin për fillimin e veprimtarisë. Një IAL përfundon veprimtarinë e tij akademike, të përcaktuar në misionin e tij, vetëm në fund të vitit të akademik. 8.3.2 Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e programeve të studimit miratohet nga	Frameëork, in those fields of educations ëhere they meet the criteria and fulfill the state standards. The HEIs offer study programs in different cycles depending on the type of the institution, as ëell as lifelong learning programs in the fields ëhere they meet the criteria and fulfill the state standards. A university offers study programs of 5th – 8th AQF level. A University College offers study programs of 5th – 7th AQF level. An Academy offers study programs of 5th – 8th AQF level. A Higher Professional College offers study programs of 5th AQF level. 8.3 Licensing and accreditation 8.3.1 Licencing, closure and reorganization of a HEI The HEIs are licensed, closed and separated/merged based on a Decree of the Council of Ministers (DCM), upon a proposal of the minister responsible for the education, according to respective standards approved by a DCM. The HEI begins its activity only after the order of the minister responsible for the education is issued. A HEI terminates its academic activities, defined in its mission, only at the end of an academic year. 8.3.2 Licensing, closure and reorganization of study programs

ministri përgjegjës për arsimin, kur plotësohen kriteret bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, në bazë të kërkesës së institucionit të arsimit të lartë, bazuar në vlerësimin e nevojave për aftësi në tregun e punës. Pas një cikli të plotë studimi, IAL-ja mund të riorganizojë vetë programet e studimit deri në masën 20% të përmbajtjes së tyre dhe njofton për këtë ministrinë përgjegjëse për arsimin. IAL-të e një prej shteteve të Bashkimit Europian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë dhe Australisë mund të ofrojnë programe studimi ose formime profesionale të larta. Këto programe duhet të jenë të akredituara në shtetin e origjinës dhe të ofrohen në institucione shqiptare të akredituara të arsimit të lartë, pas miratimit të tyre nga ministri përgjegjës për arsimin. Realizimi i programit kryhet me të njëjtat standarde, modalitete dhe personel akademik siç zhvillohet në vendin e origjinës të institucionit të huaj. IAL-ja shqiptare ka përgjegjësi për plotësimin e standardeve dhe realizimin e procesit akademik. Hapja e këtyre programeve u nënshtrohet paraprakisht procesit të vlerësimit dhe të njohjes nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) dhe Bordi i Akreditimit, në përputhje me Kodin e Cilësisë, si dhe detyrimet e tjera ligjore. 8.3.3 Akreditimi Sistemi i akreditimit të programeve të studimit është në funksionim që prej vitit 1999. ASCAL-ja, person juridik publik, është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL-ja është agjenci e afiliuar e ENQA-së.	The licensing, closure and reorganization of study programs is approved by the minister responsible for the education, in case the criteria defined by legislation frameëork in force are met, upon the request of a HEI and based on an assessment of the needs for skills in the labor market. After a full cycle of study, HEI itself may reorganize the study programs up to 20% of their content and informs the ministry responsible for education for it. HEIs from European Union, United States of America, Canada and Australia may offer study programs or higher professional trainings. These study programs should be accredited in the country of origin and be offered by accredited Albanian HEIs, after the approval by the minister responsible for education. The program is offered ëith the same standards, modalities and academic staff, as it is offered in the country of origin of the foreign institution. The Albanian HEI is responsible for the fulfillment of the standards and accomplishment of the academic process. The licensing of these program has to undergo preliminarily to an evaluation and recognition process by the Agency for Quality Assurance in Higher Education (AQAHE) and Accreditation Board, in compliance ëith Quality Code, and other legal obligations as ëell. 8.3.3 Accreditation The accreditation system of study programs has been set up since 1999. AQAHE, a public legal body, is responsible for quality assurance in higher education. AQAHE is an affiliated agency of ENQA.

Në kuadër të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, ASCAL-ja bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me agjenci homologe, pjesë të Rrjetit Europian të Sigurimit të Cilësisë (ENQA) Akreditimi i parë institucional dhe ai i programeve kryhen përpara lëshimit të diplomave të para nga IAL-ja. Akreditimi institucional i paraprin atij të programeve të studimit. Vlefshmëria e çdo akreditimi institucional dhe e programeve të studimit që lidhen me të nuk mund të zgjasë më shumë se 6 vjet. Informacion konkret dhe zyrtar për institucionet e licencuara dhe të akredituara gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (ëëë.arsimi.gov.al), si edhe në faqen zyrtare të ASCAL (ëëë.ascal.al). 8.4 Pranimi në arsimin e lartë Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë, programet e studimit me karakter profesional *(short cycle)* dhe në programet e integruara të ciklit të dytë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm. Hyrja në arsimin e lartë realizohet përmes një aplikimi *online* në nivel kombëtar. Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme: a) janë pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të arsimit të mesëm;	AQAHE cooperates ëith other agencies, members of European Netëork for Quality Assurance (ENQA), in the frameëork of external evaluation of the quality. The first institutional accreditation and first program accreditation are conducted before the first diplomas are issued by a HEI. The institutional accreditation precedes the accreditation of the study programs. The validity of every institutional accreditation and related study programs cannot last more than 6 years. Concrete and official information on licensed and accredited HEIs is available on the official ëebsite of the Ministry of Education, Sports and Youth (ëëë.arsimi.gov.al), and on the official ëebsite of the AQAHE (ëëë.ascal.al). 8.4 Admission in Higher Education The admission to the first cycle study programs, study programs ëith professional nature (short cycle) and integrated study programs of the second cycle is possible for any candidate ëho has successfully completed the secondary education cycle. Entry into higher education is achieved through an online application at the national level. The application is open to all candidates ëho have successfully completed secondary education and meet the folloëing conditions:

b) plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me VKM-në për vitin përkatës akademik. Kandidatët vlerësohen me pikë në sistemin *online,* bazuar në plotësimin e kritereve të vendosura për pranimin në programin përkatës të studimit nga vetë IAL-ja, vlerësimit që kanë pasur në arsimin e mesëm dhe programit ku kanë aplikuar, bazuar në sistemin meritë–preferencë. Pranimi i kandidatëve në të gjitha programet e studimit të arsimit të lartë, kur studimet e mëparshme janë kryer jashtë vendit, bëhet pas njësimit të diplomës/certifikatës në Republikën e Shqipërisë dhe dorëzimit të dokumentin përkatës të njësimit, së bashku me dokumentet e tjera përkatëse të aplikimit pranë IAL-së. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare, në Republikën e Shqipërisë, diplomave/certifikatave të lëshuar jashtë vendit është ministria përgjegjëse për arsimin/Qendra e Shërbimeve Arsimore. 8.5 Organizimi dhe struktura e programeve të studimit Studimet në arsimin e lartë kryhen normalisht me kohë të plotë. Për programet e studimit me karakter profesional *(short cycle),* programet e studimit "Master profesional" dhe programet e studimit "Master ekzekutiv" mund të kryhen dhe me kohë të zgjatur. Programet e studimit, që japin të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë. 8.5.1 Programet e studimit me karakter profesional *(short cycle)*	a. are equipped ëith the legal documentation of completion of secondary education; b. meet the criterion of the average grade, defined by DCM for the respective academic year. Candidates are evaluated ëith points on the online system based on the criteria met set for admission to the respective study program by HEIs themselves, on the evaluation they have had during the secondary education and the program they applied, based on the merit-preference system. The admission of candidates in all higher education study programs, ëhen the previous studies are conducted abroad, is done after recognition of respective diploma / certificate in the Republic of Albania and submission of the relevant act of recognition together ëith other relevant application documents to the HEI. In the Republic of Albania, the institution responsible for official recognition diplomas / certificates issued abroad is the ministry responsible for Education / Center Educational Services. 8.5 Organization and structure of study program Studies in higher education are normally offered in full time mode. Study programs ëith professional nature (short cycle), "Professional master" and "Executive master" study programs can be offered in prolonged mode of study. Study programs that give the rights to exercise a regulated

Programet e studimit me karakter profesional *(short cycle),* pas arsimit të mesëm, ofrohen me 60 ose 120 kredite ECTS, respektivisht me kohëzgjatje 1 ose 2 vite akademike dhe i përkasin nivelit 5 të KSHK-së. Në përfundim lëshohet respektivisht "Certifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimimit të kryer.	profession can be offered in full time mode of study only.
8.5.2 Studimet e ciklit të parë	8.5.1 Study programs ëith professional nature (short cycle)
Programet e ciklit të parë të studimit, organizohen me jo më pak se 180 kredite ECTS, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike dhe i përkasin nivelit 6 të KSHK-së.	The study programs ëith professional nature (short cycle), after secondary education, are offered ëith 60 or 120 ECTS credits, respectively ëith 1- or 2-years duration, and belong to 5th AQF level. At the end, a "Professional Certificate" or "Professional Degree" is issued respectively in the field of education completed.
Pranimi në këto programe studimi është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me VKM. IAL-të mund të vendosin edhe kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat shpallen nga IAL-ja dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.	8.5.2 First cycle studies The first cycle study programs, are organized in not less than 180 ECTS credits, normal duration of three academic years and belong to 6th AQF level. The admission in these study programs is possible for each candidate ëho has successfully completed a secondary education cycle and meets the average grade requirement, defined yearly by DCM. HEIs can decide additional admission criteria for the selection of the candidates, ëhich are publicly announced by HEI and are made available to the Center for Educational Services (CES) and to the ministry responsible for education.
Në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma *"Bachelor"* në fushën e arsimimit të kryer.	At the end of the first cycle study programs, the "Bachelor" degree is issued, in the field of the study completed.
8.5.3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë	8.5.3 Second cycle integrated study programs
Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, realizohen me 300 ose 360 kredite ECTS dhe kohëzgjatje normale respektivisht 5 dhe 6 vite akademike, i përkasin nivelit 7 të KSHK-së dhe ofrohen në fushat e drejtësisë, mjekësisë, stomatologjisë, farmacisë, veterinarisë e arkitekturës.	

Me VKM mund të përcaktohen fusha të tjera, në të cilat mund të ofrohen programet e integruara të studimeve. Pranimi në këto programe studimi është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me VKM. IAL-të mund të vendosin edhe kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat shpallen nga institucioni i arsimit të lartë dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin. Studimet në këto programe përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master i shkencave" në fushën e arsimimit të kryer. 8.5.4 Programet e studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave", "Master i arteve" dhe "Master profesional" Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë. 8.5.4.1 Programet e studimeve "Master i shkencave" dhe "Master i arteve" Programet "Master i shkencave" apo "Master i arteve", të cilat pajisin të diplomuarit, respektivisht, me njohuri të thelluara teorike dhe aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar apo njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, në fushën e	Second cycle integrated study programs are offered ëith 300 or 360 ECTS credits, normal duration of studies of 5 and 6 academic years, belong to 7th AQF level and are offered in the fields of laë, medicine, dentistry, pharmacy, veterinary and architecture. The Council of Ministers may define other fields ëhere integrated study programs may be offered. The admission in these study programs is possible for each candidate ëho has successfully completed the secondary education cycle and meets the average grade requirement defined yearly by DCM. HEIs can decide additional admission criteria for the selection of the candidates, ëhich are publicly announced by HEI and are made available to the Center for Educational Services (CES) and to the ministry responsible for education. The studies in these programs are finalized ëith a thesis and at the end a "Master of science" degree in the respective field of the study completed is issued. 8.5.4 Study programs of the second cycle "Master of science", "Master of arts" and "Professional master" The admission in the second cycle of studies is possible for the candidates ëho have finished a first cycle study program and meet the admission criteria defined by the HEI they apply for admission.

arteve, ofrohen në vijim të ciklit të parë dhe realizohen me jo më pak se 120 kredite ECTS, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike dhe i përkasin nivelit 7 të KSHK-së. Kriter pranimi në programet "Master i shkencave" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. IAL-të mund të njohin kredite të përfituara në programet e studimit "Master profesional", me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit "Master i shkencave". Studimet "Master i shkencave" përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master i shkencave" në fushën e arsimimit të kryer, ndërsa në përfundim të studimeve "Master i arteve" lëshohet diplomë "Master i arteve" në fushën e arsimimit të kryer, të cilat mundësojnë vijimin e studimeve në ciklin e tretë të studimeve. 8.5.4.2 Programet e studimeve "Master profesional" Programet "Master profesional", të cilat pajisin të diplomuarit, njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar, ofrohen në vijim të ciklit të parë dhe organizohen me 60 ose 120 kredite ECTS, me kohëzgjatje normale, respektivisht, 1 ose 2 vite	8.5.4.1 Study programs "Master of science" and "Master of arts" The "Master of Science" or "Master of arts" study programs, that provide the graduates, respectively, ëith in-depth theoretical knoëledge as ëell as ëith scientific research skills in a given field or in-depth theoretical and practical knoëledge in the fields of arts, are offered folloëing first cycle studies ëith not less than 120 ECTS credits, normal duration of 2 academic years and belong to 7th AQF level. An admission criterion in the "Master of science" study programs is the knoëledge by the candidates of one of the five foreign languages of the European Union: English, French, German, Italian, Spanish, certified through internationally recognized tests, as by provisions in the respective bylaë of the minister responsible for education. If the individual has obtained a degree in a study program conducted in one of these languages, the obtained diploma serves as proof of the fulfillment of this criterion. HEIs may recognize credits obtained in a "Professional master" study program, ëith the aim of transferring them in a "Master of science" study program. "Master of science" studies are finalized ëith a thesis and at the end of these studies a degree in "Master of science" in the respective field of the study is issued, meanëhile at the end of a "Master of arts" study, a degree in "Master of arts" in the respective field of the study is issued. Both of them give access to third cycle studies.

akademike dhe i përkasin nivelit 7 të KSHK-së. Studimet e ciklit të dytë "Master profesional" përmbyllen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master profesional" në fushën e arsimimit të kryer. Institucionet e arsimit të lartë mund të njohin kredite të përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional", me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit "Master i shkencave". 8.5.5 Studimet e ciklit të tretë Programet e studimit të ciklit të tretë të studimeve, të cilat i korrespondojnë nivelit 8 të KSHK-së, përfshijnë programet e studimeve "Master ekzekutiv", programet e studimeve specializuese afatgjata, si dhe studimet e doktoratës. Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën "Masteri shkencave" ose "Master i arteve" dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga IAL-ja përkatëse. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të tretë është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.	8.5.4.2 "Professional Master" study programs The "Professional Master" study programs, that equip the graduates ëith in depth professional knoëledge in a specific field, are offered folloëing first cycle studies ëith not less than 60 or 120 ECTS credits, normal duration of 1 or 2 academic years, respectively, and belong to 7th AQF level. The "Professional Master" second cycle studies are finalized ëith a final examination or a graduation thesis and in conclusion, the "Professional Master" degree is issued in the educational field completed. The higher education institutions may recognize credits obtained in the "Professional Master" study programs of the second cycle ëith the aim of transferring the latter into the "Master of Science" study programs. 8.5.5 Third cycle studies The third cycle study programs, that belong to 8th AQF level, include the "Executive Master" study programs, the long-term specialization study programs as ëell as the Doctoral studies. The admission in the third cycle study programs is possible for the candidates ëho have obtained a degree "Master of Science" or "Master of Arts" and meet the admission criteria defined by respective HEI. An admission criterion in the third cycle study programs is the knoëledge by the candidate of one of the five foreign languages of the European Union: English, French, German,

8.5.5.1 Programet e studimeve të doktoratës Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore e IAL-së. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tre dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur, në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një IAL tjetër apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar. Kur studimet e doktoratës zhvillohen në bashkëpunim midis institucioneve të arsimit të lartë, pjesë të procesit kërkimor, mund të zhvillohen pranë institucioneve bashkëpunuese. Në përfundim të studimeve të doktoratës dhe të plotësimit të kritereve përkatëse të përcaktuara me VKM lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor". Institucionet e arsimit të lartë vendosin kritere për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor. 8.5.5.2 Programet e studimeve "Master ekzekutiv" Programet e studimeve "Master ekzekutiv" ofrojnë arsimim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional, organizohen me 60 ose 120 kredite ECTS dhe kohëzgjatje	Italian, Spanish, certified through internationally recognized tests, as by provisions in the respective bylaë of the minister responsible for education. If the individual has obtained a degree in a study program conducted in one of these languages, the obtained diploma serves as proof of the fulfillment of this criterion. 8.5.5.1 Doctoral study programs The Doctoral studies are built upon individual programs for independent training of candidates in scientific research in the fields defined by the basic or main HEI units. They are based on research and creative activities. The doctoral studies last for not less than three and not more than five academic years. The doctoral studies are conducted on a full-time basis near the basic unit or on a prolonged time basis in those cases ëhen the doctorate candidate is employed as an academic staff in another HEI or as research staff in an institution of basic or applied research. Ëhen the doctorate studies are conducted in cooperation betëeen institutions of higher education, parts of the research process may be developed ëithin the cooperating institutions. At the end of doctoral studies and fulfillment of the respective criteria specified in DCM, the degree of scientific grade "Doctor" is issued. The higher education institutions establish criteria for the annual assessment of the progress of candidates and for the continuation of the research project.

normale, përkatësisht 1 ose 2 vite akademike. Ato përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma "Master ekzekutiv" në fushën e arsimimit të kryer. 8.5.5.3 Programet e studimeve specializuese afatgjata Programet e studimeve specializuese afatgjata janë programe të formimit profesional që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta. Ato zgjasin jo më pak se 2 vite akademike dhe organizohen me jo më pak se 120 kredite ECTS. Ato përmbyllen me provim formimi ose me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet "Diplomë specializimi" në fushën përkatëse të programit të studimit. 8.5.6 Programet e studimeve të formimit të vazhduar Institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë të gjithë jetës. Këto programe shërbejnë për plotësim, thellim e konsolidim të njohurive dhe mund të ofrohen si kurse kualifikimi e rikualifikimi, shkolla verore dhe veprimtari të ngjashme. Programet e studimeve të formimit të vazhduar ndihmojnë individët në rritjen e kualifikimit dhe të aftësive profesionale. Struktura e këtyre programeve, kohëzgjatja dhe kreditet e tyre përcaktohen në mënyrë të pavarur nga secila njësi bazë përgjegjëse, në bashkëpunim me ministritë e linjës, nëse kanë kompetencë, sipas kuadrit ligjor për profesionet e rregulluara dhe	8.5.5.2 "Executive Master" study program The "Executive Master" study programs offer a high level of scientific and professional education. They are offered ëith 60 or 120 ECTS credits and normal duration, respectively, of 1 or 2 academic years. They are finalized ëith a graduation thesis and in conclusion the "Executive Master" degree is issued in the educational field completed. 8.5.5.3 The long-term specialization study programs The long-term specialization study programs are programs of professional training that offer special professional knoëledge. They have a duration of not less than 2 academic years and are offered ëith not less than 120 ECTS credits. They are finalized ëith the training examination or ëith a graduation thesis and at the end a "Specialization Diploma" is issued in the relevant educational field completed. 8.5.6 Lifelong Learning Programs The institutions of higher education may offer continuous education programs, as lifelong learning education. These programs aims at complementing, deepening and consolidating of knoëledges and can be offered as qualification or requalification courses, summer schools and similar activities. The continuous education study programs assist the individuals in their qualification progress and professional skills.

bëhen publike nga njësia kryesore e IAL-së. Në përfundim të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, institucionet e arsimit të lartë lëshojnë certifikatat përkatëse, të cilat regjistrohen në përputhje me këtë ligj. Institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë edhe kurse përgatitore për programet e studimeve që organizojnë. 8.6 Programet e përbashkëta të studimeve Një IAL ose njësi kryesore të tij, në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë vendit mund të ofrojë programe të përbashkëta të studimit. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse. 8.7 Sistemi i vlerësimit dhe shpërndarja e notave kaluese Vlerësimi i dijeve në arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë bëhet me nota nga 1 deri në 10. Nota më e lartë është 10 dhe nota minimale kaluese është 5. 8.8 Ndjekja e një programi të dytë studimi dhe transferimi Individët, që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi të të njëjtit cikël. Studenti nuk mund të regjistrohet njëkohësisht në më shumë se një program studimi. Bëjnë përjashtim	The structure of these programs, their duration and credits are determined independently from each responsible basic unit, in collaboration ëith the line ministries, if they have competencies, as by legal frameëork for regulated professions, and they are made public by the main HEI unit. At the end of the continuous education studies and training programs, HEIs issue the relevant certifications, ëhich are registered in accordance ëith the aforementioned laë. HEIs may also offer preparatory courses for the study programs that they offer. 8.6 Joint study programs A HEI or any of its main unit, in cooperation ëith one or several other institutions of higher education, public or non public, in Albania or abroad, may offer joint study programs. At the end of these studies a joint degree, double or multiple degree, is issued by the participating institutions. 8.7 The assessment system and passing grade distribution The assessment of the knoëledges in higher education in the Republic of Albania is done ëith grades from 1 to 10. The highest grade is 10 and the loëest passing grade is 5. 8.8 Attendance of a second study program and transfer of studies Individuals, ëho have completed a study program, have the right to attend

nga kjo rregull nxënësit dhe studentët e shkëlqyer. Transferimi i studimeve lejohet midis programeve të të njëjtit cikël studimi në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik, brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta *(short cycle)* të nivelit 5 të KSHK-së mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, që korrespondon me nivelin 6 të KSHK-së, sipas kritereve të përcaktuara nga IAL-ja. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, më qëllim vazhdimin e studimeve në institucionin pritës të arsimit të lartë, i takon komisionit përkatës, të ngritur nga njësia bazë e IAL-së. Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja, njihen dhe njësohen, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm. Njohja kryhet nga IAL-ja, të cilit i është paraqitur kërkesa për vazhdimin e studimeve. 8.9 Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën ose certifikatën përkatëse. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.	a second study program of the same cycle. The student cannot be registered, at the same time, in more than one study program. Exceptions to this rule are excellent pupils and students. Transfer of studies is permitted betëeen programs of the same study cycle in the same or similar study fields and at the beginning of the academic year only, ëithin the same institution or in a different HEIs. Credits accumulated during study programs ëith professional nature (short cycle) of the 5th AQF level, can be transferred to first cycle studies, corresponding to the 6th AQF level, according to the criteria set by the HEI. The decision on the full or partial recognition of the credits acquired by a student ëho is going to be transferred, ëith the purposes of continuing the studies in the host HEI, is taken by the relevant commission set up by the HEI's basic unit. Study periods and study program obligations, completed in other domestic or foreign institutions, are recognized in vieë of continuing of the education in the same or similar study program. The recognition is carried out by the HEI, to ëhich the application for continuation of studies has been submitted. 8.9 The issuance of diplomas, certificates and diploma supplement At the end of the study program, the student is provided ëith a diploma or a certificate. The constituent elements, diploma form and registration procedures of the diploma form are

Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë, si edhe ato "Master ekzekutiv" të ciklit të tretë, shoqërohen me suplementin e diplomës, i cili lëshohet automatikisht nga IAL-ja dhe pa pagesë. Çdo formë diplome dhe certifikate, përpara se të lëshohet nga IAL-ja, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe në regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe për kërkimin shkencor, që mbahet në QSHA. IAL-të mund të lëshojnë diploma dhe certifikata vetëm konform formës së regjistruar dhe depozituar në QSHA. IAL-të nuk mund të lëshojnë dublikatë diplome, kur kjo humbet apo dëmtohet, por mund të lëshojnë dokument të barasvlershëm me diplomën në formën e vërtetimit, i cili duhet të përmbajë emrin e institucionit që ka lëshuar diplomën, numrin e diplomës origjinale, datën e lëshimit të saj, ciklin dhe programin e studimit. 8.10 Kohëzgjatja e studimeve Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritës.	defined by the ministry responsible for education. Diplomas issued at the end of the first cycle, second cycle, and "Executive master" study programs of third cycle are accompanied by Diploma Supplement, ëhich is issued by HEI automatically and free of charge. Each form of diploma and of certificate, before being issued by the HEI, is registered in the state diplomas register and the in-state certificates register for higher education and scientific research, held at the CES. HEIs may issue diplomas and certificates only in compliance ëith the registered form ëhich is deposited at the CES. HEIs cannot issue a duplicate of diploma ëhen the latter is lost or damaged, but they can issue an equivalent document in the form of an attestation equivalent ëith the diploma, ëhich should include the name of the institution that has issued the diploma, the original diploma number, the date of issuance, the cycle and the title of the study program. 8.10 The duration of studies The maximum duration of studies in a study program cannot be more than tëice of the normal duration of the studies envisaged by the program, ëithout taking into account the period of time ëhen the student has suspended the studies. The student, ëho fails to complete the studies ëithin the maximum duration of the study program, has the right to apply for restarting studies, in the same study program or in a different study program. The student is subject to the criteria and procedures

Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e tij.	announced for admission in the study program of the receiving institution. Credits collected by the student during the previous period of study can be transferred, by decision of the basic unit of the institution that accepts the student, according to the criteria set out in its regulation.
8.11 Gjuha e studimeve Programet e studimit në IAL-të në Republikën e Shqipërisë ofrohen normalisht në gjuhën shqipe. Këto programe mund të ofrohen dhe në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian, të miratuar në aktin përkatës të hapjes së programit të studimit. Përjashtohen nga kjo rregull programet e përbashkëta të studimit të ofruara me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe programet e studimit që kanë për objekt mësimin e gjuhëve të huaja. Në rastin e programeve të studimit që ofrohen në gjuhë të huaj, studentët duhet të dëshmojnë njohjen e gjuhës së huaj përkatëse në nivelin e nevojshëm për të kryer studime të larta, të përcaktuar nga IAL-ja, ofrues i programit të studimit.	8.11 The language of study Study programs offered by HEIs in the Republic of Albania are normally delivered in Albanian language. These programs may also be offered in one of the official languages of the European Union, ëhich has to be approved in the respective act of licensing of the study program. The joint study programs offered in cooperation ëith foreign HEIs and the study programs ëhich objective is learning of a foreign language are excluded from this rule. In the case of study programs offered in a foreign language, students must demonstrate the knoëledge of the relevant foreign language at the level required to complete the studies, as determined by the HEI that provides the study program.
8.12 Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK) KSHK-ja organizohet në 8 nivele që korrespondojnë me të njëjtat nivele të Kornizës Europiane të Kualifikimeve (KEK). Është në proces referencimi i KSHK-së me KEK-në.	8.12 Albanian Qualifications Frameëork (AQF) The AQF is organized in 8 levels corresponding to the same levels as the European Qualifications Frameëork (EQF). It is in the process of referencing the AQF ëith KEK.
8.13 Ushtrimi i një profesioni të rregulluar Profesionisti fiton të drejtën për të ushtruar një profesion të rregulluar, pasi ka marrë diplomën për kualifikimin përkatës, ka kryer me sukses praktikën profesionale dhe	8.13 Pursuing a regulated profession The professional is entitled to exercise a regulated profession after having obtained the diploma for the relevant qualification, has successfully completed the professional practice

provimin e shtetit, si dhe pasi regjistrohet në urdhrin profesional përkatës. Nëse nuk është ngritur urdhri profesional dhe deri në ngritjen e tij, kompetencat përkatëse ushtrohen nga ministria kompetente që mbulon profesionin përkatës.	and state exam, as ëell as have being registered in the relevant Professional Order. If the Professional Order has not been established, and until its establishment, the relevant poëers are exercised by the competent ministry covering the relevant profession.

UDHËZIM

Nr. 15, datë 26.5.2020

PëR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019

"PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pika 4 e Kreut I, ndryshohet si më poshtë:

"4. Aplikimi i maturantëve/kandidatëve me formularët A1 dhe A1Z bëhet në portalin e maturës shtetërore online ëëë.matura.qsha.gov.al., për programet e ciklit të parë të studimeve, për programet e studimeve me karakter profesional, për programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, dhe programet e dyta të studimit që nuk janë të të njëjtit cikël studimi në institucionet e arsimit të lartë.".

b) Pas pikës 10, të Kreut I, shtohet pika 11, me këtë përmbajtje:

"11. MASR i përcjell zyrtarisht QSHA-së dhe RASH-it listën e programeve të ciklit të parë të studimeve, të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë dhe numrin e kuotave të studimit për secilin prej programeve.".

c) Në pikën 1, të shkronjës "C", të Kreut II, fjalët "deri në 10 (dhjetë)" zëvendësohen me fjalët "deri në 7 (shtatë)".

d) Pas pikës 6, të shkronjës "C", të Kreut II, shtohen pikat 7, 8 dhe 9, me këtë përmbajtje:

"7. Të gjitha IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, pas kryerjes së përllogaritjes së pikëve për çdo konkurrent, sipas kritereve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja me vendim senati, si dhe renditjes së tyre në varësi të pikëve të grumbulluara, afishojnë në mjediset publike, si dhe në faqen e zyrtare listat e renditjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

8. Brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, IAL-të, afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID e tyre të maturës, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ngarkojnë brenda afatit të përcaktuar në kalendar, një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

9. Kuotat e paplotësuara në përfundim të raundit të parë për çdo program studimi, mund të përshtaten nga IAL në programe të tjera studimi të të njëjtit cikël të ofruara brenda të njëjtës njësi kryesore, pa kaluar totalin e kuotave për njësi kryesore, dhe njofton zyrtarisht MASR për vendimin e senatit akademik mbi përshtatjen e kuotave të programeve të studimit. Në rast se përshtatja e kuotave është sipas përcaktimeve ligjore, MASR njofton IAL-të, RASH dhe QSHA për konfirmimin e përshtatjes së kuotave.".

e) Në pikën 1, të shkronjës "E", të Kreut II, fjalët "deri në 10 (dhjetë)" zëvendësohen me fjalët "deri në 5 (pesë)".

f) Pika 5, e shkronjës “B” të Kreut II, pika 6 e shkronjës “C” të kreut II dhe pika 5 e shkronjës “E” të Kreut II, shfuqizohen.

g) Në pikën 2 dhe 5, të shkronjës “A”, të Kreut III, fjalët “7 faza 48-orëshe”, zëvendësohen me fjalët “6 faza 48-orëshe”.

h) Fjalia e fundit e pikës 7, e shkronjës “G”, të Kreut III, ndryshohet si më poshtë: “IAL-të gjatë regjistrimeve respektojnë renditjen e raundit paraardhës të kandidatëve deri në plotësimin e kuotave.”.

i) Në pikat 2 dhe 5, të shkronjës “D”, të Kreut III, fjalët “5 faza 48-orëshe”, zëvendësohen me fjalët “4 faza 48-orëshe”.

j) Në pikën 4, të Kreut IV/1, fjalët “në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit,”, shfuqizohen.

k) Pika 3, e Kreut IV/2, ndryshohet si më poshtë:

“3. Aplikimi të kryhet vetëm nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe plotësojnë:

a) kriterin e notës mesatare të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave për vitin përkatës akademik, me përjashtim të kategorive të përjashtuara në këtë vendim;

b) kriteret shtesë të pranimit të vendosura nga vetë IAL-të për programet e studimit për të cilët aplikojnë.”.

l) Në pikën 2, të Kreut IV/4, pas fjalëve “të shpallin”, shtohen fjalët “në Portalin U-Albania”.

m) Pikat 4 dhe 5, të kreut IV/4, ndryshohen si më poshtë:

“4. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve publike dhe jopublike në Portalin U-Albania, përkatësisht deri në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

5. IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në Portalin U-Albania dhe në faqen e saj elektronike zyrtare (ëeb), listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datave përkatëse të përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

n) Fjalia e dytë e pikës 13, të Kreut IV/4, ndryshohet si më poshtë:

“Kandidatët fitues regjistrohen në Portalin U-Albania dhe pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit”.

o) Pas pikës 17, të kreut IV/4, shtohet pika 18) si më poshtë:

"Për çdo vit akademik, brenda datës 30 nëntor, RASH-i përcjell me shkresë zyrtare në QSHA regjistrimet përfundimtare të ciklit të dytë, në format elektronik, të dhënat e mëposhtme:

a) emri i IAL;

b) njësia kryesore e IAL-së;

c) cikli i studimit;

d) programi i studimit;

e) data e regjistrimit;

f) të dhënat personale të kandidatit të regjistruar;

g) IAL në të cilën ka kryer ciklin e parë të studimeve".

p) Në pikën 9 të kreut IV/6, shtohet shkronja "g" me këtë përmbajtje:

"*g. Kopje e njësuar e librezës së punës.".*

q) Pas pikës 1 të Kreut V, shtohet pika 1/1 më këtë përmbajtje:

"1/1. Çdo regjistrim i kryer në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, këtë udhëzim dhe jashtë datave të përcaktuara në kalendarin e procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, të miratuar nga QSHA dhe RASH, konsiderohet i pavlefshëm dhe kandidatët nuk pajisen me numër matrikullimi.".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe IAL-të publike dhe jopublike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Besa Shahini

UDHËZIM

Nr. 17, datë 23.6.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019, "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, të shkronjës "C", të kreut II, togfjalëshi "... deri në 7 (shtatë)" zëvendësohet me togfjalëshin "... deri në 10 (dhjetë)".

b) Në pikën 1, të shkronjës "E", të kreut II, togfjalëshi " ... deri në 5 (pesë)" zëvendësohet me togfjalëshin " ... deri në 10 (dhjetë)".

c) Në pikat 2 dhe 5, të shkronjës "A", të kreut III, togfjalëshi "... 6 faza 48-orëshe", zëvendësohet respektivisht me togfjalëshin " ... 7 (shtatë) faza 48-orëshe".

d) Në pikat 2 dhe 5, të shkronjës "D", të kreut III, togfjalëshi "... 4 faza 48-orëshe", zëvendësohet respektivisht me togfjalëshin " ... 5 (pesë) faza 48-orëshe".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe IAL-të publike dhe jopublike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT

DHE RINISË

Besa Shahini

UDHËZIM

Nr. 22, datë 3.9.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020, "PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË"

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, neneve 30 dhe 35, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Kudo në udhëzim, togfjalëshi "... në sistemin elektronik/në sistemin elektronik përkatës/pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në vijim "MASR" ...", zëvendësohet me togfjalëshin "në platformën *e-Albania*".

2. Kudo në udhëzim, togfjalëshi "... dhe depoziton në mënyrë shkresore pranë MASR-së ..." dhe togfjalëshi "... dhe depoziton/jnë në formë/mënyrë shkresore", shfuqizohen.

3. Kudo në udhëzim, togfjalëshi "... sipas shtojcës nr. 1 të këtij udhëzimi/sipas shtojcës nr. 1 ..." dhe "... sipas shtojcës nr. 2 ...", zëvendësohen me togfjalëshin "... sipas formularit përkatës në platformën *e-Albania*.".

4. Pika 1 dhe 2, e kreut I/A, ndryshojnë si më poshtë:

"1. Subjekti juridik vendës ose i huaj aplikon *on-line* në platformën *e-Albania*, duke plotësuar formularin për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, brenda datës 15 maj për vitin e dytë akademik pasardhës.

2. Mbi bazën e aplikimeve në platformën *e-Albania*, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në vijim "MASR", brenda një afati 30-ditor nga data e aplikimit, njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.".

5. Në fund të shkronjës "b", të pikës 3.2, të kreut I/A, shtohet fjalia me përmbajtjen si më poshtë:

“Kolegjet profesionale të larta, departamentet e të cilave kanë programe studimi që zgjasin dy vite akademike, me 120 kredite (ECTS), kanë, të paktën, dy pedagogë me gradë shkencore ose titull akademik për çdo departament. Departamenti mund të ketë në përbërje edhe personel ndihmës mësimdhënës.”.

6. Në shkronjën “a”, të pikës 4, të kreut I/A dhe I/B, fjalët “... në MASR”, zëvendësohen me togfjalëshin “... në platformën *e-Albania*”.

7. Në kreun IV, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 3/B, pas shkronjës “e”, shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

“f) Mandatpagesën për tarifën që paguhet për vlerësimin nga ekspertët e programit të studimit, sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 109/2017, të ndryshuar.”.

b) Shkronja “a”, e pikës 1/C, ndryshon me këtë përmbajtje:

“a) IAL-ja aplikon në platformën *e-Albania,* sipas formularit përkatës për mbylljen e programit/eve të studimit, jo më vonë se 6 muaj para fillimit të vitit të ri akademik. Subjekti ngarkon kërkesën e argumentuar, shoqëruar me propozimet e njësisë bazë dhe të njësisë kryesore, si dhe vendimet përkatëse të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit. IAL-ja është përgjegjëse për pasojat juridike të ardhura nga mbyllja e programit/eve të studimit për studentët që kanë përfunduar programin apo janë në proces ndjekjeje të programit.”.

8. Në kreun VI, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pika 4 ndryshon, si më poshtë:

4. Për aplikimet në platformën *e-Albania* për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve të tyre dhe hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit, zbatohen rregullat e këtij udhëzimi, me hyrjen në fuqi të tij. Aplikimet për hapjen, riorganizimin, mbylljen e njësive kryesore, mbylljes së degës së IAL-së, si dhe për bashkimin dhe ndarjen e IAL-ve, do të vijojnë të bëhen në adresën elektronike aplikime.ial@arsimi.gov.al, deri në procedimin e tyre nëpërmjet platformës *e-Albania*.”.

b) Pas pikës 5 shtohen pikat 5/1 dhe 5/2, me këtë përmbajtje:

“5/1. MASR-ja mund të kërkojë që një ose më shumë dokumente të ngarkuara elektronikisht, të dorëzohen edhe në formë shkresore nga subjekti aplikues.”.

“5/2. Struktura përgjegjëse në MASR mban procesverbalin përkatës për çdo dokumentacion të depozituar në platformën *e-Albania*.”.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Besa Shahini

UDHËZIM

Nr. 23, datë 28.9.2020

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020 "PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, neneve 30 dhe 35, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, dhe vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre",

UDHËZOJ:

1. Në kreun VI, të udhëzimit nr. 1, datë 14.1.2020, të ndryshuar, pas pikës 5/2, shtohet pika 5/3 me këtë përmbajtje:

"5/3. Përjashtimisht, aplikimet për programet e studimit për vitin akademik 2021–2022, do të pranohen deri më 31 dhjetor të vitit 2020" .

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Evis Kushi

UDHËZIM
Nr. 25, datë 1.12.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019, "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

a) kudo në përmbajtje të udhëzimit, togfjalëshi "në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi", zëvendësohet me togfjalëshin "sipas kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik".

b) në pikën 18 të kreut IV/4, togfjalëshi "... brenda datës 30 nëntor ...", zëvendësohet me togfjalëshin "... brenda datës 15 dhjetor ...".

c) pika 1 dhe 1.1 të kreut V, ndryshojnë, si më poshtë:

"1. IAL-të dorëzojnë në QSHA, në formë shkresore dhe elektronike:

a) brenda datës 30 nëntor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".

b) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar me transferim studimesh dhe program të dytë studimi në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".

c) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe të studentëve që i përkasin pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit.

d) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve shtetas të huaj në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit.

e) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të dytë të studimeve, "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve", për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".

f) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar me transferim studimesh dhe program të dytë studimi në programet e ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".

g) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të tretë të studimeve, "Master ekzekutiv", për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit.".

d) Pas pikës 4, të kreut V, shtohet pika 4/1, me përmbajtje si më poshtë:

"4/1. Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, përjashtimisht për vitin akademik 2020–2021, ngarkohen të ndryshojnë kalendarin, për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, "Master profesional"/"Master i shkencave"/"Master i arteve", për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit me transferim studimesh dhe program të dytë studimi në programet e ciklit të dytë të studimeve, si dhe për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit, në programet e ciklit të tretë të studimeve "Master Ekzekutiv", deri në datë 15.12.2020.".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

UDHËZIM

Nr. 26, datë 7.12.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 3.8.2016, "PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË VENDIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 91, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në pikën 5.4, të kreut IV, të udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

"5.4 Për njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë ngrihen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsim, komisione *ad hoc*, sipas fushave përkatëse me pedagogë ekspertë të fushës së kategorisë "profesor", të cilat mblidhen në varësi të numrit të aplikimeve dhe shqyrtojnë dosjet përkatëse. Kryetar i komisionit është ministri përgjegjës për arsimin. Komisioni përkatës nuk mund të mblidhet më vonë se 30 ditë kalendarike pas njoftimit për shqyrtimin e një aplikimi. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit, komisioni firmos procesverbalin dhe ministri përgjegjës për arsimin lëshon vërtetimin për njohjen e gradës shkencore apo titullit akademik.".

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe komisionet *ad hoc*.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Evis Kushi

UDHËZIM

Nr. 27, datë 23.12.2020

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020, "PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; të nenit 30 dhe 35, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; të vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre",

UDHËZOJ:

1. Pas pikës 5/3, të kreut VI, të udhëzimit nr. 1, datë 14.1.2020, të ndryshuar, shtohet pika 5/4 me përmbajtjen si më poshtë:

"5/4 Përjashtimisht, aplikimet për programet e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë", për vitin akademik 2021–2022, do të pranohen deri në 31 mars të vitit 2021.".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT

DHE RINISË

Evis Kushi

UDHËZIME 2021

UDHËZIM

Nr. 5, datë 3.3.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 30.3.2020 "PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE PËRBËRËS, FORMËN E DIPLOMËS OSE CERTIFIKATËS TË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE PROCEDURËS SË REGJISTRIMIT TË TYRE NË REGJISTRIN SHTETËROR TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR"

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 10 dhe 91, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

U D H Ë Z O J :

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 30.3.2020, bëhen këto ndryshime:

   a) Shkronja “m”, e pikës 1, të Kreut II, riformulohet si vijon:

   “*m) Numri i matrikullimit të ciklit paraardhës të studimeve në diplomat e ciklit të dytë dhe të tretë/ Numri i regjistrit që gjendet në vërtetimin e njësimit të diplomës, për diplomat që janë lëshuar jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe ID e Maturës Shtetërore/ Numri i dokumentit të njëvlershmërisë së dëftesës/diplomës së arsimit të mesëm të lartë që është lëshuar jashtë Republikës së Shqipërisë (numri i regjistrit veçantë për studentët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë para vitit 2006) në diplomat "Bachelor", diplomat ose certifikatat profesionale dhe diplomat "Master i shkencave" të programeve të integruara të studimeve;”.*

   b) Shkronja “n”, e pikës 1, të Kreut II, riformulohet si vijon:

   “n) Numri i diplomës së studimeve universitare të përfunduara më parë për diplomat e ciklit të dytë dhe të tretë/Numri i regjistrit që gjendet në vërtetimin e njësimit të diplomës;”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Evis KUSHI

UDHËZIM

Nr. 7, datë 31.3.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020 "PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 30 dhe 35 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, vendimit nr. 418, datë 10.05.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre" dhe vendimit nr. 112, datë 23.02.2018, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"", i ndryshuar,

U DH Ë Z O J:

1. Germa "E" e Kreut IV të udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

   "E. "DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR HAPJEN / RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"

   1. *IAL-ja ngarkon në platformën e-Albania, sipas formularit përkatës në platformën e-Albania, mbështetur në shtojcën nr. 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij , aplikimin për hapjen/riorganizimin e programit të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore "Doktor", brenda datës 30 shtator për vitin akademik pasardhës.*

   2. *MASR-ja, brenda një afati 60-ditor nga data e aplikimit njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.*

   3. *Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR, IAL-ja, brenda 15 ditëve, ngarkon elektronikisht dokumentacionin e mëposhtëm:*
      a) *Propozimin e njësisë bazë ku do të ofrohet programi i studimit;*
      b) *Projektin kërkimor-shkencor dhe zhvillimit;*
      c) *Vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton hapjen/riorganizimin e programit/eve të studimit. Në rast se propozimi vjen nga një institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkon financim nga buxheti i shtetit depozitohet miratimi paraprak i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit*

të Lartë (AKFAL). Në rast financimi nga vet IAL-ja, në vendimin e Bordit të Administrimit të IAL-së duhet të jetë e shprehur qartësisht që masa e financimit të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit do të mbulohet nga të ardhurat e IAL-së dhe nuk do të kërkohet financim shtesë nga buxheti i shtetit (për IAL-të publike).

Aktin e miratimit të financimit të projekteve kërkimore-shkencore nga AKKSHI-ja, (në rast se ka).

d) *Mandatpagesën për tarifën që paguhet për vlerësimin paraprak nga ekspertët e jashtëm te caktuar sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 109/2017, të ndryshuar.*

e) *Dokumentin e grupimit të njësive bazë (akt marrëveshje/akt i organeve kolegjiale, për grupimin e departamenteve/qendrave kërkimore-shkencore) në institucionin e arsimit të lartë, në rast grupimi sipas fushave e nënfushave, të ngjashme ose të përafërta, referuar standardeve ndërkombëtare të përcaktuara në propozimin e programit (IAL-të mund t'i referohen nënfushave të parashikuara në Manualin e FRASCAT-it, ISCED, etj.)*

f) *Deklarim për kapacitetet infrastrukturore, si vijon:*
   i. *Lista e laboratorëve shkencorë të akreditуar ose jo;*
   ii. *Lista e bibliotekave të profilizuara dhe kapaciteti fizik i tyre, i shprehur në vende/poste pune-kërkimi;*
   iii. *Lista e arkivave dhe e koleksioneve shkencore;*
   iv. *Lista e abonimeve në revista apo e botimeve shkencore periodike, përshirë dhe ato elektronike.*

g) *Deklarim për kapacitetet akademike, si vijon:*
   i. *Lista e personelit akademik të njësisë bazë, apo grupimit të njësive sipas fushave, i kategorisë "Profesor", në momentin e paraqitjes së aplikimit, dëshmitë e titujve akademikë dhe kontratat e punës.*
   ii. *Letër angazhimin e personelit akademik me tituj, të njësisë bazë, si drejtues shkencor për udhëheqjen e doktorantëve për programet e studimit të doktoratës.*

h) *Rregullore e programit të studimeve të doktoratës, e cila përfshin planin e programit të studimit të doktoratës. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese.*

j) *Në rast bashkëpunimi me një institucion tjetër vendas ose të huaj të arsimit të lartë për hapjen/riorganizimin e programeve të përbashkëta të studimit të doktoratës, së bashku me dokumentacionin e mësipërm, kërkohet depozitimi në gjuhë shqipe, i përkthyer dhe njehsuar me origjinalin të dokumenteve si më poshtë:*

   i. *akti i akreditimit të institucionit partner;*

ii. *dokumenti zyrtar i bashkëpunimit (marrëveshje kuadër), ku parashikohet ofrimi i programeve të përbashkëta të studimit;*
iii. *marrëveshja specifike për programin konkret të studimit, ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij.*
iv. *lloji dhe modeli i diplomës i miratuar nga IAL-të.*

4. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për hapjen/riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore "Doktor":

a) Shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të mësipërm realizohet në MASR, brenda 21 ditëve nga depozitimi. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR-ja i kërkon IAL-së që të bëjë plotësimin/saktësimin e dokumentacionit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Në mungesë të plotësimit të dokumentacionit brenda këtij afati, konsiderohet se subjekti ka hequr dorë në heshtje nga aplikimi dhe praktika arkivohet.

b) Në rast se dokumentacioni konsiderohet i plotë, dokumentacioni i kalon për vlerësim ekspertëve të caktuar nga MASR-ja, sipas fushave të ekspertizës dhe të zgjedhur nga lista vjetore e ekspertëve të miratuar nga ASCAL-ja, të caktuar me urdhër të ministrit. Ekspertët, brenda 21 ditëve, dorëzojnë raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni vlerësohet nga ekspertët se është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, institucionit i kërkohet plotësimi i tij brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit. Në mungesë të plotësimit të dokumentacionit, brenda këtij afati, konsiderohet se subjekti ka hequr dorë në heshtje nga aplikimi dhe praktika arkivohet.

c) Dokumentacioni i plotësuar i kalon për rivlerësim ekspertëve, të cilët, brenda 15 ditëve, dorëzojnë raportin e rivlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është përsëri i paplotë, praktika arkivohet.

d) Pas vlerësimit përfundimtar pozitiv nga ekspertët, ministri miraton me urdhër hapjen/ riorganizimin e programit të studimit.

2. Pas Kreut IV/E, shtohet Kreu IV/F me këtë përmbajtje:

"F. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR VERIFIKIMIN E KAPACITETEVE AKADEMIKE DHE INFRASTRUKTURORE PAS MIRATIMIT PËR HAPJEN /RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR".

1. Një vit pas hyrjes në fuqi të aktit të hapjes/riorganizimit së programit të studimit të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore "Doktor", IAL-ja dërgon zyrtarisht në MASR aplikimin, së bashku me dokumentacionin shoqërues, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij, për verifikimin e kapaciteteve, 3 (tre) muaj kalendarik, përpara fillimit të vitit akademik përkatës, për certifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore për këtë program studimi nga ana e MASR-së.

Informacioni i kërkuar mbi bazën e formularit të aplikimit është si më poshtë:

a) Vendimin e Senatit Akademik për përcaktimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore për programet e studimit të ciklit të tretë, për fitimin e gradës shkencore "Doktor".
b) Listën e projekteve kërkimore-shkencore dhe zhvillimit që ndjek njësia bazë.
c) Numrin dhe listën e personelit akademik të përfshirë në këto projekte dhe sipas studentëve doktorantë, sipas përcaktimeve të nenit 65 të ligjit nr. 80/2015.
d) Ndryshimet në kapacitetet akademike dhe infrastrukturore për përfshirjen në programet e studimit të doktoratës që nga momenti i hapjes/riorganizimit të programit.
e) Si dhe çdo të dhënë/dokument të përcaktuar në shtojcën nr. 4 të udhëzimit.

2. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për certifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore pas hapjes/riorganizimit të programeve të studimit të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore "Doktor":

a) MASR shqyrton dokumentacionin për verifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore mbi bazën e informacionit të paraqitur nga IAL, për kapacitetet infrastrukturore të vënë në dispozicion të projektit dhe kapaciteteve të personelit akademik të përfshira në projektin përkatës.

b) MASR shqyrton kërkesën brenda 30 ditëve dhe certifikon këto kapacitete, nëse janë në përputhje me standardet shtetërore.

3. Në kreun VI, pika 5.4 të ndryshojë si më poshtë:

"Përjashtimisht, aplikimet për programet e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" për vitin akademik 2021–2022, do të pranohen deri në 30 Prill 2021.".

4. Pas shtojcës nr.2, shtohen shtojca nr.3 dhe nr.4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTRI

Evis KUSHI

SHTOJCA NR. 3

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

PROPOZIMI PËR HAPJEN/RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"

<table>
<tr><td>1. Institucioni /IAL</td><td>2. Aplikimi (zgjidh një):
Program i ri _____
Riorganizim programi _____</td></tr>
<tr><td colspan="2">3. Emërtimi i programit të propozuar për hapje/riorganizim
Fusha kryesore e kërkimit :_____
Nënfusha sipas standardeve ndërkombëtare të kërkimit/ shkenca: Doktoratë në "_____"</td></tr>
<tr><td colspan="2">4. Viti akademik i hapjes (në rast të aplikimit për riorganizimin e programit të studimit)</td></tr>
<tr><td>5. a) Të dhënat për aktin e hapjes/riorganizimit / akreditimit të IAL dhe/ ose njësisë kryesore që ofron programin e studimit
b) Të dhëna për aktet e hapjes/riorganizimit/akreditimit të programeve të cikleve të parë dhe të dytë në fushën e studimit të programit të doktoratës</td><td>6. Vendimi i miratimit nga Senati Akademik
Nr._____, datë _____
Vendimi i miratimit nga Bordi i Administrimit Nr.____, datë_____</td></tr>
<tr><td colspan="2">7. Nëse është një program i përbashkët, cito aktin e bashkëpunimit ndërmjet IAL-ve dhe marrëveshjen specifike për realizimin e programeve të studimit të doktoratës.</td></tr>
<tr><td colspan="2">8. Organizimi i Programit:
- Programi ofrohet nga një njësi bazë/ grupimi i njësive:
Njësia/të bazë _____
Njësia Kryesore _____
Kampusi/ godina _____
- Program i përbashkët i ofruar nga disa njësi bazë:</td></tr>
</table>

Njësia/Njësitë bazë _____

Njësia/të kryesore _____

Kampusi/ godina _____

9. Të dhënat për Koordinatorin e Doktoratës:

1. **Emër, Mbiemër**:
   Pozicioni në IAL:
   Tel:
   E-mail:

10. Deklaratë e titullarit të IAL për plotësimin e standardeve akademike dhe infrastrukturore, të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

11. Firma (emër, mbiemër) e titullarit të institucionit dhe vula e institucionit.

REKTORI

Prof. Dr. _____

Data _____ **Firma, vula**

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT KËRKIMOR –SHKENCOR DHE ZHVILLIMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS PËR HAPJE/RIORGANIZIM

Institucioni i arsimit të lartë: Universiteti/Akademia _____

I. TË DHËNA MBI PROGRAMIN ZHVILLIMOR STUDIMEVE TË DOKTORATËS

Të dhëna të përgjithshme

Emërtimi i programit të studimeve të doktoratës	Doktoratë në fushën/nënfusha sipas standardeve ndërkombëtare
Cikli i studimeve:	Cikli i tretë
Lloji i programit:	Doktoratë
Njësia bazë	
Njësia kryesore	
Studimi me kohë normale, shprehur në vite:	3 -5
Studimi kohë të zgjatur, shprehur në vite:	5
Gjuha e studimit:	

II. TË DHËNA TË DETAJUARA TË PROGRAMIT ZHVILLIMOR TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS

1. Përshkrimi

Informacion i detajuar rreth programit,

- argumentimi pse duhet të hapet/riorganizohet,
- përshkrimi i kontekstit të fushës së kërkimit shkencor,
- të argumentohet rëndësia e fushave të kërkimit me nevojat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare,
- të pasqyrohen të dhënat për burimet e veçanta që ka institucioni,
- të pasqyrohen të dhënat për kapacitetet maksimale pritëse për këtë program,
- përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të programit,
- analiza SËOT e aplikimit për hapjen/riorganizimit e programit të studimit.

2. Të dhëna mbi kriteret e pranimit në këtë program, tarifa dhe modalitete financiare:

- Kriteret e pranimit në programin e studimit.
- Kosto e studimeve të doktoratës dhe tarifa e studimit të përcaktuar me vendim të Bordit të Administrimit.
- Politika e mbështetjes financiare për doktorantët nëse ka.

3. Elementët e planit vjetor të programit të studimit të doktoratës bazuar në projektin kërkimor- shkencor dhe zhvillimit të financuar të njësisë bazë

a) Koha e realizimit te veprimtarive të kombinuara, kur programet e studimit të doktoratës zhvillohen me kohë të plotë, sipas kohëzgjatjes normale të studimit nga 3 deri në 5 vite, bëhet sipas planit doktoral të miratuar nga njësia bazë përgjegjëse.
b) Koha e realizimit të veprimtarive të kombinuara, kur programet e studimit të doktoratës zhvillohen me kohë të zgjatur, sipas kohëzgjatjes normale të studimit 5 vite, bëhet sipas planit doktoral të miratuar nga njësia bazë.

4. Personeli akademik për realizimin e programit

Numri total i personelit akademik të angazhuar ___

Numri total i personelit akademik të angazhuar. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar" dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë dhe të respektojnë përcaktimet e nenit 65 të ligjit nr.80/2015. Ky numër përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik i kategorisë "Profesor" ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar.

Nr.	Personeli akademik	Titulli akademik dhe fusha e ekspertizës (Prof./Prof. As.) gradë shkencore në:	Institucioni	Njësia/ grupi i njësive bazë	Lloji i angazhimit
1					
2					
3					

5. Programet e Përbashkëta

Ky seksion plotësohet vetëm nëse programi i propozuar ofrohet në bashkëpunim me një institucion tjetër duke përfshirë edhe një përshkrim të nivelit të bashkëpunimit, duke iu përgjigjur elementëve të mëposhtëm:
- Burimet financiare dhe kontributi i partnerëve.
- Vënia në dispozicion e burimeve nga partnerët.
- Administrimi i programit.
- Modeli dhe lloji i diplomës (diplomë e përbashkët/e dyfishtë/e shumëfishtë).
- Të dhëna mbi aktin e themelimit/licencimit të institucionit partner në vendin e origjinës.
- Të dhëna mbi aktin e akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit.
- Dokument zyrtar bashkëpunimi mes palëve, marrëveshja kuadër.
- Marrëveshja specifike për programin konkret të studimit.

6. Analizë e prioriteteve të kërkimit shkencor

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm: - Argumentim i nevoja të hulumtimit, kërkimit shkencor, inovacionit, të thelluar në këtë fushë. - Marrëveshje me institucione publike dhe jo publike të cilat mund të asistojnë kërkimin shkencor.

SHTOJCA NR. 4

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

APLIKIM PËR VERIFIKIMIN E KAPACITETEVE AKADEMIKE DHE INFRASTRUKTURORE, PAS HAPJES/RIORGANIZIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË DOKTORATËS "____",

1. Institucioni /IAL	Program i studimit doktoratë në_____,
2. Viti akademik i aktivizimit të programit dhe numri i doktorantëve të regjistruar sipas viteve akademike (detajuar me kohe të plotë dhe me kohë të zgjatur) 3. Fusha kryesore e kërkimit :_____ Nënfusha e kërkimit: Doktoratë në "_____" 4. Të dhëna nëse programi ka financim nga AKKSHI apo institucioneve të tjera financuese	
5. Të dhënat për aktin e hapjes/akreditimit të IAL dhe të programit e studimit	6. Listën e projekteve/projektet kërkimore-shkencore dhe zhvillimit që zhvillohen nga njësia bazë, mbi bazë të së cilës janë ndërtuar projektet individuale të doktorantëve

	7. Përcaktimi i numrit të studentëve doktorantë nga njësia bazë për vitin akademik respektiv 8. Të dhëna mbi Vendimin e Senatit Akademik për numrin e projekteve të doktoratës të iniciuar nga IAL-ja dhe numrin e studentëve të përfshirë në to dhe atyre që do të përfshihen.

9. Nëse është një program i përbashkët, cito aktin e bashkëpunimit ndërmjet IAL-ve dhe marrëveshjen specifike për realizimin e programeve të studimit të doktoratës dhe për përcaktimin e numrit të doktorantëve

10. Organizimi i Programit:

- Programi ofrohet nga:

Njësia bazë _____

Njësia Kryesore _____

Kampusi/ godina _____

- **Program i përbashkët i ofruar nga disa njësi bazë:**

Njësia/Njësitë bazë _____

Njësia Kryesore _____

Kampusi/ godina _____

11. **Të dhënat për Koordinatorin e Doktoratës:**

Emër, Mbiemër:
Pozicioni në IAL:
Tel:
E-mail:

12. **Deklaratë e titullarit të IAL për plotësimin e standardeve akademike dhe infrastrukturore, të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.**

13. **Firma (emër, mbiemër) e titullarit të institucionit dhe vula e institucionit.**

REKTORI

Prof. Dr. _____

Data _____ **Firma, vula**

TË DHËNA MBI PROGRAMIN E STUDIMEVE TË DOKTORATËS

1. Të dhëna të përgjithshme:

Emërtimi i programit të studimeve të doktoratës	Doktoratë në fushën/nënfusha sipas standardeve ndërkombëtare
Cikli i studimeve:	Cikli i tretë
Lloji i programit:	Doktoratë
Njësia bazë	
Njësia kryesore	
Studimi me kohë të plotë, shprehur në vite:	3 -5
Studimi kohë të zgjatur, shprehur në vite:	5
Gjuha e studimit:	
Numri i studentëve aktiv në këtë program studimi, sipas viteve akademike:	

2. Të dhëna mbi kostot, tarifa dhe modalitete financiare:

- Kosto e studimeve të doktoratës dhe tarifa e studimit të përcaktuar me vendim të Bordit të Administrimit.
- Politika e mbështetjes financiare për doktorantët nëse ka.
- Lista e projekteve individuale.

3. Personeli akademik i angazhuar për realizimin e programit.

Numri total i personelit akademik të angazhuar. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar" dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë dhe të respektojnë përcaktimet e nenit 65 të ligjit nr.80/2015. Ky

numër përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik i kategorisë "Profesor" ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar.
Për ndryshimet në personelin akademik, IAL dërgon kopje të dëshmisë për fitimin e titullit, diplomës së gradës shkencore dhe kontratën e punës.

Të jepen të dhëna për ndryshimet në kapacitetet akademike dhe infrastrukturore për përfshirjen në programin e doktoratave që nga momenti i hapjes/riorganizimit të programit.

Në tabelë duhet të evidentohen numri dhe lista e personelit akademik të përfshirë në projektet e reja individuale sipas numrit të studentëve të miratuar.

Nr.	Personeli akademik	Titulli akademik dhe fusha e ekspertizës (Prof./Prof. As.) gradë shkencore në:	Institucioni	Njësia bazë ose grupimi i njësive sipas fushave	Lloji i angazhimit	Numri i doktorantëve që udhëheq
1						
2						
3						

4. Programet e Përbashkëta

Ky seksion plotësohet vetëm nëse programi i propozuar ofrohet në bashkëpunim me një institucion tjetër duke përfshirë edhe një përshkrim të nivelit të bashkëpunimit, duke iu përgjigjur elementëve të mëposhtëm: - Burimet financiare dhe kontributi i partnerëve për vitin akademik respektiv. - Vënia në dispozicion e burimeve nga partnerët. - Administrimi i programit. - Marrëveshja specifike për përcaktimin e numrit të doktorantëve për vitin akademik

5. Deklarim për kapacitetet infrastrukturore për zhvillimin e programit të studimit

(Në këtë rubrikë evidentohen në mënyrë narrative ndryshimet në kapacitete)

Lista e laboratorëve shkencorë të akreditуar ose jo;	
Lista e bibliotekave të profilizuara dhe kapaciteti fizik i tyre, i shprehur në vende/poste pune-kërkimi;	
Lista e arkivave dhe e koleksioneve shkencore;	

Lista e abonimeve në revista apo e botimeve shkencore periodike, përshirë dhe ato elektronike.	

6. Të dhëna mbi institucionet bashkëpunuese ku kryhet kërkimi shkencor i doktorantëve

UDHËZIM

Nr. 11, datë 2.6.2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019, "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin

e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Pika 9, e germës C, të kreut II, të udhëzimit nr. 10, datë 15.5.2019, të ndryshuar, riformulohet si më poshtë:

"9. Kuotat e paplotësuara, në përfundim të raundit të parë për çdo program studimi, mund të përshtaten nga IAL-ja në programe të tjera studimi të të njëjtit cikël, të ofruara brenda së njëjtës njësi kryesore, pa kaluar totalin e kuotave për njësi kryesore dhe njofton zyrtarisht MASR-në për vendimin e senatit akademik mbi përshtatjen e kuotave të programeve të studimit jo më vonë se 3 (tri) ditë pune nga data e fillimit të aplikimit për regjistrim nga kandidati për raundin e dytë. Në rast se përshtatja e kuotave është sipas përcaktimeve ligjore, MASR-ja njofton IAL-të, RASH-in dhe QSHA-në, për konfirmimin e përshtatjes së kuotave para fillimit të periudhës së aplikimit për raundin e dytë.".

2. Pas pikës 4, të germës E, të kreut II të udhëzimit, shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

"4/1. Kuotat e paplotësuara në përfundim të raundit të dytë, për çdo program studimi, mund të përshtaten nga IAL-të në programe të tjera studimi të të njëjtit cikël të ofruara brenda së njëjtës njësi kryesore, pa kaluar totalin e kuotave për njësi kryesore dhe njofton zyrtarisht MASR-në për vendimin e senatit akademik mbi përshtatjen e kuotave të programeve të studimit, jo më vonë se 3 (tre) ditë pune nga data e fillimi të aplikimit për regjistrim nga kandidati për raundin e dytë. Në rast se përshtatja e kuotave është sipas

përcaktimeve ligjore, MASR-ja njofton IAL-të, RASH-in dhe QSHA-në, për konfirmimin e përshtatjes së kuotave para fillimi të periudhës së aplikimit për raundin e tretë.”.

3. Në fund të pikës 7, seksioni G, kreu III, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Pas përfundimit të 3 fazave 48-orëshe të regjistrimit të raundit të tretë, IAL-të nuk mund të bëjnë më përshtatje të kuotave të paplotësuara të një programi studimi në programe të tjera studimi të të njëjtit cikël të ofruara brenda të njëjtës njësi kryesore.”.

4. Pika 16 e kreut IV/1, 15 e kreut IV/2, germa “f”, e pikës 13 të kreut IV/3, pikat 16 e kreut IV/4, 23 e kreut IV/5, 16 e kreut IV/6, ndryshojnë si më poshtë:

“IAL-të, brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, dërgojnë pranë QSHA-së, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format *Excel,* me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. IAL-të nuk duhet të dërgojnë në QSHA të dhënat e asnjë kandidati pas kësaj date. Për të gjithë emrat kandidatëve të dërguar pas kësaj date ose që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi, nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja duhet të kërkojë nga IAL-ja, duke njoftuar edhe kandidatin, çregjistrimin e tyre dhe konfirmimin me shkresë zyrtare brenda një afati 10-ditor për kryerjen e procesit të çregjistrimit të kandidatit nga IAL-ja.

5 Kudo në përmbajtje të udhëzimit nr. 10, datë 15.5.2019, të ndryshuar, togfjalëshi “... përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi” të zëvendësohet me togfjalëshin”... përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik”.

6. Shtojca nr. 10 shfuqizohet.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe IAL-të publike dhe jopublike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Evis Kushi

UDHËZIM
Nr. 20, datë 30.9.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020, "PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; nenet 30 dhe 35, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre"; dhe vendimit nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë 'Profesor i asociuar' dhe 'Profesor'", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 1, të kreut IV/A dhe pikën 1, të kreut IV/B, të udhëzimit nr. 1, datë 14.1.2020, të ndryshuar, togfjalëshi "brenda datës 30 shtator", të zëvendësohet me "brenda datës 30 nëntor".
2. Në pikën 1, të kreut IV/E, të udhëzimit nr. 1, datë 14.1.2020, të ndryshuar, togfjalëshi "brenda datës 30 shtator", të zëvendësohet me "brenda datës 31 dhjetor".
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

UDHËZIM
Nr. 21, datë 15.10.2021

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË, TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONE TË HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 6, të nenit 92, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet

e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të "Diplomave profesionale/certifikatave profesionale", diplomave "Bachelor", diplomave "Master i shkencave", "Master i arteve" dhe "Master profesional", "Master ekzekutiv", "Diploma të specializimit afatgjatë", të fituar jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë, Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, është Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

2. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të gradës shkencore "Doktor", të fituar në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, si dhe për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë, Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, është ministria përgjegjëse për arsimin, nëpërmjet komisioneve përkatëse. Sekretariati teknik për këtë shërbim ndodhet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

3. Njohja dhe njësimi, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes, ka për qëllim njohjen e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Republikën e Shqipërisë.

4. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm, kanë këto kuptime:

a) "Kualifikimi" është një rezultat formal i një procesi vlerësimi dhe vlefshmërie, i përfituar prej një organi kompetent/institucioni arsimor, të akredituar, që përcakton se individi ka arritur një nivel të caktuar njohurish, aftësish dhe kompetencash në përputhje me një standard të dhënë;

b) "Korniza Shqiptare e Kualifikimeve", në vijim (KSHK), sipas përcaktimeve ligjore "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve" është një sistem kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve, sipas një tërësie kriteresh, për nivele specifike të të nxënit të përftuar, që ka për qëllim integrimin dhe koordinimin e nënsistemeve kombëtare të kualifikimeve dhe përmirësimin e transparencës, aksesit, përparimit dhe cilësisë së kualifikimeve, që lidhen me tregun e punës dhe shoqërinë civile;

c) "Korniza Evropiane e Kualifikimeve", në vijim (KEK), sipas përcaktimeve ligjore "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", është një kornizë, që përmban 8 nivele, të miratuara nga Parlamenti Evropian, për të ndihmuar vendet dhe sektorët të krahasojnë kualifikimet, të përmirësojnë njohjen e ndërsjellë dhe të nxisin lëvizjen gjeografike, si dhe të nxënit gjatë të gjithë jetës;

ç) “Institucione të autorizuara” janë institucione kompetente, të cilat nuk janë institucione të arsimit të lartë, por lëshojnë diploma/certifikata profesionale, diploma të arsimit të lartë të vlefshme në vendin e origjinës, që vërtetojnë përfundimin e studimeve, konform kuadrit ligjor në fuqi të vendit përkatës;

d) “Rrjeti Evropian i Qendrave Kombëtare të Informacionit (ENIC-NARIC)” është një rrjet me qendra kombëtare, i ngritur për të mbështetur institucionet dhe qytetarët me njohjen e kualifikimeve akademike. QSHA-ja shërben si qendra kombëtare e rrjetit ENIC/NARIC për informimin dhe njohjen e diplomave për Republikën e Shqipërisë;

dh) “Refugjat” është shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë për të kërkuar mbrojtjen e atij vendi apo kthimin në atë vend, si pasojë e këtyre rrethanave, në përputhje me kriteret e nenit 1 (A) të Konventës së Gjenevës;

e) “Person i zhvendosur” është çdo person, i cili është detyruar të largohet nga shteti, shtetësinë e të cilit kanë, ose nga vendi ku kanë rezidencën e zakonshme/vendin e banimit të zakonshëm për të shmangur konfliktet e armatosura, dhunën, shkeljen e të drejtave të njeriut, fatkeqësitë natyrore, ose të shkaktuara nga njeriu, të cilët nuk kanë kaluar kufijtë e një shteti ndërkombëtarisht të njohur;

f) “Persona të ngjashëm me refugjatët” është çdo person, i cili ndodhet *de facto* në një situatë të ngjashme me atë të refugjatit, personave të zhvendosur, pavarësisht statusit të tyre ligjor;

g) “Kualifikim i dokumentuar në mënyrë jo të përshtatshme” është kualifikimi i fituar nga mbajtësi i tij, i cili nuk mund të vërtetohet nëpërmjet dokumenteve të nevojshme;

5. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë nuk shqyrton aplikimet për rastet si më poshtë:

a) diploma/certifikata profesionale, diploma, grada shkencore, për programe studimi të ndjekura në Republikën e Shqipërisë;

b) diploma/certifikata profesionale, diploma, grada shkencore për programe studimi të hapura/licencuara si programe studimi *online,* sipas përcaktimit të diplomës/suplementit/ dokumentacionit zyrtar të lëshuar nga institucioni që ka lëshuar diplomën;

c) dokumente për programe studimi të papërfunduara, që nuk përmbushin kushtet për të qenë diploma/certifikata profesionale, diploma, grada shkencore, të niveleve 5, 6, 7 dhe 8, sipas përcaktimeve të legjislacionit të vendit të origjinës dhe legjislacionit shqiptar. Këto dokumente shqyrtohen nga institucioni i arsimit të lartë pranë të cilit aplikohet për transferim studimesh;

ç) certifikata/dëshmi për kurse kualifikimi ose plotësuese, si gjuhë e huaj, kompjuter etj.;

d) certifikata, diploma dhe grada ushtarake të fituara në institucione ushtarake të arsimit të lartë, përjashtuar diplomat për drejtime civile të studimeve. Personat që zotërojnë certifikata, diploma dhe grada ushtarake të fituara në institucione ushtarake të arsimit të lartë, në funksion të ushtrimit të së drejtës për punësim në institucione me karakter ushtarak, i drejtohen institucioneve përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë për fushën ushtarake, për njohjen dhe njësimin e tyre, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) diploma/certifikata profesionale, diploma dhe grada shkencore të fituara në institucione fetare të arsimit të lartë, përjashtuar diplomat me drejtim civil studimi.

Për rastet e përmendura në këtë pikë të udhëzimit, aplikanti njoftohet zyrtarisht për mos shqyrtimin e aplikimit.

6. Kriteret që duhet të përmbushë diploma/certifikata profesionale dhe grada shkencore për t'u njohur dhe njësuar janë:

a) të jetë lëshuar nga institucione të licencuara, të njohura dhe/ ose të akredituara të arsimit të lartë në vendin e origjinës;

b) programi i studimit në përfundim të të cilit lëshohet diploma/certifikata profesionale apo diploma të jetë i njohur/akredituar në datën e lëshimit të saj;

c) certifikata apo diploma të jetë e vlefshme në vendin e origjinës;

ç) certifikata apo diploma të jetë autentike.

7. Informacioni paraprak mbi institucionet e arsimit të lartë që ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me standardet përkatëse të vendit të origjinës mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Rrjetit Evropian të Qendrave Kombëtare të Informacionit (ENIC-NARIC). Në lidhje me dhënien e informacionit për të interesuarit për sistemin dhe institucionet e arsimit të lartë, si dhe kualifikimet e lëshuara prej tyre në Republikën e Shqipërisë institucion përgjegjës është QSHA-ja.

KREU II
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI

1. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, si dhe titujve akademikë kryhet *online* nëpërmjet portalit e-Albania.

2. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar duhet të depozitohet detyrimisht në formatin elektronik gjatë aplikimit *online*, si dhe të dërgohet brenda 5 (pesë) ditëve nga data e aplikimit *online* edhe në rrugë postare sipas përcaktimeve të mëposhtme.

3. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve akademike që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare ose Evropiane të Kualifikimeve, përveç gradës shkencore "Doktor", kryhet *online* sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet *online* në portalin e-Albania, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij;

b) aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) dokumentacionin e mëposhtëm:

i. diplomën/certifikatën profesionale, diplomën ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

ii. suplementin e diplomës dhe/ose listën e notave, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);

iv. mandatpagesën ose konfirmimin e pagesës *online*, sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur

këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3.1 Në rrugë postare, pas kryerjes së aplikimit *online*, dërgohet në QSHA, dokumentacioni i specifikuar në pikën 3/a, 3/b/i dhe 3/b/ii, të kreut II, të këtij udhëzimi.

4. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore "Doktor" kryhet *online,* sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet *online* në portalin e-Albania, sipas shtojcës nr. 1;

b) aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) dokumentacionin e mëposhtëm:

i. diplomën dhe suplementin e saj (nëse ka të tillë), lëshuar nga institucioni përkatës i arsimit të lartë, që dëshmon fitimin e gradës shkencore "Doktor" ose dokumentin origjinal të barasvlershëm me diplomën në rastet kur ky përbën dokumentin zyrtar përkatës në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

ii. diplomën e studimeve pararendëse të arsimit të lartë dhe/ose vërtetimin e njësimit të diplomës i lëshuar nga institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë;

iii. disertacionin e doktoratës. Në rast se disertacioni është në gjuhë të huaj, aplikanti paraqet një përmbledhje në gjuhën shqipe;

iv. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);

v. mandatpagesën ose konfirmimin e pagesës *online,* sipas shtojcës nr. 2;

c) aplikanti duhet të depozitojë një kopje të disertacionit përkatës në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë (BKSH) dhe të paraqesë vërtetimin përkatës.

4.1 Në rrugë postare pas kryerjes së aplikimit *online*, dërgohet në QSHA, dokumentacioni i specifikuar në pikën 4/a, 4/b/i dhe 4/b/ii, të kreut II, të këtij udhëzimi.

5. Institucioni përgjegjës për njohjen në Republikën e Shqipërisë të titujve akademikë të fituar jashtë vendit, bazohet në kriteret dhe standardet shtetërore të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, në Republikën e Shqipërisë, për fitimin e titujve akademikë.

5.1 Aplikimi për njohjen e titujve akademikë kryhet *online* sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet *online* në portalin e-Albania, sipas shtojcës nr. 1;

b) aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) dokumentacionin e mëposhtëm:

i. dokumentin e fitimit të titullit akademik, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

ii. diplomën e studimeve pararendëse universitare, nëse kjo diplomë është fituar në Republikën e Shqipërisë ose kopje e doktoratës e noterizuar shoqëruar me vërtetimin e njohjes së gradës shkencore "Doktor" në Republikën e Shqipërisë, nëse studimet pararendëse janë ndjekur jashtë vendit;

iii. vërtetimin e regjistrimit të titullit akademik në bazën e të dhënave përkatëse në zbatim të kuadrit ligjor të vendit ku është fituar titulli akademik (nëse ky regjistrim është parashikuar nga legjislacioni përkatës i huaj);

iv. fotokopjen e kartës së identitetit apo pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);

v. mandatpagesën ose konfirmimin e pagesës *online,* sipas shtojcës nr. 2;

vi. deklaratën/skedën e nënshkruar në të cilin të jepet informacion për eksperiencën akademike në mësimdhënie; aktivitetin shkencor – lista e artikujve/botimeve shkencore,

pjesëmarrje në simpoziume, konferenca, kongrese shkencore të shoqëruar me titujt e materialeve të paraqitura; si dhe botime të punimeve shkencore në organe shkencore ndërkombëtare. Informacioni i parashikuar në këtë skedë duhet të shoqërohet me dokumentacionin provues përkatës.

5.2 Në rrugë postare, pas kryerjes së aplikimit *online*, dërgohet në QSHA, dokumentacioni i specifikuar në pikën 5/a dhe 5/b/i, të kreut II, të këtij udhëzimi.

KREU III
PROCEDURAT E NJOHJES DHE TË NJËSIMIT

1. Procedura e njohjes dhe njësimit, pas aplikimit *online*, e kualifikimeve akademike që i përkasin nivelit 5 deri në 8, përveç gradave shkencore "Doktor", të Kornizës Shqiptare ose Evropiane të Kualifikimeve vijon me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit nga ana e Komisionit të Njohjes së Diplomave në QSHA. Kjo procedurë, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, përfundon brenda 45 ditëve.

1.1 Sektori i Njohjes së Diplomave të Arsimit të Lartë (SENJOD) në QSHA shërben si sekretariat teknik i Komisionit të Njohjes së Diplomave.

1.2 Aplikimi nuk konsiderohet i plotë nëse mungon një nga dokumentet e cituara në këtë udhëzim.

Informimi për plotësim dokumentacioni bëhet me postë elektronike. Procedura e njohjes dhe e njësimit fillon menjëherë pasi QSHA-së i është shfaqur aplikimi në sistemin *online* në rastet kur dokumentacioni i ngarkuar në formë elektronike është i plotë sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

Brenda 3 (tri) ditëve nga fillimi i procedurës së njohjes dhe njësimit SENJOID kontakton me anë të postës elektronike me institucionin përgjegjës që ka lëshuar diplomën ose certifikatën përkatëse.

1.3 Në çdo rast, procedura e njohjes dhe njësimit nuk mund të përfundojë nëse aplikanti nuk paraqet në formatin shkresor dokumentacionin e parashikuar në këtë udhëzim, në QSHA.

1.4 Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacion, SENJOD-ja i kërkon aplikantit fillimisht plotësimin e dokumentacionit me anë të postës elektronike, brenda 15 ditëve nga momenti i depozitimit të aplikimit. Në rast të mos depozitimit të plotësimeve brenda 30 ditëve, aplikantit i kërkohen plotësime për herë të dytë me anë të postës elektronike, të cilat duhet të depozitohen brenda 30 ditëve në QSHA, në të kundërt, shqyrtimi i aplikimit përkatës ndërpritet dhe dokumentacioni arkivohet në QSHA.

1.5 SENJOD-ja llogarit afatet e përcaktuara në këtë udhëzim për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve, duke iu referuar datës së plotësimit të praktikës me të gjithë dokumentacionin e plotë.

2. QSHA-ja në zbatim të procedurës së verifikimit:

a) kërkon informacion nëse programi i studimit i përfunduar nga aplikanti në një institucion të huaj të arsimit të lartë apo institucion tjetër i autorizuar është i hapur/licencuar si program studimi *online;*

b) kërkon çdo informacion shtesë që e konsideron të nevojshëm për vlerësimin

objektiv për njohjen dhe njësimin e diplomës/certifikatës;

c) i kërkon përmes postës elektronike IAL-së përkatëse konfirmimin e autenticitetit, të paktën dy herë dhe në rast mospërgjigjeje, konfirmimi kërkohet me shkresë zyrtare (dërguar me postë zyrtare). Në rast se pas 1 viti nga momenti i kërkesës së konfirmimit me shkresë zyrtare, ende nuk ka një përgjigje nga IAL-ja, shqyrtimi i aplikimit përkatës ndërpritet dhe dokumentacioni arkivohet në QSHA. Aplikanti njoftohet për vendimin e komisionit mbi arkivimin e dokumentacionit.

Gjithashtu, konfirmimi kërkohet edhe nga institucionet e tjera përgjegjëse sipas rastit;

ç) QSHA-ja i referohet listës zyrtare të institucioneve të njohura/licencuara/ akredituara në vendin e origjinës të publikuar në faqet përkatëse zyrtare të rrjetit ENIC-NARIC dhe sipas rastit kërkon informacion pranë qendrave të rrjetit evropian të informimit dhe njohjes së diplomave (ENIC–NARIC) dhe institucioneve përgjegjëse të shteteve të tjera mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë, vlefshmërinë e diplomave apo certifikatave, nivelin e tyre sipas kornizës kombëtare apo evropiane të kualifikimeve, si dhe informacion tjetër shtesë në funksion të njësimit të diplomës. QSHA-ja shërben si qendra kombëtare e rrjetit ENIC/NARIC për informimin dhe njohjen e diplomave për Republikën e Shqipërisë;

d) materialet shkresore ose të printuara për të gjitha verifikimet e kryera, depozitohen në dosjen e aplikantit. Për verifikimet e kryera *online*, dokumentacioni i printuar firmoset nga nëpunësi që kryen verifikimet dhe depozitohet në dosjen e aplikantit.

3. Komisioni i Njohjes së Diplomave përbëhet nga tre anëtarë dhe drejtohet nga kryetari, i cili caktohet nga titullari i QSHA-së. Komisioni i Njohjes së Diplomave shqyrton, njeh dhe njëson kualifikimet akademike që i përkasin nivelit 5 deri në 8, përveç gradave shkencore "Doktor", në bazë të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë duke respektuar dhe parashikimet e kuadrit ligjor shqiptar në fuqi.

4. Në zbatim të parimit të barazisë dhe mos diskriminimit, bazuar në përcaktimet e shkronjës "b", të nenit 75 të pikës 2, të nenit 124, të ligjit nr. 80/2015:

a) Diplomat e fituara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë, përpara aplikimit të sistemit të Bolonjës në Shqipëri, të cilat e kanë datën e lëshimit të diplomës deri në vitin 2010, me kohëzgjatje normale minimale 4 (katër) vite (tetë semestra), me kohë të plotë, të njësohen si ekuivalentët e tyre që ofroheshin në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në të njëjtën periudhë kohore.

b) Diplomat e lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë, për programet e studimit të cilat përmbajnë të paktën 300 ECTS, me kohëzgjatje normale minimale 5 (pesë) vite akademike, të njësohen si ekuivalentët e tyre që ofrohen në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

5. Komisioni i Njohjes së Diplomave merr vendimin për njohje dhe njësim të certifikatës/diplomës ose mund të vendosë ta kthejë për plotësime të tjera të nevojshme të dokumentacionit te sekretaria teknike (SENJOD), sipas këtij udhëzimi. Sekretaria teknike (SENJOD) zbardh raportin dhe vendimin e Komisionit të Njohjes së Diplomave,

i cili lëshon vërtetimin e njohjes dhe njësimit për çdo aplikant, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij. Në rastet kur ky Komision nuk merr vendim për njohjen dhe njësimin e diplomës ose certifikatës, i kthen përgjigje të arsyetuar aplikantit për arsyet dhe mangësitë e aplikimit.

6. Për njohjen e gradave shkencore "Doktor" ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, Komisioni i Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNJG), i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin.

6.1 KNJG-ja përbëhet nga kryetari dhe nga një anëtar, për secilën prej fushave të studimit dhe kërkimit shkencor, pedagog i kategorisë "Profesor".

6.2 Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA shërben si sekretariat teknik i KNJG-së.

6.3 KNJG-ja mblidhet periodikisht në varësi të numrit të aplikimeve. Procedura për shqyrtimin e dosjeve nga KNJG-ja fillon në momentin që SENJOD-ja në QSHA vlerëson se janë të plota për shqyrtim dosjet për njohjen e gradës shkencore "Doktor", sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

6.4 Në përfundim të procedurave të shqyrtimit, kryetari dhe anëtarët e komisionit, nënshkruajnë procesverbalin dhe vendimin përkatës. Kryetari lëshon vërtetimin për njohjen e gradës shkencore, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

6.5 Procedura e njohjes dhe njësimit të gradës shkencore të fituar jashtë vendit, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, përfundon brenda 45 ditëve.

6.6 Përcaktimet e pikave 1.2 dhe 1.3, të kreut III, të këtij udhëzimit, lidhur me afatet procedurale, aplikohen edhe për aplikimet për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore të fituara jashtë vendit.

7. Për njohjen e titujve akademikë ngrihen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin komisione *ad hoc,* për secilin aplikim për njohje titulli akademik të fituar jashtë vendit, me pedagogë ekspertë të fushës përkatëse të kategorisë "Profesor". Komisionet *ad-hoc* për njohjen e titujve akademikë kryesohen nga ministri përgjegjës për arsimin dhe përbëhen nga kryetari dhe katër anëtarë.

7.1 Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA shërben si sekretariat teknik i komisioneve *ad hoc.*

7.2 Kërkesa për ngritjen e komisionit *ad hoc* kryhet nga Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA, menjëherë pas depozitimit të aplikimit për njohjen e titullit akademik të fituar jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.

7.3 Në përfundim të procedurave të shqyrtimit dhe vlerësimit, kryetari dhe anëtarët e komisionit *ad hoc* nënshkruajnë procesverbalin dhe vendimin përkatës. Nëse është vendosur njohja e titullit akademik, atëherë kryetari lëshon vërtetimin përkatës sipas shtojcës nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

7.4 Procedura e njohjes së titullit akademik të fituar jashtë vendit, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, përfundon brenda 45 ditëve.

7.5 Përcaktimet e pikave 1.2 dhe 1.3 të kreut III të këtij udhëzimit, lidhur me afatet procedurale, aplikohen edhe për aplikimet për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore të fituara jashtë vendit.

8. Komisioni i Njohjes së Diplomave në QSHA, KNJG-ja dhe komisionet *ad hoc*, për certifikata, diploma ose grada shkencore, si dhe tituj akademikë, interpretojnë dhe marrin vendim të argumentuar mbi njohjen ose jo, të mbështetur në legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, si edhe në praktikat më të mira të vendeve perëndimore.

9. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit, për diplomat që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ose Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (përveç gradave shkencore "Doktor") lëshohet i firmosur nga titullari i QSHA-së dhe kryetari i komisionit në dy kopje origjinale (njëra kopje i bashkëngjitet vendimit përkatës të Komisionit të Njohjes së Diplomave dhe ruhet në dosjen e aplikimit përkatës).

10. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit të certifikatave/diplomave të nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ose Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, me përjashtim të gradave shkencore, përmban minimalisht elementet e mëposhtme:

a) emrin, atësinë dhe mbiemrin e aplikantit;

b) institucionin e huaj të arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën;

c) shtetin përkatës;

ç) numrin e krediteve ECTS (nëse mund të përcaktohet);

d) emërtimin e plotë të programit të studimit;

dh) formën e studimit;

e) kohëzgjatjen e programit të studimit;

ë) datën e lëshimit të diplomës;

f) njohjen dhe njësimin e diplomës/certifikatës në Republikën e Shqipërisë.

11. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit të gradës shkencore "Doktor", sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij, përmban minimalisht elementet e mëposhtme:

a) emrin, atësinë dhe mbiemrin e aplikantit;

b) institucionin e huaj të arsimit të lartë që ka lëshuar gradën shkencore "Doktor";

c) shtetin përkatës;

ç) datën e fitimit të gradës shkencore "Doktor";

d) fushën e studimit;

dh) temën e disertacionit;

e) numrin dhe datën e vendimit të KNJG-së;

ë) numrin rendor të regjistrimit të gradës shkencore "Doktor" në regjistrin shtetëror të gradës shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit;

f) njohjen dhe njësimin e gradës shkencore "Doktor" në Republikën e Shqipërisë.

12. Vërtetimi i njohjes së titujve akademikë, përmban minimalisht elementet e mëposhtme:

a) emrin, atësinë dhe mbiemrin e aplikantit;

b) institucionin e huaj të arsimit të lartë që ka lëshuar titullin akademik;

c) emërtimin e titullit të fituar;

ç) shtetin përkatës;

d) datën e fitimit të titullit akademik;

dh) fushën e studimit;

e) numrin dhe datën e vendimit të komisionit *ad hoc*;

ë) numrin rendor të regjistrimit të titullit akademik në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit.

13. QSHA-ja është institucioni përgjegjës për mbajtjen dhe plotësimin e regjistrit shtetëror të njohjes dhe njësimit të diplomave dhe regjistrit shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë. Regjistrat mbahen në formatin *hard copy* dhe në atë elektronik.

QSHA-ja publikon listën emërore të personave të cilëve u janë njohur dhe njësuar diplomat në faqen e saj zyrtare të internetit.

KREU IV
NJOHJA E DIPLOMAVE TË PERSONAVE QË KANË STATUSIN E REFUGJATIT, PERSONAVE TË ZHVENDOSUR DHE PERSONAVE TË NGJASHËM ME REFUGJATËT

1. Për personat që kanë statusin e refugjatit, personit të zhvendosur dhe/ose personit të ngjashëm me refugjatin nuk zbatohen procedurat e parashikuara në kreun II të këtij udhëzimi.

2. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve akademike që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare ose Evropiane të Kualifikimeve, përveç gradës shkencore "Doktor", kryhet sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet në QSHA, sipas shtojcës nr. 1;

b) aplikanti dorëzon në QSHA dokumentacionin e mëposhtëm:

i. diplomën/certifikatën profesionale, diplomën ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

ii. suplementin e diplomës dhe/ose listën e notave, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës, ose dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet identiteti i tij;

iv. dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet që personi ka fituar statusin e refugjatit, person i zhvendosur dhe person i ngjashëm me refugjatët;

3. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore "Doktor", kryhet sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet në QSHA, sipas shtojcës nr. 1;

b) aplikanti dorëzon në QSHA dokumentacionin e mëposhtëm:

i. diplomën/certifikatën profesionale, diplomën ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

ii. suplementin e diplomës dhe/ose listën e notave, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës, ose dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet identiteti i tij;

iv. dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet që personi ka fituar statusin e refugjatit, person i zhvendosur dhe person i ngjashëm me refugjatët.

4. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e titujve akademik, kryhet sipas procedurës së mëposhtme:

a) formulari i aplikimit plotësohet në QSHA, sipas shtojcës nr. 1;

b) aplikanti dorëzon në QSHA dokumentacionin e mëposhtëm:

i. diplomën/certifikatën profesionale, diplomën ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

ii. suplementin e diplomës dhe/ose listën e notave, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës, ose dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet identiteti i tij;

iv. dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet që personi ka fituar statusin e refugjatit, person i zhvendosur dhe person i ngjashëm me refugjatët.

5. Refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët, të cilët paraqesin dokumentacion të pjesshëm, ose nuk mund të paraqesin dokumente për të vërtetuar kualifikimet e tyre dhe/ose periudhat e studimit, kanë të drejtën e njohjes dhe njësimit pa pagesë dhe brenda një afati të arsyeshëm të kualifikimit të tyre dhe/ose periudhave të studimit me qëllim për të vazhduar studimet e mëtejshme, ose për tu punësuar.

6. Për njohjen dhe/ose njësimin e diplomave/certifikatave profesionale, diplomave që u përkasin niveleve 5–8, gradave shkencore, titujve akademikë dhe kualifikimet e tjera të fituara jashtë Republikës së Shqipërisë dhe/ose periudhave të studimit nga mbajtësit/titullarët e statusit të refugjatit, personave të zhvendosur dhe personave të ngjashëm me refugjatët, organet kompetente, përcaktojnë procedurat e përshtatshme të vlerësimit, vlefshmërisë dhe kritereve të tjera, që lejojnë njohjen e këtyre kualifikimeve dhe/ose periudhave të studimit, edhe në mungesë të verifikimit të vlefshmërisë së tyre, apo mungesës, apo paraqitjes së dokumentacionit të pjesshëm ligjor, në ato raste kur personat e interesuar provojnë pamundësinë për të verifikuar vlefshmërinë e këtyre diplomave/certifikatave, ose nuk mund të paraqesin dokumente që ta bëjnë këtë gjë.

7. Për njohjen e kualifikimeve dhe periudhave të studimit të përcaktuara në këtë krye të këtij kreu, organet kompetente i referohen dispozitave përkatëse të këtij udhëzimi, Konventës së Lisbonës, të ratifikuar me ligjin nr. 8834, datë 22.11.2001, “Për ratifikimin

e “Konventës për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Evropë” (Lisbonë, 1997)”, si dhe dokumenteve të tjera ndërkombëtarë të njohura nga rrjeti ENIC-NARIC.

8. Kualifikimet e paraqitura sipas përcaktimeve të këtij kreu, duhet të vlerësohen nëpërmjet mbledhjes së informacionit nga burime të besueshme publike, rrjeti ENIC-NARIC, nga personi që aplikon për njohjen e kualifikimit dhe/ose periudhave të studimit dhe sipas rastit duhet të plotësohet me intervista me aplikantin, provimet dhe çdo metodë tjetër të përshtatshme vlerësimi.

Organet kompetente për njohjen dhe njësimin e diplomave dhe/ose periudhave të studimit, duhet të përdorin çdo mjet të diponueshëm dhe çdo informacion të besueshëm për të verifikuar programet e studimit, institucionet ku janë fituar kualifikimet, apo janë kryer periudhat e studimit dhe gjithashtu të përdorin për aq sa është e mundur çdo informacion apo praktikë të vlerësimeve të mëparshme për kualifikime të ngjashme për sa i përket vlefshmërisë, cilësisë, nivelit dhe rezultateve të të nxënit.

9. Organet kompetente në rastet kur refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët, për arsye të përligjura nuk mund të provojnë dhe dokumentojnë kualifikimet e tyre dhe /ose periudhat e studimit që ata pretendojnë, hartojnë një raport, i cili duhet të përmbajë një informacion të detajuar për kualifikimin e fituar, ose periudhave e studimit të përfunduara, me të gjithë dokumentacionin provues dhe dëshmitë mbështetëse të përshkruara në pikën 6 të këtij kreu.

Raporti i hartuar nuk përbën në vetvete një dokument njohjeje dhe njësimi.

10. Në të gjitha rastet raporti duhet të përmbajë:

a) të dhënat personale të aplikantit (emër, mbiemër, atësi (nëse shënohet);

b) emrin, në gjuhën origjinale të kualifikimit të fituar;

c) emrin, në gjuhën origjinale të institucionit ku është fituar kualifikimi, ose janë kryer periudhat e studimit;

d) emrin, në gjuhën origjinale të programit të studimit;

e) statusin e institucionit dhe programit të studimit (licencuar, akredituar/njohur, vlefshmërinë);

f) nivelin e kualifikimit të fituar;

g) kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit;

h) të drejtat e fituara nga kualifikimi;

i) vitin në të cilin është fituar kualifikimi, ose është kryer periudha e studimit;

j) dokumentacioni përkatës ku është mbështetur raporti.

10.1 Raporti hartohet dhe lëshohet në gjuhën shqipe dhe në atë angleze.

11. Refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët, kanë të drejtën e ankimit sipas kreut VI të këtij udhëzimi.

KREU V
TARIFAT

1. Tarifat për njohjen dhe njësimin e certifikatave/diplomave dhe gradave shkencore, që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, si dhe titujve akademikë, për çdo diplomë/titull akademik që kërkohet të njihet, përveç aplikimeve të paraqitura nga refugjatët, personat e

zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët i referohen përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Pagesa për njohjen dhe njësimin e certifikatave/diplomave dhe gradave shkencore, që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, si dhe titujve akademikë kryhet në llogarinë bankare të QSHA-së, të përcaktuar në faqen zyrtare të QSHA-së dhe e-Albania, në seksionin përkatës të njohjes së diplomave.

KREU VI
ANKIMIMI

1. Aplikanti për njohjen dhe njësimin e certifikatave dhe diplomave që i përkasin nivelit 5 deri në 8, përveç gradave shkencore "Doktor", të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim kundër vendimit të Komisionit të Njohjes së Diplomave në QSHA, sipas afateve të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

2. Aplikanti për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore "Doktor" dhe titujve akademikë ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim kundër vendimit të KNJG ose komisionit *ad hoc* pranë MAS-it, sipas afateve të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

3. Ankesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin mbi të cilin mbështeten pretendimet e ankuesit.

KREU VII
DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

1. Personat të cilët kanë aplikuar dhe/ose kanë paraqitur dokumentacionin për njohjen dhe njësimin e diplomave përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të trajtohen në bazë të dispozitave të udhëzimit nr. 17, datë 3.8.2016, "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit", i ndryshuar.

2. Udhëzimi nr. 17, datë 3.8.2016, "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit", i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Arsimit, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe komisionet përkatëse.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Evis Kushi

FORMULAR APLIKIM

PËR NJOHJE DIPLOME

Faqe **1103** nga **1165**

Shtojca nr.2

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
TIRANË

FATURE PËR ARKËTIM

Datë ___/___/ 2021

Me anë të kesaj fature shtrojmë që Banka e Nivelit të Dytë të pranojë nga klienti (emrusu / persona fizik/persona juridik) arkëtimë, për llogari të institucionit tonë, me emërtimë, kodë, numër identifikimi dhe shuma si ind poshtë

Lloji i institucionit përfitues	Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSAA)
Kodi i institucionit përfitues	[illegible]
Kodi i Degës së Thesarit bu nepron	[illegible]
Emri Adresa Mbiemri i paguesit	_____

Id e Dokumentit	Përfitues i të ardhurave		Shuma që Arkëtohet (Lekë)
	Emërtimi	Kodi i Llogarisë Ekonomike	
	[illegible]	[illegible]	[illegible]
X	TOTALI	X	[illegible]

(_____) lekë

Përfaqësuesi i institucionit
Rezarta VRAPI

KLIENTI
_____

Shtojca nr 3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

KOMISIONI I NJOHJES SË DIPLOMAVE

Nr. Prot. ____ Nr. Regjistrit ____ *Tiranë, me* _____

VËRTETIM NJOHJE DHE NJËSIMI

Vërtetohet njohja e diplomës/certifikatës së *ZTnj* _____ (emër atëse, mbiemër), lëshuar nga _____ (institucioni që ka lëshuar diplomën/certifikatën), _____ (shtetë), me datë _____ (data e lëshimit të diplomës), me program _____ vjetor (kohëngjatja e programit të studimit, __ ECTS (numri i kredisëve të fituara në mai kur këto disponohen), me kohë të _____ (forma e studimit), në _____ (emërtimi i programit të studimit).

Kjo diplomë/certifikatë njëvlehet si _____ në Republikën e Shqipërisë.

Ky vërtetim është i vlefshëm, i shoqëruar me diplomën e njohur dhe njësuar.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM **KRYETARI I KOMISIONIT**

Shtojca nr 4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr _____ Prot. Tiranë, më _____

VËRTETIM NJOHJE DHE NJËSIMI

Z/Znj. _____ (emër atësi mbiemër) ka fituar gradën shkencore "Doktor" në _____ (fushën e studimit), në Institucionin e Arsimit të Larë " _____ " (institucioni që ka lëshuar diplomën/certifikatën), në _____ (data e fitimit), nëpërmjet paraqitjes së disertacionit me temë: " _____ " (titulli i disertacionit).

Në mbrëmjetje të vendimit Nr _____, datë _____, të Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNjG) të ngritur me Urdhrin Nr _____, datë _____, "Për ngritjen e Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNjG)", grada shkencore e sipërpërmendur, e fituar në _____ (Shtetit), nga _____ (emër atësi mbiemër) është e barasvlershme me gradën shkencore "Doktor" në Republikën e Shqipërisë.

Grada shkencore "Doktor" i/e Z/Znj. _____ (emër atësi mbiemër) është regjistruar, me numër rendor _____ në regjistrin shkencor të gradave shkencore dhe tinjve akademike të fituar jashtë vendit, dhe të mbajtur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ky vërtetim është i vlefshëm, i dorëzuar me diplomën e doktoratës.

MINISTËR

Shtojca nr.5

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr._____ Prot. Tiranë, më _____

VËRTETIM I NJOHJES SË TITULLIT AKADEMIK

Z. _____ (emër atësi mbiemër) ka fituar titullin akademik "_____" (emërtimin e titullit të fituar), në _____ (fushën e studimit), në Institucionin e Arsimit të Larte "_____" (institucioni që ka lëshuar titullin akademik), më _____ (data e fitimit të titullit akademik).

Në mbësherija të vendimit Nr._____, datë _____, të Komisionit *Ad Hoc* të ngritur me Urdhrin Nr. _____, datë _____, "*Për ngrijen e Komisionit Ad Hoc për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit*", titulli akademik i sipërpërmendur, i fituar në _____ (Shteti), nga _____ (emër atësi mbiemër) është e barasvlershme me titullin akademik "_____" në Republikën e Shqipërisë.

Titulli akademik "_____" ve Z/Zoj. _____ (emër atësi mbiemër) është regjistruar, me numër rendor _____ në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit, dhe të mbajtur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ky vërtetim është i vlefshëm, i shoqëruar me dëshminë e titullit akademik.

MINISTËR

UDHËZIM
Nr. 5, datë 8.3.2022

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020, "PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenet 30 dhe 35, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre" dhe vendimit nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë 'Profesor i asociuar' dhe 'Profesor'", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020, i ndryshuar, pas pikës 5/4 të kreut VI, të shtohet pika 5/5 me përmbajtjen si më poshtë:

"5/5 "Përjashtimisht, aplikimet për programet e përbashkëta të studimit, me institucione të huaja të arsimit të lartë, për vitin akademik 2022–2023, do të pranohen deri më 29 prill 2022".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Evis Kushi

UDHËZIM
Nr. 14, datë 21.6.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 30.3.2020, "PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE PËRBËRËS, FORMËN E DIPLOMËS OSE CERTIFIKATËS TË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE PROCEDURËS SË REGJISTRIMIT TË TYRE NË REGJISTRIN SHTETËROR

TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 10 dhe 91, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 30.3.2020, "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja "i", e pikës 1, të kreut II, të shfuqizohet;

b) Shkronja "n", e pikës 1, të kreut II, të riformulohet si më poshtë:

"n) Numri i diplomës për studimet e ciklit të parë dhe për diplomat e ciklit të dytë e të tretë, numri i diplomës së studimeve universitare të përfunduara më parë /numri i regjistrit që gjendet në vërtetimin e njohjes dhe njësimit të diplomës/certifikatës së lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë.";

c) shkronja "b", e pikës 2, të kreut III, të riformulohet si më poshtë:

"b) Kopjen e aktit të hapjes/riorganizimit (nëse ka) dhe kopjen e aktit të akreditimit të IAL-së ose kur afati i akreditimit ka përfunduar, kopjen e dokumentit, me anë të të cilit vërtetohet aplikimi në organin kompetent për akreditimin periodik institucional.";

d) shkronja "ç", e pikës 2, të kreut III, të riformulohet si më poshtë:

"ç) Kopjen e aktit të akreditimit të programit të studimit për të cilin lëshohet diploma që regjistrohet ose kopjen e dokumentit me anë të të cilit vërtetohet aplikimi në organin kompetent për akreditimin periodik të programit të studimit, me përjashtim të programit të studimit për të cilin legjislacioni në fuqi nuk parashikon akreditimin e tij.";

e) shkronja "l", e pikës 1, të kreut II, të ndryshojë si më poshtë:

"l. Forma e studimeve dhe kohëzgjatja normale e programit të studimit".

2. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

UDHËZIM

Nr. 15, datë 22.6.2022

PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 19.2.2018, "PËR GJENERIMIN DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 10, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", të bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

a) në fund të pikës 2, shtohet:

"Formimi i numrit të matrikullimit, për studentët e regjistruar në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor", që japin akses në programet e studimit të ciklit të dytë "Master" në fushën e mësuesisë, të cilët nuk e plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, është sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Numri i matrikullimit, për këtë kategori studentësh identifikohet nga kodi i ciklit të studimit me shkronjën V, e cila nënkupton moslejimin për regjistrim, nga institucionet e arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë dhe mosmatrikullimin nga Qendra e Shërbimeve Arsimore në rast regjistrimi.";

b) shtojca nr. 1, që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij udhëzimi, zëvendësohet me shtojcën nr. 1 me të njëjtin numër.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillimin e Arsimit dhe Sportit, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Evis Kushi

SHTOJCA NR. 1

PËR PËRCAKTIMIN E KODIT TË CIKLIT TË STUDIMIT

Cikli i studimit	**Shënime**	**Forma e studimit**	**Kodi i**

				cikl it
DP/CP	Programe studimi me karakter profesional (1 ose 2 vjet)			Q
Bachelor	Cikli i parë i studimeve, me kohë të plotë			A
Bachelor	Cikli i parë i studimeve, me kohë të plotë			V
Master i shkencave	Cikli i dytë i studimeve, "Master i shkencave"/"Master i arteve"			B
Master profesional	Cikli i dytë i studimeve, "Master profesional" me kohë të plotë dhe me kohë të zgjatur			G
PISCD	Programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë 5- ose 6-vjeçar, me kohë të plotë			E
Master ekzekutiv	"Master ekzekutiv" cikli i tretë			K
Specializim afatgjatë	Studime specializuese afatgjata, cikli i tretë			M
Doktoratë	Doktoratë, cikli i tretë			N

UDHËZIM
Nr. 16, datë 29.6.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019, "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

a) Në kreun I të udhëzimit bëhen ndryshimet si më poshtë:

i. Në fund të shkronjës "a" të pikës 1 të shtohet togfjalëshi "*përfshirë kandidatët nga Kosova*";

ii. në shkronjën "b" të pikës 2, në shkronjat "a" dhe "c" të pikës 3 dhe në pikën 4, mbas togfjalëshit "*maturantëve/kandidatëve*" shtohet togfjalëshi "*përfshirë kandidatët nga Kosova*";

iii. në fund të pikës 5 shtohet togfjalëshi "*ndërsa për kandidatët nga Republika e Kosovës hedhja e rezultateve bëhet nga institucioni arsimor parauniversitar, i përcaktuar nga Zyra Vendore Arsimore Tiranë, pas njohjes dhe njehsimit të rezultateve nga QSHA-ja.*".

b) Në kreun II të udhëzimit bëhen ndryshimet si më poshtë:

i. në pikat 1, 2, 3 dhe 5 të shkronjës A mbas togfjalëshit "*maturantët/kandidatët*" shtohet togfjalëshi "*përfshirë kandidatët nga Kosova*";

ii. pas pikës 2, të shkronjës A, shtohet pika 2/1 me përmbajtje si më poshtë:

"*2/1. Përjashtimisht, maturantët/kandidatët, përfshirë kandidatët nga Kosova, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, me notë mesatare minimale për pranim mund të aplikojnë në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë, duke konfirmuar në rubrikat e aplikimit dakordësinë për mosndjekjen e këtyre programeve në ciklin e dytë dhe pajisen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore me numër të veçantë matrikullimi, i cili nuk i lejon të ndjekin më pas, programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë.*";

iii. në titullin e shkronjës B, si dhe në pikën 1 të shkronjës B, pas togfjalëshit "*maturantëve/kandidatëve*" shtohet togfjalëshi "*përfshirë kandidatët nga Kosova*";

iv. në pikën 5 të shkronjës C pas togfjalëshit "*Maturantët/kandidatët*" shtohet togfjalëshi "*përfshirë kandidatët nga Kosova*". Gjithashtu në pikën 9 të shkronjës C togfjalëshi "*fillimit të aplikimit për regjistrim*" zëvendësohet me togfjalëshin "*përfundimit të afatit për çregjistrim*" dhe togfjalëshi "*raundin e dytë*" zëvendësohet me togfjalëshin "*raundin e parë*";

v. në pikën 4/1, të shkronjës E, togfjalëshi "*fillimit të aplikimit për regjistrim*" zëvendësohet me togfjalëshin *"përfundimit të afatit për çregjistrim*".

c) Pas pikës 7, të shkronjës G, të kreut III, shtohen pikat 7/1 dhe 7/2 me përmbajtje si më poshtë:

"7/1. Pas përfundimit të raundit të tretë, kandidatët që janë pjesë e portalit U-albania dhe rezultojnë të pa regjistruar në asnjë program studimi, kanë të drejtën e regjistrimit në programe studimi ku ka kuota të pa paplotësuara në të gjitha IAL-të, pavarësisht aplikimeve në raundet e mëparshme, brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e përfundimit të raundit të tretë.

7/2. Studentët të cilët pas përfundimit të raundit të tretë, rezultojnë të regjistruar në një program studimi ku nuk plotësohet numri minimal i parashikuar në aktet e brendshme të IAL-ve për aktivizimin e programit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve me vendim të Senatit Akademik bëhet kalimi në program studimi të përzgjedhur prej studentit, ku ka kuota të paplotësuara. Vendimi i njoftohet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe QSHA-së për të vijuar procedurën e regjistrimit dhe matrikullimit.";

d) në kreun IV/3 të udhëzimit bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

i. titulli ndryshohet "*Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve shtetas të huaj me diploma të huaja të shkollës së mesme, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e përbashkëta të ciklit të parë dhe të dytë të integruar, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë*";

ii. në pikën 1 togfjalëshi "*kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it*" zëvendësohet me togfjalëshin "*afateve të përcaktuara nga vet IAL-të*";.

iii. pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me përmbajtje si më poshtë:

"*2.1 Njohja e dokumentacionit të kandidatëve të pajisur me diploma të huaja të shkollës së mesme, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen regjistrimin e tyre përfundimtar dhe pajis me*

numër matrikullimi studentin, si dhe brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it dhe ia komunikon IAL-së.";

iv. pas pikës 5 shtohen pikat 5.1 dhe 5.2 me përmbajtje si më poshtë:

"*5.1 Kandidatët paraqesin aplikimin e tyre pranë IAL-se përkatëse. Të dhënat e tyre i dërgohen QSHA-së nga IAL-ja në përfundim të procesit të regjistrimit të aplikimeve. Pas zhvillimit të konkurseve/testimeve të pranimit, IAL-ja i dërgon QSHA-së listat e fituesve dhe të dhënat e tyre, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të nevojshëm për zhvillimin e procedurave të njohjes së diplomës.*

5.2 Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm në institucione arsimore në të njëjtën gjuhë të huaj që zhvillohet edhe programi i studimit i ciklit të dytë i IAL-së ku aplikon, përjashtohen nga detyrimi i mbrojtjes së kësaj gjuhe sipas përcaktimeve në pikën 4, të nenit 76, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".";

v. pika 11 ndryshon si më poshtë:

"*11. IAL-të, brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, dërgojnë pranë QSHA-së, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. IAL-të nuk duhet të dërgojnë në QSHA të dhënat e asnjë kandidati pas kësaj date. Për të gjithë emrat kandidatëve të dërguar pas kësaj date ose që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi, nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja duhet të kërkojë nga IAL-ja, duke njoftuar edhe kandidatin, çregjistrimin e tyre dhe konfirmimin me shkresë zyrtare brenda një afati 10-ditor për kryerjen e procesit të çregjistrimit të kandidatit nga IAL-ja.*";

vi. pika 12 ndryshon si më poshtë:

"*12. Sekretaritë mësimore të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik.*";

vii. pika 13 shfuqizohet.

e) Në kreun IV/4 të udhëzimit bëhen ndryshimet si më poshtë:

i. pika 1 ndryshon si më poshtë:

"*1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, për çdo vit akademik të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IAL-të publike dhe jopublike, në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik.*";

ii. pika 2 ndryshon si më poshtë:

"*2. Brenda afateve IAL-të publike dhe jopublike, afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet elektronike zyrtare (ëeb) të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.*";

iii. në pikën 4 hiqet togfjalëshi *"...në Portalin U-Albania, përkatësisht deri..."*;

iv. në pikën 5 hiqet togfjalëshi *"...në Portalin U-Albania...*";

v. në pikën 13 hiqet togfjalëshi "*...në Portalin U-Albania dhe...*";

vi. pika 18 shfuqizohet.

f) Në kreun V të udhëzimit bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

i. kudo në pikën 1 në fund të togfjalëshit "*sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, 'Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit'*", shtohet termi "*i ndryshuar*";

ii. pas shkronjës "g", të pikës 1, shtohet shkronja "gj" me përmbajtje si më poshtë:

"*gj) brenda datës 30 maj të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të tretë të studimeve, "Doktoratë", për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", i ndryshuar".*";

iii. në pikën 3 togfjalëshi "*sipas udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 5, datë 19.2.2018, 'Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë'*" zëvendësohet me togfjalëshin "*sipas udhëzimit nr. 5, datë*

19.2.2018, 'Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë', i ndryshuar";

iv. në pikën 4 termi "*janar*" zëvendësohet me termin "*qershor*".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe IAL-të publike dhe jopublike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

UDHËZIM
Nr. 18, datë 8.7.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 15.10.2021, "PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË, TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONE TË HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 92, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021, "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara"*,* bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 2, e kreut II, riformulohet si më poshtë:

"Dokumentacioni shoqërues i kërkuar duhet të depozitohet detyrimisht në formatin elektronik gjatë aplikimit online.";

b) Nënpika "ii", e germës "b", të pikës 3, të kreut II, riformulohet si vijon:

"ii. Suplementin e diplomës dhe/ose listën e notave, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.".

c) Pika 3.1 e kreut II, shfuqizohet.

d) Nënpika "ii" e germës "b", të pikës 4, të kreut II, shfuqizohet.

e) Pika 4.1 e kreut II, shfuqizohet.

f) Nënpika "ii", e germës "b", të pikës 5.1, të kreut II, riformulohet si vijon:

"ii. Kopjen e dokumentit që vërteton fitimin e gradës shkencore "Doktor", e noterizuar dhe shoqëruar me vërtetimin e njohjes së gradës shkencore "Doktor" në Republikën e Shqipërisë, nëse studimet pararendëse janë ndjekur jashtë vendit.".

i) Pika 5.2 e kreut II, shfuqizohet.

j) Pika 1.2 e kreut III, riformulohet si vijon:

"1.2 Procedura e njohjes dhe njësimit fillon menjëherë pasi QSHA-së i është shfaqur aplikimi në sistemin online, në rastet kur dokumentacioni i ngarkuar në formë elektronike është i plotë, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

SENJOD vetëm në ato raste kur ka dyshime të arsyeshme për autenticitetin e diplomës ose certifikatës se lëshuar kontakton me anë të postës elektronike me institucionin përgjegjës që ka lëshuar diplomën ose certifikatën përkatëse.

Aplikimi nuk konsiderohet i plotë nëse mungon një nga dokumentet e cituara në këtë udhëzim. Informimi për plotësim dokumentacioni bëhet nëpërmjet sistemit online.".

k) Pika 1.3 e kreut III, riformulohet si vijon:

"1.3 Për arsye objektive QSHA, gjatë procedurës së njohjes dhe njësimit mund të kërkojë dokumentin/et, të parashikuar në këtë udhëzim, në formë shkresore.

Në rast të mos depozitimit të dokumentit, në formë shkresore, brenda 30 ditëve, QSHA-ja ndërpret shqyrtimin e aplikimit dhe dokumentacioni arkivohet.".

l) Pika 1.4 e kreut III, riformulohet si vijon:

"1.4 Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacion, SENJOD i kërkon aplikantit plotësimin e dokumentacionit me anë të sistemit online, brenda 15 ditëve nga momenti i depozitimit të aplikimit. Në rast të mos depozitimit të plotësimeve brenda 30 ditëve, QSHA-ja ndërpret shqyrtimin e aplikimit dhe dokumentacioni arkivohet.".

m) *Pika 5, kreu III* të riformulohet si vijon:

"5. *Komisioni i Njohjes së Diplomave merr vendimin për njohje dhe njësim të certifikatës/diplomës ose mund të vendosë ta kthejë për plotësime të tjera të nevojshme të dokumentacionit te sekretaria teknike (SENJOD), sipas këtij udhëzimi. Sekretaria teknike (SENJOD) zbardh raportin dhe vendimin e Komisionit të Njohjes së Diplomave, i cili lëshon vërtetimin e njohjes dhe njësimit për çdo aplikant, nëpërmjet sistemit online dhe nënshkrim dhe vulë elektronike, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij. Në rastet kur ky Komision nuk merr vendim për njohjen dhe njësimin e diplomës ose certifikatës, i kthen përgjigje të arsyetuar aplikantit nëpërmjet sistemit online për arsyet dhe mangësitë e aplikimit."*

n) *Pika 6.4, kreu III,* të riformulohet si vijon:

"6.4. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit, kryetari dhe anëtarët e komisionit, nënshkruajnë procesverbalin dhe vendimin përkatës. Vërtetimi lëshohet nëpërmjet sistemit online me nënshkrim dhe vulë elektronike të kryetarit, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij."

o) Pika 7.3, Kreu III, të riformulohet si vijon:

"7.3 Në përfundim të procedurave të shqyrtimit dhe vlerësimit, kryetari dhe anëtarët e komisionit ad hoc nënshkruajnë procesverbalin dhe vendimin përkatës. Nëse është vendosur njohja e titullit akademik, vërtetimi lëshohet nëpërmjet sistemit online me nënshkrim dhe vulë elektronike të kryetarit, sipas shtojcës nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij."

p) Pika 9, kreu III, të riformulohet si vijon:

"9. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit, për diplomat që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ose Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, (përveç gradave shkencore "Doktor") lëshohet i firmosur nga titullari i QSHA-së dhe kryetari i komisionit në dy kopje me nënshkrim dhe vulë elektronike (njëra kopje i bashkëngjitet vendimit përkatës të Komisionit të Njohjes së Diplomave dhe ruhet në dosjen e aplikimit përkatës).

q) Pika 3 e kreut IV ndryshon si vijon:

"3. *Aplikimi për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të titujve akademikë, kryhet sipas procedurës së mëposhtme:*

a) formulari i aplikimit plotësohet në QSHA, sipas shtojcës nr. 1;

b) aplikanti dorëzon në QSHA dokumentacionin e mëposhtëm:

i. diplomën ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

ii. suplementin e diplomës për gradën shkencore "Doktor" (nëse ka të tillë), *dhe/ose listën e notave, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.*

iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës, ose dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të te cilit vërtetohet identiteti i tij;

iv. dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet qe personi ka fituar statusin e refugjatit, person i zhvendosur dhe person i ngjashëm me refugjatët.".

r) Pika 4 e kreut IV, shfuqizohet.

s) Pas pikës 1 të kreut VII, shtohet pika 1/1 si vijon:

"1/1. Për procedurën, afatet dhe dokumentacionin ndiqen përcaktimet e parashikuar në këtë udhëzim, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në marrëveshjet dy ose më shumëpalëshe të nënshkruar ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin apo institucionit përgjegjës të autorizuar prej saj dhe një subjekti juridik të huaj, që kanë për objekt njohjen dhe njësimin e diplomave të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë."

2. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Arsimit, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe komisionet përkatëse.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

U DH Ë Z I M

Nr.23, datë 1.8.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019, "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

U DH Ë Z O J:

1. Në pikat 6, 8, 9 dhe 10 të kreut IV/3 të udhëzimit nr. 10, datë 15.5.2019, i ndryshuar, togfjalëshi "*kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it*" zëvendësohet me togfjalëshin "*afateve të përcaktuara nga vet IAL-të*".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe institucionet publike dhe jopublike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTËR

EVIS KUSHI

UDHËZIM

Nr. 27, Datë 2.8.2022

PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, AFATEVE TË APLIKIMIT, SHQYRTIMIT DHE PROCEDURAT E MASËS DHE MËNYRËS SË FINANCIMIT TË STUDENTËVE TË SHKËLQYER DHE ATYRE QË NDJEKIN PROGRAMET E STUDIMIT QË PËRBËJNË PRIORITET KOMBËTAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe të pikës 6 të vendimit nr. 386 datë 01.06.2022 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjes financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucione publike të arsimit të lartë",

UDHËZOJ:

1. Studentët shtetas shqiptarë që regjistrohen në vitin akademik 2022–2023, e në vijim në institucionet e arsimit të lartë publik, që cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën 2 të vendimit nr. 386 datë 1.06.2022, të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë*", aplikojnë për mbështetje financiare pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, brenda datës 30 janar të vitit akademik që pranohen në institucionet e arsimit të lartë publike.

2. Për secilin prej kërkesave për financim të paraqitura nga studentët, që janë pranuar në një institucion publik të arsimit të lartë, aplikojnë kandidatët që përmbushin kriteret si më poshtë:
   a) Studentët me notë mesatare që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00;
   b) Studentët që në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të Maturës Shtetërore janë vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5-10.00;
   c) Studentët fitues, të njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare të arsimit parauniversitar, me më shumë se 15 vende pjesëmarrës, pavarësisht notës mesatare, kur pranohet në programe studimi, qe lidhen me lëndën/disiplinat ku ka fituar çmimin;
   d) Studentët qe kanë zgjedhur një prej programeve të studimit që përbëjnë prioritet kombëtar dhe që ka përfunduar arsimin e mesëm te lartë me note mesatare, jo me pak se 8,5.

3. Studentët aplikojnë me dokumentacionin provues, të noterizuar ose origjinal si më poshtë:
   a) Kërkesën për aplikim;
   b) diploma dhe certifikata e Maturës Shtetërore;
   c) vërtetim nga Institucioni i arsimit të lartë publik që është pranuar në një program studimi;
   d) certifikatën e fitimit të olimpiadës sipas shkronjës "c", të pikës 2 të këtij udhëzimi.

4. Për përzgjedhjen e të gjithë kandidatëve dhe ndjekjen e ecurisë së tyre gjatë studimeve, ministri përgjegjës për arsimin cakton strukturën përkatëse për ndjekjen e procedurave të përzgjedhjes.

5. Ministria përgjegjëse për arsimin merr informacion zyrtar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) dhe institucionet publike të arsimit të lartë për vërtetimin e kritereve të sipërpërmendura.

6. Për vitet në vijim, pas vitit akademik 2022-2023, MAS do të marrë konfirmim nga IAL-të publike për notën mesatare të studentëve përfitues, në përputhje me përcaktimet e pikës 4 të vendimit nr. 386 datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave brenda datës 30 Tetor. Ky informacion do të verifikohet në raport me dokumentacionin e përcjellë nga vetë studentët përfitues, të cilët duhet të depozitojnë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, listën e notave si dhe vërtetimin për shlyerjen e të gjithë detyrimeve të vitit paraardhës, sipas përcaktimeve të pikës 4 të vendimit nr. 386 datë 1.6.2022 të Këshillit të Ministrave.

7. Bursa financiare u jepet studentëve përfitues çdo muaj, në llogarinë bankare të deklaruar nga studentët, në bankat e nivelit të dytë, pas konfirmimit të frekuentimit të programit përkatës të studimit te struktura përgjegjëse për ndjekjen e ecurisë së studentëve gjatë studimeve, brenda datës 5 të çdo muaji.

8. MAS pas marrjes së konfirmimeve përkatëse, harton listën përfundimtare, me të gjithë studentët përfitues të cilët përfitojnë, sipas pikës 10 të vendimit nr. 386 datë 1.6.2022 të Këshillit të Ministrave.

9. Lista përfundimtare me të gjithë përfituesit i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe IAL-ve publike, për nënshkrimin e marrëveshjes me studentët përfitues, brenda datës 30 Nëntor, pasi të jenë njoftuar edhe studentët përfitues.

10. Kopje zyrtare e marrëveshjeve të nënshkruara, jo më vonë se dy ditë nga data e nënshkrimit, i përcillen çdo IAL-je publike, të cilat kanë studentë përfitues të këtij fondi.

11. Pas nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe mes përfituesit të financimit ose përfaqësuesit ligjor të tij, ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe institucionit të arsimit të lartë publik, brenda datës 15 të çdo muaji, IAL-të publike duhet të kryejnë, të cilat janë përcaktuar në marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet palëve. Masa e financimit nuk mund të tejkalojë nivelin e pagës minimale të përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, në momentin e financimit të studentit dhe vlera e saj duhet të përcaktohet në marrëveshje.

12. Studentët të cilët mund të kenë kryer pagesën e tarifës së shkollimit pranë IAL-së përkatëse, menjëherë, pas nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe, IAL-ja duhet të bëjë rimbursimin e tarifës së paguar nga këta studentë.

13. Fondet për mbështetjen financiare të studentëve sipas këtij udhëzimi, përballohen nga buxheti i ministrisë së arsimit dhe sportit që i akordohet IAL-ve publike, në programin 09450, në formë grandi.

14. Për mbulimin e efekteve financiare për vitin 2022, për ato IAL publike të cilat do të kenë nevojë për fonde shtesë për përballimin e efekteve financiare që burojnë nga zbatimi i këtij udhëzimi, efektet financiare do të kompensohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.

15. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

Evis KUSHI

MINISTËR

UDHËZIM

Nr. 29, datë 7.10.2022

PËR FREKUENTIMIN E PROCESIT MËSIMOR, SIPAS LLOJIT TË VEPRIMTARIVE MËSIMORE NË AUDITOR, DHE CIKLIT TË STUDIMIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 87, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit nr. 824, datë 24.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", ministri i Arsimit dhe Sportit

UDHËZON:

1. Përcaktimi i frekuentimit të procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimore në programet e studimit me karakter profesional, programet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimit.

2. Llojet e veprimtarive mësimore në auditor janë, si më poshtë:

a) leksion;

b) seminar/ushtrim;

c) laborator;

ç) praktikë profesionale/klinike/kërkimore-shkencore.

3. Frekuentimi i procesit mësimor përcaktohet në rregulloren e programit të studimit.

Frekuentimi i leksioneve është si rregull fakultativ, por institucionet e arsimit e lartë mund të përcaktojnë, në aktet e tyre të brendshme rregullatore, frekuentim për lëndë/grup lëndësh të veçanta.

Për llojet e tjera të veprimtarive në auditor frekuentimi është, si më poshtë:

a) Për programet e studimit me karakter profesional, programet e studimit të ciklit të parë, programet e studimit të ciklit të dytë, "Master profesional", programet e studimit të ciklit të dytë, "Master i shkencave"/"Master i arteve" dhe programet e studimit të ciklit të tretë "Master ekzekutiv", veprimtaritë e tjera mësimore në auditor janë, si më poshtë:

i. seminare/ushtrime: 75%;
ii. laboratorë: 75%;
iii. praktika profesionale/klinike: 75%.

b) Për programet e studimit të ciklit të tretë "Specializim afatgjatë të ciklit të tretë" dhe programet e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë", që përmbajnë si pjesë të tij, lëndë të formimit teorik, veprimtaritë mësimore të tjera në auditor janë, si më poshtë:

i. seminare/ushtrime: 50%;
ii. laboratorë: 75%;
iii. aktivitete profesionale/klinike/kërkimore-shkencore: 75%.

4. Institucionet e arsimit të lartë, në aktet e tyre rregullatore dhe për fusha specifike të programeve të studimit mund të rritin masën e frekuentimit të procesit mësimor, të përcaktuar në këtë udhëzim.

5. Në rastet kur një IAL lëshon diplomë të përbashkët ose të dyfishtë me një IAL të huaj, frekuentimi i procesit mësimor bëhet sipas parashikimeve të këtij udhëzimi ose të marrëveshjes midis palëve.

6. Udhëzimi nr. 13, datë 20.6.2022, "Për frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimore në auditor dhe ciklit të studimit", shfuqizohet.

7. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn ne fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Evis Kushi

UDHËZIM
Nr. 30, datë 4.11.2022

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE AFATEVE TË APLIKIMIT, SI DHE TË PROCEDURAVE TË PËRCAKTIMIT TË MASËS DHE MËNYRËS SË FINANCIMIT TË STUDENTËVE TË SHKËLQYER DHE ATYRE QË NDJEKIN PROGRAME STUDIMI QË PËRBËJNË PRIORITET KOMBËTAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe të pikës 6, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", ministri i Arsimit dhe Sportit,

UDHËZOJ:

1. Studentët shtetas shqiptarë, që regjistrohen në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2022–2023, e në vijim, të cilët plotësojnë njërin nga kriteret e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 2, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", aplikojnë për mbështetje financiare pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL), brenda muajit janar të vitit akademik, në të cilin pranohen në institucionet publike të arsimit të lartë.

2. Studentët kanë mundësinë e aplikimit për përfitimin e mbështetjes financiare, nëse plotësojnë njërin nga tri kriteret si më poshtë:

a) studenti ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00 dhe në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e përshkallëzuar 9.5 deri në 10.00;

b) studenti është fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare të arsimit parauniversitar, me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, pavarësisht notës mesatare, kur pranohet në programe studimi, që lidhen me lëndën(t)/disiplinën ku ka fituar çmimin;

c) studenti ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar dhe që ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare, jo më pak se 8.5, përfshirë notën e përshkallëzuar të provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore.

3. Studentët aplikojnë duke depozituar dokumentet provuese, origjinal ose kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- kërkesën për aplikim;
- dokument identifikimi (fotokopje);
- diploma dhe certifikata e maturës shtetërore;
- vërtetim nga institucioni publik i arsimit të lartë, që aplikanti është pranuar në një program studimi;
- certifikatën e fitimit të olimpiadës, sipas kërkesave të shkronjës "c", të pikës 2, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave.

4. Pas përfundimit të afatit të aplikimeve, AKFAL-ja bën verifikimin e informacionit të paraqitur në aplikimin e çdo studenti. Për këtë qëllim merret informacion zyrtar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, për të verifikuar përmbushjen e kritereve.

5. Pas marrjes së konfirmimeve përkatëse, AKFAL-ja harton listën përfundimtare me të gjithë studentët përfitues, të cilët plotësojnë kriteret për të përfituar mbështetje financiare dhe ia përcjell ministrisë përgjegjëse për arsimin. Bazuar në këtë listë, ministria përgjegjëse për arsimin akordon fondin për çdo institucion publik të arsimit të lartë.

6. Brenda 10 ditëve nga miratimi i listës përfundimtare, sipas pikës së mësipërme, studentët përfitues dhe institucionet publike të arsimit të lartë, ku ata janë regjistruar, njoftohen për të lidhur marrëveshjen trepalëshe mes përfituesit të financimit ose përfaqësuesit ligjor të tij, ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe institucionit publik të arsimit të lartë.

7. Një kopje zyrtare e marrëveshjes së nënshkruar, jo më vonë se dy ditë nga data e nënshkrimit, i përcillet çdo institucioni publik të arsimit të lartë, ku është regjistruar studenti përfitues i fondit të mbështetjes financiare.

8. Pas nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe, çdo muaj, institucioni publik i arsimit të lartë duhet të kryejë pagesën në llogarinë bankare të përfituesit, e cila është përcaktuar në marrëveshjen e nënshkruar. Masa e financimit nuk mund të tejkalojë nivelin e pagës minimale në shkallë vendi.

9. Për studentët, të cilët mund të kenë kryer pagesën e tarifës së shkollimit, institucioni publik i arsimit të lartë, menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe, duhet të bëjë rimbursimin e tarifës së paguar.

10. Për studentët përfitues, për vitet në vijim pas vitit akademik 2022–2023, AKFAL-ja do të bëjë verifikimin e plotësimit të kërkesave të pikës 4, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave. Për këtë qëllim, studentët përfitues duhet të depozitojnë, brenda muajit tetor, listën e notave dhe vërtetimin për shlyerjen e të gjithë detyrimeve të vitit paraardhës, sipas përcaktimeve të pikës 4, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave. AKFAL-ja do të marrë konfirmim nga institucionet publike të arsimit të lartë, për notën mesatare të studentëve përfitues, brenda muajit nëntor. Në rast të mosplotësimit të kritereve të notës mesatare, studenti e humb të drejtën e përfitimit të mbështetjes financiare për vitin akademik pasardhës. Në këtë rast, AKFAL-ja njofton studentin, institucionin publik të arsimit të lartë dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin.

11. Për vitet akademike pasardhëse, pas vitit akademik të nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe, lista me të gjithë përfituesit e çdo viti akademik do të miratohet brenda muajit dhjetor, duke njoftuar studentët përfitues dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

12. Pas nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe, konfirmimi i frekuentimit të programit përkatës të studimit nga studentët përfitues, për çdo muaj të pjesës së mbetur të vitit akademik kur është nënshkruar marrëveshja, si dhe për çdo muaj të viteve akademike në vijim, do të bëhet nga institucioni publik përkatës i arsimit të lartë.

13. Fondet për mbështetjen financiare të studentëve sipas këtij udhëzimi, përballohen nga buxheti i ministrisë së arsimit dhe sportit, që i akordohet institucioneve publike të arsimit të lartë, në programin 09450, në formë grandi.

14. Për vitin 2022, për ato institucione publike të arsimit të lartë, të cilat do të kenë nevojë për fonde shtesë për përballimin e efekteve financiare që burojnë nga zbatimi i këtij udhëzimi, këto fonde shtesë do të kompensohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.

15. Udhëzimi nr. 27, datë 2.8.2022, i ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e rregullave, afateve të aplikimit, shqyrtimit dhe procedurat e masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar" shfuqizohet.

16. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

UDHËZIM

Nr. 31 datë 15.11.2022

PËR PROCEDURAT PËR KODIFIKIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 9, të vendimit nr. 310, datë 11.5.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e Kodit të Programeve të Studimit, sipas elementeve të mëposhtme:

a) Përcaktimi i nivelit të programit të studimit, sipas nivelit të përcaktuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimit;

b) Kohëzgjatja e programit të studimit;

c) Lloji i programit të studimit;

d) Fusha e detajuar në të cilën bën pjesë programi i studimit;

e) Gjuha e programit të studimit.

2. Për programet ekzistuese të studimit, institucionet e arsimit të lartë (në vijim "IAL"), duhet të dërgojnë zyrtarisht në ministrinë përgjegjëse për arsimin, propozimet e tyre të

argumentuara lidhur me kodet që duhet të përmbajnë të gjitha programet që ofrojnë, të grupuara sipas njësive kryesore të IAL-së, shoqëruar me planet e tyre mësimore, si dhe të dhënat për aktin e hapjes dhe/ose akreditimit të programit të studimit (nëse ka).

3. Vlerësimi i propozimeve të IAL-së kryhet nga Komisioni i Përkohshëm (në vijim "Komisioni"), i përbërë nga 3 (tre) ekspertë, sipas fushës, të përzgjedhur nga lista e ekspertëve të jashtëm të miratuar nga Bordi i Akreditimit. Këto Komisione ngrihen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Komisioni, vlerëson propozimet e IAL-ve, sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit KSNA 2011 (ISCED 2011) dhe Fushat e Arsimit dhe Trajnimit të KSNA-së (KSNA-F 2013) dhe legjislacionit në fuqi për kodifikimin, brenda 45 ditëve nga përcjellja e dokumentacionit nga ministria përgjegjëse për arsimin.

5. Komisioni, pas vlerësimit, harton raportin me vlerësimin përkatës dhe e depoziton në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Në raportin e vlerësimit Komisioni i propozon ministrit konfirmimin e Kodit për Programin e Studimit ose jep rekomandim lidhur me atë program studimi.

6. Në rast se Komisioni gjatë vlerësimit konstaton që propozimi i IAL-së nuk është i plotë, ministria përgjegjëse për arsimin njofton zyrtarisht IAL-në mbi mangësitë e konstatuara. IAL dërgon plotësimet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit.

7. Në rast se Komisioni gjatë vlerësimit konstaton që propozimi i IAL-së është në përputhje me përcaktimet ligjore mbi kodifikimin e programit të studimit, ministri përgjegjës për arsimin konfirmon kodin për programin përkatës, duke njoftuar IAL-në dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore me shkresë zyrtare.

8. IAL-të, në aplikimin për hapjen e programeve të reja dhe/ose të riorganizuara të studimit në masën mbi 20%, duhet të përfshijnë dhe propozimin për Kodin e Programit.

9. Ministria përgjegjëse për arsimin vlerëson propozimin e IAL-së, në funksion të procedurave për hapjen dhe/ose riorganizimin e programit të studimit, të përcaktuara në udhëzimin përkatës.

10. Kodi i Programit të Studimit përfshihet në aktin e hapjes dhe/ose të riorganizimit të programit të studimit.

11. Kodi, për secilin program studimi, regjistrohet në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor.

12. Për programet ekzistuese të studimit, institucionet e arsimit të lartë duhet të dërgojnë zyrtarisht në ministrinë përgjegjëse për arsimin, propozimet e tyre brenda muajit mars 2023.

13. Kundër vendimit të Komisionit mund të bëhet ankim nga IAL-ja, pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, e cila ia përcjell për rishikim komisionit përkatës. Komisioni, brenda 15 ditëve, pas rishqyrtimit të ankimit, merr vendimin përfundimtar.

14. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Evis Kushi

RREGULLORE
Nr.2459/1 prot., datë 15.03.2016 "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE TË PARA PËR AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton rregulla për përgatitjen, organizimin, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, duke përfshirë:

a) Kushtet dhe afatet për regjistrimin e kandidatëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre, dokumentacionin zgjedhor, listat e zgjedhësve, fushatat zgjedhore;
b) Rregullat për organizimin dhe funksionimin e administratës zgjedhore;
c) Kriteret për hartimin e listës së zgjedhësve;
d) Procedurat për votimin, vlerësimin dhe numërimin e votave, shpalljen e rezultateve;
e) Procedurat për shqyrtimin e ankimimeve;
f) Administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 131 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Neni 3
Subjekt i rregullores

1. Subjekt i kësaj rregulloreje janë institucionet publike të arsimit të lartë. Institucionet jopublike të arsimit të lartë dhe institucionet publike të pavarura të arsimit të lartë, i referohen kësaj rregulloreje në rast zhvillimi të proceseve zgjedhore në këto institucione.

2. Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë, i njësive kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë, ka të drejtën e tij të zgjedhjes dhe të të zgjedhurit, në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë rregullore dhe në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

3. Anëtarët e personeli akademik, që sipas nenit 65 ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", kanë mbushur moshën për pension, nuk kanë të drejtë të zgjidhen, si autoritete drejtuese apo në organet drejtuese dhe nuk bëjnë pjesë në trupën zgjedhore.

4. Çdo student i ciklit të parë, ciklit të dytë dhe programeve profesionale të larta, me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, kanë të drejtën e zgjedhjes së autoriteteve dhe organeve drejtuese. Çdo student ka të drejtën e zgjedhjes dhe të të zgjedhurit për përfaqësuesit student në organet drejtuese, në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë rregullore dhe në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Neni 4

Parimet e përgjithshme

1. Zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese të institucioneve publike të arsimit të lartë janë periodike, çdo 4 vjet.
2. Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë rregullore. Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës.
3. Çdo zgjedhës ka të drejtën e një vote të vetme për zgjedhjen e çdonjërit prej subjekteve, autoriteti, ose anëtari të organit drejtues.
4. Të drejtën për t'u zgjedhur në postin e një autoriteti drejtues, (rektor, dekan/drejtor dhe përgjegjës departamenti), e kanë edhe persona që nuk bëjnë pjesë në stafin akademik me kohë të plotë në njësitë kryesore dhe që plotësojnë kushtet e parashikuara në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë rregullore dhe në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", për të konkurruar për këtë post.
5. Të drejtën për t'u zgjedhur si autoritet drejtues akademik i Institucionit të Arsimit të Lartë Publik, e ka çdo anëtar i personelit akademik që nuk ka fituar, në të njëjtin funksion dhe në të njëjtin institucion, dy mandate të njëpasnjëshme apo të ndara, të fituara sipas ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Në kuptim të nenit 131, pika 3 të ligjit *80/2015,* mandat i fituar konsiderohet çdo mandat që është fituar nëpërmjet një procesi zgjedhor pavarësisht nga kohëzgjatja e tij.
6. Çdo kandidat nuk mund të konkurrojë njëkohësisht për më shumë se një post autoriteti drejtues.
7. Çdo kandidat ka të drejtën të organizojë dhe zhvillojë aktivitete për paraqitjen e programit të tij, duke mos cënuar procesin mësimor.
8. Shpallet i zgjedhur në postin e një autoriteti drejtues kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim.
9. Në rast se për postin e një autoriteti drejtues nuk regjistrohet ose nuk fiton asnjë kandidat, zgjedhjet për këtë post zhvillohen, me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, jo më përpara se 6 muaj nga data e zgjedhjeve të shpallura. Zgjedhjet e përsëritura zhvillohen në përputhje me kërkesat ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe me këtë rregullore. Gjatë periudhës kur nuk ka drejtues të zgjedhur, për caktimin e drejtuesit të njësisë veprohet sipas rregullit të përcaktuar në nenin 39, pika 9, pika 10 dhe neni 42, pika 9 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
10. Zgjedhje të përsëritura nuk zhvillohen deri në një vit përpara përfundimit të periudhës 4-vjeçare pas zgjedhjeve të fundit.

11. Në rastin kur për anëtarë të Senatit Akademik konkurrojnë me shumë kandidatë se sa numri i mandateve të caktuara për njësinë kryesore përkatëse, fitues shpallen kandidatët që fitojnë numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim. Për kandidatët që fitojnë numër të barabartë votash, zgjedhja për anëtar të Senatit Akademik bëhet me short. Shorti organizohet dhe realizohet nga Komisioni i Zgjedhjeve në Fakultet (KZF).
12. Në rastin kur mbeten vende vakante për anëtarë në Senatin Akademik, për arsye se numri i kandidateve është më i vogël se numri i mandateve, në njësinë kryesore përkatëse zhvillohet një raund i dytë zgjedhjesh, 15 ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve. Për këtë raund kanë të drejtë të regjistrohen kandidatë të tjerë që i plotësojnë kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe kërkesat e kësaj rregulloreje.

Neni 5

Periudha zgjedhore dhe thirrja e zgjedhjeve

1. Zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe organet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë publik zhvillohen në mënyrë periodike, çdo katër vjet, njëherësh në të gjithë institucionet e arsimit të lartë publik në Republikën e Shqipërisë.
2. Dita e fillimit të procesit zgjedhor dhe dita e zgjedhjeve caktohet nga ministri përgjegjës për arsimin.
3. Autoriteti më i lartë drejtues në IAL, shpall ditën e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e përcaktuar nga ministri për zgjedhjen e autoriteteve dhe organeve drejtuese në institucionin që drejton.
4. Zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë publik zhvillohen brenda së njëjtës ditë.
5. Zgjedhjet jashtë radhe për autoritetet drejtuese thirren menjëherë pas përfundimit para kohe të mandatit të autoritetit përkatës, nëse pjesa e mbetur e mandatit është jo me pak se një vit.
6. Qendrat e votimit hapen në orën 8.00 dhe mbyllen në orën 16.00. Askush nuk mund të votojë pasi KZF (KQV) merr vendim per mbylljen e votimit.

KREU II

Institucionet për përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve

Neni 6

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ)

1. Zgjedhja e anëtarëve të KIZ është detyrë dhe përgjegjësi e Senatit Akademik të institucionit. Jo me vonë se tri ditë kalendarike pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve, Senati Akademik zgjedh KIZ, në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

a) Senati akademik zgjedh anëtarët e KIZ, me votim të fshehtë, me shumicën e thjeshtë të anëtarësisë së tij, nga lista e kandidatëve që regjistrohen në sekretarinë e Senatit. Numri i anëtarëve të KIZ, përcaktohet mbi bazën e numrit të njësive kryesore të institucionit. Në çdo rast ai duhet të jetë numër tek dhe jo më i vogël se 5, njëri prej të cilëve është përfaqësues i studentëve. Nga senati akademik, caktohet dhe sekretari i KIZ-it, i cili është anëtar pa të drejtë vote pranë këtij komisioni.
b) KIZ konstituohet jo më vonë se katër ditë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve.
c) Anëtari i KIZ nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtues dhe/ose për anëtar në organet drejtuese, të çdo niveli.
d) Në mbledhjen e parë të tij KIZ zgjedh, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të tij, Kryetarin. Rezultati i zgjedhjeve publikohet në të gjitha mjediset e institucionit.
e) Gjatë periudhës zgjedhore, KIZ mblidhet jo më pak se tri herë në javë. Mbledhja thirret nga kryetari ose të paktën nga dy anëtarë. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjese jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve. Mbledhjet e KIZ janë të hapura për çdo të interesuar. Prania e kandidatëve, vëzhguesve të kandidatëve dhe përfaqësuesve të MAS në mbledhjet e KIZ është e lejuar.
f) KIZ i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij. Vendimet e KIZ publikohen në mjedisin e institucionit ku është e vendosur selia e tij, jo më vonë se 12 orë pas vendimmarrjes.

2. KIZ ka këto kompetenca:
    a) Nxjerr udhëzime për organizimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor në të gjitha njësitë e institucionit.
    b) Drejton dhe kontrollon të gjithë procesin zgjedhor.
    c) Emëron anëtarët e Komisioneve të Zgjedhjeve të Fakulteteve, të vetëpropozuar në KIZ.
    d) Akrediton vëzhguesit sipas kërkesave të kandidatëve.
    e) Vendos për numrin e qendrave të votimit për çdo njësi kryesore.
    f) Miraton vulën për KIZ, KZF dhe vulën për kryetarin e KZF-së, si dhe të KQV-së, të cilat prodhohen dhe administrohen sipas kuadrit ligjor në fuqi.
    g) Regjistron kandidatët për rektor dhe për anëtarë të Senatit Akademik.
    h) Shpall rezultatin e zgjedhjeve për rektor dhe anëtarë të senatit akademik.
    i) Administron, gjykon dhe merr vendim për ankimet që regjistrohen prej kandidatëve.
3. Mandati i anëtarit të KIZ-it ndërpritet në rastet kur:
    a) Kryen veprimtari në favor të një kandidati;
    b) Vdes;
    c) Jep dorëheqjen nga detyra;
    d) Dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
    e) Me veprimet dhe mosveprimet e tij cenon rëndë veprimtarinë e KIZ dhe procesin zgjedhor;
    f) Mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në tri mbledhje radhazi. Trajtimi i çështjes së ndërprerjes së mandatit të një anëtari të KIZ në këtë rast, bëhet vetëm me kërkesën e të paktën dy anëtarëve të tij. KIZ merr vendim mbi këtë kërkesë, jo me vonë se 1 orë pas depozitimit të saj. Vendimin për ndërprerjen e mandatit e merr KIZ kur për të votojnë "Pro" jo me pak se 2/3 e anëtarëve të tij. Vendi i mbetur bosh plotësohet brenda 24 orëve prej Senatit Akademik.
4. Sekretari i KIZ përgatit materialet për çdo mbledhje të KIZ. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve dhe për çdo rast jep shpjegime për çështjet që i kërkohen. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset e vuloset nga sekretari. Sekretari i KIZ është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të KIZ.

5. Vendimet e KIZ firmosen prej të gjithë anëtarëve dhe vulosen me vulën e KIZ. Çdo anëtar i KIZ krahas nënshkrimit të tij, mund të deklarojë në vendim votën kundër.
6. Kandidatët për rektor kanë të drejtë të kenë përfaqësuesin e tyre pranë KIZ, si anëtar ex-offico, pa të drejtë vote.

Neni 7

Komisionet e Zgjedhjeve në Fakultete

1. Vendimi për ngritjen e Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete, merren nga KIZ, jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e formimit të tij. KIZ zgjedh anëtarët e KZF, me votim të fshehtë, me shumicën e thjeshtë të anëtarësisë së tij, nga lista e kandidatëve që regjistrohen në sekretarinë e KIZ.
2. Numri i anëtarëve të KZF-së përcaktohet mbi bazën e numrit të njësive bazë në njësinë kryesore përkatëse. Në çdo rast, ai duhet të jetë numër tek dhe jo me i vogël se 3 anëtarë, njeri prej të cilëve është përfaqësues i studentëve. Çdo njësi bazë duhet të ketë anëtarin përfaqësues të saj në KZF të vetëpropozuar. Nga KIZ caktohet dhe sekretari i KZF-së, i cili është anëtar pa të drejtë vote pranë këtij komisioni.
3. Anëtari i KZF-së nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtues dhe/ose për anëtar në organet drejtuese, të cilitdo niveli.
4. Mbledhja e parë e KZF-së zhvillohet një ditë pas vendimit të KIZ për ngritjen e tij. Në këtë mbledhje zgjidhet, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të KZF-së, kryetari. Rezultati i zgjedhjeve publikohet në mjediset ku zhvillon aktivitetin akademik njësia kryesore përkatëse.
5. KZF mblidhet jo më pak se tri herë në javë. Mbledhja thirret nga kryetari ose të paktën nga dy anëtarë. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve. Mbledhjet e tij janë të hapura për çdo të interesuar. Prania e kandidatëve në mbledhjet e KZF-së është e lejuar.
6. KZF i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij. Vendimet e KZF-së publikohen në mjedisin e njësisë kryesore, ku është e vendosur selia e tij, jo më vonë se 12 orë pas marrjes së tyre.
7. KZF ka këto kompetenca:
    a. Përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në njësinë kryesore.
    b. Kryen funksionet e Komisionit të Qendrës së Votimit në rastin kur në njësinë kryesore ka vetëm një qendër votimi.
    c. Emëron kryetarin dhe anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit, në rast kur, me vendim të KIZ, në njësinë kryesore votimi do të zhvillohet në më shumë se një qendër votimi.
    d. Regjistron kandidatët për dekan të njësisë kryesore dhe për përgjegjës të njësive bazë.
    e. Publikon listën e zgjedhësve në mjediset e njësisë kryesore pas miratimit përfundimtar të saj.
    f. Shpall rezultatin e zgjedhjeve për dekan të njësisë kryesore dhe për përgjegjës të njësive bazë.
    g. Shpall rezultatin e votimit për rektorin dhe për anëtarët e senatit akademik, të cilin e dërgon në KIZ.
    h. Merr vendim brenda kompetencave të veta mbi ankimet që regjistrohen prej kandidatëve.

8. Kandidatët për dekan dhe drejtues të njësive bazë kanë të drejtë të kenë përfaqësuesin e tyre në KZF dhe KQV, si vëzhgues, të cilët akreditohen prej KIZ.
9. Mandati i anëtarit të KZF-së ndërpritet në rastet kur:
    a. Kryen veprimtari në favor të një kandidati;
    b. Vdes;
    c. Jep dorëheqjen nga detyra;
    d. Dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
    e. Me veprimet dhe mosveprimet e tij cenon rëndë veprimtarinë e KZF dhe procesin zgjedhor;
    f. Mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në tri mbledhje radhazi. Shqyrtimi i çështjes së ndërprerjes së mandatit të një anëtari të KZF-së në këtë rast, bëhet vetëm me kërkesën e të paktën dy anëtarëve të tij, të cilët e paraqesin atë te KIZ. Vendimin për ndërprerjen e mandatit e merr KIZ, jo më vonë se 1 orë pas paraqitjes së kërkesës. Për të duhet të votojnë "Pro" jo me pak se 2/3 e anëtarëve të tij. Vendi bosh plotësohet brenda 24 orëve prej KIZ.
10. Sekretari përgatit materialet për çdo mbledhje të KZF-së. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve dhe për çdo rast jep shpjegime për çështjet që i kërkohen. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset e vuloset nga sekretari. Sekretari është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të KZF-së.
11. Vendimet e KZF-së firmosen prej gjithë anëtarëve dhe vulosen me vulën KZF-së.

Neni 8
Qendrat e Votimit

Pranë çdo njësie kryesore, caktohen Qendrat e Votimit nga KIZ. Si rregull, çdo qendër votimi ka deri në 1000 (një mijë) zgjedhës, të të gjitha trupave zgjedhore, përfshirë studentët. Në rast se njësia kryesore ka më shumë se 1000 (një mijë) zgjedhës, KIZ mund të caktojë më shumë se një qendër votimi për atë njësi kryesore.

Neni 9

Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV)

1. Në rastin kur procesi i votimit do të zhvillohet vetëm në një qendër votimi në njësinë kryesore, detyrat e komisionit të qendrës së votimit kryhen prej KZF-së. Kur KIZ ka vendosur ngritjen e më shumë se një qendre votimi në njësinë kryesore, KZF ngre komisionet e qendrës së votimit (KQV).
2. KQV përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë, njëri prej të cilëve është përfaqësues i studentëve. Anëtarët e KQV emërohen prej KZF në bazë të vetëkandidimeve.
3. Vendimi për formimin e KQV-së merret prej KZF-së jo më vonë se tri ditë para ditës së votimit. Në këtë vendim caktohet edhe kryetari i KQV-së. Njëri prej anëtarëve kryen detyrat e sekretarit të KQV-së.

4. Anëtari i KQV-së nuk mund të kandidojë për asnjë post drejtues ose anëtar në organet drejtuese.
5. Komisioni i qendrës së votimit ka për detyrë vetëm organizimin, zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të votimit ditën e zgjedhjeve. Në përfundim të këtij procesi, KQV administron materialet zgjedhore, sipas procedurës dhe rregullave të caktuara ne këtë rregullore dhe ia dorëzon ato KZF-së.

Neni 10

Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve

1. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, vëzhguesit kanë këto të drejta:
   a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor;
   b) të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë;
   c) të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor;
2. Vëzhguesit kanë këto detyra:
   a) të respektojnë kërkesat e kësaj rregulloreje dhe udhëzimet e KIZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve;
   b) të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat, në qendrat e votimit ose në vende të tjera të ndaluara sipas kësaj rregulloreje;
   c) të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KIZ, si dhe me një dokument identifikimi të pranuar nga KIZ;
   d) të mos mbajnë shenja dalluese, që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit;
   e) të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit, të numërimit dhe administrimit të zgjedhjeve.

KREU III

Zgjedhësit dhe lista e zgjedhësve

Neni 11

Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve

1. Në zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë publik marrin pjesë:
   a) Anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë të njësive kryesore me kohë të plotë. Anëtarët e personelit akademik, që sipas nenit 65 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

kanë mbushur moshën për pension, nuk kanë të drejtë të zgjidhen, si autoritete drejtuese apo në organet drejtuese dhe nuk bëjnë pjesë në trupën zgjedhore.

b) Studentet që ndjekin studimet në ciklin e parë, ciklin e dytë dhe programet profesionale të larta, me kohë të plotë.

2. Lista e zgjedhësve për personelin akademik dhe studentët hartohet për çdo njësi bazë, mbi bazën e të dhënave të regjistrit të personelit akademik, të punësuar me kohë të plotë dhe me kohëzgjatje të pacaktuar që administrohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të institucionit të arsimit të lartë publik. Çdo zgjedhës identifikohet me përbërësit zgjedhorë:
   a) Emri
   b) Atësia
   c) Mbiemri
   d) Datëlindja
   e) Gjinia
   f) Njësia bazë ku është i punësuar/programi mësimor që ndjek studenti.
3. Organ përgjegjës për hartimin e listës së zgjedhësve janë strukturat e burimeve njerëzore të institucionit të arsimit të lartë publik dhe njësitë bazë, departamentet/qendrat e kërkimit shkencor.
4. Procedura për hartimin e listës së zgjedhësve është si më poshtë:
   a) Lista paraprake e zgjedhësve për personelin akademik të njësisë bazë hartohet nga strukturat e burimeve njerëzore, brenda 15 ditëve nga shpallja e ditës së zgjedhjeve.
   b) Lista paraprake dërgohet në njësinë bazë përkatëse, e cila brenda 24 orëve verifikon dhe miraton përbërjen e saj. Lista e miratuar nga përgjegjësi/i ngarkuari me detyrën e përgjegjësit, të njësisë bazë i dërgohet dekanit/drejtorit ose të ngarkuarit me detyrën e dekanit/drejtorit të njësisë kryesore, i cili e miraton dhe e shpall brenda jo më vonë se dy ditëve. Lista e miratuar afishohet në mjediset e njësisë kryesore. Një kopje e listës i dërgohet KIZ-it.
   c) Lista e miratuar duhet të jetë e firmosur në çdo faqe, prej dekanit/drejtorit ose të ngarkuarit me detyrën e dekanit/drejtorit të njësisë kryesore dhe e vulosur me vulën e njësisë kryesore.
5. Lista përfundimtare miratohet nga dekani/drejtori i njësisë kryesore. Organ përgjegjës për hartimin e listës së zgjedhësve për studentët është sekretaria mësimore e njësisë kryesore.
6. Procedura për hartimin e listës së zgjedhësve për studëntet është si më poshtë:
   a) Lista paraprake e zgjedhësve për studentët e njësisë kryesore hartohet prej sekretarisë mësimore të njësisë kryesore jo më vonë se 10 ditë nga shpallja e ditës së zgjedhjeve.
   b) Lista paraprake afishohet në mjediset e njësisë kryesore.
   c) Gjatë një periudhe deri në shtatë ditë pas shpalljes së listës paraprake, sekretaria mësimore pranon kërkesat për korrigjime.
   d) Pas verifikimit të kërkesës, sekretaria realizon korrigjimin e kërkuar.
   e) Pas përfundimit të periudhës për korrigjimin e listës, sekretaria harton listën përfundimtare e cila miratohet prej dekanit/drejtorit ose të ngarkuarit me detyrën e dekanit/drejtorit të njësisë kryesore. Lista e zgjedhësëve për studentët afishohet në mjediset e njësisë kryesore. Një kopje e listës i dërgohet KIZ-it.
   f) Lista e miratuar duhet të jetë e firmosur në çdo faqe, prej dekanit/drejtorit ose të ngarkuarit me detyrën e dekanit/drejtorit të njësisë kryesore dhe e vulosur me vulën e njësisë kryesore.
   g) Lista përfundimtare miratohet nga dekani/drejtori i njësisë kryesore.
7. Shtatë ditë përpara ditës së zgjedhjeve, lista përfundimtare e zgjedhësve për personelin akademik dhe për studentët nuk mund të korrigjohet për asnjë arsye. Pas kësaj periudhe, zgjedhësit që nuk e kanë emrin në listën e zgjedhësve ose kanë gabime në përbërësit

zgjedhorë, mund të votojnë vetëm në rastin kur, pas shqyrtimit të kërkesës së tyre, KIZ vendos me vendim lidhur me kërkesat për të marr pjesë në zgjedhje. Kërkesa të tilla, KIZ mund t'i shqyrtojë deri në dy ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Zgjedhësi i pajisur vendimin e KIZ mund të votojë vetëm me paraqitjen e tij në Komisionin e Qendrës së Votimit.

8. E gjithë procedura për hartimin e listës së zgjedhësve për personelin akademik dhe studentët monitorohet prej KIZ. Për këtë qellim, KIZ miraton një plan pune kalendar dhe cakton dy prej anëtarëve të tij për monitorimin e këtij procesi. Anëtarët përgjegjës raportojnë, në mënyrë periodike në KIZ, për ecurinë e procedurave për hetimin e listës së zgjedhësve.

Neni 12
Trupa zgjedhore për anëtarët e personelit akademik të senatit akademik

Trupa zgjedhore për senatin akademik të një Institucioni publik të Arsimit të Lartë përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i të gjitha njësive kryesore. Personel akademik me kohë të plotë, do të konsiderohet personeli i përcaktuar në germën "a" të pikës 1 të nenit 11 të kësaj rregulloreje.

Neni 13
Trupa zgjedhore për anëtarët student të senatit akademik

Trupa zgjedhore për anëtarët student të senatit akademik të një Institucioni publik të Arsimit të Lartë përbëhet nga studentët të cilët ndjekin studimet me kohë të plotë të ciklit të parë, të dytë dhe të programeve profesionale të larta, në atë institucion.

Neni 14
Trupa zgjedhore për rektorin

Trupa zgjedhore për rektorin e një Institucioni publik të Arsimit të Lartë përbëhet nga:

a) personeli akademik me kohë të plotë i të gjitha njësive kryesore. Personel akademik me kohë të plotë, do të konsiderohet personeli i përcaktuar në germën "a" të pikës 1 të nenit 11 të kësaj rregullore.
b) studentët të përcaktuar në germën "b" të pikës 1 të nenit 11 të kësaj rregulloreje. Votat e studentëve në përzgjedhjen e rektorit llogariten në masën dhjetë përqind të totalit të përgjithshëm të votave.

Neni 15
Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë kryesore

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë kryesore të një Institucioni publik të Arsimit të Lartë përbëhet nga:

a) personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore. Personel akademik me kohë të plotë, do të konsiderohet personeli i përcaktuar në germën "a" të pikës 1 të nenit 11 të kësaj rregulloreje.
b) studentët të përcaktuar në germën "b" të pikës 1 të nenit 11 të kësaj rregulloreje, në atë njësi kryesore. Votat e studentëve në përzgjedhjen e drejtuesit të njësisë kryesore llogariten në masën dhjetë përqind të totalit të përgjithshëm të votave.

Neni 16
Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë bazë

Trupa zgjedhore për drejtuesin e njësisë bazë të një Institucioni publik të Arsimit të Lartë përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë bazë. Personel akademik me kohë të plotë, do të konsiderohet personeli i përcaktuar në germën "a" të pikës 1 të nenit 11 të kësaj rregulloreje.

Neni 17
Trupa zgjedhore për anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore

Trupa zgjedhore për anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore të një Institucioni publik të Arsimit të Lartë përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore. Personel akademik me kohë të plotë, do të konsiderohet personeli i përcaktuar në germën "a" të pikës 1 të nenit 11 të kësaj rregulloreje.

KREU IV

Regjistrimi i subjekteve dhe fushata zgjedhore

Neni 18

Regjistrimi kandidatëve

1. Procesi i regjistrimit i kandidatëve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë publik fillon ditën e shpalljes nga komisioni zgjedhor përkatës dhe përfundon në orën 16.00 të ditës së pestë kalendarike.
2. Dita për fillimin e regjistrimit të kandidatëve për rektor dhe për anëtarë të Senatit Akademik shpallet prej KIZ, dy ditë, kalendarike pas ditës së kostituimit të tij.
3. Dita për fillimin e procedurës për regjistrimin e kandidatëve për dekan/drejtor të njësisë kryesore, përgjegjës të njësisë bazë departament/qendër kërkimi dhe për anëtarë të Komisioneve të përhershme të njësive kryesore, shpallet prej KZF-së dy ditë kalendarike pas ditës së konstituimit të tij.
4. Mosregjistrimi i kandidatëve bëhët me vendim të arsyetuar nga KIZ. Vendimi për mosregjistrim të kandidatëve, është i ankimueshëm pranë komisionit të apelimit.

Neni 19
Kriteret për anëtarët e senatit akademik

1. Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

2. Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik, në institucionet publike të arsimit të lartë i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të kandidatëve me këtë titull dhe për efekt përfaqësimi, kategoria e tyre mund të zbresë, sipas përcaktimeve të bëra në statutin e institucionit.

3. Kandidatët për anëtar të Senatit Akademik, në Institucionet publike të Arsimit të Lartë i përkasin kategorisë student të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe programeve profesionale të larta. Në rastet kur një student i zgjedhur në senatin akademik përfundon studimet universitare ose humbet statusin e studentit, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit, deri në përfundim të mandatit të nisur.

4. Nuk mund të kandidojnë për anëtar të Senatit Akademik, anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë apo studentët që:
   a) Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
   b) Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
   c) Janë të dënuar me parë për vepra penale;
   d) Ndaj tyre është dhënë masë disiplinore.

Neni 20
Kriteret për rektor të institucionit publik të arsimit të lartë

1. Kandidatët për rektor të institucionit publik të arsimit të lartë, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

2. Kandidatët për rektor të institucionit publik të arsimit të lartë, duhet të mbajnë titullin "Profesor" dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose jashtë tij.

3. Nuk mund të kandidojnë për rektor të institucionit publik të arsimit të lartë, kandidatët që:
   a) Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
   b) Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
   c) Janë të dënuar me parë për vepra penale;
   d) Ndaj tyre është dhënë masë disiplinore.
   e) Kanë qenë rektor të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme apo të ndara në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, përllogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara me zgjedhje pavarësisht kohëzgjatjes.
   f) Kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr.80/2015.
   g) Kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese.

Neni 21
Kriteret për drejtues të njësisë kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë

1. Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
2. Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë, i përkasin kategorisë "Profesor" dhe mund të vijnë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose jashtë tij.
3. Nuk mund të kandidojnë për drejtues të njësisë kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë, kandidatët që:
   a. Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;

b. Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
c. Janë të dënuar me parë për vepra penale;
d. Ndaj tyre është dhënë masë disiplinore;
e. Kanë qenë drejtues të njësisë kryesore të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme apo të ndara në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, përllogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara me zgjedhje pavarësisht kohëzgjatjes;
f. Kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr.80/2015;
g. Kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese.

Neni 22
Kriteret për drejtues të njësisë bazë në institucionet publike të arsimit të lartë

1. Kandidatët për drejtues të njësisë bazë në institucionet publike të arsimit të lartë, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
2. Kandidatët për drejtues të njësisë bazë në institucionet publike të arsimit të lartë, janë personel akademik me kohë të plotë i njësisë bazë që i përkasin kategorisë "Profesor" ose ka gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore "Doktor".
3. Nuk mund të kandidojnë për drejtues të njësisë bazë në institucionet publike të arsimit të lartë, kandidatët që:
    a. Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
    b. Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
    c. Janë të dënuar me parë për vepra penale;
    d. Ndaj tyre është dhënë masë disiplinore.
    e. Kanë qenë drejtues të njësisë bazë të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme apo të ndara në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, përllogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara me zgjedhje pavarësisht kohëzgjatjes.
    f. Kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit nr.80/2015.
    g. Kandidojnë për autoritete të tjera drejtuese.

Neni 23
Kriteret për anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë

1. Kandidatët për anëtarë të komisioneve të përhershme të njësive kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
2. Numri i komisioneve dhe vendeve për anëtarë të komisioneve të përhershme të njësive kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë, përcaktohen nga senati akademik në përputhje me përcaktimet e statutit të IAL-së, por jo më pak se pesë anëtarë për secilin komision. Në përbërje të komisioneve të përhershme përfaqësohen edhe studentët, sipas

përcaktimeve të statutit të institucionit të arsimit të lartë, me përjashtim të Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" dhe Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në rast se institucionet e gëzojnë të drejtën për ngritjen e këtyre komisioneve.
3. Kandidatët për anëtarë të komisioneve të përhershme të njësive kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë, vijnë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë.
4. Nuk mund të kandidojnë për anëtarë të komisioneve të përhershme të njësive kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë, kandidatët që:
   a) Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
   b) Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
   c) Janë të dënuar me parë për vepra penale;
   d) Ndaj tyre është dhënë masë disiplinore.

Neni 24
Kandidimi

1. Kandidatët për autoritete drejtuese të të gjithë niveleve, për Senatin akademik dhe komisionet e përherëshme, vetëkandidohen.
2. Kandidatët për Senatin Akademik, përfaqësues i studentëve, propozohet prej Këshillit studentor të njësisë kryesore. Çdo Këshill studentor ka të drejtën të propozojë një kandidat.
3. Dokumentet e kandidimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe kërkesat e kësaj rregulloreje.

Neni 25
Dokumentacioni për kandidim

1. Dokumentacioni për kandidim nga kandidatët dorëzohet në KIZ dhe përmban:
   a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim; deklarimin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion; deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale; deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
   b) Kopje të dokumentit të identifikimit;
   c) Kopje të noterizuar të titullit akademik;
   d) Dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar.

2. Dokumentet e kandidimit për studentët dorëzohen në KIZ, dhe përmbajnë:
   a. Kërkesën për kandidim, e cila përfshin, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim.
   b. Kopje të dokumentit të identifikimit;
   c. Vërtetimin që provon se është student me kohë të plotë në institucionin e arsimit të lartë publik përkatës;
   d. Vendimin e Këshillit studentor të njësisë kryesore për kandidimin e tij për anëtar në Senatin Akademik;

3. Pas verifikimit të dokumentacionit KIZ, jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listën e kandidatëve për rektor dhe të kandidatëve për Senatin Akademik. Listat shpallen publikisht në mjediset e të gjithë njësive kryesore të institucionit të arsimit të lartë publik.
4. Pas verifikimit të dokumentacionit, KZF, jo më vonë se 48 orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listën e kandidateve për drejtues, dekan/drejtor, të njësisë kryesore, dhe listën e kandidateve për drejtues të njësisë bazë/qendrës së kërkimit shkencor, për secilin prej njësive bazë/qendrave të kërkimit shkencor të njësisë kryesore dhe të kandidatëve për komisionet e përhershme, si dhe listën e kandidatëve për anëtar të senatit akdemik.
5. Pas regjistrimit, çdo kandidati i jepet vërtetimi i regjistrimit si kandidat prej komisionit zgjedhor që kryen regjistrimin e tij. Forma e këtij vërtetimi miratohet me vendim të KIZ.

Neni 26
Kohëzgjatja e mandateve

Organet dhe autoritetet drejtuese zgjidhen për një mandat 4-vjeçar, ndërsa komisionet e përhershme të njësive kryesore zgjidhen për një mandat 2-vjeçar. Rastet e ndërprerjes së mandateve përcaktohen në kuadrin ligjor në fuqi.
Mandati i anëtarëve të KIZ, është 4- vjeçar.

Neni 27

Përfaqësimi i njësive kryesore në Senatin Akademik

1. Jo më vonë se tri ditë kalendarike pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve, Senati Akademik i institucionit të arsimit të lartë publik, cakton me vendim, numrin e përfaqësuesve në Senatin Akademik të ardhshëm. Numri i përfaqësuesve duhet të jetë numër tek. Në çdo rast, ky numër duhet të sigurojë përfaqësimin në Senatin Akademik të të gjithë njesive kryesore të institucionit të arsimit të lartë publik. Numri i përfaqësuesve për çdo njësi kryesore përcaktohet duke patur parasysh numrin e programeve që zhvillon njësia dhe numrin e studentëve që ndjekin studimet në njesinë përkatëse.
2. Numri i përfaqësuesve në Senatin Akademik për studentët duhet të jetë në masën deri në dhjetë përqind të numrit të anëtarëve të senatit.

Neni 28

Fushata zgjedhore

1. Fushata zgjedhore fillon një ditë pas shpalljes së zgjedhjeve nga minsitri.
2. Fushata zgjedhore përfundon 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Dita para datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve deri në mbylljen e votimit, formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore.
3. Kancelaret/Administratoret dhe administrata e institucionit duhet të krijojë kushte të përshtatshme dhe të barabarta të gjithë kandidatëve për të zhvilluar aktivitetet e tyre në kuadër të fushatës elektorale. Në përputhje me kërkesën e kandidatit për kohën dhe vendin për zhvillimin e aktivitetit, administrata e institucionit merr të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e tij, jashtë orëve të mësimit që zhvillohen në institucion.

KREU V

Përgatitja e infrastrukturës dhe e dokumentacionit për zgjedhjet

Neni 29

Vendndodhja e komisioneve zgjedhore dhe vendeve të numërimit të votave

1. Vendndodhja e komisoneve zgjedhore përcaktohet sipas rregullit të mëposhtëm:
   a) Selia e KIZ vendoset në godinën ku ndodhet administrata qendrore e institucionit të arsimit të lartë publik.
   b) Selia e KZF-së vendoset në godinën ku zhvillon aktivitetin mësimor ose kërkimor njësia kryesore.
2. Vendet e numërimit të votave përcaktohen sipas rregullit të mëposhtëm:
   a) Votat për rektor, drejtuesin e njesisë kryesore, drejtuesin e njesisë bazë/qendrës së kërkimit shkencor dhe për anëtar të Senatit Akademik, anëtar të Komisioneve të Përhersheme numërohen në një sallë në godinën ku zhvillon aktivitetin mësimor ose kërkimor njësia kryesore.
   b) Vendet e numërimit të votave duhet të jenë salla me përmasa të medha, të cilat të krijojnë mundësinë, për zhvillimin normal të procesit të numërimit të votave. Organizimi i sallës për numërimin votave duhet të bëhen i tillë që t'iu japë mundësi përfaqësuesit e MAS, vëzhguesve dhe kandidatëve të vëzhgojnë procesin e vlerësimit dhe numërimit të votave.

Neni 30

Komisionet për vlerësimin dhe numërimin e votave

1. Votat për rektor, anëtarë të Senatit Akademik, drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë/qendrës së kërkimit shkencor dhe për anëtar të komisioneve të përhershme të njësive kryesore, vlerësohen dhe numërohen prej KZF-së.
2. KZF, pas numërimit të votave, plotëson tabelat zgjedhore për secilën kategori dhe ia përcjell KIZ.
3. KIZ, pas kalimit të afateve për ankimimin, shpall fituesit sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

Neni 31

Përgatitja e dokumentacionit zgjedhor

1. Për zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik, personeli akademik voton me pesë fleta me ngjyra të ndryshme:
   a) Fletëvotimi për rektor;

b) Fletëvotimi për drejtues të njësisë kryesore;
c) Fletëvotimi për drejtues të njësisë bazë/qendrës së kërkimit shkencor;
d) Fletëvotimi për anëtar të Senatit Akademik nga personeli akademik;
e) Fletëvotimi për komisionet e përherëshme nga personeli akademik;

2. Për zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik studentët votojnë me katër fletë votimi me ngjyra të ndryshme:
   a) Fletëvotimi për rektor;
   b) Fletëvotimi për drejtues të njësisë kryesore;
   c) Fletëvotimi për anëtarë të senatit akademik, përfaqësues i studentëve;
   d) Fletëvotimi për anëtarë të komisioneve të përhershme, përfaqësues i studentëve;
3. Sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve, duke i shtuar 2 përqind.
4. Fleta e votimit përgatitet prej KIZ. Duhet të jetë prej letre, me ngjyrë dhe trashësi që të mos lejojë leximin e votës në pjesën e pasme të saj. Fletët e votimit prodhohen në blloqe pa kundërfletë me numra serial unik. Informacioni që përmban fleta e votimit është:
   a) Në krye të fletës së votimit vendoset emërtesa për të cilin do të përdoret;
   b) Emërtimi i autoritetit drejtues ose Senati Akademik;
   c) Emri, atësia, mbiemri për kandidatët e regjistruar për autoritetin ose organin drejtues përkatës, të cilët renditen sipas rendit alfabetik;
   d) Në rastin kur për autoritetin drejtues ose anëtar i Senatit Akademik është regjistruar dhe konkurron vetëm një kandidat, në fletën e votimit krahas emrit të tij vendosen alterantivat për votim "Pro" ose "Kundër";
   e) Fleta e votimit për studentët në sfond të saj ka të shkruar "Për student".

Neni 32

Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KIZ në KZF

1. Një ditë përpara datës së zgjedhjeve, KIZ dërgon në KZF materialet zgjedhore, si më poshtë:
   a) Fletet e votimit për personelin akademik dhe për studentët, në përputhje me numrin e votuesve në njësinë kryesore të institucionit të arsimit të lartë publik;
   b) Listen e zgjedhësve për personelin akademik dhe listën e zgjedhësve për studentët;
   c) Vulën e KZF-së;
   d) Vulën e KQV-së, në rast se në njësinë kryesore do të ketë më shumë se një qender votimi.
   e) Procesverbalet e qendrës së votimit, ku bëjnë pjesë procesverbalet për vulosjen e kutive të votimit, hapjen e qendres se votimit, pezullimin e votimit si dhe mbylljen e votimit;
   f) Zarfin në të cilin është shënuar "Fletëvotimi të dëmtuara";
   g) Zarfin në të cilin është shënuar "Fletëvotimi të papërdorura";
   h) Zarfin në të cilin është shënuar " Zarfi i procesverbalit të vulosjes";
2. Përveç kutisë me materiale zgjedhore në KZF dërgohen edhe kutitë e votimit:
   a) Kutia e votimit për rektor;
   b) Kutia e votimit për dekan/drejtor të njësisë kryesore;
   c) Kutita e votimit për përgjegjës të njësisë bazë/qendër e kerkimit shkencor;
   d) Kutia e votimit për anëtarët e Senatit akademik nga personeli akademik i njësisë kryesore;
   e) Kutia e votimit për anëtar të Senatit akademik përfaqësues i studentëve;
   f) Kutitë e votimit për Komisionet e përhershme;

g) Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZF-së;
h) Tabelat për rezultatin e zgjedhjeve për secilën kategori;
i) Dhomat e fshehta.
j) Vulat me kodet e sigurisë.

KREU VI

Votimi

Neni 33

Veprimet paraprake për hapjen e qendrës së votimit

1. KZF nën drejtimin e kryetarit dhe sekretarit dhe në prani të vëzhguesve, një orë përpara hapjes së qendrës së votimit, kryen këto detyra:
   a) vendos tryezat, karriget, dhomën e fshehtë dhe kutitë e votimit në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtesia e votimit, levizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve;
   b) afishon udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm brenda qendrës së votimit;
   c) kontrollon të gjitha materialet e marrë në dorëzim;
   d) u tregon vezhguesve kutitë e votimit të zbrazëta. Në faqen e përparme të çdo kutie votimi vendoset emërtimi për autoritetin që do të votohet me ngjyrë të njëjtë me atë të fletës përkatëse të votimit.
   e) mbyll kutitë e votimit me kodet e sigurisë dhe i shkruan këeto kode në procesverbalin e vulosjes së kutive të votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KQV-së. Procesverbali mbyllet ne zarfin ku është shkruar "Zarfi i procesverbalit të vulosjes", i cili futet në e kutinë e votimit për rektor para fillimit të procesit të votimit.
2. Anëtarët e KZF-së, në prani të kandidatëve/vëzhguesve dhe përfaqësuesve të MAS, në rast se paraqiten, marrin vendim për hapjen e votimit dhe e nënshkruajne atë.
3. Të njëjta veprime kryen edhe nga KQV-ja në rastin kur në njësinë kryesore votimi kryhet në më shumë se një qendër votimi.

Neni 34

Procedurat e votimit

1. Votimet për autoritetet drejtuese të të gjitha niveleve dhe Senatin Akademik në lnstitucionet e Arsimit të Lartë Publik zhvillohen në një ditë të vetme, në datën e caktuar nga ministri i Arsimit dhe Sporteve.
2. Pas kryerjes së detyrave të përcaktura në këtë rregullore, kryetari i KZF-së (KQV) deklaron hapjen e votimit jo më përpara se ora 8.00.

3. Sekretari shënon në Librin e Protokollit të KZF-së (KQV) kohën e largimit dhe të kthimit të çdo anëtari të komisionit prej qendrës së votimit. Kur kryetari largohet nga qendra e votimit, ai ia kalon vulën e kryetarit për përdorim një anëtari të komisionit.
4. Fletët e votimit vulosen, në pjesen e pasme, në vendin e caktuar me vulën e KZF-së, të cilat mbajnë respektivisht shkrimin "KZF dhe emrin e Njesisë kryesore/Njësisë Bazë".
5. Në qendrën e votimit vendosen kuti votimi në numër të barabartë me numrin e autoriteteve drejtuese, rektor, dekan/drejtor, përgjegjës departamenti/qendër shkencore dhe komisione të përhershme për të cilat kryhet votimi në njësinë kryesore të institucionit të arsimit të lartë publik dhe dy kuti per Senatin akademik një për anëtarët e senatit nga personeli akademik dhe një për anëtar senati përfaqesues i studentëve.
6. Zgjedhësit qëndrojnë në radhë jashtë qendrës së votimit dhe futen njëri pas tjetrit në qendrën e votimit për të votuar, me thirrjen e nje anëtari të komisionit. Pasi hyn në qendrën e votimit:
   a) zgjedhësi thotë emrin e tij, nëse është personel akademik apo student, njësinë bazë ku bën pjesë dhe paraqet para komisionit një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit me të dhëna biometrike
      i. Letërnjoftim
      ii. Pasaportë
   b) kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë të dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë;
   c) zgjedhësi që është pajisur nga KIZ me vendim për të votuar pasi hyn në qendër e paraqet atë te kryetari i qendrës. Emri i këtij zgjedhësi dhe numri i kartës se identitetit të tij shënohet në një regjistër të veçantë;
   d) zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij;
   e) zgjedhësit, personel i stafit akademik, i jepen për të votuar fletët e votimit për rektor, për drejtues të njësisë kryesore, për përgjegjës departamenti/qendre kërkimore shkencore në të cilën bëjnë pjesë dhe për fletën e votimit për anëtarë të personelit akademik në Senatin Akademik;
   f) zgjedhësit, studentit, i jepen për të votuar fletët e votimit për rektor, për drejtues të njësisë kryesore, për anëtarë në Senatin Akademik përfaqesues i studenteve;
   g) çdo fletë e votimit vuloset, në pjesën e pasme të saj, me vulën e KZF /KQV-së.
   h) pasi merr fletët e votimit zgjedhësi hyn në dhomën e fshehtë dhe:
      i. në fletën e votimit për rektor, për drejtues të njësisë kryesore dhe për drejtues të njësisë bazë, shënon në krah të emrit të kandidatit shkruan shenjen "x"/ "+" ose ndonjë shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Shenja duhet të vendoset vetëm në krah të një emri. Në rastin kur për autoritet drejtues konkuron vetem një kandidat zgjedhësi voton një nga altemativat e shkruajtura krahas emrit të kandidatit "Pro" ose "Kundër";'
      ii. Në fletën e votimit për anëtarë të senatit akademik shënon, në krah të emrave të kandidatëve shenjen "x"/ "+" ose ndonjë shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Zgjedhësi duhet të shënojë jo më shumë emra se sa është numri i mandateve në Senatin Akademik që i përkasin njësisë krysore përkatëse. Në rast se numri i kandidateve është i barabartë ose më i vogel se numri i mandateve në Senatin Akademik që i janë caktuar njësisë kryesore, zgjedhësi shënon në krah të emrit të secilit kandidat njërën prej alternativave "Pro" ose "Kunder";
      iii. pasi bën shënimin në fletën e votimit, i palos fletët në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, del nga dhoma e fshehtë, i hedh fletet në kutitë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit;
   i) Nëse shënimi në fletën e votimit apo në të paktën një nga fletët e votimit bëhet jashtë dhomës së fshehtë, zgjedhësi nuk lejohet të fusë fletën/fletet e votimit në kuti. Kryetari i

qendrës e merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët "E dëmtuar"dhe e fut atë në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara". Në këtë rast, zgjedhësit i jepet nje fletëvotimi tjetër e të njejtit lloj dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin "Fletëvotimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletëvotimi. Nëse zgjedhësi bën shënim ose e dëmton fletën e votimit pa dashje dhe kërkon një fletëvotimi të dytë, fleta e votimit konsiderohet e dëmtuar dhe futet në zarfin "Fletëvotimi të demtuara" dhe zgjedhësit i jepet një fletëvotimi të dytë. Rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Nëse zgjedhësi shënon ose dëmton përsëri pa dashje fletën e dytë të votimit, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin "Fletëvotimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletëvotimi. Në asnjë rast fletët e votimit të dëmtuara nuk hidhen në kutitë e votimit.

j) Qendra e votimit organizohet në një menyrë të tillë që të lehtësojë procesin e votimit dhe të garantojë plotësisht fshehtesinë e votës. Në qendrën e votimit është e ndaluar përdorimi i mjeteve të komunikimit apo regjistrimit nga ana e votuesit. Në qendren e votimit mund të qëndrojnë vetëm:
   i. anëtarët dhe sekretari i KZF/KQV-së;
   ii. zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit deri në përfundim të tyre;
   iii. vëzhguesit e akredituar;
   iv. përfaqësuesit e MAS.

Neni 35

Mbyllja e votimit

1. Qendrat e votimit mbyllen në orën e caktuar. Nëse edhe pas kalimit të këtij orari ka zgjedhës që presin në radhë, komisioni mbledh dokumentet e identifikimit të të gjithë zgjedhësve të pranishëm dhe i thërret ata me radhë për të kryer votimin. Asnjë zgjedhës tjetër nuk do të lejohet të votojë nëse nuk ka qenë në radhë në kohën e mbledhjes së dokumentit të identifikimit.
2. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishem, komisioni merr vendim për mbylljen e votimit, duke plotësuar formularin përkatës, ku shënohet edhe ora e mbylljes së votimit. Pas kësaj, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët dhe sekretari i KZF/KQV-së, si dhe vëzhguesit e akredituar, kandidatët dhe përfaqësuesit e MAS-it.

Neni 36

Veprimet pas mbylljes së qendrës së votimit

1. Pas marrjes së vendimit për mbylljen e votimit, kryetari së bashku me anëtarët e KZF/KQV-së kryejnë, sipas radhës, veprimet e mëposhtme:
2. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve;
   a) shënon numrin e zgjedhësve që kanë votuar nga personeli i stafit akademik dhe student, duke numëruar nënshkrimet e bëra në listën përkatëse të zgjedhësve, si dhe atyre që janë në regjistrin e veçantë, që kanë votuar sipas kushteve të parshikuara në këtë rregullore.

b) ia deklaron shifrat me zë të lartë anëtarëve të tjerë të Komisionit dhe vëzhguesve të pranishëm;
c) i fton ata të verifikojnë shifrat e thënë prej tij;
d) urdhëron sekretarin e komisionit të shënojë në procesverbalin për "Mbylljen e votimit" numrin e personave që kanë votuar në qendrën e votimit. Në rast kundërshtimesh për përcaktimin e shifrës, pretendimet shënohen në procesverbal.

3. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve, pasqyron në procesverbalin për "Mbylljen e votimit" numrin e plotë të fletëve të votimit të qendrës së votimit, për secilin prej kategorive, duke u bazuar tek të dhënat që kanë shoqëruar marrjen në dorëzim të fletëve të votimit nga KIZ, numrin e fletëve të papërdorura dhe numrin e fletëve të demtura për secilën kategori.
4. Kryetari, nën vezhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, fillon numërimin e fletëve të votimit të papërdorura për secilin prej kategorive dhe në përfundim të numërimit ia bën të ditur shifrat anëtarëve të komisionit. Nëse kërkohet nga një anëtar i komisionit ose ndonjë nga vëzhguesit, kryetari është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit të paperdorura. Në përfundim të numërimit, fletët e votimit të papërdorura mbyllen në zarfin ku është shënuar "Fletëvotimi të papërdorura" për secilën kategori. Numri fletëve të votimit të papërdorura pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit".
5. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, numëron fletët e votimit të dëmtuara që gjenden ne zarfin "Fletëvotimi të dëmtuara" për secilën kategori. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit".
6. Në përfundim të veprimeve të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni, futen:
   a) në kutinë e materialeve zgjedhore për zgjedhjen e rektorit:
      i. zarfi "Fletëvotimi të papërdorura për zgjedhjen e rektorit";
      ii. zarfi "Fletëvotimi të dëmtuara për zgjedhjen e rektorit";
      iii. Procesverbalin për numrin e fletëve të votimit gjithsej, numrin e fletëve të papërdorura dhe numrin e fletëve të dëmtuara.
   b) Për secilën kategori veprohet në të njëjtën mënyrë.
7. Mbyllet kutia e votimit. Elementët e sigurisë për mbylljen e këtyre kutive shënohen në procesverbal.
8. Kutia e votimit dhe kutia e materialeve zgjedhore përkatëse dërgohet në KIZ. Kutitë shoqërohen nga dy anëtarë të KZF-së dhe mund të shoqërohen nga vëzhguesit e kandidatëve dhe përfaqësues të MAS-it.
9. Në rastin kur në njesinë kryesore votimi është kryer në më shume se një qendër votimi, komisioni qendrës së votimit pas administrimit të materialeve zgjedhore sipas rregullave të përcaktuara në këtë nen, i dorëzon ato së bashku me kutinë e votimit për rektor në KZF, e cila është përgjegjëse për transportin e tyre në KIZ.

Neni 37

Vlerësimi, numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultatit për zgjedhjen e rektorit, autoritetetit drejtues në njesitë kryesore, autoritetit drejtues në njesitë bazë, për anëtare në Senatin Akademik dhe për anëtarë në Komisionet e përhershme në njësitë kryesore

1. Procedurat për vlerësimin, numërimin dhe nxjerrjen e rezultatit për zgjedhjen e rektorit, autoritetetit drejtues në njësitë kryesore, autoritetit drejtues në njesitë bazë, për anëtarë në

Senatin Akademik dhe për anëtarë në Komisionet e përhershme në njësitë kryesore kryhen prej KZF-së, në një sallë të caktuar prej saj dhe që ndodhet në mjediset e njësisë kryesore.

2. Në rastin kur procesi i votimit është kryer në më shumë se një qendër votimi në njësinë kryesore, Komisioni i qendrës së votimit, pasi ka perfunduar administrimin e materialeve zgjedhore sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, i dorëzon ato në sallën e numërimit të votave, KZF-së. Dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe i kutive të votimit bëhet me procesverbal.
3. Vlerësimi, numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultateve zhvillohet sipas radhës së mëposhtme:
   a) Rektor;
   b) Drejtues i njësisë krysore
   c) Drejtuesi i njësisë bazë/qendrës së kërkimit shkencor
   d) Anëtarë të Senatit Akademik (personel akademik dhe student)
   e) Anëtarë të Komisioneve të përhershme në njësitë kryesore (personel akademik dhe student).
4. Kryetari hap kutinë e votave për rektor, nxjerr nga kutia fletët e votimit, i shpalos dhe i vendos mbi tryezë me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme. Pas kësaj:
   a) vlerëson të gjitha votat e gjetura në kuti, duke ia treguar të gjithë anëtarëve të komisionit dhe vëzhguesve. Votat e pavlefshme ndahen në një grup të veçantë.
   b) numëron votat e vlefshme dhe vota e pavlefshme, numri i tyre, së bashku me numrin e përgjithshëm të votave të gjetuara në kuti shënohen në procesverbal.
   c) verifikon numrin e përgjithshëm të votave të gjetur në kuti me numrin e votave që duhet të ishin në kuti në bazë të të dhënave të procesverbalit të KZF /KQV-së për numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit, fletët e votimit të papërdorura dhe fletët e votimit të dëmtuara. Rezultati shënohet në procesverbal.
   d) ndan në grupe të veçanta votat e hedhura nga personeli akademik dhe nga studentët dhe i numëron votat e secilit grup. Numri i tyre shënohet në procesverbal.
   e) ndan votat e personelit akademik në grupe sipas emrit të kandidatit dhe i numëron. Votat e gjetura shënohen në procesverbal.
   f) ndan votat e studentëve në grupe sipas emrit të kandidatit dhe i numëron. Votat e gjetura shënohen në procesverbal.
   g) harton tabelën përfundimtare për votimin në njësinë kryesore përkatëse dhe e miraton me vendim.
5. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:
   a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KIZ;
   b) fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në këtë rregullore;
   c) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;
   d) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;
   e) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
   f) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
   g) nuk është e qartë se për kë është votuar ose zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit.
6. Në rast se në njesinë kryesore është votuar në më shumë se një qendër votimi, KZF vlerëson dhe numëron votat për secilën qendër votimi sipas procedurës së përshkruar më sipër.
7. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave për rektor, KZF harton tabelën e rezultatit të votave për rektor. Kopje e tabelës të rezultatit të votave për rektor u jepet, sipas kërkesës, vëzhguesve, kandidatëve dhe përfaqësuesve të MAS.

8. Në rastin kur nuk ka asnjë fitues, KIZ, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje, merr vendim për organizimin dhe zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve.
9. KZF vazhdon procesin e vlerësimit dhe numërimit të votave për drejtues të njësisë kryesore, drejtues të njësisë bazë, për anëtarët e Senatit Akademik dhe Komisioneve të përhershme duke ndjekur për aq sa është e nevojshme procedurën e përshkruar në këtë nen.
10. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave, KZF harton tabelën përfundimtare të rezultateve të votimit dhe shpall me vendim të veçantë, rezultatet për secilën kategori. Tabela përfundimtare dhe vendimi i KZF-së, nënshkruhen nga të gjithë anëtarët duke deklaruar votën "pro" apo "kundër"dhe vulosen nga sekretari. Kopje të tabelës përfundimtare të rezultatit të zgjedhjeve ju jepet sipas kërkesës, vëzhguesve të kandidatëve.
11. Mënyra e përllogaritjes së votave për të gjitha kategoritë do të jetë:

    $R\% = \frac{A}{N_1} * 90\% + \frac{B}{N_2} * 10\%$

    R% - është rezultati i shprehur në përqindje e një kandidati për një pozicion të caktuar;

    A – është numri i votave pro kandidatit nga personeli akademik;

    N_1 – është numri i përgjithshëm i votave të vlefshme nga personeli akademik;

    B – është numri i votave pro kandidatit nga studentët;

    N_2 – është numri i përgjithshëm i votave të vlefshme nga studentët.

12. Vendimet e KZF për tabelat e rezultateve të zgjedhjeve ankimohen në KIZ.
13. Gjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave në vendin e numërimit të votave kanë të drejtë të qendrojnë anëtarë dhe sekretari i KZF-së, kandidatet dhe vëzhguesit e tyre të akredituar dhe përfaqësuesit e MAS-it.
14. Çdo kontestim i kandidateve apo vëzhguesve të tyre, shënohet detyrimisht në librin e procesverbaleve nga sekretari i KZF-së.

Neni 38

Ankimet

1. Çdo kandidat pjesëmarrës në zgjedhjet për autoritete drejtues ose anëtar në Senatin Akademik ka të drejtë të ankohet në KIZ kundër vendimeve të KZF-së që cënojnë interesat e tij, brenda 2 ditëve, kalendarike, nga data e shpalljes së vendimit.
2. Kundër vendimeve të KZF-së për shpalljen e tabelave të rezultatit, tabelave përmbledhëse të rezultatit dhe rezultatit të zgjedhjeve, ankimi bëhet në KIZ jo më vonë se 2 ditë kalendarike, nga data e shpalljes së tyre.
3. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha dyditore fillon në orën 16.00 të ditës së shpalljes së aktit për të cilin bëhet ankimi dhe përfundon në orën 16.00, pas dy ditëve kalendarike.
4. KIZ administron dhe merr vendim për ankimet për çështje që nuk lidhen me rezultatin e zgjedhjeve jo më vonë se 24 orë pas paraqitjes së tyre.
5. KIZ administron dhe merr vendime për ankimet për rezultatin e zgjedhjeve jo më vonë se 48 orë pas paraqitjes së tyre.
6. Çdo vendim i KIZ është i ankimueshem në Komisionin e Apelimit.

Neni 39

Ankimi në Komisionin e Apelimit

1. Komisioni i Apelimit përbëhet nga 5 anëtarë. Tre anëtarë përzgjidhen me short nga Senati Akademik i institucionit te arsimit të lartë publik, një prej të cilëve duhet të jetë me profesion jurist. Dy anëtarë të këtij komisioni janë detyrimisht përfaqësues të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.
2. Për formimin e tij, Senati Akademik i institucionit të arsimit të lartë publik tre dite pas shpalljes se ditës se zgjedhjeve prej Ministrit të Arsimit dhe Sportit, publikon kërkesën për aplikim për anëtar në Komisionin e Apelimit të institucionit. Të drejten për te aplikuar e kane individët që:
   a. Kanë përvojë pune në mësimdhënie, jo me pak se 5 (pesë) vjet, me kohë të plotë;
   b. Nuk kanë qenë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
   c. Nuk kanë lidhje gjinore në vijë të drejtë ose të tërthortë, deri në shkallë të katërt, me kandidate që konkurrojne në zgjedhje. Në rast konstatimi të tillë, anëtari dorëhiqet menjëherë dhe zëvëndësohet nga Senati Akademik me short ose nga MAS.
3. Komisioni i zgjedhur i Apelimit, në mbledhjen e parë zgjedh Kryetarin dhe Sekretarin e tij, me shumicën e thjeshtë të votave. Komisioni i Apelit i ushtron funksionet e tij për një mandat 4- vjeçar.
4. Rregullat për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Apelimit hartohen dhe vendosen prej këtij komisioni, menjëherë pas konstituimit të tij dhe zgjedhjes të kryetarit dhe sekretarit.
5. Anëtarët e Komisionit të Apelimit shpërblehen për punën që bëjnë. Masa dhe mënyra e shpërblimit të tyre caktohet me vendim të bordit/këshillit të administrimit të institucionit të arsimit të lartë publik.
6. Komisioni i Apelimit shqyrton dhe merr vendim të arsyetuar, në të cilin përfshihen dhe mendimet "kundër", për çdo ankim për vendime të marra prej KIZ;
7. Vendimi i Komisionit te Apelimit është i formës së prerë, përfundimtar, i detyruar për t'u zbatuar.
8. Kundër vendimeve të komisionit të aplelimit, bëhët ankim në rrugë gjyqësore nga palë që ka interes të ligjshëm.

Neni 40

Pavlefshmeria e zgjedhjeve

1. KIZ, kryesisht ose me kërkesë të kandidateve, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një ose më shumë njësi kryesore, në rast se:
   a) kanë ndodhur shkelje të ligjit;
   b) mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në fitimin e mandateve;
   c) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim;
   d) votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë.
2. Kërkesën për pavlefshmëri të zgjedhjeve kërkuesi duhet ta shoqërojë me shpjegimin për shkaqet ligjore ku mbështetet kërkesa, përshkrimin e shkeljeve të pretenduara dhe arsyetimin e detajuar të tyre për pasojat që kanë prodhuar.
3. Shqyrtimi i kërkesës dhe vendimi për pavlefshmëri duhet të kryhet nga KIZ, jo me vonë se dy ditë kalendarike nga depozitimi i tyre.
4. Pas përfundimit të ankimit në Komisionin e Apelimit, jo më vonë se dy ditë kalendarike pas shpalljes së vendimit përfundimtar, për zgjedhjet e shpallura të pavlefshme, KIZ shpall

përsëritjen e tyre në një datë që nuk duhet të jetë me vonë se dy javë nga dita e vendimit për pavlefshmëri.

Neni 41

Dispozita te fundit

1. Në rastet e mosmiratimit të komisioneve të përhershme në njësitë kryesore, për këto organe nuk zhvillohen zgjedhje, deri në miratimin e tyre, sipas kuadrit ligjor në fuqi.
2. Me përfundimin e procesit të shqyrtimit të ankimimeve në Komisionin e Apelimit, KIZ shpall rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për autoritete drejtuese dhe Senatin Akademik të institucuionit të Arsimit te Larte publik, si dhe kategoritë e tjera sipas përcaktimeve të kësaj rregullore.
3. Data e thirrjes se mbledhjes së parë të Sanatit Akademit te institucionit të arsimit të lartë publik caktohet nga ministri i Arsimit dhe Sporteve. Kjo datë shënon edhe shfuqizimin e Senatit të mëparshëm dhe fillimin e punës së Senatit të ri.
4. KIZ i përcjell ministrit të Arsimit dhe Sporteve vendimin për shpalljen e fituesit rektor të institucionit të Arsimit të Lartë publik. Ministri i Arsimit dhe Sporteve, pas verifikimit të ligjshmërisë së procesit zgjedhor, i percjell presidentit të Republikes vendimin e KIZ për shpalljen e fituesit rektor të institucionit të Arsimit të Lartë publik.
5. Rektori i zgjedhur dhe dekretuar, emeron drejtuesit e zgjedhur të njësive kryesore të institucionit të arsimit të lartë publik, brenda muajit të parë të dekretimit të tij.
6. Dekani/Drejtori i zgjedhur i njësisë kryesore emëron drejtuesit e zgjedhur të njësive bazë/qendrave të kërkimit shkencor, brenda muajit të parë të emrimit të tij.
7. I gjithë dokumentacioni zgjedhor ruhet në arshivën e institucionit, në bazë të rregullave të përcaktuara në kuadrin ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arshivimin e dokumentacionit.
8. Kjo rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar si e tillë nga të gjithë institucionet e arsimit të lartë publik në Republikën e Shqipërisë.
9. Monitorimi i procesit zgjedhor në të gjithë komisionet zgjedhore apo qendrat e votimit, realizohet nga vëzhguesit e akredituar të kandidatëve, kandidatët dhe përfaqësuesit e MAS-it.

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA

URDHRA TË MINISTRIT PËRGJEGJËS PËR ARSIMIN

URDHËR

Nr. 294, datë 17.08.2015

PËR SHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, PËR KANDIDATËT NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, SI DHE KANDIDATËT SHQIPTARË NGA MAQEDONIA, MALI I ZI, PRESHEVA, BUJANOVCI DHE MEDVEGJA, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015 – 2016

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 4, të nenit 33 dhe 34 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 - 2016",

URDHËROJ:

1. Shpërndarjen e kuotave të pranimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit, për secilin prej institucioneve publike të arsimit të lartë, për kandidatët nga Republika e Kosovës dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, sipas tabelës bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita

Nikolla

URDHËR

Nr. 295, datë 18.08.2015

PËR SHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË TRANSFERIMIT TË STUDIMEVE, SI DHE KUOTAT PËR PROGRAME TË DYTA STUDIMI, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE JOUNIVERSITARE PROFESIONALE DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, NË VITIN AKADEMIK 2015-2016

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 33, 35 dhe 36 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007,

"Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 638, datë

22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 - 2016",

URDHËROJ:

1. Shpërndarjen e kuotave të transferimit të studimeve, si dhe kuotave për programe të dyta studimi, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2015-2016, sipas tabelës bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Kanë të drejtë të aplikojnë për të përfituar kuota për transferim studimesh:

a) Të gjithë ata kandidatë të cilët nuk kanë qenë/janë objekt i udhëzimit nr. 33 datë 19.9.2014, "Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit, në institucionet e arsimit të lartë publik e privat, në vitin akademik 2014-2015, të studentëve që transferojnë studimet nga institucionet private të arsimit të lartë të cilëve u është hequr licenca", të ndryshuar;

b) Kandidatët të cilët kanë grumbulluar në programin e studimit që kanë ndjekur dhe nga ku duan të transferohen të paktën 30 kredite (ECTS), të njohura të vlefshme për programin e studimit ku do të transferohen;

c) Kandidatët që kanë ndjekur një program studimi në Republikën e Shqipërisë në një IAL publike ose që kanë ndjekur një program studimi të akredituar në një IAL private në momentin e aplikimit për transferim, si dhe kandidatët që kanë ndjekur një program studimi jashtë vendit, në një institucion të arsimit të lartë të akredituar në vendin e origjinës, si institucion dhe program studimi.

3. Kanë të drejtë të aplikojnë për të përfituar kuota për program të dytë studimi:

a) Kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të të njëjtit cikël dhe lloj (diplomë jouniversitare profesionale, "Bachelor", program të integruar të ciklit të dytë) me atë program ku po aplikojnë, në rastet kur kanë përfunduar studimet:

- në Republikën e Shqipërisë, në një IAL publike, ose në një IAL private, në një program studimi të akredituar përpara përfundimit të programit përkatës të studimit; - jashtë vendit dhe kanë kryer njohjen e diplomës në MAS.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

URDHËR

Nr. 298, datë 19.08.2015

PËR CAKTIMIN E DATËS SË FILLIMIT TË VITIT AKADEMIK 2015-2016 NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Viti akademik 2015-2016 në institucionet e arsimit të lartë, të fillojë në datën 12 tetor 2015 dhe të përfundojë në datën 30 shtator 2016.

2. Periudha 21 dhjetor 2015 deri në 3 janar 2015, të jetë periudhë pushimesh për studentët.

3. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit të kandidatëve fitues, të dërgojnë në të gjitha ndërmarrjet "Trajtimi i Studentëve" sh.a., listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Agjencia Kombëtare e Provimeve, ndërmarrjet "Trajtimi i Studentëve" sh.a. dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

URDHËR

Nr. 417, datë 02.11.2015

PËR SHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË TRANSFERIMIT TË STUDIMEVE NË PROGRAMET TË CIKLIT TË DYTË, TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I SHKENCAVE"/"MASTER I ARTEVE TË BUKURA NË VITIN AKADEMIK 2015-2016"

Në mbështetje te nenit 102 te Kushtetutes, të neneve 34,35 dhe 36 te ligjit m. 9741., datë 21,.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 135 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit te lartë në Republiken e Shqipërisë" dhe Vendimit ru.638, datë 22.07.2015, të Këshillit të Ministrave' "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike

te arsimit te lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015 - 2016” , i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Të shpërndahen sipas tabelave nr. 1 dhe m.2, bashkëlidhur këtij Urdhri, kuotat për transferimin e studimeve, si dhe kuotat për program të dytë studimi, në mbështetje te kërkesave të institucioneve publike të arsimit te lartë dhe pikes 1/1 Shtojcës 1./1 të Vendimit nr. 638, datë 22.07.201.5, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar.

2. Kanë të drejtë të aplikojnë për të përfituar kuota për transferim studimesh kandidatët që kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë, në Republikën e Shqipërise, në një IAL publike, ose që kanë ndjekur një program studimi të akredituar në nje IAL private, si dhe kandidatët që kanë ndjekur një program studimi jashtë vendit, dhe kanë njësuar diplomen përkatese në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

3. Kanë të drejtë te aplikojnë për të perfituar kuota për program të dytë studimi kandidatët që kanë përfunduar (diplomë universitare e ciklit të dytë “Master profesional” dhe “Master i shkencave” / “Master i arteve të bukura”)në të njejtin cikël dhe lloj me atë program studimi ku po aplikojnë:
- në Republiken e Shqipërisë, në një IAL publike, ose në një program studimi, të akredituar në IAL private, përpara perfundimit te programit perkatës të studim;

- jashtë vendit, dhe kanë njësuar diplomën përkatese në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

4. Nuk kanë të drejtë të aplikojnë, për të përfituar kuota për transferim studimesh dhe për program të dytë studimi, të gjithë ata kandidatë të cilët janë objekt i udhëzimit nr.33, datë19.09.2014 “Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit, në institucionet e arsimit të lartë publik e privat, në vitin akademik 2014-2015, të studentëve që transferojne studimet nga institucionet private të arsimit të lartë te cilëve u është hequr licenca”, i ndryshuar.

5. Ngarkohen për zbatimin e ketij urdhri, Sekretari i Përgjithshem, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

MINISTRI

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

MINISTRI

U R DH Ë R I P Ë R B A SH K Ë T

Nr. 54, Datë 30.01.2019

"PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE TË DETAJUARA MBI TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË"

Në mbështetje të pikës 4 të, nenit 102 të Kushtetutës dhe shkronjës "a", të pikës 2 të vendimit nr.781, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave "Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë", U R DH Ë R O J M Ë:

1. Miratimin e formatit dhe mënyrës së publikimit të të dhënave të detajuara, mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare të institucioneve publike të arsimit të lartë, mbi bazë mujore.

2. Formati i publikimit, i cili do të përmbajë të dhëna të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet e institucioneve publike të arsimit të lartë, kryhet sipas aneksit A, bashkëlidhur këtij Urdhri.

3. Brenda datës 15 të çdo muaji, raportimi financiar nga institucionet publike të arsimit të lartë sipas përcaktimeve të pikës 2 te ketij Urdhri, rakordohet me degën e thesarit përkatëse dhe publikohet në faqen zyrtare të IAL-së përkatëse.

4. Brenda datës 20 të çdo muaji, institucionet publike të arsimit të lartë përcjellin raportimin financiar sipas pikës 2 dhe 3 të këtij Urdhri, në format elektronik pranë Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, e cila e publikon në faqen e saj zyrtare.

5. Administratorët e institucioneve publike të arsimit të lartë, pasqyrojnë dhe përditësojnë sipas afateve të përcaktuara të dhënat sipas këtij udhëzimi edhe pranë Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, institucionet publike të arsimit të lartë dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në "Fletoren Zyrtare".

MINISTRI I ARSIMIT, **MINISTRI I FINANCAVE**

SPORTIT DHE RINISË **DHE EKONOMISË**

BESA SHAHINI **ANILA DENAJ**

MINISTRIA E ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

MINISTRIA E KULTURËS
MINISTRI

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 418 datë 30.7.2019

PËR PËRCAKTIMIN E SHËRBIMEVE TË OFRUARA ME ÇMIME TË REDUKTUARA PËRMES PËRDORIMIT TË KARTËS SË STUDENTIT NË FUSHËN E ARTIT DHE KULTURËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 2, të vendimit nr. 226, datë 17.4.2019 të Këshillit të Ministrave "Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetëror edhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit",

URDHËROJMË:

1. Përfituesit e kartës së studentit përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara në masën pesëdhjetë për qind (50%), në sistemin tarifor për aksesin në fushën e institucioneve të artit dhe kulturës sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Përfituesit e kartës së studentit përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara në masën shtatëdhjetë për qind (70%) në sistemin tarifor për aksesin në muze publikë në varësi të Ministrisë
përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, parqet kombëtare arkeologjike dhe monumentet e
kulturës sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Shërbimet e ofruara nga institucionet e trashëgimisë kulturore për aksesin në muze publikë në varësi të Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, parqet kombëtare arkeologjike dhe
monumentet e kulturës, për studentët të organizuar në ekspedita mësimore dhe leksione të hapura, janë
me tarifë zero.
4. Shërbimet e ofruara në kuadër të edukimit artistik përmes artit, kulturës dhe turizmit kulturor
në skena dhe ambiente të hapura, nga institucionet e artit dhe trashëgimisë kulturore janë me tarifë
zero.
5. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxheti i Ministrisë së Kulturës.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit,

Sportit dhe Rinisë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Kulturës dhe institucionet publike të artit dhe kulturës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË **MINISTËR I KULTURËS**

Besa Shahini **Elva Margariti**

LIDHJA NR.1

1. Shfaqje me çmime të reduktuara në masën pesëdhjetë për qind (50%) në sistemin tarifor të biletave në institucionet të artit si vijon:

a) Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor;
b) Teatri Kombëtar;
c) Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli";
d) Cirku Kombëtar;
e) Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmije dhe Teatri i Kukullave.

12. Fotokopje dhe skanime në masën pesëdhjetë për qind (50%) të tarifave të miratuara në Bibliotekën Kombëtare.

3. Temat studimore, në masën pesëdhjetë për qind (50%) të tarifave të miratuara në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit.

LIDHJA NR.2

1. Vizita me çmime të reduktuara në masën shtatëdhjetë për qind (70%) në sistemin tarifor të biletave në muze publikë, parqet kombëtare arkeologjike dhe monumentet e kulturës si vijon:

a) Muzeu Historik Kombëtar;b) Galeria Kombëtare e Arteve;
c) Qendra Muzeore Krujë "Muzeu Kombëtar Skënderbeu, Muzeu Etnografik Krujë";
d) Qendra Muzeore Berat "uzeu i Ikonografisë Onufri, Muzeu Etnografik Berat";
e) Qendra Muzeore Durrës"Muzeu Kombëtar Arkeologjik, Parku Arkeologjik";
f) Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar Korçë, Muzeu Arkeologjik, Korçë, Muzeu i Arsimit, Korçë;
g) Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me gjethe
h) Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi, Shkodër;
i) Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, Vlorë;
j) Parku Kombëtar Arkeologjik, Apoloni;
k) Parku Kombëtar Arkeologjik, Bylis;
l) Parku Kombëtar i Butrintit;
m) Parku Kombëtar Arkeologjik , Kalaja Shkodër;
n) Parku Kombëtar Arkeologjik, Amantia;
o) Parku Kombëtar Arkeologjik, Orikum;
p) Parku Kombëtar Arkeologjik, Finiq;
q) Parku Kombëtar Arkeologjik, Antigone;
r) Kalaja Berat;
s) Kalaja Gjirokastër;
t) Kalaja Lezhë;
u) Kala Porto-Palermo;

v) Kalaja e Kaninës;
ë) Kalaja e Himarës;
x) Manastiri i 40 Shenjtorëve;
y) Manastiri i Mesopotamit.

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 440, datë 11.09. 2019

"PËR

PËRCAKTIMIN E SHËRBIMEVE TË OFRUARA ME ÇMIME TË REDUKTUARA PËRMES PËRDORIMIT TË KARTËS SË STUDENTIT NË FUSHËN E TURIZMIT DHE MJEDISIT"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 2, të Vendimit nr. 226, datë 17.04.2019 të Këshillit të Ministrave "*Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetëror edhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit*",

URDHËROJMË:

1. Miratimin e shërbimit me tarifë zero për hyrjen e studentëve, në zonat e përcaktuara sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxheti i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MINISTRI I ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË

Blendi KLOSI **Besa SHAHINI**

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 1242, datë 14.8.2019

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SHËRBIMEVE QË DO TË OFROHEN NGA STRUKTURAT VARTËSE TË MINISTRISË SË MBROJTJES, ME ÇMIME TË REDUKTUARA PËRMES PËRDORIMIT TË KARTËS SË STUDENTIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të pikës 2, të vendimit nr. 226, datë 17.4.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekteve të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit",

URDHËROJMË:

1. Miratimin e listës së shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara për studentët, sipas lidhjes nr. 1: "Lista me shërbimet e reduktuara që ofron Instituti i Gjeografisë dhe i Infrastrukturës Ushtarake për studentët", që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I MBROJTJES
Olta Xhaçka

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

Lidhja nr.1

LISTA ME SHËRBIMET DHE ÇMIMET E REDUKTUARA QË OFRON INSTITUTI I GJEOGRAFISË DHE I INFRASTRUKTURËS USHTARAKE PËR STUDENTËT

Nr.	**Emërtimi i produktit**	**Njësia e matjes**	**Çmimi i përdorur (lekë)**	**Çmimi i reduktuar për studentët (lekë)**

1	Hartë Topografike shk.1:10.000	fletë	800	400
2	Hartë Topografike shk.1:25.000	fletë	650	300
3	Hartë Topografike shk.1:50.000	fletë	600	300
4	Hartë Topografike shk.1:100.000	fletë	500	250
5	Hartë Topografike shk.1:200.000	fletë	400	200
6	Hartë Topografike shk.1:500.000	fletë	300	150
7	Hartë Rrugore Shqipëria shk.1:400.000 (një fletë harte)	fletë	950	500
8	Hartë Rrugore Shqipëria shk.1:200.000 (një fletë harte)	fletë	400	200
9	Hartë Rrugore e plotë Shqipëria shk.1:200.000 (3 fletë harte)	fletë	1200	600
10	Hartë Tirana shk.1:12.5000	fletë	600	300
11	Hartë e Metropolit shk.1:75.00	fletë	600	300
12	Hartë detare, Gjiri i Durrësit	fletë	600	300
13	Hartë detare, Gjiri i Vlorës	fletë	1000	500

14	Hartë detare, Spille-Radhimë	fletë	1100	550
15	Skanim dhe pllotim hartë pavarësisht vitit të prodhimit	fletë	1200	600
16	Skanim dhe printim të fotografive ajrore të vjetra të bëra me aparatin në distancë fokale 70 mm	fletë	670	350
17	Skanim dhe printim të fotografive ajrore të bëra pas viteve ‘90	fletë	800	400
18	Pika të triangulacionit dhe nivelacionit shtetërore	pika	1500	750

LIDHJA NR.1

1. Shërbimi i hyrjes me tarifë zero për hyrjen e studentëve në zonat si më poshtë:
   a) Parku Kombëtar Mali i Dajtit (hyrja me postbllok)
   b) Monumenti Natyror Syri i Kaltër;
   c) Parku natyror Kune-Vain-Tale.

URDHËR NR.293, DATË 29.09.2020

PËR CAKTIMIN E DATËS SË FILLIMIT TË VITIT AKADEMIK 2020-2021 NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 1 të nenit 87 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Viti akademik 2020 - 2021 në institucionet e arsimit të lartë fillon në datën 2 nëntor 2020.

2. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit të kandidatëve fitues, të dërgojnë në të gjitha ndërmarrjet "Trajtimi i Studentëve" sh.a., listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI

URDHËR

Nr. 219, datë 16.7.2021

PËR MBYLLJEN E DEGËS "EPITECH ALBANIA", SI NJËSI BAZË E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË TË HUAJ "*ECOLE POUR L'INFORMATIQUE ET LES NOUVELLE TECHNOLOGIES* (*EPITECH*)"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; germave "a" dhe "ç", nënpika "i", të pikës 6, të vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre",

URDHËROJ:

1. Mbylljen e degës "Epitech Albania", si njësi bazë "Ekspert i Teknologjisë së Informacionit", i njësisë kryesore "Ekspert i Teknologjisë së Informacionit" të institucionit të arsimit të lartë të huaj "Ecole pour l'Informatique et les Nouvelle Technologies (EPITECH)" dhe ndërprerjen e veprimtarisë së saj akademike.

2. Personi juridik, qendra "Epitech Albania", regjistruar me vendimin nr. 1101, datë 9.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, "Për regjistrimin si person juridik", ka këto detyrime:

a) të mbyllë të gjitha detyrimet lidhur me veprimtarinë akademike për vitin akademik 2020–2021, në të dy programet e studimit të ofruara prej saj "Bachelor", në "Teknologji Informacioni" dhe "Master i Shkencave" në "Ekspert i Teknologjisë së informacionit";

b) të përgatitë dosjen për çdo student të pa diplomuar, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit të lartë për vazhdimin e studimeve dhe t'ia vendosë atë në dispozicion vetë studentit, pa asnjë detyrim financiar shtesë nga ana e tij, brenda datës 31 gusht 2021;

d) të vendosë në dispozicion të ministrisë përgjegjëse për arsimin çdo informacion të kërkuar dhe të vazhdojnë të mbajnë kontakte me MASR-në, deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

e) të kthejë pagesat e kryera nga studentët për pjesën e papërfunduar të programeve përkatëse të studimit, për rastet kur pagesat janë kryer, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbushur që mund të ketë ndaj studentëve.

3. Personi juridik, qendra "Epitech Albania", nuk duhet të kryejë asnjë lloj veprimi financiar apo lëvizje në llogaritë bankare, përveç atyre që kanë lidhje me sa parashikohet në shkronjën "e", të pikës 2, të këtij urdhri. Personi juridik privat, që përfaqëson degën "Epitech Albania", nuk mund të kryejë asnjë lloj ndryshimi të aksioneve apo kuotave të qendrës, aseteve të luajtshme e të paluajtshme të saj, para shlyerjes së detyrimeve të parashikuara në këtë urdhër.

4. Të gjitha shpenzimet për likuidimin e studentëve dhe kryerjen e procedurave për ta, në zbatim të këtij urdhri, të përballohen nga personi juridik, qendra "Epitech Albania".

5. Personi juridik, qendra "Epitech Albania", duhet të marrë masa që të ketë në dispozicion staf administrativ dhe personel akademik të nevojshëm deri në mbylljen dhe përfundimin e procesit, sipas afateve të përcaktuara në këtë urdhër.

6. Personi juridik, qendra "Epitech Albania", të arkivojë menjëherë të gjithë dokumentacionin ligjor të degës "Epitech Albania", sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat".

7. Për personin juridik privat, qendra "Epitech Albania", administrator i degës "Epitech Albania", mund të aplikohen masa të tjera, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në rast të moszbatimit të këtij urdhri.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar dhe personi juridik qendra "Epitech Albania".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT

DHE RINISË

Evis Kushi

URDHËR
Nr. 275, datë 19.5.2022

PËR PEZULLIMIN E VEPRIMTARISË SË KOLEGJIT UNIVERSITAR "PAVARËSIA", VLORË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të shkronjës "k", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Pezullimin e veprimtarisë së Kolegjit Universitar "Pavarësia", Vlorë, për një afat maksimal dyvjeçar, duke filluar nga viti akademik 2022–2023 e në vijim, deri në plotësimin e kushteve, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Pezullimi i veprimtarisë së Kolegjit Universitar "Pavarësia", Vlorë, konsiston në detyrimin që të mos regjistrojë studentë të rinj në asnjë nga programet e studimit që ofron, përfshirë studentë në vitin e parë, në vite të ndërmjetme apo dhe transferime, për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së pezullimit të veprimtarisë.
3. Kolegji Universitar "Pavarësia", Vlorë, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, duhet të dorëzojë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, planin e masave për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ministria e Arsimit dhe Sportit, në rast të mospërmbushjes të kushteve të vendosura në shtojcën nr. 1 të këtij urdhri, i propozon Këshillit të Ministrave mbylljen e veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Kolegji Universitar "Pavarësia", Vlorë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

SHTOJCA 1

1. Kolegji Universitar "Pavarësia", Vlorë, të ndjekë procedurat ligjore pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për akreditimin e institucionit.
2. Kolegji Universitar "Pavarësia", Vlorë, të ndjekë procedurat ligjore pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për akreditimin e programeve të studimit.
3. Kolegji Universitar "Pavarësia", Vlorë, të marrë masa për plotësimin e kapaciteteve akademike, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe të përmbushë detyrimet ligjore mbi deklarimin e personelit akademik, pranë institucioneve përgjegjëse për tatimet dhe sigurimet shoqërore.
4. Kolegji Universitar "Pavarësia", Vlorë, të marrë masa për pajisjen me regjistrat themeltarë të studentëve, të arritjeve akademike dhe të lëshimit të diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Kolegji Universitar "Pavarësia", Vlorë, të ndjekë procedurat për pajisjen e studentëve me numra matrikullimi, sipas kuadrit ligjor në fuqi.